NGA KOLEKSIONI I

RISALE-I NURIT

SHUAAT

RREZET

AUTOR

BEDIUZZAMAN

SAID NURSI

PARATHËNIE

Kush është
Bediuzzaman SAID NURSI
dhe ç'është vepra e tij
"RISALE-I NUR"?

Bediuzzaman Said Nursi u lind në Turqinë Lindore më 1876 dhe ndërroi jetë në 1960 në moshën tetëdhjetë e trevjeçare, pas një jete e një lufte vetmohuese e shembullore për çështjen e Islamit.

Ai qe shkollar i një rangu shumë të lartë, sepse nuk pati studiuar vetëm shkencat tradicionale, por edhe ato moderne. Si rezultat i studimit dhe i aftësive të tij të rralla, që në rini pati fituar epitetin **"Bediuzzaman**" *(Mrekullia e kohës), epitet të cilin ia dhanë dijetarët më të shquar.*

Jeta individuale e Bediuzzamanit kapi dekadat e fundit të kalifatit dhe të Shtetit Osman, të rrëzimit dhe copëtimit të tij pas Luftës së Parë Botërore dhe, pas formimit të Republikës më 1923, përjetoi tridhjetë e shtatë vjetorin e Republikës, vite këto deri më 1950 të njohura për shtypjen antiislame të qeverisë dhe për represionin kundër drejtësisë fetare.

Pas Luftës së Parë Botërore, përpjekjet e Bediuzzamanit në rrugën e Islamit qenë shumë të mëdha. Ai, jo vetëm që u jepte mësim studentëve të tij dhe hynte në debate e diskutime me shkollarë e drejtues nga të gjitha anët e botës islame, por edhe komandoi e drejtoi për afro dy vjet një regjiment vullnetarësh kundër pushtimit rus në Turqinë Lindore në vitin 1914 derisa ra në burg. Gjer në atë kohë, ai kishte kërkuar e studiuar në detaje problemet e Islamit, duke marrë pjesë aktivisht në jetën publike. Sidoqoftë, vitet që panë tranzicionin nga Kalifati në Republikë, panë gjithashtu edhe tranzicionin nga "Saidi

i Vjetër në Saidin e Ri". Saidi i Ri u karakterizua nga një tërheqje të tij prej jetës publike dhe u përqëndrua në studim, në adhurim e mendim, sepse ajo që kërkohej tani ishte një luftë e një natyre tjetër.

Pas një periudhe afro dyvjeçare, më 1925, Bediuzzamanani u detyrua të mërgojë në Anadollin Perëndimor dhe 28 vjet me radhë, deri në prag të dhjetëvjeçarit të fundit të jetës së tij, ai vuajti mërgimin, burgimin, ngacmimin dhe persekutimin prej autoriteteve.

Gjatë viteve në mërgim e izolim vendosi të shkruante **"Risale-i Nur"** *(Mesazhet e Dritës)* dhe përhapjen e tij anembanë Turqisë.

Vetë Bediuzzmani në ligjëratë të drejtë u shpreh: *"Tani unë e shoh qartë se pjesa më e madhe e jetës sime është komanduar e drejtuar jashtë aftësisë së perceptimit tim që do të nxirrte këto mesazhe për t'i shërbyer çështjes së Kur'anit. Sikur e gjithë jeta ime si shkollar të kishte kaluar në parapërgatitjen për këto shkrime, të cilat demonstrojnë mrekullinë e Kur'anit".*

Bediuzzamani e kuptoi çështjen esenciale të rënies së botës islamike, e cila u dobësua pikërisht në themelin e besimit. Ky dobësim i shoqëruar me sulmet e pashembullta kundër atyre themeleve në shekujt e XIX-të dhe XX-të, të ndërmarra nga materialistët, ateistët e të tjerët në emër të shkencës e të progresit, e bënë atë që të kuptonte nevojën urgjente dhe themelore, e cila ishte ruajtja dhe forcimi i besimit. Kërkohej të harxhoheshin të gjitha përpjekjet për të rindëruar godinën e Islamit nga themelet e saja, duke filluar nga **besimi** dhe t'u përgjigjej po me atë gjuhë atyre sulmeve, me një xhihad ma'nevij, ose me *"Xhihadin e fjalës".*

Kështu, në mërgim, Bediuzzamani shkroi një mori veprash të titulluara **"Risale-i Nur"** *("Mesazhet e dritës")*, të cilat do t'i shpjegonin dhe paraqisnin njeriut modern parimet bazë të besimit dhe të vërtetat e Kur'anit. Metoda e tij analizon besimin e mosbesimin dhe demonstron, përmes argumenteve të qarta logjike, se, duke ndjekur metodën e Kur'anit, jo vetëm që është e mundur t'i provosh në mënyrë të arsyeshme të gjitha të vërtetat e besimit, si: ekzistencën e Zotit të Lartësuar, Njësinë e Tij, profetësinë dhe ringjalljen e qënieve të gjalla, por gjithashtu se këto të vërteta kanë të vetmin *shpjegim racional për ekzistencën*, për njeriun dhe universin.

Kështu, Bediuzzamani i demonstroi të vërtetat e fesë më së miri, në formën më të lehtë të të kuptuarit, nëpërmjet krahasimeve, shpjegimeve dhe provave të arsyeshme, të cilat janë të papajtueshme

me interpretimet materialiste për ato zbulime moderne, duke i cilësuar ato interpretime materialiste joracionale dhe absurde.

Në të vërtetë Bediuzzamani, me veprat e tij, provoi se zbulimet mahnitëse të shkencës, lidhur me universin, vërtetojnë e përforcojnë të vërtetat e fesë.

Rëndësia e **"Risale-i Nurit"** nuk mund të çmohet, sepse nëpërmjet kësaj vepre, Bediuzzaman Said Nursi luajti një rol të madh në ruajtjen dhe rigjallërimin e besimit islam në Turqi, pikërisht në ditët shumë të errëta të historisë dhe, në të vërtetë, roli dhe rëndësia e kësaj vepre vazhdon të rritet edhe në ditët e sotme anembane botës. Për më tepër **"Risale-i Nuri"**, veçanërisht, është i përshtatshëm t'u drejtohet jo vetëm muslimanëve, por gjithë njerëzimit për disa arsye:

Së pari: Sepse është shkruar në harmoni me mentalitetin e njeriut modern, qoftë musliman ose jo, i cili ka qenë mbushur e frymëzuar thellë nga filozofia materialiste.

Së dyti: **"Risale-i Nuri",** në mënyrë specifike, u përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe dyshimeve që shkakton kjo filozofi; u përgjigjet të gjitha "pse-ve" që arrin të ketë mendja e shëndoshë e njeriut modern. Gjithashtu **"Risale-i Nuri"** shpjegon çështjet e thella të besimit, të cilat më parë vetëm shkollarët e përparuar i studiuan në detaje, në atë mënyrë që çdo njeri, madje dhe ai për të cilin subjekti është i ri, mund të kuptojë, të fitojë diçka pa patur ndonjë vështirësi a shqetësim.

Një arsye tjetër është se duke shpjeguar natyrën e vërtetë të universit dhe qëllimin e njeriut, **"Risale-i Nuri"** tregon se lumturia, në këtë botë dhe në tjetrën, arrihet vetëm nëpërmjet besimit dhe njohjes së Zotit të Lartësuar.

"Risale-i Nuri" gjithashtu tregon dhimbjen e rëndë dhe mjerimin që i shkakton mosbesimi shpirtit dhe ndërgjegjjes së njeriut; dhe se njerëzit të cilët kanë humbur udhën e drejtë përgjithësisht përpiqen t'i shmangin të tjerët duke i bërë të shkujdesur dhe duke i shkëputur nga realiteti. Kështu, duke lexuar këtë vepër, çdo njeri mund të kërkojë strehë në besim.

Bediuzzamani, nëpërmjet **"Risale-i Nuri"** na udhëzon për tek konceptimi i drejtë i Kur'anit dhe i Sunnetit të pastër profetik. Ai na paralajmëron për rrezikun e rënies në bidate, risi, në ekstreme dhe në greminat e çudhëzimit, që rreziqe të tilla janë të shumta në këtë kohë. Ai jep shpjegime të shumta të hollësishme si tek shembulli i trajtesës së *"Ixhtihadit"* e cila është Fjala e Njëzet e Shtatë tek koleksioni i Fjalëve, ku në atë trajtesë theksohet domosdoshmëria e ndjekjes së

njërës nga katër shkollat e sheriatit Islam –***Katër medh'hebët***– të cilat përfaqësojnë mendimet e sakta të dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sunnetit vel-Xhemaah.

Gjithashtu në Shkreptimën e Katërt të *"Koleksionit të Shkreptimave"* dhe në *"Shkreptimën e Njëmbëdhjetë,"* Bediuzzamani bën një shtjellim të detajuar tek trajtesa *"Rruga e Praktikave të Profetit Muhammed A.S.M. dhe Kundërhelmi ndaj sëmundjes së bidatit"* duke treguar në të domosdoshmërinë e ndjekjes së Sunnetit Profetik si dhe duke paralajmëruar për rreziqet e rënies në kthetrat e sekteve devijuese, në kurthet e lëvizjeve negative që synojnë të realizojnë qëllime të mbrapshta të kësaj dynjaje duke shfrytëzuar fenë dhe paralajmëron për rrezikun e rënies në grackat e grupeve heretike. Gjithashtu, nëpërmjet dhjetëra trajtesave të ndryshme të **"Risale-i Nurit"**, Bediuzzamani ndriçon për ne në mënyra të ndryshme botëkuptimin e drejtë të Ehli Sunnetit vel-xhemaah, të cilët janë njerëzit e së vërtetës, duke ua mundësuar kështu besimtarëve të të gjitha niveleve në këtë kohë të trazuar të ecin në rrugën e drejtë të Kur'anit e të Sunnetit me një bindje të plotë e të sigurtë dhe duke i shpëtuar ata përfundimisht nga ekstremet.

Kështu, Fjalët e shkruara rreth mistereve të Kur'anit janë ilaçi më i efektshëm dhe balsami më i mirë për plagët e kësaj kohe; janë drita më e dobishme për tërësinë e Islamit i cili është zbuluar para sulmeve të errësirës, dhe janë udhëzuesi më i vërtetë për ata që bredhin të hutuar e të çoroditur në luginat e çudhëzimit. Koleksioni i Fjalëve në këtë kohë, të cilat janë shkreptimat e mrekullisë së Kur'anit, janë si një kundërhelm ndaj çudhëzimit ateist. Atëherë nuk do të ishte e perceptueshme të qëndrosh indiferent ndaj kësaj vepre brilante, **"Risale-i Nurit"**.

Përfundim:

Kur'ani i Shenjtë i drejtohet inteligjencës dhe njeriut të të gjitha niveleve. Ai i kërkon njeriut që ta njohë universin, funksionin e tij, të mësojë për natyrën e vërtetë dhe për qëllimet e krijimit; të mësojë Atributet e Krijuesit të Vetëm dhe detyrat e tij si një krijesë. Kjo është Pikërisht metoda që tregon Bediuzzamani nëpërmjet argumenteve të qarta, se kur kur'ani lexohet në këtë mënyrë, të gjitha bazat e besimit mund të provohen racionalisht.

Kur ndiqet kjo metodë, personi arrin një besim të vërtetë që do të ishte mjaftë i fortë e i qëndrueshëm për t'i bërë ballë çdo dyshimi që

buron nga “fytyra” e sulmeve të holla të materialistëve, natyralistëve dhe ateistëve.

Nevoja kryesore e njeriut është nevoja për fe, nevoja për ta njohur e adhuruar Zotin e Plotëfuqishëm me të gjitha Atributet dhe Emrat e Tij të Bukur, është nevoja për t’iu bindur ligjeve të Tij, atyre të manifestuara në univers dhe atyre që u zbuluan nëpërmjet Profetëve të Tij; të pranojë mesazhin e Kur’anit, e librit të fundit të shpallur, i cili u shpjegua nga Profeti i fundit, Muhammedi A.S.M. *(paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të)* dhe të pranojë se Islami është feja e plotësuar e njerëzimit.

Në **“Risale-i Nur”** Bediuzzamani demonstron se nuk ka kundërthënie apo ndarje ndërmjet shkencës e fesë dhe, përparimi i vërtetë e lumturia për njeriun mund të arrihet vetëm në këtë rrugë, në rrugën e Kur’anit.

RREZJA E DYTË

Fruti i fundit i burgut të Eskishehirit

Rrezja e Dytë e Shkreptimës së Tridhjet e Njëtë.

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Kjo rreze u shkrua para gjashtëmbëdhjetë vitesh në një kohë kur qëndroja i vetmuar në burgun e Eskishehirit pasi shokët e mi ishin liruar. Ajo u shkrua me një shpejtësi të madhe me penën time të mangët në një kohë pikëlluese, të vështirë e të pakëndshme dhe prandaj kësaj i mungon diçka rregulli. Dhe në këto ditë -domethënë pas gjashtëmbëdhjetë vitesh- unë fillova ta korrigjoja dhe e gjeta tej mase të vlefshme, të fuqishme dhe të rëndësishme lidhur me besimin dhe me vërtetimin e Unitetit Hyjnor.

Said Nursi

[Kjo formon një 'Pikë' të shtatë rreth Gjashtë Emrave më të mëdhenj dhe është rreth Emrit më të madh ***All-llahu Ehad***, *Allahu, (është) Një i Vetëm.*]

Shënim

Në shikimin tim, kjo trajtesë është shumë e rëndësishme, sepse misteret kuptimplota e të holla të besimit që ajo i përmban, zbulohen dhe zhvillohen në të. Ai që e lexon dhe e kupton këtë trajtesë do ta shpëtojë besimin e tij, në dashtë Zoti xh.sh.. Për fat të keq, unë nuk kam qenë në gjendje të takohem me ndonjë këtu dhe kam qenë i pamundur të shkruaj vetë një kopje të pastër.

Në qoftë se dëshiron ta kuptosh vlerën e trajtesës, lexo së pari Frutet e dytë dhe të tretë që ndodhen tek fillimi i trajtesës, pastaj lexoje me kujdes konkluzionin në fund dhe çështjen në dy faqet që e paraprijnë atë, dhe atëherë studioje avash plotësisht trajtesën!

E Shtata e Gjashtë Pikave rreth Gjashtë Emrave më të mëdhenj, rreth "*All-llahu Ehad*"

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Dhe prej Tij ne kërkojmë ndihmë.

I inspiruar nga një kuptim madhështor i vërsetit,

"*Dije pra se, padyshim nuk ka Zot tjetër përveç Allahut"*,[1] dhe nga një betim i njohur i profetit Muhammed a.s.m., kjo trajtesë përbëhet nga një pikë e hollë që unë i kapa -i ndjeva- rreth tre fruteve të bukur, të ëmbël e të hollë të vërtetimit të Unitetit Hyjnor, dhe tre çështje duke e bërë të domosdoshme atë si dhe prova të tij.

Po, betimi që përdorej më shpesh nga profeti Muhammed a.s.m. ishte ky betim: "*Betohem në Atë që në Dorën e të Cilit është qënia e Muhammedit a.s.m..."*[2] Ky betim madhështor i Muhammedit a.s.m. tregon se edhe sfera më e gjërë prej sferave të pemës së universit, maja më e skajshme e saj dhe dega më e largët e degëve të saj, ekzistojnë gjithashtu nëpërmjet fuqisë dhe dëshirës së Krijuesit të Vetëm të Unitetit; sepse në qoftë se edhe më i miri i krijesave dhe më i nderuari që është Muhammedi a.s.m., nuk e ka në dorë veten e tij, nuk është pronar i vetvetes, dhe nuk është i lirë në veprat e tij; madje aktet e tij, lëvizjet dhe qëndrimet e tij janë të lidhura me një Dëshirë të Gjithanshme të Pafundme dhe me zgjedhjen e Tij xh.sh., atëherë nuk ndodhet absolutisht ndonjë gjë në ekzistencë, as funksion, as gjendje apo rrethanë, qoftë e pjesshme apo universale, që të mund të jetë jashtë sferës së asaj fuqie madhështore e Gjithëpërfshirëse për gjithçka, dhe as jashtë asaj Dëshire të gjithanshme e cila përfshin çdo gjë.

Po, ky betim domethënës i Muhammedit a.s.m. e tregon dhe e shpreh Unitetin Madhështor e gjithëpërfshirës së Hyjnisë në mënyrën më madhështore.

Meqenëse njëqind apo ndoshta një mijë prova të qarta të këtij Uniteti Hyjnor janë shtjelluar e shpjeguar në koleksionin e ***Siraxhun-Nur***[3] *-llamba Ndriçuese-* që përfshihet brenda koleksionit të Risale-i Nurit, ne ia referojmë asaj detajet dhe provat e kësaj të vërtete të lartësuar. Në këtë Rrezen e Dytë, në të parën e Tre 'Stacioneve' të shkurtër të përfshira në këtë të vërtetë madhështore të besimit, do të shpjegohen në mënyrë të përmbledhur tre fruta të hollë, të ëmbël, të vlefshëm, të ndritshëm e universalë prej frutave të panumërt, me anë të të cilëve do të aludojmë për intuitat dhe eksperiencat që e shtyjnë zemrën time për tek ato fruta.

---

[1] Kur'an, 47:19

[2] Transmeton Ibn Maxheh, dhe Ahmedi në Musnedin e tij.

[3] Një koleksion nga Risale-i Nuri që përbëhet nga një dua, trajtesa për të sëmurët, trajtesa për të moshuarit, shkreptima e trembëdhjetë, Tridhjetë e tre dritaret, një dua në arabisht dhe fjalimet mbrojtëse të Ustadhit në Gjykatën e Denizlit. Përkthyesi

Në Stacionin e Dytë, do të shpjegohen tre çështje universale dhe motive detyruese duke e bërë të domosdoshme këtë të vërtetë të shenjtë dhe, të cilat kanë fuqinë e tre mijë çështjeve të tilla.

Në Stacionin e Tretë do të përmenden tre shenja duke treguar këtë të vërtetë të Unitetit Hyjnor, të cilat kanë fuqinë e treqind shenjave, treguesve dhe provave të tilla.

Fruti i Parë i Stacionit të Parë

Bukuria Hyjnore dhe Përplotësia Hyjnore bëhen të dukshme në Unitetin Hyjnor dhe në vërtetimin e tij. Në qoftë se nuk do të kishte pasur unitet, ai thesar i parapërjetshëm do të kishte mbetur i fshehur.

Po, bukuria Hyjnore dhe Plotësia e Tij e pakufishme; përsosuria Hyjnore e pafundme dhe Hijeshia; dhe mirësitë e pallogaritshme dhe dhuratat e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm dhe bukuria dhe plotësimi i përkryer i të kërkuarit përjetësisht, që të gjitha këto shihen në pasqyrën e Unitetit, nëpërmjet unitetit dhe dritës së manifestimeve të Emrave të bukur Hyjnorë të përqëndruar në fytyrat e të pjesshmeve që ndodhen tek largësitë më të skajshme të pemës së krijimit.

Për shembull, dërgimi i qumështit të pastër të bardhë e të shijshëm për foshnjën e vogël që thith gjirin, i cili nuk ka forcë apo fuqi, nga një vend i paparashikuar, domethënë, prej ndërmjet gjakut dhe jashtëqitjes, është një akt i pjesshëm. Kur ky akt i pjesshëm shikohet nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor, shfaqet qartë bukuria e përjetshme e mëshirës së të Gjithëmëshirshmit me të gjithë shkëlqimin dhe madhështinë e saj, nëpërmjet furnizimit dhe mbajtjes me ushqim në mënyrë të mrekullueshme e të butë të gjithë të vegjëlit në botë dhe nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre me dhembshurinë e butësinë më të madhe duke ua nënshtruar atyre nënat e tyre. Por ky akt, akti i dërgimit të qumështit, në qoftë se nuk do të shikohej nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor, do të fshihej tërësisht ajo bukuri vezulluese dhe nuk do të dukej fare, dhe ai akt i pjesshëm i furnizimit me rizk do t'u referohej gjithashtu shkaqeve, rastësisë dhe natyrës, duke humbur kështu të gjithë vlerën e tij dhe madje do të humbiste natyrën e tij, nëpërmjet transformimit të saj.

Gjithashtu, për shembull, në qoftë se shërimi prej një sëmundjeje të tmerrshme do të shikohej nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor nëpërmjet shfaqjes plotësisht të bukurisë së dhembshurisë së Mëshirëplotit të Vetëm në fytyrën e dhuratës së shërimit për të gjithë të sëmurët që janë shtruar në spitalin gjigant të quajtur toka, nëpërmjet

ilaçeve, barnave dhe mjekimeve prej farmacisë së madhe të quajtur bota, dhembshuria e bukur e Mëshirëplotit Absolut dhe aktet e mëshirës së tij bëhen të dukshme në mënyrë universale e madhështore. Në qoftë se nuk do të shikohej nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor, ai akt i pjesshëm, por i ditur, i perceptueshëm dhe i vetëdijshëm i dhuratës së shërimit, do t'u atribuohej veçorive të ilaçeve të pajeta, forcës së verbër dhe Natyrës së pavetëdijshme, atëherë natyra e asaj dhurate mëshireje do të ndryshonte plotësisht dhe do të humbiste urtësinë dhe vlerën e saj.

Unë do të shpjegoj këtu, për shkak të lidhjes së saj, një pikë të hollë që më erdhi në zemër, prej pikave të salevateve mbi profetin Muhammed a.s.m.. Kjo ka të bëjë me salevatin e mirënjohur që recitohet rregullisht nga ndjekësit e medhhebit *Shafii* në fund të tesbihatit që ndjekin pesë faljet e detyruara të përditshme.. *"O Allah! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit a.s.m. dhe familjes së tij aq sa numri i sëmundjeve dhe i ilaçeve të tyre, dhe bekoje atë dhe ata dhe jepu paqe të pafundme."*

Këto salevate janë shumë të rëndësishme, sepse urtësia e krijimit të njeriut dhe misteri i gjithëpërfshirjes së aftësive të tij, është që ai të kërkojë strehim tek Krijuesi i tij Gjithëbujar, t'i lutet e t'i përgjërohet Atij dhe të bëjë falënderime e lavdërime për Të në çdo kohë, madje në çdo minut e çast. Motivi më i fuqishëm shtytës dhe shtytësi më i efektshëm që e nxit njeriun për të kërkuar strehim tek Prania Hyjnore janë sëmundjet dhe lëngimet, ashtu siç janë llojet e shërimit, të kurimeve dhe të shëndetit të mirë ato që, me në krye mirësitë e ëmbla dhe favoret e mira, e shtyjnë njeriun për t'i bërë falënderime Allahut me mallëngjim të plotë dhe e nxisin atë për të bërë lavdërime e për të qenë mirënjohës ndaj Krijuesit me të gjithë kuptimet e tyre. Dhe për këtë arsye, këto salevate të bekuara për profetin a.s.m. u bënë shumë domethënëse, të vlefshme, të larta e të thella.

Ndonjëherë kur recitoja frazën: "*sa numri i të gjitha sëmundjeve dhe ilaçeve të tyre*", unë e shihja tokën në formën e një spitali dhe ndjeja me qartësi të plotë ekzistencën e Shëruesit të Vërtetë, mëshirën dhe dhembshurinë e Tij të plotë, i Cili i siguron ilaçet për të gjitha sëmundjet, fizike e shpirtërore, u përgjigjet të gjitha nevojave në të gjitha anët e tokës dhe vështroja zemërbutësinë e Tij universale dhe dhembshurinë e Tij të shenjtë gjithëpërfshirëse.

Gjithashtu, për shembull, në qoftë se dhurata e udhëzimit dhe e besimit mbi dikë që vuan e përjeton dhimbje të tmerrshme të çudhëzimit do të shihej nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor, atëherë

bukuria e parapërjetshme e Atij Gjithëbujari Absolut dhe e Mirëbërësit Absolut bëhet e dukshme në fytyrën e asaj dhurate më të lartë, gjë e cila e transformon njeriun e vetëm, të pafuqishëm e të përkohshëm në një rob të adresuar të të Adhuruarit të tij Madhështor, të Sulltanit të Universit dhe Zotit të të gjitha botëve, dhe i jep atij nëpërmjet atij besimi një lumturi të përjetshme dhe një pronë të përhershme të bukur shumë të gjërë e të këndshme dhe një banesë të amshuar, madje i bën të gjithë besimtarët -secilin sipas shkallës së tij- që ta arrijnë atë mirësi të përgjithshme dhe atë bujari të vazhdueshme.. Dhe kështu, ai e shikon në fytyrën e kësaj dhurate më të madhe, madje shikon në tiparet e saj Bukurinë e Gjithëbujarit Absolut dhe të Mirëbërësit Absolut, atë bukuri të parapërjetshme të amshuar të cilës, nuk mund t'i afrohet kurrë zhdukja dhe përkohshmëria. Një shkreptimë prej asaj bukurie të përjetshme është e tillë, saqë ajo i bën të gjithë besimtarët që ta duan, dhe disa njerëz, elitën, i bën të joshur marrëzisht pas saj dhe përmallues të zjarrtë të saj.

Ndërsa në qoftë se nuk do të shikohej kjo dhuartë, dhurata e udhëzimit të atij personi, nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor, atëherë ai besim i pjesshëm i atij individi do t'i atribuohej ose vetë atij personi -ashtu siç pretendojnë *muëtezilitët* mendjemëdhenj e kokëfortë- ose disa shkaqeve. Atëherë ai xhevahir i shtrenjtë i të Gjithëmëshirshmit, vlera dhe çmimi i të cilit është vetëm Parajsa, do të pakësohej e katandisej në të qenurit një copë xhami dhe nuk do t'i reflektonte më shkreptimat e asaj bukurie të shenjtë.

Kështu, mund të shihet nga këto tre shembuj, se mijëra prej llojeve të bukurisë Hyjnore dhe qindra e mijëra shembuj të Plotësimit Hyjnor, shfaqen e kuptohen dhe provohet realiteti i tyre nga këndvështrimi i Unitetit Hyjnor; dhe kjo realizohet nëpërmjet përqëndrimit të atyre llojeve të bukurisë Hyjnore dhe plotësimit Hyjnor në të gjitha ato gjendje të pjesshme të qënieve të pjesshme që janë në pjesët më të fundme e të skajshme të sferës së shumësisë.

Atëherë, shfaqja e kësaj bukurie Hyjnore dhe e plotësimit të saj për zemrat nëpërmjet Unitetit Hyjnor dhe ndjeshmëria shpirtërisht për ato të dyja është ajo që i ka shtyrë të gjithë Evlijatë dhe të pastërtit që t'i gjejnë ndriçimet më të ëmbëla dhe ushqimin shpirtëror më të shijshëm në përmendjen dhe në përsëritjen e Fjalës së Njësisë, e cila është ***La i Lahe il-lall-llah***, *Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut*, duke pohuar Unitetin Hyjnor. Dhe meqenëse madhështia Hyjnore dhe lartësia, lavdia Hyjnore dhe sovraniteti absolut i Hyjnisë së të Përjetshmit të Vetëm kuptohen e vërtetohen në Fjalën e Njësisë, në Unitetin Hyjnor,

profeti Muhammed a.s.m. tha: *"Gjëja më e mirë që kam thënë unë dhe profetët para meje është* ***La il-lahe il-lall-llah****, Nuk ka zot tjetër përveç Allahut".*[4]

Po, megjithëse një mirësi e vogël, një dhuratë dhe një furnizim, rizk, si një lule, si një frut apo si një dritë, secila është si një pasqyrë e vogël, nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor ato pasqyra të vogëla papritmas qëndrojnë sup më sup dhe bashkohen me të gjitha shoqet e tyre dhe lidhen me njëra-tjetrën derisa ai lloj transformohet në një pasqyrë shumë të madhe që reflekton një lloj të bukurisë Hyjnore e cila manifestohet mbi të.

Misteri i Unitetit shfaq një bukuri të përhershme e të amshuar nëpërmjet asaj bukurie të përkohshme kalimtare, ashtu siç tha Meulana Xhelalud-din Rumiu:

"Imagjinata që është kurthi i shenjtorëve, është një pasqyrë që reflekton fytyrat e ndritshme si hënë në kopshtin e Zotit xh.sh..

Kurse në qoftë se ajo bukuri nuk do të shikohej nëpërmjet Unitetit Hyjnor, domethënë, po të mos ishte Uniteti Hyjnor, secili frut i pjesshëm do të mbetej i braktisur, i vetmuar, i lënë e i veçuar prej shokëve të tij dhe, as nuk do ta shfaqte atë bukuri të shenjtë dhe as nuk do ta shpjegonte atë plotësim të lartësuar. Madje edhe ajo shkreptimë e pjesshme e bukurisë që shkëlqen brenda tij, do të shuhej e do të humbiste. Mjaft thjesht, ajo do të bëhej e kundërta e saj; nga të qënurit një diamant, ajo do të kthehej në një copë xhami.

Gjithashtu, nëpërmjet misterit të vërtetimit të Unitetit Hyjnor, në qëniet e gjalla që janë frutat e pemës së krijimit, shfaqen një Personalitet Hyjnor, një Njësi Hyjnore, një fytyrë jolëndore e të Gjithëmëshirshmit e karakterizuar, e përcaktuar nga shtatë Atribute, një përqëndrim i Emrave, dhe manifestimi i përcaktimit dhe i personifikimit të Atij të Cilit i adresohet nëpërmjet fjalëve,

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë".[5]

Ose përndryshe -domethënë, pa misterin e Unitetit Hyjnor- shkreptima e Atij personaliteti, e asaj Njësie, e asaj Fytyre dhe manifestimi i atij përcaktimi do të zgjeroheshin e shtriheshin aq sa shtrirja e universit dhe do të shpërndaheshin e do të fshiheshin. Ajo do të shihej vetëm me sytë e zemrës që janë me të vërtetë shumë të

[4] Transmentojnë, Maliku, Tirmidhiu etj...
[5] Kur'an, 1:5

mëdhaja e gjithëpërfshirëse; sepse madhështia e lartësisë Hyjnore do ta mbulonte atë; jo gjithkush do të mund ta shikonte atë me syrin e zemrës.

Gjithashtu kuptohet qartë nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor në ato qënie të gjalla të pjesshme se Krijuesi i tyre i shikon ato, e di gjendjen e tyre, e dëgjon thirrjen e tyre dhe i bën ato ashtu siç dëshiron, duke u dhënë cilëndo formë që do Ai. Mjaft thjesht, prapa krijueshmërisë së çdo qënieje të gjallë shfaqet për intuitën e besimit, për shikimin e imanit, një personifikim jolëndor dhe një përcaktim jolëndor i Atij që ka fuqi e dëshirë, i Cili është Gjithëdëgjues, i Gjithëditur dhe Gjithëshikues. Dhe në mënyrë të veçantë, pas krijueshmërisë së njeriut -midis krijesave të gjalla- shikohet nëpërmjet besimit dhe nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, dhe me qartësi të plotë, Ai personifikim jolëndor dhe Ai përcaktim i lartësuar; sepse modelet e kuptimeve të tilla si njohja, fuqia, jeta, dëgjimi e shikimi, të cilat janë baza e atij personifikimi të Njësisë, janë të pranishme në njeriun, dhe ai i tregon ato nëpërmjet atyre modeleve. Për shembull, ai që t'i jep sytë, shikon edhe syrin, edhe atë çfarë sheh syri -ky është një kuptim i hollë- dhe pastaj i dhuron ato. Sigurisht okulisti që bën për syrin tënd një palë syze, e shikon përshtatshmërinë e shikimit për syrin tënd, dhe pastaj i përgatit ato për ty. Po kështu, edhe Ai që dhuron veshët, sigurisht dëgjon atë çfarë dëgjojnë veshët, dhe pastaj ai i bën dhe i dhuron ato. Shembuj për atributet e tjera mund të bëhen në të njëjtën mënyrë.

Gjithashtu, njeriu mban shenjat, skalitjet dhe manifestimet e Emrave të bukur Hyjnorë; me këto skalitje e manifestime, ai dëshmon për ato kuptime të shenjta.

Gjithashtu, nëpërmjet dobësisë së tij, pafuqisë, varfërisë dhe padijes, njeriu vepron si një pasqyrë në një mënyrë tjetër; ai dëshmon për fuqinë, njohjen, dëshirën dhe për atributet e tjera të Atij që ka dhembshuri e mëshirë mbi dobësinë dhe mbi varfërinë e tij, dhe i vjen në ndihmë atij.

Kështu, meqenëse nëpërmjet Unitetit Hyjnor, një mijë e një Emra Hyjnorë janë përqëndruar në pikat më të skajshme dhe në të pjesshmet më të shpërndara të sferës së shumësisë, në mesazhet e vogëla të njohura si qëniet e gjalla, dhe duhet të lexohen shumë qartë, Ai Krijues i Gjithurtë i shumon kopjet e tyre në shkallë të gjërë, sidomos speciet e të vegjëlve të tyre i shumon në mënyra të shumta të ndryshme dhe i përhap -i boton- ato anembanë.

Ajo që më shtyri për tek e vërteta e këtij Frutit të parë dhe që më çoi tek ajo ishte një ndjenjë e sigurt dhe një eksperiencë. Ajo ishte sa vijon:

Unë pikëllohesha shumë dhe më vinte jashtë mase keq për gjendjen e gjallesave dhe sidomos për qëniet e vetëdijshme prej tyre, dhe veçanërisht për njeriun, dhe në mënyrë akoma më të veçantë për të shtypurit dhe për ata të goditurit me fatkeqësi. Unë thirra nga thellësitë e zemrës sime:

Këto ligje të pandryshueshme që veprojnë në botë nuk i dëgjojnë dhimbjet e vuajtjet e këtyre të pafuqishmive dhe mjeranëve të dobët, as ato elemente dhe ato ngjarje dërrmuese nuk e dëgjojnë rënkimin e tyre. A nuk ndodhet ndokush që do t'i vinte keq e të kishte mëshirë për gjendjen e tyre të mjeruar dhe të ndërhynte në gjendjet e tyre të veçanta?"

Shpirti im bërtiste nga thellësirat e tij. Zemra ime kërkoi me të gjithë fuqinë e saj:

"A nuk kanë një Pronar të Vërtetë dhe një Zot Gjithëbujar që të kujdeset dhe t'i mbrojë ato krijesa të bukura, ato mallra shumë të çmueshëm e të vyer dhe këta të dashur të pëlqyeshëm, të përmalluar e mirënjohës?"

Përgjigjja e plotë dhe e mjaftueshme që jep qetësi e kënaqësi të plotë për britmat e shpirtit tim dhe për shqetësimet e zemrës sime ishte kjo: Atyre krijesave të dashura që rënkojnë nën presionin e ligjeve universale të të Gjithëmëshirshmit e Mëshirëplotit të Gjithëlavdishëm dhe që kërkojnë ndihmë nën goditjet e ngjarjeve dhe të sulmeve të tyre, Krijuesi xh.sh. u jep nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, sipër atyre ligjeve, favore të veçanta, ndihma të veçanta, dhe Hyjninë e Tij të veçantë drejt çdo gjëje drejtpërdrejtë; dhe Krijuesi xh.sh. i drejton çështjet e çdo gjëje pikërisht me Qënien e Tij Madhështore dhe i dëgjon ankesat e të gjitha gjërave; Ai është Pronari i Vërtetë, Mbrojtësi dhe Prijësi i gjithçkaje.

Qysh kur unë njoha këtë mister prej Kur'anit dhe prej dritës së imanit, unë ndjeva një gëzim të pafundmë në vend të atij dëshpërimi të pafundmë. Duke qenë tërësisht në Pronësi të Një Pronari të tillë të Gjithëlavdishëm dhe duke qenë i lidhur me Të, në shikimin tim të gjitha qëniet e gjalla fituan një rëndësi dhe një vlerë një mijë herë më të madhe, sepse meqenëse gjithësecili krenohet me nderin dhe me famën e Pronarit të tij, dhe me rangun e personit me të cilin ai është lidhur, dhe fiton një dinjitet nëpërmjet zbulimit të kësaj lidhjeje

nëpërmjet dritës së besimit dhe gjendjes së të qenurit i pronësuar, dhe për shkak të fuqisë së asaj lidhje, një mizë mposhti një faraon; madje ai duhet të ndjehej krenar për atë lidhje që të tejkalojë një mijë herë më shumë krenarinë e faraonëve, të cilët ishin të pakujdesshëm, që e imagjinuan vetveten të ishin të pavarur dhe se i kishin në pronësi vetvetet e tyre dhe, kishin krenari të tepruar -e cila u shua tek dera e varrit- që krenoheshin me paraardhësit e tyre dhe me sundimin e Egjiptit.

Po kështu mushkonja, nëpërmjet shfaqjes së dinjitetit të lidhjes së saj, mundi të zhdukë krenarinë e Nimrudit, që u shndërrua në turp e torturë kur ai provoi grahmat e vdekjes, duke e katandisur Nimrudin në hiçgjë.

Dhe kështu, vërseti Kur'anor,

"Vërtet që shirku është një gjynah (krim) shumë i madh" ,[6] na mëson se shirku -të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh.- është një krim i madh, meqenëse ai shkel të drejtat, nderin dhe dinjitetin e të gjitha krijesave.

Vetëm Ferri -Xhehennemi- mund ta pastrojë këtë krim, krimin e Shirkut.

Fruti i Dytë i Unitetit Hyjnor

Fruti i Parë pa tek Esenca më e pastër dhe më e shenjtë e Krijuesit të të gjitha botëve; tani ky fruti i dytë shikon tek universi dhe tek natyra e tij esenciale.

Po, nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, kuptohen dhe realizohen veçoritë e universit dhe plotësimet e tij, kuptohen detyrat e larta të qënieve, vendosen rezultatet e krijimit të qënieve, njihet vlera dhe rëndësia e krijesave; qëllimet Hyjnore në botë gjejnë ekzistencë, dhe bëhen të dukshëm shembujt e urtësisë në krijimin e qënieve të gjalla dhe shfaqet misteri i ekzistencës së qënieve të vetëdijshme; dhe shfaqen fytyrat e bukura e buzëqeshëse të mëshirës dhe të urtësisë prapa fytyrave të rrepta e të zemëruara të këtyre ngjarjeve dërrmuese e shtypëse brenda transformimeve të habitshme dhe të ndryshimeve; si dhe njihen ekzistencat e shumta të qënieve kalimtare, të tilla si rezultatet e tyre, natyrat e tyre të vërteta, shpirtërat e tyre dhe tesbihatet që ato i lënë në vendet e tyre në Botën e Dukshme para se ato të largohen.

[6] Kur'an, 31:13

Për më tepër, vetëm nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor njihet se universi, si një tërësi, është një libër kuptimplotë i Krijuesit të përjetshëm; dhe të gjitha qëniet nga toka për tek Froni Hyjnor janë një koleksion i mrekullueshëm i mesazheve Hyjnore; dhe të gjitha botët e krijesave janë një ushtri madhështore e rregullt Hyjnore; dhe të gjitha llojet e qënieve nga mikrobet dhe mizat për tek hundëbrirët, shqiponjat dhe planetët janë nëpunës të zellshëm të Sulltanit të Parapërjetshëm; dhe meqenëse ato veprojnë si pasqyra dhe kanë një lidhje me atë Sulltan, atëherë vlera e të gjitha gjërave e tejkalon pafundësisht vlerën e tyre individuale; dhe zbulohen përgjigjet e pyetjeve të pazgjidhshme e të ngatërruara: nga vjen rrjedha e këtyre qënieve dhe karvani i krijesave? Ku do të shkojnë? Përse erdhën dhe çfarë do të bëjnë?

Përndryshe, këto plotësime të larta të universit do të zhdukeshin, dhe ato të vërteta të larta e të shenjta do të transformoheshin në të kundërtat e tyre.

Për shkak se krimi i shirkut dhe i mosbesimit përbën shkelje kundra të gjitha plotësimeve të universit, ndaj të vërtetave të tij të shenjta dhe ndaj të drejtave të larta të qënieve, universi bëhet i zemëruar prej jobesimtarëve dhe idhujtarëve. Qiejt e toka bëhen të zemëruara, dhe elementet bashkohen për t'i shkatërruar ata, duke i përmbytur e zhytur ata që i përshkruajnë ortakë Allahut, të tillë si populli i Nuhut a.s., populli i Adit, populli i Themudit dhe populli i Faraonit.

Në përputhje me vërsetin,

"Ai (zjarri) pothuaj shpërthen me vrull".[7]

Ferri inatoset dhe tërbohet aq shumë kundra jobesimtarëve dhe atyre që i përshkruajnë ortakë Allahut, saqë ai pothuaj shpërthen me vrull.

Po, të përshkruarit ortakë me Allahun është një fyerje e tmerrshme ndaj universit dhe një shkelje e madhe dhe përçmim ndaj tij. Duke mohuar detyrat e shenjta të qënieve dhe qëllimet e krijimit të tyre, shirku fyen nderin e tyre. Për ta ilustruar këtë, ne do të aludojmë për këtë të vërtetë me një shembull të vetëm prej mijëra shembujsh.

Për shembull, nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor universi i ngjason një meleku gjigant trupor, që ka qindra e mijëra koka, madje sa numri i llojeve të qënieve, në çdo kokë ka qindra e mijëra gojë, madje sa numri i individëve të atij lloji; dhe në çdo gojë ka qindra e

[7] Kur'an, 67: 8

mijëra gjuhë, madje sa numri i organeve të atij individi, i pjesëve dhe i qelizave të atyre gjymtyrëve të tij. Atëherë ky univers madhështor dhe kjo krijesë e çuditshme, ky melek madhështor e shenjtëron dhe e lavdëron Krijuesin e Gjithëlavdishëm me këto gjuhë të panumërta. Atëherë ai është në një pozitë të lartë duke u marrë me adhurim madhështor të ngjashëm me adhurimin e Melekut Israfil a.s...

Nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, universi gjithashtu është një tokë e lërueshme që përgatit prodhime të shumta e të korra të bollshme për botën e Ahiretit dhe për vendbanimet e saj.. ai është si një fabrikë e madhe që prodhon mallra të shumtë, të tilla si veprat e njeriut, për nivelet e Botës së Lumturisë; ai është si një kamër kinematografike me qindra e mijëra lente objektivi duke nxjerrë në mënyrë të vazhdueshme fotografitë e kësaj bote për t'ua shfaqur spektatorëve në botën e përjetshme dhe veçanërisht në Parajsë.

Atëherë, ndërsa universi, nëpërmjet Unitetit Hyjnor është në këtë formë të mahnitshme si një melek i bindur trupor i gjallë, shirku e transformon atë në një kolektivitet të pajetë, të pashpirt, të padetyrë, kalimtar, i pakuptim, i mjerë dhe i kotë, duke u rrokullisur në stuhitë e ngjarjeve, të ndryshimeve dhe në errësirat e mosekzistencës.

Shirku -të përshkruarit ortakë me Allahun- e shndërron këtë fabrikë të çuditshme, madhështore, të rregullt e të dobishme në diçka të padobishme, të paleverdishme e të papunë; e shndërron në një lodër rastësie të ngatërruar e të pavetëdijshme, si diçka pa prodhim, pa rezultat ose pa funksion; e kthen në një fushë lojërash të Natyrës së shurdhët dhe të Forcës së verbër, një vend zie për të gjitha qëniet e vetëdijshme -me mend- një thertore për të gjitha krijesat e gjalla dhe si një luginë lotësh.

Në përputhje me vërsetin,

"Vërtet që shirku është një gjynah (krim) shumë i madh".[8]

Shirku, megjithëse është një e keqe e vetme, ai çon për tek krime të tilla të shumta saqë ata që e kryejnë atë krim, meritojnë torturim të pafundmë në zjarrin e Xhehennemit. Megjithatë, meqenëse ky Fruti i dytë është shpjeguar e provuar në mënyrë të përsëritur tek koleksioni *Siraxhun-Nur -llamba Ndriçuese-*, ne e kemi shkurtuar këtu këtë të vërtetë të gjatë.

Një ndjenjë e çuditshme dhe një perceptim që më shtynë mua për tek ky Fruti i Dytë. Kjo ishte sa vijon:

---

[8] Kur'an, 31:13

Në një ditë kur po sodisja stinën e pranverës, unë pashë se qëniet që mbushnin sipërfaqen e tokës dhe vërshonin karvan pas karvani shfaqnin në faqen e tokës qindra e mijëra shembuj e modele të Ringjalljes së madhe dhe të Tubimit të madh.

Këto qënie, dhe sidomos qëniet e gjalla dhe të vegjëlit e tyre, shfaqeshin vetëm për një kohë të shkurtër, dhe pastaj zhdukeshin. Tablotë e vdekjes dhe të përkohshmërisë në mes të atij aktiviteti të vazhdueshëm e të madh m'u dukën shumë të trishtueshme e të dhimbshme;

Unë ndjeva një keqardhje të tillë saqë më bëri të qaja. Sa më shumë i vështroja vdekjet e atyre krijesave të dashura të vogla, aq më shumë më dhimbte zemra. Unë bërtita nga keqardhja e tyre dhe ndjeva brenda meje tronditje të thellë shpirtërore. Jeta që mbaronte me një fund të tillë, m'u duk se ishte një torturë më e keqe se sa vdekja.

Gjithashtu pashë në botën e bimëve dhe të kafshëve se ato gjallesa shumë të bukura e shumë të dashura dhe plot art të vlefshëm, sapo t'i hapnin sytë e tyre për një çast në ekspozitën e universit, pastaj zhdukeshin e kalonin. Sa më shumë ta shikoja këtë gjendje, unë ndjeja një dhimbje pikëlluese, zemra ime donte të ankohej duke qarë e rënkuar ndaj Paracaktimit e fatit.

Ajo bëri pyetje të tmerrshme: "Atëherë, përse ato erdhën në këtë botë, dhe përse largohen pa qëndruar në të? sepse këto krijesa të bukura largohen pa dobi, pa ndonjë synim, pa rezultat dhe shumë shpejt bëheshin mosekzistuese para syve të mi, pavarësisht se qenë krijuar, ushqyer e mbështetur me gjërat më të domosdoshme dhe u zhvilluan me kaq shumë vëmendje dhe art dhe në një formë të tillë të vlefshme.

Mirëpo pas të gjithë kësaj, ne shohim grisjen e tyre si leckë, shpërndarjen e tyre, asgjësimin, zhdukjen dhe hedhjen e tyre në errësirat e mosekzistencës..

Sa herë që e shikoja këtë skenë të dhimbshme, bërtisnin të gjitha aftësitë e mia të holla që ishin shumë të joshura pas llojeve të plotësimit dhe të sprovuara e të robëruara pas llojeve të bukurisë, të përmalluara pas gjërave të vyera e të çmueshme, dhe kërkuan ndihmë duke thënë: "Përse nuk mëshirohen këto krijesa? A nuk është turp kjo? Nga vijnë kjo përkohshmëri e zhdukje brenda këtyre përmbysjeve dhe transformimeve të çuditshme që pareshtur i sulmojnë këto qënie të mjera?" Sapo filluan kundërshtimet e tmerrshme të drejtohen drejt Kaderit Hyjnor dhe drejt rrethanave të dhimbshme të fytyrës së

jashtme të jetës dhe të ngjarjeve të saja, drita e Kur'anit, misteri i besimit, favori i të Gjithëmëshirshmit dhe besimi në Unitetin Hyjnor, që të gjitha më erdhën në ndihmë. Ato i ndriçuan ato errësira dhe i transformuan vajtimet e mia në gëzim, rënkimet e mia në lumturi dhe keqardhjet e mia në thirrjet ***Ma Sha' All-llah, Barakall-llah,*** *Çfarë çudirash ka dashur Allahu, i Bekuar është Allahu*. Ato më bënë mua të deklaroja duke thënë: *Lavdi Zotit për dritën e besimit,* sepse nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, Unë pashë se të gjitha krijesat, dhe veçanërisht krijesat e gjalla, prodhojnë rezultate vërtet domethënëse dhe kanë dobi të përgjithshme.

Shkurtazi: Të gjitha qëniet e gjalla, për shembull, kjo lule e stolisur dhe kjo bletë prodhuese ëmbëlsirash, janë poema Hyjnore plot kuptime të thella, saqë qënie të vetëdijshme të panumërta i studiojnë ato me kënaqësi të plotë.. Ato janë mrekulli të çmueshme të fuqisë Hyjnore.. janë shpallje e kënde njoftimi për Urtësinë e Krijuesit ku ekspozojnë artin e Autorit të tyre të Gjithëlavdishëm në mënyrë tepër joshëse e tërheqëse përpara shikimeve të panumërta të vëzhguesve vlerësues e admirues.

Gjithashtu, Rezultati më i lartësuar i krijimit të qënies së gjallë është që ajo të shfaqet përpara shikimit të Krijuesit të Gjithëlavdishëm, i Cili dëshiron ta shikojë Vetë artin e Tij, dhe të shohë bukuritë e krijimit të Tij dhe hijeshinë e manifestimeve të Emrave të Tij.

Një funksion tjetër i lartësuar i krijimit të tyre është përshkruar në Letrën e Njëzet e Katërt, dhe është kryerja e tyre në pesë mënyra të misionit të shfaqjes së Hyjnisë absolute dhe shfaqjes së Plotësimit Hyjnor që bëjnë të domosdoshme këtë aktivitet absolut në univers.

Por unë pashë se qënia e gjallë, përveç dobive dhe rezultateve të lartëpërmendura që ka, e lë shpirtin e tij në vendin e vet -në qoftë se është qënie me shpirt- dhe lë formën dhe identitetin e saj në kujtesat dhe në Pllakat e tjera të Ruajtjes, dhe i vendos ligjet e qënies së saj dhe një lloj prej jetës së ardhme të saj në farat dhe në vezët e saj, dhe i vendos veçoritë e plotësimit dhe të bukurisë që i ka reflektuar si pasqyra, i lë ato në botën e padukshme dhe në sferën e Emrave Hyjnorë; dhe pas gjithë kësaj futet nën perden e zhdukjes me gëzim e kënaqësi me një vdekje të jashtme -domethënë duke u liruar nga detyrat-, fshihet vetëm nga shikimet e dynjasë, nga sytë e botës!.

Po, kështu e pashë natyrën e qënies së gjallë dhe thashë nga thellësitë... ***El-Hamdu Lil-lah,*** *Lavdia i takon Allahut...*

Këto lloje bukurie dhe këto shembuj hijeshie që shihen në të gjithë nivelet e universit dhe në të gjitha botërat e qënieve, dhe që janë shpërndarë gjithandej, demonstrojnë me siguri të plotë se situata e mëparshme e shëmtuar, e egër, e neveritshme dhe e mjerueshme, të cilën e bën të domosdoshme shirku, është krejtësisht e pamundur dhe e rreme, sepse një shëmti e tillë e lemerishme nuk do të mund të ekzistonte e fshehur nën perden e një bukurie të tillë të vërtetë e të pastër. Në qoftë se ajo do të gjendej atje, atëherë ajo bukuri e vërtetë do të ishte e pavërtetë, e pabazë, e kotë dhe e rreme. Kjo do të thotë se shirku -të përshkruarit ortakë me Allahun- nuk ka realitet, rruga e tij është e mbyllur, ai është zhytur në baltë; ajo çfarë parashtron e vendos ai është e pamundur dhe e papranueshme. Meqenëse kjo e vërtetë e besimit, e cila u përket ndjenjave, është shpjeguar në detaje me prova të shumta në shumë pjesë të koleksionit *Siraxhun-nur*, ne do të mjaftohemi këtu me këtë tregues.

Fruti i Tretë i Unitetit Hyjnor

Ky frut shikon tek qëniet e vetëdijshme, dhe veçanërisht tek njeriu.

Po, nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor, midis të gjitha krijesave, njeriu mund të arrijë tek plotësimet më të larta dhe të bëhet fruti më i vlefshëm i universit dhe më i ploti dhe më i përsosuri i krijesave, më fatlumi i qënieve të gjalla, i adresuari i Zotit të të gjitha botëve dhe i merituari që të jetë miku i ngushtë i Tij dhe i dashuri i Tij.

Po, të gjitha plotësimet e njeriut dhe qëllimet e tij të larta janë të lidhura me Unitetin Hyjnor dhe gjejnë ekzistencë e realizohen nëpërmjet misterit të unitetit Hyjnor; sepse në qoftë se nuk do të kishte unitet, njeriu do të ishte më fatkeqi i krijesave, më i ulëti i qënieve, më i dobëti i kafshëve dhe më i vuajturi dhe i dëshpëruari i qënieve të vetëdijshme; sepse së bashku me pafuqinë e tij të pafundme, me armiqtë e tij të panumërt, me varfërinë e tij të pakufishme dhe me nevojat e tij të pafundme, ai është pajisur me shumë aftësi e shqise deri në atë shkallë që ai nëpërmjet tyre të mund të ndjejë lloje të panumërta dhimbjesh dhe të përjetojë lloje të panumërta kënaqësish. Ai ka qëllime e dëshira të tilla, saqë Vetëm Ai që e sundon përnjëherësh të gjithë universin, mund t'i plotësojë ato dëshira.

Për shembull, njeriu ka një dëshirë të fortë për pavdekshmëri. Vetëm Ai që ushtron kontroll mbi të gjithë universin si të ishte një pallat, mund t'i përgjigjet kësaj dëshire, mund ta mbyllë derën e kësaj bote dhe të hapë atë të Ahiretit, ashtu si të mbyllte derën e një dhome

dhe të hapte atë të një dhome tjetër. Njeriu gjithashtu ka mijëra dëshira, edhe negative edhe pozitive, të cilat, ashtu si dëshira për pavdekshmëri, shpërndahen gjithandej botës dhe shtrihen deri në përjetësi. Është vetëm i Vetmi Unik, i Cili nëpërmjet misterit të Unitetit e mban të gjithë universin në kapjen e Tij, që duke iu përgjigjur këtyre dëshirave të njeriut mund t'i shërojë plagët e tmerrshme të 'pafuqisë' dhe të 'varfërisë' së tij.

Për më tepër, njeriu ka aq shumë dëshira të holla, të pjesshme, jolëndore e të fshehura që lidhen me qetësinë e me rehatinë e zemrës së tij, dhe ka qëllime të lidhura me pavdekshmërinë dhe me lumturinë e shpirtit të tij, aq të gjëra, gjithëpërfshirëse dhe universale, saqë atyre mund t'iu përgjigjet vetëm se Ai që shikon perdet më të holla e më të pakapshme të zemrës së tij, që ka lidhje me të, dhe që dëgjon zërat më të padëgjueshëm e të fshehur, dhe që nuk i lë ato pa iu përgjigjur.

Ai i Vetëm gjithashtu duhet të ketë fuqi të mjaftueshme për t'i nënshtruar qiejt dhe tokën sikur ato të ishin dy ushtarë të bindur, dhe t'i bëjë ato të kryejnë vepra universale.

Gjithashtu, nëpërmjet misterit të unitetit, të gjitha gjymtyrët dhe shqiset e njeriut fitojnë një vlerë të lartë, kurse nëpërmjet shirkut -të përshkruarit ortakë me Allahun- dhe nëpërmjet mosbesimit, ato bien në një shkallë pafundësisht të ulët. Për shembull, aftësia më e çmueshme e njeriut është mendja. Nëpërmjet misterit të unitetit Hyjnor, ajo bëhet një çelës i ndritshëm për thesaret e shenjta Hyjnore dhe për arkat e universit. Ndërsa në qoftë se ajo do të binte në shirk -në të përshkruarin ortakë me Allahun- dhe në mosbesim, ajo do të bëhej një vegël fatzezë tortureje që grumbullon tek koka e njeriut të gjitha dhimbjet pikëlluese të së shkuarës dhe frikësimet dhe ankthet e tmerrshme të së ardhmes.

Gjithashtu, për shembull, dhembshuria, mëshira, veçoria më e hollë, e këndshme dhe e ëmbël prej veçorive të njeriut; në qoftë se misteri i Unitetit Hyjnor nuk i vjen në ndihmë asaj, ajo do të bëhej një torturë e kobshme që do ta zbriste njeriun në errësirat e mjerimit. Një nënë e pakujdesshme, e cila imagjinon se e ka humbur fëmijën e saj të vetëm përjetësisht, e ndjen plotësisht këtë dhimbje përcëlluese.

Gjithashtu, për shembull, edhe dashuria, e cila është ndjenja më e ëmbël, më e kënaqshmja, më e larta dhe më e çmueshmja e njeriut; Në qoftë se misteri i Unitetit Hyjnor do ta ndihmonte atë, ajo i jep njeriut të vogël shtrirjen dhe gjërësinë e universit, dhe e bën atë një sulltan të dashur për të gjitha krijesat. Ndërsa vetë dashuria në qoftë se do të

binte në shirk dhe në mosbesim -Ruajna Zot- ajo do të shndërrohej në një fatkeqësi të madhe saqë do ta griste e copëtonte zemrën e njeriut të dobët në çdo çast për shkak të ndarjes përjetësisht prej të dashurve të saj të panumërt, meqë ata vazhdimisht zhduken me vdekjen. Mirëpo argëtimet e kota, duke shkaktuar pakujdesi, i mpijnë ndjenjat përkohësisht, duke mos e lejuar njeriun ta ndjejë këtë dhimbje.

Në qoftë se ti do të bëje analogji me këto tre shembuj për qindra aftësitë dhe shqiset e njeriut, do të kuptoje se deri në çfarë shkalle është Uniteti Hyjnor boshti për plotësimet njerëzore. Meqenëse ky fruti i tretë gjithashtu është shpjeguar shumë mirë dhe në mënyrë të hollësishme me prova në ndoshta njëzet prej trajtesave të koleksionit *Siraxhun-Nur*, unë po mjaftohem me këtë tregues të shkurtër këtu.

Ajo çfarë më shtyri mua për tek ky Frut ishte ndjenja që vijon:

Një ditë unë isha në një majë të një mali të lartë. Nëpërmjet një zgjimi shpirtëror mjaft të fuqishëm për të larguar pakujdesinë time, vdekja dhe varri m'u shfaqën me të gjithë realitetin e tyre të plotë. Ashtu si tek të tjerët, dëshira ime e zjarrtë e bashkëlindur për pavdekshmëri ziu përbrenda nga zemërimi dhe u rebelua kundra vdekjes. Gjithashtu edhe simpatia dhe dhembshuria në natyrën time u zemëruan dhe ngritën krye kundra varrit dhe asgjësimit të njerëzve të plotësimit, profetëve të shquar, Evlijave -shenjtorëve- dhe të pastërtive, për të cilët unë ndiej dashuri të madhe dhe kam lidhje të ngushta me ta. Përballë kësaj çështje unë pashë në gjashtë drejtimet, duke kërkuar ndihmë, por unë nuk gjeta as ngushëllim as ndihmë; sepse duke vështruar të shkuarën, unë pashë se ajo ishte shndërruar në një varrezë të madhe; drejtimi i së ardhmes ishte transformuar në një errësirë të tmerrshme; drejtimi i sipërm ishte shumë i tmerrshëm, edhe drejtimi i poshtëm; dhe po kështu i djathti dhe i majti, të gjitha këto drejtime shkaktonin situata të dhimbshme e të trishtueshme. Papritmas, misteri i Unitetit Hyjnor më erdhi në ndihmë, e ngriti perden përpara shikimit tim dhe më shfaqi realitetin e këtyre drejtimeve duke thënë: Shiko!

Para së gjithash unë hodha vështrimin tek fytyra e vdekjes, e cila më frikësonte shumë. Unë pashë se për njerëzit e besimit, ajo ishte një lirim prej detyrave. Exheli -çasti i fundit i jetës- ishte letra e lirimit. Ajo ishte një ndryshim banese, parathënia e një jete të amshuar, dhe dera që të çon për tek ajo jetë. Ishte lirim prej burgut të kësaj dynjaje dhe shkuarje për tek kopshtet e Ahiretit. Ishte rasti që njeriu të futet tek prania e të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë me qëllim që të marrë shpërblimet për shërbimin e tij. Ishte një ftesë për të shkuar për tek

bota e lumturisë. Duke e kuptuar këtë me siguri të plotë, unë fillova ta dua vdekjen.

Pastaj unë hodha vështrimin për tek përkohshmëria dhe jetëshkurtësia, dhe pashë se zhdukja e gjërave ishte vetëm ripërtëritje e tyre, ishte një ripërtëritje e këndshme, ashtu si figurat në ekranin e kinemasë dhe si flluskat në ujin rrjedhës nën diell.

Prandaj, unë mësova me siguri se zhdukja e gjërave dhe përkohshmëria e tyre ishte një ripërtëritje e manifestimeve shumë të bukura të Emrave më të bukur Hyjnorë dhe një detyrë të cilën e kryenin brenda një ekskursioni dhe udhëtimi në botën e dukshme pas ardhjes së tyre nga bota e padukshme; dhe ato ishin një manifestim i urtë i qëllimshëm i bukurisë Hyjnore; ato kryenin funksionin e pasqyrave të bukurisë së përjetshme të qënieve.

Pastaj unë hodha vështrimin për tek gjashtë drejtimet, dhe pashë se nëpërmjet misterit të Unitetit Hyjnor ato ishin aq të ndritshme saqë të verbonin sytë. Unë pashë se e shkuara nuk ishte një varr i madh, por duke qenë transformuar në të ardhmen, kishte bërë mijëra tubime të ndritshme miqsh dhe mijëra pamje të mbushura me dritë. Unë pashë tek fytyrat e vërteta të mijëra çështjeve si këto të dyja, dhe i pashë se ato nuk shkaktonin veçse gëzim e kënaqësi.

Unë i kam përshkruar ndjenjat e mia rreth këtij frutit të tretë me prova, të pjesshme dhe universale, ndoshta në dyzet trajtesat e koleksionit *Siraxhun-Nur*. Ato janë shpjeguar aq qartë dhe prerazi dhe veçanërisht në Shkreptimën e Njëzet e Gjashtë -Trajtesa për të moshuarit- në trembëdhjetë shpresat e saj, saqë nuk do të mund të kishte shpjegim më të qartë. Prandaj këtu unë e kam prerë shkurt këtë çështje shumë të gjatë në këtë stacion.

. . .

STACIONI I DYTË

[Ndodhen prova të pallogaritshme të cilat në formë absolutisht të sigurt bëjnë të domosdoshme Unitetin Hyjnor dhe kërkojnë medoemos Njësinë; ato prova as nuk e pranojnë dhe as nuk e lejojnë shirkun -të përshkruarin ortakë me Allahun. Meqenëse me qindra dhe ndoshta me mijëra prej atyre argumenteve janë demonstruar në detaje në Risale-i Nur, këtu vetëm tre prej tyre, të cilat bëjnë të domosdoshëm Unitetin Hyjnor, do të parashtrohen shkurtazi.]

I Pari

Sipas dëshmisë së akteve të urta dhe dalluese që vëzhgohen në univers, krijesat bëhen nëpërmjet atributeve Absolute të Një Sundimtari të Gjithurtë, Madhështori të Plotë dhe, nëpërmjet Emrave të Tij Absolutë, nëpërmjet njohjes së Tij të pakufishme dhe nëpërmjet fuqisë së Tij të pafundme.

Po, mund të kuptohet e mësohet me siguri nëpërmjet një intuite të sigurt prej këtyre veprave në univers, madje mund të shikohet se, Ai Autor ka një sovranitet dhe një sundim tek shkalla e Hyjnisë së përgjithshme absolute, ka një madhështi dhe një madhësi tek shkalla e fuqisë absolute; ka një plotësi dhe një vetëmjaftueshmëri tek shkalla e Hyjnisë absolute dhe ka një aktivitet dhe një sundim të cilat janë absolutisht pa kufizim, të pakufishëm dhe të pafundmë; këto kuptohen qartë dhe janë të dukshme.

Sa për sundimin, madhështinë, plotësinë, vetëmjaftueshmërinë, absolutësinë, gjithëpërfshirjen, pakufizueshmërinë dhe pafundësinë,

këto të gjitha bëjnë të domosdoshme Unitetin dhe janë të kundërtat e shirkut -të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh..

Dëshmia për Unitetn e sovranitetit dhe të sundimit: Kjo është provuar me siguri të plotë në vende të shumta në Risale-i Nur. Një përmbledhje e shkurtër është sa vijon:

Shenja e sundimit është pavarësia, vetmia dhe refuzimi i ndërhyrjes së të tjerëve; sundimi i bën të domosdoshme këto. Madje njeriu i nevojshëm nga natyra për ndihmën e të tjerëve e refuzon ndërhyrjen e të tjerëve në çështjet e tij nëpërmjet një hijeje prej atij sundimi me qëllim që të ruajë pavarësinë e tij. Për këtë arsye, nuk mund të jenë dy mbretër në një vend, as dy guvernatorë në një provincë, as dy kryetarë bashkie në një qytet dhe as dy kryepleq në një fshat. Në qoftë se do të kishte dy mbretër në një vend, kjo do të çonte në kaos; rebelimet do të shpërthenin dhe ligji dhe rregulli do të përmbyseshin. Meqenëse një hije e vetme e sundimit tek njeriu i pafuqishëm dhe i nevojshëm për ndihmë, e refuzon ndërhyrjen e të tjerëve dhe e hedh poshtë prerazi pjesëmarrjen e tyre deri në këtë shkallë, atëherë sigurisht sundimi, i cili është në Hyjninë absolute të të Gjithëfuqishmit absolut, i Cili është i çliruar prej pafuqisë, nuk do ta pranonte në asnjë mënyrë ndërhyrjen dhe pjesëmarrjen e të tjerëve.

Ai do ta refuzonte atë me forcë e me vrull dhe me zemërim do t'i dëbonte nga Divani i Tij ata që i përshkruajnë Atij ortakë imagjinarë. Kërcënimet e rrepta të Kur'anit të gjithurtë kundra atyre që i përshkruajnë ortakë Zotit xh.sh. burojnë nga kjo e vërtetë.

Dëshmia për Unitetin e madhështisë dhe të gjithëlavdisë: Kjo gjithashtu është shpjeguar me prova të ndritshme në Risale-i Nur dhe, këtu do të aludohet për një kuptim shumë të shkurtër të saj.

Për shembull, madhështia dhe madhësia e dritës së diellit nuk lënë ndonjë nevojë për drita të tjera të dobëta pranë tij dhe drita e tij nuk u lejon të tjerave ndonjë efekt që mund të përmendet. Gjithashtu madhështia dhe madhësia e fuqisë Hyjnore nuk lënë nevojë për asnjë forcë apo fuqi tjetër dhe nuk i japin asnjë fuqie tjetër ndonjë efekt të vërtetë apo aftësi krijimi -për të krijuar. Në mënyrë të veçantë qëniet e gjalla e të vetëdijshme, që janë pikat mbi të cilat kthehen dhe orientohen të gjitha qëllimet Hyjnore në univers dhe tek të cilat ato përqëndrohen dhe vërtiten rreth tyre; do të ishte krejtësisht e pamundur që ajo madhështi dhe ajo madhësi t'ua linin të tjerëve diçka prej tyre.

Gjithashtu gjendjet, rrethanat, frutat dhe rezultatet që janë të pjesshmet e qënieve të gjalla dhe në të cilat manifestohen qëllimet e

krijimit të njeriut dhe qëllimet e zanafillës së llojeve të mirësive të panumërta, nuk mund t'u referohen absolutisht duarve të të tjerëve.

Për shembull, mirënjohja e vërtetë dhe kënaqësia reale që burojnë nga çdo qënie e gjallë si rezultat i një shërimi të pjesshëm prej ndonjë sëmundjeje, ose për shkak të ndonjë furnizimi me rizk që i ka ardhur ose që u udhëzua për tek Allahu, gjëra që nuk mund të jenë veçse nga Allahu xh.sh., dhe mirënjohja i bëhet vetëm Atij; prandaj paraqitja e mirënjohjes dhe e vlerësimit ndaj dikujt tjetër përveç Zotit xh.sh. do të prekte madhështinë dhe madhësinë Hyjnore dhe do të fyente dinjitetin dhe lavdinë e të Adhuruarit Absolut.

Si aludon plotësia për misterin e unitetit: Edhe kjo është shpjeguar me prova të ndritshme në Risale-i Nur, dhe një kuptim i saj tej mase i shkurtër është ky:

Krijimi i qiejve dhe i tokës në mënyrë të vetëkuptueshme kërkon medoemos një fuqi absolute të plotësimit më të skajshëm; madje sistemet e çuditshme trupore të qënieve të gjalla gjithashtu bëjnë të domosdoshme një fuqi me një plotësi absolute. Plotësia që është në fuqinë absolute e cila është e përjashtuar dhe e lirë nga pafuqia dhe e shenjtëruar dhe larg kufizimit, padyshim bën të domosdoshme Unitetin, sepse ta bësh të mangëtën të plotë, të kufizuarën të pakufizuar; dhe ta bëje të pafundmen të fundme, dhe ta zbrisje e pakësoje fuqinë më të fortë tek pafuqia më e dobët do të bënte të domosdoshme ta bëje të fundme një fuqi të pafundme nëpërmjet diçkaje të fundme; kjo është krejtësisht e pamundur në pesë mënyra.

Dëshmitë për Unitetin e pakufizueshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe pafundësisë:

Edhe kjo gjithashtu është përmendur në detaje në trajtesën *Siraxhun-Nur*. Një përmbledhje e kuptimit të saj është sa vijon:

Çdo akt prej akteve që veprojnë në univers, nëpërmjet përhapjes gjërësisht të efektit të tij në të gjitha anët duke dominuar tregon se ai është gjithërrethues, gjithëpërfshirës, i pakufizuar, i palimit dhe absolut. Dhe Shirku dhe pjesëmarrja vendosin një kufizim mbi atë gjithëpërfshirje dhe mbi atë pakufizueshmëri dhe vendosin limite mbi atë që është e palimit, duke shkatërruar realitetin e absolutësisë dhe natyrën e gjithëpërfshirjes. Sigurisht shirku është i pamundur në ato akte të cilat janë absolute, gjithëpërfshirëse dhe gjithërrethuese për gjithçka, dhe sigurisht ai është mosekzistues.

Po, natyra e pakufizueshmërisë, e absolutësisë është e kundërta e shirkut, sepse kuptimi i absolutësisë edhe në qoftë se do të ishte në

diçka të fundme, materiale dhe të kufizuar, përhapet, shpërndahet dhe depërton duke dominuar dhe e pavarur në të gjitha anët. Ashtu si ajri, drita dhe nxehtësia dhe madje edhe uji, në qoftë se secila prej këtyre gjërave do të manifestonte pakufizueshmëri, absolutësi, ajo do të përhapej kudo në të gjitha anët. Meqenëse ky aspekt i pakufizueshmërisë, edhe në qoftë se do të ishte tek gjëja e pjesshme, i bën gjërat fizike dhe të kufizuara depërtuese e dominuese në këtë mënyrë, atëherë sigurisht, pakufizueshmëria e vërtetë universale do t'u jepte Atributeve që janë edhe të pafundme, të çliruara nga lënda, të padefekte dhe të pakufizuara, do t'u jepte një depërtuesshmëri dhe një gjithërrethim të tillë të plotë saqë ato nuk mund ta pranojnë shirkun dhe pjesëmarrjen; dhe këto të dyja nuk mund të kenë absolutisht asnjë mundësi.

Shkurtazi: Sundimi i mijëra akteve të përgjithshme që veprojnë në univers dhe qindra Emrat e bukur Hyjnorë, manifestimet e cilësive, madhështia e tyre, plotësia, gjithëpërfshirja, pakufizueshmëria dhe pafundësia e të cilëve shihen qartë, secili prej tyre është një provë e fuqishme për Unitetin Hyjnor dhe për vërtetimin e tij.

Dhe për shembull, ashtu si një fuqi e jashtëzakonshme kur fillon të aktivizohet nëpërmjet një aktiviteti që i mposht të gjitha rrethinat e saj dhe, forcat e tjera shpërndahen, po ashtu çdo akt prej akteve Hyjnore dhe çdo manifestim prej manifestimeve të Emrave të bukur Hyjnorë shfaqin fuqinë e tyre të jashtëzakonshme në veprat e tyre, saqë në qoftë se nuk do të ishte një sundim i përgjithshëm dhe një drejtësi absolute që t'i ndalonte tek limiti i tyre, atëherë secila nga ato fuqi do t'i kishte mposhtur të gjitha qëniet.

Për shembull, a do të ishte e mundur për fuqinë universale e cila i krijon të gjithë plepat në botë dhe që i administron, të mos merrte nën kontrollin e Vet individët e pjesshëm të pemëve si arra, molla dhe kajsia që janë të shpërhapura pranë plepave, dhe të mos i rregullonte e t'i dominonte, apo t'ua dorëzonte ato forcave të tjera?

Po, në të gjitha llojet e krijesave dhe, madje në çdo individ ndjehen një forcë dhe një fuqi sunduese të cilat në mënyrë të qartë kanë kapacitetin për të sunduar të gjithë universin dhe t'i nënshtrojnë të gjitha qëniet.

Sigurisht, një fuqi e tillë nuk do ta pranonte ortakërinë e asnjë lloji, dhe nuk do ta lejonte shirkun në asnjë aspekt.

Gjithashtu, për pronarin e një peme frutdhënëse, çështja e rëndësisë më të madhe është fruti në majat e degëve të pemës dhe

bërthamat e saj të futura në zemrat e atyre frutave, madje ato janë vetë zemrat e frutave të saj. Në qoftë se pronari i pemës do të ishte me mend, nuk do ta bënte pronësinë e tij të shkonte kot duke ia dorëzuar përherë frutat që varen prej degëve dikujt tjetër. Pikërisht në të njëjtën mënyrë; elementet, të cilët janë degët e pemës së quajtur Universi; dhe bimët dhe kafshët, të cilat janë majat e elementeve dhe janë si lulet dhe gjethet për pemën; dhe qëniet njerëzore që janë majet e gjetheve dhe të luleve, -pronari i pemës në asnjë mënyrë nuk do t'ua dorëzonte forcave të tjera adhurimin dhe falënderimet e atyre frutave, të cilët janë frutet më të rëndësishëm dhe rezultati i krijimit të tyre, dhe veçanërisht zemrat e tyre, bërthamat gjithëpërfshirëse të frutave, dhe aftësitë e tyre të kujtesës, të cilat njihen si 'zemra e jashtme', duke mohuar kështu sovranitetin e Hyjnisë së Tij, dhe duke prekur e zhdukur gjithashtu përshtatshmërinë e Tij për t'u adhuruar.

Gjithashtu, meqenëse qëllimet e Hyjnisë janë përqëndruar në të pjesshmet që janë në skajet e sferës së mundësisë dhe të shumësisë, dhe madje janë përqëndruar edhe në të pjesshmet e gjendjeve të atyre të pjesshmëve, dhe në të pjesshmet e periudhave të tyre të cilat shtrihen tek adhurimi dhe kthehen e orientohen tek i Adhuruari i vetëm xh.sh... dhe meqenëse të gjitha llojet e mirënjohjes, falënderimit dhe të lavdërimit, dhe të gjithë shembujt e falënderimit dhe të ibadeteve burojnë nga ato të pjesshme, nuk ka dyshim se Krijuesi xh.sh. nuk do t'ua dorëzonte ato të tjerëve dhe nuk do ta prishte urtësinë e Tij të madhërishme me këtë dorëzim dhe nuk do ta anullonte e ta shfuqizonte Hyjninë e Tij madhështore, sepse qëllimi më i rëndësishëm Hyjnor në krijimin e qënieve është ta bëjë Vetveten të njohur e të dashur tek qëniet e vetëdijshme, dhe që t'i shtyjë ata për të bërë lavdërime, lartësime e falënderime vetëm për Të.

Për shkak të këtij misteri të hollë, aktet dhe mirësitë, qofshin të pjesshme apo universale, të përqëndruara në skajet e sferës së shumësisë, si rizku, furnizimi dhe shërimi dhe sidomos udhëzimi dhe besimi, edhe akte e mirësi të tjera të ngjashme me këto të cilat rezultojnë në falënderime, në adhurim, mirënohje, dashuri, lavdërim dhe në ibadet, janë një mirëbërësi e drejtëpërdrejtë e Krijuesit të botëve, një bamirësi e drejtëpërdrejtë e Sulltanit të të gjitha qënieve dhe një akt i drejtëpërdrejtë i udhëzimit dhe aktit të Tij. Dhe me qëllim që ta shfaqë këtë, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm në mënyrë të përsëritur ia atribuon rizkun, udhëzimin dhe shërimin vetëm Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm dhe, tregon se dhurimi, dhënia e secilës prej tyre është e veçantë për Të dhe e kufizuar Vetëm tek Ai;

dhe në të njëjtën kohë mohon me forcë ndërhyrjen e të tjerëve në ato vepra të mëdhaja.[9]

Po, mirësia e imanit që e bën njeriun të fitojë banesën e lumturisë së përjetshme nuk mund të jetë veçse mirësia e Atij që e krijoi atë banesë dhe e Atij që e bëri imanin si çelës për të; Ai është Allahu i Gjithëlavdishëm dhe Gjithëbujar dhe askush tjetër përveç Tij.

Askush nuk mund ta mbyllë këtë dritare më të madhe që ka pamje nga adhurimi ndaj të Adhuruarit të Vërtetë dhe askush nuk mund ta bllokojë këtë mjet më të rëndësishëm për tek Ai, apo ta vulosë.

Shkurtazi: Gjendjet e pjesshme më të holla dhe frutat që janë në majat më të skajshme të pemës së krijimit dëshmojnë dhe aludojnë për Unitetin Hyjnor dhe për vërtetimin e tij në dy mënyra:

Së Pari: Qëllimet e Hyjnisë në Univers grumbullohen në gjendjet e pjesshme; synimet e saj përqëndrohen në to; manifestimet e shumicës së Emrave të bukur Hyjnorë, shfaqja dhe përcaktimet e tyre grumbullohen në to; dhe rezultatet e krijimit të qënieve dhe dobitë e tyre shfaqen në to; prandaj secila prej tyre, duke u nisur nga kjo pikë e përqëndrimit dhe e grumbullimit, deklaron duke thënë: Unë jam prona e Atij që krijoi të gjithë universin; unë jam vepra dhe akti i Tij.

Mënyra e Dytë:

Zemra e atij fruti të pjesshëm, po ashtu edhe kujtesa e njeriut, që në një hadith quhet '*zemra e jashtme*'[10], është një indeks i përmbledhur i shumicës së llojeve, një model i zvogëluar i hartës së tij, një farë jolëndore e pemës së universit dhe një pasqyrë e hollë për shumicën e Emrave të bukur Hyjnorë. Kështu, përhapja e atyre zemrave dhe kujtesave, të cilat janë që të gjitha të ngjashme dhe mbajnë të njëjtën stampë, dhe janë shpërhapur gjërësisht duke dominuar në faqen e të gjithë universit, padyshim ato shikojnë tek Një i Vetëm në Dorën e të Cilit janë frerët e qiejve e të tokës dhe, secila prej tyre deklaron duke thënë: "Unë jam vepra dhe arti i vetëm Atij".

Për të përfunduar: Në lidhje me dobitë e tij, një frut shikon tek pronari i pemës së tij. Në lidhje me farën e tij, ai shikon tek të gjitha pjesët, anëtarët dhe tek natyra e pemës; dhe në lidhje me stampën në fytyrën e tij, ai shikon tek të gjithë frutat e pemës, stampa e të cilëve është e njëjtë. Ato bashkarisht deklarojnë: "Ne të gjithë jemi të njëjtë,

---

[9] Për shembull, *"Vërtet që Allahu, Ai është padyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, i Përhershmi më i Fortë",* (Kur'an, 51:58)
[10] Buhariu, al-Musir, v. 237; al-Nikah, v11.8;

kemi dalë nga një dorë e vetme. Ne jemi prona e një Pronari të Vetëm; Ai që krijoi njërën prej nesh, padyshim është Krijuesi i të gjithave prej nesh".

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, për sa ka të bëjë me stampat në faqet e qënieve të gjalla në skajet e sferës së shumësisë, dhe veçanërisht tek njeriu, sidomos për sa ka të bëjë me shenjat dalluese që gjenden në fytyrën e tij dhe lidhur me indeksin e tij si zemra, me rezultatet e natyrës së tij dhe me qënien e tij si një frut, ato të gjitha shikojnë drejtpërdrejtë tek Ai i Vetmi i Cili i mban qiejt dhe tokën nëpërmjet Hyjnisë së Tij madhështore dhe, ato të gjitha dëshmojnë për Unitetin e Tij.

Çështja e Dytë që bën të domosdoshëm Unitetin Hyjnor.

Ky është fakti se në Unitet janë një lehtësi dhe një kollajllëk deri në shkallën e domosdoshmërisë, ndërsa në shirk ndodhen vështirësi e probleme deri në shkallën e qënies së tij i pamundur. Kjo e vërtetë është shpjeguar e demonstruar me prova të shndritshme e vendimtare në shumë trajtesa prej atyre që Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, i quajti *Siraxhun-Nur -llamba Ndriçuese-* dhe veçanërisht në Letrën e Njëzet ku u shpjegua në mënyrë të hollësishme dhe në pikën e katërt të Shkreptimës së Tridhjetë ku u shpjegua shkurtazi.

Është demonstruar me provat më të fuqishme se në qoftë se të gjitha gjërat i atribuohen një Qënieje të Vetme, krijimi dhe rregullimi i Universit janë aq të lehta sa krijimi dhe rregullimi i një peme; dhe krijimi dhe bërja e një peme janë aq të kollajtë sa krijimi dhe bërja e një fruti; dhe krijimi dhe administrimi i një pranvere të plotë janë aq të lehta sa krijimi dhe administrimi i një luleje; dhe zhvillimi dhe edukimi i një lloji që përfshin individë të panumërt dhe administrimi i tyre është aq i lehtë dhe pa probleme sa lehtësia e një individi të vetëm.

Ndërsa në qoftë se, në rrugën e shirkut, të gjitha gjërat do t'u atribuoheshin shkaqeve dhe natyrës, krijimi i një individi të vetëm është aq i vështirë sa krijimi i species, madje sa ai i të gjitha specieve; dhe krijimi i një bërthame të vetme do të ishte aq i vështirë sa krijimi i pemës, madje sa ai i njëqind pemëve; dhe krijimi i një peme, ngritja e saj, gjallërimi, administrimi, përkujdesja dhe drejtimi i çështjeve të saj do të ishin aq të vështira e problematike si administrimi i të gjithë universit, madje edhe më e vështirë.

Meqenëse realiteti i çështjes është provuar në koleksionin *Siraxhun-Nur* në këtë mënyrë, dhe ne shohim një bollëk të madh në qëniet së bashku me shkallën më të lartë të artit dhe me vlerën më të madhe, saqë çdo qënie e gjallë, e cila është si një makineri e jashtëzakonshme përmban gjymtyrë e pjesë përbërëse të shumta, krijohet me bollëk absolut dhe me një lehtësi të jashtëzakonshme pa vështirësi dhe me një shpejtësi sa çel e mbyll sytë; kjo demonstron në mënyrë të domosdoshme dhe të vetëkuptueshme se ai bollëk i madh dhe ajo lehtësi burojnë nga uniteti dhe nga qënia e tyre veprat e një të Vetmi Unik.

Përndryshe, në të kundërt, nuk do të kishte lirësi (malli), bollëk, shpejtësi, lehtësi dhe vlerë; një frut që tani merret me pesë para nuk do të merrej me pesëqind lira, ose do të kishte qenë aq i rrallë, sa të ishte i paarritshëm, i pagjendshëm. Dhe lehtësia e shikuar në krijimin e gjallesave dhe kollajllëku në veprimin e tyre të organizuar si lehtësia dhe organizimi i punës së orës ose i makinerive elektrike të cilat punojnë thjesht me prekjen e çelësave të tyre.. Unë them se kjo lehtësi e shikuar në krijimin e qënieve të gjalla dhe kollajllëku në veprimin e tyre, bëhet -në rrugën e shirkut- e vështirë dhe problematike deri në shkallën e pamundësisë.

Dhe qëniet e gjalla që linden në një ditë ose në një orë, madje në një minut dhe vijnë në jetën e dynjasë me gjymtyrët e tyre të plota dhe me kushtet e jetës së tyre, nuk do të vinin në ekzistencë -në rrugën e shirkut- as për një vit, as për një shekull, dhe madje nuk do të vinin kurrë.

Është provuar në më shumë se njëqind vende në mënyrë vendimtare në koleksionin *Siraxhun-Nur* saqë do ta bënte të heshtë edhe mohuesin më kryeneç e kokëfortë, se në qoftë se të gjitha gjërat do t'i atribuoheshin Një të Vetmi Unik të Unitetit, atëherë krijimi dhe sjellja në ekzistencë e tyre do të ishin si krijimi i një gjëje të vetme dhe do të realizoheshin me një shpejtësi të jashtëzakonshme dhe me një lirësi e bollëk të madh. Ndërsa në qoftë se shkaqeve dhe natyrës do t'u jepej gjithashtu një pjesë, atëherë krijimi i një gjëje të vetme do të bëhej aq i vështirë, i ngadaltë, i papërfillshëm, i parëndësishëm dhe i shtrenjtë sa ai i të gjitha gjërave. Në qoftë se dëshiron të shohësh provat e kësaj të vërtete, ti mund t'u referohesh Letrës së Njëzet, Letrës së Tridhjetë e Tretë, Fjalës së Njëzet e Dytë dhe Fjalës së Tridhjetë e Dytë, Shkreptimës së Njëzet e Tretë, e cila është rreth Natyrës, dhe Shkreptimës së Tridhjetë që është rreth Emrit më të madh, veçanërisht Pikës së Katërt dhe Pikës së Gjashtë të saj që janë

rreth Emrave Hyjnorë ***El-Ferd*** dhe ***El-Kajjum***. Ti do të shohësh se kjo e vërtetë është provuar me aq siguri sa "dy edhe dy bëjnë katër". Ndërsa këtu ne do të aludojmë vetëm për një argument të vetëm prej atyre qindra argumenteve, sa vijon:

Krijimi i të gjitha gjërave është ose nga mosekzistenca ose nga elementet dhe qëniet e tjera në formën e kompozimit -përbërjes.

Në qoftë se krijimi dhe sjellja në ekzistencë do t'u atribuohej Një të Vetmi Unik, atëherë do të duhej patjetër që Esenca e Gjithëlavdishme të kishte një njohje gjithëpërfshirëse për gjithçka dhe një fuqi mbisunduese mbi të gjitha gjërat. Në këtë mënyrë, dhënia e ekzistencës së jashtme për gjërat, format e të cilave janë të pranishme në Njohjen e Tij ose të cilat ekzistojnë si njohje tek Ai xh.sh. dhe sjellja e tyre nga një mosekzistencë e jashtme, është aq e lehtë dhe e thjeshtë sa ndezja e një shkrepëseje, ose si lehtësia e shpërndarjes së një lënde kimike mbi një shkrim të padukshëm me qëllim që ta shfaqë atë, ose si kalimi i një imazhi prej filmit fotografik në letër. Nëpërmjet urdhrit *"Bëhu! Dhe ajo bëhet (në çast)!"* Krijuesi xh.sh. i nxjerr gjërat nga një mosekzistencë e jashtme për në ekzistencë të jashtme, gjëra që planet e të cilave, programet, format, trajtat dhe përpjesëtimet e të cilëve janë të pranishme në njohjen e Krijuesit të Gjithëlavdishëm.

Ndërsa në qoftë se krijimi do të ishte në formën e kompozimit -përbërjes- dhe artit dhe jo prej mosekzistencës, atëherë grumbullimi i tij prej elementeve dhe prej qënieve është tjetra shumë e lehtë, sepse ashtu si grumbullimi i ushtarëve të shpërndarë e të lidhur me një regjiment të caktuar me anë të zërit të një borie dhe secili prej tyre duke marrë një pozitë të rregullt e të organizuar që është një çështje e lehtë, dhe të gjithë ushtarët janë si një forcë mbështetëse për komandantin e tyre, për ligjin e tij depërtues dhe për syrin e tij largpamës me qëllim që të lehtësojë këtë ushtrim ushtarak dhe për të ruajtur një pozitë të caktuar, po ashtu, në të njëjtën mënyrë, mobilizohen grimcat e vockëla nën komandën e Krijuesit të të gjitha botëve nëpërmjet parimeve të Kaderit dhe të Njohjes së Tij dhe nëpërmjet ligjeve të Fuqisë së Tij mbisunduese dhe, qëniet që kanë kontakt me ato grimca bëhen si të ishin fuqia e Atij Sulltani, ligji i Tij, nëpunësit e Tij dhe mjete lehtësimi e kollajllëku. Kështu ato grimca vijnë për t'i dhënë formë ekzistence një qënieje të gjallë, futen brenda një mase të përcaktuar që i ngjason një kallëpi jolëndor të specifikuar nga njohja dhe nga Kaderi Hyjnor, dhe ndalojnë atje.

Por në qoftë se krijimi i gjërave do t'u atribuohej duarve dhe shkaqeve të ndryshme dhe natyrës, atëherë cilido shkak qoftë nuk

mund të krijojë asgjë nga mosekzistenca dhe nga asgjëja -nga asnjë drejtim; dhe për këtë kanë pajtueshmëri mendimi të gjithë njerëzit e arsyes; sepse ai shkak nuk posedon njohuri gjithëpërfshirëse për çdo gjë dhe as fuqi mbisunduese mbi gjithçka. Prandaj ajo mosekzistencë nuk do të ishte vetëm një moseksistencë e jashtme dhe e dukshme, por gjithashtu do të ishte një mosekzistencë absolute. Dhe mosekzistenca absolute nuk do të ishte kurrë burimi i një ekzistence. Prandaj do të duhej që krijimi të ishte në formën e kompozimit -përbërjes.

Gjendja është se kompozimi -përbërja- e trupit të një mizeje të vetme apo kompozimi i një luleje të vetme do të bënte të domosdoshme të grumbulloje të gjitha grimcat e tij prej të gjithë sipërfaqes së tokës pasi t'i filtronte e t'i pastronte duke i kaluar përmes një site të hollë të veçantë dhe kjo do të mund të bëhej veçse me vështirësi të pallogaritshme. Madje edhe në qoftë se ato do të grumbulloheshin, ruajtja e tyre në një formë të rregullt pa u shpërndarë brenda atij trupi do të ishte një çështje tjetër e vështirë për shkak të mospasjes së kallëpeve jolëndorë ekzistues si njohje, sepse do të duhej të ekzistonin aq shumë kallëpe fizikë e natyralë, sa numri i gjymtyrëve të asaj qënie të gjallë, me qëllim që të mund të formohet ai trup i gjallesës..

Kështu, t'ua atribuosh krijimin e të gjitha gjërave një të Vetmi Unik, do të lindte një lehtësi e skajshme deri në shkallën e domosdoshmërisë, në kundërshtim me atribuimin e krijimit shkaqeve të shumta gjë e cila lind aq shumë vështirësi e probleme deri në shkallën e pamundësisë. Gjithashtu, në qoftë se çështja e të gjitha gjërave do t'i atribuohej Një të Vetmi të Unitetit, ato do të bëheshin të çmueshme në shkallën më të skajshme me bollëkun absolut dhe plot art me urtësinë e fuqinë më të skajshme, ndërsa në qoftë se -në rrugën e Shirkut- çështja e qënieve do t'u atribuohej shkaqeve të shumta dhe natyrës, ato do të ishin në një shtrenjtësi të skajshme edhe pse janë në pavlefshmërinë, keqformimin dhe në dobësinë më të skajshme; sepse ashtu si një njeri që i bashkohet ushtrisë, bëhet i lidhur me një komandant dhe mbështetet tek ai, fiton një forcë morale të ushtrisë, pasi ai do të mund të grumbullonte për të një ushtri të madhe në qoftë se do ta kërkonte medoemos puna.

Përveç kësaj, forca e atij komandanti dhe ushtria janë si një fuqi rezervë për të; kështu fuqia e tij individuale shumëfishohet me mijëra herë dhe ai fiton një forcë fizike përveç qënies së tij i padetyruar për të mbajtur burimet e asaj fuqie me të cilën është lidhur dhe as të mbajë municionet e pajimet e tij meqë ato i mban ushtria. Prandaj, ai ushtar

ka mundësi të zërë rob një mareshall armik, ose të detyrojë banorët e një qyteti të shpërngulen, ose të kapë e nënshtrojë një kështjellë të madhe. Veprat e tij do të ishin të jashtëzakonshme dhe me një rëndësi e vlerë shumë të madhe.

Por, në qoftë se ai person do ta linte ushtrinë dhe do të qëndronte më vete i braktisur, ai do ta humbiste atë fuqi të mrekullueshme morale, atë forcë e atë mbështetje dhe do të bëhej një njeri i zakonshëm dhe do të ishte i aftë të kryente veçse vepra të parëndësishme, të pjesshme e të pavlefshme në raport me fuqinë e tij individuale dhe do të zvogëloheshin arritjet e tij me atë përpjesëtim.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, meqenëse në rrugën e Unitetit Hyjnor çdo gjë bëhet e lidhur me të Gjithëfuqishmin e Gjithëlavdishëm dhe mbështetet tek Ai, një mizë mund të shpartallojë një Faraon, një mushkonjë mund të mposhtë një Nimrud dhe një mikrob mund të zhdukë një tiran.

Gjithashtu, një farë e vockël mund të mbajë mbi shpatullat e saj një pemë të madhe si Mali, përveç qënies së saj si burimi dhe magazina e të gjitha mjeteve të asaj peme dhe i anëtarëve të saj.

Gjithashtu, të gjitha grimcat nëpërmjet asaj lidhjeje e mbështetjeje, mund të kryejnë detyra të panumërta në formimin e trupave, të cilët mbajnë mijëra lloje, forma, modele dhe arte.

Punët në të cilat janë vënë në shërbim ato nëpunëse të vockëla dhe ato ushtarë të vegjël janë pafundësisht të përkryera dhe me artin e me vlerën më të madhe, sepse Ai i Cili i bën ato vepra është i Gjithëfuqishmi i Gjithëlavdishëm që i ka vendosur në dorën e atyre nëpunësve këto vepra dhe i ka bërë ato si perde për Fuqinë e Tij.

Mirëpo në qoftë se çështja do t'u atribuohej shkaqeve, ashtu siç është në rrugën e shirkut, atëherë veprat e një mize do të ishin aq të papërfillshme e të vogla sa vetë miza dhe arti i grimcës nuk do të konsiderohej gjë ashtu si vetë grimca. Domethënë çdo gjë do të humbiste vlerën si në kuptim ashtu dhe fizikisht, saqë askush nuk do të jepte asnjë grosh për të gjithë dynjanë.

Meqenëse realiteti është ky; dhe meqenëse ashtu siç shohim me sytë tonë, çdo gjë është pafundësisht e çmueshme, plotë art, kuptimplotë dhe e fuqishme; atëherë pa dyshim nuk ka rrugë tjetër përveç rrugës së Unitetit Hyjnor. Në qoftë se do të kishte pasur rrugë tjetër veç saj, do të bëhej e domosdoshme t'i ndryshoje të gjitha qëniet dhe ta boshatisja dynjanë në mosekzistencë dhe atëherë ta rimbushje

përsëri atë me gjepura të pakuptimta në vend të tyre me qëllim që të mund të hapet një rrugë për shirkun që të ndiqet!!

Dhe ja, ti tashmë ke dëgjuar një përmbledhje të një prove të vetme lidhur me Unitetin Hyjnor prej qindra provave të shpjeguara në Risale-i Nur, që në fjalët e Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, është *Siraxhun-Nur -llamba Ndriçuese.*

Ti mund të bësh anologji me këtë për të tjerat.

Çështja e Tretë që bën të domosdoshëm Unitetin Hyjnor

Krijimi në çdo gjë dhe sidomos në gjallesa është me një art të jashtëzakonshëm dhe me një përkryerje të skajshme.

Për më tepër, bërthama e vogël është një model i vogël i frutit; fruti është një model i zvogëluar i pemës; pema është model i zvogëluar i llojit, dhe lloji është modeli i universit dhe shembulli i tij i zvogëluar, indeksi i tij i përmbledhur, harta e tij e thukët, bërthama e tij jolëndore, në kuptim, një pikë gjithëpërfshirëse dhe një pikël e grumbulluar dhe e distiluar nga universi sipas parimeve të njohjes dhe të peshave të urtësisë. Prandaj Ai që krijon njërën nga ato që u përmendën, nuk ka dyshim se Vetëm Ai është Krijuesi i të gjithë universit. Po, Ai që krijoi farën e një bostani është, në mënyrë të vetëkuptueshme, Ai që krijoi bostanin; nuk mund të jetë dikush tjetër përveç Tij, kjo do të ishte krejtësisht e pamundur.

Po, ne shohim se çdo qelizë në gjak është shumë e organizuar dhe kryen aq shumë detyra të mëdhaja të cilat nuk janë më të vogëla nga rëndësia se sa detyrat që kryhen nga yjet. Gjithashtu rruazat e kuqe e të bardha në gjak që punojnë me një shkallë të tillë vetëdijeje në mbrojtjen dhe në të ushqyerit e trupit, saqë ato parakalojnë në plotësim nëpunësit më të mëdhenj -ministrat- dhe më të sinqertë se sa ushtarët e ruatjes -bodigardët. Të gjitha qelizat e trupit manifestojnë procese të tilla të rregullta dhe janë të mirorganizuara në hyrjet dhe në daljet dhe me një aktivitet të vazhdueshëm në trup saqë parakalojnë administrimin e trupit më të përkryer dhe atë të pallatit më të përsosur.

Secili prej individëve të kafshëve dhe të bimëve mban shenja të tilla dalluese në fytyrën e tij dhe makineri të tilla në kraharorin e tij, saqë vetëm Ai që i krijoi të gjitha kafshët dhe bimët, mund t'i vendosë ato shenja.

Dhe çdo lloj prej llojeve të gjallesave është shpërndarë në mënyrë të tillë të rregullt dhe është përzier në mënyrë të përshtatshme e të

harmonizuar me llojet e tjera, saqë nuk mund ta krijojë atë lloj dhe nuk mund t'i drejtojë çështjet e tij veçse Ai që i krijoi të gjitha ato lloje, që i drejton, që i administron çështjet e tyre, dhe që kujdeset për to në të njëjtën kohë, saqë i bëri ato lloje të ngjyrosura e të larmishme si një sixhade e gjallë e thurur prej katërqind mijë prej specieve të kafshëve dhe të bimëve të shpërndara mbi të gjithë faqen e tokës.

Në qoftë se do të bëheshin analogji me këto për gjëra të tjera, do të kuptohej se lidhur me krijimin dhe sjelljen në ekzistencë, universi është një tërësi që nuk mund të ndahet në pjesë, dhe për sa i përket Hyjnisë dhe drejtimit të çështjeve, është një universale ndarja e së Cilës është e pamundur.

Ky faktori i tretë, i cili bën të domosdoshëm -Unitetin Hyjnor-, është shpjeguar e provuar në mënyrë vendimtare e të ndritshme në shumë trajtesa të koleksionit *Siraxhun-Nur* dhe veçanërisht në Vendqëndrimin e Parë të Fjalës së Tridhjetë e Dytë, duke demonstruar se ashtu si reflektimet e diellit, një provë e Unitetit dhe vërtetimi i tij reflektohet e përfaqësohet në pasqyrën e çdo gjëje. Duke u mjaftuar me ato shpjegime, ne po e presim shkurt këtu një tregim të gjatë.

STACIONI I TRETË

[Në këtë stacion do të shpjegohen tre shenja universale për vërtetimin e Unitetit Hyjnor]

Shenjat, provat dhe dëshmitë e Unitetit Hyjnor janë të pallogaritshme. Meqenëse mijëra prej atyre provave janë shpjeguar në detaje në koleksionin *Siraxhun-Nur*, në këtë stacionin e Tretë do të shtjellohen në mënyrë të përmbledhur tre prova universale.

Shenja e Parë dhe Prova

Fraza ***Vahdehu,*** *Ai është Një*, është përfundimi i kësaj. Në çdo gjë ka një unitet, dhe uniteti tregon Një të Vetëm. Po, një vepër që ka unitet, në mënyrë të vetëkuptueshme buron nga një autor; kështu, një buron nga një. Fakti se ndodhet një unitet në çdo gjë demonstron se ato janë veprat dhe artifaktet e Një të Vetmi Unik. Po, universi është si një gonxhe trëndafili e mbështjellë me mijëra perde Uniteti. Madje ai është një njeri shumë i madh i veshur me aq shumë rroba uniteti sa numri i Emrave të bukur Hyjnorë dhe i akteve të tyre universale e gjithëpërfshirëse. Ose ai është Pema Tuba e krijimit nga degët e së cilës varen llojet e unitetit aq sa numri i llojeve të krijesave.

Po, administrimi i universit është një dhe i njëjti; drejtimi i çështjeve të tij është Një dhe i njëjti; Sovraniteti i Tij është një dhe i njëjti; shenja, stampa e tij është një dhe e njëjta.. dhe kështu, një, një, një deri në një mijë, janë të gjitha nga i Njëjti, Njëri.. po kështu Emrat e bukur Hyjnorë dhe aktet e tyre që administrojnë këtë univers, secili prej tyre janë një dhe i njëjti; Çdo Emër dhe çdo akt rrethon të gjithë universin ose pjesën më të madhe të tij. Domethënë, urtësia që vepron në të është një dhe e njëjta; organizimi në të është i njëjti; furnizimi me ushqim në të është një dhe i njëjti; mëshira që nxiton për t'u ardhur në ndihmë atyre në nevojë është një dhe e njëjta, shiu që është shpërndarësi i asaj mëshire prej pijeve të buta, është një dhe i njëjti, dhe kështu, një, një, një... deri në një mijë, janë që të gjitha një dhe e njëjta.

Po kështu edhe dielli i cili përhap ngrohtësi për këtë univers është një dhe i njëjti; hëna, llamba e tij, është një dhe e njëjta; zjarri, i cili pjek ushqimet, është një dhe i njëjti; malet e tij që janë depot e tij, thesaret dhe direkët, janë një dhe e njëjta; retë që vadisin kopshtet janë një dhe e njëjta; Dhe kështu një, një, një deri në një mijë gjëra, janë që të gjitha një dhe e njëjta.

Të gjithë këto shembuj uniteti në botë janë prova që e tregojnë të Vetmin e Unitetit aq qartë dhe shndritshëm sa dielli. Për më tepër, elementet dhe botërat e qënieve të universit secili duke rrethuar faqen e tokës, dhe duke qenë një dhe e njëjta; dhe ndërfutja dhe bashkimi i tyre nëpërmjet lidhjeve të ndërsjella e të përbashkëta dhe madje edhe nëpërmjet ndihmës reciproke, padyshim janë shenja të qarta se Pronari i universit, Krijuesi dhe Autori i tij është Një dhe i Njëjti.

Shenja e Dytë dhe Prova

Përfundimi i kësaj është Fraza ***La sherike lehu***, *Ai nuk ka shokë*. Ky është fakti se ndodhet një rregull i patëmetë dhe më i ploti dhe harmonia më e bukur dhe balanca e drejtë e cila nuk bën absolutisht padrejtësi në çdo gjë në univers duke filluar nga grimcat për tek planetët.

Po, rregulli i përkryer dhe harmonia e balancuar mund të ndodhin vetëm nëpërmjet unitetit dhe njësisë; sepse në qoftë se do të ndërhynin shumë duar në një akt të Vetëm, ato do të shkaktonin vetëm konfuzion e do ta prishnin atë.

Eja tani dhe shqyrtoje madhështinë e këtij rregulli të përkryer; ai e ka bërë këtë univers në formën e një pallati madhështor e gjigant, në selicin prej gurëve të tij është aq plot art sa ai i gjithë pallatit.. dhe e ka bërë atë si një qytet madhështor, të hyrat dhe të dalat e të cilit dhe mallrat dhe ushqimet e vlefshme të pakufishme, arrijnë në mënyrë të rregullt e të përkryer mu në kohën e duhur prej vendeve të paparashikuara nga prapa perdes së të Padukshmes. Rregulli gjithashtu e ka transformuar universin në një libër elokuent të mrekullueshëm aq kuptimplotë, saqë secila nga shkronjat shpreh kuptimet e njëqind rreshtave, dhe çdo rresht në të shpreh kuptimet e njëqind faqeve, dhe çdo faqe në të shpjegon kuptimet e njëqind kapijtujve, dhe çdo kapitull në të shpreh me elokuencë kuptimet e njëqind librave. Për më tepër, të gjithë kapitujt e tij, faqet, rreshtat, fjalët dhe shkronjat shikojnë njëra-tjetrën dhe aludojnë për njëra-tjetrën.

Tani eja dhe shiko rregullin e përkryer brenda kësaj rregullsie të çuditshme: Ai e ka bërë të gjithë universin sa të pastër aq modern; ose e ka bërë atë si të ishte një pallat i bukur madhështor i cili në mënyrë të vazhdueshme pastrohet e fshihet; ose si një *huri* xhenneti duke veshur shtatëdhjetë mantele, veshje të zbukuruara e të stolisura njëra mbi tjetrën; madje është si një gonxhe trëndafili e mbështjellë me shtatëdhjetë petla të holla, të zbukuruara e shumëngjyrëshe.

Tani eja dhe shqyrtoje drejtësinë e plotë të balancës brenda rregullit dhe pastërtisë ku çdo gjë peshohet me atë balancë. Krijesat dhe organizmat mikroskopikë që nuk mund të shihen veçse pasi të zmadhohen një mijë herë, po kështu yjet dhe diejt të cilët janë një mijë herë më të mëdhenj se sa toka, secili prej tyre peshohet në ato pesha e balanca dhe të gjitha atyre krijesave u jepen domosdoshmëritë e tyre pa mangësi. Ato krijesa shumë të vogla dhe ato qënie gjigante qëndrojnë të barabarta sup më sup përpara asaj peshoreje, peshores së drejtësisë, pavarësisht se midis të mëdhajave ndodhen disa që në qoftë

se do ta humbisnin balancën e tyre sikur edhe për një sekond të vetëm, ajo do të shkatërronte ekuilibrin e botës dhe do të ndodhte kijameti.

Tani eja dhe shikoje bukurinë dhe hijeshinë tërheqëse të mahnitshme brenda rregullit, pastërtisë dhe balancës; ajo e ka bërë universin e gjërë si një festival shumë të bukur e të shkëlqyeshëm, në formën e një ekspozite madhështore me stolisje të skajshme dhe si një pranverë vezulluese me lule të çelura menjëherë; ajo e ka bërë pranverën e madhe gjithashtu si një lule të gjërë madhështore duke e mbuluar faqen e tokës me qindra e mijëra prej luleve të bukura të saj.

Të gjitha lulet e pranverës i ka zbukuruar me çdo lloj dekorimi. Po, nëpërmjet manifestimeve të bukura të Emrave më të bukur Hyjnorë, të cilët zotërojnë bukurinë dhe hijeshinë më të skajshme, të gjitha botët e qënieve në univers dhe të gjithë anëtarët e secilit, manifestojnë një bukuri të tillë në përputhje me kapacitetet e tyre saqë *Huxhxhetul Islam* Imam Gazali tha: "*Nuk mund të jetë asgjë më e mirë ose më e bukur se sa ajo që ekziston në sferën e mundësisë"*, kështu, kjo bukuri gjithëpërfshirëse e tërheqëse, kjo pastërti e përgjithshme e jashtëzakonshme, dhe kjo balancë e ndjeshme dominuese e gjithanshme, dhe kjo rregullsi dhe harmoni e mrekullueshme që rrethon gjithçka, janë prova të tilla dhe shenja të unitetit Hyjnor saqë ato janë më të pastërta dhe më të ndritshme se sa drita e diellit në mesditë.

[Një përgjigje tej mase e shkurtër por shumë e fuqishme ndaj një pyetjeje me dy pjesë që lidhet me këtë stacion]

Pjesa e Parë e Pyetjes:

Ti thua në këtë stacion se bukuria, hijeshia, mirësia dhe drejtësia kanë rrethuar e përfshirë universin. Por çfarë thua ti për shëmtitë, fatkeqësitë, sëmundjet, sprovat dhe vdekjet që ne i shohim përreth nesh?

Përgjigjja: Një shembull i vetëm shëmtie që është shkak për të prodhuar shembuj të shumtë bukurie ose është shkak për t'i shfaqur ato, konsiderohet gjithashtu bukuri. Ndërsa mosekzistenca e një shëmtie që çon në fshehjen e shembujve të shumtë të bukurisë dhe në mosshfaqjen e tyre, nuk konsiderohet një shëmti e vetme, por një shëmti e shumëfishtë. Për shembull, në qoftë se nuk do të ekzistonte një shëmti si një njësi matëse, atëherë bukuria do të bëhej vetëm një lloj dhe shkallët e saj të shumta do të mbeteshin të fshehura; por nëpërmjet ndërhyrjes së shëmtisë zbulohen shkallët e bukurisë; sepse ashtu siç shfaqen shkallët e nxehtësisë nëpërmjet ekzistencës së të

ftohtit, dhe shkallët e dritës njihen nëpërmjet errësirës, po ashtu shembujt universalë të së mirës, dobitë universale, mirësitë universale dhe shembujt universalë të bukurisë bëhen të dukshme nëpërmjet ekzistencës së një të keqeje të pjesshme, një dëmi të pjesshëm dhe të një shëmtie të pjesshme. Kjo do të thotë se krijimi i shëmtisë nuk është e shëmtuar, por është e bukur, sepse rezultatet e shumta që shkaktohen, që lindin prej saj janë të bukura. Po, një njeri përtac i cili pëson dëm prej shiut, dëmi i tij nuk mund t'i mohojë rezultatet e mira të cilat e bëjnë shiun mëshirë; ai nuk mund ta transformojë mëshirën në dëmtim -në zemërim.

Sa për përkohshmërinë, zhdukjen dhe vdekjen, është demonstruar me prova tej mase të fuqishme vendimtare në Letrën e Njëzet e Katërt se ato nuk janë në kundërshtim me mëshirën e përgjithshme, me bukurinë e gjithanshme dhe me mirësinë gjithëpërfshirëse; përkundrazi, ato në fakt bëhen të domosdoshme prej këtyre gjërave. Madje edhe krijimi i shejtanit, meqenëse është shkak për lëvizjen e dy pulsimeve themelore për përparimin shpirtëror të njeriut, domethënë, për 'Garën dhe përpjekjen' -Luftën-, atëherë krijimi i species së shejtanit është gjithashtu e mirë dhe nga ky aspekt krijimi i tyre konsiderohet e bukur.

Madje edhe ndëshkimi i mohuesve në Xhehennem është gjë e mirë, gjë e bukur, sepse nëpërmjet mosbesimit, mohimit të tyre ata kanë shkelur të drejtat e të gjitha qënieve dhe kanë fyer e prekur nderin e tyre. Meqenëse këto dy pika janë shpjeguar në detaje në trajtesat e tjera, ne mjaftohemi këtu me këtë tregues të shkurtër.

Pjesa e Dytë e Pyetjes[11]

Le ta pranojmë përgjigjen rreth shejtanit dhe jobesimtarëve nga ky këndvështrim i përgjithshëm, por përse i Pasuri Absolut i Vetëmjaftueshëm, i Bukuri Absolut, Mëshirëploti Absolut dhe më i Miri Absolut i sprovon individët e dobët me fatkeqësi, me të këqija e me shëmti?

Përgjigjja: Të gjitha llojet e mirësisë, bukurisë dhe të mirëbërësisë vijnë drejtëpërdrejtë prej thesarit të mëshirës së Atij Hirploti Absolut dhe mëshirëploti Absolut dhe vijnë prej vërshimit të mirëbërësisë së Tij të veçantë. Ndërsa fatkeqësitë dhe të këqijat janë rezultate të pjesshme të pakta dhe individuale prej rezultateve të shumta të ligjeve të përgjithshme univesale dhe të kanuneve të mbretërimit të Hyjnisë së

[11] Përgjigjja për pjesën e dytë të pyetjes është shumë e rëndësishme; ajo largon dyshime të shumta.

Tij të cilat përfaqësojnë dëshirat e Tij universale dhe quhen ***A'datull-llah.***

Kështu, ato gjëra bëhen të pjesshme dhe kërkohen prej atyre ligjeve. Prandaj Ai -Allahu- i krijon ato pasoja të pjesshme të këqija me qëllim që t'i ruajë e t'i mbajë ato ligje të cilat janë boshti për dobitë universale. Mirëpo përballë atyre rezultateve të pjesshme të dhimbshme, Ai u përgjigjet me ndihmë të mëshirshme të veçantë dhe me favore Hyjnore të veçanta thirrjeve e britmave për ndihmë të individëve të goditur nga fatkeqësitë e nga sprovat. Me këtë shfaq se Ai është Vepruesi me zgjedhje, me dëshirë dhe se të gjitha aspektet e të gjitha gjërave janë të lidhura me dëshirën e Tij dhe, se edhe ligjet universale gjithashtu i nënshtrohen gjithmonë Vullnetit dhe Zgjedhjes sëTij; dhe se një Krijues, Mbështetës Mëshirëplotë e dëgjon thirrjen e atyre që vuajnë nga shtrëngimi dhe ngushtësia e atyre ligjeve të përgjithshme dhe i ndihmon dhe i mbështet ata me mirësitë e me favoret e Tij; dhe se Ai me këto mirëbërësi të veçanta dhe me bërjen të dashur të Vetvetes së Tij në mënyra të veçanta, ka hapur dyert e manifestimeve të Tij të veçanta, pasi ka hapur një fushë të pafundme e të pakufizuar për manifestimet e Emrave të Tij të pakufishëm e të pakufizuar nëpërmjet përjashtimeve -nga rregullat- të ligjeve universale dhe të kanuneve të përgjithshme dhe të rezultateve të tyre të pjesshme të këqija.

Meqenëse kjo shenja e dytë e vërtetimit të Unitetit Hyjnor është sqaruar ndoshta në njëqind vende tek koleksioni *Siraxhun-nur*, ne u mjaftuam me një aluzion të shkurtër për të.

Shenja e Tretë dhe Prova

Kjo përbëhet nga stampa të panumërta të unitetit Hyjnor për të cilat aludojnë frazat "***Lehul-Mulku Ve Lehul-Hamdu***", "*I Tij është Sundimi dhe Atij i takon lavdërimi".*

Po, ashtu si manifestimi i diellit në pasqyrë që tregon diellin,po ashtu në fytyrat e të gjitha gjërave, qofshin të pjesshme apo universale duke filluar nga grimcat e vockëla për tek planetët ndodhet një stampë, një shenjë e qartë, si një pasqyrë, duke treguar Diellin e parapërjetësisë dhe të paspërjetësisë dhe dëshmon Unitetin e Tij. Meqenëse shumica e atyre stampave, shenjave të pakufishme janë përshkruar në detajë në koleksionin *Siraxhun-Nur*, ne këtu do të mjaftohemi me një tregues vetëm për tre prej tyre, sa vijon:

Ashtu si në fytyrën e universit si një tërësi ne shohim se është vendosur një stampë e madhe uniteti që përbëhet nga ndihma e ndërsjellë, bashkëpunimi, mbështetja reciproke, ngjashmëria e ndërsjellë dhe ndërfutja midis specieve të qënieve, secila përballë tjetrës, po ashtu në faqen e tokës është një stampë që vërteton Unitetin Hyjnor e vendosur në ushtrinë e të Gjithëlavdishmit të Vetëm, ushtri e cila përbëhet nga katërqind mijë specie prej llojeve të kafshëve e të bimëve, duke iu dhënë të gjithave furnizimet e tyre, armët, uniformat, instruksionet dhe shkarkimet e çmobilizimet të cilat që të gjitha janë të ndryshme e të llojllojshme me rregullsi të plotë, pa ngatërresë dhe tamam në kohën e duhur.

Gjithashtu në fytyrën e njeriut shikohet një stampë Uniteti të cilën e tregon ekzistenca e shenjave dalluese në fytyrën e çdo njeriu, tipare që e dallojnë atë nga të gjitha fytyrat e tjera në të gjithë tokën. Madje në fytyrën e çdo qënie, qoftë e pjesshme apo universale, shihet një stampë uniteti. Gjithashtu në kokën e çdo krijese, qoftë e madhe apo e vogël, e pakët apo e shumtë vëzhgohet një vulë e Njësisë Hyjnore. Stampat e qënieve të gjalla janë veçanërisht të ndritshme e vezulluese; madje çdo qënie e gjallë në vetvete është një stampë uniteti, një vulë njësie, një firmë e Krijuesit të Përjetshëm.

Po, të gjitha lulet, të gjithë frutat, të gjitha gjethet, të gjitha bimët dhe të gjitha kafshët janë vula të tilla të Njësisë Hyjnore dhe stampa të Krijuesit të Përjetshëm saqë ato i transformojnë të gjitha pemët në formën e mesazheve Hyjnore; të gjitha speciet e krijesave i transformojnë në formën e një libri të të Gjithëmëshirshmit; të gjitha kopshtet në formën e një dekreti mbretëror, Hyjnor; madje ka vënë në atë mesazh, në mesazhin e pemës, aq shumë vula sa numri i luleve të saj, aq shumë firma sa numri i frutave të saj dhe aq shumë stampa sa numri i gjetheve të saj. Gjithashtu ka vendosur në atë libër, në librin e llojeve dhe të specieve, aq shumë vula aq sa numri i individëve të tyre, të cilat shfaqin shkruesin e tij dhe e bëjnë të njohur Atë; Gjithashtu ka vendosur në dekretin mbretëror Hyjnor, në dekretin e kopshtit aq shumë stampa të Unitetit Hyjnor aq sa numri i bimëve, i pemëve dhe i kafshëve që ndodhen në të, duke bërë të njohur Autorin e tyre, Sulltanin urdhërues. Në fakt ndodhen katër stampa të Unitetit Hyjnor në të gjitha pemët, në origjinat dhe në fundet e tyre, në anët e jashtme dhe në anët e tyre të brendshme për të cilat aludojnë Emrat e bukur Hyjnorë: ***El-Ev-Velu, EL-A'hiru***, ***Edh-Dhahiru, El-Batinu,*** *I Pari* dhe *i Fundit, I Jashmi dhe i Brendshmi -i Dukshmi, i Padukshmi.*

Ashtu siç tregon Emri ***El-Ev-vel***, *I Pari*, farërat[12] origjinale të pemëve frutdhënëse janë arka, kutia të vogëla që përmbajnë programet e atyre pemëve, indekset e tyre dhe planin e punës së tyre.. Ato janë punishtet e vogëla që përmbajnë aparatet, domosdoshmëritë dhe formimet e tyre. Ato janë makineritë që përmbajnë sistemet e tyre, të ardhurat e tyre të holla dhe harxhimet e tyre të holla në fillimin e jetës së tyre.

Ashtu siç tregon Emri ***El-A'hir,*** *i Fundit*, rezultatet dhe frutat e pemëve përfaqësojnë tabelat e njoftimit për pemët, janë letra njoftimi pasi ato mbajnë format e pemëve, gjendjet dhe cilësitë e tyre.. Ato janë shpallje duke pohuar funksion, dobitë dhe veçoritë e pemëve.. Ato janë përmbledhje duke njoftuar e treguar për shembujt, shoqet e atyre pemëve, pasardhësët e tyre dhe për brezat që do të vijnë pas tyre; këtë e bëjnë nëpërmjet farërave që i mbajnë në zemrat e frutave.

Ashtu siç tregon Emri ***Edh-Dhahir,*** *I Jashtmi -i Dukshmi-*, format dhe trajtat në të cilat vishen pemët janë mantele të qëndisura e të modeluara me mjeshtëri të cilat janë prerë e shkurtuar, rregulluar e zbukuruar tamam në përputhje me degët, me anëtarët dhe me pjesët e pemëve. Ato veshje, janë aq të holla, aq të drejtëpeshuara dhe kuptimplote saqë i transformojnë pemët në formën e një libri, të një mesazhi dhe në formën e një poeme.

Ashtu siç tregon Emri *El-Batin, i Brendshmi -i Padukshmi-*, punishtet brenda pemëve janë fabrika që prodhojnë të gjitha pjesët dhe anëtarët e pemëve dhe, i drejtojnë dhe i administrojnë ato me balancën më të hollë e më të ndjeshme. Ato gjithashtu dërgojnë me rregullsi të plotë e me sistem të përkryer ushqimin dhe substancat e domosdoshme për të gjithë anëtarët e tyre të veçantë e të ndryshëm. Ato fabrika të çuditshme veprojnë me një shpejtësi të skajshme si ajo e vetëtimës dhe me një lehtësi të skajshme si ajo e kurdisjes së një ore dhe, me një uniformitet, rregullsi e njëtrajtësi të tillë si bindja e ushtrisë ndaj urdhrit të komandantit, saqë prej tyre çuditin mendjet.

---

[12] Qysh nga kohët e lashta, një shprehje e përgjithshme në gjuhën popullore që u bë si proverb ishte "ngritja (dalja) prej farës", e cila mund të shihet si një lloj aluzioni për autorin e kësaj trajtese; sepse nëpërmjet shkëlqimit të Kur'anit, shërbëtori i Risale-i Nurit (autori i saj) zbuloi dy *Miëraxhe* -ngjitje- për njohjen e Zotit dhe për vërtetimin e Unitetit Hyjnor në farërat dhe në lulet. Ai e zbuloi ujin e jetës pikërisht në vendet tek të cilat u mbytën Natyralistët. Ai e arriti realitetin dhe dritën e njohjes së Zotit nga farërat. Për këtë arsye, për këtë urtësi, këto dy gjëra përsëriten shpesh në Risale-i Nur.

Shkurtazi: Origjinat, zanafillat e pemëve janë kutia të vockëla dhe programe.. Fundet e tyre janë modele dhe tabela njoftimi.. Anët e tyre të jashtme janë mantele të qëndisura dhe veshje të modeluara artistikisht.. ndërsa anët e tyre të brendshme janë punishte e fabrika. Këto katër aspekte shikojnë njëra-tjetrën dhe si një e tërë këto të katërta formojnë një stampë shumë të madhe. Madje një Emër më i madh bëhet i dukshëm nëpërmjet tyre, sepse në mënyrë të vetëkuptueshme askush tjetër përveç Autorit të vetëm të Unitetit, i Cili e administron të gjithë universin, nuk mund t'i kryejë këto vepra. Ashtu si pemët, edhe origjinat, fundet, anët e jashtme dhe të brendshme të të gjitha qënive të gjalla mbajnë vulat e Njësisë Hyjnore dhe stampat e Unitetit.

Duke bërë një analogji me pemët në këto tre shembuj, edhe pranvera gjithashtu është një pemë që mban lule të shumta. Farërat dhe rrënjët që i janë besuar dhe i janë lënë si amanet dorës së vjeshtës mbajnë stampën e Emrit ***El-Ev-Vel,*** *I Pari*. Frutat, drithërat, kokrrat dhe zarzavatet që zbrazen në prehërin e verës duke mbushur fustanellën e saj të përzgjatur, mbajnë vulën e Emrit ***El-A'hir****, I Fundit*. Qëndisjet dhe mantelet natyrale të dekoruara me qindra e mijëra zbukurime e modelime të cilat i vesh stina e pranverës njëra mbi tjetrën si veshjet e *hurive* mbajnë vulën e Emrit ***Edh-Dhahir****, I Jashtmi -i Dukshmi*. Ndërsa fabrikat e Autorit të Përjetshëm duke punuar në stinën e pranverës brenda tokës, dhe kazanat values të të Gjithëmëshirshmit dhe kuzhinat Hyjnore që gatuajnë e pjekin ushqimet, secili prej tyre mban vulën e Emrit ***El-Batin,*** *i Brendshmi -i Padukshmi.*

Madje secili lloj prej specieve, le të jetë ai lloji njerëzor për shembull, është gjithashtu një pemë; farërat dhe rrënjët e saj janë në thellësirat e së shkuarës, ndërsa frutet dhe rezultatet e saj janë në të ardhmen. Dhe ashtu si ekzistenca e ligjeve të rregullta që veprojnë brenda jetës seksuale dhe përjetësimit të species që mbajnë një stampë të qartë Uniteti, po ashtu ligjet dhe parimet e organizuara të jetës individuale dhe shoqërore në rrethanat e tanishme mbajnë një stampë uniteti të fshehur nën shqetësimin dhe çrregullimin e jashtëm; dhe nën rrethanat e saj të ngatërruara, ajo mban një stampë uniteti të sunduar nga parimet e Kaderit dhe të Vendimit Hyjnor, të njohura si rrjedha e caktuar e jetës.

Përfundim

[Një aluzion i shkurtër për shtyllat e tjera të besimit, të cilat i përmban misteri i vërtetimit të unitetit Hyjnor.]

O Njeri i shkujdesur! Eja tani dhe shqyrtoji, sikur vetëm një herë tre frutet, tre shkaqet e domosdoshme dhe tre provat në tre stacionet e kësaj trajtese, dhe shiko:

A do të ishte e mundur që Autori i Gjithëfuqishëm, i Gjithurtë, Mëshirëplotë dhe i Gjithëditur të ishte indifirent ndaj virtyteve të realitetit Muhammedan i cili në kuptim sundon në univers, të ishte indiferent ndaj tesbihateve të tij a.s.m. dhe ndaj dritave të islamit? Ai Krijues që drejton gjërat në këtë univers dhe që nuk neglizhon as edhe shërimin më të vogël, as falënderimin më të pakët dhe as artin më të vogël sa krahu i një mize; dhe nuk ua referon absolutisht të tjerëve çështjen e këtyre të pjesshmeve dhe nuk ua atribuon atyre; Ai që i bashkangjit bërthamës më të vogël detyra dhe shembuj urtësie aq të mëdhaja sa pemës; dhe i Cili e bën të kapshme e të perceptueshme mëshirën e Tij, dhembshurinë dhe urtësinë nëpërmjet të gjitha arteve të Tij, dhe që e bën të njohur Vetveten nëpërmjet çdo mjeti dhe e bën Vetveten të dashur nëpërmjet çdo mirësie? A do të ishte e mundur që të mos ishte qëllimi më i madh e më i rëndësishëm prej qëllimeve të Atij Krijuesi të Gjithëlavdishëm, dhe drita më e madhe prej dritave të Tij dhe pasqyra më e gjërë prej pasqyrave të Tij -a do të ishte e mundur të mos ishte- mesazhi Muhammedan a.s.m. i cili i stolisi të gjitha krijesat dhe i mbushi ato me gëzim, që e ndriçoi të gjithë universin dhe i transformoi qiejt dhe tokën në një zhurmëri *dhikri* e *tehlili*, duke përmendur e njësuar Krijuesin, dhe i cili mori nën sundimin e tij, fizik e shpirtëror, gjysmën e globit tokësor dhe një të pestën e njerëzimit për katërmbëdhjetë shekuj pa ndërprerje; ose a do të ishte e mundur që të mos ishin pejgamberët a.s., të cilët i shërbyen të njëjtit realitet ashtu si Muhammedi a.s.m., të dërguarit e Krijuesit të Gjithëlavdishëm, të dashurit e Tij dhe mesazhierët e Tij?

Ruajna Zot! Jo Kurrë, aq sa numri i mrekullive të pejgamberëve!

Dhe a do të ishte e mundur, në cilindo drejtim qoftë, që Krijuesi i Gjithurtë e Mëshirëplotë të mos e shkaktonte ringjalljen, gjë e cila është më e lehtë për të se sa sjellja e pranverës, dhe të mos hapte banesën e lumturisë dhe botën e përjetshme, në një kohë që Ai Krijues i ka lidhur njëqind shembuj urtësie e fruta çdo gjëje sado e pjesshme të jetë; dhe nëpërmjet urtësive të jashtëzakonshme, dhe mëshirës së Tij të gjithanshme e bën të njohur Hyjninë e Tij dhe i bën ato të dashura për krijesat, a do të ishte e mundur që Ai të mos e sjellë ringjalljen, dhe kështu të mohonte të gjithë urtësinë dhe mëshirën e Tij, madje edhe

Hyjninë dhe Plotësinë e Tij dhe t'i shtynte të tjerët që t'i mohonin ato, dhe t'i dënonte me asgjësim të përhershëm të gjitha krijesat e Tij të dashura të cilat Ai i do? Ruajna Zot, njëqind mijë herë! Ajo Bukuri absolute, e pastër, e lartësuar, e shenjtëruar është krejtësisht e përjashtuar dhe njëqind herë larg asaj shëmtie absolute.

Një Shënim i Gjatë

Një pyetje lidhur me ringjalljen e të vdekurve

Vërseti i përsëritur shpesh,

"Do të jetë vetëm një saihah, britmë e vetme"[13] dhe vërseti,

"Dhe çështja e orës (çastit të fundit) do të jetë sa një "hap e mbyll sytë..."[14] tregojnë se ringjallja e të vdekurve dhe tubimi i madh do të ndodhin menjëherë, në çast, vetëtimthi. Mirëpo arsyet e ngushta të njerëzve kërkojnë shembuj konkretë e të dukshëm me qëllim që ta pranojnë e ta perceptojnë këtë ngjarje shumë të jashtëzakonshme dhe këtë çështje të pashembullt.

Përgjigjja: Ringjallja përbëhet nga tri çështje; ato janë: rikthimi i shpirtërave tek trupat e tyre, ringjallja e trupave, dhe ribërja dhe ngritja e trupave.

Çështja e Parë: Një shembull për rikthimin e shpirtërave tek trupat e tyre është grumbullimi i ushtarëve të një ushtrie të disiplinuar, pasi ata ishin shpërndarë në të gjitha anët për të pushuar, me zërin e lartë të borisë ushtarake. Po, *Suri* që është Boria e Melekut Israfil nuk është më pak i fuqishëm se sa Boria ushtarake. Gjithashtu bindja e shpirtërave që janë në anën a paspërjetësisë dhe në botën e grimcave dhe të cilët iu përgjigjën me "*Po, ne e pranojmë*" pyetjes kur dëgjuan thirrjen *"A nuk jam Unë Zoti juaj?"*[15] e cila erdhi nga parapërjetësia, ato - shpirtëra- janë sigurisht më të nënshtruar, më të disiplinuar dhe më të bindur se sa ushtarët në një ushtri të disiplinuar. Fjala e Tridhjetë ka demonstruar me prova vendimtare se jo vetëm shpirtërat, por të gjitha grimcat gjithashtu, formojnë një ushtri Hyjnore dhe janë ushtarët e saj nën komandë.

Çështja e Dytë: Një shembull për ringjalljen e trupave është ky: Ashtu siç mund të ndizen qindra e mijëra llamba elektrike të një qyteti

---

[13] Kur'an, 36:29
[14] Kur'an, 16:77
[15] Kur'an, 7:172

të madh në një natë festivali, prej një qendre të vetme në një çast të vetëm, si të ishte pa kohë -pa kalimin e ndonjë kohe-, po ashtu mund të ndizen qindra miliona drita të shpërndara në sipërfaqen e tokës nga një qendër e vetme. Meqenëse elektriciteti që është njëra nga krijesat e Allahut xh.sh. dhe është një shërbëtore ndriçimi në Bujtinën e Tij, ka këto veçori dhe mundësinë për të kryer detyrat e saj në përputhje me instruksionet, ushtrimet, sistemin dhe me rregullin që ajo ka marrë prej Krijuesit të saj, atëherë sigurisht ringjallja e madhe e të vdekurve do të ndodhë sa "hap e mbyll sytë" brenda caqeve të ligjeve të rregullta të urtësisë Hyjnore, ato ligje të cilat i përfaqësojnë mijëra shërbëtorë të ndritshëm si elektriciteti.

Çështja e Tretë: Një shembull për ribërjen dhe ngritjen e trupave menjëherë në çast, është ringritja dhe ribërja në formë të plotë e të gjitha pemëve së bashku me të gjitha gjethet e tyre në pranverë pikërisht në të njëjtën mënyrë si ato të pranverave të mëparshme brenda pak ditëve, të cilat janë një mijë herë më të shumta në numër se sa i gjithë njerëzimi.. Gjithashtu rikrijimi i të gjitha luleve të pemëve, i frutave dhe i gjetheve të saj me një shpejtësi të rrufeshme ashtu siç ishin në pranverën e kaluar.. po ashtu zgjimi i menjëhershëm së bashku i numrave të pallogaritshëm i farërave, drithërave, i bërthamave dhe i rrënjëve, të cilat janë burimi i asaj pranvere dhe zbulimi dhe riardhja e tyre në jetë.. Gjithashtu ringjallja e kufomave të ngritura si skelete të pemëve, duke iu bindur menjëherë urdhrit të "Ringjalljes pas vdekjes.."

Gjithashtu rimëkëmbja dhe ringjallja e anëtarëve të panumërt të të gjitha specieve të kafshëve të vogëla e shumë të holla.. Gjithashtu ringjallja e të gjitha llojeve të insekteve fluturuese dhe sidomos mizat para syve tonë, të cilat vazhdimisht pastrojnë fytyrat e tyre, sytë dhe krahët duke na kujtuar ne avdesin dhe pastrimin dhe duke ledhatuar fytyrat tona, numri i të cilave vetëm për një vit është më i madh se sa numri i të gjithë njerëzimit qysh prej kohës së Ademit a.s.. Ringjallja e këtyre insekteve në çdo pranverë së bashku me speciet e tjera dhe ribërja e tyre brenda pak ditëve, nuk jep një shembull të vetëm por mijëra shembuj për ringjalljen dhe rimëkëmbjen e menjëhershme të trupave njerëzorë në Ditën e kijametit.

Po, meqenëse kjo dynja është bota e 'urtësisë' ndërsa Banesa e Ahiretit është Bota e 'Fuqisë', shumë Emra të bukur Hyjnorë të tillë, si: ***El-Hakim, El-Muret-tib, El-Mudeb-bir*** dhe ***El-Murebbi***, *I Gjithurti, Organizuesi, Rregulluesi* dhe *Edukuesi*, po ashtu edhe Urtësia Hyjnore kërkuan medoemos që krijimi i gjërave në këtë botë të

jetë gradual dhe me kalimin e kohës. Ndërsa në Ahiret 'Fuqia' dhe 'Mëshira' do të manifestohen më shumë se sa 'Urtësia' dhe, duke mos pasë nevojë për lëndë, kohë, afat e për pritje, gjërat do të bëhen menjëherë në çast. Duke aluduar për faktin se gjërat që bëhen këtu për një ditë ose për një vit do të bëhen në Ahiret për një çast ose vetëtimthi, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm deklaron:

"Dhe çështja e orës (çastit të fundit) do të jetë sa një "hap e mbyll sytë", ose edhe më afër".[16]

Në qoftë se dëshiron të jesh aq i sigurt për ndodhjen e ringjalljes së të vdekurve aq sa je i sigurtë për ardhjen e pranverës tjetër, studioji me kujdes Fjalën e Dhjetë dhe Fjalën e Njëzet e Nëntë, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e ringjalljes, dhe do ta shohësh! Në qoftë se nuk do ta besoje atë si ardhjen e kësaj pranvere, atëherë më gjyko rreptë!

Çështja e Katërt: Vdekja e Dynjasë dhe ndodhja e kijametit. Në qoftë se do të përplasej një planet ose një kometë nëpërmjet një urdhri Hyjnor me globin tonë tokësor, që është bujtina jonë, do të shkatërrohej vendstrehimi dhe vendbanimi ynë -domethënë toka- ashtu siç shkatërrohet për një minut një pallat që është ndërtuar për dhjetë vjet.

Përmbledhjet e lartëpërmendura të katër çështjeve të ringjalljes janë të mjaftueshme sa për tani, dhe le t'i rikthehemi temës sonë kryesore.

Gjithashtu, a do të ishte e mundur që Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm të mos jetë Fjala e Atij Krijuesi të Gjithëlavdishëm, fjalë e cila është interpretuesi elokuent i të gjitha të vërtetave të lartësuara të universit, gjuha e mrekullueshme i të gjitha plotësimeve të Krijuesit të universit dhe koleksioni i mahnitshëm i të gjitha qëllimeve të Tij? Ruajna Zot! Jo, sa numri i mistereve të vërseteve të tij. Ose a do të ishte e mundur që Autori i Gjithurtë i Cili i bëri krijesat e Tij të gjalla e të vetëdijshme të flasin me njëra-tjetrën në të gjitha gjuhët e tyre të panumërta; i Cili i njeh zërat e tyre dhe çfarë ato thonë, i dëgjon ato në mënyrë të qartë nëpërmjet akteve dhe mirësive të Tij, dhe pastaj Ai vetë të mos fliste apo të mos ishte në gjendje të flasë? A ka ndonjë mundësi apo gjasë për këtë? Meqenëse në mënyrë të vetëkuptueshme Ai flet, dhe kryesori midis atyre të cilëve Ai u adresohet me ligjëratën e Tij dhe që e kupton atë është njeriu, atëherë sigurisht me në krye Kur'anin fisnik dhe të gjithë librat e shenjtë të mirënjohur, janë Fjala e Tij.

---

[16] Kur'an, 16:17

Ose, a do të ishte e mundur që Krijuesi i Gjithurtë, i Cili e bëri këtë univers si një mjet për ta bërë Vetveten të njohur, të dashur, të lavdëruar dhe të vlerësuar; dhe nëpërmjet mirësive të Tij të shumëllojshme i bën qëniet e gjalla të lumtura e të kënaqura, dhe i bëri falënderimet dhe mirënjohjen e tyre si një bosht i rëndësishëm për Hyjninë e Tij.. dhe e bëri universin e gjërë së bashku me të gjithë elementet dhe boshtet e tij, një shërbëtor të bindur, një vendbanim, një ekspozitë, një banket; dhe kështu deshi t'i shumojë mijërat e të gjitha llojeve të ndryshme të qënieve të gjalla; që i bëri disa prej gjetheve të pemëve të cilat nuk mbajnë fruta si plepi dhe vidhi edhe si djep, edhe si mitër, edhe si ushqimore për qëniet e gjalla që i kryejnë lavdërimet e tyre në ajër, domethënë, për një lloj mizash; -A do të ishte e mundur që ky Autor i Gjithurtë t'i linte qiejt e stolisur e të zbukuruar dhe yjet e shpërndarë që lëshojnë dritë pa pronar, të boshatisur, pa qëllim, pa jetë, pa shpirt ose pa banorë; domethënë t'i linte ato pa melekë e pa qënie shpirtërore? Ruajna Zot, sa numri i melekëve dhe i qënieve shpirtërore!

Gjithashtu, a do të ishte e mundur që Autori i Gjithurtë, Rregulluesi, i Cili shkruan me penën e Kaderit të Tij në farërat dhe në frutat e më të vogëlës bimë dhe më vogëlës pemë origjinat e tyre dhe fundet dhe rrjedhat e jetës së tyre brenda një rregulli të përkryer, dhe se Ai shkruan me rregull të plotë dhe me dallueshmëri origjinat e rezultatet e pranverës madhështore si të ishte ajo një pemë; dhe se Ai nuk mbetet indifirent edhe për gjërat më të vogëla e të parëndësishme.. A do të ishte e mundur që ky Autor i Gjithëlavdishëm të mos i shkruante punët e njeriut dhe të mos i regjistronte lëvizjet dhe veprat e tij, të cilat kanë rëndësi të madhe, meqenëse ai është rezultati i universit, kalifi i Zotit në tokë, mbikqyrësi i llojeve të krijesave të Tij dhe inspektor për to; dhe të mos i përfshinte ato brenda sferës së Kaderit të Tij apo të tregohej i shkujdesur për to? Ruajna Zot, sa numri i veprave të njeriut, të cilat peshohen me balanca!

Shkurtazi: Universi së bashku me të gjitha të vërtetat e tij thërret e thotë:

Unë besoj në Zotin dhe në melekët e Tij dhe në librat e Tij, dhe në pejgamberët e Tij, dhe në Kaderin Hyjnor, se edhe e mira e tij, edhe e keqja e tij janë prej Zotit të Gjithëfuqishëm, dhe se ringjallja pas vdekjes është e vërtetë; unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhammedi a.s.m. është i dërguari i Allahut xh.sh., Zoti i dhëntë bekime atij, familjes së tij dhe sahabëve, dhe u dhëntë atyre paqe.

Amin.

Një dua rreth Unitetit Hyjnor dhe parathënia e saj.

Në kasiden e tij *El-Xhel-xhelutijjeh*, në vendin që u përmend, Imam Aliu -Zoti qoftë i kënaqur me të dhe e nderoftë- i jep Risale-i Nurit Emrat ***Siraxhun-Nur*** dhe ***Siraxhus-Sÿrxh*** në mënyrë të çuditshme. Meqenëse ai i jep Risale-i Nurit këto dy Emra shtesë, dhe Emri ***Siraxhun-Nur*** përsëritet shpesh në trajtesën e tanishme, ne kemi marrë njërën prej duave të tij më të rëndësishme, dhe duke e zgjeruar -shtrirë- atë dy shkallë duke e bërë gjuhën tonë të flasë në rrugën e gjuhës së tij të lartësuar, dhe e paraqesim këtë dua vijuese tek Divani i të Vetmit të Unitetit.

Duaja

O Zot! Nuk ka në qiej as rrotullim, as yje dhe as lëvizje planetësh... Në atmosferë as re, as vetëtima dhe as tesbihatet e rrufesë...

Në tokë as mbushullia e qënieve të gjalla dhe as artifaktet e çuditshme...

Në detet as një pikë uji, as një peshk dhe as ndonjë krijesë e çuditshme...

Në male as gurë dhe as bimë, dhe brenda tyre as mineral...

Në pemë as gjethe, as lule, dhe as ndonjë frut i zbukuruar...

Në trupat e gjërave të gjalla as një aktivitet, as ndonjë gjymtyrë e mirërregulluar dhe as ndonjë sistem...

Në zemrën e njeriut as mendim, as inspirim, dhe as besim i ndriçuar...

veçse dëshmon për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde dhe është dëshmi për Unitetin Tënd, dhe në sundimet e Tua është krejtësisht e nënshtruar. Nëpërmjet fuqisë me të cilën Ti i nënshtron qiejt dhe tokën, nënshtroma nefsin tim dhe nënshtroma dëshirën time dhe nënshtroji për Risale-i Nurin dhe për shërbimin ndaj Kur'anit dhe ndaj besimit zemrat e shërbëtorëve të Tu dhe zemrat e qënieve shpirtërore, qofshin të lartësuar apo të ulët; O Gjithëdëgjues! O i Afërt! O Përgjigjësi i duave! Amin...

Dhe të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, Krijuesit të të gjitha botëve.

"*Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti*".[17]

[17] Kur'an, 2:32

RREZJA E TRETË

Një lutje

[Kjo trajtesë provon me vendosmëri të jashtëzakonshme, me vërtetësi dhe me siguri së bashku me një thukëti të mahnitshme stili, themelet më të rëndësishme të besimit, të tilla si: domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit, Unitetin, Njësinë e Zotit, madhështinë e Hyjnisë së Tij, madhësinë e pafundme të fuqisë së Tij, gjërësinë e mëshirës së Tij, universalitetin e Sovranitetit të Tij, gjithëpërfshirjen e njohjes së Tij, gjithëpërfshirjen e urtësisë së Tij. Treguesit e ringjalljes së të vdekurve dhe veçanërisht ato të theksuara në fund, janë tej mase të fuqishme.]

PARATHËNIE

Kjo prova e tetë e themeleve të besimit[18] jep dëshmi për domosdoshmërinë e ekzistencës së Zotit xh.sh. dhe për Unitetin e Tij, prova të sigurta për gjithëpërfshirjen e Hyjnisë së Tij dhe për

[18] Meqenëse kjo tjatesë është prova e tetë prej koleksionit "Shkopi i Musait"... Përkthyesi.

madhështinë e Fuqisë së Tij. Kjo gjithashtu provon gjithëpërfshirjen e Sovranitetit të Tij, tregon gjërësinë e mëshirës Hyjnore, gjithëpërfshirjen e njohjes Hyjnore dhe faktin se urtësia Hyjnore i rrethon dhe i gjithëpërfshin të gjitha qëniet e universit.

Shkurtazi: Në secilën nga parathëniet e kësaj provës së Tetë janë tetë përfundime[19]. Në secilën nga Tetë parathëniet provohen këto tetë përfundime nëpërmjet dëshmive të tyre; prandaj kjo prova e Tetë ka veçori e vlera të larta.

Said Nursi

NJË LUTJE

[19] Të gjitha 'provat e themeleve të besimit' demonstrojnë qartë domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit dhe Unitetin e Tij, dhe në mënyrë të tërthortë i demonstron përfundimet e tjera të tyre. Përveç provimit qartë të domosdoshmërisë së ekzistencës së Krijuesit dhe të Unitetit të Tij, kjo prova e Tetë, 'Një dua' ka nëntë përfundime. Ajo provon:
1 Madhështinë e Hyjnisë;
2 Madhësinë e Fuqisë Hyjnore;
3 Gjithëpërfshirjen e Sovranitetit Hyjnor;
4 Shtrirjen e pakufishme të Mëshirës Hyjnore;
5 Faktin se Njohuria Hyjnore i përfshin të gjitha gjërat;
6 Gjithëpërfshirjen e Urtësisë Hyjnore;
7 Madhështinë vezulluese të Sundimit Hyjnor.

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Padyshim se në krijimin e qiejve dhe të tokës, në këmbimin me radhë të natës dhe të ditës, në anijet që lundrojnë përmes detit me çfarë është e vlefshme për njerëzimin, në ujin që Allahu derdh nga qielli duke e bërë tokën pas tij të gjallë pas vdekjes së saj, në lëvizjen (dhe gjallërinë) e të gjitha krijesave të cilat Ai i ka shpërndarë gjithandej, në ndryshimin e drejtimit të erërave dhe të reve që mbahen mes qiellit dhe tokës: të gjitha këto janë me të vërtetë ajete (prova, dëshmi, tregues) për popullin që mendojnë".[20]

[Kjo Trajtesë "*Një Lutje*", e cila përbën **Rrezen e Tretë** është një lloj komentimi për vërsetin e lartëpërmendur.]

Profeti i Zotit, Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, komentuesi dhe inerpretuesi më i lartë i Kuranit, shpjegoi një nivel -rreth Unitetit Hyjnor- prej niveleve të shumtë të ndritshëm të këtij vërseti sublim në njërën prej nëntëdhjetë e nëntë pjesëve të lutjes së tij të pashoqe -***Xhaushen El-Kebir***. Duke aluduar në lutjen nëpërmjet një mijë e një Emrave Hyjnorë për një mijë e një provat e Unitetit Hyjnor, ai bëri një përshkrim për Krijuesin, Mbështetësin e tij. Njëra prej atyre pjesëve është kjo:

O Ti që je i Pari i të gjitha gjërave dhe i Fundit;
O Zoti i të gjitha gjërave, dhe Autori i tyre;
O Furnizuesi i të gjitha gjërave, dhe Krijuesi i tyre;
O Bërësi i të gjitha gjërave dhe Pronari i tyre;
O Dhënësi i nevojës për të gjitha gjërat. Dhe o Dhënësi i begatisë, i bereqetit;
O Themeluesi i të gjitha gjërave, dhe Përtëritësi i tyre;
O Shkaktuesi i të gjitha gjërave, që i përcakton ato me masën e duhur.
O Edukuesi i të gjitha gjërave, dhe Administratori i tyre;
O Ti që i rrethon dhe i mbështjell të gjitha gjërat, dhe shkakton ndryshimin e tyre të vazhdueshëm;
O Jetëdhënësi i të gjitha gjërave, dhe o Dhënësi i Vdekjes.
Lavdia të takon Ty! Nuk ka zot tjetër përveç Teje! Mëshirë! Mëshirë! Na shpëto nga zjarri i Ferrit!

Ky model tregon se njohja e Profetit më të nderuar a.s.m. lidhur me Krijuesin, dhe Provat e tij për Unitetin Hyjnor ishin në një nivel të tillë saqë askush tjetër nuk është i barabartë me të, dhe se në këtë fushë ai është udhëheqësi më i lartë. Duke e ndjekur atë, gjithkush mund të hyjë në atë thesar. Është e qartë se njohja, shkencat dhe artet

[20] Kur'an, 2: 164

plotësohen nëpërmjet lidhjes së ideve dhe bashkimit -kombinimit- të mendjeve; nëpërmjet ideve duke qenë të kombinuara dhe punëve të ndryshme duke plotësuar njëra-tjetrën, veprat përfundohen. Kjo është përse Artizani -mjeshtri- i cili shpiku pushkën shihhane[21] ishte më i shkathët edhe më i aftë se sa ai që shpiku mitralozin e lehtë tani. Ndërsa ai i cili dëgjon me vëmendje me veshin e zemrës duanë e *Xheushen el-kebir*, duke e imagjinuar vetveten të jetë në praninë e profetit analfabet a.s.m. dhe e dëgjon atë prej tij, do të kuptonte dhe do të shikonte se ato një mijë e një të vërteta të shenjta, të cilat përmbajnë një mijë e një prova dhe përshkrime, dhe secila prej tyre është konkluzioni, përfundimi i një zinxhiri mendimi dhe një dritare e hapur për Unitetin Hyjnor, u kompozua nga analfabeti a.s.m. midis një populli analfabet në një mjedis analfabet, dhe në një komb që s'kishte shkrime të shenjta, krejtësisht origjinalë në mënyrë shpikëse duke mos imituar kërkënd, duke zgjidhur vetë nëpërmjet shkëlqimit enigmën e krijimit dhe talismanin e Universit. Kjo nuk ishte në mënyrë imituese si sot me ndihmën dhe me duatë e mijëra të ndritshmive, por prej dhembshurisë së tij të pakufishme dhe shpirtbutësisë së pafundme -për shkak të të cilave ai u bën ftesë si banorëve të qiejve nën kupën e qiellit ashtu edhe grumbullimit të gjërë në xhaminë madhështore të universit- ai kërkon ndihmë, ngushëllim, mëshirë dhe shpëtim për njerëzit dhe thotë:

O Ti që madhështia jote është në qiej;
O Ti që në tokë janë shenjat e Tua;
O Ti që dëshmitë e Tua janë në të gjitha gjërat;
O Ti që çudirat e Tua të habitshme janë në oqean;
O Ti që e fillon krijimin dhe pastaj e përtërin atë;
O Ti që thesaret e Tua janë në male;
O Ti që e krijon gjithçka në mënyrën më të mirë;
O Ti që të gjitha çështjet do të kthehen tek Ty;
O Ti që mirësia Jote është e dukshme në të gjitha gjërat;
O Ti që e shfaq fuqinë Tënde nëpërmjet të gjitha krijesave.
Lavdia të takon Ty! Nuk ka Zot tjetër përveç Teje! Mëshirë! Mëshirë! Na shpëto ne nga zjarri i Xhehennemit!

Këtu, komentatori më i lartësuar i Kuranit është duke shpjeguar një aspekt të vërsetit që u përmend lart. Një përkthim i shkurtër dhe kuptimi i tij është ky. Ai thotë:

"O i Vetmi i Lavdisë që madhështia Jote shihet në qiejt dhe në trupat qiellorë! O i Vetmi i Plotësisë që shenjat dhe dëshmitë e Unitetit

[21] Shishhane: një lloj pushke e vjetër me strall, që mbushej nga gryka. Përkthyesi.

Tënd vëzhgohen në tokë dhe në të gjitha qëniet e saj! O Ekzistuesi i Vetëm i domomsdoshëm, që provat e ekzistencës Tënde të domosdoshme janë të pranishme në të gjitha gjërat dhe në të gjitha krijesat! O i Gjithëlavdishmi i Vetëm i Plotësisë, që krijon të gjitha qëniet e çuditshme në oqeanet e gjërë! O Krijues Gjithëbujar që krijon thesaret e depozituar në male me qëllim që të plotësojë nevojat e qënieve të gjalla! O Dhuruesi Hirplot i mirësive, që e krijon gjithçka në mënyrën më të mirë dhe që siguron të gjitha gjërat e domosdoshme për secilën në mënyrën më të mirë! O i Plotëpushtetshëm i Vetëm, Mbështetësi i të gjitha gjërave; që të gjitha gjërat referohen tek Ti në të gjitha çështjet, për të gjitha nevojat, dhe që të gjitha qëniet mbështeten tek Ti në të gjitha rrethanat, Ty të takojnë të gjitha të drejtat, gjykimet dhe sundimi! O Hirplot i Vetëm i Gjithëditur që shenjat e qarta të favoreve të Tua, dhe manifestimet e mirësive të Tua, dhe skalitjet e holla të arteve të Tua, dhe dhuratat e bukura të Mëshirës Tënde, vëzhgohen në të gjitha gjërat! O i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithurtë i Vetëm që e ke bërë universin një ekspozitë mrekullish me qëllim që të shfaqësh Fuqinë Tënde për krijesat e vetëdijshme, dhe që i ke bërë artifaktet e Tua dhe shpalljet duke njoftuar Plotësitë e Tua, të tilla, si fuqinë, urtësinë dhe mëshirën! Ti je krejtësisht i lirë dhe larg të gjithë pafuqisë dhe mangësisë; "Nuk ka Zot tjetër përveç Teje që mund t'i ngushëllojë e t'i ndihmojë gjendjet tona! Mëshirë! Mëshirë! Na shpëto prej zjarrit të Xhehennemit!"

I dërguari më fisnik i Allahut, komentatori më i lartë i Kuranit, e shpjegoi vërsetin me këtë dua. Pastaj studenti më i rëndësishëm, i përpiktë, inteligjent dhe i saktë, Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, hartoi një lutje -dua- si shpjegim për komentin e duasë së profesorit të tij dhe, duke zbuluar një aspekt tjetër të duasë, ai zbuloi një fytyrë tjetër të vërsetit. Duke mbajtur në mendje lutjen e profesorit të tij fisnik, ai e përshkroi atë aspekt të vërsetit sa vijon: Ashtu siç dhamë një kuptim dhe një përkthim të shkurtër të duasë lartë, po kështu do të bëjmë edhe për këtë:

"O Zot! Në qiej nuk ka rrotullim e as lëvizje veçse nëpërmjet rregullit të tyre dhe urtësisë ato dëshmojnë për ekzistencën, duke të të bërë Ty të njohur. Në tokë nuk ka ndryshime, as transformime, as gjendje dhe as rrethana, veçse nëpërmjet rregullit dhe rregullsisë së tyre, ato të bëjnë Ty të njohur së bashku me unitetin dhe me Hyjninë Tënde. Në male nuk ka minerale, as kimikate dhe as shkëmbinj të depozituar për qëniet e gjalla, veçse nëpërmjet përdorimeve dhe dobive të tyre dëshmojnë Hyjninë dhe ekzistencën Tënde. Në zemër nuk ka ndonjë mendim të inspiruar nga e Padukshmja veçse tregon për

ekzistencën Tënde dhe dëshmon për Unitetin Tënd. Në pemët nuk ka gjethe veçse nëpërmjet rregullit të tyre dhe urtësisë ato të njohin Ty, domethënë, shpallin se ato janë veprat e artit Tënd. Në trupat nuk ka lëvizje veçse dëshmojnë për Hyjninë Tënde. O Krijuesi im! Për hir të fuqisë Tënde, e cila nënshtron qiejt dhe tokën, nënshtromi ato gjëra që unë i dëshiroj!

Tani, një student i pafuqishëm i Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe një shërbëtor i mjerë i Kuranit, duke e shpjeguar këtë lutje të tij gjithashtu, deshi të zbulonte në dritën e Emrit më të madh një aspekt të vërsetit të lartësuar me anë të shpjegimit të atij aspekti të lutjes së lartëpërmendur, e cila është vetëm se njëra prej njëqind pjesëve të lutjes së Interpretuesit të lartë, domethënë, e *Xhaushan el-kebir*. Studenti i Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, thotë:

O Zoti im dhe O Mbështetësi im!

Unë shikoj nëpërmjet syve të besimit, të instruksionit dhe të dritës së Kuranit, nëpërmjet mësimeve të të Dërguarit më të nderuar a.s.m. dhe nëpërmjet treguesve të Emrit Hyjnor ***El-Hakim***, *i Gjithurti* se, në qiejt nuk ka rrotullim e as lëvizje veçse tregojnë nëpërmjet rregullit dhe rregullsisë së tyre, ekzistencën Tënde.

Nuk ka ndonjë trup qiellor veçse nëpërmjet kryerjes pa zhurmë dhe në heshtje të detyrës së tij dhe duke qëndruar në vend pa mbështetëse, dëshmon për Hyjninë dhe për Unitetin Tënd.

Nuk ka ndonjë yll veçse nëpërmjet krijimit të tij të balancuar, të ekuilibruar, të pozicionimit të tij të rregullt, buzëqeshjes së tij të ndritshme, stampës së ngjashmërisë dhe shëmbëllimit të tij me yjet e tjerë, tregon madhështinë e Hyjnisë dhe Unitetitn Tënd. Nuk ka asnjë prej dymbëdhjetë planetëve veçse nëpërmjet lëvizjes së tij me urtësi, nënshtrimit të tij të bindur, detyrës së tij të mirorganizuar dhe satelitëve të tij të rëndësishëm, dëshmon për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde dhe tregon Sundimin e Hyjnisë Tënde.

Po, - O Krijuesi i qiejve dhe i tokës, ashtu siç dëshmojnë qiejt me banorët e tyre, dhe çdo qiell në vetvete, të gjithë së bashku dëshmojnë në mënyrë të vetëkuptueshme e të qartë për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde dhe, dëshmojnë në mënyrë të fuqishme e të saktë për Unitetin Tënd dhe për vetminë Tënde, o Ti që drejton dhe administron të gjitha grimcat me të gjitha komponentet e tyre të rregullta dhe, o Ti që i bën të lëvizin planetët dhe satelitët e tyre të rregullt, duke ia nënshtruar ato Urdhërit Tënd, duke dëshmuar në mënyrë të qartë e të fuqishme domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde

saqë atë dëshmi e vërtetojnë prova e tregues të ndritshëm sa numri i yjeve në qiej.

Gjithashtu, këto qiej të pastër, të qartë e të bukur tregojnë në mënyrë të qartë madhështinë e Hyjnisë Tënde dhe madhështinë e fuqisë Tënde e cila i krijon të gjitha gjërat.. dhe tregojnë në mënyrë të fuqishme gjërësinë e sundimit Tënd gjithëpërfshirës që rrethon qiejt madhështorë dhe për mëshirën Tënde e cila i përfshin të gjitha gjallesat... dhe padyshim dëshmojnë për gjithanshmërinë e urtësisë Tënde për çdo veprim dhe për diturinë Tënde gjithëpërfshirëse e cila është e lidhur me të gjitha gjendjet dhe rrethanat e të gjitha krijesave të qiejve, i rrethon dhe i rregullon ato, dhe për urtësinë Tënde e cila i rrethon dhe i përfshin të gjitha gjërat. Kjo dëshmi është aq e dukshme saqë sikur yjet janë fjalët dhe treguesit e mishëruar të dëshmisë së qiejve.

Gjithashtu, ashtu si ushtarët e disiplinuar, anijet e mirorganizuara, aeroplanët e çuditshëm apo llampat e mrekullueshme, yjet në arenën e qiejve, në detet e tyre dhe në hapësirat e mëdha, tregojnë madhështinë vezulluese të Sovranitetit të Hyjnisë Tënde. Ashtu siç sugjerohet nga detyrat e diellit -një yll midis anëtarëve të asaj ushtrie- të cilët janë lidhur me planetët e tij dhe me tokën tonë, disa nga shokët e tij, yjet e tjerë, shikojnë tek botërat e Ahiretit dhe nuk janë pa detyra; ato janë diejt e botërave të përjetshme.

O Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm! O i Vetmi i Unitetit!

Këto yje të jashtëzakonshëm dhe këto diej madhështorë dhe hëna të çuditshme... janë nënshtruar, janë vënë në rregull dhe janë vënë në punë në sundimin Tënd, në qiejt e Tu, nëpërmjet urdhrit Tënd, forcës, fuqisë, administrimit dhe drejtimit Tënd. Të gjithë ato trupa qiellorë lavdërojnë e lartësojnë Krijuesin e tyre të Vetëm, i Cili i krijon, i rrotullon dhe i administron ato; nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tyre të natyrshme, ato deklarojnë duke thënë:

"Lavdia i takon Allahut! Allahu është më i Madhi!" Edhe unë gjithashtu deklaroj shenjtërinë Tënde së bashku me të gjitha lavdërimet e tyre.

O i Plotëfuqishëm i gjithëlavdisë, i fshehur në intensitetin e manifestimit Tënd dhe i mbuluar me madhështinë e lartësisë Tënde! O i Gjithëfuqishëm i Gjithëlavdishëm! O i Plotëpushtetshëm i fuqisë absolute!

Unë kam kuptuar nëpërmjet mësimit të Kuranit të gjithurtë dhe nëpërmjet instruksionit të Profetit Tënd më të nderuar se, ashtu siç

dëshmojnë qiejt dhe yjet për ekzistencën dhe për Unitetin Tënd, po ashtu **atmosfera** dëshmon për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde dhe unitetit Tënd me retë e saj, me shkreptimat, rrufetë, erërat dhe me shirat.

Po, retë e pajeta dhe të pavetëdijshme duke dërguar ujin e jetës shiun, për t'u ardhur në ndihmë gjallesave në nevojë, kjo ndodh vetëm se nëpërmjet mëshirës dhe urtësisë Tënde; rastësia e ngatërruar kurrësesi nuk mund të ndërhyjë.

Po kështu rrufeja që është elektriciteti më i fuqishëm, e cila aludon për potencialin për ndriçim, për dritë, e nxit njeriun për të përfituar prej dobive të saj ndriçuese dhe në mënyrë të bujshme e të mahnitshme ndriçon fuqinë Tënde vepruese. Rrufeja njofton ardhjen e shiut duke e bërë hapësirën e pakufishme të flasë dhe i bën qiejt të kumbojnë me zërat, me tingujt duke të Të lavdëruar e duke të Të shenjtëruar; dhe nëpërmjet gjuhës së fjalës, me gojë, ajo dëshmon për Hyjninë Tënde.

Po kështu erërat që janë ngarkuar me detyra të shumta si, sigurimin e furnizimit më jetik për gjallesat dhe më të lehtën për ta përfituar, dhe duke siguruar e lehtësuar frymëmarrjen, për ndonjë qëllim e transformon atmosferën -për ndonjë urtësi- në një "pllakë për të shkruar e fshirë", ç'ka shkruan atë që është e dobishme dhe e fshin atë që e dha dobinë, duke treguar kështu aktivitetin e Fuqisë Tënde dhe duke dëshmuar ekzistencën Tënde. Gjithashtu mëshira e mjelur nëpërmjet mëshirës Tënde prej reve dhe e dërguar për gjallesat, dëshmon nëpërmjet fjalëve të pikave të saj të balancuara e të rregullta për gjërësinë e mëshirës dhe të Dhembshurisë Tënde.

O Rregullues i Fuqishëm dhe Aktiv! O Dhurues i lartësuar e Gjithëbujar!

Ashtu siç dëshmuan retë, shkreptima, rrufeja, era dhe shiu, secili më vete, për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde, po ashtu si një tërësi ato të gjitha tregojnë në mënyrë shumë të fuqishme për Unitetin Tënd dhe për Vetminë Tënde nëpërmjet veçorisë së harmonisë së tyre duke qenë njëra brenda tjetrës dhe duke e ndihmuar njëra-tjetrën në detyrat e tyre, megjithëse nga natyra ato janë të pangjashme, të ndryshme dhe të kundërta me njëra-tjetrën.

Ato tregojnë gjithashtu madhështinë e Hyjnisë Tënde, e cila e bën dhe e transformon atmosferën e gjërë në një ekspozitë çudirash, duke e mbushur dhe duke e zbrazur atë ndoshta disa herë në disa ditë apo në një ditë të vetme. Ato dëshmojnë për madhështinë e Fuqisë Tënde mbisunduese e gjithëpërfshirëse për gjithçka; e cila e shkruan atë

atmosferë të gjërë dhe e ndryshon atë si të ishte një "Pllakë shkrimi", dhe i shtrydh ato si një sfungjer dhe vadit me ujë kopshtin e tokës; ato gjithashtu tregojnë mëshirën Tënde të pakufishme dhe sundimin Tënd të pakufi, që nën perden e atmosferës administrojnë të gjithë tokën dhe të gjitha krijesat. Për më tepër, ajri përdoret në detyra aq të urta dhe retë dhe shiu përdoren në dobi aq të perceptuara, saqë në qoftë se nuk do të ishte njohja dhe urtësia që i rrethojnë dhe i përfshijnë të gjitha gjërat, ato nuk do të mund të përdoreshin kështu në këtë mënyrë.

O Ti që vepron siç dëshiron!

Nëpërmjet aktivitetit Tënd në atmosferë, Fuqia Jote, që në mënyrë të vazhdueshme shfaq shembujt e ringjalljes së të vdekurve dhe të Tubimit të madh dhe që e transformon verën në dimër dhe dimrin në verë gjatë një ore, që një botë e sjell dhe një tjetër e dërgon tek e Padukshmja, si dhe akte të tjera të ngjashme... këto tregojnë dhe japin shenja se ajo do ta transformojë këtë dynja në Ahiret dhe atje do të shfaqë aktet e saja të përhershme.

O i Gjithëfuqishëm i Gjithëlavdishëm!

Ajri, retë, shiu, rrufeja dhe shkreptima në atmosferë janë të nënshtruara dhe të vëna në punë në Sundimin Tënd, nëpërmjet urdhrit, forcës dhe fuqisë Tënde. Këto krijesa, të cilat nga natyra janë kaq të ndryshme me njëra-tjetrën shenjtërojnë Sundimtarin dhe Komandantin e tyre, i Cili i ka bërë ato t'u nënshtrohen menjëherë urdhërave të Tij shumë të shpejta; ato lavdërojnë e lartësojnë mëshirën e Tij.

O Krijuesi i tokës dhe i qiejve! O i Gjithëlavdishëm!

Nëpërmjet instruksionit të Kuranit të gjithurtë dhe mësimit të profetit më të nderuar a.s.m., unë besoj dhe di se ashtu siç dëshmojnë qiejt për domosdoshmërinë e ekzistencës dhe të Unitetit Tënd nëpërmjet yjeve të tyre, atmosferës dhe nëpërmjet gjithçkaje që ato përmbajnë, po ashtu **toka**, nëpërmjet të gjitha krijesave të saj dhe me gjendjet e saj jep dëshmi e tregues sa numri i qënieve të saj për ekzistencën dhe për Unitetin Tënd. Po, nuk ka ndonjë transformim në tokë, dhe as ndonjë ndryshim në të, të tilla si ato të pemëve dhe të kafshëve duke ndryshuar veshjet e tyre në çdo vit, qofshin universale apo të pjesshme veçse tregojnë nëpërmjet rregullit, harmonisë dhe simetrisë së tyre ekzistencën dhe Unitetin Tënd. Dhe nuk ka ndonjë kafshë veçse, nëpërmjet ushqimit që i shkon asaj me mëshirë në lidhje me nevojat e saj dhe me dobësinë duke iu dhënë të gjitha gjymtyrëve dhe aftësive të domosdoshme për të vazhduar jetën e saj, dëshmon për ekzistencën dhe për Unitetin Tënd. Dhe nuk ka ndonjë bimë apo

kafshë të krijuar para syve tonë në pranverë veçse të bën Ty të njohur nëpërmjet artit të saj të çuditshëm, stolisë së saj të hollë dhe qënies së saj duke u dalluar nga të gjitha krijesat e tjera, si dhe nëpërmjet rregullit dhe balancimit të saj. Mrekullitë e fuqisë Tënde të cilat mbushin tokën dhe të cilat njihen si bimët dhe kafshët, krijimi i i tyre nga farat, vezët, pikat e spermës, lëngu etj., në mënyrë perfekte, pa gabim, në mënyrë të zbukuruar, secili me tiparet e veta dalluese, formojnë një dëshmi më të ndritshme e më të fuqishme se sa dielli për ekzistencën, unitetin, urtësinë dhe për fuqinë e pafundme të Krijuesit të tyre të Gjithurtë.

Gjithashtu, nuk ka ndonjë element, të tilla si ajri, uji, drita, zjarri dhe dheu veçse jep dëshmi për unitetin dhe për ekzistencën Tënde, nëpërmjet kryerjes së funksioneve të vet me vetëdije e në mënyrë të plotë pavarësisht se nuk ka vetëdije, dhe duke qenë mjeti për arritjen e frutave dhe prodhimeve të shumëllojshme me rregullsinë më të madhe prej thesarit të së Padukshmes pavarësisht qënies së atij elementi i thjeshtë, pa rregull, duke shkelur e shtypur njëra-tjetrën dhe të shpërndara në çdo vend.

O Krijues, O i Gjithëfuqishëm! O Hapësi i formave, O i Gjithëditur! O Krijues Aktiv!

Ashtu si së bashku me të gjithë banorët e saj, toka dëshmon për qënien e Krijuesit të tyre i Domosdoshëm për të ekzistuar, po ashtu ajo dëshmon për Unitetin dhe Njësinë Tënde, O i Vetëm!, O Unik! O i Dhembshur! O Mirëdashës! O Dhurues Gjithëbujar! O Furnizues! nëpërmjet stampës në fytyrën e saj dhe stampave në fytyrat e të gjithë banorëve të Tu, dhe unitetit të tyre dhe qënies së tyre njëri brenda tjetrit dhe, duke ndihmuar njëri-tjetrin dhe, nëpërmjet të gjithë Emrave dhe akteve të Hyjnisë që i shohin ato duke qenë të njëjtat, ajo dëshmon me qartësinë më të madhe Unitetin dhe Njësinë Tënde; në të vërtetë ajo jep dëshmi aq sa numri i krijesave, dëshmi të vetëkuptueshme.

Gjithashtu, toka nëpërmjet qënies së saj e ngjashme me një fushim ushtarak, një ekspozitë, një vend instruksioni, dhe nëpërmjet të gjithë katërqind mijë kombeve të ndryshëm të pranishëm në divizionet e bimëve dhe të kafshëve të saj në mënyrë të rregullt duke iu dhënë të gjithë atyre pajimet e domosdoshme, -toka- tregon madhështinë e Hyjninë Tënde dhe faktin se Fuqia Jote depërton në të gjitha gjërat.

Gjithashtu, llojet e ndryshme të ushqimit të gjallesave të panumërta duke iu dhënë atyre me mëshirë, me bujari, pikërisht në kohën e duhur nga dheu i thjeshtë dhe i thatë dhe, bindja dhe nënshtrimi i plotë i atyre

individëve të panumërt ndaj urdhërave Hyjnorë, demonstron se mëshira Jote i përfshin të gjitha gjërat dhe sundimi Yt i rrethon ato.

Gjithashtu, dërgimi i karvaneve të krijesave, të cilat janë në një gjendje ndryshimi të vazhdueshëm në tokë, dhe shtyrja e tyre nëpërmjet ndërkëmbimit të jetës dhe vdekjes, dhe administrimi e drejtimi i bimëve dhe i kafshëve, dhe kjo bëhet e mundur vetëm se nëpërmjet një njohje që është e lidhur me çdo gjë dhe një urtësie që sundon në të gjitha gjërat; kjo tregon për gjithëpërfshirjen e njohjes dhe të Urtësisë Tënde.

Gjithashtu kjo rëndësi më e madhe, kjo dhënie dhe ky shpenzim i pakufishëm, këto manifestime Hyjnore absolute, këto adresime Hyjnore të pakufishme dhe këto mirëbërësi Hyjnore të pafundme për këtë njeri që ka sundim e kontroll mbi të gjitha qëniet e tokës dhe është i ngarkuar me detyra të pakufishme në një periudhë të shkurtër dhe është i pajisur me aftësi dhe me instrumente jolëndore që e përgatisin atë për një jetë të gjatë në një kohë të pakufishme.. pa dyshim ajo nuk mund të përfshihet në këtë medrese të dynjasë, as në këtë fushim ushtarak të përkohshëm të tokës, as në këtë ekspozitë të përkohshme të botës, as në këtë jetë të shkurtër pikëlluese të turbulluar, as në këtë jetë të dëshpëruar e të ngatërruar dhe as në këtë botë kalimtare të mbushur plot me fatkeqësi e bela. Përkundrazi, e gjitha kjo padyshim tregon për një jetë tjetër të përhershme dhe për një jetë tjetër të amshuar të përjetshme dhe tregon për mirëbërësitë, dhuratat e Ahiretit në botën e përjetshme, madje dëshmon për të.

O Krijuesi i të gjitha gjërave!

Të gjitha krijesat e tokës administrohen dhe janë nënshtruar në sundimin Tënd, në tokën Tënde, nëpërmjet fuqisë, forcës dhe dëshirës Tënde dhe nëpërmjet njohjes dhe urtësisë Tënde.

Hyjnia, aktiviteti i së cilës vëzhgohet në faqen e tokës është aq gjithëpërfshirëse dhe e gjithanshme, dhe administrimi i saj dhe drejtimi janë aq të përkryera e të sakta dhe kryhen me një njëjtësi -njëllojshmëri- të tillë saqë tregon se është një Hyjni, një fuqi që ushtron kontroll, e cila është një tërësi që nuk mund të copëzohet dhe një universale që nuk mund të ndahet. Së bashku me të gjithë banorët e saj, toka shenjtëron dhe lartëson Krijuesin e saj me gjuhë të panumërta shumë më të qarta se sa fjala e folur; ato vlerësojnë dhe lartësojnë Furnizuesin e tyre të Gjithëlavdishëm për mirësitë e Tij të pakufishme me gjuhët e qënieve të tyre.

O i Pastërti i Vetëm dhe O i Shenjti i Vetëm, i fshehur në intensitetin e madhështisë Tënde dhe i mbuluar me madhështinë e lartësisë Tënde!

Nëpërmjet të gjitha shenjtërimeve dhe tesbihateve të tokës, unë të shenjtëroj dhe deklaroj që Ti je krejtësisht i lirë dhe larg çdo mangësie, pafuqie dhe ortakërie; dhe nëpërmjet të gjithë lavdërimit dhe lartësimit të tokës, unë jap për Ty lavdërime e vlerësime.

O Krijues i Tokës dhe i Detit!

Unë kam kuptuar nga mësimi i Kuranit dhe nga instruksioni i profetit Tënd më të nderuar a.s.m., se ashtu siç dëshmojnë qiejt, atmosfera dhe toka për Unitetin dhe për ekzistencën Tënde, po ashtu detet, lumenjtë, përronjtë dhe burimet në mënyrë të vetëkuptueshme dëshmojnë për domosdoshmërinë e ekzistencës dhe të Unitetit Tënd.

Po, nuk ka ndonjë qënie, madje nuk ka ndonjë pikë uji në detet e kësaj dynjasë sonë që janë burim çudirash -si të ishin gjeneratorë avulli- detet që janë si kazanë kaldaje të çuditshëm për botën tonë duke prodhuar avull, veçse bëjnë të njohur Krijuesin e tyre, nëpërmjet ekzistencës së tyre, rregullsisë, dobive dhe gjendjeve të tyre.

Dhe nuk ka krijesë prej krijesave të çuditshme të cilave u dërgohen furnizimet në mënyrë të plotë prej rërës së thjeshtë dhe ujit të thjeshtë... dhe nuk ka kafshë prej krijesave të gjalla të detit, me qëniet e tyre të mirorganizuara, dhe veçanërisht peshqit që mbushin e zbukurojnë detet nëpërmjet një peshku duke prodhuar një milion vezë, veçse tregon Krijuesin e saj dhe dëshmon për Furnizuesin e saj nëpërmjet krijimit të saj, detyrave të saj, qënies së saj e administruar, e ushqyer, e mbështetur, e zhvilluar dhe e mbikëqyrur.

Gjithashtu, prej xhevahirëve të çmuar e të zbukuruar në dete, nuk ka ndonjë veçse nëpërmjet krijimit të tij tërheqës dhe cilësive të dobishme të njeh dhe të bën Ty të njohur. Po, ashtu siç dëshmon secili xhevahir më vete, po ashtu të gjithë ato xhevahirë në tërësinë e tyre bashkarisht dëshmojnë Unitetin Tënd, nëpërmjet qënies së tyre të përziera bashkë, të ndërfutjes tek njëra-tjetra, harmonisë, duke mbajtur të njëjtën stampë në natyrat e tyre, të qënies së tyre të krijuara me një lehtësi të skajshme dhe që gjenden në një shumicë të skajshme në numrin e individëve...

Gjithashtu bërja e deteve të cilët kanë rrethuar tokën duke u mbajtur të varura pezull në atmosferë -në qiell- me tokën e tyre madhështore, të cilët lundrojnë, udhëtojnë rreth diellit pa u derdhur, pa u shpërndarë dhe pa e shkelur tokën e thatë.. dhe krijimi i krijesave të

gjalla të shumëllojshme të mirorganizuara dhe i xhevahirëve të tyre prej rërës së tyre të thjeshtë dhe prej ujit të tyre të thjeshtë.. dhe administrimi i ushqimeve të atyre krijesave, i nevojave dhe i çështjeve të tjera të tyre në mënyrë të plotë e të përgjithshme.. dhe drejtimi e pastrimi i sipërfaqes së deteve prej kërmave të panumërta të pashmangshme të gjallesave të ngordhura... ato dëshmojnë, në mënyrë të tërthortë aq sa numri i tyre, për ekzistencën Tënde dhe për domosdoshmërinë e Saj.

Gjithashtu, ashtu siç tregojnë qartë për madhështinë e Sovranitetit të Hyjnisë Tënde, dhe për madhështinë e Fuqisë Tënde e cila i rrethon të gjitha gjërat, po ashtu ato tregojnë gjërësinë absolute të Mëshirës Tënde dhe të Sundimit Tënd të cilat sundojnë mbi të gjitha gjërat dhe u vijnë në ndihmë gjithçkaje duke filluar nga yjet madhështorë të mirorganizuar në lartësitë e qiejve, përtej qiejve dhe deri tek peshqit e vegjël në fund të detit të cilët ushqehen në mënyrë të rregullt. Ato gjithashtu tregojnë për Njohurinë Tënde gjithëpërfshirëse dhe për Urtësinë Tënde e cila përfshin të gjitha gjërat, të cilat demonstrohen nga rregulli, dobitë, shembujt e urtësisë nga balancimi dhe ekuilibri i të gjitha gjërave. Duke pasur rezervuarë të tillë mëshire për njeriun që vjen mysafir në këtë bujtinën e kësaj dynjaje dhe duke i nënshtruar ato për udhëtimin e tij, për shëtitjen, për anijen e tij dhe për dobitë e tij, kjo tregon se Ai i Cili i nderon mysafirët e tij në një natë të vetme në një bujtinë të cilën e ka ndërtuar për ta në rrugën e udhës së tyre, duke u dhënë një bollëk të madh dhuratash prej deteve.. sigurisht Ai duhet të ketë përgatitur dete të përjetshëm mëshire tek vendqëndrimi i Sundimit të Tij të përhershëm, dhe ato që shihen këtu janë thjesht modelet e tyre të vegjël dhe të përkohshëm përpara atyre të përjetshmive..

Kështu, situata vërtet e çuditshme e deteve përreth tokës dhe administrimi i krijesave të saj dhe furnizimi i tyre për ushqim në mënyrën më të rregullt, demonstron në mënyrë të vetëkuptueshme se të gjitha ato janë të nënshtruara në mbretërinë Tënde, nëpërmjet urdhrit Tënd, Fuqisë Tënde, Forcës Tënde dhe vetëm nëpërmjet administrimit Tënd; ato shenjtërojnë Krijuesin e tyre nëpërmjet gjuhëve të qënieve të tyre duke deklaruar: ***Allahu Ekber***, *Allahu është më i Madhi*!

O i Plotëfuqishëm i Gjithëlavdishëm! O Ti që i bëre malet direkë dhe mbajtës të thesareve për anijen e tokës!

Nëpërmjet instruksionit të profetit Tënd më të nderuar dhe nëpërmjet mësimit të Kuranit të gjithurtë, unë kam kuptuar se ashtu siç të njohin Ty dhe të bëjnë Ty të njohur detet me çudirat dhe me

mrekullitë e tyre, po ashtu edhe **malet** Të njohin dhe të bëjnë Ty të njohur nëpërmjet shërbimeve plot urtësi që ato kryejnë; sepse ato sigurojnë që toka të çlirohet nga efektet e tërmeteve dhe nga tronditjet e brendshme; ato e qetësojnë, e shpëtojnë tokën nga cënimi, shkelja e deteve; ato e pastrojnë ajrin prej gazrave helmues, të dëmshme; janë rezervuarë për ruajtjen dhe depozitimin e ujit; dhe thesare për mineralet dhe për metalet e domosdoshme për qëniet e gjalla.

Po, nuk ka ndonjë prej gurëve që gjenden në male, as prej substancave të ndryshme të përdorura si ilaçe për sëmundje, as prej shumëllojshmërisë së metaleve dhe mineraleve, të cilat janë esencialë për qëniet e gjalla dhe veçanërisht për njeriun, as prej llojeve të bimëve që zbukurojnë malet dhe fushat me lulet dhe me frutat e tyre, veçse nëpërmjet urtësisë, rregullit, krijimit të hollë e të bukur që ato shfaqin, që është krejtësisht e pamundur që ato t'i atribuohen rastësisë, dëshmojnë në mënyrë të vetëkuptueshme për domosdoshmërinë e ekzistencës së Një Krijuesi të Vetëm, Zotëruesi të një fuqie të pafundme, të një urtësie të pafundme, të një mëshire të pafundme dhe të një bujarie të pafundme. Kjo është veçanërisht e vërtetë prej substancave që gjenden në male të tilla, si: kripa, kripa oksalati, sulfati kinine dhe aluniti, të cilat në anën sipërfaqësore i ngjasojnë njëra-tjetrës, por shijet e të cilave janë krejtësisht të ndryshme, dhe sidomos bimët me llojet e tyre të shumta të ndryshme që dalin prej një dheu të thjeshtë dhe me lulet dhe me frutet e tyre të ndryshme. Për më tepër, nëpërmjet qënies së tyre të administruara dhe të drejtuara si një tërësi, origjinat e tyre, situatat, krijimi, arti i tyre që të gjitha duke qenë të ngjashme, dhe lehtësia, shpejtësia dhe lirësia -bollëku- në bërjen e tyre, ato dëshmojnë për unitetin dhe Njësinë e Krijuesit të tyre.

Gjithashtu, krijesat në sipërfaqen e maleve dhe në brendësi të tyre duke u krijuar gjithandej në tokë dhe duke u shpërndarë në çdo anë të tokës në të njëjtën kohë, në të njëjtën trajtë, në mënyrë të përkryer dhe pa gabim, duke mos penguar një veprim tjetrin, dhe duke u krijuar pa ngatërresë pavarësisht qënies së tyre të përziera me të gjitha llojet e tjera, që të gjitha tregojnë madhështinë e Hyjnisë Tënde dhe madhështinë e Fuqisë Tënde, për të Cilën asgjë fare nuk është e vështirë.

Gjithashtu malet, si në sipërfaqen e tyre po ashtu në brendësinë e tyre duke qenë të mbushura në mënyrë të rregullt me pemë, bimë dhe me minerale për të plotësuar nevojat e panumërta të krijesave të gjalla në tokë, dhe madje për të siguruar ilaçet për sëmundjet e tyre të shumta të ndryshme dhe për të kënaqur e ngopur orekset dhe shijet e tyre të

ndryshme, dhe këto duke u shfaqur për ata që kanë nevojë, këto tregojnë gjërësinë e pafundme të mëshirës Tënde dhe shtrirjen e pafundme të Sundimit Tënd. Ndërsa qënia e tyre të përgatitura në mënyrë të perceptueshme, me dije, pa ngatërresë, në mënyrë të rregullt sipas nevojës, pavarësisht qënies së tyre të gjitha të përziera dhe të fshehura në errësirën e shtresës së dheut, kjo tregon njohurinë Tënde gjithëpërfshirëse e cila i rrethon të gjitha gjërat, dhe gjithëpërfshirjen e Urtësisë Tënde, e cila i vendos në rregull të gjitha gjërat.

Atëherë përgatitja e ilaçeve, depozitimi i substancave mjekësore, i mineraleve dhe i metaleve tregon qartë për proceset e mëshirshme, bujare dhe të planifikuara të Hyjnisë Tënde dhe marrjen e masave të holla të përkujdesjes Tënde.

Gjithashtu, bërja e maleve të larta si magazina rezervë të rregullta dhe si depo për të plotësuar nevojat e ardhshme të udhëtarëve në bujtinën e kësaj bote, dhe qënia e tyre duke u depozituar me të gjitha thesaret e domosdoshme për jetën, në të vërtetë tregojnë dhe dëshmojnë se Krijuesi i Cili është kështu Gjithëbujar dhe Mikpritës, i Gjithurtë, i Dhembshur, i Gjithëfuqishëm dhe Ushqyes e Zhvillues, sigurisht Ai zotëron thesare të përjetshme për mirësitë e Tij të përjetshme në botën e përjetshme për ata udhëtarë mysafirë të Tij të cilët Ai, në mënyrë të qartë, i do...

Atje yjet do të kryejnë funksionet që malet i kryejnë këtu.

O i Plotëfuqishëm mbi të gjitha gjërat!

Malet dhe krijesat brenda tyre janë nënshtruar e depozituar në Sundimin Tënd nëpërmjet Forcës dhe Fuqisë Tënde, Njohurisë dhe Urtësisë Tënde! Ato shenjtërojnë e lavdërojnë Krijuesin e tyre, i Cili i nënshtron ato dhe i vë në punë në këtë mënyrë.

O Krijues dhe o i Gjithëmëshirshëm! O Mbështetës dhe o Mëshirëplotë!

Nëpërmjet instruktimit të profetit Tënd më të nderuar a.s.m. dhe mësimit të Kuranit të gjithurtë, unë kam kuptuar se ashtu si qiejt, atmosfera, toka, detet dhe malet, bashkë me krijesat e tyre dhe me gjithçka që ato përmbajnë, të njohin dhe të bëjnë Ty të njohur, po ashtu bëjnë të gjitha **pemët dhe bimët**, së bashku me të gjitha gjethet e tyre, lulet dhe frutat. Të gjitha gjethet e tyre me lëvizjet dhe me recitimet e tyre të dalldisura; të gjitha lulet e tyre të cilat përshkruajnë dhe bëjnë të njohur nëpërmjet zbukurimit të tyre Emrat e Krijuesit të tyre; dhe të gjitha frutat e tyre, të cilat buzëqeshin me ëmbëlsinë e tyre nëpërmjet manifestimit të mëshirës në to, dëshmojnë nëpërmjet

rregullit brenda artit të tyre të çuditshëm, i cili është krejtësisht i pamundur që t'i atribuohet rastësisë, nëpërmjet balancimit brenda rregullit, stolisë brenda balancës, qëndisjeve brenda stolisë, erërave -parfumave- të mira të larmishme brenda qëndisjeve dhe shijeve të ndryshme të frutave brenda erërave, parfumave,- dëshmojnë aq qartë saqë është e vetëkuptueshme për domosdoshmërinë e ekzistencës së Një Autori mëshira e të Cilit është e pafundme dhe bujaria e të Cilit është e pafundme. Në të njëjtën kohë, ngjashmëria e tyre, përngjasimi i ndërsjellë gjithandej tokës, mbajtja e tyre të njëjtën stampë mbi krijimin e tyre, dhe qënia e tyre të lidhura në administrimin dhe organizimin e tyre, dhe koinçidenca e tyre në aktet krijuese dhe në Emrat e Bukur Hyjnorë të lidhur me to, dhe anëtarët e panumërt të njëqind mijë specieve, llojeve të tyre duke u ngritur njëra përmbi tjetrën pa ngatërresë, e gjitha kjo formon një dëshmi nëpërmjet tyre si një tërësi për Unitetin dhe Njësinë e Autorit të tyre, ekzistenca e të Cilit është e domosdoshme.

Gjithashtu, ashtu siç dëshmojnë ato për ekzistencën Tënde të domosdoshme dhe për Unitetin Tënd, po ashtu të ushqyerit dhe administrimi në qindra mijëra mënyra i anëtarëve të panumërt të ushtrisë së krijesave të gjalla në faqen e tokës, e cila përbëhet nga katërqind mijë kombe të ndryshëm, në mënyrë të përkryer, pa ngatërresë dhe pa vështirësi, tregon madhështinë e Hyjnisë Tënde brenda Unitetit Tënd dhe madhështinë e fuqisë Tënde, e cila e krijon pranverën me aq lehtësi si krijimin e një luleje të vetme dhe rrethon e i përfshin të gjitha gjërat. Ato gjithashtu tregojnë gjërësinë e pakufishme të mëshirës Tënde, e cila përgatit shumëllojshmëri të panumërta ushqimesh për kafshët dhe për njerëzit gjithandej tokës; dhe nëpërmjet të gjithë atyre veprave, dhuratave, mirëbërësive, administrimit, furnizimit me ushqim, duke u kryer me rregullsi të plotë, dhe gjithçka, madje edhe grimcat e vockëla, duke qenë të bindura e të nënshtruara ndaj atyre urdhrave, ato sigurisht tregojnë shtrirjen e pafundme të Sundimit Tënd; dhe nëpërmjet çdo pjese të atyre pemëve dhe bimëve, ashtu si gjethet e tyre, lulet, frutat, rrënjët, degët dhe sythet duke u bërë me çdo aspekt të tyre duke u njohur e shikuar, në përputhje me qëllimet e dobishme, shembujt e urtësisë dhe me dobitë, ato tregojnë qartë me gishta të panumërta për njohurinë Tënde, e cila i rrethon dhe i përfshin të gjitha gjërat dhe për gjithëpërfshirjen e Urtësisë Tënde. Me gjuhë të panumërta, ato lavdërojnë dhe lartësojnë bukurinë tërësisht të përkryer të artit Tënd dhe plotësinë e mirësisë Tënde e cila është në bukurinë më të skajshme.

Gjithashtu, këto dhurata të çmueshme dhe mirësi të vlefshme, dhe këto shpenzime dhe nderime të jashtëzakonshme, në këtë banesë të përkohshme dhe në këtë bujtinë kalimtare, në një kohë të shkurtër dhe në një jetë të pakët, tregojnë dhe madje dëshmojnë se Mëshirëploti, Zotërues i Fuqisë dhe i Bujarisë është Ai që e ka sjellë gjithë këtë mëshirë për miqtë e Tij.. Nuk ka dyshim se Ai ka përgatitur pemë frutdhënëse dhe bimë të lulëzuara të përjetshme të denja e të përshtatshme për Xhennetin e përhershëm në një botë të përjetshme në një mbretëri të përjetshme për shërbëtorët e Tij të cilët do t'i bëjë të jetojnë përjetësisht.. me qëllim që të pengojë përmbysjen e rezultateve të shpenzimeve dhe të mirëbërësive të Tij të cilat i shpenzoi për ta bërë Veten të dashur e të Njohur, që të mos e bëjë të kundërt rezultatin e domosdoshëm -domethënë, që të mos thonë të gjitha krijesat: "Ti na bëre që t'i provojmë e shijojmë të gjitha ato mirësi dhe na ekzekutove para se t'i hamë"- dhe për të mos shfuqizuar sundimin e Hyjnisë së Tij, dhe për të mos e dënuar mëshirën e Tij të pafundme dhe për të mos e bërë të mohueshme; dhe me qëllim për të mos i shndërruar të gjithë të dashurit e Tij të mallëngjyer për Të në armiq nëpërmjet privimit të tyre në këtë mënyrë.. i Gjithëmëshirshmi Gjithëbujar sigurisht ka përgatitur thesaret e përjetshme të mëshirës në Xhennetet e përjetshëm. Ato këtu janë thjesht vetëm modele për t'ua shfaqur blerësve -klientëve.

Gjithashtu ashtu si të gjitha pemët dhe bimët që të shenjtërojnë dhe të bëjnë Ty tesbihate dhe të lavdërojnë nëpërmjet fjalëve të gjetheve të tyre, të luleve dhe të frutave, po ashtu çdo fjalë prej atyre fjalëve, në vetvete gjithashtu Të shenjtëron. Lavdërimet e frutave në mënyrë të veçantë nëpërmjet gjuhës së gjendjes -me shumëllojshmërinë e madhe të tulit të tyre origjinal, artit të tyre të çuditshëm, farërave të jashtëzakonshme dhe atyre tabakave të ushqimit duke ua dhënë duarve të pemëve dhe të vendosura mbi to dhe të dërguara për miqtë e Tu të gjallë- tesbihatet, lavdërimet e tyre janë aq të qarta saqë janë pothuajse gojore..

Të gjitha këto janë të bindura e të nënshtruara ndaj urdhrit që lëshohet prej Teje, në Sundimin Tënd nëpërmjet forcës dhe fuqisë Tënde, mirëbërësisë dhe dëshirës Tënde dhe nëpërmjet mëshirës dhe Urtësisë Tënde.

O Krijues që fshihesh në intesitetin e manifestimit Tënd dhe i mbuluar me madhështinë e lartësisë Tënde! O Autor, o i Gjithurtë, o Krijues, o Mëshirëplotë!

Nëpërmjet gjuhëve të të gjitha pemëve dhe bimëve, dhe gjetheve të tyre, luleve dhe frutave dhe sa numri i tyre, unë të lavdëroj e të lartësoj

Ty dhe deklaroj se Ti je i lirë prej të gjitha të metave, larg pafuqisë dhe ortakëve!

O Krijues, o i Plotëfuqishëm! O Planifikues, o i Gjithurtë! O Ushqyes, o Mëshirëplotë!

Nëpërmjet instruksionit të profetit më të nderuar a.s.m. dhe nëpërmjet mësimit të Kur'anit të gjithurtë, unë kam kuptuar dhe besuar se ashtu si bimët dhe pemët që të Njohin dhe bëjnë të njohura Atributet e Tua të shenjta dhe Emrat e Tu të Bukur; po ashtu midis **njerëzve** dhe **kafshëve**, të cilët janë ato krijesa të gjalla që kanë shpirtëra, nuk ka asnjë prej tyre veçse dëshmon nëpërmjet gjymtyrëve të saj të brendshme e të jashtme të cilat punojnë me aq rregullsi siç punojnë orët e mirërregulluara, dhe nëpërmjet sistemit shumë të hollë dhe nëpërmjet balancimit dhe ekuilibrit në trupat e tyre, dhe nëpërmjet dobive dhe qëllimeve domethënëse të shqiseve dhe aftësive të holla, artit të madh në krijimin e tyre dhe në qënien të pajisura me shumë urtësi dhe me ekuilibër të saktë të sistemeve të tyre trupore, -veçse dëshmon- domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde dhe realitetin e Atributeve të Tua. Sepse forca e errët, natyra e pavetëdijshme, rastësia e paqëllim në asnjë mënyrë nuk mund të ndërhyjnë në një art të tillë të perceptueshëm, të hollë, dhe në një urtësi të tillë të vetëdijshme e të hollë dhe në atë balancë të përkryer të urtë; ato nuk mund të jenë vepra e tyre; kjo është krejtësisht e pamundur. Gjithashtu është krejtësisht e pamundur që qëniet e gjalla të krijonin vetveten, sepse atëherë secila prej grimcave të tyre duhet të posedonte njohuri dhe urtësi gjithëpërfshirëse si të ishin zot, duhet të ishin të afta të njihnin, të shikonin dhe t'i krijonin të gjitha pjesët e trupave të tyre dhe ta formonin atë; madje ajo do të duhej të ishte në gjendje ta njihte, ta shihte dhe ta bënte gjithçka në dynja të lidhur me të, dhe të mund të thuhej se "ajo e bëri vetveten".

Gjithashtu, qënia e tyre të nënshtruara ndaj të njëjtit administrim dhe të njëjtit planifikim, dhe e gjithë qënia e tyre duke qenë i njëjti lloj, dhe të gjitha ato duke mbajtur të njëjtën stampë, të tilla si ngjashmërinë në tiparet e fytyrës si syri, veshi dhe gjuha, dhe uniteti në stampën e urtësisë që vëzhgohet në fytyrat e anëtarëve të të njëjtës specie, dhe ngjashmëria në mjetet e jetesës dhe të krijimit, dhe qënia e të gjitha atyre njëra brenda tjetrës; nuk ka ndonjë prej këtyre rrethanave veçse dëshmon në mënyrë të prerë për Unitetin Tënd dhe, nëpërmjet manifestimeve të të gjithë Emrave të Tu të cilët shikojnë Universin duke qenë mbi secilin individ, dëshmon për njësinë Tënde brenda Unitetit.

Gjithashtu, nëpërmjet qënies të pajisura, të ushtruara dhe të nënshtruara si një ushtri e rregullt dhe e disiplinuar dhe nga më e vogla për tek më e madhja, bindja e tyre në mënyrë të rregullt ndaj urdhrave të Hyjnisë dhe nënshtrimi i qindra e mijëra specieve dhe kafshëve në faqen e tokës së bashku me njeriun ndaj atyre urdhrave -që të gjitha këto-dëshmojnë shkallën e madhështisë së asaj Hyjnie; dhe nëpërmjet vlerës së tyre të madhe pavarësisht shumësisë së madhe të tyre, dhe bërja e tyre me shpejtësi të skajshme pavarësisht se ato janë të plotësuara, dhe krijimi i tyre me lehtësi të skajshme pavarësisht përkryerjes së tyre.. dëshmojnë prerazi madhështinë e fuqisë Tënde. Gjithashtu ato tregojnë në mënyrë vendimtare shtrirjen e pakufishme të Mëshirës Tënde, e cila u dërgon ushqimin të gjitha atyre, duke filluar nga mikrobet për tek hundëbrirët, dhe nga insekti më i vockël për tek shpendi më i madh të shpërndarë në skajet e lindjes, të perëndimit, të veriut dhe të jugut; dhe nëpërmjet të gjithë atyre duke kryer funksionet e tyre natyrore si ushtarët e bindur që merren rishtas, dhe në çdo pranverë faqja e tokës duke u transformuar në një fushim ushtarak për ato krijesa në vend të atyre që i përfunduan shërbimet e tyre në vjeshtën e kaluar.. kjo tregon për gjërësinë e mëshirës Tënde absolute.

Gjithashtu, nëpërmjet një njohjeje të thellë dhe një urtësie të saktë, të gjitha krijesat e gjalla duke qenë kopje të zvogëluara të universit, dhe qënia e tyre duke u bërë pa mangësi, pa të meta, pa ngatërresë midis pjesëve të përziera dhe pa konfuzion midis formave të ndryshme të tyre tregojnë sa numri i tyre për njohurinë Tënde e cila i përfshin të gjitha gjërat dhe për urtësinë Tënde që i rrethon e përfshin të gjitha gjërat; ndërsa nëpërmjet qënies së të gjitha atyre të bëra aq të bukura e të holla saqë janë mrekullitë e artit dhe çudirat e urtësisë, ato tregojnë në mënyra të panumërta bukurinë krejtësisht të plotë të artit Tënd Hyjnor të cilin Ti e do shumë dhe dëshiron ta shfaqësh; dhe nëpërmjet të gjitha atyre, dhe veçanërisht të vegjëlit e tyre duke u ushqyer në mënyrën më të mirë duke i kënaqur dëshirat dhe orekset e tyre, japin tregues të pakufishëm për bukurinë e shkëlqyer të Përkujdesjes Tënde.

O i Gjithëmëshirshëm, O Mëshirëplotë! O Më i Vërteti për të përmbushur premtimin Tënd! O Pronari i Ditës së Gjykimit!

Nëpërmjet instruktimit të profetit më të nderuar a.s.m. dhe udhëzimit të Kur’anit të Gjithurtë, unë kam kuptuar se meqenëse rezultati më i madh i universit është jeta, dhe esenca më e zgjedhur e jetës është shpirti, dhe më të zgjedhurit e qënieve me shpirtëra janë qëniet inteligjente dhe midis qënieve inteligjente -të vetëdijshme- ai

me natyrë gjithëpërfshirëse është njeriu; dhe meqenëse i gjithë universi me rolin e tij është i nënshtruar ndaj jetës dhe punon për jetën, dhe qëniet e gjalla u nënshtrohen qënieve me shpirtëra dhe dërgohen në këtë dynja për hir të tyre, dhe qëniet me shpirtëra i nënshtrohen njeriut dhe janë gjithmonë në ndihmë të tij; dhe meqenëse nga natyra njerëzit në mënyrë të sinqertë e serioze e duan Krijuesin e tyre, dhe Krijuesi i tyre i do ata, dhe e bën Vetveten të dashur për ta nëpërmjet çdo mjeti; dhe meqenëse kapaciteti i bashkëlindur i njeriut dhe aftësitë shpirtërore të tij shikojnë e orientohen për tek një botë tjetër e qëndrueshme dhe për një jetë tjetër të përhershme, dhe zemra dhe inteligjenca e tij dëshirojnë përjetësinë me të gjithë fuqinë e tyre, dhe gjuha e tij i kërkon me përgjërim Krijuesit të tij përjetësi me lutje të pafundme; Ai sigurisht nuk do t'i ofendonte njerëzit, të cilët e duan shumë Atë dhe duhen, duke u shkaktuar atyre të vdesin dhe atëherë të mos i sillte ata përsëri në jetë, ndërsa Ai i krijoi ata për një dashuri të përjetshme, duke i bërë ata -kështu- të ndjenin armiqësi të përhershme; kjo do të ishte e pamundur. Njerëzit u dërguan për të punuar në këtë dynja me qëllim që të jetojnë të gëzuar në një botë tjetër të përjetshme dhe me qëllim që ta fitojnë atë jetë. Emrat Hyjnorë të manifestuar mbi njeriun në këtë jetë të shkurtër e kalimtare tregojnë se njerëzit, të cilët do të jenë pasqyrat reflektuese të atyre Emrave në botën e përjetshme, do t'i marrin manifestimet e tyre të përjetshme.

Po, miku i vërtetë i të Vetmit të përjetshëm, dhe pasqyra e vetëdijshme e të Qëndrueshmit të Vetëm duhet të jetë i qëndrueshëm, i përhershëm.

Nga rrëfenjat e sakta kuptohet se shpirtërat e kafshëve do të jetojnë vazhdimisht, dhe se disa individë të veçantë prej kafshëve do të kalojnë për tek bota e përjetshmërisë bashkë me trupat e tyre, të tilla, si: Hud Hudi -pupëza- dhe milingonat e Hazreti Sulejmanit a.s., deveja e Salihut a.s, qeni i shokëve të Shpellës -*Tefsiru Kurtubij*- dhe se çdo specie prej tyre do të ketë një trup të veçantë që të mund ta përdorë nga koha në kohë. Kjo gjithashtu kërkohet nga urtësia dhe realiteti; po ashtu kërkohet nga mëshira dhe Hyjnia.

O i Gjithëfuqishëm dhe o Vetekzistues i Përhershëm!!!

Të gjitha krijesat e gjalla, qëniet me shpirtëra dhe qëniet e vetëdijshme u janë nënshtruar urdhërave të Hyjnisë Tënde dhe janë vënë në punë në detyrat e tyre të natyrshme vetëm nëpërmjet forcës dhe fuqisë Tënde. Disa i janë nënshtruar njeriut, jo për shkak të forcës dhe sundimit të njeriut, por nëpërmjet mëshirës Hyjnore, për shkak të dobësisë dhe pafuqisë së tij të bashkëlindura. Çdo kafshë e kryen

adhurimin e saj të veçantë, si me gjuhën e gjendjes po ashtu edhe me atë të fjalës duke lavdëruar Krijuesin e vet, Shpikësin, dhe të Adhuruarin duke e shenjtëruar Atë i Cili është krejtësisht i lirë dhe larg të metave dhe pasjes ortakë, dhe duke e lartësuar e falënderuar për mirësitë dhe dhuratat e Tij.

Lavdia të takon Ty, O Krijues i Vetëm që fshihesh në intensitetin e manifestimit Tënd dhe i mbuluar me madhështinë e lartësisë Tënde!

JUnë të shenjtëroj nëpërmjet tesbihateve të të gjitha qënieve me shpirtëra duke deklaruar: *Lavdia të takon Ty, o Krijues, që i ke bërë nga uji të gjitha gjërat e gjalla...!*[22]

O Mbështetësi i të gjitha botëve! O Zoti i të parëve dhe i të fundmive! O Mbështetësi i qiejve dhe i tokës!

Nëpërmjet instruksionit të profetit më të nderuar a.s.m. dhe mësimit të Kuranit të gjithurtë, unë kam kuptuar e besuar se ashtu si qiejt, atmosfera, globi tokësor, toka dhe deti, pemët, bimët dhe kafshët, së bashku me të gjithë anëtarët e tyre, pjesët dhe grimcat Të njohin, Të tregojnë e dëshmojnë për ekzistencën dhe për Unitetin Tënd; po kështu qëniet e gjalla, esenca e universit, dhe njeriu, esenca e krijesave të gjalla, dhe **profetët, evlijatë** dhe **dijetarët e pastër**, esenca e njerëzimit dhe, nëpërmjet vizioneve, zbulesave, inspirimeve dhe shfaqjeve **të zemrave** dhe të **intelektit të tyre,** të cilat formojnë esencën e profetëve, evlijave dhe të dijetarëve të pastër, dëshmojnë me sigurinë e konsensusit të njëqindfishtë për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde, të Unitetit dhe të Njësisë, dhe japin njoftime për to; dhe nëpërmjet mrekullive të tyre, kerameteve, dhe provave të sigurta, provojnë atë çfarë thonë.

Po, nuk ka asgjë që i ndodh zemrës, gjë e cila shikon tek Ai që e inspiron atë prej prapa perdes së të Padukshmes; dhe nuk ka inspirim, të saktë i cili e bën atë të shikojë dhënësin e inspirimit; dhe nuk ka besim të sigurtë, i cili zbulon në formën e "sigurisë absolute" atributet e Tua të shenjta dhe Emrat më të Bukur; dhe nuk ka zemër të ndritur prej Profetëve dhe Evlijave, e cila vëzhgon me "shikimin e sigurisë" dritat e Ekzistuesit të domosdoshëm; dhe nuk ka intelekt të ndriçuar prej dijetarëve të pastër dhe prej të të vërtetëve, i cili vërteton e provon me "njohjen e sigurisë" shenjat e ekzistencës së Krijuesit të të gjitha gjërave dhe provat e Unitetit të Tij; - Nuk ka ndonjë prej këtyre që nuk dëshmon për domosdoshmërinë e ekzistencës Tënde, për Atributet e

[22] Kuran, 21:30

Tua, për Njësinë dhe për Emrat e Tu të bukur, dhe i tregojnë dhe aludojnë për to.

Gjithashtu, ashtu siç duke u mbështetur tek mrekullitë e tyre, kerametet dhe tek provat, të gjithë ata qindra e mijëra lajmëtarë të vërtetë të sihariqeve dëshmojnë për ekzistencën dhe për Unitetin Tënd; kështu ata me unanimitet njoftojnë, shpallin dhe provojnë shkallën e madhështisë së Hyjnisë Tënde, e cila sundon duke filluar nga administrimi i tërësisë së çështjeve të Fronit Sublim, i Cili i rrethon të gjitha gjërat, për tek njohja, dëgjimi, administrimi, mendimet sekrete e private të zemrës, dëshirat dhe lutjet e saj. Ato tregojnë e provojnë gjithashtu madhështinë e Fuqisë Tënde, e cila krijon gjëra të ndryshme të panumërta përnjëherësh, dhe e bën gjënë më të madhe me aq lehtësi si atë më të vogëlën duke mos penguar një veprim një tjetër dhe asnjë çështje duke mos e penguar një çështje tjetër.

Gjithashtu, ato njoftojnë e provojnë nëpërmjet mrekullive dhe provave të tyre gjërësinë madhështore të mëshirës Tënde, e cila e bën universin si një pallat madhështor për qëniet me shpirtëra dhe veçanërisht për njeriun; e cila ka përgatitur parajsën dhe lumturinë e përhershme për xhindët dhe për njerëzit; që nuk harron madje as qënien më të vockël të gjallë; dhe përpiqet që të ngopë e kënaqë zemrën më të pafuqishme.

Ata gjithashtu njoftojnë për shtrirjen e pafundme të sundimit Tënd absolut i cili i nënshtron, i vë në shërbim dhe në punë të gjitha llojet e krijesave nga grimcat për tek planetët...

Ata gjithashtu, dëshmojnë, tregojnë dhe aludojnë për njohurinë Tënde gjithëpërfshirëse, e cila e bëri universin si një libër madhështor i cili përmban mesazhe aq sa numri i pjesëve të tij, dhe i cili ka regjistruar të gjitha ngjarjet e qënieve në një *Regjistër të Qartë* dhe në një *Libër të Qartë* dhe ato janë dy regjistrat e ***El-Leuhul-Mahfudhit,*** *Pllakës së Ruajtur*, dhe i cili ka vendosur, ka shkruar në mënyrë të plotë e pa gabime në farërat e tyre indekset dhe programet e të gjitha pemëve dhe biografitë e qënieve të vetëdijshme në kujtesat e kokave të tyre.

Ata gjithashtu dëshmojnë për gjithëpërfshirjen e urtësisë Tënde të Shenjtë, e cila u bashkangjit qëllime të shumta të gjitha gjërave, duke i bërë madje edhe pemët të prodhojnë rezultate sa numri i frutave të tyre, dhe e cila ndjek dobitë për të gjitha qëniet e gjalla sa numri i gjymtyrëve të tyre, dhe madje sa numri i pjesëve dhe i qelizave të tyre,

dhe duke e përdorur gjuhën e njeriut në detyra të shumta, e pajis atë me aftësi për të peshuar shijet sa numri i ushqimeve.

Ata gjithashtu dëshmojnë me unanimitet për vazhdimësinë e manifestimeve të Emrave lidhur me Bukurinë dhe Madhështinë Tënde, shembujt e të cilëve shihen në këtë dynja, se ato do të vazhdojnë në mënyrë të shndritshme për të gjithë përjetësinë, dhe se mirësitë e Tua, shembujt e të cilëve vëzhgohen në këtë botë kalimtare, do të vazhdojnë në banesën e lumturisë në një mënyrë akoma më vezulluese, dhe se ata që përmallohen për ato në këtë dynja do t'i shoqërojnë dhe do të jenë së bashku me to në të gjithë përjetësinë.

Atëherë, me në krye **profetin më të nderuar a.s.m.,** duke u mbështetur në qindra prej mrekullive të tij të ndritshme, dhe **Kurani fisnik** duke u mbështetur në ajetet e tij vendimtare, pastaj të gjithë **pejgamberët** a.s. të cilët janë me shpirtërat e tyre të shndritshëm, dhe të gjithë **evlijatë**, të cilët janë polet shpirtërorë me zemrat e tyre të mbushura me dritë, dhe të gjithë **dijetarët e pastër** me mendjet e tyre të ndritshme, duke u mbështetur tek kërcënimet dhe premtimet e Tua të përsëritura në të gjitha shkrimet e shenjta dhe në librat qiellorë, dhe duke besuar në atributet e Tua të shenjta, të tilla si: fuqia, mëshira, favori, urtësia, lavdia dhe bukuria, dhe funksionet e Tua, në dinjitetin e madhështisë Tënde, dhe në sundimin e Hyjnisë Tënde, sihariqojnë nëpërmjet zbulesave të tyre, shikimeve të tyre të ngulitur me shkallën e "njohjes së sigurisë" duke sihariquar xhindet dhe njerëzit për lumturinë e përjetshme dhe duke i paralajmëruar me xhehennem njerëzit e çudhëzuar; ata e besojnë këtë dhe dëshmojnë për të.

O i Plotëfuqishëm, O i Gjithurtë! O i Gjithëmëshirshëm, O Mëshirëplotë! O Gjithëbujar i Vetëm i Vërtetë në premtimin Tënd! O Detyrues i Gjithëlavdishëm! O Zotërues i Dinjitetit, madhështisë dhe i lartësisë!..

Ti je i Shenjtëruari Absolut, i Lartësuari Absolut dhe krejtësisht i përjashtuar dhe larg diskretimit dhe përgënjeshtrimit të kaq shumë miqve besnikë prej evlijave të vërtetë, dhe kaq shumë premtimeve të Tua të shumta, atributeve dhe funksioneve të Tua të shenjta.. dhe kretësisht larg mohimit të kërkesave të sigurta të Sovranitetit të Hyjnisë Tënde dhe duatë e Shërbëtorëve të pranueshëm e të panumërt të Tu, të cilët Ti i do dhe që tërheqin dashurinë Tënde nëpërmjet besimit tek Ti, vërtetimit dhe bindjes ndaj Teje.. Ti je i shenjtëruar, i lartësuari absolut, dhe larg konfirmimit të mohimit të ringjalljes nga ana e njerëzve të çudhëzimit dhe të mohimit, të cilët nëpërmjet mosbesimit, rebelimit dhe mohimit të premtimeve të Tua, ofendojnë

madhështinë e lartësisë Tënde, fyejnë dinjitetin dhe lavdinë Tënde, nderin e Hyjnisë Tënde dhe prekin dhembshurinë e Hyjnisë Tënde, Unë deklaroj se drejtësia, bukuria dhe mëshira Jote janë krejtësisht të lartësuara dhe larg një tiranie të tillë të shëmtuar dhe një shëmtie të tillë. Me të gjitha grimcat e qënies sime, unë dëshiroj të recitoj vërsetin,

"Lavdi, Madhështia dhe Lavdia i takojnë Atij! Larg nga të gjitha trillimet e shpifjet që i ngjisin e thonë për Të. Madhështor dhe i Lartësuar (pa kufi)"[23]

Në të vërtetë, ata të dërguarit e Tu të vërtetë prej lajmëtarëve të Sundimit Tënd dëshmojnë me "sigurinë absolute", "me njohjen e sigurisë" dhe me "shikimin e sigurisë", për thesaret e mëshirës Tënde në Ahiret dhe për depot e mirësive të Tua në botën e përhershme, dhe zbulojnë në mënyrë të plotë e të jashtëzakonshme manifestimet e bukura të Emrave të Tu në banesën e Lumturisë, dhe japin sihariqet e këtyre. Duke besuar se rrezja më e lartë e Emrit Tënd ***El-Hakk***, i Cili është burimi, dielli dhe mbrojtësi i të gjithë realiteteve, është kjo e vërteta e Ringjalljes dhe e Tubimit të Madh, ata e japin mësim atë për shërbëtorët e Tu.

O Zoti i Pejgamberëve dhe i të Drejtëve!

Ata të gjithë janë të nënshtruar dhe nëpunës në sundimin Tënd nëpërmjet urdhrit dhe fuqisë Tënde, nëpërmjet dëshirës dhe planifikimit Tënd, dhe nëpërmjet njohjes dhe urtësisë Tënde. Ata demonstrojnë nëpërmjet shenjtërimit, lavdërimit dhe lartësimit duke deklaruar që je Një i Vetëm, se globi është si një vend i gjërë për **dhikër** -për përmendje- dhe se universi është si një xhami madhështore për adhurim.

O Mbështetësi im! O Mbështetësi i qiejve dhe i tokës! O Krijuesi im! O Krijuesi i gjithçkaje! Për hir të fuqisë Tënde, dëshirës, urtësisë, sundimit dhe mëshirës Tënde, e cila i nënshtron qiejt dhe yjet e tyre, tokën dhe gjithçka që ajo përmban, dhe të gjitha krijesat së bashku me të gjitha cilësitë dhe aktet e tyre, nënshtroma nefsin tim dhe nënshtroji për mua dëshirat e mia! Nënshtroji zemrat e njerëzve të Risale-i Nurit, me qëllim që ata të mund t'i shërbejnë Kuranit dhe besimit! Dhe më jep mua dhe vëllezërve të mi besim të plotë dhe një vdekje të mirë, mbyllje të mirë! Ashtu siç ia nënshtrove detin Musait a.s., zjarrin Ibrahimit a.s., malet dhe hekurin Davudit a.s., xhindet dhe njerëzit Sulejmanit a.s., dhe diellin dhe hënën Muhammedit a.s.m., nënshtroji zemrat dhe mendjet për Risale-i Nurin! Më ruaj mua dhe të gjithë

[23] Kur'an, 17:43

studentët e Risale-i Nurit nga e keqja e nefsit dhe e shejtanit, dhe nga ndëshkimi i varrit dhe i zjarrit të xhehennemit, dhe na jep lumturi në Xhennet!

Amin.Amin.Amin.

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[24]

Ndërsa duaja e fundit e tyre do të jetë: *"Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Zotin e gjithë botëve".*[25]

Në qoftë se ka pasur ndonjë gabim nga ana ime në paraqitjen tek dera e Krijuesit tim Mëshirëplotë këtë trajtesë instruktive të cilën e kam marrë nga Kur'ani dhe nga "*Xheushan el-Kebir*" -një dua e profetit Muhammed a.s.m.- si adhurim në formën e mendimit reflektiv, duke e bërë Kuranin dhe *Xheushenin* ndërmjetësuesin tim, unë kërkoj falje për mangësitë e mia.

Said Nursi

. . .

RREZJA E KATËRT

[Ndërsa duke qenë Shkreptima e Pestë në kuptim dhe në shkallë, në formë e në 'Stacion', kjo formon Rrezen e Katërt të çmueshme të Shkreptimës së Tridhjetë e Njëtë të Letrës së Tridhjetë e Njëtë, dhe është një pikë e rëndësishme dhe e hollë që lidhet me vërsetin *"Allahu Vetëm na Mjafton neve..."*[26]]

Shënim: Ndryshe nga veprat, nga librat e tjerë, Risale-i Nuri e fillon çështjen në një mënyrë të mbuluar, të paqartë për lexuesin, veçse ama ajo qartësohet në mënyrë graduale dhe i zbulon pak e nga pak kuptimet e saj.

---

[24] Kur'an, 2:32
[25] Kur'an, 10:10
[26] Kur'an, 3:173

Në mënyrë të veçantë Shkalla e Parë e kësaj Trajtese, përveç qënies së saj një e vërtetë shumë e çmuar, është tej mase e hollë dhe e thellë. Kjo shkallë m'u shfaq në mënyrë të veçantë si shërim për sëmundjet e mia të ndryshme të thella; dhe u shfaq në formën e një diskutimi domethënës i sunduar nga ndjenjat, në formën e një bashkëbisedimi të zjarrtë, të gjallë dhe të një dialogu sekret të zemrës. Ata që i kanë ndjenjat krejtësisht në harmoni dhe në pajtueshmëri me mua mund ta kuptojnë atë plotësisht. Përndryshe ajo nuk do të vlerësohej tërësisht.]

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".[27]

Në një kohë kur kisha mbetur i izoluar dhe i privuar prej çdo gjëje nga "njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje", unë u godita nga pesë lloje mërgimi.

Në atë kohë të pleqërisë vuajta shumë prej pesë sëmundjeve të shkaktuara pjesërisht nga hidhërimet e mia. Për shkak të pakujdesisë së shkaktuar nga vuajtja e mjerimi, unë nuk u orientova tek dritat e Risale-i Nurit, të cilat do të më kishin ngushëlluar e ndihmuar, por shikova drejt tek zemra ime, dhe kërkova shpirtin tim. Unë pashë se sunduese tek unë ishin një dëshirë mposhtëse për pavdekshmëri, një dashuri e zjarrtë për ekzistencë, një përmallim i madh për jetë, së bashku me një pafuqi të pakufishme dhe një varfëri të pafundme. Por një përkohshmëri e tmerrshme po e shuante atë pavdekshmëri. Duke vuajtur nga kjo gjendje e imja, unë thirra ashtu si poeti i brengosur:[28]

"*Ndërsa zemra ime dëshiron pavdekshmërinë, Urtësia e Krijuesit, realiteti dëshiron kalimin e trupit tim;*

Unë jam goditur me një sëmundje të pashërueshme të cilën madje as Lukmani nuk do të mund ta shëronte!"

Ula kokën në dëshpërim. Papritmas vërseti,

"Allahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve", më erdhi në ndihmë, duke më thënë ta lexoja atë me vëmendje. Kështu unë e recitova atë pesëqind herë në çdo ditë. Duke e

---

[27] Kur'an, 3:173

[28] Kjo i referohet Njazi Al-Misri (1218-1294), një poet sufi i cili u lind në krahinën e Malatias në Turqi. Ai studioi në Al-Azhar, dhe prandaj u quajt Almisri. Ai shkroi një divan poezie dhe vepra të tjera, dhe dha mësim në shkollat fetare të Stambollit për shumë vite. Përkthyesi.

shkruar shkurtazi një pjesë të dritave të çmuara të cilat m'u zbuluan në formën e "Shikimit të sigurisë" dhe vetëm nëntë drita dhe shkallë, unë i referoj lexuesit tek Risale-i Nuri për hollësitë e njohura me "sigurinë absolute", dhe jo me shkallën e mëparshme të "shikimit të sigurisë".

Shkalla E Parë e vërsetit të ndritshëm *"Allahu vetëm na mjafton neve".*

Dëshira ime e zjarrtë për pavdekshmëri nuk drejtohet tek pavdekshmëria ime, por tek ekzistenca e Atij të Plotit Absolut dhe tek përplotësia dhe pavdekshmëria e Tij. Dhe kjo për shkak të ekzistencës në qënien time esenciale të një hijeje të njërit prej manifestimeve të Një Emri prej Emrave të të Plotit Absolut, Zotëruesit të Plotësisë dhe të bukurisë. Ai nga Vetvetja dhe jo për ndonjë arsye tjetër është i denjë për dashuri. Veçse ama kjo dashuri e natyrshme e kishte humbur rrugën e saj për shkak të pakujdesisë dhe ishte kapur pas hijes dhe kishte dashuruar pavdekshmërinë e pasqyrës.

Mirëpo sapo erdhi vërseti,

"Allahu Vetëm na mjafton neve, dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve", e ngriti perden. Unë pashë, ndjeva dhe përjetova me shkallën e "sigurisë absolute" se kënaqësia e pavdekshmërisë dhe lumturia e saj janë të pranishme në esencën e saj, madje në një formë më të mirë e më të plotë në pavdekshmërinë e të Qëndrueshmit përjetësisht, Zotëruesit të përplotësisë, në besimin se Ai është Mbështetësi dhe Zoti im, në besimin tek Ai dhe duke iu nënshtruar. Sepse një e vërtetë e qëndrueshme që nuk vdes realizohet për mua nëpërmjet pavdekshmërisë së Tij xh.sh., sepse vërtetohet nëpërmjet intuitës së besimit tim se "qënia ime esenciale është një hije e një Emri Hyjnor i cili është i qëndrueshëm përjetësisht dhe që nuk vdes".

Gjithashtu kënaqet e ngopet nëpërmjet asaj intuite të besimit shtytësi për ekzistencën e plotësisë absolute dhe i Cili duhet absolutisht -dashuria e bashkëlindur, e natyrshme dhe e fortë për Esencën e Tij.

Gjithashtu nëpërmjet asaj intuite të besimit -e cila lidhet me pavdekshmërinë e Të Qëndrueshmit Përjetësisht dhe me ekzistencën e Tij xh.sh. njihen plotësitë e universit dhe zbulohen veçoritë e tij, si dhe pikërisht veçoritë e llojit njerëzor, dhe mësohet se tërheqja, joshja e natyrshme e dikujt pas plotësisë e shpëton atë nga dhimbje të pakufishme dhe bëhet mjeti i kënaqësisë dhe i ëndjes.

Gjithashtu, nëpërmjet intuitës së besimit formohet një lidhje me Atë të Qëndrueshëm të përjetshëm, dhe nëpërmjet besimit në atë lidhje, vjen në ekzistencë një lidhje me të gjitha sundimet e Tij në përgjithësi. Dhe për shkak të asaj lidhje, njeriu shikon -nëpërmjet dritës së besimit- një sundim të pakufishëm, ashtu si të shikonte pronën e tij dhe përfiton prej tyre në kuptim.

Gjithashtu nëpërmjet asaj intuite të besimit dhe me anë të asaj lidhjeje, formohet një lidhje, një hallkë, me të gjitha qëniet, arrihet një lloj unioni me to.

Në këtë mënyrë lindet një ekzistencë e pakufishme -përveç ekzistencës së tij personale e cila vjen në shkallë të dytë, në vend të dytë- nëpërmjet asaj intuite të besimit dhe të atyre lidhjeve, hallkave dhe unioneve, saqë sikur ajo të ishte një ekzistencë si ekzistenca e tij, dhe kështu qetësohet dashuria e zjarrtë e bashkëlindur e tij për ekzistencën.

Gjithashtu, nëpërmjet asaj intuite të besimit, bashkimit dhe unionit, formohet një vëllazëri me të gjithë njerëzit e plotësimit dhe të virtytit. Kështu, nëpërmjet njohjes së ekzistencës së të Qëndrueshmit të Përjetshëm dhe të pavdekshmërisë së Tij, ata njerëz të panumërt nuk kanë shkuar në asgjësi dhe as nuk kanë humbur; pavdekshmëria dhe ekzistenca e vazhdueshme e plotësimeve të atyre miqve të panumërt, të cilët një person i tillë nëpërmjet intuitës së besimit i do, i admiron dhe i vlerëson dhe me të cilët ai është i lidhur, i sjell dhe i shkakton personit të asaj intuite besimi një kënaqësi të lartë sublime.

Gjithashtu, nëpërmjet asaj intuite besimi, lidhjeje, hallke, bashkimi e vëllazërie, unë ndjeva dhe përjetova në veten time një lumturi të pafundme, që buronte nga lumturia e të gjithë të dashurve të mi, për lumturinë e të cilëve unë me gatishmëri e me gjithë kënaqësi do të sakrifikoja jetën dhe pavdekshmërinë time, sepse një mik i mirë gëzohet dhe kënaqet, me lumturinë e mikut të tij të ngushtë. Prandaj nëpërmjet ekzistencës dhe pavdekshmërisë së të Qëndrueshmit të Përjetshëm, me plotësi absolute, shpëtojnë të gjithë profesorët e mi dhe të gjithë të dashurit e mi, që janë profetët a.s., Evlijatë dhe dijetarët e pastër me në krye profetin më të nderuar a.s.m., familjen e tij dhe sahabët e tij të nderuar, dhe shpëtojnë të gjithë të dashurit e mi të panumërt; që të gjithë ata shpëtojnë nga asgjësimi i përhershëm dhe fitojnë një lumturi të përjetshme të amshuar. Këtë e ndjeva nëpërmjet asaj intuite të besimit dhe reflektoi tek unë diçka nga lumturia e tyre dhe përjetova një kënaqësi të pastër dhe më bëri të lumtur.

Dhe më mbuloi lumturia më e madhe për shkak të asaj lidhjeje, vëllazërie, bashkimi e dashurie.

Gjithashtu unë ndjeva një kënaqësi shpirtërore të pafundme që shpëtova prej dhimbjeve të pakufishme, që buronin nga lidhja që kisha me bijtë e llojit tim, dhe nga dhembshuria për të afërmit e mi; unë ndjeva nëpërmjet intuitës së besimit se të gjithë të afërmit e mi nga gjaku dhe të afërmit e mi nga shpirti, për të cilët nga natyra unë dëshiroj të sakrifikoj jetën time dhe përjetësinë, dhe këtë do ta bëja me krenari, për hir të shpëtimit të tyre prej rreziqeve dhe shkatërrimeve, me në krye baballarët dhe nënat, prindërit e mi.. Unë ndjeva se ata shpëtojnë nga asgjësimi, nga mosekzistenca dhe asgjësia e përjetshme dhe prej dhimbjeve të pakufishme dhe fitojnë një mëshirë të gjërë absolute nëpërmjet ekzistencës dhe pavdekshmërisë së të Qëndrueshmit të Vërtetë të përjetshëm; dhe se një mëshirë e gjërë absolute përkujdeset për ta dhe i mbron ata në vend të dhembshurisë së pjesshme e të mangët e cila s'ka ndonjë efekt -ndikim- dhe që është burim dhimbjeje e dëshpërimi. Dhe ashtu siç përjeton kënaqësi nëna për fëmijën e saj dhe ndjen rehati kur ai është rehat, edhe unë gjithashtu përjetova kënaqësi dhe u gëzova për shpëtimin e të gjithë atyre për të cilët unë kisha dhembshuri, për përfshirjen e tyre nën mbrojtjen e asaj mëshire të gjërë dhe që po gjenin mirësi në hijen e saj, dhe me këtë intuitë u gëzova tej mase, dhe bëra falënderime të thella për Allahun xh.sh..

Gjithashtu, nëpërmjet asaj intuite besimi dhe nëpërmjet lidhjes së tij, unë njoha dhe ndjeva se Risale-i Nuri, i cili ishte frut i jetës sime dhe burimi i lumturisë sime dhe detyra ime e natyrshme, shpëtoi nga qënia e tij i humbur dhe pa dobi dhe nga asgjësimi dhe humbja e kuptimit të tij, dhe mësova nëpërmjet asaj lidhjeje besimi, madje ndjeva nëpërmjet qëndrueshmërisë së atyre Risaleve të freskëta dhe me zhvillimin e tyre në kuptim se ato do të ishin të frutshme dhe të qëndrueshme. Unë pata bindje të plotë se në këtë ishte një kënaqësi shpirtërore e cila e tejkalonte shumë kënaqësinë e pavdekshmërisë sime, dhe nëpërmjet asaj kënaqësie unë përjetova një ndjenjë vërtetë të plotë; sepse unë besova se nëpërmjet pavdekshmërisë së të Qëndrueshmit të përjetshëm, Zotëruesit të plotësisë absolute dhe nëpërmjet ekzistencës së Tij, Risale-i Nuri nuk skalitej vetëm në zemrat dhe në kujtesat e njerëzve, por gjithashtu ai studiohej nga krijesa të vetëdijshme të panumërta dhe nga qënie shpirtërore, dhe përveç kësaj, nëse do të merrte kënaqësinë e Zotit xh.sh. u skalit në Pllakat e Ruajtura, dhe stoliset me frutat e shpërblimit dhe të thevabit.

Unë mësova se në mënyrë të veçantë qënia e tij i lidhur me Kur'anin, dhe pranueshmëria e tij nga profeti a.s.m., dhe -në dashtë Zoti xh.sh.- duke qenë objekt i kënaqësisë Hyjnore, një moment nga ekzistenca e tij dhe duke qenë nën shikim Hyjnor, kjo ishte më e madhe dhe më e vlefshme se sa vlerësimi i të gjithë njerëzve të kësaj bote.

Kështu, unë kuptova se unë jam gjithmonë gati që të sakrifikoj jetën dhe pavdekshmërinë time për pavdekshmërinë, vazhdimësinë, për vlerat dobiprurëse dhe për pranueshmërinë tek Allahu e secilës prej atyre trajtesave, të cilat provojnë dhe mbështesin të vërtetat e besimit, dhe se lumturia ime qëndron në shërbim të atyre trajtesave të Risale-i Nurit për Kur'anin fisnik. Në këtë mënyrë unë kuptova nëpërmjet lidhjes së besimit se me anë të pavdekshmërisë Hyjnore, ato janë objekt vlerësimi dhe admirimi që tejkalojnë njëqind herë vlerësimin dhe admirimin e njerëzve. Prandaj unë thirra me të gjithë fuqinë time: *"All-llahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Gjithashtu nëpërmjet asaj intuite besimi unë mësova se besimi në pavdekshmërinë e Të Qëndrueshmit të përjetshëm të Gjithëlavdishëm dhe në ekzistencën e Tij i Cili jep qëndrueshmëri të përhershme dhe jetë të vazhdueshme, dhe se frutat, rezultatet e besimit të cilat janë veprat e mira janë frute të përhershme të kësaj jete të përkohshme, dhe janë mjete për një pavdekshmëri të pambarim; unë e binda nefsin tim që të jem si fara e cila e lë lëvozhgën e saj që të transformohet në një pemë frutdhënëse, domethënë e binda nefsin tim që ta lërë qëndrueshmërinë time të kësaj dynjaje që i ngjason lëvozhgës me qëllim që të japë fruta të pavdekshëm. Së bashku me nefsin tim thashë: *"All-llahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Për ne ekzistenca e Tij e përjetshme është e mjaftueshme!

Gjithashtu, nëpërmjet asaj intuite besimi dhe lidhjes së ibadetit unë mësova me "njohjen e sigurisë" se ajo çfarë qëndron përtej perdes së dheut ishte një botë e ndriçuar, dhe se shtresa e rëndë e dheut, nën të cilën kanë rënë të vdekurit, do të ngrihet prej tyre; dhe se gryka tek e cila futesh për tek dera e varrit nuk të çon në errësirat e mosekzistencës. Unë thashë me gjithë fuqinë time: *"Allahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Kështu unë formova një bindje të fortë dhe nëpërmjet asaj intuite besimi mësova me "sigurinë absolute" se në një kohë që dëshira e fortë

për pavdekshmëri në natyrën time shikoi tek pavdekshmëria e të Qëndrueshmit të Përjetshëm, Zotërues të Plotësisë dhe tek ekzistenca e Tij në dy drejtime, veçse ai e kishte humbur të dashurin e vet për shkak të egos së tij e cila i kishte vënë perde përpara tij dhe ishte kapur pas pasqyrës, dhe u bë i trullosur dhe i hutuar. Ajo dëshirë shumë e thellë dhe e fuqishme për pavdekshmëri sundoi në qënien time esenciale me anë të hijes së njërit prej Emrave të të Plotit Absolut, i Cili është i Dashuri për Vetveten, dhe i dashur nga natyra, i Adhuruari i përmalluar, e kishte dhënë këtë dëshirë të fortë për pavdekshmëri. Dhe ndërsa vetëm Plotësia e Esencës së Tij është mëse e mjaftueshme si shkak për adhurim dhe si motiv për dashuri, pasi për dashurinë e Tij nuk të shtyn ndonjë arsye apo motiv tjetër, dhe përveç Vetes së Tij nuk kërkon asnjë gjë për dashuri, duke dhuruar frutat e përjetshëm të lartëpërmendur, ashtu siç u shpjegua më lart, dhe që secila prej tyre meriton që për hir të saj të sakrifikohen jo një jetë e vetme dhe një pavdekshmëri e vetme, por nëse do të ishte e mundur me mijëra nga jetët dhe pavdekshmëritë e dynjasë, dhe ndjeva se Ajo Plotësi e Esencës së Tij nëpërmjet kësaj mirëbërësisë së Tij e kishte ngulitur atë dëshirë të fortë të natyrshme dhe e kishte thelluar edhe më shumë.

Në qoftë se do të kishte qenë brenda fuqisë sime do të kisha deklaruar me të gjitha grimcat e qënies sime: *"All-llahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*. Madje e thashë me atë nijet.

Gjithashtu, ajo intuitë besimi, e cila kërkon pavdekshmërinë e saj dhe gjeti ekzistencën e përjetshme të Allahut -ashtu siç tregova lart tek disa prej fruteve të saj nëpërmjet paragrafeve që fillonin me "Gjithashtu... Gjithashtu... Gjithashtu..."- më dhanë mua një kënaqësi dhe një gëzim të tillë saqë unë thashë me të gjithë shpirtin tim, me të gjithë fuqinë time, nga thellësitë e zemrës sime, së bashku me nefsin tim: *"All-llahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*.

Shkalla e Dytë e Vërsetit të ndritshëm *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*

Njëherë kur isha goditur me pleqërinë, mërgimin, vetminë dhe izolimin përveç pafuqisë sime të pafundme të bashkëlindur dhe i privuar nga çdo gjë dhe pa kërkënd që të më ndihmonte "njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje" më sulmonin me spiunat dhe me dredhitë e tyre, dhe pikërisht në këtë kohë unë i fola zemrës sime duke i thënë: Ushtritë po sulmojnë një njeri të vetëm, të sëmurë e të dobët

që i ka duart e lidhura. A nuk ka ai -domethënë unë- ndonjë pikë mbështetje? Ndërkohë iu referova vërsetit: *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*. Dhe vërseti më tregoi mua sa vijon:

Nëpërmjet lidhjes që buron nga besimi, ti mbështetesh tek një Sulltan Madhështor Zotërues i një fuqie absolute, saqë përgatit me rregullsi të plotë në çdo stinë mbi sipërfaqen e tokës të gjitha ushtritë e bimëve dhe të kafshëve që përbëhen nga katërqind mijë lloje kombesh e grupesh duke i pajisur me pajime dhe me mjetet e domosdoshme për to; Ai i ripërtërin uniformat e dy ushtrive të rregullta madhështore të cilat janë pemët dhe zogjtë fluturues duke i veshur me rroba të reja dhe duke ndryshuar simbolet e tyre, saqë Ai i ndryshon veshjen e malit dhe mbulesën e fushës -shkretëtirës- ashtu siç i ndryshon fustanet e pulave dhe veshjet e shpendëve të bukur.

Për më tepër, ky Sulltan i vendos të gjitha racionet e ushqimit të ushtrisë madhështore të gjallesave -me në krye njeriun- jo si në mënyrën që ka zbuluar në kohët e fundit njeriu bashkëkohor prej "ekstrakteve" të mishit, sheqerit dhe të tjera veç këtyre të dyjave, por në mënyrën e ekstrakteve -shtrydhjeve- shumë më të plota e më të mira, madje që e tejkalojnë njëqind herë -mënyrën e njeriut. Ato janë ekstraktet e të gjitha llojeve të ushqimeve; janë ekstraktet "mëshirë" të njohura si farërat dhe bërthamat. Për më tepër, Ai gjithashtu i mbështjell ato ekstrakte me mbështjellëse në përputhje me Kaderin Hyjnor dhe në harmoni e në përshtatje me pjekjen, shtrirjen dhe rritjen e tyre, dhe i ruan ato në kutia e sunduqe -enë- shumë të vogëla. Edhe këto sunduqe të vockëla gjithashtu prodhohen në fabrikën e ***"Kun Fejekun***" *"Bëhu! Dhe ajo është bërë (në çast)"* me një shpejtësi shumë të skajshme dhe me lehtësi absolute dhe me një bollëk shumë të madh, saqë Kur'ani i gjithurtë e përmend atë me Fjalën e Zotit xh.sh., *"Është vetëm se Ai t'i thotë asaj: "Bëhu!" dhe ajo është e bërë (në çast)!"*[29]

Dhe pavarësisht se të gjitha ato ekstrakte janë të ngjashme me njëra-tjetrën dhe të përbëra nga të njëjtat lëndë që nuk do të plotësonin nevojën e një qyteti të vetëm, Furnizuesi Gjithëbujar pjek prej tyre vetëm në stinën e verës aq sa mund t'i mbushë të gjitha qytetet në tokë me ushqime që janë shumë të shijshme e të ndryshme.

Përderisa mund të gjesh një pikë të tillë mbështetjeje nëpërmjet lidhjes së besimit, atëherë ti mund të mbështetesh në një forcë madhështore dhe tek një fuqi absolute.

---

[29] Kur'an, 36:82, etj...

Duke e marrë këtë mësim nga vërseti, unë fitova një forcë të tillë morale dhe një qëndrueshmëri besimi saqë unë do të mund të sfidoja jo vetëm armiqtë e mi të tanishëm, por të gjithë botën. Prandaj përsërita nga thellësitë e shpirtit tim vërsetin: *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Duke kërkuar një burim ndihme për varfërinë dhe për nevojën time të pafundme, dhe unë përsëri përdora të njëjtin vërset. Ai më tha: Nëpërmjet adhurimit dhe të robërisë tënde, ti je bërë i lidhur me një Pronar Gjithëbujar, dhe emri yt është regjistruar në fletoren, në regjistrin e furnizimit të krijesave me ushqime. Ai e shtron sofrën e mirësive të Tij në çdo pranverë e verë dhe e lëviz atë, madje e shtrin dhe e zgjat atë më shumë se njëqind herë duke e stolisur me ushqime të ndryshme të shijshme që i sjell nga bota e padukshme dhe nga mosekzistenca prej vendeve që nuk mund t'i parashikojë robi dhe prej dheut të thatë, saqë sikur vitet e kohës dhe ditët e çdo viti të ishin enë, pjata për frutat e mirësisë së Tij dhe për ushqimet e mëshirës së Tij që shfaqen në një varg të pandërprerë -një pas një.

Ato janë ekspozita për shkallët e mirëbërësive të Furnizuesit Mëshirëplotë për shkallë Universale dhe të pjesshme. Ti je shërbëtori, robi i një Pasaniku të këtillë absolut. Në qoftë se do të ishe i vetëdijshëm për robërinë tënde, atëherë varfëria jote e dhimbshme do të transformohej në një oreks të kënaqshëm. Unë me rolin tim e mora pjesën time prej këtij vërseti Kur'anor dhe thashë me vete: "Po, po! Ajo është pikërisht e vërteta. Dhe përsërita duke u mbështetur tek Allahu xh.sh.: *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve."*

Shkalla e Tretë e vërsetit të ndritshëm *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Në kohën kur i gjeta të këputura lidhjet e mia me dynjanë për shkak të presioneve, shtypjeve të mërgimit dhe të sëmundjes dhe të padrejtësive që vuajta, dhe se besimi më njoftonte se unë isha caktuar për një botë tjetër të përjetshme, për një mbretëri të përhershme dhe për një lumturi të vazhdueshme, unë i braktisa ofshamat "ah! ah!" që buronin nga dëshpërimi dhe i zëvendësova me atë çfarë sihariqonte për mirësi e gëzim dhe që më bënte të jepja falënderime të vazhdueshme. Por ky objektiv i imagjinatës, ky qëllim i shpirtit dhe rezultati i krijimit do të mund të arriheshin e realizoheshin vetëm nëpërmjet një fuqie të pakufishme të të Gjithëfuqishmit Absolut që i njeh të gjitha lëvizjet e

krijesave të Tij, pushimet, aktet dhe gjendjet e tyre dhe që i regjistron ato gjithashtu; dhe që e merr këtë njeri të vogël dhe absolutisht të pafuqishëm si mikun e Tij dhe si atë të cilit i bëhet adresimi, duke i dhënë një rang mbi të gjitha krijesat. Duke menduar për këto dy pika, domethënë për aktivitetin e kësaj fuqie të pakufishme dhe për rëndësinë e vërtetë që Krijuesi xh.sh. ia dha këtij njeriu pavarësisht parëndësisë së tij në dukje, unë desha një shpjegim që do të shtonte besimin tim dhe që do të kënaqte mendjen time. Unë përsëri përdora atë vërset Kur'anor. Ai më tha: "Vëreje me kujdes "*Na*-në" tek "*Hasbuna-ja*" "*Allahu vetëm na mjafton neve"* dhe shikoji ata që e thonë "*Hasbuna*-në" bashkë me ty me gojë dhe nëpërmjet gjuhës së gjendjes". Kështu me urdhëroi ajeti!..

Kështu, unë hodha vështrimin dhe menjëherë pashë se zogj të panumërt, dhe zogj fluturues shumë të vegjël, krijesa fluturuese të panumërta si mizat, kafshë të panumërta, krijesa të vogla të gjalla, bimë dhe gjëra në rritje të pallogaritshme, dhe numra të pafundmë pemësh dhe shkurrishtesh... që të gjitha këto përsërisnin si unë nëpërmjet gjuhës së gjendjes kuptimin e "*Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve*"; madje ato ua sillnin ndërmend edhe të tjerëve atë... sepse Ai që ushtron kontroll mbi të gjitha ato dhe që i garanton të gjitha gjërat e domosdoshme të jetëve të tyre në një mënyrë të tillë që Ai i krijon përpara syve tonë dhe veçanërisht në pranverë me një bollëk shumë të madh, me një lehtësi të skajshme, me shpejtësi të skajshme dhe me një shtrirje të skajshme, pa gabim, pa defekt dhe pa ngatërresë, prej vezëve, prej pikëlave të lëngut, prej farërave dhe bërthamave të cilat i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe lënda e të cilave është e njëjtë; që i krijon të stolisura, të balancuara dhe të rregullta njëqind mijë lloje kafshësh, njëqind mijë specie shpendësh, njëqind mijë lloje bimësh dhe njëqind mijë lloje pemësh, të cilat që të gjitha me veçoritë e tyre dalluese, janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Me të gjithë këtë përzierje, përngjasimi dhe përafrimi, Ai na demonstron ne Unitetin dhe Njësinë e Tij brenda madhështisë dhe lartësisë së Fuqisë së Tij. Ndërkaq unë kuptova nga vërseti se ishte krejtësisht e pamundur që të kishte ndonjë ndërhyrje apo ortakëri në ato akte të Hyjnisë dhe të krijueshmërisë të cilat shfaqnin mrekulli të tilla të panumërta.

Pastaj hodha vështrimin tek '***Ene***' '*Unë*' që gjendej në '*Hasbuna'* "*Allahu vetëm na mjafton*", domethënë hodha vështrimin tek vetja ime, bëra hulumtim në të dhe pashë se Ai që i krijoi kafshët nga një pikë uji, më krijoi edhe mua gjithashtu nga ajo; dhe më krijoi mua si një mrekulli prej mrekullive të Tij; Ai hapi veshin tim, bashkëngjiti syrin

tim, dhe vendosi në kokën time trurin, në kraharorin tim një zemër dhe në gojën time një gjuhë, saqë krijoi në atë tru, në atë zemër dhe në atë gjuhë me qindra pesha dhe masa të holla me të cilat të mund të peshoj e të njoh të gjitha dhuratat e të Gjithëmëshirshmit të ruajtura e të depozituara në thesaret e mëshirës Hyjnore dhe me dhuratat e Tij bujare; dhe ka përfshirë në ato gjymtyrë me mijëra instrumente për të hapur dhe kuptuar thesaret e manifestimeve të pafundme të Emrave të Bukur Hyjnorë dhe i mbështeti ato instrumente dhe aparate me instruksione ndihmëse sa numri i aromave, i shijeve dhe i ngjyrave.

Po kështu, Ai xh.sh. ka përfshirë në këtë trup me rregull të përkryer emocione të ndjeshme, shqisa të brendshme dhe aftësi të holla jolëndore. Ai i ka krijuar me art të përkryer të gjitha sistemet, gjymtyrët dhe aftësitë e domosdoshme për jetën e njeriut, me qëllim që Ai të më bëjë mua të shijoj, të provoj e të kuptoj të gjitha shumëllojshmëritë e mirësive të Tij dhe që të më bëjë të njohur manifestimet e ndryshme të panumërta të Emrave të Tij, nëpërmjet atyre ndjenjave të holla dhe shqisave të brendshme, dhe të më shtyjë që t'i provoj e shijoj ato.

Për më tepër, Ai e ka bërë trupin tim, i cili duket i mjerë, i varfër dhe i parëndësishëm, ashtu si trupat e të gjithë besimtarëve, si një kalendar të bukur dhe si një ditar të universit, dhe si një kopje të zvogëluar të botës më të madhe, si një model të zvogëluar të kësaj dynjaje, si një mrekulli e ndritshme dhe e qartë e artit të Tij; si një blerës kërkues të çdo lloji prej llojeve të mirësive të Tij të panumërta, si një listë dhe indeks, dhe si një qendër për ligjet e Hyjnisë së Tij, si një mjet për të ekzekutuar urdhërat dhe zhvillimet e Tij; si një model për kopshtin e luleve të dhuratave të urtësisë dhe të mëshirës së Tij dhe si një marrës të kuptueshëm të adresimit Hyjnor. Gjithashtu Krijuesi ma dha mua jetën që ta bëjë ekzistencën -e cila është mirësia më e madhe- të madhe e të shumtë në qënien time, me qëllim që mirësia e kësaj ekzistencës sime të mund të shtrihet me jetën sa bota e dukshme.

Gjithashtu Ai xh.sh. më dha 'humanizmin', nëpërmjet të cilit mirësia e ekzistencës të mund të zbulohet në botërat fizike e shpirtërore, duke hapur rrugën për të përfituar -nëpërmjet shqiseve të veçanta për njeriun- prej atyre sferave të gjëra të mirësive.

Ai gjithashtu më ka dhuruar 'Islamin', nëpërmjet të cilit mirësia e ekzistencës të mund të shtrihet sa shtrirja e botës së padukshme dhe e botës së dukshme.

Gjithashtu Ai më dha mua besimin e sigurt të verifikuar, nëpërmjet të cilit mirësia e ekzistencës të mund t'i rrethojë mirësitë e dynjasë dhe të Ahiretit dhe të mund t'i përfshijë ato.

Gjithashtu Ai më dha njohjen dhe dashurinë për Zotin xh.sh. brenda besimit. Nëpërmjet kësaj Ai dhuroi një rang nëpërmjet të cilit mirësia e ekzistencës të mund t'i shtrijë duart me lavdërime e vlerësime për tek sferat e shumta duke filluar nga sfera e mundësive për tek bota e domosdoshmërisë dhe për tek sfera e Emrave të Bukur Hyjnorë, me qëllim që të përfitoj prej tyre.

Gjithashtu, Ai më ka dhënë në mënyrë të veçantë njohjen e Kur'anit dhe urtësinë e besimit, që nëpërmjet kësaj mirësie Ai më ka dhuruar një epërsi mbi shumë krijesa.

Gjithashtu Ai më ka dhënë aftësi gjithëpërfshirëse si ato që u përmendën më lart me qëllim që unë të mund të jem pasqyrë e plotë për Njësinë e Tij dhe për Hyjninë e Tij të përjetshme, dhe që të mund t'i përgjigjem me adhurim universal Hyjnisë së Tij universale të shenjtë.

Gjithashtu ashtu siç është vërtetuar nga të gjitha librat dhe shkrimet e shenjta që iu shpallën njerëzimit nëpërmjet profetëve, të dëshmuara e të provuara nga të gjithë pejgamberët, evlijatë dhe të pastërtit, Ai e blen prej meje ekzistencën time, jetën, dhe veten time -siç thuhet në vërsetet e Kur'anit- të cilat janë dhurata dhe të lëna amanet tek unë, me qëllim që ato të mos humbasin dhe të mos shkojnë kot. Ai në mënyrë të përsëritur dhe kategorike ka premtuar se do t'i ruajë ato me qëllim që t'i rikthejë përsëri tek unë, dhe se si çmim Ai do të japë një lumturi të përjetshme dhe parajsën. Këtë unë e kuptova me "njohurinë e sigurisë" dhe e besova me bindje të plotë.

Kështu, unë mësova nga vërseti, *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve",* se Krijuesi im madhështor i Gjithëlavdishëm e Gjithëbujar, "hap" nëpërmjet Emrit të Tij ***El-Fettah***, *Hapës,* format e qindra mijërave të llojeve të kafshëve dhe të bimëve prej pikave të ngjashme e të kufizuara dhe prej bërthamave të ngjashme dhe të kufizuara në numër, i hap me lehtësinë dhe me shpejtësinë më të skajshme dhe me përkryerjen më të skajshme, dhe ashtu siç u përmend më parë, Krijuesi xh.sh. i dha njeriut këtë rëndësi madhështore të habitshme, duke e bërë atë boshtin kryesor të veprave të Hyjnisë së Tij madhështore; po ashtu Ai do ta krijojë Ringjalljen e të vdekurve dhe Xhennetin dhe do të na dhurojë lumturinë e

përjetshme me aq lehtësi dhe siguri ashtu siç do të krijojë pranverën e ardhshme.

Nëse do të kishte qenë e mundur, unë do të kisha deklaruar nëpërmjet gjuhëve të të gjitha krijesave, por meqenëse ajo nuk është e mundur, unë deklaroj me nijet dhe nëpërmjet mendimit dhe imagjinatës:

"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve". Dhe kështu unë dëshiroj ta përsëris atë gjatë gjithë përjetësisë.

Shkalla e Katërt e vërsetit të ndritshëm "*All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Njëherë, kur një periudhë e pakujdesisë sime koinçidoi me qënien time të tronditur nga vështirësi e nga lëndime të ndryshme të tilla si: pleqëria, mërgimi, sëmundja dhe qënia ime i mposhtur në çështjen time, unë u mposhta nga një shqetësim pikëllues saqë pikërisht ekzistenca ime, pas së cilës isha lidhur fort dhe pas së cilës unë isha robëruar, do të pushonte së ekzistuari, do të shkonte në mosekzistencë, madje ekzistenca e të gjitha krijesave do të kalonte e do të përfundonte në zhdukje... Shkuarja e të gjithave në mosekzistencë më shkaktoi shqetësim të madh dhe një tronditje të dhimbshme. Përsëri unë përdora vërsetin *All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve",* Ai -vërseti- më tha: "Studioje kuptimin tim dhe shiko nëpërmjet teleskopit të besimit!" Unë vështrova kuptimet e tij dhe pashë nëpërmjet syve të besimit se qënia ime e cila është një grimcë shumë e vockël ishte një pasqyrë për një ekzistencë të pakufishme, dhe nëpërmjet një shtrirjeje të pafundme ishte një mjet për të fituar ekzistenca të panumërta; ajo ishte një fjalë urtësie që prodhonte lloje të shumta të përhershme ekzistence që janë më të çmueshme se sa ekzistenca ime dhe më të larta në vlerë. Unë kuptova me "njohjen e sigurisë" se për shkak të lidhjes së saj me atë ekzistencë të pafundme, saqë të jetuarit e saj për një çast ishte aq e vlefshme sa të ekzistuarit përjetësisht; sepse duke kuptuar nëpërmjet intuitës së besimit se qënia ime është një vepër prej veprave të Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, si dhe arti dhe manifestimi i Tij, xh.sh... unë shpëtova prej errësirrës së pafundme të frikësimeve pikëlluese dhe prej dhimbjeve të ndarjeve të panumërta. Unë mësova se brenda një ndarje të përkohshme ishte një bashkim i përhershëm me qëniet që i doja, me të cilat nëpërmjet hallkave të vëllazërisë sa numri i Emrave të Bukur

Hyjnorë të manifestuar në aktet që lidhen me krijesat e gjalla në mënyrë të veçantë, unë kisha fituar një lidhje.

Dihet se për ata të cilët i lidh i njëjti fshat, qytet apo vend, ose i njëjti regjiment, komandant, ose profesor, ne ndiejmë një vëllazëri të ngushtë dhe një miqësi të ngrohtë e të fortë; ndërsa ata që janë të privuar nga lidhje të këtilla vuajnë vazhdimisht një torturë të hidhur të rrethuar nga errësira të dhimbshme.

Gjithashtu frutat e një peme, në qoftë se do të kishin pasë vetëdije, intelekt, do të ndjenin se ato janë vëllezër, shokë dhe vëzhgues të njëri-tjetrit. Në qoftë se pema do të pushonte, ato fruta do të këputeshin prej saj, secili frut do të ndiente dhimbjen e ndarjes aq sa numri i frutave.

Kështu, nëpërmjet besimit dhe lidhjes që rezultojnë prej tij, ekzistenca ime -si ajo e të gjithë besimtarëve- fiton dritat e ekzistencave të panumërta të paprekura nga ndarja. Madje edhe në qoftë se ekzistenca ime do të largohej, qëndrueshmëria e atyre llojeve të ekzistencës pas saj do ta bënin ekzistencën time të kënaqur e të qetë sikur ajo të kishte mbetur vetë e plotë.

Për më tepër, ashtu siç është demonstruar në detaje në Letrën e Njëzet e Katërt, ekzistencat e të gjitha krijesave të gjalla dhe veçanërisht të atyre me shpirtëra, janë si fjalë. Ato fliten dhe shkruhen dhe pastaj zhduken. Por në vend të ekzistencave të tyre, ato lënë prapa ekzistenca të shumta të cilat mund të numërohen si ekzistenca të shkallës së dytë, si kuptimet e tyre, shëmbëlltyrat dhe format e tyre -në qoftë se kanë qenë Fjalë të bekuara, të mira- dhe realitetet e tyre.. vetëm atëherë ato kalojnë poshtë perdes dhe zhduken. Edhe ekzistenca ime është njëlloj si ajo fjalë.

Po ashtu është ekzistenca e çdo gjallese. Kur ato largohen nga ekzistenca e jashtme, ekzistenca ime dhe ekzistencat e të gjitha krijesave të gjalla, lënë pas tyre shpirtërat e tyre -në qoftë se janë prej qënieve me shpirtëra- dhe lënë kuptimet e tyre, realitetet dhe shëmbëlltyrat, rezultatet e tyre të kësaj dynjaje dhe frutat e Ahiretit të prodhuara nga ato në mënyra individuale -veç e veç-; ato lënë prapa format dhe identitetet e tyre në kujtesat e njerëzve dhe në Pllakat e Ruajtura dhe në shiritat e filmave të pamjeve të përjetshme, dhe në ekspozitat e njohjes së Parapërjetshme; dhe ato lënë në regjistrin e punëve të tyre tesbihatet e bëra nga qëniet e tyre esenciale, të cilat i përfaqësojnë dhe u japin qëndrueshmëri, dhe përgjigjet e tyre të bashkëlindura ndaj manifestimeve të Emrave të Bukur Hyjnorë dhe

çfarë kërkojnë medoemos Emrat, dhe qënien e tyre si pasqyra ekzistuese për to, e lënë në sferën e Emrave.

Ato lënë prapa në vendet e tyre ekzistenca të shumta jofizike si këto, më të vlefshme se sa ekzistencat e tyre të jashtme, dhe atëherë ato largohen. Këtë unë e njoha me "njohurinë e sigurisë".

Kështu, nëpërmjet besimit, intuitës dhe lidhjes që rezultojnë nga besimi, njeriu mund të pretendojë të jetë pronar i këtyre llojeve të lartëpërmendura të ekzistencave të përhershme jolëndore. Dhe në qoftë se nuk do të ishte besimi, ai do të humbiste në kotësi, do të shkonte në mosekzistencë, përveç qënies së tij i privuar nga ato lloje ekzistencash.

Njëherë, unë ndjeva një dëshpërim të madh për shkak të zhdukjes me një shpejtësi të madhe të luleve të pranverës dhe për asgjësimin e tyre; madje më erdhi shumë keq dhe u lëndova për ato krijesa delikate. Por e vërteta e lartëpërmendur që buroi nga besimi tregoi se ato lule të tilla bëhen lule në botën e kuptimit. Secila si një pemë frutdhënëse ose si një kalli. Për sa ka të bëjë me dritat e ekzistencës, të gjitha ato ekzistenca -përveç shpirtit- prodhojnë një përfitim të njëqindfishtë. Ekzistencat e tyre të jashtme nuk shkojnë në mosekzistencë, ato fshihen. Ato gjithashtu janë forma të reja të realitetit të qëndrueshëm të specieve; sepse qëniet e pranverës së kaluar prej gjetheve, luleve, frutave dhe gjërave të ngjashme me to, janë të njëjtat si ato në këtë pranverë; ndryshimi është vetëm i jashtëm.

Unë madje kuptova se ndryshimi i jashtëm ishte për t'i lejuar ato fjalë urtësie, ato fraza mëshire dhe ato shkronja fuqie të fitojnë kuptime të shumta të ndryshme. Në vend të ankimit dhe vajtimit për ikjen e atyre luleve, unë thirra duke përsëritur: ***Ma shaall-llah, Barekall-llah***..!

Kështu, nëpërmjet intuitës së besimit dhe duke qenë i lidhur nëpërmjet besimit me Krijuesin e qiejve dhe të tokës, unë perceptova nga larg se çfarë burimi krenarie dhe nderi ishte të jesh vepra e artit të një Mjeshtri i Cili i stolisi qiejt me dritat e yjeve dhe e zbukuroi tokën me lule dhe me çudirat e krijesave dhe shfaqi mijëra mrekulli në secilin nga artifaktet e fuqisë së Tij- Sa e çmueshme dhe e rrallë do të ishte të jesh bërë nga një Mjeshtër i Tillë Mrekullibërës. Vërseti në mënyrë të veçantë më mësoi mua se meqenëse Ai Mjeshtër Mrekullibërës ka shkruar në kopjen e vockël të njeriut librin madhështor të qiejve dhe të tokës, madje duke e bërë njeriun të zgjedhur dhe një përmbledhje të plotë të atij libri, çfarë nderi i madh, çfarë arritje, plotësie, dhe mënyre për të fituar vlerë të lartë ishte kjo

për njeriun, dhe se nëpërmjet lidhjes dhe intuitës së besimit, ai mund ta merrte dhe ta pretendonte atë nder. Duke i përfytyruar të gjitha krijesat në mendjen time, unë formova nijetin dhe thashë nëpërmjet gjuhëve të të gjitha atyre: *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Shkalla e Pestë e vërsetit të ndritshëm *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Njëherë tjetër kur jeta ime po tronditej nga pesha të rënda e situata të egra, unë e ktheva shikimin tim drejt jetës dhe pashë se jeta ime po kalonte shpejt për në Ahiret; unë po i afrohesha fundit të jetës sime; ajo kishte filluar të shuhej për shkak të shtypjes që kisha vuajtur. Mirëpo detyrat e rëndësishme të jetës, veçoritë e saja të larta dhe dobitë e saj të çmueshme të përmendura në trajtesën e Risale-i Nurit e cila hulumton rreth Emrit Hyjnor ***El-Hajj***, *i Gjalli i Përjetshëm*, nuk përshtaten me këtë shuarje të shpejtë; përkundrazi ato përshtaten me një jetë të gjatë dhe të amshuar. Ndërkaq, me të gjithë dëshpërimin dhe dhimbjen mendova për këtë dhe iu referova profesorit tim duke përdorur vërsetin Kur'anor: *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*, dhe ai më tha: Shikoje jetën ashtu siç e dëshiron ***El-Hajjul-Kajjum*** "*i Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi i Përhershëm*", i Cili ta dhuroi jetën!" Kështu e sodita atë me këtë teleskop dhe pashë se në qoftë se një aspekt i jetës shikonte tek unë, njëqind aspekte shikonin tek ***El-Hajj El-Muhji***, "*I Gjalli i Përjetshëm Jetëdhënës".* Në qoftë se njëri nga rezultatet e saja kishte të bënte me mua, një mijë nga rezultatet e saja i përkisnin Krijuesit tim. Prandaj, një çast i vetëm nga jeta, ose një moment nga koha brenda këtij aspekti ishte shumë i mjaftueshëm, dhe nuk ishte nevoja për një kohë të gjatë. Meqenëse kjo e vërtetë është shpjeguar me prova në pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit, këtu në formë të përmbledhur e të shkurtuar ne do ta shpjegojmë atë në 'katër çështje'.

Çështja e Parë: Unë sodita në mënyrën që esenca dhe realiteti i jetës shikojnë tek ***El-Hajj El-Kajjum***, "*I Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm"* dhe pashë se në realitet jeta ime ishte një magazinë çelësash të thesareve të Emrave Hyjnorë.. ishte një hartë e zvogëluar e skalitjeve të tyre të mahnitshme.. ishte një indeks i manifestimeve të tyre, një balancë e hollë dhe një masë e ndjeshme për të peshuar të vërtetat më të mëdhaja të universit.. ishte një fjalë urtësie e shkruar për të njohur dhe për të njoftuar, për të kuptuar dhe për të

bërë të kuptuar Emrat Madhështorë të vlefshëm të ***El-Hajj El-Kajjum,*** "*Të Gjallit të Përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm".*

Realiteti i jetës në këtë mënyrë fiton me mijëra shkallë e rangje të çmueshme, madje vazhdimësia e saj prej një ore gjen dhe fiton rëndësinë e një jete të gjatë. Prandaj, për sa ka të bëjë me lidhjen e saj me të Përjetshmin e Vetëm, i Cili nuk ka kohë, nuk përkufizohet nga koha, jeta nuk mund të shikohet lidhur me gjatësinë apo me shkurtësinë e saj.

Çështja e Dytë: Hodha vështrimin tek të drejtat reale të jetës dhe pashë e kuptova se jeta ime është një mesazh Hyjnor; ajo i fton vëllezërit e mi, krijesat e tjera të vetëdijshme, të lexojnë vetveten; ajo është një vend studimi që bën të njohur Krijuesin Gjithëbujar. Ajo është një afishe njoftimi që shpall plotësitë e Krijuesit tim.. prej të drejtave të saj janë stolisja me vetëdije të plotë me dhurata të çmueshme dhe me dekorata të vyera që i janë dhuruar nga Krijuesi i jetës për t'i shfaqur përpara shikimit të Sulltanit të Gjithëlavdishëm në paradën e përditshme të përsëritur duke i paraqitur me vetëdije, me besim, me falënderime dhe me mirënjohje. Gjithashtu, prej të drejtave të saj është të perceptojë përshëndetjet e qënieve të gjalla të panumërta të cilat përshkruajnë me to Krijuesin e tyre; të kuptojë dhuratat e tesbihateve të tyre që i paraqesin si falënderim e lavdërim për Allahun; dhe t'i shohë e t'i shpallë ato duke i dëshmuar.

Gjithashtu, prej të drejtave të saj është që ajo të bëjë të njohur me gojë dhe nëpërmjet gjuhëve të gjendjes së natyrshme dhe të adhurimit bukuritë e Hyjnisë së ***El-Hajj El-Kajjum,*** *"Të Gjallit të Përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm"*.. Dhe kështu, të drejta të larta të këtilla të jetës nuk kërkojnë një kohë të gjatë; dhe përveç kësaj ato e lartësojnë njëmijëfish vlerën dhe gradën e jetës; dhe ato janë një mijë herë më të vlefshme, më të larta dhe më të çmueshme se sa të drejtat e jetës së kësaj dynjaje. Dhe kur e mësova këtë me "njohjen e sigurisë", thashë: "Lavdi Zotit! Sa i madh është besimi! Dhe sa shumë jetik është ai! Në çdo gjë që futet, ai i jep jetë asaj; madje një dritë prej tij e transformon këtë jetë të përkohshme në jetë të përhershme, dhe heq vulën e përkohshmërisë që është vënë sipër saj.

Çështja e Tretë: Unë sodita detyrat e natyrshme të jetës sime dhe tek dobitë e saj jomateriale të cilat shikonin Krijuesin tim Gjithëbujar, dhe pashë se ajo kryente detyrën e pasqyrës për Krijuesin e jetës në tre mënyra:

Mënyra e Parë: Nëpërmjet pafuqisë së saj, dobësisë, varfërisë dhe nevojës, jeta ime kryen misionin e një pasqyre që reflekton fuqinë e Krijuesit të jetës, forcën, pasurinë dhe mëshirën e Tij. Sepse ashtu siç njihen shkallët e shijes së ushqimit sipas përqindjes së shkallës së urisë, dhe shkallët e dritës njihen nëpërmjet shkallëve të errësirës; dhe shkallët e nxehtësisë njihen nëpërmjet shkallëve të të ftohtit, po ashtu nëpërmjet pafuqisë sime dhe varfërisë sime të pakufishme në jetën time, unë kuptova fuqinë absolute të Krijuesit tim dhe mëshirën e Tij të gjërë lidhur me përgjigjen ndaj nevojave të mia të pafundme dhe lidhur me zmbrapsjen e armiqve të mi të panumërt. Dhe mësova detyrën e adhurimit dhe u pajisa me lutje, dua, përgjërim, përulësi dhe, duke kërkuar strehim tek Zoti xh.sh. i ndërmora këto detyra.

Mënyra e Dytë: është të vepruarit si një pasqyrë për Atributet universale dhe gjithëpërfshirëse dhe për aktet madhështore të Krijuesit tim Gjithëbujar nëpërmjet kuptimeve të njohjes, dëshirës, dëgjimit, shikimit dhe si shembulli i këtyre prej cilësive të pjesshme në jetën time. Po, unë mësova nëpërmjet të pjesshmeve cilësi të tilla, si njohjen, dëgjimin, shikimin, fjalën dhe dëshirën me të cilat përshkruhet jeta ime private dhe aktet e mia që i kryej me vetëdije; dhe mësova nëpërmjet tyre -si masa e vogëlsisë sime në krahasim me madhësinë e universit- atributet universale e gjithëpërfshirëse të Krijuesit tim, të tilla, si: njohjen, dëshirën, dëgjimin, shikimin, jetën dhe fuqinë; dhe, gjithashtu kuptova nëpërmjet tyre cilësitë e Tij madhështore të tilla, si: dashurinë, zemërimin, mëshirën dhe dhembshurinë. Unë i besova ato atribute dhe ato cilësi madhështore, i vërtetova dhe i dëshmova dhe, nëpërmjet tyre, gjeta një rrugë tjetër për njohjen e Allahut.

Mënyra e Tretë: është të vepruarit si një pasqyrë për Emrat Hyjnorë, skalitjet dhe manifestimet e të cilëve janë të pranishëm në jetën time.

Po, sa herë që sodisja tek jeta ime dhe tek trupi im, shikoja qindra lloje prej veprave të mrekullueshme, skalitjeve dhe arteve dhe, për më tepër, vështroja se unë ushqehesha në mënyrën më të mëshirshme e të dhembshur. Kështu nëpërmjet dritës së besimit unë kuptova se sa bujar i jashtëzakonshëm, i mëshirshëm, i dhembshur, me fuqi të skajshme dhe me mjeshtëri të mahnitshme ishte Ai i Cili më krijoi dhe më dha jetë. Unë gjithashtu mësova se çfarë do të thotë Tesbihat, shenjtërim, lavdërim, falënderim, madhërim, lartësim, njësim dhe të deklaruarit e madhështisë dhe të lartësisë së Tij dhe si shembulli i këtyre prej detyrave të natyrshme, qëllimeve të krijimit dhe rezultateve të jetës.

Unë mësova me "njohjen e sigurisë" arsyen pse jeta është krijesa më e çmueshme në univers dhe përse çdo gjë i nënshtrohet asaj, dhe mësova urtësinë e ekzistencës së një pasioni të bashkëlindur për jetën tek gjithkush; dhe kuptova se shpirti i jetës është vetëm besimi.

Çështja e Katërt: me qëllim që të mësoja dhe të gjeja përgjigje se cila ishte kënaqësia reale e jetës sime në këtë dynja dhe cila ishte lumturia e saj, unë përsëri bëra hulumtim mbi vërsetin *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".* Unë pashë se kënaqësia më e pastër dhe lumturia më e panjollosur në këtë jetën time qëndronin në besim. Domethënë, në besimin tim të sigurt se unë isha krijesa, artifakti dhe robi krejtësisht pronë e një Krijuesi të Vetëm të Gjithëmëshirshëm i Cili më krijoi dhe më dha jetë, se isha nën shikimin e Tij, nën përkujdesjen, ushqehesha prej Tij dhe gjatë gjithë kohës kisha nevojë për Të, dhe se Ai ishte edhe Mbështetësi im, edhe Zoti im dhe ishte shumë Mëshirëplotë dhe i Dhembshur për mua. Ky besimi im ishte një kënaqësi e plotë, e përhershme, pa dhimbje dhe ishte një lumturi e papërshkrueshme. Ndërkaq unë kuptova nga vërseti se sa e përshtatshme ishte thënia: *"Lavdi Zotit për mirësinë e besimit!"*

Kështu, këto katër çështje, domethënë, realiteti, të drejtat, detyrat dhe kënaqësia e jetës tregojnë se, sa më shumë që të orientohet jeta tek ***El-Hajj, El-Kajjum, El-Baki,*** *"i Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm, i Qëndrueshmi i Amshuar",* dhe sa më shumë të bëhet besimi jeta dhe shpirti i jetës, aq më e qëndrueshme bëhet ajo dhe aq më shumë fruta të qëndrueshëm prodhon ajo.

Për më tepër, ajo bëhet aq e lartë e sublime, saqë ajo merr manifestimin e përjetësisë; ajo nuk shikon më tek gjatësia apo tek shkurtësia e jetës. Këtë unë e mësova nga vërseti. Dhe në emrin e të gjitha jetëve dhe qënieve të gjalla, dhe me atë qëllim e mendim, unë deklarova: *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Shkalla e Gjashtë e vërsetit të ndritshëm *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".*

Në kohën kur pleqëria ime po më kujtonte për ndarjen time personale nëpërmjet atyre ndarjeve të përgjithshme të gjithanshme të cilët paralajmëronin ngjarjet e kijametit dhe shkatërrimin, fundin e dynjasë, dhe nëpërmjet zbulimit të gjërë të jashtëzakonshëm, në kohët e fundit të jetës sime, të ndjeshmërisë për bukurinë, mallëngjimit të madh ndaj saj, dhe joshjes pas plotësive të ngulitura thellë në natyrën

time... nëpërmjet të gjitha këtyre, pashë se zhdukja dhe përkohshmëria të cilat shkatërrojnë në mënyrë të vazhdueshme, dhe se vdekja dhe mosekzistenca të cilat shkaktojnë ndarje vezhdimisht; i pashë ato të dyja duke e prishur në mënyrë të tmerrshme e të llahtarshme bukurinë e kësaj dynjaje të bukur, duke e shformuar e duke e copëtuar atë dhe duke shkatërruar bukurinë e krijesave të saj. Unë ndjeva dhimbje të thella dhe u pikëllova shumë nga ajo çfarë pashë. Duke kërkuar ngushëllim pasi dashuria 'metaforike' në natyrën time u rebelua shumë kundra kësaj situate, unë përdora vërsetin Kur'anor. Ndërkohë ai më tha: "Recitomë mirë, dhe studioje me vëmendje kuptimin tim!"

Kështu unë hyra në observatorin e sures së *Dritës*, *En-Nur*, në vërsetin "*Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës..."* Prej andej sodita nëpërmjet teleskopit të besimt nivelet më të largëta të vërsetit "*Allahu vetëm na mjafton neve...",* dhe në të njëjtën kohë pashë nëpërmjet intuitës së besimit misteret e tij më të holla.. Unë pashë se ashtu siç shfaqin pasqyrat, objektet e shndritshëm, copat e xhamit dhe madje edhe shkumëzimi i detit dhe flluskat e tij lloje të ndryshme të bukurisë së fshehur të dritës së diellit dhe bukurinë e ndryshme të shtatë ngjyrave të tij, dhe me kapacitetet e tyre të ndryshme dhe me ndryshimin dhe ripërtëritjen, ripërtërijnë bukuritë e tij; dhe duke reflektuar e përthyer dritën, bëjnë të njohur bukuritë e fshehura të diellit dhe shtatë ngjyrat në dritën e tij; po ashtu është çështja me këto artifakte të bukura, me këto krijesa të holla dhe me këto qënie të hijshme e të këndshme, të cilat vijnë pa pushim dhe largohen me qëllim që të veprojnë si pasqyra për bukurinë e shenjtë të "të Hirplotit të Gjithëlavdishëm" i Cili është "Drita e parapërjetshme dhe e paspërjetshme" duke ripërtërirë me këtë manifestimet e bukurisë së Tij të shenjtë dhe manifestimet e bukurisë së përhershme të Emrave të Tij të Bukur xh.sh... Atëherë Bukuria e jashtme në këto krijesa dhe hijeshia e dukshme në to nuk janë pronë e tyre, por ato janë aluzione për atë bukuri të shenjtë të përjetshme e cila dëshiron të shfaqet, dhe janë shenja e shkreptima të asaj hijeshie të pastër që manifestohet vazhdimisht, dhe të asaj bukurie të shenjtë të lartësuar e cila dëshiron të shihet e të bëjë të shohë. Kjo është shpjeguar në mënyrë të hollësishme në Risale-i Nur dhe është mbështetur me prova të fuqishme. Këtu, do të aludohet në mënyrë të shkurtuar për tre nga ato prova.

Prova e Parë: Bukuria e një objekti të punuar me mjeshtëri, e bukur tregon prerazi bukurinë e mjeshtërisë, të artit. Kjo bukuri arti dhe përsosmëria e tij artistike tregon bukurinë e Autorit të saj që buron prej asaj mjeshtërie; dhe bukuria e titullit të mjeshtërisë së Artistit tregon bukurinë e cilësisë së atij Autori Mjeshtër e cila i referohet asaj

mjeshtërie; dhe bukuria e kësaj cilësisë së tij tregon bukurinë e aftësive dhe të talentit të tij; dhe bukuria e aftësisë së tij tregon në mënyrë të vetëkuptueshme bukurinë e esencës së Tij dhe bukurinë e realitetit të Tij.

Ashtu si këto dëshmi që janë vendimtare e të vetëkuptueshme, po ashtu Hijeshia dhe Bukuria e jashtme në krijesat e bukura në të gjithë këtë botë, dhe arti i mrekullueshëm që shihet në të gjitha krijesat e bukura, dëshmojnë në mënyrë vendimtare për bukurinë dhe hijeshinë e veprave të Autorit të Gjithëlavdishëm. Dhe bukuria dhe hijeshia në aktet e Tij xh.sh. -padyshim tregojnë për bukurinë dhe hijeshinë e titujve që i shikojnë ato akte, domethënë, dëshmojnë bukurinë dhe hijeshinë e Emrave të bukur Hyjnorë. Dhe bukuria dhe hijeshia e Emrave dëshmon në mënyrë vendimtare për bukurinë dhe hijeshinë e Atributeve të shenjta, të cilat janë burimi i atyre Emrave. Dhe bukuria dhe hijeshia e Atributeve dëshmon prerazi për bukurinë dhe hijeshinë e cilësive dhe aftësive esenciale të cilat janë burimi i atyre atributeve. Dhe bukuria dhe hijeshia e cilësive dhe e aftësive esenciale dëshmojnë në mënyrë të vetëkuptueshme për bukurinë dhe hijeshinë e Plotësisë së Shenjtë të Esencës që është burimi i akteve dhe është vepruesi që cilësohet nga Emrat dhe Atributet, dhe dëshmojnë për bukurinë e shenjtë të Realitetit të Tij. Domethënë, Krijuesi, Autori Hirplot Zotëron një bukuri e hijeshi të pakufishme që i përshtatet Esencës së Tij të shenjtë, një hije e vetme e së cilës i ka zbukuruar të gjitha këto qënie; Ai, Krijuesi, Zotëron një bukuri të lartësuar, të shenjtë, një manifestim i së cilës e ka pajisur me bukuri të gjithë universin, si dhe ka stolisur e ndriçuar me shkreptimat e asaj bukurie e hijeshie të gjithë sferën e mundësive.

Po, ashtu si një vepër e punuar me mjeshtëri që nuk mund të vijë në ekzistencë pa një akt, po ashtu edhe akti nuk mund të ndodhë pa një veprues, që ta kryejë aktin. Dhe ashtu siç është e pamundur që të ketë emra pa dikë që ata tregojnë, po ashtu është e pamundur të ketë atribute pa dikë që ato cilësojnë. Meqenëse ekzistenca e një vepre arti tregon në mënyrë të vetëkuptueshme aktin e një autori i cili e punoi atë me mjeshtëri, dhe se ekzistenca e atij akti tregon ekzistencën e vepruesit të tij, titujt e tij dhe cilësitë e tij të cilat sollën si rezultat atë vepër, dhe për emrin e tij, atëherë padyshim plotësia dhe bukuria e veprës së artit tregojnë gjithashtu bukurinë dhe plotësinë të veçanta për aktin që e punoi me mjeshtëri, dhe kjo tregon bukurinë e veçantë e të përshtatshme për emrin e bërësit të aktit; dhe kjo me “njohurinë e sigurisë” dhe në mënyrë të vetëkuptueshme tregon për plotësinë dhe

bukurinë e Esencës dhe të Realitetit të Tij, të cilat janë të përshtatshme dhe të denja për atë Esencë dhe për atë realitet.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, meqenëse është e pamundur për aktivitetin e vazhdueshëm nën perden e veprave të artit në univers që të jetë pa shkaktuesin e aktivitetit; dhe Emrat manifestimet dhe skalitjet e të cilëve janë të dukshme mbi krijesa, është e pamundur që të jenë pa atë që ato tregojnë e shprehin, po ashtu është e pamundur që fuqia, dëshira dhe të tjera si këto prej Atributeve madhështore të cilat janë pothuajse të dukshme, të jenë pa Atë që ato cilësojnë.

Atëherë të gjitha veprat e artit, krijesat dhe artifaktet në këtë univers, me ekzistencat e tyre të pakufishme, tregojnë në mënyrë vendimtare ekzistencën e akteve të Krijuesit të tyre, Autorit dhe Bërësit të tyre; tregojnë ekzistencën e Emrave të Tij, ekzistencën e Atributeve të Tij, ekzistencën e cilësive të Tij esenciale dhe ekzistencën e domosdoshme të Esencës së Tij më të pastër e të shenjtë.

Gjithashtu, të gjitha llojet e ndryshme të bukurisë, të plotësisë dhe të hijeshisë që shihen në krijesat dëshmojnë me qartësi të plotë -por në një mënyrë të veçantë dhe të denjë për shenjtërinë dhe për domosdoshmërinë e tyre- për plotësitë dhe bukuritë e pafundme, të pakufishme dhe të larmishme të akteve të Autorit të Gjithëlavdishëm, për Emrat e Tij, Atributet, Cilësitë dhe për Esencën e Tij të shenjtë; Gjithashtu ato tregojnë në mënyrë vendimtare për bukuritë e tyre të larta e sublime, të cilat i tejkalojnë shumë ato të të gjitha qënieve.

Prova e Dytë përmban Pesë Pika:

Pika e Parë: Duke u mbështetur në ndriçimet dhe në zbulesat e tyre, imamët, drejtuesit e njerëzve të realitetit kanë besuar dhe kanë deklaruar me unanimitet -pavarësisht rrugëve dhe metodave të tyre që ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra- se shembujt e bukurisë dhe të hijeshisë në të gjitha gjërat janë hijet, shkreptimat dhe manifestimet e bukurisë së shenjtë të fshehur dhe e hijeshisë së lartësuar të Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm.

Pika e dytë: Të gjitha krijesat e bukura shfaqen karvan pas karvani dhe pastaj pa ndaluar, zhduken; ato vijnë njëra pas tjetrës në vijim dhe pastaj largohen. Mirëpo një bukuri e lartë dhe e pandryshueshme e shfaq vetveten në pasqyrat e atyre krijesave duke demonstruar me siguri nëpërmjet vazhdimësisë së manifestimit të saj se ajo bukuri nuk u përket atyre krijesave të bukura; dhe nuk është as bukuria e atyre pasqyrave. Përkundrazi ajo janë rrezet e një bukurie të përjetshme,

ashtu siç tregon vazhdimësia e bukurisë së rrezeve të diellit mbi flluskat e ujit rrjedhës bukurinë e tij të vazhdueshme.

Pika e Tretë: Është e qartë dhe e vetëkuptueshme se ashtu siç vjen drita nga diçka e ndritshme, dhënia e ekzistencës nga diçka ekzistuese, mirëbërësia -dhurata- nga pasuria, bujaria nga begatia dhe mësimdhënia nga njohja, po ashtu është e vetëkuptueshme se dhënia e hijeshisë vjen nga i hijshmi dhe dhënia e bukurisë vjen nga i bukuri; kjo nuk mund të jetë në ndonjë mënyrë tjetër. Duke u mbështetur mbi këtë të vërtetë ne besojmë dhe themi se të gjitha llojet e bukurisë që shihen tek të gjitha qëniet vijnë nga një i bukur Hirplot, bukuria e të Cilit është e pakufishme saqë universi duke ndryshuar vazhdimisht dhe duke u ripërtërirë pandërprerë përshkruan bukurinë e Atij të Bukuri Hirplotë dhe e bën atë të njohur nëpërmjet të gjitha krijesave të tij dhe nëpërmjet gjuhëve të përmbushjes së tyre të detyrës së pasqyrave që reflektojnë atë bukuri.

Pika e Katërt: Ashtu si trupi që mbështetet tek shpirti, ekziston nëpërmjet tij dhe gjallërohet prej tij, dhe ashtu siç shikon fjala tek kuptimi dhe ndriçohet nga ai; dhe forma mbështetet tek Realiteti dhe fiton vlerë nëpërmjet tij; po ashtu kjo botë, bota e dukshme materiale e fizike është një trup, një fjalë, një formë e cila mbështetet tek Emrat Hyjnorë prapa Perdes së të Padukshmes, duke marrë jetë dhe gjallëri prej tyre; ajo orientohet drejt tyre dhe i shikon ato dhe zbukurohet dhe i shtohet shkëlqimi: Të gjitha llojet e bukurisë fizike burojnë nga bukuritë jofizike të kuptimeve të tyre dhe nga një hijeshi jolëndore e realiteteve të tyre. Sa për realitetet e tyre, ato marrin shkëlqim prej Emrave Hyjnorë dhe janë një lloj prej hijeve të atyre Emrave. Kjo e vërtetë është provuar në mënyrë vendimtare në Risale-i Nur.

Kjo do të thotë se të gjitha varietetet dhe llojet e bukurisë në univers janë shenjat, treguesit dhe manifestimet -nëpërmjet Emrave- të një bukurie të shenjtë, bukuri që manifestohet pa të meta dhe e zhveshur nga lënda, bukuri që manifestohet nga prapa perdes së të padukshmes. Por ashtu si Esenca më e pastër dhe e shenjtë e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm të Cilës nuk i ngjason absolutisht asnjë esence tjetër, dhe ashtu si Atributet e Tij madhështorë që janë të shenjta dhe pafundësisht më të larta se atributet e qënieve të mundshme, po ashtu bukuria e Tij e shenjtë gjithashtu nuk i ngjason bukurisë së qënieve të mundshme dhe nuk është absolutisht si hijeshia e krijesave. Përkundrazi, ajo është një bukuri e lartë, sublime, e shenjtë, e lartësuar dhe absolute. Sigurisht, një bukuri e përjetshme që një manifestim i vetëm i së cilës është parajsa e gjërë me të gjitha

shijet e hijeshisë dhe të shkëlqimit të saj dhe shikimi për një orë i bukurisë së Tij xh.sh. nga banorët e Xhennetit i bën ata ta harrojnë atë parajsë të bukur, atëherë nuk ka dyshim se kjo bukuri e amshuar është e pafundme, krejtësisht e pangjashme, e pakrahasueshme dhe e pashoqe.

Dihet se bukuria e një gjëje i përshtatet asaj dhe është në përputhje me të; dhe ka me mijëra lloje bukurish e ngjyrash të cilat që të gjitha ndryshojnë nga njëra-tjetra ashtu si ndryshimi i llojeve të krijesave. Për shembull, bukuria e perceptuar nga syri nuk është njëlloj si diçka e bukur e dëgjuar me vesh; dhe një bukuri absrakte e kapur nga mendja nuk është njëlloj si bukuria e ushqimit që ndjehet e shijohet me gojë; po ashtu bukuritë që vlerësohen e perceptohen si të bukura nga zemra, shpirti dhe nga shqiset e jashtme dhe të brendshme janë të gjitha të ndryshme ashtu si ndryshimi i atyre shqiseve dhe i aftësive të holla.

Për shembull, bukuria e besimit, bukuria e realitetit, bukuria e dritës, bukuria e një luleje, bukuria e shpirtit, dhe bukuritë e formës, mëshirës, drejtësisë, mirësisë dhe urtësisë... çdo lloj prej llojeve të kësaj bukurie është i ndryshëm nga tjetra.

Gjithashtu, bukuria e Emrave të bukur të Hirplotit të Gjithëlavdishëm; kjo bukuri që është një bukuri absolute ndryshojnë nga njëra-tjetra; Prandaj llojet e bukurisë dhe të hijeshisë në qënie gjithashtu janë të ndryshme për këtë shkak.

Në qoftë se dëshiron të shikosh një manifestim të vetëm prej llojeve të bukurisë së Emrave të Hirplotit të Gjithëlavdishëm që manifestohet në pasqyrat e qënieve, vështro me syrin e imagjinatës së gjërë tek sipërfaqja e tokës duke e supozuar të jetë një kopësht i vogël përpara teje; ti do të shohësh se termat si mëshira, dhembshuria, urtësia dhe drejtësia aludojnë edhe për Emrat e Allahut, edhe për aktet e Tij, edhe për Atributet e Tij si dhe për cilësitë e Tij madhështore.

Hidhe vështrimin tek ushqimet e qënieve të gjalla -me në krye njeriun- ato ushqime dërgohen në mënyrë të rregullt e të mahnitshme prej prapa perdes së të padukshmes... dhe shihe bukurinë e mëshirës Hyjnore.

Pastaj shikoje mënyrën e mrekullueshme të të ushqyerit e të gjithë të vegjëlve, dhe dy pompat e qumështit të varura sipër kokave të tyre në kraharorët e nënave të tyre, ai ushqim që është më i ëmbli e më i pastërti rrjedh për ta si uji i Selsebilit, Keutherit... dhe shikoje bukurinë joshëse, bukurinë e mëshirës Hyjnore.

Atëherë shikoje bukurinë e pashoqe të urtësisë Hyjnore, e cila e ka bërë të gjithë universin si një libër madhështor urtësie çdo shkronjë e të cilit përmban njëqind fjalë; çdo fjalë të të cilit përmban qindra rreshta; çdo rresht i të cilit përmban një mijë e një kapituj dhe çdo kapitull i të cilit përmban me mijëra libra të vegjël... Shikoje bukurinë e pakrahasueshme, bukurinë e urtësisë Hyjnore.

Pastaj shikoje bukurinë autoritare e të ndritshme, bukurinë e drejtësisë Hyjnore që i mban të gjithë universin dhe të gjitha qëniet e tij në ekuilibër; mban balancën e të gjithë trupave qiellorë të lartë e të poshtëm; dhe u jep përshtashmëri, simetri, përpjesëtim e harmoni që janë elementët më të rëndësishëm thelbësorë të bukurisë; dhe e bën çdo gjë të fitojë gjendjen më të mirë; dhe u jep të drejtat e jetës qënieve të gjalla; dhe siguron se të drejtat e tyre janë të garantuara; dhe ndalon e dënon agresorët.

Pastaj hidhe vështrimin tek njeriu! Gjithëruajtësi ka shkruar historinë e jetës së kaluar të tij në fuqinë e memories së tij -në kujtesën e tij- e cila është aq e vogël sa një kokërr gruri; dhe i ka përfshirë programet e jetëve dytësore të të gjitha bimëve dhe pemëve në farërat dhe në bërthamat e tyre; dhe u ka dhënë gjallesave gjymtyrë dhe aftësi të domosdoshme për t'u mbrojtur; shikoji për shembull krahët e bletëve dhe thumbimet, pickimet e tyre thumbuese, bajonetat e vogla të bimëve gjembake dhe lëvozhgat e forta të farave; dhe shihe bukurinë e hollë të ruatjes dhe të mbrojtjes Hyjnore.

Pastaj shikoji mysafirët e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit Gjithëbujar tek tryeza e të gjithë tokës, dhe erërat e këndshme të ushqimeve të ndryshme të panumërta të përgatitura nga mëshira, dhe ngjyrat e tyre të bukura e të larmishme, dhe shijet e tyre të shijshme e të ndryshme, dhe organet dhe gjymtyrët e të gjitha krijesave të gjalla të cilat përshtaten dhe ndihmojnë kënaqësinë dhe ëndjet e jetëve të tyre; dhe shikoje bukurinë jashtëzakonisht të këndshme dhe të ëmbël të mirëbërësisë dhe të bujarisë Hyjnore.

Hidhe vështrimin tek format e mahnitshme, të urta e kuptimplota të krijesave të gjalla -me në krye njeriun- ato forma që hapen nga pikat e lëngut nëpërmjet manifestimit të Emrave Hyjnorë ***El-Fet-tah*** dhe ***El-Musav-vir***, *Hapësi* dhe *Formëdhënësi*, dhe hidhe vështrimin tek fytyrat joshëse të luleve të pranverës të cilat hapen nga farërat dhe bërthamat shumë të vogëla.. dhe shikoje bukurinë e mrekullueshme, bukurinë Hyjnore të 'Hapjes' dhe të 'formëdhënies'.

Kështu, duke bërë analogji me këto shembuj, secili nga Emrat e Bukur Hyjnorë ka një bukuri të lartë e të shenjtë të veçantë për të, një manifestim i vetëm i të cilës bën të bukur botën e gjërë dhe speciet e panumërta të qënieve.

Ashtu siç shihet manifestimi i bukurisë së një Emri Hyjnor në një lule të vetme; po ashtu pranvera është një lule, edhe parajsa gjithashtu është një lule ende e paparë.

Në qoftë se do të kishe mundësinë ta shihje pranverën, të gjithë pranverën, dhe ta shihje parajsën me syrin e besimit, atëherë vështroje dhe shikoje madhështinë e bukurisë së përjetshme.

Në qoftë se ti do t'i përgjigjeshe asaj bukurie me bukurinë e besimit dhe me bukurinë e adhurimit, ti do të ishe krijesa më e bukur dhe në modelin më të bukur. Ndërsa në qoftë se ti e takon atë bukuri me shëmtinë e pakufishme të çudhëzimit dhe me shëmtinë e neveritshme të rebelimit, mosbindjes, ti do të ishe krijesa më e shëmtuar dhe në efekt do të ishe krijesa më e neveritshme për të gjitha krijesat e bukura.

Pika e Pestë: Në përputhje me rregullin se të gjitha artet e bukura, mjeshtëritë e të holla, veçoritë, plotësitë, bukuritë dhe hijeshitë dëshirojnë ta shfaqin vetveten dhe vetë të jenë të vlerësuara, një mjeshtër madhështor i cili ka qindra arte, mjeshtëri, plotësi dhe bukuri të pafundme ndërtoi një pallat madhështor të jashtëzakonshëm me qëllim që të bëjë të njohur dhe të paraqesë e të përshkruajë të gjitha artet e Tij, mjeshtëritë, plotësitë dhe bukuritë e Tij të fshehura.

Kushdo që e shikon këtë pallat madhështor të mbushur me mrekulli e çudira, sigurisht menjëherë do të mendonte për virtytet, artet, plotësitë dhe veçoritë e ndërtuesit, autorit dhe pronarit të tij.

Ky shikim hulumtues e çon atë t'i vërtetojë e t'i besojë ato virtyte e veçori tamam sikur t'i shihte me sytë e tij, dhe do të thonte: "Ai që nuk është i bukur dhe mjeshtër i talentuar në të gjitha anët, kurrësesi nuk do të mund të ishte burimi, krijuesi, "ndërtuesi dhe shpikësi i këtij pallati të mahnitshëm, i kësaj vepre kaq të bukur".Është sikur bukuritë jolëndore të atij "Ndërtuesi dhe Plotësitë e Tij janë mishëruar në këtë pallat".

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në qoftë se nuk do t'i ishin prishur mendja dhe zemra, ai person që do ta shikonte bukurinë e kësaj bote që quhet universi, këtë ekspozitë të mahnitshme, këtë pallat madhështor dhe krijesat e çuditshme, nuk ka dyshim se ai menjëherë do të mendonte se ky pallat që është stolisur me këtë bukuri madhështore,

është vetëm se një pasqyrë reflektuese për të shfaqur bukuritë e një tjetri, hijeshitë dhe plotësitë e Tij. Domethënë, përderisa ky pallat, pallati i botës, nuk ka të barabartë e të përngjashëm dhe asgjë nuk i ngjason atij që të mund ta kishte marrë bukurinë prej saj dhe të kishte imituar e kopjuar hijeshitë prej saj, atëherë nuk ka dyshim se Autori i tij, dhe ndërtuesi i tij zotëron bukuritë dhe hijeshitë që përshtaten me Vetveten e Tij dhe me Emrat e Tij; bota merr bukurinë prej Tij. Dhe për këtë arsye u ndërtua kjo botë në përputhje me dritat e asaj bukurie, dhe u shkrua si një libër i mahnitshëm madhështor me qëllim që ta shprehë atë bukuri.

Prova e Tretë përmban tre Pika:

Pika e Parë: kjo është një e vërtetë e shpjeguar në mënyrë të hollësishme në Vendqëndrimin e Tretë të Fjalës së Tridhjetë e Dytë. Duke ia referuar asaj Fjale shpjegimin e saj të detajuar, këtu ne do ta shqyrtojmë vetëm me një aluzion të hollësishëm.

Ne i sodisim krijesat dhe sidomos kafshët dhe bimët që janë para nesh, dhe shohim se mbi ato sundon një stolisje e vazhdueshme, një zbukurim i hollë dhe një rregull i përsosur -që kurrsesi ato nuk mund t'i atribuohen Rastësisë- të cilat tregojnë qëllim dhe vullnet dhe bëjnë të ditur njohjen dhe urtësinë.

Gjithashtu shikohet se në çdo gjë ndodhet një art aq i përkryer, një urtësi aq të hollë, një stolisje aq e lartësuar, një organizim aq me dhembshuri dhe një situatë aq e ëmbël, saqë kuptohet qartë në mënyrë të vetëkuptueshme, se prapa perdes së të padukshmes, është një Autor mrekullibërës i Cili dëshiron ta bëjë artin e Tij të vlerësueshëm, të tërheqë shikimet për tek ai art dhe të kënaqë shikuesit; që dëshiron ta bëjë Vetveten të njohur tek të vetëdijshmit, dëshiron ta bëjë Vetveten të dashur tek ata dhe t'i shtyjë ata për të bërë Lavdërime ndaj Tij duke shfaqur shumë prej mjeshtërive dhe plotësive të Tij në çdo vepër të artit të Tij.

Gjithashtu shikohet se Krijuesi xh.sh. u bën mirë krijesave të vetëdijshme me qëllim që t'i kënaqë ato dhe t'i bëjë të lumtura e miq për Vetveten, u dhuron çdo lloj mirësie të shijshme prej vendesh të paparashikuara në një mënyrë që është krejtësisht e pamundur që t'i atribuohen rastësisë.

Gjithashtu vëzhgohen një trajtim bujar, një njohje e ndërsjellë dhe një dialog i ngushtë miqësor me gjuhën e gjendjes dhe një përgjigje me dhembshuri ndaj lutjeve gjë që e bën të perceptohet një dhembshuri shumë e thellë dhe një mëshirë shumë e lartësuar.

Domethënë, Dhurimi i mirësisë dhe dhënia e kënaqësisë që shihen prapa bërjes të njohur dhe bërjes të dashur, të cilat janë aq të qarta si dielli, burojnë nga një dëshirë dhembshurie shumë e rrënjosur dhe nga një dëshirë mëshire shumë e fuqishme dhe e gjërë.

Atëherë ekzistenca e një dëshire të tillë të fuqishme e të rrënjosur në dhembshurinë dhe në mëshirën në Atë i Cili është i Vetmjaftueshmi Absolut dhe që nuk ka nevojë për asgjë, sigurisht demonstron një bukuri krejtësisht të plotë, të parapërjetshme, të përhershme dhe të pashoqe, natyra dhe realiteti i të cilës bëjnë të domosdoshme dëshirën e saj për t'u shfaqur dhe për ta shikuar vetveten në pasqyra. Me qëllim që ta shfaqë e ta shohë vetveten në pasqyra të ndryshme, kjo bukuri ka marrë formën e dhembshurisë dhe të mëshirës; pastaj në pasqyrat e qënieve të vetëdijshme ajo ka marrë gjendjen e mirëbërësisë; pastaj ka marrë formën e bërjes së vetvetes të njohur e të dashur, dhe pastaj dha dritën, dritën e stolisjes së krijesave dhe dritën e bërjes së tyre të bukura.

Pika e Dytë: Ekzistenca e një përmallimi të fortë Hyjnor dhe e një dashurie të fuqishme Hyjnore tek ata persona të panumërt dhe sidomos tek klasa më e lartë e njerëzimit, pavarësisht rrugëve dhe metodave të tyre që janë të gjitha të ndryshme, tregojnë në mënyrë të vetëkuptueshme për një bukuri të pashoqe dhe e bëjnë të domosdoshme atë. Po, një dashuri e tillë shikon vetëm tek një bukuri e tillë dhe e bën të domosdoshme atë, dhe një pasion i tillë kërkon një hijeshi të tillë. Madje të gjitha lavdërimet e dhëna nga qëniet me gojë dhe nëpërmjet gjuhës së gjendjes shikojnë tej ajo bukuri e parapërjetshme dhe ngjiten tek ajo. Në shikimin e ashikëve si Shemsi Tabrizi, të gjitha tërheqjet, robërimet, ekstazat, dallditë dhe të vërtetat tërheqëse në univers janë shenjat e një të vërteteje tërheqëse të parapërjetshme dhe të paspërjetshme. Ndërsa lëvizja e dalldisur dhe rrotullimet që i bëjnë trupat qiellorë të lartë e të poshtëm dhe të gjitha qëniet të vallëzojnë e të rrotullohen si flutura dhe dervishë mevlevi ashikë janë përgjigjjet e pasionuara, plotë dashuri në kryerjen e detyrës ndaj shfaqjeve autoritare të bukurisë së shenjtë të asaj të vërtete tërheqëse.

***Pika e Tretë*:** Të gjithë dijetarët që kanë kërkuar e verifikuar realitetin kanë pajtueshmëri mendimi se ekzistenca është mirësi e pastër dhe dritë, ndërsa mosekzistenca është thjesht e keqe dhe errësirë. Imamët e njerëzve të arsyes dhe njerëzit e zemrës kanë rënë dakord unanimisht, nëpërmjet analizave përfundimtare, se të gjithë shembujt e mirësisë, të bukurisë dhe të kënaqësisë burojnë nga

ekzistenca, dhe se të gjitha të këqijat, të prishurat, fatkeqësitë, dhimbjet e vuajtjet -dhe madje edhe mëkatet- i atribuohen mosekzistencës.

Në qoftë se ti thua: Burimi i të gjitha bukurive është ekzistenca, por gjithashtu në ekzistencë ndodhen mosbesimi dhe egoizmi i nefsit?

Përgjigjja: Mosbesimi është mosekzistencë për shkak se ai është mohimi i të vërtetave të besimit. Sa për ekzistencën e egoizmit, ajo është një formë mosekzistence që ka fituar ngjyrën dhe formën e ekzistencës për shkak të një pretendimi të gabuar të pronësisë, duke mos e njohur egoizmi qënien e vet që është thjesht një pasqyrë dhe duke e përfytyruar diçka imagjinare të jetë aktuale -reale.

Meqenëse burimi i të gjitha bukurive është ekzistenca dhe burimi i të gjitha llojeve të shëmtisë është mosekzistenca, atëherë nuk ka dyshim se ekzistenca më e fuqishme, më e lartësuar, më e shndritshme dhe më e largëta prej mosekzistencës është ekzistenca e parapërjetshme dhe e paspërjetshme e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm... dhe ajo kërkon bukurinë që është më e fuqishmja, më e lartësuara, më e ndritshmja dhe më e largëta prej mangësive -të metave-; madje ajo duhet të jetë një bukuri e tillë. Ashtu siç bën të domosdoshme dielli dritën e gjithanshme e gjithëpërfshirëse, po kështu Ekzistuesi i Vetëm i domosdoshëm bën të domosdoshme një bukuri të përjetshme; Ai jep dritë nëpërmjet saj.

Të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut për Dritën e Imanit.

"*Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime...*"[30]

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".

. . .

Shënim

Nëntë shkallët e vërsetit të ndritshëm "*Allahu vetëm na mjafton neve"* do të shkruheshin, por për shkak të disa rrethanave, tri shkallë janë shtyrë për më vonë.

Kujtesë: Meqenëse Risale-i Nuri i përket Kur'anit dhe është një komentim i mbështetur me prova nga Kur'ani, ai përmban përsëritje të domosdoshme, me urtësi, madje të dobishme të cilat nuk i shkaktojnë lexuesit mërzi. Gjithashtu, meqenëse Risale-i Nuri përbëhet nga provat

[30] Kur'an, 2:286

e vërtetimit të Unitetit Hyjnor, e cila nuk shkaton mërzi, por përsëritet me kënaqësi e zell, përsëritjet e saj të domosdoshme nuk konsiderohen një mangësi në të dhe nuk duhet të shkaktojnë mërzi.

. . .

Kapitulli i Pestë

Mbi shkallët e *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"*.[31]

Kjo përbëhet nga Pesë "Pika".

Pika e Parë

Kjo frazë është një ilaç i provuar mirë për sëmundjen e pafuqisë njerëzore dhe për atë të varfërisë njerëzore: *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve"* sepse Ai është Dhënësi i ekzistencës, është i Qëndrueshmi përjetësisht. Prandaj nuk ka dëm apo të keqe nga kalimi e zhdukja e qënieve; sepse gjërat që janë të dashura vazhdojnë të ekzistojnë nëpërmjet vazhdimësisë së Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm i Cili u dha atyre ekzistencë.

Ai është Autori, Krijuesi, i Qëndrueshmi përjetësisht; atëherë kalueshmëria, zhdukja e krijesave nuk shkakton dëshpërim, sepse boshti i dashurisë për to, Krijuesi i tyre, është i Qëndrueshëm përjetësisht.

Ai është Mbreti i Përjetshëm dhe Pronari, prandaj nuk ka pikëllim për kalimin, zhdukjen e pronave të Tij të ripërtërira për largëmin dhe për ripërtëritjen e tyre;

Ai është Dëshmitari i Gjithëditur i Qëndrueshëm përjetësisht, prandaj asnjë brengë nuk duhet të ndjehet për zhdukjen nga kjo botë e

[31] Ky është Kapitulli i Pestë i Shkreptimës së Njëzet e Nëntë në arabisht të cilën Ustadhi e përfshiu këtu pa shënime. Kush dëshiron, le t'i referohet asaj shkreptime në formën e saj të plotë. Përkthyesi

gjërave që janë të dashura, sepse ato kanë ekzistencë të përjetshme në sferën e njohjes së Dëshmitarit të Amshuar dhe në shikimin e Tij.

Ai është Pronari dhe Krijuesi i Qëndrueshëm përjetësisht; prandaj nuk ka dhimbje për kalimin, zhdukjen e gjërave të bukura, sepse burimi i bukurisë së tyre, Emrat e Krijuesit të tyre janë të përjetshëm.

Ai është Trashëgimtari -Ai që jep trashëgimi- Dhënësi i Jetës dhe Qëndrueshmi përjetësisht; prandaj nuk duhet të ketë vajtim e pikëllim për ndarjen nga të dashurit, sepse Ai që do t'i ringjallë dhe do t'i rikthejë përsëri, është i përhershëm.

Ai është Hirploti i Gjithëlavdishëm, i Qëndrueshmi përjetësisht; prandaj nuk duhet të ketë dëshpërim për zhdukjen e gjërave të bukura, sepse ato gjëra të bukura janë pasqyrat e Emrave të bukur, të cilët vazhdojnë bashkë me bukuritë e tyre pas zhdukjes së pasqyrave.

Ai është i Adhuruari, i Dashuri i Qëndrueshëm përjetësisht, atëherë nuk duhet të ndjehet pikëllim për kalimin, zhdukjen e të dashurave 'metaforike', sepse i Dashuri i vërtetë është i përhershëm.

Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, i Dashuri, i Dhembshuri, i Qëndrueshmi i Përjetshëm; kështu kalimi, zhdukja e dhuruesve të jashtëm të mirësive dhe të mëshirës nuk ka rëndësi; kjo nuk duhet të shkaktojë dëshpërim e brengë, sepse Ai që Mëshira dhe Dhembshuria e të Cilit i rrethojnë dhe i përfshijnë të gjitha gjërat është i Qëndrueshëm përjetësisht.

Ai është Hirploti, i Miri, dhe Mirëbërësi i Qëndrueshëm; Prandaj, zhdukja e qënieve të mira, të këndshme e të dhembshura nuk duhet as të shkaktojë dhimbje, dhe as nuk duhet t'i jepet rëndësi, sepse Ai që merr vendin e të gjitha atyre dhe një manifestim të vetëm të të Cilit ato të gjitha nuk mund ta zëvendësojnë, është i Qëndrueshëm Përjetësisht.

Meqenëse Ai është i Qëndrueshëm Përjetësisht dhe i Zotëron të gjitha këto atribute, Ai e merr vendin e çdo lloji prej të dashurave të përkohshme e kalimtare në këtë dynja.

"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".

Po, e mjaftueshme për pavdekshmërinë e kësaj dynjaje dhe për gjithçka që ajo përmban, është ekzistenca e përjetshme e Pronarit, Autorit dhe Krijuesit të saj.

Pika e Dytë

I mjaftueshëm për pavdekshërinë është Allahu, sepse Ai është Zoti im i Përjetshëm, Krijuesi im i Përhershëm, Dhënësi i Përjetshëm i ekzistencës sime, Autori im i Përjetshëm, Pronari im i Përjetshëm, Dëshmitari im i Përjetshëm, i Adhuruari im i Përjetshëm dhe Ringjallësi im i Përjetshëm. Prandaj nuk ka dëm në zhdukjen e qënies sime; nuk duhet të ketë as dëshpërim, as pikëllim dhe as lëndim; sepse Dhënësi i ekzistencës time është i Përjetshëm, dhe krijueshmëria e Tij nëpërmjet Emrave të Tij është e përjetshme. Cilësitë në personin tim nuk janë gjë tjetër veçse një rreze prej njërit nga Emrat e Tij të Përjetshëm. Kështu zhdukja e atyre cilësive të mia dhe kalimi i tyre nuk konsoderohen asgjësim për to, sepse ato janë të pranishme në sferën e njohjes së Krijuesit të tyre, janë të përjetshme dhe brenda shikimit të Tij.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua lidhur me pavdekshmërinë dhe me kënaqësinë e saj, janë njohja ime, të kuptuarit, vetëdija dhe besimi se rrezet në qënien time të Një Emri të përjetshëm të Zotit tim të Përjetshëm janë të përhershme; dhe se realiteti i qënies sime nuk është gjë tjetër veçse një hije e Atij Emri Hyjnor; dhe se nëpërmjet misterit të reflektimit të tij ose të imazhit në pasqyrën e qënies sime, natyra ime nuk është në vetvete e dashur, por e dashur për llogari të pavdekshmërisë së gjërave të ndryshme të përjetshme të reflektuara në të.

Pika e Tretë

"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve" sepse Ai është Ekzistuesi i vetëm i domosdoshëm, dhe këto qënie të përkohshme kalimtare nuk janë gjë tjetër veçse vende reflektimi dhe ripërtëritje e manifestimeve të ekzistencës së Tij dhe të Dhënies së ekzistencës. Nëpërmjet Tij dhe nëpërmjet të qenurit i lidhur me Të dhe nëpërmjet njohjes së Tij, janë dritat e pafundme të ekzistencës; ndërsa pa Të ndodhen errësirat e pafundme të mosekzistencës dhe dhimbjet e pakufishme të ndarjeve.

Këto qënie të përkohshme kalimtare janë thjesht pasqyra, dhe me ndryshimin e përcaktimeve të tyre relative, ato ripërtërihen në gjashtë aspekte në përkohshmërinë e tyre, në zhdukjen dhe në përhershmërinë e Tij;

I Pari: Ekzistenca e përhershme e kuptimeve të tyre të bukura dhe e identiteteve në Botën e Shëmbëllesës.

I Dyti: Ekzistenca e përhershme e formave të tyre në pllakat e Botës së Shëmbëllesës.

I Treti: Ekzistenca e përhershme e rezultateve dhe e frutave të tyre që shikojnë botën tjetër, që janë orientuar drejt Ahiretit.

I Katërti: Ekzistenca e përhershme e tesbihateve të tyre Hyjnore, të përfaqësuara -në Pllakën e Ruajtur-, të cilat janë një lloj ekzistence për to.

I Pesti: Ekzistenca e Përhershme në ekspozitat e njohjes dhe me panoramat e përjetshme.

I Gjashti: Ekzistenca e Përhershme e shpirtërave të tyre, në qoftë se janë prej qënieve me shpirtëra, sepse funksionet dhe gjendjet e tyre të ndryshme në vdekjen e tyre, në përkohshmërinë, në zhdukjen, në asgjësimin, në shfaqjen dhe në shuarjen e tyre, nuk është gjë tjetër veçse ajo çfarë kërkohet nga Emrat e Bukur Hyjnorë. Për shkak të këtij misteri, qëniet u bënë si një lumë i rrëmbyer me një shpejtësi të skajshme në valët e jetës e të vdekjes, ekzistencës dhe të mosekzistencës. Dhe nga ky funksion buron aktiviteti i përhershëm dhe Krijueshmëria e vazhdueshme. Atëherë unë dhe gjithkush tjetër detyrohet të thotë: *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve".* Domethënë, për sa ka të bëjë me ekzistencën, është e mjaftueshme për mua që jam vepra e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm; të marrësh këtë ekzistencë të ndritshme për një çast të vetëm kalimtar është e preferueshme mbi miliona vite të ekzistencës së dukshme të pafrutshme.

Po, nëpërmjet misterit të të qenurit i lidhur me Zotin nëpërmjet besimit, një minut i kësaj ekzistence është e barasvlershme me mijëra vite pa lidhjen e besimit; madje shkallët e ekzistencës së atij minuti janë më të plota e më të shtrira se sa ato mijëra vite.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për ekzistencën dhe për vlerën e ekzistencës është qënia ime arti i Atij të Vetmi madhështia e të Cilit është në qiell dhe shenjat e Tij janë në tokë, dhe i Cili i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë Ditë.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për krenarinë dhe për nderin është qënia ime krijesa, robi krejtësisht në pronësi dhe shërbëtori i Një të Vetmi, në lidhje me plotësinë dhe bukurinë e të Cilit të gjitha bukuritë dhe plotësitë e universit janë thjesht hije të dobëta e të zbehta, janë shenjat e plotësisë së Tij dhe treguesit e bukurisë së Tij.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për gjithçka është Ai i Cili ruan numra të pallogaritshëm mirësish në kontenierë të vegjël, në arka shumë të holla, midis ***Kefit*** dhe ***Nunit*** *-Bëhu! Dhe ajo eshtë bërë (në*

çast)”- dhe nëpërmjet fuqisë së Tij ruan me miliona ton në një grusht të Vetëm prej sunduqeve, arkave të holla të quajtura farërat dhe bërthamat”.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua në vend të të gjithë atyre që kanë bukuri e mirëbërësi është Hirploti Mëshirëplotë; sepse të gjitha këto krijesa të bukura janë thjesht pasqyra të përkohshme për ripërtëritjen e dritave të bukurisë së Tij me kalimin e stinëve, shekujve dhe epokave.

Dhe të gjitha këto mirësi të përsëritura, të herëpas-hershme dhe këto fruta të njëpasnjëshme të pranverës e të verës janë vende manifestimi për ripërtëritjen e shkallëve të mirëbërësisë së tij të vazhdueshme me kalimin e krijesave, të ditëve dhe të viteve.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua për jetën dhe për natyrën e saj të vërtetë, është qënia ime një hartë, një indeks, një përmbledhje, balancë dhe masë për manifestimet e Emrave të Krijuesit të vdekjes dhe të jetës.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për jetën dhe për detyrën e saj, është qënia ime një fjalë e shkruar me penën e fuqisë, duke treguar e duke bërë të kuptueshëm Emrat e të Gjithëfuqishmit Absolut, të Gjallit të përjetshëm dhe të Vetekzistuesit të përhershëm, nëpërmjet jetës sime duke marrë manifestimet e cilësive esenciale të Krijuesit tim; dhe Ai ka Emrat më të bukur.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për jetën dhe për të drejtat e saj është shfaqja ime midis vëllezërve të mi krijesa dhe duke e shpallur e duke e ekspozuar në shikimin e dëshmuesve të Krijuesit të universit qënien time të stolisur me manifestimet e Emrave të Krijuesit tim, i Cili më ka stolisur me mantelin e zbukuruar me xhevahire të qënies sime, veshjen e natyrës sime të bashkëlindur dhe gjerdanin e jetës sime të mirësistemuar, që është zbukuruar me dhuratat e mëshirës së Tij.

Gjithashtu, të mjaftueshme për mua për të drejtat e jetës sime janë kuptimi im ndaj përshëndetjeve të krijesave të gjalla të Dhënësit të jetës dhe vëzhgimi im ndaj tyre, dhe dëshmia ime për to.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për të drejtat e jetës sime është qënia ime e stolisur dhe e zbukuruar me xhevahiret e mirëbërësisë së Tij, për t’i paraqitur ato me vetëdije, për shkak të besimit tim, ndaj shikimit të Sulltanit të Parapërjetshëm.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për jetën dhe kënaqësitë e saja është njohja ime, kuptimi, vetëdija dhe besimi që unë jam robi i Tij,

artifakti, krijesa, i varfëri dhe nevojtari për Të; dhe Ai është Krijuesi Mëshirëplotë për mua, Gjithëbujar i Dhembshur e Mirëbërës ndaj meje, i Cili më ushqen ashtu siç i përshtatet urtësisë dhe mëshirës së Tij.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për jetën time dhe për vlerën e saj është qënia ime një masë, nëpërmjet pafuqisë sime absolute, varfërisë sime absolute dhe dobësisë sime absolute, për shkallët e fuqisë së të Gjithëfuqishmit absolut dhe për shkallët e mëshirës së Mëshirëplotit absolut dhe për nivelet e fuqisë së të Plotfuqishmit Absolut.

Gjithashtu, është e mjaftueshme për mua qënia ime si masë nëpërmjet të pjesshmeve të cilësive të mia të tilla, si: njohja, dëshira dhe fuqia e pjesshme për të kuptuar atributet dhe cilësitë gjithëpërfshirëse të Krijuesit tim. Unë kuptoj njohjen e Tij gjithëpërfshirëse nëpërmjet njohjes sime të pjesshme.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për plotësi është njohja ime se Zoti im është i Ploti absolut, dhe çfarëdo gjërash që ndodhen në univers të cilat janë të plota, ato janë shenjat e Plotësisë së Tij dhe tregues të Plotësisë së Tij.

Gjithashtu, e mjaftueshme për mua për plotësi në veten time është besimi në Zotin, sepse për njeriun, besimi është burimi i të gjitha plotësimeve.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua për të gjitha nevojat e mia të kërkuara nëpërmjet gjuhëve të aftësive të mia të ndryshme, është Zoti im, Ushqyesi, Edukuesi, Krijuesi dhe Dhënësi i formës sime; Atij i takojnë Emrat më të bukur; Ai më jep me ngrënë e me pirë; më zhvillon, më administron dhe më plotëson mua; Ai është i pakufishëm në lavdi, dhe favoret e Tij janë gjithëpërfshirëse.

Pika e Katërt

I mjaftueshëm për mua për të gjitha dëshirat e mia është Ai i Cili hapi formën time dhe formën e krijesave të gjalla si shembulli im nga një lëng nëpërmjet artit të Tij të hollë, fuqisë së Tij të hollë, urtësisë së Tij të hollë dhe Hyjnisë së Tij të hollë.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua për të gjitha qëllimet e mia është Ai i Cili më bëri, më krijoi, hapi veshët dhe sytë e mi, përfshiu në trupin tim gjuhën dhe zemrën time, dhe vendosi në to dhe në aftësitë e tjera të mia peshore të panumërta të sakta për të peshuar përmbajtjet e thesareve të mëshirës së Tij. Gjithashtu, Ai vendosi në

gjuhën time, në zemrën time dhe në natyrën time, instrumente të ndjeshme të pallogaritshme për të matur e vlerësuar varietetet e thesareve të Emrave të Tij.

Gjithashu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili, nëpërmjet Hyjnisë së Tij të gjithëlavdishme, mëshirës së Tij të bukur, Hyjnisë së Tij madhështore, dhembshurisë së Tij bujare, fuqisë së Tij madhështore dhe urtësisë së Tij të hollë, përfshiu në personin tim të vogël e të ulët dhe vendosi në qënien time të dobët e të varfër këto gjymtyrë e aftësi, këto organe e sisteme, këto shqisa e ndjenja, këto aftësi të brendshme dhe fuqi shpirtërore, që të më lejojë t'i njoh të gjitha shumëllojshmëritë e mirësitë e mirësive të Tij dhe për të kuptuar e përjetuar shumicën e manifestimeve të Emrave të Tij.

Pika e Pestë

Unë dhe të gjithë njerëzit duhet të deklarojmë me mirënjohje e me krenari:

I mjafueshëm për mua është Ai që më krijoi dhe më nxori nga errësira e mosekzistencës, duke më dhuruar mua dritën e ekzistencës.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili më bëri të gjallë dhe më dhuroi mirësinë e jetës e cila u jep gjithçka atyre që e posedojnë atë dhe i shtrin duart e saja tek të gjitha gjërat.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili më bëri një qënie njerëzore dhe më dhuroi mua mirësinë e humanizmit që e bën njeriun si një botë.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai që më bëri mua besimtar dhe më dhuroi mirësinë e besimit i cili i bën dynjanë dhe Ahiretin si dy tryeza të mbushura me mirësi dhe ia paraqet ato besimtarit nëpërmjet dorës së besimit.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili më bëri një anëtar të ummetit -komunitetit- të të Dashurit të Tij, Muhammed a.s.m. dhe që më dhuroi mua dashurinë për Zotin dhe të jem i dashur prej Tij, të cilat gjenden në besim dhe janë shkallët më të larta të plotësimit njerëzor; dhe nëpërmjet kësaj dashurie që buron nga besimi shtrihen duart e përfitimit të besimtarit tek përmbajtjet e pafundme të sferave të mundësisë dhe të domosdoshmërisë.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili më dha preferencë lidhur me natyrën, specien, fenë dhe besimin mbi shumicën e krijesave të Tij, që nuk më bëri mua të pagjallë, as kafshë dhe as nuk

më la në çudhëzim. Prandaj lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Vetëm Atij.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili më bëri mua një vend gjithëpërfshirës për manifestimet e Emrave të Tij, dhe në përputhje me kuptimin e hadithit: *"Qiejt dhe toka nuk më nxënë, unë përfshihem në zemrën e shërbëtorit tim besimtar".*[32]

Ai më dhuroi një mirësi të cilën nuk e nxë universi; domethënë, natyra esenciale e njeriut është një vend gjithëpërfshirës i manifestimit të të gjithë Emrave të Bukur Hyjnorë të manifestuar në univers.

Gjithashtu, i mjaftueshëm për mua është Ai i Cili e bleu prej meje pronën e Tij që është tek unë, me qëllim që ta ruajë atë dhe më vonë të ma kthejë përsëri dhe na dha parajsën si çmim të saj. Atij i takojnë falënderime e lavdërime sa numri i grimcave të qënies sime të shumëzuar me numrin e atomeve në ekzistencë, në univers.

I mjaftueshëm për mua është Krijuesi im; Zoti qoftë i lartësuar!
Dhe Drita e Muhammedit: bekimet e Allahut qofshin mbi të!
Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut!
I mjafuteshëm për mua është Krijuesi im; Zoti qoftë i Lartësuar!
Jeta e brendshme e zemrës sime është përmendja e Allahut;
përmendja e Ahmedit; bekimet e Zotit qofshin mbi të!
Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut!

. . .

RREZJA E PESTË

Shenjat e Kijametit, e orës së Fundit.

[Para trembëdhjetë vitesh, si një shtojcë për diskutimin në librin tonë ***"Muhakemat"*** i cili u botua para tridhjetë viteve -synon vitin 1911-, drafti i njëzet çështjeve qe shkruar rreth *Barrierës* së *Dhul Karnejnit*, rreth *Gog Magogëve -xhuxh Maxhuxhët-* dhe rreth shenjave të fundit të kohës. Kjo tani është korrigjuar për hir të një miku të dashur, dhe u bë Rrezja e Pestë.]

[32] Transmeton Ahmedi

Rrezja e Pestë së Shkreptimës së Tridhjetë e Njëtë e Letrës së Tridhjetë e Njëtë.

Shënim: Me qëllim që të mund të kuptohet qëllimi i Parathënies, *çështjet* që ndjekin parathënien duhet të lexohen përpara.

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Një pikë e hollë rreth vërsetit,

"E pra disa nga shenjat paralajmëruese tashmë kanë ardhur"[33] u shkrua me qëllim që të mbrojë besimin e besimtarëve të zakonshëm dhe për ta ruajtur atë prej dyshimeve. Ashtu si vërsetet alegorike të Kur'anit, disa hadithe rreth ngjarjeve të fundit të kohës kanë kuptime të thella. Ato nuk mund të shpjegohen në të njëjtën mënyrë si vërsetet e pakundërshtueshme, dhe jo gjithkush mund t'i kuptojë ato; Por, ndoshta dijetarët i interpretojnë në vend të shpjegimit të tyre. Në përputhje me vërsetin,

*"Por askush nuk i di kuptimet e fshehta, kuptimet përfundimtare (**ta'wil**) përveç Allahut. Dhe ata që janë plotësisht të vendosur në dije, të rrënjosur thellë në dije..."*[34]

Kuptimi i tyre, interpretimi dhe ajo çfarë synohet prej tyre kuptohen vetëm pas ndodhjes së ngjarjeve, dhe vetëm atëherë njihet qëllimi i tyre; kështu ata që janë plotësisht të vendosur në dije, thonë:

"Ne besojmë në të; i tëri (ajete të qarta e të paqarta) është nga Zoti ynë."
Dhe ata -dijetarë- i sqarojnë ato të vërteta të fshehura. Kjo Rrezja e Pestë përmban një parathënie dhe Njëzet e Tre "Çështje".

Parathënia përbëhet nga Pesë "Pika".

Pika e Parë

Meqenëse besimi dhe përgjegjshmëria janë një provim, një sprovë dhe garë brenda sferës së zgjedhjes së njeriut, çështjet që janë të errëta, të paqarta, të thella dhe në nevojë për një studim të kujdesshëm dhe eksperimental -provë-, nuk janë të qarta në mënyrë të vetëkuptueshme,

---

[33] Kur'an, 47:18
[34] Kur'an, 3: 7

sa t'i besonte ato gjithkush me hir e me pahir -dashur e pa dashur-; dhe kjo me qëllim që të dallohet besimi i Ebu Bekrit nga mohimi i Ebu Xhehlit, dhe që të mund të ngriheshin besimtarët në lartësinë më të lartë dhe të zbrisnin mohuesit në ultësirën më të madhe; sepse në qoftë se nuk ka zgjedhje - vullnet të lirë- nuk do të kishte përgjegjshmëri. Për shkak të këtij misteri dhe urtësie, mrekullitë shfaqeshin vetëm rrallë.

Pastaj, në këtë botë përgjegjshmërie e provimi, ashtu si disa vërsete alegorike të Kur'anit, edhe shenjat e kijametit dhe shenjat e fundit të kohës, të cilat mund të shihen me sy, janë të errëta, të paqarta dhe të hapura për interpretim.

Meqenëse kur dielli do të lindë në perëndim, kjo shenjë do të jetë aq e qartë saqë gjithkush do të detyrohej ta besonte e vërtetonte atë pa zgjedhje, dera e pendesës do të jetë mbyllur në atë kohë dhe pendimi e besimi nuk do të pranohen më; sepse në vërtetimin e asaj shenje do të ishin të barabartë si ai që ka besim si Ebu Bekri, po ashtu edhe ai që është me kryeneçësi në mohim si Ebu Xhehli. Madje edhe kur Isai a.s. -Jezusi- të zbresë, të vijë, dhe kur vetë do ta njohë se ai është pikërisht Jezusi dhe jo dikush tjetër përveç tij, jo gjithësecili do të mund ta njohë atë; ai do të njihet veçse nëpërmjet dritës së besimit.

Gjithashtu edhe *Dexhali* dhe *Sufjani* midis figurave të frikshme të cilët do të shfaqen me shenjat e kijametit, as vetë ata, në fillim, nuk do t'i njohin vetvetet se janë *Dexhali* dhe *Sufjani*.

Pika e Dytë: Çështjet e së Padukshmes të cilat iu bënë të njohura profetit të nderuar a.s.m. nuk janë të njëllojta; disa prej atyre çështjeve iu bënë të njohura atij në mënyrë të detajuar, kështu ai, në asnjë mënyrë, as nuk mund t'i ndryshonte këto dhe as nuk mund të ndërhynte në to, ashtu si vërsetet e pakundërshtueshme të Kur'anit dhe "hadithet e shenjta".[35]

Disa çështje të tjera të së padukshmes iu bënë të njohura atij në mënyrë të përgjithshme, dhe çështja e ilustrimit dhe e shpjegimit të tyre në mënyrë të detajuar, ose një formë alegorike iu la *ixhtihadit* - interpretimit- të tij a.s.m. ashtu si hadithet që vërtiten rreth ngjarjeve kozmike dhe ndodhive të së ardhmes, të cilat nuk janë prej themeleve të besimit.

Vetë profeti a.s.m. është ai që i ilustron ato çështje, i shpjegon në detaje ose në formë alegorike në mënyrë të përshtatshme me urtësinë e

[35] Hadith Kudsi:

përgjegjshmërisë së njeriut. Për shembull, u dëgjua një shungullimë -zhurmë e madhe- në vendin ku po bisedonte profeti a.s.m. me disa njerëz. Ai tha: "*Ky është zëri i një guri i cili ka qenë duke u rrokullisur poshtë për xhehennem qysh prej shtatëdhjetë viteve dhe tani ka arritur në fund të xhehennemit."*[36]

Dhe pas pesë minutash pasi Ai bëri këtë njoftim të çuditshëm, erdhi një person dhe tha: "Filan hipokrit i cili ishte shtatëdhjetë vjeç kishte vdekur dhe kishte shkuar në xhehennem", duke shfaqur kështu kuptimin e fjalëve elokuente të profetit a.s.m..

Shënim: ngjarjet e pjesshme të së ardhmes të cilat nuk përfshihen midis të vërtetave të besimit konsideroheshin të parëndësishme nga profeti a.s.m..

Pika e Tretë përbëhet nga dy "Pika".

E Para: Për shkak se me kalimin e kohës njerëzit e zakonshëm u dhanë kuptime të mirëfillta -të fjalëpërfjalshme- dhe realitete fizike disa hadithe që janë rrëfyer në formën e krahasimeve dhe të alegorive; hadithe të tilla në pamje të jashtme nuk përputhen me realitetin.

Megjithëse janë e vërtetë e pastër dhe e qëndrueshme, ato nuk shfaqen për shikimin e tyre të jenë në përputhje me realitetin e gjendjes. Për shembull, dy melekët e quajtur *Demi* dhe *Peshku* të cilët janë prej mbajtësve të tokës -ashtu siç ka Arshi mbajtësit e tij-, u përfytyruan nga njerëzit e zakonshëm si një 'Dem' i vërtetë gjigant dhe si një 'Peshk' i madh i vërtetë.

E Dyta: Disa hadithe erdhën lidhur me shumicën e myslimaneve në një trevë, ose lidheshin me ekzistencën e shtetit islamik atje, ose që kishin të bënin me qendrën e kalifatit islam, por ato u kuptuan se ishin gjithëpërfshirëse për të gjithë myslimanët dhe për të gjitha anët e botës. Pavarësisht se ishin të veçanta, të pjesshme për ndonjë aspekt, ato u supozuan se ishin universalë dhe të përgjithshëm.

Për shembull, në një hadith sherif, thuhet:

"*Nuk bëhet kijameti për sa kohë që thuhet në tokë: "Allah, Allah".*[37] Domethënë, vendet ku përmendet emri i Zotit do të mbyllen, dhe thirrja e Ezanit dhe Ikametit do të recitohen në Turqisht.

---

[36] Transmetoi Muslimi
[37] Transmetoi Muslimi

Pika e Katërt: Ashtu siç janë fshehur çështjet e së padukshmes, si exheli dhe vdekja, për shumë arsye e shembuj urtësie, po ashtu kijameti, fundi i botës, që është vdekja e dynjasë, exheli i njerëzimit dhe vdekja e kafshëve, ka mbetur sekret, i fshehur për shumë arsye të dobishme.

Po, në qoftë se koha e Exhelit do të kishte qenë përcaktuar, atëherë gjysma e parë e jetës do të kalonte në shkujdesje absolute, dhe gjysma e dytë në frikë absolute pasi në çdo ditë bëhet një hap përpara drejt litarëve të vdekjes. Kjo do të shkatërronte balancën e urtë e të dobishme të shpresës dhe të frikës.

Gjithashtu, krejtësisht e ngjashme me këtë, në qoftë se kijameti, fundi i botës, vdekja dhe exheli i saj, do të kishin qenë përcaktuar, shekujt e hershëm dhe të mesëm do të mbeteshin pothuajse të pandikuar, ose pak, nga ideja e Ahiretit, dhe shekujt e mëvonshëm do të kishin kaluar e jetuar në frikë e në panik të vazhdueshëm. Asnjë kënaqësi e vlerë nuk do të kishte mbetur për jetën e kësaj bote, dhe as ibadeti - i cili është bindja e individit me zgjedhjen, dhe me vullnetin e tij të lirë brenda frikës dhe shpresës - nuk do të kishte pasë rëndësi dhe as urtësi.

Gjithashtu, në qoftë se koha e kijametit do të kishte qenë e përcaktuar, disa nga të vërtetat e besimit do të kishin qenë të qarta e të vetëkuptueshme dhe gjithësecili do t'i besonte ato me hir e me pahir. Misteri i përgjegjshmërisë së njeriut, urtësia dhe qëllimi i besimit, të cilat janë të lidhura me zgjedhjen dhe me vullnetin e njeriut, do të mohoheshin e shfuqizoheshin.

Për dobi të shumta të tilla si këto, çështjet që lidhen me të padukshmen mbeten sekret, të fshehura. Prandaj çdo njeri në mënyrë të vazhdueshme parashikon në çdo minut ardhjen e exhelit të tij ashtu siç mendon qëndrueshmërinë e tij në të, dhe mendon për ato të dyja bashkarisht dhe përpiqet me seriozitet për dynjanë ashtu siç përpiqet për Ahiret. Dhe ashtu siç e parashikon ai kijametin në çdo shekull, po ashtu parashikon vazhdimësinë e dynjasë në të. Dhe kështu ai punon për jetën e përhershme brenda përkohshmërisë së kësaj dynjaje, dhe orvatet të ndërtojë dynjanë sikur ai nuk do të vdiste kurrë.

Pastaj në qoftë se koha e fatkeqësive dhe e katastrofave do të kishte qenë e përcaktuar, njeriu do të vuante dhimbje e lëndime shpirtërore si rezultat i parashikimit të ardhjes së fatkeqësisë dhe katastrofës dhjetë herë më të mëdha se sa vetë fatkeqësia.

Prandaj urtësia Hyjnore dhe mëshira e saj e gjërë e kanë fshehur kohën e ndodhjes së tyre dhe e kanë lënë atë sekret, me qëllim që njeriu të mos e vuajë atë fatkeqësi të tillë shpirtërore. Për shkak se shumica e ngjarjeve të fshehura kozmike janë të lidhura me shembuj të tillë urtësie, është ndaluar dhënia e njoftimeve për të padukshmen. Madje edhe ata që bëjnë parashikime për të padukshmen me një leje Hyjnore, e njoftojnë atë parashikim vetëm me aluzione dhe në mënyrë të tërthortë e të paqartë, me përjashtim të të vërtetave të besimit dhe të atyre që janë boshti i përgjegjshmërisë së njeriut, dhe kjo me qëllim që të mos ketë mungesë respekti dhe mosbindje ndaj parimit Hyjnor,

"Thuaj: Askush në qiej e në tokë nuk e di Gajbin (të fshehtën, të panjohurën) veç Allahut..."[38]

Madje edhe sihariqet që erdhën në Teurat, në Inxhil dhe në Zebur rreth profetit Muhammed a.s.m. erdhën disi të mbuluara e të paqarta. Si rrjedhojë e kësaj, pasuesit e atyre shkrimeve të shenjta vendosen kuptime të ndryshme mbi ato sihariqe dhe nuk e besuan profetin më të nderuar a.s.m...

Por, meqenëse urtësia në përgjegjshmërinë e njeriut bën të domosdoshme që çështjet e përfshira midis bazave të besimit të komunikohen në mënyrë të qartë dhe të përsëritur, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm dhe interpretuesi i tij i lavdishëm dhe i besueshëm i tregojnë çështjet e Ahiretit në mënyrë të detajuar, dhe i përmendin ngjarjet e ardhshme të dynjasë vetëm në mënyrë të përmbledhur.

Pika e Pestë: Gjithashtu, meqenëse çudirat, çështjet e jashtëzakonshme të cilat lidhen me epokën e dy Dexhalëve, -domethënë me Dexhalin e muslimanëve dhe me Dexhalin më të madh- janë transmetuar të shoqëruara me përmendjen e atyre të dyve, u imagjinuan se ato çudira të jashtëzakonshme do të buronin prej pikërisht personave të tyre dhe u kuptuan kështu; kjo ka çuar që rrëfenjat të bëhen alegorike dhe kuptimet e tyre të vërteta të bëhen të fshehura -të mbuluara.

Dhe për shembull, është e mirënjohur se kur të vdesë Dexhali i muslimanëve, shejtani i cili i shërben atij do të lëshojë klithma duke lexuar me zë të lartë lajmet për të gjithë botën nga Dikili Tash, Obelisku në Stamboll, dhe gjithkush do ta dëgjojë zërin e tij duke thënë se "ai vdiq". Domethënë, lajmi do të transmetohet nga radioja, e cila është e çuditshme prej të cilës çuditën edhe vetë shejtanët.

---

[38] Kur'an, 27:65

Gjithashtu, meqenëse rrethanat e çuditshme dhe aktivitetet e frikshme të regjimit të Dexhalit, organizata e fshehur dhe qeveria që ai themelon janë transmetuar të shoqëruara me personin e tij, sikur ato të kishin lidhje pikërisht me të, kuptimi i tyre i vërtetë ka mbetur i fshehur dhe i mbuluar.

Për shembull, ndodhet një rrëfenjë me këtë kuptim: "Ai do të jetë aq i fuqishëm dhe jetëgjatë saqë vetëm Isai, Jezusi a.s.m. do të jetë në gjendje që ta vrasë; ose ndryshe nuk ka asnjë mënyrë tjetër për ta vrarë atë".[39] Kjo do të thotë se: Ai që do ta përmbysë rrugën e tij dhe sistemin e tij grabitqar e makut, dhe që do t'i eliminojë ato përfundimisht do të jetë veçse një fe e lartësuar qiellore e cila do të shfaqet midis ndjekësve të vërtetë të Isait, Jezusit a.s. dhe që do të ndjekë të vërtetat e Kur'anit dhe do të bashkohet me të. Me ardhjen e Isait a.s. dhe me shfaqjen e fesë së vërtetë krishtere, metoda ateiste e Dexhalit do të shfaroset e do të zhduket përfundimisht. Përndryshe, personi i atij Dexhali do të mund të vritet nga një mikrob i vetëm ose nga një sëmundje e thjeshtë si gripi.

Gjithashtu, shpjegimet dhe pohimet e disa transmetuesve që burojnë nga ixhtihadet dhe nga interpretimet e tyre personale, të cilat janë të zbuluara para gabimeve, janë përzier me fjalët e hadithit profetik. Fjalët e tyre janë supozuar të jenë pjesë e hadithit, dhe kështu është fshehur e mbuluar kuptimi, sepse ai hadith nuk shfaqet të jetë në përputhje me realitetin, dhe rrëfenja bëhet alegorike.

Gjithashtu, në kohët e hershme personaliteti kolektiv i shoqërisë dhe i bashkësisë nuk qenë zhvilluar dhe nuk qenë të qarta ashtu siç janë në kohën e tanishme, dhe ideja individuale dhe interesimi për individin ishte mbisundues; prandaj cilësitë e mëdhaja dhe aktet e shtrira gjërësisht të komunitetit u atribuoheshin personave të cilët i udhëhoqën ato bashkësi kolektive. Me qëllim që të jenë të denjë e të përshtatshëm për cilësi universale të jashtëzakonshme, mbinjerëzore, ata persona duhet të kishin trupa gjigantë dhe të kishin një shtat të gjërë, një forcë të jashtëzakonshme dhe një fuqi kolosale që ta kalonte njëqind herë fuqinë e tyre personale, dhe kështu ata udhëheqës u përfytyruan në mënyrë të çuditshme. Gjendja është se ky përfytyrim nuk përputhej me realitetin, dhe ajo rrëfenjë u bë alegorike.

Gjithashtu, pavarësisht se rrethanat dhe cilësitë e dy Dexhalëve janë të ndryshme nga njëri-tjetri, ato janë ngatërruar në rrëfenjat që na kanë ardhur neve në formë absolute; njëri është supozuar të jetë tjetri.

---

[39] transmeton Tirmidhiu

Gjithashtu, rrethanat e *Mehdiut të Madh* nuk u përshtaten rrëfenjave që aludojnë për gjendjet e *Mehdive* që erdhën para tij; dhe këto janë bërë hadithe alegorike.

Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, përmend vetëm Dexhalët myslimanë.

Kjo shënon fundin e parathënies. Tani ne fillojmë me "Çështjet".

• • •

[Tani, me përkujdesjen e Allahut, prej qindra shembujsh që tregojnë për ato ngjarje të fshehta të së Padukshmes, do të shpjegohen Njëzet e Tre Çështje në mënyrë shumë të përmbledhur, meqenëse ato çështje qenë përhapur nga ateistët me idenë për të prishur besimet e myslimanëve të zakonshëm. Unë i kërkoj mëshirës Hyjnore që këto "Çështje" nuk do të shkaktojnë dëm, ashtu siç pandehin ateistët, por se kur të shihet se secila çështje është një shkreptimë e një mrekullie profetike dhe interpretimet e tyre të vërteta të provohen e të qartësohen, ato do të jenë, me leje të Zotit, një mjet i rëndësishëm. Dhe i përgjërohem e i lutem Krijuesit tim të Gjithëmëshirshëm që të m'i mbulojë gjynahet dhe gabimet e mia me faljen e Tij të gjërë. Sigurisht, Ai është Gjithëdëgjues dhe Ai që u përgjigjet lutjeve.]

Stacioni i Dytë i Rrezes së Pestë

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Çështja e Parë

Ndodhet një hadith që thotë:

"Dora e Sufjanit, i cili është njëri prej individëve të fundit të kohës, do të jetë e shpuar tejpërtej, e çarë".

Allahu e di më së miri; një interpretim i kësaj është sa vijon: Pasuria nuk mund qëndrojë në dorën e tij, për shkak se ai është prishanik i madh dhe i zhytur në argëtime të shthurura dhe në kotësira e qejfe. Kështu, pasuria derdhet e vërshon nga pëllëmba e tij për në prishje pa hesap. Në një proverbë thuhet:

"Filani ka një vrimë në dorën e tij" -i prish paratë. Domethënë, Ai është shumë prishanik që harxhon pa kriter.

Kështu, ky hadith nënkupton se *Sufjani* do t'i mbajë të lidhur njerëzit pas vetes së tij duke i nxitur ata të jenë prishanikë dhe duke i shtyrë për tek një lakmi e fortë dhe për tek ambicia e madhe; dhe do t'i mbajë ata të nënshtruar nëpërmjet atij damari të dobët të karakterit të tyre. Hadithi sherif paralajmëron dhe njofton se: Prishaniku do të bëhet skllav i tij dhe do të poshtërohet e do të bie në kurthet e tij.

Çështja e Dytë

Në një rrëfenjë, thuhet: Një person i frikshëm në fundin e kohës do të ngrihet në mëngjes -do të dalë, do të lindë në mëngjes- dhe në ballin e tij do të jetë e shkruar:

"Ky është kafir -mohues."[40]

Vetëm Allahu e di se cila është e drejta; kjo mund të interpretohet sa vijon:

Ai Sufjan do të veshë kapelën strehëgjërë të jobesimtarëve, dhe do t'i detyrojë njerëzit që ta veshin atë. Por meqenëse vënia e saj, veshja e asaj kapeleje, do të përgjithësohet nëpërmjet detyrimit dhe forcës së ligjit, ajo kapelë strehëgjërë do të drejtohet me lejen e Zotit xh.sh. -

[40] Transmetuan Buhariu, Muslimi

pasi bie në sexhde (në adhurim)- prandaj nuk bëhet kafir -mohues- ai që e vesh atë i detyruar, jo me dëshirën e tij.

Çështja e Tretë

Ndodhet një rrëfenjë*: "Sundimtarët despotikë të fundit të kohës, dhe veçanërisht Dexhali do të kenë xhennete dhe xhehenneme të rremë".*[41] Njohja është vetëm me Zotin, një interpretim është ky: ky është një tregues për burgun dhe për shkollën e mesme të cilat janë vendosur përballë zyrave të qeverisë dhe shikojnë njëra-tjetrën; njëra nga ato të dyja do të bëhet një imitim -kopjim- i shëmtuar i hurive dhe i djelmoshave të parajsës, dhe tjetra është një vend ndëshkimi dhe një burg.

Çështja e Katërt

Ndodhet një rrëfenjë e cila thotë: *"Në fundin e kohës asnjë nuk do të mbetet që do të thotë: Allah! Allah!"*[42]

Askush nuk e di të panjohurën përveç Allahut; një interpretim i kësaj duhet të jetë sa vijon: Vendet e dhikrit ku përmendet Emri Allah... Allah... Allah, teqet, zavijet dhe shkollat fetare, medresetë, do të mbyllen dhe një emër tjetër përveç emrit Allah do të përdoret në shenjat e islamit, të tilla si Ezani dhe Ikameti. Kjo nuk do të thotë se i gjithë njerëzimi do të bie në mosbesim absolut, sepse të mohuarit e Zotit është më larg arsyes se sa të mohuarit e universit. Nuk e pranon arsyeja që shumica e njerëzimit do të bien në këtë mohim, e jo më të gjithë ata. Mosbesimtarët nuk e mohojnë ekzistencën e Zotit xh.sh; mendjet e tyre rrëshqasin, bien në gabim, vetëm lidhur me Atributet e Tij madhështore.

Një interpretim tjetër është ky: me qëllim që të mos e përjetojnë tmerrin e kijametit, shpirtërat e besimtarëve do të kapen, do të merren prej tyre pak më përpara ndodhjes së fundit të botës. Kijameti do të shpërthejë vetëm mbi kokat e mosbesimtarëve.

Çështja e Pestë

Ndodhet një rrëfenjë: *"Në fundin e kohës, disa persona të tillë si Dexhali do të pretendojnë Hyjninë dhe do t'i detyrojnë njerëzit të bëjnë sexhde, të përkulen para tyre."*[43]

---

[41] Transmetuan Buhariu dhe Muslimi
[42] Transmetoi Muslimi
[43] Transmetuan, Hakimi, Musnedi Ahmedit

Allahu e di më së miri; një interpretim është ky: Ashtu si një komandant injorant që mohon ekzistencën e mbretit, imagjinon në vetveten e tij dhe në drejtuesit e tjerë një sundim të vogël në përpjesëtim me fuqinë e tyre, po kështu, ata që vijnë për të udhëhequr shkollën e natyralistëve dhe të materialistëve, imagjinojnë në vetvetet e tyre një lloj hyjnie në përpjesëtim me fuqinë e tyre, i bëjnë nënshtetasit e tyre të bien poshtë duke i shërbyer fuqisë së tyre si adhurim përpara tyre dhe para statujave të tyre; domethënë i bëjnë që t'i përkulin kokat e tyre për ta.

Çështja e Gjashtë

Ndodhet një rrëfenjë: *"Mashtrimi, sprova e fundit e kohës do të jetë aq e tmerrshme saqë askush nuk do të jetë në gjendje ta përmbajë vetveten."*[44], Për shkak të kësaj, për një mijë e treqind vjet, me urdhër të profetit a.s.m., *i gjithë ummeti i ka kërkuar mbrojtje Allahut prej atij mashtrimi, sprove -prej mashtrimit të Dexhalit dhe prej mashtrimit të fundit të kohës"- pas kërkimit mbrojtje prej torturave të varrit.*[45]

Vetëm Zoti e di se cila është më e drejta, kjo mund të interpretohet kështu; Mashtrimi i fundit të kohës do t'i tërheqë e joshë personat për tek vetvetja dhe do t'i robërojë ata.

Njerëzit do t'i bashkohen atij me zgjedhjen e tyre, dhe madje me dëshirë të fortë e të papërmbajtur. Për shembull, në Rusi, burrat dhe gratë lahen së bashku të zhveshur në banja publike. Dhe për shkak se nga natyra gratë kanë një prirje të bashkëlindur për ta shfaqur bukurinë e tyre, ato me dëshirën e tyre e flakin vetveten në atë joshje (mashtrim, shthurje) dhe çudhëzohen. Edhe burrat gjithashtu, duke qenë nga natyra të joshur marrëzisht pas bukurisë, mposhten nga nefset e tyre instiktivë dhe nga një gëzim i dehur, bien në atë zjarr përvëlues dhe digjen.

Dhe kështu, mashtrimi i asaj kohe do t'i joshë me anë të dëfrimeve, zbavitjeve, gjynaheve të mëdhaja dhe risive të kohës të tilla, si: vallëzimet e teatret, -do t'i joshë e tërheqë kërkuesit e qejfeve dhe të kënaqësive përreth tyre si flutura nate, duke i bërë ata të dehur.

Por në qoftë se kjo do të ndodhte nëpërmjet shtrëngimit, obligimit dhe detyrimit absolut, atëherë nuk do të kishte zgjedhje të lirë, dhe si rrjedhojë, nuk do të ishte mëkat.

Çështja e Shtatë

---

[44] Transmetoi Musned, Ahmed
[45] Transmetuan Buhariu, Muslimi

Ndodhet një rrëfenjë, *"Sufjani do të jetë një shkollar i madh; ai do t'i bëjë njerëzit të bien në çudhëzim nëpërmjet dijes. Shumë shkollarë të tjerë do ta ndjekin atë."*

Dhe dija është vetëm me Allahun; një interpretim është ky: Megjithëse ai nuk ka mjete që e çojnë në pushtet të tilla si fuqinë dhe forcën, fiset dhe njerëzit, guximin dhe pasurinë, ashtu si një mbret, ai do ta fitojë atë pozitë nëpërmjet zgjuarsisë së tij, shkencës, shkathtësisë dhe njohjes politike dhe, nëpërmjet mendjemprehtësisë së tij ai do t'i magjepsë e ngashënjejë mendjet e shumë shkollarëve të tjerë, duke u imponuar atyre dëshirat e tij. Ai do të tërheqë mësues të shumtë për ta mbështetur, dhe duke u treguar atyre rrugën për një sistem edukimi të zhveshur nga mësimet fetare, do të punojë për vënien në jetë gjërësisht të asaj metode.

Çështja e Tetë

Rrëfenjat pohojnë se mashtrimi i tmerrshëm i Dexhalit do të ndodhë në radhët e myslimanëve saqë i gjithë ummeti i ka kërkuar Zotit xh.sh. mbrojtje prej tij.

Askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit; një interpretim është ky: Dexhali i myslimanëve është ndryshe nga Dexhali i jobesimtarëve. Në fakt, ashtu si Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, disa dijetarë hetues thanë se Dexhali i myslimanëve është *Sufjani*. Ai do të shfaqet midis myslimanëve dhe do ta kryejë punën e tij nëpërmjet mashtrimit. Ndërsa Dexhali i Madh i jobesimtarëve është ndryshe nga *Sufjani*. Sepse ata që nuk i nënshtrohen forcës absolute dhe detyrimit të *Dexhalit të madh*, bëhen martira, ndërsa ata që i nënshtrohen pa dëshirë, nga detyrimi, nuk bëhen mohues dhe ndoshta nuk janë as gjynahqarë.

Çështja e Nëntë

Në rrëfenjat, ngjarjet e shoqëruara me *Sufjanin* dhe ndodhitë e mashtrimit të fundit të kohës janë përfytyruar se do të ndodhin rreth Damaskut ose në Gadishullin Arabik.

Zoti e di më së miri; një interpretim është ky: Meqenëse në kohët e hershme qendrat e kalifatit ishin në Irak, në Damask dhe në Medine, nëpërmjet ixhtihadeve të tyre personale, transmetuesit i komentuan dhe i përfytyruan ato ngjarje se do të ndodhnin rreth qendrës së shtetit islamik -sikur kalifati do të mbetej kështu- dhe thanë: në Sham -Damask- dhe në Alep. Ata i detajuan nëpërmjet ixhtihadeve të tyre personale ato që erdhën në mënyrë të përmbledhur e konçize në hadithe.

Çështja e Dhjetë

Rrëfenjat përmendin fuqinë e jashtëzakonshme të figurave -personave- të fundit të kohës.

Njohja është me Zotin; një interpretim i kësaj është ky: Ky është një aluzion për personalitetin kolektiv që ata figura përfaqësojnë. Në një kohë, komandanti i përgjithshëm i ushtrisë japoneze, që e kishte shpartalluar Rusinë, u tregua në një pikturë me njërën këmbë në oqeanin paqësor dhe me këmbën tjetër në kështjellën e Portit Artur.

Domethënë, shtrirja e personalitetit të tij kolektiv u pikturua, u përfytyrua në përfaqësimin e personit të tij, dhe në formën gjigante të përfaqësimit. Sa për fuqinë e tyre të madhe e të jashtëzakonshme, meqenëse shumica e zhvillimeve dhe akteve që ata kryen janë shkatërruese dhe lidhen me orekset, me epshet dhe me dëshirat, ata u shfaqën të kishin një fuqi të jashtëzakonshme; sepse shkatërrimi është i lehtë; një kunj shkrepëseje mund të djegë një fshat. Sa për kënaqjen dhe ngopjen e dëshirave shtazore, meqenëse kjo është ajo që dëshiron nefsi instinktiv, ajo është shumë e kërkuar.

Çështja e Njëmbëdhjetë.

Ndodhet një rrëfenjë e cila thotë: "*Në fundin e kohës, një burrë do të kujdeset për dyzet gra*".[46]

Zoti e di se cila është më e drejtë; kjo mund të interpretohet në dy mënyra:

Së Pari: Martesa e ligjshme do të pakësohet në atë kohë, ose siç ndodhi në Rusi, ajo do të zhduket. Ai që ikën nga të qënurit i lidhur me një grua, do të mbetet i palidhur, dhe do të bëhet bari për dyzet gra të mjera.

Së Dyti: Ky është një aluzion se në atë kohë mashtrimi e shthurjeje, shumica e burrave do të shkatërrohen në luftëra, dhe për ndonjë arsye, për ndonjë urtësi Hyjnore, shumica e fëmijëve të lindur do të jenë vajza. Dhe ndoshta, liria e plotë e grave do t'i nxisë aq shumë epshet e tyre saqë do të fitojnë epërsi të natyrshme mbi bashkëshortët e tyre. Kjo do të ketë si rezultat bërjen e fëmijëve të tyre të kujdesen pas tyre, formës së tyre, dhe nëpërmjet një urdhri Hyjnor fëmijët femra do të jenë më të shumtë.

Çështja e Dymbëdhjetë

[46] Transmeton Buhariu, Nikah

Në rrëfenjat thuhet: *"Dita e Parë e Dexhalit do të jetë një vit; dita e tij e dytë një muaj, dita e tij e tretë një javë, dhe dita e tij e katërt një ditë, si ditët e tjera".*[47]

Askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit xh.sh.

I Pari:Ky është një aluzion dhe një shenjë se Dexhali i madh do të shfaqet afër polit të veriut ose në anën e veriut të botës, sepse viti në zonën e Polit të Veriut është një ditë dhe një natë.

Në qoftë se dikush do të udhëtonte një ditë të plotë prej andej me tren duke ardhur në drejtimin tonë, do të shohë se dielli nuk perëndon për një muaj të plotë në verë. Në qoftë se ai do të afrohej me makinë një ditë tjetër në këtë drejtim, do të shihte se dielli është i dukshëm për një javë të plotë. Kur isha i zënë rob lufte në Rusi, unë isha afër kësaj zone. Kjo do të thotë se ky parashikon në mënyrë të mrekullueshme se *Dexhali i madh* do të sulmojë nga veriu për tek ky drejtim.

Interpretimi i tij i dytë: Tre ditët u referohen si Dexhalit të madh po ashtu edhe Dexhalit të myslimanëve duke pasur tre periudha despotizmi.

Me një elokuencë të lartë profeti Muhammed a.s.m. e njofton ummetin e tij se në ditën e tij të parë; në periudhën e tij të parë të qeverisjes, ai do të kryejë vepra aq të mëdhaja saqë ato nuk mund të kryheshin për treqind vjet.

Në ditën e tij të dytë, domethënë në periudhën e tij të dytë, ai do të realizojë vepra të tilla që nuk do të mund të realizoheshin për tridhjet vjet. Në ditën e tij të tretë dhe në periudhën e tij, transformimet dhe ndryshimet që do të bëjë, nuk do të mund të bëheshin për dhjetë vite. Ndërsa në ditën e tij të katërt dhe në periudhën, ai do të jetë i zakonshëm, nuk do të ndërmarrë asgjë veçse do të përpiqet të mbajë e të ruajë pozitën e tij.

Çështja e Trembëdhjetë

Ndodhet një rrëfenjë e shëndoshë e cila thotë:
"Isai a.s., Jezusi, do ta vrasë Dexhalin e madh."[48]
Njohja është vetëm me Allahun; ndodhen dy aspekte për këtë:

Aspekti i Parë: Do të ishte vetëm një person i çuditshëm, i jashtëzakonshëm me fuqinë e mrekullive i cili do të mund ta vriste Dexhalin e frikshëm dhe të ndryshonte rrugën e tij, i cili -Dexhali- e

[47] Transmetoi Muslimi
[48] Transmetoi Tirmidhi

mbron vetvetn nëpërmjet çudirave me të cilat do t'i joshë njerëzit dhe do t'i nënshtrojë duke përdorur magjinë, fuqitë hipnoze, shpirtërat dhe të tjerë, dhe do të magjepsë gjithkënd. Dhe ai person -që do ta vrasë Dexhalin- do të jetë Isai -Jezusi- a.s., profetësinë e të cilit e besojnë shumica e njerëzimit, të cilin e ndjekin shumica e njerëzve dhe që është i admiruar tek të gjithë dhe shumë i lidhur me ta.

Aspekti i Dytë është ky: Do të jenë ndjekësit vërtetë të devotshëm të Isait, Jezusit a.s. ata që do ta vrasin personalitetin kolektiv gjigant të materializmit dhe të ateizmit të cilin do ta formojë Dexhali -sepse Dexhali do të vritet nga shpata e Isait, Jezusit a.s.- dhe do të shkatërrojnë idetë e tij dhe mosbesimin, ide të cilat janë ateiste. Ata krishterë të vërtetë të devotshëm do ta bashkojnë, shkrijnë esencën e krishterimit të vërtetë me esencën e islamit dhe do ta shpartallojnë e dërrmojnë Dexhalin me anë të fuqisë që buron nga kombinimi i realitetit të krishterimit me të vërtetat e islamit, dhe do ta vrasë atë në kuptim -në efekt.

Rrëfenja se *"Isai, -Jezusi- a.s. do të vijë dhe do të kryejë faljet e detyruara prapa Mehdiut dhe do ta ndjekë atë"*[49] aludon për këtë union, bashkim, për sovranitetin e Kur'anit, për vërtetësinë e tij dhe për qënien e tij i ndjekur.

Çështja e Katërmbëdhjetë

Në një rrëfenjë thuhet: *"Dexhali do ta tërheqë fuqinë e tij kryesore prej çifutëve, çifutët do ta ndjekin atë me dëshirë, me bindje."*[50]

Zoti e di më së miri; ne mund të themi se pjesërisht kuptimi i kësaj rrëfenje u përmbush në Rusi, sepse çifutët që ishin persekutuar e përndjekur nga çdo shtet, u grumbulluan me shumicë në Gjermani me qëllim që të marrin hakun e tyre ndaj shteteve dhe popujve. Atëherë, për shkak të rolit që luajti në themelimin e partisë komuniste revolucionare, *Trocki* i tmerrshëm, i cili ishte çifut, mori në dorë udhëheqjen e ushtrisë Ruse, dhe pastaj e vunë atë në krye të qeverisë në Rusi pas *Leninit*, i cili e kishte stërvitur dhe edukuar atë, dhe e shkatërruan tmerrësisht Rusinë dhe shkretuan e rrënuan atë që ajo kishte arritur për një mijë vite. Ata -çifutët- treguan se ishin komitetet e fshehta revolucionare të Dexhalit dhe përmbushën disa prej veprave të tij. Ata shkaktuan gjithashtu tronditje të rënda edhe në qeveritë dhe në vendet e tjera, dhe nxitën shumë turbullira.

---

[49] Transmetoi Buhariu
[50] Transmetoi Muslimi

Çështja e Pesëmbëdhjetë

Ngjarjet që i raporton Kur'ani në mënyrë të përmbledhur, ngjarje që kanë të bëjnë me *Gog Magogët* -Xhuxh Maxhuxhët- i përmend hadithi sherif disi në mënyrë të detajuar. Por ato detaje nuk janë si shembulli i përmbledhjes së Kur'anit që i vërteton në mënyrë të qartë e të sigurtë çështjet e pakundërshtueshme, por ndoshta ato konsiderohen deri diku alegorike; dhe kërkojnë interpretim. Madje ato kanë nevojë të interpretohen, sepse *ixhtihadet* -interpretimet- e transmetuesve janë përzier me to.

Po, askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit; një interpretim është ky: Ai është një aluzion dhe një shenjë se ashtu si fiset mançuriane e mongole, të cilët Kur'ani me gjuhën qiellore i quan *xhuxh maxhuxh -Gog Magog-*[51] së bashku me disa fise të tjera nga Kina e përreth saj, që disa herë e kanë përmbysur Azinë dhe Europën, po kështu ata do ta shkatërrojnë të gjithë botën në të ardhmen dhe do të shkaktojnë kaos. Madje edhe anarkistët e famshëm në organizatat komuniste tani janë të lidhur me ta, janë prej tyre.

Po, ideja e socializmit lindi në Revolucionin Francez dhe lulëzoi nëpërmjet thirrjes së tij për vullnetarizëm -doktrinë e vullnetarizmit, e mendimit dhe veprimit të lirë të individit.

Pastaj meqenëse socializmi bën thirrje për të shkatërruar disa çështje të shenjta, ajo ide e ngulitur socialiste u shndërrua në bolshevizëm. Dhe për shkak se bolshevizmi i prishi madje edhe më shumë vlerat e shenjta morale dhe humane dhe ato të zemrës njerëzore, natyrisht farërat që ai mbolli do të prodhonin anarki e cila nuk njeh kufi për ndonjë gjë dhe nuk ka respekt për asgjë. Sepse në qoftë se hiqen prej zemrës njerëzore dhembshuria, mëshira dhe respekti, atëherë mendja dhe zgjuarsia do të sundojë duke marrë në dorë frerat e njeriut dhe do t'i bëjnë ata njerëz si kafshë të egëra, si qen dhe nuk mund të qeverisen më nëpërmjet politikave.

Vendet për idenë e anarkisë do të jenë ato vende të mbushura me të shtypur, fiset e largëta prej civilizimit, larg qeverisë dhe shtetit dhe të cilat e kanë bërë zakon sulmin dhe plaçkitjen. Njerëzit që u përshtaten atyre kushteve janë fiset mançuriane dhe mongole dhe një pjesë prej fiseve të Kirgiz, të cilët ishin shkaku për ndërtimin e Murit të madh kinez i cili ka një gjatësi prej dyzet ditësh dhe është një nga shtatë mrekullitë e botës. Dhe kështu profeti më i nderuar a.s.m. i cili

[51] Kur'an, 18:94, 21:96

komentoi atë që Kur'ani e shprehu në mënyrë të përmbledhur, njoftoi e parashikoi në mënyrë të mrekullueshme e të saktë shfaqjen e tyre.

Çështja e Gjashtëmbëdhjetë

Në një rrëfenjë lidhur me Isain -Jezusin- a.s. duke vrarë Dexhalin, thuhet: *Dexhali do të ketë një formë vigane, një trup gjigant jashtëzakonisht të madh dhe do të jetë më i gjatë se një minare, ndërsa Isai -Jezusi- a.s. do të jetë shumë i vogël në krahasim me të."*

Askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit; një interpretim duhet të jetë sa vijon: Është një aluzion e një shenjë se, në sasi, komuniteti shpirtëror i muxhahidinëve të cilët do ta njohin Isain a.s. dhe që do ta ndjekin me dritën e besimit do të jetë shumë i vogël e i pakët në krahasim me ushtritë shkencore e materiale të Dexhalit, domethënë në kulturën ushtarake.

Çështja e Shtatëmbëdhjetë

Në një rrëfenjë, thuhet: *Në ditën kur do të shfaqet Dexhali, e gjithë bota do ta dëgjojë. Ai do ta përshkojë botën me udhëtim për dyzet ditë dhe do të ketë një gomar, një kafshë të jashtëzakonshme.*

Zoti e di më së miri; me kusht që rrëfenja të tilla të jenë krejtësisht të shëndosha, të sakta, ato kanë disa interpretime. Ato në mënyrë të mrekullueshme parashikojnë se në kohën e Dexhalit, mjetet e komunikimit dhe të transportit do të jenë aq të avancuara, saqë një ngjarje do të dëgjohet në të gjitha anët e botës në një ditë. Dexhali do të bërtasë në Radio dhe e dëgjojnë atë lindja dhe perëndimi, dhe ngjarja lexohet në të gjitha gazetat dhe revistat e tij.

Dhe njeriu mund të shëtisë në të gjithë botën për dyzet ditë dhe shikon shtatë kontinentet dhe shtatëdhjetë qeveritë e saj. Këto rrëfenja parashikuan kështu në mënyrë të mrekullueshme telegrafinë, telefonin, radion, hekurudhën dhe aeroplanin dhjetë shekuj më përpara se ato të shfaqeshin. Për më tepër, Dexhali nuk dëgjohet në botë me qënien e tij si Dexhal, por me cilësinë e një mbreti dhe sundimtari despotik absolut. Dhe udhëtimi i tij gjithandej tokës nuk do të jetë që t'i pushtojë ato vende, por që të shkaktojë mashtrimin, çudhëzimin dhe ngashënjimin. Ndërsa kafsha e tij ose gomari, ose është treni hekurudhor që njëri nga dy veshët e tij dhe koka e tij është burim zjarri si xhehennemi; dhe veshi tjetër i tij është një vend i shtruar, i mobiluar dhe i stolisur bukur si një xhennet i rremë. Ai i dërgon armiqtë e tij tek koka e tij me zjarr, ndërsa miqtë e tij i vendos tek koka e përgatitur për gosti. Ose ndryshe, gomari i tij ose kafsha e tij është një makinë e çuditshme.. ose një aeroplan.. ose.. (duhet heshtja).

Çështja e Tetëmbëdhjetë

Ndodhet një rrëfenjë e cila thotë: *"Në qoftë se ummeti im përparon në rrugën e drejtë, ai do të ketë një ditë."*[52]

Domethënë, në përputhje me vërsetin, *"...në një Ditë gjatësia e së cilës është sa një mijë vjet në llogarinë tuaj."*[53] ai do të ketë sundim dhe shkëlqim e lavdi për një mijë vite. Në qoftë se nuk vazhdon në rrugën e drejtë, ai do të ketë gjysëm dite, afërsisht pesëqind vite, dhe do të jetë sundues e triumfator vetëm për pesëqind vjet.

Zoti e di më së miri; kjo rrëfenjë nuk jep njoftime për kijametin, por për sundimin dinjitoz e triumfator të islamit dhe për sovranitetin e kalifatit, dhe në fakt u bë realitet një e vërtetë e qëndrueshme dhe një mrekulli e së padukshmes. Sepse, për shkak se në fund të kalifatit Abasid sunduesit e tij politikanë e humbën sensin e tyre të drejtimit, rrugën e drejtë, shteti abasid vazhdoi vetëm për pesëqind vite. Por për shkak se ummeti në përgjithësi nuk devijoi nga rruga e drejtë, i erdhi në ndihmë kalifati Osman dhe mori në dorë sundimin e ummetit, i cili ka vazhduar në ekzistencë për një mijë e treqind vjet. Pastaj për shkak se politikanët osmanë nuk qenë në gjendje të mbanin drejtimin e tyre, kalifati i tij mbijetoi vetëm pesëqind vite (si kalifat); dhe me vdekjen e tij (kalifatit), ai vërtetoi parashikimin e mrekullueshëm të hadithit. Meqenëse ky hadith është diskutuar në trajtesat e tjera, ne e përmblodhëm shkurt atë.

Çështja e Nëntëmbëdhjetë

Në rrëfenja ndodhen parashikime të ndryshme rreth Mehdiut, i cili është prej Ehli Bejtit, dhe shfaqja e tij është prej shenjave të kijametit. Në fakt, disa dijetarë dhe Evlija deklaruan shumë kohë më parë se ai ishte shfaqur.

Zoti e di më së miri se cila është e drejta; një interpretim i këtyre rrëfenjave të ndryshme është ky: Mehdiu i madh do të ketë detyra e misione të shumta. Ai do të kryejë detyra në shumë botëra e sfera, në botën e politikës, në botën e fesë, në botën e shtetit dhe në botën e xhihadit.

Gjithashtu, meqenëse në çdo shekull në kohë dëshpërimi njerëzit kanë nevojë për ndonjë si Mehdiu për të forcuar moralin e tyre, ose për mundësinë e një Mehdiu që të shfaqet në atë kohë për t'i ndihmuar ato.

---

[52] Ebu Davud
[53] Kur'an, 32: 5

Prandaj është shfaqur prej Ehlibejtit dikush si Mehdiu në çdo periudhë, madje në çdo shekull nëpërmjet mëshirës Hyjnore, dhe ka ruajtur sheriatin e stërgjyshit të tij më të lavdishëm dhe ka rigjallëruar sunnetin e tij të pastër. Për shembull, Mehdiu i Abasidëve u shfaq në botën e politikës dhe të shtetit; u shfaqën Shejh Gejlani, El-Gauth el-Aëdham, Sheh Nakshibendi, katër polet shpirtërorë -Ahmed Rifai, Ahmed El-Bedevi, Ibrahim el-Dasuki dhe Ebu el-Hasan Shazili- dhe dymbëdhjetë imamët në botën e fesë e të besimit. Për këtë arsye disa nga njerëzit e Realitetit thanë se ai tashmë ishte shfaqur.

Por, meqenëse kjo çështje është shpjeguar në Risale-i Nur, ne ia referojmë atij diskutimin e kësaj, dhe këtu themi vetëm këtë:

Nuk ka familje në të gjithë dynjanë me një mbështetje kaq të ndërsjellë për njëri-tjetrin, dhe nuk ka as ndonjë fis me një harmoni të tillë dhe as ndonjë komunitet apo shoqëri kaq e ndriçuar si familja, fisi, komuniteti dhe shoqëria e Ehli Bejtit, e Familjes së profetit a.s.m..

Po, Ehli Bejti, Familja e Profetit a.s.m. ka lindur qindra heronj të shenjtë dhe ka prodhuar mijëra udhëheqës shpirtërorë të Ummetit, dhe është ushqyer me shpirtin e Realitetit të Kur'anit, me dritën e besimit dhe me nderin e islamit dhe kështu ata u ngjitën drejt plotësive. Prandaj duhet medoemos që ata t'i shfaqin botës drejtësinë e plotë të kryekomandantit të tyre, Mehdiut më të madh dhe vërtetësinë e tij nëpërmjet ringjalljes së sheriatit të Muhammedit, realitetit të Kur'anit dhe të sunnetit të profetit a.s.m. dhe t'i shpallin e t'i vënë në praktikë në fundin e kohës.

Kjo çështje është krejtësisht e arsyeshme, përveç qënies së saj e domosdoshme, esenciale dhe e kërkuar nga parimet e shoqërisë njerëzore.

Çështja e Njëzet

"Lindja e diellit nga perëndimi i tij dhe shfaqja prej tokës e Dabbetul'erd, (e kafshës)."[54] lindja e diellit në perëndim do të jetë një shenjë e vetëkuptueshme e fundit të botës, dhe për shkak se është e vetëkuptueshme, ajo do të jetë një ngjarje qiellore e cila do të mbyllë derën e pendesës, derë e cila lidhet me zgjedhjen e arsyes. Prandaj kuptimi i saj është i qartë dhe nuk ka nevojë për interpretim. Njeriu mund të thotë vetëm sa vijon:

Zoti e di më së miri; shkaku i jashtëm i asaj lindje do të jetë ky: me ngritjen (zhdukjen) e Kur'anit nga toka -i cili është si mendja e saj-

[54] Transmetuan, Buhariu, Muslimi

toka do ta humbasë drejtësinë, do të çmendet, dhe do të përplaset -nëpërmjet lejes Hyjnore- me një planet tjetër, dhe rrotullimi i saj do të përmbyset. Nëpërmjet vullnetit Hyjnor, do të bëhet udhëtimi i saj nga perëndimi në lindje në vend të nga lindja në perëndim, dhe dielli do të fillojë të lindë në perëndim.

Po, në qoftë se do të këputej forca tërheqëse e Kur'anit Kerim i cili është litari i fortë i Allahut dhe i cili e lidh tokën me Fronin Hyjnor dhe do të shkëputeshin lidhjet e globit tokësor, pra do të këputej graviteti, ajo do të bëhej e trullosur dhe e çmendur, dhe me lëvizjen e saj të pakontrolluar e të kundërt, dielli do të lindte në perëndim. Ka një interpretim tjetër për këtë hadith i cili është se për shkak të përplasjes -me planetët- nëpërmjet urdhrit Hyjnor, do të bëhet kijameti.

Sa për *Dabbetul Erd* -kafshën-, në Kur'an është një tregues shumë i përmbledhur, një shprehje e shkurtuar e bërë nga gjuha e gjendjes së saj. Sa për detajet e saj, unë nuk i njoh ashtu si shembulli i çështjeve të tjera, veçse për tani unë mund të them këtë: Askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit, ashtu siç bëri Zoti xh.sh. të sundojë fatkeqësia e karkalecave dhe e pleshtave, insekteve mbi popullin e Faraonit, dhe bëri që popullin e Ebrehes; të cilët u përpoqën të shkatërronin Qaben, t'i sundojnë e t'i sulmojnë *zogjt Ebabilë*, po ashtu, ata që shtyhen e nxiten me dëshirë e me vetëdije nëpërmjet mashtrimeve të *Sufjanit* dhe *të Dexhalit* dhe vazhdojnë në rebelim, në mosbindje dhe në korrupsion, dhe bien në ateizëm, në mosbesim, në mosmirënjohje, në mizori, në tradhti e në mashtrim nëpërmjet shtytjes së anarkisë dhe të tmerrit që do t'i përhapin *Xhuxh e Maxhuxht, Gog magogët*, do të shfaqet prej tokës kundra tyre një kafshë -për një urtësi Hyjnore dhe me qëllim që t'i sjellë ata në vete- dhe do ta bëjë që t'i sundojë ata dhe t'i shkatërrojë plotësisht.

Ajo kafshë, *Dabbetul erdi* -Allahu e di më së miri- është një specie dhe jo një individ, sepse në qoftë se do të kishte qenë individ dhe një kafshë e vetme gjgante, një krijesë e vetme nuk do të mund të ishte gjithandej në çdo vend. Kjo do të thotë se ajo është një specie e tmerrshme kafshësh.

Ndoshta, ashtu siç tregohet nga vërseti, *"... përveç një krimbi të vogël nga toka i cili po brente pak e nga pak në shkopin e tij..."*[55] ajo krijesë do të jetë një lloj termitesh (mizash të mëdhaja) që quhen *"Dabbetul Erd"*, të cilat do të brejnë e gërmitin kockat e njerëzve si të ishin dru, duke i

[55] Kur'an, 34:14

vendosur vetvetet e tyre në çdo pjesë të trupave të tyre, nga dhëmbët deri tek thonjtë e gishtërinjve të tyre.

Duke e bërë atë krijesë, *"Dabbedul Erd"* të flasë mbi çështjen e besimit, vërseti tregon se nëpërmjet bekimit të besimit, dhe shmangies së ligësive dhe të abuzimeve nga ana e tyre, besimtarët do të jenë të shpëtuar prej saj.

"Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime."[56] *"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."*[57]

Tre Çështje të Përmbledhura duke Plotësuar Njëzet Çështjet e Mëparshme.

Çështja e Parë

Ashtu si në disa rrëfenja, Isai a.s. thirret me emrin *El-Mesih*, po kështu me të njëjtin emër thirren edhe dy Dy Dexhalët ashtu siç erdhi në duanë që kërkohet mbrojtje *istiadheh*, ku thuhet:

"...(kërkoj mbrojtje) prej mashtrimit të El-Mesihi el-Dexhal"

Cila është urtësia në këtë emërtim dhe cili është interpretimi i saj?

Përgjigjja: Urtësia e saj -Dhe Allahu e di më së miri- është: Ashtu si, me urdhrin Hyjnor, Isai, Jezusi a.s. shfuqizoi disa nga urdhëresat e rënda e të vështira që ishin në sheriatin e Musait a.s. duke bërë të lejueshme disa gjëra që i lakmojnë nefset, si pija e verës, po kështu me tundimin dhe joshjen e shejtanit dhe për shkak të ndikimeve të tij, Dexhali i Madh do t'i shfuqizojë disa urdhëresa të sheriatit të Isait a.s. dhe duke shkatërruar lidhjet në përputhje me të cilat administrohet jeta e shoqërisë krishtere, ai do të përgatisë terrenin për anarki e terror dhe për ardhjen e xhuxh maxhuxhëve.

Gjithashtu *Sufjani*, i cili është Dexhali i myslimanëve, përpiqet të shfuqizojë disa nga urdhëresat e përjetshme të sheriatit të Muhammedit a.s.m., dhe duke shkatërruar lidhjet fizike e shpirtërore të jetës humane duke i lënë nefset kokëfortë, të dehur, të trullosur, të shashtisur e pa kufizim, ai do t'i zgjidhë, lirojë *zinxhirët* e ndritshëm të respektit, të mëshirës dhe të dashurisë të cilat lidhin individët e shoqërisë njerëzore; dhe duke i detyruar njerëzit për një liri e cila është thjesht despotizëm i pastër me qëllim që ata të bien mbi njëri-tjetrin në

[56] Kur'an, 2:286
[57] Kur'an, 2:32

moçalin e poshtërimit, të epsheve dhe të dëshirave të korruptuara, ai do të hapë rrugën për një anarki të tmerrshme dhe për një terror të llahtarshëm. Dhe në atë kohë ata njerëz në asnjë mënyrë tjetër nuk mund të mbahen nën kontroll përveç se nëpërmjet despotizmit shtypës.

Çështja e Dytë

Të përmendura në rrëfenja janë arritjet e çuditshme, veprat e jashtëzakonshme të të Dy Dexhalëve, si dhe fuqia dhe madhështia e tyre mbinjerëzore; saqë në rrëfenja erdhi se disa njerëz fatkëqinj do t'u atribuojnë një lloj hyjnie atyre të dyve. Cila është arsyeja për këtë?

Përgjigjja: Njohja është me Zotin; arritjet dhe veprat e tyre duke qenë aq të mëdhaja e të jashtëzakonshme është se meqenëse shumica e tyre të shtyjnë për në shkatërrim dhe nxisin epshin e nefsit, ata i kryejnë ato vepra me lehtësi, saqë në një hadith thuhet: *"Në ditë e vetme prej ditëve të tyre është një vit."* Domethënë, veprat që ata kryejnë në një vit nuk do të kryheshin normalisht për treqind vite.

Ndodhen katër aspekte dhe arsye për sa ka të bëjë me shkakun e shfaqjes së fuqisë së tyre që është e jashtëzakonshme -mbinjerëzore.

I Pari: Meqenëse, si rezultat i planit Hyjnor që i lejoi ata të bëjnë kështu, gjërat e mira dhe përparimet që arrihen nëpërmjet fuqisë së një ushtrie guximtare dhe të një kombi aktiv në qeveritë e tyre të mëdhaja e despotike u atribuohen padrejtësisht atyre, kjo shkakton që personat e tyre të imagjinohen se kanë fuqinë e një mijë burrave. Por me plot të drejtë dhe në përputhje me rregullat, veprat e mira pozitive, nderi dhe plaçkat e fituara nëpërmjet akteve të një komuniteti duhet të ndahen midis komunitetit dhe duhet t'u jepen anëtarëve të tij; në një kohë që të këqiat, negativet, humbjet dhe shkatërrimet duhet t'i atribuohen administrimit të keq të kryetarit të komunitetit dhe të metave e gabimeve të tij.

Për shembull, në qoftë se një batalion pushton një kështjellë, nderi i fitores dhe plaçkat që ata marrin i takojnë fuqisë së armëve të tyre. Kurse në qoftë se ka humbje dhe anë nagative për shkak të planit të gabuar, ato i atribuohen komandantit të tyre.

Kështu, krejtësisht në kundërshtim me këtë parim themelor të së vërtetës dhe të realitetit, meqenëse progresi pozitiv dhe të gjitha gjërat e mira u atribuohen atyre udhëheqësve frikësues, dhe zhvillimet negative, të këqijat dhe gabimet u atrbuohen njerëzve fatkëqinj, si rrjedhojë e planit Hyjnor, ata persona që meritojnë të përbuzen nga gjithësecili, janë të dashur nga të gjithë të pavëmendshmit dhe të pakujdesshmit.

Aspekti i Dytë dhe Arsyeja e Dytë:

Për shkak se të Dy Dexhalët përdorin despotizmin më të egër, tiraninë më të madhe, dhunën më të ashpër dhe terrorin më të skajshëm, ata shfaqen të kenë një fuqi të madhe.

Po, despotizmi i tyre është aq i jashtëzakonshëm, i çuditshëm saqë ata ndërhyjnë -nën maskën e ligjit- në ndërgjegjjen e çdo individi dhe në çështjet e tij të shenjta, madje deri tek lloji i veshjeve të tij. Unë imagjinoj se me një parandjenjë të së ardhmes, dashuruesit e lirisë prej myslimanëve turq -në shekullin e fundit- e perceptuan këtë despotizëm të tmerrshëm, dhe duke e gjuajtur atë me shigjeta, e sulmuan egër. Por ata u mashtruan krejtësisht dhe nuk e qëlluan objektivin; ata sulmuan një front të gabuar.

Ajo është një tirani dhe një mizori aq e madhe saqë -për shkak të një personi të vetëm- shkatërron njëqind fshatra dhe ndëshkon të pafajshmit dhe i detyron të shpërngulen dhe i poshtëron.

Aspekti i Tretë dhe Arsyeja e Tretë: Për shkak se të dy Dexhalët do të fitojnë përkrahje prej organizatave të fshehta çifute, të cilat ushqejnë një urrejtje të madhe kundra islamit dhe krishterimit, dhe një mbështetje prej një organizate tjetër të fshehtë e cila punon nën maskën e lirisë së grave; dhe për shkak se Dexhali i myslimanëve do të mund të mashtrojë madje edhe lozhet e Masonëve -komitetet e Masonëve- dhe do të fitojë mbështetjen e tyre, ata do të supozohen se kanë një fuqi të madhe.

Gjithashtu, kuptohet nga disa konkluzione dhe intuita të disa Evlijave se Dexhali i quajtur *Sufjan,* i cili do të vijë të udhëheqë shtetin islam, do të jetë një politikan kryesues, i cili është jashtëzakonisht i aftë, i zgjuar, aktiv, nuk ka dëshirë për t'u dukur, dhe nuk u jep rëndësi rangut personal dhe lavdisë; ai gjithashtu do të jetë një komandant i përgjithshëm i ushtrisë që është shumë guximtar, i fortë, energjik dhe i vendosur dhe nuk ulet në nivelin e kërkimit të famës, nuk e begenis kërkimin e famës dhe do t'i robërojë muslimanët. Duke shfrytëzuar mungesën e tyre të hipokrizisë, ai do t'ia përshkruaj vetvetes veprat e tyre brilante të jashtëzakonshme, si dhe progresin që ata kanë arritur të shtyrë nga nevoja e madhe që buron nga transformimi dhe ripërtëritja e ushtrisë së madhe dhe e shtetit të madh dhe nga tronditjet e luftës së parë botërore, dhe do t'i shtyjë lavdërimtarët që të përhapin gjithandej se ai posedon në personin e tij një fuqi të çuditshme dhe një forcë të jashtëzakonshme.

Aspekti i Katërt dhe shkaku i Katërt: Dexhali i Madh do të ketë shqisa, aftësi që kanë ndikim dhe forcë nënshtruese që u ngjasojnë fuqive hipnotizuese dhe kanë ndikim në shpirtëra.

Kurse Dexhali i muslimanëve do të ketë fuqi nënshtruese dhe hipnotizuese në njërin sy. Madje në një rrëfenjë, thuhet: *"Dexhali do të jetë i verbër në njërin sy."*[58] duke tërhequr vëmendjen për tek kjo dhe duke treguar se njëri nga sytë e Dexhalit të madh do të jetë i verbër në krahasim me syrin tjetër të tij, hadithi tregon se meqenëse ata të dy do të jenë mohues absolutë, ata do ta kenë vetëm njërin sy dhe shikimi i tyre do të kufizohet tek kjo dynja dhe ata nuk do të kenë sy që shikojnë Ahiretin dhe pasojat e veprave.

Unë gjithashtu e pashë Dexhalin e myslimanëve në një botë shpirtërore, dhe vëzhgova me sytë e mi se ai posedonte një fuqi nënshtruese hipnotizuese në njërin prej syve të tij, dhe unë e njoha atë dhe e kuptova se ishte krejtësisht mohues i Zotit xh.sh.. Ky mohim është ai që e shtyn atë që t'i sulmojë me guxim e arrogancë shenjtëritë. Por meqenëse njerëzit e zakonshëm nuk do ta dinë realitetin e çështjes, do ta supozojnë se ai i kryen veprat e tij me një guxim të jashtëzakonshëm dhe me një forcë të madhe.

Gjithashtu, për shkak se një komandant i tillë i madh, me fat, i suksesshëm, tinëzar dhe dredharak, shfaqet në kohën e thyerjes së një kombi heroik e të lavdishëm, me dashurinë e tyre për heroizmin njerëzit do ta miratojnë, duartrokasin e adminirojnë atë duke mos e shikuar natyrën e tij të fshehtë e të tmerrshme, dhe ai do të përpiqet që t'i mbulojë e t'i fshehë ligësitë e tij.. u shkatërrofshin!..

Por siç kuptojmë nga hadithet se nëpërmjet dritës së besimit dhe dritës së Kur'anit që gjenden në shpirtin e ushtrisë heroike, muxhahide dhe në kombin e kapur pas fesë së tij, do t'i shtyjnë ata që ta shohin të vërtetën dhe do të përpiqen të riparojnë shkatërrimin e tmerrshëm të atij komandanti.

Çështja e Tretë e Përmbledhur.

Kjo përbëhet nga tre ngjarje instruktive:

Ngjarja e Parë: Një ditë, Hazreti Umer Ibn Hattabi, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, u nis me profetin e Zotit xh.sh., dhe profeti a.s.m. ia bëri atij me shenjë për njërin prej fëmijëve të një grupi çifutësh, dhe tha:

[58] Transmetoi Buhariu

Ky është pikërisht imazhi i tij! Hazreti Umeri i tha: "Atëherë më lër, o i dërguar i Zotit, që ta godas qafën e tij, ta vras!" Por i dërguari i Zotit iu përgjigj:

"Në qoftë se ai është Sufjani -Dexhali i myslimanëve- ti nuk mund ta vrasësh atë, dhe në qoftë se ai nuk është, ai nuk mund të vritet nëpërmjet imazhit të tij." [59]

Hadithi tregon se në fundin e sundimit të tij, imazhi i Sufjanit do të shfaqet në shumë gjëra, dhe se ai do të lindet çifut, midis çifutëve. Është e çuditshme se megjithëse Hazreti Umeri, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, ishte mjaft i zemëruar dhe armiqësor ndaj imazhit të tij të shikuar në një fëmi saqë deshi ta vriste, ndërsa tek ai *Sufjan* u bënë më shumë ata që e lavdërojnë, e admirojnë dhe e vlerësojnë atë.

Ngjarja e Dytë: Shumë njerëz rrëfejnë se Dexhali i muslimanëve do të jetë kureshtar rreth kuptimit të sures: *"(Betohem) për fikun dhe për ullirin!"* dhe do të pyesë rreth saj.

Është e çuditshme por vërseti *"Por ja! Me të vërtetë që njeriu i kalon të gjithë kufijtë"*[60] në suren vijuese *"Lexo! Me Emrin e Zotit tënd,*[61] sipas llogaritjes së shkencës së *xhefrit* dhe sipas kuptimit të saj, gjithashtu tregon pikërisht vendin e tij dhe personin e tij, duke treguar se ai do të bëjë shkelje të tepërta dhe agresion ndaj xhamive dhe ndaj atyre që kryejnë faljet. Domethënë, ai njeri, perceptoi se një sure e shkurtër ka lidhje me të, por ai gabon dhe troket derën e komshisë së saj.

Ngjarja e Tretë: Në një rrëfenjë, thuhet*: Dexhali i muslimanëve do të shfaqet në Horosan.*"[62]

Askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit; një interpretim i saj është ky: populli turk i cili ishte kombi më guximtar e i fuqishëm i lindjes, dhe ushtria heroike e islamit, ishin në kohën e asaj rrëfenje përreth krahinave të Horasanit dhe akoma nuk e kishin bërë atdheun e tyre në Anadoll. Duke përmendur vendbanimin që ata populluan, ky është një tregues se *Dexhali Sufjan* do të shfaqej prej midis tyre.

Është e çuditshme, madje mjaft e çuditshme, se ai përkohësisht do të përpiqet të përdorë kombin turk dhe turqizmin i cili për shtatëqind vjet ka qenë një shpatë vezulluese prej diamanti, simbol për nderin e islamit dhe për krenarinë e tij në dorën e islamit dhe të Kur'anit, -do t'i

---

[59] Buhariu
[60] Kur'an, 96: 6
[61] Kur'an, 96: 1
[62] Transmetoi Tirmidhi

përdorë- kundra shenjave të islamit. Por ai nuk do të jetë i suksesshëm dhe do të tërhiqet. Nga këto rrëfenja kuptohet se "ushtria heroike do t'i shpëtojë, duke marrë frerat prej dorës së tij".

Vetëm Allahu e di më së miri se cila është e vërteta, dhe askush nuk e di të panjohurën përveç Zotit xh.sh.

. . .

RREZJA E GJASHTË

[Kjo përbëhet nga vetëm dy Pika]

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

[Do të shpjegojmë në mënyrë të përmbledhur në këtë Rrezen e Gjashtë vetëm dy pika prej qindra pikave të cilat i përmban *teshehhudi* në namaz *"Et-tehijjatu El Mubarekatu, Es-salevatu, Et-tajjibatu.. Lil-lahi.."*. Ato të dyja janë dy përgjigje të përmbledhura rreth dy pyetjeve që lidhen me dy pika në *Tesheh-hud.*

Sa për të vërtetat e tjera të *tesheh-hudit* ne do t'i shpjegojmë në një kohë tjetër në dashtë Zoti xh.sh.]

Pyetja e Parë: Frazat e bekuara të *teshehhudit* u folën në formë dialogu që u zhvillua ndërmjet Zotit të Gjithëlavdishëm dhe të Dërguarit të Tij fisnik a.s.m. në Natën e *Mi'ëraxhit*, atëherë cila është urtësia dhe arsyeja për recitimin e tyre -fjalëve të bekuara të teshehhudit- në faljet rituale:

Përgjigjja: Namazi i çdo besimtari është miraxhi i tij -mjeti i ngritjes së tij-; atëherë fjalët e *teshehhudit,* të cilat ishin të përshtatshme për Praninë Hyjnore, u folën gjatë Miraxhit madhështor të Hazreti Muhammedit a.s.m., dhe duke i recituar ato, besimtarët e

kujtojnë atë bashkëbisedim të shenjtë. Nëpërmjet kujtimit të atyre fjalëve, dhe nëpërmjet sjelljes ndërmend të tyre, kuptimet e atyre fjalëve të bekuara pushojnë së qenuri të veçanta, të pjesshme dhe bëhen universale; kuptimet e tyre të shenjta dhe gjithëpërfshirëse janë, ose mund të jenë të përfytyrueshme, të perceptueshme. Nëpërmjet një përfytyrimi të tillë, vlera dhe drita e tyre rriten, lartësohen e zgjerohen.

Për shembull, Profeti Muhammed a.s.m. tha në atë natë të bekuar përpara Pranisë Hyjnore në vend të dhënies ***Selam***: "*Et-tehijjatu Lil-lahi...*" -përshëndetjet i takojnë Allahut-...

Domethënë, O Zoti im! Të gjitha tesbihatet e gjalla që qëniet e gjalla shfaqin nëpërmjet jetëve të tyre dhe dhuratave të bashkëlindura... dhe ato çfarë i paraqesin Autorit të tyre të Gjithëlavdishëm, të takojnë Ty. Edhe unë me rolin tim, duke i përfytyruar të gjitha ato dhe nëpërmjet besimit tim në to, gjithashtu t'i ofroj ato Ty".

Po, ashtu si me fjalët *Et-tehijjat* i dërguari i Zotit, me nijet i paraqiti tek Divani i Zotit të Gjithëlavdishëm të gjitha ibadetet e natyrshme që i kryejnë krijesat e gjalla nëpërmjet mënyrës së krijimit të tyre, po ashtu profeti a.s.m. thotë nëpërmjet Fjalës *Mubarekat*, e cila është përmbledhja e *Përshëndetjeve* me një kuptim të gjërë përfshin ibadete e bekime të natyrshme, dhe begatitë e të gjitha krijesave të cilat janë boshti i bereqetit dhe i begatisë nga ana e atyre që i shikojnë, dhe të cilat janë esenca e jetës dhe e qënieve të gjalla, dhe sidomos e farërave, bërthamave, kokrrave dhe vezëve. Ai e tha me këtë kuptim të gjërë.

Nëpërmjet fjalës *Salevat*, e cila është përmbledhja e *Mubarekat* -bekimeve-, ai a.s.m. synoi ibadetet e lartësuara e të ndritshme të qënieve të plotësuara humane dhe të Melekëve më të afërt -të cilët janë përmbledhjet e qënieve me shpirt- dhe e paraqet atë posaçërisht për të Adhuruarin e Tij të Gjithëlavdishëm xh.sh..

Pastaj ajo çfarë tha Zoti i Gjithëlavdishëm në atë natë: *Es-selamu alejke Ja Ejjuhenne bijju" -Paqja qoftë mbi Ty, o Profet!-* ishte një tregues dhe një urdhër indirekt se në të ardhmen, qindra e miliona njerëz do ta thonin atë të paktën dhjetë herë në ditë. Ai selam Hyjnor i jep asaj fjale një dritë gjithëpërfshirëse dhe një kuptim të lartë.

Gjithashtu, profeti Muhammed a.s.m. duke iu përgjigjur përshëndetjes Hyjnore nëpërmjet thënies: *"Esselamu alejna ve ala Ibadil-lahis-salihine"*, (Paqja qoftë mbi ne dhe mbi shërbëtorët e drejtë të Zotit xh.sh.) tregon e të sjell ndërmend se ai a.s.m. i kërkoi

Krijuesit të tij Gjithëbujar duke shpresuar dhe duke u lutur që ummeti i tij madhështor dhe anëtarët e drejtë të tij të reflektonin islamin, i cili përfaqëson përshëndetjen Hyjnore, dhe se i gjithë ummeti i tij do ta përshëndesnin njëri-tjetrin me fjalët "*Esselamu alejke, ve alejkesselam"* (Paqja qoftë mbi ty! dhe paqja qoftë mbi ty!) përshëndetje e cila ndërmjet besimtarëve është një shenjë universale e islamit.

Xhebraili a.s.m., i cili mori pjesë në atë bashkëbisedim të lartë tha në atë natë me urdhrin Hyjnor: *'**Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve eshhedu enne Muhammeden Resulull-lah**!' 'Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhammedi a.s.m. është i dërguari i Allahut'*. Kjo thënie e Xhebrailit jep sihariqe, lajme të gëzueshme se i gjithë ummeti i Muhammedit a.s.m. do të bënte dëshmi në këtë mënyrë deri në Ditën e Kijametit.

Duke të të kujtuar këtë bashkëbisedim të shenjtë të lartësuar, kuptimet e fjalëve fitojnë shkëlqim e gjithëpërfshirje.

Një gjendje e çuditshme shpirtërore më ndihmoi në zbulimin e të vërtetës së lartëpërmendur; ajo është sa vijon:

Një herë ndërsa isha në një mërgim të errët, në një natë të errët dhe në një gjendje të errët pakujdesie, e tanishmja e këtij universi madhështor iu shfaq imgjinatës sime në formën e një kufome të tmerrshme, të pajetë, të pashpirtë, të vdekur e të shkretë. E shkuara, gjithashtu, u shfaq se ishte e vdekur, e zbrazur, e pashpirt dhe e tmerrshme; ajo hapësirë e pakufishme dhe ajo kohë e pakufishme morën formën e një shkretëtire të errët. Unë përdora faljet me qëllim që të shpëtoja nga ajo gjendje e tmerrshme shpirtërore dhe nga ajo frikë, dhe kur thashë '*Et-tehijjat*' në *teshehhud*, papritmas universi erdhi në jetë. Ai ringjallet duke marrë një formë të gjallë e të ndritshme dhe u bë një pasqyrë e shndritshme për manifestimet e të Gjallit të Përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm. Unë pashë se me të gjitha pjesët e tij të gjalla, universi në mënyrë të vazhdueshme i paraqet të Gjallit të Përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm përshëndetjet dhe dhuratat e jetëve të tij. Unë e kuptova këtë me 'Njohurinë e sigurisë', madje me 'sigurinë absolute'. Dhe kur thashë: ***Esselamu alejke Ja Ejjuhen-nebijju,*** '*paqja qoftë mbi Ty, o Profet!*', papritmas ajo kohë e zbrazur e pakufishme u transformua nën udhëheqjen e profetit Muhammed a.s.m. nga të qenit një shkretëtirë e mjeruar, e vetmuar, në një vend të njohur e të këndshëm argëtimi të mbushur me qënie shpirtërore.

Pyetja e Dytë: Krahasimi që gjendet tek fundi i *teshehhud* i cili është: ***All-llahumme Sal-li ala Muhammedin ve ala Ali Muhammedin kema sal-lejte ala Ibrahime ve Ala A'li Ibrahime"*** *O Zot! Jepi bekime Muhammedit dhe Familjes së Muhammedit, ashtu siç i dhe bekime Ibrahimit dhe Familjes së Ibrahimit"*[63], ky krahasim shfaqet të jetë në kundërshtim me rregullat e krahasimeve, sepse Muhammedi a.s.m. ishte më i madh se Ibrahimi a.s. dhe mori Mëshirë Hyjnore më shumë se sa ai.

Cili është misteri i këtij krahasimi? Cila është urtësia e posaçërimit të këtij lloji salavatesh në *teshehhud*? Dhe cili është misteri i urtësisë që qysh prej kohëve të hershme e njëjta dua është përsëritur në të gjitha namazet rituale, dhe në çdo kohë dhe nga ana e atyre, milionat e duave të të cilëve kanë qenë pranuar, dhe kërkimi i tyre me ngulm, megjithëse në qoftë se një dua do të pranohej njëherë, ajo do të ishte e mjaftueshme, dhe sidomos në qoftë se gjëja e kërkuar është premtuar nga Zoti xh.sh..

Për shembull, Zoti i Gjithëfuqishëm ka premtuar: *"Shpejt Zoti yt do të të ngrejë Ty në gradën e lartë të premtuar të lavdërimit dhe shkëlqimit,* (*Mekamun Mahmud*)*"*,[64] megjithatë gjithmonë pas ezanit dhe ikametit duaja e transmetuar:

"*Dhe ngreje atë tek stacioni i lavdërimit dhe lavdisë që Ti ia ke premtuar atij*", përsëritet; i gjithë ummeti lutet që ai premtim të përmbushet.

Cila është arsyeja për këtë?

Përgjigjja: Kjo pyetje përmban tre pyetje dhe tre aspekte:

Aspekti i Parë: Pavarësisht se Hazreti ynë Ibrahimi a.s. nuk është i barabartë me profetin Muhammed a.s.m., veçse ama familja e Ibrahimit a.s. ose pasardhësit e tij ishin profetë; ndërsa familja e profetit Muhammed a.s.m. ishin Evlija'ë, dhe Evlijatë nuk mund ta arrijnë nivelin e profetëve.

Dëshmia se kjo dua për familjen e tij -Ehlibejtin- ka qenë pranuar në formën më të ndritshme është kjo:

Qënia e Evlijave, të cilët erdhën nga pasardhësit e vetëm dy vetave prej familjes së Muhammedit a.s.m. që janë Hasani dhe Hysejni, Zoti qoftë i kënaqur prej të dyve, ata Evlija që janë me shumicën e tyre

---

[63] Buhariu
[64] Kur'an, 17:79

absolute imamët, udhëheqësit shpirtërorë dhe drejtuesit e tarikateve Sufi të realitetit midis treqind e pesëdhjetë milionë muslimanëve dhe arritën një shkallë si shkalla e profetëve të bijve të Israelit, ashtu siç rrëfehet në hadith: *"Dijetarët e ummetit tim janë si profetët e bijve të Israelit."*

Gjithësecili prej tyre e udhëhoqi pjesën më të madhe të ummetit për në rrugën e së vërtetës dhe të Realitetit të islamit; këta janë frutat e pranimit të kësaj duaje për familjen e Muhammedit a.s.m. në krye të të cilës janë: Xhafer Sadik, Shejh Gejlani dhe Shejh Nakshibandi, Zoti qoftë i kënaqur prej tyre.

Aspekti i Dytë: Arsyeja për bekimet e këtij lloji duke qenë të kufizuara për namazet rituale është se ato i kujtojnë njeriut se ai është në rrugën të cilën e hapën dhe e morën karvani i madh i profetëve dhe i evlijave, të cilët janë më të ndriturit, më të plotësuarit, më të drejtët e njerëzimit dhe anëtarët e tij të shquar. Ai i është bashkangjitur atij grumbullimi të madh, i cili merr fuqi nëpërmjet konsensusit të tij të njëqindfishtë dhe që nuk mund ta ngatërrojë rrugën e tij dhe është duke e shoqëruar atë në Rrugën e Drejtë. Duke e sjellur këtë ndërmend, ai shpëton prej dyshimeve djallëzore dhe prej iluzioneve të këqija.

Dëshmia se anëtarët e këtij karvani janë miqtë dhe krijesat e pranueshme të Pronarit të universit, dhe kundërshtarët e tyre janë armiq të urryer prej krijesave të tij, është se, që nga koha e Ademit a.s., ndihma e mbështetja ka ardhur gjithmonë nga e padukshmja për karvanin, kurse kundërshtarëve të tyre gjithmonë u kanë rënë fatkeqësi qiellore.

Po, ashtu si të gjithë kundërshtarët si shembulli i popullit të Nuhut, Themudit, Adit, Faraonit dhe Nemrudit që të gjithë kanë marrë goditje prej të Padukshmes që tregojnë zemërimin Hyjnor dhe dënimin e Tij; po ashtu heronjtë e shenjtë të karvanit madhështor si Nuhu, Ibrahimi, Musai, paqja qoftë mbi të gjithë ata, dhe Muhammedi a.s.m. dhe si shembulli i këtyre prej profetëve të nderuar dhe prej imamëve të lartësuar, kanë manifestuar në mënyrë të mrekullueshme dhe të jashtëzakonshme mrekulli dhe mirësi Hyjnore të marra nga e Padukshmja.

Meqenëse një goditje e vetme tregon zemërim, dhe një nderim i vetëm tregon dashuri, atëherë mijëra goditje kanë rënë mbi kundërshtarët dhe mijëra mirësi dhe shembuj ndihmeje kanë ardhur për karvanin gjë që dëshmon e provon në mënyrë të vetëkuptueshme

dhe aq qartë si dita për vërtetësinë dhe drejtësinë e atij karvani të bekuar dhe se ata janë të udhëzuar drejtë në rrugën e drejtë.

Vërseti: *"Në rrugën e atyre të cilëve Ti u ke u dhuruar mirësinë Tënde"* në fundin e Sures *El-Fatiha* shikon dhe orientohet tek ata të drejtë, tek ai karvan; kurse vërseti: *"Jo (në rrugën) e atyre që merituan zemërimin Tënd..." "dhe as në (rrugën) e atyre të cilët u humbën"* shikojnë kundërshtarët e tyre. Kjo pikë të cilën e shpjeguam është shpjeguar me qartësi në fundin e Sures *El-Fatiha*.

Aspekti i Tretë: Arsyeja për kërkimin në mënyrë të përsëritur për diçka e cila do të jepet me siguri është kjo: Gjëja e kërkuar, si *"Mekami Mahmud"* -Stacioni i Lavdërimit dhe i Lavdisë- është maja e diçkaje. Ajo është një degë e një të vërteteje të gjërë e cila përfshin të vërteta të larta e domethënëse si të vërtetën e *Mekamit Mahmud*. Është një frut i rezultatit më të madh të krijimit të universit. Të kërkosh nëpërmjet duasë majën, degën dhe frutin është të kërkosh në mënyrë indirekte realizimin e asaj të vërtete të gjërë, ekzistencën dhe ardhjen dhe realizimin e botës së përjetshme, e cila është dega më e madhe e pemës së krijimit, dhe kërkimi i realizimit të kijametit dhe Ringjalljes së të vdekurve që është rezultati më i madh i universit, dhe kërkimi i hapjes së Botës së Lumturisë.

Duke kërkuar dhe duke u lutur për këto, njeriu gjithashtu merr pjesë në adhurim dhe në duatë e të gjithë humanizmit, të cilat janë shkaku më i rëndësishëm i esencës së botës së lumturisë dhe i Xhennetit të përjetshëm. Këto dua të pakufishme janë gjithashtu të pakta në krahasim me këtë qëllim madhështor të pakufishëm.

Për më tepër, dhënia e *Mekamit Mahmud* Hazreti Muhammedit a.s.m. është një tregues për Shefaatin e tij më të madh për të gjithë ummetin e tij. Atëherë Ai është i lidhur me lumturinë e të gjithë ummetit të tij.

Prandaj është thjesht urtësi e pastër kërkimi i tij bekime e dua të pafundme për mëshirë për të nga i gjithë ummeti i tij.

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti, Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".

. . .

RREZJA E SHTATË
SHENJA MË E MADHE

Një paralajmërim i rëndësishëm dhe një sqarim

Jo gjithësecili do të jetë në gjendje t'i kuptojë të gjitha çështjet e diskutuara në këtë trajtesë tepër të rëndësishme, por askush nuk do të mbetet pa pjesë prej saj. Në qoftë se dikush do të hynte në një kopësht të madh, ai do të gjente se duart e tij nuk do t'i arrinin të gjitha frutat që ai përmban, por sasia që do të binte brenda kapjes së tij do të ishte e mjaftueshme për të. Kopshti nuk ekziston vetëm për të; ai ekziston gjithashtu edhe për ata krahët e të cilëve janë më të gjatë se të tijat.

Ndodhen pesë shkaqe të cilat e bëjnë të vështirë të kuptuarin e këtij libri.

Së pari: Unë i kam shkruar vëzhgimet e mia ashtu siç m'u shfaqën në përputhje me kuptimin tim, dhe i shkrova për veten time; unë nuk i

kam shkruar ato në përputhje me nivelin e të kuptuarit dhe konceptimit të të tjerëve, siç është rasti me trajtesat e tjera.

Së dyti: Meqenëse pohimi i vërtetë i Unitetit Hyjnor është shtjelluar në këtë libër, në formën më gjithëpërfshirëse, në sajë të manifestimit të Emrit më të Madh, temat e diskutuara janë shumë të gjëra, tepër të thella dhe ndonjëherë shumë të gjata. Prandaj, jo gjithkush mund t'i përfshijë këto çështje menjëherë.

Së treti: Meqenëse çdo çështje përbën një të vërtetë të madhe e të shtrirë, një fjali e vetme zgjatet mbi të gjithë faqen ose edhe më shumë, me qëllim që të mos thyhet e të mos copëzohet e vërteta në çështje. Një provë e vetme kërkon parathënie të shumta.

Së katërti: Meqenëse shumica e çështjeve të përfshira në këtë libër kanë prova dhe dëshmi të shumta, ndonjëherë diskutimi bëhet i zgjatur në fjalë nëpërmjet përfshirjes së dhjetë ose njëzet provave me anë të demonstrimit. Aftësitë e kufizuara mendore nuk mund ta kapin këtë.

Së pesti: Është e vërtetë se dritat e kësaj trajtese më erdhën nga shkëlqimi i muajit të bekuar të Ramazanit; veçse kjo u shkrua me nxitim dhe u mjaftova me draftin e parë. Meqenëse vuaja prej sëmundjeve, lodhjeve të ngushtësive nga drejtime të ndryshme dhe meqenëse ndjeja se ato vinin në zemrën time pa zgjedhjen dhe pa vullnetin tim, unë nuk e pashë të përshtatshme që t'i prekja, t'i rregulloja apo t'i korrigjoja ato që kisha shkruar, sipas mendimeve të mia. Prandaj trajtesa mori këtë formë e cila e ndërlikon dhe e vështirëson të kuptuarin e saj. Përveç kësaj, një numër paragrafesh në arabisht u larguan -u shuan- dhe Stacioni i Parë i shkruar tërësisht në arabisht, u hoq e u bë në një vepër të ndarë.

Pavarësisht mangësive dhe vështirësive që burojnë nga këto pesë shkaqe, kjo trajtesë ka një rëndësi të tillë saqë Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, në mënyrë të mrekullueshme parashikoi hartimin e saj dhe i dha asaj emrat ***El Ajetul Kubra,*** *Shenja më e Madhe* dhe ***Asa Musa*** *Shkopi i Musait*. Ai e pa këtë pjesë të Risale-i Nurit me nderim të veçantë, dhe e drejtoi shikimin e njeriut drejt saj.[65]

---

[65] Ngjarja që ndodhi në Denizli e konfirmon plotësisht parashikimin e Imam Aliut lidhur me ***El-Ajetul Kubra***. Sepse botimi i fshehtë i këtij libri qe shkaku i burgimit tonë, dhe triumfi i së vërtetës së saj të shenjtë e më të fuqishme ishte shkaku kryesor për pafajësinë dhe lirimin tonë. Kështu Imam Aliu shfaqi parashikimin e tij të mrekullueshëm dhe provoi pranimin e duasë që ai bëri në emër të *"Nëpërmjet **El-Ajetul Kubra** na siguro prej vdekjes së befasishme!"*.

Kjo trajtesë është një e vërtetë prej të vërtetave të ***El-Ajetul Kubra*** dhe një koment i saj; ajo në të njëjtën kohë përbën Rrezen e Shtatë, të emëruar nga Imam Aliu si "*Shkopi i Musait*".

Kjo trajtesë përbëhet nga një parathënie dhe dy stacione. Parathënia shtjellon katër çështje të rëndësishme; Stacioni i parë shpjegon nëpërmjet gjuhës arabe komentin e vërsetit më të madh;

Stacioni i dytë shpjegon provat e Stacionit të parë dhe i sqaron e i provon ato.

Shumë është shpjeguar në parathënien vijuese, por nuk ishte qëllimi im për ta zgjatur atë kështu; ajo nuk ishte me zgjedhjen time. Fakti që ajo u shkrua në këtë gjatësi tregon ekzistencën e një nevoje. Madje, disa njerëz mund ta vlerësojnë atë si shumë të shkurtër, pavarësisht gjatësisë së saj.

Said Nursi

PARATHËNIE

"Dhe Unë (Allahu) nuk i krijova njerëzit dhe xhindët, veçse që ata duhet të më adhurojnë vetëm Mua".[66]

Sipas kuptimit të këtij vërseti madhështor, qëllimi për dërgimin e njeriut në këtë botë dhe urtësia e nënkuptuar në të, përbëhet nga njohja e Krijuesit të të gjitha qënieve, besimi në Të dhe kryerja e adhurimit ndaj Tij. Dhe detyra e tij e natyrshme dhe obligimi që i takon atij janë: Të njohë Zotin, t'i besojë Atij; dhe ta pranojë e ta besojë ekzistencën dhe unitetin e Tij me nënshtrim dhe me siguri të plotë.

Po, njeriu i dobët i cili nga natyra e do jetën e vazhdueshme të amshuar dhe ekzistencën e pavdekshme; i cili ka shpresa të pakufishme dhe dhimbje të pafundme, duhet medoemos që të gjitha gjërat, objektet dhe plotësitë të jenë të papërfillshme e të parëndësishme për të, madje shumica e tyre të mos ketë asnjë vlerë për t'u përmendur, përveç besimit në Zotin dhe njohjes së tij dhe përveç mjeteve të cilat e çojnë atë për dore tek ai besim i cili është themeli bazë i asaj jete të amshuar dhe çelësi i saj.

Dhe meqenëse kjo e vërtetë është provuar me dëshmi të forta dhe me qartësi të plotë në Risale-i Nur, ne ia referojmë atij shpjegimin e saj duke shtjelluar këtu brenda '*Katër Çështjeve'*, vetëm dy humnera që trondisin sigurinë e besimit në këtë shekull, dhe që çojnë në ngurim e turbullim.

Mjetet për të shpëtuar prej ***humnerës së parë*** janë këto dy çështje:

Çështja e parë:

Ashtu siç është provuar në mënyrë të hollësishme në Shkreptimën e Trembëdhjetë të Letrës së Tridhjetë e Një, "në çështjet e përgjithshme mohimi nuk ka vlerë përballë provës dhe ai është shumë i dobët". Për shembull, lidhur me shikimin e hënës së Re në fillimin e muajit të bekuar të Ramazanit, në qoftë se dy dëshmitarë prej njerëzve të zakonshëm e provojnë shfaqjen e hënës së re nëpërmjet shikimit e dëshmimit të tyre, dhe me mijëra fisnikë e dijetarë e mohojnë -shikimin e hënës së re- duke thënë: "Ne nuk e kemi parë hënën", mohimi i tyre është i pavlefshëm dhe pa fuqi për të bindur. Kur është një çështje prove -vërtetimi- çdo person përforcon dhe mbështet tjetrin, dhe rezulton konsensus. Por kur është një çështje mohimi, nuk ka ndryshim apo dallim në të nëse mohimi ka buruar nga një person apo nga një mijë persona; secili person mohues mbetet i vetmuar dhe i

[66] Kuran 51:56

izoluar. Sepse ai i cili provon a vërteton shikon përtej vetvetes, sheh pikërisht çështjen dhe pastaj e gjykon atë ashtu siç është. Atëherë, ashtu si në shembullin që ne dhamë, në qoftë se dikush thotë "Hëna është në qiell", dhe pastaj shoku i tij e drejton gishtin e tij drejt hënës, të dy ata bashkohen e forcohen; gjykimi i tyre përforcohet e rrënjoset. Ndërsa në mohim dhe në refuzim, mohuesi nuk e shikon çështjen ashtu siç është, madje ai është i pamudur për të bërë kështu. Prandaj është një parim i mirënjohur që thotë: "Nuk mund mund të provohet një mohim vendi i të cilit është i papërcaktuar -i paspecifikuar".

Për shembull, në qoftë se unë pohoj ekzistencën e një gjëje në botë, dhe ti e mohon atë, unë me lehtësi mund ta vërtetoj ekzistencën e saj me një tregues të vetëm. Por për ty që ta justifikosh mohimin tënd, domethënë të vërtetosh mosekzistencën e asaj gjëje- do ishte e domosdoshme të kërkosh plotësisht nëpërmjet të gjithë botës, dhe madje do të të duhej që ti të zhyteshe në thellësitë e kohëve të shkuara duke kontrolluar në çdo aspekt të tyre. Vetëm atëherë ti mund të thuash: "Ajo nuk ekziston dhe kurrë nuk ka ekzistuar".

Meqenëse ata të cilët mohojnë e refuzojnë nuk e shohin çështjen ashtu siç është, por gjykojnë sipas nefseve të tyre, në përputhje me mendjet dhe me pikëpamjet e tyre, ata në asnjë mënyrë nuk mund ta përforcojnë e mbështesin njëri-tjetrin. Sepse perdet e shikimit tek ata janë të ndryshme dhe shkaqet penguese për njohjen janë të shumëllojshme tek ta. Çdonjëri mund të thotë: "Unë nuk e shoh filan gjë; prandaj në mendimin dhe në besimin tim, ajo nuk ekziston". Por askush nuk mund të thotë: "Ajo në fakt nuk ekziston". Në qoftë se dikush do ta thonte këtë mohim -sidomos në çështjet e besimit të cilat përfshijnë gjithë universin- fjala e tij do të ishte një shpifje e madhe dhe një gënjeshtër aq e madhe sa dynjaja; ai që do ta thoshte këtë, nuk do të ishte në gjendje as të flasë të vërtetën dhe as nuk do të mundej kurrë të drejtohej e të ndreqej.

Shkurtazi: Rezultati në rast pohimi -vërtetimi- është një dhe i vetëm dhe në të ka mbështetje; çdo shembull pohimi i mbështet të gjithë shembujt e tjerë. Ndërsa në mohim -në refuzim- rezultati nuk është një dhe i vetëm por i shumëfishtë -i përbërë. Shumësia -numri i madh- buron nëpërmjet thënies së çdo personi lidhur me vetveten, "në mendimin tim dhe në shikimin tim", ose "në besimin tim" e të tjera të ngjashme me këto prej shkaqeve të cilat pengojnë shikimin e saktë. Dhe kjo çon në shumësi dhe në ndryshim sipas ndryshimit të personave. Për këtë arsye rezultatet vijnë gjithashtu të shumëfishta. Prandaj nuk ndodh absolutisht mbështetje; një shembull i ndarë nuk

mund t'i mbështesë të gjithë shembujt e tjerë. Dhe kështu, duke u nisur nga ky realitet, nuk ka vlerë apo rëndësi në shumësinë e dukshme të mosbesimtarëve dhe të mohuesve të cilët kundërshtojnë besimin..

Por në kohën që nuk duhet të ndikohet siguria dhe besimi i besimtarit dhe nuk duhet të përzihet besimi i tij me asnjë lloj dyshimi e ngurrimi, ne shohim se filozofët e Europës po ngjallin dyshime dhe mohime në këtë shekull dhe u ka shkaktuar turbullim e konfuzion disa fatkëqinjve të joshur marrëzisht pas tyre; dhe kështu shkatërruan sigurinë e tyre, zhdukën lumturinë e tyre të përjetshme dhe i bënë të bien në mjerim.

Sepse ky mohimi i tyre e transformoi kuptimin e vdekjes, e cila godet në çdo ditë tridhjetë mijë njerëz, nga kuptimi i saj i vërtetë që është: përfundimi i detyrës së njeriut në tokë, në kuptimin e ekzekutimit të përjetshëm dhe të asgjësimit përfundimtar dhe fundit të frikshëm e të tmershëm. Dhe u bë varri -dera e të cilit nuk mbyllet- të helmosë kënaqësitë e atij mohuesi dhe ia turbullon jetën me dhimbjet dhe me brengat më të hidhura duke e kërcënuar vazhdimisht atë me ekzekutimin e tij të përjetshëm. Atëherë kupto nga kjo se sa i madh është besimi! Dhe sa e madhe është mirësia e tij! Dhe kupto se si ai është jetë për jetën!

Çështja e dytë:

Lidhur me një çështje problematike për t'u diskutuar në shkencë ose në art, ata të cilët qëndrojnë jashtë asaj shkence apo arti nuk mund të flasin me siguri të plotë e me autoritet sado të mëdhenj, të ditur dhe të shquar që ata mund të jenë; dhe as gjykimet e tyre nuk mund të pranohen si vendimtare në atë çështje. Ata nuk mund të përfshihen brenda konsensusit të dijetarëve të asaj shkence.

Për shembull, gjykimi i një inxhinieri të madh në diagnostikimin dhe në kurimin e një sëmundjeje nuk ka të njëjtën vlerë as me atë të doktorit më të ulët. Prandaj nuk merren në konsideratë fjalët e mohimit që burojnë nga filozofi më i madh lidhur me çështjet shpirtërore dhe nuk ka peshë, dhe në mënyrë të veçantë fjala e atij që është zhytur thellë në sferën materiale, i cili në mënyrë të vazhdueshme bëhet më i larguar nga jolëndorja apo shpirtërorja dhe më i pagdhendur dhe më i pandjeshëm ndaj dritës -mendja e të cilit është e kufizuar tek ajo që shohin sytë e tij-, fjalët e një njeriu të tillë janë të padenja për t'u marrë në konsideratë dhe janë të pavlefshme lidhur me çështjet jomateriale -shpirtërore.

Për çështjet e shenjta dhe shpirtërore dhe për ato që lidhen me unitetin Hyjnor ka një pajtueshmëri të plotë mendimi midis qindra e mijërave prej njerëzve të së vërtetës, të tillë si Shejh Gejlani, iu shenjtëroftë sekreti i tij, i cili pa Fronin Sublim të Zotit ndërsa ishte akoma në tokë, dhe i cili harxhoi nëntëdhjetë vite duke përparuar në punën shpirtërore derisa i zbuloi të vërtetat e besimit në të tre stacionet e sigurisë: 'me njohjen e sigurisë', 'me shikimin e sigurisë' dhe 'me vërtetësinë e sigurisë'.

Duke qenë çështja kështu, çfarë vlere kanë fjalët e filozofëve të cilët nëpërmjet zhytjes së tyre në detajet më të shpërndara të botës materiale dhe në aspektet më të vogla e më të holla të shumësisë janë të mbytur e të trullosur? A nuk janë të mbytura mohimet dhe kundërshtimet e tyre si zëri i një mushkonje nga gjëmimi i rrufesë?

Esenca e mosbesimit që kundërshton të vërtetat e Islamit dhe lufton kundra tyre është mohim, injorancë dhe refuzim. Edhe në qoftë se ajo do të shfaqej -në anën e jashtme- si një pohim a vërtetim i ndonjë lloji dhe si një manifestim i qënies, ajo në realitet është mohim e mosqënie.

Ndërsa *Besimi* është njohje dhe manifestim i qënies; ai është një pohim dhe një gjykim. Madje edhe çështjet negative të besimit janë perde për një të vërtetë pozitive dhe si një titull për të -janë si një derë për tek një e vërtetë pozitive si dhe një perde duke e mbuluar atë.

Në qoftë se mosbesimtarët të cilët luftojnë kundra besimit do të përpiqeshin -me vështirësi të mëdha- të pohojnë a vërtetojnë besimet e tyre negative dhe t'i bëjnë ato të pranueshme në formën e 'pranimit të mosqënies', dhe të 'vërtetimit të mosqënies', atëherë ai mohim -mosbesim- i tyre mund të konsiderohet -nga një aspekt- si një formë njohjeje e gabuar dhe si një gjykim i gabuar -jo i saktë.

Por ama ajo që është shumë e lehtë për t'u kryer nga thjesht 'mospranimi', nga 'mohimi' dhe nga 'mosvërtetimi' është veçse injorancë absolute dhe një mungesë e plotë gjykimi.

Përmbledhja:

Besimi në mohim është dy llojesh:

I pari është ai që nuk ka lidhje dhe nuk i vlerëson të vërtetat e islamit; ai është një vërtetim i gabuar, një besim i pabazë, një pranim i gabuar dhe një gjykim i padrejtë tipik për të. Ky lloj mohimi është jashtë sferës së diskutimit tonë. Ai nuk ka lidhje me ne dhe ne nuk kemi asnjë lidhje me të.

Lloji i dytë kundërshton të vërtetat e besimit dhe lufton kundra tyre. Edhe ky gjithashtu është dy llojesh:

I pari është refuzim dhe mospranim; ai është thjesht mospranim apo mosmiratim për pohim -për vërtetim. Ky mohim është veçse injorancë, vetëm se mosgjykim -asnjë gjykim nuk përfshihet në të- dhe ai ndodh me lehtësi. Edhe ky gjithashtu është jashtë sferës së gjykimit tonë.

I dyti është pranimi i mosqënies, dhe panimi -miratimi- me zemër i mosqënies. Ky lloj mohimi është gjykim; është një besim që e çon personin në detyrim. Dhe ai detyrohet të pohojë a vërtetojë mohimin dhe refuzimin e tij.

Mohimi përmban dy lloje:

I pari: që mohuesi thotë: Filan gjë nuk ekziston në një vend të veçantë dhe as në një drejtim të veçantë. Ky lloj mohimi i përcaktuar mund të provohet; edhe ai është jashtë diskutimit tonë.

Lloji i dytë: është refuzimi dhe mohimi i çështjeve të shenjta, të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse të besimit, të cilat orientohen dhe lidhen me këtë dynja, që përfshijnë universin, shikojnë tek Ahireti dhe përfshijnë shekujt e ndryshëm. Ky mohim -ashtu siç e kemi treguar në çështjen e parë- nuk mund të provohet në asnjë mënyrë; sepse kjo do të bënte të domosdoshme që të ndodhej një shikim gjithëpërfshirës për universin, një vështrim i gjithanshëm për Ahiretin dhe një vizion depërtues që të shikonte çdo aspekt të kohës pa kufi; me qëllim që të vërtetohej si shembulli i këtij mohimi.

Humnera e dytë **dhe mjeti për të shpëtuar prej saj:** Kjo gjithashtu përbëhet nga dy çështje:

E para: Mendjet që janë bërë të ngushta për shkak të neglizhencës ose të mëkateve ose si rezultat i zhytjes në botën materiale, nuk janë në gjendje të kapin çështjet e mëdha lidhur me '*Madhështinë', 'Lartësinë'* dhe me '*Pafundësinë*'; prandaj -këto mendje- duke u krenuar me njohjen që ato kanë, rrëshqasin e bien në mohim e përgënjeshtrim. Meqenëse ato nuk mund t'i përfshijnë çështjet shumë të gjëra, të thella dhe të gjithanshme të besimit brenda mendjeve të tyre të ngushtuara e të kufizuara dhe zemrave të tyre të prishura e të vdekura -shpirtërisht-, ata e hedhin vetveten në mosbesim dhe në çudhëzim dhe mbyten.

Por në qoftë se këta do të ishin në gjendje të shikonin tek natyra e vërtetë e mosbesimit të tyre dhe tek esenca e çudhëzimit të tyre, ata do të shihnin se, ajo që është e arsyeshme në besim ndaj 'mdhështisë', e

përshtatshme me të dhe e domosdoshme për të, përballet me mosbesimin e tyre i cili i fsheh dhe përmban absurditete dhe pamundësi të shumëfishta.

Risale-i Nuri e ka provuar këtë të vërtetë me qindra krahasime me të njëjtin përfundim si '*dy edhe dy bëjnë katër'*. Për shembull, ai që nuk pranon besimin në domosdoshmërinë e Ekzistencës së Tij xh.sh., në Parapërjetësinë e Tij dhe në Atributet e Tij gjithëpërfshirës, në llogari të madhështisë dhe të lartësisë së tyre, ai do t'ua përshkruante e atribuonte domosdoshmërinë e ekzistencës, parapërjetshmërinë e Tij xh.sh. dhe Atributet Hyjnore numrit të pakufishëm të qënieve, madje atomeve të pafundmë, me qëllim që të mund të besonte mohimin e tij; ose ai do të duhej të hiqte dorë nga mendja ashtu si sofistët idiotë duke mohuar vetë ekzistencën e tij dhe duke mohuar edhe ekzistencën e universit.

Kështu të gjitha të vërtetat e besimit dhe të islamit, duke i mbështetur çështjet e tyre tek 'madhështia' dhe tek 'lartësia' -të cilat janë kërkesat e atyre të vërtetave- dhe duke u vendosur në zemrat e pastërta dhe në mendjet e shëndosha me bindjen më të plotë dhe me nënshtrimin më të madh, i shpërtojnë personat e tyre nga absurditetet e mëdhaja, nga bestytënitë e tmerrshme dhe nga injoranca e errët e mosbesimit të cilat i konfrontojnë ata.

Po, madhështia dhe lartësia janë dy perde të domosdoshme; kjo bëhet e qartë nga shpallja e asaj Madhështie dhe Lartësie në çdo kohë:

Në thirrjen e *Ezanit,* në namaz dhe në shumicën e riteve islame duke deklaruar e përsëritur:

Allahu Ekber... Allahu Ekber... Allahu Ekber... Allahu Ekber...

Dhe gjithashtu ajo shpjegohet në hadithin Kudsi: *"Madhështia është mburoja (mbulesa) ime dhe Lartësia është manteli Im";* dhe shfaqet gjithashtu në pjesën e tetëdhjetë e gjashtë të *Xhaushan El-Kebir* në komunikimin më të inspiruar të Profetit Muhammed a.s.m. me Krijuesin xh.sh. ku shprehet:

O Ti që përveç Mbretërisë Tënde asnjë mbretëri tjetër nuk ekziston;

O Ti që Lavdërimet e Tua nuk mund të numërohen nga shërbëtorët e Tu;

O Ti që lavdia Jote nuk mund të përshkruhet nga krijesat e tua;

O Ti që Plotësia Jote shtrihet përtej të gjitha vizioneve;

O Ti që Atributet e Tua kalojnë limitet e të gjitha kuptimeve - kapjeve;

O Ti që Madhështia Jote është përtej kapjes së të gjithë mendimit;

O Ti që Cilësitë e Tua nuk mund t'i përshkruajë njeriu në mënyrë të përshtatshme;

O Ti që Dekretin -Vendimin- Tënd nuk mund ta zmbrapsin shërbëtorët e Tu;

O Ti që shenjat e Tua shfaqen në çdo gjë;

Qofsh i Lavdëruar; nuk ka zot tjetër përveç Teje - mbrojtje, mbrojtje, na shpëto ne nga zjarri!

. . .

SHENJA MË E MADHE

Vëzhgimet e një udhëtari i cili pyet universin lidhur me Krijuesin e tij

Me Emrin e Allahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"*E lavdërojnë dhe e ngrenë në lavdi e madhështi Atë shtatë qiejt dhe toka dhe gjithë ç'është në ta dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij,por ju nuk e kuptoni lavdërimin e tyre. Me të vërtetë që Ai është i Gjithëdurueshëm dhe Fajfalës"*[67]

[Ky stacioni i Dytë, përveç shpjegimit të këtij 'vërseti më të madh' shtjellon e sqaron gjithashtu provat dhe argumentet e stacionit të parë të cilin e përmban dhe i cili erdhi në gjuhën arabe]

Meqenëse ky vërset më i madh, ashtu si shumë vërsete të tjerë të Kuranit, përmend së pari qiejt -atë faqe të shndritshme- duke shpallur Unitetin e Zotit dhe duke bërë të njohur Krijuesin e këtij kozmosi, pasi ajo faqe e mbush me habi, me admirim e me gëzim cilindo hulumtues e studiues që e vështron atë, edhe ne gjithashtu le të fillojmë me një përmendje të qiejve.

Në të vërtetë, çdo udhëtar i cili vjen në bujtinën dhe në mbretërinë e kësaj dynjaje sa herë që hap sytë e vështron, sheh një bujtinë e cila i ngjason një gostie me bujari të skajshme, një ekspozite në shkallën më të skajshme të përsosmërisë artistike, një fushimi stërvitjeje shumë madhështor, një vendi të çuditshëm e të mahnitshëm zbavitjeje, një

[67] Kuran 17:44

vendi që të ngjallë kënaqësinë dhe përmallimin më të skajshëm dhe një libri të hapur kuptimplotë me një elokuencë e urtësi të skajshme. Mysafiri udhëtar pyet veten gjithashtu se kush është pronari i kësaj bujtine bujare dhe Autori i këtij Libri të madh dhe kush është Sulltani i kësaj mbretërie madhështore.

Së pari prezantohet tek ai faqja e bukur e qiejve, e skalitur dhe e shkruar me shkronjat e praruara të yjeve. Ajo faqe e thërret atë duke i thënë:

"Më shih mua! Unë do të të bëj të njohur Atë që ti kërkon." Udhëtari hedh vështrimin dhe sheh se një manifestim i Hyjnisë është duke kryer detyra të ndryshme në qiej: ai manifestim shfaqet në ngritjen e qindra mijëra prej trupave qiellorë duke i mbajtur ata lartë pa asnjë shtyllë mbështetëse; disa prej atyre trupave janë një mijë herë më të mëdhenj se sa toka jonë, dhe rrotullohen shtatëdhjetë herë më shpejt se sa një gjyle topi.

-Ai manifestim shfaqet- në bërjen e tyre të lëvizin në harmoni dhe me shpejtësi të jashtëzakonshme pa u përplasur me njëri-tjetrin;

-Ai manifestim shfaqet- në bërjen e atyre llambave e kandilave të panumërt të ndizen në mënyrë të vazhdueshme, pa përdorimin e ndonjë lënde djegëse, pa vaj, dhe duke mos u shuar..

-Ai manifestim shfaqet- në drejtimin e këtyre masave të mëdha të pakufishme pa ndonjë zhurmë, pa çrregullim e pështjellim.. ai e sheh gjithashtu manifestimin e asaj Hyjnie në nënshtrimin e atyre krijesave madhështore në detyra të caktuara ashtu si nënshtrimi i diellit dhe i hënës në kryerjen e detyrave të tyre përkatëse pa i braktisur ato dhe pa vonesë..

-E sheh- në administrimin e këtij numri të madh të cilin nuk e përkufizojnë shifrat brenda asaj hapësire të pafundme që shtrihet nga poli në pol, administrim i cili ndodh në të njëjtën kohë, me të njëjtën fuqi, në të njëjtin model, me të njëjtën mënyrë të natyrshme, në të njëjtën formë, të bashkuara, dhe pa mangësinë apo defektin më të vogël..

Atë e tmerroi ajo çfarë pa prej manifestimit të Hyjnisë në nënshtrimin e atyre planetëve madhështorë të cilët kishin fuqi agresive, duke i bërë ato të nënshtruara e të bindura ndaj ligjeve të Saj pa tejkaluar caqet dhe pa u shmangur.. dhe në pastrimin dhe shkëlqimin e faqes së qiejve, duke hequr të gjithë mbeturinat dhe hedhurinat e atij grumbullimi të madh...

Në bërjen e atyre trupave të manovrojnë si një ushtri e disiplinuar.. dhe pastaj duke e bërë tokën të rrotullohet, i shfaq qiejt në çdo natë e në çdo ditë në një formë të ndryshme, ashtu si një ekran kinemaje duke shfaqur skena të vërteta dhe imagjinuese para krijesave spektatore.

Ndodhet brenda këtij aktiviteti Hyjnor një e vërtetë madhështore e përbërë nga: *Nënshtrimi, Administrimi, Rrotullimi, Rregullimi, Pastrimi* dhe *Punësimi- vënia në punë.* Kjo e vërtetë me madhështinë dhe me gjithëpërfshirjen e saj dëshmon për domodoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit të atyre qiejve dhe për unitetin e Tij, dhe dëshmon -ashtu siç shihet- se ekzistenca e Tij xh.sh. është më e qartë se sa ekzistenca e atyre qiejve.

Ky kuptim u përmend në shkallën e Parë të Stacionit të Parë:

La i lahe il-lall-llahu El-Vaxhibu El-Vuxhud...

. . .

Pastaj hapësira e cila është vendtubimi i çudirave dhe ekspozita e gjërave të jashtëzakonshme e njohur si '*Atmosfera*' i thirri me një zë gjëmimtar atij mysafiri udhëtar të ardhur në dynja duke thënë:

"Më shih mua! Ti mund të zbulosh e të gjesh nëpërmjet meje Atë që ti kërkon me mallëngjim e dëshirë të fortë, dhe unë të njoh me Atë i Cili të ka dërguar ty këtu."

Ai hedh vështrimin tek fytyra e errët e hapësirës ndërsa ajo pikonte mëshirë! Dhe dëgjon zërin e saj të frikshëm e të tmerrshëm por që mban nektarin e sihariqeve! Dhe shikon se:

'Retë' që qëndrojnë pezull midis qiellit dhe tokës, e ujisin kopshtin e botës në mënyrën më të urtë dhe të mëshirshme; i furnizojnë banorët e tokës me ujin e jetës, zbusin e ulin nxehtësinë e natyrshme të jetës, dhe shpejtojnë për të dhënë ndihmë kudo që të jetë e nevojshme.

Megjithëse ato re të rënda e të mëdhaja përmbushin detyra të shumta si shembulli i këtyre, ato fshihen e davariten menjëherë pasi kanë mbushur hapësirën.

Të gjitha pjesët e tyre tërhiqen për të pushuar në një mënyrë që nuk mund të shihet asnjë gjurmë e tyre, tamam si një ushtri e rregullt dhe e mirëdisiplinuar e cila e shfaq dhe e fsheh vetveten në përputhje me urdhërat e befasishme. Por sapo të marrin urdhërin: "*Ejani dhe lëshoni shi!",* ato bashkohen dhe e mbushin atmosferën për një orë, madje në disa minuta, dhe rrinë në gatishmëri të plotë duke pritur urdhëra të tjerë ashtu si ushtari që pret urdhrin e komandantit!

Pastaj udhëtari hedh vështrimin tek ‘era’ në atmosferë dhe sheh se ajri vihet në punë me urtësi dhe me bujari të skajshme në detyra të tilla të shumta saqë sikur secila prej atyre atomeve të pashpirta të atij ajri të pavetëdijshëm të dëgjonte e të kuptonte urdhërat që vijnë tek ai prej Sulltanit të këtij universi. Ai i kryen detyrat e tij nëpërmjet fuqisë dhe mbisundimit të Atij Urdhëruesi dhe i zbaton ato në mënyrë të rregullt duke mos neglizhuar asnjërën prej tyre. Kështu ai u jep frymëmarrje duke i mbushur me frymë të gjitha qëniet dhe u përcjell të gjitha gjallesave tingujt dhe lëndët e domosdoshme si nxehtësinë, dritën dhe elektricitetin; po ashtu ndërmjetëson e ndihmon në pjalmimin e bimëve, si dhe kryen detyra të tjera të shumta të ngjashme me këto. Kështu, era -ajri- vihet në punë tek të gjitha këto detyra nëpërmjet një Dore të padukshme që ka vetëdijen me njohjen, vitalitetin dhe forcën më të skajshme.

Pastaj udhëtari hedh vështrimin tek ‘Shiu’ dhe shikon se brenda atyre pikave të holla të ndritshme e të ëmbla të cilat dërgohen prej një thesari të fshehur mëshire, ndodhen aq shumë dhurata mëshireje dhe detyra të shumta të përfshira saqë është sikur vetë mëshira e dhuruar të mishërohej e të merrte trajtë duke vërshuar prej burimeve të thesarit Hyjnor në formën e atyre pikave. Për këtë arsye shiu është quajtur ‘mëshirë’.

Pastaj udhëtari hedh vështrimin tek ‘vetëtima’ dhe dëgjon ‘rrufenë’, dhe sheh se të dyja këto vihen në shërbim në detyra shumë të çuditshme.

Pastaj kthen shikimin tek mendja e tij dhe thotë: Kjo re e pajetë dhe e pavetëdijshme, që i ngjason pambukut të gërhanuar, natyrisht nuk na njeh ne; kur ajo vjen për të na ndihmuar, kjo nuk ndodh për shkak se ajo ka dhembshuri për ne dhe i vjen keq për gjendjen tonë. Ajo nuk mund të shfaqet e të fshihet pa marrë urdhëra. Përkundrazi ajo vepron në përputhje me urdhërat e një komandanti të Gjithëfuqishëm Absolut dhe Një Mëshirëploti Absolut; pasi ajo fshihet e zhduket pa lënë asnjë gjurmë dhe pastaj papritmas rishfaqet me qëllim që të fillojë punën e saj; dhe e mbush botën e atmosferës si dhe e boshatis atë nga koha në kohë duke zbatuar urdhrin e një Sulltani të Gjithëlavdishëm të Lartësuar dhe Veprues Aktiv; dhe shkruan në pllakën e qiellit vazhdimisht me urtësi dhe e fshin nëpërmjet heqjes duke e transformuar atë në një pllakë fshirjeje dhe vërtetimi dhe në një formë të zvogëluar të tubimit të ringjalljes dhe të kijametit. Reja u hip erërave me urdhrin e një Sundimtari Rregullator dhe Drejtuesi Gjithëbujar, Dorëgjerë, Mirëbërës dhe Përkujdesës duke mbajtur

thesaret e shirave të mëdha secili aq i rëndë sa një mal dhe shpejton për t'u ardhur në ndihmë vendeve të tokës që kanë nevojë për të. Është sikur reja të qante me keqardhje për gjendjen e tyre; me lotët e saj i bën lulet të buzëqeshin, zbut nxehtësinë e diellit, ujit kopshtet e botës dhe lan e pastron fytyrën e saj nga papastërtitë me qëllim që të shkëlqejë me pastërti e me bukuri.

Pastaj ai udhëtar kureshtar i thotë mendjes së tij: Ky ajër i pagjallë i cili nuk ka as jetë, as vetëdije, as qëndrueshmëri dhe as objektiv, që është në tronditje të vazhdueshme në shpërthim që nuk qetësohet, i stuhishëm dhe i lëkundur, vjen në ekzistencë dhe shfaqen për shkak të tij -dhe nëpërmjet formës së tij të jashtme- qindra mijra akte, detyra, mirësi e mbështetje të mbushura me urtësi, me mëshirë dhe me gjenialitet, gjë që në mënyrë të vetëkuptueshme provon se kjo erë e zellshme, kjo shërbëtore e palodhshme nuk vepron kurrë nga vetvetja; përkundrazi, ajo vepron në përputhje me urdhërat e një komandanti të Gjithëfuqishëm, të Gjithëdituri Absolut dhe të Një të Gjithurti Gjithëbujar Absolut.

Sikur secila prej grimcave të saj të kuptonte e të dëgjonte -ashtu si ushtari i bindur- çdo urdhër që lëshohet nga ana e Atij Komandanti; sikur secila grimcë të ishte e vetëdijshme për çdo detyrë të veçantë dhe i nënshtrohet çdo urdhëri Hyjnor që kalon përmes ajrit. Ajo i ndihmon të gjitha kafshët për frymëmarrje dhe për të jetuar; të gjitha pemët për pjalmim dhe për t'u rritur, dhe kultivon të gjitha lëndët e domosdoshme për mbijetesën e tyre. Ajo drejton dhe administron retë, bën të mundur lundrimin e anijeve me vela; mundëson përcjelljen dhe transmetimin e tingujve dhe të zërave, veçanërisht nëpërmjet radiofonisë, telefonave, telegrafëve dhe radiove, si dhe kryen edhe funksione të tjera të shumta universale.

Për më tepër, atomet e ajrit përbëhen nga lëndë të thjeshta si azoti dhe oksigjeni, dhe secili duke i ngjasuar tjetrit; unë shoh se ajo vihet në punë vetëm se nëpërmjet një Dore Urtësie dhe me rregull të plotë në qindra e mijëra prej trajtave të ndryshme të artit Hyjnor gjithandej globit.

Prandaj, udhëtari gjykoi duke thënë: "Në të vërtetë ashtu siç deklaroi qartë vëseti;

"...në ndryshimin e drejtimit të erërave dhe të reve që mbahen në rregull të disiplinuar mes qiellit dhe tokës..."[68]

[68] Kuran 2:164

Ai që urdhri i të Cilit kalon tek ajri dhe i Cili e përdor atë në shërbime e në detyra Hyjnore të pakufishme, nëpërmjet ndryshimit të drejtimit të erërave, dhe në vepra të pafundme mëshire, nëpërmjet nënshtrimit të reve, dhe i Cili e krijon ajrin në këtë formë, Një i Tillë mund të jetë vetëm se Krijuesi i Ekzistencës së domosdoshme, i Gjithëfuqishëm mbi gjithçka, i Gjithëditur për gjithçka; Zotëruesi i Lavdisë dhe i Bujarisë".

Ky është konkluzioni që nxori tani udhëtari ynë.

Pastaj ai e kthen shikimin e tij drejt 'shiut' dhe sheh se brenda tij përfshihen dobi aq të shumta aq sa pikat e shiut dhe manifestime Hyjnore aq të shumta sa grimcat e shiut, dhe shembuj urtësie aq të bollshëm sa atomet e tij.

Për më tepër, ai sheh se ato pika të ëmbëla, të holla e të bekuara janë krijuar në një mënyrë aq të bukur e të rregullt, saqë veçanërisht shiu i dërguar -që bie- në verë, dërgohet dhe bëhet të bie me një balancë e rregullsi të tillë saqë madje edhe erërat e stuhishme, të cilat i bëjnë objektet e mëdha të përplasen, nuk mund ta shkatërrojnë atë ekuilibër dhe as rregullin e tij.

Pikat nuk përplasen me njëra-tjetrën dhe as nuk bashkohen në një mënyrë të tillë duke u bërë masa të dëmshme uji. Uji duke u përbërë nga dy elemente të thjeshtë si hidrogjeni dhe oksigjeni, përdoret në qindra e mijëra detyra e arte të ndryshme të mbushura me urtësi e vetëdije.

Atëherë ky shi që është pikërisht mishërimi i mëshirës Hyjnore mund të jetë prodhuar vetëm se tek thesari i padukshëm i mëshirës së të 'Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit', dhe me rënien e tij shpjegon qartë në formë fizike vërsetin: *"Dhe Ai është i Cili zbret shiun (edhe) pasi ata kanë humbur çdo shpresë dhe e shpërndan mëshirën e Tij"*.[69]

Pastaj udhëtari dëgjon rrufenë dhe shikon vetëtimën. Ai kupton se këto dy ngjarje të çuditshme në atmosferë janë si një demonstrim material i vërsetit,

"Rrufeja madhëron e lavdëron Allahun",[70]
"Drita e fortë e vetëtimës së Tij gati verbon shikimin".[71]

Edhe këto gjithashtu njoftojnë ardhjen e shiut dhe kështu japin lajme të gëzueshme për nevojtarët.

---

[69] Kuran 42:28
[70] Kuran 13:13
[71] Kuran 24:43

Po, bërja e atmosferës së errët të flasë në mënyrë të befasishme me një tingull të mrekullueshëm, mbushja e qiellit të errët me një dritë që gati të verbon shikimin dhe me një zjarr që tmerron çdo krijesë dhe ndezja e reve të mëdha që u ngjasojnë maleve prej pambuku ose tubacioneve të ngarkuara me ujë e me borë -këto dhe fenomene të ngjashme me këto situata të urta të çuditshme, janë si goditje të dhëna në kokën e njeriut neglizhent, shikimi i të cilit është drejtuar poshtë tokës, dhe e zgjojnë atë duke thënë:

"Ngrije lart kokën tënde, shiko tek veprat e mrekullueshme dhe tek çudirat e Vepruesit Aktiv të Gjithëfuqishëm i Cili dëshiron që ta bëjë Veten të njohur tek shërbëtorët e Tij. Dhe ashtu siç nuk je i lirë të bredhësh sipas tekave të tua në këtë ekzistencë, po ashtu edhe këto fenomene e ngjarje nuk janë kot e pa qëllim; përkundrazi secila prej tyre shtyhet e bëhet të kryejë detyra të veçanta dhe të urta me bindje e nënshtrim dhe secila prej tyre vihet në punë prej një Krijuesi Rregullator të Gjithurtë.

Dhe kështu udhëtari kureshtar dëgjon një dëshmi të lartë dhe të dukshme për një të vërtetë që përbëhet nga nënshtrimi i reve, ndryshimi i drejtimit të erërave, rënia e shiut dhe nga administrimi i fenomeneve të atmosferës, dhe thotë:

Unë besova në Zotin...

Ajo që u pohua në shkallën e dytë të Stacionit të Parë shpreh vëzhgimet e udhëtarit në atmosferë:

La i lahe il-lall-llahu El-Vaxhibu El-Vuxhudi...

• • •

Pastaj 'globi tokësor' i adresohet atij udhëtari meditues, të cilit i është bërë tashmë zakon udhëtimi reflektiv. Globi i thotë nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tij:

"Përse ti po bredh nëpër ajër dhe endesh nëpër qiej dhe në hapësirë? Eja tek unë që të të bëj ty të njohur Atë të Cilin ti po kërkon. Shiko tek funksionet që unë kryej dhe lexoji faqet e mia!"

Ai hedh vështrimin dhe sheh se globi tokësor -ashtu si një mevlevi Ashik- me lëvizjen e tij të dyfishtë vijëzon -skicon- përreth fushës së tubimit më të madh një rreth që përcakton vijueshmërinë e ditëve, të viteve dhe të stinëve. Ajo -toka- është si një anije Hyjnore madhështore e ngarkuar me qindra e mijëra lloje të ndryshme ushqimesh dhe me pajime të nevojshme e të domosdoshme për të

gjitha qëniet e gjalla, duke lundruar me ekuilibrin më të madh në oqeanin e hapësirës dhe duke u rrotulluar rreth diellit.

Pastaj ai hedh vështrimin tek faqet e tokës dhe sheh se secila faqe prej kapitujve të saj shpallte dhe bënte të njohur Krijuesin e saj me mijëra vërsetet e saj... por duke qenë i pamundur dhe nuk gjeti kohë që t'i lexonte të gjitha faqet, ai e përkufizoi shikimin vetëm tek një faqe e vetme që merrej me krijimin dhe administrimin e qënieve të gjalla në pranverë dhe soditi sa vijon:

Format e anëtarëve të pallogaritshëm të qindra e mijëra specieve shfaqeshin, me saktësinë më të skajshme, nga një lëndë e thjeshtë dhe pastaj ushqeheshin në mënyrën më të mëshirshme. Pastaj, në mënyrë të mrekullueshme disa farërave u jepeshin krahë -fletë- të holla për të fluturuar dhe kështu ato shpërndaheshin. Ato shpërndaheshin në mënyrë të goditur, të saktë dhe ushqeheshin e mbështeteshin në mënyrën më të dhembshur e të mëshirshme. Lloje të bollshme të ndryshme të shijshme e të mira ushqimi u siguroheshin në mënyrën më të mëshirshme e të butë; ato silleshin nga asgjëja, nga dheu i thatë, nga rrënjët e forta si kockat, nga farërat e ngjashme me njëra-tjetrën dhe nga pikat e lëngut -ujit- të cilat ndryshojnë pak midis njëra-tjetrës, dhe njëqind mijë lloje ushqimesh dhe pajimesh të domosdoshme dërgoheshin prej thesarit të së padukshmes për tek gjallesat në çdo pranverë- si një vagon i ngarkuar treni- me rregullsinë më të skajshme. Dhe veçanërisht dërgimi i qumbështit të pastër të shijshëm duke çurguar prej burimeve të kraharorëve të dashura të nënave të mbuluara me dhembshuri, mëshirë e me urtësi si dhurata për të vegjëlit dhe fëmijët..

E gjitha kjo provon në mënyrë të vetëkuptueshme, se ky është një manifestim në skajin më të lartë të dhembshurisë dhe të mbështetjes me ushqim prej manifestimeve të mëshirës së të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë dhe të mirëbërësisë së Tij të përgjithshme.

Përmbledhja:

Kjo faqe e gjallë e pranverës së bukur shfaq shembuj e modele të Tubimit më të madh, dhe është një demonstrim konkret i këtij vërseti:

"Shihni pra tek pasojat -shenjat- e mëshirës së Allahut, se si Ai e ringjall tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht që (Allahu i Cili siç ringjalli tokën pas vdekjes së saj) do të ngrejë me siguri të vdekurit (Ditën e Ringjalljes) dhe Ai është i Gjithëfuqishëm për gjithçka".[72]

[72] Kuran 30:50

Për më tepër, mund të thuhet se ky vërset shpreh në mënyrë të mrekullueshme kuptimet e ardhura në këtë faqe, e cila është pranvera. Kështu, udhëtari kuptoi se toka nëpërmjet të gjitha faqeve të saj, në mënyrë të përpjesëtuar me përmasat dhe me fuqinë e tyre deklaron duke thënë:

"La i lahe il-la Huve", *"Nuk ka zot tjetër përveç Atij".*

Në shprehjen e kuptimit të vëzhguar nga udhëtari nëpërmjet dëshmisë së shkurtër të njërit prej njëzet aspekteve të një faqeje të vetme prej më shumë se njëzet faqeve të globit tokësor, u përmend në shkallën e Tretë të Sacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu.....]

. . .

Pastaj ai udhëtar reflektues sa herë që lexonte një faqe, forcohej besimi i tij i cili është çelësi i lumturisë, dhe i shtohej njohja e tij për Allahun e cila është çelësi për përparimin shpirtror, dhe iu zbulua intuitës -mendjemprehtësisë- së tij një shkallë tjetër prej të vërtetës së besimit në Allahun i cili është një bazë e fortë dhe burimi i të gjitha plotësimeve; gëzimi dhe kënaqësia e tij u shtuan dhe zelli i tij u nxit; dhe megjithëse kuptoi mësime të plota e bindëse prej qellit, atmosferës dhe tokës, ai kërkoi edhe më shumë. Pastaj ai dëgjoi jehonën e dhikrit -përmendjes së Zotit- të bërë me entuziazëm nga zhurma dhe trazira e deteve dhe e lumenjve të mëdhenj, dhe dëgjoi tingujt e tyre të dëshpëruar por të këndshëm. Në mënyra të shumta ata i thonin atij nëpërmjet gjuhës së gjendjes dhe të foljes: "Na shiko ne, lexoji gjithashtu edhe shenjat tona!".

Duke vështruar, udhëtari ynë pa sa vijon:

Detet duke çuar dallgë në mënyrë të vazhdueshme të fuqishme e jetike, të cilat nga pikërisht natyra e tyre bashkohen, shpërndahen, derdhen e mbysin, e kanë rrethuar globin tokësor. Ato të dyja -detet dhe toka- rrotullohen bashkarisht me një shpejtësi të skajshme dhe udhëtojnë në një vit të vetëm brenda një rrethi, gjërësia dhe distanca e të cilit është prej njëzet e pesë mijë vitesh.

Mirëpo, pavarësisht nga kjo, detet nuk shpërndahen kurrë, nuk derdhen absolutisht dhe nuk e cënojnë e nuk e shkelin fqinjen e tyre të thatë -tokën. Ato sigurisht lëvizin, qëndrojnë të qetë, ruhen e mbrohen nëpërmjet urdhërit të Atij që ka fuqi Absolute dhe madhështi Absolute.

Pastaj duke vështruar në thellësitë e detit, udhëtari pa se përveç gurëve të çmuar, xhevahirëve që kanë bukurinë, stolinë dhe simetrinë më të skajshme, ndodheshin mijëra lloje të ndryshme kafshësh që mbështeteshin me ushqime, administroheshin dhe përcaktoheshin lindjet dhe vdekjet e tyre duke ecur në mënyrën më të disiplinuar e të përkryer. Ardhja e ushqimeve dhe e furnizimeve të tyre nga rëra e thjeshtë dhe nga uji i kripur në mënyrë të lehtë e të plotë provon në mënyrë të vetëkuptueshme se kjo realizohet vetëm se nëpërmjet administrimit të të Gjithëmëshirshmit Zotërues të lavdisë dhe nëpërmjet dhënies së jetës dhe të furnizimeve nga ana e Mëshirëplotit Zotërues të bukurisë.

Pastaj udhëtari hodhi vështrimin tek 'lumenjtë' dhe pa se dobitë e natyrshme në to, funksionet që ato kryejnë dhe rimbushjet, rifurnizimet e tyre të vazhdueshme shkaktohen nga një urtësi e mëshirë e tillë saqë në mënyrë të pakundërshtueshme provojnë se të gjithë lumenjtë, burimet, rrëketë, curilat dhe kanalet e lundrueshëm burojnë e rrjedhin prej thesarit të të Gjithëmëshirshmit Zotërues të Lavdisë dhe të bujarisë. Madje ato ruhen, rezervohen e shpërndahen në mënyrë aq të jashtëzakonshme saqë thuhet në një hadith kuptimi i të cilit është: *"Katër lumenj rrjedhin nga Xhenneti"*.[73]

Domethënë vërshimi i këtyrë lumenjve është shumë përtej llogaritjeve të shkaqeve të jashtme, sepse ato rrjedhin e vijnë prej thesarit të një Xhenneti jolëndor të pasosur dhe prej bollëkut të madh të një burimi të padukshëm dhe të pashterur.

Për shembull lumi i bekuar i Nilit i cili e ka transformuar shkretëtirën e Egjiptit në një Parajsë të kësaj dynjaje buron prej një mali që ndodhet në jug i quajtur Mali i Hënës duke mos shteruar kurrë, sikur të ishte një det i vogël.

Në qoftë se uji që derdh lumi në gjashtë muaj do të grumbullohej bashkë në fomën e një mali dhe pastaj të ngrinte, ai do të ishte më i madh se ai mal. Por vendi ku mbahet e depozitohet uji në mal është më i vogël se sa një e gjashta e atij mali. Sa për ujin që rimbush e rifurnizon lumin, shiu që hyn në rezervuarin e lumit është shumë i pakët në atë zonë të nxehtë dhe gëlltitet e përpihet shpejt nga toka e etur dhe e djegur për ujë.

Kështu i gjithë ai grumbullim është i paaftë të mbajë e të ruajë ekuilibrin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të lumit. Prandaj u transmetua në hadith se Nili i bekuar rrjedh në mënyrë të

[73] Transmetoi Muslimi

mrekullueshme nga një Xhennet i padukshëm. Ky hadith ka një kuptim të thellë dhe shpreh një të vërtetë të bukur.

Dhe kështu udhëtari pa një dëshmi të vetme dhe një të vërtetë të vetme prej mijëra dëshmive dhe të vërtetave që janë aq të gjëra sa gjërësia e vetë deteve, dhe kuptoi se të gjithë ato deklarojnë e shpallin me unanimitet me fuqinë e madhështisë së tyre -deteve dhe oqeaneve- duke thënë:

"La i lahe il-la Huve", *"Nuk ka zot tjetër përveç Atij"*

Dhe u shfaqën para tij dëshmitarë aq të shumtë sa numri i krijesave në dete për vërtetësinë e kësaj dëshmie.

Duke shprehur e përcjellur dëshminë e deteve dhe të lumenjve, ne folëm në shkallën e katërt të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu...]

• • •

Pastaj malet, shkretëtirat dhe fushat i bëjnë ftesë atij udhëtari të zhytur në udhëtimin reflektiv duke i thënë: "Lexoji gjithashtu edhe faqet tona".

Ndërkaq ai me rolin e tij hodhi vështrimin dhe pa se funksionet universale të maleve dhe dobitë e tyre të përgjithshme janë prej një madhështie dhe fuqie të tillë saqë hutojnë mendjet.

Për shembull, shfaqja e maleve nga toka nëpërmjet urdhërit Hyjnor qetëson trazirën e tokës dhe lehtëson zemërimin, indinjatën dhe mllefin që burojnë nga zhurmat, turbullimet dhe trazirat brenda saj. Sapo malet të ngrihen lart, toka fillon të marrë frymë e rehatuar; dhe ajo shpëton prej dridhjeve, lëkundjeve dhe trazirave; dhe qetësia e saj, ndërsa ndjek detyrën e saj të rrotullimit, nuk prishet më. Ashtu siç ngrihen direkët dhe shtyllat në anije për t'i mbajtur ato nga lëkundja e mbytja dhe për të ruajtur ekuilibrin e tyre, po ashtu malet që janë direkë e shtylla me thesare për anijen e tokës e mbrojnë atë nga lëkundja, e bëjnë të qëndrueshme dhe ruajnë ekuilibrin e saj. Kurani Kerim e ka treguar këtë kuptim në shumë vërsete, dhe midis tyre janë këto:

"Dhe malet (i bëmë) si shtylla mbështetëse".[74]

"Dhe kemi vendosur në të male përforcues (që qëndrojnë fort)".[75]

---

[74] Kuran 78:7

[75] Kuran 50:7

Dhe malet Ai i ka ngulur fort".[76]

Dhe për shembull, ndodhen të depozituara dhe të ruajtura në male të gjitha llojet e burimeve, ujërave, mineraleve dhe materialeve të tjera për të cilat kanë nevojë të gjitha qëniet e gjalla në një mënyrë aq të urtë, të përkryer, bujare, rregulluese e parashikuese saqë në mënyrë të vetëkuptueshme provojnë se këto male janë magazina dhe depo rezervash nën urdhërin e një të Gjithëfuqishmi fuqia e të Cilit është e pafundme dhe të Një të Gjithurti urtësia e të Cilit është e pafundme.

Duke nxjerrë si përfundim prej këtyre dy shembujve funksionet e tjera dhe shembujt e urtësisë -aq të mëdhaja sa madhësia e maleve dhe sa gjërësia e fushave -udhëtari pa se malet dhe fushat dëshmojnë dhe shpallin unitetin Hyjnor duke deklaruar ***"La i lahe il-la Huve"****, "Nuk ka zot tjetër përveç Atij"* nëpërmjet gjuhës së të gjithë shembujve të urtësisë së të dyjave -maleve dhe fushave- dhe me gjuhën e të gjitha funksioneve të atyre të dyjave dhe veçanërisht mënyra e gjërave dhe e lëndëve duke u depozituar e duke u ruajtur në to për rezervë.

Ajo dëshmi dhe ajo shprehje e Unitetit Hyjnor janë aq të fuqishme e të forta si malet dhe aq të gjëra e të shtrira si fushat; dhe ai gjithashtu tha me devocion: "Unë besoj në Zotin".

Në shprehjen e këtij kuptimi u përmend në shkallën e pestë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El- Vaxhibul....]

. . .

Pastaj, ndërsa ai udhëtar po udhëtonte me mendjen e tij nëpër male e fusha, u hap përpara mendimit të tij dera e botës së 'pemëve dhe bimëve' e cila i bëri ftesë duke i thënë: "Eja tek ne, shëtit në kopshtin tonë dhe lexo reshtat tonë!". Ai u fut brenda dhe pa se pemët dhe bimët po mbanin një kuvend madhështor të shkëlqyer për *tehlil* dhe për *teuhid* -për të deklaruar Unitetin Hyjnor- dhe kishin formuar një rreth *dhikri* dhe *shukri* -për të përmendur e falënderuar Allahun.

Ai kuptoi nga gjuhët e gjendjeve të tyre sikur ato thonin bashkarisht dhe shpallnin me unanimitet ***"La i lahe il-la Huve",*** *"Nuk ka zot tjetër përveç Atij".* Sepse ai pa tre të vërteta të mëdhaja e të përgjithshme duke treguar e provuar se të gjitha pemët frutdhënëse dhe të gjitha bimët e lulëzuara bënin dëshminë e tyre duke bërë tesbihate dhe thonin bashkarisht nëpërmjet gjuhëve elokuente të gjetheve të tyre

[76] Kuran 79:32

simetrike, dhe nëpërmjet frazave fjalëshumë të luleve të tyre të bukura, dhe nëpërmjet fjalëve retorike të mirërenditura e joshëse të frutave të tyre -thonin- ***"La i lahe il-la Huve"***, *"Nuk ka zot tjetër përveç Atij!"*.

E para: Ashtu siç shihet në mënyrën më të qartë në secilën prej bimëve dhe pemëve e vërteta e një mirëbërësie dhe e një bujarie të bëra me qëllim si dhe një zemërgjërësi e dorëgjërësi të bëra me paramendim, po ashtu në tërësinë e pemëve dhe të bimëve duhet të shihet një e vërtetë e tillë e qartë si qartësia e dritës së diellit.

E dyta: E vërteta e dallimit dhe e diferencimit të bëra me qëllim nëpërmjet urtësisë, dhe zbukurimi e formimi të bëra me paramendim nëpërmjet mëshirës -e cila është aq e qartë si qartësia e dritës- në realitet e në kuptim.

Atëherë dallimi midis atyre llojeve dhe anëtarëve të pakufishëm është qëllim e synim, dhe ndryshimi dhe dallueshmëria ndërmjet tyre është urtësi e kërkuar, dhe prekja e stolisjes së zbukurimit janë mëshirë e synuar; kjo e vërtetë është aq e qartë saqë nuk le asnjë vend për t'ia atribuuar atë rastësisë, saqë ajo shfaq aq qartë si dita se këto janë veprat e Autorit të Gjithurtë dhe skalitjet dhe qëndisjet e Tij të mrekullueshme.

E treta: E vërteta e hapjes dhe e zhvillimit të formave të krijesave të pakufishme me qindra e mijëra modele e forma të ndryshme duke u hapur nga kokrrat e kufizuara në numër dhe të ngjashme me njëra-tjetrën dhe nga bërthamat e kufizuara të përafërta me njëra-tjetrën, dhe kultivimi e rritja e tyre me rregullsinë dhe ekuilibrin më të skajshëm dhe me stolinë e bukurinë më të skajshme, pavarësisht se ato janë të thjeshta, të pa jeta dhe të përziera me njëra-tjetrën; atëherë hapja e formave të secilit prej anëtarëve të atyre llojeve të dallueshme nga njëra-tjetra -që janë më shumë se dyqind mijë lloje- secila në formën e trajtën e saj të veçantë me rregullin më të plotë, me ekuilibër të plotë, me vitalitet e urtësi dhe pa ndonjë gabim, sigurisht kjo është një e vërtetë më e qartë dhe më e ndritshme se dielli...

Dëshmitë që e provojnë këtë të vërtetë janë aq të shumta sa lulet, frutat dhe gjethet që shfaqen në pranverë. Kështu udhëtari shprehu kuptimet e larta që shpërthyen në zemrën e tij dhe tha: ***"El-Hamdu Lil-lahi ala niëmetil iman"***, *"Lavdi Zotit për mirësinë e besimit"*.

Në shprehjen e këtyre të vërtetave dhe në dëshminë e dhënë për to, u përmend në shkallën e gjashtë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El Vaxhibul....]

. . .

Ndërsa ky udhëtar përmes kozmosit po kthehej prej atij udhëtimi reflektiv, me entuziazëm e zell të shtuar, i gëzuar me kënaqësinë e qëndrimit të tij tek e vërteta dhe për gjetjen e kopshteve të besimit, duke u kthyer prej kopshtit të pranverës, duke mbajtur një tufë të madhe e të gjërë -prej luleve të njohjes dhe të imanit- sa vetë gjërësia e pranverës, papritmas u hap përballë mendjes së tij të përmalluar për realitetin dhe para mendimit të tij të mallëngjyer për njohjen, dera e botës së shpendëve dhe të kafshëve; ato shpendë dhe ato kafshë e ftojnë atë me qindra e mijëra zëra dhe me gjuhë të ndryshme për të hyrë në atë botë të gjërë, dhe i urojnë mirëseardhje në botën e tyre... Ndërkohë ai u fut në të dhe pa se të gjithë shpendët dhe të gjitha kafshët, me të gjitha grupet, speciet dhe kombet e tyre përmendin e shpallin në bashkëtingëllim **"*La i lahe il-la Huve*",** *"Nuk ka zot tjetër përveç Atij"* nëpërmjet gjuhës së gjendjes dhe fjalëve të tyre, sikur sipërfaqja e tokës të ishte një kuvend madhështor *dhikri* dhe një asamble madhështore *tehlili* -për shpalljen e Unitetit Hyjnor. Ai pa se secila prej tyre ishte një odë -poemë- që i kushtohej Zotit, si një fjalë duke shpallur Lavdinë e Tij; si një letër duke treguar Mëshirën e Tij, secila prej tyre duke përshkruar Krijuesin me falënderime dhe lëvdata; të gjitha ato lavdëronin Krijuesin e tyre. Sikur shqiset, fuqitë, gjymtyrët dhe organet e atyre kafshëve dhe shpendëve të ishin fjalë të rregullta dhe të balancuara ose shprehje të përkryera e retorike.

Ai pa tre të vërteta të mëdhaja dhe gjithëpërfshirëse që tregonin në mënyrë vendimtare se ato shpendë e kafshë i kryenin falënderimet e tyre ndaj Krijuesit dhe Furnizuesit të tyre nëpërmjet atyre fjalëve dhe dëshmonin për Unitetin e Tij xh.sh. me ato fraza.

E para: E vërteta e sjelljes në ekzistencë, e artit dhe e krijimit; domethënë e vërteta e dhënies së jetës, dhënies së shpirtit, të cilat kurrësesi nuk mund t'u atribuohen rastësisë, forcës së verbër dhe natyrës së shurdhët; sepse ato janë: një sjellje në ekzistencë nga mosqënia që ndodh me urtësi, një art i shoqëruar me përsosuri dhe një krijim i shoqëruar me dëshirë, dhe një formim i ndërtuar mbi njohje. Ato shfaqin me qartësi në njëzet aspekte manifestimin e 'njohjes, të urtësisë dhe të dëshirës'; dhe ato janë një argument i ndritshëm për domosdoshmërinë e ekzistencës së ***'El-Hajj El–Kajjum'***, *'I Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi i Përhershëm'*, dhe ato janë një dëshmitar i vërtetë për shtatë Atributet e Tij Madhështore dhe janë një shenjë vërtetësie për Unitetin e Tij xh.sh.. Domethënë, e vërteta e

dhënies së jetës jep në ekzistencë dëshmitarë vërtetimi sa numri i të gjitha qënieve të gjalla.

E dyta: E vërteta e dallimit, zbukurimit dhe e formimit, e cila bëhet e qartë nëpërmjet atyre krijesave të pakufishme të cilat ndryshojnë nga njëra-tjetra nëpërmjet shenjave dhe tipareve dalluese në fytyra dhe nëpërmjet formimit të stolisur, të zbukuruar, të dallueshëm e të ndryshëm, nëpërmjet përmasave të balancuara, të holla e të ndryshme, dhe nëpërmjet formave të rregulluara e sistematike. Ajo është një e vërtetë aq e fuqishme dhe aq e madhe saqë nuk mund ta posedojnë këtë akt gjithëpërfshirës që shfaq dukshëm për syrin një mijë çudira dhe shembuj urtësie përveç të Gjithëfuqishmit për gjithçka dhe të Gjithurtit për çdo gjë; nuk ka absolutisht asnjë mundësi tjetër.

E treta: E vërteta e hapjes së formave të atyre kafshëve të panumërta me qindra e mijëra trajta e modele të ndryshme, prej vezëve që janë të ngjashme, të kufizuara dhe të caktuara në numër, dhe prej pikave të kufizuara të ujit të quajtur spermë që janë të përafërta në ngjasim me njëra-tjetrën ose të ndryshëm me një dallim të pakët.

Hapja e atyre formave -të cilat në vetvete janë mrekullia e urtësisë- me rregull të plotë, me ekuilibër të plotë, pa asnjë gabim, as shtesë dhe as mangësi, kjo sigurisht është një e vërtetë aq e ndritshme e brilante saqë ndriçohet me prova e dëshmi të shumta sa vetë numri i kafshëve.

Dhe kështu udhëtari pa botën e shpendëve dhe të kafshëve dhe mori një mësim të plotë prej treguesit të konsensusit të këtyre "Tre të vërtetave" duke treguar qartë se të gjitha llojet e kafshëve dëshmojnë duke thënë bashkarisht: *"**La i lahe il-la Huve",** "Nuk ka zot tjetër përveç Atij"*; saqë sikur toka u bë si një njeri shumë i madh duke thënë: "***La i lahe il-la Huve***" në raport me madhësinë dhe gjërësinë e saj, dhe prej forcës dhe fuqisë së saj e mbush kubenë e qiellit derisa ta dëgjojnë edhe banorët e qiellit.

Në shprehjen e këtyre të vërtetave, ne folëm në shkallën e shtatë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El- Vaxhibul- Vuxhudi]

. . .

Pastaj ky udhëtar hulumtues deshi të futej në "Botën e njeriut", në dynjanë e humanizmit me qëllim që të kalonte duke u ngjitur në shkallët e pafundme të njohjes Hyjnore dhe të ngjitej në një shkallë më të lartë në kënaqësitë e tyre dhe në një pozitë më të lartësuar në dritat e

tyre të pafundme. Këtu së pari, humanizmi, i kryesuar nga profetët, i bëjnë ftesë atij për të hyrë, dhe ai e pranoi ftesën. Duke soditur para së gjithash tek vendqëndrimi i kohëve të shkuara, ai pa se të gjithë profetët -paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta- të cilët janë më të ndriturit dhe më të përkryerit të llojit njerëzor, recitonin bashkarisht e përmendnin me një gjuhë të vetme, me unanimitet dhe njërëzi: ***"La i lahe il-la Huve",*** *"Nuk ka zot tjetër përveç Atij".* Të gjithë ata bënin thirrje për tek Uniteti i Zotit me fuqinë e mrekullive të tyre të panumërta të ndritshme të cilat i konfirmonin ata dhe pretendimet e tyre; ai pa se ata të gjithë i bënin thirrje njerëzimit për tek besimi në Zotin xh.sh. dhe për ta nxjerrë atë- humanizmin- prej nivelit të kafshërisë dhe për ta ngritur në shkallën e melekëve. Prandaj, udhëtari u ul në gjunjë me edukatë, me etikë e nderim të madh në klasat e asaj shkolle drite, dhe i kushtoi vëmendje mësimit. Ai pa se në dorën e secilit prej atyre mësuesve, më të lartësuarit, më të famshmit dhe më të shquarit e atyre qënieve humane, ndodheshin mrekulli të shumta, të cilat u ishin dhuruar atyre nga Krijuesi i të gjitha botëve si shenja duke konfirmuar e vërtetuar misionin e tyre. Për më tepër, një grup i madh njerëzish, një komunitet i tërë, i kishte konfirmuar e pranuar pretendimet e tyre dhe kishin hyrë në besim nëpërmjet komunikimit të secilit prej tyre... prandaj, udhëtari mundi të kuptojë me analogji forcën dhe fuqinë e Unitetit e të Njësisë, atë të vërtetë mbi të cilën kanë rënë dakort me unanimitet ata njerëz të vërtetë numri i të cilëve është më shumë se 'njëqind mijë'...

Gjithashtu ai kuptoi gabimin e rëndë dhe krimin më të madh të cilin e kryejnë njerëzit e çudhëzimit, mohuesit e asaj të vërtete të ngulitur fort e cila ka këtë fuqi dhe të cilën e beson dhe e mbështet ky numër i madh prej njoftuesve të vërtetë dhe e provon me mrekullitë e tyre të panumërta... ai gjithashtu kuptoi dënimin pikëllues të përhershëm që e meritojnë mohuesit... gjithashtu ai njohu drejtësinë dhe vërtetësinë e atyre që i pranuan, u besuan atyre dhe hynë në besim. Me këtë u shfaq para tij një shkallë shumë e madhe dhe e lartë e shenjtërisë së besimit dhe e lartësisë së Unitetit Hyjnor.

Po, mrekullitë e pafundme, secila prej tyre është një konfirmim real nga ana e të Vërtetit -Krijuesit xh.sh.- për profetët, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta; goditjet qiellore që u ranë kundërshtarëve dhe mohuesve shfaqin vërtetësinë e tyre dhe mbështetjen e Zotit xh.sh. për ta; secila prej tyre ishte një provë për vërtetësinë e tyre; për plotësimet e tyre individuale secila duke qenë si një tregues për drejtësinë e tyre; mësimet dhe udhëzimet e tyre të shëndosha tregojnë se ata janë me të vërtetën; forca e besimit të tyre,

serioziteti më i lartë, gatishmëria për t'u vetëflijuar dhe devocioni i tyre i skajshëm, që të gjitha këto dëshmojnë për vërtetësinë dhe për drejtësinë e thirrjes së tyre; Librat dhe fletët e shenjta që mbahen nga duart e tyre, studentët e tyre të panumërt të cilët arritën realitetin dhe u ngjitën tek plotësimi, dhe u drejtuan e u udhëzuan tek drita duke i ndjekur ata, të gjitha këto dëshmojnë vërtetësinë e rrugës së tyre dhe drejtësinë e udhës së tyre. Për më tepër, unanimiteti i atyre përçuesve të vërtetë në të gjitha çështjet pozitive sigurisht është një provë vendimtare për vërtetësinë e besimit dhe një fuqi aq e madhe që përforcon të vërtetën e tij saqë asnjë fuqi tjetër në botë nuk mundet absolutisht të konfrontohet e të përballet me të. Ajo është një e vërtetë e tillë vendimtare saqë përpara saj zvogëlohet e shuhet çdo hezitim.

Udhëtari kuptoi urtësinë e qënies së besimit në të gjithë profetët si një shtyllë prej shtyllave të imanit, dhe se ai besim përfaqëson një burim tjetër fuqie të madhe për besimin e tij. Kështu ai nxori dobi të mëdha të besimit prej mirësive të tyre, në shprehjen e të cilave ne folëm në Shkallën e Tetë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El- Vaxhibul Vuxhudi...]

. . .

Ai udhëtar kërkues duke pasë provuar kënaqësi të larta prej fuqisë së besimit dhe duke pasë thithur flladin e pastër të jetës, u kthye prej asamblesë së profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta. Ndërkohë i bëjnë ftesë atij ata të cilët i provuan pretendimet e profetëve me shkallën e njohjes së sigurtë dhe sollën argumente vendimtare për vërtetësinë e tyre; ata janë dijetarët dhe shkollarët e thellë, origjinalë dhe të saktë të cilët quhen ***El-Asfija ves-Sid-dikunë*** *'Të pastërtit dhe më të vërtetit'*... Ata i bënë ftesë atij për tek shkollat e tyre dhe ai hyri e pa një grupim të madh që përfshinte me mijëra gjeni dhe qindra e mijëra shkollarë të saktë e të lartë duke i provuar të gjitha çështjet pozitive që lidhen me fenë, në krye të të cilave qëndron çështja e domosdoshmërisë së ekzistencës së Krijuesit xh.sh. dhe ajo e Unitetit të Tij, me demonstrime të tilla të thella saqë nuk lënë asnjë vend as edhe për dyshimin më të vogël.

Po, unanimiteti i atyre dijetarëve të mëdhenj në parimet dhe në shtyllat e imanit -pavarësisht dallimeve dhe ndryshimeve të tyre në aftësitë e tyre të natyrshme dhe në metoda e pikëpamje- secili prej tyre duke u mbështetur në fuqinë dhe në sigurinë e argumenteve të tij, sigurisht kjo është në vetvete një provë vendimtare e tillë saqë askush

nuk mund ta kundërshtojë, as ta refuzojë apo ta dyshojë përveç dikujt që ka zgjuarsi më të mprehtë dhe më të lartë se sa zgjuarsia e atyre gjenive, ose në qoftë se argumenti i tij do të ishte më i fuqishëm se sa argumentet e atyre të gjithëve dhe në qoftë se prova e tij do të ishte më elokuente se sa të gjitha provat e tyre! Kjo është krejtësisht e pamundur. Prandaj ata nuk mund të konfrontohen e sfidohen veçse me injorancë, me shtirje si injorancë dhe me mohim lidhur me çështjet negative të cilat nuk mund të provohen, ose me kryeneçësi dhe me mbyllje të syve ndaj asaj drite. Gjendja është se ai i cili i mbyll sytë e tij, ai vetëm ditën e tij e bën natë.

Udhëtari kuptoi se dritat të cilat i përhapën këta profesorë të thellë të kësaj shkolle të madhe e të lartë ka ndriçuar gjysmën e globit tokësor për më shumë se një mijë vite. Ai gjeti në fe një forcë të tillë morale e shpirtërore saqë sikur të grumbulloheshin të gjithë njerëzit e mohimit dhe të kryeneçësisë, nuk do të ishin në gjendje ta lëkundnin apo ta shkatërronin atë as sa një fije.

Një aluzion të shkurtër për mësimin e mësuar nga udhëtari në këtë shkollë ne e thamë në Shkallën e Nëntë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El- Vaxhibul- Vuxhudi...]

. . .

Udhëtari ynë soditës kur u kthye prej shkollës së dijetarëve u nxit me ngulm nga një mallëngjim i zjarrtë për t'iu shtuar e zbuluar besimi dhe u sundua nga një dëshirë e fortë për të parë dritat dhe kënaqësitë të cilat janë në rrugën e ngjitjes prej shkallës së njohjes së sigurisë për tek shkalla e shikimit të sigurisë. Atë e ftuan me mijëra e miliona 'Evlija të drejtë' udhëzues të lartë të cilët u përpoqën për tek realiteti, arritën tek e vërteta dhe mbërritën tek shkalla e shikimit të sigurisë me ngjitjen e tyre nën hijen e *miraxhit* -ngjitjes- të profetit Muhammed a.s.m. dhe në gjurmët e profetit a.s.m. në udhën më të madhe Muhammedane.

Këta e ftuan atë në një vend të madh e të lumtur dhikri -për përmendjen e Zotit xh.sh.- dhe për tek një vendtakim i drejtë e fisnik udhëzimi, i cili përhapte shkëlqim e dritë duke i mbushur të gjitha anët dhe ato vërshonin e përhapeshin duke buruar nga njëpasnjëshmëria e *teqeve* të tyre, *zavijeve* dhe vendeve të tyre të ndritshme. Ndërkohë ai hyri dhe pa se këta njerëzit e zbulesave, të ndriçimeve dhe të kerameteve përsërisnin me unanimitet frazën '***La i lahe il-la Huve'***, *'Nuk ka zot tjetër përveç Atij'*, duke shpallur me të domosdoshmërinë e

ekzistencës së Krijuesit xh.sh. dhe Unitetin e Tij, duke u mbështetur në zbulesat e tyre, në kerametet dhe në shikimet e tyre.

Po, ashtu siç njihet dielli nëpërmjet shtatë ngjyrave në dritën e tij, po ashtu të vertetën e Njësisë Hyjnore e pranojnë dhe e vërtetojnë me unanimitet të plotë këta gjeni të shenjtë, këta njohës të ndritshëm të cilët përfaqësojnë njerëzit e tarikateve të ndryshme të vërteta, njerëzit e metodave të ndryshme të drejta dhe kurset e shumta të vërteta, të cilët u ngjyrosën me shtatëdhjetë lloje, madje me aq shumë ngjyra sa numri i Emrave të bukur Hyjnorë prej ngjyrave vezulluese e të dallueshme dhe prej dritave të larmishme e të ndryshme të manifestuara në zemra e në horizonte prej dritës së Diellit të parapërjetshëm e të paspërjetshëm.

Udhëtari e pa manifestimin e asaj të vërtete të ndritshme me syrin e sigurisë. Ai pa se unanimiteti i profetëve, pajtueshmëria e dijetarëve të pastër dhe përputhshmëria në mendim e Evlijave të drejtë formon konsensusin më të lartë dhe është një e vërtetë më e ndritshme se sa drita e ditës që tregon diellin.

Një aluzion të shkurtër për shkëlqimet dhe dobitë që mori ky udhëtar prej teqeve dhe zavijeve ne e thamë në shkallën e Dhjetë të Stacionit të parë.

[La i lahe il-lall-llahu El- Vaxhibul- Vuxhudi...]

. . .

Pastaj ai udhëtar deshi, nëpërmjet të gjitha aftësive të tij të holla dhe fuqisë së tij, të shtonte përparimin dhe ngjitjen në forcën e besimit dhe në zbulimin e njohjes së tij lidhur me Krijuesin, meqë ai ishte i vetëdijshëm se dashuria për Zotin që buron prej besimit në Allahun xh.sh. e cila shpërthen prej njohjes së Tij xh.sh. është plotësimi më i madh human, më i rëndësishmi dhe më i gjëri; madje ajo -dashuria për Zotin- është burimi dhe themeli i të gjitha plotësimeve humane; prandaj ai e ngriti kokën e tij duke soditur qiejt dhe i tha mendjes së tij:

“Përderisa jeta është gjëja më e shtrenjtë në univers, dhe të gjitha krijesat i janë nënshtruar jetës; dhe më të çmueshmit e qënieve të gjalla janë frymorët -qëniet me shpirt; dhe më të lartësuarit e qënieve me shpirt janë të vetëdijshmit... dhe përderisa globi tokësor -për hir të kësaj pozite të lartë- boshatiset në çdo shekull e në çdo vit, dhe rimbushet me qëllim që të shtojë këtë substancë më të çmueshme -

qënie të gjalla; atëherë sigurisht duhet medoemos që këto qiej të lartësuar e të zbukuruar të kenë banorët dhe popujt e tyre të përshtatshëm për to prej gjallesave, prej qënieve me shpirtëra dhe prej atyre që kanë vetëdije. Saqë janë transmetuar rrëfenja të sakta që konfirmojnë shikimin e 'Melekëve' dhe bisedimin me ta qysh nga koha e Ademit a.s. ashtu si shfaqja e Xhebrailit a.s. në formë njeriu përpara sahabëve në prezencë të profetit -në vendin ku ishte ulur profeti a.s.m.. Ndërkaq udhëtari tha: "Ah sikur të kisha nderin dhe t'i shikoja banorët e qiejve, dhe ah sikur t'i dija mendimet e tyre rreth të vërtetës së besimit dhe të Unitetit Hyjnor; sepse dashuria më e rëndësishme lidhur me Krijuesin e universit është dëshmia e tyre... ndërsa po mendonte e thonte kështu me vetveten, ai papritmas dëgjoi një zë qiellor duke i thënë: "Meqenëse ti dëshiron të takohesh me ne dhe të dëgjosh mësimin tonë, atëherë mësoje se 'çështjet e besimit' të cilat kanë zbritur me ndërmjetësinë tonë tek të gjithë pejgamberët, në krye të të cilëve është profeti Muhammed a.s.m. me Kuranin Kerim - atyre çështjeve- së pari u kemi besuar neve. Mësoje gjithashtu se të gjithë shpirtërat e mirë prej nesh që janë shfaqur para njerëzve kanë dëshmuar që të gjithë pa përjashtim me unanimitet për domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit të universit, për Unitetin e Tij dhe për Atributet e Tij të shenjta; dhe këtë e kanë shpallur me pajtueshmëri të plotë. Përputhshmëria dhe bashkëpërgjigjja e ndërsjellë e këtyre shpalljeve dhe njoftimeve të panumërta është një udhëzues e tregues për ty aq i ndritshëm si dielli".

Udhëtari e kuptoi atë që synonin ata, dhe drita e besimit të tij shkëlqeu dhe vezulloi, derisa u ngjit në qiej.

Një aluzion i shkurtër për mësimin që mori ky udhëtar prej Melekëve u përmend në Shkallën e Njëmbëdhjetë të Stacionit të parë:

[La i lahe il-lall-llahu El-Vaxhibul- Vuxhudi...]

• • •

Pastaj ai udhëtar i zellshëm e i përmalluar për mësimin që mori prej gjuhëve të grupeve dhe botërave të ndryshme të krijimit dhe prej gjendjeve të tyre në botën e dukshme në aspektet e tyre trupore e materiale, deshi me mallëngjim të fortë të bënte më shumë shëtitje e udhëtim dhe të studionte e të kërkonte realitetin dhe vazhdoi shqyrtimin e asaj çfarë ndodhet në botën e padukshme dhe në botën e ndërmjetme. Ndërkohë përpara tij u hap dera e 'mendjeve të drejta e të ndriçuara dhe e zemrave të pastërta e të ndritshme', prej të cilave janë

të zhveshura njëri prej grupeve të njerëzimit; sepse mendja dhe zemra janë si bërthama dhe si thelbi i njeriut dhe në sajë të atyre të dyjave ai mundi të bëhej fruti i universit; dhe ato të dyja kanë fuqi të shtrihen e të zgjerohen derisa mund të përfshijnë të gjithë botën pavarësisht qënies së atyre të dyjave të vogëla.

Udhëtari pa se zemrat dhe mendjet janë ngushtica humane -pengesa- midis botës së padukshme dhe botës së dukshme, dhe lidhjet dhe marrëdhëniet midis atyre dy botëve -lidhur me njeriun- ndodhin tek ato pika; prandaj ai u foli mendjes dhe zemrës së tij njëherësh duke u thënë: "Afrohuni, se më e shkurtëra e rrugëve që të çon tek realiteti është nëpërmjet derës suaj, prandaj ejani që të përfitojmë duke i studiuar mendjet dhe zemrat që përshkruhen me besim dhe t'i shqyrtojmë cilësitë dhe ngjyrat e atyre të dyjave; sepse ky mësim nuk merret nga gjuhët ashtu siç është rasti me rrugët e tjera".

Ai nisi të kthejë fletët e mendjeve dhe filloi të hapë faqet e zemrave duke soditur e shqyrtuar gjatë, dhe pa se të gjitha mendjet e shëndosha, të drejta e të ndriçuara pajtohen unanimisht lidhur me *akiden* e ngulitur e të qartë në besimin dhe në Unitetin Hyjnor dhe kanë përputhshmëri në sigurinë dhe në bindjen e fortë lidhur me Unitetin e Zotit, pavarësisht aftësive të tyre të ndryshme, metodave, pikëpamjeve dhe medhhebeve të ndryshme, e madje të kundërta.

Domethënë, ato janë mbështetur dhe janë lidhur me një akide të pandryshueshme dhe kanë hyrë në një të vërtetë të rrënjosur që nuk shkulet e nuk këputet kurrë; prandaj unanimiteti i këtyre mendjeve lidhur me besimin, me domosdoshmërinë e ekzistencës dhe me Unitetin e Zotit xh.sh. është një zinxhir i ndritshëm që nuk këputet kurrë dhe një dritare e gjërë ndriçuese e hapur drejt botës së të vërtetës.

Gjithashtu ai pa se të gjitha zemrat e shëndosha e të ndritshme kanë unanimitet e pajtueshmëri midis tyre lidhur me zbulesat, shikimet dhe me dëshmimet e tyre të sigurta e sublime për sa ka të bëjë me shtyllat e besimit, dhe kanë përputhshmëri e pajtueshmëri lidhur me çështjet e Unitetit Hyjnor, pavarësisht metodave dhe pikëpamjeve të tyre të largëta e të ndryshme. Domethënë secila prej këtyre zemrave të ndritshme është një arsh -Fron- shumë e vogël i Njohjes Hyjnore; ato janë pasqyra gjithëpërfshirëse për Dritat e manifestimeve të të kërkuarit përjetësisht; ato janë kthyer drejt të vëtetës, janë lidhur me të dhe e manifestojnë atë.

Atëherë, ato janë dritare të hapura drejt diellit të vërtetësisë. Domethënë, tërësia e këtyre zemrave, duke u marrë bashkërisht, formon dritaren më të madhe e më të gjërë si deti përballë atij dielli.

Pajtueshmëria dhe unanimiteti i këtyre zemrave dhe mendjeve lidhur me domosdoshmërinë e ekzistencës së Zotit xh.sh. dhe me Unitetin e Tij sigurisht është udhëzuesi më i përkryer dhe mësuesi më i madh, i besueshëm, i sigurtë dhe i pagabueshëm; sepse kurrësesi nuk është e mundshme apo e konceptueshme në ndonjë drejtim që një supozim që s'ka realitet, një mendim i pavërtetë -që nuk lidhet me realitetin- dhe një atribut i rremë i pabazë t'i mashtrokan të gjithë këto sy të mprehtë e depërtues të këtij numri shumë të madh të këtyre zemrave të pastërta dhe të këtyre mendjeve të shëndosha e serioze, dhe ky mashtrim të vazhdoka për gjatë shekujve me një ngulitje të plotë dhe t'i bënte ato të gjithë të binin në kurthin e shtrembërimit dhe të shkujdesjes! Madje edhe sofistët idiotë, të cilët mohojnë kozmosin, nuk do të pajtoheshin me një mendje të prishur e të hutuar e cila e gjen të mundshme një gjë të tillë!

Të gjithë këtë e kuptoi udhëtari ynë, dhe tha së bashku me mendjen dhe me zemrën e tij: *"**Amentu bil-lahi",** "Unë besova në Zotin xh.sh".*

Duke aluduar për njohjen e besimit të cilën e nxori ky udhëtar prej mendjeve të drejta e të shëndosha dhe prej zemrave të ndritshme u përmend në shkallën e dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-lahu El Vaxhibul- Vuxhudi...]

. . .

Pastaj ai udhëtar i cili e vështroi nga afër Botën e Padukshme dhe që udhëtoi në dy botët e mendjes dhe të zemrës, nisi të trokasë derën e asaj bote nëpërmjet këtij lloji mendimi e hulumtimi:

"Jam kureshtar të di, çfarë thotë kjo botë e padukshme?" Sepse meqenëse ne shohim në këtë botë të dukshme trupore se Krijuesi xh.sh., i Cili fshihet pas perdes së të Padukshmes, e bën të njohur Vetveten e Tij nëpërmjet të gjitha këtyre artifakteve të Tij të stolisura e të bëra me plot art dhe i Cili na shtyn neve për ta dashur Atë nëpërmjet këtyre mirësive të Tij të ëmbëla e të mira të pafundme, dhe i Cili na njofton neve për Plotësitë e Tij të fshehura nëpërmjet këtyre veprave të panumërta të mrekullueshme e plot mjeshtëri arti.. po, Ai i Cili e bën të njohur e të dashur Vetveten e Tij nëpërmjet aktit dhe gjuhës së gjendjes e cila është më e qartë se sa fjala dhe ligjërimi; sigurisht Ai do

të flasë me fjalë e me të ligjëruar siç flet Ai me akte e me gjendje duke e bërë Vetveten e Tij të Njohur e të Dashur.

Kështu udhëtari iu adresua vetvetes duke i thënë: Ne duhet ta njohim Atë xh.sh. nëpërmjet manifestimeve të Hyjnisë së Tij në botën e Padukshme. Ndërkohë ai e zhyti zemrën e tij në thellësira dhe pa nëpërmjet syrit të mendjes së tij sa vijon:

E vërteta e '***Vahjit Hyjnor', '****Shpalljes Hyjnore'* mbisundonte në të gjitha çastet e kohët -nëpërmjet manifestimeve më të fuqishme e më të qarta- në të gjitha anët e botës së Padukshme. Dhe vjen dëshmia për ekzistencën dhe për Unitetin e Tij xh.sh. prej Njohësit të të gjitha gjërave të së padukshmes.

Ajo është dëshmia e '*vahjit'* dhe e '*ilhamit' -shpalljes* dhe *inspirimit-* e cila është shumë më e fuqishme se sa dëshmia e universit dhe e qënieve të krijuara; sepse Ai xh.sh. nuk do t'i linte bërjen të njohur të Vetvetes së Tij dhe as treguesit e ekzistencës dhe të Unitetit të Tij vetëm tek dëshmia e krijesave të Tij, përkundrazi Ai flet fjalë parapërjetësie të cilat janë në përshtatje me Qënien e Tij; dhe nuk ka as kufi dhe as fund për Fjalën e Atij i Cili është i pranishëm dhe gjithëshikues me fuqinë dhe me njohjen e Tij në çdo vend. Dhe ashtu siç e bën Atë të njohur kuptimi i Fjalës së Tij. Po ashtu të folurit -ligjërimi i Tij- e bën Vetveten e Tij të njohur së bashku me Atributet e Tij.

Po, konsensusi dhe pajtueshmëria e njëqind mijë profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, lidhur me të gjitha njoftimet e tyre që buronin prej *Vahjit Hyjnor,* dhe dëshmitë dhe mrekullitë e librave të shenjtë dhe të fletëve -shkrimeve- qiellore të cilat janë shpallja -*Vahji*- dhe fruti i tij i shikuar, dhe të cilat i kanë pranuar dhe i kanë vërtetuar shumica absolute e njerëzimit, i kanë ndjekur ato si shembull dhe janë udhëzuar me udhëzuesit e tyre, e bënë udhëtarin të kuptojë në mënyrë të vetëkuptueshme se *Vahji* -shpallja Hyjnore- është një e vërtetë e qëndrueshme rreth së cilës nuk ka asnjë dyshim. Gjithashtu ai kuptoi se e vërteta e *vahjit* tregon e njofton Pesë të Vërteta të Shenjta si dhe i konfirmon dhe i ndriçon ato.

E Para: Të folurit në përputhje me kuptimet e njerëzve dhe me nivelin e mentalitetit dhe të aftësive të tyre mendore është një formë që quhet '*Begenia* -zbritja- Hyjnore tek mendjet e njerëzve'... Po, Ai i Cili i bëri të flasë të gjitha krijesat e Tij të vetëdijshme me shpirtëra dhe i Cili kupton të folurën e tyre, Hyjnia e Tij kërkon medoemos që kuptimet e fjalës së Tij të parapërjetshme të derdhen në formë fjalësh

me qëllim që njerëzit ta kenë të lehtë për t'i lexuar ato midis fjalëve të tyre.

E Dyta: Ai i Cili e krijoi ekzistencën në mënyrë të mrekulleshme, dhe e mbushi Kozmosin me krijesat e Tij të mrekullueshme dhe i pajisi ato me gjuhë duke folur për Plotësitë e Tij, sigurisht e domosdoshmërisht Ai do ta bënteVetveten të njohur edhe me fjalët e Tij gjithashtu.

E Treta: Ai i Cili u përgjigjet me akt lutjeve dhe falënderimeve të bëra nga njerëzit e vërtetë, të cilët janë më të zgjedhurit, janë elita e tyre dhe janë më të nevojshmit, më të përmalluarit dhe më të ndjeshmit midis njerëzve, atëherë përgjigja ndaj atyre duave dhe falënderimeve me fjalën e Tij xh.sh. është prej funksionit të krijueshmërisë -të Qënies së Tij Krijues.

E Katërta: Atributi i të folurit i cili është një bashkëshoqërues esencial i domosdoshëm dhe një manifestim i ndritshëm i dy Atributeve të 'Njohjes' dhe të 'Jetës', sigurisht ai do të gjendej në formë gjithëpërfshirëse, të përjetshme dhe të amshuar tek Ai i Cili ka njohje gjithëpërfshirëse dhe jetë të përhershme.

E Pesta: Ai i Cili i krijoi krijesat e Tij dhe i pajisi ato me pafuqi e mallëngjim, me varfëri e nevojë, dhe me ankth e shqetësim për të ardhmen; dhe i Cili u dha atyre dashurinë dhe adhurimin derisa ata u bënë të ndiejnë dashuri të fortë dhe mallëngjim të papërmbajtur për të njohur Zotin e tyre të vërtetë dhe Pronarin dhe Zotëruesin e çështjes së tyre; të cilët ndiejnë nevojë të madhe për një fuqi tek e cila të mbështeten e të strehohen- ndërsa bien rrokullimthi në varfëri, në pafuqi dhe në ankthin për të ardhmen- atëherë është kërkesë prej Hyjnisë së Tij që t'i bëjë ata ta ndiejnë e ta kuptojnë ekzistencën e Tij nëpërmjet të folurit të Tij xh.sh..

Kështu që, udhëtari kuptoi se dëshmitë që tregojnë me unanimitet për ekzistencën e Ekzistuesit të domosdoshëm dhe për unitetin e Tij xh.sh. në vahjin qiellor të përgjithshëm i cili përmban të vërtetat e begenisë- zbritjes- Hyjnore, Vetënjohjes Hyjnore, përgjigjjes së mëshirshme, 'Bashkëbisedimit Hyjnor' dhe vetëdeklarimit të përjetshëm -këto janë dëshmia më e madhe, madje ajo është më e madhe se dëshmia e diellit për vetveten në mes të ditës.

Pastaj udhëtari hodhi vështrimin tek '*ilhamet'*, 'inspirimet', dhe pa se inspirimet e vërteta ndonëse janë të ngjashme -nga një drejtim- me *vahjin* 'shpalljen', meqë ato janë një lloj i bashkëbisedimit Hyjnor, por ama ka dy dallime -ndryshime:

I Pari*:* Pjesa më e madhe e '*Vahjit* Hyjnor' i cili është shumë më i lartë e më sublim se sa '*ilhami'*, 'inspirimi', vjen nëpërmjet melekëve, ndërsa shumica e '*ilhamit'* 'inspirimeve' vjen drejtpërdrejtë, pa ndërmjetës. Për ta sqaruar këtë, do të sjellim shembullin që vijon:Dihet se një mbret ka dy mënyra për adresim dhe për lëshim dekretesh e urdhërash:

E para: në Emrin e shtetit, të madhështisë së tij, të sundimit dhe të sovranitetit të tij mbi të gjithë. Ai nis ndonjë prej të dërguarve të tij tek ndonjëri prej guvernatorëve të tij, dhe ndonjëherë ai takohet me të, dhe ia përçon urdhërin, dhe këtë e bën me qëllim që të shfaqë madhështinë e atij sovraniteti dhe rëndësinë e atij urdhëri.

E dyta: Në emrin e tij personal dhe jo në emrin e mbretërisë dhe as me titullin e monarkut. Ai flet në mënyrë private me telefonin e tij privat lidhur me ndonjë çështje private dhe me ndonjë çështje të pjesshme me shërbëtorin e tij të veçantë e të besuar ose me ndonjërin prej nënshtetasve të tij të zakonshëm.

Në të njëjtën mënyrë është fjala e Sulltanit të parapërjetshëm xh.sh.. Ai flet nëpërmjet *vahjit* ose *ilhamit* gjithëpërfshirës -i cili kryen funksionin e vahjit- dhe flet me Emrin e "***Rab-bil Aleminë***" *"Zoti i të gjitha botëve",* dhe me titullin e '***Ha'likul Keuni***' '*Krijuesi i universit*'. Gjithashtu Ai ka edhe një mënyrë tjetër të foluri, në një formë private, nga prapa perdeve dhe mbulesave, me çdo individ dhe me çdo qënie të gjallë, në përputhje me aftësitë e tyre, në një mënyrë të përshtatshme me marrësin, dhe kjo për shkak të qënies së Tij Zoti dhe Krijuesi i të gjitha qënieve të gjalla.

Ndryshimi i dytë: *Vahji* është i pastër dhe pa hije dhe i veçantë e i rezervuar për të zgjedhurit. Ndërsa *ilhami* -inspirimi- ka hije dhe përzierje ngjyrash; ai është i përgjithshëm dhe ka forma të ndryshme dhe shumë të pangjashme, ashtu si inspirimet e melekëve, inspirimet e njeriut dhe inspirimet e kafshëve.

Ilhami -inspirimi- me llojet e tij të ndryshme dhe me format e tij shumë të pangjashme tregon hapësirën e gjërësisë dhe të shumësisë së fjalëve Hyjnore të cilat janë më të shumta se numri i pikave të deteve.. Ndërkaq udhëtari kuptoi prej kësaj një aspekt prej komentimit të versetit Kuranor:

"Thuaj (o Muhammed a.s.m njerëzimit): Sikur deti të ishte bojë (për të shkruar) Fjalët e Zotit tim, sigurisht që deti do të shterrohej para se të mbaronin Fjalët e Zotit tim".[77]

Pastaj ai hodhi vështrimin tek natyra, tek urtësia dhe tek dëshmia e *ilhamit* -inspirimit- dhe pa se natyra e tij, urtësia dhe rezultati i tij përbëheshin prej katër dritash:

Drita e Parë: Ashtu siç bëhet i dashur Allahu xh.sh. për krijesat e Tij me anë të akteve të Tij tek ata i Cili u bën të njohur "Dashurinë Hyjnore", po ashtu është prej kërkesave të "Dashurisë dhe të Mëshirës" -domethënë të qënies së Tij *Vedud* dhe *Rahman*- që Ai të bëhet i dashur për ta edhe nëpërmjet fjalës dhe prezencës.

Drita e Dytë: Ashtu siç u përgjigjet Ai xh.sh. duave të shërbëtorëve të Tij nëpërmjet akteve të Tij, po ashtu është kërkesa dhe funksioni i mëshirëgjërësisë së Tij që t'u përgjigjet atyre edhe me fjalë nga prapa perdeve.

Drita e Tretë: Është një bashkëshoqërim i Hyjnisë se ashtu siç u përgjigjet Ai xh.sh. me akte thirrjeve për ndihmë, duave dhe përgjërimeve të atyre prej krijesave të Tij të cilat janë goditur me fatkeqësi të rënda e me vuajtje, po ashtu Ai duhet t'u vijë në ndihmë atyre me fjalët e *ilhamit* -inspirimit- të cilat janë një lloj i ligjërimit të Tij.

Drita e Katërt: Ashtu siç e bën Zoti xh.sh. të perceptueshme ekzistencën e Tij, prezencën dhe mbrojtjen e Tij për krijesat e Tij të vetëdijshme -të cilat qëndrojnë në pafuqi e në dobësi të rënda, në varfëri e në nevoja të mëdha dhe të cilët janë më të mallëngjyerit e më të nevojshmit për ta njohur Pronarin e tyre, Mbrojtësin, Rregullatorin dhe Ruajtësin e tyre- po ashtu është prej kërkesës së dhembshurisë dhe të mëshirës Hyjnore dhe prej domosdoshmërisë së tyre që Ai xh.sh. t'i bëjë gjithashtu të perceptueshme prezencën e Tij, afrueshmërinë dhe ekzistencën e Tij për një krijesë të veçantë në përputhje me aftësinë e saj, dhe me anë të disa *ilhameve* -inspirimeve- të vërteta, me fjalë tek telefoni i zemrës së saj, e cila konsiderohet si një lloj i bashkëbisedimit Hyjnor.

Pastaj ai hodhi vështrimin tek dëshmia e *ilhamit* -inspirimit- dhe pa se në qoftë se dielli -si supozim- do të kishte jetë dhe vetëdije, dhe shtatë ngjyrat në dritën e tij të ishin shtatë atribute për të -si supozim- atëherë ai do të kishte një mënyrë të foluri me anë të rrezeve dhe të

[77] Kur'an, 18: 109

manifestimeve të tij të cilat janë në dritën e tij. Dhe në këtë gjendje: Edhe ekzistenca e formës së tij, edhe reflektimi i tij në gjërat e tejdukshme; domethënë bisedimi i tij me çdo pasqyrë reflektuese, me çdo gjë të ndritshme, me çdo copë xhami, me flluskat e detit dhe me pikat e tij; madje edhe me grimcat e tejdukshme në përputhje me aftësinë e secilës prej tyre.. dhe përgjigjja e tij ndaj nevojave të secilës prej tyre.. e gjitha kjo është një dëshmi e vërtetë për ekzistencën e diellit, për mosqënien e një akti pëngesë për një akt tjetër, dhe për mosqënien e një fjale bllokim a pengesë për një fjalë tjetër të tij...

Ashtu siç shihet kjo me qartësi, po ashtu është çështja lidhur me bashkëbisedimin e Monarkut të parapërjetshëm e të paspërjetshëm, e Zotëruesit të lavdisë, e Krijuesit të të gjitha qënieve, Zotëruesit të bukurisë, Dritës së parapërjetshme; ai është një ligjërim, bisedim universal e gjithëpërfshirës ashtu si njohja dhe fuqia e Tij xh.sh.. Prandaj kapet e perceptohet në mënyrë të vetëkuptueshme manifestimi i gjërë i atij ligjërimi në përputhje me aftësinë e çdo gjëje pa e bllokuar një pyetje një pyetje tjetër, pa e penguar një veprim një veprim tjetër, dhe pa u përzier e ngatërruar një fjalë adresimi me një adresim tjetër.

Udhëtari kuptoi me një njohje sigurie e cila iu ofrua shikimit të sigurisë se të gjitha ato manifestime, ato bisedime dhe *ilhame* -inspirime- veçmas ose bashkërisht provuan e dëshmuan me unanimitet domosdoshmërinë e Atij Dritëdhënësi të parapërjetshëm xh.sh., për prezencën e Tij xh.sh., për Unitetin dhe për Njësinë e Tij.

Dhe kështu u përmend një aluzion i shkurtër për atë që mori ky udhëtar kureshtar prej mësimit të njohjes prej botës së padukshme në shkallën e katërmbëdhjetë dhe të pesëmbëdhjetë të Stacionit të parë:

[La i lahe il-lall-llahu El- Vaxhibul Vuxhudi]

. . .

Pastaj ai udhëtar nëpër dynja iu adresua mendjes së tij duke i thënë: “Meqenëse unë po e kërkoj Pronarin dhe Krijuesin tim nëpërmjet krijesave të këtij kozmosi, do të ishte më mirë për mua që t’i shkoja për vizitë atij i cili është njeriu më i plotësuar në ekzistencë, më i madhi që të udhëheqë për tek e mira -madje edhe sipas dëshmisë së armiqve të tij- më i shquari midis tyre, më i vërteti në fjalë, më i larti në pozitë dhe më i ndrituri i tyre në mendje; ai është Muhammedi *Sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem*, paqja dhe bekimet e Zotit xh.sh. qofshin mbi të, i cili me virtytet e tij dhe me Kuranin ka ndiçuar katërmbëdhjetë shekuj... Atëherë me qëllim që të nderohem e të privilegjohem me vizitën e tij, dhe të kërkoj shpjegim prej tij lidhur me

atë që kërkoj, na duhet që të shkojmë së bashku tek më i miri i shekujve... tek shekulli i lumturisë.. shekulli i profetësisë.. Së bashku me mendjen e tij ai hyri në atë shekull dhe pa se ai ishte bërë në sajë të Tij a.s.m. shekulli i lumturisë së vërtetë për njerëzimin. Sepse nëpërmjet dritës që ai kishte sjellë, i kishte transformuar më primitivët dhe më analfabetët e njerëzve në profesorë dhe mësues të botës.

Dhe kështu, ai iu adresua mendjes së tij duke i thënë: "Para së gjithash ne duhet të njohim diçka rreth madhështisë dhe vlerës së këtij personaliteti të mrekullueshëm, dhe këtë duhet ta arrijmë nëpërmjet saktësisë së haditheve, thënieve të tij dhe vërtetësisë së njoftimeve të tij, dhe pastaj ta pyesim atë rreth Krijuesit tonë xh.sh..."

Kështu ai nisi të shqyrtojë e hulumtojë, dhe gjeti për vërtetësinë e profetësisë së tij prova vendimtare të panumërta, por ai këtu tregoi vetëm nëntë prej provave më të përgjithshme.

E Para: Përshkrimi i tij me të gjitha virtytet e shquara, me cilësitë dhe veçoritë e lavdërueshme, saqë për to dëshmuan edhe armiqtë e tij... shfaqja e qindra mrekullive prej tij, si: çarja më dysh e hënës me një shenjë të vetme të bërë nga gishti i tij, ashtu siç e shpreh Kurani,

" Dhe hëna u ça më dysh".[78]

Shpartallimi i ushtrisë së armiqve për shkak se hyri në sytë e atyre të gjithëve pluhuri i pakët në grushtin e tij që ua hodhi atyre, ashtu siç e tregon vërseti Kuranor,

"Dhe nuk e hodhe ti (pluhurin në sytë e armikut, o Muhammed a.s.m.) kur e lëshove nga grushtet e tua, por e hodhi Allahu"[79].

Dhënia për të pirë ujë ushtrisë së tij të etur nga uji që buroi si burimi i *Keutherit* prej pesë gishtave të tij të bekuar.. si dhe qindra mrekulli të tjera që u shfaqën në duart e tij të cilat na janë transmetuar neve në mënyrë të saktë e të sigurtë, sipas vërseteve të qarta kur'anore ose sipas haditheve që gëzojnë statusin e "*Tavattur*".

Meqenëse disa prej atyre mrekullive, që janë më shumë se treqind, janë shtjelluar me prova vendimtare në veprën e shquar e të mrekullueshme që titullohet *"Mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m."* -Letra e Nëntëmbëdhjetë-, ne ia lëmë asaj vepre diskutimin e mrekullive, dhe le ta lëmë udhëtarin të vazhdojë së foluri.

---

[78] Kuran 54: 1
[79] Kuran 8:17

Pastaj ai i foli vetes së tij duke i thënë: “Një qënie që përveç të gjitha këtyre veçorive fisnike dhe virtyteve të larta ka të gjitha këto mrekulli të ndritshme për t’i demonstruar, sigurisht ai duhet të jetë më i vërteti në fjalë prej të gjithë njerëzve...

Do të ishte krejtësisht e pamundur dhe e pazakonshme që ai të zbriste në dredhi, në gënjeshtër e në iluzion, të cilat janë veprat e njerëzve të ligj.

E Dyta: Qënia e Kuranit i cili është në dorën e tij, duke qënë mrekulli në shtatë mënyra të ndryshme, atë dekret që u lëshua prej Pronarit të Universit, e pranojnë dhe e vërtetojnë më shumë se treqind milion njerëz në çdo shekull. Meqenëse Fjala e Njëzet e Pestë, domethënë trajtesa e “*Mrekullive të Kuranit*” e cila është dielli i Risale-i Nurit ka provuar me argumente të fuqishëm se ky Kur’an Kerim është mrekulli prej dyzet aspektesh të ndryshëm, dhe se ai është Fjala e Zotit të të gjithë botëve, udhëtari ia referoi asaj trajtese të shquar shpjegimin e hollësishëm të mrekullisë së tij. Pastaj tha:

Besniku i Fjalës së Allahut, interpretuesi i vërtetë i tij, përçuesi i këtij lajmi të madh tek të gjithë njerëzit, dhe i cili është pikërisht e vërteta dhe vetë realiteti, prej tij nuk mund të burojë kurrë ndonjë gënjeshtër, dhe ai nuk do të jetë kurrë objekt dyshimi; sepse kjo do të ishte një shkelje ndaj atij dekreti dhe tradhti ndaj Atij i Cili e lëshoi atë.

E Treta: Ai a.s.m. u dërgua me një sheriat -ligj- të pastër, me një fe të natyrshme, me një adhurim të sinqertë, me një dua të përgjëruar, me një thirrje të gjithanshme dhe me një besim -iman- të ngulitur; as nuk ka pasë si shembulli i asaj për të cilën ai u dërgua dhe as nuk do të ketë; as nuk ka ekzistuar një formë më e plotë se ajo për të cilën ai u dërgua dhe as nuk do të ekzistojë. Sepse ‘Sheriati’ i cili u shfaq prej një analfabeti a.s.m. dhe -ai sheriat- administroi një të pestën e njerëzimit për katërmbëdhjetë shekuj në një mënyrë të drejtë e të saktë nëpërmjet ligjeve të tij të holla e të shumta, nuk pranon kurrë ndonjë rival.

Po kështu ‘islami’, i cili u shfaq prej veprave, thënieve dhe prej gjendjeve të brendshme të atij që ishte analfabet a.s.m., nuk ka rival, as nuk ka ardhur dhe as nuk do të vijë si shembulli i tij; sepse në çdo shekull ai- islami- ka qenë për treqind milion njerëz një udhëzues dhe strehë, mësuesi dhe edukatori i mendjeve të tyre, ndriçuesi dhe pastruesi i zemrave të tyre, shkaku për pastrimin dhe zhvillimin e

personave të tyre dhe burimi i progresit dhe i përparimit të shpirtërave të tyre..

Profeti a.s.m. gjithashtu është i pakrahasueshëm në të gjitha llojet e ibadeteve të cilat i përmban feja e tij; devocioni i tij i madh dhe frika e tij e madhe prej Allahut, përpjekja dhe aktiviteti i tij i vazhdueshëm dhe kryerja e detyrave të tij të adhurimit në mënyrë të plotë dhe me vëmendjen më të madhe për dimensionet e tyre më të thella, për misteret më të holla të adhurimit brenda gjendjeve dhe rrethanave më të vështira, dhe përmbushja e atij adhurimi të sinqertë nga ana e profetit Muhammed a.s.m. duke mos imituar askënd, duke kombinuar në mënyrën më të plotë dhe me të gjitha kuptimet e tij fillimin dhe fundin e adhurimit. Nuk ka dyshim se as nuk është parë dhe as nuk do të shihet si shembulli i tij lidhur me kryerjen e ibadeteve.

Gjithashtu ai a.s.m. e përshkruan Krijuesin e tij nëpërmjet ***Xheushan El-Kebir*** -që është njëra prej mijëra duave e lutjeve të tij- e përshkruan Zotin xh.sh. me një shkallë të tillë të lartë njohjeje saqë atë shkallë njohjeje nuk e arritën të gjithë *A'rifînët* -njohësit- dhe *Evliatë* -shenjtorët-dhe ata të gjithë nuk kanë qenë në gjendje as ta arrijnë atë shkallë përshkrimi qysh prej lashtësisë.. Kjo tregon se ai është i pakrahasueshëm në 'dua'. Cilido që do ta shikonte pjesën në fillimin e trajtesës së "*El-Munaxhat*" rreth lutjeve, e cila shtjellon një paragraf të vetëm prej nëntëdhjetë e nëntë paragrafëve të ***Xhushan e El-Kebir,*** sigurisht do të thonte se kjo dua e shkëlqyeshme -***Xhaushani***- e cila përfaqëson kulmin e njohjes Hyjnore, është e pakrahasueshme -e pashoqe.

Gjithashtu në përcjelljen e mesazhit të tij dhe në thirrjen që u bëri njerëzve për tek e vërteta, ai a.s.m. shfaqi një qëndrueshmëri të tillë, një vendosmëri dhe një guxim të tillë saqë megjithëse shtete dhe fe të mëdhaja, dhe madje edhe vetë populli i tij, fisi dhe xhaxhai i tij e kundërshtuan atë në mënyrën më armiqësore, përsëri ai nuk shfaqi as edhe shenjën më të vogël të ngurimit, të ankthit apo të frikës. Fakti se ai sfidoi me sukses të gjithë botën dhe e bëri islamin profesorin e botës, gjithashtu provon se nuk ka edhe nuk mund të jetë askush si ai a.s.m. lidhur me komunikimin e mesazhit dhe me thirrjen për tek e vërteta.

Në besimin e tij, ai kishte një fuqi aq të jashtëzakonshme, një siguri aq të mrekullueshme, një gjallëri aq të mahnitshme dhe një bindje aq të lartë duke mbushur me dritë të gjithë botën, saqë nuk mundën të ndikonin tek ai të gjitha idetë, besimet, filozofitë e të urtëve dhe mësimet e udhëheqësve fetarë që dominonin në atë shekull, të

gjitha këto nuk qenë në gjendje të ndikonin në besimin e tij as me ndonjë dyshim, ngurrim, dobësim apo me ndonjë iluzion. Po, ato nuk mundën të ndikonin në sigurinë e tij, as në besimin e tij, as në mbështetjen e tij tek Allahu dhe as në qetësinë e tij tek Ai, pavarësisht armiqësisë dhe mohimit të skajshëm të tyre ndaj tij. Për më tepër, frymëzimi, inspirimi i të gjithë atyre që u ngjitën në nivelet shpirtërore dhe në shkallët e besimit prej njerëzve të shenjtërisë dhe të drejtësisë, me në krye Sahabët e nderuar, dhe përfitimi i tyre vazhdimisht duke marrë shkëlqim prej shkallës së besimit të tij dhe që të gjithë ata e shikuan se ai është në më të lartin e niveleve dhe të shkallëve. E gjitha kjo shfaq në mënyrë të vetëkuptueshme se besimi i tij a.s.m. është gjithashtu i pakrahasueshëm dhe i pashoq.

Ndërkaq, udhëtari ynë kuptoi dhe vërtetoi me mendjen e tij se gënjeshtra e dyshimi nuk kanë asnjë vend tek ai i cili solli një sheriat të tillë të shenjtë të pashoq, një islam të tillë të pakrahasueshëm, një adhurim të pastër të parival, një dua të tillë të shkëlqyer të jashtëzakonshme, një thirrje të tillë universale e të gjithanshme dhe një besim të tillë të mrekullueshëm.

Prova e Katërt: Unanimiteti i të gjithë profetëve paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, dhe konsensusi i tyre lidhur me pikërisht të vërtetat e besimit është një provë e fuqishme për ekzistencën dhe për Unitetin e Allahut xh.sh.; dhe gjithashtu është një dëshmi e fortë për vërtetësinë dhe profetësinë e këtij profeti a.s.m.. Sepse të gjitha cilësitë e shenjta, mbrekullitë dhe funksionet që tregojnë vërtetësinë dhe profetësinë e atyre pejgamberëve a.s. gjendeshin si ato dhe më të plota se ato në atë personalitet a.s.m., ashtu siç dëshmohet e konfirmohet nga historia. Të gjithë ata profetë a.s. njoftuan gojarisht, me gjuhën e fjalës -domethënë me Teurat, Inxhil, Zebur dhe me fletët që ndodheshin në duart e tyre- për ardhjen e këtij personaliteti të bekuar dhe sihariquan njerëzit për ardhjen e tij a.s.m. (saqë më shumë se njëzet prej shembujve më vendimtarë të këtyre sihariqeve -lajmeve të gëzueshme- të nxjerra prej shkrimeve të shenjta, prej atyre librave qiellorë, janë shtjelluar dhe provuar në Letrën e Nëntëmbëdhjetë e cila titullohet "*Trajtesa e mrekullive të profetit Muhammed a.s.m.*") . Ashtu siç sihariquan ata për ardhjen e tij a.s.m. po ashtu ata e vërtetojnë atë a.s.m. nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tyre -domethënë, nëpërmjet profetësisë dhe mrekullive të tyre- dhe përfundojnë me konfirmimin e tyre për vërtetësinë e thirrjes së tij a.s.m.. Sepse ai është paraprijësi më i plotë, i pari dhe më i plotësuari në misionin e profetësisë dhe në thirrrjen për tek Allahu xh.sh..

Udhëtari kuptoi se ashtu siç tregojnë ata -domethënë ata profetë- nëpërmjet gjuhës së fjalës dhe me konsensus për Unitetin Hyjnor, po ashtu ata dëshmojnë nëpërmjet gjuhës së gjendjes dhe me unanimitet për vërtetësinë e këtij profeti fisnik a.s.m..

Prova e Pestë: Gjithashtu me mijëra Evlija të cilët arritën tek e vërteta, realiteti, plotësimi, kerameti, zbulesat dhe shikimet e dëshmimet nëpërmjet instruktimit dhe udhëzimit të këtij profeti fisnik a.s.m. dhe duke e ndjekur atë, -e gjitha kjo- jep një dëshmi me unanimitet jo vetëm për Unitetin Hyjnor por gjithashtu edhe për vërtetësinë dhe profetësinë e këtij profeti fisnik -për profesorin dhe imamin e tyre.

Përsëri, fakti se ata shikojnë, nëpërmjet dritës së shenjtërisë, disa prej të vërtetave që ai i njoftoi lidhur me botën e padukshme, dhe se ata i besojnë dhe i vërtetojnë të gjitha ato të vërteta nëpërmjet dritës së besimit -ose me njohjen e sigurisë, ose me shikimin e sigurisë, ose me sigurinë absolute- kjo demonstron qartë si dielli shkallën e vërtetësisë së udhëzuesit të tyre më të madh dhe drejtësinë e mësuesit të tyre më të shquar a.s.m.. Kjo gjithashtu u kuptua nga udhëtari ynë.

Prova e Gjashtë: Me miliona dijetarë e shkollarë të pastër, të sinqertë e të saktë dhe gjeni të urtë prej besimtarëve kanë arritur stacionin më të lartë të dijes në sajë të asaj që mësuan prej të vërtetave të shenjta që i solli ky profet fisnik a.s.m. -pavarësisht se ai ishte analfabet- dhe në sajë të asaj që mësuan nga shkencat e larta që buruan prej atyre të vërtetave të shenjta dhe prej Njohjes Hyjnore që ai zbuloi.. Të gjithë këta, ashtu siç provojnë dhe mbështesin me unanimitet dhe me argumentet më të fuqishëm, Unitetin Hyjnor, i cili është themeli i misionit dhe i thirrjes së tij, po ashtu ata dëshmojnë me unanimitet për vërtetësinë e këtij mësuesi më të madh dhe për drejtësinë e këtij profesori më të shquar dhe për saktësinë e fjalës së tij a.s.m.. Atëherë, kjo dëshmia e tyre është një provë e qartë si dita për vërtetësinë e tij dhe për drejtësinë e mesazhit të tij. Risale-i Nuri gjithashtu me pjesët e tij që kalojnë mbi njëqind është veçse një provë e vetme e vërtetësisë dhe e drejtësisë së këtij profeti të dashur a.s.m..

Prova e Shtatë: Grupimi i madh që quhet "***El-A'l Vel As'hab"*** "*Familja dhe Sahabët e profetit a.s.m*.", të cilët me intuitën e tyre, me njohurinë dhe me arritjet e tyre shpirtërore janë më të shquarit, më të respektuarit, më të lavdëruarit, më të devotshmit në fe, më symprehtët dhe më të lartësuarit e njerëzve pas profetëve, i hetuan, i studiuan dhe i shqyrtuan me vëmendjen më të madhe, me seriozitet dhe me saktësi, të gjitha gjendjet, mendimet dhe rrethanat e këtij profeti fisnik a.s.m.,

qofshin ato të fshehura apo të hapura. Pastaj ata erdhën në një konkluzion unanim se ai a.s.m. në dynja ishte, më i vërteti në fjalë, më i larti i tyre në pozitë dhe më i devotshmi e më i kapuri fort pas të vërtetës dhe realitetit. Udhëtari kuptoi se ky vërtetimi i tyre i patundur dhe besimi i tyre i thellë është një provë e ndritshme ashtu siç tregon dita për dritën e diellit.

Prova e Tetë: Ashtu siç tregon ky kozmos autorin e tij, shkruesin dhe formëdhënësin e tij i Cili e krijoi, e administron dhe e rregullon, si dhe nëpërmjet paracaktimit të masës së tij, formimit dhe rregullimit ka autoritet e kontroll mbi të sikur ai të ishte një pallat luksoz ose si një libër i madh, ose si një ekspozitë e mahnitshme ose si një shfaqje madhështore, po ashtu ai padyshim thëret dhe kërkon medoemos ekzistencën e dikujt i cili të shprehë kuptimet që përmban ky libër i madh, të dijë dhe të bëjë të ditur qëllimet Hynore prapa krijimit të universit, të japë mësim urtësitë Hynore në ndryshimet dhe në transforimet e tij, të japë instruksion për rezultatet e lëvizjeve të tij funksionale, të shpallë vlerën e tij esenciale dhe plotësimet e qënieve brenda tij. Domethënë, kërkon medoemos një lajmëtar të lartë, një thirrës të vërtetë, një profesor të ditur dhe një njoftues ekspert. Ndërkohë udhëtari kuptoi se kozmosi -me këtë kërkesë- tregon dhe dëshmon për vërtetësinë e këtij profeti fisnik a.s.m. dhe për drejtësinë e tij i cili i përmbushi këto funksione e detyra më mirë se çdo kush tjetër, dhe për qënien e tij më i lartësuari dhe i dërguari më besnik i Zotit të të gjitha botëve.

Prova e Nëntë: Ndodhet pas perdes Një i vetëm i Cili dëshiron të demonstrojë me këto artifakte gjeniale e të urta plotësimin e talentit dhe të artit të Tij; dëshiron ta bëjë Vetveten të njohur e të dashur nëpërmjet këtyre krijimeve të panumërta të stolisura e të dekoruara; dëshiron të bëjë të detyrueshme dhënien e falënderimeve dhe të lavdërimeve ndaj Tij nëpërmjet mirësive të panumërta të çmueshme e të kënaqshme të cilat Ai i ka dhuruar.. t'i nxisë njerëzit për tek adhurimi ndaj Hyjnisë së Tij me një adhurim që karakterizohet me dashuri, me mirënjohje dhe me falënderime ndaj këtij furnizimi të përgjithshëm me ushqime jetike dhe përballë këtij zhvillimi e rritjeje, me dhembshuri dhe mbrotje (saqë Ai përgatit ushqime dhe gosti Hyjnore në një mënyrë të tillë saqë kënaq e ngop edhe më të hollat e shijeve të gjuhëve dhe të gjitha llojet e orekseve)... dhe dëshiron t'i bëjë njerëzit që të besojnë në Hyjninë e Tij, me nënshtrim, përulësi e bindje ndaj Hyjnisë së Tij të Cilën e shfaq me ndryshimin e stinëve, me ndryshimin e natës dhe të ditës dhe nëpërmjet ndryshimeve të të gjitha gjërave të ngjashme me këto, të veprave të Tij madhështore,

zhvillimeve të mëdha, aktivitetit të mahnitshëm dhe krijueshmërisë plot urtësi.. Dhe dëshiron të demonstrojë drejtësinë dhe vërtetësinë e Tij në të gjitha kohët duke mbrojtur virtytin dhe të virtytshmit dhe duke shkatërruar të keqen dhe të këqinjtë, duke i asgjësuar me goditje qiellore shtypësit dhe gënjeshtarët.. Nuk ka dyshim se krijesa më e dashur tek Ai i Cili është i mbuluar me të padukshmen, dhe robi e shërbëtori më i vërtetë për Të është ai që ka punuar dhe që u ka shërbyer me sinqeritet qëllimeve të Tij të cilat u përmendën lart; ai që ka zgjidhur e ka sqaruar misterin më të madh në krijimin e kozmosit dhe që ka zbuluar e shpjeguar enigmën e tij, dhe ai i cili përpiqet e vepron gjithmonë në emrin e Krijuesit të tij, i cili kërkon ndihmë, forcë e sukses vetëm prej Tij në çdo gjë dhe që i merr ato vetëm prej Tij xh.sh.. Atëherë kush do të mund të ishte tjetër kush përveç Muhmmed Kurejshiut a.s.m.!

Pastaj udhëtari iu adresua mendjes së tij duke i thënë: “Meqenëse këto nëntë të vërteta dëshmojnë e provojnë vërtetësinë e këtij profeti fisnik a.s.m., atëherë nuk ka dyshim se ai është boshti i krenarisë së botës dhe burimi i nderit të njerëzimit, dhe ai është i denjë dhe i merituesheëm të quhet krenaria e botëve dhe lavdia e bijve të Ademit. Fakti që sovraniteti madhështor i atij dekreti të të Gjithëmëshirshmit i cili është Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm, të cilin ai e mban në dorë, ka pushtuar gjysmën e botës, së bashku me plotësimet e tij individuale dhe me virtytet e larta, tregon se ai është njeriu më i madh në ekzistencë, ai është ky profet madhështor. Dhe fjala më e rëndësishme lidhur me Krijuesin tonë është fjala e tij a.s.m..

Eja o mendja ime, dhe shiko! Themeli i të gjitha thirrjeve të këtij profeti fisnik a.s.m. dhe qëllimi i të gjithë jetës së tij është dëshmia për ekzistencën e Ekzistuesit të domosdoshëm, për të provuar Unitetin e Tij, për të shpjeguar Atributet e Tij Madhështore dhe për të shfaqur Emrat e Tij të bukur; dhe vërtetimi i të gjithë kësaj, shpallja dhe njoftimi mbështeten tek fuqia e dhënë prej qindra mrekullive të tij vendimtare, të ndritshme e të qarta të cilat i shfaqi Allahu nëpërmjet tij dhe prej mijëra të vërtetave themelore të ngulitura të përfshira në fenë e tij.

Domethënë, dielli shpirtëror i cili e ndriçon këtë kozmos dhe argumenti i ndritshëm për ekzistencën e Krijuesit tonë xh.sh. dhe për Unitetin e Tij është ky profet fisnik të cilin e thërrasim ***Habibull-llah,*** *i Dashuri i Zotit*. Ndodhen tre lloje të mëdhaja konsensusi të pagabueshëm që secili prej tyre pohon, konfirmon e mbështet dëshminë e tij a.s.m.

Konsensusi i Parë**:* Konsensusi me unanimitet i bërë prej asaj asambleje të ndritshme, të shquar e të njohur gjithandej botës si: ***"A'L Muhammed", *Famlja e profetit Muhammed a.s.m.".*

Ajo asamble e ndritshme të cilën e paraprin imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe i cili tha: "Edhe në qoftë se do të ngrihej -hiqej- perdja, siguria ime nuk do të shtohej"; dhe pas tij janë me mijëra Evlija të mëdhenj që kanë intuita të mprehta dhe shikime që depërtojnë tek e padukshmja si shembulli i Shejh Gejlanit -iu shenjtëroftë sekreti i tij- i cili pa Fronin më të lartë dhe formën madhështore të Israfilit ndërsa vetë ishte akoma në tokë.

Konsensusi i Dytë: Konsensusi me unanimitet i bërë prej xhematit të njohur si ***Sahabët*** e nderuar, Zoti qoftë i kënaqur prej tyre, të cilët janë të shquar në të gjithë botën; dhe vërtetimi i tyre me unanimitet dhe me një besim të ngulitur e të fuqishëm për këtë profet fisnik a.s.m. saqë ai i shtyu ata që t'i sakrifikonin edhe shpirtërat e tyre, pasurinë e tyre, baballarët e tyre dhe fiset e tyre; janë ata të cilët e gjetën vetveten midis një populli primitiv dhe në një mjedis analfabet, i zbrazur e i zhveshur nga dukuritë e jetës sociale dhe nga mendimet politike, që nuk kishin udhëzim dhe as ndonjë libër ndriçues; të cilët ishin të zhytur e të humbur në errësirën e periudhës midis profetëve; dhe të cilët në një kohë shumë të shkurtër u bënë profesorët, udhëzuesit, politikanët dhe sundimtarët e drejtë të popujve dhe të shteteve më të civilizuara dhe të përparuara nga ana shkencore, politike dhe shoqërore, dhe e sunduan botën nga lindja në perëndim dhe flamurët e drejtësisë së tyre u valëvitën nga toka dhe deti.

Konsensusi i Tretë: Është vërtetimi dhe konfirmimi i grupit madhështor të dijetarëve të përpiktë të cilët depërtuan thellë në shkencat e tyre dhe që me mijëra dalin e lulëzojnë në ummetin e tij dhe ndjekin metoda e medhhebe të ndryshme; dhe të cilët përparojnë në mënyrë të çuditshme në çdo shkencë dhe punojnë në fusha të ndryshme. Atëherë, vërtetimi i të gjithë këtyre për të me unanimitet dhe me shkallën e njohjes së sigurisë, sa kansensus i madh është!

Udhëtari gjykoi se dëshmia e këtij profeti analfabet a.s.m. për Unitetin Hyjnor nuk është një dëshmi personale dhe e pjesshme, por e përgjithshme, universale e ngulitur dhe e patundur. Edhe sikur të bashkoheshin të gjithë shejtanët që ekzistojnë, ata nuk do të mund ta sfidonin atë. I tillë ishte përfundimi i arritur nga udhëtari.

Në lidhje me mësimin e mësuar në shkollën e dritës nga ai udhëtar nëpër botë, ai udhëtar në jetë, kur ai shëtiti me mendjen e tij në

shekullin e lumturisë, ne folëm në fundin e Shkallës së Gjashtëmbëdhjetë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El -Vaxhibul Vuxhudi...]

• • •

Udhëtari i palodhshëm dhe i pangopur, i cili mësoi se qëllimi i jetës në këtë botë, madje jeta -esenca- e jetës është vetëm se besimi, iu adresua zemrës së tij duke i thënë: "Fjala e Atij të Cilin ne po e kërkojmë është më e famshmja, më e vërteta, më e ndritshmja dhe më e urta; ajo ka sfiduar në çdo shekull cilindo që ka refuzuar t'i nënshrohet asaj; ajo fjalë është kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm...

Atëherë le ta shqyrtojmë këtë libër dhe të kuptojmë se çfarë thotë ai... Por le të qëndrojmë për një çast para se ne të hyjmë në këtë botë të bukur që të hulumtojmë e studiojmë atë që na bën neve ta vërtetojmë me siguri se ky libër është prej Krijuesit tonë... Dhe kështu ai nisi të hulumtojë.

Meqenëse ky udhëtar jetoi në shekullin e tanishëm, ai së pari hodhi vështrimin tek Risale-i Nuri, trajtesat e të cilit janë shkreptimat e mrekullisë shpirtërore të Kuranit kerim. Ai pa se njëqind e tridhjetë pjesët e tij janë në vetvete një komentim i çmuar i vërseteve të Furkanit -Kuranit. Dalluesit të së drejtës nga e shtrembëra sepse ai -Risale-i Nuri- zbulon pikat e tyre të holla dhe dritat e tyre vezulluese.

Megjithëse se Risale-i Nuri i ka përhapur të vërtetat e Kuranit me një xhihad -luftë e përpjekje- të vazhdueshme në të gjitha horizontet e drejtimet në këtë shekull kryeneç ateist, askush nuk ka mundur ta kundërshtojë apo ta kritikojë atë, gjë që provon se profesori i tij, burimi i tij, autoriteti i tij dhe dielli i tij është Kurani kerim i cili sigurisht është qiellor prej Fjalës së Zotit të të gjitha botëve dhe jo fjalë njeriu. Saqë Fjala e Njëzet e Pestë dhe fundi i "Letrës së Nëntëmbëdhjetë" janë një provë e vetme midis qindra provave të cilat i demonstron Risale-i Nuri për të shpjeguar mrekullinë e Kuranit; ajo provë e vetme e përfshirë në ato dy trajtesa i provon dyzet aspektet e mrekullisë së Kuranit në një mënyrë të tillë saqë cilido që e shikon atë, duke qëndruar larg shfaqjes së ndonjë kritike apo kundërshtimi, admiron argumentet e saj dhe shpreh lëvdata vlerësuese.

Udhëtari e la për Risale-i Nurin që t'i provojë aspektet e Mrekullisë së Kuranit Kerim dhe se ai është Fjala e vërtetë e Allahut; dhe u kthye vetëm tek një tregues i shkurtër prej pak pikash duke treguar madhësinë e tij.

Pika e parë: Ashtu si Kurani Kerim me të gjitha mrekullitë dhe me të vërtetat e tij duke treguar vërtetësinë e tij është mrekulli për profetin Muhammed a.s.m., po ashtu edhe Muhammedi a.s.m. me të gjitha mrekullitë e tij, me provat e profetësisë së tij dhe me plotësimet e tij në njohje është gjithashtu mrekulli për Kuranin Kerim, dhe është një provë vendimtare se Kurani Kerim është Fjala e Allahut, Zotit të të gjitha botëve.

Pika e dytë: Kurani Kerim e transformoi jetën shoqërore me një ndryshim madhështor, i ndriçoi horizontet dhe i mbushi ato me lumturi dhe me të vërteta; ai shkaktoi një revolucion të madh si në nefset dhe në zemrat e njerëzve, po ashtu edhe në shpirtërat dhe në mendjet e tyre, si dhe në jetën e tyre individuale, shoqërore e politike; dhe bëri që ky revolucion të përjetësohej e të vazhdonte në një mënyrë të tillë, saqë gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë vërsetet e tij lexohen e recitohen qysh prej katërmbëdhjetë shekujsh në çdo moment nga gjuhët e më shumë se njëqind milion njerëzve me gjithë respekt e nderim; ai i ka edukuar njerëzit, ka dëlirësuar personat e tyre dhe ka pastruar zemrat e tyre. Për shpirtërat ai ka qenë mjeti i zhvillimit dhe i përparimit; për mendjet ka qenë orientim e dritë, dhe për jetën ka qenë vetë jeta dhe lumturia. Sigurisht ky libër është i pakrahasueshëm, është i pashoq; ai është i jashtëzakonshëm, është një çudi, është mrekulli.

Pika e tretë: Kurani Kerim, qysh prej atij shekulli deri në kohën tonë, ka demonstruar një elokuencë të tillë saqë bëri që vlera që u jepej poemave të njohura si ***"El-Mual-Lekatu-Es-Seb'A"*** *"Shtatë poemat e varura"* të cilat ishin poezitë e poetëve më elokuentë dhe që ishin shkruar me ar dhe ishin varur në muret e Qabesë, bëri që të zhvlerësoheshin e të katandiseshin deri në atë pikë saqë e bija e Lebidit, kur po e ulte poshtë poezinë e babait të saj prej murit të Qabesë, tha: "E krahasuar me vërsetet e Kuranit, kjo nuk ka më asnjë vlerë; Tani që erdhën vërsetet ti dhe ato si shembulli yt nuk keni më vend këtu."

Gjithashtu kur një poet nomad dëgjoi këtë vërset duke u recituar, "***Fasda'ë bima tuëmer",*** *"Prandaj, shpalle hapur atë që je urdhëruar..."*[80], ai menjëherë ra përtokë në sexhde. Ata e pyetën: "A u bëre musliman?" Jo, u përgjigj ai, "Unë bëra sexhde përpara elokuencës së këtij vërseti." Po kështu, me mijëra dijetarë e shkollarë prej gjenive të shkencës së Retorikës të tillë si: Abdul Kahir Xhurxhani, Sekkaki dhe Zamahsheriu

[80] Kuran 15: 94

kanë miratuar e konkluduar me unanimitet se, *"Elokuenca e Kuranit është përtej aftësisë dhe kapacitetit njerëzor dhe është e paarritshme"*.

Gjithashtu, Kurani Kerim qysh në kohën kur u shpall -dhe akoma- vazhdon t'i sfidojë të gjithë letrarët, retoricienët kryeneçë dhe egoistë, dhe u tha atyre në një mënyrë të paramenduar për të thyer arrogancën dhe kokëfortësinë e tyre: Ejani dhe prodhoni një sure të vetme si ajo e Kuranit, ose ndryshe pranoni shkatërrimin, humbjen dhe poshtërimin në këtë botë dhe në Ahiret". Kur Kurani e shpalli këtë sfidën e tij, retoricienët kryeneçë të atij shekulli e lanë rrugën e shkurtër të prodhimit të një sureje të vetme si të Kuranit, dhe në vend të saj zgjodhën rrugën e gjatë, rrugën e luftës e cila do të sillte shkatërrim e mjerim për shpirtërat dhe për pasuritë e tyre. Kjo zgjedhja e tyre provon se nuk mund të ecët në atë rrugë të shkurtër.

Gjithashtu, me miliona libra në arabisht janë në qarkullim; disa prej tyre janë shkruar prej miqve të Kuranit me qëllim që t'i përngjasojnë dhe ta imitojnë atë; të tjerët janë shkruar prej armiqve të tij me qëllim që ta kundërshtojnë e ta kritikojnë atë. Asnjëri prej atyre librave të shkruar nuk ka qenë në gjendje ta arrijë nivelin e Kuranit dhe as t'i afrohet stilit të tij qysh prej asaj kohe e gjer tani -pavarësisht progresit e përparimit në letërsi. Madje edhe sikur një njeri i zakonshëm ta dëgjonte kur recitohet Kurani Kerim, do të detyrohej të thonte se, "Ky Kuran nuk u ngjason asnjërit prej këtyre librave, dhe asnjë njeri, cilido qoftë ai, asnjë mohues dhe asnjë idiot nuk do të jetë në gjendje të thotë: se ai është poshtë tyre, atëherë shkalla e elokuencës së tij është sipër të gjithë atyre. Njëherë një njeri recitoi vërsetin, *"Gjithë ç'është në qiej dhe në tokë lavdërojnë Allahun",*[81] pastaj tha: "Unë nuk e shoh aspektin e mrekullueshëm, të cilin ju e shihni, në elokuencën e këtij vërseti".

Atij iu tha: "Kthehu prapa me imagjinatën tënde -ashtu si ky udhëtar- tek ai shekull dhe dëgjoje vërsetin sikur recitohet atje." Duke imagjinuar vetveten se është atje para shpalljes së Kuranit Kerim, ai pa se të gjitha qëniet e botës ishin të flakura në një hapësirë të zbrazur të madhe të pakufishme, në një dynja të përkohshme kalimtare, dhe ajo ishte në një gjendje të mjeruar, në konfuzion e në errësirë; ishte e pajetë, e pavetëdijshme dhe pa qëllim e pa detyrë.

Mirëpo me të dëgjuar këtë vërset të Kuranit Kerim dhe me ta shqyrtuar, papritmas ai sheh se ky vërset hoqi një perde prej fytyrës së universit dhe prej fytyrës së të gjithë botës derisa u duk e ndriçuar dhe

[81] Kuran 57:1

rrezatuese; dhe kjo fjalë e parapërjetshme dhe ky dekret i amshuar dha një mësim për të gjitha qëniet e vetëdijshme, për të zgjedhurit sipas të gjithë shekujve dhe duke demonstruar për ta se, ky kozmos është si një xhami madhështore, dhe se të gjitha krijesat -veçanërisht qiejt dhe toka- janë të zhytura në një përmendje vitale të Zotit, në *Dhikr*, në *Tehlil*, dhe në *tesbihate*. Të gjithë ishin ngjitur tek detyrat dhe tek funksionet e tyre me të gjithë zellin e kënaqësinë dhe i kryenin ato me gëzim e mirënjohje...

Të gjithë këtë e vëzhgoi udhëtari ynë. Kështu duke shijuar shkallën e lartësisë së elokuencës së Kuranit dhe duke i krahasuar edhe vërsetet e tjera nëpërmjet analogjisë, kuptoi misterin lidhur me pushtimin dhe mbisundimin e elokuencës së rrallë të Kuranit mbi gjysmën e globit tokësor dhe mbi një të pestën e njerëzimit, dhe mësoi një shembull të vetëm urtësie prej mijëra urtësive për vazhdimësinë e pandërprerë të monarkisë së respektuar e madhështore të Kuranit Kerim për katërmbëdhjetë shekuj.

Pika e Katërt: Kurani ka demonstruar një ëmbëlsi të tillë të vërtetë, saqë ndërsa përsëritja e shpeshtë e gjësë më të ëmbël shkakton mërzitje, ai nuk i shkakton mërzitje atij që nuk i është prishur zemra dhe që nuk i është prishur shija, madje përsëritja e recitimit të tij shton shijen dhe ëmbëlsinë e tij. Kjo është një çështje e pranuar tek të gjithë qysh prej atij shekulli, saqë është bërë si proverbë.

Për më tepër, Kurani demonstron një freski të tillë, një rini dhe një origjinalitet, saqë edhe pse ai ka jetuar për katërmbëdhjetë shekuj, dhe ka kaluar nëpër duar të shumta, ai e ruan dhe e mban freskinë e tij ashtu sikur të ishte shpallur tani. Çdo shekull e shikon Kuranin të gëzojë një rini të re, sikur t'i adresohej atij shekulli në mënyrë të veçantë. Gjithashtu, dijetarët e çdo dege të shkencës, megjithëse e mbajnë Kuranin vazhdimisht në anën e tyre me qëllim që të përfitojnë prej tij, dhe vazhdimisht ndjekin metodën e tij të shpjegimit, shohin se Kurani ruan origjinalitetin e stilit të tij dhe mënyrën e shpjegimit të tij.

Pika e Pestë: Kurani Kerim e ka shtrirë njërin prej krahëve të tij drejtë së shkuarës dhe tjetrin drejtë së ardhmes -njërin krahë e ka në të shkuarën dhe tjetrin në të ardhmen. E vërteta mbi të cilën kanë rënë dakort profetët e mëparshëm është rrënja e Kuranit dhe njëri nga krahët e tij; ajo -e vërtetë- mbështet dhe i konfirmon ata; edhe ata gjithashtu e mbështesin dhe e vërtetojnë atë me gjuhën e unanimitetit.

Gjithashtu, Evlijatë e drejtë dhe dijetarët e pastër janë frutet që marrin jetë prej pemës së Kuranit Kerim. Kështu plotësimi e përparimi

i tyre shpirtëror tregon se pema e tyre e bekuar është e gjallë, dhe e begatë, është me shkëlqim të vazhdueshëm, e rrënjosur dhe e ngulitur- dhe mjet që të çon tek e vërteta; Dhe ata të cilët rriten e jetojnë nën mbrojtjen e krahut të saj të dytë dhe jetuan nën hijen e saj prej njerëzve të të gjitha tarikateve të vërteta të Shenjtërisë dhe prej dijetarëve të të gjitha dijeve të sakta të islamit dëshmojnë se Kurani është e vërteta e pastër dhe grumbullimi i të vërtetave, dhe në gjithëpërfshirjen dhe gjithanshmërinë e tij, ai është një mrekulli e ndritshme.

Pika e Gjashtë: Vërtetësia e Kuranit dhe drejtësia e tij tregojnë se gjashtë aspektet e tij janë të ndritshëm. Po, shtyllat e argumentit dhe të provës, janë nën të; shkreptimat e stampës së mrekullisë sipër tij; dhuratat e lumturisë në këtë botë dhe në tjetrën para tij -qëllimi i tij; të vërtetat e shpalljes qiellore, *vahjit*- domethënë, pika e mbështetjes, prapa tij; pranimi dhe konfirmimi i mendjeve të drejta të panumërta në të djathtën e tij; dhe qetësia e vërtetë, tërheqja e sinqertë dhe nënshtrimi i zemrave të shëndosha dhe i ndërgjegjeve të pastërta në të majtën e tij; të gjitha këto -gjashtë aspekte- provojnë se Kurani Kerim është një kështjellë e fortë qiellore në tokë, e pasulmueshme, e pacënueshme dhe e mahnitshme.

Gjithashtu ndodhen gjashtë 'Stacione' që konfirmojnë se ai është pikërisht vërtetësia dhe e drejta e pastër. Ai kurrësesi nuk mund të jetë fjalë njeriu. E shtrembëra dhe kotësia nuk mund të gjenden kurrë në të.

I pari i atyre stacioneve është konfirmim për Autorin dhe Rregullatorin e këtij kozmosi, i Cili e ka bërë si praktikën dhe rregullin e Tij që të shfaqë gjithmonë bukurinë në univers, të mbrojë të mirën dhe të drejtën t'i eliminojë mashtruesit dhe gënjeshtarët. Ai xh.sh. e ka mbështetur dhe e ka vërtetuar këtë Kuran duke i dhënë vendin më të respektuar, më të pranuar, më të lartësuar dhe më mbisundues dhe shkallën më të lartë të suksesit në botë.

Gjithashtu ai i cili është burimi i islamit dhe interpretuesi i Kuranit- besimi i tij i ngulitur në të dhe respekti i tij më i madh ndaj Kuranit Kerim duke i kaluar të gjithë në nderim; qënia e tij midis zgjimit dhe gjumit kur zbriste mbi të *Vahji* -kur i vinte shpallja- duke zbritur mbi të pa vullnetin e tij; dhe fjalët dhe bisedimet e tjera duke mos u përngjasuar dhe duke mos ardhur pranë tij -mosarritja e fjalëve të tjera të tij tek synimi i tij- dhe mosngjasimi i tyre me të, pavarësisht se ai ishte më elokuenti i njerëzve; shpjegimi i tij nëpërmjet këtij Kurani nga prapa perdes së të padukshmes lidhur me ngjarjet e vërteta kozmike që kanë ndodhur në të shkuarën dhe që do të ndodhnin në të ardhmen, megjithëse se ishte analfabet, pa asnjë ngurrim me siguri të

plotë; dhe mosshfaqja e asnjë dredhie apo gabimi ose të situatave të ngjashme me këto sado të vogëla që të jenë pavarësisht se ai ishte midis shikimeve të njerëzve më symprehtë duke vëzhguar sjelljet e tij.. atëherë besimi i këtij interpretuesi fisnik dhe i këtij përçuesi të madh a.s.m. dhe konfirmimi i tij me të gjithë fuqinë e tij për çdo dekret e deklaratë të Kuranit Kerim, dhe qëndrueshmëria dhe moslëkundja e tij prej asnjë gjëje sado e madhe të ishte, mbështet dhe konfirmon se Kurani është qiellor, dhe i gjithi është vërtetësi, drejtësi dhe fjalë e bekuar e Zotit Mëshirëplotë.

Gjithashtu, lidhja e një të pestës së njerëzimit, madje e pjesës më të madhe prej tyre me atë Kuran Kerim që shihet para tyre, me një lidhje joshëse dhe kapjeje në fe, duke e dëgjuar atë me seriozitet, me zell dhe me mallëngjim, dhe sipas dëshmisë së shumë treguesve, ngjarjeve dhe ndriçimeve, xhindët, melekët dhe qëniet shpirtërore duke u grumbulluar gjithashtu përreth tij në një mënyrë të vërtetë adhuruese dhe vlerësuese ashtu siç rrotullohen e kthehen fluturat dashuruese të dritës.. E gjitha kjo është një konfirmim e vërtetim se ky Kuran zë pozitën më të lartë dhe më sublime dhe ai pranohet e admirohet nga të gjitha qëniet e kozmosit.

Gjithashtu, të gjitha klasat e njerëzimit duke filluar nga më idiotja dhe më e ulëta deri tek më e zgjuara, më e mprehta dhe më e shkolluara duke marrë pjesën e tyre të plotë prej mësimeve që i jep Kurani Kerim, dhe kuptimi i tyre prej tij të vërtetat më të thella; dhe të gjitha grupet e dijetarëve, veçanërisht Muxhtehidët e Sheriatit -interpretuesit e Sheriatit të shquar-, qindrat e shkencave islame dhe degët e njohjes, dhe shkollarët e ndritshëm e të saktë të teologjisë dhe të parimeve të fesë duke i nxjerrë prej Kuranit dhe duke marrë prej tij të gjitha nevojat dhe përgjigjjet për shkencat e tyre, kjo është një stampë duke konfirmuar e vërtetuar se Kurani Kerim është burimi i të vërtetës dhe minerali i Realitetit.

Gjithashtu, moskundërshtimi i letrarëve arabë të cilët ishin më të përparuarit lidhur me letërsinë, sidomos ata që nuk kishin hyrë në islam -megjithëse kishin dëshirën më të madhe për ta kundërshtuar Kuranin- shmangia dhe pafuqia e tyre përpara një aspekti të vetëm -i cili ishte aspekti i elokuencës- prej shtatë aspekteve më mëdha të mrekullisë së Kuranit, dhe paaftësia e tyre për të prodhuar vetëm një sure të vetme si ato të Kuranit Kerim, shmangia e tyre prej kësaj dhe moskundërshtimi i tij prej oratorëve më të famshëm dhe prej dijetarëve gjenialë që kanë ardhur deri tani, për ndonjë aspekt të mrekullisë së tij -pavarësisht dëshirës së tyre për të fituar famë nëpërmjet

kundërshtimit- dhe qëndrimi i tyre i heshtur në pafuqi prej saj, sigurisht e gjitha kjo është një provë vendimtare se Kurani Kerim është një mrekulli dhe përtej kapacitetit njerëzor.

Po, vlera e fjalës, epërsia dhe elokuenca e saj është e dukshme nëpërmjet njohjes se: *"kush e tha*?" "*kujt ia tha?"* dhe "*përse e tha?"* Atëherë Kurani nuk ka pasë kurrë të barabartë, të ngjashëm me të, dhe asgjë nuk i është afruar kurrë atij. Sepse Kurani Kerim është një ligjërim dhe adresim prej Zotit të të gjitha botëve dhe është fjalim prej Krijuesit të tyre. Kurani është një ligjërim që nuk mund të imitohet- në asnjë aspekt- ai nuk ka asnjë shenjë artificializmi. Pastaj ai të cilit iu adresua Kurani është i dërguar në emër të të gjithë njerëzimit, madje në emrin e të gjitha krijesave; ai është më i nderuari, më i famshmi dhe më i shquari i njerëzve i cili u bë i adresuari; fuqia dhe gjërësia e besimit të tij u bë shkas për islamin madhështor, saqë u ngjit me të tek niveli i ***Kabe Kausejnë****, "Sa largësia e dy harqeve ose edhe më afër"* dhe zbriti i ngarkuar si i adresuari i të Kërkuarit përjetësisht -Krijuesit të Amshuar.

Pastaj, Kurani Kerim i shpjegimit të mrekullueshëm ka shpjeguar rrugën e lumturisë së të dyja botëve, dhe ka sqaruar rezultatin e krijimit të kozmosit, dhe qëllimet Hyjnore brenda tij. Ai gjithashtu shpjegon besimin e lartë e të gjërë që mban ai i adresuar fisnik, besim i cili përfshin të gjitha të vërtetat islame duke treguar çdo anë të këtij universi të madh dhe duke e kthyer atë ashtu si dikush që kthen hartën ose orën para tij. Duke ia bërë të ditur njeriut Autorin e tij Krijues xh.sh., nëpërmjet periudhave dhe përmbysjeve të kozmosit- atëherë sigurisht është krejtësisht e pamundur të prodhohet si shembulli i këtij Kur'ani të shpjegimit të mrekullueshëm; shkalla e mrekullisë së tij nuk mund të arrihet kurrë.

Gjithashtu, mijëra nga dijetarët e lartë e të saktë secili prej tyre ka shkruar komente duke shpjeguar Kuranin, disa prej të cilëve përbëhen prej tridhjetë, dyzet ose madje prej shtatëdhjetë volumesh, duke shfaqur e provuar nëpërmjet dëshmive dhe argumenteve cilësitë e panumërta, pikat e holla, veçoritë, misteret, kuptimet e larta, dhe tregues të shumtë lidhur me njoftimet e shumta të së padukshmes dhe llojet e tyre të ndryshme; atëherë shfaqja e të gjithë këtyre ato veçori duke i provuar të gjitha, sigurisht është një provë vendimtare se Kurani Kerim është një mrekulli e jashtëzakonshme Hyjnore, dhe veçanërisht njëqind e tridhjetë pjesët e Risale-i Nurit, secila prej tyre provon me argumente vendimtare një nga cilësitë e Kuranit dhe një prej pikave të holla të tij. Secila pjesë e Risale-i Nurit -si, *Mrekullia e Kuranit* dhe

Stacioni i Dytë i Fjalës së Njëzet, secila dedukton e nxjerr si përfundim gjëra të shumta prej Kuranit lidhur me çudirat e civilizimit si shembulli i trenit dhe i avionit, dhe *Rrezja e Parë* e quajtur "*Shenjat e Kuranit*", e cila bën të njohur treguesit e vërseteve që aludojnë për Risale-i Nurin dhe Elektricitetin, dhe tetë trajtesat e shkurtëra të quajtura "Tetë Simbolet", të cilat shfaqin se sa të mirërregulluara, sa të holla, sa plot me kuptime dhe sa misterioze janë fjalët e Kuranit, dhe trajtesa e vogël e cila provon në pesë aspekte mrekullinë e vërseteve tek fundi i sures *El-Fet'h* lidhur me njoftimet e tyre për të padukshmen- secila pjesë e Risale-i Nurit shfaq një të vërtetë, një dritë të Kuranit. E gjitha kjo formon një Stampë duke konfirmuar e vërtetuar se Kurani nuk ka të ngjashëm, është i pashoq; ai është mrekulli e çudi; ai është gjuha e botës së padukshme në botën e dukshme; ai është Fjala e Njohësit të të gjitha gjërave të së padukshmes.

Kështu, për shkak të këtyre cilësive dhe veçorive të Kuranit të treguara lart në gjashtë pika, në gjashtë aspekte dhe në gjashtë nivele -stacione-, sovraniteti i tij sublim dhe i ndritshëm dhe sundimi i tij i shenjtë e madhështor ka vazhduar me shkëlqim të plotë duke ndriçuar faqet e shekujve dhe faqen e tokës për një mijë e treqind vite.

Dhe gjithashtu, për hir të atyre veçorive, Kurani fitoi cilësi të shenjta saqë secila nga shkronjat e tij fiton të paktën dhjetë thevabe -shpërblime- dhe dhjetë merita; dhe një pjesë prej vërseteve dhe sureve prodhojnë njëqind, ose një mijë ose më shumë fruta prej frutave të Ahiretit; në kohë të bekuara, drita, shpërblimi dhe vlera e çdo shkronje ngrihet nga dhjetë në qindra..

Udhëtari nëpër botë kuptoi veçori të shenjta si shembulli i këtyre dhe iu adresua zemrës së tij duke i thënë: Në të vërtetë, ky Kuran Kerim i shpjegimit të mrekullueshëm, i cili është kështu i mrekullueshëm në çdo drejtim, nëpërmjet konsensusit të sureve të tij, nëpëmjet pajtueshmërisë së vërseteve të tij me përkimin e mistereve dhe dritave të tij dhe në përputhshmërinë e fruteve dhe veprave të tij, dëshmon me treguesit e tij në formën e provave për ekzistencën e Ekzistuesit të domosdoshëm, për Unitetin e Tij xh.sh., për atributet e Tij Madhështore dhe për Emrat e Tij të bukur, saqë nga ajo dëshmi dalin e pikojnë dëshmitë e pafundme të të gjithë njerëzve të besimit.

Kështu u përmend në shkallën e shtatëmbëdhjetë të Stacionit të Parë një aluzion i shkurtër për atë që mori udhëtari nga mësimi i Unitetit Hyjnor dhe nga një mësim i besimit prej Kuranit Kerim.

[La i lahe il-lall-llahu El Vaxhibul Vuxhudi]

. . .

Pastaj udhëtari ynë, udhëtari nëpër jetë, njohu tani me siguri se besimi, tek i cili arriti, është kapitali më i madh për njeriun, sepse ai i dhuron njeriut të varfër jo vetëm një fushë apo një banesë të përkohshme e kalimtare, por i dhuron si pronë të gjithë kozmosin e madh, si dhe e bën atë të denjë për të fituar një mbretëri të madhe të përjetshme dhe më të gjërë se sa dynjaja. Besimi gjithashtu siguron për njeriun kalimtar të gjitha domosdoshmëritë për një jetë të përhershme të amshuar dhe e shpëton prej asgjësimit të përjetshëm njeriun e mjerë i cili pret të ngjitet në trekëmbëshin e exhelit; dhe hap për njeriun një thesar të përjetshëm për lumturi të përhershme.

Prandaj, udhëtari iu adresua vetes së tij duke i thënë:

"Ec përpara"! le të fitojmë një shkallë tjetër prej shkallëve të pafundme të besimit.. le të shqyrtojmë 'tërësinë e kozmosit' dhe le të dëgjojmë çfarë thotë edhe ai gjithashtu me qëllim që të lëshojmë dritë mbi ato mësime që i morëm prej shtyllave dhe pjesëve përbërëse të kozmosit. Duke soditur nëpërmjet teleskopit të madh e gjithëpërfshirës, të cilin e kishte marrë prej Kuranit, ai pa se kozmosi ishte aq kuptimplotë dhe i mirorganizuar saqë ai dukej në formën e një libri të trupëzuar të Krijuesit xh.sh. ose në formën e një Kur'ani Hyjnor të mishëruar, ose në formën e një pallati të stolisur i të Kërkuarit përjetësisht xh.sh., ose në formën e një qyteti të mirësistemuar i të Gjithëmëshirshmit; sepse të gjitha suret e atij libri, vërsetet dhe fjalët e tij, madje edhe shkronjat, kapitujt, pjesët, faqet dhe vijat e tij, dhe 'fshirja dhe ripohimi' i tyre i vazhdueshëm, kuptimplotë e domethënëse si dhe ndryshimi dhe transformimi plot urtësi e art që ndodhin tek të gjitha ato.. e gjitha kjo tregon me unanimitet e në mënyrë të vetëkuptueshme ekzistencën e Një të Gjithëdituri për gjithçka dhe të Një të Gjithëfuqishmi mbi çdo gjë; si dhe shpreh ekzistencën e një Krijuesi Zotërues të lavdisë, dhe të Një Formëdhënësi Zotërues të plotësisë i Cili sheh çdo gjë -shikon të gjitha gjërat- dhe njeh lidhjen e të gjitha gjërave me të gjitha gjërat.

Dhe kështu, të gjitha speciet dhe grimcat e kozmosit, të gjithë banorët dhe përmbajtjet e tij, gjithçka që hyn në të dhe që e lë atë, të gjitha ndryshimet e dobishme dhe ripërtëritjet e tij plot urtësi, të gjitha të ardhurat e tij, të gjitha këto tregojnë e shpallin njëzëri ekzistencën dhe unitetin e një Krijuesi të lartësuar, dhe të një Autori të Cilit nuk i

ngjason asgjë, i Cili vepron me një fuqi të pakufishme dhe me një urtësi të pafundme.

Kjo dëshmi madhështore e kozmosit provon -ekzistencën e Krijuesit dhe të unitetit të Tij- dy të vërteta të mëdhaja dhe të gjëra në mënyrë të përpjesëtuar me madhësinë dhe gjërësinë e kozmosit; ato të dyja janë:

E Vërteta e Parë: Është e vërteta e *Krijueshmërisë* dhe e *Mundësisë* të cilën e shikuan filozofët, të urtit e islamit dhe dijetarët gjenialë të parimeve të fesë dhe të shkencës së teologjisë, dhe e provuan atë me argumente të fuqishëm.

Ata thanë: "Meqenëse ndërrimi dhe ndryshimi vëzhgohen në botë dhe në të gjitha gjërat, atëherë bota duhet të jetë e përkohshme dhe e krijuar; ajo nuk mund të jetë e pakrijuar. Në qoftë se ajo është e krijuar, atëherë duhet të jetë një Krijues i Cili e krijoi atë. "Dhe në qoftë se nuk gjendet ndonjë shkak në esencën e një gjëje për qënien e saj ose për mosqënien e saj, në një mënyrë që këto të dyja të jenë njëlloj të mundshme, ajo gjë nuk mund të jetë e domosdoshme dhe as e parapërjetshme..."

Gjithashtu është provuar me argumente vendimtarë se është e pamundur që gjërat të krijojnë njëra-tjetrën, meqë ajo do të kërkonte e lindte nocionin absurd e të rremë të shkakësisë dhe vargun shkakor që nuk mbaron kurrë. Atëherë bëhet e domosdoshme ekzistenca e Ekzistuesit të domosdoshëm, ngjashmëria e të Cilit nuk mund të ekzistojë, dhe shëmbëllimi i të Cilit është i pamundur. Dhe gjithçka tjetër përveç Tij është e mundshme dhe e krijuar.

Po, e vërteta e krijueshmërisë ka sunduar të gjithë kozmosin, dhe shumica e shembujve të saj janë të dukshme për syrin; pjesa tjetër e mbetur mund të shikohet veçse nga mendja; sepse ne shohim se me ardhjen e vjeshtës në çdo vit vdes një botë shumë e madhe, dhe së bashku me të vdesin individët e panumërt të njëqind mijë llojeve të bimëve dhe të kafshëve të vogëla; secili anëtar i çdo specieje është si një kozmos i vogël me jetë. Por ajo vdekje ndodh me rregullin më të skajshëm, pasi ato individuale -ato gjëra- i lënë farërat, bërthamat dhe vezët e tyre -të cilat bëhen bosht për ringjalljen dhe ngritjen e tyre në jetë, dhe të cilat në vetvete janë mrekullitë e mëshirës dhe të urtësisë si çudirat e fuqisë dhe të njohjes- i lënë ato amanet tek Urtësia e Gjithëruajtësit Zotërues të lavdisë dhe nën përkujdesjen dhe mbrojten e Tij, duke ua dorëzuar duarve të tyre -duarve të urtësisë, fuqisë...- fletët e punëve të tyre dhe programet e funksioneve të tyre, dhe atëherë

ato vdesin... Me ardhjen e stinës së pranverës, pemët e vdekura, rrënjët dhe kafshët e vogëla vijnë përsëri në jetë, ringjallen tamam njashtu siç ishin, duke dhënë kështu qindra e mijëra shembuj, modele e prova për Ringjalljen më të madhe. Në vendin e të tjerave, bimët dhe kafshët duke u ngjasuar atyre krejtësisht krijohen dhe vijnë në jetë.

Atëherë qëniet e pranverës së kaluar duke botuar fletët e punëve të tyre që ato i kryen dhe detyrat që ato përmbushën, dhe duke shpallur ato fletë në këtë pranverë.. Kjo demonstron qartazi një shembull të vërsetit Kerim: *"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen."* [82]

Po kështu, aspekti i kozmosit si një tërësi; në çdo vjeshtë dhe në çdo pranverë vdes një botë e madhe dhe vjen në ekzistencë një botë e re. Vdekjet dhe lindjet e llojeve të panumërta të gjallesave ndodhin në ato të dyja me rregullin dhe ekuilibrin më të skajshëm, saqë sikur dynjaja të ishte një hotel a stacion në të cilin qëniet e gjalla strehohen e qëndrojnë për një kohë, ku botërat udhëtuese dhe dynjatë lëvizëse vijnë e kryejnë në të detyrat e tyre, dhe pastaj largohen prej saj dhe e lënë atë.

Kështu, krijimi i botëve me jetë, sjellja në ekzistencë e qënieve të ngarkuara me detyra në këtë dynja në një mënyrë të tillë krijimi e sjelljeje në ekzistencë me të gjithë njohjen dhe urtësinë, me balancë dhe ekuilibër, me rregullsi e sistem; dhe vënia e tyre në punë me fuqi, dhe vënia e tyre në shërbim me mëshirë në qëllimet Hyjnore, në objektivat Hyjnore dhe në shërbimet e të Gjithëmëshirshmit, tregon në mënyrë të vetëkuptueshme për domosdoshmërinë e ekzistencës së Një Esenceje të Shenjtë të Gjithëlavdishme fuqia e të Cilës është e pakufishme dhe urtësia e së Cilës është e pafundme; dhe i demonstron ato për mendjet në mënyrë aq të qartë si qartësia e diellit. Le ta mbyllim derën e çështjeve të 'Krijueshmërisë' dhe t'ia referojmë ato Risale-i Nurit dhe librave të Teologëve.

Sa për aspektin e 'Mundësisë', ai është një aspekt tjetër i cili ka mbisunduar në kozmos dhe e ka gjithëpërfshirë atë; pasi ne shohim se çdo gjë, sidoqë të jetë ajo, universale ose e pjesshme, e madhe apo e vogël; dhe çdo qënie prej Arshit në tokë, dhe prej atomeve për tek planetët, që të gjitha dërgohen në dynja me një esencë të veçantë, me një formë specifike, me një identitet të dallueshëm, me atribute të veçanta, me cilësi të urta dhe me organe të dobishme.

---

[82] Kuran, 81: 10

Tani, t'i japësh atë veçori asaj esence të veçantë dhe atij thelbi midis mundësive të pafundme.. Gjithashtu, t'i veshësh atë formë specifike e të përshtatshme me shenja dalluese prej aq shumë mundësive dhe gjasave sa vetë numri i formave.. Gjithashtu ta bësh të dallueshme atë qënie me një identitet të përshtatshëm për të midis mundësish aq të shumta sa anëtarët e tjerë të species së saj; dhe ta pajisësh me atribute të veçanta, të përshtatshme dhe të dobishme objektin e krijuar që është i paformë dhe ngurrues midis mundësive dhe gjasave që janë aq të shumta sa numri i llojeve të atributeve dhe të shkallëve të tij.. Gjithashtu ta pajisësh atë krijesë me ato cilësi plot urtësi dhe t'i instalosh e t'i ngjisësh ato organe të dobishme ndërsa ajo është pa qëllim, e hutuar dhe e turbulluar midis mundësive dhe probaliteteve të panumërta që rezultojnë nga një pafundësi e rrugëve dhe e modaliteteve të mundshme.. të gjitha këto shenja, tregues, prova e dëshmi të cilat burojnë nga e vërteta e 'mundësisë' padyshim formojnë njërin nga dy krahët e kësaj dëshmie më të madhe të dhënë nga kozmosi; sepse ai sa numri i të gjitha qënieve të mundshme universale e të pjesshme dhe sa numri i mundësive të çdo gjëje të mundshme -nga ato që u përmendën- si esenca dhe identiteti, trajta dhe forma që ka, dhe atributi dhe gjendja me të cilën dallohet, ka prova e dëshmi për ekzistencën e Ekzistuesit të domosdoshëm xh.sh. i Cili specifikon, zgjedh, dallon dhe krijon; fuqia e Tij është e pafundme; asnjë gjë dhe asnjë çështje nuk mund të fshihet prej Tij; asgjë nuk është e vështirë për Të; gjëja më e madhe është aq e lehtë për Të si ajo më e vogëla; Ai mund ta krijojë pranverën me aq lehtësi si një pemë, dhe e krijon pemën me aq lehtësi si krijimin e një bërthame.

Meqenëse dëshmia e kozmosit, me dy krahët dhe me dy të vërtetat e tij, është provuar plotësisht dhe është shpjeguar në pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit, dhe veçanërisht në Fjalën e Njëzet e Dytë dhe të Tridhjetë e Dytë si dhe në Letrën e Njëzet dhe të Tridhjetë e Tretë, ne i referojmë lexuesit tonë tek ato trajtesa dhe e mbyllim këtë çështje shumë të gjatë.

Ndërsa *krahu i dytë* e dëshmisë më të madhe universale që buron nga kozmosi është sa vijon:

E Vërteta e Dytë: E vërteta e bashkëpunimit. Ndodhet për t'u parë një e vërtetë bashkëpunimi midis këtyre qënieve që përpiqen për të ruajtur ekzistencën e tyre, dhe në qoftë se ato kanë jetë, jetën e tyre, dhe kryejnë funksionet e tyre brenda këtyre përmbysjeve të tronditura të vazhdueshme dhe këtyre transformimeve e ndryshimeve të pandërprera; është një e vërtetë që qëndron përtej kapaciteteve të tyre.

Për shembull, elementet shpejtojnë për të ndihmuar qëniet e gjalla, sidomos ndihma e reve për botën bimore; bota bimore për të ndihmuar botën shtazore; dhe bota shtazore për të ndihmuar botën njerëzore. Qumështi i shijshëm çurgon prej kraharorëve, si burimi i Parajsës- për të ushqyer të vegjëlit; fakti se qënieve të gjalla u jepen furnizimet me ushqim dhe u plotësohen nevojat në një mënyrë që tejkalon kapacitetet e tyre, nga vende të paparashikuara; rifurnizimi i qelizave të trupit me grimcat e ushqimit... si dhe shembuj të tjerë të shumtë si këto për të vërtetën e bashkëpunimit që ndodh nëpërmjet nënshtrimit të tyre nga Krijuesi i tyre dhe nëpërmjet vënies së tyre në punë prej të Gjithëmëshirshmit të tyre... e gjitha kjo demonstron me qartësi Hyjninë universale e gjithëpërfshirëse të Krijuesit të të gjitha botëve dhe mëshirën e Tij të gjërë e të gjithanshme i Cili e administron të gjithë këtë kozmos të gjërë me aq lehtësi si të adminstronte një pallat të thjeshtë.

Po, shfaqja e gjërave bashkëpunuese me njëra-tjetrën -të cilat janë të pajeta, të pavetëdijshme dhe pa dhembshuri- duke u shfaqur në mënyrë të ndjeshme, të dhembshur e të vetëdijshme ndaj njëra-tjetrës sigurisht është një dëshmi e fortë se ato shtyhen e bëhen të vrapojnë për t'i ardhur në ndihmë njëra-tjetrës dhe për të bashkëpunuar nga fuqia e Krijuesit Zotërues të lavdisë, nga mëshira e Mëshirëplotit që ka mëshirë absolute, dhe nga urdhëri i të Gjithurtit urtësia e të Cilit është absolute. Kështu, 'bashkëpunimi' universal i dukshëm gjithandej kozmosit; 'ekuilbri' gjithëpërfshirës dhe 'ruajtja' e gjithanshme që sundojnë me rregullsinë më të madhe në të gjitha gjërat, duke filluar nga planetët dhe galaktikat deri tek organet e gjallesës dhe tek gjymtyrët e saj të holla, madje tek grimcat e trupit të saj; dhe 'stolisja', pena e së cilës lëviz nga fytyra e shndritshme e qiejve për tek faqja e zbukuruar e tokës, madje deri tek fytyra e luleve të bukura; dhe 'Rregulli' që sundon duke filluar nga rruga e qumështit dhe nga sistemi diellor deri tek frutat e drithërat të tilla si misri e shegat; dhe 'caktimi i detyrave' për të gjitha gjërat duke filluar nga dielli, hëna, elementet dhe retë deri tek bletat mjaltëse dhe milingonat.. si dhe të tjera si shembulli i këtyre të vërtetave shumë të mëdhaja, që të gjitha këto japin një dëshmi në përpjesëtim me madhësinë e tyre, dhe dëshmia e tyre formon krahun e dytë të dëshmisë së dhënë nga kozmosi. Meqenëse Risale-i Nuri e ka provuar dhe sqaruar këtë dëshmi të madhe, ne do të mjaftohemi këtu vetëm me këtë tregues të shkurtër.

Një aluzion të shkurtër për mësimin e besimit të mësuar nga udhëtari ynë prej kozmosit, ne e thamë në Shkallën e Tetëmbëdhjetë të Stacionit të Parë:

[La ilahe il-lall-llahu El-Vaxhibul Vuxhudi...]

. . .

Pastaj udhëtari i cili erdhi në dynja dhe kërkoi Krijuesin e saj, dhe u ngjit në tetëmbëdhjetë shkallë dhe arriti tek Froni i Realitetit nëpërmjet një ngjitjeje dhe avancoi prej stacionit të njohjes indirekte për tek stacioni i prezencës dhe i adresimit të drejtpërdrejtë; ky i mallëngjyer iu adresua shpirtit të tij duke i thënë:

Në suren hapëse të Kuranit vërsetet që shtrihen nga fillimi deri tek fjala ***Ij-jake,*** *Vetëm Ty,* janë si një formë falënderimi e lavdërimi të shprehura në mënyrë indirekte; kurse fjala ***Ij-jake*** tregon e shpreh një ardhje tek prezenca e Tij dhe tek adresimi i Tij i drejtpërdrejtë. Atëherë ne duhet ta kërkojmë Atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të heqim dorë nga kërkimi i Tij në mënyrë indirekte. Sepse njeriu duhet të pyesë vetë diellin -i cili ndriçon gjithçka- lidhur me diellin; sepse Ai i Cili i shfaq të gjitha gjërat duke i bërë ato të qarta, sigurisht Ai do ta shfaqte vetveten më shumë dhe më qartë se çdo gjë. Atëherë ashtu siç mund ta shohim diellin dhe të njihemi me të nëpërmjet rrezeve dhe dritës së tij, po ashtu ne mund të përpiqemi gjithashtu, sipas kapaciteteve tona -ta njohim Krijuesin tonë xh.sh. nëpërmjet manifestimeve të Emrave të Tij të bukur dhe nëpërmjet dritave të Atributeve të Tij madhështore.

Ne do të shtjellojmë këtu me shkurtësinë dhe përmbledhjen më të madhe, vetëm dy të vërteta prej të vërtetave të shumta dhe prej detajeve të përmbledhura të dy shkallëve prej shkallëve të pafundme të dy rrugëve prej rrugëve të shumta që çojnë tek ky qëllim:

E Vërteta e Parë

E Vërteta e Aktivitetit mbisundues, e atij aktiviteti dominues në kozmos, i cili është i dukshëm para syve tonë. Është ajo e vërtetë e cila i administron, i transformon dhe i ripërtërin të gjitha qëniet në qiej e në tokë me një aktivitet të autoritetshëm e të pandërprerë. Është ajo që të çon në perceptimin e të vërtetës së manifestimit të Hyjnisë -në mënyrë të vetëkuptueshme- brenda të vërtetës së atij aktiviteti të urtë në të gjitha drejtimet e tij. Ky perceptim çon në kapjen dhe në perceptimin e shfaqjes së Hyjnisë -në mënyrë të domosdoshme- brenda të vërtetës së manifestimit të Hyjnisë që rrezaton me mëshirë në të gjitha anët.

Nga ky aktivitet i vazhdueshëm, i urtë e mbisundues, veprat e një Autori të Gjithëfuqishëm e të Gjithëditur bëhen të dallueshme sikur nga prapa një perdeje. Dhe nga prapa perdes së këtyre akteve ushqyese dhe administruese të Hyjnisë, mësohen në mënyrë të vetëkuptueshme - deri në shkallën e ndjeshmërisë- Emrat e bukur Hyjnorë që manifestohen në të gjitha gjërat. Atëherë, nga prapa perdes së Emrave të bukur të manifestuar me lavdi e bukuri njihet me shkallën e njohjes së sigurisë, edhe me shikimin e sigurisë, dhe madje me sigurinë absolute, ekzistenca e Shtatë Atributeve të Shenjta. Gjithashtu mësohet me njohje të sigurt dhe në mënyrë të vetëkuptueshme e të domosdoshme, me shkallën e njohjes së sigurisë dhe me dëshminë e të gjithë krijimit, prej manifestimeve të pafundme të këtyre Shtatë Atributeve të shenjta, në një formë plot gjallëri, fuqi, njohje, dëgjimi, shikimi, dëshire dhe ligjërimi, ekzistenca e Ekzistuesit të vetëm të domosdoshëm i Cili përshkruhet me këto Atribute dhe i Cili ngrihet me Emra të tillë si: Një, i Vetmi dhe Vepruesi i Vetëm i Pashoq i Përjetshëm. Kështu ekzistenca e Tij xh.sh. shfaqet për syrin e besimit në zemër në mënyrën më të qartë e më të shndritshme se sa dielli për syrin; e kap sikur ta shihte.

Sepse një libër i bukur e i thellë domosdoshmërisht presupozon - merr me mend- aktin e të shkruarit; dhe një shtëpi e ndërtuar mirë presupozon aktin e ndërtimit; dhe aktet e të shkruarit bukur dhe të ndërtuarit mirë presupozojnë emrat e shkruesit dhe të ndërtuesit; dhe titujt e shkruesit dhe të ndërtuesit në mënyrë të qartë nënkuptojnë artet dhe atributet e shkrimit dhe të ndërtimit; dhe këto arte e atribute në mënyrë të vetëkuptueshme bëjnë të domosdoshëm Atë që do të cilësohet nga Emrat dhe nga Atributet, dhe do të jetë artisti dhe mjeshtri. Sepse ashtu siç është e pamundur të ketë një vepër pa një veprues, ose një emër pa atë që përshkruhet me atë emër, po ashtu është e pamundur që të ketë një mjeshtëri pa një mjeshtër.

Atëherë, duke u mbështetur mbi këtë të vërtetë dhe mbi këtë parim, universi me të gjithë qëniet që ai përmban i ngjason një koleksioni librash e mesazhesh kuptimplote e të thellë të shkruar nga Pena e Kaderit Hyjnor; dhe ai -universi- u ngjason ndërtesave dhe pallateve të pafundme të ndërtuara nga çekani i fuqisë Hyjnore. Secili nga këto, veçmas e bashkërisht, me mijëra mënyra e me rrugë të panumërta tregojnë e shprehin dëshminë e mëposhtme:

Këto akte të panumërta e të mëshirshme Hyjnore, dhe këto manifestime të pafundme të një mijë e një Emrave të bukur Hyjnorë të cilët janë burimi i atyre akteve, dhe manifestimet e pafundme të Shtatë

Atributeve të Shenjta gjithëpërfshirës të cilët janë burimi i atyre Emrave të bukur, tregojnë në mënyra të pafundme për domosdoshmërinë e ekzistencës dhe për Unitetin e një Esence të Gjithëlavdishme të parapërjetshme e të paspërjetshme e Cila përshkruhet nga ato Shtatë Atribute të Shenjta dhe gjithëpërfshirëse dhe është burimi i tyre; gjithashtu të gjithë shembujt e bukurisë, të hijeshisë, të vlefshmërisë dhe të plotësisë që gjenden në ato qënie janë prej një bukurie të shenjtë e përshtatshme për ato akte Hyjnore, për Emrat Hyjnorë, për Atributet e të Kërkuarit përjetësisht dhe për çështjet e Krijuesit xh.sh. dhe e denjë për to.. Secila prej tyre -në vetvete- dhe në tërësinë e saj dëshmojnë për bukurinë e shenjtë dhe për plotësinë e shenjtë të Esencës së Tij xh.sh..

Kështu, e vërteta e Hyjnisë që e manifeston vetveten brenda të vertetës së aktivitetit mbisundues zbulon dhe e bën vetveten të njohur në cilësi dhe në akte të tilla si krijimi, sjellja në ekzistencë, në artin dhe në mjeshtërinë që realizohen me njohje dhe me urtësi; e shfaq atë në paracaktim, formim dhe në administrim që karakterizohen nga rregulli dhe ekuilibri; shfaqet në transformim, ndryshim, në bërjen të zbresë dhe në bërjen të plotë të cilat realizohen me qëllim e dëshirë; dhe bëhet e qartë në dhënien ushqim, në mirëbërësi, në bujari e bamirësi të cilat jepen me dhembshuri e mëshirë.

Dhe brenda të vërtetës së manifestimit të Hyjnisë, e vërteta e shfaqjes së Hyjnisë, e cila kapet menjëherë dhe ndjehet dukshëm, e bën të njohur e të kuptueshme vetveten nëpërmjet manifestimeve të mëshirshme dhe bujare të emrave të bukur Hynorë, dhe nëpërmjet manifestimeve të bukura e të lavdishme të shtatë atributeve afirmuese, pohuese, të cilat janë: ‘Jeta’, ‘Njohja’, ‘Fuqia’, ‘Dëshira’, ‘Dëgjimi’, ‘Shikimi’ dhe ‘Ligjërimi’.

Po, ashtu si atributi i të folurit, i cili e bën të njohur Esencën më të shenjtë nëpërmjet *vahjit* -shpalljes- dhe *ilhamit* -inspirimit-, po ashtu atributi i ‘fuqisë’ e bën të njohur Esencën e Tij xh.sh. nëpërmjet të gjitha veprave të mrekullueshme të cilat janë si fjalë të mishëruara që përshkruajnë Një të Gjithëfuqishëm Zotërues të lavdisë, dhe e bëjnë të njohur Atë duke e paraqitur kozmosin nga një cep në tjetrin si një Furkan -Kuran- të trupëzuar, si një libër të trupëzuar dallimi.

Gjithashtu, atributi i ‘Njohjes’ e bën të njohur Esencën e të Vetmit të Pashoq, Esencën më të shenjtë, nëpërmjet secilës prej objekteve të urta, të mirorganizuara dhe të drejtpeshuara të krijimit, nëpërmjet secilës krijese të administruar, të drejtuar, të stolisur dhe të bërë e dallueshme prej njohjes së Krijuesit.

Sa për atributin e 'jetës', ai nuk provohet vetëm nga dëshmitë e tij, por gjithashtu edhe nga të gjitha veprat që shpallin 'Fuqinë' e Zotit, nga të gjithë format e mirërregulluara, të urta, të balancuara e të stolisura dhe nga gjendjet që tregojnë 'Njohjen' e Zotit xh.sh., si dhe nga të gjitha provat e të gjitha atributeve. Kështu, 'jeta' duke shfaqur si dëshmitarë të gjitha qëniet e gjalla, të cilat veprojnë si pasqyra duke i reflektuar ato prova të shumta, bën të njohur Esencën e të Gjallit të Përjetshëm dhe të Vetekzistuesit të Përhershëm. Gjithashtu është ky atribut i cili në mënyrë të vazhdueshme e ndryshon kozmosin me qëllim që të prodhojë në të manifestime e skalitje gjithnjë të freskëta e të ndryshme, dhe e transformon atë në një pasqyrë madhështore të përbërë nga pasqyra më të vogëla të panumërta.

Me këtë analogji, edhe atributet e 'shikimit', 'dëgjimit', 'dëshirës' dhe të 'ligjërimit', secili prej tyre bën të njohur Esencën më të Shenjtë, ashtu siç e bën Atë të njohur kozmosi. Ato atribute ashtu siç tregojnë për ekzistencën e Esencës së Tij xh.sh., po ashtu ato tregojnë në mënyrë të vetëkuptueshme për ekzistencën dhe realitetin e jetës dhe se Ai xh.sh. është "***Hajj***" *i Gjalli i përjetshëm*; sepse njohja është një shenjë e jetës, dëgjimi është një tregues për jetën; shikimi i përket vetëm të jetuarit; dëshira ndodh vetëm me jetën. Fuqia e zgjedhjes gjendet vetëm në qëniet e gjalla; dhe ligjërimi -folja- është shenja e atyre që janë pajisur me jetë dhe me njohje. Kështu, nga këto pika kuptohet se Atributi i 'jetës' ka dëshmi e prova shtatë herë më shumë se sa kozmosi; ai atribut e bën të njohur ekzistencën e vet dhe ekzistencën e Atij të Vetmi i Cili cilësohet me të, **'*El-Hajj*'**, saqë 'jeta' u bë themeli dhe burim i të gjithë atributeve dhe origjina dhe boshti i Emrit më të madh.. Meqenëse Risale-i Nuri e vërteton këtë të vërtetën e parë me prova të fuqishme si dhe e sqaron, ne do të mjaftohemi tani me një pikë prej këtij oqeani.

E Vërteta e Dytë

Folja Hyjnore që vjen prej atributit të 'të folurit'.

Ligjërimi Hyjnor është i pafundmë, dhe kjo sipas kuptimit të brendshëm të vërsetit, *"Thuaj: Sikur deti të ishte bojë (për të shkruar) Fjalët e Zotit tim (pa asnjë mëdyshje se deti do të shterrohej para se të mbaronin Fjalët e Zotit tim)..."* [83]

Të folurit është treguesi më i qartë për njohjen e ekzistencës së Folësit, domethënë kjo e vërtetë -Folja Hyjnore- jep dëshmi të panumërta për ekzistencën e Folësit të Parapërjetshëm xh.sh. dhe për

[83] Kuran 18: 109

Unitetin e Tij. Meqenëse dy dëshmi të fuqishme të kësaj të vërtete janë *vahji* dhe *ilhami* -shpallja dhe inspirimi- dhe janë shtjelluar në shkallët e katërmbëdhjetë dhe të pesëmbëdhjetë; dhe një dëshmi tjetër e madhe është provuar nga librat e shenjtë qiellorë, siç u tregua në Shkallën e Dhjetë; dhe një provë tjetër e ndritshme dhe gjithëpërfshirëse jepet nga Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm, siç u diskutua në Shkallën e Shtatëmbëdhjetë -për të gjitha këto arsye- ne i referojmë lexuesit tonë tek ato shkallë për shpjegimin dhe për vërtetimin e kësaj të vërtete.

Janë të mjaftueshme për ne dhe për udhëtarin tonë, i cili ishte i pamundur të vazhdonte përtej kësaj pike, dritat dhe misteret e përfshira në vërsetin Kerim i cili e shpall këtë të vërtetë në mënyrë të mrekullueshme dhe ua shton dëshminë e tij të gjitha dëshmive të mëparshme:

"Allahu dëshmon se La i lahe il-la Huve (nuk ka zot tjetër përveç Atij); dëshmojnë edhe Melekët, edhe ata që janë pajisur me dije; Ai mban krijimin e Tij në drejtësi të plotë; nuk ka zot tjetër përveç Atij, i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti" [84]

Duke aluduar për thelbin e mësimit të mësuar nga udhëtari ynë tek ky Stacion i shenjtë, ne folëm në Shkallën e Nëntëmbëdhjetë të Stacionit të Parë:

[La i lahe il-lall-llahu El-Vaxhibul Vuxhudi...]

. . .

SHËNIM

Secila nga të vërtetat dëshmuese të Nëntëmbëdhjetë Shkallëve të kapitullit të parë të Stacionit të dytë të përmendura lart, ashtu siç tregojnë Ekzistencën e domosdoshme nëpërmjet ekzistencës dhe

[84] Kuran 3:18

prezencës se tyre, po ashtu nëpëmjet gjithëpërfshirjes së tyre ato tregojnë e pohojnë Unitetin dhe Njësinë e Zotit. Por meqenëse ato e provuan ekzistencën në mënyrën më të qartë e të shkoqitur, ne i quajtëm ato më parë si "Provat e Ekzistencës së domosdoshme".

Sa për kapitullin e dytë të Stacionit të dytë, meqenëse do të provojë së pari Unitetin Hyjnor në mënyrë të qartë dhe do të provojë ekzistencën e domosdoshme brenda tij, ai u quajt "Provat e Unitetit Hyjnor".

Veçse ama që të dy -domethënë, kapitulli i parë dhe i dyti- i provojnë unitetin dhe ekzistencën njëherazi, bashkërisht; por me qëllim që të bëjmë dallim midis tyre, në kapitullin e parë u përsërit paragrafi "nëpërmjet Dëshmisë së madhështisë së gjithëpërfshirjes së të Vërtetës...", ndërsa në kapitullin e dytë u përsërit paragrafi: "nëpërmjet shikimit të madhështisë së gjithëpërfshirjes së të Vërtetës..." duke aluduar për Unitetin e qartë e të dukshëm, sikur të shihej Uniteti Hyjnor.

Unë synova t'i shpjegoja shkallët e kapitullit të dytë ashtu siç bëra në kapitullin e parë, por për shkak të disa pengesave, unë detyrohem ta shkurtoj e ta përmbledh.

Prandaj, unë ua referoj pjesëve të tjera të Risale-i Nurit që t'i shpjegojnë këto çështje ashtu siç e meritojnë të shpjegohen.

KAPITULLI I DYTË

Lidhur me provat e Unitetit Hyjnor

[Ai udhëtar i cili u dërgua në dynja me qëllim që të arrinte besimin, që udhëtoi nëpër të gjithë kozmosin me mendjen e tij me qëllim që t'i pyeste të gjitha gjërat lidhur me Krijuesin e tij dhe që të njihej me Mbështetësin -Zotin- e tij në çdo vend, besimi i të cilit u ngulit e u përforcua deri në shkallën e sigurisë absolute për domosdoshmërinë e ekzistencës së Zotit xh.sh. të cilin ai e kërkonte; ky udhëtar iu adresua mendjes së tij duke i thënë: "Eja që të dalim së bashku në një udhëtim tjetër të ri me qëllim që nëpërmjet tij të shohim prova e argumente të cilat na çojnë ne tek Uniteti i Krijuesit tonë të Gjithëlavdishëm".

Ata të dy u nisën së bashku duke kërkuar me zell të madh këto -prova të Unitetit Hyjnor- dhe në të parin e vendqëndrimeve gjetën se ndodheshin katër të vërteta të shenjta duke sunduar mbi të gjithë kozmosin, të vërteta që në mënyrë të vetëkuptueshme kërkonin medoemos Unitetin e Zotit xh.sh..]

■ E VËRTETA E PARË: *Hyjnia Absolute*

Zhytja e çdo klase prej klasave të njerëzimit në një lloj ibadeti -adhurimi- dhe prokopia e tyre me të sikur ai të ishte i bashkëlindur, i natyrshëm.. dhe prokopia dhe përfshirja e gjallesave të tjera, madje edhe prokopia e qënieve të pashpirta në kryerjen e shërbimeve dhe të funksioneve të tyre të natyrshme të cilat janë një lloj ibadeti.. dhe qënia e secilës prej mirësive dhe dhuratave materiale e shpirtërore, të cilat mbushin kozmosin, si mjet adhurimi e falënderimi për një adhurueshmëri e cila i mbështet me rrugët e ibadetit dhe të falënderimit të gjitha ato dhurata e mirësi duke u bërë mjete që i nxisin njerëzit për adhurim, për falënderime dhe për lavdërime e mirënjohje.. mënyra në të cilën të gjitha manifestimet e së Padukshmes dhe zbulesat e shpirtit, *vahji* dhe *ilhami* -shpallja dhe inspirimi- shpallin unanimisht përshtatshmërinë ekskluzive për adhurimin e një Zoti të Vetëm e të Pashok.. e gjitha kjo, në mënyrë të vetëkuptueshme provon realitetin dhe mbisundimin e një Hyjnie të Vetme Absolute.

Meqenëse e vërteta e një Hyjnie të tillë ekziston, atëherë ajo në asnjë mënyrë nuk pranon ortakëri me të; sepse ata të cilët i përgjigjen asaj Hyjnie -domethënë, përshtatshmërisë për t'u adhuruar- me

falënderime dhe me ibadet, janë frutat e vetëdijshëm e të gjallë në më të lartën e degëve të pemës së kozmosit; prandaj mundësia e ekzistencës së të tjerëve që të tërheqnin vëmendjen e atyre qënieve të vetëdijshme, t'i joshnin ata për tek vetja e tyre, dhe t'i bënin mirënjohës dhe falënderues për ta, duke u përpjekur që t'i bëjnë ata ta harrojnë të Adhuruarin e tyre të Vërtetë -i Cili mund të harrohet shpejt për shkak të padukshmërisë së Tij- do të ishte një kontradiktë e plotë e tillë për esencën e Hyjnisë dhe për qëllimet e saja të shenjta, saqë kjo kurrsesi nuk do të mund të pranohej. Për këtë arsye, Kur'ani Kerim në mënyrë të përsëritur dhe me vrull e hedh poshtë dhe e refuzon shirkun -të përshkruarin ortakë me Zotin- dhe i kërcënon politeistët me ndëshkimin e Xhehennemit -Ferrit.

■ E VËRTETA E DYTË: *Perëndia Absolute*

Autoriteti i përgjithshëm dhe i gjithanshëm dhe veprat e kudondodhshme prej një dore të fshehur gjithandej kozmosit -dhe veçanërisht në qëniet e gjalla- me urtësi dhe me mëshirë në zhvillimin dhe në furnizimin e tyre me ushqim të cilat realizohen bashkërisht në të njëjtën mënyrë në çdo drejtim dhe në një formë krejtësisht të paparashikuar, duke rrethuar njëra-tjetrën, sigurisht duhet të jetë rrezatimi dhe drita që tregojnë një Hyjni -Perëndi- të Vetme Absolute, madje është një provë vendimtare për realitetin e saj.

Meqenëse ndodhet një Perëndi e Vetme Absolute, atëherë ajo nuk do të pranonte absolutisht ortakëri apo shirk; sepse më i rëndësishmi i qëllimeve të Asaj Perëndie -Hyjnie- dhe më i skajshmi i synimeve të Saj është manifestimi i bukurisë së Saj, shpallja e plotësisë së Saj, shfaqja e arteve të Saj të çmueshme, dhe ekspozimi i artifakteve të Saj të vlefshme; dhe të gjitha këto synime janë kombinuar e përqëndruar tek çdo qënie e gjallë, madje tek të gjitha gjërat e pjesshme; prandaj Perëndia e Vetme Absolute nuk do ta pranonte kurrë shirkun -ortakërinë- sepse një ndërhyrje e rastësishme e shirkut në çdo qënie -sado e pjesshme që të jetë ajo- ose në çdo gjallesë -sado e thjeshtë apo e vogël që të jetë ajo- do t'i prishte arritjet e atyre qëllimeve dhe do t'i shkatërronte ato synime, dhe do t'i largonte mendjet -fytyrat- e atyre qënieve të vetëdijshme prej atyre qëllimeve dhe prej atyre që i deshi dhe i synoi ato, dhe do t'i kthente drejt shkaqeve gjë që do të ishte krejtësisht në kundërshtim me Esencën e Perëndisë absolute dhe do të ishte armiqësore ndaj saj. Atëherë kjo Perëndi -Hyjni- e vetme absolute sigurisht do ta ndalonte shirkun dhe format e tij sido që ato të jenë. Udhëzimet e shumta e të vazhdueshme të Kur'anit Kerim për tek Uniteti i Zotit, dhe shenjtërimi i Tij, pastrimi dhe lartësimi duke e

shpallur Atë krejtësisht të shenjtëruar -dhe larg çdo mangësie e ortakërie- në vërsetet e tij të larta, në fjalët e tij dhe madje në shkronjat dhe në trajtat e tij, burojnë prej këtij misteri më të madh, të cilin sapo e shpjeguam.

■ E VËRTETA E TRETË: *Plotësitë*

Po, të gjithë shembujt e lartësuar të urtësisë në univers, të gjitha bukuritë e tij të jashtëzakonshme, ligjet e tij të drejta dhe qëllimet e tij të urta dëshmojnë e tregojnë në mënyrë të vetëkuptueshme për ekzistencën e të vërtetës së plotësive.. Ajo është një dëshmi e dukshme për plotësinë e Krijuesit xh.sh. i Cili e krijoi këtë kozmos nga mosqënia dhe e administron çështjen e tij në çdo anë e në çdo aspekt në mënyrë të mrekullueshme, tërheqëse dhe të bukur; gjithashtu ajo është një tregues i qartë për plotësimin e njeriut i cili është pasqyra e ndjeshme dhe reflektuese e manifestimeve të Krijuesit xh.sh..

Atëherë, meqenëse ekziston e vërteta e plotësive, dhe meqenëse plotësia e Krijuesit, i Cili e krijoi kozmosin në plotësim, është një e vërtetë e sigurt dhe e verifikuar, dhe meqenëse plotësimi i njeriut, i cili është fruti më i mirë i kozmosit, kalifi i Zotit në tokë, krijesa më e nderuar dhe më e dashur e Krijuesit xh.sh. është një e vërtetë e qëndrueshme dhe e verifikuar gjithashtu, atëherë t'i përshkruash ortakë -shirk- Zotit xh.sh. do të ishte e papranueshme dhe e gabuar, sepse shirku i cili e transformon formën e kozmosit -që ka plotësi dhe urtësi të dukshme- në një lodër të kotë në dorën e rastësisë, dhe në një vend argëtimi për natyrën, në një thertore mizore të tmerrshme për qëniet e gjalla, dhe në një ceremoni të errët e të frikshme varrimi -në një shtëpi të tmershme zie- për qëniet e vetëdijshme, meqë në të zbret çdo gjë në asgjësi, bie në zhdukje dhe kalon shpejt pa qëllim dhe pa objektiv -dhe i cili (shirku) e zbret njeriun, plotësimet e të cilit janë të dukshme në veprat e tij, tek niveli më i ulët i kafshëve, si krijesa më e mjerë dhe më e poshtëruara, dhe i cili -shirku- hedh perde mbi pasqyrat e plotësisë së Krijuesit xh.sh. -ato pasqyra janë të gjitha qëniet të cilat dëshmojnë plotësinë e shenjtë absolute të Krijuesit Gjithëbujar- duke shfuqizuar me këtë rezultatin e aktivitetit të Tij dhe duke mohuar krijueshmërinë e Tij xh.sh.!! atëherë, ky shirk nuk mund të mbështetet absolutisht mbi ndonjë të vërtetë, dhe nuk mund të gjendet absolutisht në kozmos.

Meqenëse shirku -të përshkruarit ortakë me Zotin- është në kontradiktë me plotësitë Hyjnore, njerëzore dhe kozmike dhe mohimet e tij ndaj tyre janë vërtetuar e shpjeguar në mënyrë të hollësishme në Rrezen e Dytë e cila shpjegon tre fruta të Unitetit Hyjnor me prova të

forta e vendimtare, veçanërisht në Stacionin e parë të saj, ne i referojmë lexuesit tonë tek ajo dhe e presim shkurt diskutimin këtu.

■ E VËRTETA E KATËRT: *Sovraniteti Absolut*

Po, kushdo që e sodit kozmosin me një vështrim gjithëpërfshirës, do të shihte se ai i ngjason një mbretërie shumë madhështore, duke qenë në aktivitetin dhe në madhështinë më të skajshme; ai do të shfaqej për të sikur të ishte një qytet i madh që administrohet në mënyrën më të urtë dhe me një mbretërim e sundim me forcën dhe madhështinë më të skajshme; ai do të gjente se të gjitha gjërat dhe të gjitha speciet secila prej tyre janë të zhytura me bindje e nënshtrim në një funksion të veçantë.

Sipas metaforës ushtarake të përfshirë në vërsetin,

"Dhe të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të tokës",[85] komandat krijuese e mbisunduese, urdhërat autoritarë, dhe ligjet e Mbretit të shenjtë të shpallura në ato ushtri të shumta duke filluar nga ushtritë e grimcave, batalionet e bimëve dhe brigadat e kafshëve deri tek ushtritë e yjeve, të cilët janë ushtarë Hyjnore të organizuar të Allahut, përfshijnë si ushtarin më të ulët po ashtu edhe komandantin më të lartë. -Ato të gjithë tregojnë në mënyrë të vetëkuptueshme ekzistencën e një sovraniteti të vetëm absolut dhe të një autoriteti të vetëm Universal.

Meqenëse Sovraniteti i vetëm absolut është një e vërtetë e qëndrueshme dhe ekzistuese, atëherë sigurisht shirku nuk ka të vërtetë; sepse e vërteta vendimtare të cilën e shpreh qartë vërseti Kur'anor,

"Po të kishte pasur në to (në qiej dhe në tokë) perëndi të tjera përveç Allahut, atëherë padyshim që të dyja (qiejt dhe toka) do të ishin shkatërruar"[86], tregon se në qoftë se do të ndërhynin duar të shumta në një punë të veçantë dhe nëse ato do të kishin influencë, rezultati do të ishte rrëmujë, dhe do të ngatërrohej vetë ajo punë. Në qoftë se do të ishin dy mbretër në një vend ose dy kryetarë në një krahinë, rregulli do të zhdukej, dhe administrata do të transformohej në anarki e pështjellim.

Gjendja është se ndodhet gjithandej një sistem i tillë shumë i mahnitshëm duke filluar nga krahu i mushkonjës për tek llambat e qiellit, dhe nga qelizat e trupit për tek shenjat e planeteve, saqë nuk mund të ketë mundësi për ndërhyrjen e ndonjë shirku tek punët e Allahut as sa masa e një atomi.

---

[85] Kuran 48: 4
[86] Kuran 21:22

Për më tepër, vetë sovraniteti është një stacion dinjiteti; ky stacion nuk do të pranonte rival e kundërshtar, pasi kjo do të shpërfillte e shkilte dinjitetin e Sovranitetit. Fakti se njeriut të cilit i nevojitet ndihma e shumë njerëzve për shkak të pafuqisë dhe dobësisë së tij, do të vriste vëllain e tij ose djemtë e tij në mënyrën më mizore për hir të një sundimi të jashtëm, të përkohshëm e të pjesshëm, tregon se sovraniteti refuzon çdo nocion të ortakërisë dhe nuk pranon kurrë rivalitet. Në qoftë se njeriu -i cili është i pafuqishëm- do të kryente një veprim të tillë për hir të një sovraniteti të pjesshëm, atëherë nuk do të ishte e mundur në asnjë mënyrë a gjendje që ta lejonte apo ta pranonte Ai i Cili është i Gjithëfuqishëm Absolut, i Cili ka në zotërim të gjithë kozmosin, ndonjë ndërhyrje apo ortakëri prej dikujt në Sovranitetin e Tij të shenjtë që është boshti i Hyjnisë së Tij absolute dhe Hyjnia e Tij reale dhe universale.

Meqenëse kjo e vërtetë është vërtetuar me prova të fuqishme në vende të shumta gjithandej Risale-i Nurit dhe veçanërisht në Stacionin e Dytë të Rrezes së Dytë, ne i referojmë lexuesit tek ato faqe për një diskutim të mëtejshëm të saj.

Dhe kështu, shoku ynë udhëtar pasi i dëshmoi këto katër të vërteta, Uniteti Hyjnor u bë i njohur për të në shkallën e shikimit të sigurt e të qartë. Besimi i tij u shtua dhe u ngjit më lart, dhe me të gjithë fuqinë e tij ai tha: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut; Ai është Një i Vetëm, Ai nuk ka ortakë”.

Duke aluduar për mësimin që ai mori nga ky stacion, ne e përmendëm në Stacionin e parë të Kapitullit të Dytë.

[La i lahe il lall-llahu....]

. . .

Pastaj ai udhëtar i lëvizshëm dhe jo i qetë iu adresua mendjes së tij duke i thënë: Fakti se njerëzit e besimit, dhe sidomos ata që kanë hyrë në tarikatin Sufi, në mënyrë të vazhdueshme përsërisin fjalët ***“La i lahe il-la Huve”,*** *“Nuk ka zot tjetër përveç Atij”* dhe duke thirrur e shpallur Unitetin e Zotit xh.sh., është një tregues se pohimi e vërtetimi i Unitetit Hyjnor përmban shumë shkallë. Një vërtetim i tillë i Unitetit Hyjnor është detyra më e shenjtë e lartësuar, është farzi i natyrshëm më i ëmbël, më i kënaqshëm dhe është ibadeti më i lartë i besimit, akti më i lartë i adhurimit. Meqenëse çështja është kështu, eja, o zemër, që të hapim derën e një vendqëndrimi tjetër në këtë banesë instruksioni e provimi me qëllim që të njohim nëpërmjet saj një shkallë tjetër prej shkallëve të Unitetit Hyjnor, sepse pohimi i vërtetë i Unitetit Hyjnor,

rreth të cilit po kërkojmë, nuk përkufizohet mbi një njohje i cila buron prej imagjinatës, përkundrazi, është një pohim i cili me termat e logjikës vlerësohet si e kundërta e imagjinatës, domethënë është shumë më e lartë se sa thjesht njohja e bazuar mbi imagjinatë, ajo është dija, që është rezultati që buron nga argumenti, dhe që përcakohet si njohje".

Pohimi i vërtetë i Unitetit të Zotit është gjykim, konfirmim, nënshtrim dhe pranim, saqë i mundëson njeriut që të udhëzohet për tek Zoti i tij nëpërmjet çdo gjëje. Dhe i jep mundësi atij që në çdo gjë të shohë rrugët e ndritshme të cilat e çojnë atë për tek Krijuesi i tij Gjithëbujar, dhe ai nuk do të shihte asgjë si pengesë për tek prezenca e Tij xh.sh. -asgjë absolutisht nuk do ta ndalonte qetësimin e zemrës së tij nga Prezenca e Krijuesit të tij.

Në qoftë se çështja nuk do të ishte kështu, njeriu do të detyrohej që gjithmonë të griste perden e kozmosit me qëllim që ai të mund të njihej me Zotin e tij! Prandaj udhëtari bëri thirrje duke thënë: Atëherë eja me ne që të trokasim derën e 'Madhështisë dhe të Lartësisë së Zotit', dhe le të futemi në vendqëndrimin e 'Akteve dhe veprave' dhe në botën e 'krijimit dhe të shpikjes'.. Sapo hyri në këtë vendqëndrim, ai pa se 'pesë të vërteta gjithëpërfshirëse' mbisundonin të gjithë kozmosin, provonin Unitetin Hyjnor dhe në mënyrë të vetëkuptueshme e kërkonin medoemos atë.

■ **E VËRTETA E PARË:** ***E Vërteta e Mahështisë dhe e Lartësisë së Zotit.***

Meqenëse kjo e vërtetë është shpjeguar me prova të ndryshme në Stacionin e Dytë të Rrezes së Dytë dhe në vende të tjera të ndryshme në Risale-i Nur, ne do të mjaftoheshim këtu me sa vijon:

Ai i Cili i krijoi dhe pastaj i administron në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë yjet që janë mijëra vite larg nga njëri-tjetri; dhe i Cili krijon individë të panumërt të një lloji të vetëm prej një luleje të mbjellur në lindje, ose në perëndim ose në veri ose në jug të tokës, dhe u jep formë atyre në një kohë të vetme, në një trajtë të vetme dhe në një model të vetëm; dhe i Cili na njofton për ngjarjen më të çuditshme e cila i përket të shkuarës dhe botës së padukshme në Fjalën e Tij, në vërsetin: *"Ai është i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë..."*[87] duke e provuar atë ngjarje sikur ajo ndodh para nesh, nëpërmjet krijimit të shembujve dhe modeleve të tyre në faqen e tokës, dhe veçanërisht me ardhjen e stinës së pranverës, në të cilën gjejmë e shohim me sy më

[87] Kuran 57:4

shumë se njëqind mijë shembuj e modele të Ringjalljes më të madhe të më shumë se dyqind mijë llojeve prej grupeve të bimëve dhe specieve të kafshëve, të cilat krijohen, rriten e zhvillohen vetëm brenda pesë ose gjashtë javëve.. nuk ka dyshim se Ai në dorën e të Cilit është administrimi i këtij grupimi të madh të bashkuar, duke i ushqyer, duke i zhvilluar dhe duke i furnizuar me rizk, duke i dalluar ato njëra nga tjetra, duke i stolisur me rregullin dhe me ekuilibrin më të plotë, pa asnjë ngatërresë, pa mangësi, pa gabim, pa vonesë dhe pa neglizhencë, Ai që nëpërmjet Dorës së të Cilit rrotullohet toka dhe ndodh dukuria e natës dhe e ditës me një rregullsi të mahnitshme ashtu siç e shpreh qartë vërseti Kur'anor: *"Allahu ndërfut natën tek dita dhe e ndërfut ditën tek nata..."*[88] duke regjistruar dhe duke fshirë -me këtë rrotullim- ngjarjet ditore dhe ndryshimet e tyre në faqen e natës e të ditës; dhe Ai i Cili njeh në të njëjtën kohë dhe në njëjtin moment mendimet më të fshehura e më sekrete që i ndodhin zemrës së njeriut dhe i administron ato sipas Dëshirës së Tij.. Ai duhet të jetë -vepruesi i këtyre akteve që secila prej tyre në realitet është një akt i vetëm, individual, i veçantë- një i vetëm, i Plotëfuqishëm Zotërues i lavdisë i Cili zotëron një madhështi e lartësi të tillë saqë në mënyrë të qartë i shkul të gjitha rrënjët e shirkut dhe i zhduk e i fshin të gjitha gjurmët dhe mundësitë e tij sido që të jetë lloji i tyre, prej cilitdo drejtimi, në çdo gjë dhe në cilindo vend që të jetë.

Meqenëse kjo lartësi dhe kjo fuqi maadhështore ekzistojnë, dhe meqenëse ky atribut i lartësisë Hyjnore është në kulmin e plotësisë të gjithëpërfshirjes së gjithanshme, atëherë sigurisht ato nuk do të lejonin absolutisht asnjë lloj shirku -politeizmi- sepse shirk do të thotë t'i atribuosh pafuqi dhe nevojë asaj fuqie Absolute, t'i ngjisësh mangësi asaj lartësie Hyjnore dhe defekt asaj plotësie, t'i imponosh kufizim asaj gjithëpërfshirjeje, dhe ta bësh të fundme të pafundmen absolute. Asnjë njeri që ka mendje, vetëdije dhe natyrë të shëndoshë të paprishur nuk do ta pranonte këtë.

Kështu, shirku meqenëse cënon e fyen atë lartësi, dinjitetin e Zotëruesit të lavdisë dhe madhështinë e Tij, është një krim aq i madh saqë është i pafalshëm. Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm e shpreh dhe e sqaron atë nëpërmjet kërcënimit dhe ndëshkimit të rëndë ndaj tij me vërsetin, *"Padyshim që Allahu nuk fal që Atij t'i vihen shokë -në adhurimin- por Ai fal përveç kësaj (çdo gjë tjetër) këdo që Ai dëshiron."*[89]

---

[88] Kuran 31: 29
[89] Kuran 4:48

■ E VËRTETA E DYTË: ***Shfaqja e Akteve Hyjnore në mënyrë absolute dhe gjithëpërfshirëse***.

Janë ato akte Hyjnore që shihen në veprim në kozmos duke u shfaqur në mënyrë absolute dhe gjithëpërfshirëse. Vetëm Urtësia Hynore dhe Dëshira Hyjnore i kufizojnë dhe u vënë cak atyre akteve si dhe kapaciteteve të bashkëlindur të objekteve dhe vendeve në të cilat ato manifestojnë vetveten. Rastësia e shmangur e pa qëllim, natyra e shurdhët, forca e verbër, shkaqet e pajeta e të pavetëdijshme dhe elementët e shpërndarë e të hallakatur nuk mund ta shtrijnë dorën e tyre apo të ndërhyjnë në ato akte të cilat janë me ekuilibrin, me urtësinë dhe hollësinë më të skajshme, të cilat realizohen me të gjithë intuitën, gjallërinë, vitalitetin, me rregullin dhe saktësinë. Shkaqet nuk janë gjë tjetër veçse një perde e jashtme të cilën e përdor fuqia vepruese e Zotëruesit të lavdisë dhe të madhështisë si dhe e nënshtron atë në përputhje me urdhrin, me vullnetin dhe me fuqinë e Tij xh.sh..

Tre prej shembujve të panumërt:

Ne do të shpjegojmë tre prej pikave të holla të shumta që rrëfejnë tre akte të treguar në tre vërsetet e lidhur me njëri-tjetrin në suren *el-Nahl*.

Vërseti i Parë:

"Dhe Zoti yt inspiroi edhe bletën duke i thënë: Ndërtoji shtëpitë e tua në male".[90]

Po, bleta është një mrekulli e fuqisë Hyjnore lidhur me gjendjen e saj të natyrshme dhe me funksionin; është një mrekulli e tillë e madhe saqë me emrin e saj u quajt një sure madhështore në Kuranin Kerim; sepse të shkruash e të regjistrosh programe të plota për përmbushjen e detyrës së saj të rëndësishme në një kokë shumë të vogël të asaj makinerie të vogël mjalti.. vendosja e më të mirit dhe e më të shijshmit të ushqimeve në stomakun e saj të vogël dhe pjekja e tyre në të.. zgjedhja e vendit të duhur për vendosjen e helmit vrasës në thumbin e saj duke shkatërruar qëniet e gjalla dhe pa u shkaktuar dëm gjymtyrëve të tjera të trupit, kjo nuk mund të realizohet veçse me kujdesin më të madh, me njohjen më të skajshme, me urtësinë dhe me vullnetin më të skajmë, dhe me rregullin dhe me ekuilibrin më të madh; prandaj nuk do të mund të ndërhynte absolutisht ndonjë gjë që nuk ka vetëdije, as rregull dhe as ekuilibër si shembulli i natyrës së shurdhët dhe i rastësisë së verbër në këto akte të mrekullueshme.

---

[90] Kuran 16:68

Dhe kështu ne shohim tre mrekulli në këtë art Hyjnor, dhe shikojmë gjithashtu shfaqjen e këtij akti Hyjnor, në bletët e panumërta që gjenden të shpërndara në të gjitha anët e tokës. Atëherë shfaqja e këtij akti Hyjnor, gjithëpërfshirja e atij akti duke i rrethuar të gjithë me të njëjtën urtësi, me të njëjtin kujdes dhe me të njëjtin ekuilibër, në të njëjtën kohë, me të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën simetri tregon në mënyrë të vetëkuptueshme për Unitetin e Zotit dhe provon Njësinë e Tij.

Vërseti i Dytë:

"Me të vërtetë që edhe tek bagëtitë ka mësim për ju. Ne ju japim juve të pini nga ajo që është në barkun e tyre nga bashkimi ndërmjet sekrecioneve të gjëndrave dhe të gjakut, qumësht të pastër, të shijshëm dhe të përshtatshëm për ata që e pinë."[91]

Ky dekret Hyjnor derdh instruksione e mësime. Të vendosësh në thithet e lopëve, deveve, dhive e deleve, si dhe tek nënat humane ndërmjet gjakut dhe jashtëqitjes por pa u ndotur prej tyre, një lëndë e cila është e kundërta e tyre, qumbësht të mirë, të pastër, të këndshëm, ushqyes dhe të bardhë, dhe të inspirosh në zemrat e atyre nënave butësinë dhe dhembshurinë që arrijnë deri tek caku i vetëflijimit dhe të preferencës për të vegjëlit e tyre është akoma më e këndshme, më e ëmbël dhe më e vlefshme se qumështi -kjo sigurisht kërkon një shkallë të tillë mëshire, urtësie, njohjeje, fuqie, vullneti dhe kujdesi saqë ajo kurrsesi nuk mund të jetë vepra e rastësisë së turbullt, e elementeve të ngatërruar dhe e forcave të verbëra. Prandaj, veprimi i këtij arti Hyjnor, gjithëpërfshirja e këtij arti Hyjnor dhe manifestimi me të njëjtën urtësi, me të njëjtin kujdes, në të njëjtin moment dhe në të njëjtën mënyrë të mrekullueshme, në zemrat e panumërta dhe në kraharorët e nënave të panumërta të qindra e mijëra specieve dhe në të gjithë faqen e tokës- kjo sigurisht provon Unitetin e Zotit dhe në mënyrë të vetëkuptueshme tregon Njësinë e Tij xh.sh..

Vërseti i Tretë:

"Dhe nga frutat e hurmave dhe nga rrushi ju merrni pije dhe ushqim të mirë. Padyshim që këtu ka shenjë të qartë për njerëzit që mendojnë."[92]

Ky vërset bën ftesë dhe tërheq vëmendjen për tek hurma dhe rrushi, duke thënë: "Për ata që kanë mend, ndodhet një provë e madhe, një argument dhe një dëshmi për Unitetin Hyjnor në këto dy fruta."

---

[91] Kuran 16:66
[92] Kuran 16: 67

Po, dy frutat që u përmendën konsiderohen si ushqim dhe si furnizim, dhe në të njëjtën kohë si frut; ato të dyja janë burimi i shumë lëndëve të shijshme ushqyese, pavarësisht se pema e secilës rritet në dhé të pajetë dhe lulëzon në një tokë të djerrë. Secila prej atyre të dyjave është një mrekulli prej mrekullive të fuqisë Hyjnore dhe një çudi prej çudirave të jashtëzakonshme të Urtësisë Hyjnore. Secila prej atyre të dyjave janë uzina sheqeri dhe ëmbëlsirash, fabrika shurupi si mjalti dhe vepra arti të krijuara me rregull të përkryer, me balancë të ndjeshme, me mjeshtëri të urtë, me përkujdesje të plotë artistike, saqë gjithkush që do të kishte mend sa një grimcë dhe që do të kishte intuitë do të detyrohej të thonte se, "Ai i Cili i krijoi këto gjëra kështu, është pikërisht Ai i Cili krijoi të gjithë universin", sepse ajo çfarë ne shohim para syve tonë të varur poshtë -për shembull- janë afërsisht njëzet vile rrushi, prej kësaj dege të vogël të hollë; secila vile -vesh rrushi- mban afërsisht njëqind kokrra të embëla rrushi dhe substanca të sheqerosura si mjalti dhe secila kokërr prej tyre është e mbuluar me një mbulesë të hollë, delikate, të këndshme, të ngjyrshme dhe të shndritshme, si dhe përfshin në brendësinë e saj të butë bërthama të forta të cilat janë mbajtëset e historive të jetës dhe të programit të saj.. po, krijimi i të gjithë kësaj dhe i kokrrave të tjera në të gjithë rrushin dhe në gjëra të ngjashme me to -të cilat janë të panumërueshme- mbi faqen e të gjithë tokës, me të njëjtin kujdes, me të njëjtën urtësi, dhe krijimi i atij arti të jashtëzakonshëm të mrekullueshëm me numrat e tyre të mëdha në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë, sigurisht provon në mënyrë të vetëkuptueshme se Ai i Cili e kryen këtë akt është vetëm se Krijuesi i të gjithë universit, dhe se ky akt i cili kërkoi atë fuqi absolute dhe atë urtësi të pafundme është vetëm se prej aktit të Atij Krijuesi të Gjithëlavdishëm.

Po, forcat e verbëra, natyra e shurdhët dhe shkaqet e shpërndara e të ngatërruara nuk mund t'i shtrijnë duart e tyre e të ndërhyjnë në atë balancë të hollë e të ndjeshme, në atë mjeshtëri të madhe dhe në atë rregull të urtë të atij arti, përkundrazi, ato vihen në shërbim dhe nënshtrohen nëpërmjet një urdhri Hyjnor në aktet Hyjnore; ato janë objekte pasive dhe pranimi, madje ato janë vetëm perde të nënshtruara nëpërmjet Dorës së Tij xh.sh..

Dhe atëherë, ashtu siç tregojnë këto tre vërsete tre të vërteta dhe secila prej tyre provon Unitetin Hyjnor në tre pika, po ashtu ndodhen akte Hyjnore të panumërt dhe manifestime Hyjnore të pallogaritshëm që tregojnë me unanimitet për Unitetin e të Vetmit Krijues dhe japin një dëshmi të vërtetë për të Vetmin Unik, Zotëruesin e lavdisë dhe të bujarisë.

■ E VËRTETA E TRETË: ***E vërteta e krijimit dhe e shpikjes***.

Domethënë, krijimi i qënieve -veçanërisht i bimëve dhe i kafshëve- me një shumësi absolute, me një shpejtësi absolute dhe me rregullsi absolute.. dhe krijimi i krijesave me një lehtësi absolute, me një bukuri e hijeshi të skajshme, me një mjeshtëri e talent të skajshëm dhe me rregull të përkyer.. dhe shpikja e gjërave me vlerë të skajshme, me cilësi dhe me dallim të qartë pavarësisht bollëkut të skajshëm, përzierjes dhe kombinimit.

Po, t'i krijosh gjërat në një shumësi të skajshme me një shpejtësi të skajshme, me një lehtësi të skajshme dhe kollaj dhe me një mjeshtëri e përsosuri të kombinuara me përkujdesje e rregullsi, me vlerë të madhe dhe me dallueshmëri me gjithë bollëkun e madh dhe me përzierjen, pa ndonjë lloj ngatërrimi, pa defekt e pamangësi, pavarësisht dendësisë së diferencave dhe dallimeve.. ky krijim nuk mund të realizohej -as nuk do të plotësohej- veçse nëpërmjet fuqisë së të Plotëfuqishmit të Vetëm Unik, fuqia e të Cilit është e tillë saqë asgjë nuk shfaqet e vështirë për të.

Po, që ta kuptojmë atë që e vështrojmë dhe e shohim me sytë tonë duhet që krijimi i yjeve dhe i grimcave të jenë të barabarta para asaj fuqie; më të mëdhatë e gjërave të jenë si më të vogëlat e tyre, individët e panumërt të llojit të jenë si individi i vetëm i tij, universalja gjithëpërfshirëse e madhe si e pjesshmja e vogël e veçantë, ringjallja e tokës së madhe si ringjallja e një peme të vetme, dhe krijimi i pemës së lartë si krijimi i një grimce shumë të vockël.

Nëpërmjet këtij misteri të rëndësishëm të cilin e përmban kjo shkallë e pohimit të Unitetit Hyjnor, që e përmban kjo e Vërteta e Tretë dhe fjala e unitetit -domethënë nëpërmjet misterit se universalja më e madhe është si e pjesshmja më e vogël përpara fuqisë Hyjnore duke mos pasur as edhe diferencën më të vogël midis të shumtës dhe të paktës, zbulohen misteret e holla e të fshehura të Kuranit Kerim. Shpjegimi dhe sqarimi i kësaj urtësie të çuditshme dhe i kësaj enigme të madhe e cila është përtej kapjes së arsyes -ndonëse është themeli më i rëndësishëm i islamit, boshti më i thellë i besimit dhe baza më e madhe e Unitetit Hynor- bëjnë të mundshme të njohësh sekretet më të fshehura e më të panjohura për realitetin e krijimit të universit të cilat nuk kanë mundur t'i kuptojnë as filozofët.

Falënderime e lavdërime njëqind mijë herë sa shkronjat e Risale-i Nurit qofshin për Krijuesin tim Mëshirëplotë që Risale-i Nuri e ka

zgjidhur këtë enigmë të çuditshme, e ka zbuluar këtë, të cilën injoranti e pandeh të errët, të paqartë e të çuditshme, madje e ka provuar me argumente të fuqishëm; dhe sidomos tek diskutimi i "***Ai është i Gjithëfuqishëm mbi gjithçka"*** në fund të Letrës së Njëzet; dhe në studimin lidhur me qënien e Zotit si ***"Vepruesi i Plotëfuqishëm***" në Fjalën e Njëzet e Nëntë, dhe e ka provuar hapësirën dhe pakufizueshmërinë e fuqisë Hyjnore me argumente të fuqishëm me shkallën e "dy edhe dy bëjnë katër" në shkallët ***Allahu Ekber*** në Shkreptimën e Njëzet e Nëntë e cila është shkruar në arabisht. Duke ua referuar sqarimin dhe shpjegimin e hollësishëm atyre pjesëve të Risale-i Nurit, do doja t'i shpjegoja këtu në mënyrë të shkurtuar si një indeks i përmbledhur ato thëmele dhe prova të cilat e trajtojnë këtë mister, e zbulojnë dhe e sqarojnë; dhe pastaj do të aludoja për trembëdhjetë mistere me trembëdhjetë shkallë, dhe fillova të shkruaja misterin e parë dhe të dytë, por për fat të keq ndërhynë dy pengesa të fuqishme materiale dhe jomateriale dhe më shkaktuan që t'i lija pa shkruar misterët e tjerë në kohën e tanishme.

Misteri i parë: Në qoftë se diçka është esenciale, e kundërta e saj nuk mund të hyjë në esencën e përcaktuar nga ajo gjë. Sepse kjo do të ishte bashkimi i dy të kundërtave, e cila është një absurditet. Duke u mbështetur mbi këtë parim;

Meqenëse Fuqia Hyjnore është esenciale -lidhet me Esencën e Tij- dhe është një bashkëshoqëruese e domosdoshme e Esencës së Tij më të shenjtë, atëherë pafuqia -e cila është e kundërta e asaj fuqie- në asnjë mënyrë nuk mund të hyjë tek Esenca e të Plotfuqishmit.

Dhe meqenëse ekzistenca e shkallëve në gjënë e vetme ndodh nëpërmjet ndërhyrjes së të kundërtës së saj në të -ashtu siç formohen shkallët e fuqisë së dritës dhe të dobësisë së saj me ndërhyrjen e errësirës, dhe gradat e ngritjes së temperaturës dhe të uljes së saj me ndërhyrjen e të ftohtit, dhe siç përcaktohen sasitë më të mëdha dhe më të vogëla të fuqisë nga ndërhyrja dhe e kundërta e rezistencës- atëherë është e pamundur që të përmbajë shkallë ajo fuqi esenciale - është krejtësisht e pamundur që të ekzistojnë shkallët në atë fuqi të Esencës Hyjnore.. Ajo i krijon dhe i shpik gjërat ashtu si gjënë e vetme. Meqenëse ajo Fuqi Esenciale është e zhveshur nga shkallët, nga dobësia dhe nga mangësia, atëherë sigurisht nuk qëndron asnjë pengesë para saj dhe krijimi i asnjë gjëje nuk i shkakton asnjë vështirësi asaj.

Atëherë, meqenëse asgjë nuk është e vështirë për fuqinë e Zotit, Ai e krijon ringjalljen më të madhe me aq lehtësi si krijimin e pranverës;

krijimi i pranverës është aq i thjeshtë për Të si krijimi i një peme të vetme; krijimi i pemës është aq i kollajt për Të si krijimi i një luleje të vetme. Për më tepër, Ajo fuqi e krijon lulen aq artistikisht si një pemë; e krijon pemën në mënyrë aq të mrekullueshme si pranverën; dhe e krijon pranverën në mënyrë aq gjithëpërfshirëse dhe aq të çuditshme si ringjalljen; kështu ajo krijon, dhe kështu ne e shohim krijimin që e bën ajo para syve tonë.

Është provuar në Risale-i Nur me prova vendimtare e të fuqishme se në qoftë se krijimi nuk do t'i atribuohej Unitetit Hyjnor, do të bëhej krijimi i një luleje aq i vështirë sa vështirësia e krijimit të një peme dhe madje më e vështirë; dhe do bëhej krijimi i pemës më i vështirë dhe më i ngatërruar se sa kijimi i praverës. Për më tepër, të gjitha do të binin lidhur me vlerën, mjeshtërinë dhe me cilësinë artistike; dhe qënia e cila tani merr një minut për t'u krijuar, do të prodhohej me vështirësi për një vit, ose ndoshta nuk do të mund të prodhohej kurrë.

Atëherë duke u mbështetur në këtë mister, të gjitha frutat, lulet, pemët, dhe gjallesat e holla të lidhura me to, dalin në ekzistencë me një bollëk e shumësi të skajshme megjithëse janë me një cilësi e vlerë të skajshme; dhe shfaqen me një shpejtësi e lehtësi të skajshme megjithëse janë bërë me një mjeshtëri e art të skajshëm; dhe paraqiten në ekzistencë me rregull duke kryer funksionet e tesbihatet e tyre dhe, duke lënë prapa farërat e tyre në vend të tyre, ato kalojnë e largohen në rrugën e tyre.

Misteri i dytë: Ashtu si një diell i vetëm që lëshon dritë tek një pasqyrë e vetme, nëpërmjet një manifestimi të fuqisë esenciale dhe duke u mbështetur tek misteri i dritësisë, i tejdukshmërisë dhe i bindjes, po ashtu ai reflekton me lehtësi me vetë imazhin e tij -së bashku me dritën dhe nxehtësinë e tij- nëpërmjet urdhrit Hyjnor dhe për shkak të aktivitetit të shtrirë të asaj fuqie të pakufizuar, mbi paqyra të panumërta, mbi objekte të shndritshëm dhe mbi pika. E madhja dhe e vogëla janë të njëjta, nuk ka ndryshim ndërmjet tyre.

Gjithashtu, ashtu si një fjalë e vetme e cila mund të hyjë në veshin e një njeriu me lehtësi të plotë, po ashtu për shkak të hapësirës së pafundme të krijueshmërisë së pakufishme, ajo fjalë mund të hyjë në mendjet e miliona personave dhe në veshët e tyre me lehtësi e kollaj nëpërmjet Urdhërit Hyjnor; përpara saj mijëra dëgjuesit dhe dëgjuesi i vetëm janë të barabartë, nuk ka ndryshim mes tyre.

Dhe ashtu siç i shikon syri një vend të vetëm dhe mijëra vende me lehtësi të plotë, ose një dritë e vetme ose një qënie e ndritshme e vetme

shpirtërore -si Xhebraili a.s.- në kohën që sheh, shkon e vjen në një vend të vetëm me gjithë lehtësinë -duke u mbështetur në hapësirën e pafundme të aktivitetit Hyjnor brenda manifestimit të mëshirës- po ashtu ai sheh, shkon e vjen -nëpërmjet fuqisë Hyjnore- me të njëjtën lehtësi në mijëra vende. Këtu nuk ka ndryshim midis të paktës dhe të shumtës.

Dhe kështu, fuqia esenciale e parapërjetshme -dhe Zotit i takon krahasimi më i lartë- për shkak të qënies së saj më e holla dhe më e zgjedhura e dritave, madje ajo është drita e të gjitha dritave, dhe për shkak të qënies së esencës së gjërave, realitetet e tyre dhe aspektet dhe dimensionet e tyre të brendshme, -për shkak të qënies së tyre- të tejdukshme dhe të ndritshme si pasqyrat, dhe për shkak se çdo gjë duke filluar nga grimcat tek bimët dhe nga të gjitha llojet e gjallesave për tek yjet, diejt dhe hënat- janë të bindura në mënyrën më të disiplinuar e të plotë ndaj dekretit të asaj fuqie esenciale dhe të nënshtruara e të varura në mënyrë absolute ndaj urdhërave të asaj fuqie të parapërjetshme, atëherë sigurisht ajo fuqi i shpik gjërat e panumërta duke i krijuar si gjënë e vetme dhe vjen tek çdo gjë në çdo moment dhe në çdo vend. Asnjë gjë nuk është pengesë për një gjë tjetër; e madhja dhe e vogëla, e shumta dhe e pakta, e pjesshmja dhe e tëra janë të barabarta tek ajo; të gjitha janë njëlloj për atë fuqi, për të cilën asgjë nuk është e vështirë.

Duke u mbështetur në misteret e Rregullit, ekuilibrit, bindjes ndaj urdhërave dhe nënshtrimit ndaj dispozitave -ashtu siç u përmend në Fjalën e Dhjetë dhe në Fjalën e Njëzet e Nëntë- një anije shumë e madhe mund të drejtohet e të lëvizë aq lehtë ashtu siç mund të lëvizë fëmija me gisht anijen e tij lodër- kukull.. dhe një komandant, ashtu siç e dërgon një ushtar të vetëm në betejë me të dhënë urdhrin e tij “Sulm”, po ashtu me të njëjtin urdhër ai e dërgon në luftë një ushtri të disiplinuar e të bindur..

Në qoftë se do të ndodheshin dy male në gjendje ekuilibri a baraspeshimi mbi dy pjatat e një peshoreje shumë të madhe e të ndjeshme dhe pastaj do të sillej një peshore tjetër dhe do të vendosej në secilën prej pjatave të saj një vezë në baraspeshim të plotë, atëherë ashtu siç do të ishte e mundur për një kokërr arre të vetme që ta ngrente lart njërën nga dy pjatat e peshores dhe tjetrën ta ulte poshtë, po ashtu pikërisht kjo arrë -nëpërmjet ligjit të urtësisë- do të mund ta ngrente lart në majë të malit njërën nga dy pjatat e peshores së madhe që mban malin dhe ta ulte pjatën tjetër në fund të luginës.

Ashtu siç është çështja kështu, po ashtu është çështja lidhur me fuqinë Hyjnore meqë ajo është absolute e pafundme, është e ndritshme, është esenciale dhe e përjetshme; gjenden me atë fuqi urtësia absolute dhe drejtësia e plotë të cilat janë burimi, origjina, boshti, themeli dhe fillimi i të gjithë rregullit, sistemeve dhe i ekuilibrit në krijim; e pjesshmja dhe universalja, e madhja dhe e vogëla prej çdo gjëje qoftë dhe prej gjithçkaje janë të bindura ndaj urdhërit të asaj fuqie dhe të nënshtruara ndaj veprimeve të saj.. kështu, ajo fuqi i vë në lëvizje dhe i rrotullon yjet dhe planetët me aq lehtësi -nëpërmjet misterit të urtësisë së rregullit të Tij- siç rrotullon e lëviz atomet.. dhe ashtu siç Ai e sjell në jetë me lehtësi një mizë, po ashtu Ai u dhuron jetë me të njëjtën lehtësi dhe me të njëjtin urdhër të gjitha specieve të mizave, insekteve dhe të gjitha llojeve të bimëve e të kafshëve duke i shtyrë ato për tek fusha e jetës, nëpërmjet misterit të urtësisë dhe ekuilibrit të brendaqenësishëm në Fuqinë e Tij.. dhe ashtu siç mbjell ajo një pemë në pranverë me një shpejtësi të jashtëzakonshme dhe i jep frymë, i jep jetë në rrënjët dhe në degët e saj të cilat janë si kocka, po ashtu nëpërmjet asaj fuqie absolute, të urtë e të drejtë dhe me të njëjtin urdhër i jep jetë kësaj toke të madhe e cila është si një kufomë e madhe, ashtu siç i dha jetë me lehtësi asaj peme në pranverë, duke krijuar qindra e mijëra lloje shembujsh e modelesh që tregojnë ringjalljen e madhe dhe ngritjen në jetë. Dhe ashtu si Ai xh.sh. e ngjall tokën nëpërmjet një urdhri krijues, po ashtu sipas përmbajtjes së këtyre ajeteve:

"Do të jetë vetëm një thirrje e vetme, dhe ja! Ç'të shohësh! Ata të gjithë do të jenë sjellë përpara Nesh!"[93]

"...Dhe çështja e orës (çastit të fundit) është sa një 'hap e mbyll sytë' ose edhe më afër." [94]

"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm." [95]

Ai do t'i sjell të gjithë njerëzit e xhindët, dhe çfarë është shtazor, shpirtëror, engjëllore, do t'i sjellë të gjithë me të njëjtin urdhër dhe me të njëjtën lehtësi në fushën e Ringjalljes më të madhe dhe para peshores më të madhe; dhe asnjë veprim nuk është pengesë për një veprim tjetër.

Shkrimi i mistereve të tjerë, prej misterit të tretë deri tek i trembëdhjeti, në kundërshtim me dëshirën time, është shtyrë në një kohë tjetër në dashtë Zoti xh.sh..

---

[93] Kuran 36:53
[94] Kuran 16:77
[95] Kuran 31:28

■ E VËRTETA E KATËRT: ***Tërësia e qënieve dhe shfaqja e tyre së bashku.***

Ekzistenca e të gjitha qënieve dhe shfaqja e tyre së bashku, të ndërfutura dhe të ngjashme me njëra-tjetrën, dhe qënia e njërës prej tyre si një shembull i zvogëluar për tjetrën, ose si një model më i madh për të, dhe qënia e një grupi prej tyre si një e tërë dhe universale ndërsa grupet e tjerë si të pjesshme, pjesët dhe individët e tij, duke i ngjasuar njëri-tjetrit në stampën e gjendjes së natyrshme, dhe lidhja e ngushtë -ngjashmëria- në skalitjen e mjeshtërisë artistike, dhe bashkëpunimi midis tyre, secili prej tyre duke ndihmuar e plotësuar funksionin e natyrshëm të tjetrit.. Dhe gjëra të ngjashme me këto në pika të shumta të aspektit të Unitetit në qëniet, shpallin në mënyrë të vetëkuptueshme Unitetin Hyjnor dhe provojnë e vërtetojnë se Autori i tyre është Një i Vetëm, Unik, dhe shfaqin -nga aspekti i Hyjnisë mbisunduese- se të gjitha qëniet në kozmos nuk pranojnë ndarje e copëzim. Ato janë si një universale dhe si një tërësi që nuk mund të copëzohen.

Për shembull, në çdo pranverë, të krijosh, të administrosh dhe të furnizosh e të mbështesësh anëtarët e panumërt të katërqind mijë llojeve e specieve të ndryshme të bimëve dhe të kafshëve, pavarësisht se ato janë së bashku dhe të ndërfutura tek njëra-tjetra, në një moment të vetëm dhe në të njëjtën mënyrë, pa defekt e gabim, duke i mbështetur ato me urtësinë më të plotë dhe me artin dhe me mjeshtërinë më të skajshme.. po kështu, t'i krijosh individërt e panumërt të të gjitha llojeve të shpendëve duke filluar nga shembulli i tyre i zvogëluar -insektet- për tek shembulli i tyre më i madh -fajkuat, skifterët- pastaj t'i pajisësh ato me mjetet e fluturimit dhe të jetesës dhe t'i bësh ato të udhëtojnë nëpër botën e ajrit; dhe të vendosësh në fytyrat e tyre stampën e mrekullueshme të mjeshtërisë artistike, dhe të instalosh me të gjithë rregullin vulën e urtësisë në trupat e tyre, dhe të vendosësh një shenjë të Unitetit të Zotit në natyrën -thelbin- e tyre me të gjithë përkujdesjen dhe mbështetjen...

Gjithashtu t'i bësh grimcat e ushqimit në mënyrë të urtë e të mrekullueshme të shpejtojnë për t'u ardhur në ndihmë qelizave të trupit; bërja e bimëve për të ndihmuar kafshët, kafshët duke mbështetur njeriun; të gjitha nënat duke nxituar për t'u ardhur në ndihmë të vegjëlve të tyre të pafajshëm dhe duke u dhënë përkujdesje, ta bësh këtë përpjekje, këtë mbështetje dhe këtë bashkëpunim të realizohen në kuadrin e një urtësie të plotë dhe brenda një mëshire të plotë.

Po kështu, të veprosh mbi të gjitha gjërat, të pjesshme dhe universale, duke filluar nga rruga e qumështit, sistemi diellor dhe elementët e tokës, deri tek perdet, klitat e bebes së syrit, petalet e trëndafilit, lëvoret e misrit dhe farat e bostanit si të ishin sfera të ndërfutura njëta brenda tjetrës, me të njëjtën rregullsi, përkryerje artistike, me të njëjtin akt dhe me të njëjtën urtësi -ta realizosh të gjithë këtë, provon e vërteton në mënyrë të vetëkuptueshme se Ai i Cili i kryen këto akte, sigurisht është Një i Vetëm, Unik; vula e Tij është mbi të gjitha gjërat në ekzistencë.

Ai ashtu siç nuk përkufizohet nga asnjë vend, është i pranishëm në çdo vend; dhe Ai është afër çdo gjëje, pavarësisht se çdo gjë është larg Tij, ashtu si dielli. Ashtu siç nuk janë të vështira për Të objektet më të mëdhenj të tilla si Rruga e Qumështit dhe sistemi diellor, po ashtu qelizat në gjakun e njeriut dhe mendimet që kalojnë përmes zemrës së tij nuk mund t'i fshihen Atij, as nuk janë përtej kapjes së fuqisë së Tij.

Sado e madhe dhe e shumtë që mund të jetë një gjë, ajo është aq e lehtë për Të sa gjëja më e vogël dhe më e pakët. Ai e krijon insektin e vogël me modelin dhe mjeshtërinë e skifterit; e krijon lulen me natyrën dhe me rregullin e një peme; e krijon kopshtin me hijeshinë dhe bukurinë e pranverës; dhe e krijon pranverën me madhështinë e ringjalljes. Gjërat më të çmuara në mjeshtërinë e tyre artistike Ai na i jep dhe na i dhuron me çmimin më të lirë. Çmimi që Ai na kërkon është thjesht të themi ***"Bismil-lah"*** *"Me Emrin e Allahut"* dhe ***"El-hamdu lil-lah"*** *"Lavdërimi dhe falënderimi i takojnë Allahut"*; Domethënë çmimi i caktuar për të gjitha ato mirësi të shumta të çmuara është të themi në fillim ***"Bismil-lahi Rahmanir-Rahim"*** dhe në fund ***"EL-hamdu lil-lah"***.

Meqenëse kjo e vërteta e katërt është shpjeguar e provuar tjetërkund në Risale-i Nur, ne mjaftohemi këtu me këtë aluzion të shkurtër:

Dhe shoku ynë udhëtues pa në fazën e dytë;

■ **E VËRTETA E PESTË:** ***Sistemi dhe rregullsia me e plotë dhe njëjtësia e substancave.***

Domethënë, njëjtësia e rregullsisë më të plotë në tërësinë e kozmosit, në shtyllat e në pjesët e tij, madje në të gjitha qëniet që përfshihen në të; dhe njëjtësia e nëpunësve dhe e substancave të kozmosit të gjërë të cilat janë boshti i administrimit të tij dhe janë të lidhura me skemën e tij të përgjithshme; fakti se Emrat Hyjnorë dhe aktet që janë në veprim në atë qytet madhështor, në atë ekspozitë të

madhe rrethojnë dhe i përfshijnë të gjitha gjërat; kështu Emri është i njëjti, akti është i njëjti dhe natyra është e njëjta në çdo vend pavarësisht se gjërat janë të ndërfutura njëra brenda tjetrës; fakti se elementet dhe speciet të cilat janë themeli për ndërtimin e atij pallati madhështor, për administrimin e tij dhe për futjen e gëzimit në të, gjithëpërfshijnë e mbulojnë sipërfaqen e tokës duke qenë të shpërndarë në shumicën e vendeve të saj, duke qëndruar pikërisht i njëjti element dhe i njëjti lloj dhe me të njëjtën natyrë në çdo vend pavarësisht qënies së tyre të ndërfutura njëra brenda tjetrës.. e gjitha kjo kërkon, provon, dëshmon dhe tregon domosdoshmërisht dhe në mënyrë të vetëkuptueshme se Autori dhe Regullatori i këtij kozmosi, dhe Sulltani dhe Ushqyesi -Zhvilluesi- i kësaj mbretërie, dhe Pronari dhe Ndërtuesi i këtij pallati është Një i Vetëm, Unik. Ai nuk ka asnjë përngjasues, as ministër, as ndihmës, as shok, as rival; Ai është i pastër dhe larg çdo paaftësie dhe mangësie.

Po, rregullsia në vetvete është një shprehje e plotë e unitetit; ajo kërkon një Rregullator të Vetëm; Ajo nuk lë vend për shirk -të përshkruarit ortakëri Krijuesit- i cili është burim kundërshtie e divergjence.

Atëherë meqenëse ndodhet një rregullsi e urtë dhe e hollë në të gjithë kozmosin -sido që të jetë gjëja, universale apo e pjesshme- duke filluar nga rrotullimi ditor dhe vjetor i tokës deri tek fizionomia e njeriut, tiparet e tij, sistemi i ndjenjave të tij dhe deri tek qarkullimi i qelizave të bardha dhe të kuqe në gjakun e njeriut, atëherë -asgjë- përveç të Plotfuqishmit Absolut nuk mund ta shtrijë dorën e tij qëllimisht dhe në mënyrë krijuese tek ndonjë gjë, dhe as nuk mund të ndërhyjë në të. Pëkundrazi, të gjitha gjërat, përveç Tij, janë përfituese, mjete manifestimi dhe pasive.

Tani, përderisa bërja e rregullsisë, dhënia e sistemit dhe veçanërisht ndjekja e qëllimeve dhe vënia e tyre në rregull nëpërmjet shfaqjes së dobive nuk mund të bëhen veçse me njohje dhe me urtësi, dhe veçse me dëshirë depërtuese dhe me zgjedhje, atëherë sigurisht, kjo rregullsi që rrotullohet me urtësi, dhe këto lloje të ndryshme sistemesh në krijesat e pafundme që shfaqen para shikimeve tona dhe që vërtiten rreth interesave dhe dobive, në mënyrë të vetëkuptueshme tregojnë e dëshmojnë me çdo gjendje se Krijuesi dhe Rregullatori i të gjitha qënieve është Një i Vetëm; Ai është vepruesi, dhe është Ai në dorën e të Cilit është zgjedhja; çdo gjë që del në ekzistencë shfaqet vetëm se nëpërmjet fuqisë së Tij; merr një gjendje të veçantë vetëm se

nëpërmjet dëshirës së Tij dhe dhe merr një formë të rregullt veçse me zgjedhjen e Tij.

Dhe meqenëse llampa nxehtësidhënëse e kësaj bujtine të dynjasë është një; dhe kandili i saj i varur për të numëruar ditët është një; sfungjerët e saj të mëshirshëm janë një; dhe kuzhina e saj e ndezur është një; dhe pija e saj jetëdhënëse është një, dhe fusha e saj e mbrojtur është e njëjta... një.. një.. një.. deri në një mijë e një shembuj të tjerë njëjtësie, atëherë sigurisht këto shembuj njëjtësie dëshmojnë në mënyrë të vetëkuptueshme se Autori dhe Mjeshtri i kësaj bujtine është Një i vetëm; Ai është pafundësisht Bujar dhe aq Mikpritës për mysafirët e Tij të mëdhenj saqë Ai i ka nënshtruar më të mëdhenjtë e këtyre nëpunësve të Tij duke i bërë shërbëtorë të bindur për të garantuar rehatinë e mysafirëve të Tij prej gjallesave.

Dhe meqenëse janë Një ato Emra të bukur, ato atribute e akte Hyjnore të cilat drejtojnë çështjet e kozmosit dhe të cilat i shfaqin manifestimet e tyre, skalitjet dhe gjurmët e tyre në të gjitha anët e botës.. atëherë Emrat e bukur Hyjnorë të tillë, si: ***El- Hakimu, El-Musav-viru, El-Mudeb-biru, El-Muhji, El-Murebbi,*** *i Gjithurti, Formëdhënësi, Rregullatori, Jetëdhënësi* dhe *Ushqyesi -Zhvilluesi-* dhe pikërisht shembujt e tyre janë në çdo vend... dhe atribute të tilla si: "Urtësia, mëshira dhe përkujdesja" dhe pikërisht shembujt e tyre janë në çdo vend... dhe akte të tilla si: "formimi, drejtimi dhe mbështetja me ushqim" dhe pikërisht shembujt e tyre janë në çdo vend... dhe të gjithë ato janë të ndërfutur njëri brenda tjetrit.

Ato e përfshijnë dhe e rrethojnë çdo vend në shkallën më të lartë duke qenë secili Emër e akt i pranishëm atje; sikur secili prej tyre të plotësonte skalitjen e tjetrit saqë sikur ato Emra dhe akte të bashkoheshin me njëri-tjetrin në një mënyrë të tillë që fuqia të bëhej pikërisht urtësia dhe mëshira, dhe urtësia të bëhej pikërisht përkujdesja dhe jeta. Për shembull, sapo shfaqet aktiviteti i Emrit ***El-Muhji,*** *Jetëdhënësi* në ndonjë gjë, aktiviteti i shumë Emrave të tillë si, ***El-Hakk, El- Musav-vir*** dhe ***Er-Rezzak,*** *Krijues, Formëdhënës* dhe *Furnizues*, gjithashtu shfaqen në të njëjtën kohë, në çdo vend dhe në të njëjtin sistem.

Kjo sigurisht dhe në mënyrë të vetëkuptueshme dëshmon e provon se Ai i Cili njihet dhe emërohet me ato Emra Gjithëpërfshirës, dhe vepruesi i atyre akteve të gjithanshme dhe të dukshme gjithandej në të njëjtin model, sigurisht është një Veprues i Vetëm Unik.. në këtë ne besojmë dhe për këtë ne dëshmojmë!

Dhe meqenëse elementët që janë substanca dhe materiali i krijimit rrethojnë sipërfaqen e tokës dhe janë shpërndarë sipër saj, dhe secila nga speciet e krijesave -që mbajnë vula të ndryshme shfaqin Unitetin- janë shpërndarë gjithandej tokës në Unitet dhe e kanë pushtuar atë, pavarësisht qënies së saj një specie e vetme, atëherë sigurisht, ato elemente së bashku me atë çfarë ato përmbajnë, dhe ato specie së bashku me individët e tyre janë produkt dhe prona e Një të Vetmi Unik. Ato janë produktet dhe shërbëtorët e Atij të Vetmi Fuqiplotë i Cili nëpërmjet Fuqisë së Tij absolute i vë në shërbim ato elemente madhështore mbisunduese sikur ato të ishin shërbëtore të bindura; dhe i nënshtron ato specie të shpërndara në të gjitha anët e tokës sikur ato të ishin ushtarë të mirëdisiplinuar.. Meqenëse kjo e vërtetë gjithashtu është provuar e shpjeguar në vende të tjera të Risale-i Nurit, ne mjaftohemi këtu me këtë tregues të shkurtër.

Duke i përmbledhur shikimet dhe përshtypjet e tij që i nxori nga këto pjesë të vërteta, nëpërmjet begatisë së besimit dhe gëzimit të Unitetit Hyjnor dhe duke shprehur ndjenjat e tij, udhëtari ynë iu adresua zemrës së tij duke i thënë:

Vështroje faqen e ngjyrosur të librit të madh të kozmosit;

Shiko çfarë formash ka shkruar pena e artë e Fuqisë.

Asnjë pikë e errët nuk mbetet për shikimin e syrit të zemrës, për të vetëdijshmit;

Është sikur Zoti t'i ketë shkruar shenjat e Tij me dritë.

Gjithashtu mësoje se:

Këto dimensione të pafundme janë fletët e librit të botës, dhe këto shekuj të panumërt janë rreshtat e ngjarjeve të kohës.

Në pllakën e ruajtur të Realitetit është shkruar:

Çdo qënie në botë është një fjalë e mishëruar, kuptimplote, e urtë.

Gjithashtu dëgjoje këtë:

Të gjitha gjërat shpallin, "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut".

Dhe njëzëri ato vazhdimisht thonë: Ja Hakk, "O i Vërtetë!" dhe të gjitha kërkojnë në harmoni duke thënë: Ja Hajj, "o i Gjalli i Përjetshëm!"

Po, në të gjitha gjërat ndodhet një shenjë duke treguar Faktin se Ai është Një i Vetëm.

Dhe kështu zemra e udhëtarit e pranoi të vërtetën dhe e afirmoi; dhe ato të dy thanë së bashku: Po, po.

Dhe kështu erdhi në vendqëndrimin e dytë të kapitullit të dytë të stacionit të parë një aluzion i shkurtër për atë që pa udhëtari nëpër

kozmos dhe mysafiri në të prej pesë të vërtetave të Unitetit, të cilat janë:

[Lai lahe il-lall-llahu...]

• • •

Kur ai udhëtar nëpër botë po shëtiste nëpër shekuj të ndryshëm, hasi rastësisht shkollën e *Muxheddidit* -Ripërtëritësit- të mijëvjeçarit të dytë, Imam Rabbanit, Ahmed Faruki. Ai hyri në të dhe filloi të dëgjonte.

Imami thonte midis të tjerash në mësimin që ai jepte:

"Rezultati më i rëndësishëm i të gjithë tarikateve të Sufizmit është zbulimi i të vërtetave të besimit dhe qartësimi i tyre; dhe sqarimi e zbulimi i një çështjeje të vetme është më e preferueshme se sa një mijë keramete".

Imami gjithashtu thonte:

"Në kohët e hershme, disa personalitete të mëdhenj thonin se "një person do të shfaqet prej teologëve dhe prej dijetarëve të shkencave të teologjisë; ai do t'i provojë të gjitha të vërtetat e besimit dhe të Islamit me prova të arsyeshme dhe me qartësinë më të skajshme. Unë do të doja të isha unë ai person, madje mund të jem unë ai.[96]

Meqenëse besimi dhe Uniteti Hyjnor janë themeli i të gjitha plotësive njerëzore, substanca, drita dhe jeta e plotësimit human, dhe hadithi -parimi- "*mendimi reflektiv i një ore është më i mirë se sa adhurimi i një viti",* i referohet dhe aludon për reflektimin në besim; dhe se "mënyra heshtur e dhikrit që praktikohet në tarikatin Nakshibendi dhe rëndësia e saj është veçse ky lloj prej llojeve të këtij reflektimi të lartë e të shkëlqyer."

Dhe kështu Imami jepte mësim dhe udhëtari e dëgjonte me të gjithë vëmendjen. Pastaj ai u kthye dhe iu adresua vetvetes duke i thënë:

Meqenëse ky imam heroik thotë kështu, dhe se shtimi i fuqisë së besimit edhe sikur sa pesha e një atomi është më e çmueshme se sa tonelatat e njohurive apo të formave të tjera të plotësive, madje ajo do të ishte njëqind herë më e ëmbël dhe më e mirë se sa eksperiencat

[96] Koha ka provuar se personi për të cilin aludohet këtu nuk është në fakt një individ, por vetë Risale-i Nuri. Ndoshta njerëzit e zbulesave e panë në zbulesat e tyre "Risale-i Nurin" në personin e interpretuesit dhe shpallësit të tij, i cili nuk ka rëndësi, dhe thanë: Ai është një person. Autori.

vizionare. Dhe meqenëse kundërshtitë dhe dyshimet e grumbulluara rreth besimit dhe Kur'anit -të cilat i shkaktojnë filozofët e Europës që prej një mijë vitesh- kanë gjetur rrugën e tyre për tek zemrat e besimtarëve, dhe me to sulmojnë njerëzit e besimit, dhe përpiqen me to të trondisin shtyllat e besimit të cilat janë themeli i lumturisë së përjetshme dhe boshti i jetës së pavdekshme, dhe çelësi i xhennetit të amshuar, atëherë sigurisht, para së gjithash, ne duhet ta forcojmë besimin tonë dhe ta transformojmë atë nga një besim imitues në besim real verifikues.

Atëherë, eja të përparojmë, o nefs, me këto njëzet e nëntë shkallë të besimit të cilat i kemi gjetur, që secila prej tyre është aq e ngulitur dhe e fuqishme si një mal, duke synuar t'ia bashkojmë ato numrit të *dhikrit* dhe të *tesbihateve* të bekuara të namazit, i cili është numri i tridhjetë e tre; dhe me qëllim që të shohim një vendqëndrim të tretë në këtë botë instruksioni, le të trokasim tek dera e administrimit dhe e mbështetjes Hyjnore në botën e qënieve të gjalla dhe le ta hapim atë me çelësin e ***Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim***, *Me Emrin e Allahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.*

Udhëtari trokiti tek dera e këtij vendqëndrimi të tretë i cili është një përmbledhje e tubim çudirash dhe një shfaqje gjërash të jashtëzakonshme; ai e trokiti derën me përgjërim e lutje dhe pastaj e hapi me ***Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim***. Vendqëndrimi i tretë u bë i dukshëm për të; ai hyri në të dhe pa se ai vendqëndrim ndriçohej nga katër të vërteta të mëdhaja dhe gjithëpëfshirëse që demonstronin dhe zbulonin Unitetin Hyjnor aq qartë si dielli vezullues.

. . .

■ **E VËRTETA E PARË e cila është e Vërteta e *Hapjes*.**

Domethënë, hapja e formave të panumërta të ndryshme, të rregullta e të dallueshme nëpërmjet manifestimit të Emrit Hyjnor ***El-Fet-tah*** prej një lënde shumë të thjeshtë, dhe hapja e zbulimi i tyre së bashku në të gjitha anët e botës, në një moment të vetëm dhe nga një akt i vetëm.

Po, ashtu si fuqia krijuese e Allahut që ka hapur qënie të panumërta të ndryshme, si hapja e luleve, në kopshtin e kozmosit, dhe nëpërmjet manifestimit të Emrit ***El-Fet-tah***, *Hapësi*, i ka dhënë secilës prej tyre një formë të rregullt që i përshtatet dhe një identitet të dallueshëm, po ashtu fuqia e Krijuesit, u ka dhënë -në mënyrën më të mrekullueshme- një formë të drejtpeshuar, simetrike, të zbukuruar dhe të dallueshme secilës prej katërqind mijë llojeve të gjallesave në

kopshtin e tokës, të cilat janë në urtësinë dhe në mjeshtërinë artistike më të skajshme. Po, kjo hapja e formave është prova më e fortë e Unitetit Hyjnor dhe mrekullia më e çuditshme e fuqisë Hyjnore, ashtu siç tregojnë këto dy vërsete:

"Ai ju krijon ju në barkun (mitrat) e nënave tuaja, krijim pas krijimi (hap pas hapi në faza të caktuara) në tri errësira. I Tillë është Allahu, Zoti juaj. I Tij është mbisundimi; nuk ka zot tjetër përveç Atij. Atëherë, ku do të ktheheni?" [97]

"Vërtet, asgjë nuk i fshihet Allahut, as në tokë dhe as në qiej."

"Ai është i Cili ju formëson në mitra ashtu siç Ai dëshiron; nuk ka zot tjetër përveç Atij, i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti."[98]

Meqenëse hapja e formave është vërtetuar e shpjeguar në mënyrë të përsëritur në mënyra të ndryshme në vende të tjera në Risale-i Nur, dhe veçanërisht në shkallën e gjashtë dhe në shkallën e shtatë të kapitullit të parë të Stacionit të Dytë të kësaj trajtese, ne ia referojmë diskutimin e kësaj çështjeje atyre vendeve dhe këtu do të mjaftohemi me fjalën që vijon:

Sipas dëshmisë së shkencës së botanikës dhe të biologjisë, të bazuara mbi studime dhe kërkime të thella, ndodhet në hapjen dhe në zbulimin e formave, një gjithëpërfshirje dhe një mjeshtëri e tillë artistike saqë këtë akt të gjithanshëm e gjithëpërfshirës nuk mund ta zotërojë askush tjetër përveç të Vetmit Unik, Fuqiplotit absolut i Cili i sheh dhe i bën të gjitha gjërat; sepse ky akt i hapjes së formave kërkon ekzistencën e një urtësie të skajshme, e një përkujdesjeje të skajshme dhe një gjithëpërfshirjeje të skajshme brenda një fuqie absolute që sundon në çdo vend dhe në çdo kohë. Dhe një fuqi të këtillë e zotëron veçse i Vetmi Unik në Dorën e të Cilit është drejtimi i tokës dhe i qiejve.

Po, ashtu siç erdhi në vërsetin kuranor të lartëpërmendur *"në tri errësira*", krijimi i njeriut, hapja e formave të tij hap pas hapi në mitrat e nënave me ekuilibër e stoli dhe me rregull e dallueshmëri pa ndonjë ngatërresë, pa gabim e pa mangësi, nga një lëndë e thjeshtë, është një provë shumë e fuqishme për Unitetin e Zotit.

Atëherë, gjithëpërfshirja e kësaj të vërtete -hapja e formave dhe gjithanshmëria e saj nëpërmjet të njëjtës fuqi, të njëjtës urtësi dhe të njëjtës mjeshtëri artistike, për të gjithë njerëzit, për të gjitha kafshët dhe për të gjitha bimët në të gjitha anët e tokës, sigurisht është

[97] Kuran 39:6
[98] Kuran 3:5-6

argumenti më i fuqishëm për Unitetin e Zotit; sepse akti i gjithëpërfshirjes në vetvete është një formë Uniteti që nuk lë vend për shirk -për t'i përshkruar ortak Zotit xh.sh..

Ashtu si nëntëmbëdhjetë të vërtetat e kapitullit të parë që dëshmuan -nëpërmjet ekzistencës së tyre- për domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit xh.sh., po ashtu ato dëshmojnë -nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre- për Unitetin e Tij.

Pastaj udhëtari ynë pa të vërtetën e dytë vijuese në vendqëndrimin e Tretë:

. . .

■ E VËRTETA E DYTË: Ajo është e vërteta e *Mëshirës*

Kjo do të thotë se ndodhet një i Vetëm i Cili e ka bërë për ne tokën -ashtu siç duket ajo qartë para syve tonë- si një vend të shkëlqyer gostie, dhe ka mbushur fytyrën e saj me mijëra dhurata të mëshirës, dhe ka shtruar për ne me atë mëshirë një gosti që përmban qindra e mijëra ushqime të shijshme të ndryshme të përgatitura mbi atë tryezë; dhe e ka bërë për ne brendësinë e tokës -nëpërmjet mëshirës dhe urtësisë së Tij- si një depo të madhe që përmban me mijëra nga mirësitë dhe nga dhuratat e Tij të çmueshme. Ai na zhvillon me mëshirën më të skajshme duke e ngarkuar tokën prej botës së padukshme në rrotullimin e saj vjetor -si të ishte një anije tregtare- me qindra e mijëra prej llojeve më të mira të domosdoshme jetike për njeriun dhe prej llojeve më të bukura dhe i dërgon ato në çdo vit sikur ato të ishin një anije e ngarkuar ose një tren i mbushur. Çdo pranverë në të është si një tren që transporton ushqime e veshje për ne. Dhe me qëllim që ne të përfitojmë prej të gjitha atyre dhuratave dhe mirësive, Ai na ka dhënë qindra, madje mijëra orekse, nevoja, ndjenja, dëshira dhe shqisa..

Po, ashtu siç u shtjellua në Rrezen e katërt e cila shpjegon vërsetin, *"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*[99], dhe provoi atje se Ai xh.sh. na ka dhuruar ne një stomak që mund të gjejë kënaqësi në shumëllojshmëri të pafundme ushqimi.

Ai na ka dhënë ne një jetë të tillë saqë nëpërmjet shqiseve të shoqëruara me të ne mund të përfitojmë prej mirësive të panumërta të botës së gjërë fizike sikur ajo të ishte një sofër e shtruar për mirësitë.

---

[99] Kuran 3:173

Ai xh.sh. na ka nderuar neve me gjendjen humane me qëllim që ne të mund të kënaqemi prej dhuratave të pafundme të botës materiale dhe të botës shpirtërore, nëpërmjet instrumenteve të tilla si mendja dhe zemra.

Ai na ka mësuar ne islamin me qëllim që ne të marrim dritë nga thesaret e pafundmë të botës së padukshme dhe të botës së dukshme.

Ai na ka drejtuar ne tek besimi me qëllim që ne të ndriçohemi prej dritave të botëve të dynjasë dhe të Ahiretit dhe prej dhuratave të atyre të dyjave.

Sikur ky kozmos të ishte një pallat i lartë i stolisur nga ana e mëshirës së gjërë me gjërat dhe me qëniet më të çmueshme, dhe iu dhanë dorës së njeriut çelësat e thesareve dhe të banesave të tij të panumërta dhe u vendosën në natyrën e njeriut të gjitha nevojat dhe shqiset e domosdoshme për të përfituar prej gjithçkaje që ndodhet në pallat.

Atëherë, kjo mëshirë që rrethon këtë botë dhe Ahiretin, dhe në të vërtetë të gjitha gjërat, padyshim është një manifestim i Hyjnisë brenda Unitetit.

Ashtu si drita e diellit që është një shembull i shquar "uniteti" me anë të gjithëpërfshirjes së Tij të gjitha gjërat që janë përballë tij, po ashtu çdo objekt i ndritshëm dhe i tejdukshëm që merr reflektimin e dritës, nxehtësisë dhe të shtatë ngjyrave të diellit, është një shembull dhe një simbol i 'Njësisë'.

Prandaj, kushdo që do të shikonte dritën e tij gjithëpërfshirëse do të konkludonte se dielli i kësaj toke është një dhe i vetëm. Duke shikuar reflektimin e ngrohtë dhe të ndritshëm të diellit në të gjitha objektet e shndritshme, dhe madje dhe në pikat e ujit, ai do të thonte se njësia e diellit, ose vetë dielli është i pranishëm me atributet e tij afër të gjitha gjërave, ai është në pasqyrën e zemrës së çdo gjëje.

Ashtu siç është çështja kështu në krahasim -Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë- gjithëpërfshirja e të gjitha gjërave nga mëshira e të Gjithëmëshirshmit Zotërues të bukurisë, si drita, demonstron Unitetin e Atij të Gjithëmëshirshmi dhe mosekzistencën e ndonjë ortaku për Të në asnjë aspekt, dhe se ekzistenca e manifestimeve të dritave të shumicës së Emrave të Atij të Gjithëmëshirshmi dhe një lloj prej manifestimit të Esencës së Tij të shenjtë gjenden në çdo gjë, dhe sidomos në të gjitha qëniet e gjalla, dhe në mënyrë të veçantë tek njeriu -meqë i Gjithëmëshirshmi i ka dhënë atij nën perden e mëshirës së Tij të gjërë e të gjithanshme një gjithëpërfshirje që buron nga jeta e

cila e bën atë të shohë të gjithë universin dhe të vendosë lidhje me të-kjo provon njësinë e Atij të Gjithëmëshirshmi xh.sh. dhe praninë e Tij tek çdo gjë, dhe se 'Ai' i bën të gjitha gjërat në të gjitha gjërat.

Po, ashtu si Ai i Gjithëmëshirshëm që nëpërmjet Unitetit dhe gjithëpërfshirjes së mëshirës së Tij, shfaq madhështinë e lavdisë së Tij në të gjithë kozmosin dhe mbi të gjithë tokën, po ashtu Ai nëpërmjet manifestimit të njësisë së Tij në çdo gjallesë dhe sidomos tek njeriu dhe duke grumbulluar të gjitha modelet e atyre mirësive dhe duke i ngulitur ato në gjymtyrët e asaj qënieje të gjallë dhe në instrumentet e tij dhe duke i vënë ato në rregull, dhe duke e bërë atë individ të vetëm të marrë -nga një aspekt- tërësinë e universit pa e rrënuar banesën dhe vendstrehimin e tij, sikur Ai të shpallte dhembshurinë e bukurisë së Tij dhe të bënte të njohur përqëndrimin e llojeve të mirëbërësisë së Tij tek njeriu.

Në qoftë se do të merrnim bostanin si shembull, në secilën nga farat e tij gjendet vetë bostani; pra, mund të thuhet se bostani është i përqëndruar në farën e tij; atëherë Krijuesi i kësaj fare të vetme duhet medoemos të jetë Krijuesi i atij bostani, sepse me një peshore të veçantë të Njohjes së Tij dhe me një ligj të veçantë të urtësisë së Tij, Ai e nxjerr farën prej tij, e mbledh dhe e bën t'u përshtatet balancave dhe ligjeve të urtësisë së Tij. Atëherë absolutisht asnjë gjë tjetër nuk do të mund ta prodhonte atë farë përveç Krijuesit të vetëm të atij bostani; -që ta prodhonte atë ndonjë tjetër përveç Tij do të ishte krejtësisht e pamundur.

Meqenëse nëpërmjet manifestimit të mëshirës kozmosi është bërë si një pemë ose si një kopësht, dhe toka bëhet si fruti ose si bostani, dhe njeriu e gjallesa bëhen si fara, atëherë sigurisht duhet që Krijuesi i më të vogëlës së gjallesave të jetë Krijuesi i të gjithë tokës, dhe Zoti i më të hollës së qënieve të gjalla duhet të jetë Zoti i të gjithë kozmosit.

Shkurtazi: Ashtu si krijimi i formave të rregullta të të gjitha qënieve dhe hapja e tyre nga një lëndë e thjeshtë -nëpërmjet të vërtetës së hapjes e cila është gjithëpërfshirëse- që provon Unitetin në mënyrë të vetëkuptushme, po ashtu e vërteta e mëshirës, e cila i rrethon të gjitha gjërat, nëpërmjet dhënies ushqim të gjitha qënieve të gjalla që vijnë në ekzistencë dhe hyjnë në jetën e kësaj bote, veçanërisht të porsaardhurit -të vegjëlit- me rregullin dhe me sistemin më të skajshëm, duke bërë që t'u arrijnë atyre të gjitha domosdoshmëritë e jetëve të tyre, duke ua siguruar të gjitha ato, pa harruar asnjërën prej tyre; gjithëpërfshirja e të njëjtës mëshirë dhe arritja e saj tek çdo

individ, në çdo vend dhe në çdo moment, demonstron në mënyrë të vetëkuptueshme edhe Unitetin, edhe Njësinë brenda Unitetit.

Meqenëse Risale-i Nuri është prej manifestimeve të Dy Emrave ***El-Hakimu*** dhe ***Er-Rahimu,*** *i Gjithurti* dhe *Mëshirëploti* prej Emrave të bukur Hyjnorë, dhe meqenëse sqarimi i pikave të holla të 'të vërtetës së mëshirës' dhe manifestimet e saj së bashku me vërtetimin dhe shpjegimin e saj janë shtjelluar në shumë vende të Risale-i Nurit, ne u mjaftuam këtu duke aluduar për të me këtë pikë prej atij deti të gjërë.

Dhe ajo që shoku ynë udhëtar pa e soditi në vendqëndrimin e tretë është:

. . .

■ **E VËRTETA E TRETË e cila është e vërteta e *Rregullimit* dhe e *administrimit*.**

Domethënë, e vërteta e administrimit të trupave qiellorë të cilët janë në shpejtësinë dhe në madhësinë më të skajshme, dhe e administrimit të elementëve të cilët janë në ndërfutjen dhe në përzierjen më të skajshme, dhe e administrimit të krijesave të tokës të cilat janë në nevojën dhe pafuqinë më të skajshme, duke i administruar ato me rregullin dhe me ekuilibrin më të plotë; duke i bërë ato të nxitojnë për të ndihmuar njëra-tjetrën, pavarësisht përzierjes dhe shkrirjes së tyre me njëra-tjetrën.

Domethënë, ajo është e vërteta e shikimit në administrimin e të gjitha çështjeve të tyre, dhe në bërjen e këtij pallati madhështor të mahnitshëm dhe si një pallat i lartë i stolisur bukur.

Duke i lënë mënjanë sferat e gjëra të këtij administrimi madhështor e të mëshirshëm, meqenëse ai është shpjeguar e provuar në pjesë të rëndësishme të Risale-i Nurit, si tek Fjala e Dhjetë, ne do të tregojmë me anë të një krahasimi një faqe të vetme dhe një fazë të vetme të atij administrimi siç e manifeston ai vetveten në pranverë mbi sipërfaqen e tokës.

Le të supozojmë, për shembull, se një person i madh i jashtëzakonshëm grumbulloi e formoi një ushtri prej katërqind mijë kombesh e grupesh të ndryshme, dhe siguroi gjithçka që i përket çdo ushtari prej atyre kombeve e grupeve të ndryshme, -siguroi- uniformat, armët, racionet e ushqimit, instruksionet, shkarkimet dhe shërbimet e ndryshme të shumëllojshme; dhe i pajisi ato me pajime të ndryshme pa asnjë mangësi, pa asnjë defekt apo gabim; dhe i pajisi ato në kohën e

duhur pa vonesën më të vogël, pa ngatërresë dhe me rregullin më të plotë; nuk ka dyshim se ai administrim i gjërë, kompleks, i hollë, i ekuilibruar, i shumtë dhe i drejtë është veçse prej një fuqie të jashtëzakonshme të atij komandanti të jashtëzakonshëm, dhe asnjë shkak nuk ka mundësi që ta shtrijë dorën e tij tek ato; sepse në qoftë se do ta shtrinte dorën, do të prishej ai ekuilibër dhe do të shkaktonte konfuzion.

Ashtu siç është çështja kështu në këtë shembull, ne gjithashtu shohim me sytë tonë se një dorë e padukshme krijon dhe administron në çdo pranverë një ushtri madhështore që përbëhet nga katërqind mijë lloje të ndryshme gjallesash, pastaj në stinën e vjeshtës -e cila është një model i kijametit- i shkarkon treqind mijë prej atyre katërqind mijë specieve të bimëve dhe të kafshëve prej detyrave të tyre nëpërmjet formave të vdekjes me emrin e vdekjes. Dhe në pranverë -e cila është shembull i tubimit që ndjek Ringjalljen- krijon dhe ndërton treqind mijë të modeleve të Ringjalljes më të madhe brenda pak javëve me rregullin dhe disiplinën më të skajshme. Saqë Ai xh.sh. pasi na tregon në vetë pemën katër lloje të zvogëluar ringjalljeje, me rimëkëmbjen e vetë pemës, të gjetheve të saj, të luleve dhe të frutave të saj -ashtu siç ishin në pranverën e kaluar- Ai kështu na shfaq dhe provon Unitetin e Tij, Njësinë e Tij, vetminë e Tij, fuqinë e Tij absolute dhe mëshirën e Tij të pakufishme brenda plotësisë së Hyjnisë, mbisundimit dhe urtësisë, dhe Ai xh.sh. e shkruan këtë çështjen e Unitetit Hyjnor me Penën e Kaderit në faqen e çdo pranvere në faqen e tokës; dhe kjo, duke i dhënë çdo lloji dhe çdo grupi të asaj ushtrie të Krijuesit xh.sh. furnizimet e ndryshme ushqimore dhe gjithçka që i nevojitet asaj prej armëve mbrojtëse të ndryshme dhe gjithçka që i shkon asaj prej rrobave dhe uniformave të shumëllojshme, dhe çfarë i përshtatet asaj prej instruksioneve dhe shkarkimeve të ndryshme, dhe çfarë është në përputhje me të gjitha pajimet dhe domosdoshmëritë e saj. Krijuesi xh.sh. ua jep të gjithë këtë me rregullin dhe ekuilibrin më të plotë, pa gabim, pa shkarje, pa ngatërresë e pa harresë dhe ua jep tamam në kohën e duhur e të përcaktuar prej burimeve të paparashikuar.

Dhe pasi shoku ynë udhëtar studioi vetëm një faqe të vetme në një pranverë të vetme dhe pa në mënyrë të qartë e të ndritshme çështjen e Unitetit Hyjnor, iu adresua nefsit të tij duke i thënë:

Ai i Cili krijon e ndërton këto lloje ringjallje në çdo pranverë që janë me mijëra dhe që e tejkalojnë çudinë e Ringjalljes më të madhe është pikërisht Ai i Cili u ka dhënë të gjithë pejgamberëve me mijëra premtime se Ai do ta sjellë Ringjalljen dhe Kijametin për shpërblim e

për ndëshkim, dhe kjo për fuqinë e Tij është më e lehtë se sa pranvera; dhe ka përfshirë me mijëra tregues rreth Ringjalljes në Kuranin Kerim, i cili e vërteton atë në mënyrë të qartë dhe me aluzione në një mijë versete. Dhe ka përfshirë kercënimet e Tij xh.sh... Atëherë nuk ka dyshim se torturimi i Xhehennemit është thjesht drejtësi e pastër për ata që bëjnë fajin e mohimit të Ringjalljes përpara Atij të Gjithëfuqishmi Detyrues, Zemërues dhe Zotëruesi i lavdisë..

Dhe kështu gjykoi shoku ynë udhëtues dhe me këtë u qetësua nefsi i tij; edhe nefsi i tij gjithashtu tha: "Ne besojmë në atë që ti thua".

Ajo që soditi udhëtari nëpër botë në vendqëndrimin e tretë është:

. . .

■ **E VËRTETA E KATËRT: e cila është shkalla e tridhjetë e tre; ajo është e vërteta e *Dhembshurisë* dhe e *Furnizueshmërisë.***

Domethënë, e vërteta e dhënies së rizkut -furnizimit- për të gjitha gjallesat, veçanërisht qënieve me shpirtëra, dhe sidomos të pafuqishmive dhe të dobëtive dhe në mënyrë të veçantë fëmijëve dhe të vegjëlve në të gjithë sipërfaqen e tokës, në brendësi të tokës, në ajër sipër saj dhe në oqeanin përreth saj, duke u dhënë atyre të gjithëve furnizimet edhe materiale për stomakun, edhe shpirtërore për zemrën me të gjithë dhembshurinë dhe mëshirën dhe këtë prej ushqimeve të bëra e të nxjerra prej dheut të thjeshtë e të thatë dhe prej copave të thata e të pajeta të druve si kocka, dhe në mënyrë të veçantë nxjerrja e më të mirit të atyre ushqimeve prej midis gjakut dhe urinës, dhe nxjerrja e sasive të mëdha të ushqimeve prej një fare të vetme të fortë si kocka e cila nuk peshon as sa një dirhem; atëherë nxjerrja e të gjithë kësaj në kohën e duhur, në mënyrë të rregullt përpara syve tonë pa harruar askënd, pa ngatërresë e pa gabim, sigurisht është e vërteta e furnizueshmërisë me rizk prej një doreje të padukshme. Po, vërseti kuranor,

"Vërtet që Allahu, Ai është padyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i fuqisë, i Përhershmi më i fortë",[100] i cili e posaçëron dhe e kufizon tek i Vërteti, Zoti xh.sh., detyrën e mbështetjes dhe të furnizimit me rizk, po ashtu vërseti i Kuranit,

"*Nuk ka krijesë të gjallë në tokë që të mos e ketë furnizimin e përshtatur nga Allahu dhe Ai di vendbanimin dhe vendruajtjen e saj; gjithçka është në libër të*

[100] Kuran 51:58

Qartë"[101] jep një garanci Hyjnore dhe një zotim Hyjnor për të siguruar ushqime për të gjithë njerëzit dhe kafshët.

Po ashtu vërseti Kuranor,

"Dhe sa shumë krijesa të gjalla nuk mbartin dot ushqimin e tyre! Allahu është i Cili i ushqen ato dhe ju. Dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri"[102], vërteton e shpall se Allahu xh.sh. është Ai i Cili garanton dhe siguron -ashtu siç shihet qartë- furnizimet me ushqime për të gjithë të pafuqishmit, për të varfërit dhe për krijesat e mjera dhe të tjerët si shembulli i tyre të cilët nuk janë në gjendje t'i sigurojnë ato ushqime, dhe Ai ua dërgon atyre në mënyrë të paparashikueshme, nga burime që nuk u kanë ardhur ndërmend; në të vërtetë prej të padukshmes, madje prej asgjësë, ashtu si shembulli i insekteve që gjenden në thellësitë e oqeaneve të cilët ushqehen mbi asgjënë; dhe të gjithë të vegjëlve të tyre që u vjen rizku -ushqimi- nga ku nuk parashikohet; dhe Ai xh.sh. ua ka garantuar të gjitha kafshëve furnizimet e tyre dhe në fakt ua siguron ato drejtpërdrejt nga e padukshmja -ashtu siç shihet qartë në çdo pranverë. Kjo shpallje u drejtohet në mënyrë të veçantë atyre njerëzve të cilët adhurojnë shkaqet dhe janë të pavetëdijshëm se është pikërisht Ai i Cili i dhuron furnizimet nga prapa perdes së shkakësisë.

Shumë vërsete të tjerë të Kuranit dhe pjesë të panumërta të dëshmisë kozmike demonstrojnë me unanimitet se është dhembshuria e Një Gjithëfurnizuesi të Vetëm të Gjithëlavdishëm ajo që i ushqen të gjitha qëniet e gjalla.

Tani, pemët kërkojnë një formë të veçantë ushqimi, mirëpo nuk kanë as fuqi dhe as vullnet. Prandaj, ato qëndrojnë në vendet e tyre, duke u mbështetur tek Zoti xh.sh., dhe ushqimi i tyre vjen duke nxituar për tek ato.

Po kështu, ushqimi i të vegjëlve të pafuqishëm vërshon tek gojët e tyre nga pompat e vogëla të çuditshme, të ndihmuar nga përkujdesja dhe urtësia e nënave të tyre. Atëherë kur të vegjëlit fitojnë pak fuqi e dëshirë, qumështi ndalon, ndërpritet.. E gjitha kjo provon në mënyrë të vetëkuptueshme se rizku hallall -ushqimi hallall- nuk vjen në përpjesëtim me fuqinë dhe dëshirën, por vjen në përpjesëtim me dobësinë dhe pafuqinë të cilat japin e nxisin mbështetjen tek Allahu xh.sh..

---

[101] Kuran 11:6
[102] kuran 29:62

Ekzistenca e vullnetit, e fuqisë dhe e zgjuarsisë -të cilat nxisin lakminë e cila çon në privim e humbje në shumicën e rasteve- i ka shtyrë njerëzit e shkolluar, të cilët janë të vetëdijshëm për to, drejt poshtërimit dhe drejt asaj që i ngjason lypsarisë; ndërsa në kontrast me ta, mungesa e fuqisë e kurorëzuar me mbështetje tek Zoti i ka çuar shumicën e njerëzve të zakonshëm të trashë e të pagdhendur në pasuri e begati, saqë është bërë si proverbë:

"Sa shumë njerëz të ditur janë përpjekur më kot,
dhe sa shumë injorantë kanë fituar furnizim të bollshëm",

e cila vërteton se krijesa nuk e gjen dhe nuk e fiton ushqimin -rizkun- hallall me fuqi e me vullnet, por i jepet asaj nga ana e një mëshire e cila ka pranuar punën dhe përpjekjen e saj; dhe i dhurohet prej mëshirës dhe dhembshurisë që ndjejnë keqardhje për nevojën dhe varfërinë e krijesës.

Tani, rizku -furnizimi- është dy llojesh:

I pari: Furnizimi i vërtetë dhe natyral i cili kërkohet për jetën; ky është i garantuar prej Krijuesit, Mbështetësit. Në të vërtetë, ai është aq i rregullt dhe i përcaktuar mirë saqë ky furnizim natyral, i depozituar në trup në formën e dhjamit dhe të gjërave të tjera, është i mjaftueshëm për të siguruar mbijetesën për të paktën njëzet ditë, edhe sikur të mos hahet asgjë. Ata që në pamje të jashtme vdesin nga uria para njëzet ose tridhjetë ditësh para se të ketë mbaruar furnizimi -rizku- i tyre natyral, vdekja e tyre nuk buron nga mungesa e rizkut, por nga një sëmundje që shkaktohet nga një zakon i keq dhe nga heqja dorë prej zakonit.

Lloji i dytë i furnizimit -rizkut: Është furnizimi metaforik dhe artificial, i cili është si i domosdoshëm -fiton paraqitjen e domosdoshmërisë- pasi njeriu lëshohet keq pas tij nëpërmjet bërjes zakon, prishjes pa hesap dhe keqpërdorimit. Dhe ky lloj nuk garantohet dhe nuk sigurohet nga Krijuesi, por varet tek mirëbërësia dhe bujaria e Tij xh.sh.: Ndonjëherë Ai mund ta japë atë, dhe ndonjëherë Ai mund të mos e japë.

Lidhur me llojin e dytë të furnizimit, është i lumtur dhe me fat ai që e di se përpjekja hallall me kursim dhe me vetëmjaftueshmëri - të cilat janë boshti i lumturisë dhe i kënaqësisë - është një lloj adhurimi dhe është një dua aktive për fitimin e rizkut; prandaj ky fatlum e kalon jetën e tij me kënaqësi dhe e pranon atë mirësi të Zotit me mirënjohje e me vlerësim.

Ndërsa fatkeqi i mjerë në këtë furnizim -rizk- është ai i cili heq dorë nga përpjekja hallall për shkak të prishjes pa hesap dhe të lakmisë

-të cilat janë shkaku i mjerimit, i humbjes dhe i dhimbjes- dhe e kalon jetën e tij, madje e shkatërron atë duke trokitur çdo derë me përtaci, shtypje dhe me ankesa.

Ashtu siç kërkon stomaku rizk -ushqim- po ashtu edhe zemra, shpirti, mendja, syri, veshi, goja dhe të tjerat si shembulli i tyre prej aftësive të holla dhe prej ndjenjave të njeriut kërkojnë rizkun -furnizimin - e tyre prej Gjithëfurnizuesit Mëshirëplotë, dhe e marrin rizkun prej Tij me të gjithë falënderimin dhe mirënjohjen.

Krijuesi xh.sh. i dhuron secilës prej tyre, prej thesarit të mëshirës së Tij, rizkun e saj që i përshtatet, që e shijon dhe me të cilin kënaqet. Madje Gjithëfurnizuesi Mëshirëplotë e krijoi secilën prej atyre aftësive të holla si syrin, veshin, zemrën, imagjinatën, mendjen dhe të tjerat të ngjashme me to, si një çelës për thesarin e mëshirës së Tij me qëllim që t'i mbulojë ato me rizk të gjërë, me qëllim që t'u japë atyre me një masë më të bollshme. Ashtu siç është syri një çelës për thesarin që përmban xhevahire të tillë të çmuar si bukurinë e hijeshinë që shtrihen e shihen në faqen e universit, po ashtu edhe aftësitë e tjera të holla, secila prej tyre është një çelës për një botë të veçantë; secila përfiton prej asaj bote me anë të besimit -imanit-; ato të gjitha përfitojnë nëpërmjet besimit..

Le të kthehemi përsëri tek tema pasi u larguam prej saj..

Krijuesi i Gjithëfuqishëm i Gjithurtë ashtu siç e krijoi jetën si një përmbledhje gjithëpërfshirëse e nxjerrë dhe e zgjedhur prej kozmosit, dhe përqëndroi në të qëllimet e Tij të përgjithshme dhe manifestimet e Emrave të Tij të bukur, po ashtu Ai e bëri rizkun -furnizimin- në botën e jetës një qendër gjithëpërfshirëse të aktivitetit Hyjnor, duke krijuar brenda qënieve të gjalla, instinktin, oreksin dhe shijen për rizk duke i bërë kështu qëniet e gjalla që t'i përgjigjen Hyjnisë së Tij dhe dashurisë së Tij me një mirënjohje, falënderim dhe adhurim të vazhdueshëm dhe universalë që është njëri prej qëllimeve më të rëndësishme dhe shembujve të urtësisë të brendaqenësishme në krijimin e universit.

Për shembull, Krijuesi xh.sh. e ka mbushur, e ka populluar çdo zonë të mbretërisë së gjërë Hyjnore; kështu Ai i ka mbushur qiejt me melekë dhe me qënie shpirtërore; e ka mbushur botën e padukshme me shpirtëra, ashtu siç e ka mbushur botën materiale -për urtësinë e gjallërimit dhe për futjen e gëzimit dhe të kënaqësisë në të, dhe veçanërisht tek bota e ajrit dhe e tokës, madje tek çdo anë e saj dhe në çdo kohë e vakt- nëpërmjet ekzistencës së qënieve të gjalla, dhe

sidomos nëpërmjet ekzistencës së shpendëve, zogjve të mëdhenj e të vegjël me insekte.

Krijuesi nguliti nevojën për rizk -furnizim- dhe kënaqësinë për të tek kafshët dhe tek njeriu; dhe i bëri ata të përpiqen vazhdimisht pas rizkut të tyre, sikur ajo nevojë të ishte një kërbaç -thupër- për t'i nxitur, për t'i shtyrë, për t'i lëvizur e për t'i bërë të rendin pas rizkut të tyre duke i shpëtuar ata prej dembelisë dhe papunësisë; dhe kjo është vetëm një urtësi prej urtësive të aktiviteteve Hyjnore. Në qoftë se nuk do të kishin qenë si shembujt e kësaj urtësie prej urtësive të rëndësishme, Allahu xh.sh. do t'i kishte bërë furnizimet e caktuara për kafshët të nxitonin instiktivisht drejt tyre për t'i përmbushur nevojat e tyre, pa ndonjë përpjekje e mundim nga ana e tyre, ashtu siç i ka bërë furnizimet e bimëve e të pemëve të nxitojnë drejt tyre kështu.

Në qoftë se do të gjendej një sy që të mund të shihte llojet e bukurisë së Emrit Hyjnor ***Er-Rahimu***, *Mëshirëploti* dhe aspektet e hijeshisë së Emrit Hyjnor "***Er-Rezzak***, *Gjithëfurnizuesi*, dhe dëshminë që japin ato të dy për Unitetin Hyjnor duke i parë në mënyrë të plotë ku të mund të shikonte në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe universale sipërfaqen e tokës dhe ta sodiste atë në një moment, ai -sy- do të shihte se çfarë bukurie e ëmbël dhe çfarë hijeshie e kënaqshme përfshihet në manifestimin e dhembshurisë së Gjithëfurnizuesit Mëshirëplotë dhe në mëshirën e Tij duke i mbështetur nga e Padukshmja dhe duke shfaqur mirëbërësi e bujari Hyjnore ndaj karvaneve të kafshëve të cilave gati u mbaruan furnizimet në fund të dimrit, -duke i mbështetur- me ushqim e mirësi tej mase të shijshme, të bollshme e të shumëllojshme, duke i vendosur ato në duart e bimëve, në kurorat -lulesat- e pemëve, dhe të varura në kraharorët e nënave, dhe duke i dërguar ato prej thesareve të fshehura të mëshirës së Tij. Poseduesi i atij syri gjithëshikues këtu do të kuptonte sa vijon:

Ai i Cili e prodhon një mollë të vetme -për shembull- dhe e jep atë si një furnizim të vërtetë duke ia dhuruar si mirëbërësi një personi, nuk mund të jetë veçse Ai i Cili i rrotullon të gjitha stinët, netët dhe ditët dhe i Cili e bën globin tokësor si një anije tregtare duke u rrotulluar, lundruar dhe udhëtuar, dhe kështu shkakton rezultatet, prodhimet e stinëve dhe ua sjell ato atyre miqve nevojtarë të tokës të cilët qëndrojnë duke i pritur ato; sepse stampa e natyrës së asaj molle të vetme, vula e urtësisë, shenja e të Kërkuarit përjetësisht dhe vula e mëshirës që gjendet në ballin e saj gjenden gjithashtu tek balli i të gjitha mollave, të gjitha frutave, perimeve dhe tek të gjitha bimët dhe kafshët. Prandaj, Pronari i asaj molle të vetme dhe Autori i saj i vërtetë

është Pronari dhe Autori i të gjitha bashkëgjinorëve -i shembujve- të saj, i vëllezërve të mollës prej banorëve të tokës, dhe Ai është Pronari dhe Autori i tokës së madhe e cila është kopshti i saj; dhe Ai është Krijuesi i pemës së kozmosit e cila është fabrika e saj; dhe Ai është Krijuesi i stinës së saj e cila është punishtja e saj;dhe Ai është Krijuesi i pranverës dhe i verës të cilat janë fusha e rritjes dhe e zhvillimit të saj; Ai është Pronari Zotërues i lavdisë dhe Krijuesi Zotërues i bukurisë; Ai nuk ka shok, dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij.

Atëherë çdo frut është një vulë e shkëlqyer dhe e qartë e Unitetit Hyjnor, meqë ai bën të njohur shkruesin dhe autorin e pemës së tij e cila është toka; ai njeh Shkruesin dhe Krijuesin e kopshtit të atij fruti dhe ai është libri i universit; ai demonstron Unitetin e Tij xh.sh. dhe tregon aq sa numri i frutave vulat konfirmuese të vendosura në dekretin e Unitetit.

Meqenëse Risale-i Nuri është një manifestim i Emrave ***Er-Rahim, El-Hakim*** prej Emrave të Bukur Hyjnorë, dhe shumë shkreptima e mistere të së vërtetës së dhembshurisë janë shpjeguar e provuar në shumë pjesë të tij, ne ua lëmë diskutimin e mëtejshëm të çështjes atyre pjesëve dhe mjaftohemi me këtë aluzion të shkurtër për atë thesar të madh të padukshëm, për shkak të rrethanave të mia të papërshtatshme.

. . .

Dhe kështu, shoku ynë udhëtar tani thotë: ***El Hamdu Lil-lah*** *“Falënderimi i takon Allahut”,* lavdi Zotit! I Cili më dha sukses që të dëgjoj tridhjetë e tre të vërtetat të cilat dëshmojnë për domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit tim, Pronarit tim dhe për Unitetin e Tij; dhe të Cilin mbeta duke e kërkuar në çdo vend, dhe për të Cilin pyeta çdo gjë. Secila prej atyre të vertetave është si një diell ndriçues që largon çdo errësirë; secila prej tyre është me fuqinë e malit të fortë e të palëkundur;

Secila prej tyre me verifikimet e saj dëshmon në mënyrë vendimtare për ekzistencën e Tij xh.sh., dhe me gjithëpërfshirjen e saj provon në mënyrë të qartë Unitetin e Tij, dhe provon fuqishëm nëpërmjet saj, në mënyrë të nënkuptuar, të gjitha shtyllat e tjera të besimit. Dhe unanimiteti dhe konsensusi i tërësisë së të vërtetave e transformoi besimin tonë nga besim imitues në besim verifikues, dhe nga verifikimi për tek njohja e sigurisë; nga njohja e sigurisë për tek shikimi i sigurisë, dhe nga shikimi i sigurisë për tek siguria absolute, lavdi Zotit! Kjo është nga mirësia e Zotit tim.

"Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun i Cili na udhëzoi ne për këtë vend. Kurrë nuk do të kishim gjetur ne drejtimin, po të mos na kishte udhëhequr Allahu. Vërtet që të Dërguarit e Zotit erdhën me të vërtetën." [103]

Në kapitullin e dytë të Stacionit të Parë erdhi një aluzion shumë i shkurtër për dritat e besimit të cilat i fitoi ky udhëtar kërkues mallëngjyes në shikimet e tij në vendqëndrimin e tretë prej katër të vërtetave të mëdhaja.

[La i lahe il-lall-llahu El-Vahidu....]

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga çna ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti" [104]

• • •

O Krijuesi im!

Për hir të "Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim", o Allah! o i Gjithëmëshirshëm! o Mëshirëplotë! Jepi paqe e bekime Prijësit tonë Muhammedit a.s.m., familjes së tij dhe të gjithë sahabëve të tij sa numri i të gjitha shkronjave të Risale-i Nurit të shumëzuara dhjetë herë me numrin e minutave në të gjithë jetët tona në këtë botë dhe në Ahiret, dhe pastaj me numrin e grimcave në trupin tim gjatë gjithë jetës sime; më fal mua dhe ata që më ndihmojnë mua me sinqeritet në kopjimin dhe në shpërndarjen e Risale-i Nurit, edhe baballarët tonë, profesorët tonë, shejhët tonë, motrat tona, vëllezërit tonë dhe studentët e sinqertë të Risale-i Nurit, veçanërisht ata të cilët e shkruajnë dhe e kopjojnë këtë trajtesë; nëpërmjet mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

Amin.

Përfundimi i lutjes sonë është,

"Falënderimi e lavdërimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botëve!"

[103] Kuran7:43
[104] Kuran 2:32

SHËNIM

Meqenëse pjesët e tjera të Risale-i Nurit nuk ishin të disponueshme në vendin që pashë hartimin e trajtesës së mëparshme, e cila u shënua këtu nga domosdoshmëria, disa çështje të rëndësishme të 'Fjalëve' dhe të 'Shkreptimave' janë përmbledhur gjithashtu në '*El-Ajetul Kubra'*, që është një përsëritje e dukshme. Ne synuam t'i kishim studentët e Risale-i Nurit në këtë zonë që të shkruanin një Risale-i Nur të plotë në miniaturë; ne i shënuam ato të gjitha në trajtesën e tanishme.

Kjo kopje e rishikuar e këtij drafti të palimuar u shkrua nga një person i bekuar. Megjithëse ai ishte i paditur për çështje të tilla, ne pamë në kopjet e shkruara prej tij një korrespondencë -koinçidencë- të hollë e të thellë të shkronjave:

Ndodheshin gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë elifa[105] të shkruar në fillimin e rreshtave në këtë kopje. Ky numër korrespondon plotësisht me vlerën, sipas *Ebxhedit*, të titullit të '*El Ajetul Kubra'* i cili iu dha kësaj trajtese prej Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe kështu demonstron përshtatshmërinë e këtij titulli për këtë trajtesë. Ne gjithashtu e kuptuam këtë korrespondencë numerike të jetë një tregues se kjo trajtesë është një shkreptimë që vjen nga drita e vërseteve të Kuranit, meqë ato janë gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë në numër.

[105] Elif: Shkronja e parë e alfabetit arab, e shkruar si një vizë vertikale dhe vlera numerike e së cilës është një. Përkthyesi

Misioni i Risale-i Nurit

Sot, dëgjova një shkëmbim imagjinar pyetjesh dhe përgjigjjesh. Le të shpjegoj për ju një përmbledhje të tij.

Një person prej tyre më tha: "Mobilizimi i madh, gatishmëria e plotë dhe përpjekja e Risale-i Nurit për hir të besimit dhe për të provuar Unitetin Hyjnor është gjithmonë në rritje. Meqenëse vetëm një pjesë prej trajtesave të tij është e mjaftueshme për ta heshtur edhe ateistin më kryeneç, përse atëherë bëhet gjithë ky mobilizim i ethshëm dhe kjo gatishmëri?"

Ata iu përgjigjën: "Risale-i Nuri nuk po riparon rrënime të pjesshme, as nuk po meremeton një shtëpi të vogël të shkallmuar të vetme, por ai po rindërton gjithashtu rrënime të përgjithshme universale, dhe po meremeton një kështjellë të madhe gjithëpërfshirëse -shkëmbinjtë dhe gurët e së cilës janë si male- e cila përfshin e rrethon islamin. Risale-i Nuri nuk përpiqet të reformojë vetëm një zemër të veçantë dhe vetëm një ndërgjegje të veçantë, por gjithashtu përpiqet, dhe në dorën e tij është Kurani, për të kuruar zemrën e përgjithshme -kolektive- dhe për të fashuar mendimet e përgjithshme të plagosura nga mjetet e korrupsionit të përgatitura dhe të grumbulluara që prej një mijë viteve; ai vepron aktivisht për të shëruar ndërgjegjen e përgjithshme e cila është orientuar drejt korrupsionit si rezultat i rrënimit të themeleve të islamit, rrymave të tij dhe i shenjave të tij, të

cilat janë një mbështetje e madhe dhe strehë për të gjithë dhe sidomos për masat e besimtarëve -për besimtarët e thjeshtë. Po, ai përpiqet që t'i kurojë ato plagë të mëdha të thella me ilaçet e mrekullisë së Kuranit dhe të imanit.

Përballë këtyre rrënimeve universale të tmerrshme, këtyre plasaritjeve të mëdha dhe plagëve të thella, duhet të ekzistojnë prova vendimtare dhe përgatitje e mjete të pajisura me shkallën e sigurisë absolute dhe me fuqinë dhe me palëkundshmërinë e maleve, dhe duhet të ekzistojnë ilaçe të provuara mirë për to nga elita dhe të jenë me efektshmërinë e një mijë e një ilaçeve, dhe që të kenë veçori të rivalizojnë ilaçe të panumërta.

Ky është misioni i Risale-i Nurit i cili shfaqet në këtë kohë prej mrekullisë së Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm, dhe e përmbush në mënyrën më të plotë këtë funksion; Ai gjithashtu është boshti i zbulimit të shkallëve të pafundme të besimit dhe burim përparimi në shkallët e tij të larta e të pafundme.

Në këtë mënyrë u zhvillua një bashkëbisedim i gjatë të cilin unë e dëgjova plotësisht, dhe falënderova shumë Allahun dhe e përmblodha atë për ju.

Said Nursi

. . .

RREZJA E NËNTË


PJESA E PARË E SHTESËS SË FJALËS SË DHJETË DHE NJË SHTOJCË E SAJ E RËNDËSISSHME

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ ۞ فَسُبْحَانَ ٱللَّهِ حِينَ تُمْسُونَ وَحِينَ
تُصْبِحُونَ ۞ وَلَهُ ٱلْحَمْدُ فِي ٱلسَّمَٰوَاتِ وَٱلْأَرْضِ وَعَشِيًّا وَحِينَ تُظْهِرُونَ ۞
يُخْرِجُ ٱلْحَيَّ مِنَ ٱلْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ ٱلْمَيِّتَ مِنَ ٱلْحَيِّ وَيُحْيِي ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَ
كَذَٰلِكَ تُخْرَجُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَكُم مِّن تُرَابٍ ثُمَّ إِذَآ أَنتُم بَشَرٌ تَنتَشِرُونَ ۞
وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَ لَكُم مِّنْ أَنفُسِكُمْ أَزْوَٰجًا لِّتَسْكُنُوٓا۟ إِلَيْهَا وَجَعَلَ
بَيْنَكُم مَّوَدَّةً وَرَحْمَةً ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ
خَلْقُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَٱخْتِلَٰفُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَٰنِكُمْ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ
لِّلْعَٰلِمِينَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ مَنَامُكُم بِٱلَّيْلِ وَٱلنَّهَارِ وَٱبْتِغَآؤُكُم مِّن فَضْلِهِۦٓ ۚ إِنَّ
فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ لِّقَوْمٍ يَسْمَعُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ يُرِيكُمُ ٱلْبَرْقَ خَوْفًا وَطَمَعًا
وَيُنَزِّلُ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءً فَيُحْيِۦ بِهِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ
لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَن تَقُومَ ٱلسَّمَآءُ وَٱلْأَرْضُ بِأَمْرِهِۦ ۚ ثُمَّ إِذَا دَعَاكُمْ
دَعْوَةً مِّنَ ٱلْأَرْضِ إِذَآ أَنتُمْ تَخْرُجُونَ ۞ وَلَهُۥ مَن فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ كُلٌّ
لَّهُۥ قَٰنِتُونَ ۞ وَهُوَ ٱلَّذِي يَبْدَؤُا۟ ٱلْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُۥ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ ۚ وَلَهُ
ٱلْمَثَلُ ٱلْأَعْلَىٰ فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ۞


Në këtë **“Rrezen e Nëntë”** do të shpjegojmë një argument të fuqishëm dhe një provë më të madhe nga këto vërsete të larta qiellore

që vërtetojnë një bosht të besimit dhe polin e tij, dhe nga këto dëshmi të larta të shenjta që provojnë realitetin e ringjalljes.

Ishte një tregues i hollë i përkujdesjes Hyjnore dhe i favorit, që në fundin e veprës së titulluar **"Muhakemat"**, të cilën tridhjetë vjet më parë e shkroi Saidi i Vjetër si parathënie të komentit, *Qëllimi i Dytë*: do të shpjegojmë e komentojmë dy vërsete të Kur'anit që aludojnë për Ringj-alljen.



"Mirëpo, sapo tha: Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti", aty ndaloi dhe nuk mundi ta shkruajë më. Lavdërime e falënderime aq të shumta sa provat dhe sa dëshmitë për ringjalljen i takojnë Krijuesit Mëshirëplotë që tridhjetë vjet më vonë më mundësoi që ta vazhdoja. Po, nëntë apo dhjetë vjet më parë, All-llahu xh.sh. më dhuroi "Fjalën e Dhjetë" dhe të "Njëzet e Nëntën", dy vepra brilante që përmbajnë prova të fuqishme të shumta dhe interpretimet e të parit prej dy vërseteve në fjalë.



Ato i heshtën ata që e mohuan Ringjalljen. Dhe tani, nëntë apo dhjetë vjet më vonë, pas shpjegimit të atyre dy kështjellave të fortifikuara të besimit në Ringjallje, All-llahu xh.sh. më dhuroi mbarësi për të shpje-guar vërsetin e dytë të lartëpërmendur me këtë trajtesë.

Kështu, *"Rrezja e Nëntë"* përbëhet nga ***"Nëntë Stacione të Larta"*** me një ***"Parathënie"*** të rëndësishme që janë treguar me vërsetet e lartëpërmendura.

PARATHËNIE

[Kjo parathënie përmban "Dy Pika" që demonstrojnë në mënyrë të shkurtuar një rezultat gjithëpërfshirës prej rezultateve të shumta jetësore dhe të mirësive shpirtërore të besimit në Ringjalljen, dukę shpjeguar se sa i domosdoshëm dhe, në të vërtetë, sa esencial është ky besim për jetën njerëzore, dhe veçanërisht për jetën shoqërore. Gjithashtu ne do të sjellim një provë të përgjithshme, prej provave të shumta të ringjalljes dukę sqaruar gjithashtu se sa çështje e vetëkuptueshme dhe e padyshimtë është besimi në Ringjallje].

PIKA E PARË

Ne do të tregojmë, si një shembull, katër midis qindra provave të këtij fakti, se besimi në botën e përtejme është pikërisht baza dhe themeli i të gjithë jetës shoqërore dhe individuale të njeriut, themeli i të gjithë lumturisë së tij si dhe i plotësimeve dhe i arritjeve:

● ***Prova e parë:*** Fëmijët, të cilët përbëjnë gati gjysmën e gjinisë njerëzore, mund ta durojnë ndarjen dhe vdekjen që përpara tyre shfaqen aq të tmerrshme e tragjike, vetëm nëpërmjet idesë së Xhennetit. Vetëm nëpërmjet kësaj, ata mund të gjejnë forcë shpirtërore në trupat e tyre të dobët e delikatë dhe mund të gjejnë shpresë që i lejon ata të jetojnë të gëzuar, pavarësisht gjendjes së tyre shpirtërore të prekshme e të lëndueshme të cilët qajnë edhe për shkakun më të vogël e të parëndësishëm.

Për shembull, duke menduar për Xhennetin, fëmija do të thonte: "Vëllai im i vogël apo shoku im i dashur që ka vdekur, është bërë tani një zog i Xhennetit. Ai është duke shëtitur atje dhe po bën një jetë më të mirë se jetën tonë." Ndryshe, vdekjet që ndodhin në rrethin e fëmijëve tek të mëdhenjt dhe tek të vegjëlit si dhe shfaqja e vdekjes përpara shikimeve të tyre të frikësuara të cilët janë të dobët, do të shkatërronte fuqinë e tyre të rezistencës dhe forcën e brendshme, dhe do të bënte të qanin jo vetëm sytë e tyre, por të gjitha aftësitë e tyre të brendshme, shpirti, zemra dhe mendja. Dhe ata fëmijë të dobët ose do të shkatërroheshin, ose do të bëheshin si kafshë të çmendura e të mjera...

● ***Prova e dytë:*** Të moshuarit, të cilët –nga njëri aspekt– përbëjnë gjysmën e njerëzimit, gjejnë mbështetje e durim ndërsa janë në buzë të

varrit vetëm me besimin në botën e përtejme. Vetëm nëpërmjet këtij besimi ata gjejnë ngushëllim për afrimin e zhdukjes së jetës me të cilën ata janë shumë të lidhur dhe të mbylljes së portës së dynjasë së tyre të ëmbël e të bukur. Të moshuarit, që janë bërë si fëmijë e që preken në shpirtërat e në temperamentet e tyre, vetëm nëpërmjet shpresës për jetë të përhershme mund ta përballojnë dëshpërimin e dhimbshëm e të tmerrshëm që buron nga parashikimi i vdekjes dhe i ndarjes. Përndryshe, po të mos ishte ky besim për botën tjetër, këta baballarë e nëna të cilët janë më të meritueshmit për mëshirë e keqardhje, dhe më të nevojshmit për paqen e qetësinë e zemrës, do të përjetonin një turbullirë të shpirtit dhe një trazirë e shqetësim të zemrës, saqë bota do të dukej për ta si një burg i errët i nëndheshëm dhe jeta do të bëhej për ta torturë e rëndë.

● ***Prova e tretë:*** Të rinjtë dhe adoleshentët, të cilët përbëjnë boshtin dhe themelin e jetës shoqërore, nuk do t'i qetësonte ndjenjat e tyre të trazuara, dhe nuk do t'i pengonte ata nga tejkalimi i caqeve për tek padrejtësia e shkatërrimi, nuk do t'i ndalonte nefsin e tyre të stuhishëm dhe pasionet e tyre, dhe nuk do ta siguronte ecjen e tyre më të mirë duke u shërbyer qëllimeve të jetës shoqërore, veçse frika nga zjarri i Xhehen'nemit. Ndërsa po të mos ishte kjo frikë nga ndëshkimi i Xhehennemit, të rinjtë të dehur nga pasionet e tyre të stuhishme do të ndiqnin parimin, "Forca është e drejta", dhe do ta kthenin botën në një Xhehennem për të dobëtit e të pafuqishmit. Ata do ta transformonin jetën e lartë humane në një jetë të ulët e në një gjendje shtazarake.

● ***Prova e katërt:*** Qendra më gjithëpërfshirëse e gjinisë njerëzore në jetën e saj të kësaj bote, burimi më themelor i saj, xhenneti i saj, strehimi dhe kështjella e lumturisë së kësaj bote është jeta e familjes. Shtëpia e çdo individi është si një botë e vogël për të. Jeta dhe lumturia e jetës së familjes së tij dhe gjallëria e shtëpisë varet nga respekti i ndërsjellë, serioz, i sinqertë e i kushtuar midis të gjithëve, nga përkujdesja e vërtetë dhe nga mëshira që arrin deri në cakun e vetësakrifikimit. Kurrë nuk do të arrihej ky respekt i sinqertë dhe kjo mëshirë e vërtetë e ndërsjellë, veçse me besimin në ekzistencën e marrëdhënieve të përjetshme shoqërore, e mëshirës së përhershme dhe të bashkëshoqërimit të amshuar, në një kohë të pafund, dhe nën hijen e një jete të pakufishme, të cilat i lidhin marrëdhënie të respektuara e të shquara atërore, marrëdhënie të pastërta vëllazërore dhe marrëdhënie të sinqerta e të ngushta shoqërore.

Për shembull, bashkëshorti thotë me vete: "Kjo bashkëshortja ime do të jetë shoqja e përhershme e jetës sime në një botë të përjetshme

dhe në një jetë të amshuar. Në qoftë se ajo tani është plakur dhe është bërë e shëmtuar, nuk ka rëndësi, sepse ajo ka një bukuri të përjetshme që do ta shfaqë vetveten në të ardhmen, dhe për këtë unë tani sakrifikoj gjithçka që kërkon ai bashkëshoqërim i përjetshëm, dhe tregoj çdo mëshirë e dhembshuri ndaj saj." Kështu, ai do ta trajtonte bashkëshorten e tij të moshuar me aq dashuri të shumtë, me mëshirë e përkujdesje sikur ajo të ishte një Huri e bukur. Përndryshe, një shoqërim e lidhje e ngushtë që përfundon e zgjat një orë, apo dy orë pas martesës dhe pastaj ndiqet nga një ndarje e përhershme, padyshim do të ishte një shoqërim sipërfaqësor, kalimtar e i pa themel. Ajo nuk do të ishte asgjë më shumë se sa një instinkt epshor i kafshëve dhe se një mëshirë figurative dhe një respekt artificial; gjithashtu do të shfaqeshin interesat e tjera të nefsit si ato të kafshëve dhe pasionet e shfrenuara dhe do ta mposhtnin atë mëshirë e respekt, dhe si rrjedhojë, një xhennet i kësaj bote do të kthehej në një Xhehennem të padurueshëm.

Atëherë, nga qindra rezultate të besimit në Ringjalljen, vetëm njëri rezultat lidhet me jetën shoqërore të njeriut. Në qoftë se aspektet e tjerë që janë me qindra dhe dobitë e këtij rezultati të vetëm do të dilnin si përfundim i deduktueshëm nëpërmjet analogjisë, me këto katër prova të vërteta, do të kuptohej se ndodhja dhe realizimi i realitetit të Ringjalljes është aq e sigurtë sa e vërteta e lartë e humanizmit dhe sa nevojat e tij të përgjithshme. Ajo madje do të ishte një dëshmi më e qartë se sa nevoja e stomakut për ushqime, madje e dëshmon në mënyrë më të qartë se sa kjo.

Në qoftë se përfundimet e vërtetësisë së ringjalljes do të plaçkiteshin nga gjendja njerëzore, atëherë se esenca e humanizmit – Ringjallja–natyra dhe esenca e të cilit janë të larta, të rëndësishme e të gjalla, do të binin në gjendjen e coftinës, dhe të një strehimi mikrobesh.

Le t'i kushtojnë vëmendje sociologët, politikanët dhe moralistët, të cilët interesohen për çështjet e humanizmit, për moralin dhe për shoqërinë njerëzore, si mendojnë ata ta mbushin këtë zbrazëti, dhe me çfarë do t'i kurojnë ata këto plagë të thella? U kumbofshin veshët e tyre!..

PIKA E DYTË

Pika e dytë na shpjegon në mënyrë shumë të përmbledhur, një provë të vetme, midis provave të panumërta, e cila buron nga dëshmia që shtyllat e tjera të besimit japin për ringjalljen.

Kështu, që të gjitha mrekullitë që tregojnë profetësinë e Muhammedit a.s.m., të gjitha provat e profetësisë së Tij dhe të gjitha dëshmitë e vërtetësisë së Tij, dëshmojnë e vërtetojnë së bashku realitetin e vërtetësisë së ringjalljes, sepse gjatë jetës së Tij të bekuar, ai personalitet i lartë u përqëndru, pas Njësisë së All-llahut xh.sh., tek ringjallja midis të gjitha çështjeve të besimit. Dhe në të vërtetë, mrekullitë dhe provat që tregojnë vërtetësinë e të gjithë profetëve, paqja dhe bekimet e All-llahut qofshin mbi ta, dhe që u shkaktojnë njerëzve t'i vërtetojnë ato, dëshmojnë të njëjtën vërtetësi, e cila është ringjallja.

Dhe gjithashtu, fraza وَبِرُسُلِهِ *"Dhe besojmë në të gjithë Profetët"*, domosdoshmërisht ndiqet nga fraza وَكُتُبِهِ *"Dhe besojmë në Librat e Shpallur Qiellorë",* dhe kjo gjithashtu jep dëshmi për të njëjtën vërtetësi, si më poshtë vijon:

Të gjitha mrekullitë, provat dhe të vërtetat që argumentojnë vërtetësinë e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm dëshmojnë e vërtetojnë realizimin dhe ndodhjen e Ringjalljes sepse një e treta e Kur'anit përbëhet nga përmendjet për Ringjalljen, dhe shumica e sureve të shkurtëra fillojnë me vërsete të fuqishme që lidhen me ringjalljen. Kur'ani e shpall këtë të vërtetë me mijëra nga vërsetet e tij të lartë, në mënyrë të qartë e të nënkuptuar. Ai e provon atë dhe e demonstron qartë.

Për shembull:

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ۞ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمْ إِنَّ زَلْزَلَةَ السَّاعَةِ شَيْءٌ عَظِيمٌ ۞

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا ۞ إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ ۞ إِذَا السَّمَاءُ انْشَقَّتْ

۞ عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ۞ هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ ۞

"Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën dhe të përmbyset."[106]

[106] Kur'an, 81: 1

"O njerëz! Kinie frikë All-llahun tuaj! Vërtet që tronditja e Orës (së Gjykimit) është gjë e tmerrshme."[107]

"Kur toka të dridhet me tronditjen e madhe (për të fundit herë)."[108]

"Kur qielli të plasë."[109]

"Kur qielli të çahet."[110]

"Për çfarë po pyesin njëri-tjetrin?"[111]

"A të ka arritur ty ngjarja e mbulimit (trishtimi i Ditës së Kijametit)?"[112]

Ashtu si këto vërsete, në fillimin e pothuajse tridhjetë-dyzet sureve, që tregojnë me sigurinë më të madhe se e vërteta e ringjalljes është më e rëndësishmja dhe më esencialja e të vërtetave të humanizmit, po ashtu vërsetet e tjera demonstrojnë me prova bindëse dëshmitë e ndryshme të të njëjtës vërtetësi.

A do të ishte e mundur që besimi në ringjalljen të ishte i pavërtetë, një besim i bërë aq qartë si dielli nga mijëra dëshmi e tregues të tjerë të parashtruar në një libër që mban frutin e të gjitha të vërtetave të shumta shkencore e kozmike që përfshihen në shkencat islame, ndonëse një tregues i vetëm i një vërseti të vetëm do të ishte i mjaftueshëm? A nuk do të ishte mohimi i këtij besimi si të mohoje diellin, e madje si të mohoje ekzistencën e kozmosit? A nuk do të ishte kjo njëqind shkallë e pamundur dhe e kotë?

Një mbret, në ndonjë rast, mund të dërgojë një ushtri në fushën e betejës, thjesht që një tregues i vetëm i tij të mos konsiderohet gënjeshtër; atëherë a do të ishte e mundur që t'i konsiderosh gënjeshtra mijërat e fjalëve, pretendimet dhe kërcënimet e Atij Monarku të Gjithëlavdishëm e t'i konsiderosh ato si të pavërteta?

Tani për provën e kësaj të vërtete të ringjalljes mjafton vetëm një tregues i vetëm nga ai mbret shpirtëror i cili ka sunduar për trembëdhjetë shekuj pa ndërprerje, që ka edukuar shpirtëra të panumërt, mendje, zemra dhe nefse, i ka pastruar ata dhe i ka drejtuar për tek e vërteta dhe realiteti; a nuk do të mjaftonte një tregues i vetëm prej tij për të provuar realitetin e ringjalljes? A edhe pasi të jetë provuar e demonstruar kjo e vërtetë me mijëra dëshmi të qarta, nuk

---

[107] Kur'an, 22: 1
[108] Kur'an, 99: 1
[109] Kur'an, 82: 1
[110] Kur'an, 84: 1
[111] Kur'an, 78: 1
[112] Kur'an, 88: 1

pranohet? A nuk do të ishte injorant e idiot ai që nuk e pranon këtë të vërtetë të qartë? A nuk do të ishte drejtësi e pastër për të ndëshkimi i Xhehennemit?

Dhe gjithashtu, të gjitha Shkrimet Qiellore dhe Librat e Shenjtë, që secili nga ato iu adresua një shekulli e një kohe të caktuar, e vërtetojnë me mijëra nënshkrime pretendimin e Kur'anit për të vërtetën e ringjalljes, ndonëse shpjegimi i tyre për të është i përmbledhur e shkurt, dhe kjo sipas kohës dhe shekullit të tyre; ajo e vërtetë e sigurt, të cilën e shpjegoi qartë e në mënyrë të detajuar Kur'ani i komentimit të mrekullueshëm, ky libër i cili iu adresua të ardhmes dhe të gjitha epokave.

Ne do të përfshijmë këtu, për shkak se lidhet me temën e ringjalljes, një provë të ringjalljes e nxjerrë nga fundi i *Trajtesës së lutjes"* –Munaxhat–. Kjo provë, duke përmbajtur dëshminë e dhënë për إِيمَانٌ بِالْيَوْمِ الْآخِرِ *"Besimin në Ditën e Ringjalljes",* midis shtyllave të tjera të besimit, dhe veçanërisht për Besimin në Rusul **"të Dërguarit"** e All-llahut xh.sh. dhe në Kutub **"Librat"** e Tij, është e shkurtër por e fuqishme. Ajo mjafton për të larguar të gjitha dyshimet.

Kështu është thënë në **"Munaxhat"**:

"O All-llah i Gjithëmëshirshëm! Nëpërmjet udhëzimit të profetit më të nderuar dhe mësimit të Kur'anit, unë kam kuptuar se të gjithë librat e shenjtë dhe profetët, me në krye Kur'anin dhe profetin më të nderuar, tregojnë e dëshmojnë me unanimitet për shfaqjet e Emrave të Bukur Hyjnorë, plot Madhështi e Bukuri, që shenjat e të Cilëve shihen kudo në këtë dynja e në të gjitha botët, do të vazhdojnë në përjetësi në formë akoma më të shndëritshme; se Mirësitë Hyjnore, shfaqjet e mëshirshme dhe shembujt e të cilave ne i shohim në këtë botë kalimtare, do të zgjasin e do të vazhdojnë në mënyrë më të shndëritshme në Banesën e Lutmurisë, dhe se ata të përmalluar, të cilët i shikojnë ato në jetën e shkurtër të kësaj bote, me kënaqësi do t'i shoqërojnë me dashuri e mallëngjim dhe do të mbeten përjetësisht së bashku në Botën tjetër.

Dhe për më tepër, të gjithë profetët, me në krye profetin Muhammed a.s.m. dhe Kur'anin e gjithurtë, të cilët kanë në duart e tyre të gjithë shpirtërat e ndriçuar, evlijatë të cilët janë udhëheqësit e të gjitha zemrave të ndritura dhe shërbëtorët e vërtetë të All-llahut xh.sh., që janë burimi i të gjitha mendjeve të mprehta e të ndritura; ata të gjithë e besojnë ringjalljen dhe u japin njerëzve lajmet e gëzueshme

për lumturinë e përjetshme. Për më tepër, ata shpallin e dëshmojnë me besim të fortë se zjarri i Xhehen'nemit ekziston për ata që janë të çudhëzuar, kurse Xhenneti ekziston për ata që janë të udhëzuar drejtë. Ata e bëjnë këtë duke u mbështetur në qindra keramete të qarta dhe në vërsete vendimtare, dhe në premtimet e kërcënimet që Ti, o All-llah, i ke përmendur shumë shpesh në të gjitha shkrimet qiellore dhe në librat e shenjtë, duke u mbështetur në Dinjitetin e Madhështisë Tënde dhe në Mbretërinë e Hyjnisë Tënde, në veprat e Tua madhështore, dhe në Atributet e Tua të shenjta si fuqia, mëshira, përkujdesja, urtësia, madhështia e bukuria, si dhe duke u bazuar në vizionet e tyre të shumta dhe në shikimet e tyre të cilat na përçojnë neve shenjat dhe efektet e botës tjetër, dhe duke u mbështetur në besimin e në bindjen e tyre që janë tek shkalla e njohjes së sigurtë dhe tek shikimi i sigurt i të vërtetës.

"O i Gjithurtë dhe i Gjithëfuqishëm i Vetëm! O i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë! O Gjithëbujar i Vetëm gjithmon i vërtetë në premtimin Tënd! O i Gjithautoritetshëm i Vetëm dhe i Gjithëlavdishëm, Zotëruesi i Madhështisë, i Shkëlqimit dhe i Lartësisë!."

Ti je i Lartësuar, i Shenjtëruar dhe i Pastruar pafundësisht, Ti je i shpëtuar nga të bërit e shumë evlijave dhe miqve të Tu të sinqertë dhe pastaj ata të shfaqeshin si gënjeshtarë dhe të paraqitej e rreme dëshmia e aq shumë Emrave të Tu të Bukur dhe e pamjeve të Tua; Ti je i lartësuar dhe i shenjtëruar nga refuzimi e dështimi për të kryer atë që është bërë e domosdoshme në mënyrë vendimtare nga Sovraniteti i Hyjnisë Tënde; je i lartësuar nga mospranimi i lutjeve të panumërta dhe i duave për botën e përtejme që bëhen nga shërbëtorët e Tu të shumtë të cilët Ti i do dhe të cilët kërkojnë dashurinë Tënde me besim tek Ti dhe me bindje e nënshtrim ndaj Teje; dhe je i shenjtëruar nga miratimi ndaj mohimit të ringjalljes që bëhet nga njerëzit e humbur e të çudhëzuar të cilët e fyejnë Lavdinë Tënde dhe Madhështinë me mosbesimin e tyre kryengritës dhe me mohimin e tyre ndaj premtimeve të Tua, të cilët tejkalojnë caqet dhe veprojnë në kundërshtim me Madhështinë e Hyjnisë Tënde dhe sulmojnë Mëshirën e Hyjnisë Tënde. Ne e shpallim shenjtërinë e drejtësisë Tënde absolute, të bukurisë së pafund dhe të mëshirës Tënde të gjërë, dhe e shpallim lartësinë e tyre dhe qënien e tyre larg kësaj padrejtësie e shëmtie të pakufishme.

Ne besojmë me të gjithë fuqinë tonë në të vërtetën dhe në saktësinë e dëshmisë së dhënë nga qindra e mijëra mesazhierë të vërtetë, nga të

gjithë profetët, evlijatë, të pastërtit të cilët thërrasin për tek Ty dhe janë dëshmuesit me të gjitha shkallët e sigurisë, që janë lajmëtarët e sovranitetit të All-llahut, e thesareve të mëshirës Tënde të përjetshme, e pasurive të mirësisë Tënde të fshehur në botën e përhershme, dhe për shfaqjet e mahnitshme e të mrekullueshme të Emrave të Bukur të Tu që do të shfaqen plotësisht në Banesën e lumturisë. Treguesit e tyre janë të vërteta e të sakta, parashikimet e tyre janë të vërteta. Ata i mësojnë shërbëtorët e Tu me urdhrin Tënd brenda sferës së të vërtetës, se rrezja më e madhe që shfaqet nga Emri Hyjnor ***"Hakk" "i Vërteti"*** që është burimi, dielli dhe mbrojtësi i të gjitha të vërtetave, është e vërteta më e madhe, domethënë ringjallja. Në këtë ata besojnë dhe atëherë e japin mësim si esencën e të vërtetës.

O All-llah! Për hir të mësimit dhe porosive që ata japin, na dhuro neve dhe Studentëve të Risale-i Nur'it besim të plotë dhe na dhuro përfundim të mirë me iman të jetës sonë, dhe na bëj ne nga ata që përfitojnë prej shefa'atit (ndërmjetësimit) të tyre... **Amin**...

Të gjitha provat dhe dëshmitë që provojnë vërtetësinë e Kur'anit, dhe madje të gjitha librat qiellorë dhe mrekullitë e provat që vërtetojnë profetësinë e të dashurit të Zotit xh.sh. dhe madje atë të gjithë profetëve, tregojnë realitetin e botës tjetër, që është pjesa më e lartë e asaj që pretendojnë librat dhe mesazhierët. Gjithashtu, shumica e provave dhe e dëshmive për ekzistencën dhe Njësinë e Krijuesit, Qënies së Vetme të domosdoshme, dëshmojnë në mënyrë të tërthortë ekzistencën dhe hapjen e banesës së lumturisë dhe të Botës së përjetësisë që është boshti kryesor dhe treguesi i Hyjnisë. Sepse siç do të shpjegohet e demonstrohet më poshtë, ekzistenca e Qënies së Vetme të domosdoshme, të gjitha Atributet e Tij, shumica e Emrave të Tij, dhe Veçoritë e Tij të shenjta dhe Aspekte të tilla, si: "Hyjnia, Përkujdesja, Mëshira, Urtësia e Drejtësia"..., kërkojnë ekzistencën e botës tjetër si një çështje e domosdoshme; ato bëjnë të domosdoshme një botë të përjetshme në mënyrë të prerë, dhe ato e kërkojnë ringjalljen për qëllimin më të domosdoshëm të dënimit dhe shpërblimit.

Po, meqenëse ka një All-llah, Ekzistues i para dhe i paspërjetësisë, duhet që medoemos të jetë gjithashtu një botë tjetër, që është boshti i përjetshëm i Sovranitetit të Tij Hyjnor. Dhe meqenëse, Një Hyjni absolute shfaqet në Kozmos dhe veçanërisht tek gjallesat, Një Hyjni madhështore, e Urtë dhe absolute, atëherë gjithashtu duhet të jetë një botë e përjetshme lumturie për të hyrë tek

ajo, me qëllim që të ruajë urtësinë e Tij nga kotësia, dhe përkudesjen e Tij nga tradhtia.

Dhe meqenëse, të gjitha këto mirëbërje të pafund, këto bekime, mirësi, bujari, përkujdesje e mëshira që ne i shikojmë me sytë tanë, i tregojnë çdo mendjeje që nuk është e shuar dhe çdo zemre që nuk ka vdekur, domosdoshmërinë e ekzistencës së Një Krijuesi të Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë nga prapa perdes, atëherë duhet patjetër të jetë, ashtu siç është e vërtetë, një jetë e amshuar e cila do të mbrojë mirësitë e Tij kundra talljes, bekimet e Tij kundra mashtrimit, mirëbërjen e Tij kundra armiqësisë, mëshirën e Tij kundra torturës dhe bujarinë e përkujdesjen e Tij kundra tradhtisë. Po, Ai i Cili e bën mirësinë mirësi të vërtetë dhe bekimet bekime të vërteta, pikërisht Ai është burimi i ekzistencës së një jete të përhershme në Botën e Qëndrueshmërisë e të Përjetsisë... Po, medoemos duhet të realizohet kjo.

Dhe meqenëse, *n*ë fillimin e çdo pranvere, Pena e Fuqisë shkruan pa u lodhur në faqen e ngushtë të tokës njëqindmijë libra të ndërthurur, që të gjithë pa gabimin më të vogël, siç duket qartë përpara syve tanë, atëherë Pronari i asaj Pene ka premtuar dhe është betuar njëqindmijë herë se "Unë do të shkruaj dhe do t'ju bëj juve të lexoni një libër të bukur e të përjetshëm, në një vend shumë më të shtrirë se sa ky vend i ngushtë, i përzier e i ngatërruar dhe në një mënyrë shumë më të lehtë se sa ky libër i vogël e i shkurtër i pranverës". Ai Krijues, e përmend atë libër me të gjitha urdhëresat e dekretet e Tij. Domethënë, projekti origjinial i librit padyshim është shkruar; ai do të regjistrohet në shkrim me të gjitha shënimet e tij në Ditën e Ringjalljes. Regjistri i veprave të të gjithëve atëherë do të jetë i shkruar.

Dhe meqenëse toka ka një rëndësi aq të madhe, sa që është bërë zemra e kozmosit; ajo është qendra e tij, pjesa e tij e zgjedhur, rezultati përfundimtar i tij, dhe pikërisht arsyeja për krijimin e tij. Kjo është për shkak të shumësisë së krijesave që gjenden në të, dhe për shkak se ajo është banesa, origjina, punishtja dhe vendi i shfaqjes dhe i ringjalljes së qindra e mijëra llojeve të ndryshme të gjallesave duke ndryshuar vazhdimisht. Pavarësisht vogëlsisë së përmasës së saj, ajo është bërë barazvlerësja e qiejve të gjërë. Kështu ne gjithmonë lexojmë në të gjithë dekretet qiellorë: رَبُّ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِ *"Mbështetësi (All-llahu) i qiejve dhe i Tokës."*

Biri i Ademit, njeriu, gjithashtu ka një rëndësi të veçantë.

Dhe meqenëse Ai sundon në çdo pjesë të tokës që ne sapo e përshkruam; Ai ushtron kontroll mbi shumicën e krijesave të saj duke nënshtruar rreth vetvetes shumicën e gjallesave, dhe duke i bërë shumicën e objekteve të krijuara të notojnë rreth tij sipas skicës së dëshirave të tij, dhe sipas nevojave të tij të bashkëlindura, dhe i organizon, i ekspozon dhe i stolis. Ai koordinon lloje të çuditshme prej tyre në çdo vend, saqë nuk tërheq vetëm shikimet e njeriut e të xhindit, por tërheq gjithashtu edhe shikimet e banorëve të qiejve dhe ato të të gjithë universit, madje edhe shikimin admirues të Pronarit të universit. Kështu, nga ky këndvështrim, lloji njerëzor fiton një vlerë e rëndësi shumë të madhe, dhe ai për më tepër, demonstron nëpërmjet arteve dhe shkencave të tij, se ai është qëllimi i urtë për krijimin e universit, se është rezultati më i lartë i frutit të madh të krijimit, dhe se ai vepron në tokë si Kalif –zëvendës i All-llahut xh.sh.. Meqenëse në tokë ai shfaq e organizon veprat e mrekullueshme të Krijuesit, është shtyrë dënimi i kundërshtimit të tij dhe i mohimit të tij, dhe i është lejuar jetesa në dynja. Për shkak të veprimeve që kryen, llojit njerëzor i është dhënë shtyrje afati dhe ndihmohet nga All-llahu xh.sh..

Dhe meqenëse, biri i Ademit –njeriu–, duke poseduar natyrën që ne kemi përshkruar, është tej mase i dobët e i pafuqishëm për sa i përket natyrës së tij thelbësore dhe gjendjes së tij. Megjithatë, pavarësisht kësaj dobësie e varfërie dhe nevojave e dhimbjeve të pakufishme para të cilave ai zbulohet, ekziston një Sundues i Gjithëfuqishëm, i Gjithurtë e i Gjithë-mëshirshëm, i Cili në një mënyrë krejtësisht përtej fuqisë dhe vullnetit të njeriut, e bën këtë glob të madh tokësor një magazinë që përmban çdo lloj minerali e ushqimi që atij i nevojitet, dhe e bën një dyqan të mbushur me të gjithë artikujt që ai dëshiron. Kështu Sundimtari i Vetëm kujdeset për njeriun dhe e ushqen duke i dhururar atij çfarë dëshiron.

Dhe meqenëse, All-llahu xh.sh. i zotëron këto veçori, Ai e do njeriun dhe e bën Vetveten të dashur tek njeriu. Ai është i përjetshëm, dhe ka botëra të përjetshme. Ai i realizon të gjitha gjërat me drejtësi, Ai bën gjithçka me urtësi. Por sovraniteti madhështor dhe Mbretëria e përjetshme e Sundimtarit të parapërjetësisë nuk mund të përfshihet plotësisht brenda jetës së shkurtër të njerëzimit, kësaj toke të përkohshme e kalimtare. Për më tepër, aktet shumë të mëdha të padrejtësisë dhe të mosbindjes që ndodhin midis njerëzve në kundërshtim e në kontradiktë me drejtësinë, dhe në kudërshtim me ekuilibrin dhe bukurinë e kozmosit, tradhtia e tyre, mohimi dhe mosbesimi ndaj Mirëbërësit dhe Furnizuesit të tyre, dhe të gjitha këto mbeten të pandëshkuara në këtë botë, gjithashtu ata i kalojnë në rehati

jetët e tyre mizore e tradhtare, ndërsa njerëzit e mjerë e të shtypur i kalojnë jetët e tyre në mjerim. Por, pikërisht esenca e Drejtësisë Absolute, që shenjat e të cilës shihen gjithandej universit, është krejtësisht e kundërt dhe e papajtueshme me idenë e mosringjalljes së mizorëve dhe të tradhtarëve, së bashku me të shtypurit e pashpresë, të cilët janë të barabartë në këtë botë përpara vdekjes!

Dhe meqenëse, Pronari i kozmosit ka zgjedhur e i ka dhënë një rang të lartë dhe rëndësi tokës midis krijesave të universit, dhe zgjodhi njeriun dhe i dhuroi atij një pozitë të lartë midis të gjithë krijesave të tokës. Gjithashtu, Ai ka zgjedhur midis njerëzimit, si miqtë e Tij dhe si objektet e adresimit të Tij profetët, evlijatë dhe dijetarët e pastër, sepse ata janë njerëz të vërtetë të cilët përshtaten plotësisht me qëllimet Hyjnore të krijimit, të cilët e bëjnë vetveten të dashur tek Krijuesi i tyre nëpërmjet besimit e nënshtrimit. Ai i nderon e i fisnikëron ata me mrekulli e me ndihmë Hyjnore, dhe i dënon armiqtë e tyre me goditje qiellore. Ai, zgjodhi midis miqve të Tij të dashur e të shquar imamin, udhëheqësin e tyre dhe simbolin e krenarisë dhe lavdisë së tyre, Muhammedin a.s.m.. Ai ndriçoi me dritën e tij gjysmën e globit tokësor dhe një të pestën e njerëzimit të lartësuar për shumë shekuj. Është sikur kozmosi të ishte krijuar për hir të tij; të gjitha qëllimet e universit u bënë të qarta nëpërmjet tij, u bënë të dukshëm përmes fesë me të cilën ai u dërgua, dhe u shfaqën qartë me Kur'anin që iu shpall Atij.

Megjithëse ai meritoi dhe ishte i përshtatshëm të merrte shpërblimin për një periudhë të pafund kohe për shërbimet e tij të çmueshme të pafund, që ai kreu shërbime që zakonisht do të merrnin miliona vite për t'u kryer, pavarësisht të gjitha këtyre, atij iu dha një jetë shumë e shkurtër, jo më shumë se gjashtëdhejtë e tre vjeç, dhe ajo gjithashtu kaloi në luftë e mundim. A do të ishte e mundur, e përfytyru-eshme dhe e konceptueshme që të mos ringjallet ai personalitet, së bashku me të gjithë të tjerët si ai dhe më të dashurit e tij? Apo të mos jetë edhe tani i gjallë me shpirtin e tij? Apo të zhduket në një zbrazëtirë të përjetshme? Jo, njëqindmijë herë jo!.. Po, i gjithë universi dhe të gjitha realitetet kozmike kërkojnë ringj-alljen e tij, kërkojnë jetën e tij nga Pronari i kozmosit...

Dhe meqenëse, Trajtesa ***"El Ajetul Kubra"*** *(Shenja më e Madhe),* e cila është *Rrezja e Shtatë,* ka vërtetuar me tridhjetë e tre mendime të pajtuara me unanimitet, secili aq i fuqishëm sa një mal, se universi është vepra e një Dore të Vetme, dhe se bota është pronë e vetëm Një të Vetmi. Kanë treguar në mënyrë të vetëkuptueshme se Njësia është

boshti i plotësimit Hyjnor. Ato kanë shpjeguar se, me unitet e Njësi, i gjithë universi transformohet dhe fiton aspektin e shërbëtorit të bindur dhe të nëpunësit të nënshtruar të Atij Krijuesi të Vetëm. Gjithashtu, me ardhjen e botës së përtejme dhe me ekzistencën e saj, realizohen plotësimet e All-llahut xh.sh., mbrohen nga rrëzimi dhe mbrohet Drejtësia e Tij Absolute nga tallja e nga tradhtia e plotë, nga kotësia e idiotizmi; merr Mëshira e Tij Gjithëpërfshirëse sferën e saj dhe shpëton nga dhënia e torturimit diskretitues; duket krenaria dhe fuqia e Tij absolute dhe shpëtojnë nga pafuqia e mjerë, si dhe shenjtërohet secili nga Atributet Madhështore të All-llahut.

Kijameti do të ndodhë me një siguri absolute. Ringjallja do të ndodhë, dyert e banesës së shpërblimit dhe dënimit do të hapen për arsye të **"*Tetë meqenëseve"*** të shtjelluara më lartë, nga qindra pika që lidhen me besimin tek All-llahu xh.sh.. Vetëm atëherë do të përmbushet dome-thënia e vërtetë e tokës dhe e pozicionimit të saj qëndror, si dhe kuptimi i vërtetë dhe vlera e njeriut. Atëherë drejtësia, urtësia, mëshira dhe Mbret-ërimi i Sundimtarit të Gjithurtë i Cili është Krijuesi dhe Mbështetësi i tokës dhe i njeriut, do të vendosen e shfaqen rishtas. Atëherë miqtë e vërtetë dhe dashuruesit e përmalluar të All-llahut të Përjetshëm do të shpëtojnë nga asgjësimi i përhershëm, dhe më i madhi e më i vlefshmi i atyre miqve do të marrë shpërblimin për shërbimet e shenjta me të cilat ai kënaqi gjithë kozmosin. Atëherë plotësimet e Mbretit të përjetësisë do të shenjtërohen, do të pretendojnë lartësinë e tyre dhe qënien e tyre larg çdo mangësie e defekti; do të lartësohet e largohet Fuqia e Tij nga pafuqia, Urtësia e Tij nga marrëzia, dhe Drejtësia e Tij nga të gjitha llojet e padre-jtësisë.

Shkurtazi: ***Meqenëse All-llahu ekziston, sigurisht edhe Bota e përtejme ekziston.***

Atëherë, tre shtyllat e besimit, që u shtjelluan më lartë, e vërtetojnë dhe dëshmojnë ringjalljen me të gjitha dëshmitë e provat. Gjithashtu, dy shtyllat e mbetura të besimit të përfshira në këto Fjalë:

وَمَلَٰٓئِكَتِهِۦ وَبِٱلْقَدَرِ خَيْرِهِۦ وَشَرِّهِۦ مِنَ ٱللَّهِ تَعَالَىٰ

"Dhe (besoj) dhe në engjëjt e Tij, dhe në Paracaktimin Hyjnor (Kaderin), e mira e tij dhe e keqja janë nga All-llahu i Plotëfuqishëm", bëjnë të domosdoshëm ringjalljen dhe dëshmojnë e tregojnë botën e përjetësisë në mënyrën më të fuqishme.

Të gjitha provat, shikimet e dëshmitë e pafund dhe bisedat që provojnë ekzistencën e engjëjve dhe funksionin e tyre të robërisë ndaj

All-llahut xh.sh., gjithashtu vërtetojnë në mënyrë të tërthortë ekzistencën e botës së shpirtërave, të botës së padukshme, të botës së përtejme, banesës së lumturisë dhe ekzistencën e Xhennetit dhe të Xhehennemit që do të mbushen me xhinde e njerëz. Sepse engjëjt kanë mundësi me lejen e All-llahut që t'i shikojnë ato botëra e të hyjnë në to, dhe të gjithë engjëjt e afërm me Fronin e All-llahut xh.sh., të tillë si Hazreti Xhebraili, i cili komunikon me njerëz, njoftojnë ekzistencën e atyre botëve që u përmendën dhe përshkruajnë me unanimitet udhëtimin e tyre nëpër to. Ashtu siç pranojmë pa diskutim ekzistencën e kontinentit të Amerikës, të cilin ne vetë kurrë nuk e kemi parë, nga njoftimet e udhëtarëve që vijnë nga ai kontinent, po ashtu, ne duhet të besojmë me gjithë sigurinë, siç besojmë me të vërtetë, në ekzistencën e botës së përjetësisë së Ahiretit, ekzistencën e Xhennetit e të Xhehennemit, duke u mbështetur mbi njoftimet e dhëna nga engjëjt, njoftime që kanë autoritetin e njëqind rrëfenjave të pakundërshtueshme.

Dhe, përsëri, të gjitha provat e përfshira në ***Trajtesën e Paracaktimit Hyjnor ose Kaderit***, e cila është *Fjala e Njëzet e Gjashtë*, duke vërtetuar shtyllën e Besimit në Paracaktimin Hyjnor, në mënyrë të tërthortë vërteton ringjalljen, shpërndarjen e regjistrave të punëve dhe peshimin e veprave të njeriut që do të ndodhin tek peshorja e madhe. Sepse ngjarjet në ekzistencën e të gjitha gjërave regjistrohen para syve tanë nëpër Pllakat e rregullit e të balancës; biografia e çdo qënie të gjallë është gdhendur në aftësinë e kujtesës së saj, në farishten e saj, dhe në Tablo të tjera të ngjashme; veprat e çdo qënie të pajisur me shpirt, dhe veçanërisht ato të njeriut, janë regjistruar në Pllakat e Ruajtura. Kështu, gjithë ky parapërcaktim nga Kaderi gjithëpërfshirës, ky caktim kaq i urtë, ky regjistrim kaq i përpiktë dhe kjo skalitje kaq e saktë, mund të jetë vetëm për hir të një shpërblimi të përhershëm dhe të një dënimi që do të jepen në Gjyqin e Madh si rezultat i një Gjykate të Lartë. Përndryshe, ai regjistër gjithëpërfshirës e i përpiktë dhe ai regjistrim, do të ishin krejtësisht kot e pa kuptim. Kjo do të ishte në kundërshtim me Urtësinë dhe Realitetin.

Për më tepër, në qoftë se nuk do të ndodhte ringjallja, të gjitha kuptimet e vërtetuara që janë skalitur në librin e universit nga Pena e Paracaktimit Hyjnor do të shkatërroheshin. Kjo do të ishte një gjë krejtësisht e pamundur, do të ishte aq absurde dhe madje një përçartje e tillë, si të mohoje ekzistencën e universit...

Përmbledhje: Pesë shtyllat e besimit, së bashku me të gjitha provat e tyre, tregojnë e kërkojnë ndodhjen dhe ekzistencën e

ringjalljes, ekzistencën e botës së Ahiretit, dhe hapjen e dyerve të saj. Ato e dëshmojnë atë dhe e bëjnë të domosdoshme.

Për shkak se ndodhen mbështetje e prova të tilla madhështore e të patundura për të vërtetën e ringjalljes, krejtësisht të denja për madhështinë e saj, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm i kushton rreth një të tretën e përmbajtjeve të tij Ringjalljes dhe Ahiretit, dhe e bën atë gurin themeltar për të gjitha të vërtetat e tij dhe ndërton gjithçka mbi bazat e saj...

(Parathënia përfundoi.)

RREZJA E DHJETË

Kjo përbëhet prej përshkrimeve të detajuara të përmbajtjeve të koleksioit të Shkreptimave, nga Shkreptima e pesëmbëdhjetë deri tek e tridhjeta dhe nga koleksioni i Rrezeve prej të parës deri tek Rrezja e Nëntë.

. . .

RREZJA E NJËMBËDHJETË

Një frut prej frutave të burgut të Denizlit

[Kjo trajtesë është një mbrojtje e Risale-i Nurit kundra ateizmit dhe mosbesimit absolut. Kjo është mbrojtja jonë e vërtetë në këtë burgosjen tonë, sepse ne përpiqemi e punojmë vetëm për iman.

Kjo trajtesë është një frut dhe një kujtim i burgut të Denizlit dhe produkti i dy xhumave.]

Said Nursi

Frutat e Besimit

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.
"Kështu (Jusufi) mbeti në burg dhe për ca vite të tjera."[113]

Sipas kuptimit të brendshëm të këtij vërseti, Jusufi a.s. është model për të burgosurit. Kështu burgu bëhet një lloj prej *"shkollës së Jusufit".* Meqenëse një numër i madh prej studentëve të Risale-i Nurit kanë hyrë dy herë në këtë shkollë, atëherë duhet që ata të studiojnë dhe të japin mësim një pjesë prej përmbledhjeve të çështjeve të imanit të cilat i ka provuar Risale-i Nuri, dhe të cilat kanë lidhje me burgun; dhe me qëllim që të udhëhiqen prej tyre, për të përfituar nga ato, dhe për të rregulluar etikën dhe sjelljet në këtë shkollë të hapur për dhënie edukimi. Dhe ja, ne do të shpjegojmë pesë ose gjashtë prej atyre përmbledhjeve.

Said Nursi

[113] kuran 12 :42

ÇËSHTJA E PARË

Ashtu siç është shpjeguar në "Fjalën e Katërt", në çdo ditë Krijuesi ynë na dhuron kapitalin e njëzet e katër orëve të jetës me qëllim që me të ne të mund të fitojmë të gjitha gjërat e domosdoshme për dy jetët tona, të dynjasë dhe të Ahiretit. Në qoftë se ne shpenzojmë njëzet e tre orë mbi këtë jetë të shkurtër të kësaj dynjaje dhe neglizhojmë për ta shpenzuar orën e vetme të mbetur, e cila është e mjaftueshme për pesë namazet e detyruara, për jetën tonë të përjetshme të Ahiretit, do të kuptohej se ne do të bënim një gabim të madh, sa e paarsyeshme do të ishte kjo. Sigurisht që ne do të vuanim si pasojë e këtij gabimi të rëndë dhe i ashpërsisë së zemrës, dhe do të vuanim dëshpërimin e mendjes dhe të shpirtit si dënim për atë gabim; dhe do të silleshim keq për shkak të dëshpërimit, dhe do të dështonim për të korrigjuar sjelljen për shkak të të jetuarit në një gjendje dëshpërimi, dhe madje do të bënim të kundërtën. Ne mund të bëjmë krahasimin.

Ne duhet të mendojmë se çfarë prove e rëndë por me shumë dobi do të ishte në qoftë se ne do ta shpenzonim një orë të vetme në kryerjen e pesë namazeve të detyruara. Secila nga orët e sprovës dhe nga kohët e vuajtjeve do të transformohej në një ditë adhurimi; është sikur orët kalimtare të fitonin nëpërmjet bekimit të kësaj ore cilësinë e përjetshmërisë; dhe do të bëheshin si orë të përjetshme e të amshuara. Dhe dëshpërimi ynë dhe brenga e shpirtit dhe e zemrës do të zhdukeshin.. Kjo orë ibadeti do të bëhej si shlyerje për gjynahet dhe për gabimet që ishin bërë, të cilat ndoshta qenë shkaku për hyrjen në burg.. Dhe me këtë ne zbulojmë urtësinë e sprovimit tonë me burgim dhe bëhet burgu si një shkollë në të cilën merren mësime të dobishme.. dhe së bashku me vëllezërit tonë në fatkeqësi e sprovë ne gjejmë në të një takim të këndshëm e ngushëllues.

Gjithashtu në "Fjalën e Katërt" u përmend një krahasim midis humbjes së madhe që do të pësonte ai që gulçon pas pjesës së tij të dynjasë dhe që braktis Ahiretin i cili është:

Mund të krahasohet se sa në kundërshtim me interesat e një njeriu do të ishte nëse ai jep pesë ose dhjetë lira prej njëzet e katër lirave që

ka në pronësi për të blerë një biletë llotarie, në të cilën marrin pjesë një mijë njerëz bashkë me të -dhe ndoshta mundësia për të fituar është një në një mijë- ndërsa nuk shpenzon vetëm njërën nga njëzet e katër orët që i ka në pronësi për të blerë një biletë e cila e bën atë të fitojë një thesar të përjetshëm të Ahiretit. Duke ditur se mundësia për ta fituar atë -për besimtarët, punët e të cilëve mbyllen me të mira, që përjetojnë vdekje të lumtura- është me sigurinë nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë prej një mijës; ashtu siç e kanë konfirmuar atë njëqind e njëzet e katër mijë profetët e nderuar dhe të dërguarit, numrat e pallogaritshëm të Evlijave -shenjtorëve- dhe të dijetarëve të pastër si rezultat i zbulesave dhe i ndriçimeve të tyre.

Drejtorët e burgjeve dhe kryegardianët, rojet e burgjeve, dhe madje administratorët e vendit dhe ruajtësit e rendit publik duhet të jenë mirënjohës ndaj këtij mësimi të Risale-i Nurit, sepse të qeverisësh dhe të drejtosh një mijë besimtarë të cilët vazhdimisht kanë në mendje burgun e xhehennemit -Ferrit- është shumë më e lehtë se të qeverisësh dhjetë vetë prej atyre që kanë braktisur namazin dhe që kanë prishur besimin dhe moralet, të cilët mendojnë vetëm për burgjet e dynjasë, që nuk e dallojnë cila është hallall dhe cila është haram dhe që janë mësuar të jetojnë në mënyrë të padisiplinuar.

* * *

NJË PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJES SË DYTË

Ashtu siç është shpjeguar mirë në trajtesën "*Udhëzuesi për të rinjtë*", se është aq e sigurtë dhe e qartë se vdekja do të na bie ashtu si nata që do të ndjekë të sotmen, dhe ashtu siç është ky burg një bujtinë e përkohshme i cili nuk boshatiset deri sa të mbushet përsëri; po ashtu edhe dynjaja është si një hotel dhe si një bujtinë në rrugën e karvaneve që udhëtojnë shpejt të cilët zbresin në të për një natë dhe pastaj ikin e vazhdojnë. Sigurisht vdekja që e ka boshatisur më shumë se njëqind herë çdo qytet prej banorëve të saj dhe që i shtyn ata nëpër varreza, patjetër që ajo kërkon diçka më shumë se sa kjo jetë kalimtare dhe më të madhe në lartësi se sa kjo. Risale-i Nuri e ka zgjidhur enigmën e kësaj të vërtete të madhe dhe e ka zbuluar. Një përmbledhje e saj është kjo:

Meqenëse vdekja nuk mund të vritet, dhe as dera e varrit nuk mund të mbyllet, gjëja më e madhe në rëndësi dhe që përbën problemin më të madh për njeriun është shpëtimi prej dorës së xhelatit të vdekjes dhe

të shpëtojë prej burgut të vetmuar të varrit. Po, ka zgjidhje, dhe nëpërmjet misterit të Kuranit, Risale-i Nuri e ka provuar atë në mënyrë vendimtare e me aq siguri sa dy edhe dy bëjnë katër. Një përmbledhje e shkurtër e kësaj është sa vijon:

Vdekja ose është një asgjësim i përjetshëm, një trekëmbësh në të cilin do të ekzekutohen me varrje njeriu dhe të gjithë të dashurit dhe të afërmit e tij, ose ajo -vdekja- është një lirim nga detyra, një pushim nga puna, për të shkuar në një botë tjetër më të mirë; është një pashaportë për të hyrë në pallatet e lumturisë me dëshminë e imanit dhe me dokumentin e tij.Ndërsa varri është ose një burg vetmie i errët dhe një pus i thellë, ose është një derë për tek kopshtet e përjetshëm dhe për tek një vend i ndritshëm gostie pas lirimit prej burgut të dynjasë. Trajtesa "*Udhëzuesi për të rinjtë*" e ka provuar këtë të vërtetë me një krahasim.

Për shembull, trekëmbëshi për varje është vendosur në oborin e këtij burgu dhe është i mbështetur tek muri. Dhe menjëherë pas murit është një zyrë e madhe lotarie, e cila jep bileta për një lojë lotarie në të cilën marrin pjesë të gjithë njerëzit. Ne pesëqind të burgosurit këtu presim radhën tonë që të na bëhet ftesa një e nga një pa përjashtim për tek ajo arenë, tek ai mejdan, me hir e me pahir; shmangia e saj është e pamundur. Ose do të thuhet për gjithësecilin nga ne: "Eja të marrësh dekretin e ekzekutimit tënd me varje dhe ngjitu tek litarët!", ose merr urdhrin për burgun e përjetshëm të vetmisë dhe "hyr prej kësaj dere të hapur," ose thuhet : "Myzhde për ty! Ti ke fituar një biletë e cila të bën të fitosh miliona lira floriri, eja dhe merri!". Dhe ja, ne shohim shpalljet e kësaj ftese të përhapura gjithandej dhe i shohim njerëzit duke u ngjitur tek trekëmbëshi -litarët- njëri pas tjetrit. Ne shohim se disa prej tyre varen, ndërsa të tjerët e bëjnë trekëmbëshin si një shkallë për të aritur tek zyra e dhënies së çmimeve që ndodhet pas murit. Ne tashmë njohim me siguri të plotë se çfarë po ndodh në atë zyrë -sikur ta shikonim me sy- duke u mbështetur në atë që njoftojnë zyrtarët e lartë të asaj zyre, të cilët japin njoftime të vërteta që nuk pranojnë dyshim.

Ndërkaq në burgun tonë hynë dy grupe. Njëri prej tyre mbante vegla muzikore, verë, ëmbëlsira dhe pasta, të cilat në anën e jashtme janë mjalt, ndërsa nga ana e brendshme janë helm, të cilët i kanë futur shejtanët në formë njeriu. Ata na i paraqesin neve dhe përpiqen të na bëjnë që t'i hamë. Ndërsa grupi i dytë mban në duart e tij libra edukativë, shkrime instruktive, ushqime të lejuara dhe pije të bekuara. Ata na i paraqesin si dhurata, dhe që të gjithë së bashku na thonë me

sigurinë dhe me seriozitetin më të madh: Ato dhurata e ushqime që u paraqesin grupi i parë, të cilat janë vetëm për provim e testim, në qoftë se i pranoni dhe jeni të kënaqur me to, sigurisht fundi juaj është ekzekutimi me varje në këtë trekëmbësh para nesh ashtu siç i keni parë të tjerët. Ndërsa në qoftë se ju pranoni dhuratat që ne ua kemi sjellë me urdhrin dhe me emrin e Sundimtarit të këtyre vendeve, dhe në qoftë se do t'i lexoni duatë dhe shkrimet instruktive që ndodhen në ato libra, ju do të jeni të shpëtuar nga ekzekutimi me varrje, dhe do të merrni biletën prej asaj zyre me të cilën do të fitoni një çmim shumë të madh, do të merrni një dhuratë nga Sulltani dhe nderim e mirësi prej tij. Besojeni këtë që po jua themi me aq siguri sikur ta shihnit me sytë tuaj.. Por ruhuni prej atyre ëmbëlsirave helmuese -të ndaluara, të dyshuara- sepse në qoftë se ju do të hani prej tyre, do të ndoten barqet tuaja dhe do të goditeni nga sëmundje të tmerrshme si rezultat i ndikimit të helmeve dhe do të vuani dhimbje të rënda deri ne kohën e ngjitjes suaj tek trekëmbëshi për t'u ekzekutuar me varje.

Ashtu si ky krahasim, për njerëzit e besimit dhe të adhurimit -me kusht që ata të kenë mbyllje të mirë për punët e tyre dhe vdekje të lumtura- Kaderi Hyjnor do t'u japë atyre thesare të pasosura të përjetshme pasi të mbarojë exheli i tyre në dynja. Ndërsa ata që vazhdojnë në ligësi, në akte të paligjshme dhe në mëkate e shthurje, dhe që nuk janë penduar tek Krijuesi për gjynahet e tyre, ata do të ekzekutohen me një asgjësim të përjetshëm -për ata që besojnë në pavdekshmërinë e shpirtit të njeriut, por që marrin rrugën e shthurjes e të ligësisë- dhe marrin vendimin e mjerimit të tyre të përjetshëm me një siguri nëntëdhjetë e nëntë përqind.

Këtë njoftim të sigurt e japin njëqind e njëzet e katër mijë pejgamberët, paqa dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta[114] në duart e të cilëve janë mrekullitë që i konfirmojnë; dhe e japin atë njoftim njëqind e njëzet e katër milionë Evlija -Zoti ua shenjtëroftë sekretin- të cilët i shikojnë në ndriçimet e tyre gjurmët dhe hijet -si një ekran kinemaje- ato çfarë kanë thënë profetët; gjithashtu atë njoftim e japin dijetarë hulumtues[115] të panumërt dhe interpretuesit e ligjit të shenjtë -muxhtehidët e vërtetë- të cilët i kanë vërtetuar pretendimet e tyre me prova vendimtare dhe me argumente të fuqishme duke i provuar në përputhje me arsyen dhe në mënyrë të sigurt e absolute gjërat e thëna

---

[114] transmetoi Ahmedi

[115] Njëri nga ata dijetarë hulumtues është Risale-i Nuri, i cili për njëzet vite ka heshtur edhe filozofët më kryeneçë dhe ateistët më kokfortë. Pjesët e ndryshme të tij janë të disponueshme; gjithkush mund t'i lexojë; askush nuk mund t'i kundërshtojë ato. Autori

prej atyre dy grupeve të shquara të njerëzimit, dhe kanë vënë firmat e tyre mbi to. Atëherë gjendja e atij që nuk u kushton vëmendje njoftimeve të dhëna me unanimitet nga dekretet e këtyre tre komuniteteve dhe grupeve të lartësuara të njerëzve të realitetit, të cilët janë diejt, hënat dhe yjet e njerëzimit dhe udhëheqësit e shenjtë të humanizmit, dhe që nuk merr rrugën e drejtë që ata treguan, -gjendja e tij- do të ishte një humbje e madhe. Çfarë humbje e madhe do të ishte për atë që nuk shfaq interesim ndaj urdhërave të tyre, që nuk ndjek rrugën e drejtë që të çon në lumturinë e përjetshme nëpërmjet udhëzimeve të tyre, dhe që nuk i kushton vëmendje fundit të tij të dhimbshëm -që arrihet me një siguri nëntëdhjetë e nëntë përqind- në një kohë që ai nuk e ndjek atë rrugë në të cilën ka vetëm një përqind rrezikshmëri, dhe në një kohë që do ta braktiste atë rrugë -me një përqind rrezikshmërie- dhe do ta ndryshonte duke marrë një rrugë tjetër edhe po të ishte më e gjatë, për shkak se një njeri i thotë ka rrezik në të; -gjendja e tij- është si një pijanec i dehur idiot i mjerë i cili ka humbur humanizmin e tij, mendjen, zemrën dhe shpirtin deri në atë shkallë saqë ai injoron dragonjtë e tmerrshëm që shihen nga larg dhe janë duke iu kërdisur, dhe lufton kundra pickimit të mushkonjave duke u dhënë rëndësi vetëm këtyre. Sepse pavarësisht njoftimeve të vërteta të dhëna prej atyre lajmëruesve të panumërt, ai e braktisi më të shkurtërën dhe më të lehtën e dy rrugëve, e cila me sigurinë qind për qind të çon në Parajsë dhe në lumturinë e përjetshme, dhe ka zgjedhur rrugën më të ashpër, më të ngushtë e më të gjatë; e cila është e mbushur plot me vështirësi dhe që me sigurinë nëntëdhjetë e nëntë përqind të çon përfundimisht në burgun e xhehennemit dhe në mjerim të përjetshëm. Ndërsa njeriu -ashtu siç thamë- nuk do ta merrte një rrugë të shkurtër në dynja në të cilën ka vetëm një përqind rrezikshmëri ose në të cilën është burgimi i një muaji të vetëm duke u mbështetur në fjalën e një njoftuesi të vetëm, i cili mund të ishte gënjeshtar. Përkundrazi, ai do të preferonte një rrugë tjetër edhe sikur të ishte e gjatë, ose pa dobi, dhe kjo vetëm që të mos ketë dëm.

Dhe meqenëse e vërteta e çështjes është kjo, atëherë duhet që ne të sprovuarit me burg t'i pranojmë me gjithë kënaqësi e gëzim dhuratat e grupit të dytë me qëllim që të marrim plotësisht hakun ndaj fatkeqësisë së burgut. Domethënë, ashtu si kënaqësia e hakmarrjes së një minuti, ose kënaqësia e hakmarrjes së disa minutave ose e disa orëve në shthurje që mund të na çojë ne në burg, ku disa prej nesh kalojnë në të pesëmbëdhjetë vite, disa të tjerë dhjetë vite, të tjerët pesë vite, ose një vit, ose dy vite ose tre vite dënim, atëherë për inat të burgut, ne duhet të marrim hakun tonë për këtë fatkeqësi duke i transformuar një ose dy

orë të jetëve tona të burgut në një ose dy ditë adhurimi, dhe dënimet tona prej dy ose tre vitesh -nëpërmjet dhuratave të grupit të bekuar, karvanit të dytë- në njëzet apo tridhjet vite të jetës së përhershme, dhe dënimin tonë me njëzet apo tridhjet vjet burgim në një mjet faljeje prej miliona viteve prej xhehenemit. Përballë qarjes dhe dëshpërimit të dynjasë sonë, ne duhet t'i bëjmë jetët tona të përhershme të buzëqeshin. Dhe me këtë ne sigurisht që kemi marrë plotësisht hakun tonë ndaj asaj sprove, dhe kemi shfaqur me të vërtetë se burgu është një shkollë edukimi për rregullimin e moralve e të sjelljeve. Le të shikojnë oficerët e burgut, drejtuesit dhe drejtorët se njerëzit që ata i supozuan se ishin kriminelë, banditë, vrasës, të shthurur, prishës të rendit dhe të dëmshëm për vendin, u bënë studentë të një shkolle të bekuar edukimi në të cilën mësojnë etikën e bukur dhe moralin e shëndoshë dhe u bënë anëtarë të dobishëm për vendet dhe për njerëzit.. Le t' i bëjnë ato shumë falendërime Zotit.

* * *

ÇËSHTJA E TRETË

Kjo është përmbledhja e një ngjarjeje instruktive e cila është përmendur në trajtesën "*Udhëzuesi për të rinjtë*".

Një herë, në njërën nga ditët e festës së republikës po rrija pranë dritares së burgut *Eskishehir* i cili ka pamje nga shkolla e mesme për vajza. Vajzat adoleshente të asaj shkolle luanin e vallëzonin në sheshin dhe në oborrin e shkollës me gëzim e hare. Papritmas m'u shfaq si në një ekran kinemaje -në një ekran jolëndor- gjendja e atyre pas pesëdhjetë viteve: unë pashë se prej atyre pesëdhjetë deri në gjashtëdhjetë vajzave studente, dyzet deri në pesëdhjetë prej tyre ishin bërë pluhur në varrezat e tyre, dhe po vuanin tortura. Dhjetë prej tyre ishin shndërruar në plaka të shëmtuara që kishin mbushur shtatë-tetëdhjetë vite. Fytyrat e tyre ishin shformuar dhe bukuria e tyre ishte prishur, dhe vuanin dhimbje prej shikimeve me përbuzje dhe me shpërfillje prej atyre prej të cilëve ato prisnin admirim e dashuri, meqë ato nuk e kishin ruajtur dëlirësinë në ditët e rinisë së tyre! Po, unë e pashë këtë me siguri të plotë, dhe qava për gjendjen e tyre të dhimbshme. Disa nga shokët e mi të burgut e dëgjuan vajtimin tim dhe erdhën e më pyetën rreth kësaj. Unë u thashë atyre: "Lërmëni vetëm për tani, unë dëshiroj të jem vetëm."

Po, ajo çfarë unë pashë ishte realitet, jo imagjinatë. Ashtu si vera dhe vjeshta që ndiqen nga dimri, po ashtu vera e rinisë dhe vjeshta e pleqërisë ndiqen nga dimri i varrit dhe i Berzahut -botës së ndërmjetme. Nëse do të ishte e mundur që të shfaqeshin ngjarjet që do të ndodhnin pas pesëdhjetë viteve në të ardhmen, në të njëjtën mënyrë siç shfaqen ngjarjet e pesëdhjetë viteve të kaluara në të tashmen, dhe të shfaqeshin ngjarjet e njerëzve të çudhëzimit dhe gjendjet e tyre në të

ardhmen, atëherë ata do të qanin me pikëllim dhe do të përshtiroseshin prej kënaqësisë të paligjshme dhe prej atyre gjërave të ndaluara me të cilat ata gëzohen e qeshin në kohën e tanishme.

Ndërsa isha i zhytur në shqyrtim dhe i përqëndruar tek skenat e ekranit shpirtëror që po shfaqeshin para meje në burgun *Eskishehir*, papritmas para meje u mishërua një personalitet kolektiv sikur ai përfaqësonte shejtanin njerëzor dhe bënte thirrje për shthurje, përhapte ligësinë dhe çudhëzimin dhe më thonte: "Ne dëshirojmë që t'i përjetojmë ato, prandaj mos ndërhyni tek ne!". Unë iu përgjigja: Meqenëse ti nuk e kujton vdekjen dhe e zhyt vetveten në ligësi e në çudhëzim për kënaqësi e qejfe, ti duhet ta dish me siguri se -sipas çudhëzimit tënd- e gjithë e shkuara është e vdekur dhe mosekzistuese; ajo është një varrezë e madhe, e shkretë, e mbushur plot me trupa të kalbur e me kufoma të prishura.

Prandaj në qoftë se ti ke një fije mend dhe në qoftë se ke zemër që nuk të ka vdekur, dhimbjet dhe vuajtjet që burojnë -sipas çudhëzimit tënd- nga vdekja e përjetshme dhe prej llojeve të ndarjeve të panumërta të të afërmve dhe të dashurve të tu të panumërt, e zhdukin atë kënaqësi të pjesshme e të dehur të cilën ti e përjeton tani në një kohë shumë të shkurtër. Ashtu siç është mosekzistuese e shkuara për ty, po ashtu edhe e ardhmja gjithashtu është mosekzistuese për ty, dhe kjo, për shkak të mosbesimit tënd; madje ajo -e ardhmja- është një rrënore e shkretuar, e tmerrshme, e errët dhe e vdekur.. Nuk ka ndonjë prej qënieve të mjera që vjen dhe shfaqet në ekzistencë -duke kaluar nëpërmjet të tashmes- veçse e kap atë xhelati i vdekjes dhe e flak në mosekzistencë. Dhe ti meqenëse je i lidhur me ato botëra -sipas mendjes tënde- atëherë e ardhmja e godet kokën tënde ateiste duke i lëshuar shqetësime të rënda, dhimbje pikëlluese e ankthe tronditëse, saqë i përmbyt krejtësisht kënaqësitë e tua të pjesshme e të shthurura.

Në qoftë se i braktis ligësinë dhe çudhëzimin dhe futesh në sferën e besimit të sigurt e të verifikuar dhe në drejtësi, atëherë ti do të shikoje nëpërmjet dritës së besimit se e shkuara nuk është mosekzistuese dhe as një varrezë që prish e asgjëson gjithçka, por ajo është në fakt një botë ekzistuese e mbushur me dritë -e cila transformohet në të ardhme dhe në një dhomë pritjeje për shpirtrat e pavdekshëm që presin ringjalljen, duke hyrë në *Firdeusin* -xhennetin- e lumturisë së përjetshme i përgatitur për ta; prandaj kjo të bën të përjetosh -ndërsa je akoma në dynja- kënaqësinë e xhennetit shpirtëror sipas shkallës së besimit tënd. Edhe e ardhmja gjithashtu shfaqet nëpërmjet dritës së besimit, jo si një rrënore e shkretë dhe as si një luginë e errët dhe e

frikshme, por si vendbanime lumturie të përjetshme të të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit dhe të Gjithëlavdishmit dhe Mirëbërësit, mëshira e të Cilit përfshin çdo gjë dhe Nderimi i të Cilit rrethon gjithçka. Dhe ashtu siç ka shtruar Krijuesi xh.sh. në pranverë e në verë dy tryeza të mbushura plot e përplot me shumëllojshmëri mirësish e ushqimesh, po ashtu Ai ka shtruar sofrat madhështore në ato pallate të larta dhe ka hapur ekspozitat e mirëbërësisë dhe të dhuratave të Tij të përgjithshme atje; dhe njerëzit shtyhen e nxiten për atje.

Po, kështu besimtari i shikon ato nëpërmjet ekranit të besimit -secili sipas shkallës së tij- dhe ka mundësi që të përjetojë diçka prej kënaqësive të asaj bote të përjetshme. Domethënë, kënaqësia e vërtetë pa dhimbje gjendet vetëm në besimin në Zot; ajo është e mundur vetëm nëpërmjet imanit.

Duke qenë se lidhet me diskutimin tonë, ne do të shpjegojmë këtu me anë të një krahasimi i cili është përfshirë si një shënim tek trajtesa *Udhëzuesi për të rinjtë,* vetëm një dobi të vetme dhe një kënaqësi prej mijërave të tilla të cilat i prodhon besimi edhe në këtë dynja; ai është sa vijon:

Për shembull, përfytyro -o vëlla- se djali yt i vetëm të cilin ti e do shumë ka rënë në shtrat duke vuajtur dhimbjet në agonitë e vdekjes, dhe ti je duke menduar me shumë pikëllim se do të ndahesh përjetësisht prej tij. Përfytyro -ndërsa je në këtë gjendje pikëlluese- papritmas vjen një doktor i aftë si Hazreti Hizri ose si Hazreti Lukmani, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, dhe i japin fëmijës tënd të dashur një ilaç kundra helmit; dhe fëmija papritmas hap sytë e tij i gëzuar dhe i lumtur me kënaqësinë e jetës. Ti mund të kuptosh se çfarë kënaqësie dhe lumturie do të të jepte kjo.

Po kështu është gjendja tek ata miliona të varrosur në varrezën e së shkuarës të cilët ti i do shumë -ashtu si këtë fëmi- dhe me të cilët ti je i lidhur.

Ndërsa ata janë gati duke u asgjësuar e duke pushuar së ekzistuari në varrezën e së shkuarës -në shikimin tënd-, kur papritmas realiteti i besimit lëshon një dritë nga dritarja e zemrës -ashtu siç bëri Lukmani i urtë me atë fëmijë- tek ajo varrezë e madhe e cila imagjinohet të jetë një vend ekzekutimi. Nëpërmjet asaj drite, të gjithë të vdekurit ngrihen e vijnë në jetë -në Botën e ndërmjetme- duke thirrur me gjuhën e gjendjes: “Ne nuk jemi të vdekur.. dhe as nuk do të vdesim kurrë; ne do të takohemi së shpejti me ju. Po, ashtu siç i jep shërimi fëmijës gëzim e kënaqësi të pakufishme pas dëshpërimit dhe këputjes së

shpresës, po ashtu është çështja këtu ç‘ka na bën ne të jemi të sigurt se besimi -duke na dhënë gëzim e kënaqësi në këtë dynjanë tonë- provon se realiteti i tij është një bërthamë e tillë saqë në qoftë se do të mishërohej një parajsë private për çdo besimtar, do të shfaqej prej saj -do të dukej- Pema Tuba e asaj fare. Kështu unë i thashë atij shejtani kryeneç në formë njeriu, atij personaliteti kolektiv; dhe në kokëfortësinë e tij ai më tha:

“Të paktën ne mund të jetojmë si kafshët, duke i kaluar jetët tona në gëzim e hare, dhe duke qenë të zhytur në dëfrim e shthurje duke mos menduar rreth këtyre çështjeve të holla e të vështira”.

Unë iu përgjigja duke i thënë: “Ti nuk mund të krahasohesh me kafshën; ti nuk je si kafsha, sepse kafshët nuk mendojnë për të shkuarën e për të ardhmen. Ato nuk ndjejnë as dëshpërime e as hidhërime për të shkuarën, as ankthe e frikësime për të ardhmen. Prandaj, kafsha e gjen kënaqësinë e saj të plotë, dhe falënderon Krijuesin e saj Gjithëbujar; madje edhe kafsha që bëhet gati për t‘u therrur nuk ndjen ndonjë gjë përveç dhimbjes së thikës kur kalon sipër fytit të saj; dhe menjëherë sapo të zhduket kjo ndjeshmëri, ajo shpëton prej asaj dhimbjeje. Kjo do të thotë se sa shembull i madh i mëshirës dhe i dhembshurisë Hyjnore është mosbërja të njohur të padukshmen dhe mbulimi -fshehja- e fatkeqësive dhe e katastrofave që do t’i bien dikujt dhe sidomos kafshëve dhe shtazëve.

Por, o njeri, e shkuara dhe e ardhmja jote shfaqen deri në një farë shkalle nga e padukshmja për shkak të arsyes tënde, prandaj ti je krejtësisht i privuar nga rehatia dhe qetësia që gëzojnë kafshët për shkak të vendosjes së perdes së të padukshmes para tyre. Pikëllimet dhe ndarjet e dhimbshme duke ardhur nga e shkuara dhe ankthet dhe frikësimet që burojnë nga e ardhmja e zhdukin kënaqësinë tënde të pjesshme, e largojnë atë dhe të zbresin ty në një shkallë më të ulët se sa kafsha lidhur me kënaqësinë.

Meqenëse realiteti është ky, ose flake tutje mendjen tënde, bëhu kafshë e shpëto, ose eja në vete nëpërmjet besimit; dëgjoje Kuranin, dhe merr kënaqësi të pastër njëqind herë më të madhe se sa ajo e kafshëve edhe në këtë dynja të përkohshme gjithashtu. Duke ia thënë këtë argument unë e heshta.

Megjithatë ai personalitet kolektiv kokëfortë përsëri kundërshtoi duke më thënë: “Të paktën ne mund të jetojmë si ata perëndimorë të cilët janë të pafe”.

Unë iu përgjigja: Ti nuk mund të jesh madje as si njerëzit e pafe të Europës; sepse ata në qoftë se mohojnë një profet të vetëm, ata besojnë në profetët e tjerë; madje edhe në qoftë se ata nuk njohin asnjërin prej profetëve, mirëpo mund të kenë besim në Zotin xh.sh.; madje edhe në qoftë se nuk e njohin Zotin xh.sh., ata mund të posedojnë disa cilësi personale të lavdërueshme dhe veçori njerëzore nëpërmjet të cilave ata gjejnë plotësim. Por në qoftë se një musliman mohon profetin e fundit të kohës a.s.m. i cili ishte vula e profetëve, profeti i fundit dhe më i madhi i profetëve; dhe feja dhe shkaku i të cilit janë universalë, dhe në qoftë se do ta mohonte e braktiste fenë e tij dhe do të dilte nga sfera e udhëzimit të tij -që s'ka fe tjetër si ajo në vërtetësi e përbotshmëri-, atëherë ai nuk do të pranonte profet tjetër, dhe ndoshta nuk do të pranonte as edhe besimin në Zot; sepse ai nuk i njohu të gjithë profetët e tjerë dhe as nuk u udhëzua tek besimi në Zotin veçse nëpërmjet profetit të fundit të kohës a.s.m., nëpërmjet udhëzimit e komunikimit të tij; prandaj nuk do të mbetej në zemrën e tij ndonjë gjë prej atyre pa i besuar atij a.s.m.. Për këtë arsye, qysh në kohët e hershme njerëzit kanë hyrë në islam prej të gjitha feve të tjera, ndërsa kurrë nuk ka ndodhur që të bëhet një musliman i vetëm çifut i vërtetë, as mexhus -pagan- dhe as kristian; por ata musliman që braktisin fenë e tyre mund të bëheshin ateista me morale të prishura dhe me cilësi të korruptuara; dhe ata bëhen të dëmshëm për vendin, kombin dhe për njerëzit". Unë e provova këtë, dhe ai personalitet kolektiv kryeneç nuk mundi t'u ngjasonte as ateistëve të huaj.. Dhe meqenëse nuk gjeti ku të mbështetet, ai u zhduk sysh dhe ra në xhehennem; sa fund i keq!

O shokët e mi që jeni duke studiuar së bashku me mua në këtë shkollë të Jusufit! Meqenëse realiteti është ky, dhe Risale-i Nuri e provon atë aq qartë e në mënyrë vendimtare si drita e diellit saqë qysh prej njëzet vitesh ai e ka thyer kokëfortësinë e kryeneçëve dhe i ka detyruar ata të besojnë, atëherë ne duhet ta ndjekim rrugën e besimit dhe sjelljen e drejtë, e cila është e lehtë, e shëndoshë dhe e dobishme për dynjanë tonë, për të ardhmen tonë, për ahiretin tonë, për vendet tona dhe për kombin tonë. Dhe duhet ta kalojmë kohën tonë të lirë duke recituar suret e Kuranit që ne dimë në vend të zhytjes në fantazitë pikëlluese; ne duhet t'i gjallërojmë kohët tona duke lexuar atë çfarë ne dimë prej sureve të Kuranit në çdo kohë, duke mësuar kuptimet e tij nga vëllezërit tonë që merren me të; dhe të bëjmë faljet kaza që na kanë mbetur pa i kryer në të shkuarën, të cilat duhej t'i kishim bërë; dhe duke përfituar nga cilësitë e mira të njëri-tjetrit ta transformojmë këtë burg në një kopësht të bekuar duke mbjellur në të fidanet e sjelljeve të mira dhe të dalin prej tij pemë të dobishme frutdhënëse. Me

vepra të mira si këto, ne duhet të përpiqemi sa më shumë që t'i bëjmë drejtorët dhe gardianët e burgut profesorë udhëzues që të përgatisin në këtë shkollë të Jusufit burra për në xhennet dhe mbikëqyrës të mirë, që t'u japim atyre edukim dhe trajnim të mirë; dhe jo të jenë torturues si *Zebanitë* -engjëjt e Ferrit- duke qëndruar mbi kriminelët dhe vrasësit.

* * *

ÇËSHTJA E KATËRT

Përsëri, ndodhet një shpjegim i kësaj në trajtesën *"Udhëzuesi për të rinjtë"*. Një ditë, vëllezërit e mi, të cilët më ndihmojnë, më pyetën duke më thënë:

Ndonëse kanë kaluar tashmë pesëmbëdhjetë ditë që nga shpërthimi i luftës -dhe tani kanë kaluar shtatë vite[116]- ti nuk ke pyetur asgjë fare për këtë luftë të tmerrshme botërore, e cila e ka zhytur të gjithë botën në kaos, në tronditje e në ankth dhe e cila është lidhur ngushtë me fatin e botës islame dhe ti as nuk ke qenë aspak kureshtar për të ditur rreth asaj, në një kohë që ne shohim disa fetarë dhe dijetarë duke lënë xhematin në xhami dhe duke vrapuar për të dëgjuar radion. A ka ndonjë çështje më të madhe se sa kjo që të preokupton ty? Apo mos vallë është e dëmshme në ndonjë mënyrë që të preokupohesh me të?"

Unë iu përgjigja atyre: Kapitali i jetës është shumë i pakët dhe udhëtimi i jetës këtu është i shkurtër; ndërsa detyrat e domosdoshme dhe misionet me të cilat jemi ngarkuar janë të shumta; këto detyra janë si sfera të ndërfutura njëra brenda tjetrës si rrathë bashkëqendrorë rreth njeriut. Kështu duke filluar nga sfera e zemrës, e stomakut dhe e trupit, nga ajo e shtëpisë së tij, e lagjes në të cilën jeton, e qytetit të tij, e vendit, e tokës, e globit dhe e njerëzimit dhe duke përfunduar tek sfera e të gjitha qënieve të gjalla dhe e të gjithë botës ndodhen sfera të ndërfutura njëra brenda tjetrës. Çdo njeri mund të ketë detyra në secilën nga ato sfera; por më e rëndësishmja dhe më e madhja e detyrave, madje më e vazhdueshmja e më e qëndrueshmja e tyre në lidhje me të, janë në më të vogëlën e atyre sferave dhe në ato që janë më të afërtat me të; ndërsa detyrat e tij më pak të rëndësishme dhe të përkohshme mund të jenë në më të madhen dhe në më të largëtën e atyre sferave. Sipas kësaj analogjie, më të mëdhatë dhe më të vogëlat e detyrave janë në përpjesëtim -në raport- të kundërt me gjërësinë e

[116] Kjo fjalë kundërshtuese i refrohet vitit 1946. Përkthyesi

sferës; domethënë sa më shumë të zvogëlohet -afrohet- sfera, aq më shumë zmadhohet detyra; dhe sa më shumë të zmadhohet -largohet- sfera, aq më shumë pakësohet rëndësia e detyrës..

Por meqenëse sfera më e madhe është tërheqëse dhe joshëse, ajo e bën njeriun të neglizhojë në detyrat e tij më të rëndësishme e të domosdoshme në sferën e vogël e të afërt me të, dhe e preokupon njeriun me gjëra jo të domosdoshme, e drejton mendimin e tij tek punët që nuk i interesojnë, tek gjëra të parëndësishme e dytësore; kjo ia shkatërron kapitalin e jetës së tij dhe e bën që ta humbasë për kot jetën e tij; kjo e vret jetën e tij të çmueshme mbi gjëra të pavlefshme. Për më tepër, duke ndjekur me kureshtje lajmet e luftës, zemra e një njeriu mund të anojë tek njëra palë midis dy forcave kundërshtare; kështu ai nuk e gjen në veten e tij mohim ndaj padrejtësive dhe tiranisë së asaj pale ndërluftuese. Madje ndjehet i rehatuar për ato; dhe në këtë mënyrë bëhet partner në tiraninë e saj.

Përgjigjja për pikën e parë: Përpara njeriut -dhe sidomos muslimanit - ndodhet një çështje e rëndësishme dhe një ngjarje e madhe e cila është më e madhe se sa lufta që zhvillohet midis shteteve më të mëdhaja për hir të sundimit mbi globin tokësor. Ajo çështje ka një rëndësi aq të madhe saqë në qoftë se çdo njeri do të kishte pasurinë dhe fuqinë e gjermanëve dhe të anglezëve, nuk do të hezitonte që t'i shpenzonte të gjitha ato për hir të fitimit të asaj çështjeje të dëshiruar e të kërkuar. Ajo çështje është ajo të cilën e njoftuan njëqind mijë prej më të shquarve të njerëzimit; dhe e ngritën flamurin e saj yjet dhe udhëzuesit e pakufishëm të njerëzimit duke u mbështetur në mijëra prej dokumenteve të Krijuesit të të gjitë botëve dhe në premtimet e kërcënimet e Tij; madje një grup prej tyre e kanë parë vërtet me sy; ajo çështje është vendimtare për njeriun; ajo është sa vijon:

Që njeriu të fitojë me besimin, ose të humbasë pa të, një pronë madhështore të përjetshme dhe banesa e pallate të mira në kopshtet e xhennetit *Adn* gjerësia e të cilit është sa qiejt dhe toka. Në qoftë se nuk e sigurojnë dokumentin e besimit, ata do ta humbasin atë çështje, dhe kjo është humbja më e përfushtë. Në këtë shekull, shumë janë duke e humbur çështjen për shkak të flamës -murtajës- së materializmit; saqë një i ri prej njerëzve të dijes, të realitetit dhe të zbulesës, zbuloi dhe dëshmoi se, në një vend, prej dyzet vetëve që kishin vdekur, vetëm pak individë shpëtuan me besimin e tyre në agonitë e vdekjes dhe e mbyllën mirë jetën e tyre; ndërsa të tjerët humbën -u shkatërruan! Dëshiroj të di në qoftë se do t'i jepej në shkëmbim ndonjërit prej këtyre sundimi i dynjasë, prona dhe stolia e saj në vend të asaj

çështjeje më të madhe, a do të ishte ky shkëmbim i përshtatshëm për atë çka humbi; a do t'ia kompensonte në ndonjë mënyrë? Jo, kurrë!

Meqenëse ne studentët e Risale-i Nurit e dimë se do të ishte thjesht çmenduri në qoftë se do të braktiseshin detyrat të cilat na bëjnë ne ta fitojmë atë çështje të madhe, ose nëse do të neglizhoheshin detyrat e avokatit të çuditshëm i cili i ruan nëntëdhjetë përqind nga humbja e saj, ose të preokupoheshin me gjëra të tjera të jashtme e me detyra të parëndësishme sikur dynjaja do të ishte e përhershme. Ne jemi të sigurt se në qoftë se gjithësecili nga ne do të kishte mençuri e intuitë njëqind herë më të madhe se sa ajo që ne kemi tani, përsëri do t'i përdornim ato vetëm në rrugën e asaj çështjeje.

O vëllezërit e mi të rinj këtu në këtë fatkeqësi të burgut! Ju akoma nuk e keni studiuar Risale-i Nurin ashtu siç e kanë parë e studiuar vëllezërit e mi të hershëm të cilët hynë në burg me mua. Duke i përmendur ata dhe mijëra studentë si shembulli i tyre si dëshmitarë, unë them këtë: Unë e provoj dhe e kam provuar, se është Risale-i Nuri ai që e fiton atë çështje më të madhe për nëntëdhjetë njerëz prej njëqind prej atyre; ai siguron -fiton- për ta besim të sigurt e të verifikuar, i cili është dokumenti i fitimit dhe dëshmia e tij, që e ka fituar çështjen për njëzet mijë njerëz gjatë njëzet viteve që kaluan. Nuk ka dyshim se ai ka buruar prej mrekullisë shpirtërore të Kuranit dhe është avokati kryesues në mbrojtje të asaj çështjeje të madhe në këtë kohë. Megjithëse këto tetëmbëdhjetë vite armiqtë e mi dhe ateistët e materialistët i kanë mashtruar disa anëtarë të qeverisë me intrigat dhe me komplotet e tyre mizore të shumëllojshme kundra meje dhe i kanë nxitur ata për të na shkatërruar neve dhe na kanë shtyrë neve për në thellësirat e burgjeve ashtu si këtë herë, por ata nuk kanë bërë gjë për t'u përmendur dhe as nuk do të bëjnë në dashtë Zoti xh.sh., sepse ata nuk kanë qenë në gjendje t'i shkaktojnë dëm kalasë prej çeliku të Risale-i Nurit, as nuk kanë prekur pajisjet e tij që arrijnë njëqind e tridhjetë pjesë pajisjesh -Trajtesash- me përjashtim të dy apo tre trajtesave prej tyre.

Prandaj, kushdo që dëshiron të ngarkojë a caktojë një avokat për të mbrojtur çështjen e tij, mjafton të mbrohet me të dhe të kapet pas dritës së tij.

O vëllezër! Mos kini frikë! Risale-i Nuri nuk mund të ndalohet nga qarkullimi, dhe as nuk mund të fshihet e të bllokohet nga shikimi. Me përjashtim të dy apo tre trajtesave, trajtesat e tij janë duke qarkulluar me liri të plotë midis strukturave të shtetit. Në dashtë Zoti do të vijë ajo ditë në të cilën drejtorët dhe gardianët fatlumë do të shpërndajnë

Risale-i Nurin tek të burgosurit ashtu siç shpërndajnë tek ta bukën dhe ilaçin, dhe do t'i transformojnë burgjet në shkolla udhëzimi, edukimi dhe reformimi.

* * *

ÇËSHTJA E PESTË

Ashtu siç u përshkrua në detaje në trajtesën "*Udhëzuesi për të rinjtë*", nuk ka dyshim se rinia do të ikë e do të zhduket; ajo do të transformohet në pleqëri e në vdekje, ashtu si vera që ia jep vendin e saj vjeshtës dhe dimrit, dhe ashtu siç ndiqet dita nga nata; edhe kjo

është aq e sigurt si shembulli i kësaj të vërtete. Të gjitha urdhëresat qiellore japin sihariqe -lajme të gëzueshme- se në qoftë se rinia kalimtare dhe e përkohshme shpenzohet në vepra të mira, në dëlirësi dhe brenda caqeve të sjelljes së mirë, ajo do ta bënte njeriun të fitojë një rini të pavdekshme, të përjetshme.

Në qoftë se, nga ana tjetër, rinia harxhohet në ligësi e shthurje, atëherë ashtu si zemërimi i një minuti që mund ta shtyejë njeriun në kryerjen e krimit të vrasjes dhe e çon në vuajtjen e miliona minutave prej dënimit të burgut, po ashtu dehja e rinisë, dalldia, shthurja dhe kënaqësia e saj kalimtare -në ato që nuk i ka lejuar All-llahu- i shkaktojnë njerut dhimbje më të shumta e më të thella në pikërisht kënaqësinë e paligjshme, përveç ndëshkimit të tmerrshëm në Ahiret dhe dënimit pikëllues në dynja dhe përveç vuajtjeve dhe ndëshkimeve të thella që burojnë nga zhdukja e kënaqësisë dhe përveç mëkateve dhe dënimeve që vuan në këtë botë. Çdo i ri me mend dëshmon për vërtetësinë e ekzistencës së këtyre dhimbjeve në vetë kënaqësinë prej eksperiencës së vet. Për shembull në dashurinë e ndaluar, ose në ashkun jo në mënyrën e drejtë ka dhimbje që e hidhërojnë kënaqësinë e pjesshme në to; prej tyre janë dhimbja e xhelozisë, dhimbja e ndarjes nga i dashuri, dhimbja e mospërgjigjjes me të njëjtën dashuri.. si dhe shumë hidhërime të tjera të cilat e transformojnë atë kënaqësi të pjesshme në mjalt helmues.

Në qoftë se ti dëshiron të dish se si ato përfundojnë në spitale, për shkak të sëmundjeve që burojnë nga keqpërdorimi i rinisë së tyre; dhe në burgje për shkak të ekseseve -teprive- të tyre, dhe nëpër pijetore -mejhane- nëpër vende të shthurjes dhe në varreza për shkak të dëshpërimit që buron nga boshllkëku dhe mosushqimi i zemrave dhe i shpirtërave të tyre dhe nga moskryerja e funksioneve të tyre të drejta, shko e pyet tek spitalet, tek burgjet, tek pijetoret dhe tek varrezat; ti do të dëgjosh vajtimet dhe ofshamat e dëshpërimit nga goditjet që kanë marrë të rinjtë si dënim për abuzimet në rininë e tyre, për tepritë dhe ekstremet e tyre dhe për kënaqësitë e paligjshme.

Me në krye Kuranin, me shumë nga vërsetet e tij, të gjithë librat qiellorë dhe shkrimet e shenjta japin sihariqe se në qoftë se shpenzohet brenda caqeve të moderimit, rinia është një mirësi e këndshme dhe e ëmbël, një mjet i fuqishëm për veprat e mira, e cila fiton rezultatin e një rinie të ndritshme e të pavdekshme në Ahiret.

Meqenëse realiteti është ky, dhe meqenëse limitet e së lejuarës janë të mjaftueshme për kënaqësi dhe meqenëse një orë prej kënaqësisë së paligjshme çon ndonjëherë në një dënim prej një ose dhjetë vite

burgosjeje, atëherë, sigurisht, është absolutisht e domosdoshme që ta shpenzojmë mirësinë e ëmbël të rinisë me dëlirësi, me ndershmëri dhe në rrugën e drejtë si mirënjohje dhe falënderime ndaj asaj mirësie të shijshme të dhuruar; madje kjo është më e domosdoshmja.

* * *

ÇËSHTJA E GJASHTË NGA FRUTET E BESIMIT

[Kjo përbëhet nga një provë e vetme e shkurtër e shtyllës së besimit në All-llah, për të cilën ndodhen me mijëra argumente të përgjithshme vendimtare që janë shpjeguar në shumë vende në Risale-i Nur]

Në Kastamonu (një qytet në veri të Turqisë) një grup studentësh të shkollave të mesme erdhi tek unë, duke më thënë: ***"Na trego neve rreth Krijuesit, sepse mësuesit tonë nuk flasin për Zotin."***

Dhe unë u thashë atyre: ***"Të gjitha shkencat që ju i studioni, në mënyrë të vazhdueshme flasin për Zotin xh.sh. dhe bëjnë të njohur Krijuesin, secila me gjuhën e saj të veçantë. Mos i dëgjoni mësuesit, dëgjoni ato shkenca."***

Për shembull, një farmaci e pajisur mirë me ilaçe dhe me përgatesa jetësore në çdo kavanoz a shishe, të peshuara në masa të sakta e të çuditshme, padyshim tregon një kimist shumë të aftë dhe një farmacist të urtë e të ditur.

Në të njëjtën mënyrë, me shkallën që është më e madhe, më e plotë dhe më mirë e pajisur se sa farmacia në treg, farmacia e globit tokësor me barnat dhe ilaçet e saja të gjalla në shishet të cilat janë katërqind mijë llojet e bimëve dhe të kafshëve, tregon dhe bën të njohur –madje edhe për sytë që janë të verbër– nëpërmjet masës ose shkallës së shkencës së mjekësisë që ju studioni, të Gjithurtin e Lavdisë, i Cili është Farmacisti i farmacisë madhështore të tokës.

Për të marrë një shembull tjetër, një fabrikë e çuditshme e cila end mijëra lloje tekstilesh prej një materiali të thjeshtë, ajo padyshim bën të njohur fabrikuesin dhe mekanikun e aftë.

Në të njëjtën mënyrë, në cilëndo shkallë që është më e madhe dhe më e plotë se sa fabrika njerëzore, kjo makineri Hyjnore udhë-tuese e njohur si globi tokësor e cila ka qindra e mijëra uzina kryesore, koka, ku në secilën prej tyre ndodhen qindra e mijëra fabrika të përkryera, tregon e bën të njohur nëpërmjet masës ose shkallës së shkencës së inxhinierisë, të cilën ju po e studioni, Fabrikuesin e saj dhe Pronarin.

Dhe, për shembull, një depo, një magazinë ose një dyqan në të cilin janë sjellë dhe rezervuar në mënyrë të rregullt e të sistemuar një mijë e një varietete ushqimesh, pa dyshim kjo bën të njohur një pronar të çuditshëm, një mbikëqyrës të furnizimeve dhe të artikujve ushqimorë.

Në të njëjtën mënyrë, në cilëndo shkallë që është më e madhe dhe më e plotë se sa një depo e tillë apo një fabrikë, kjo ushqimore, ky dyqan ushqimesh i të Gjithëmëshirshmit, i njohur si globi tokësor, kjo anije Hyjnore, kjo depo Hyjnore dhe ky dyqan duke mbajtur mallra e furnizime dhe ushqim të konservuar, i cili në një vit udhëton me rregull rreth një orbite prej njëzet e katër mijë vitesh, dhe duke transportuar grupet e qënieve, që secili grup prej tyre kërkon një lloj të veçantë ushqimi, dhe duke kaluar përmes stinëve në udhëtimin e saj dhe duke e mbushur pranverën me qindra e mijëra nga furnizimet e ndryshme, si një vagon i madh, ua sjell ato krijesave të gjalla të mjera, ushqimi i të cilave ka mbaruar në dimër. Nëpërmjet masës ose shkallës së shkencës së ekonomisë të cilën ju e studioni, kjo depo e tokës bën të njohur dhe bën të dashur administratorin dhe pronarin me shkallën e madhështisë së kësaj depoje në krahasim me atë depo të ndërtuar nga njeriu.

Dhe, për shembull, le të imagjinojmë një ushtri e cila përbëhet nga katërqind mijë lloje kombesh dhe secili lloj a komb ka ushqimin e tij të veçantë e të ndryshëm, përdor armë të ndryshme, vesh uniforma të ndryshme, kryen ushtrime të ndryshme stërvitore, dhe çmobilizimi nga detyrat e tij është i ndryshëm. Në qoftë se kjo ushtri, ky fushim, ka një komandant mrekullibërës i cili i furnizon vetë të gjithë ato kombe të ndryshme, të gjitha furnizimet e tyre të ndryshme, armët, uniformat dhe pajimet pa harruar e ngatërruar asnjërin prej tyre, atëherë sigurisht ushtria e mahnitshme dhe fushimi tregojnë komandantin e jashtëzakon-shëm, dhe e bëjnë atë të dashur me vlerësim e mirënjohje.

Në të njëtën mënyrë, fushimi pranveror i faqes së tokës në të cilën, në çdo pranverë, një ushtrie Hyjnore të rekrutuar rishtazi, që përbëhet prej katërqind mijë lloje të bimëve dhe kafshëve, u jepen të gjithëve uniformat e tyre të ndryshme, racionet e ushqimit, armët, stërvitja dhe

çmobilizimi në një mënyrë krejtësisht të plotë e të rregullt nga një komandant i vetëm i përgjithshëm, i cili nuk harron dhe nuk neglizhon asnjërin prej tyre; në cilëndo shkallë, fushimi pranveror i faqes së tokës është më i gjërë dhe më i plotë se sa ushtria njerëzore -kjo nëpërmjet masës ose shkallës së shkencës ushtarake që ti studion- ua bën të njohur njerëzve të vëmendshëm e të ndjeshëm Sundimtarin e tokës, Mbështetësin, Administratorin dhe Koman-dantin më të Shenjtë duke shkaktuar habi dhe brohoritje. E bën Atë të dashur, të vlerësuar dhe të lavdëruar.

Një shembull tjetër: Me miliona drita elektrike që lëvizin e udhëtojnë në çdo anë të një qyteti të mahnitshëm, ku lënda djegëse e asaj fabrike dhe e atyre llambave elektrike nuk mbaron kurrë, në mënyrë të vetëkuptueshme kjo bën të njohur një mjeshtër çudibërës dhe një elektriçist jashtëzakonisht të talentuar i cili drejton e vë në veprim elektricitetin, i bën llambat lëvizëse, rregullon burimin e energjisë, ndërton fabrikën dhe sjell lëndën djegëse; kjo i bën të tjerët ta përshëndesin, ta duartrokasin dhe ta duan.

Në të njëjtën mënyrë, megjithëse disa nga llambat e yjeve në çatinë e pallatit të botës në qytetin e universit – në qoftë se vlerësohen në mënyrën që thotë astronomia, se ato janë njëmijëherë më të mëdha se sa toka dhe lëvizin shtatëdhjetë herë më shpejtë se sa një gjyle topi, ato nuk e prishin rregullin e tyre, as nuk përplasen me njëra-tjetrën, as nuk shuhen dhe as nuk mbaron lënda e tyre djegëse. Sipas astronomisë, të cilën ju e studioni, këto llamba tregojnë me gishtë-rinjtë e tyre prej drite fuqinë e pafundme të Krijuesit të tyre. Dielli ynë, për shembull, i cili është një milion herë më i madh se globi tokësor dhe një milion herë më i vjetër në moshë, është një llambë dhe sobë në një bujtinë të të Gjithëmëshirshmit të vetëm, me qëllim që të vazhdojë të jetë i ndezur e i ndriçuar, do t'i duhej medoemos aq shumë vaj, sa detet e tokës, aq shumë qymyr sa malet e saj, dhe aq shumë drurë e kërcunj sa njëmijë herë përmasa e tokës, që ai të mos shuhet. Por Ai i cili e ndez dhe e ndriçon atë dhe që ndriçon të gjithë yjet e tjerë të mëdha si ai pa lëndë djegëse, pa dru, pa qymyr dhe duke mos u shuar dhe që i bën ato të udhëtojnë së bashku me një shpejtësi madhështore të pakufishme dhe pa u përplasur me njëri-tjetrin, sigurisht kjo është një fuqi e pafundme dhe një sovranitet madhështor i pakufishëm. Atëherë, ky univers madhështor me llambat elektrike dhe kandilat që ai përfshin, na njoftojnë me dëshminë e yjeve të ndritshëm – sipas masës së shkencës së elektri-citetit që ju po e studioni, Sunduesin, Ndriçuesin, Drejtuesin dhe Autorin e ekspozitës madhështore të gjithësisë; ato e bëjnë atë të Dashur, të Lavdëruar dhe të Adhuruar.

Dhe, për shembull, një libër, në një rresht të të cilit shkruhet hollë e bukur një libër i tërë dhe në çdo fjalë të të cilit shkruhet një sure Kur'ani me një penë të hollë, i cili është më kuptimploti dhe që të gjitha çështjet e të cilit mbështesin njëra-tjetrën; ky libër i mahnitshëm, pa dyshim tregon aftësinë e jashtëzakonshme të shkr-uesit të tij dhe fuqinë e plotë të Autorit të tij. Domethënë, një libër i tillë si ky, padyshim bën të njohur shkruesin dhe autorin e tij së bashku me plotësimet dhe artet e tij, në mënyrë aq të qartë si dita. Ai e bën Atë të vlerësuar me fraza të tilla si: Mashaall-llah, Barekall-llah "Çfarë çudirash ka dashur Zoti xh.sh., "I bekuar është All-llahu!" etj.

Po kështu është libri madhështor i universit. Ne shohim me sytë tonë një penë e cila shkruan në faqen e tokës, që është njëra nga faqet e tij, dhe në pranverë, e cila është një fletë e vetme, treqindmijë lloje bimësh e kafshësh, të cilët janë si treqind mijë libra të ndryshëm, të gjithë së bashku njëri brenda tjetrit, pa gabim apo defekt, pa i ngatërruar ato e pa konfuzion, në mënyrë të përkryer dhe me rregull të plotë. Ndonjëherë shkruan një poemë të shkëlqyeshme prej një fjale të tij, si një pemë, dhe një indeks të plotë të një libri nga një pikë e tij si bërthama.

Ashtu siç shihet qartë para nesh, kjo tregon me siguri se pas tij është një penë rrjedhëse që shkruan, po ashtu, ju duhet të vlerësoni shkallën e domethënies së këtij Kur'ani madhështor i cili është i mbushur pafundësisht plot me kuptime. Në çdo fjalë të tij ndodhen shembuj të shumtë urtësie, shkallën që tregon ky Kur'an madhështor i mishëruar, që është bota, për Krijuesin e tij dhe për shkruesin dhe Autorin e tij, duke e krahasuar me atë libër që u përmend në shembëlltyrë. Dhe kjo në përputhje me masën e shtrirë dhe me vizionin largpamës të shkencës natyrale që ju e studioni dhe të shkencave të leximit dhe të shkrimit që ju i keni praktikuar në shkollë.

Madje, ju kuptoni se duke deklaruar *"Zoti është më i madhi!"* kjo e bën Atë të njohur. Duke shprehur Fjalët *"Lavdia i takon Zotit xh. sh.",* ajo e përshkruan Atë, dhe duke shprehur lavdërime *"I gjithë lavdërimi i takon Zotit xh.sh."*, kjo e bën atë të dashur.

Kështu, çdo shkencë nga qindra të tilla si këto bëjnë të njohur Krijuesin e Gjithëlavdishëm të universit së bashku me Emrat e Tij, secila nëpërmjet masës ose shkallës së saj të gjërë, pasqyrës së saj të veçantë, syve të saj largpamës dhe shikimit kërkues e hulumtues; të gjitha bëjnë të njohur Atributet dhe plotësimet.

Ndërkohë unë u thashë studentëve të rinj: Urtësia në përsëritjen e vërseteve të mëposhtme të Kur'anit bëhet me qëllim që të na japë mësim në këtë çështje, e cila është një provë e ndritshme dhe madhështore e Unitetit Hyjnor, dhe që të bëjë të njohur Krijuesin tonë: رَبُّ السَّمٰوَاتِ وَالْاَرْضِ خَلَقَ السَّمٰوَاتِ وَالْاَرْضَ *"Krijuesi i qiejve e i tokës" dhe "Ai i krijoi qiejt dhe tokën."*

Unë ua thashë këtë studentëve dhe ata e pranuan plotësisht, duke e vërtetuar atë e duke thënë: *"Falënderime të pafundme i takojnë Zotit xh.sh., sepse ne kemi marrë një të vërtetë absolute dhe një mësim të shenjtë!"*

Dhe unë thashë: **"Njeriu është një makineri e gjallë që pikëllohet nga mijëra dëshpërime e dhimbje të ndryshme dhe merr kënaqësi në mijëra mënyra të ndryshme. Pavarësisht pafuqisë së tij, ai ka armiq të panumërt, materialë e shpirtërorë. Pavarësisht varfërisë së tij të pafundme, ai ka nevoja të pallogaritshme, të jashtme e të brendshme dhe është një krijesë e mjerë që në mënyrë të vazdueshme merr goditjet e vdekjes dhe të ndarjes. Por megjithatë, nëpërmjet besimit dhe adhurimit, ai befas bëhet i lidhur me një Monark aq të Gjithëlavdishëm saqë ai gjen një pikë mbështetje kundra të gjithë armiqëve të tij dhe një burim ndihme për të gjitha nevojat e tij. Si gjithkush, krenohet me nderin dhe rangun e Prijësit të tij tek i cili është lidhur, krenohet me pozitën që e ka tek Ai. Po kështu ju mund ta krahasoni për veten tuaj se sa i kënaqur e mirënjohës, falënderues dhe plot krenari bëhet njeriu kur lidhet nëpërmjet besimit me një të Plotfuqishëm, Fuqia e të Cilit është e pafundme, dhe me një Monark Mëshirëplotë. Duke hyrë në shërbim të Tij nëpërmjet adhurimit me bindje e mirënjohje e transformon exhelin dhe vdekjen për vetveten nga një ekzekutim i përjetshëm me varje në një biletë kalimi dhe në një leje për tek Bota e qëndrueshme."**

Dhe ashtu siç u thashë vëllezërve të mi studentë, po ashtu u them të burgosurve të goditur nga fatkeqësia: ***"Ai që e njeh Krijuesin dhe që i bindet Atij është fatmadh edhe në qoftë se ai është në burg. Ndërsa ai që e harron Atë është i mjerë dhe i burgosur edhe në qoftë se jeton në një pallat."*** Madje, një njeri i shtypur, por fatmadh u tha tiranëve të mjerë të cilët po e ekzekutonin: *"Unë nuk po ekzekutohem, por po lirohem dhe po shkoj në lumturi. Veçse ama unë shoh se ju po dënoheni me ekzekutim të përjetshëm, dhe kështu unë po marr hak plotësisht mbi ju."*

Dhe duke thënë: لَآ إِلَٰهَ إِلَّا ٱللَّهُ *"Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut!"*, ai me lumturi dha shpirtin e tij.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."[117]

* * *

[117] Kur'an, 2: 32

ÇËSHTJA E SHTATË

[Një frut që u poq në një ditë të premte prej ditëve të burgut të Denizlit.]

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe çështja e Orës (çasti i fundit) është sa një "hap e mbyll sytë ose edhe më afër."[118]

"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm."[119]

"Shihni pra te pasojat e Mëshirës së Allahut, se si Ai ringjall tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht që (Allahu, i Cili siç ringjalli tokën pas vdekjes së saj) do të ngrejë me siguri të vdekurit (ditën e ringjalljes) dhe Ai është i Gjithëfuqishmi për të gjitha gjërat."[120]

Të burgosurit e burgut të Denizlit që kishin mundësi të merrnin kontakt me mua, e lexuan mësimin në çështjen e gjashtë që u përmend më parë të cilin e pata dhënë një herë me gjuhën e shkencave shkollore për studentët e shkollës së mesme në Kastamonu, të cilët patën ardhur tek unë dhe më kërkuan duke më thënë: "Na trego neve rreth Krijuesit tonë", dhe duke pasë fituar një besim të qëndrueshëm dhe të fortë, ata ndjenë një dëshirë të zjarrtë për Ahiretin. Ata përsëri kërkuan duke më thënë: Na mëso ne gjithashtu rreth Ahiretit me qëllim që të mos çudhëzohemi nga nefset tonë urdhërues për të liga dhe nga shejtanët e

---

[118] Kuran, 16:77
[119] Kuran, 31:28
[120] Kuran, 30:50

kësaj kohe, dhe me qëllim që ato të mos jenë përsëri shkaku për futjen tonë në burg. Kështu duke zbritur tek kërkesa e këtyre, dhe për t'i ardhur në ndihmë nevojës së studentëve të Risale-i Nurit në burgun e Denizlit dhe për dëshirën e madhe të atyre që e lexuan çështjen e gjashtë, unë e pashë si domosdoshmëri për mua që të bëj një shpjegim të përmbledhur për shtyllën e besimit në Ahiretin, si dhe që t'u jap atyre një përmbledhje të shkurtuar të pjesëve të ndryshme nga Risale-i Nuri.

Ashtu siç pyetëm në "çështjen e gjashtë" tokën dhe qiejt për Krijuesin tonë xh.sh. dhe ato na u përgjigjën me gjuhën e shkencave të cilat na e bënë të njohur Krijuesin tonë Gjithëbujar në mënyrë aq të qartë si qartësia e diellit, po ashtu ne do të pyesim së pari Krijuesin tonë rreth të cilit ne kemi mësuar, lidhur me Ahiretin, pastaj do të pyesim profetin tonë më të madh a.s.m., pastaj profetët e tjerë, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, dhe librat e shenjtë, pastaj melekët dhe pastaj universin. Në këtë shkallën e parë, ne e pyesim Allahun rreth Ahiretit. Ai na përgjigjet neve nëpërmjet të gjithë profetëve që Ai ka dërguar, nëpërmjet të gjitha dekreteve të Tij dhe nëpërmjet të gjithë Emrave të bukur dhe Atributeve të Tij madhështorë duke na thënë: "Po, Ahireti ekziston, dhe Unë do t'ju dërgoj juve atje". Por meqenëse 'Fjala e Dhjetë' e ka provuar Ahiretin me dymbëdhjetë të vërteta të ndritshme e vendimtare dhe e ka sqaruar atë nëpërmjet treguesit të disa Emrave të bukur Hyjnorë, ne këtu do të aludojmë në mënyrë të përmbledhur për ato tregues, duke i vlerësuar si të mjaftueshme ato shpjegime.

Po, nuk mund të ndodhet ndonjë Sulltan madhështor apo ndonjë sovranitet që nuk i shpërblen ata që i binden dhe që nuk ndëshkon rebelët. Atëherë nuk ka dyshim se Sulltani i Përjetshëm -i Cili është në shkallën e Hyjnisë absolute- i shpërblen ata që formojnë lidhje me Të nëpërmjet besimit dhe të cilët u nënshtrohen me bindje dekreteve të Tij; dhe i ndëshkon ata të cilët mohojnë madhështinë dhe krenarinë e Tij nëpërmjet mohimit dhe mosbindjes. Dhe nuk ka dyshim se ai shpërblim do të jetë në përshtatshmëri me mëshirën dhe me bukurinë e Tij; dhe ai ndëshkim duhet të jetë në përshtatshmëri me krenarinë dhe madhështinë e Tij. Kështu, Emrat Hyjnorë ***Es-Sultanu Ed-Dejan,*** *Sulltani i Drejtë* dhe ***Rabbul-A'lemine,*** *Zoti i të gjitha botëve* u përgjigjen pyetjeve tona rreth Ahiretit.

Gjthashtu, ne shohim me sytë tonë me një shikim të qartë si qartësia e diellit një mëshirë të përgjithshme dhe një dhembshuri gjithëpërfshirëse dhe një bujari të plotë të gjithanshme mbi faqen e

tokës. Për shembull, në çdo pranverë ajo mëshirë i stolis të gjitha pemët frutdhënëse dhe bimët, dhe u vesh atyre rroba të blerta sikur të ishin huritë e Xhennetit; ajo u jep duarve të tyre lloje të ndryshme nga të gjitha frutat, dhe ato na i ofrojnë neve duke na thënë: "Urdhëroni, merrni vetë e hani...!". Ti i shikon ato të na japin për të ngrënë mjalt të shijshëm e shërues nëpërmjet duarve të një insekti helmues -nga bleta! Dhe na vesh me mëndafshin e butë të cilin e end një insekt i paduar! Ajo depoziton për ne në një grusht prej farërave të vockëla dhe prej kokrrave me qindra tonelata ushqimi dhe i transformon ato në thesare e furnizime rezervë për ne. Atëherë Ai që zotëron këtë mëshirë të gjërë, këtë dhembshuri të përgjithshme dhe këtë bujari të gjithanshme të plotë, sigurisht nuk do t'i ekzekutojë dhe nuk do t'i asgjësojë shërbëtorët e Tij besimtarë e të dashur për Të, ata të cilët Ai i ushqeu, i zhvilloi, u dha mirësi dhe i nderoi deri në këtë shkallë mirëbërësie, butësie dhe përkujdesjeje. Përkundrazi Ai do t'i shkarkojë ata nga detyrat e tyre në jetën e dynjasë me qëllim që t'i përgatisë ata për shembuj më të ndritshëm e më të mëdhaja mëshire. Dhe duke vepruar në këtë mënyrë, Emrat e bukur Hyjnorë: ***Er-Rahman****, i Gjithëmëshirshmi* dhe ***El-Kerim,*** *Gjithëbujari* i përgjigjen pyetjes sonë rreth Ahiretit duke na thënë: "Xhenneti është një realitet".

Gjithashtu ne shohim para syve tonë se një Dorë urtësie vepron në të gjitha krijesat në faqen e tokës dhe se një drejtësi është në fuqi me masat e saj. Ato të dyja janë aq të holla e të ndritshme saqë mendja njerëzore nuk mund të përfytyrojë më të mira e më të larta se ato.. Ti shikon se urtësia e parapërjetshme i ka dhuruar njeriut një fuqi memorie -e cila është aq e vogël sa një farë sinapi- dhe shkroi në atë aftësi të kujtesës të gjithë historinë e jetës së tij dhe ngjarje të panumërta që do ta prekin atë sikur ajo të ishte një librari shumë e zvogëluar; ajo urtësi e vendosi atë në një qoshe të trurit të tij; me qëllim që t'ia kujtojë gjithmonë atij ditën e llogarisë, Ditën e Tubimit të madh, në të cilën do të botohen fletët e veprave, si një regjistër. Dhe ti shikon se drejtësia absolute e vendos çdo gjymtyrë të qënies së gjallë në vendin e saj të përshtatshëm; dhe e vendos atë në sistem me balancën më të hollë -duke filluar nga mikrobi për tek hundëbriri, nga bletët tek shqiponjat dhe nga një lule e bukur për tek pranvera e lulëzuar, e cila çel me miliona lule në pranverë.. ti shikon se ajo i jep çdo anëtari një përpjesëtim të ndërsjellë, ekuilibër, rregull dhe bukuri; që të gjitha këto brenda një bukurie të lulëzuar dhe një hijeshie të ndritshme, saqë krijesat janë bërë si modele të mishëruara të bukurisë, të artit dhe të balancimit pa asgjë të kotë; ajo ua jep të gjitha qënieve të gjalla të drejtat e tyre të jetës me balancë të plotë, dhe i bën gjërat e

mira të prodhojnë rezultate të mira, dhe gjërat e këqija të prodhojnë rezultate të këqija; dhe qysh nga koha e Ademit a.s. ajo ka bërë që të ndjehet forca dhe përhershmëria e saj nëpërmjet goditjeve shkatëruese që ajo u ka dhënë njerëzve rebelë e tiranë. Sigurisht dhe padyshim, ashtu siç nuk mund të jetë dielli pa dritë, po ashtu urtësia e parapërjetshme dhe drejtësia e përhershme nuk mund të realizohen plotësisht veçse me një jetë tjetër të amshuar. Prandaj Emrat e bukur Hyjnorë ***El-Hakimu,*** *i Gjithurti*, ***El- Hakemu,*** *i Dituri*, ***El-Adlu,****i Drejti,* nuk do ta lejonin kurrë padrejtësinë e tmerrshme, pabarazinë dhe paurtësinë që të shtypurit dhe shtypësit të jenë të barabartë në vdekje; atëherë duhet medoemos që të jetë një jetë tjetër pas vdekjes me qëllim që urtësia dhe drejtësia të përmbushin realitetin e tyre. Dhe kështu ato Emra të bukur Hyjnorë i përgjigjen në mënyrë vendimtare pyetjes sonë rreth Ahiretit.

Gjithashtu ne shohim se çdo qënieje të gjallë i sigurohen nevojat të cilat janë përtej fuqisë së saj për t'i arritur dhe i përmbushen të gjitha kërkesat që ajo i kërkon -nëpërmjet një lloji duaje- qoftë nëpërmjet gjuhës së nevojave të saja të domosdoshme ose nëpërmjet gjuhës së aftësive të saja të natyrshme, dhe i jepen asaj në kohën më të përshtatshme dhe më të mirë prej një Dore të Mëshirëplotit, mëshira e të Cilit është gjithëpërfshirëse, dhe prej një Gjithëdëgjuesi dëgjimi i të Cilit është Absolut dhe prej një të Dhembshuri dhembshuria e të Cilit është e gjithanshme... Gjithashtu gjejnë përgjigje të gjitha duatë e njeriut të cilat janë të vullnetshme, dhe sidomos duatë e të zgjedhurve, të pastërtive midis njerëzimit, dhe veçanërisht duatë e profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, që shumica e atyre duave pranohen në mënyrë të jashtëzakonshme -dhe ato përgjigjje na bëjnë ne të kuptojmë me siguri se prapa perdes është një Gjithëdëgjues dhe Gjithëpërgjigjës i Cili dëgjon ofshamat e atyre që vuajnë dhe duatë e nevojtarëve, dhe u përgjigjet atyre; Ai dëgjon duanë e çdo nevojtari dhe shikon nevojën më të vogël të krijesës më të vogël dhe dëgjon rënkimin e qënies më të dobët duke e përfshirë atë me Dhembshurinë e Tij dhe, duke iu përgjigjur me veprim, e kënaq atë.. Meqenëse çështja është kështu, atëherë duaja për lumturi të përjetshme, për qëndrueshmëri dhe për përjetësi - e cila është duaja më e mirë, më e përgjithshmja, dhe që prek të gjitha qëniet dhe që lidhet me të gjitha Emrat e bukur Hyjnorë dhe me të gjithë Atributet Madhështorë -këtë dua e bën më i miri i krijesave që është njeriu- dhe e përmban atë brenda duave të tij më i madhi i shërbëtorëve dhe më i dashuri i tyre tek Ai, ai profet i nderuar i cili është imami i pejgamberëve, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta të cilët janë diejt e njerëzimit dhe

eksploruesit e tij të cilët i thonë *Amin* kësaj duaje të tij; madje çdo besimtar i Ummetit të tij i thotë *Amin* duasë së tij nëpërmjet salevateve të bëra disa herë në çdo ditë mbi të; madje marrin pjesë të gjitha krijesat në duanë e tij duke thënë: "O Zoti ynë! Përgjigjju duasë së tij! Jepe atë çfarë ai kërkon! Edhe ne gjithashtu dëshirojmë atë çfarë kërkon Ai!" -Atëherë prej të gjitha shkaqeve të panumërta të cilat bëjnë të domosdoshme ringjalljen brenda këtyre kushteve të parefuzueshme, nuk ka dyshim se një dua e vetme e profetit Muhammed a.s.m. për përjetshmëri në Ahiret dhe për lumturi të përhershme do të kishte qenë një arsye e mjaftueshme për ekzistencën e Parajsës dhe për krijimin e Ahiretit, të cilat janë aq të lehta për Fuqinë Hyjnore sa krijimi i pranverës. Dhe kështu Emrat e bukur Hyjnorë ***El-Muxhibu, Es-Semiu*** dhe ***Er-Rahimu,*** *Përgjigjësi i lutjes, Gjithëdëgjuesi* dhe *Mëshirëploti* i përgjigjen pyetjes sonë rreth Ahiretit.

Gjithashtu, dukuritë e vdekjes, vdekja universale dhe skenat e ringjalljes në ndryshimin e stinëve në të gjithë tokën tregojnë qartazi -ashtu siç tregon dita për diellin- se prapa perdes është një Krijues i vetëm i Cili e administron globin madhështor të tokës me rregullsinë më të skajshme dhe me një lehtësi të skajshme -ashtu sikur të administronte një kopësht të vogël, madje sikur të administronte një pemë të vetme me rregullin e saj- dhe e administron pranverën e madhe dhe e stolis atë me aq lehtësi si të administronte një lule të vetme dhe me stolisjen e saj simetrike; dhe shkruan në faqen e tokës treqind mijë prej llojeve të bimëve dhe të kafshëve sikur këto të ishin treqind mijë libra duke shfaqur treqind mijë modele të Ringjalljes dhe shembujt e Tubimit të Madh. Ky Krijues i Gjithëfuqishëm i Cili i shkruan këto modele të përziera e të ndërfutura njëri brenda tjetrit pa çrregullim dhe pa pështjellim, pa harresë, pa gabim, në mënyrë të përkryer, të rregullt e plot kuptim, pavarësisht se të gjitha i ngjasojnë njëra-tjetrës, janë të ndërthurura e të pleksura me njëra-tjetrën -ky Krijues- shfaq brenda lavdisë së madhështisë një fuqi vepruese me një mëshirë të pakufishme dhe me një urtësi të pafundme. Krijuesi xh.sh. me këtë Mëshirën dhe me Urtësinë e Tij e përfshin ekzistencën dhe i jep njeriut një pozitë më të lartë; ka nënshtruar për të universin madhështor duke e bërë si shtëpi e si djep për të; pastaj e ngriti atë në rangun e kalifit në tokë dhe e ngarkoi atë duke i besuar amanetin më të madh të cilën e refuzuan qiejt, toka dhe malet për ta mbajtur; dhe e preferoi atë mbi të gjitha krijesat e tjera; e nderoi atë me bisedimin Hyjnor dhe me adresimin Hyjnor, dhe e bëri si një oficer urdhërues mbi qëniet e tjera të gjalla; dhe meqenëse Ai i ka dhuruar kështu

njeriut këtë stacion të lartë, dhe në të gjithë Librat e Tij të shpallur Hyjnorë i ka premtuar atij lumturi të përjetshme dhe jetë të pavdekshme në Ahiret, atëherë sigurisht e padyshim Ai do t'i hapë për të dyert e një lumturie të përjetshme dhe do ta shkaktojë kijametin dhe ringjalljen e të vdekurve, gjë e cila është më e lehtë për fuqinë e Tij se sa pranvera.

Dhe me këtë Emrat e bukur Hyjnorë ***El-Muhji, El-Mumitu, El-Hajju, El-Kajjumu, El-Kadiru*** dhe ***El-Alimu,*** *Jetëdhënësi, Shkaktuesi i vdekjes, i Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm, i Gjithëfuqishmi dhe i Gjithëdituri,* i përgjigjen pyetjes sonë rreth Ahiretit.

Po, me të vërtetë, fuqia Hyjnore e cila i ringjall rrënjët e të gjitha pemëve dhe të bimëve në çdo pranverë dhe që krijon modelet e treqind mijë llojeve të ringjalljes së të vdekurve në të gjitha kafshët dhe bimët, madje shfaq një mijë shembuj të ringjalljes dhe një mijë tregues për të në dy mijë pranvera[121] nëse dikush do ta shikonte me imagjinatë periudhën njëmijëvjeçare të secilit prej komuniteteve të Musait a.s. dhe të Muhammedit a.s.m. që ata i kaluan e të konsideroheshin së bashku! Si mund të konsiderohet e vështirë apo e pagjasë për këtë fuqi absolute që t'i ringjallë trupat dhe ringjalljen trupore? A nuk do të ishte një mijë herë verbim e paarsyeshmëri ta konsideroje atë të pagjasë apo të vështirë?

Pastaj, njëqind e njëzet e katër mijë profetë a.s., të cilët janë më të shquarit e njerëzimit, kanë njoftuar lumturinë e përjetshme dhe përjetshmërinë e Ahiretit me unanimitet dhe duke u mbështetur në mijëra premtime të Zotit të Gjithëfuqishëm; dhe e kanë provuar vërtetësinë e tyre nëpërmjet mrekullive të tyre të ndritshme; gjithashtu, njerëz të panumërt të shenjtërisë, Evlijatë e drejtë e kanë mbështetur të njëjtën vërtetësi nëpërmjet ndriçimeve dhe zbulesave të tyre. Meqenëse kjo është kështu, sigurisht kjo e vërtetë është aq e qartë sa dielli, dhe ata që kanë dyshim për këtë janë të çmendur.

Po, idetë dhe gjykimet e një ose dy ekspertëve në një shkencë apo art lidhur me shkencën e tyre i hedhin poshtë idetë kundërshtuese të dhjetë burrave të cilët nuk janë ekspertë në atë shkencë apo në atë art, madje edhe në qoftë se këta dhjetë burra do të ishin ekspertë në fushat e tjera. E ngjashme me këtë, dy njerëz duke bërë një pohim pozitiv rreth një subjekti, për shembull duke provuar hënën e re të Ramazanit

[121] Çdo pranverë e ardhshme është si ringjallja për pranverën e kaluar për të cilën ndodhi kijameti dhe mbaroi jeta e saj. Autori

në ditën e dyshimit, ose duke pretenduar se ndodhet një kopësht në tokë në të cilin arrat e kokut u ngjasojnë kutiave të qumështit, dhe e fitojnë çështjen. Sepse njëri duke bërë një pohim pozitiv duhet vetëm ta tregojë vendin ku gjenden arrat e kokut ose të shfaqë një arrë të tillë, dhe kështu e fiton çështjen me lehtësi. Ndërsa mohuesi i cili mohon ekzistencën e atij kopshti nuk mund ta provojë çështjen e tij veçse në qoftë se do të udhëtonte e kërkonte në të gjitha anët e botës dhe ta kërkonte pretendimin e tij në të gjitha vendet. Kështu ai që njofton për xhennetin, për banesën e lumturisë, dhe për përjetshmërinë, i provon ato dhe e fiton çështjen thjesht duke shfaqur një shenjë, ose një aluzion ose një hije prej hijeve të tij nëpërmjet ndriçimit, kurse ata që e mohojnë ekzistencën e xhennetit, do të mund ta fitonin çështjen duke provuar mohimin e tyre vetëm duke e parë të gjithë universin dhe të gjithë kohën nga parapërjetësia për tek paspërjetësia dhe duke i demonstruar ato. Për shkak të kësaj urtësie, dijetarët e vërtetë verifikues kanë rënë dakord mbi një parim themelor i cili është: "Nuk mund të provohet mohimi vendi i të cilit është i papërcaktuar -ashtu si të vërtetat e besimit që përfshijnë të gjithë universin- në qoftë se çështja nuk është e pamundur në vetvete, në esencë.

Si rrjedhojë e kësaj të vërtete të sigurt, ndërsa idetë kundërshtuese të mijëra filozofëve nuk duhet të hedhim as dyshimin dhe as iluzionin më të vogël, mbi një njoftues të vërtetë, mbi një raportim të vërtetë lidhur me çështjen e besimit, ju mund të kuptoni se çfarë çmendurie do të ishte të biesh në dyshim për thjesht mohimin e një grushti filozofësh materialistë mendjet e të cilëve kanë rënë tek sytë e tyre dhe nuk shikojnë veçse materien; madje kanë vdekur zemrat e tyre dhe nuk i ndjejnë çështjet shpirtërore; ndërsa mbi ato parime kanë rënë dakord njëqind e njëzet e katër mijë shkollarë ekspertë dhe njoftues të vërtetë prej profetëve të vërtetë -paqa qoftë mbi ta- me pohimet e tyre pozitive, si dhe specialistë të panumërt në fushën e realitetit dhe dietarët hetues.

Gjithashtu, ne shohim, si në vetet tona ose në atë që është përreth nesh një mëshirë gjithëpërfshirëse, një urtësi të gjithanëshme dhe një përkujdesje të vazhdueshme mirësie duke përhapur -shpërndarë- dritën e tyre si dita. Gjithashtu ne shohim shenjat e një Hyjnie madhështore dhe dritat e një drejtësie të saktë e të lartë dhe manifestimet e një administrimi krenar e të lavdishëm. Madje ne shohim një 'urtësi' e cila i jep, i bashkangjit pemës aq shumë urtësi sa numri i luleve dhe i frutave të saj; dhe shohim një 'mëshirë' e cila i jep çdo njeriu mirësi e dhurata sa numri i gjymtyrëve, i aftësive dhe i ndjenjave të tij. Ne shohim një 'drejtësi' krenare, dinjitoze e cila u jep goditje njerëzve të

pabindur e rebelë si shembulli i popujve të Nuhut, Hudit dhe Salihut, dhe popujve të Adit, Themudit dhe Faraonit; dhe megjithatë -ajo drejtësi- është e këndshme pasi merr në mbrojtje edhe të drejtat e krijesës më të vogël dhe më të dobët; dhe vërseti vijues,

"Dhe nga Treguesit e Tij është se qielli dhe toka qëndrojnë me urdhërin e Tij dhe më pas, kur Ai t'ju thërrasë ju me një thirrje kur ç'të shohesh! Ju do të dilni nga toka (nga varret tuaj për llogari e shpërblim),"[122] e shpreh në mënyrë të mrekullueshme dhe të përmbledhur madhështinë e asaj Hyjnie të gjithëlavdishme dhe dinjitetin e saj absolut. Ashtu si me thirrjen e komandantit të tyre dhe me zërin e borisë, ushtarët e disiplinuar në dy kazerma nxitojnë -hidhen menjëherë- për të marrë armët dhe detyrat e tyre, po ashtu qiejt dhe toka që janë si dy kazerma të mirorganizuara, sapo t'u bëhet thirrja të vdekurve të cilët flenë në ato të dyja, nëpërmjet borisë së Israfilit a.s., ata menjëherë do t'i veshin uniformat e trupave të tyre dhe do të ngrihen në jetë -do të ringjallen.

Duke provuar dhe demonstruar këtë, është e njëjta situatë e shfaqur nga qëniet në kazermat e tokës në pranverë nëpërmjet rënies së borisë nga engjëlli i rrufesë, dhe nga kjo kuptohet madhështia e pafundme e sovranitetit të Hyjnisë. Duke u mbështetur mbi verifikimet e mëparshme, dimensionet dhe qëllimet e asaj mëshire, urtësie, përkujdesjeje, drejtësie dhe të atij sovraniteti të përhershëm, do të realizohen në një botë tjetër; domethënë ato e kërkojnë medoemos ringjalljen, ashtu siç e ka vërtetuar Fjala e Dhjetë; prandaj nuk ka dyshim për ardhjen e Ahiretit. Madje mosardhja e tij është e pamundur në një mijë pamundësi; sepse mosardhja e tij do të kishte kuptimin që ajo mëshirë pafundësisht e bukur të transformohej në një mizori të shëmtuar; që ai plotësim i pakufishëm urtësie të kthehej në një kotësi pafundësisht e mangët dhe në një harxhim të tepërt të paqëllim; që ajo përkujdesje pafundësisht e ëmbël dhe e këndshme të transformohej në një tradhti të shëmtuar e të hidhur; që ajo drejtësi e saktë e mirëbalancuar dhe e drejtë të kthehej në një tirani të ashpër e mizore; dhe që ai sovranitet i përjetshëm madhështor dhe tërësisht i plotëfuqishëm të binte -të rrëzohej; domethënë ta akuzoje plotësinë e Hyjnisë për pafuqi, paaftësi e mangësi... kjo do të ishte krejtësisht e paarsyeshme dhe një pamundësi e shumëfishtë jashtë limiteve të mundësisë, e pasaktë dhe e papranueshme; sepse të gjithë ata që kanë vetëdije -inteligjencë- e dinë së All-llahu xh.sh. e krijoi këtë njeri në formën më të bukur, në modelin më të përsosur, e zhvilloi në mënyrën më të mirë dhe e pajisi me gjymtyrë, organe dhe me aftësi të holla -si

[122] Kuran 30: 25

mendja dhe zemra- me të cilat përmallohet dhe aspiron për lumturinë e përjetshme dhe për jetën e amshuar në Ahiret, dhe ato e shtyjnë drejt tyre. Gjithashtu ata kuptojnë se sa padrejtësi e mizori do të ishte në qoftë se fundi i këtij njeriu të nderuar do të ishte mosqënia e përjetshme! Gjithashtu ata do ta kuptonin se sa në kundërshtim me urtësinë do të ishte mosringjallja, duke i bërë të gjitha gjymtyrët dhe aftësitë e tij të natyrshme -të cilat kanë mijëra qëllime e dobi- pa rezultat, pa dobi, pa qëllim dhe pa vlerë në një kohë që Krijuesi i Gjithëlavdishëm ka vendosur qindra urtësi e dobi vetëm në tru! Gjithashtu ata do ta kuptonin pafuqinë e jashtme dhe injorancën e plotëqë janë në kundërshtim të plotë me madhështinë e atij Sovraniteti dhe me plotësinë Hyjnore se, sa në kundërshtim me urtësinë do të ishte mospërmbushja e mijëra premtimeve të Tij! Ruajna Zot! Jo, kurrë nuk mund të ndodhë kjo! Ti mund të bësh analogji me këto edhe për 'përkujdesjen' dhe për 'drejtësinë'.

Dhe kështu Emrat e Zotit xh.sh ***Er-Rahman,*** *i Gjithmëshirshmi,* ***El-Hakim,*** *i Gjithurti,* ***El-Adil,*** *i Drejti,* ***El-Kerim,*** *Gjithëbujari* dhe ***El-Hakim,*** *Sunduesi,* prej Emrave të bukur Hynorë i përgjigjen nëpërmjet të vërtetave të lartëpërmendura pyetjes sonë me të cilën ne e pyetëm Krijuesin tonë rreth Ahiretit, dhe ato e provojnë atë në mënyrë të sigurt, të padyshimtë, madje në mënyrë aq të qartë si qartësia e diellit.

Për më tepër, ne vëzhgojmë me sytë tonë një 'ruajtje' gjithëpërfshirëse, e cila sundon mbi çdo gjë të gjallë, dominon mbi çdo ngjarje, ruan format e saj të shumta, regjistron punët dhe detyrat e saj të natyrshme, shënon tesbihatet që ajo i kryen -me gjuhën e gjendjes së saj të natyrshme- ndaj emrave Hynorë... i shënon ato në pllakat e botës së shëmbëllesës, në farërat e saj, në bërthamat dhe në aftësinë e kujtesës, -të cilat janë shembuj e modele të zvogëluara të ***'Lehul El-Mahfudhit',*** dhe sidomos në kujtesën e njeriut e cila është si një bibliotekë shumë e zvogluar e vendosur në trurin e tij, por në të njëjtën kohë ajo është shumë e madhe; gjithashtu i regjistron ato edhe në pasqyra të tjera lëndore dhe jolëndore, dhe në gjëra të tjera të cilat ato reflektohen. Me të ardhur pranvera -ajo lule e mishëruar e fuqisë Hynore- Atributi 'Ruajtës' na i shfaq ato shkrime jolëndore në formë fizike të dukshme të shikuar dhe shfaq në atë lule më të madhe realitetin e ringjalljes që e përmban dhe e shpreh vërseti Kuranor,

"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen"[123]*;* dhe e shpall atë me gjuhët e miliona e miliona treguesve

[123] Kuran, 81:10

dhe shembujve, dhe provon për ne në mënyrë të sigurt e me forcën më bindëse se të gjitha gjërat -dhe sidomos gjallesat- nuk u krijuan që të përfundojnë për në asgjësi, as që të bien në mosekzistencë, as që të asgjësohen -dhe veçanërisht njeriu- përkundrazi, ata u krijuan për të fituar pavdekshmëri nëpërmjet përparimit, për t'u futur nëpërmjet pastrimit të nefseve të tyre në botën e jetës së amshuar, dhe për të hyrë nëpërmjet kapaciteteve të tyre të bashkëlindura në një detyrë të përjetshme e cila i pret ata në banesën e përjetshmërisë. Po, të gjitha pemët, rrënjët, farërat dhe bërthamat e të gjitha bimëve të panumërta që vdiqën në kijametin e vjeshtës, sapo të vijë ringjallja e pranverës ato recitojnë vërsetin, *"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen"*, nëpërmjet gjuhës së tyre të veçantë dhe shprehin njërin prej kuptimeve të tij me shembujt e detyrave të bashkëlindura që ato kanë kryer në vitet e kaluara, dhe në të njëjtën kohë ato shfaqin madhështinë e 'Ruajtjes' në shtrirjen më të gjërë ashtu siç e përmban vërseti, *"Ai është i Pari që s'ka fillim dhe i Fundit që s'ka mbarim, i Dukshmi dhe i Padukshmi"*[124] dhe na udhëzojnë ne për tek katër të vërteta madhështore në çdo gjë dhe japin prova vendimtare për sigurinë e ringjalljes ashtu si siguria e ardhjes së pranverës dhe po me aq lehtësi.

Po, dritat e këtyre katër Emrave të bukur Hyjnorë dhe manifestimet e tyre ndodhin në të gjitha gjërat nga më e vogla e të pjesshmes për tek më e madhja e universales. Për shembull, nëpërmjet manifestimit të Emrit Hyjnor ***El-Ev-Velu,*** *i Pari që s'ka fillim* një farë -e cila është origjina e pemës- është një program i saktë, i hollë dhe i plotë i pemës dhe një enë e vogël që përmban sistemet e patëmeta të krijimit të saj dhe të gjitha kushtet e formimit të saj duke provuar kështu madhështinë e "*Ruajtjes Hyjnore*".

Atëherë, së bashku me farërat e pemës, frutat e saj manifestojnë Emrin Hyjnor ***El-Ahiru,*** *i Fundit që s'ka mbarim*. Ata janë arka që përmbajnë indekset e të gjitha detyrave që i ka kryer pema në përputhje me natyrën e saj dhe ligjet e jetës së saj të dytë, duke dëshmuar kështu deri në nivelin më të lartë "*Ruajtjen Hyjnore*".

Forma fizike e pemës, e cila manifeston Emrin Hyjnor ***Edh-Dhahir,*** *i Dukshmi* është një mantel e një veshje, një çështje e dekoruar artistikisht dhe e zbukuruar dhe e stolisur me motive të praruara, si të ishin veshjet me shtatëdhjetë ngjyra të larmishme të Hurive të Xhennetit. Kjo demonstron dukshëm madhështinë e fuqisë,

[124] Kuran,57:3

plotësinë e urtësisë dhe bukurinë e mëshirës brenda "*Ruajtjes Absolute Hyjnore*".

Sa për makinerinë brenda asaj peme, e cila manifeston emrin Hyjnor ***El-Batin,*** *i Padukshmi,* ajo është një uzinë e jashtëzakonshme me një sistem të përsosur, madje është një laborator i madh kimik, madje një depo për të furnizuar me ushqime e cila nuk lë pa ushqim asnjërën prej degëve të saj, prej frutav ose gjetheve duke provuar kështu në mënyrë aq të qartë si dielli fuqinë e plotë, drejtësinë, mëshirën e bukur dhe urtësinë brenda *Ruajtjes Hyjnore.*

Dhe ashtu siç shfaq secila nga farërat, frutat, ana e jashtme e pemës dhe ana e brendshme e saj manifestimet e katër Emrave të bukur Hyjnorë ***El-Ev-Vel, El-A'hir, Edh-Dhahir*** dhe ***El-Batin,*** edhe globi tokësor gjithashtu i shfaq ato dhe demonstron në mënyrë të vetëkuptueshme se Krijuesi, Gjithëruajtësi i Gjithëlavdishëm e Gjithëbujar vepron me një fuqi Absolute, me drejtësi, me urtësi dhe me mëshirë; sepse globi tokësor është si një pemë për sa ka të bëjë me ndryshimin e stinëve vjetore. Nëpërmjet manifestimit të Emrit Hyjnor ***El-Ev-Vel,*** *i Pari që s'ka fillim,* të gjitha farërat dhe kokrrat që iu lanë në amanet në vjeshtë *Ruajtjes Hyjnore,* dërgojnë, lëshojnë sythe, rrënjë e degë të pallogaritshme, i mbështesin ato në të gjitha drejtimet, dhe çelin lule të bukura dhe fruta të mirë të pallogaritshëm dhe e veshin tokën me mantelin e zbukuruar të pranverës. Ato farëra dhe bërthama janë listat e parimeve që burojnë nga Kaderi Hyjnor, janë fletët e vogëla të punëve të pemës së verës së kaluar, janë koleksione të zvogëluar në të cilët janë shkruar urdhërat Hyjnorë; madje të gjitha ato farëra e bërthama përfshijnë gjithçka që lidhet me formimin e pemës madhështore të tokës.

Pastaj fundi i pemës vjetore të tokës është -në vjeshtën e dytë- depozitimi i saj në ato enë shumë të vockëla të gjitha detyrat që pema i ka kryer në vjeshtë, të gjitha tesbihatet, lavdërimet dhe dhikrin që ajo i ka recituar përpara Emrave Hyjnorë në përputhje me krijimin e saj, dhe të gjitha fletët e punëve të saj të cilat ajo do t'i botojë në ringjalljen e pranverës së ardhshme. Të gjitha këto ia dorëzon Dorës së urtësisë së të Gjithëruajtësit të Gjithëlavdishëm dhe duke recituar Emrin e All-llahut ***El-A'hir*** përpara universit me gjuhë të panumërta.

Ndërsa faqja e dukshme e pemës është hapja e saj treqind mijë lloje universale lulesh, të cilat demonstrojnë treqind mijë shembuj dhe shenja të ringjalljes së të vdekurve; dhe është përhapja e saj ato tryeza të shtruara të të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë dhe të Gjithëfurnizuesit Gjithëbujar; është dhënia e banketeve të saj për të

gjitha qëniet e gjalla. Gjithçka që ndodhet në anën e dukshme të asaj peme përmend dhe reciton Emrin Hyjnor ***Edh-Dhahir*** me gjuhët e frutave të saj, të luleve, të ushqimeve dhe të shijeve duke shfaqur aq qartë e shndritshëm si dielli të vërtetën e *"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen".*[125]

Fytyra e brendshme e kësaj peme madhështore është një punishte dhe një uzinë e cila vë në lëvizje në mënyrë të saktë e të rregullt numra të pallogaritshëm makinerish të mirorganizuara dhe fabrikash të mirëbalancuara, të cilat gatuajnë e pjekin mijëra tonelata ushqime nga një peshë e vogël dhe ua japin ato të varfërve dhe të miturve. Ajo punon me një saktësi e balancë të tillë saqë nuk lë asnjë vend për ndërhyrjen e rastësisë. Ashtu si disa engjëj të cilët e lavdërojnë All-llahun me një mijë gjuhë, me fytyrën e brendshme të tokës ajo shpall Emrin Hyjnor ***El-Batin*** në njëqind mijë mënyra dhe e provon atë.

Ashtu si lidhur me jetën e saj vjetore, toka është si një pemë, dhe e shpjegon qartë *Ruajtjen Hynore* brenda atyre katër Emrave të bukur Hynorë, dhe e bën atë një çelës për derën e ringjalljes, po ashtu për sa ka të bëjë me jetën e saj të shekujve dhe të epokave, ajo përsëri është si një pemë e mirorganizuar, frutat e së cilës -për të gjithë shekujt dhe epokat dërgohen në tregun e Ahiretit. Kështu e gjithë toka bëhet si një pasqyrë shumë e madhe për manifestimet e atyre katër emrave Hyjnorë, dhe hap një rrugë aq të gjërë për Ahiretin saqë mendjet tona janë të paafta për ta kapur e përshkruar atë: Prandaj mjaftohemi me sa vijon dhe nuk themi më shumë:

Ashtu si akrepat e një ore javore të cilët numërojnë sekondat, minutët, orët dhe ditët që i ngjasojnë njëri-tjetrit, provojnë dhe tregojnë njëri-tjetrin, dhe ai që e sheh lëvizjen e akrepit të sekondave detyrohet të pranojë lëvizjen e të tjerëve; po ashtu ditët, të cilat numërojnë sekondat e kësaj dynjaje, është një orë e madhe e Krijuesit të Gjithëlavdishëm të qiejve dhe të tokës; dhe vitet që numërojnë minutat e saj, dhe shekujt që tregojnë orët e saj, dhe epokat që bëjnë të njohur ditët e saj; që të gjitha këto i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe tregojnë e provojnë njëra-tjetrën.

Nga ky këndvështrim ne e shohim tokën të na informojë ne nëpërmjet shenjave të saja të panumërta për ardhjen e një pranvere të përhershme dhe një mëngjesi të përjetshëm pas këtij dimri të errët të kësaj dynjaje të përkohshme.. ajo informon për këtë me sigurinë e ardhjes së mëngjesit të kësaj nate dhe me sigurinë e ardhjes së

[125] Kur'an 81:10

pranverës pas këtij dimri. Kështu Emri Hyjnor ***El-Hafidhu,*** *Gjithëruajtësi* së bashku me katër Emrat Hyjnorë -*i Pari, i Fundit, i Dukshmi* dhe *i Padukshmi*- i përgjigjen nëpërmjet të vërtetave të lartëpërmendura pyetjes sonë me të cilën ne e pyetëm Krijuesin tonë rreth ringjalljes.

Gjithashtu, meqenëse ne shohim me sytë tonë dhe kuptojmë se njeriu është fruti përfundimtar dhe gjithëpërfshirës i pemës së universit.. dhe për sa ka të bëjë me realitetin Muhammedan a.s.m., ai është bërthama e saj origjinale... ai është shenja më e madhe e Kuranit të Universit.. madje ai është vërseti, shenja mbajtëse e manifestimeve të Emrit më të madh në atë Kuran të Universit si *ajeti Kursi* në Kuranin e gjithurtë.. është mysafiri më i nderuar në pallatin e Universit.. është funksionari më aktiv i autorizuar për të vepruar mbi banorët e tjerë të pallatit.. është zyrtari, nëpunësi i ngarkuar për të shikuar të ardhurat dhe shpenzimet dhe për mbjelljen dhe kultivimin e kopshteve në lagjen e tokës në qytetin e universit... dhe është ministri i saj më i bujshëm dhe përgjegjësi i pajisur me qindra shkenca dhe mijëra arte.. dhe një inspektor kërkues në mbretërinë e tokës, i dërguar nga ana e Sulltanit të parapërjetshëm dhe të paspërjetshëm dhe një veprues nën vëzhgimin e Tij.. mbikqyrës në rajonin e tokës në vendin e universit, dhe ai që vepron me autoritet sipër saj aktet e të cilit, të pjesshme dhe universale, regjistrohen... është një shërbëtor universal, i ngarkuar me një adhurim të gjërë gjithëpërfshirës... është ai i cili ka marrë amanetin më të madh të cilit iu shmangën qiejt, toka dhe malet për ta mbajtur.. dhe para të cilit janë dy rrugë: në njërën nga ato ai është më i mjeri i qënieve të gjalla, dhe në tjetrën është më fatlumi, njëra është për fatkëqinjtë, dhe tjetra për fatlumët... është vendi i manifestimit të Emrit më të madh të Monarkut të universit dhe një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjithë Emrave të Tij... është i adresuari i veçantë i Tij, i synuari për adresimin Hyjnor, është ai që e kupton më mirë Fjalën Hyjnore... është më i nevojshmi i qënieve të gjalla të universit... është krijesa e gjallë e mjerë i cili ka dëshira, qëllime dhe dhimbje të pakufishme, ka armiq të panumërt dhe gjëra që e dëmtojnë atë pavarësisht varfërisë së tij të pafundme dhe pafuqisë së tij... ai është më i pasuri lidhur me aftësitë dhe potencialet - midis gjallesave... më i ndjeshmi dhe më i vuajturi lidhur me kënaqësitë e jetës, ku kënaqësitë e të cilit përzihen me dhimbje të tmerrshme.. është më i përmalluari për pavdekshmëri dhe më i nevojshmi për përjetësi, madje është më i denji për pavdekshmëri... ai lutet për hir të pavdekshmërisë dhe të përjetshmërisë me dua të pakufishme, edhe në qoftë se do t'i jepeshin kënaqësitë e të gjithë botës, dëshira e tij për pavdekshmëri

nuk do të ngopej -kënaqej-.. është ai që e do deri në shkallën e adhurimit Atë të cilin i ka dhuruar mirësi dhe e bën Atë të dashur tek të tjerët dhe gjithashtu është i dashur.. ai është mrekullia më e madhe e fuqisë së Krijuesit absolut, e të Kërkuarit përjetësisht, madje është çudia e krijimit, dhe të gjitha aftësitë e tij, të cilat përfshijnë universin, dëshmojnë se ai është krijuar për të shkuar në përjetësi.

Ky njeri, i cili lidhet nëpërmjet këtyre njëzet të vërtetave universale të lartëpërmendura me emrin Hynor ***El-Hak,*** *i Vërteti,* dhe i cili është i lidhur ngushtë me Emrin Hynor ***El-Hafidhu,*** *Gjithëruajtësi* të Cilit nuk mund t'i shmanget asgjë në qiell e në tokë, i Cili shikon nevojën më të papërfillshme të gjallesës më të vogël dhe dëgjon thirrjen e nevojës së saj dhe e ndihmon, dhe duke qenë të lidhura me të gjithë universin veprat e këtij njeriu regjistrohen nga shkruesit e Tij fisnikë.. Ky njeri -ashtu siç kërkohet nga njëzet të vërtetat e lartëpërmendura, me sigurinë më të madhe dhe pa asnjë dyshim do të ketë për të ringjallje dhe gjyq, dhe në përputhje me Emrin Hyjnor ***El-Hakk,*** *i Vërteti*, ai do të marrë shpërblim për shërbimet dhe veprat që ka paraqitur -kryer- dhe do të ndëshkohet për fajet e tij; dhe në përputhje me Emrin Hyjnor ***El-Hafidhu,*** *Gjithëruajtësi*, ai do të merret në pyetje dhe do t'i bëhet thirrja për të dhënë llogari për veprat e tij, të cilat qofshin të pjesshme apo universale që të gjitha janë regjistruar; dhe nuk ka dyshim se para tij do të hapen dyert e një lumturie të përjetshme dhe të një gostie të amshuar, ose dyert e burgjeve të tmerrshëm dhe të mjerimit të përjetshëm; njeriu i cili ka qenë një oficer me komandë mbi specie të shumta të qënieve në këtë botë, dhe që ka ndërhyrë në to dhe ndonjëherë i ka hedhur ato në rrëmujë, -ai njeri- nuk do të mund të hyjë në dhé pa u pyetur kurrë e pa dhënë llogari për veprat e tij, as nuk do mund të shkrihej në fshehtësi pa u ngritur; nuk mund të mos zgjohet prej gjumit të tij.

Sepse nuk mund të pranohet kurrë me arsye, që të dëgjohet një dua më e fshehur se sa zëzëllima e mizës dhe madje ajo në fakt ndihmohet me gjërat më të domosdoshme të jetës, dhe pastaj të mos dëgjohen duatë -lutjet- të cilat kanë fuqi që të trondisin Arshin, qiejt dhe tokën, të cilat nisen nga ato njëzet të vërteta të lartëpërmendura që bëjnë dua duke kërkuar qëndrueshmëri e përjetshmëri. Gjithashtu nuk do të arsyetohej kurrë me mend, madje do të ishte jashtë sferës së mundësisë që të merreshin nëpër këmbë, të shkileshin e të humbisnin krejtësisht ato të drejta të shumta; madje është e pamundur për shkak të mospasjes aspak kotësi në to -madje as sa krahu i një mize ashtu siç dëshmohet nga rregulli, sistemi dhe përsosmëria e saj- të harxhoheshin krejtësisht kot aftësitë e njeriut të cilat janë të lidhura me ato të vërteta,

dhe të shkatërroheshin kot të gjitha shpresat dhe dëshirat e tij të cilat shtrihen për në përjetësi, dhe të shkonin kot të gjitha ato lidhje dhe të vërtetat e shumta të universit të cilat i ushqejnë ato aftësi e dëshira, sepse kjo pamundësi do të ishte një padrejtësi e tillë e tmerrshme dhe një shëmti tiranike e tillë saqë të gjitha qëniet do ta refuzonin dhe do ta hidhnin poshtë duke thënë: Kjo është një pamundësi e njëqindfishtë dhe e papranueshme dhe e pamundur në mijëra aspekte; madje këtë e refuzojnë të gjitha qëniet të cilat dëshmojnë për Emrat e bukur Hyjnorë: ***El-Hak***, *i Vërteti*, ***El-Hafidhu,*** *Gjithëruajtësi****, El-Hakimu,*** *i Gjithurti****, El-Xhemilu,*** *i Gjithëbukuri, Hirploti* dhe ***Er-Rahimu,*** *Mëshirëploti*. Dhe kështu na përgjigjen këto Emra të bukur Hyjnorë ***El-Hak, El-Hafidhu, , El-Hakimu, El-Xhemilu*** dhe ***Er-Rahimu*** për pyetjen tonë rreth Ahiretit; dhe ato Emra na flasin duke na thënë: "Ashtu siç jemi ne të vërtetë dhe realitet, dhe të gjitha qëniet që dëshmojnë për ne janë të vërteta, po ashtu ringjallja e të vdekurve është e vërtetë dhe e sigurt.

Po të mos ishte çështja më e qartë se dielli, unë do të shkruaja më shumë, por e shkurtova duke u mjaftuar me shembujt e lartëpërmendur.

Kështu, duke bërë një analogji me çështjet në paragrafet e lartëpërmendur, Secili prej njëqind Emrave të bukur Hyjnorë, madje prej një mijë Emrave të cilët janë orientuar drejt universit e provojnë në mënyrë të vetëkuptueshme nëpërmjet manifestimeve të tyre dhe reflektimeve në qëniet Atë të Cilin ato tregojnë; po ashtu ato e demonstrojnë ringjalljen e të vdekurve dhe Ahiretin, duke i provuar ato në mënyrë të sigurtë.

Gjithashtu, ashtu si nëpërmjet të gjitha dekreteve të Tij në të gjitha shkrimet dhe librat që Ai ka shpallur dhe nëpërmjet të gjithë Emrave të Tij me të cilët Ai përshkruhet dhe ka emëruar Vetveten, Krijuesi ynë na jep ne përgjigje të shenjta e vendimtare për pyetjen me të cilën ne e pyetëm Atë rreth Ahiretit; po ashtu Krijuesi ynë xh.sh. na përgjigjet nëpërmjet gjuhëve të engjëjve të Tij dhe na e bën të njohur Ahiretin në një mënyrë tjetër, sepse melekët thonë:

"Ka pasur qindra ngjarje të sigurta të dëshmuara e të vërtetuara me unanimitet qysh nga koha e Ademit a.s. për takimin tuaj si me qëniet shpirtërore po ashtu edhe me ne; dhe ka shenja e dëshmi të panumërta për ekzistencën dhe për adhurimin tonë dhe për atë të qënieve shpirtërore. Në përputhje mendimi me njëri-tjetrin, ne u kemi thënë udhëheqësve -profetëve- tuaj kur jemi takuar me ta se ne udhëtojmë nëpër banesa të Ahiretit dhe përmes koridoreve të tyre, dhe ne

gjithmonë e themi atë që ne shohim gjatë udhëtimit. Ne ju japim sihariqe dhe nuk kemi asnjë dyshim se holle, sallone të bukur e të përjetshëm dhe pallate të stolisur të bukur dhe banesa me dekore përtej tyre janë bërë gati për të pritur mysafirë të nderuar të rëndësishëm dhe janë përgatitur për ardhjen e tyre. Ne ju japim lajme të sigurta për këtë". Dhe kështu përgjigjen melekët e nderuar rreth pyetjes sonë.

Pastaj Krijuesi ynë Gjithëbujar caktoi për ne mësuesin më të madh.. profesorin më të mirë... modelin më të vertetë dhe udhëzuesin më të drejtë... dhe Ai është Muhammed Hashimiu Arab a.s.m., paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të. Krijuesi e dërgoi atë si vulën e të gjithë profetëve a.s. si profetin e fundit. Atëherë, na duhet -para çdo gjëje- ta pyesim profesorin tonë lidhur me pyetjen që i bëmë Krijuesit tonë xh.sh. rreth Ahiretit me qëllim që të përparojmë e të ngjitemi në njohje nga shkalla e 'njohjes së sigurisë' për tek ato të 'shikimit të sigurisë' dhe të 'sigurisë absolute'; sepse ky profet i dashur i vertetë dhe i mbështetur nga ana e Krijuesit të Gjithëditur me një mijë mrekulli, ashtu siç është ai një mrekulli e Kuranit, i cili provoi për të gjithë botën se Kurani është Fjala e Zotit xh.sh., është libri i Krijuesit të të gjitha botëve, libër i cili nuk përmban asgjë të shtrembër, po ashtu nëpërmjet dyzet aspekteve të tij, Kurani provon se ai ishte i vërtetë dhe i dërguari i Zotit të të gjitha botëve.

Realiteti i Ringjalljes, të cilin ato dy mrekulli e provojnë -njëra gjuha e botës së dukshme, me të cilën është konfirmimi dhe vërtetimi i të gjithë pejgamberëve a.s. dhe i Evlijave, dhe tjetra është gjuha e botës së padukshme e cila përmban e përfshin të gjithë librat qiellorë dhe të gjitha të vërtetat e universit- është aq i sigurtë sa dielli në mesditë.

Ndërsa lidhur me pytjen se përse profetët e mëparshëm a.s. nuk e sqaruan çështjen e Ringjalljes për popujt e tyre ashtu siç e shpjegoi Kurani i gjithurtë? Arsya se pse profetët e mëparshëm nuk shpjeguan ringjalljen me hollësi ashtu si Kurani ishte se në atë kohë njerëzimi ishte në fazën e fëmijërisë së tij, në fazën primitive të nomadizmit. Dhe siç dihet, sqarimi është i përmbledhur, jo i detajuar në mësimet fillestare.

Përmledhja: Meqenëse shumica e Emrave të bukur Hynorë kërkojnë medoemos Ahiretin dhe tregojnë për të, në mënyrë indirekte, duhet medoemos që edhe provat dhe argumentet që tregojnë Emrat e bukur Hyjnorë me rolin e tyre të jenë dëshmi për vërtetimin dhe ndodhjen e Ahiretit.

Dhe meqenëse melekët njoftojnë lidhur me atë çfarë shohin prej banesave të Ahiretit dhe botën e përjetshmërisë, atëherë në mënyrë indirekte duhet medoemos që treguesit dëshmues për ekzistencën e melekëve, për botën e shpirtrave dhe për adhurimin e tyre, edhe ato me rolin e tyre janë tregues e dëshmi që vërtetojnë botën tjetër..

Dhe meqenëse pas unitetit Hynor, gjëja më e rëndësishme që profeti Muhamed a.s.m. pretendoi dhe vërtetoi gjatë jetës së tij ishte Ahireti, atëherë sigurisht të gjitha mrekullitë dhe provat e tij të cilat tregojnë profetësinë e tij dhe vërtetësinë e tij, në mënyrë indirekte dëshmojnë ekzistencën e Ahiretit dhe se ai do të vijë.

Dhe meqenëse një e katërta e Kur'anit është rreth ringjalljes dhe Ahiretit dhe i provon ato me mijra nga vërsetetet e tij dhe jep njoftime për to, atëherë medoemos të gjitha dëshmitë dhe provat të cilat tregojnë të vërtetat e Kuranit, në mënyrë indirekte provojnë ekzistencën e Ahiretit.

Tani shikoni se sa e rrënjosur thellë, sa e fortë dhe e sigurt është kjo shtyllë madhështore e besimit.

* * *

NJË PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJES SË TETË

[Në çështjen e shtatë, ne pyetëm disa nivele të qënieve rreth Ringjalljes së të vdekurve, por ne e shkurtuam diskutimin për shkak se përgjigjjet e dhëna nga Emrat e Bukur të Krijuesit na dhanë një siguri të tillë aq të fuqishme saqë nuk lanë më nevojë për pyetje të mëtejshme. Ndërsa në këtë çështje ne do ta përmbledhim njërën prej qindra frutave, dobive dhe rezultateve që i përmbush "Besimi në Ahiretin", duke përfshirë edhe ato që rezultojnë në lumturinë e njeriut si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën.

Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm nuk lë nevojë për shpjegim të mëtejshëm lidhur me lumturinë e Ahiretit, kështu ne ia referojmë subjektin Kuranit. Dhe duke ia lënë shpjegimet e lumturisë së kësaj bote Risale-i Nurit, ne këtu do të përshkruajmë në formë të përmbledhur tre ose katër prej qindra rezultateve të cilat i realizon "Besimi në Ahiretin" të cilat shikojnë dhe orientohen tek jeta individuale dhe shoqërore e njeriut.]

Fruti i parë

Ashtu si njeriu -në kundërshtim me qëniet e tjera të gjalla- ka lidhje me shtëpinë e tij, po ashtu ai ka lidhje me dynjanë -botën etj; dhe ashtu siç ka lidhje me të afërmit e tij, po ashtu nga natyra ai ka lidhje serioze me njerëzimin -me llojin njerzor. Dhe ashtu siç do ai qëndrueshmëri në dynjanë kalimtare, po ashtu ai, dëshiron me shumë mallëngjim e pasion për pavdekshmëri në botën e përjetësisë; dhe ashtu siç përpiqet vazhdimisht për të siguruar nevojat e stomakut tij për ushqim, po ashtu ai është i detyruar nga natyra -madje përpiqet- për të siguruar ushqime për mendjen e tij, zemrën, shpirtin, dhe për humanizmin etj, dhe t'i marrë ato prej tryezave të shtrira në gjërësinë e dynjasë, madje të shtrira gjer në përjetësi, pasi ai ka shpresa e dëshira të tilla që asgjë përveç lumturisë së përjetshme nuk do t'i kënaqte e t'i ngopte ato. Ashtu siç është përmendur në Fjalën e Dhjetë, në Trajtesën e Ringjalljes, kur isha i vogël i fola imagjinatës sime: "Cilën nga këto të dyja preferon ti? A të kalosh një jetë të lumtur që vazhdon për një milion vite së bashku me sundimin e botës, por atëherë do të pushosh së ekzistuari, dhe e gjitha ajo do të përfundojë në asgjësi, apo dëshiron të jetosh përgjithmonë por të kesh një ekzistencë, një jetë të zakonshme dhe të vështirë?". Unë pashë se imagjinata ime deshi të dytën, dhe duke ndjerë dhimbje nga e para, tha: "Unë dua të jetoj përgjithmonë, edhe sikur të jetoja në Ferr!".

Kështu, meqenëse të gjitha kënaqësitë e kësaj bote nuk e kënaqin, nuk e ngopin, madje as magjinatën, e cila është një shërbyese e natyrës humane, atëherë sigurisht realiteti i natyrës gjithëpërfshirëse njerëzore është e lidhur nga natyra me përjetshmërinë dhe me pavdekshmërinë.

Atëherë, sa thesar i madh, i mjaftueshëm dhe i plotë është "Besimi në Ahiretin" për këtë njeri të lidhur me këto dëshira e shpresa të cilat nuk mbarojnë, ndërkohë që ai nuk ka si kapital veçse një pjesë prej zgjedhjes së pjesshme -vullnetit të lirë- dhe një varfëri absolute!

Dhe ky besim në Ahiretin është për të një bosht për lumturinë e kërkuar dhe për kënaqësinë e dëshiruar. Sa burim ndihme, strehimi,

dhe sa mjet ngushëllimi është ky besim përballë dhimbjeve e dëshpërimeve të pafundme të kësaj bote! Sikur ta sakrifikonte njeriu të gjithë jetën e kësaj dynjaje në rrugën e fitimit të këtyre frutave dhe dobive, përsëri kjo do të kishte qenë e lirë!

Fruti i dytë që shikon tek jeta individuale e njeriut:

Ajo që e shqetëson vazhdimisht njeriun dhe që ia bën jetën helm është mendimi i tij i vazhdueshëm për fundin e tij dhe si do jetë hyrja e tij në varr, ashtu siç përfunduan e hynë tek ai -varri- të dashurit dhe të afërmit e tij. Njeriu i mjerë, i cili është i gatshëm të sakrifikonte dhe shpirtin e tij për një mik të dashur të ngushtë, mendon për mijërat, milionat ose për mijëra milionat e miqve prej vëllezërve të tij njerëzor të cilët përfundojnë në asgjësi nëpërmjet vdekjes -asaj ndarjeje të përjetshme pas së cilës nuk ka takim- dhe ky mendim, ky përfundim e bën njeriun të vuajë tortura e dhimbje më të rënda se sa Ferri. Mu në atë pikë, vjen "Besimi në Ahiretin", i hap sytë e tij dhe ia heq perden nga sytë, dhe i thotë: "Shiko!" Ndërkohë ai sheh me besim, dhe duke parë se ato miq kanë shpëtuar prej vdekjes, kalbëzimit dhe rrënimit të përjetshëm dhe se janë duke pritur me gëzim një botë drite, ai merr një kënaqësi të thellë shpirtërore e cila njofton kënaqësitë e Parajsës. Duke u mjaftuar me shpjegimet dhe provat e këtij rezultati që janë bërë në Risale-i Nur, ne e presim shkurt këtu.

Fruti i tretë lidhur me jetën personale të njeriut...

Epërsia, avantazhi dhe dallimi i njeriut mbi qëniet e tjera të gjalla dhe rangu i tij i lartë janë për shkak të cilësive të tij të lartësuara, aftësive të tij të bashkëlindura gjithëpërfshirëse, adhurimit të tij universal dhe për sferat e gjëra të ekzistencës së tij.

Prandaj njeriu i kufizuar vetëm për të tashmen, e cila është e zhveshur nga e shkuara dhe e ka shkëputur lidhjen me të ardhmen, të cilat janë mosekzistuese, të vdekura dhe të errrëta për të -ky njeri i fiton virtytet si burrërinë, dashurinë, vëllazërinë dhe humanizmin mbi bazën e së tashmes së ngushtë; ato përkufizohen tek ai në përputhje me masat dhe peshat e tij të kufizuara, kështu ai u jep babait të tij ose vëllait të tij ose bashkëshortes ose kombit të tij dhe u shërben atyre në përputhje me ato masa të ngushta, sikur nuk i ka njohur ata më parë dhe siç nuk do t'i shohë kurrë më në të ardhmen pas ndarjes së tyre; dhe kështu ai nuk do të ngjitej kurrë në shkallën e vërtetësisë në besnikëri, as në pozitën e sinqeritetit në shoqëri, as në shkallën e miqësisë së pastër në dashuri dhe as në respektin e pastër në shërbim; sepse gjërësia e atyre virtyteve dhe e plotësimeve u zvogëluan dhe u

pakësuan në raport me vetveten e tyre, në mënyrë të përpjesëtuar, dhe atëherë, pikërisht për shkak të arsyes së tij, njeriu është duke rënë në nivelin më të ulët të kafshëve. Por, sapo i vjen "Besimi në Ahiretin" tek ky njeri që ta shpëtojë, ta mbështesë e ta ndihmojë, e transformon atë kohë të ngushtë -që i ngjason varrit- në një kohë të gjërë e shumë të shtrirë saqë ajo përfshin njëherësh të shkuarën dhe të ardhmen, dhe i shfaq atij një ekzistencë të gjërë sa gjërësia e dynjasë, madje një gjerësi që shtrihet nga parapërjetësia për tek paspërjetësia.

Atëherë ngrihet ky njeri për ta respektuar e nderuar babain e tij me kërkesë të atësisë që shtrihet deri në botën e lumturisë dhe në botën e shpirtërave; dhe e përkrah vëllain e tij- me këtë mendim- të vëllazërisë që shtrihet gjer në paspërjetësi; e do gruan e tij, e shoqëron dhe e ndihmon sepse ajo do të jetë një shoqe e bukur për të në Parajsë. Ai nuk do t'i shfrytëzonte detyrat e rëndësishme të cilat janë për lidhje në atë sferë të jetës dhe të ekzistencës për gjëra të pavlefshme të kësaj bote, as për qëllimet e saj të pjesshme dhe as për interesat e saj të papërfillshme. Prandaj ai do të jetë i suksesshëm dhe do të triumfojë me vërtetësinë e plotë, me besnikërinë e sinqertë në lidhjet, në marrëdhëniet dhe në shërbimet e tij; si dhe cilësitë e tij të mira dhe arritjet do të fillojnë të përparojnë e të ngjiten në mënyrë të përpjesëtuar dhe do të lartësohet humanizmi i tij; secila sipas shkallës së vet. Ai njeri i cili nuk mund të ngjitej as tek niveli i harabelit lidhur me marrjen e kënaqësisë nga jeta, u bë tani -në sajë të besimit në Ahiret- mysafiri më i shquar dhe i lumtur në dynja, epror mbi të gjitha kafshët, madje ai bëhet krijesa më e dashur dhe shërbëtori më i nderuar i Krijuesit dhe i Pronarit të universit.

U mjaftuam me kaq në shpjegimin e këtij rezultati meqë atë e ka shpjeguar Risale-i Nuri me prova dhe argumente.

Dobia e katërt e besimit në Ahiretin, e cila shikon tek jeta shoqërore e njeriut.

Një përmbledhje e këtij rezultati është shpjeguar në Rrezen e Nëntë të Risale-i Nurit; ajo është sa vijon:

Fëmijët të cilët përbëjnë një të katërtën e njerëzimit, nuk mund të jetojnë e të bëjnë jetë humane veçse nëpërmjet 'besimit në Ahiret', dhe mbështesin kapacitetin e tyre human; sepse po të mos ishte ky besim, ata do të detyroheshin t'i kalonin jetët e tyre duke i mbushur me paturpësi, me shqetësime, turbullime e ankthe të dhimbshme; kështu ata nuk do të gëzoheshin me lojërat e tyre dhe as nuk do të ngushëlloheshin me lodrat e tyre; sepse vdekjet e vazhdueshme të cilat

godasin përreth tyre fëmijë si ata ndikojnë shumë në vetëdijet e tyre delikate e të ndjeshme, në zemrat e tyre të dobëta, të cilat në të ardhmen do ushqejnë e do të kenë shpresa e dëshira të shumta, dhe në shpirtërat e tyre të prekshëm, të lëndueshëm e të paqëndrueshëm; dhe kështu ata goditen me shqetësim e turbullim, saqë jeta dhe mendja e tyre bëhen si dy mjete torturimi për ta. Por atëherë, nëpërmjet instruktimit në "besimin në Ahiretin" në vend të shqetësimeve dhe lodrave pas të cilave ata ushqehen me qëllim që mos i shohin ato vdekje, ata ndjejnë një gëzim dhe një shtrirje, një qetësim, dhe thonë: "vëllai im -ose shoku im-, i cili ka vdekur, është bërë tani një zog prej zogjve të Xhennetit. Ai është duke fluturuar rreth e qark dhe është duke shëtitur e duke e kënaqur vetveten më shumë se ne. Dhe nëna ime -edhe në qoftë se ka vdekur- veçse ama ajo ka shkuar te mëshira e gjërë Hyjnore; gjithashtu ajo do të më marrë përsëri në kraharorin e saj të butë e të dashur në Parajsë, dhe unë do ta shoh përsëri atë nënë të dhembshur. Kështu fëmijët mund të jetojnë në një gjendje të qetë që i përshtatet humanizmit.

Po kështu pleqtë të cilët përbëjnë një të katërtën e njerëzimit, është vetëm "besimi në Ahiretin" tek i cili ata mund të gjejnë ngushllim përballë shuarjes së afërt të jetëve të tyre, hyrjes së tyre nën dhe, dhe përfundimit të botërave të tyre të bukura e të dashura, që dynjaja e bukur dhe e ëmbël i mbylli dyert e saja në fytyrat e tyre. Ata baballarë të respektuar dhe të mëshirshëm dhe ato nëna vetëflijuese të dhembshura, po të mos ishte "besimi në Ahiretin" do të ndjenin një trazirë e brengë të tillë shpirtërore dhe një shqetësim të zemrës, saqë do të bëhej dynjaja aq e ngushtë për ta si burgu, dhe vetë jeta do të bëhej një torturë e tmerrshme.

Ndërkohë "besimi në Ahiretin" u thotë atyre: "Mos u shqetësoni, o të moshuar! Ju keni një rini të pavdekshme të amshuar e cila është para jush dhe ju pret, dhe keni një jetë të shndritshme, të pafundme e të përjetshme që ju pret ju. Ju do të bashkoheni me gëzim me fëmijët tuaj dhe me të afërmit që i keni humbur. Të gjitha veprat tuaja të mira janë ruajtur dhe ju do të merrni shpërblim për to".

Kështu, "besimi në Ahiretin" u jep atyre një ngushëllim dhe një gëzim të tillë, saqë në qoftë se ndonjëri prej atyre të moshuarve sikur të mbante peshat e njëqind pleqërive, sikur të përjetonte pleqëri njëqind herë më shumë, ai do t'i duronte duke pritur atë jetë të lumtur Ahireti e cila do t'i ndjekë ato pesha pleqërie.

Po kështu të rinjtë, të cilët përbëjnë një të tretën e njerëzimit, ndoshta nuk e dëgjojnë zërin e mendjeve të tyre të pjesshme. Me

ndjenjat e tyre të stuhishme e të rrëmbyera ata jo gjithmonë janë në gjendje të kontrollojnë mendjet e tyre të guximshme dhe përmbysen nga pasionet e tyre. Kështu, në qoftë se këta të rinj humbasin 'besimin në Ahiret" dhe nuk do ta kujtonin dënimin e Xhehennemit, atëherë pasuritë e njerëzve në shoqëri, dinjiteti i tyre, rehatia e njerëzve të dobët dhe nderi i të moshuarve do të kërcënoheshin me rrezik. Ndoshta një i ri prej tyre do të shkatërronte lumturinë e një shtëpie të sigurt e të kënaqur për hir të një minuti kënaqësie, dhe atëherë si rrjedhojë, do të provonte të vuante dënimin me burg për katër apo pesë vite, dhe do të shndërrohej në një gjendje që i ngjason një kafsheje të egër.

Por në qoftë se *'besimi në Ahiret'* i vjen në ndihmë dhe e mbështet, ai menjëherë vjen në vete dhe i flet vetes së tij duke i thënë:

"Pavarësisht se policët e qeverisë dhe sytë -informatorët- e saj nuk mund të më shikojnë dhe unë mund t'u fshihem atyre, por ama melekët e Sulltanit më të madh të Gjithëlavdishëm i Cili zotëron burgun e Xhehennemit, atë burg të madh të përjetshëm, më shohin dhe janë duke më regjistruar të gjitha veprat e mia të liga.. Atëherë unë nuk jam i lirë dhe i pavarur, por jam një mysafir udhëtar i ngarkuar me detyra... Një ditë edhe unë gjithashtu do të jem i vjetër dhe i dobët si shembulli i tyre". Ai papritmas fillon të ndjejë keqardhje, simpati dhe respekt për ata, ndaj të cilëve dëshironte t'u shkilte të drejtat e tyre në mënyrë mizore. Kjo gjithashtu është shpjeguar me prova në Risale-i Nur, kështu duke e vlerësuar atë si të mjaftueshme, ne e presim shkurt këtu.

Gjithashtu, një pjesë tjetër e njerëzimit janë të sëmurët, të shtypurit, të goditurit me fatkeqësi si shembulli ynë, të varfërit dhe të burgosurit të cilët janë dënuar me dënime të rënda; të gjithë këta përbëjnë pjesën më të rëndësishme të njerëzimit. Në qoftë se atyre nuk do t'u vinte në ndihmë *"besimi në Ahiretin"* dhe në qoftë se nuk do të ngushëlloheshin me të, atëherë vdekja të cilën ata e gjejnë vazhdimisht para tyre duke e kujtuar atë nga sëmundjet, nga poshtërimi të cilin e shohin prej shtypësve -pa pasë mundësi të marrin hakun- dhe nga tradhtia e arrogantëve dhe e zullumqarve, prej të cilëve ata nuk mund ta shpëtojnë nderin e tyre dhe nga dëshpërimi i tmerrshëm për humbjen e pasurive dhe të fëmijëve të tyre në fatkeqësi të rënda nga dëshpërimi i vuajtjes së torturave të burgut për pesë apo dhjetë vite për shkak të një minuti ose dy ose të një apo dy orëve kënaqësie.. që të gjitha këto sigurisht e transformojnë dynjanë në një burg të madh për këta të mjeruar dhe e bëjnë vetë jetën torturë të dhimbshme për ta!

Por sapo t'u vijë atyre në ndihmë 'besimi në Ahiretin' duke i mbështetur me ngushëllim, ata papritmas marrin frymë lirshëm, dhe në përputhje me shkallën e besimit të tyre, dëshpërimi i tyre, ankthi, shqetësimi, tronditja, zemërimi dhe dëshira për hakmarrje qetësohen, ulen e fashiten, ndonjëherë pjesërisht dhe ndonjëherë tërësisht.

Unë madje mund të them se: "Po të mos ishte besimi në Ahiretin ai i cili më mbështeti mua dhe vëllezërit e mi në fatkeqësinë tonë të tmerrshme dhe në këtë hyrjen tonë në burg -pa pasë bërë asnjë faj-, hidhërimi i një dite të vetme do ishte aq i dhimbshëm dhe i rëndë si vetë vdekja; dhe kjo fatkeqësi do të na shtynte ne ta braktisnim edhe jetën duke e flakur. Por falënderime të pafundme qofshin për Zotin, i Cili më bëri mua t'i përballoj dhimbjet e shumë prej vëllezërve të mi të cilët janë më të dashur për mua se sa vetja ime; të duroj humbjen e mijërave prej kopjeve të Risale-i Nurit të cilat i dua më shumë se sytë e mi; të duroj humbjen e librave të mi shumë të çmueshëm e të praruar.. më bëri ta duroj e ta përballoj të gjithë këtë dëshpërim dhe brengë me atë 'besim në Ahiretin', pavarësisht se unë nuk mund ta duroja as dhe fyerjen më të vogël dhe as të mbahesha nën sundim prej dikujt cilido qoftë ai; unë ju betohem -që të qetësoheni- se drita e 'besimit në Ahiretin' dhe forca e tij më dhanë një durim, qëndresë, rezistencë, ngushëllim, vendosmëri dhe më mbushi me entuziazëm për të fituar shpërblimin e një xhihadi të madh në këtë provim deri në atë shkallë, ashtu siç thashë në fillimin e kësaj trajtese, unë e konsiderova veten time të jem në një medrese -shkollë- të mirë që gjithçka në të është mirësi e bukuri; ajo medrese është e denjë t'i jepet titulli ***El-Medresetu El-Jusufie,*** *Shkolla e Jusufit.* Po të mos ishte sëmundja e herëpashershme dhe pezmatueshmëria që burojnë nga pleqëria, unë do të punoja me seriozitet më të madh në mësimet e mia në këtë medrese pasi kam një rehati e qetësi të mendjes. Megjithatë, ne u shmangëm prej subjektit. Shpresoj që ky largim nga tema të falet.

Gjithashtu, "shtëpia e gjithësecilit" është një botë e vogël për të, madje është një parajsë e zvogëluar për të. Në qoftë se 'besimi në Ahiretin' nuk do të ishte sundues e dominues në lumturinë e kësaj shtëpie, atëherë të gjithë anëtarët e asaj familjeje do të vuanin një tronditje të dhimbshme dhe një shqetësim e torturë të rëndë në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin, gjithësecili sipas shkallës së dhembshurisë dhe të dashurisë së tij për ta, dhe do të transformohej ajo parajsë në një ferr të padurueshëm, ose ajo do t'ua mpinte mendjet e tyre me dëfrime e shthurje të përkohshme dhe shembulli i tyre në këtë do të ishte si struci, kur e sheh gjahtarin e fsheh kokën e tij në rërë që

të mos e shohë gjahtari meqë nuk është në gjendje as të ikë dhe as të fluturojë.

Edhe ata gjithashtu i zhysin kokat e tyre në pakujdesi, me qëllim që të mos i shohë ata vdekja, zhdukja dhe ndarja, duke i bllokuar përkohësisht ndjenjat e tyre në mënyrë të çmendur, sikur të kishin gjetur ilaç për atë nga e cila vuajnë!

Për shembull, nëna -e cila do të sakrifikomte vetveten për hir të fëmijës së saj- sa herë që i sheh fëmijët e saj të zbuluar para rrezikut dridhet vazhdimisht nga frika për ta. Po ashtu edhe fëmijët, kur nuk munden t'i shpëtojnë baballlarët e tyre ose vëllezërit e tyre nga fatkeqësitë e pandërprera do të mbeteshin në shqetësim të vazhdueshëm dhe do të ndjenin frikë të vazhdueshme.

Sipas kësaj analogjie, jeta e asaj familjeje, e cila supozohet se është jetë e lumtur, e humbet lumturinë e saj në këtë dynja të tronditur e kalimtare sepse ajo nuk ua jep lidhjes midis anëtarëve dhe as lidhjes së të afërmve midis njëri-tjetrit -brenda një jete tepër të shkurtër- shoqërimin e vërtetë, besnikërinë e vërtetë, sinqeritetin e plotë dhe shërbimin dhe dashurinë e pastër; madje moralet e mira zvogëlohen, veniten e rrudhen në raport me shkurtimin e vetë jetës, dhe ndoshta ato marrin tatëpjetën dhe humbasin krejtësisht.

Mirëpo, sapo të hyjë në atë shtëpi 'besimi në Ahiretin', ajo ndriçohet krejtësisht, sepse atëherë lidhja farefisnore, dhembshuria dhe dashuria që i lidh ato nuk maten brenda një kohe tepër të shkurtër, por maten në përputhje me lidhjet dhe marrëdhëniet që shtrihen në përjetësinë dhe në qëndrueshmërinë e tyre në botën e Ahiretit dhe në lumturinë e përjetshme; atëherë secili nga anëtarët e familjes shfaq respekt të pastër ndaj të tjerëve, u dhuron dashuri të sinqertë, dhe shfaq dhembshuri të vërtetë dhe demonstron shoqërim të sinqertë duke i shpërfillur gabimet e njëri-tjetrit.

Kështu moralet e tyre të mira rriten e lartësohen, dhe lumturia e humanizmit të vërtetë fillon të zbulohet dhe të rrezatojë në atë shtëpi. Meqenëse edhe kjo gjithashtu është shpjeguar me prova në Risale-i Nur, ne mjaftohemi me atë dhe e shkurtojmë këtu.

Po kështu, çdo 'qytet' në vetvete është një shtëpi e madhe për banorët e tij. Në qoftë se 'besimi në Ahiretin' nuk do të ishte sundues mbi anëtarët e kësaj familjeje të madhe, do të mbisundonin mbi ta urrejtja, interesat vetjake, dredhia, egoizmi, shtirja, hipokrizia, ryshfeti e mashtrimi në vend të bazave të sjelljeve të mira dhe të moraleve të lavdërueshme të cilat janë sinqeriteti, burrëria, zelli, virtyti, dashuria,

vetëflijimi, kërkimi i kënaqësisë së Zotit dhe shpërblimi i Ahiretit. Kuptimet e terrorizmit, anarkisë dhe mizorisë do të mbisundonin nën emrin e rregullit, sigurisë dhe të humanizmit që ata shfaqin. Atëherë do të bëhej helm jeta e atij qyteti. Fëmijët do të bëheshin ngatërrestarë, rinia do të lëshohej pas pijeve alkoolike dhe dëfrimeve; të fuqishmit do t'u futeshin aventurave të rrezikshme, duke bërë padrejtësi e shkelje; ndërsa të moshuarit do të nisnin të vajtonin e rënkonin.

Duke bërë analogji me këtë, edhe vendi gjithashtu, është i gjithi një shtëpi shumë e madhe. Atdheu është shtëpia e familjes së kombit. Në qoftë se 'besimi në Ahiretin' do të sundonte në këto shtëpi të mëdhaja, virtytet do të zbuloheshin, shtriheshin dhe bëheshin të qarta në to; do të shfaqeshin respekti i ndërsjellë, mëshira serioze, dashuria e pastër pa kompensim, ndihma e ndërsjellë, shërbimi i vërtetë pa mashtrim, marrëdhëniet shoqërore dhe mirëbërësia, lëmosha pa hipokrizi; virtyti, përnderimi -respekti i madh- pa mendjemadhësi, dhe të gjitha moralet e tjera do të zhvilloheshin.. sepse 'besimi në Ahiretin' u thotë atyre fëmijëve: "Hiqni dorë nga trazirat e ngatërresat! Ndodhet një xhennet për t'u fituar! Mos u largoni prej tij duke u marrë me lojëra!". Ai, nëpërmjet udhëzimit të Kuranit u mëson vetëpërmbajtjen dhe vendos moralet tek ata.

Ai u thotë të rinjve: "Ndodhet zjarri i xhehennemit përpara jush, prandaj hiqni dorë prej pijeve alkoolike dhe prej dëfrimeve!" dhe i sjell ata në vete.

Ai i thotë shtypësit: "Ruhu! Ndodhet një torturë e rëndë; ti do të marrësh goditje!" dhe e bën atë t'i nënshtrohet e t'i bindet drejtësisë.

Ai u flet të moshuarve: "Merrni lajme të gëzueshme! Para jush është një rini e përjetshme plot freski e bukuri; një lumturi Ahireti e përjetshme dhe e vazhdueshme është duke ju pritur; ajo është më e lartë se të gjithë llojet e lumturisë që ju i keni humbur dhe shumë më e madhe se sa ato; prandaj ejani dhe përpiquni që t'i fitoni ato!" kështu ai i transformon lotët e tyre në qeshje e gëzim.

Duke bërë analogji me këto, 'besimi në Ahiret' shfaq efektet e tij të mira dhe i dërgon rrezet e dritës së tij tek çdo grup, sido që të jetë, i pjesshëm, universal, i përgjithshëm, i veçantë, i pakët apo i shumtë.

Le të kumbojnë veshët e sociologëve dhe të moralistëve, të cilët janë të interesuar për jetën shoqërore të njerëzimit, le të marrin një shënim të veçantë!

Në qoftë se mijëra dobitë, mirësitë dhe avantazhet e mbetura të 'besimit në Ahiret' do të krahasoheshin me këto pesë ose gjashtë të

cilat i përmendëm më lartë, do të kuptohej se vetëm besimi është boshti i lumturisë në këtë botë dhe në tjetrën dhe në jetët e të dyjave.

. . .

Duke i vlerësuar si të mjaftueshme përgjigjjet e fuqishme ndaj dyshimeve të dobëta -lidhur me Ringjalljen trupore të përshkruar në Fjalën e Njëzet e Tetë dhe në trajtesat e tjera të Risale-i Nurit, ne vetëm do të tregojmë këtu një aluzion shumë të përmbledhur e të shkurtër, dhe themi:

Shumica e Emrave të bukur Hyjnorë manifestohen në trupësi, e cila është pasqyra më gjithëpërfshirëse e tyre. Më i skajshmi i qëllimeve Hyjnore për krijimin e universit shfaqet në trupësi, dhe ajo është qendra më e pasur dhe më aktive e atyre qëllimeve. Varietetet më të mëdhaja të mirësive të shumëllojshme dhe të përgjithshme Hyjnore qëndrojnë e bëhen të qarta në trupësi.

Pjesa më e madhe e farërave të duave të cilat i bën njeriu nëpërmjet gjuhës së nevojave të tij dhe shumica e bazave të falënderimeve dhe lavdërimeve që ai i paraqet tek Krijuesi i tij Mëshirëplotë gjithashtu burojnë e dalin nga trupësia. Larmia më e madhe e farërave të botërave jolëndore dhe shpirtërore gjithashtu shtrihen dhe janë në trupësi.

Duke bërë analogji me këtë, meqenëse qindra prej të vërtetave universale përqëndrohen në trupësi, Krijuesi Gjithëbujar e shumon trupësinë dhe e shton mbi sipërfaqen e tokës me qëllim që të manifestohen në to ato të vërteta të lartëpërmendura; dhe me një shpejtësi të pafundme dhe me një aktivitet madhështor Krijuesi i Gjithurtë u vesh karvaneve të njëpasnjëshëm të qënieve një ekzistencë duke i dërguar ato në ekspozitën e kësaj bote. Pastaj Ai i shkarkon ato nga shërbimi dhe dërgon qënie të tjera në vendin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Dhe kështu Ai e bën fabrikën e universit të jetë në punë të vazhdueshme dhe në lëvizje të pandërprerë. Duke thurur prodhimet trupore sipër tokës, Ai e bën tokën si një vend kultivimi për Ahiretin dhe fidanishten e Parajsës.

Në fakt, me qëllim që të kënaqë e të qetësojë stomakun fizik -trupor- të njeriut, Ai xh.sh. dëgjon dhe pranon duanë për pavdekshmëri të stomakut të tij të cilën e bën nëpërmjet gjuhës së gjendjes; duke i dhënë rëndësinë më të madhe, dhe me qëllim që t'i përgjigjet Ai përgatit në trupësi numra të pallogaritshëm të llojeve të panumërta të ushqimeve të shijshme të punuara mjeshtërisht si dhe mirësi të çmueshme, të gjitha duke dhënë kënaqësi të ndryshme. Kjo

demonstron në mënyrë të vetëkuptueshme dhe të padyshimtë se në Ahiret kënaqësitë më të shumta dhe të ndryshme të Parajsës do të jenë trupore, dhe se mirësitë e banesës së përjetshme të lumturisë, të cilën të gjithë e duan dhe familjarizohen me të, do të jenë trupore.

A do të ishte e mundur dhe a do të arsyetohej me mend që i Gjithëfuqishmi Mëshirëplotë dhe i Gjithëdituri Gjithëbujar i Cili pranon vazhdimisht lutjen e bërë nëpërmjet gjuhës së gjendjes nga stomaku i zakonshëm, i thjeshtë dhe e kënaq atë me ushqime fizike pafundësisht të mrekullueshme, që gjithmonë i përgjigjet në fakt dhe me qëllim -pa ndërhyrjen e rastësisë- të mos pranonte lutjet e përgjithshme dhe duatë e pafundme të njeriut dhe të mos e kënaqte atë përjetësisht -i cili është rezultati më i rëndësishëm i universit, kalifi i Zotit në tokë dhe adhuruesi dhe shërbëtori i dashur, i zgjedhur dhe i nderuar- të cilat ai i paraqet nëpërmjet stomakut më të lartë të humanizmit për kënaqësi trupore, të lartësuara e universale në botën e përjetshmërisë, të cilën ai gjithmonë e dëshiron, me të cilën ai është i njohur, i lidhur dhe të cilën ai e do nga natyra? A do të ishte e mundur që Ai të mos u përgjigjej në fakt atyre duave dhe të mos realizonte Ringjalljen trupore? Jo, kurrë! Kjo është e pamundur në njëqind pamundësi, madje do të ishte krejtësisht absurde, sepse a do të ishte e mundur që Ai të dëgjonte zëzëllimën e një mize dhe të mos dëgjonte gjëmimin e rrufeve? A do të ishte e mundur që Ai të pajiste një ushtar të vetëm të zakonshëm dhe të injoronte të gjithë ushtrinë e madhe? Jo, kjo do të ishte e pamundur dhe absurde.

Po, në përputhje me deklarimin e qartë të vërsetit, *"Dhe në të do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti, gjithçka që mund të kënaqë sytë..."*,[126] njeriu do të shohë e përjetojë në parajsë në formë të përshtatshme kënaqësi fizike me të cilat ai është më i familjarizuar dhe shembujt e të cilave ai i ka provuar në këtë botë. Sevapi, shpërblimi për falënderimet e sinqerta dhe për adhurimet e veçanta të cilat i kryen secila prej gjymtyrëve të tij, si gjuha, syri dhe veshi dhe gjymtyrët e tjera, do t'u jepet nëpërmjet kënaqësive të posaçme për ato gjymtyrë.

Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm i përshkruan aq qartë kënaqësitë fizike, saqë do të ishte e pamundur të mos pranohet kuptimi i jashtëm, dhe të bëje ndonjë interpretim që të shmang nga kuptimi i jashtëm.

Atëherë, frutat dhe rezultatet e 'besimit në Ahiret' tregojnë se ashtu si realiteti dhe nevojat e stomakut -njërit prej gjymtyrëve të

[126] Kuran 43: 71

njeriut- janë dëshmi vendimtare për ekzistencën e ushqimit; po ashtu realiteti dhe plotësimet e njeriut, dhe nevojat e tij të bashkëlindura, dëshira për përjetësi dhe aftësitë dhe potencialet e tij kërkojnë rezultatet dhe dobitë e lartëpërmendura të 'besimit në Ahiret', dhe janë prova të sigurta për Ahiretin, Parajsën dhe për kënaqësitë fizike, dhe ato dëshmojnë për ekzistencën e tyre të sigurt. Gjithashtu, realiteti i plotësimeve të universit dhe shenjat e tij krijuese kuptimplote dhe të gjitha të vërtetat e tij që lidhen me të vërtetat e lartëpërmendura humane janë dëshmi për ekzistencën e sigurtë të botës së Ahiretit, ringjalljes së të vdekurve dhe për hapjen e dyerve të Xhennetit dhe të Xhehennemit. Kjo është provuar në mënyrë të shndritshme në Risale-i Nur, dhe veçanërisht në Fjalën e Dhjetë dhe në Fjalën e Njëzet e Tetë -me të dyja stacionet e tyre-, në Fjalën e Njëzet e Nëntë, në Rrezen e Nëntë, dhe në trajtesën e lutjes në Rrezen e Tretë, saqë ato nuk lënë vend për asnjë dyshim.

Duke i referuar lexuesit për tek ato, ne po e presim shkurt këtu këtë tregim të gjatë.

. . .

Përshkrimet e Kuranit lidhur me xhehenemin janë gjithashtu aq të qarta e të shkoqura saqë nuk lënë asnjë nevojë për përshkrime të mëtejshme. Duke ia referuar Risale-i Nurit shpjegimet e detajuara të saj, ne do të shtjellojmë këtu në mënyrë tepër të shkurtuar atë çfarë largon disa dyshime të dobta në dy pika.

Pika e parë

Mendimi për xhehennemin dhe frika prej tij nuk i zhduk kënaqësitë e frutave të lartëpërmendura të besimit; sepse mëshira e pakufishme Hyjnore i thotë njeriut të frikësuar: Eja tek Unë, dhe hyr në derën e Pendesës! Atëherë ekzistenca e Ferrit nuk do të të trembë, por do të t'i bëjë të njohura plotësisht kënaqësitë e Parajsës, dhe do të të bëjë t'i provosh plotësisht ato; ai do të marrë hakun tënd dhe atë të të gjitha krijesave të pakufishme, të drejtat e të cilave janë shkelur, me qëllim që me këtë t'i kënaqë dhe të fusë gëzimin tek ata.

O i mbytur në çudhëzim -dhe që je i pamundur të dalësh prej tij! Ekzistenca e Ferrit është më e mirë për ty se sa asgjësimi i përjetshëm; dhe ekzistenca e tij është gjithashtu një lloj mëshire për mosbesimtarët; sepse njeriu -madje dhe kafshët me këlyshë- marrin kënaqësi tek kënaqësia dhe lumturia e të afërmve të tyre, fëmijëve dhe të dashurve, dhe-nga një drejtim- janë të lumtur.

Prandaj, o ateist! Për shkak të çudhëzimit tënd, ti ose do të biesh në mosekzistencë tek ekzekutimi yt i përjetshëm, ose do të hysh në Ferr! Sa për mosekzistencën, e cila është e keqe absolute, meqenëse ajo përbëhet nga asgjësimi përfundimtar i të gjithë të dashurve të tu, të afërmve, të paraardhësve dhe të pasardhësve, të cilët ti i do dhe për lumturinë e të cilëve ti bëhesh i lumtur, kjo do t'i shkaktonte shpirtit tënd, zemrës dhe natyrës tënde humane dhimbje dhe tortura një mijë herë më të rënda se sa tortura e Ferrit; sepse po të mos kishte Ferr, nuk do të kishte Parajsë. Nëpërmjet mosbesimit tënd, gjithçka bie në mosekzistencë. Në qoftë se ti futesh në Xhehennem dhe mbetesh brenda sferës së ekzistencës, ata që ti i do dhe të afërmit e tu do të jenë të lumtur në Parajsë, ose ata do të jenë brenda sferave të ekzistencës nën mëshirën e All-llahut xh.sh.. Kjo do të thotë që ti duhet ta mbështesësh idenë e Ekzistencës së Ferrit. Ta kundërshtosh këtë, do të thotë të mbështesësh mosekzistencën, e cila është të mbështesësh eleminimin dhe asgjësimin e të gjithë të dashurve dhe miqve të panumërt!

Po, Xhehennemi është një tokë -banesë- ekzistuese që kryen funksionin e burgut nëpërmjet urtësisë dhe drejtësisë së të Gjithurtit të Gjithëlavdishëm; është një vend i frikshëm dhe i tmerrshëm brenda sferës së ekzistencës e cila është mirësi e pastër. Përveç atë të burgut, ajo banesë -skëterra- ka funksione të tjera dhe detyra të mëdha, përmbush qëllime dhe kryen shumë shërbime që lidhen me botën e Përjetshmërisë. Ai është gjithashtu një vendbanim madhështor për shumë krijesa të gjalla si Melekët e Xhehennemit.

Pika e dytë

Ekzistenca e Xhehennemit dhe tortura e rëndë e tij nuk e kundërshton fare mëshirën e pakufishme, as drejtësinë e vërtetë dhe as urtësinë e balancuar në të cilën nuk ka tepri e harxhim të kotë, përkundrazi, mëshira, drejtësia dhe urtësia kërkojnë dhe bëjnë të domosdoshme ekzistencën e xhehennemit. Sepse të ndëshkosh një tiran i cili shkel e dhunon të drejtat e një mijë të pafajshmive, dhe të vrasësh një kafshë të egër që i kafshon e i bën copa njëqind kafshë frikacake, kjo do të ishte për të shtypurit mëshirë e njëmijëfishtë brenda drejtësisë. Ndërsa që të falësh tiranët dhe t'i lësh të lira ato kafshë të egra, do të ishte një padrejtësi e shëmtuar dhe mungesë mëshire e njëqindfishtë për ata qindra të mjerë në vend të asaj mëshire të vendosur gabim -jo në vendin e duhur.

E ngjashme me këtë, mohuesi absolut -i cili hyn në burgun e xhehennemit- me kufrin -mohimin- e tij ai mohon të drejtat e Emrave

të bukur Hyjnorë, domethënë ai i shkel ato të drejta.. dhe nëpërmjet mohimit të dëshmisë së qënieve për ato Emra, ai shkel të drejtat e tyre gjithashtu, dhe duke mohuar detyrat e lartësuara të tesbihateve të krijesave ndaj Emrave të bukur Hyjnorë ai i shkel të drejtat e tyre, dhe nëpërmjet mohimit të qënies së tyre pasqyra dhe duke mohuar llojet e ibadetit që kryejnë krijesat ndaj manifestimit të Emrave të bukur Hyjnorë, që është qëllimi i krijimit të universit dhe njëri shkak për ekzistencën dhe vazhdimësinë e tij, ai shkel të drejtat e të gjitha krijesave.

Prandaj, mohimi është një krim i madh dhe një padrejtësi e tillë e përpjesëtimeve të mëdha saqë ai nuk mund të falet, dhe meriton kërcënimin e vërsetit, *"Padyshim që All-llahu nuk fal që atij t'i vihen shokë..."*[127]

Përkundrazi, mosflakja këtë njeri në xhehennem, si mëshirë për të, do të kundërshtonte mëshirën, do të ishte në kundërshtim të plotë me të drejtën e këtyre numrave të mëdhenj të krijesave dhe të qënieve, të drejtat e të cilave janë shkelur e dhunuar.

Atëherë, ashtu siç kërkojnë ata ankues ekzistencën e xhehennemit, po ashtu dinjiteti i Madhështisë së Krijuesit dhe madhështia e plotësisë së Tij sigurisht e kërkojnë këtë.

Po, në qoftë se një rebel i përçmuar i cili sulmon njerëzit do t'i thonte sundimtarit Krenar të vendit: "Ti nuk mund të më fusësh në burg!", duke fyer dinjitetin e tij, sigurisht ai sundimtar do të ndërtonte enkas një burg për atë idiot të pasjellshëm në qoftë se nuk do të ndodhej burg në qytet dhe do ta fuste brenda.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, nëpërmjet mosbesimit të tij, mohuesi absolut fyen rëndë dinjitetin e lavdisë Hyjnore, dhe nëpërmjet mohimit të tij ofendon madhështinë e fuqisë së Tij; dhe nëpërmjet agresionit të Tij prek plotësinë e Hyjnisë së Tij. Madje edhe në qoftë se nuk do të ekzistonin ato shkaqe që e bëjnë të domosdoshëm funksionimin e Ferrit dhe shumë arsye për shembujt e urtësisë në ekzistencën e tij; është shenja e atij dinjiteti e madhështie që të krijojë një xhehennem për mohues të tillë si ai, dhe që t'i flakë ata brenda tij.

Për më tepër, vetë natyra e mosbesimit bën të njohur Ferrin! Po, ashtu si në qoftë se do të mishërohej natyra e vërtetë e besimit që do të mund të ndërtonte, me kënaqësitë dhe me mirësitë e bukurisë së saj një xhennet privat në ndërgjegjen dhe në zemrën e njeriut, që është një

[127] Kuran 4:48

xhennet i zvogëluar që në këtë drejtim jep lajme të fshehta për xhennetin e përjetshmërisë i cili e pret atë në Ahiret, po ashtu mohimi -kufri- dhe sidomos kufri absolut -hipokrizia dhe apostazia, felëshimi- janë shkaku i dhimbjeve të errëta e të tmerrshme dhe i torturave shpirtërore saqë në qoftë se do të mishëroheshin, ato do të bëheshin Ferr privat për felëshuesit, dhe në këtë mënyrë njoftojnë për Ferrin e madh në Ahiret i cili është më i tmerrshëm dhe më torturues.

Ne e kemi provuar me prova në Risale-i Nur dhe gjithashtu u aludua për të në fillimin e kësaj çështjeje gjithashtu.

Meqenëse kjo dynja është një tokë e kultivueshme për Ahiretin, atëherë të vërtetat e vogëla që gjenden në të prodhojnë dhe lëshojnë filiza në Ahiret. Kështu, kjo farë helmuese -kufri- tregon, nga ky këndvështrim, atë Pemë të Zekkumit dhe thotë: "Unë jam origjina e asaj Peme dhe thelbi i saj". Atëherë për fatkeqin i cili më mohon mua në zemrën e tij, do të prodhoj për të një shembull privat të asaj peme të mallkuar.

Dhe meqenëse mohimi -kufri- është agresion e shkelje ndaj të drejtave të panumërta, ai sigurisht është një krim i pafundmë dhe meriton ndëshkim të pafundmë. Drejtësia humane e konsideron dënimin me pesëmbëdhjetë vite burgim -afërsisht tetë milion minuta- të jetë drejtësi për vrasjen që ndodh për një minutë, dhe e konsideron këtë dënim të përshtatshëm për të drejtat dhe interesat e përgjithshme, atëherë nuk ka dyshim se një minut i vetëm prej mohimit absolut -duke e konsideruar një minut të vetëm mohimi të barabartë me një mijë vrasje- do të përballet me një torturim përafërsisht tetë miliard minuta; kjo është në përputhje me atë ligj të drejtësisë humane. Atëherë, një person që e kalon një vit të jetës së tij në mosbesim meriton të torturohet një trilion e tetëqind e tetëdhjetë miliard minuta, domethënë të jetë i përshtatshëm për Ferr, duke manifestuar kuptimin e vërsetit, *"Ata do të banojnë në të përgjithmonë"*. [128]

Megjithatë..

Përshkrimet e Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm lidhur me Parajsën dhe Ferrin dhe provat e ekzistencës së tyre në Risale-i Nur -i cili është një koment Kuranor që buron prej Kuranit- nuk lënë asnjë nevojë për ndonjë shpjegim tjetër.

[128] Kuran 4:169

Shumë ajete kuranore si: *" ...dhe që mendojnë thellë për krijimin e qiejve dhe të tokës (duke thënë): "Zoti ynë! Ti nuk e ke krijuar gjithë këtë kotë (pa qëllim). Lavdia të takon Ty! Na ruaj ne prej ndëshkimit të zjarrit."*[129]

"Edhe ata të cilët thonë: Zoti ynë! Largoje prej nesh ndëshkimin e xhehennemit. Vërtet që ndëshkimi i tij është gjithnjë dënim i pandalshëm, i përhershëm". "Vërtet i keq është ai vend (xhehennemi) për të banuar e për të qëndruar në të".[130]

Dhe ajo që përsëritej më shpesh nga profeti Muhammed a.s.m. në duatë e tij në çdo kohë, po ashtu dhe nga profetët e tjerë a.s dhe nga njerëzit e realitetit ishte duaja: ***"Exhir na minen-nar", "Nexh-xhina minen-nar"*** dhe ***"Hal-lisna minen-nar",*** *"Na ruaj prej zjarrit të Ferrit", "Na çliro prej zjarrit të Ferrit"* dhe *"Na shpëto prej zjarrit të Ferrit"*, i cili për shkak të zbulesave dhe të ndriçimeve ishte i sigurt... e gjitha kjo na tregon se çështja më e madhe për njerëzimin në tokë është shpëtimi prej zjarrit të xhehennemit.

Xhehennemi është gjithashtu një e vërtetë shumë e gjërë, e madhe dhe shumë e rëndësishme e universit të cilin disa nga njerëzit e ndriçimit, të shikimit dhe të dëshmimit dhe ata të cilët i hetojnë realitetet, e kanë vëzhguar, dhe duke parë disa nga distilimet dhe hijet e tij, kanë bërtitur prej tmerrit të tij: "*Na shpëto prej zjarrit të xhehennemit".*

Po, përplasja dhe ndërfutja e të mirës dhe të keqes në këtë univers, e kënaqësisë dhe e dhimbjes, dritës dhe errësirës, nxehtësisë dhe të ftohtit, bukurisë dhe shëmtisë, udhëzimit dhe çudhëzimit janë për një shembull të madh urtësie. Sepse në qoftë se nuk do të kishte pasë të keqe, e mira nuk do të ishte njohur; në qoftë se nuk do të kishte pasë dhimbje, kënaqësia nuk do të kuptohej. Dritës pa errësirë do t'i mungonte e gjithë rëndësia. Shkallët e nxehtësisë kuptohen nëpërmjet ekzistencës së të ftohtit. Nëpërmjet shëmtisë, një shembull i vetëm i realitetit të bukurisë bëhet një mijë shembuj realitetesh, madje fiton mijëra lloje bukurie dhe shkallë hijeshie. Në qoftë se nuk do të ekzistonte Ferri, shumë nga kënaqësitë e Parajsës do të mbeteshin të fshehura.

Duke bërë analogji me këto, çdo gjë, nga një drejtim, mund të njihet nëpërmjet të kundërtës së saj; dhe një e vërtetë e vetme mund të prodhojë të vërteta të shumta nëpërmjet ekzistencës së të kundërtës.

---

[129] Kuran 3:191
[130] Kuran 25:65-66

Meqenëse këto qënie të ndërfutura derdhen, vërshojnë nga kjo botë e përkohshme për tek bota e përjetshme, atëherë sigurisht, ashtu si gjëra të tilla, si e mira dhe kënaqësia, drita dhe bukuria, besimi dhe gjëra të ngjashme me këto të cilat derdhen në Xhennet; po ashtu gjëra të dëmshme si e keqja, dhimbja, errësira, shëmtia, mohimi dhe gjëra të ngjashme me to vërshojnë e bien në xhehennem. Dhe rrymat e këtij universi vazhdimisht të trazuar vërshojnë për tek ato dy pellgje duke u qetësuar e duke u boshatisur tek ato të dyja në fund të udhëtimit - qarkullimit.

Duke ju referuar për 'pikat aluduese' tek fundi i Fjalës së Njëzet e Nëntë, ne mjaftohemi me kaq dhe e ndërpresim diskutimin këtu.

• • •

O shokët e mi studentë këtu në shkollën e Jusufit!

Rruga më e lehtë për të shpëtuar nga burgu i tmerrshëm i përjetshëm -xhehennemi- është që të shfrytëzojmë rastin e qëndrimit tonë në burgun e kësaj bote duke përfituar prej tij. Përveç kësaj, kjo është ajo që i ka shkurtuar duart tona prej shumë gjynaheve dhe na ka shpëtuar neve prej tyre. Atëherë ne duhet të bëjmë *istigfarë* dhe *teube* - të kërkojmë falje dhe të bëjmë pendim- për gjynahet që kemi bërë në të shkuarën, me qëllim që ta transformojmë çdo orë prej orëve të këtij burgu në barasvlerën e një dite të plotë adhurimi.

Pra, ky është rasti më i mirë që mund të kemi për të shpëtuar prej atij burgu të përjetshëm dhe për të fituar Parajsën e ndritshme. Në qoftë se ne do ta humbisnim këtë rast, jetët tona në Ahiret do të qanin ashtu siç po qajnë ato këtu në dynjanë tonë, dhe ne do të merrnim goditjen e vërsetit, *"...Ai ka humbur dynjanë dhe Ahiretin".* [131]

Ishte festa e Kurban Bajramit -festa e sakrificës- kur po shkruhej ky 'stacion'. Imagjinata ime më çoi tek një e pesta e njerëzimit duke përsëritur e deklaruar së bashku ***All-llahu Ekber,*** *Zoti është më i madhi*, dhe më shumë se treqind milionë muslimanë e thonë atë bashkërisht: Sikur jehona e ***All-llahu Ekber*** të ngrihej lartë e të zmadhohej sa madhësia dhe gjërësia e globit tokësor dhe sikur toka t'i bënte të gjitha motrat e saja -planetët- udhëtues në hapësirat e qiejve ta dëgjonin këtë fjalë të shenjtë. Dhe më shumë së njëzet mijë haxhillarë në Arefat dhe në festë, deklarojnë së bashku Frazën ***All-llahu Ekber***, këtë që e foli dhe e urdhëroi një mijë e treqind vjet më parë profeti më i nderuar a.s.m. së bashku me *Ehlibejtin* -familjen e tij- dhe me sahabët

[131] Kuran 22:11

e nderuar. Unë e ndjeva plotësisht, madje u binda plotësisht se ato jehona, zëra e deklarime, që të gjitha ishin një përgjigje në formën e një adhurimi të gjërë universal për manifestimin e Hynisë universale nëpërmjet madhështisë së titujve sublim të All-llahut ***Rabbil-Erdi, Rabbil-Aleminë****, "Krijuesi, mbështetësi i tokës, Krijuesi i të gjitha botëve".*

Pastaj pyeta veten: jam kureshtar të di në qoftë se kjo Frazë e shenjtë ***All-llahu Ekber*** ka ndonjë lidhje me çështjen tonë, Ahiretin. Papritmas m'u shfaq se kjo Frazë së bashku me Fjalët e tjera të bekuara e të mira ***-Subhanall-llah, El Hamdu lil-lah, ve la-i lahe il-lAll-lah-*** dhe të tjera të ngjashme me këtë prej fjalëve të shenjave të Islamit, padyshim të sjellin ndërmend Ahiretitn qoftë në mënyrë të pjesshme ose universale dhe tregojnë realizimin e tij.

Për shembull, një aspekt i kuptimeve të ***All-llahu Ekber*** është se 'Fuqia Hyjnore' dhe 'Njohja Hyjnore' janë më të mëdhaja se çdo gjë; asgjë absolutisht nuk mund të dalë prej sferës së njohjes së Tij, as nuk mund të ikë apo të shpëtojë prej kontrollit të Fuqisë së Tij.

Ai xh.sh. është më i madh se sa çdo gjë e madhe të cilën ne e kemi frikë më shumë dhe që e zmadhojmë. Domëthënë Ai është më i madh se sa bërja e Ringjalljes së të vdekurve, duke na shpëtuar neve nga mosekzistenca, dhe duke na dhënë lumturi të përjetshme. Ai është më i madh se çdo gjë e çuditshme apo e paimagjinueshme e cila del jashtë sferës së mendjes sonë, saqë ashtu siç shprehet qartë nga vërseti,

"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm."[132] ringjallja e njerëzimit është më e lehtë për fuqinë e Tij se sa krijimi i një njeriu të vetëm. Është në lidhje me këtë kuptim që kur çdokush përballet me fatkeqësi të rënda ose me ndonjë gjë të madhe ose me ndonjë sipërmarrje të madhe, thotë: ***All-llahu Ekber, All-llahu Ekber*** duke e bërë këtë Frazë si burim ngushëllimi, forceje dhe mbështetjeje për vetveten.

Po, kjo frazë dhe dy shoqet e saja, domethënë ***Subhanall-llah, vel Hamdu lil-lah*** janë indeksi i të gjitha adhurimeve dhe farat dhe përmbledhjet e namazeve rituale -ashtu siç u tregua në Fjalën e Nëntë; dhe me qëllim që të mbështesin, ngulisin dhe të thellojnë kuptimin e namazit, ato përsëriten në tesbihatet që i ndjekin faljet. Ato janë një përgjigje e fuqishme për pyetjet që burojnë nga çudia, kënaqësia dhe nga frika që ndjen njeriu prej gjërave të çuditshme, të bukura dhe të

[132] Kuran 31:28

jashtëzakonshme që ai i sheh në univers, dhe të cilat e bëjnë atë të bëjë falënderime dhe të ndihet i druajtur prej madhështisë së tyre.

Për më tepër, në fundin e Fjalës së Gjashtëmbëdhjetë përshkruhet se si në një ditë feste një ushtar i thjeshtë dhe një mareshall futen në praninë e mbretit, ndërsa në herët e tjera ushtari ka kontakt me mareshallin vetëm se nëpërmjet shkallës së oficerit dhe nëpërmjet stacionit të tij. E ngjashme me këtë, në një mënyrë të ngjashme me njohjen e Evlijave të drejtë, një njeri që bën haxhin fillon të njohë Zotin e tij të Vërtetë nëpërmjet titullit ***Rabbil Erdi ve Rabbil A'leminë.***

Sa herë që hapen nivelet e madhështisë Hyjnore në zemrën e tij, Fraza ***All-llahu Ekber*** u përgjigjet pyetjeve të përsëritura të çuditshme e të ethshme të cilat e mposhtin shpirtin e tij.

Për më tepër në fund të shkreptimës së trembëdhjetë përshkruhet se si fraza ***Allahu Ekber*** u përgjigjet në mënyrën më efektive dredhive finoke të shejtanit duke i prerë ato nga rrënjët, si dhe i përgjigjet shkurt por fuqishëm çështjes sonë rreth Ahiretit.

Po, ashtu si kjo frazë ***Allahu Ekber*** që i përgjigjet pyetjes sonë rreth Ahiretit në mënyrë konçize dhe njëkohësisht të fuqishme, po ashtu edhe fraza ***El-Hamdu Lilah****, i gjithë lavdërimi i takon Allahut*, gjithashtu na kujton Ringjalljen. Ajo na thotë: "Unë nuk do të kisha asnjë kuptim po të mos kishte Ahiret. Sepse unë them: Allahut i takojnë të gjitha lavdërimet dhe falënderimet që janë paraqitur nga parapërjetësia për tek paspërjetësia, prej cilitdo që ato të jenë dhënë dhe për cilindo, sepse lumturia e përjetshme është origjina dhe kulmi i të gjitha mirësive; dhe është pikërisht ajo e cila e bën mirësinë mirësi të vërtetë që nuk zhduket dhe nuk kalon; dhe është ajo e cila i shpëton të gjitha krijesat e vetëdijshme prej fatkeqësive të mosekzistencës dhe i çliron prej saj; prandaj vetëm lumturia e përjetshme është ajo që mund të jetë e barasvlefshme me atë kuptimin tim universal.

Po, çdo ditë të gjithë besimtarët duke thënë të paktën njëqind e pesëdhjetë herë pas namazve të detyruara: ***El-Hamdu lil-lah*** ashtu siç urdhërohet nga sheriati, dhe qënia e saj shprehja e lavdërimeve dhe falënderimeve e cila shtrihet prej parapërjetësisë në paspërjetësi, ajo sigurisht është çmimi i paradhënë, i parapaguar për fitimin e lumturisë së përjetshme në xhennet, sepse nuk mund të kufizohet kuptimi i lavdërimeve vetëm tek mirësitë e përkohshme kalimtare të kësaj dynjaje të cilat janë të njollosura e të turbulluara me dhimbje, jo, përkundrazi, madje në qoftë se do ta lidhje pikërisht tek ato mirësi, do

të shihje se ato janë vetëm mjete për mirësi të përjetshme të amshuara mbi të cilat është e meritueshme të jepen falënderime.

Sa për frazën e shenjtë ***Subhanall-llah,*** *Lavdia qoftë për Zotin,* me kuptimin e saj të deklarimit të Krijuesit të lartësuar, të pastruar dhe larg çdo ortaku, pa të meta, pa defekte, pa tirani, pa pafuqi, pa mizori, pa nevojë dhe pa dredhi, dhe të gjitha mangësitë që kundërshtojnë plotësinë e Tij, bukurinë dhe lavdinë; ky kuptim të kujton lumturinë e përjetshme dhe tregon Ahiretin dhe Parajsën brenda tij dhe është boshti i lavdisë së Tij xh.sh. i bukurisë, i madhështisë dhe i plotësisë së Sovranitetit të Tij; fraza aludon për to dhe i tregon ato. Sepse ashtu siç është provuar edhe më parë, në qoftë se nuk do të kishte pasë lumturi të përjetshme, atëherë gishtat e akuzës do të drejtoheshin tek madhështia e Tij, tek plotësia, lavdia, bukuria dhe tek mëshira e Tij, dhe do ta njollosnin me mangësi e të meta; Ruajna Zot! Ai xh.sh është i lartësuar dhe i shenjtëruar pafundësisht dhe larg çdo defekti e mangësie!

Domethënë, ekzistenca e Ahiretit nuk ka dyshim, pasi atë e kërkojnë medoemos sovraniteti i All-llahut, plotësia e Tij, madhështia, bukuria dhe mëshira e Tij xh. sh..

Dhe kështu, këto tre fraza të shenjta së bashku me ***Bismil-lahin*** dhe ***La ilahe il-lAll-llah*** dhe me frazat e tjera të bekuara, secila prej tyre është një farë prej farërave të shtyllave të Imanit, dhe secila prej tyre është një përmbledhje për të vërtetat e shtyllave të Imanit dhe për të vërtetat e Kuranit. Dhe ashtu siç janë këto tre fraza bërthamat dhe farërat e pesë namazeve të përditshme, po ashtu ato janë bërthamat e Kuranit kerim, ashtu siç shihet në fillimin e disa sureve të ndritshme duke shkëndijuar si brilantë e xhevahirë vezullzes. Ato gjithashtu janë burimet e vërteta dhe bazat e Risale-i Nurit, shumica e inspirimeve të të cilit vinin në fillim kur po recitoja tesbihatet që ndiqnin faljet; ato janë farërat e të vëtetave të tij.

Ato gjithashtu janë *virdet* e rrugës Muhammedane, që përmenden menjëherë pas namazit brenda një rrethi shumë të gjerë të shenjtërisë dhe të adhurimit të Muhammedit a.s.m., pasi në çdo namaz më shumë se njëqind milion besimtarë në atë rreth të madh dhikri përsërisin bashkarisht tridhjetë e tri herë ***Subhanall-llah***, tridhjetë e tri herë ***Elhamdu lil-lah*** dhe tridhjetë e tri herë ***Allahu Ekber***.

Sigurisht ti duhet ta kesh kuptuar tani vlerën e madhe të recitimit tridhjetë e tri herë pas pesë namazeve të detyruar, në një rreth të tillë madhështor për përmendjen e Zotit xh.sh. secilën prej atyre frazave të

bekuara, që siç u shpjeguan më lartë, janë përmbledhjet dhe farërat edhe të Kuranit, edhe të besimit, edhe të namazeve. Ti gjithashtu ke kuptuar shpërblimin e madh që ato fitojnë.

[Dhe kështu, ashtu si çështja e parë e kësaj trajtese që ishte një mësim i vlefshëm rreth pesë namazeve të detyruara, po ashtu fundi i kësaj trajtese u bë -pa zgjedhjen time- një mësim i rëndësishëm rreth virdeve që ndjekin namazet.]

Lavdi Zotit për mirësitë e Tij.

Lavdi të takon ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti!" [133]

*** * ***

ÇËSHTJA E NËNTË

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"I Dërguari (Muhammedi a.s.m.) beson në çfarë i është zbritur atij nga Zoti i tij dhe po kështu besimtarët (besojnë bashkë me të). Gjithësecili prej tyre beson në All-llahun, në melekët e Tij, në Librat e Tij, në të Dërguarit e Tij. (Ata thanë:) "Ne nuk bëjmë asnjë dallim mes njëri-tjetrit prej të Dërguarve të Tij..."[134]

Një pyetje e madhe dhe një gjendje e veçantë shpirtërore duke buruar nga zbulimi i një mirësie të madhe shpirtërore ishin shkaqet për shpjegimin e një çështjeje të gjatë universale rreth këtij vërseti gjithëpërfshirës, të lartësuar e sublim. Ishte si më poshtë vijon:

---

[133] Kuran 2:32
[134] Kuran 2:285

Në shpirtin tim erdhi kjo pyetje: Përse konsiderohet mosbesimtar ai që mohon një pjesë prej të vëretave të besimit, dhe ai që nuk e pranon një pjesë të tyre nuk mund të jetë mysliman, ndonëse drita e besimit në Zotin dhe në Ahiretin është si dielli që shpërndan e largon çdo errësirë?

Gjithashtu, përse një person i cili mohon njërën nga shtyllat dhe të vërtetat e besimit bëhet apostat -felëshues- dhe kjo e zbret atë në mohimin absolut, dhe ai që nuk e pranon atë del prej sferës së islamit; ndërsa duhet që besimi i tij në shtyllat e tjera -nëse gjendet, nëse beson- ta shpëtonin atë prej mohimit absolut?

Përgjigjja: Besimi është një e vërtetë e vetme e cila, duke buruar e duke u përbërë prej gjashtë shtyllash, nuk mund të ndahet. Ai është universal dhe nuk mund të ndahet në pjesë. Ai është një tërësi, shtyllat e të cilit nuk pranojnë ndarje, copëzim, sepse secila prej atyre shtyllave të besimit provon shtyllat e tjera me provat që provon vetveten. Ato janë prova shumë të fuqishme për njëra-tjetrën.

Prandaj ai që nuk mund t'i mohojë të gjitha shtyllat së bashku me të gjitha provat e tyre, ai në realitet nuk mund të mohojë asnjërën prej shtyllave të besimit, madje as edhe një të vërtetë të vetme prej të vërtetave të tij, dhe nuk mund t'i mohjë ato; veçse në qoftë se mohuesi do t'i mbyllte sytë e tij dhe të kapej pas mospranimit ose pas refuzimit, dhe atëherë të futej në 'mohimin kryeneç', dhe kjo me kalimin e kohës do ta shtynte për tek mohimi absolut, dhe do të humbiste humanizmin e tij dhe do të shkonte në Ferr; edhe fizikisht edhe mendërisht.

Atëherë në këtë stacion, me përkujdesjen e Zotit, ne do ta shpjegojmë këtë çështje të lartë në gjashtë pika në formën e përmbledhjeve të shkurtëra, ashtu si tek frutat e besimit kur duke provuar ringjalljen e të vdekurve, provat e shtyllave të tjera të besimit rreth ringjalljes u shpjeguan në formën e përmbledhjeve konçize.

PIKA E PARË

Besimi në Zotin i provon me provat e tij edhe shtyllat e tjera të besimit edhe besimin në Ahiretin, ashtu siç u shpjegua qartë në çështjen e shtatë të frutave të besimit.

Po, sovraniteti i Hyjnisë, fuqia e saj e parapërjetshme, forca e saj e qëndrueshme, pasuria e saj absolute dhe sundimi Hyjnor i vazhdueshëm i paspërjetshëm të cilat e administrojnë këtë univers të pakufishëm -me të gjithë gjërat e tij të domosdoshme- sikur të administronte një pallat apo një qytet... dhe të cilat i drejtojnë të gjitha çështjet e tij në mënyrë të rregullt e të balancuar, dhe e ndryshojnë atë

në përputhje me urtësitë e shumta... të cilat i drejtojnë të gjitha grimcat dhe planetet, dhe që i pajisin mizat dhe yjet së bashku si ushtarë të bindur e të disiplinuar të një ushtrie të rregullt.. dhe të cilat i shtyjnë të gjitha ato brenda sferës së komandës dhe të vullnetit për tek një paradë madhështore të përgjithshme për adhurim të sinqertë nëpërmjet një manovreje të lartë, një sprove, provimi dhe stërvitjeje për detyra dhe instruksione për to, nëpërmjet një aktiviteti dhe veprimtarie të vazhdueshme dhe nëpërmjet një lëvizjeje dhe udhëtimi të pandërprerë.. A do të ishte e mundur, ose a do të arsyetohej me mend; madje a do të kishte ndonjë mundësi që të mos ndodhej një vend i përjetshëm, një mbretëri e vazhdueshme dhe një shfaqje e amshuar dhe një manifestim i përjetshëm në një banesë të përhershme si shembulli i kësaj mbretërie të përjetshme dhe si ky sundim i përhershëm i vazhdueshëm? Jo! Ruajna Zot! jo, kurrë, një mijë herë jo!

Atëherë sovraniteti i Hyjnisë xh.sh. dhe madhështia e saj, dhe shumica e Emrave të bukur Hyjnorë -ashtu siç erdhi në çështjen e shtatë- dhe të gjitha dëshmitë dhe provat e domosdoshmërisë së ekzistencës së Tij xh.sh. dëshmojnë e tregojnë Ahiretin dhe e kërkojnë medoemos atë.

Kështu shikoje dhe kupto se çfarë mbështetje të fortë ka ky pol besimi, dhe beso në të sikur ta shihje!

• • •

Pastaj besimi në Zot, ashtu siç nuk mund të jetë pa besimin në Ahiret, po ashtu nuk do të arsyetohej me mend po të ishte ‘besimi në Zotin’ pa ‘besimin në profetët’, ashtu siç u përmend në mënyrë të përmbledhur në trajtesën e Ringjalljes.

A do të ishte e mundur dhe a mund ta pranonte arsyeja që Zoti xh.sh. i Cili e krijoi këtë univers, me qëllim që të shfaqë Hyjninë e Tij dhe denjësinë për t’u adhuruar, si një libër i mishëruar çdo faqe e të cilit shpreh një libër me kuptime dhe çdo rresht i të cilit tregon një faqe me kuptime; dhe e krijoi si një Kuran të mishëruar, të gjitha shenjat krijuese, fjalët dhe madje dhe pikat dhe shkronjat e të cilit janë mrekulli që e shenjtërojnë dhe e lartësojnë.. e krijoi në formën e një xhamie të mëshirës së Tij ana e brendshme e së cilës është zbukuruar me mbishkrime dhe me dekore të panumërta, dhe në çdo qoshe të së cilës janë speciet e qënieve secila e preokupuar me adhurimin e diktuar nga natyra e saj për Krijuesin e tyre të Gjithëmëshirshëm..

A do të ishte e mundur që ky Krijues, i Adhuruari i Vërtetë të mos dërgonte profesorë që t’i jepnin mësim kuptimet që gjenden në atë

libër të madh dhe t'i bënin të njohura përmbajtjet e tij.. ose a do të ishte e mundur që Ai të mos dërgonte komentatorë që t'i shpjegonin ajetet -shenjat- e atij Kurani të mishëruar të Krijuesit Absolut?.. Ose a do ishte e mundur që Ai të mos caktonte imamë për atë xhami të madhe që t'u prinim si imamë atyre të cilët e adhurojnë Atë në mënyra dhe në forma të ndryshme ibadeti...? Ose a do të ishte e mundur që Ai të mos i pajiste ato profesorë, komentatorë dhe imamë me dekretet Hyjnore? Jo, Ruajna Zot! Jo, kurrë! Një mijë herë jo!

Pastaj, Krijuesi Mëshirëplotë Gjithëbujar i Cili me qëllim që të shfaqë për qëniet e vetëdijshme bukurinë e mëshirës së Tij dhe mirësinë e dhembshurisë së Tij dhe plotësinë e Hyjnisë së Tij, dhe me qëllim që t'i nxisë ata për ta lavdëruar e falënderuar Atë, e krijoi universin në formën e një shtëpie madhështore gostie, të një ekspozite të madhe të shndritshme, si një vend të mrekullueshëm shëtitjeje në të cilën shfaqen varietete të pafundme prej mirësive të shijshme, dhe janë renditur arte të panumërta të jashtëzakonshme dhe gjëra të mrekullueshme të ndritshme..

A do të ishte e mundur që ky Krijues Mëshirëplotë Gjithëbujar të mos fliste -nëpërmjet profetëve të Tij me ato qënie të vetëdijshme tek kjo gostia e Tij madhështore... dhe a do të arsyetohej me mend që Ai të mos i njoftonte ata për detyrat e tyre të falënderimit dhe për mënyrën e mirënjohjes së tyre ndaj atyre mirësive të mëdha dhe për detyrat e tyre të adhurimit përballë manifestimeve të mëshirës së Tij dhe përballë bërjes së Tij Vetveten të Dashur? Ruajna Zot! Jo, njëqind mijë herë jo!

Pastaj, Krijuesi i Cili e do krijesën dhe artin e Tij, dhe dëshiron të tërheqë admirimin dhe vlerësimin për tek Ai, madje kërkon aprovimin dhe miratimin, siç tregohet nga marrja e Tij parasysh krijimin e mijëra llojeve të shijeve dhe të kënaqësive të gjuhës; Krijuesi xh.sh. e bën të njohur vetveten nëpërmjet secilës prej krijesave të Tij dhe shfaq një lloj prej bukurisë së Tij jolëndore, i do ato dhe e stolisi këtë univers me çudirat dhe mrekullitë e arteve dhe të krijesave të Tij.

A do të arsyetohej me mend që të mos u fliste ky Krijues Mrekullibërës njerëzve, të cilët janë komandantët e qënieve të gjalla në univers? Dhe a do të ishte e mundur që Ai të mos dërgonte profetë prej atyre të shquarve, dhe të mbeteshin ato arte të holla e të bukura pa vlerësim, dhe të mbetej bukuria e atyre Emrave të bukur të jashtëzakonshëm pa admirim e aprovim, dhe të mbeteshin bërja e Tij Vetveten të njohur e të dashur pa vlerësim e pa asgjë si kompensim? Ruajna Zot! Jo, kurrë! Një mijë herë jo!

Pastaj, Folësi i Gjithëditur i Cili u përgjigjet -në kohën e duhur- duave të të gjitha qënieve të gjalla, duke ua përmbushur nevojat e tyre të natyrshme, dhe duke i ndihmuar e pranuar të gjitha lutjet dhe dëshirat që ngrihen për tek Ai nëpërmjet gjuhës së gjendjes, dhe u flet e u përgjigjet qartë me akt e veprim nëpërmjet mirësive dhe dhuratave të Tij të pafundme, të cilat tregojnë qëllim, zgjedhje dhe dëshirë; a do të ishte e mundur dhe a do të arsyetohej me mend që ky Folës i Gjithëditur të fliste me gjallesën më të vogël me veprim e gjendje, i mjekon sëmundjen e saj dhe e ndihmon me mirëbërësinë e Tij, ia plotëson kërkesat e saj, dhe pastaj të mos takohej me udhëheqësit shpirtërorë të njerëzimit, të cilët janë rezultati më i zgjedhur i universit, kalifi i Tij në tokë, komandantët e shumicës së krijesave në tokë?... ose a do të arsyetohej me mend që Ai të mos fliste me ta me fjalë e gojarisht ashtu siç flet Ai me gjallesat me veprim e me gjendje?... ose a do të ishte e mundur që Ai të mos dërgonte me ta dekretet e Tij, fletët dhe librat e Tij të shenjtë?.. Ruajna Zot! Një mijë herë!

Dhe kështu me sigurinë dhe me provat e Tij të panumërta, ‘Besimi në Zotin’ provon ‘Besimin në profetët’ a.s. dhe ‘Besimin në librat e Tij të shenjtë’.

• • •

Pastaj Ai që e bëri universin që të jehonojë e të këndojë me të vërtetën e Kuranit; ai që e njohu dhe e bëri të njohur në mënyrën më të plotë Atë Krijues Mrekullibërës, që e deshi Atë dhe e bëri të dashur; që përmbushi falënderimet ndaj Tij dhe u tregoi edhe të tjerëve që të bëjnë falënderime ndaj Tij; madje e bëri globin tokësor që të deklarojë ***Subhanall-llah, El-Hamdu lil-lah, Allahu Ekber*** saqë i bëri të dëgjojnë edhe qiejt e lartë... Ai që iu përgjigj manifestimit të Hyjnisë së Krijuesit me një adhurim të shtrirë universal; që udhëhoqi një të pestën e njerëzimit në numër dhe gjysmën e tij në cilësi gjatë një mijë e treqind viteve dhe që i solli tokën dhe detin në ekzistencë... Ai që thirri me Kuranin Kerim në veshin e universit dhe në të gjithë shekujt përballë qëllimeve Hyjnore, që dha një mësim të madh, që bëri një thirrje fisnike, duke demonstruar detyrën dhe vlerën e njeriut, dhe duke bërë të qartë shkallën dhe pozitën e tij... Ai është Muhammed Emini a.s.m., i vërteti dhe i vërtetuari me anë të një mijë e një mrekullive të tij.

A do të ishte e mundur që të mos ishte ky rob, ky shërbëtor i dashur, i zgjedhur e i përzgjedhur, profeti më i nderuar i Atij të Adhuruari të Vërtetë xh.sh.?... A do të ishte e mundur që të mos ishte

ai pejgamberi më i madh i Tij? Ruajna Zot! Jo kurrë! Një mijë herë, jo!

Atëherë, e vërteta e ***Eshhedu en la ilahe il-lAll-llah,*** *Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut,* provon me argumentet e saj të vërtetën e ***Eshhedu enne Muhammeden Resulull-llah,*** *Dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Zotit.*

. . .

Pastaj, Krijuesi i cili i bëri krijesat e Tij të flasin me njëra-tjetrën me qindra e mijëra gjuhë e mënyra të foluri, i Cili dëgjon fjalën e të gjithave dhe e njeh atë, a do të ishte e mundur që Ai të mos fliste Vetë?... jo, Ruajna Zot! Pastaj, a do të arsyetohej me mend që Ai të mos i shpallte qëllimet e Tij Hyjnore nëpërmjet një libri madhështor si Kurani Kerim i cili u përgjigjet të trija pyetjeve të mëdha para të cilave turbullohen mendjet: Prej nga vijnë këto krijesa? Ku do të shkojnë ato? Dhe përse ato vijojnë karvan pas karvani, ndalojnë për një kohë, dhe pastaj ikin?... jo, ruajna Zot!

Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm i cili i ka ndriçuar e rrezatuar trembëdhjetë shekujt... i cili në çdo orë shprehet e shqiptohet me respektin e nderimin më të plotë nga njëqind milionë gjuhë... i cili është skalitur e shkruar në kraharorët e miliona hafizëve me të gjithë lartësinë e shenjtërinë, ai që ka qeverisur me ligjet e tij pjesën më të madhe të njerëzimit, që i ka edukuar e zhvilluar shpirtërat e tyre, që i ka pastruar zemrat e tyre dhe që i ka udhëzuar mendjet e tyre... ai që është mrekulli e përjetshme ashtu siç janë provuar dyzet aspektet e mrekullisë së tij në Risale-i Nur, dhe i cili demonstron një aspekt të mrekullisë së tij për secilën prej dyzet klasave të njerëzimit, ashtu siç u shpjegua në Mektubin e Nëntëmbëdhjetë, Mektubin e kerametit të jashtëzakonshëm... ky Kuran madhështor meritoi me të drejtë të quhet *'Fjala e All-llahut'*, dhe profeti Muhammed a.s.m. me mijërat e mrekullive të tij u bë një mrekulli e ndritshme për të.

A do të ishte e mundur që të mos ishte ky Kuran Kerim Fjala e Atij Folësi të parapërjetshëm xh.sh.? Dhe a do të ishte e mundur që ato të mos ishin Dekretet e Atij Krijuesi të përjetshëm? Ruajna Zot! Njëqind herë ruajna Zot! Atëherë, 'Besimi në Zotin' së bashku me argumentet e tij provojnë se Kurani Kerim është "*Fjala e All-llahut xh.sh*.".

. . .

Pastaj, Sulltani i Gjithëlavdishëm i Cili e mbush sipërfaqen e tokës me qënie të gjalla në mënyrë të vazhdueshme dhe e boshatis atë, dhe e

mbush këtë botë me qënie të vetëdijshme me qëllim që ta bëjë Vetveten të njohur, të adhuruar dhe të lavdëruar...

A do të ishte e mundur që ky Sulltan i Gjithëlavdishëm t'i linte të zbrazur qiejt dhe yjet, dhe të mos i mbushte ato pallate qiellorë me banorë e me qënie të përshtatshme për to?...

A do të ishte e mundur që ky Sulltan Madhështor ta linte sovranitetin e Hyjnisë së Tij në më të shtrirën e mbretërive të Tij pa dinjitet e madhështi, pa shërbëtorë, pa funksionarë, pa përfaqësues emisarë, pa kontrollues mbikëqyrës, pa shikues admirues, pa rob të nderuar dhe pa subjekte të bindur? Ruajna Zot! Sa numri i melekëve ruajna Zot!

Pastaj, Sundimtari i Gjithurtë dhe i Gjithëdituri Mëshirëplotë i Cili e shkroi këtë univers në formën e një libri regjistroi të gjithë historinë e jetës së çdo pemeje në secilën prej bërthamave të saj; dhe shkroi në farërat e barit, të bimëve dhe të luleve të gjitha detyrat e tyre jetike, dhe regjistroi saktësisht jetët e qënieve të vetëdijshme në memoriet e tyre aq të vogla sa farat e sinapit dhe ruajti me fotografitë e panumërta të gjitha aktet dhe ngjarjet në të gjithë sundimin e Tij dhe në të gjitha epokat e sovranitetit të Tij; i Cili krijoi xhehennemin, urën e Siratit dhe Peshoren më të madhe -shkallët më të larta të drejtësisë- për hir të manifestimit dhe realizimit të drejtësisë, urtësisë dhe mëshirës të cilat janë baza më e rëndësishme e Hyjnisë...

A do të ishte e mundur për këtë Sundimtar të Gjithurtë dhe për këtë të Gjithëditur Mëshirëplotë që të mos i regjistrojë veprat e njeriut të cilat lidhen me qëniet?...

A do të ishte e mundur që Ai të mos i regjistrojë punët e njeriut për shpërblim e ndëshkim dhe të mos i shkruajë gabimet dhe të mirat e tij në pllakat e paracaktimit Hyjnor?

Ruajna Zot! Sa numri i shkronjave të shkruara në Pllakën e Ruajtur të Kaderit.

Domethënë, e vërteta e 'Besimit në Zotin' së bashku me argumentet e saj provojnë të vërtetën e 'Besimit në Melekë' ashtu siç provojnë në mënyrë të sigurt të vërtetën e 'Besimit në Kaderin Hyjnor'. Shtyllat e besimit e provojnë njëra-tjetrën aq qartë siç shfaq dielli ditën, dhe ashtu siç tregon dita diellin.

PIKA E DYTË

Të gjitha mësimet dhe pretendimet e librave qiellorë dhe të shkrimeve të shenjta me në krye Kuranin, dhe pretendimet e të gjithë

profetëve -me në krye profetin Muhammed a.s.m.- vërtiten mbi baza të qëndrueshme dhe mbi shtylla të përcaktuara. Ato të gjithë janë përpjekur në mënyrë të vazhdueshme për t'i dhënë mësim tek të tjerët dhe për t'i provuar ato pika bazë. Të gjitha provat dhe dëshmitë të cilat dëshmojnë për profetësinë dhe vërtetësinë e tyre orientohen e shohin tek ato shtylla e baza, duke mbështetur vërtetësinë e tyre. Ato themele e baza janë "besimi në Zotin", "besimi në melekët e tij", "në të Dërguarit e tij", dhe në kaderin, e mira tij dhe e keqja e tij janë prej Allahut xh.sh..

Atëherë është krejtësisht e pamundur të bësh ndarje midis gjashtë shtyllave të besimit, pasi secila shtyllë i provon të gjitha shtyllat e tjera, i kërkon të gjitha ato dhe i bën të domosdoshme. Prandaj, të gjashtë shtyllat janë si një tërësi, një universale të cilat nuk mund të copëtohen në pjesë dhe ndarja e të cilave është jashtë limiteve të mundësisë. Ashtu si pema e bekuar Tuba rrënjët e së cilës shtrihen në qiej, dhe secila nga degët e saj secili frut dhe secila nga gjethet e asaj Peme madhështore mbështeten tek jeta e përjetshme e asaj Peme, dhe askush nuk mund të mohojë jetën e një gjethi të vetëm që lidhet me atë pemë në qoftë se nuk do të mundej të mohonte jetën e asaj peme të dukshme e cila është aq e qartë si dielli; në qoftë se do ta mohonte, atëherë ajo pemë do ta përgënjeshtronte me numrin e degëve të saj, të frutave dhe të gjetheve dhe do ta bënte të heshtë; po ashtu Imani -besimi- me gjashtë shtyllat e tij është e ngjashme me këtë.

Në fillimin e këtij 'Stacioni', unë synova t'i shpjegoja gjashtë shtyllat e besimit në tridhjetë e gjashtë pika, secila me pesë nënndarje. Gjithashtu unë synova t'i përgjigjesha e ta shpjegoja më mirë e më shumë pyetjen e madhe që erdhi në fillim. Mirëpo disa pengesa e rrethana të papritura nuk e lejuan këtë. Unë mendoj se pika e parë nuk lë nevojë për sqarim të mëtejshëm për njerëzit inteligjentë, pasi ajo është një kriter i mjaftueshëm për temën.

U kuptua plotësisht se në qoftë se një musliman mohon njërën nga shtyllat e besimit, ai bie në mosbesim absolut. Sepse përballë shpjegimeve të përmbledhura të feve të tjera, islami i shpjegon dhe i shtjellon ato plotësisht e në mënyrë të detajuar, dhe shtyllat e besimit janë të lidhura së bashku. Muslimani i cili nuk e njeh Muhammedin a.s.m. dhe nuk e pranon atë, ai nuk e njeh as Zotin xh.sh. -me Atributet e Tij- dhe nuk e njeh as Ahiretin... atëherë besimi i muslimanit bazohet mbi prova të tilla të fuqishme të patundura dhe të panumërta saqë nuk ka asnjë arsye për mohim. Ato, mjaft thjesht, e detyrojnë arsyen t'i pranojë.

PIKA E TRETË

Një herë unë thashë: ***El-Hamdu lil-lah,*** pastaj kërkova për një mirësi e cila do të ishte e barasvlefshme me kuptimin e saj pafundësisht të gjërë. Papritmas, m'u shfaq fjalia vijuese: ***"****El-hamdu lil-lahi Alal Imani bil-lah, ve ala vahdanijjetihi, ve ala vuxhubi vuxhudihi, ve ala Sifatihi, ve Esma'ihi, hamden biadedi texhe-lijjati Esma'ihi minel- Ezeli ilel Ebedi".*

"I Gjithë lavdërimi qoftë për Zotin për besimin në Zot, dhe për unitetin e Tij, për ekzistencën e Tij të domosdoshme, për Atributet e Tij dhe për Emrat e Tij, sa numri i manifestimeve të Emrave të Tij prej parapërjetësisë për tek paspërjetësia".

Unë hodha vështrimin në të dhe e gjeta plotësisht të përshtatshme për kuptimin... që është sa vijon...

. . .

ÇËSHTJA E DHJETË

ÇËSHTJA E DHJETË E TRAJTESËS SË FRUTEVE TË BESIMIT QË ËSHTË RREZJA E NJËMBËDHJETË

NJË LULE E EMIRDAGUT

Një përgjigje shumë e fuqishme për kundërshtimet që ngrihen kundra përsëritjes në Kur'an.

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Për shkak të gjendjes sime të mjerueshme, kjo çështje është disi e ngatërruar dhe e pagjashme. Por unë kuptova se nën këto shprehje të ngatërruara, sigurisht ndodhej një lloj shumë i vlefshëm i mrekullisë, por fatkeqësisht unë nuk isha i aftë për ta shprehur atë. Megjithatë, sado të pangjyra të jenë shprehjet, meqenëse lidhen me Kur'anin, ato janë edhe "Adhurim në formë reflektimi" edhe "sedef" për një xhevahir të shenjtë, të lartë e të ndritshëm. Diamanti në dorë është ai që duhet të shikohet dhe jo sedefi a mbulesa e tij e grisur. Gjithashtu, unë shkrova në një a dy ditë gjatë muajit të Ramazanit ndërsa isha shumë i sëmurë dhe në gjendje të mjerueshme e pa ushqim, nga domosdoshmëria, në mënyrë të përmbledhur e shkurt, dhe duke përfshirë të vërteta e prova të shumta në një fjali të vetme. Prandaj, të mos merren në konsideratë mangësitë e saja.[135]

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ndërsa po lexoja Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm në muajin e Bekuar të Ramazanit, po reflektoja thellë në kuptimet e tridhjetë e tre vërseteve që aludojnë për Risale-in Nurin në Rrezen e parë, ku cilido vërset prej atyre që më dilte para, unë shikoja se faqja, fleta dhe tregimi i vërsetit gjithashtu shikonin tek Risale-i Nuri dhe tek studentët e tij, nga këndvështrimi i marrjes së tyre një pjesë prej tregimit dhe kuptimit, e sidomos prej vërsetit të *Dritës* tek sureja *En-Nur*; ato vërsete tregojnë e aludojnë me dhjetë gishtërinjtë për Risale-in Nurin; gjithashtu edhe vërsetet e errësirës që vijnë pas atij vërseti,

[135]Ashtu si Çështja e Dhjetë e frutit të burgut të Denizlit, ajo është një lule e vogël e shndritshme e Emirdagut dhe e këtij muaji të Ramazanit të Bekuar. Duke shpjeguar një shembull urtësie për përsëritjen në Kur'an, ajo i largon iluzionet helmuese të njerëzve të çudhëzimit.(Autori)

tregojnë e aludojnë drejtpërdrejt për ata që e luftojnë dhe e kundërshtojnë Risale-in Nurin; këto madje, u japin atyre një pjesë më të madhe. Unë kuptova mjaft qartë se ky "stacion" ngrihet nga veçantia për tek përbotshmëria, dhe se një pjesë e asaj përbotshmërie është Risale-i Nuri dhe studentët e tij në këtë shekull.

Vërtet, në lidhje me gjërësinë, lartësinë dhe gjithëpërfshirjen që merr Fjalimi i Kur'anit nga stacioni i gjërë Absolut i Hyjnisë universale, i Folësit të parapërjetësisë, dhe nga stacioni i madh i atij të cilit iu adresua ky libër në emër të të gjitha qënieve nga stacioni i gjërë i udhëzimit të të gjithë njerëzimit në të gjithë shekujt, dhe nga stacioni i shpjegimit më të lartë e gjithëpërfshirës të ligjeve Hyjnore që lidhen me Dynjanë e Ahiretin, me qiejt e tokën, dhe me parapërjetësinë e paspërjetësinë, ato ligje që i përkasin Hyjnisë së Tij si Krijues i universit dhe që përfshijnë të gjitha qëniet; ky fjalim shfaq një mrekulli të tillë të lartë e një gjithëpërfshirje, saqë si niveli i tij i thjeshtë e i dukshëm, që u bën qejfin e i bën të ndihen të nderuar mendjet e thjeshta të njerëzve të zakonshëm –të cilët janë pjesa më e madhe që Kur'ani u adresohet –po ashtu edhe niveli i tij më i lartë– shtresa më e kulturuar dhe e arsimuar–, marrin pjesë prej tij.

Ai sikur i adresohet çdo shekulli e çdo klase të njerëzimit, jo si një pjesë e historisë apo si një mësim nga një tregim historik, por si një pjesë e një parimi universal, sikur ai të shpallej rishtas. Dhe në mënyrë të veçantë kërcënimet e tij të përsëritura shpesh:

اَلظَّالِمِينَ ۞ اَلظَّالِمِينَ *"për keqbërësit... për keqbërësit"*

dhe paralajmërimet e tij të ashpra për ardhjen e fatkeqësive qiellore e tokësore për shkak të gjynaheve të tyre dhe padrejtësive –përmes këtyre dhe ndëshkimit që u ra popujve të Adit, Themudit dhe Faraonit, ai– me këtë përsëritje- u tërheq vëmendjen për padrejtësitë e pakrahasueshme të këtij shekulli, dhe nëpërmjet përmendjes së shpëtimit të profetëve, si shpëtimi i Ibrahimit a.s. dhe i Musait a.s., ai u jep ngushëllim e qetësi besimtarëve të cilëve u bëhet padrejtësi.

Vërtet, për të gjitha kohët e shkuara dhe epokat e shekujt e kaluar që, nga pikëpamja e pakujdesisë dhe e çudhëzimit, formojnë një vend të lemerishëm e të tmerrshëm të mosekzistencës dhe një varrezë të dhimbshme e të rrënuar, ***Kur'ani i Shpjegimit të Mrekullueshëm*** i tregon çdo shekulli dhe çdo klaseje njerëzore, në formën e faqeve të gjalla instruktive, botët e çuditshme që jetojnë e që janë të pajisura me shpirtëra, dhe botët ekzistuese të Krijuesit Furnizues të cilat lidhen me

ne; me një mrekulli të lartë ai ndonjëherë na përcjell neve tek ato kohë dhe disa herë i sjell ato kohë tek ne. Duke gjallëruar e duke i dhënë jetë universit, që nga pikëpamja e çudhëzimit është i pajetë, i mjerë, i vdekur dhe një zonë e shkretë e pafund duke u rrotulluar përmes ndarjes e tatëpjetës, me të njëjtën mrekulli, ky i njëjti **Kur'an i kalibrit të fuqishëm**, i sjell në jetë ato qënie të vdekura, i bën ato të bisedojnë me njëra-tjetrën si nëpunës të ngarkuar me detyra dhe të shpejtojnë për të ndihmuar njëri-tjetrin; ai i instrukton njerëzimin, xhindet dhe engjëjt me urtësinë e vërtetë, të shndritshme e të kënaqshme. Atëherë, ai me siguri fiton shquarsi, dallueshmëri të shenjta Hyjnore e tituj të lartë nderi, si ndodhja e dhjetë të mirave dhe meritave në secilën nga shkronjat e tij dhe ndonjëherë njëqind, njëmijë apo mijëra merita; dhe sikur xhindet e njerëzit të mblidheshin bashkë, qënia e tyre të paaftë për të nxjerrë si shembulli i tij; dhe fjala e tij krejtësisht e përshtatshme me të gjithë njerëzimin e me të gjitha qëniet; dhe qënia e tij i skalitur gjithmonë me entuziazëm e dëshirë të fortë në zemrat e miliona *hafizëve*; mosdhënia e tij mërzitje nga përsëritjet e tij të shpeshta e të shumta; dhe pavarësisht shumë vendeve e fjalive të tij të mbuluara e të fshehura, vendosja e tij në mënyrë të plotë në mendjet e fëmijëve delikatë; dhe qënia e tij i këndshëm si uji i Z*emzemit* në veshët e të sëmurëve dhe të atyre që janë në grahmat e vdekjes, të cilët shqetësohen edhe nga fjala më e vogël; dhe dhënia e tij lumturi për studentët e tij në këtë botë dhe në tjetrën.

Dhe rrjedhshmëria e stilit të tij, i cili, duke iu përmbajtur e respektuar plotësisht qënien analfabet të përçuesit të tij, nuk lejon fjalë të fryra, artificializëm apo shtirësi, dhe zbritja e tij direkt nga qiejt e demonstron një mrekulli të tillë. Gjithashtu ai tregon një mrekulli të hollë në hijeshinë dhe udhëzimin e mendjeve të thjeshta të njerëzve të zakonshëm duke u bërë qejfin atyre –të cilët përbëjnë shumicën e klasave të njerëzimit– përmes zbritjes e begenisë në shprehjet e tij me qëllim që t'u afrohet shkallëve të tyre të të kuptuarit, e duke hapur përpara tyre fletët e qarta, që shfaqen në mënyrë të vetëkuptueshme si qiejt e toka... dhe duke dhënë mësim mrekullitë e çuditshme të fuqisë dhe rreshtat kuptimplotë të urtësisë nën ato gjëra të zakonshme.

Dhe me qëllim që të bëjë të ditur se ai është gjithashtu një libër lutjeje e faljeje, libër thirrjeje, përmendjeje dhe libër i Njësisë Hyjnore të cilat kërkojnë përsëritje, ai demonstron një llojë mrekullie duke bërë të kuptueshme në një fjali të vetme dhe në një tregim të vetëm, përmes përsëritjeve të tij të këndshme, kuptime të shumta të ndryshme për klasa të shumta të ndryshme të njerëzimit. Gjithashtu, me qëllim që të bëjë të njohur se gjërat më të vogla e më të holla në ngjarjet e

zakonshme janë brenda shikimit të Mëshirës së të Gjithëmëshirshmit, brenda sferës së rregullimit të Tij dhe Dëshirës së Tij, ai demonstron një lloj mrekullie duke u dhënë rëndësi edhe ngjarjeve më të vogla që u ndodhën sahabëve, shokëve të profetit Muhammed a.s.m. në themelimin e Islamit dhe në kodifikimin e sheriatit dhe me to ai shfaq rregulla Hyjnore që veprojnë në univers si dhe ligje gjithëpërfshirëse. Përveç kësaj, ai shfaq se ato ngjarje të pjesshme të cilat janë si farëra në themelimin e Islamit e të sheriatit në përgjithësi, do të prodhonin në vijim të kohërave frutat më të rëndësishëm.

Në lidhje me përsëritjen, duke qenë e domosdoshme për shkak të përsëritjes së nevojës, përsëritja e disa vërseteve që, si përgjigje e pyetjeve të shumta të përsëritura gjatë një periudhe njëzet vjeçare dhe që instruktoi nivele të ndryshëm dhe të shumtë njerëzish, nuk është gabim. Ai përsërit fjali që kanë mijëra rezultate dhe përsërit udhëzime që janë përfundime të dëshmive të pafund, të cilat përshkruajnë një revolucion e ndryshim të madh, të tmerrshëm e gjithëpërfshirës që duke shkatërruar plotësisht universin e madh dhe duke ndryshuar formën e tij tek Dita e Gjyqit të madh, do të zhdukë Dynjanë dhe do të themelojë Ahiretin madhështor në vend të tij dhe do të provojë se të gjitha të pjesshmet e të tërat duke filluar nga atomet gjer tek yjet janë në Dorën e Qënies së Vetme, Krijuesit, dhe nën drejtimin e Tij. Ai gjithashtu i përsërit tek shpjegimi i inatosjes Hyjnore dhe i zemërimit Hyjnor ndaj gjynaheve, padrejtësive të njeriut, te shkelja dhe kundërshtimi i qëllimit të krijimit për shkak të rezultatit të krijimit të universit, ato padrejtësi e gjynahe shkaktojnë trazirën e qënieve dhe bëjnë të zemërohen toka, qiejt dhe elementet; të përsërisësh vërsete të tilla nuk është gabim, por mrekullia më e fuqishme dhe elokuenca më e lartë; është një elokuencë e një stil i ndritur e i qartë që i korrespondon ekzaktësisht kërkesave të rrethanave.

Për shembull, siç është shpjeguar në Shkreptimën e Katërmbëdhjetë të Risale-i Nur, fjalia  *"Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti",* duke qenë një vërset i vetëm dhe duke u përsëritur njëqind e katërmbëdhjetë herë në Kur'an, është një e vërtetë e madhe e cila lidh Fronin Hyjnor me tokën dhe ndriçon kozmosin dhe i nevojitet gjithkujt në çdo kohë; ajo sikur të përsëritej me miliona herë, akoma do të kishte nevojë për të. Për të lind nevoja e dëshira jo vetëm çdo ditë si buka, por çdo minut si ajri e drita.

Dhe për shembull, vërseti, إِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ *"Dhe sigurisht Furnizuesi yt është i Lartë në Fuqi, i Gjithëmëshirshmi"*, që përsëritet tetë herë në Suren, طسم (sure el-Shuara). Duke e përsëritur këtë të vërtetë që ka fuqinë e mijëra të vërtetave për shkak të rezultatit të krijimit të universit dhe në Emrin e Hyjnisë universale Absolute, duke përmendur shpëtimin e profetëve, historitë e të cilëve tregohen në sure dhe ndëshkimet e popujve të tyre, kjo përsëritje bëhet me qëllim që të sqarojë se Dinjiteti Hyjnor kërkon torturimin e atyre popujve zullumqarë e tiranë dhe se Mëshira Hyjnore, gjithashtu, kërkon shpëtimin e profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta. Atëherë, ky vërset sikur të përsëritej me mijëra herë, akoma do të shfaqej nevoja e malli për të. Përsëritja këtu është një elokuencë e hollë dhe një mrekulli e lartë e mahnitshme.

Dhe për shembull, vërseti, فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ

"Atëherë pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhinde) e mohoni!"[136] i cili përsëritet në suren *Er-Rrahman*, po ashtu edhe vërseti, وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ *"Mjerë ajo Ditë për mohuesit (e Ditës së ringjalljes)"*[137], në suren *El-Murselat*, bërtasin në fytyrën e të gjithë shekujve duke kërcënuar njerëzimin dhe xhindet dhe shpallin qartë në zonat e qiejve e të tokës se mohimi i mirësive të Zotit nga xhindet e njerëzit, mosbesimi, mosmirënjohja dhe padrejtësitë e tyre shkaktojnë zemërimin e universit dhe e bëjnë tokën e qiejt të inatosen kundër atyre që prishin rezultatet e Krijimit të botës, që mohojnë e i përgjigjen me mospërfillje Madhështisë së rregullit Hyjnor dhe që shkelin në mënyrë agresive të drejtat e të gjitha krijesave. Atëherë, në qoftë se një mësim kaq i përgjithshëm, që lidhet me mijëra të vërteta dhe që ka fuqinë e rëndësinë e mijëra çështjeve, do të përsëritej me mijëra herë, akoma do të ndihej nevoja për të, për përmbledhjen e tij madhështore dhe për elokuencën e bukur e të mrekullueshme.

Dhe për shembul, përsëritja e frazës,

سُبْحَانَكَ يَا لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ الْأَمَانُ الْأَمَانُ خَلِّصْنَا وَأَجِرْنَا وَنَجِّنَا مِنَ النَّارِ

[136] Kur'an 55:13
[137] Kur'an, 77:15

Lavdia të takon Ty, nuk ka zot tjetër përveç Teje! Mëshirë! Mëshirë! Na ruaj, na mbro e na shpëto nga zjarri i Xhehenemit!


te duatë e profetit Muhammed a.s.m. të quajtura ***Xhevshen el-Kebir***, të cilat i përshtaten të vërtetës së Kur'anit dhe është një lloj i përmbledhjes që buron prej tij. Meqenëse ai përmban të vërtetën më të madhe si Njësia dhe më të rëndësishmen e tre detyrave më të mëdha të krijesave përpara Hyjnisë, përmendjet e Zotit, lavdërimet, dhe shenjtërimin e Tij; dhe meqenëse çështja më e madhe e njerëzimit është shpëtimi i tij nga Ferri e mjerimi, dhe synimi më i domosdoshëm i adhurimit dhe i pafuqisë njerëzore është duaja, atëherë edhe sikur ajo të përsëritej me mijëra herë, do të ishte akoma pak.

Kështu, përsëritja në Kur'an shikon e synon parime të fuqishme si këto: Ndonjëherë, madje në një faqe, në lidhje me kërkesat e pozitës dhe nevojës për shpjegim dhe në lidhje me kërkesat e elokuencës, ai shpreh të vërtetën e Unitetit Hyjnor ndoshta njëzet herë, në mënyrë të qartë e të nënkuptuar. Përsëritja nuk shkakton mërzi, por ajo ngjall një fuqi mallëngjimi dhe një ëmbëlsi për përsëritjen e leximit. Përmes përsëritjes elokuenca shton fuqi e lartësi pa shkaktuar mërzi e lodhje. Është shpjeguar në Risale-in Nur me prova vendimtare se sa me vend, të përshtatshme dhe të pranueshme, për sa i përket retorikës, janë përsëritjet në Kur'an.

Urtësia dhe kuptimi i sureve të Kur'anit të Shpjegimit të Mrekullueshëm që u shpallën në Mekë nga ato që u shpallën në Medine, në lidhje me elokuencën, mrekullinë e thukëtinë e stilit, është siç vijon: Në Mekë rreshti i parë i atyre të cilëve Kur'ani u adresohej dhe i atyre që e kundërshtonin atë ishin idhujtarët e kurejshit që ishin analfabetë e të paditur, kështu një stil kaq i fuqishëm e i lartë në lidhje me retorikën ishte i domosdoshëm. Atëherë në shumicën e sureve që u shpallën në Mekë, duke i përsëritur e duke i shprehur shtyllat e besimit dhe shkallët e Njësisë Hyjnore me përmbledhjen më të fuqishme, më të lartë e të mrekullueshme, ai provon aq fuqishëm krijimin e parë, ringjalljen, All-llahun dhe Ahiretin, jo vetëm në një faqe të vetme, në një vërset, fjali apo fjalë, por ndonjëherë në një shkronjë përmes mjeteve gramatikore, si duke ndryshuar vendet e fjalëve apo të fjalive, duke bërë një fjalë të pashquar, si dhe përmes heqjes e përfshirjes, saqë gjenitë dhe udhë-heqësit e shkencës së retorikës e takuan dhe e shikuan atë me habi. Risale-i Nuri, "Fjala e Njëzet e Pestë" dhe veçanërisht shtojcat e saj, të cilat provojnë shkurtimisht dyzet aspektet e mrekullisë së Kur'anit; gjithashtu komenti i Kur'anit *Isharatul-ixhaz* nga Risale-i Nuri arabisht në mënyrë të mrekullueshme provon

aspektin e mrekullisë së Kur'anit në lidhje me renditjen e fjalëve të tij. Në fakt, ato dy trajtesa kanë provuar se në suret që u shpallën në Mekë dhe në vërsetet e tyre janë stilet më të larta të elokuencës dhe mrekullia më e lartë dhe e përmbledhur.

Sa për suret që u shpallën në Medine dhe vërsetet, meqenëse rreshti i parë i atyre të cilëve ato iu adresuan dhe i atyre të cilët i kundërshtuan ato ishin *njerëzit e librit* –çifutët dhe krishterët– të cilët e pranojnë ekzistencën e Zotit, atëherë rregullat e elokuencës, stilet e udhëzimit dhe bazat e thirrjes për te e drejta kërkonin që fjalimi, i cili u adresohej *njerëzve të librit* –çifutëve dhe krishterëve– t'i përgjigjej realitetit të situatës së tyre; kështu, çfarë kërkohej nga ato rregulla nuk ishte shpjegimi i parimeve të larta dhe i shtyllave të besimit në një stil të thjeshtë, të qartë e të hollësishëm, por shpjegimi i çështjeve të veçanta të sheriatit dhe i urdhëresave të tij, të cilat ishin shkak kundërshtie dhe origjinat e shkaqeve të çështjeve dytësore dhe të ligjeve të përgjithshme. Kështu, në suret që u shpallën në Medine dhe në vërsetet, përmes shpjegimeve në stil të detajuar, të qartë e të thjeshtë dhe në mënyrë të pakrahasueshme shpjegimi tipik për Kur'anin, ai në pjesën më të madhe përmend brenda atyre çështjeve të veçanta dytësore një përmbledhje të fuqishme e të lartë, një konkluzion e provë, një fjali që lidhet me Njësinë Hyjnore, me Emrat Hyjnore ose me Ahiretin; e bën çështjen e veçantë të sheriatit të përgjithshme dhe siguron se ajo përputhet me besimin tek Zoti xh.sh.**.** Ajo pozitë e qartë e ndriçon atë pjesë, e lartëson dhe e përgjithëson. Risale-i Nuri i ka provuar cilësitë, pikat e holla dhe elokuencën e lartë në përmbledhjet e përfundimet, të cilat shprehin Njësinë Hyjnore dhe që vijnë kryesisht te fundet e vërseteve, si,



"Në të vërtetë Zoti është i Gjithëfuqishmi mbi gjithçka." "Sigurisht Zoti ka njohuri për gjithçka", "Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti", "Ai është i Larti në Fuqi i Gjithëmëshirshmi."

Në shpjegimin e Rrezatimit të Dytë në Dritën e Dytë tek Fjala e Njëzet e Pestë, dhjetë prej shumë pikave të holla e prej cilësive të atyre përmbledhjeve e përfundimeve, ai ka provuar për kryeneçët se tek ato ndodhet një mrekulli më e lartë. Po, në shpjegimin e atyre çështjeve

dytësore të sheriatit dhe të ligjeve të jetës sociale, ai i ngre shikimet e atyre të cilëve u adresohet për tek çështjet e larta e të përgjithshme, dhe e transformon stilin e thjeshtë në stil të lartë, tamam sikur ai e kalon lexuesin nga mësimi i sheriatit për tek mësimi i Njësisë Hyjnore, kjo vërteton se Kur'ani është një libër sheriati, rregullash dhe urtësie; gjithashtu ai është libër i parimeve të fesë dhe i besimit, libër lutje, mendimi e thirrje. Dhe përmes mësimit të shumë qëllimeve të udhëzimit Kur'anor në çdo pjesë, ai shfaq një elokuencë brilante e të mrekullueshme, të ndryshme nga ajo e sureve që u shpallën në Mekë.

Ndonjëherë në dy fjalë, për shembull, te رَبُّ الْعَالَمِينَ *"Zoti i të gjitha botëve"* dhe رَبُّكَ *"Zoti yt",* ku përmes frazës رَبُّكَ *"Zoti yt"* ai shpreh Njësinë Hyjnore dhe përmes رَبُّ الْعَالَمِينَ *"Zoti i të gjitha botëve"* shpreh Unitetin Hyjnor. Duke ditur se Njësia përmban Unitetin. Madje ai stil elokuence mund të shikojë tek një fjali e vetme dhe të tregojë, si shembull, depërtimin e Njohurisë së Tij tek vendosja e grimcës në beben e syrit dhe vendosja e diellit në mes të qiellit, dhe tek gjithëpërfshirja e Fuqisë së Tij e Cila vendos me një vegël të vetme çdo gjë në vendin e vet, duke e bërë diellin sikur të ishte një sy për qiellin.

Dhe për shembull, pas vërsetit, خَلَقَ السَّمٰوَاتِ وَالْأَرْضَ *"I Cili krijoi qiejt e tokën",*

duke ndjekur vërsetin, يُولِجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَيُولِجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ *"Ai ndërfut natën te dita, dhe Ai ndërfut ditën te nata."*[138]

Ai thotë: وَهُوَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ *"Sigurisht që Ai është i Gjithëdituri i asaj që është në gjokse (në zemrat e njerëzve)."*[139]

Ai thotë: **"*Brenda madhështisë së krijimit të tokës e të qiejve, Ai njeh e rregullon gjithashtu mendimet e zemrës.*"** Dhe përmes shpjegimit të këtij lloji e transformon atë nivel të thjeshtë e të paditur dhe veçanërisht diskutimin që marrin parasysh mendjet e njerëzve të

[138] Kur'an, 35:13
[139] Kur'an, 35:38

zakonshëm, në një bisedim të lartë, tërheqës e të përgjithshëm për qëllimin e udhëzimit.

***Një pyetje*:** "Meqenëse për arsye se një e vërtetë e rëndësishme ndonjëherë nuk është e dukshme për shikimet sipërfaqësore dhe, meqenëse në disa pozita lidhja nuk njihet në shprehjen e përmbledhjes së lartë që i përket Njësisë Hyjnore apo një parimi të përgjithshëm midis një ngjarjeje të pjesshme e të zakonshme, disa e imagjinojnë se ka mangësi në elokuencë. Për shembull, duke përmendur parimin shumë të lartë, وَفَوْقَ كُلِّ ذِي عِلْمٍ عَلِيمٌ *"Por përmbi të gjithë ata që janë të pajisur me dije, është Një i Gjithëdituri (All-llahu)."*[140]

te Hazreti Jusufi a.s., duke strehuar vëllanë e tij me marifet, kjo nuk shfaqet të jetë në ruajtje me elokuencën. Cili është kuptimi i tij dhe urtësia në të?"

***Përgjigjja*:** Në shumicën e sureve të gjata dhe në ato me gjatësi mesatare që secila është si një Kur'an i vogël, dhe në shumë faqe e pjesë nuk ndiqen vetëm dy apo tre qëllime prej katër qëllimeve të Kur'anit, që janë: *Njësia Hyjnore, profetësia, ringjallja dhe drejtësia me ibadetin*, por secila përmban natyrën e Kur'anit dhe katër qëllimet përnjëherësh. Domethënë, secila prej tyre është libër përmendjeje, besimi, reflektimi, libër sheriati, urtësie dhe libër udhëzimi. Dhe kështu, meqenëse secila përshkruan treguesit madhështorë të Hyjnisë dhe gjithëpërfshirjen e të gjitha gjërave, duke qenë një lloj recitimi i librit madhështor të universit, në çdo diskutim dhe ndonjëherë në një faqe të vetme, Kur'ani ndjek shumë qëllime; ndërsa duke dhënë mësim në njohjen e Zotit, në shkallët e Njësisë Hyjnore dhe në të vërtetat e besimit, edhe në qoftë se me një lidhje të dobët në dukje, ai hap një subjekt tjetër udhëzuesi në pjesën vijuese dhe i bashkangjit lidhje të fuqishme të dobtës. Kështu, stili i korrespondon plotësisht diskutimit që kërkon ajo pozitë dhe rrit nivelin e elokuencës.

***Një pyetje e dytë*:** "Cilat janë urtësia dhe qëllimi i Kur'anit që i provon me mijëra herë Ahiretin, Njësinë Hyjnore dhe shpërblimet e dënimet e njeriut, që tërheq vëmendje për tek ato në mënyrë të qartë, të nënkuptuar e me aluzione dhe i jep ato mësim në çdo sure, në çdo faqe dhe në çdo diskutim?"

***Përgjigjja*:** Kur'ani i jep mësim njeriut dhe i tërheq vëmendjen për tek çështjet më të rëndësishme, më domethënëse e më të mëdha që

[140] Kur'an, 12:76

ndodhin midis krijesave e mundësive, dhe për ndryshimet e historisë së universit që lidhet me detyrën e njeriut dhe me mjetet e mjerimit të tij apo të lumturisë – njeriu i cili mori përsipër detyrën e amanetit, si ***kalif***, zëvendës i Zotit në tokë–, dhe në të njëjtën kohë Kur'ani zhduk dyshimet e shumta që i vijnë njeriut pa ndërprerje, dhe dërrmon mohimet e llojeve të tërbuara dhe kokëfortësinë. Kështu, Kur'ani e bën njeriun t'i mbështesë e t'i besojë ato revolucione të mëdha dhe që t'u parashtrojë atyre çështjet thelbësore më të domosdoshme të cilat janë aq të mëdha sa revolucionet e ndryshimet, atëherë në qoftë se Kur'ani tërheq vëmendjen e tij për tek ato me mijëra herë dhe me miliona herë, kjo nuk do të quhej kurrë tepri në elokuencë, dhe ato diskutime duhet të lexohen pasi nuk ka më të rëndësishme e më të mëdha se sa ato. Ato nuk shkaktojnë mërzi, dhe nevoja nuk mbaron për t'i përsëritur e lexuar me miliona herë.

Për shembull, meqenëse vërseti,

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ
خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۝

"Vërtet se ata të cilët besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, për ta do të jenë kopshtet e begatë nën të cilët rrjedhin lumenj (në Xhnenet). "Ata do të banojnë aty përherë."[141]

ia tregon të vërtetën e njoftimeve të lumturisë së përgjithshme njeriut të mjerë, i cili në çdo minut takon realitetin e vdekjes dhe ky sihariq e shpëton njeriun nga përfytyrimi për vdekjen si një ekzekutim i përjetshëm. Kështu e shpëton atë –botën e tij dhe të gjithë ata që ai i do– nga asgjësimi, madje ai u jep atyre një sovranitet të përhershëm dhe i bën të përfytyrojnë një lumturi të përjetshme. Kështu, në qoftë se ky vërset do të përsëritej me miliarda herë, përsëritja e tij nuk do të konsiderohej kurrë tepri, edhe sikur të vlerësohej sa universi, përsëri elokuenca nuk e humbet vlerën e saj. Kështu, ti shikon se Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm i cili i trajton shembujt e këtyre çështjeve të vlefshme dhe orvatet të bindë ata të cilëve ai u adresohet, duke vërtetuar me prova vendimtare ndodhjen e revolucioneve dhe ndryshimet e mëdha që do ta shkatërrojnë formën aktuale të universit dhe i bën ato para tyre të lehta e të qarta sikur të ishte ndryshimi i një shtëpie dhe trasnformimi i formës së saj; Kur'ani i mrekullueshëm sigurisht tërheq vëmendjen me mijëra herë për tek

[141] Kur'an, 5:85

këto çështje –në mënyrë të qartë, të nënkuptuar e me aluzione–, dhe kjo nuk është e tepërt, por përtërin mirësinë, ashtu siç përtërihen nevojat esenciale të bukës, ilaçit, ajrit dhe dritës.

Dhe për shembull, siç është provuar në mënyrë vendimtare në **Risale-in Nur**, urtësia e përsëritjes në Kur'an:

إِنَّ ٱلْكَٰفِرِينَ فِى نَارِ جَهَنَّمَ ۞ وَٱلظَّٰلِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

"Vërtet që për këqbërësit është një ndëshkim i dhimbshëm"[142]*, "Për ata që mohuan (All-llahun) për ta do të jetë zjarri i Xhehennemit."*[143]

dhe vërsete të tjera, kërcënimi e paralajmërimi si këto të cilët përsëriten me ashpërsi, egërsi e dhunshëm është se mosbesimi i njeriut është një tejkalim e një shkelje e tillë kundër të drejtave të universit e të shumicës së krijesave, dhe ai shkakton zemërimin e qiejve e të tokës dhe bën të inatosen elementet, saqë ato japin goditje me stuhi, shtrëngata e tufane mbi mohuesit e mbi keqbërësit. Dhe sipas deklarimit të qartë të vërseteve,

إِذَآ أُلْقُوا۟ فِيهَا سَمِعُوا۟ لَهَا شَهِيقًا وَهِىَ تَفُورُ ۞ تَكَادُ تَمَيَّزُ مِنَ ٱلْغَيْظِ

"Kur ata të flaken në të (Zjarr), ata do të dëgjojnë të marrë frymë (tmerrësisht) duke u djegur në flakë", "Ai pothuaj shpërthen me vrull..."[144]

Xhehennemi zemërohet keq me ata mohues të padrejtë e të ligj, saqë arrin shkallën e shpërthimit me furi e tërbim. Kështu, në qoftë se Monarku i universit do ta përsëriste në urdhërat e Tij, me zemërim të madh e me ashpërsi, atë krim (mohimin) dhe ndëshkimin e tij me mijëra, miliona apo miliarda herë, akoma ajo nuk do të ishte aspak tepri dhe as mangësi në elokuencë. Duke parë atë krim të përgjithshëm dhe atë shkelje e agresion ndaj të drejtave të pakufishme, dhe sipas urtësisë së shfaqjes së rëndësisë së të drejtave dhe përkujdesjes Hyjnore dhe duke nxjerrë në pah shëmtinë e pafund në mosbesim dhe në ligësinë e atyre mohuesve, ajo nuk përsëritet për humbjen e njeriut dhe vogëlsinë e tij, por për madhësinë e mëkatit të mohuesit dhe madhësinë e krimit të tij të padrejtë.

Pastaj ne shikojmë se me qindra miliona njerëz që prej njëmijë vjetësh, i kanë lexuar çdo ditë ato vërsete të Kur'anit, jo me mërzi, por

---

[142] *Kur'an, 14:22*
[143] Kur'an, 35:36
[144] Kur'an, 67:7-8

me dëshirë të madhe, me mall e nevojë. Vërtet, çdo ditë, gjithë kohën, për gjithkënd, një botë zhduket dhe dera e një bote të re hapet për ta. Në përsëritjen e لَآ إِلٰهَ إِلَّا اللهُ *"Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut"* me mallin e nevojës për të, me mijëra herë, me qëllim që të ndriçohet secila nga ato botëra kalimtare dhe të shkëlqejnë me dritën e besimit, ajo e bën atë fjali Njësie لَآ إِلٰهَ إِلَّا اللهُ sikur të ishte një llambë ndriçuese në qiellin e atyre botëve, ditëve dhe e atyre perdeve të ndryshueshme... Në të njëjtën mënyrë, sipas urtësisë së vlerësimit nëpërmjet leximit të Kur'anit, dënimet e atyre krimeve dhe kërcënimet e rrepta të Monarkut të Parapërjetësisë, të cilat dërrmojnë kokëfortësinë e tyre dhe përmes veprimit për të shpëtuar nga kryengritja e shpirtit, që të mos i zhysë në errësirrë ato perde të shumëfishta kalimtare dhe botët e përkohshme shtegtuese, që të mos i bëjnë të shëmtuara imazhet e tyre që reflektohen në pasqyrat e jetëve të tyre dhe që të mos kthejnë kundra tyre ato shikime shoqëruese miqësore të cilat mund të dëshmojnë në favor të tyre, e jo kundra, Kur'ani i përsërit ato në mënyrën më domethënëse. Madje edhe djajtë mposhten e ikin nga imagjinata që të jenë pa vend këto kërcënime kaq të fuqishme, të ashpra e të përsëritura të Kur'anit. Ai tregon se torturat e Xhehennemit janë thjesht drejtësi për mohuesit të cilët nuk u kushtojnë vëmendje atyre.


Dhe për shembull, duke përsëritur shumë herë tregimet e Musait a.s. të cilat përmbajnë shumë shembuj urtësie dhe dobi si Shkopi i Musait, dhe gjithashtu urtësia në përsëritjen e tregimeve të profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit xh.sh. qofshin mbi ta, është që të demonstrojë se profetësitë e të gjithë profetëve të tyre janë një provë e profetësisë së Muhammedit a.s.m.**.** Në përputhje me urtësinë e pamohueshme të pikëpamjes së realitetit të profetësisë së këtij Personaliteti, dhe meqenëse jo gjithkush ka gjithmonë kohë apo aftësi për të lexuar gjithë Kur'anin, ashtu si shtyllat e rëndësishme të besimit, ai i përsërit ato tregime me qëllim që t'i bëjë të gjitha suret e gjata dhe ato me gjatësi mesatare, secilën si një Kur'an të vogël. T'i përsërisësh ato nuk është tepri, por në të vërtetë, ajo kërkohet nga elokuenca, dhe jep mësim se ngjarja e shfaqjes së Muhammedit a.s.m. është ngjarja më e madhe e njerëzimit dhe çështja më e rëndësishme e universit.

Është treguar në mënyrë vendimtare në Risale-i Nur e me prova e tregues të shumtë se përmes dhënies së pozitës më të lartë Personit të profetit Muhammed a.s.m. në Kur'an, dhe duke e bërë مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللهِ

"Muhammedun resulull-llah," Muhammedi është i dërguari i Tij- i cili përmban katër nga shtyllat e besimit të shoqëruara me لَآ إِلٰهَ إِلَّا اللهُ *"Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut,"* se profetësia e Muhammedit a.s.m. është e vërteta më e madhe në univers, se Personi i Muhammedit a.s.m. është më i nderuari i krijesave dhe personaliteti i tij universal kolektiv dhe rangu i tij i shenjtë i njohur si e vërteta Muhammedane është dielli më rrezatues i dy botëve, dhe vlera e tij për këtë pozitë të jashtëzakonshme është provuar gjithashtu. Njëra nga mijëra provat është kjo. Sipas parimit, اَلسَّبَبُ كَالْفَاعِلِ *"Shkaku është si vepruesi"* me barasvlerën e të gjitha veprave të mira të kryera nga i gjithë komuniteti i tij në të gjitha kohët duke hyrë në librin e tij të punëve të mira, drita që ai solli duke ndriçuar të gjitha të vërtetat e kozmosit; kënaqësia që ai u jep jo vetëm xhindeve, njerëzve, melekëve dhe gjallesave, por gjithashtu edhe universit, qiejve e tokës; dhe lutjet e bimëve të ofruara nga gjuha e prirjes dhe e gatishmërisë së gjendjeve të tyre, dhe lutjet e kafshëve të ofruara nëpërmjet gjuhës së nevojës së tyre të natyrshme; dhe komuniteti i drejtë i atij personaliteti duke i çuar atij *salavate* e duke bërë prej lutjeve të mëshirës me salat e selam, dhe përfitime shpirtërore të milionave –dhe së bashku me qëniet shpirtërore e madje miliardat– nga lutjet e pamohueshme janë pranuar, siç dëshmojmë aktualisht me sytë tonë; dhe meqenëse secila nga shkronjat e Kur'anit –që i kalojnë të treqindmijët– fitojnë nga dhjetë, njëqind deri në njëmijë mirësi e fruta prej dritave të pafundme, duke hyrë në librin e veprave të tij vetëm me recitimin e Kur'anit nga i gjithë komuniteti i tij, Dituria e të Gjithëditurit të Vetëm i së Padukshmes parapriu dhe shikoi se realiteti Muhammedan i cili është një personalitet shpirtëror kolektiv, në të ardhmen do të ishte si Pema Tuba e Parajsës. Ishte në përputhje me pozitën që Ai i dha atij një rëndësi të tillë të madhe në Kur'an, dhe në dekretet e Tij tregoi se arritja e ndërmjetësimit të tij *–shefa'atit–* do të jetë vetëm duke ndjekur e aderuar tek Sunneti i tij i nderuar që është çështja më e rëndësishme që lidhet me njeriun. Dhe nga koha në kohë ai mori në konsideratë personalitetin e tij njerëzor dhe gjendjen njerëzore në jetën e tij të hershme, e cila ishte si bërthama e Pemës madhështore të Tubasë.

Kështu, meqenëse të vërtetat e përsëritura në Kur'an janë të kësaj vlere, të gjitha natyrat e shëndosha do ta dëshmonin se, në përsëritjet në Kur'an, është një mrekulli shpirtërore e fuqishme dhe e gjërë; veçse në qoftë se një person është goditur nga një sëmundje e zemrës dhe

nga një sëmundje e ndërgjegjjes për shkak të plagëve të materializmit dhe që përfshihet nën rregullin:



Kur syri është sëmurë dritën s'e duron,

As goja me plagë ujin s'e shijon.

* * *

DY SHTOJCA, TË CILAT FORMOJNË NJË PËRFUNDIM TË KËSAJ ÇËSHTJES SË DHJETË

E para: Dymbëdhjetë vjet më parë unë dëgjova se një ateist i tmershëm e kryeneç kishte nxitur një komplot kundër Kur'anit nëpërmjet pasjes së tij të përkthyer. Ai tha: "Kur'ani duhet të

përkthehet që të njihet se çfarë malli është." Me fjalë të tjera, duke thënë, le të shohë gjithkush përsëritjet e tij të panevojshme dhe le të lexohet përkthimi në vend të tij, ai kurdisi një komplot të tmerrshëm. Megjithatë provat e pamohueshme të Risale-i Nurit provuan në mënyrë vendimtare se *një përkthim i vërtetë i Kur'anit është i pamundur dhe gjuhët e tjera,* përveçse gjuhës së pasur Arabe *nuk mund t'i ruajnë veçoritë e Kur'anit dhe pikat e holla të elokuencës së tij*. Përkthimet e rëndomta e të pjesshme të njeriut kurrë nuk mund të zënë vendin e fjalëve të mrekullueshme të Kur'anit, që çdo shkronjë e të cilit fiton nga dhjetë deri në njëmijë merita; prandaj, leximi i përkthimit nuk mund të bëhet në vend të tij nëpër xhami. Duke u shpërndarë gjithandej Risale-i Nuri e asgjësoi atë komplot të tmershëm. Unë e mora me mend se ai ishte për shkak të përpjekjeve prej idioti e të çmenduri të hipokritëve për të shuar diellin e Kur'anit, për llogari të djallit, duke i fryrë atij si fëmijët idiotë, pasi morën mësim prej atij ateisti; unë u inspirova që ta shkruaj këtë *"çështjen e dhjetë"* ndërsa isha në një ngushticë të madhe dhe në situatën më të dëshpëruar. Por unë nuk e di realitetin e situatës meqë kam qenë i pamundur të takohem me të tjerët.

Shtojca e dytë: Pas lirimit tonë nga burgu i Denizlit, po rrija një ditë në katin e sipërm të hotelit të famshëm "Shehir." Vallëzimi shumë i hollë, i hijshëm e joshës i gjetheve, i degëve, dhe i rrënjëve të shumë plepave në kopshtet e bukur përballë meje, secili në lëvizje të dalldisur e në ekstazë, si një rreth dervishësh, me prekjen e flladit, më lëndoi zemrën time të dëshpëruar e të zymtë për shkak të ndarjes nga vëllezërit e mi dhe që kisha mbetur i vetmuar. Papritmas, më erdhën ndërmend stinët e vjeshtës e të dimrit dhe një pakujdesi më mposhti. Kështu më erdhi aq keq për ato plepa të bukur e për ato krijesa të gjalla që përkundeshin me gaz e hare, saqë m'u mbushën sytë me lot. Me këtë kujtues të ndarjeve dhe të mosqënies nën perden e zbukuruar të universit, dëshpërimi i botës –i mbushur plot me vdekje e ndarje rëndoi mbi mua. Atëherë, papritmas, Drita të cilën e solli e Vërteta Muhammedane a.s.m. më erdhi në ndihmë dhe i transformoi atë dëshpërim e dhimbje të pafundme në gëzim. Vërtet që i jam përjetësisht mirënjohës Qënies së Muhammedit a.s.m. për ndihmën e ngushëllimin që prekën atë gjendje në atë kohë. Një shembull i vetëm i shkëlqimeve të pafund të asaj Drite ishte shpëtim për mua, për të gjithë besimtarët dhe për gjithkënd. Ajo ishte kështu:

Ai shikim i pavëmendshëm i shfaqi ato krijesa të bekuara e të bukura në atë periudhe kohe të ishin pa funksion e qëllim dhe lëvizjen e tyre të ishte jo nga gëzimi, por sikur ato dridheshin nga

mosekzistenca dhe ndarja duke u shkallmuar për tek shuajtja. Ai shikim i shkujdesur më preku aq shumë ndjenjat e dëshirës për qëndrueshmëri të përhershme, për përmallimin ndaj gjërave të mira, për dashurinë e ekzistencës, për dhembshurinë ndaj llojit njerëzor dhe për dashurinë e jetës, saqë ai e transformoi dynjanë në një llojë Ferri shpirtëror dhe mendjen në një instrument torture. Atëherë, mu në atë pikë, Drita që Muhammedi a.s.m. kishte sjellë si dhuratë për njerëzimin, ngriti perden; ajo shfaqi në vend të shuajtjes, mosqënies, asgjësimit, mungesës së qëllimit, kotësisë, përkohshmërisë dhe ndarjes kuptime e shembuj urtësie sa numri i gjetheve të atyre plepave.

Risale-i Nuri ka provuar se rezultatet e detyrat mund të ndahen në tri lloje:

Lloji i parë është i orientuar e shikon tek Emrat e Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Ashtu si një mjeshtër i aftë, i cili në qoftë se prodhon një makineri të çuditshme do të duartrokitej e vlerësohej nga të gjithë për shpikjen e tij dhe do të thonin për të ***Masha'All-llah, Barekall-llah,*** po ashtu ajo makineri me rolin e saj e përshëndet mjeshtrin e saj dhe e lavdëron atë nëpërmjet gjuhës së gjendjes së saj, e duke shfaqur në mënyrë perfekte rezultatet e synuara prej saj. Të gjitha qëniet e gjalla dhe të gjitha gjërat janë makineri të tilla si ajo; ato duartrokasin Mjeshtrin e tyre përmes lavdërimeve të tyre.

Lloji i dytë i shembujve të urtësisë orientohet për tek shikimet e gjallesave dhe të qënieve të vetëdijshme. Secila nga qëniet bëhet një objekt i këndshëm studimi e libër njohurie. Ato i kanë kuptimet e tyre në sferën e ekzistencës në mendjet e qënieve të vetëdijshme, format e tyre i kanë në memoriet e tyre, tek tablotë në Botën e Shëmbëllesës dhe në regjistrat e Botës së Padukshme. Atëherë, ato lënë botën e dukshme e tërhiqen për te bota e padukshme. Domethënë ato lënë ekzistencën e dukshme dhe fitojnë shumë ekzistenca që i përkasin kuptimit të së padukshmes dhe njohurisë.

Po, meqenëse All-llahu xh.sh. ekziston dhe dituria e Tij përfshin e rrethon gjithçka, atëherë në pikëpamjen e realitetit, në botën e besimtarëve, sigurisht nuk ndodhen mosqënie, shuarje, asgjë, asgjësim dhe përkohshmëri. Ndërsa bota e jobesimtarëve është plotë mos-ekzistencë, ndarje, asgjësim e përkohshmëri. Thënia në gjuhën e gjithësecilit:

"Për ata të cilët Allahu ekziston, gjithçka ekziston, ndërsa për ata që Allahu nuk ekziston, për ta nuk ekziston asgjë**,"** e sqaron këtë fakt.

Përmbledhja: Besimi ashtu siç e shpëton njeriun nga asgjësimi i përhershëm në kohën e vdekjes, gjithashtu ai shpëton botën private të gjithësecilit nga errësira e asgjësimit dhe e asgjësë. Ndërsa mosbesimi, dhe sidomos në qoftë se ai është mosbesim absolut, me vdekjen e çon njeriun dhe botën e tij private në mosekzistencë, dhe e flak atë në Ferr – si errësirë. Ai i transformon kënaqësitë e jetës në dhimbje e helme të ashpra.

Le të kumbojnë veshët e atyre që preferojnë jetën e kësaj bote mbi atë të Ahiretit! Le të vijnë ata e të gjejnë një zgjidhje për këtë, ose le të hyjnë në besim e të shpëtojnë veten e tyre nga kjo humbje e tmerrshme!...

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti"[145]

Nga vëllai juaj që ka shumë nevojë për duatë tuaja dhe që ju do juve jashtë mase

Said Nursi

* * *

[145] Kur'an, 2:32

Një letër nga Husrevi për ustadh Bediuzzaman Said Nursi lidhur me Çështjen e Dhjetë

Profesori im i dashur dhe i nderuar!

Falënderime të pafundme qofshin për Zotin e Gjithëfuqishëm që ne kemi marrë trajtesën *Një lule e Emirdagut*, Çështjen e Dhjetë e frutave të Denizlit, e cila e ka përmirësuar brengën tonë të ndarjes sonë dymujore dhe dëshpërimin tonë që kemi qenë të pamundur për të komunikuar; ajo rendit virtytet e përsëritjes së vërseteve të mëshirshme, të dhembshura, të lavdishme dhe madhështore në Kuranin Kerim. Të cilat i ngjallin zemrat tona me jetë të freskët dhe i gjallërojnë shpirtërat tonë me fllad të freskët; ajo shpjegon domosdoshmërinë, domethënien dhe arsyen për përsëritjet, dhe gjithashtu është një mbrojtje brilante e Risale-i Nurit. Në të vërtetë, sa më shumë që ne t'i marrim erë kësaj luleje, duke merituar kështu vlerësim e admirim, aq më shumë shtohet malli i shpirtërave tonë për të. Ashtu si, si përballë vështirësive të burgimit tonë nëntë mujor, nëntë çështjet e frutave të besimit shfaqën bukurinë e tyre duke kontribuar për lirimin tonë, po ashtu nëpërmjet tregimit të çudirave të mrekullisë së ngjeshur të Kuranit, Çështja e Dhjetë, lulja e tyre, përsëri shfaqi bukurinë e tyre.

Po, o profesori im i dashur, ashtu si bukuria madhështore dhe e hollë e trëndafilit që e bën shikuesin t'i harrojë gjembat në kërcellin e tij, po kështu kjo lule e ndritshme na ka bërë ne që të harrojmë dëshpërimin e atyre nëntë muajve; ajo i ka bërë ato si asgjë. Mënyra e të shkruarit të saj jo vetëm që i kënaq ata që e studiojnë atë, por ajo çudit mendjen. Prej shumë bukurive që përmban, ajo tregon plotësisht vlerën e përsëritjeve përballë tradhtisë së 'thjeshtimit' të Kuranit në sytë e njerëzve duke e përkthyer atë. Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm duke u provuar të jetë aq i ri, i freskët sikur të shpallej rishtas, ndjekësit e tij duke u kapur fort pas tij në çdo shekull, dhe bindja e tyre e plotë ndaj urdhëresave dhe ndalesave të tij; dhe kërcënimet e tij të ashpra të tmerrshme të përsëritura për shtypësit në çdo shekull, dhe vështrimi i tij i mëshirshëm dhe i dhembshur për të

shtypurit; dhe midis kërcënimeve të tij të cilat shikojnë këtë shekull; tiranët duke u bërë të qajnë e të bërtasin vazhdimisht për këto gjashtë apo shtatë vitet e fundit nga Ferri qiellor i cili të kujton shembullin e hapësirës më të thellë; dhe studentët e Risale-i Nurit duke qenë në krye të të shtypurve në këtë shekull; dhe qënia e tyre të çliruar nga mjeritë e tyre, personale e të gjithanshme, ashtu siç gjetën çlirim e lehtësim profetët e hershëm; dhe tregimi i saj për goditjet që u jepen të pafeve, kundërshtarëve të saj, dhe torturat e ferrit; dhe Lulja duke u mbyllur me dy shtojca të bukura e të holla; të gjitha këto e shtyjnë këtë studentin tënd të varfër, Husrevin, për të dhënë i gëzuar falënderime të panumërta. Ashtu siç e kam përmendur për profesorin tim të dashur, unë kurrë nuk e kam përjetuar në jetën time gëzimin dhe lumturinë që ma jep kjo lule e bukur, siç u kam thënë vëllezërve të mi në raste të shumta. Zoti i Gjithëfuqishëm vendosi mbi shpatullat e tyre të dobëta një peshë shumë të rëndë e të madhe. Zoti qoftë i kënaqur me profesorin tonë të dashur, dhe Zoti i bëftë ata të buzëqeshin përjetësisht duke ua lehtësuar peshën e tyre. Amin!

Po, o profesori im i dashur!

Ne jemi gjithmonë të kënaqur me Zotin xh.sh., me Kuranin, me të Dashurin e Tij, me Risale-i Nurin dhe me ty, o profesori ynë i dashur, që je njoftuesi i Kuranit. Ne kurrë nuk pendohemi që të ndjekim ty. Ne nuk kemi absolutisht asnjë qëllim në zemrat tona për të bërë dëm; ne kërkojmë vetëm Zotin dhe kënaqësinë e Tij. Ndërsa koha kalon, mallëngjimi ynë shtohet për t'u takuar me All-llahun brenda limiteve të kënaqësisë së Tij. T'ia referosh Zotit të Gjithëfuqishëm ata të cilët na kanë bërë ne keq, pa përjashtim, dhe t'i falësh ata, dhe t'i bësh mirë gjithësecilit duke i përfshirë edhe ata tiranë, është një shenjë e islamit e ngulitur në zemrat e studentëve të Risale-i Nurit. Ne i paraqesim falënderime të pafundme Krijuesit, i Cili e dha këtë pa kërkimin tonë.

Studenti yt me shumë të meta,

Husrevi

. . .

ÇËSHTJA E NJËMBËDJETË

[Qindra prej frutave të panumërta të pjesshme dhe universale të pemës së shenjtë të besimit, njëra prej të cilave është parasja, një tjetër është lumturia e përjetshme, dhe një tjetër është shikimi i Krijuesit, janë shtjelluar me prova e shpjegime në Risale-i Nur. Atëherë duke ia referuar shpjegimin e mëtejshëm të tyre veprës ***Siraxhun-Nur,*** *Llampës ndriçuese*, këtu ne do të shtjellojmë pak shembuj prej frutave të saj të mira të pjesshëm e të veçantë dhe jo shtyllat e saj universale.]

Njëra nga këto: Një ditë ndërsa po recitoja në një lutje me këtë përmbatje: O Zoti im! "Në përnderim të Xhebrailit, Mikailit, Israfilit dhe Azrailit dhe nëpërmjet ndërmjetësimit të tyre -duke i përdorë ata si *vesile* dhe si *shefatë*- më ruaj mua nga të këqiat e shejtanëve prej xhindëve dhe prej njerëzve... Dhe sa përmenda emrin e Azrailit, përmendja e të cilit i mbush njerëzit me frikë dhe i bën të dridhen nga tmerri, unë përjetova një gjendje të mirë shpirtërore, një kënaqësi tepër të ëmbël dhe një ngushëllim të madh. Ndërkohë falënderova Allahun duke thënë: ***El-Hamdu lil-Lah***, dhe fillova ta doja Azrailin me një dashuri të pastër, sepse ai është njëri prej melekëve që besimi në ekzistencën e tyre është njëra nga shtyllat e imamit. Ne do të tregojmë shumë shkurt vetëm një frut të pjesshëm prej frutave të shumta të këtij aspekti të pjesshëm të besimit në melekët.

Një tjetër: Gjëja më e çmueshme që ka gjithësecili dhe ajo për të cilën ata dridhen më shumë, është shpirti i tyre. Unë ndjeva me siguri një gëzim të thellë përballë dorëzimit të shpirtit një doreje 'të fortë e të besuar' që ta ruajë atë nga kotësia, nga humbja dhe nga asgjësimi. Kjo më dha një kënaqësi të madhe.

Pastaj m'u kujtuan Melekët e ngarkuar me regjistrimin e punëve të njeriut, dhe pashë se ato kishin fruta të mirë e të shijshëm si këto:

Çdo njeri, për hir të përjetësimit të veprave të tij të mira dhe që të mbeten fjalët e vlefshme, përpiqet seriozisht që t'i ruajë e t'i mbrojë ato që të mos humbasin, qoftë nëpërmjet shkrimit, ose poezisë, ose madje edhe nëpërmjet një shiriti kinematografik, dhe sidomos në qoftë se ato vepra do të prodhonin fruta të përhershëm në Parajsë; ai do të përmallohej që t'i ruante ato më shumë..

Kiramul-Katibinë -Melekët Regjistues- qëndrojnë mbi shpatullat e njeriut me qëllim që ta shfaqin atë në pamjet e përjetshme, që t'i fotografojnë veprat e tij që ato të shfaqen në skena të amshuara dhe që pronarët -autorët- e atyre veprave të shpërblehen dhe të fitojnë çmime

të larta të vazhdueshme.. Kjo m'u duk aq e këndshme, e shijshme dhe e ëmbël saqë unë nuk mund ta përshkruaj...

Pastaj, kur 'njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje' më kishin privuar nga të gjitha shkaqet e jetës shoqërore, më kishin izoluar nga çdo gjë që më ngushëllonte, nga librat e mi, nga të dashurit e mi, dhe më kishin lëshuar në vendet e mërgimit dhe të vetmisë, dhe kur isha në një gjendje ngushtësie dhe brengosjeje deri në atë shkallë saqë unë ndjeja se dynjaja po shembej mbi kokën time.. ndërsa isha në këtë gjendje të dëshpëruar, befas një frut prej frutave të shumtë të 'besimit në Melekët' më erdhi në ndihmë; ai frut, ndiçoi të gjitha anët e dynjasë sime dhe i dha dritë të gjithë botës përreth meje, duke e mbushur atë më 'melekë' e me shpirtëra të mirë derisa u përhap kënaqësia e gëzimi në çdo anë.[146]

Gjithashtu ai tregoi se botët e njerëzve të çudhëzimit janë të mbushura me vajtimet e vetmisë, kotësisë, zbrazëtisë dhe të errësirës.

Ndërsa po gëzoja e shijoja kënaqësitë e këtij fruti, imagjinata ime mori një frut prej frutave të shumta të 'besimit në profetët' -i cili i ngjason këtij- dhe në fakt e provoi -e shijoi atë. Dhe papritmas ndjeva se besimi im u zgjerua, u shtua dhe u shtri saqë u bë universal dhe i gjithanshëm, sepse tek unë u ndriçuan të gjithë ato kohë të shkuara dhe ndriçuan me dritën e vërtetimit dhe të besimit në ta, saqë unë ndjeja sikur po jetoja me ta, dhe secili nga profetët u bë si konfirmim me mijëra firma për shtyllat e besimit të cilat i solli dhe për tek të cilat bëri ftesë vula e atyre profetëve -profeti i Fundit të kohës a.s.m., duke i heshtur shejtanët.

Pastaj m'u shfaq një pyetje me përgjigje vendimtare e cila është përfshirë në shkreptimën e Trembëdhjetë, rreth urtësisë së kërkimit mbrojtje All-llahut prej shejtanit -*Hikmetul- Isti adheti*. Në kuptim ajo më pyeti:

Njerëzit e besimit të cilët janë si këto fruta të besimit, dhe si këto dobi e rezultate të ëmbëla me shije të pakufishme, dhe të cilët kanë rezultate të këndshme e të mira të veprave të mira dhe dobitë e tyre të shumta; të cilët kanë përkujdesjen e vazhdueshme prej më të Mëshirshmit të mëshiruesve dhe suksesin dhe mëshirën e Tij.. të gjitha këto u japin atyre forcë e mbështetje; atëherë përse ndodh shpesh që ata mposhten prej njerëzve të çudhëzimit dhe ndonjëherë njëzet prej njerëzve të çudhëzimit i mposhtin dhe shkatërrojnë njëqind prej tyre?..

---

[146] Musned, v,173; al-Tirmidhi, zuhd,9; Ibn Maxhah, Zuhd 19

Për këtë më erdhi ndërmend kjo:

Përse Kurani Kerim mobilizon këtë grumbullim të madh force në favor të njerëzve të besimit duke përmendur mbështetjen që u jep atyre Zoti xh.sh. me Melekë kundra dredhive e vesveseve të dobëta të shejtanit?

Meqenëse Risale-i Nuri e ka shpjeguar urtësinë e kësaj me prova vendimtare, ne do të aludojmë këtu për përgjigjen e asaj pyetjeje në mënyrë shumë të shkurtër: Po, ndonjëherë ndodh që kundër vandalëve ose një barbari të vetëm i cili i përpiqet t'i vërë zjarrin një pallati për ta rrënuar, njëqind burra marrin përsipër mbrojtjen e atij pallati; madje mund të kërkojnë ndihmë edhe tek mbreti apo tek pushteti për ruajtjen e pallatit; sepse qëndrimi në këmbë i pallatit kushtëzohet nga të gjitha kushtet, shtyllat dhe shkaqet që e bëjnë atë të qëndrojë në këmbë; kurse mosekzistenca dhe shkatërrimi i pallatit mund të ndodhë nëpërmjet mosekzistencës së një kushti të vetëm. Kështu, si ky shembull, ne kuptojmë se si shejtanët prej xhindëve dhe njerëzve bëjnë shkatërrime të tmerrshme dhe djegie të mëdha jolëndore nëpërmjet një akti shumë të pakët e të vogël, ashtu siç mund të digjet e rrënohet një pallat shumë i madh me një fije të vetme shkrepëseje.

Po, baza dhe origjina e të gjithë të keqes, ligësive dhe e mëkatëve është mosekzistencë, është shkatërrim. Mosekzistenca dhe shkatërrimi qëndrojnë të fshehura nën ekzistencën e jashtme.

Kështu, duke u mbështetur mbi këtë pikë shejtanët prej xhindëve dhe njerëzve dhe qëniet e këqija mund t'i bëjnë ballë një fuqie të pakufishme me anë të një forcjeje tej mase të dobët, duke i shtyrë njerëzit e së vërtetës dhe të realitetit që në mënyrë të vazhdueshme të kërkojnë strehim tek Dera e mëshirës Hyjnore dhe të përpiqen për të shkuar tek ajo. Prandaj Kurani mobilizon forca të mëdhaja për mbrojtjen e tyre. Ai ua dorëzon duarve të tyre nëntëdhjetë e nëntë Emra të bukur Hynorë dhe lëshon dekrete të fuqishme me qëllim që ata të qëndrojnë të palëkundur e t'u bëjnë ballë atyre armiqve.

Nga kjo përgjigje u bë e dukshme maja -fillimi- i një të vërtete madhështore dhe baza e një çështjeje të madhe. Ajo është si më poshtë vijon:

Ashtu si parajsa që depoziton prodhimet dhe rezultatet e të gjitha botëve të ekzistencës, dhe prodhon filizat e përjetshme të farërave të mbjella në këtë botë, po ashtu xhehennemi i djeg dhe i përcëllon prodhimet e mosekzistencës me qëllim që të shfaqë rezultatet shumë të dhimbshme të botërave të pakufishme të mosekzistencës dhe të

asgjësisë. Dhe midis funksioneve të shumta të tij, fabrika e tmerrshme e xhehennemit pastron botën e ekzistencës prej papastërtive dhe ndyrësive të botës së mosekzistencës. Për tani ne nuk do ta hapim derën e kësaj çështjeje të madhe; në dashtë Zoti ajo do të shpjegohet më vonë.

Po kështu, një pjesë prej frutave të besimit në Melekët lidhet me *Munker* dhe *Nekir* -Melekët pyetës- që marrin në pyetje; ajo është sa vijon:

Një ditë thashë: "Unë sigurisht, ashtu si çdokush tjetër padyshim që do të hyj në varr." Dhe hyra në të me imagjinatë: Ndërsa po më merrte frika prej shkretisë dhe dëshpërimit të atij vendi të ngushtë, të errët, të ftohtë e të vetmuar të varrit, kur befas, dy shokë të bekuar e të nderuar prej grupit *'Munker dhe Nekir'* u shfaqën dhe erdhën tek unë. Ata filluan të debatojnë me mua. Zemra ime dhe varri im u zgjeruan, u ndriçuan dhe u ngrohën; u hapën dritare me pamje nga bota e shpirtërave... u gëzova nga thellësia e shpirtit dhe e falënderova shumë All-llahun për atë situatë që pashë e cila do të realizohet në të ardhmen ndonëse tani e pashë me imagjinatë.

Ashtu sikur vdiq një student gjatë kohës që studionte gramatikën arabe, dhe kur e pyetën *'Munker dhe Nekir'* në varr: "Kush është Zoti yt?, ai u përgjigj: "*kush*" është kryefjala, "*Zoti yt*" është kallzuesi i saj... më pyesni diçka më të vështhtirë; kjo është e lehtë!" - sepse ai mendoi se ishte akoma në medrese duke marrë mësimin; ashtu si kjo përgjigje që i bëri të qeshnin melekët dhe shpirtërat që ishin të pranishëm dhe atë Evlija të drejtë të cilit iu zbulua varri dhe pa ngjarjen, madje i solli një buzëqeshje edhe mëshirës Hyjnore; dhe e shpëtoi atë prej ndëshkimit... po ashtu u përgjigj heroi martir prej studentëve të Risale-i Nurit -Hafiz Aliu i ndjerë- i cili vdiq në burg ndërsa ishte duke lexuar e shkruar Trajtesën e 'Frutave të besimit' me entuziazëm të plotë, iu përgjigj pyetjeve të të dy melekëve në varr - ashtu siç u përgjigj në gjykatë me të vërtetat e Trajtesës së "Frutave të besimit", po ashtu unë dhe studentët e Risale-i Nurit do t'u përgjigjemi në dashtë Zoti atyre pyetjeve të cilat do të jenë të mirëfillta -në fakt- në të ardhmen dhe figurative, në kuptim, në të tashmen, do t'u përgjigjemi me provat e ndritshme të Risale-i Nurit dhe me argumentet e tij vendimtarë, duke i bërë melekët që t'i konfirmojnë, t'i vlerësojnë dhe t'i miratojnë ato.

Një shembull tjetër i 'besimit në melekët' që të çon në lumturinë e kësaj botë është ky: Një fëmijë i pafajshëm ndërsa ishte duke marrë mësimin e tij të besimit prej Ilmi Hafizit -fikhut fillestar- kur

papritmas një fëmijë tjetër vjen tek ai duke qarë me rënkim për vdekjen e vëllait të tij të pafajshëm dhe ndërkohë ky e qetësoi dhe e ngushëlloi duke i thënë: “Mos qaj, o vëllai im, por falëndero All-llahun, sepse vëllai yt ka shkuar me melekët, ka kaluar në Xhennet, dhe do të udhëtojë e do të shëtisë atje me liri të plotë ashtu si melekët, dhe do të gjejë kënaqësi e lumturi më mirë se ne; ai do të fluturojë si melekët dhe do të shohë çdo vend”. Ai i transformoi vajtimin dhe britmat e tij të brengosura në buzëqeshje e gëzim.

Edhe unë ashtu si ai fëmijë vajtues, në situatën e zymtë të këtij dimri pikëllues, mora lajmin e dy vdekjeve.

Njëra ishte ajo e nipit tim, Fuadit të ndjerë, i cili kishte arritur të dalë i pari në shkollat e larta dhe ishte botuesi i të vërtetave të Risale-i Nurit.

E dyta, ishte motra ime e ndjerë, e quajtur Hanëm, një shkollare e cila shkoi në Haxh dhe vdiq ndërsa po bënte *tavafin*, duke u rrotulluar rreth Qabesë. Këto vdekje të të dy të afërmve të mi më bënë mua të vajtoja si vajtimi për Abdurrahmanin e mjerë, që është përshkruar në Trajtesën për të moshuarit. Atëherë, nëpërmjet dritës së besimit unë pashë -në zemrën time- se Fuadi i pafajshëm dhe Hanëmeja e drejtë kishin si shoqërues melekë dhe huri në vend të shoqërimit të njerëzve, dhe pashë shpëtimin e atyre të dyve prej rreziqeve dhe mëkateve të kësaj bote. Ndërkaq nisa të falënderoja All-llahun -më të Mëshirshmin e mëshiruesve- me një mijë falënderime, i Cili e transformoi atë dëshpërim të rëndë në një ndjenjë kënaqësie e gëzimi... dhe fillova t’i përgëzoj ata, të përgëzoj vëllain tim Abdul Mexhidin -babain e Fuadit- dhe të përgëzoj dhe veten time gjithashtu.

Kjo u shkrua dhe u përfshi këtu me qëllim që këta dy të ndjerë të marrin një lutje për mëshirë.

Të gjitha krahasimet dhe alegoritë në Risale-i Nur përshkruajnë frutat e besimit që kanë si rezultatin e tyre lumturinë në këtë botë dhe në tjetrën. Ato fruta universalë të mëdha shfaqin në dynja lumturinë e jetës dhe bëjnë të përjetohen kënaqësitë e saja gjatë jetës; ato fruta universale e të shtrirë njoftojnë se besimi i çdo njeriu do ta bëjë atë të fitojë në Ahiret një lumturi të përjetshme, madje ai do të prodhojë filiza, do të zhvillohet e zgjerohet atje në atë mënyrë. Pesë prej atyre frutave të shumtë universale i kemi shkruar tek Fundi i Fjalës së Tridhjetë e Nëntë si frutat e Miraxhit, dhe pesë Fruta janë përfshirë si shembuj në Degën e Pestë të Fjalës së Njëzet e Katërt.

Ne thamë në fillim se secila nga shtyllat e besimit ka fruta të shumtë të ndryshëm, madje ka fruta të panumërt, dhe se tërësia e shtyllave të besimit bashkërisht ka gjithashtu fruta të pakufishëm; një frut i vetëm prej tërësisë së frutave është Parajsa madhështore... tjetri është lumturia e përjetshme... ndërsa një tjetër që është më i ëmbël është shikimi i Krijuesit xh.sh. atje.

Gjithashtu disa nga frutat e besimit që janë boshti për të fituar lumturinë e të dyja botëve janë përshkruar mirë e qartë në krahasimin e përfshirë tek fundi i Fjalës së Tridhjetë e Dytë.

Dëshmia se 'besimi në Kaderin Hyjnor' ka gjithashtu fruta të çmueshëm në këtë dynja, është fakti se thënia "*Ata që besojnë në Kaderin Hyjnor janë të shpëtuar nga brenga, nga mjerimi"*, njihet gjërësisht si një proverbë. Dy fruta të 'besimit në Kaderin Hyjnor' janë shpjeguar në krahasimin e bukur e të hollë tek fundi i Trajtesës rreth 'Kaderit Hyjnor', i cili është rreth dy njerëzve që futen në një kopësht të këndshëm të Pallatit mbretëror... edhe unë vetë në veten time kam përjetuar me mijëra herë dhe kam kuptuar se nuk ka lumturi për jetën e kësaj dynjaje pa besim në Kaderin Hyjnor; po të mos ishte ky besim, do të shkatërrohej krejtësisht lumturia e kësaj bote. Madje sa herë që unë i shihja fatkeqësitë e dhimbshme nga këndvështrimi i besimit në Kaderin Hyjnor, ato fatkeqësi lehtësoheshin e pakësoheshin shumë, dhe pyesja me habi: si mund të vazhdojnë të jetojnë ata që nuk besojnë në Kaderin Hyjnor?

Për njërin prej frutave universalë të shtyllës së besimit -besimit në Melekë- është aluduar në Stacionin e Dytë të Fjalës së Njëzet e Dytë, si më poshtë vijon:

Duke iu lutur Zotit të Gjithëfuqishëm, Azraili a.s. tha:

"Shërbëtorët e Tu do të ankohen prej meje dhe do të zemërohen me mua kur unë të kryej detyrën time të marrjes së shpirtërave në kohën e vdekjes."

Atij iu tha në përgjigje: " Unë do t'i bëj sëmundjet dhe fatkeqësitë një perde për detyrat e tua, kështu që ankesat e shërbëtorëve të Mi do të drejtohen tek ato shkaqe dhe jo tek ti."

Edhe vetë detyra e Azrailit është një perde tjetër prej atyre perdeve me qëllim që ankesat e pajustifikueshme të mos drejtohen tek All-llahu i Gjithëfuqishëm, sepse meqenëse urtësinë, mëshirën, bukurinë dhe dobinë që gjendet në vdekje ndoshta nuk mund t'i shohë gjithësecili pasi shikon tek aspekti i jashtëm i çështjeve dhe fillon të shfaqë kundërshtim e ankesa. Kështu, për hir të kësaj urtësie -domethënë me

qëllim që të mos drejtohen ankesat e pajustifikueshme tek Mëshirëploti Absolut- Azraili a.s. u bë një perde.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, funksioni i të gjithë melekëve, dhe madje detyrat dhe funksionet e të gjitha shkaqeve të jashtme janë perde për dinjitetin e Hyjnisë, me qëllim që dinjiteti dhe shenjtëria e fuqisë Hyjnore dhe gjithëpërfshirja e mëshirës Hyjnore të jenë të ruajtura në gjërat bukuria e të cilave nuk është e dukshme dhe urtësia e të cilave nuk është e kuptueshme; dhe që ato të mos jenë objekt kundërshtimesh dhe, që në shikimin sipërfaqësor fuqia Hyjnore të mos shfaqet se është në kontakt me gjëra të ulëta, të rëndomta e bajate.

Sepse Risale-i Nuri ka provuar në mënyrë vendimtare me dëshmi të panumërta se stampat e Unitetit Hyjnor mbi të gjitha gjërat tregojnë qartë se asnjë shkak nuk ka efekt real dhe as aftësi për të krijuar. Krijimi dhe sjellja në ekzistencë janë të veçanta vetëm për Krijuesin. Shkaqet janë thjesht një perde. Qëniet e vetëdijshme si melekët nuk mund të bëjnë asgjë përveç një lloji detyre vullnetare në përputhje me natyrat e tyre dhe me adhurimin aktiv që quhet 'fitim' dhe është i pjesshëm dhe jo kreativ.

Po, dinjiteti dhe madhështia kërkojnë vendosjen e shkaqeve të jashtme si perde para shikimit të mendjes. Ndërsa Uniteti dhe Njësia kërkojnë që shkaqet të hiqen nga pasja e ndonjë efekti real; ato refuzojnë që shkaqet të kenë ndonjë ndikim real.

Dhe kështu, ashtu si melekët dhe shkaqet e jashtme të vënë në shërbim në veprat e mira, që i përkasin ekzistencës, janë mjete për shenjtërimin Hynor dhe për lartësimin dhe pastrimin e fuqisë Hynore prej mangësisë e tiranisë në gjërat bukuria e të cilave nuk njihet e nuk shihet, dhe për ta ruajtur e shenjtëruar nga të përshkruarit defekt asaj; po ashtu shejtanët prej xhindëve dhe njerëzve dhe elementët e dëmshëm të vënë në shërbim në gjërat e këqija që i përkasin mosekzistencës, edhe këto janë një lloj shërbimi për tesbihatet Hynore dhe një mjet për shenjtërimin, lartësimin, shfajsimin dhe pastrimin e fuqisë Hynore duke e shpëtuar nga të qenurit objekt i ankesave dhe i kundërshtimeve dhe nga akuzat e padrejta për mizori; janë me qëllim që ta shenjtërojnë dhe ta deklarojnë Krijuesin të lirë dhe të pastër prej të gjitha të metave në univers. Sepse të gjitha mangësitë dhe të metat që burojnë nga mosekzistenca ose nga mungesa e aftësisë; ose nga shkatërrimi, ose dështimi për të kryer detyrat, të cilat që të gjitha janë mosekzistuese, janë akte mosekzistuese dhe i përkasin mosekzistencës. Mangësitë, të metat u atribuohen këtyre perdeve të këqia e djallëzore; ankesat dhe kundërshtimet janë të meritueshme t'u drejtohen atyre,

dhe ato janë një mjet për Krijuesin e Gjithëfuqishëm duke e shpallur Atë të lirë e të pastër prej të gjitha mangësive, sepse aktet që i përkasin të këqiave, mosekzistencës dhe shkatërrimit nuk kërkojnë -në origjinë, në fakt- as forcë, as fuqi:

Veprimi i pakët, ose forca e parëndësishme, e pjesshme, madje ndonjëherë edhe neglizhenca për të kryer një detyrë, çojnë në lloje mosekzistenceje dhe shkatërrimi. Prandaj, supozohet se ata autorë të së keqes posedojnë fuqi, por ata nuk kanë në efekt veçse mosekzistencën dhe pafuqinë, përveçse një fitimi të pjesshëm. Meqenese ato të këqija burojnë nga mosekzistenca, bërësit e së keqes konsiderohen si veprues të vërtetë. Në qoftë se ata janë qënie të vetëdijshme, qënie me inteligjencë, meritojnë ta paguajnë shtrenjtë duke provuar pasojat e rënda të punës së tyre. Kjo do të thotë se ata të këqinj shkatërrues janë bërësit e akteve të tyre të këqija. Ndërsa, meqenëse aktet e mira, mirësitë dhe punët e drejta janë ekzistuese, i përkasin ekzistencës, ata të cilët i kryejnë ato, nuk janë bërësit e vërtetë dhe nuk ka ndonjë ndikim real; ata vetëm janë të denjë që të mirat të kalojnë nëpërmjet duarve të tyre dhe t'i afrohen nderimit Hynore. Dhe shpërblimi i tyre për punën e tyre është thjesht nderim e favor Hynor. Kurani Kerim e bën të qartë këtë nëpërmjet dekretit të tij: *"Çfarë do e mirë që të vjen, ajo është prej Allahut, kurse çfarë do e keqe që të bie ty, ajo është nga vetja jote"*. [147]

Shkurtazi

Botërat e ekzistencës dhe botërat e pakufishme të mosekzistencës kur përplasen së bashku dhe kur prodhojnë fruta si Xhennetin dhe xhehennemin, dhe kur të gjitha botërat e ekzistencës thonë: ***El-Hamdu lil-lah, El-Hamdu lil-lah*** ndërsa të gjitha botërat e mosekzistencës deklarojnë: ***Subhanall-llah, Subhanall-llah***, madje edhe kur përplasen melekët me shejtanët, dhe të mirat dhe të këqiat; madje dhe kur zhvillohet polemika rreth zemrës ndërmjet inspirimit dhe vesveseve djallëzore.. kur e gjitha kjo ndodh nëpërmjet ligjit gjithëpërfshirës të kundërshtimit -konkurencës- manifestohet befas një frut prej frutave të 'besimit në Melekët' dhe e zgjidh çështjen duke e ndriçuar universin e errësuar dhe duke na shfaqur neve një dritë prej dritave të vërsetit, *"All-llahu është Drita e qiejve dhe e tokës"*[148] dhe ai na tregon neve se sa i ëmbël është ky frut.

---

[147] Kuran 4:79
[148] Kuran, 24:35

Fjala e Njëzet e Katërt dhe Fjala e Njëzet e Nëntë kanë treguar një frut tjetër universal dhe kanë provuar në mënyrë të shndritshme ekzistencën e melekëve dhe detyrat e tyre.

Po, në çdo gjë në univers, të pjesshme dhe universale, në çdo botë të qënies, është një Hyjni madhështore e mëshirshme e cila e bën vetveten të njohur e të dashur. Sigurisht, është e domosdoshme që t'i përgjigjesh asaj Madhështie, asaj Mëshire, asaj bërje të njohur e të dashur me falënderime dhe me adhurim gjithëpërfshirës të vetëdijshëm, duke i deklaruar ato të jenë të shenjtëruara, të lartësuara, të pastërta dhe të lira prej të gjitha mangësive dhe defekteve.

Meqenëse krijesat e pashpirta të pavetëdijshme dhe elementet e mëdhaja të universit nuk mund ta kryejnë këtë adhurim madhështor, atëherë vetëm melekë të panumërt mund ta kryejnë atë detyrë në vend të tyre... Dhe këta melekë janë ata që mund t'i përfaqësojnë -me të gjithë urtësinë e madhështinë- aktivitetin madhështor të sovranitetit të asaj Hyjnie gjithandej, në çdo qoshe të universit, dhe në çdo pjesë të tij nga toka në plejada dhe nga thellësitë e tokës për tek lartësirat e hapësirës.

Për shembull, nëpërmjet këtij fruti, krijimi i tokës dhe detyrat e saj natyrale, të cilat ligjet e pashpirta të filozofisë i tregojnë të jenë të errëta e të shkreta, janë vendosur në mënyrën më të ndritshme e të familjarizuar mbi shpatullat e -domethënë nën mbikëqyrjen e- Dy melekëve të e quajtur ***Eth-Thaur,*** *Demi dhe* ***Hut****, Peshku.* Dhe një e vërtetë, një substancë e Ahiretit e quajtur ***Sahren,*** *Shkëmbi* dërgohet si një gurë themeltar i përjetshëm i kësaj toke kalimtare, duke aluduar se një pjesë prej tokës do të boshatiset dhe do të transformohet në të ardhmen në një parajsë të përjetshme dhe ai gur themeltar do të bëhet pikë mbështetje për Dy melekët *Demi* dhe *Peshku*. Kjo është transmetuar nga profetët e hershëm të bijve të Israilit, dhe gjithashtu edhe nga Ibnu Abbasi, Zoti qoftë i kënaqur prej tij. Por, fatkeqësisht me kalimin e kohës ky kuptim i shenjtë dhe kjo alegori e hollë u morën si të mirëfillta, u transformuan në një të vërtetë fizike të trupëzuar nga njerëzit e zakonshëm dhe fitoi një formë jashtë limiteve të arsyes. Meqenëse melekët udhëtojnë përmes tokës dhe shkëmbinjve dhe në qendrën e tokës ashtu siç udhëtojnë në ajër, atëherë ato nuk kanë aspak nevojë -dhe as vetë toka nuk ka nevojë- për ndonjë shkëmb fizik të gurëzuar dhe as për dem e peshk fizik të trupëzuar për t'i mbështetur ato! Domethënë, ajo rrëfenjë ishte veçse një alegori. Gjithashtu, për shembull, meqenëse globi tokësor bën tesbihate për All-llahun sa numri i kokave të llojeve që gjenden në të, prej kafshëve, bimëve dhe

qënieve të pashpirta... dhe me gjuhët e anëtarëve të atyre llojeve, dhe me numrin e gjymtyrëve të atyre specieve, dhe me numrin e gjetheve dhe frutave të atyre anëtarëve, sigurisht do të jetë një melek i caktuar me dyzet mijë koka dhe me dyzet mijë gjuhë në çdo kokë, secila prej tyre do të shfaqë dyzet mijë tesbihate Hyjnore, të cilat do të paraqesin e bëjnë të njohur këtë adhurim të natyrshëm, të pavetëdijshëm e madhështor, dhe do ta përfaqësojnë e do ta paraqesin atë me dije e vetëdije tek Prania e Shenjtë Hyjnore, ashtu siç e bëri të ditur njoftuesi i vërtetë pikërisht këtë të vërtetë.

Gjithashtu, ekzistenca dhe natyra e jashtëzakonshme e melekëve si Xhebraili a.s., i cili përcjell e shpall lidhjet Hyjnore me njeriun, që është rezultati më i rëndësishëm i krijimit të universit, dhe Israfili a.s. dhe Azraili a.s. të cilët thjesht përfaqësojnë aktet më madhështore të Krijuesit në botën e qënieve frymore, të cilat janë dhënia e jetës dhe vdekja, lirimi nga detyrat me vdekjen; dhe ata melekë i mbikëqyrin ato me një adhurim të pastër; dhe Mikaili a.s. i cili përfaqëson me vetëdije të plotë llojet e falënderimeve të pavetëdijshme ndaj mirësive të të Gjithëmëshirshmit në rizk -në ushqim- që është sfera më gjithëpërfshirëse dhe më e shtrira, si dhe mëshira më e ëmbël në sferat e jetës; gjithashtu Mikaili a.s. i mbykëqyr ato -ekzistenca- dhe natyra e jashtëzakonshme e melekëve si këta, dhe pavdekshmëria e shpirtërave të tyre kërkohen medoemos nga sovraniteti dhe madhështia e Hyjnisë.

Ekzistenca e tyre dhe ajo e çdo grupi të veçantë prej tyre është aq e sigurt dhe e padyshimtë, si ekzistenca e sovranitetit dhe e madhështisë që shihen në univers aq qartë si dielli. Krahasime të tjera mund të bëhen me këtë për çështjet e tjera lidhur me melekët.

Po, i Gjithëfuqishmi i Gjithëlavdishëm dhe Hirplotë krijoi katërqind mijë specie të qënieve të gjalla në globin tokësor, dhe i krijoi qëniet me shpirt me një bollëk të madh, madje prej substancave të zakonshme e të prishura, duke i mbushur me to të gjitha anët e tokës; dhe i bëjnë ato të deklarojnë me gjuhët e tyre me admirim: ***"Masha'alla, Barekall-llah, Subhanallah"*** përballë mrekullive të artit të Tij xh.sh.. Dhe Ai i Cili i bëri edhe kafshët më të holla të deklarojnë ***"El-Hamdu lil-lah, Esh-Shukru lil-lah"*** dhe ***"All- llahu Ekber"*** ndaj mirësive dhe favoreve të mëshirës së Tij të gjërë, padyshim dhe sigurisht që Ai ka krijuar banorë dhe qënie me shpirtëra të përshtatshëm për qiejt madhështorë, prej atyre që nuk e kundërshtojnë urdhërin e Tij dhe që e adhurojnë Atë vazhdimisht; Ai i mbush me to qiejt duke mos i lënë ato bosh. Ai krijoi shumë lloje të ndryshme të panumërta melekësh, shumë më të mëdhenj në numër se sa llojet dhe

speciet e gjallesave. Disa prej tyre janë shumë të vegjël, ata u ngjiten pikave të shiut dhe flokëve të borës, dhe admirojnë artin Hyjnor dhe mëshirën Hyjnore në gjuhët e tyre.

Një grup tjetër prej tyre ngjiten tek yjet udhëtues, dhe në udhëtimet e tyre përmes hapësirës shpallin për të gjithë botën adhurimin e tyre nëpërmjet *tekbireve* dhe *tehlileve* -***All-llahu Ekber*** dhe ***La ilahe il-lall-llah***- përpara madhështisë, dinjitetit dhe lavdisë së Hyjnisë.

Unanimiteti dhe pajtueshmëria e të gjithë librave të shpallur qiellorë, dhe e të gjitha feve qysh nga koha e Ademit a.s. lidhur me ekzistencën dhe adhurimin e Melekëve, dhe njoftimet e shumta me unanimitet në të gjitha epokat për bisedimin dhe takimin e njerëzve me melekë, provojnë se ekzistenca e tyre është aq e sigurtë sa ekzistenca e njerëzve të Amerikës të cilët ne nuk i kemi parë kurrë, dhe se melekët kanë lidhje me ne.

Tani eja dhe shijo nëpërmjet dritës së besimit këtë frut të dytë universal; shiko se si ai e mbush universin nga cepi në cep, duke e bërë atë të bukur dhe duke e transformuar atë në një xhami të madhe dhe në një vend të gjërë adhurimi.

Kështu, universi i errët, i ftohtë, i pajetë dhe i shkretë siç e përfytyron shkenca dhe filozofia materialiste- bëhet nëpërmjet besimit një univers me jetë, me vetëdije, i ndriçuar dhe i këndshëm, duke i lejuar njerëzit e besimit të përjetojnë një manifestim të kënaqësive të jetës së pavdekshme, secili sipas shkallës së tij, ndërsa akoma janë në këtë botë.

Përfundim: Meqenëse nëpërmjet mistereve të Unitetit Hynor dhe të Njësisë Hynore, e njëjta fuqi, të njëjtët Emra, e njëjta urtësi, dhe i njëjti art gjenden në çdo pjesë të universit, uniteti i Krijuesit xh.sh. autoriteti, dhënia ekzistencë, Hyjnia, krijueshmëria dhe shenjtëria e Tij shpallen nëpërmjet gjuhëve të gjendjeve të tyre të natyrshme të të gjitha krijesave, të pjesshme dhe universale.

Gjithashtu Ai xh.sh. krijoi Melekë në të gjitha anët e universit -që me anë të gjuhëve të tyre lavdëruese e falënderuese- të kryejnë me vetëdije tesbihatet që i bën çdo krijesë nëpërmjet gjuhës së gjendjes së saj pa vetëdije. Melekët nuk e kundërshtojnë All-llahun në urdhërat që u jep. Përveç adhurimit të pastër, ata nuk bëjnë asgjë; ata nuk sjellin asgjë në ekzistencë; ata nuk mund të ndërhyjnë në asgjë pa leje; madje as nuk mund të ndërmjetësojnë pa leje. Ata manifestojnë në shkallën më të lartë kuptimin e:

"Ata janë vetëm robër të nderuar e të nënshtruar".

"Ata nuk flasin derisa të këtë folur Ai dhe ata punojnë nën komandën e Tij".[149]

PËRFUNDIM

[kjo formon një tregues të shkurtër për një të vërtetë të gjatë lidhur me një pikë të hollë mrekullie me një rëndësi shumë të madhe e cila m'u shfaq pas perëndimit të diellit dhe demonstron qartë parashikimet e mrekullueshme të sures *Felek* lidhur me të padukshmen]

Me Emrin e All-llahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"*Thuaj:I mbështetem (All-llahut) Zotit të Agimit (të më ruajë)*
Nga sherri (e keqja) që Ai ka krijuar,
Dhe nga sherri i errësirës (së natës) kur ajo vjen me errësirën e saj.
Dhe nga sherri i atyre që bëjnë magji kur u fryjnë nyjeve,
Dhe nga sherri i ziliqarit kur me zili vepron."[150]

Duke urdhëruar të Dërguarin e Zotit dhe komunitetin e tij a.s.m. për të mbrojtur veten tuaj nga qëniet e këqija dhe nga shejtanët prej xhindëve dhe njerëzëve të cilët përpiqen e luftojnë në univers për llogari të mosqënies", Ky vërset madhështor i mrekullueshëm shikon tek të gjitha epokat, dhe nëpërmjet kuptimit të tij aludues shikon në një shkallë më të lartë tek epoka jonë e çuditshme, madje shikon në mënyrë të qartë, dhe u bën thirrje shërbëtorve të Kuranit që t'i kërkojnë mbrojtje e strehim Allahut. Ky parashikim i mrekullushëm rreth së padukshmes do të shpjegohet shkurtazi në pesë shenja, sa vijon:

Të gjitha vërsetet e kësaj sureje kanë kuptime të shumta. Vetëm lidhur me kuptimin e saj aludues, përsëritja e saj fjalën '*Sherr*' katër herë në pesë fjali; dhe me një lidhje të fuqishme dhe në katër mënyra, tregimi i saj me gisht me të njëjtën datë për katër të këqia të

[149] Kuran 21: 26-27
[150] Kuran 113: 1-5

pashembullta, të tmerrshme, të stuhishme lëndore dhe jolëndore të kësaj epoke, revolucionet dhe me përplasjet e saj; dhe dhënia e urdhërit të saj në mënyrë të nënkuptuar: "tërhiquni prej këtyre", sigurisht është udhëzim nga e padukshmja në një mënyrë të përshtatshme për mrekullinë e Kuranit.

Për shembull, fjalia: "*Thuaj: I mbështetem Zotit të Agimit,"* koinçidon me datën 1352 ose 1354 sipas llogaritjes me sistemin *Ebxhed* dhe *Xhefri,* duke aluduar për luftën e dytë botërore, e cila po afrohej, po ziente dhe atëherë shpërtheu për shkak të ambicies dhe lakmisë mbisunduese të përgjithshme të njerëzimit, si dhe për luftën e parë; dhe në efekt i thotë ummetit të Muhammedit a.s.m. *"*Mos hyni në këtë luftë, por kërkoni strehim tek Krijuesi juaj". Me një tjetër prej kuptimeve të saj aluduese, si një nderim i veçantë për studentët e Risale-i Nurit, të cilët janë shërbëtorët e Kuranit, ajo bën një aluzion për ta se ata do të shpëtonin rreth të njëjtës datë prej Burgut Eskishehir dhe nga një e keqe e madhe, dhe se komplotet për t'i eleminuar ata do të asgjësoheshin. Ishte sikur po i urdhëronte ata në mënyrë simbolike që t'i kërkonin mbrojtje Zotit xh.sh.. Dhe për shembull, Fjalia *"Nga sherri (e keqja) që Ai ka krijuar"* bën 1361 -***ra*** e dyfishuar nuk është llogaritur- tregon duke drejtuar gishtin nëpërmjet datave qoftë sipas kalendarit *Rumi* apo *Hixhrit* për tek kjo luftë e pashoqe, mizore, tiranike dhe shkatërruese.

Duke 'koinçiduar' gjithashtu me studentët e Risale-i Nurit, të cilët punojnë me të gjithë fuqinë e tyre për t'i shërbyer Kuranit, duke shpëtuar prej një komploti të madh për t'i eleminuar ata, nga një fatkeqësi e dhimbshme dhe nga Burgu i Denizlit, ajo gjithashtu shikon tek ata me një kuptim aludues. Me një shenjë të mbuluar, të fshehur, ajo u thotë: "Mbrojeni veten tuaj prej sherrit të krijesave".

Dhe për shembull, duke bërë 1328 në qoftë se shkronjat e dyfishuara nuk llogariten, dhe 1358 në qoftë se ***lami*** llogaritet, fjalia, *".... i atyre që bëjnë magji kur u fryjnë nyjeve"* 'koinçidon' me datat kur për shkak të ambicies dhe lakmisë së tyre, tiranët Europianë të cilët shkaktuan dy luftërat botërore, nxitën... një ndryshim, zëvëndësim të Sulltanit dhe luftërat ballkanike dhe italiane me idenë për të prishur rezultatet e Revolucionit kushtetues, i cili favorizonte Kuranin; atëherë me shpërthimin e luftës së Parë botërore, me anë të diplomatëve politikanë duke fryrë të këqijat e tyre lëndore dhe jolëndore, magjitë, shtrigëritë dhe helmin e tyre në kokat e gjithkujt nëpërmjet gjuhës së radios dhe duke ngulitur planet dhe komplotet e tyre të fshehta në zemrën e fatit njerëzor, ata përgatitën të këqijat që do të shkatërronin

mizorisht një mijë vite të progresit të civilizimit që korrespondon ekzaktësisht me kuptimin e "*... e atyre që bëjnë magji kur u fryjnë nyjeve".*

Dhe për shembull, fjalia *"Dhe nga sherri i ziliqarit kur me zili vepron",* bën 1347 -***Ra*** e dyfishuar dhe ***tenvini*** nuk janë llogaritur- dhe koinçidon ekzaktësisht, dhe korrespondon në kuptim, me përmbajtjet e rëndësishme që ndodhen në këtë vend për shkak të trajtimeve të imponuara nga evropianët dhe me ndryshimet që ndodhën në këtë komb fetar për shkak të shtypjes së filozofisë, dhe smirës së madhe, rivalitetit dhe përplasjeve në vende të ndryshme të cilat shtruan rrugën për luftën e dytë botërore. Këto sigurisht janë shkreptimat e parashikimeve të mrekullueshme të kësaj sureje të shenjtë lidhur me të padukshmen.

Një përkujtues

Të gjithë vësetet e Kuranit kanë kuptime të shumtë. Dhe të gjithë kuptimet janë universalë; ato kanë kuptime -domethënie- në çdo shekull. Ato që u diskutuan këtu janë vetëm niveli i tij i kuptimeve aluduese i cili shikon tek shekulli ynë. Brenda atij kuptimi universal epoka jonë është njëra domethënie, njëri kuptim. Por, ajo ka fituar veçanti, dhe e shikon atë dhe datën e saj. Meqenëse këto katër vitet e fundit unë nuk i kam njohur as fazat e luftës, as rezultatet e saj, nëse është shpallur ose jo paqe, dhe nuk kam pyetur, unë nuk kam trokitur tek dera e kësaj sureje të shenjtë për të mësuar se sa aluzione të shumtë përmban ajo për këtë shekull dhe për luftërat e tij. Megjithatë, është provuar dhe shpjeguar në pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit dhe veçanërisht tek *Rumuzati Semanije, Tetë simbolet,* se ky thesar përmban dhe shumë mistere të tjerë, kështu duke ua referuar ato lexuesve, unë po e pres shkurt këtu.

Përgjigjja për një pyetje që mund t'i ndodhë ndonjërit.

Në këtë shkreptimë të mrekullisë, në *"Nga sherri (e keqja) e asaj që Ai ka krijuar*" tek fillimi, edhe ***'min'*** (prej) edhe '***sherr-ri'*** (e keqja) duke u llogaritur, dhe në *"Dhe nga sherri i ziliqarit kur me zili vepron"* në fund, vetëm fjala ***sherr-rr*** duke u llogaritur, dhe ***ve-min*** duke mos u llogaritur, dhe duke mos u llogaritur asnjëra prej këtyre fjalëve ***"ve min sherr-rrin nef-fathati fil ukad"*** është një shenjë duke treguar një lidhje shumë të hollë. Sepse ndodhet si e mira ashtu dhe e keqja tek njerëzit, dhe jo e gjithë e keqja i bie gjithësecilit. Duke aluduar për këtë, ***min*** dhe ***sherr-rr*** të cilat janë pjesëtore, nuk llogariten. Por ziliqari është krejtësisht i keq kur ai ka zili, prandaj nuk

është nevoja për pjesëtore. Dhe në përputhje me aluzionin e ***"e atyre që bëjnë magji kur u fryjnë nyjeve"*** nuk është nevoja për të llogaritur këtu fjalën '***e keqja'*** sepse të gjitha veprat e atyre magjistarëve dhe e atyre diplomatëve shtriganë të cilët e kanë përflakur globin për hir të interesave të tyre janë thjesht të këqija.

Një shtojcë për një pikë rreth mrekullisë së kësaj sureje

Ashtu si me katër prej pesë fjalive të saj, kjo sure shikon, me kuptimin e saj aludues, tek katër Revolucionet dhe stuhitë më të mëdhaja e të këqija të këtij shekulli, po ashtu me kuptimin e saj aludues dhe sipas llogaritjes me sistemin *Xhefër* nëpërmjet përsëritjes së saj katër herë frazën ***min sherr-rri*** (*nga sherri i)* -dyfishimi nuk është llogaritur- ajo shikon dhe tregon me gisht tek shekulli i grindjes së Xhengiz Hanit dhe Hulagu dhe tek koha e rënies së dinastisë Abaside, e cila ishte fatkeqësia më e tmerrshme e përjetuar nga bota islame.

Po, pa dyshim '***sherr-rr'*** bën 500, dhe '***min'*** është 90. Vërsete të shumta të cilët shohin nga e ardhmja, si Imam Aliu -Zoti qoftë i kënaqur me të- po ashtu edhe Gauthul Aëdham -iu shenjtëroftë sekreti i tij- të cilët aluduan edhe për shekullin tonë, edhe për atë shekull dhe bënë parashikime ekzaktësisht në të njëjtën mënyrë.

Me '***Gàsik'*** duke bërë 1161 dhe '***Idhà vekab'*** duke bërë 810, fjalët **'*Gàsik idhà vekab*'** nuk shikojnë tek këto kohë, por tek të këqijat lëndore dhe jolëndore të atyre kohëve. Në qoftë se ato do të llogariteshin së bashku, ato bëjnë 1971, dhe njoftojnë për ndonjë të keqe të tmerrshme të asaj date. Në qoftë se të korrat e farrërave të së tashmes nuk korrigjohen -nuk përmirësohen- goditjet sigurisht që do të jenë të tmerrshme.

Një shtesë për Shtojcën e Çështjes së Njëmbëdhjetë

Me Emrin e All-llahut i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Vëseti, *"Nuk ka detyrim (në fe) vërtet Rruga e Drejtë është bërë e qartë nga rruga e gabuar"*[151], i cili është një pjesë plotësuese e Ajetit *Kursi*, bën 1350; "*Kushdo që mohon të keqen"-tagutin-* bën 1929 ose 1928; *"dhe beson në All-llahun, ai ka rrokur"* bën 946, duke i korresponduar Emrit 'Risaletu'n Nur*'. "Mbajtësin më të sigurt"* bën 1347; "*që nuk thyhet kurrë*" dhe *"All-llahu është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri"*, *All-*

[151]Kuran 2:256

llahu (është Mbrojtësi i atyre që e besojnë Atë) në qoftë se do të llogariteshin bashkarisht bën 1012, dhe në qoftë se nuk llogariten bashkarisht bën 945, me një dyfishim që nuk llogaritet; "*prej (thellësirave të errësirës) Ai do t'i nxjerrë në dritë"* bën 1372, pa dyfishim; *"Por sa për ata që nuk besojnë, mbështetës (ndihmues) të tyre janë tagutët (të këqinjtë)"* bën 1417; *"(këta i nxjerrin) nga drita dhe i zhysin në errësirë"* 1338, dyfishimi nuk është llogaritur; *"këta janë banorët e zjarrit dhe atje do të banojnë përgjithmonë"* bën 1925, dyfishimi është llogaritur.

Mua m'u shfaq se me kuptimet e tyre aluduese, këto vërsete 'koinçidojnë' ekzaktësisht dhe dy herë edhe me emrin *Risaletun Nur* dhe me formën e luftës së tij; dhe me datën që njerëzit e mosbesimit po përpiqeshin të shuanin dritën e botës së islamit me luftën e vitit 1293 (1876-77); edhe me datën e marrëveshjeve të tmerrshme që po firmoseshin në 1338 duke shfrytëzuar Luftën e Parë Botërore dhe me qëllim që ta zhyste atë në errësirë, në fakt.

Gjithashtu m'u shfaq se drita dhe errësira kundërvihen në mënyrë të përsëritur në këto vërsete, dhe në këtë luftë jolëndore një dritë e cila buron nga drita e Kuranit do të bëhej një pikë mbështetjeje për njerëzit e besimit. Unë u detyrova ta regjistroja këtë në shkrim. Pastaj unë pashë se lidhja e kuptimit të saj me këtë shekull ishte aq e fuqishme saqë edhe në qoftë se nuk do të kishte pasur asnjë shenjë nëpërmjet koinçidencave, unë përsëri do të kisha qenë i sigurt se këto vërsete po flisnin me ne nëpërmjet kuptimeve të tyre aluduese, ashtu siç shohin ato tek të gjithë shekujt.

Po, **së pari** fjalia tek fillimi *"nuk ka detyrim (në fe, vërtet rruga e drejtë është bërë e qartë) nga rruga e gabuar"* tregon nëpërmjet llogaritjes me sistemin *Ebxhed* dhe *Xhefër* datën 1350 (në qoftë se është Rumi 1934, ose në qoftë se është Hixhri, 1931-2), dhe nëpërmjet kuptimit të tij aludues, thotë: Çështjet e fesë duke u ndarë prej atyre të kësaj bote në atë datë, liria e ndërgjegjjes, e cila është në kundërshtim me forcën dhe me detyrimin në fe dhe me luftën fetare dhe me *xhihadin* e armatosur për fenë, u pranua si një rregull themelor dhe si një parim politik nga qeveritë, dhe ky shtet u bë Republikë laike. Nga ky këndvështrim, *xhihadi* do të jetë një *xhihad* fetar jofizik me shpatën e besimit të verifikuar e të sigurt. Sepse ai shfaq një shkreptimë të mrekullisë duke treguar se një dritë do të shfaqet prej Kuranit e cila do të bëjë të njohur dhe do të parashtrojë e shtjellojë qartë prova aq të fuqishme saqë ato do t'i demonstrojnë gati në mënyrë të dukshme udhëzimin dhe të vërtetat e fesë.

Për më tepër, sa për fjalën ***Halidune*** *-dhe atje do të banojnë përgjithmonë*, duke përsëritur kontrastin -kundërshtinë, përplasjen- ndërmjet dritës dhe errësirës, besimit dhe errësirës -burimi dhe origjina e të gjithë krahasimeve në Risale-i Nur dhe pikërisht si ato- është një shenjë e fshehur se një hero i madh në përpjekje e luftë për '*xhihadin Maënevi'* në atë ditë është Risale-i Nuri, i cili mban emrin e dritës. Sepse shpata e tij jofizike ka zgjidhur me qindra mistere të fesë duke mos lënë asnjë nevojë për shpatat fizike.

Po, falënderime të panumërta i qofshin All-llahut, për njëzet vite Risale-i Nuri e ka demonstruar në fakt këtë parashikim dhe këtë shkreptimë të mrekullisë. Për shkak të këtij misteri të madh, studentët e Risale-i Nurit nuk ndërhyjnë në politikë, as në rrymat politike të botës dhe as në luftën e tyre materiale; nuk u japin rëndësi atyre dhe as nuk ulen në nivelin e përfshirjes me ta. Studentët e vërtetë të tij u thonë armiqve të tyre më të tmerrshëm përballë fyerjeve dhe agresionit të tyre:

"O ju fatkëqinj! Unë po përpiqem t'ju shpëtoj nga asgjësimi dhe t'ju ngre ju prej nivelit më të ulët e më të dhimbshëm të kafshërisë jetëshkurtër për tek lumturia e humanizmit të pavdekshëm, ndërsa ju punoni për vdekjen dhe për ekzekutimin tim. Kënaqësitë tuaja në këtë botë janë shumë të pakta dhe jetëshkurtëra, dhe dënimet e torturat që ju do të vuani në Ahiret do të jenë shumë të mëdha e të gjata. Për mua vdekja do të jetë një lirim e shkarkim prej detyrave. Shporruni! Unë nuk do të shqetësohem me ju, bëni çfarë të doni!" Ata -studentët e Risale-i Nurit- nuk ndjejnë zemërim për armiqtë e tyre, por ndjejnë mëshirë e keqardhje. Ata përpiqen t'i reformojnë ata, me shpresë që ata të shpëtojnë.

Së Dyti: "*Dhe beson në Allahun, atëherë ai ka rrokur mbajtësin më të sigurtë"*. Këto dy fjali të bekuara kanë një lidhje të fuqishme, dhe sipas llogaritjes me sistemin *Ebxhed* dhe *Xhefër,* e para korrespondon ekzaktësisht me emrin e Risaletun Nur, dhe e dyta korrespondon në kuptim; dhe sipas llogaritjes me sistemin *Xhefer* me qënien e tij duke u realizuar e duke u plotësuar dhe me pushtimet e tij të ndritshme. Këto korrespondenca janë një tregues se në këtë shekull në këtë datë, Risaletun Nur është mbajtësi më i sigurt. Domethënë, është një zinxhir i pathyeshëm me një fuqi shumë të madhe dhe një litar i Zotit ***-Hablull-llah.*** Ato njoftojnë nëpërmjet kuptimeve të tyre aluduese se ata që mbahen e kapen pas tij do të jenë të shpëtuar.

Së Treti: edhe në kuptim edhe sipas llogaritjes me sistemin *Xhefer*, fjalia *"Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë"* bën një aluzion për Risale-i Nurin, sa vijon:

(Perdja u ul këtu dhe leja nuk u dha për të shkruar. Ajo është shtyrë për një kohë tjetër)

SHËNIM

Arsyeja që leja nuk u dha për të shkruar përkujtuesin e kësaj pike për tani është se ajo prek deri diku politikat e kësaj bote, dhe ne jemi të ndaluar për t'i marrë këto në konsideratë. Po, vërseti "*Por ja, me të vërtetë njeriu i kalon të gjithë kufijtë (në mosbesim, në veprat e ulëta e poshtërsi)"*[152] shikon tek ky 'tagut' dhe tërheq vëmendjen për tek ai...

Said Nursi

. . .

Pjesa e një letre nga Husrevi, heroi i Risale-i Nurit në lidhje me Çështjen e Njëmbëdhjetë prej Frutave të Besimit

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!
"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ty!
Profesori im i dashur dhe i nderuar!

Me mirësinë e madhe që përmban për këtë komb e për këtë vend, me çështjen e saj të nëntë, Trajtesa 'Frutat e Besimit' nuk qe mjet shpëtimi vetëm për studentët e tij ndërsa ishin në mes të armiqve të tyre më të mëdhenj dhe tmerrësisht kryeneçë, por gjithashtu me Çështjen e saj të Dhjetë dhe të Njëmbëdhjetë ajo lavdëron e duartroket

[152] Kuran 96 : 6

në mënyrë të veçantë studentët e Risale-i Nurit në rrugët e realitetit. Për më tepër, lidhur me rrethanat e varrit tek të cilat ne jemi të sigurtë se do të hyjmë, duke e bërë familjar atë vend nën tokë i cili e bën gjithësecilin të dridhet dhe i cili është burim tmerri për të pakujdesshmit në mënyrë të veçantë ku ne do të takohemi e do të flasim me melekët; ky shoqërim na bëri ne të lumtur, dhe i largoi frikësimet tona të tmerrshme rreth asaj vendqëndreseje të parë, duke na lënë ne të marrim frymë lirshëm.

Në duart e atyre si unë që nuk e kanë parë atë jetë të ndritshme, ajo i ngjason një llambe elektrike rrezet e së cilës penetrojnë në qindra e mijëra vite. Ajo gjithashtu i ngjason një lulishteje modele, aromat dhe erërat e së cilës janë gjithmonë burim kënaqësie.

Po, unë i sugjeroj profesorit tonë të dashur që ashtu si studentët të cilët ia thonë përmendësh mësimet e tyre mësuesit të tyre, edhe ne gjithmonë duhet t'ia përshkruajmë profesorit tonë të dashur shkëlqimin që ne marrim prej Risale-i Nurit. Por tani profesori ynë i dashur nuk po përmbahet nga të folurit.

Profesori im i dashur! Realiteti i Risale-i Nurit, bukuria e Fruteve dhe shkëlqimi i luleve të tij më kanë shtyrë të shpreh pak fjalë, me mirënjohje, në emrin e vendit tim dhe kanë gjallëruar shumë zemra të cilat flasin si zemra ime. Por tani, për shkak të 'lules' së 'Frutit të Njëmbëdhjetë të besimit' hapat e ndërmarra kundra Risale-i Nurit në zonën tonë dhe duart e ngritura kundra tij, janë bërë më të ashpra e më të forta dhe janë nxitur në akte.

Studenti yt modest Husrevi

Një letër e shkruar në emrin e të gjithë studentëve të Risale-i Nurit në Isparta për të dhënë urime për Ramazanin, e cila është amenduar në trembëdhjetë pjesë.

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!
"Dhe s'ka ndonjë gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij".

Profesori ynë i nderuar, i cili nëpërmjet shkëlqimit të Kuranit dhe të vërtetave të Risale-i Nurit dhe aspiratave të studentëve të tij besnikë vajton duke i pikuar sytë gjak për mirëqënien e botës islame në këtë botë dhe në tjetrën...

I cili në këto ditë të stuhishme të fundit të kohës është i rrethuar me më shumë vuajtje e sëmundje se sa Hazreti Ejjubi a.s., dhe nëpërmjet dritës së Kuranit, provave të Risale-i Nurit dhe përpjekjeve të studentëve të tij punon për të shëruar sëmundjet e botës islame ashtu si Lukmani i urtë, dhe ka provuar me tridhjetë e tre vërsetet e Kuranit dhe me parashikimet e Imam Aliut dhe të Gauth el Aëdham se Risale-i Nuri me pjesët e tij të ndryshme është e vërtetë dhe realitet...

I cili megjithëse vetë është i sëmurë, i moshuar, i dobët dhe në rrethana të mjerueshme, sakrifikon më shumë se çdokush tjetër jetën e tij për botën e islamit dhe u përgjigjet atyre që i bëjnë padrejtësi me të vërtetat e Kuranit dhe me provat e Risale-i Nurit, dhe nëpërmjet besnikërisë së studentëve të Risale-i Nurit me lutje e me vepra të mira...

I cili së bashku me studentët e tij u dërgua në burg për shkak se u botua një nga veprat e tij të rëndësishme -***El-Ajetul Kubra***- dhe nëpërmjet udhëzimit të Kuranit, mësimeve të Risale-i Nurit dhe entuziazmit të studentëve të tij e transformoi burgun në një *"shkollë të Jusufit*" dhe një vend mësimi, dhe ishte shkaku për të gjithë të paditurit midis nesh që të mësonin aty për të lexuar të gjithë Kuranin, dhe pavarësisht të qënurit i moshuar e i dobët, nëpërmjet fuqisë së shenjtë të Kuranit, ngushëllimeve të Risale-i Nurit dhe qëndresës së vëllezërve të tij, mori mbi vete peshat e të gjithëve prej nesh, dhe nëpërmjet 'Frutave të besimit' dhe 'Fjalës Mbrojtëse' të cilat ai i shkroi, mrekullia e Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm, dhe provat e fuqishme të Risale-i Nurit, dhe sinqeriteti i studentëve të tij, me lejen Hyjnore patën hapur derën e burgut dhe fituam pafajësinë tonë, dhe e bëmë atë ditë një festë për ne dhe për botën islame, dhe duke provuar se Risale-i Nuri është 'Dritë mbi drita' fitoi të drejtën për të që të lexohet e të shkruhet lirshëm deri në fundin e kohës...

I cili ka provuar me mbështetjen e shenjtë të Kuranit të kalibrit më të lartë, dhe me ushqimin tjetër mondan të Risale-i Nurit dhe me oreksin e studentëve të tij- ka provuar se bota islame ka nevojë për Risale-i Nurin ashtu siç ka nevojë për ujë e për ajër; dhe se mijërat prej atyre të cilët i kanë lexuar këto tratesa dhe i kanë shkruar kanë hyrë në varr në një gjendje besimi, dhe kurrë nuk i ka mposhtur dhe nuk i ka ngushtuar studentët të cilët e ndjekin atë, dhe nëpërmjet mësimeve qiellore të Kuranit, parimeve të Risale-i Nurit, zgjuarsisë së studentëve të tij, dhe Çështjes së Dhjetë dhe të Njëmbëdhjetë të 'Frutave të Besimit' dhe të luleve të tij shuajti zjarret e ndarjes që nata dhe dita djegin në zemrat tona, dhe ashtu si uji i jetës dhe uji -pija- e Keutherit i mbushi ata me gëzim e lumturi...

I Cili, në përputhje me disa premtime dhe kërcënime të Kuranit të kalibrit të lartë dhe zbulimeve të sigurta të Risale-i Nurit, të vëzhgimeve të studentëve të tij të ndjerë dhe të atyre që zbulojnë ndodhitë e varrit, e ka shpëtuar vdekjen për besimtarët -gjënë më të frikshme prej të gjithë botës- nga të qenurit asgjësimi i përjetshëm dhe e ka transformuar atë në një shkarkim prej detyrave, dhe ka treguar se për mosbesimtarët dhe për hipokritët ajo -vdekja- është një asgjësim i përjetshëm; ka provuar në përputhje me njoftimet e sigurta të Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm, të konfirmuara dhe nga një mijë mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m. dhe nga dyzet aspektet e mrekullisë së Kuranit, dhe të mbështetura nga provat e Risale-i Nurit - të cilat burojnë nga Kurani- i cili ka shpartalluar madje edhe armiqtë e tij më kryeneçë dhe janë parashtruar nga studentët e Risale-i Nurit, dhe janë mbështetur gjithashtu nga shumë shenja, eksperienca dhe bindje se varri i frikshëm, i ftohtë, i errët dhe i ngushtë është për besimtarët një gropë e Parajsës dhe një derë për tek kopshtet e Parajsës, ndërsa për mosbesimtarët dhe për ateistët shtiracakë është një gropë e Ferrit plot me gjarpërinj e kuçedra; dhe i ka bërë melekët e quajtur *Munker* dhe *Nekir*, të cilët do të hyjnë aty, shoqërues familjarë për njerëzit e së vërtetës dhe për ata që kanë marrë rrugën e realitetit; dhe i përfshiu studentët e Risale-i Nurit midis 'studentëve të shkecave fetare', dhe zbuloi me vdekjen e heroit martir, të ndjerit Hafiz Aliut, se ata u përgjigjen pyetjeve të *Munker ve Nekir* me Risale-i Nurin; dhe i cili i kërkon mëshirës Hyjnore që ata prej nesh që janë akoma gjallë gjithashtu të përgjigjen me Risale-i Nurin...

I Cili, nëpërmjet demonstrimit të një aspekti të mrekullisë lidhur me secilin prej dyzet niveleve të Kuranit të kalibrit më të lartë, dhe nëpërmjet tij duke qenë fjala e parapërjetshme e Zotit, dhe nëpërmjet veprave "*Mrekullia e Kuranit*" dhe "*Tetë Simbolet*" prej Risale-i Nurit,

dhe përpjekjeve të jashtëzakonshme të vëllezërve heroikë dhe studentëve të Risale-i Nurit si shkruesi kryesor i 'Fabrikës së trëndafilit' -trëndafilishtes- dhe nëpërmjet Husrevit, njërit prej shkruesve heroikë të Risale-i Nurit duke u urdhëruar të "shkruajë!", megjithëse asnjë qysh nga koha e profetit a.s.m. nuk ka qenë në gjendje ta shkruante atë në një mënyrë të tillë të mrekullueshme, qënia e saj e shkruar si Kurani i shkruar në Pllakën e Ruajtur -ka provuar në një mënyrë të bukur e të shndritshme, që kurrë nuk është parë e as nuk është dëgjuar më parë- se Kurani i kalibrit më të lartë është Fjala e vërtetë e Allahut, dhe më i madhi i të gjithë librave të shpallur qiellorë, dhe se ndodhen mijëra sure Fatiha brenda një sureje Fatiha, dhe mijëra sure Ihlas brenda një sureje Ihlas; dhe se shkronjat e Kuranit fitojnë dhjetë, njëqind, një mijë dhe mijëra merita dhe vepra të mira...

I Cili ka provuar se Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm duke demonstruar mrekullinë e tij për një mijë e treqind vite dhe duke i ndaluar ata që e kundërshtojnë, dhe nëpërmjet provave të Risale-i Nurit që janë aq të qarta saqë pothuajse janë të dukshme, dhe nëpërmjet penave prej diamanti të studentëve të Risale-i Nurit -ka provuar- se Fjala e Njëzet e Pestë dhe shtojca e saj, e cila ka sfiduar botën dhe ka heshtur madje edhe kryeneçin më të madh, janë mrekullitë e Kuranit në Dyzet aspekte...

I Cili ka provuar në Trajtesën prej Risale-i Nurit e titulluar "*Mrekullitë e Muhammedit a.s.m."* duke treguar se Muhammedi a.s.m ishte një mesazhier i vërtetë, prijësi i të gjithë njëzet e katër mijë profetëve, dhe më i virtytshmi i tyre, dhe nëpërmjet Kuranit të kalibrit më të lartë duke shpallur për universin se i Dërguari i Zotit xh.sh. u dërgua si mëshirë për të gjitha botët, dhe se Risale-i Nuri duke demonstruar nga fillimi gjer në fund se ai a.s.m. ishte mëshirë për të gjitha botët, dhe duke ia shfaqur madje edhe të verbërve se veprat dhe sjelljet e të dërguarit janë shembulli më i mirë e më i bukur për t'u ndjekur në botë, dhe nëpërmjet dëshmisë së fatkeqësive duke u ngritur e larguar kur Risale-i Nuri u përhap në Anadoll dhe në vende të tjera, dhe fatkeqësitë duke ndodhur kur ai braktisej e lihej i heshtur, dhe nëpërmjet lidhjes së fortë e të qëndrueshme të studentëve të Risale-i Nurit me punën e tyre pavarësisht rrethanave të tyre tepër të vështira, ka treguar se sa me përfitm dhe me leverdi është ndjekja e sunnetit të profetit a.s.m. dhe se të ndjekësh një sunnet të vetëm në këtë kohë fiton shpërblimin e njëqind martirëve, dhe ka provuar në mënyrë absolutisht të sigurt se për njëzet vite Risale-i Nuri ka zmbrapsur fatkeqësitë dhe katastrofat që ndryshe do t'i kishin rënë Anadollit, pikërisht ashtu siç zmbraps dhënia e sadekasë fatkeqësinë!

Tani, meqenëse pafajësia e Risale-i Nurit ka mbushur me gëzim së pari profesorin tonë të dashur, pastaj neve studentët e pafuqishëm e me të meta, pastaj botën islame, dhe shkaktoi një festival të madh, dhe duke dhënë urimet tona për Ramazanin dhe Natën e Kadrit dhe për festën e tretë, i lutemi Allahut të Gjithëfuqishëm që ne të shohim edhe më shumë të tilla, dhe duke iu përgjëruar që t'i falë gabimet dhe të metat midis nesh, ne ju dërgojmë përshëndetjet e të gjithëve këtu dhe i puthim duart e tua të bekuara dhe kërkojmë duatë e tua, o profesori ynë!

Studentët e Risale-i Nurit
në Isparta dhe në rrethinat e saj

. . .

Ta refuzosh me modesti këtë letër, e cila është njëqind herë më e madhe se sa më takon, do të ishte mosmirënjohje dhe një fyerje për mendimet e mira të të gjithë studentëve, ndërsa ta pranosh atë ashtu siç është do të tregonte krenari, egoizëm dhe mendjemadhësi. Prandaj duke shqyrtuar trembëdhjetë pjesë, unë po ju dërgoj ju një kopje të kësaj letre të gjatë të shkruar nga shkruesi i Risale-i Nurit në emrin e gjithësecilit, edhe me falënderime, edhe për të shpëtuar nga krenaria dhe nga mosmirënjohja. Kjo mund të shtohet tek fundi i çështjes së Njëmbëdhjetë me titullin: "*Një letër prej studentëve të Risale-i Nurit të Ispartës dhe të rrethinave të saj*" . Megjithëse unë e kam korrigjuar

letrën në këtë mënyrë, dy herë një pëllumb zbriti tek dritarja ime. Ai do të hynte por pa kokën e Geilanit dhe nuk hyri. Pak minuta më vonë një pëllumb tjetër u ul pikërisht në të njëjtën mënyrë. Edhe ai gjithashtu pa kokën e shkruesit dhe nuk hyri brenda. Unë thashë: "Ka shumë të ngjarë që këto janë mbajtësit e njoftimeve të mira ashtu si harabeli dhe zogu '*Kuddus'* më parë. Ose për shkak se ne e kemi shkruar këtë letër si letrat e tjera të shumta sekrete, ato erdhën për të na përgëzuar për korrigjimin e letrës ndjellamirë në këtë mënyrë."

Said Nursi

. . .

RREZJA E DYMBËDHJETË

[Pjesë nga "Mbrojtja e Fjalës" e dhënë në Gjykatën e Denizlit][153]

Po, ne jemi një shoqëri dhe ne jemi një shoqëri e cila në çdo shekull ka pasur treqind e pesëdhjetë milionë -tani rreth një miliardë e gjysëm- anëtarë.

Në çdo ditë nëpërmjet pesë namazeve të detyruar, anëtarët e saj demonstrojnë me nderim të plotë lidhjen e tyre me parimet e asaj shoqërie të shenjtë. Nëpërmjet -parimit- programit të shenjtë të *"Padyshim që besimtarët janë vëllezër -janë një vëllazëri e vetme",*[154] ata nxitojnë për t'u ardhur në ndihmë njëri-tjetrit me duatë e tyre dhe me fitimet e përparimet e tyre shpirtërore. Ne jemi anëtarët e asaj shoqërie të shenjtë e të gjërë dhe detyra jonë e veçantë e kryesore është që t'ua mësojmë besimtarëve në mënyrë të sigurt e të verifikuar të vërtetat Kur'anore të besimit!, dhe t'i shpëtojmë ata dhe veten tonë nga zhdukja e përjetshme dhe nga burgimi i vetmuar i përhershëm i Botës së ndërmjetme- Berzah. Ne nuk kemi absolutisht asnjë lidhje me ndonjë shoqëri materiale, politike, komplotuese dhe as me ndonjë grup klandestin ilegal, dhe as me organizata të fshehta lidhur me atë që ne jemi akuzuar pa u mbështetur në asnjë fakt; ne nuk e ulim veten në gjëra të tilla.

. . .

Në qoftë se ne do të kishim pasur ndonjë dëshirë për të ndërhyrë në çështjet e kësaj bote, ajo nuk do të kishte qenë me një zëzëllimë të tillë si një mizë, ajo do të kishte shpërthyer si të qëlluarit me gjyle topi.

Të akuzosh dikënd i cili e mbrojti veten me vrull në Gjykatën ushtarake dhe në zyrën e kryetarit të asamblesë kombëtare në prani të një Mustafa Qemali të zemëruar, për kurdisje komplotesh për tetë vite duke mos lejuar askënd të jetë në dijeni të saj, kjo sigurisht është për shkak të ndonjë mërie ose urrejtjeje.

---

[153]Meqenëse çështjet ishin të njëjtat, profesori ynë Bediuzzaman Said Nursi, paraqiti të njëjtën mbrojtje -duke kapërcyer aty ku ka qenë e domosdoshme dhe duke shtuar aty ku ka qenë e nevojshme- për gjykatën e Afjonit ashtu siç e pati paraqitur tek Denizli. Prandaj Ai i bashkoi pjesën më të madhe të "Mbrojtjes së Fjalës" të Denizlit me ato të Afjonit dhe u dha atyre emrin e "Rrezes së Katërmbëdhjetë".
Nënshkruan, Studentët e tij.

[154] Kur'an, 49:10

Në këtë çështje, Risale-i Nuri nuk duhet të sulmohet për shkak të gabimeve të mia personale as të atyre të disave prej vëllezërve të mi. Kjo lidhet drejtpërdrejt me Kur'anin, dhe Kur'ani lidhet me Fronin Sublim; kështu kush është ai që do të guxonte ta shtrijë dorën e tij atje për t'i zgjidhur e liruar ato litarë të fortë?

Për më tepër, Risale-i Nuri, për bekimet e të cilit -materialë e shpirtërorë- për këtë vend, dhe për shërbimin e tij të jashtëzakonshëm, aludohet nga tridhjetë e tre vërsetet e Kur'anit, nga tre parashikimet e Imam Aliut -Zoti qoftë i kënaqur prej tij- dhe nga disa njoftime të sigurta të Gauth el-Aëdham -iu shenjtëroftë sekreti i tij-, nuk mund të mbahet përgjegjës për gabimet tona të papërfillshme personale; kjo nuk mund dhe nuk duhet të jetë. Përndryshe dëme të pandreqshme - materiale dhe shpirtërore - do t'i vinin këtij vendi.[155]

Në dashtë Zoti, agresioni dhe komplotet e disa ateistëve mendjeligë e keqdashës kundra Risale-i Nurit do të prishen, sepse studentët e tij nuk mund të krahasohen me të tjerët; ata nuk mund të shpërndahen, të shpartallohen dhe as të bëhen që ta braktisin atë; nëpërmjet përkujdesjes Hyjnore ata nuk do të mposhten. Ata e kanë fituar vlerësimin e këtij kombi, sikur ata të ishin forcë jetike për të, dhe gjenden gjithandej; madje edhe në qoftë se nuk do t'i kishte parandaluar ata Kur'ani prej mbrojtjes fizike, ata përsëri nuk do të ndërlikoheshin e përfshiheshin në incidente të vogëla e të padobishme si ato të Shejh Saidid dhe të Menemen. Në qoftë se Ruajna Zot, Ata do të persekutoheshin dhe Risale-i Nuri do të sulmohej derisa të ndjeheshin të shtrënguar e të detyruar, ata ateistë shtiracakë të cilët gënjejnë qeverinë, sigurisht që do të vinin për t'u penduar për të një mijë herë më shumë.

Shkurtazi: Ne nuk ndërhyjmë në dynjanë e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, kështu edhe ata nuk duhet të ndërhyjnë në shërbimin tonë të besimit dhe në jetët tona të Ahiretit.

I Burgosuri Said Nursi

. . .

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i Lartësuar!

---

[155] Ky peticion u shkrua njëzet ditë para tërmetit të Kastamonus. Nëpërmjet bekimeve të Risale-i Nurit, Kastamonuja u ruajt prej fatkeqësisë më shumë se çdo provincë tjetër, por tani fatkeqësitë kanë filluar dhe kanë konfirmuar atë që ne thamë!

Efendilerë!

Unë ju them me siguri se përveç atyre që gjenden këtu të cilët nuk kanë lidhje ose pak lidhje me ne, unë kam aq shumë vëllezër të vërtetë dhe shokë besnikë në rrugën e së vërtetës, aq sa mund të doni.

Nëpërmjet zbulimeve të sigurta të Risale-i Nurit, ne njohim me siguri të patundur si dy edhe dy bëjnë katër se nëpërmjet misterit të Kur'anit Kerim - për ne vdekja është transformuar prej një asgjësimi të përjetshëm në një shkarkim nga detyrat, dhe se për ata të cilët na kundërshtojnë ne dhe që ndjekin çudhëzimin vdekja e sigurt është ose asgjësim i përjetshëm (në qoftë se ata nuk kanë besim të sigurt për Ahiretin), ose kjo vdekje është një burg i vetmuar i përjetshëm dhe i errët (në qoftë se ata besojnë në Ahiretin mirëpo janë zhytur në jetën e shthurjes dhe të çudhëzimit)

Unë ju pyes ju: A ka në dynja ndonjë çështje më të madhe se sa çështja e vdekjes?... A ka ndonjë çështje njerëzore më të rëndësishme dhe më të madhe se sa kjo çështje? Atëherë si mund të shfrytëzohet kjo çështje për hir të diçkaje tjetër?....

Meqenëse është e pamundur që të ketë diçka tjetër më të rëndësishme se sa kjo çështje, atëherë përse merreni kështu me ne dhe luftoni kundra nesh? Përballë dënimit tuaj më të madh, ne marrim letrat tona të lirimit për të shkuar në botën e dritës, kështu që ne e presim atë me qëndresë të plotë...

Por ne e dimë me shkallën e sigurisë së njohjes dhe aq qartë sikur ta shikonim, ashtu siç ju shohin ne ju në këtë sallë gjyqi, se ata të cilët na refuzojnë e na dënojnë për llogari të çudhëzimit do të dënohen në një të ardhme të shpejtë me asgjësim të përjetshëm dhe me burgim të vetmuar fillikat dhe do ta vuajnë atë dënim të tmerrshëm, dhe me ndjenjat tona të humanizmit në ndjejmë keqardhje për ta. Unë jam gati ta provoj këtë fakt të sigurt e të rëndësishëm dhe gjithashtu ta hesht edhe më kryeneçin prej tyre. Unë jam i gatshëm të pranoj çdo lloj dënimi qoftë, në qoftë se nuk do ta provoja këtë më qartë se dielli në mesditë dhe përpara dijetarëve dhe filozofëve tuaj më të mëdhenj dhe jo vetëm përpara këtyre shkollarëve të autorizuar të këtij komiteti të cilët nuk kanë pjesë nga dija dhe nga përvoja; ata janë të mbushur me paragjykim dhe nuk kanë njohuri rreth çështjeve shpirtërore e morale, si dhe nuk preokupohen për to.

Thjesht si një shembull, unë ju jap trajtesën e *"Frutave të besimit"*, e cila u shkrua për të burgosurit në dy të premte, dhe duke shpjeguar parimet, objektivat dhe bazat e Risale-i Nurit, është si një mbrojtje e

tij. Ne po punojmë në mënyrë të fshehtë nën vështirësi të mëdha që ta kemi të shkruar këtë trajtesë me shkronjat e reja[156] me qëllim që t'ua paraqesim departamenteve të Qeverisë në Ankara. Lexojeni dhe studiojeni atë me kujdes; në qoftë se zemra juaj -unë nuk mund të flas për shpirtin tuaj- nuk më mbështet, unë do të qëndroja i heshtur përballë çfarëdo lloj fyerjesh dhe torturash që do të më jepnit në burgimin e vetmuar fillikat në të cilin unë po mbahem tani!

Shkurtazi: Ose lëreni Risale-i Nurin krejtësisht të lirë, ose thyejeni e copëtojeni këtë të vërtetë të fuqishme e të parefuzueshme në qoftë se ju mundeni! Deri tani, unë nuk kam menduar as për ju dhe as për dynjanë tuaj. Dhe unë as nuk do të mendoja për të, mirëpo ju më detyruat, dhe ndoshta edhe Kaderi Hyjnor na dërgoi ne në këtë rrugë me qëllim që t'ju paralajmërojmë juve. Sa për ne, ne kemi vendosur për të marrë si udhëzuesin tonë parimin e shenjtë,

"Kushdo që beson në Kaderin Hyjnor është i shpëtuar nga brenga e nga mjerimi", dhe t'i përballojmë të gjitha vështirësitë me durim.

I burgosuri Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, të Cilit i takon lavdërimi!

Duke thënë se ne "qenkemi duke shtrembëruar fenë", ata na kanë dënuar për përpilimin e një *Hizbi* Kur'ani, si një *An'am*,[157] i madh prej qindra vërseteve të mirënjohur të cilët janë burimet e posaçme të Risale-i Nurit, megjithëse ky është një zakon islam që është praktikuar qysh prej kohës së profetit a.s.m.. Ata gjithashtu duan të na dënojnë, duke na bërë fajtorë lidhur me trajtesën e veshjes islame, për të cilën unë tashmë kam kryer një vit dënim, dhe e cila trajtohej si privatisht, dhe si e regjistruar në raportin e policisë, dhe u nxor nga poshtë druve të zjarrit -ata dëshirojnë të thonë se ajo u shkrua dhe u botua këtë vit.

Gjithashtu, unë shpreha fjalë të fuqishme ndaj personit të Mustafa Qemalit i cili ishte kryetari i qeverisë në Ankara; unë e kritikova atë në fytyrën e tij dhe ai nuk u përgjigj por qëndroi i heshtur; megjithatë unë bëra kritika të natyrshme, të domosdoshme dhe me mirëbesim ndaj tij

---

[156] Kjo i referohet Alfabetit latin.

[157] Më parë ka qenë një praktikë e zakonshme e përbashkët duke u grumbulluar bashkë në një volum të vetëm për leximin e vazhdueshëm të sures el-An'am dhe të sureve të tjera me merita dhe të vërseteve nga Kurani.

pas vdekjes së tij kur unë po shpjegoja kuptimin e një hadithi që tregoi e aludoi për gabimin e tij, dhe këto u quajtën e u konsideruan si një krim. Por, çfarë rëndësie ka hiri -e mira- e dikujt që është i vdekur dhe nuk ka më asnjë lidhje me qeverinë përveç hirit të kombit, qeverisë dhe ligjeve të drejtësisë, të cilat janë një manifestim i sovranitetit Hyjnor?

Përveç kësaj, liria e ndërgjegjjes, që është njëri nga parimet e qeverisë së republikës tek e cila jemi mbështetur shumë dhe me të cilën mbrojmë vetet tona, është bërë baza e akuzave kundra nesh; sikur ne dalim kundra parimit të lirisë së ndërgjegjjes.

Një gjë tjetër më atribuohet mua në raportin e policisë, e cila kurrë nuk më ka ndodhur ndonjëherë, se meqenëse kritikoj të këqijat dhe të metat e qytetërimit modern, unë nuk pranokam ta përdor radion[158], t'i përdorë aeroplanët dhe trenat; unë jam akuzuar se kundërshtokam progresin -përparimin modern.

Në dashtë Zoti, prokurori i drejtë dhe i paanshëm i Denizlit dhe Gjykata do të bëjnë analogji me shembujt e lartëpërmendur dhe do të shfaqin se sa të padrejta janë këto procese gjyqësore, dhe të mos u japin aspak rëndësi dyshimeve të pabaza të atyre raporteve.

Më e jashtëzakonshmja e tyre është kjo: Ai prokuror në një proces tjetër gjyqësor më pyeti: Ti the në Rrezen e Pestë private -të fshehtë- se ushtria do ta shpëtonte vetveten prej komandimit të atij personi të frikshëm. Qëllimi yt ishte të nxisje ushtrinë për të ngritur krye kundra qeverisë. Unë iu përgjigja: "Ajo që unë doja të thoja ishte se, komandanti ose do të vdiste ose do të transferohej, dhe ushtria do të shpëtonte prej dominimit të tij". Si është e mundur që një trajtesë e cila është edhe tej mase private, dhe kopjet e së cilës më kanë rënë në dorë vetëm dy herë për tetë vite dhe pastaj janë humbur, dhe që shpjegon një kuptim universal të një hadithi rreth fundit të kohës, dhe në mënyrë origjinale u shkrua shumë kohë më parë, dhe përveç kësaj as dhe një ushtar i vetëm nuk e ka parë, -si mundet- një trajtesë e tillë të jetë arsyeja për akuza të tilla?

Më e çuditshmja e të gjithave ishte kjo, se unë thashë në një vend se, mirësive të mëdhaja të Zotit të Gjithëfuqishëm lidhur me aeroplanin hekurudhën dhe radion duhet t'u përgjigjemi me

[158] Unë e thashë, për të nxitur dhënien e falënderimeve të pafundme për një mirësi të lartë Hyjnore si radioja, që Kur'ani të recitohet nëpër radio me qëllim që njerëzit të mund ta dëgjojnë atë anembanë botës, dhe atmosfera e globit të bëhej një recituese e Kur'anit.

falënderime të mëdha, por njerëzimi nuk e ka bërë këtë dhe ka lëshuar bomba me aeroplanë mbi kokat e njerëzve. Ndërsa falënderimet për mirësinë e madhe të radios do të shfaqeshin nëpërmjet bërjes së saj recituese universale miliona gjuhëshe e Kur'anit e cila do t'i lejonte njerëzit gjithandej tokës ta dëgjonin Kur'anin.

Dhe në shpjegimet në Fjalën e Njëzet lidhur me parashikimet e Kur'anit rreth çudirave të civilizimit, unë thashë për sa ka të bëjë me aluzionet e një vërseti se mohuesit -jobesmtarët- do ta mposhtnin botën islame nëpërmjet hekurudhës. Megjithëse i nxita myslimanët që të vepronin drejt këtyre çudirave, unë u akuzova në fund të padisë, për shkak të shpirtëligësisë së prokurorit të mëparshëm, për kundërshtim të përparimeve moderne të tilla, si: hekurudha, aeroplani dhe radioja.

Gjithashtu, megjithëse kjo nuk ka absolutisht asnjë lidhje, dikush ka thënë rreth emrit "Risaletun-Nur", i cili është një emër tjetër për Risale-i Nurin, se "ai është një mesazh" -*risalet*- i inspiruar nga drita e Kur'anit: dhe duke i ngjitur një kuptim të gabuar nga një vend tjetër në akuzë, ata e kthyen atë në një padi tjetër, sikur unë paskam thënë: "Risale-i Nuri është një mesazhier Hyjnor".

Gjithashtu, unë kam provuar në mënyrë vendimtare në njëzet vende në mbrojtjen time se ne nuk do t'i bënim fenë, Kur'anin dhe Risale-i Nurin mjete për asnjë gjë, as edhe për faqen e të gjithë botës, dhe nuk kemi mundur dhe as nuk do të ndryshojmë as edhe një të vërtetë të vetme prej të vërtetave të tyre për të gjithë botën, dhe kjo është si jemi ne në fakt. Përgjatë këtyre njëzet viteve të fundit ndodhen me mijëra dëshmi të kësaj. Meqenëse kjo është kështu, ne deklarojmë me të gjithë fuqinë tonë: *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Said Nursi

. . .

Me Emrin e të Cilit i takon Lavdërimi.

Një shtojcë për kundërshtimet e mia ndaj akuzës.

[Atyre që u adresohen këto kundërshtime nuk janë gjykata e Denizlit dhe prokurori i përgjithshëm, por janë zyrtarët dashakëqinj dhe të dyshuar, kryesisht prokurorët e Ispartas dhe të Inebolus, të cilët me proceverbalet e rreme e të pasakta, ishin shkaku i padisë së jashtëzakonshme kundra nesh këtu.]

Së Pari: Studentët e Risale-i Nurit, të cilët janë të pafajshëm dhe aspak të përfshirë në politika, në mënyrë të paimagjinueshme dhe pa asnjë bazë a motiv janë quajtur një shoqëri politike, dhe të mjerët që i janë bashkuar atij rethi dhe që nuk kanë asnjë qëllim tjetër përveç besimit dhe Ahiretit, janë konsideruar fajtorë për qënien e tyre përhapës të asaj shoqërie, ose nëpunësit aktiv ose anëtarët e saj, ose për leximin e Risale-i Nurit, ose për mësimdhënien e tij, ose për shkak se e shkruan atë, dhe janë dërguar në gjyq. Një provë e sigurt se sa larg është kjo prej esencës së drejtësisë së vërtetë është se megjithëse sipas parimeve të lirisë së mendimit dhe lirisë së studimit nuk konsiderohet krim të lexosh veprat e dëmshme të Doktor Dozit[159] dhe të ateistëve të tjerë armiqësorë ndaj islamit, është quajtur një krim për ata njerëz të nevojshëm për të vërtetat e Kur'anit dhe të besimit për ta lexuar e shkruar Risale-i Nurin, i cili i jep mësim ato të vërteta në mënyrë aq të shndritshme si dielli.

Për më tepër, vetëm se pak fjali prej dy ose tri trajtesave midis qindrave të tilla, të cilat i patëm mbajtur privatisht me qëllim që të mos u përshkruhej asnjë kuptim i gabuar atyre që nuk u lejuan të botoheshin, u bënë pretekst për të na paditur. Ndërsa me një përjashtim, gjykata Eskishehir i pati shqyrtuar me imtësi dhe i pati hetuar ato trajtesa, duke parë e menduar çfarë bënin ato të domosdoshme. Sa për përjashtimin, unë dhashë një përgjigje tepër vendimtare për të edhe në peticionin tim, edhe në kundërshtimet e mia ndaj Gjykatës së Eskishehir, dhe u provua në njëzet aspekte se "ne kemi dritën dhe jo topuzin e politikave". Prapëseprapë, ata prokurorë të padrejtë deduktuan, nxorrën si rrjedhim, se tre apo katër Fjalitë në tre trajtesat private të pabotuara mund të shtriheshin e arrinin të gjithë Risale-i Nurin, dhe më akuzuan mua dhe ata të cilët e lexojnë dhe e shkruajnë Risale-i Nurin për kundërshtim ndaj qeverisë.

Unë thërras për të dëshmuar shokët e mi të afërm dhe ata të cilët më takojnë, dhe unë bëj be se përveç dy presidentëve, një deputeti, dhe guvernatorit të kastamonus, për më shumë se tetë vite, nuk e kam ditur se cilët ishin anëtarët dhe ministrat e qeverisë, as kryetarët, as nëpunësit dhe as deputetët e saj, dhe nuk kam pasë as edhe kureshtjen më të vogël për ta njohur e kuptuar një gjë të tillë.

A do të ishte e mundur që një person të mos njihte njerëzit të cilët ai i kundërshton dhe të mos ishte kureshtarë për ta, që ai të mos i njihte

[159] Reinhart Dozy (1820-1883), orientalist Hollandez, me origjinë Franceze. Njëra nga veprat e tij është "Tarihul-Islam" "Historia e Islamit" e cila u përkthye në turqisht nga ateistët.

nëse ata janë miq apo armiq, dhe të mos i jepte rëndësi zbulimit të kësaj? Nga kjo kuptohet qartë se ata po kurdisin komplote e po shpikin pretekste krejtësisht të pabaza për të më bërë fajtor e për të më dënuar me çfarëdo që të ndodhë.

Meqenëse kjo është si të jetë, unë nuk i them gjykatës këtu, por atyre njerëzve të padrejtë: Mua s'më bëhet vonë fare as edhe për dënimin më të rëndë që mund të më jepni; ajo s'ka asnjë rëndësi. Sepse unë jam shtatëdhjetë vjeç dhe në derën e varrit.

Do të ishte një fat i mirë për mua ta shkëmbeja një ose dy vite të jetës së përndjekur e të pafajshme me rangun e martirizimit. Nëpërmjet mijëra provave të Risale-i Nurit, unë besoj me siguri absolute se për ne vdekja përbëhet nga fletë lirimi.

Në qoftë se ne ekzekutohemi, dhimbja e një ore do të ishte çelësi për lumturinë e përjetshme dhe për mëshirën. Por të ngatërroni drejtësinë për llogari të ateizmit dhe ta preokuponi qeverinë me ne pa asnjë arsye, dijeni me siguri se ju do të dënoheni me asgjësim të përjetshëm dhe me burgim të vetmuar të përhershëm dhe do të dridheni! Unë do të shoh se ju do ta paguani këtë shumë herë më tepër. Megjithatë, përsëri mua më vjen keq për ju. Po, vdekja, e cila e ka boshatisur këtë qytet njëqind herë duke e kthyer në varrezë, sigurisht ka kërkesa më të mëdhaja se jetën. Dhe çështja e shpëtimit të njerëzve prej ekzekutimit nga vdekja është kërkesa më ngulmuese dhe më e rëndësishmja me të cilën ata përballen, dhe nevoja e tyre më esenciale dhe e domosdoshme e veçantë.

Atëherë, edhe të çmendurit do ta kuptonin se në sytë e realitetit dhe të drejtësisë ata që akuzojnë për pretekste të papërfillshme studentët e Risale-i Nurit, të cilët e kanë gjetur këtë ngushëllim për vetveten, dhe Risale- Nurin i cili e jep atë të mbështetur nga mijëra prova, bëhen vetë objekt akuze.

Ndodhen tre çështje të cilat i mashtrojnë këto njerëz të padrejtë, duke i çuar ata të kenë dyshime se studentët e Risale-i Nurit janë një shoqëri politike, me të cilën ata nuk kanë asnjë lidhje:

E Para: Që prej ditëve të hershme, studentët e mi kanë qenë lidhur me mua me pasion, si vëllezër, dhe kjo u ka dhënë shkas dyshimeve për një shoqëri politike.

E Dyta: Disa nga studentët e Risale-i Nurit kanë vepruar si grupe brenda komunitetit islam, ashtu si kudo dhe siç lejohet nga ligjet e Republikës, dhe kjo është supozuar se ata janë një shoqëri; ajo ishte

thjesht një vëllazëri e pastër në shërbim të besimit dhe një solidaritet i cili shikon tek Ahireti.

E Treta: Meqenëse ata njerëz të padrejtë i njohin vetvetet se janë çudhëzuar dhe janë dashuruesit e jetës së kësaj bote, dhe meqenëse ata i gjejnë disa nga ligjet e tokës të përshtatshme për vetveten, ata thonë me vete: "Padyshim, Saidi dhe shokët e tij dalin kundra nesh dhe kundra ligjeve të qeverisë të cilat janë favorizuese për pasionet e palejueshme -të qytetërimit tonë. Atëherë, ata duhet të kenë një shoqëri politike e cila është kundërshtare për ne".

Prandaj, unë u them atyre:

O fatkëqinj! Në qoftë se dynjaja do të kishte qenë e përjetshme dhe njeriu do të mbetej në të përgjithmonë, dhe në qoftë se detyrat e njeriut do të përbëheshin vetëm nga politikat, atëherë do të kishte qenë i mundur ndonjë kuptim në këto shpifjet tuaja. Dhe në qoftë se unë do t'i kisha hyrë kësaj pune për qëllime politike, ju nuk do të kishit gjetur dhjetë fjali në njëqind trajtesa, por një mijë fjali luftarake dhe të lidhura me politikat. Dhe në qoftë se do të supozonim të pamundurën, ashtu si ju, të punomin me të gjithë fuqinë tonë për qëllimet e kësaj bote, për kënaqësitë e politikat -për të cilat edhe shejtani nuk mund të bënte ndonjë t'i besonte e pranonte- madje edhe në qoftë se do të ishte kështu, meqenëse nuk ka asgjë gjatë këtyre njëzet viteve që e sugjeron këtë, dhe qeveria shikon dorën dhe jo zemrën, dhe të gjitha qeveritë kanë kundërshtarë të rreptë; por përsëri nuk ka asgjë për të cilën ne mund të akuzohemi sipas ligjeve të drejtësisë, fjala ime e fundit është:

"Allahu është më se i mjaftueshëm për mua. Nuk ka të Adhuruar tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit madhështor"[160]

. . .

Me Emrin e Tij të Cilit i takon Lavdërimi.

[Do të përmend me saktësi një kujtesë të vjetër dhe një çështje të hollë të mbrojtjes e cila nuk u nxor në shesh në Gjykatën e Eskishehirit dhe nuk është regjistruar zyrtarisht, dhe madje as nuk qe shkruar në mbrojtjen time.]

Ata më pyetën atëherë:

Çfarë mendon ti rreth Republikës? Unë u përgjigja: "Biografia ime të cilën ju e keni shtënë në dorë, provon se unë isha një republikan

[160] Kur'an, 9 :129

fetar përpara secilit prej jush, me përjashtim ndoshta të një kryetari të gjykatës së Eskishehir, që ka qenë lindur.

Një përmbledhje e saj është kjo: Ashtu si tani, në atë kohë unë jetoja në veçim, në vetmi në një Varr të pabanuar. Dikush më sillte mua sup dhe unë u jepja thërrime buke mizave. E haja bukën me sup. Disa njerëz e dëgjuan këtë dhe më pyetën rreth kësaj, dhe unë u thashë atyre: "kombet e mizave dhe të bletëve janë republikane, unë u jap mizave thërrimet e bukës nga respekti për republikanizmin e tyre.

Atëherë ata thanë: "ti po kundërshton udhëheqësit e hershëm të islamit". Unë iu përgjigja: "kalifët e drejtë ishin edhe kalifë, edhe presidentë të republikës. Sigurisht, Ebu Bekri i Drejtë (Zoti qoftë i kënaqur me të), dhjetë të përgëzuarit me parajsë, të cilëve u është premtuar xhenneti, dhe sahabët e profetit ishin si presidentë të Republikës. Por ai nuk ishte ndonjë titull i pakuptim; ata ishin udhëheqës të një republike fetare kuptimi i së cilës ishte drejtësia e vërtetë dhe liria e Sheriatit.

I nderuar prokuror dhe të nderuar anëtarët e gjykatës! Ju po më akuzoni për pasjen e një ideje, të kundërtën e së cilës unë e kam pasë për pesëdhjetë vite. Në qoftë se ju më pyesni rreth republikës laike, ajo që unë kuptoj prej saj është sekularizëm që do të thotë të jesh i paanshëm; domethënë në përputhje me parimin e lirisë së ndërgjegjes, ajo i referohet një qeverie që nuk ndërhyn tek njerëzit me mentalitet fetar e të devotshëm, ashtu siç nuk ndërhyn në pafesi e në shthurje. Unë jam tërhequr nga jeta politike e sociale për dhjetë vite, dhe tani janë njëzet vite që i jam larguar politikës.

Unë nuk e njoh gjendjen e qeverisë së Republikës. Në qoftë se - Ruajna Zot! - ajo ka marrë një formë të frikshme me anë të të cilës, për llogari të pafesisë, ajo shpall ligje e dekrete duke dënuar ata që punojnë për besimin e tyre dhe për jetët e tyre të Ahiretit, unë ua shpall ju pa frikë dhe ju paralajmëroj: Në qoftë se unë do të kisha një mijë jetë, unë do të isha gati t'i sakrifikoja të gjitha ato për besimin dhe për Ahiretin. Bëni çfarë të doni, fjala ime e fundit është: *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".*

Përballë dënimit të padrejtë, që më jepni dënim me vdekje ose burgim të përjetshëm, unë them: Ashtu siç ka zbuluar Risale-i Nuri dhe ka provuar me siguri, unë nuk po ekzekutohem, por po lirohem nga detyrat; unë jam duke shkuar tek bota e dritës dhe tek banesa e lumturisë. Ndërsa ju, o fatkëqinj që po na persekutoni në emrin e çudhëzimit! Meqenëse unë e di se ju do të dënoheni me asgjësim të

përjetshëm dhe me burgim të vetmuar të përhershëm, unë jam i përgatitur ta dorëzoj shpirtin tim me qetësi të plotë të mendjes, duke pasë marrë plotësisht hak mbi ju.

I burgosuri Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij të Cilit i takon Lavdërimi.

O Efendilerë!

Unë jam plotësisht i bindur -si rezultat i treguesve dhe i dëshmive të shumta- se sulmet që na bëhen neve nuk kanë si motiv pretendimin e thënë: se ne shfrytëzojmë ndjenjat fetare për të prishur rendin dhe qetësinë publike".

Jo, por ai sulm -që realizohet nën atë maskë të rreme- kryhet në emrin e mohimit dhe të ateizmit dhe ka si synim besimin tonë dhe dhënien fund përpjekjeve dhe shërbimeve tona në rrugën e këtij besimi dhe për hir të vendosjes së rendit dhe qetësisë publike... Ne kemi tregues e prova të shumta për këtë.

Le të paraqesim këtu vetëm një provë të vetme për këtë.

Njëzet mijë njerëz kanë lexuar njëzet mijë kopje prej Risale-i Nurit për gjatë njëzet viteve, të cilët kanë qenë të kënaqur me to dhe i kanë pranuar. Dhe megjithatë nuk ka ndodhur asnjë ngjarje e vetme që të prishë rendin nga ana e studentëve të Risale-i Nurit. Dhe qeveria nuk ka regjistruar asnjë incident të këtij lloji, ashtu siç nuk ka mundur gjykata e mëparshme dhe as gjykata aktuale të gjejë si shembulli i këtij incidenti, duke ditur se rezultatet e kësaj propagande të tillë të fuqishme dhe të përhapur shumë sigurisht do ta shfaqnin për njëzet ditë në formën e icindetëve dhe të ndodhive; pra ajo do të bëhej e dukshme brenda njëzet ditëve. Domethënë, në kundërshtim me parimin e lirisë së ndërgjegjjes, paragrafi 163 i këtij ligji të errët, të paqartë[161], i cili i përfshin të gjithë fetarët, thirrësit dhe këshilluesit, është një mask e rreme.

Ateistët i mashtrojnë disa anëtarë të qeverisë, ngatërrojnë institucionin legal, dhe dëshirojnë të na shtypin, të na godasin e të na shkatërrojnë me çfarëdo që të ndodhë. Meqenëse realiteti i çështjes është ky, ne themi me të gjithë fuqinë tonë: O ju të mjerë që e shisnin

[161] Paragrafi 163 i kodit penal: një ligj i projektuar për të detyruar parimin e "Sekularizmit" dhe për të penguar rritjen dhe zhvillimin e ndonjë lëvizjeje fetare. Përkthyesi

fenë për dynjanë dhe keni rënë në mosbesim absolut! Bëni çfarëdo që të mundeni! Dynjaja juaj do të jetë fundi i juaj! Le të sakrifikohen edhe kokat tona gjithashtu për të vërtetën e shenjtë për të cilën qindra e miliona heronj kanë sakrifikuar kokat e tyre! Ne jemi gati për çdo lloj dënimi, madje edhe për ekzekutimin tonë! Në këtë situatë, duke qenë jashtë burgut është njëqind herë më keq se qënia jonë brenda tij. Meqenëse nuk ka aspak liri -as liri fetare, as liri të ndërgjegjjes, dhe as liri shkollore- nën despotizmin absolut që na konfronton, për ata me nder, njerëzit e fesë dhe mbështetësit e lirisë, nuk ka zgjedhje tjetër përveç vdekjes ose hyrjes në burg. Ne themi: *"Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi"* [162]

I burgosuri Said Nursi

. . .

Me Emrin e Tij, të Cilit i takon Lavdërimi.

Kryetari i gjykatës, Ali Riza Bej!

Unë kam një pyetje të rëndësishme me qëllim që të mbrojë të drejtat e mia: Unë nuk i njoh shkronjat e reja, dhe shkrimi im i dorës nuk është i mirë me shkronjat e vjetëra. Gjithashtu, ata nuk më lejojnë të takohem me ndokënd, unë po mbahem në një gjendje krejtësisht të izoluar ose mjaft thjesht në një burgim të vetmuar fillikat. Madje ata tërhoqën prej meje fletëpadinë vetëm pas pesëdhjetë minutash pasi ma kishin dhënë atë. Gjithashtu unë nuk mundem nga ana financiare të kërkoj ndihmë nëpërmjet një avokati. Unë qeshë në gjendje të siguroj vetëm një kopje nga pjesa e mbrojtjes sime të cilën ua paraqita juve me shkronjat e reja në mënyrë sekrete - fshehurazi. Gjithashtu unë pata shkruar një ose dy kopje prej trajtesës "Frutat e besimit", e cila është një lloj mbrojtjeje e Risale-i Nurit dhe një përmbledhje e metodës së tij për t'ia dhënë prokurorit të përgjithshëm dhe për t'ia dërguar departamenteve të qeverisë në Ankara.

Por ata në mënyrë të befasishme i tërhoqën ata prej meje dhe nuk m'i rikthyen më. Ndërsa autoritetet gjyqësore në Eskishehir më dërguan një makinë shkrimi në burg, dhe ne mundëm të shkruanim disa kopje nga mbrojtja ime me shkronjat e reja; edhe gjykata i shkroi ato gjithashtu. Atëherë, kërkesa ime e ngutshme është, ose na dërgoni një makineri shkrimi, ose na lejoni neve që ta sjellim atë -makinën- nga jashtë me qëllim që ne të mund të shkruajmë me shkronjat e reja

[162] Kur'an, 2 :156

dy apo tre kopje edhe prej mbrojtjeve tona, edhe prej trajtesës “Frutat e besimit”, e cila konsiderohet -ashtu siç thashë- një llojë mbrojtjeje e Risale-i Nurit. Atëherë ne do t’i dërgojmë ato edhe tek ministria e drejtësisë, edhe tek këshilli i ministrave, edhe tek asambleja kombëtare, edhe tek Këshilli i Shtetit. Sepse është pikërisht Risale-i Nuri baza e padisë, dhe akuzat kundra Risale-i Nurit dhe kundërshtimet ndaj tij nuk janë ndonjë çështje e papërfillshme dhe personale saqë të mos u jepet aspak rëndësi. Përkundrazi ajo është një çështje e përgjithshme dhe një ngjarje e madhe serioze që lidhet me këtë vend, me këtë komb dhe me këtë qeveri dhe, prandaj do të ngjallë interes të madh dhe do të tërheqë vëmendjen e të gjithë botës islame.

Po, ata të cilët në mënyrë të fshehtë e tinëzare sulmojnë Risale-i Nurin janë ata të cilët përpiqen me qëllim që të shkatërrojnë vlerësimin, dashurinë dhe vëllazërinë e botës islame ndaj këtij kombi në këtë atdhe. Kjo dashuri dhe vëllazëri e cila konsiderohet si forca më e madhe e këtij kombi, kështu me qëllim që të realizohet shkatërrimi i kësaj dashurie dhe i kësaj vëllazërie dhe ndryshimi dhe transformimi i saj në urrejtje, në ftohje e largim, ndodhen gishtërinj që përpiqen të shfrytëzojnë politikën dhe bërjen e saj mjet dhe instrument për të inkurajuar ateizmin dhe mohimin absolut; dhe prandaj ata nëpërmjet kësaj mashtrojnë qeverinë. Ata e kanë mashtruar qeverinë dhe dy herë e kanë ngatërruar drejtësinë kur i thonë: “Risale-i Nuri dhe studentët e tij e shfrytëzojnë fenë për politika dhe ka mundësi që ata të prishin rendin dhe qetësinë publike.

O Ju mjeranë!... Risale-i Nuri nuk ka lidhje me politikën, por ai copëton kufrin -mohimin absolut- në anën e poshtme të të cilit ndodhet anarkia dhe në anën e sipërme të tij ndodhet despotizmi absolut- duke e thyer e zmbrapsur atë.

Argumenti më i madh për këtë është Trajtesa “Frutat e besimit” e cila është një tregues i vetëm prej qindra treguesve dhe provave duke treguar se Risale-i Nuri përpiqet për të themeluar e vendosur rendin, qetësinë, lirinë dhe drejtësinë në këtë vend. Kjo trajtesë duhet të shqyrtohet e hetohet nga një komitet prej studiuesve dhe sociologëve të shquar; dhe në qoftë se ata nuk do të konfirmonin atë që them, unë do të pranoja çfarëdo dënimi, dhe çdo llojë ekzekutimi.

I burgosuri Said Nursi

. . .

Kryetar i Gjykatës!

Tre çështje u bënë bazat e akuzës në vendimin e gjykatës:

Çështja e Parë: është një shoqëri politike. Unë thërras si dëshmitarë të gjithë studentët e Risale-i Nurit këtu dhe ata të cilët më kanë takuar, dhe ata të cilët lexojnë apo shkruajnë Risale-i Nurin; ju mund t'i pyesni ata. Unë nuk i kam thënë askujt se ne do të themelojmë një shoqëri politike apo një tarikat Nakshibendi, por gjithmonë u thoja: "Ne po përpiqemi të shpëtojmë imanin tonë, dhe nuk është zhvilluar midis nesh ndonjë bisedë jashë përgjithësimit të njerëzve të besimit dhe jashtë komunitetit të shenjtë islam i cili ka më shumë se treqind milionë myslimanë.[163]

Nëpërmjet vëllazërisë së të gjithë besimtarëve dhe për shkak të shërbimit tonë ndaj Kur'anit ne e gjetëm vetveten në partinë e Kur'anit -Hizb el-Kur'an-, që e cila në Kur'an, quhet *Hizb Allah*. Në qoftë se kjo është ajo për të cilën aludon akuza, ne e pranojmë atë me gjithë krenari. Por në qoftë se aludon për kuptime të tjera, atëherë ne nuk dimë asgjë për to.

Çështja e Dytë: Ashtu siç është pohuar në akuzë dhe siç konfirmohet nga raporti i policisë së Kastamonus, disa libra si trajtesa rreth "Hixhabit" dhe trajtesa "Gjashtë sulmet" dhe "shtojca e saj" u gjetën brenda sunduqeve të mbyllura dhe të gozhduara dhe poshtë stivës së druve dhe qymyrit. Domethënë ato nuk qenë përgatitur për t'u botuar asnjëherë.

Ato qenë hetuar e kritikuar nga Gjykata e Eskishehir, dhe një dënim i lehtë u lëshua për to; dhe sigurisht ato janë trajtuar si private. Tani, duke lexuar kuptime të gabuara në disa prej fjalive të tyre, ajo akuzë do të na kthejë prapa nëntë vitesh dhe të na ngarkojë ne një përgjegjësi të re rreth një padie të mëparshme dhe të na dënojë për të me një dënim të cilin ne tashmë e kemi vuajtur.

Çështja e Tretë: në akuzë dhe në shumë vende ndodhen shprehje të tilla, si: Mund të prishin rendin dhe sigurinë e shtetit.

Domethënë, me ato fraza është vendosur ajo që është e mundshme në vend të ndodhive aktuale -reale.

Dhe unë them: Është e mundur dhe ka të ngjarë që çdo person të kryejë krimin e vrasjes; a është e mundur të dënohet çdo person dhe të akuzohet për krim për shkak të mundësisë?

I burgosuri Said Nursi

. . .

[163] Ky numër i myslimanëve në botë ishte në atë kohë, Përkthyesi

Me Emrin e Tij, të Cilit i takon Lavdërimi!

Kryetari i Gjykatës!

Unë ju paraqes mbrojtjen time, e cila është në formën e një peticioni që e dërgova tek departamentet e qeverisë në Ankara dhe tek presidenti i Republikës, dhe përgjigjen me letër nga zyra e kryeministrisë, e cila tregon se ata e njohën dhe e pranuan rëndësinë dhe peticionin tim.

Të përfshira në këtë mbrojtje janë përgjigjjet vendimtare ndaj dyshimeve të pabaza dhe fyese që prokuroria ka deklaruar kundra nesh. Ndodhen gjëra të shumta të pavërteta e të palogjikshme në raportin e komitetit të ekspertëve prej këtu, i cili u mbështet mbi raportet sipërfaqësore dhe dashakeqe të vendeve të tjera; kundërshtimet e mia për këto janë paraqitur gjithashtu.

Shkurtazi: Ashtu siç deklarova më parë, unë i thashë Gjykatës së Eskishehir kur ajo deshi të më fajësonte e dënonte në bazë të nenit 163: prej dyqind deputetëve të qeverisë republikane, i njëjti numër, 163, ra dakord të posaçërojnë, të japin njëqind e pesëdhjetë mijë lira për të ndërtuar medresenë time -*Dar'el-funu-El-Xhamia*- në qytetin e Vanit. Rënia e tyre dakord për këtë dhe interesi që shfaqi qeveria e Republikës ndaj meje do të thotë shfuqizim i akuzës së drejtuar ndaj meje sipas nenit 163. Megjithëse unë ia thashë këtë Gjykatës, komiteti i ekspertëve e ndryshoi atë që unë thashë dhe shkroi: "163 deputetë hapën procese gjyqësore kundra Saidit". Për shkak të kësaj akuze krejtësisht të pabazë të atij komiteti të parë të ekspertëve, prokuroria po bën akuza kundra nesh. Kjo pavarësisht faktit se Risale-i Nuri ishte çuar, me vendimin tuaj, tek komiteti më i lartë i ekspertëve dhe i dijetarëve dhe, pasi i kishin studiuar, hetuar e shqyrtuar me imtësi të gjitha pjesët e tij, komiteti i ekspertëve unanimisht bëri këtë pohim rreth nesh:

"Nuk ka asnjë shenjë dhe asgjë të qartë apo të nënkuptuar në shkrimet e Said Nursit apo tek studentët e Risale-i Nurit që sugjeron se ata kanë ndonjë synim për të shfrytëzuar fenë ose çështjet e shenjta, që të nxisin shkeljen dhe dhunimin e sigurisë së shtetit, apo që gjenden në një shoqëri politike, apo që komplotojnë në ndonjë mënyrë kundra qeverisë. Kuptohet se në letërkëmbimet e tyre, studentët e Said Nursit nuk ushqyen asnjë qëllim të keq kundra qeverisë, as nuk kanë pasur idenë për të themeluar ndonjë shoqëri politike, ose për të ngritur një tarikat Sufi". Komiteti i dytë i ekspertëve gjithashtu deklaroi në mënyrë unanime se "nëntëdhjetë e nëntë përqind e trajtesave të Risale-

i Nurit nuk janë larguar as sa një gisht prej themeleve dhe parimeve të fesë, dhe as nga principet e dijes dhe të Hakikatit -Realitetit- dhe ato trajtesa janë edhe të sinqerta dhe të ç'interesuara -në mënyrë të paanshme.

Është krejtësisht e qartë se këto trajtesa nuk synojnë të shfrytëzojnë fenë, as të formojnë një shoqëri politike dhe as të shkelin rendin dhe sigurinë e shtetit. Gjithashtu, letrat dhe korrespondenca ndërmjet studentëve të Risale-i Nurit ose ndërmjet studentëve dhe Said Nursit janë të këtij lloji.

Me përjashtim të disa letrave private të fshehta -numri i të cilave nuk i kalon dhjetë- të cilat nuk kanë prekur çështje shkencore; madje ato mbajnë shenjën e ankimit e të dhimbjes, të gjitha trajtesat shpjegojnë vërsetet e Kur'anit ose kuptimet e vërteta të Haditheve. Pjesa më e madhe e Trajtesave të Risale-i Nurit janë shkruar për të shpjeguar të vërtetat e fesë dhe të besimit, rreth parimeve të besimit në Allahun, në të dërguarin e Tij dhe në botën tjetër.

Me qëllim që këto të vërteta të shpjegohen në mënyrën më të mirë, Trajtesat e Risale-i Nurit përmbajnë krahasime dhe shembuj ilustrues e tregime. Ato trajtesa paraqesin pikëpamjen e tyre shkencore, udhëzimin e tyre dhe këshillat morale brenda aspekteve të lavdëruara dhe ngjarjeve instruktive të zgjedhura prej eksperiencave të tij në jetë. Këto trajtesa nuk përmbajnë asgjë që do të dëmtonte qeverinë, administratën apo rendin publik.

Kështu, prokuroria e injoroi raportin e këtij komiteti të shquar ekspertësh e specialistësh dhe që bëri akuza të jashtëzakonshme kundra nesh duke u bazuar mbi raportin e parë të ngatërruar e të mangët; prandaj ne jemi vërtet shumë të mërzitur. Ne kurrësesi nuk mund ta vlerësojmë të përshtatshëm me drejtësinë e kësaj gjykate e cila ka provuar paanshmërinë dhe drejtësinë e saj. Në qoftë se nuk do të kishte gabim në krahasim, kjo i ngjason kësaj ngjarje: E pyetën një Bektashi, përse nuk falesh -përse nuk kryen namazet e detyruara? Ai u tha në përgjigje: sepse në Kur'an thuhet: *"Mos u afroni në namaz - falje..."*[164]

Dhe kur i thanë: Përse nuk e plotëson leximin e vërsetit i cili vazhdon duke thënë *"... Kur jeni të pirë",*

ai u përgjigj: "Unë nuk jam hafiz Kur'ani".

---

[164] Kuran, 4:43

E ngjashme me këtë ata morën një fjali të vetme prej Risale-i Nurit, dhe duke shpërfillur atë që vijon, e cila e vendos atë brenda kontekstit dhe që e shpjegon, e përdorin kundra nesh. Ju do të shikoni shembuj të shumtë -rreth tridhjetë-dyzet të tillë- në mbrojtjen që do ta paraqes, duke i krahasuar me akuzën.

Unë do të tregoj një ngjarje të hollë e cila është njëri prej atyre shembujve.

Prokuroria në Gjykatën e Eskishehir përdori, si rezultat i një gabimi, një frazë kur shpjegonte ndikimin e mësimeve të Risale-i Nurit lidhur me besimin, "Risale-i Nuri prish popullin". Megjithëse më vonë ajo nuk e përdori më, njëri nga studentët e Risale-i Nurit i quajtur Abdu Rrezzak, tha pasi kishte kaluar një vit tek ajo gjykatë:

O Fatkeq! Si mundet dikush t'i thotë 'prishje' 'udhëzimit' të Risale-i Nurit?

A mund të thuhet për Risale-i Nurin, vlera fetare e të cilit është shfaqur dhe është konfirmuar, dhe që nuk i ka shkaktuar asnjë dëm apo të keqe administratës së qeverisë gjatë njëzet viteve, dhe që nuk ka dëmtuar askënd; por përkundrazi ka udhëzuar me mijëra të rinj, ka forcuar besimin e tyre dhe ka drejtuar sjelljet e tyre? Atëherë, si mund ta përshkruash ti 'udhëzimin' e Risale-i Nurit se qenka 'prishje'?

O Fatkeq! Risale-i Nuri ka marrë lavdërimin indirektë të tridhjetë e tre vërseteve të Kur'anit, vlera e tij për fenë është vërtetuar nga tre parashikime të mrekullueshme të Imam Aliut -Zoti qoftë i kënaqur me të- dhe nga aluzionet e fuqishme të Gauth al-Aëdham -iu shenjtëroftë sekreti-; A nuk e ke frikë Zotin?

Zoti ta këputtë gjuhën tënde!

Tani, prokuroria i ka parë këto fjalë të atij studenti, kështu unë ia referoj ndërgjegjjeve tuaja dhe paanshmërisë e drejtësisë tuaj shprehjen: "Saidi ka përhapur korrupsion".

Me idenë e ndërhyrjes në mësimet shoqërore të Risale-i Nurit, prokuroria tha: vendi i fesë është ndërgjegjja; feja nuk mund të lidhet me ligjet e me rregullat; sepse kur ajo ishte e lidhur me ato të dyja në të shkuarën, u shfaqën anarki e trazira shoqërore". Kështu unë them: Feja nuk përbëhet thjesht nga imani; pjesa e dytë e fesë është puna e drejtë - e ndershme.

A do të mjaftonte frika prej burgut apo frika se mos shihet nga ndonjë agjent i fshehtë i policisë së shtetit për t'i larguar e shmangur ata që bëjnë krime të rënda të cilat helmojnë shoqërinë, të tilla si:

vrasja, shkelja e kurorës, vjedhja, bixhozi dhe alkoli? Nëse do të ishte kështu, do të duhej që të ishte një polic ose një detektiv i caktuar përherë, në mënyrë të palëvizshme, në çdo shtëpi ose në anën e gjithësecilit, me qëllim që zemërgurët dhe shpirtërat e pandreqshëm të shmangen prej atyre akteve të ndyra.

Ndërsa, lidhur me veprat e mira dhe besimin, Risale-i Nuri vendos një ndalues të përhershëm jolëndor në anën e gjithkujt. Risale-i Nuri me lehtësi i shpëton ata prej veprave të liga duke u kujtuar atyre Burgun e Xhehennemit dhe zemërimin Hyjnor.

Gjithashtu, për shkak të nënshkrimit -firmës- në një trajtesë të një koinçidence të çuditshme e të jashtëzakonshme, prokuroria bëri një deduktim të pakumptimtë, duke thënë: ata janë "anëtarët e një shoqërie politike". Sa çudi, a mund t'u jepet emri i një shoqërie autorëve të nënshkrimeve që gjenden në regjistrat e pronarëve të dyqanëve dhe të tregtarëve? Ndodhet një akuzë e pabazë e ngjashme me këtë në Gjykatën e Eskishehir. Kur unë u përgjigja dhe u tregova trajtesën e titulluar "Mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m.", ata u çuditën. Në qoftë se ne do të kishim formuar një shoqëri dynjaje, ata të cilët kanë pësuar shumë dëm për llogarinë time, sigurisht do të kishin ikur prej meje me urrejtje të plotë. Kjo do të thotë se ashtu si unë dhe si ne që kemi lidhje që nuk këputet me Imam Gazalin, meqë ajo është një lidhje Ahireti dhe jo dynjaje, po ashtu këta fetarë të pafajshëm, të sinqertë e të pastër kanë shfaqur një lidhje të fuqishme me këtë të dobët -me mua- për hir të mësimeve të tij rreth imanit -besimit. Kjo u ka dhënë shkas hamendjeve të kota të një shoqërie imagjinare politike".

Fjala ime e fundit është:

Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne ai është Rregulluesi më i mirë i punëve.

I burgosuri në një burg të vetmuar

Said Nursi

. . .

[Kjo pjesë është shumë e rëndësishme]

Me Emrin e Tij të Cilit i takon lavdërimi!

Një Pjesë e Rëndësishme e Fjalës sime të fundit

O Ju efendilerë!...

I nderuar kryetar i Gjykatës! Dëshiroj që të jeni të vëmendshëm dhe ta kuptoni mirë se çfarëdo vendimi të lëshoni për të dënuar studentët e Risale-i Nurit, nuk është tjetër veçse shërbim i drejtpërdrejt për mohimin dhe për ateizmin, dhe nuk është gjë tjetër veçse akuzë ndaj të vërtetave të Kur'anit dhe të besimit që në rrugën e udhëzimit të tyre ecin në çdo vit treqind milion myslimanë qysh prej një mijë e treqind vitesh; domethënë kjo është një përpjekje për të bllokuar rrugën më të madhe dhe për të mbyllur rrugën e drejtë e cila të çon tek Realiteti dhe tek lumturia e dy botëve; kjo do të të tërhiqte drejt jush urrejtjet dhe kundërshtimet e tyre. Sepse ndjekësit e kësaj rruge i ndihmojnë me lutjet e tyre dhe me veprat e mira ata të cilët tashmë e përshkuan atë -domethënë në atë rrugë bëjnë lutje *Halefët* për *selefët.*[165]

Pastaj këta -të cilët mbajnë qëndrim armiqësor ndaj imanit- do të jenë shkak për të prodhuar një problem shumë të madh në këtë atdhe; atëherë çfarë përgjigjje do të jepnit në Ditën e kijametit dhe në Gjyqin e Fundit kur përballë jush do të qëndrojnë ata treqind milionë myslimanë ankues dhe t'ju pyesin: përse i lejuat librat ateistë dhe ato libra të cilët nga fillimi gjer në fund sulmojnë islamin në mënyrë të qartë si shembulli i librit "Tarihul-Islam" i Doktor Dozit, dhe me to keni mbushur bibliotekat tuaja, dhe lejuat që ato të lexohen me të gjithë lirinë dhe lejuat që studentët e tyre të formojnë shoqëri në përputhje me ligjet tuaja? Dhe përse nuk e kundërshtoni aspak ateizmin, as komunistët, as anarkistët, as shoqëritë ilegale, as shoqëritë e vjetra revolucionare korruptuese dhe as turqizmin negativ megjithëse ato janë në kundërshtim me politikën tuaj? Ndërkohë që ju kundërshtoni persona të cilët nuk kanë aspak lidhje me politikën madje ata persona janë lexuesit e një vepre të së vërtetës dhe të Realitetit si Risale-i Nuri, i cili është një komentim i vërtetë i Kur'anit; ju kundërshtoni studentët e Risale-i Nurit të cilët nuk kanë lidhje me politikat dhe e kanë marrë rrugën e Kur'anit dhe të imanit vetëm për të shpëtuar vetveten dhe bashkëqytetarët e tyre prej asgjësimit të përjetshëm dhe prej burgut të vetmuar. Kjo ndodh në një kohë që ata nuk kanë asnjë lidhje me asnjë grupim politik, por ju i kundërshtoni ata sepse ju supozoni se shoqëria dhe vëllazëria për hir të Zotit e cila bashkon zemrat e tyre -supozoni- se ajo vjen si rezultat i lidhjes së tyre me ndonjë shoqatë të caktuar; prandaj ju i akuzuat dhe vazhdoni t'i akuzoni dhe t'i dënoni me një ligj të çuditshëm... përse?

---

[165] Sepse Halefët arritën tek mirësia e imanit nëpërmjet selefëve -në sajë të mirësisë së Zotit-; prandaj çdo veprim të mirë që kryejnë halefët do të regjistrohet si një vepër e mirë për selefët -Përkthyesi

Në qoftë se ata do ta thonin këtë, si do të përgjigjeshit ju? Edhe ne ju bëjmë të njëjtën pyetje.

Armiqtë tanë, ateistët dhe hipokritët -shtiracakët- ju mashtrojnë juve, ngatërrojnë sistemin e drejtësisë dhe e bëjnë qeverinë të merret me ne -në një mënyrë të dëmshme për vendin dhe për popullin; duke e quajtur despotizmin absolut "Republik", dhe duke e bërë apostazinë absolute -felëshimin- pjesë të regjimit, dhe duke e quajtur ligësinë absolute "civilizim", dhe duke i bashkangjitur emrin e ligjit, forcës arbitrare dhe detyrimit për llogari të mosbesimit, ata edhe e preokupojnë qeverinë, edhe na kanë shpërndarë e shqetësuar, duke dhënë kështu goditjet e tyre ndaj ligjit islam dhe ndaj ligjit të vendit e të popullit, duke u shërbyer të huajve.

O Ju Efendilerë! Ashtu siç është treguar nga katër tërmete të fortë në katër vite duke koinçiduar ekzaktësisht me agresionin e ashpër kundra studentëve të Risale-i Nurit dhe qënien e tyre të persekutuar, dhe në çdo rast ndodhja e tyre ekzaktësisht në kohën kur studentët sulmoheshin, dhe ndalimi i atyre -tërmeteve- kur sulmet kundra tyre ndalonin, -këto tregojnë- se ju jeni përgjegjës për katastrofat dhe fatkeqësitë qiellore e tokësore që kanë ndodhur për qënien tonë duke u dënuar aktualisht...![166]

Said Nursi
që po mbahet në një izolim të plotë
dhe në burgim të vetmuar fillikat në Burgun e Denizlit.

. . .

Me Emrin e Tij të Cilit i takon lavdërimi.

Një pjesë tjetër e Fjalës sime të Fundit

Meqenëse unë nuk mund të di gjë rreth jetës shoqërore aktuale, dhe duke parë drejtimin dhe -orientimin- drejt të cilit ecën prokuroria e përgjithshme; dhe insistimi juaj për të nxjerrë vendimin për të më dënuar me pretekstin e akuzës ndaj meje për formimin e një shoqërie

[166] Ustadh Said Nursi e justifikon dhe e analizon këtë se Risale-i Nuri përbëhet nga fjalë të mira prej llojit të sadekasë së pranuar të cilat janë një mjet për të larguar fatkeqësinë, prandaj pengimi për t'i përhapur dhe për t'i mbajtur të fshehta prej njerëzve, hap rrugën për rënien e fatkeqësive. Përkthyesi.

politike, ndonëse unë i qeshë përgjigjur kësaj akuze dhe e pata përgënjeshtruar me përgjigje vendimtare dhe me argumente të prera; gjithashtu komiteti i ekspertëve në Ankara e hodhi poshtë atë akuzë unanimisht; dhe unë ndërsa duke qenë i çuditur për insistimin tuaj deri në këtë shkallë mbi këtë çështje, m'u shfaq në zemrën time ky kuptim:

Meqenëse shoqëria dhe prirja drejt komuniteteve vëllazërore, dhe drejt grupimeve dhe shoqërive të sinqerta që i përkasin Ahiretit dhe vëllazërisë janë secila prej themeleve të jetës shoqërore dhe një domosdoshmëri prej nevojave esenciale të natyrës njerëzore, dhe më e rëndësishmja, më e madhja dhe më e domosdoshmja e lidhjeve duke filluar nga jeta e familjes dhe e fisit dhe duke arritur tek jeta e kombit dhe tek jeta islame humane, dhe është një pikë mbështetjeje dhe mjet ngushëllimi për çdo njeri përballë sulmeve të gjërave materiale dhe jomateriale të cilat shkaktojnë dëm e trazira dhe të cilat i ndesh çdo njeri në univers dhe nuk mund t'i luftojë vetëm, dhe për t'i mposhtur e kapërcyer të gjitha ato pengesa e barriera lëndore e jolëndore që orvaten ta pengojnë njeriun nga përmbushja e detyrave të tij islame e humane, dhe ndonëse shoqëria dhe vëllazëria mbi të cilat bashkohen studentët e Risale-i Nurit janë të zhveshura prej çdo aspekti politik, madje ajo është një vëllazëri e pastër dhe e sinqertë dhe një mjet për të arritur mirësinë në dynja dhe lumturinë -në Ahiret; sepse ata bashkohen në mësimet e Kur'anit dhe të imanit në hijen e një shoqërie të pastër e të sinqertë në rrugën e së vërtetës, dhe të cilët janë të bashkuar kundra çdo gjëje që dëmton kombin dhe atdheun. Kështu do të ishte detyrë që ata të vlerësoheshin e administroheshin meqë ata mblidhen në këto takime lidhur me besimin.

Ndërsa ata që u japin përshtypjen dhe kuptimin e një shoqërie politike këtyre takimeve, ata ose janë krejtësisht të mashtruar, ose janë anarkistë e tradhtarë që luftojnë barbarisht humanizmin dhe tiranikisht janë armiqësorë kundra islamit, kundra kombit, kundra sovranitetit islam, dhe kundra gjërave të shenjta të fesë, dhe ushqejnë armiqësi ndaj jetës shoqërore në një mënyrë krejtësisht të korruptuar e të shthurur, ose ata janë ateistë djallëzorë që punojnë për llogari të të huajve që t'i presin e shkatërrojnë arteriet e jetës së këtij kombi ose ta prishin atë duke mashtruar qeverinë dhe duke çudhëzuar e shtrembëruar bazat e drejtësisë me qëllim që të kenë sukses për të na bërë që t'i kthejmë armët tona jo materiale- të cilat deri tani i kemi përdorur kundra tiranëve, faraonëve dhe anarkistëve, që t'i kthejmë- kundra vëllezërve dhe vendit tonë, ose ata përpiqen që t'i thyejnë e t'i copëtojnë këto armë.

. . .

O Ju efendilerë!

Ndodhet një orgazatë e fshehtë e cila vepron qysh prej dyzet vjetësh për llogari të të huajve me qëllim që ta shthurnin këtë komb në emrin e mohimit dhe të ateizmit; dhe përpiqet që ta copëtojë këtë vend, duke përdorur të gjitha mjetet e mënyrat për të sulmuar të vërtetat e Kur'anit dhe të imanit. Në fakt ky grupim i fshehtë revolucionar i korruptuar përbëhet nga forma të ndryshme.

Unë do të dëshiroja nëse do të më lejonit t'u adresohem në prezencën tuaj dhe para jush disa zyrtarëve e nëpunësve të pavëmendshëm dhe të larguar nga drejtësia të cilët ky grupim i ka bërë si një perde -maskë- duke u mbrojtur pas tyre dhe nëpërmjet tyre duke çudhëzuar e shtrembëruar gjykatën. (mirëpo shpallja e vendimit për dhënien e pajfajsisë sonë në ditën vijuese e shtyu për më vonë atë fjalim të ashpër.)

Said Nursi

Në izolim të plotë e në burgim të vetmuar.

Një përgjigje e vërtetë për një pyetje të Rëndësishme

Disa zyrtarë me rangje të larta më pyetën:

Përse nuk e pranove ofertën e Mustafa Qemalit prej një rroge treqind lirash[167] dhe postin e *Vaizit A'mm* -predikuesit të përgjithshëm- në Kurdistan dhe në provincat Lindore në vend të Shejh Sanusit.[168] Sepse ti në qoftë se do ta kishe pranuar atë rrogë do të kishe qenë shkak për t'i shpëtuar me qindra e mijëra burra të cilët u therrën për shkak të Revolucionit.[169]

---

[167] Kjo ishte një rrogë shumë e madhe në atë kohë; atë e merrnin vetëm ministrat

[168] Shejh Sanusi punoi si predikues -vaiz- fetar në provincat lindore dhe pati një rol të shquar në shpalljen e Fetvasë-vendimit- të xhihadit kundra Anglezëve gjatë pushtimit. Përkthyesi.

[169] Në provincat lindore të Kurdistanit ndodhën shumë revolucione. Më i rëndësishmi i tyre ishte revolucioni të cilin e udhëhoqi njëri nga kryetarët e fiseve kurde "Shejh Sejd Bejrani" kundra politikës së Mustafa Qemalit e cila ishte kundra Islamit. Mustafa Qemali pati mundësi ta shpartallonte atë dhe

Unë u thashë në përgjigje:

Në vend të marrjes sime përsipër për të shpëtuar njëzet ose tridhjetë vite prej jetës së dynjasë për këta njerëz, Risale-i Nuri ka qenë mjet dhe shkak për të shpëtuar miliona vite prej jetës së Ahiretit për qindra e mijëra bashkëqytetarë, domethënë Risale-i Nuri ka kryer një punë që i shpërblen dhe ua kompenson atë humbje me mijëra herë më shumë.

Në qoftë se do ta kisha pranuar atë ofertë, nuk do të shfaqej Risale-i Nuri i cili mban misterin e sinqeritetit, që nuk mund të ndjekë askënd dhe që nuk mund të jetë mjet shfrytëzimi për asgjë, çfarëdo që të jetë. Unë madje u thashë vëllezërve të mi të respektuar në burg: Në qoftë se gjyqtarët që janë në Ankara të cilëve u shkaktuan dhimbje goditjet e forta të Risale-i Nurit dhe më dënuan mua me ekzekutim me varje, dhe pastaj Risale-i Nuri mundi të shpëtonte besimin e tyre dhe t'i shpëtonte ata prej asgjësimit të përhershëm, atëherë dëshmoni se unë i fal ata me gjithë zemër!

Unë i thashë drejtorit të policisë dhe inspektorëve të cilët më shqetësuan tepër me përgjimet dhe me kontrollet e tyre, pasi u shpall vendimi i pafajësisë sonë prej gjykatës së Denizlit: "nuk ka dyshim se është një keramet i pamohueshëm i Risale-i Nurit se pas një hetimi e gjurmimi që zgjati për nëntë muaj, askush nuk mundi të gjejë asnjë dokument apo ndonjë lidhje me ndonjë lëvizje, apo me ndonjë shoqëri apo me ndonjë xhemat brenda apo jashtë as në qindra trajtesat dhe letrat të cilat i shkrova gjatë njëzet viteve të jetës sime të mbushur me dhimbje dhe me lloje të padrejtësive dhe as tek studentët e Risale-i Nurit të cilët numërohen me mijëra. A do të kishte qenë e mundur që kjo situatë e jashtëzakonshme të ishte arritur nëpërmjet fuqisë së mendimit apo nëpërmjet ndonjë planifikimi? Sepse nëse do zbuloheshin sekretet e një personi të vetëm për disa vite të jetës së tij, sigurisht do të shfaqeshin njëzet çështje që do ta ngatërronin ose do ta dënonin. Atëherë, kjo është realiteti.

Por në qoftë se ju do të thonit: Ndodhet një zgjuarsi dhe një gjenialitet i pathyeshëm e i pamposhtur që e organizon këtë çështje dhe e vë në lëvizje."

Ose në qoftë se do të thonit: se kjo është një përkujdesje e jashtëzakonshme Hyjnore dhe një Ruajtje Hyjnore, unë do t'ju thoja:

---

ekzekutoi komandantin e Revolucionit dhe 47 prej përkrahësve të atij komandanti me 15/4/1925. Përkthyesi.

“Atëherë do të ishte gabim të luftosh këtë gjenialitet; kjo do të shkaktonte një dëm të madh për kombin dhe Atdheun; Dhe të konfrontosh e të kundërshtosh një përkujdesje të tillë Hyjnore dhe një Ruajtje të tillë Hyjnore do të ishte një kryeneçësi e rebelim si e faraonit.

Dhe në qoftë se do të thonit: “Në qoftë se ne të lirojmë dhe nuk të mbajmë nën mbikëqyrje e nën kontroll, ti mund të ndotesh e turbullosh jetën tonë shoqërore me mësimet e tua dhe me misteret e tua të fshehura.”

Unë do t’ju thoja:

Të gjitha mësimet e mia pa përjashtim kanë rënë në dorë të qeverisë dhe të autoriteteve ligjore dhe janë parë prej tyre; në to nuk është gjetur asgjë që bën të domosdoshëm dënimin, madje as edhe dënimin për një ditë të vetme.

Dyzet deri në pesëdhjetë mijë kopje të atyre mësimeve kanë kaluar nga dora në dorë midis individëve të kombit duke u studiuar me shumë vëmendje dhe me kureshtje, por lexuesit e atyre trajtesave vetëm kanë përfituar, dhe asnjë prej tyre nuk ka pësuar ndonjë dëm.

Gjithashtu, meqenëse edhe gjykata e mëparshme dhe gjykata e tanishme nuk mundën të gjenin asnjë shkelje që e zë ligji, atëherë do të ishte një padrejtësi e shëmtuar dhe e pakuptim për ju të ndërhyni në pafajësinë tonë që na u dha unanimisht nga gjykata e re dhe të ndërhyni tek unë dhe tek Risale-i Nuri, ashtu siç është provuar në mënyrë vendimtare nga gjykata e mëparshme që ishte në gjendje të japë dënim me gjashtë muaj burg vetëm për pesëmbëdhjetë prej njëqind e njëzet vëllezërve të mi të cilët mbaheshin në burg, krejtësisht në mënyrë arbitrare dhe me pretekstin e pesë apo dhjetë fjalëve prej njëqind e tridhjetë trajtesave për hir të një personaliteti të shquar në shikimin e botës.[170]

Për më tepër, unë nuk kam mësime të reja, dhe asnjë prej sekreteve të mia nuk ka mbetur i fshehur saqë ju po përpiqeni t’i modifikoni ato nëpërmjet mbikëqyrjes dhe përgjimeve.

Unë tani jam shumë i nevojshëm për lirinë time.

Mjaft më tani me këto mbikëqyrje të panevojshme, të padrejta dhe të pakuptimta para të cilave kam qenë zbuluar gjatë këtyre njëzet viteve. Durimi im ka mbaruar. Ka mundësi se për shkak të pleqërisë

[170] Synon Mustafa Qemalin.

dhe të dobësisë sime të bëj një dua të cilën s'e kam bërë më parë, sepse "Duaja e të shtypurit -e atij që i është bërë padrejtësi[171] , është një e vërtetë e fuqishme.

Pastaj ai despot dhe këta mjeranë tiranë të cilët kanë zënë vende të larta në sytë e botës, na thanë:

"Ti qysh prej njëzet vitesh nuk e ke vënë kapelen tonë strehëgjërë mbi kokën tënde as edhe një herë; ti nuk e ke zbuluar kokën tënde në praninë as të gjykatës së mëparshme dhe as përpara gjykatave të tanishme; ti e ke paraqitur veten tënde me veshjen e mëprashme. Ndërsa shtatëmbëdhjetë milionë kanë marrë veshjen moderne."

Unë thashë:

"Nuk janë shtatëmbëdhjetë milion, as shtatë milion, madje nuk gjenden prej atyre që e veshin atë veshje të re me zgjedhjen -vullnetin- e tyre me përjashtim të shtatëmijë të dehurve, adhuruesve të perëndimit dhe të imituesve të tij. Prandaj, në vend që të vesh kijafetin e ri -veshjen e re- për të cilën më detyron forca e ligjit dhe për të cilën më lejon *Ruhsati* i Sheriatit.[172]

Unë preferoj të vesh kijafetin e shtatë miliard prej personave të respektuar dhe të etikës së rrugës së sheriatit dhe të *Azimetit* -të devocionit dhe frikës ndaj Zotit. Nuk mund të thuhet për dikë si unë që për njëzet e pesë vite është tërhequr nga jeta sociale se ai "me kokëfortësi na kundërshton.

Le të supozojmë se ajo është një kokëfortësi; meqenëse vetë Mustafa Qemali nuk mundi ta thyente këtë kokëfortësi, dhe meqenëse dy gjykata dhe autoritetet e tre provincave nuk mundën ta copëtojnë atë, atëherë kush jeni ju që përpiqeni më kot për ta thyer atë kokëfortësi edhe për dëmin e kombit edhe të qeverisë! Edhe po ta supozonim se unë jam një oponent politik, meqenëse ju e pranoni dhe e njihni që unë jam një person që i ka këputur lidhjet e tij me dynjanë që prej njëzet vitesh dhe me këtë unë konsiderohem një person i vdekur -nga aspekti shpirtëror- që prej njëzet vitesh, atëherë nuk do të kishte asnjë dobi që ky person të vinte përsëri në jetë dhe në mënyrë të pakuptimtë të përfshihej në jetën politike duke i shkaktuar vetvetes një dëm të konsiderueshëm, dhe të luftonte kundra jush; do të ishte çmenduri të kesh dyshime të pabaza për kundërshtimin e tij ndaj jush.

---

[171] "Kije frikë lutjen e të shtypurit sepse nuk ka perde midis saj dhe Allahut". Transmetoi Muslimi.

[172] Meqenëse kjo është detyrim. Përkthyesi

Meqenëse do të ishte çmenduri madje të flasësh seriozisht me të çmendurit, unë do ta braktis të folurën me ju. Unë u thashë:

"Bëni çfarë të doni!" unë nuk do të ndjehem i obliguar ndaj jush!", gjë e cila edhe i zemëroi, edhe i heshti. Fjala ime e fundit është:

Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve.. Allahu është mëse i mjaftueshëm për mua. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht. Dhe Ai është Zoti i Arshit madhështor.[173]

. . .

Ajo që thashë këtë herë në mbrojtjen time të shkurtër.

Mëshira, realiteti dhe e vërteta e Risale-i Nurit na ndalon neve nga përfshirja në politika. Sepse përfshirja në to do t'i bënte të pafajshmit të goditen me fatkeqësi dhe ne do të kishim qenë të padrejtë ndaj tyre. Disa njerëz pyetën për këtë çështje, dhe unë u thashë:

Në shekullin e stuhishëm aktual, egoizmi dhe racializmi që burojnë prej civilizimit mizor, dhe diktatura ushtarake që rezultoi nga lufta botërore, dhe pamëshirshmëria që buroi nga çudhëzimi kanë çuar në një tirani të tillë ekstreme në një despotizëm të skajshëm saqë në qoftë se njerëzit e së vërtetës do t'i mbronin të drejtat e tyre nëpërmjet forcës fizike, ose nëpërmjet tiranisë së egër, shumë mjeranë do të digjeshin me pretekstin e partishmërisë dhe në atë situatë ata gjithashtu do të ishin jashtë mase tiranë dhe do të shpartalloheshin. Sepse ata që veprojnë e sulmojnë të shtyrë nga emocionet e lartëpërmendura për disa pretekste të papërfillshme, godasin njëzet deri në tridhjetë njerëz për shkak të gabimeve të një njeriu apo të dy njerëzve prej tyre, dhe i shkatërrojnë. Saqë, në qoftë se në rrugën e së drejtës dhe të vërtetësisë, njerëzit e së vërtetës do të godisnin vetëm atë që goditi, ata do të fitonin vetëm kundrejt tridhjetë humbjeve, dhe atëherë janë në pozitën e shpartallimit.

Në qoftë se, në përputhje me rregullin e padrejtë despot të përgjigjjes me të njëjtin lloj, njerëzit e së vërtetës gjithashtu do të shtypnin njëzet deri në tridhjetë njerëz për shkak të gabimeve të njërit ose të dy vetave prej tyre, atëherë do të kryenin një padrejtësi të tmerrshme në emrin e të drejtës.

Kështu, kjo është arsyeja e vërtetë dhe urtësia që ne i shmangemi me të fortë dhe ikim prej politikave dhe nuk ndërhyjmë në qeveri dhe

[173] Kuran 9:129

ikim para zbulimit ndaj politikës dhe qeverisë sipas urdhërit të Kuranit. Sepse fuqia e së vërtetës që ne e kemi në dispozicion është e tillë saqë ne mund t'i mbrojmë të drejtat tona plotësisht.

Por meqenëse çdo gjë është kalimtare dhe e përkohshme, dhe meqenëse vdekja nuk vdes, dhe dera e varrit nuk mbyllet, dhe në qoftë se njëri vuan mundime, këto i transformohen në mëshirë, atëherë ne sigurisht do ta vendosim besimin tonë tek Allahu me durim e mirënjohje, dhe do të rrimë të heshtur. Ndërsa përpjekja me forcë e në mënyrë të dëmshme për të thyer qetësinë tonë është krejtësisht në kundërshtim me konceptet e drejtësisë, të ndershmërisë, të zellit patriotik dhe të atdhedashurisë.

Për të përfunduar:

Anëtarët e qeverisë, politikanët, administratorët, policia dhe sistemi i drejtësisë nuk kanë absolutisht asgjë për të luftuar kundra nesh. Por nëpërmjet fanatizmit të mosbesimit absolut, të cilin asnjë qeveri në botë nuk mund ta mbrojë dhe nuk gjendet asnjë person që të familjarizohet me të, dhe nëpërmjet fanatizmit të ateizmit, i cili buron nga materializmi dhe është një murtajë e tmerrshme që godet humanizmin, dhe nëpërmjet të keqes së tyre, disa ateistë tinëzarë mashtrojnë një numër prej nëpunësve të qeverisë, ngjallin dyshimet e tyre, dhe i nxisin ata kundra nesh. Dhe ne themi: "Në qoftë se ata do të nxisnin jo një numër të tillë të pakët prej njërëzve të dyshuar por sikur të nxisnin të gjithë botën kundra nesh, nëpërmjet fuqisë së Kuranit dhe të përkujdesjes Hyjnore, ne nuk do të ikim dhe ne nuk do t'i lëshojmë armët përballë këtyre felëshuesve ateistë prej mohuesve.

Said Nursi

. . .

RREZJA E TREMBËDHJETË

[Kjo Rreze përbëhet nga Letra të ndritshme shumë të rëndësishme, të cilat Ustadh Said Nursi ua dërgoi studentëve të tij (në burg); ato shpjegojnë dhe ilustrojnë në mënyrën më brilante dhe të plotë *xhihadin* e madh e të ndritshëm të Risale-i Nurit.]

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ju përgëzoj me të gjithë qënien time për Natën e Bekuar, *Natën e Kadrit*, e cila kaloi, dhe për festën e lumtur që do të vijë; dhe ju lë amanet në mëshirën e të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë dhe në Unitetin e Tij xh.sh..

Megjithëse unë nuk ju shoh ju të nevojshëm për ngushëllim, sepse kuptimi i *"Ai që beson në Kaderin Hyjnor, shpëton nga brenga"*, është i mjaftueshëm, veçse ama unë do të them sa vijon:

Unë kam parë me siguri ngushëllimin e plotë të cilin e jep kuptimi aludues i vërsetit Kerim,

"Prit pra me durim (o Muhammed a.s.m.) për Vendimin dhe Gjykimin e Zotit tënd, pasi ti me të vërtetë që je nën Sytë Tanë dhe lartëso Lavditë e Zotit tënd kur të ngrihesh".[174] Kjo ishte kështu:

Ndërsa mendoja me rehati e qetësi për kalimin e muajit të bekuar të Ramazanit, me harresën e telasheve të dynjasë, papritmas ky episod i paimagjinueshëm, i tmerrshëm dhe krejtësisht i padurueshëm na ra neve; megjithatë unë vëzhgova qartë se ai ishte thjesht mirësi - përkujdesje- e pastër Hyjnore për mua, për Risale-i Nurin, për ju, për muajin e Ramazanit dhe për vëllezërit tanë.

Unë do të përmend vetëm dy ose tre prej dobive të tij të shumta lidhur me veten time:

Njëra prej tyre: Ai episod më nxiti mua për në përpjekje e punë të pandërprerë në muajin e Ramazanit me një stimulim të fortë, me seriozitet të madh, me përgjërim e kërkim srehimi tek Allahu duke mposhtur një sëmundje të rëndë.

---

[174] Kur'an, 52:48

E Dyta: Unë pata një dëshirë të fortë për të parë e për të takuar gjithësecilin prej jush dhe gjithashtu të isha pranë jush në këtë vit. Unë do të isha i kënaqur e do të pranoja t'i gjitha këto brenga e vështirësi që kam vuajtur kundrejt takimit me njërin nga ju dhe për të ardhur në Isparta.

E Treta: Në një mënyrë të jashtëzakonshme, të gjitha gjendjet dhe rrethanat e dhimbshme si në Kastamonu, po ashtu edhe këtu ndryshojnë në mënyrë të befasishme, dhe në kundërshtim me dëshirën dhe parashikimin tim; pasi një dorë e Përkujdesjes Hyjnore shihet pas ngjarjeve, saqë na bën ne të themi: *"E mira është në atë që zgjedh Allahu"*. Ajo që më bëri ta kuptoja këtë më shumë, ishte se njerëzit më të pakujdesshëm dhe pozitat më të larta po bëhen të lexojnë Risale-i Nurin -për të cilin mendoj vazhdimisht- me vëmendje të madhe, duke hapur fusha të reja pune në sfera të tjera.

Përballë dhimbjeve dhe dëshpërimeve të gjithësecilit prej jush të grumbulluara tek unë dhe të cilat preknin shumë ndjenjat dhe zemërdhembshurinë time për ju, dhe kjo përveç dhimbjeve të mia, dhe rënia e kësaj fatkeqësie në muajin e bekuar të Ramazanit që çdo orë prej tij është sa njëqind orë, dhe i bën çdo orë prej atyre njëqind *sevabeve* -meritave- sa dhjetë orë ibadeti, deri sa të arrijnë në një mijë orë ibadeti.

Pastaj ata njerëz të sinqertë si shembulli juaj të cilët e studiuan Risale-i Nurin dhe e kuptuan atë ashtu siç duhet, dhe perceptuan se dynjaja është e përkohshme kalimtare, dhe se ajo është vetëm se një vend i përkohshëm tregtie; dhe ata të cilët sakrifikuan gjithçka që kishin në rrugën e besimit dhe të Ahiretit të tyre; dhe besuan se vështirësitë e mundimet kalimtare, të cilat i vuajnë në këtë shkollë të Jusufit, do të prodhojnë kënaqësi të vazhdueshme dhe dobi të përjetshme, -keqardhja dhe pikëllimi im për ju, që burojnë nga ndjeshmëria e fortë, u transformuan në urime, përgëzime e vlerësime për qëndrueshmërinë tuaj; dhe me rolin tim thashë: "***El-hamdu lil-lah ala kul-li hal, sivel kufri ved-dalal",*** *"Lavdi Zotit për çdo gjendje përveç mohimit e çudhëzimit".*

Unë jam i mendimit se në këtë këndvështrim ndodhen dobi të këtilla edhe për mua, edhe për vëllazërinë tonë, edhe për Risale-i Nurin, edhe për muajin e bekuar, muajin e Ramazanit, edhe për ju; saqë në qoftë se do të ngrihej -hiqej- perdeja, do t'ju bënin ato dobi të thonit: ***"Ja Rab-bi, leke El-Hamd Ve Esh-Shukr"***, "*O Zot, lavdërimi e falënderimi të takojnë Ty,* në të vërtetë kjo fatkeqësi që ka rënë mbi ne është një shembull i përkujdesjes -mirësisë- Tënde për ne*".*

Mos i fajësoni dhe mos i qortoni -o vëllezërit e mi- ata të cilët u bënë shkak për rënien e kësaj ndodhie -fatkeqësie. Ky plan i tmerrshëm i shtrirë është përgatitur qysh prej një kohe të gjatë, por ama ai erdhi i lehtësuar në kuptim dhe do të kalojë shpejt -me lejen e Zotit xh.sh.. Prandaj, mos u dëshpëroni, por udhëzohuni me vërsetin Kur'anor: *"E ndodh që ju mund të mos e pëlqeni një gjë që është në të vërtetë e mirë për ju dhe të pëlqeni një gjë tjetër që është e keqe për ju..."*[175]

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur! Unë jam shumë i lumtur e shumë me fat që jam pranë jush. Herë pas here unë bisedoj me ju në imagjinatë dhe gjej ngushëllim. Dijeni se po të kishte qenë e mundur, unë me krenari e me gëzim do t'i kisha mbajtur e duruar të gjitha mundimet dhe vështirësitë tuaja.

Për shkakun tuaj, unë i dua Ispartën dhe rrethinat e saj bashkë me dheun dhe gurët e tyre. Madje unë deklaroj, dhe do ta them këtë në ceremoni zyrtare: Edhe në qoftë se autoritetet e Ispartës do të më jepnin dënim, dhe një provincë tjetër do të më jepte pafajësinë, unë përsëri do të preferoja këtë qytet.

Po, unë jam nga Isparta në tri aspekte pavarësisht se nuk mund ta provoj këtë gjeneologjikisht -historikisht; por unë kam bindjen se stërgjyshërit, paraardhësit e Saidit, të cilët erdhën në botë -lindën- në zonën e Isparit[176], shkuan atje prej këtu.

Gjithashtu provinca e Ispartës më ka dhënë mua vëllezër të tillë të vërtetë saqë kjo më bën që unë të sakrifikoja, me gjithë kënaqësi e gëzim, për gjithësecilin prej tyre jo Abdul-Mexhidin[177] dhe Abdur-Rahmanin[178] por edhe Saidin -veten time.

Unë besoj se nuk ndodhet në globin tokësor -në këtë kohë- ndonjë që të vuajë më pak -në zemër, në shpirt dhe në mendim- se sa studentët e Risale-i Nurit, sepse zemrat e tyre, shpirtërat dhe mendjet e tyre nuk

---

[175] Kur'an, 2 :216

[176] Një zonë në afërsi të së cilës ndodhet fshati Nurs ku është vendlindja e Ustadh Said Nursit. Përkthyesi.

[177] Abdul Mexhidi (vdiq më 1967) ishte vëllai më i vogël i Bediuzzamanit. Ai ishte mësues për shkencat fetare, pastaj myfti. Ai përktheu disa pjesë të Risale-i Nurit në Arabisht dhe disa të tjera nga arabishtja në Turqisht. Përkthyesi.

[178] Abdurrahmani (1903-1928) ishte djali i vëllait më të madh të Bediuzzamanit, Abdullahut. Ishte "djali shpirtëror" i Bediuzzamanit, studenti dhe ndihmësi i tij.

vuajnë ngushtësi e pikëllim për shkak të dritave të *imanit tahkikij* -besimit të sigurt e të verifikuar. Sa për mundimet fizike dhe vështirësitë e kësaj bote- ata kanë mësuar prej Risale-i Nurit se ato janë edhe kalimtare e të parëndësishme, edhe të bëjnë të fitosh sevab dhe janë mjet për hapjen e një fushe veprimi për t'i shërbyer besimit dhe për ta zgjeruar atë; dhe kështu ata i takojnë ato mundime me dhënie falënderimesh e me durim. Ata provojnë nëpërmjet gjendjeve të tyre se *imani tahkikij* -besimi i sigurt dhe i verifikuar- është burim lumturie edhe në këtë banesën e dynjasë gjithashtu. Po, ata veprojnë me seriozitet dhe me qëndrueshmëri për t'i transformuar këto vështirësi e mundime të përkohshme në shembuj të përhershëm mëshire, duke thënë: "Le të shohim atë çfarë Zoti vepron, është më e mira çfarëdo që Ai bën!

I lutemi Allahut të Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë që t'i shumojë numrat e atyre si ata, dhe t'i bëjë ata boshtin e nderit, të krenarisë dhe të lumturisë për këtë vend, dhe t'u dhurojë atyre lumturinë e përjetshme në Xhennetin *Firdeus*. Amin!

Said Nursi

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Zbritja e këtij Vendimi Hyjnor mbi ne -nga këndvështrimi i Kaderit Hyjnor- vjen për shkak se disa studentë të rinj anuan e kërkuan të fitojnë gjëra të kësaj dynjaje nëpërmjet Risale-i Nurit, gjëra të cilat nuk harmonizohen me kuptimin e vërtetë të sinqeritetit; prandaj ata i gjetën vetet e tyre të konfrontuar nga rivalët egoistë, të cilët shtyhen nga interesi vetjak.

Sigurimi -marrja në dorë- e një trajtese, origjinali i së cilës u shkrua para njëzet e pesë vitesh -domethënë Rrezja e Pestë- në një vend të largët, dhe kopjet e së cilës nuk i kam shtënë në dorë veçse një ose dy herë gjatë tetë viteve, dhe pastaj në të njëjtën kohë ato kopje u humbën, bëri që një numër prej njerëzve xhelozë si ai i hoxhallarëve të këqinj, të ngjallnin dyshime me atë trajtesë në rradhët e punonjësve në zyrat e departamentit të drejtësisë.

Dhe në të njëjtën kohë ndikoi kundër -ktheu në drejtim të kundërt- lajmi i botimit të trajtesës ***EL-Ajetul-Kubra,*** *Shenja më e Madhe* me shkronjat e reja pa miratimin tim, në vend të trajtesës "*Çelësi i besimit"* të cilën doja ta botoja, dhe arritja e disa kopjeve prej saj këtu,-ky njoftim- ktheu përkundër, ndryshoi plotësisht pozitën, tek sferat e qeverisë; dhe të dyja çështjet u bënë të ngatërruara për ta. Sikur "*Rrezja e pestë"* u botua në kundërshtim me kodin civil. Disa

njerëz të këqinj e bën qimen tra, e bën mizën buall dhe na flakën neve në këtë vend të izoluar.

Kurse Kaderi Hyjnor na shtyu ne këtu me qëllim që të fitojmë dobi, na shtyu për të mirën tonë, dhe na bëri ne të fitojmë një shpërblim të madh dhe më shumë se sa shpërblimi që merrnin asketët e kohëve të hershme që veçoheshin në vende të izoluara me zgjedhjen e tyre. Kaderi na ftoi përsëri tek shkolla e Jusufit me qëllim që të na e mësonte plotësisht mësimin e sinqeritetit dhe që të na drejtonte e rregullonte lidhjet dhe marrëdhëniet tona me dynjanë, të cilat në të vërtetë janë të parëndësishme. Ne themi përballë dyshimeve të pabaza të njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje:

Rrezja e Shtatë nga fillimi gjer në fund është rreth imanit, nxit për në besim; ju jeni bërë konfuz në çështje dhe jeni mashtruar. Ndërsa Rrezja e pestë është krejtësisht e ndryshme nga ajo; kjo është një trajtesë e veçantë dhe tepër private -sekrete- saqë nuk është gjetur tek ne pavarësisht kërkimeve dhe hetimeve të holla. Dhe origjinali i kësaj trajtese u shkrua para njëzet viteve, dhe jo vetëm që nuk duam që ajo të botohet, por gjithashtu nuk duam as që t'ia tregojmë ndokujt, cilido qoftë ai, në kohën e tanishme. Ajo është një trajtesë që parashikon e njofton disa ngjarje të së ardhmes, e vërtetoi realiteti atje, dhe ajo nuk sfidon askënd dhe nuk kundërshton asgjë.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Unë përsëri ju përgëzoj për festën tuaj të lumtur; mos u dëshpëroni që ne nuk mundëm të takoheshim personalisht. Në të vërtetë ne jemi gjithmonë së bashku, dhe në dashtë Zoti kjo solidarësi -frymë kolektiviteti- do të vazhdojë në rrugën për në përjetësi. Unë jam i mendimit dhe kam bindjen se shpërblimet e përjetshme që ju i fitoni në punën dhe në shërbimin tuaj në rrugën e besimit, të virtyteve, të veçorive shpirtërore dhe të gëzimeve të shpirtit dhe të zemrës të cilat ju i arrini, i zhdukin shqetësimet dhe mundimet që ju bien juve përkohësisht në kohën e tanishme. Deri tani nuk është gjendur askush që të ketë vuajtur aq pak vështirësi sa studentët e Risale-i Nurit në rrugën e shërbimit më të madh të shenjtë. Po, Parajsa është e shtrenjtë; ajo nuk është e lirë. Ta shpëtosh imanin -besimin- prej kufrit –mohimit absolut- i cili i shkatërron të dyja jetët, jetën e dynjasë dhe të Ahiretit, ka rëndësinë më të madhe në këtë kohë.

Edhe në qoftë se do të kishte ndonjë vështirësi e mundim, kjo duhet të takohet me entuziazëm, falënderime e me durim. Meqenëse

Krijuesi ynë i Cili na ka vënë në punë në këtë shërbim dhe më shtyn për tek ai, është ***Rrahim*** dhe ***Hakim***, *Mëshirëplotë* dhe *i Gjithurtë* atëherë ne duhet të kërkojmë strehim me qetësi dhe të mbështetemi tek mëshira dhe urtësia e Tij dhe ta takojmë çdo fatkeqësi që na bie me kënaqësi e me gëzim.

Një vëlla heroik i yni ka marrë mbi vete të gjithë përgjegjësinë për botimin e Trajtesës *EL-Ajetul-Kubra*. Ai në të vërtetë ka shfaqur se sa i merituesshëm është ai për nderim të jashtëzakonshëm dhe për merita që i përkasin botës tjetër me anë të penës së tij që transkriptoi -kopjoi- *El-Hizb el-Kur'an*[179] dhe *Hizb al-Nuri*[180]; gjendja e tij më bëri të qaja me gëzim të thellë.

Ka shumë urtësi tek Rrezja e Shtatë -El-Ajetul-Kubra- duke tërhequr vëmendjen për tek vetvetja, dhe duke përgatitur terrenin për triumfet e së ardhmes që ajo meriton: Konfiskimi i përkohshëm i asaj trajtese nuk do t'i shfuqizojë shërbimet dhe shpenzimet e atij vëllai dhe të bashkëshortes së tij; në dashtë Zoti, kjo do t'i bëjë ato të shkëlqejnë edhe më shumë. Këtë ne e presim nga mëshira Hyjnore.

Nga vëllai juaj i cili, nëpërmjet përdorimit të vetës së parë shumës në të gjitha lutjet e tij, të tilla si: ***"Exhirna... Ver Hamna, Vah fadhna****, Na Shpëto ne; kij mëshirë mbi ne; na ruaj ne"*, ju përfshin ju të gjithëve pa përjashtim brenda atyre duave; dhe ai -vëllai juaj- vepron në përputhje me parimin e "*El-ishtirak el-maënevij*", *pjesëmarrja shpirtërore*, sikur ne të ishim trupa të shumtë dhe një shpirt i vetëm, dhe ai pikëllohet më shumë për dhimbjet dhe mundimet tuaja se sa ju; dhe ai pret prej "Personalitetit tuaj kolektiv" forcë, ndihmë, vazhdimësi, qëndrueshmëri dhe *Shefaat* -ndërmjetësi.

Vëllai juaj
Said Nursi

• • •

Në një kohë kur, nën efektet e kësaj ngjarjeje, unë vendosa ta lija krejtësisht vetveten për ta sakrifikuar për vëllezërit e mi të pafajshëm, dhe duke kërkuar një zgjidhje, unë lexova "*Xhel Xheludije*".[181]

---

[179] *Hizb el-Kur'an*: Një koleksion prej vërseteve të zgjedhura prej sureve të Kur'anit Kerim, të cilët thellojnë besimin dhe lidhen me reflektimin e imanit rreth universit. Përkthyesi

[180] *EL-Hizb el-Nuri* është një përmbledhje e shqyrtimeve reflektive, të cilën e shkroi Ustadhi në gjuhën arabe, dhe në dashtë Zoti do të botohet tek koleksioni *EL-Melahik*.-Përkthyesi.

[181] Një kaside -poezi- e shkruar ne siriakishte dhe në arabisht, e cila i atribuohet Hazreti Aliut - Ali Ibn Ebi Talib. Përkthyesi

Papritmas m'u shfaq se Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, u lut: "*O Zot! Na shpëto ne*!"; në dashtë Zoti, ju do të jeni të shpëtuar nëpërmjet kuptimit të duasë së tij.

Po, në kasiden e tij *El-Xhel-xhelutija*, Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të dha njoftimet për Risale-i Nurin në dy mënyra, dhe aludon për Trajtesën "*El-Ajetul-Kubra*" me rreshtat: *"Dhe nëpërmjet "EL-Ajetul-Kubra", më siguro e më mbro nga fatkeqësia e befasishme"*. Nëpërmjet këtij aluzioni, ai është duke treguar se për shkak të "*EL-Ajetul-Kubra*", një fatkeqësi me përmasa të mëdhaja do t'u binte studentëve të Risale-i Nurit dhe është duke iu përgjëruar Allahut që t'i shpëtojë studentët nga fatkeqësia për hir të Trajtesës *El-Ajetul Kubra*; ai është duke i bërë trajtesën dhe burimin e saj si një ndërmjetësuese për *shefaat*. Po, botimi i Trajtesës *El-Ajetul Kubra* u bë pretekst -shkas- për fatkeqësinë që ndodhi, dhe e konfirmoi ekzaktësisht atë shenjë të së Padukshmes.

Gjithashtu, në faqen e kundërt të kasides, në fund të aluzioneve për pjesët e Risale-i Nurit dhe në renditjen e tyre, ajo thotë në kuptim: "Këto shkronja drite, grumbullojnë së bashku veçoritë e tyre; Dhe studiojnë kuptimet e tyre, sepse nëpërmjet tyre e mira përmbushet".

Domethënë: "Fjalët dhe shkronjat e Risale-i Nurit, për të cilat aludohet, grumbullojnë së bashku veçoritë e tyre dhe studiojnë kuptimet e tyre; sepse e gjithë e mira dhe lumturia arrihet nëpërmjet tyre". Mund të nënkuptohet nga fraza "Studiojnë kuptimet e shkronjave të tyre, se ajo nuk u referohet shkronjave të cilat nuk shprehin kuptim, por trajtesave të quajtura *Sözler*, që do të thotë "Fjalët".

"Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime."[182] *Askush nuk e di të panohurën përveç Zotit*".

Said Nursi

• • •

Vëllai im i dashur e besnik, Refet Bei!

Unë nuk mund t'i takoj me indeferentizëm pyetjet e tua të karakterizuara me njohje, pasi ato u bënë çelësa për të vërteta të rëndësishme të përfshira në pjesën e Risale-i Nurit e quajtur *Mektubat*, *Letrat*. Një përgjigje e shkurtër është sa vijon:

---

[182] Kur'an, 2 :286

Meqenëse Kur'ani është një adresim i parapërjetshëm dhe flet me të gjitha klasat e humanizmit dhe me të gjitha grupet e adhuruesve, ai duhet të posedojë kuptime të shumta në harmoni me aftësitë e tyre të të kuptuarit, dhe të përmbajë nivele të shumta prej kuptimeve universalë. Disa komentatorë zgjedhin e preferojnë vetëm kuptimin më të përgjithshëm, ose vetëm kuptimin më të qartë, ose atë që shpreh një akt të detyrueshëm, ose kuptimin që tregon një *sunnet muekkedeh* -një praktikë të konfirmuar të profetit a.s.m.. Për shembull, për vërsetin, *"Edhe gjatë natës po kështu lartëso lavditë e Tij",*[183] ata përmendin një sunnet të rëndësishëm, dy rekatët e namazit *tehexhxhud*; dhe për vërsetin, *"edhe me perëndimin e yjeve"*[184] përmendin se është *sunneti muekkedeh* i namazit të agimit të hershëm. Gjendja është se kuptimi i parë ka pjesë të tjera të shumta përbërëse përveç atij kuptimi.

Vëllai im! Të folurit me ty nuk mbaron.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë sapo përfundova namazin e drekës, dhe më erdhët në mendim ndërsa recitoja *tesbihatet*, se gjithësecili prej jush është i dëshpëruar duke menduar për vetveten dhe për të afërmit e tij që banojnë së bashku me të në shtëpi. Dhe papritmas m'u shfaq në zemrën time se, në qoftë se ata të kohëve të hershme të cilët preferuan Ahiretin e tyre mbi dynjanë e tyre dhe të cilët u veçuan nëpër shpella e në vende të tjera të izoluara me qëllim që t'i shpëtonin personat e tyre prej mëkateve të jetës shoqërore, dhe këtë e bënin për të fituar Ahiretin duke punuar me sinqeritet; dhe të cilët i kaluan jetët e tyre duke munduar vetveten dhe duke bërë pendesë… Unë them se në qoftë se ata do të ishin në këtë kohë, sigurisht që do të ishin studentët e Risale-i Nurit.

Nuk ka dyshim se këta -duke qenë nën kushtet e këtyre kohëve- janë dhjetë herë më shumë në nevojë se sa ishin ata, dhe fitojnë dhjetë herë më shumë merita e veçori se sa ata, dhe janë dhjetë herë më shumë të rehatuar e të qetë se sa ata.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë! Shumë e shumë përshëndetje!

---

[183] Kur'an, 52:49
[184] Kur'an, 52:49

Në kohët e hershme në qytetin tim e recitonim *Suren* "*Ihlas*" një mijë herë në Ditën e Arefatit[185]. Kurse tani unë mund ta lexoj pesëqind herë ditën para Ditës së Arefatit dhe pesëqind herë në Ditën e Arefatit. Ai që midis jush ka mundësi që t'i recitojë të gjitha njëherësh, le ta bëjë. Megjithëse unë nuk mund të takohem dhe nuk mund të flas me asnjërin prej jush, veçse ama në shumicën e kohëve unë mund ta shoh secilin prej jush dhe të takohem me të personalisht brenda duave kur lutem, dhe ndonjëherë me emrin e tij.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë marr me mend se deri tani dy drejtuesit e grupit kryesor të rrethit të Fabrikës së *Nurit* - Dritës-, kanë shpëtuar.

Ai rreth, ai grup, kanë përmbushur triumfet e njëzet-tridhjetë viteve për gjashtë ose shtatë vite. Si të ishte një kujtim për penat e tyre të ndrishme, shërbimi i tyre nuk mbaron; ai u shkakton *sevabeve* - meritave- të regjistrohen në librat e veprave të tyre në vendet e tyre. Në fakt, *Hizb Nuri* ka arritur pushtime të tilla mposhtëse dhe ka hyrë në vende të tilla të rëndësishme, saqë sikur ata, të cilët e botuan, të ishin duke punuar vazhdimisht. Unë pandeha se, ashtu si personi i parë, Hafiz Mustafa, i cili ka punuar aq shumë dhe është aq shumë i zellshëm, ishte jashtë, pastaj unë dëgjova se ai është brenda këtu. Duke e menduar të ishte ndoshta ndonjë Mustafa tjetër, unë gjeta ngushëllim.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur!

Këtë mëngjes ndërsa po recitoja *tesbihatet*, u pikëllova e më erdhi keq për gjendjen e Hafiz Teufikut.[186] Mua m'u kujtua se ishte hera e dytë që ai e vuante këtë mundim e shqetësim. Ndërkohë papritmas m'u shfaq mua: Përgëzoje atë! Për shkak të një paralajmërimi të kotë, të panevojshëm, ai donte ta tërhiqte pak vetveten nga një pozitë e rëndësishme dhe nga pjesa e tij e madhe në Risale-i Nur. Por

---

[185] Pragu i festës së Kurban Bajramit. Përkthyesi.

[186] Hafiz Teufik (1887-1965), njëri nga studentët e parë të Risale-i Nurit dhe njëri prej shkruesve të tij më të rëndësishëm. Ai gjithashtu u quajt "Shamli" meqë ai e kishte kaluar një pjesë të rinisë së tij në Damask, ku babai i tij shërbeu si një oficer në ushtri. Ai kaloi kohë në burgjet e Eskishehirit dhe të Denizlit së bashku me Bediuzzamanin. Përkthyesi.

madhështia dhe shenjtëria e shërbimit të tij përsëri i dhanë atij një pjesë të madhe dhe një thevab të bollshëm. Po, nuk duhet të ikësh nga një nderim i tillë shpirtëror i lartë për shkak të një dëshpërimi të vogël dhe për shkak të një mundimi kalimtar.

Po, o vëllezërit e mi! Meqenëse çdo gjë është kalimtare dhe do të largohet, në qoftë se ajo do të ishte kënaqësi dhe ëndje, do të largohej pa dobi dhe lë prapa dëshpërim e pikëllim. Ndërsa në qoftë se ajo do të ishte lodhje, ngushtësi e mundim, do të linte prapa shpërblime të mëdhaja për dynjanë e për Ahiretin, nga këndvështrimi i të qenurit shërbim i shenjtë, pasi ajo fiton dobi të tilla të ëmbla e të kënaqshme saqë i zvogëlon në asgjë lodhjen e mundimin. Me përjashtim të njërit prej jush, unë jam më i moshuari dhe jam ai që ka vuajtur më shumë telashe e mundime, por megjithatë, unë ju siguroj se duke praktikuar durimin e plotë, dhënien e falënderimeve dhe qëndrueshmërinë, unë jam i kënaqur e i lumtur me gjendjen time.

Dhe nuk është falënderimi në fatkeqësi veçse për hir të shpërblimit që merret prej saj, dhe për dobitë që vijnë prej saj në këtë botë dhe në tjetrën.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur!

Me zhdukjen e gjërave që pengonin plotësimin e çështjeve të trajtesës “Frutat e besimit”, në dashtë Zoti, shkrimi do të rifillojë. Njëra nga këto pengesa ishte i ftohti, tjetra ishte habia dhe frika e Masonëve prej fuqisë së saj. Unë mendoj për këtë fatkeqësi që na ra nga këndvështrimi i Kaderit Hyjnor dhe gjej se vështirësitë e vuajtjet e mia transformohen në mëshirë. Po, ashtu siç është shpjeguar në Trajtesën e Kaderit, ndodhen dy shkaqe për çdo ngjarje:

I Pari: Është një shkak i jashtëm, njerëzit i bazojnë gjykimet e tyre mbi të, dhe shpeshherë ata veprojnë padrejtësisht.

Tjetri: Është shkaku i vërtetë, realiteti; në përputhje me të cilin gjykon Kaderi Hyjnor; ai vepron me drejtësi -nën padrejtësinë e njerëzve- në pikërisht të njëjtën ngjarje.

Për shembull, një njeri dërgohet në burg me akuzën e një vjedhjeje gjë të cilën ai nuk e ka kryer. Por Kaderi Hyjnor e gjykon atë me burgosje për një krim të tij të fshehur, sekret; dhe Kaderi vepron me drejtësi nëpërmjet pikërisht padrejtësisë njerëzore. Dhe në këtë çështjen tonë, provimi i vështirë në të cilin hymë me qëllim që të dallohet diamanti nga copat e parëndësishme të qelqit, që të dallohen

të devotshmit e vërtetë prej atyre që janë të paqëndrueshëm e të luhatshëm dhe të dallohen të pastërtit e sinqertë prej atyre që nuk janë në gjendje të braktisin egoizmin e tyre dhe interesat personale… ky provim i vështirë në të cilin hymë, përmban dy shkaqe:

I Pari: Është solidariteti i fuqishëm dhe i sinqertë dhe shërbimi i jashtëzakonshëm ndaj fesë, saqë shkaktoi indinjatën dhe dyshimet e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje dhe të politikanëve; njerëzit e panë këtë shkak dhe na bënë padrejtësi.

I Dyti: Meqenëse jo gjithkush më vete do të mund ta demonstronte vlerën e këtij shërbimi të shenjtë nëpërmjet sinqeritetit të plotë dhe solidaritetit që meriton, Kaderi Hyjnor pa tek ky shkak, dhe bëri drejtësi në hakun tonë.

Ky Kader Hyjnor është mëshirë Hyjnore për ne brenda drejtësisë së pastër, pasi ai -Kaderi- i grumbulloi në një vend të vetëm vëllezërit e përmalluar për njëri-tjetrin, dhe i transformoi vështirësitë e tyre në *ibadete* -akte adhurimi- dhe i shndërroi pasuritë e humbura në sadeka -në lëmosha, në akte bamirësie- si dhe tërhoqi shikimet dhe vëmendjen për tek trajtesat që kishin shkruar vëllezërit. Gjithashtu ai na bëri të kuptojmë se pasuritë e dynjasë, fëmijët e saj dhe rehatia e njeriut në të janë çështje të përkohshme kalimtare, dhe se njeriu përfundimisht do të kalojë në dhe, do të hyjë në varr; prandaj nuk do të kishte arsye që ai të prishë Ahiretin e tij për hir të atyre gjërave të përkohshme, por duhet të mësohet me durim dhe të rezistojë; të jetë një model i mirë dhe shembull heroik, madje të jetë imam -drejtues- për vëllezërit e tij në të ardhmen… Dhe gjithashtu në shumë aspekte të tjerë të ngjashëm-qënia jonë këtu ka qenë thjesht mëshirë e pastër Hyjnore.

Megjithatë ndodhet një aspekt i vetëm i cili më shkaktoi një mendim, që ishte, se në qoftë se plagoset një gisht i njeriut, atëherë syri, mendja dhe zemra i neglizhojnë detyrat e tyre të rëndësishme dhe bëhen të preokupuara me të. Pra të gjitha ato gjymtyrë preokupohen me atë plagë. Gjithashtu zemrat dhe shpirtërat tonë do të preokupoheshin me plagët e vështirësive dhe mundimeve që na bien në jetët tek të cilat kemi hyrë dhe të cilat janë me vendimin e domosdoshmërisë. Madje ajo situatë më çoi mua në mendim tek këshilli i Masonëve ndonëse ishte e domosdoshme ta harroja dynjanë në atë kohë. Dhe unë e preokupova mendimin tim për dhënien e goditjeve disiplinuese mbi ta. Dhe unë gjeta ngushëllim nga mundësia se Zoti xh.sh. do ta pranonte këtë gjendje, gjendjen e pakujdesisë, si një lloj prej luftës ideologjike.

Unë mora përshëndetjet e Ali Gulit, vëllait të Hafiz Mehmetit, mësuesit të shquar të Risale-i Nurit. Edhe unë i dërgoj përshëndetje e dua atij si dhe të gjithë vëllezërve të tij dhe të gjitha familjeve të fshatit Sava[187], të gjallëve dhe të vdekurve.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria juaj i prish të gjitha planet e Masonëve dhe të shtiracakëve. Po, o vëllezërit e mi, nuk ka arsye a motiv për ta fshehur, ata ateistë i krahasuan Risale-i Nurin dhe studentët e tij me tarikatet Sufi dhe në mënyrë të veçantë me tarikatin Nakshibendi, dhe nisën sulmet e tyre kundra nesh me të njëjtat plane, me të cilat mposhtën ndjekësit e tarikateve Sufi, me idenë dhe me shpresën që të na përçanin dhe të na hidhnin poshtë. Ata përdorën:

Së Pari: Mjetet e frikësimit dhe të kërcënimit dhe duke shfaqur abuzimet dhe aktet që u keqpërdorën në tarikatin Sufi.

Së Dyti: Duke shpallur e duke bërë publike mangësitë dhe gabimet e drejtuesve dhe të ndjekësve të tarikatit.

Dhe së Treti: Mjetet që i përdorën ndaj tarikatit Nakshibendi dhe tarikateve të tjera, ishin: që t'i korruptonin me ligësi ngashënjyese dhe duke i shushatur e narkotizuar me kënaqësitë e helmuara dhe trullosëse të filozofisë materialiste dhe të civilizimit me qëllim që të shkatërronin lidhjet e solidaritetit të tyre dhe hallkat e vëllazërisë midis tyre, duke përçmuar pabesisht *murshidët* -drejtuesit- dhe profesorët e tyre me gënjeshtra e fyerje; dhe duke diskretituar rrugët dhe tarikatet e tyre me disa prej parimeve të shkencës dhe të filozofisë. Ata na sulmuan me të njëjtat armë -të cilat i përdorën kundra Nakshibendive dhe Sufive- por ata u mashtruan; sepse rruga e Risale-i Nurit është themeluar mbi sinqeritetin e plotë, mbi braktisjen e egoizmit dhe duke e kërkuar dhe ndijuar mëshirën Hyjnore brenda vështirësive dhe mundimeve të punës, duke i kërkuar e provuar kënaqësitë e përhershme brenda dhimbjeve kalimtare, duke i shfaqur dhimbjet e rënda brenda vetë kënaqësive të shthurura, duke shpjeguar se boshti i kënaqësisë së

[187] *Sava* ose Sav: Një fshat afër qytetit të Ispartas. Të gjithë banorët e Savës, të rinj e të vjetër, burra e gra, vullnetarisht i shërbyen besimit nëpërmjet botimit të Risale-i Nurit dhe kopjimit të tij. Përkthyesi.

pastër të pafundme edhe në dynja gjithashtu është në besim, dhe duke dhënë mësim të vërtetat dhe duke i bërë të kuptueshme çështjet të cilat dora e asnjë filozofie nuk mund t'i arrijë. Prandaj, në dashtë Zoti xh.sh. ai -Risale-i Nuri- do t'i asgjësojë të gjitha planet e tyre, dhe do të tregojë se asnjë krahasim nuk mund të bëhet ndërmjet rrugës së Risale-i Nurit me ato të tarikateve Sufi, ai do t'i heshtë ata plotësisht.

• • •

Një Pikë e Hollë

Këtë mëngjes dikush më thirri nga oborri i xhandarmërisë -policisë- pranë meje dhe unë u ngjita tek dritarja. Ai më tha: "Dera jonë është mbyllur vetvetiu dhe sado që u përpoqëm, ne nuk mundëm ta hapim".

Kështu unë i thashë: Ajo është një shenjë për ju se midis njerëzve që ju i ruani dhe i mbani pas kangjellave të derës së burgut, ndodhen ata të cilët janë të pafajshëm si ju. "Madje ata më fyen me pretekstin se u takova për një minut me njërin nga vëllezërit e mi në fe të cilin nuk e kisha parë që prej dhjetë vitesh, dhe me një pretekst tjetër ata madje e mbyllën edhe derën tjetër të jashtme.

Dhe si një dënim për të, edhe dera juaj u mbyll gjithashtu".

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ndodhen edhe tre pika të tjera lidhur me pikën e hollë të cilën e shkrova dje për ju:

E Para: Si një përfaqësues i një personaliteti kolektiv të një grupi të bekuar që do të formohet në të ardhmen, nëpërmjet bekimeve të atij personaliteti kolektiv, dera e mbyllur me shul, u hap vetvetiu; përsëri ata u zemëruan me një përfaqësues të një grupi të bekuar i cili tani është në ekzistencë dhe duke u takuar me mua për gjysëm minuti, pas dhjetë vitesh. Unë gjithashtu u zemërova, dhe përsëri thashë: "U mbyllshin dyert!" Në mëngjesin tjetër -kjo nuk kishte ndodhur kurrë më parë- dyert e rojtarëve u mbyllën, dhe nuk u hapën për dy orë.

Pika e Dytë e Hollë: Unë i dërgova një shënim -vërejtje- prokurorit të përgjithshëm nëpërmjet drejtorit të burgut. Unë thashë në të: "Unë po mbahem në izolim dhe nuk mund të takohem me askënd.

Edhe në qoftë se mund të takohesha, unë nuk njoh askënd në këtë qytet... me dikë prej këshillit të qytetit këtu... dhe kështu me radhë".

Më vonë prokurori pyeti nëse isha në izolim i vetmuar. Drejtori i burgut tha: "Jo". Të dy ata e kundërshtuan vërejtjen time. Në të njëjtën ditë, një i afërm i largët dhe gjysëm i çmendur erdhi e më vizitoi për një gjysëm minuti, dhe u paraqit në një mënyrë të tillë për të treguar se unë nuk kisha qenë kurrë në një izolim të vetmuar. Kundërshtimet e tyre u kthyen mbi ta.

E Treta: Zhurma e të rinjve ngatërrestarë tek dera tjetër pranë meje ndërmjet namazeve të akshamit e të jacisë më shqetësuan mua, por jo shumë. Ishte ajo ditë që ata gjetën një shkas dhe e mbyllën derën. Duhma e rëndë gjithashtu u bë më e keqe në qelinë time, dhe shurdhimi me zhurmë që e bënë të rinjtë pranë derës sime, më shqetësoi jashtë mase. Unë përsëri thashë: "U mbyllshin dyert! Përse e bëjnë ata këtë?" Në atë mëngjes incidenti ndodhi.

• • •

Vëllezërit e mi!

Dy çështjet që i keni shkruar me shkronjat e reja kanë pasë një efekt të jashtëzakonshëm. Do të ishte gjë e shkëlqyeshme në qoftë se do të shkruheshin gjithashtu edhe çështja e parë, çështja e dytë dhe çështja e tretë. Por unë e gjej shqetësuese, kam merak në qoftë se do të ishin Husrevi dhe Tahiri ata që do ta bënin këtë meqë penat e tyre janë veçanërisht të përshtatshme për Kur'anin dhe për transkriptimin Kur'anor, dhe janë të ngarkuara për të. Do të ishte më mirë në qoftë se të tjerët do t'i shkruanin.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur!

Gjatë vitit të kaluar unë përdorja një sasi -domethënë, rreth një kilogram makarona dhe oriz.

Nuk kam dyshim se ato janë një mjet bereqeti. Por ju nuk i lini ato tek unë tani që të mund t'i gatuaj. Kështu unë jua jap juve si dhuratë, dhe si një mjet bekimi e bereqeti. Në një rast, unë pashë një shtim të çuditshëm në makaronat.

Unë i thaja copat pasi i gatuaja. Unë vetë dhe të tjerët pamë se një copë e vetme ishte dhjetë herë më e madhe se sa normalja.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur!

Mbrëmjen e kaluar ndërsa po recitoja *virdet* -lutjet- rojtarët dhe të tjerët mundën të më dëgjonin.

Ndërkaq mua m'u shfaq në zemër: A nuk e pakëson shpërblimin kjo shfaqje -ky recitim hapur? U shqetësova dhe u trondita, por m'u kujtua thënia e famshme e *Huxhxhetul Islam* Imam Gazalit: "Ndonjëherë bërja e diçkaje në mënyrë të hapur është më mirë se sa ta fshehësh atë." Domethënë, recitimi i virdeve në mënyrë të hapur në shumë drejtime mund të jetë shumë më e lavdërueshme, sepse të tjerët mund të përfitojnë prej saj, ose e imitojnë atë, ose zgjohen nga pakujdesia; ose ajo mund të jetë për të shpallur shenjat e islamit përballë atyre që vazhdojnë e ngulmojnë në çudhëzim ose në ligësi, dhe mbrojnë e shfaqin dinjitetin e fesë... dhe ka shumë dobi të tjera... dhe sidomos në këtë kohë. Hipokrizia nuk futet në veprat e atyre që kanë mësuar në mënyrë të plotë mësimit e sinqeritetit; madje recitimi hapur është shumë më i mirë se sa fshehur, me kusht që të mos ndërhyjë artificializmi i fshehur. Dhe kështu unë gjeta ngushëllim prej kësaj fjale.

• • •

Para dy ditësh më thirri hetuesi-përmbarues i gjyqit - dhe kur po mendoja për mënyrën se si do t'i mbroja vëllezërit e mi, unë hapa librin "*Hizb el-Masun*" të Imam Gazalit, dhe këto vërsete më të tërhoqën shikimin tim:

"Padyshim që Allahu i mbron ata që besojnë..." [188]

"... se si u prin ndriçimi përpara tyre dhe nga e djathta e tyre..." [189]

"Allahu është Hafidh (Mbrojtës e Ruajtës) mbi ta..." [190]

"Për ta është Tuba (gëzimet më të larta, ose lloj peme e xhennetit me shije të papërshkrueshme)..." [191]

"Zoti ynë! Na e bën të përkryer Dritën tonë për ne dhe na fal ne...!" [192]

Unë pashë se në qoftë se *sheddeja* –dyfishuessja- dhe *medde* -shenja zgjatëse- nuk numërohen, -vavi *është* gjithashtu një *medde*- sipas llogaritjes së *Ebxhedit* dhe *Xhefrit*, bën 1362, që është ekzaktësisht data e këtij viti; edhe kuptimi i tij, edhe numri koinçidojnë me kohën që ne vendosëm të mbrojmë vëllezërit tonë besimtarë. Unë

---

[188] Kur'an, 22:38
[189] Kur'an, 57:12
[190] Kur'an, 42: 6
[191] Kur'an, 13:29
[192] Kur'an, 66: 8

thashë, lavdi Zotit, kjo nuk lë më nevojë për mbrojtjen time. Pastaj mendimi, "dua të di se si do të dal", m'u shfaq. Isha kurreshtar. Unë pashë se sipas llogaritjes së *Xhefrit*, me kusht që "*tenvini*" të numërohet, dy frazat *"Allahu Hafidhun alejhim" "Allahu është mbrojtës mbi ta...*" dhe "*Tuba*", bëjnë ekzaktësisht një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy. Në qoftë se një "*medde*" nuk llogaritet, ajo bën dy, dhe në qoftë se ajo llogaritet, bën tre. Duke koinçiduar ekzaktësisht -në këtë kohë që ne kemi aq shumë nevojë për mbrojtjen Hyjnore- me datën e këtij viti, dhe me datën e vitit tjetër; ajo na ngjushëlloi neve me sigurinë se ne do të jemi të ruajtur, të mbrojtur, pavarësisht një sulmi të tmerrshëm kundra nesh i cili ishte përgatitur në vitin e kaluar në një shkallë të madhe dhe në një fushë të gjërë.

Risale-i Nuri duke bërë më shumë pushtime brilante në sferat sunduese për shkak të kësaj ngjarjeje, do të thotë se arrestimi i tij i përkohshëm nuk është dhe nuk duhet të na shkaktojë neve dëshpërim. Gjithashtu unë e konsideroj konfiskimin e trajtesës *El-Ajetul-Kubra* për shkak të botimit të saj, të jetë një shpallje, duke tërhequr vëmendjen prej të gjitha anëve për tek stacioni i saj vezullues. Unë sapo e lexova vërsetin,

"Zoti ynë!" Na e bën të përkryer Dritën tonë për ne dhe na fal ne..."

Fraza "*Vaqfir lena"* "*Dhe Na fal ne"* bën tamam një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy. Ajo koinçidon ekzaktësisht me datën e këtij viti dhe na bën thirrje dhe na urdhëron që vazhdimisht të kërkojmë falje me qëllim që drita jonë të mund të plotësohet dhe që Risale-i Nuri gjithashtu të mos mbetet i mangët.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ata të cilët e kaluan këtë provim të fortë në këto dy shkolla të Jusufit[193]-në të parën dhe në të tashmen- dhe nuk u lëkundën, dhe nuk e lanë mësimin e tyre rreth imanit -mësimet e Risale-i Nurit- dhe nuk hoqën dorë nga të qënit studentët e tij sido që të ishin rrethanat ndonëse gojët e tyre janë djegur nga supa përvëluese, dhe moralet e të cilëve nuk u thyen pavarësisht gjithë këtij agresioni dhe të gjitha këtyre sulmeve... Këta do të jenë të mirëpritur dhe të duartrokitur nga

[193] Domethënë, burgun e Eskishehirit (1935-1936) dhe burgun e Denizlit (1943-1944). Përkthyesi.

melekët dhe nga qëniet shpirtërore ashtu siç do të jenë të mirëpritur e të duartrokitur nga njerëzit e realitetit dhe nga brezat e ardhshëm. Unë jam i bindur për këtë, por meqenëse, midis jush janë disa që janë të sëmurë, të dobët ose të varfër, pikëllimi fizik është shumë i madh. Dhe përballë kësaj çështjeje, le të jetë gjithësecili prej jush ngushëllues për secilin prej atyre dhe një shembull i mirë për të në durim dhe në sjellje të mira, dhe një vëlla i dhembshur për të duke i dhënë solidaritet dhe përkujdesje të mirë; dhe një shok inteligjent në diskutimin e mësimeve të besimit, dhe një pasqyrë e pastër duke reflektuar cilësitë e bukura morale... Kështu duke i zvogëluar në asgjë mundimet fizike.

Po! Kështu unë e përfytyroj çështjen dhe ngushëllohem me të, o vëllezërit e mi dhe o ju që ju dua më shumë se shpirtin tim. Një ditë unë do t'jua dërgoj Xhyben e Meulana Halidit[194] -iu shenjtëroftë sekreti i tij- mosha e të cilës është njëqind e njëzet vjeç. Unë do ta vesh secilin prej jush me të në emrin e tij, në të njëjtën mënyrë ashtu siç më veshi ai mua me të. Kurdo që ta doni, unë do t'jua dërgoj atë.

Kur ne arritëm këtu në fillim, doktori më bëri një vaksinë kundër lisë së bardhë. Ajo formoi një të tharë -çiban- dhe krahu im u ënjt. Ënjtja ka lëvizur poshtë krahut tim; ajo nuk më le të fle dhe ma bën të vështirë marrjen e avdesit. Jam kurreshtar të di, a mos vallë trupi im nuk e duron vaksinimin kundra lisë apo mos ndodhet ndonjë kuptim tjetër në çështje? Unë pata bërë një vaksinim të tillë para njëzet vitesh në Ankara dhe akoma ajo qelbëzohet herë pas herë dhe më shkakton dhimbje. Dhe kam frikë se mos është kjo si ajo gjithashtu; si janë tuajat, si është kjo çështje tek ju?

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një arsye që drejtësia e Kaderit Hyjnor na shtyu ne për tek Shkolla e Jusufit në Denizli është edhe nevoja e të burgosurve në të, edhe nevoja e njerëzve të saj dhe ndoshta edhe nevoja e zyrtarëve dhe e nëpunësve të sferës së drejtësisë, për Risale-i Nurin dhe për studentët e tij -nevojë që ishte shumë më e madhe se në çdo vend tjetër. Dhe për shkak të kësaj, ne hymë në këtë provim të vështirë me një detyrë që i

[194] Maulana Halid el-Bagdadi (1193/1779 - 1242/1826-7), njëri prej dijetarëve më të ndritur të kohës së tij, i cili qe njohur si Muxhedidi - Ripërtëritësi- i kohës së tij. Xhybja e tij iu dha Bediuzzamanit në Kastamonu rreth vitit 1940 nga Sejjide Asija, pasardhësja e njërit prej kalifëve të tij. Përkthyesi

përket besimit dhe Ahiretit. Vetëm një ose dy prej njëzet ose tridhjetë të burgosurve i kryenin namazet e detyruar siç duheshin kryer; por duke ndjekur studentët e Risale-i Nurit, dyzet deri në pesëdhjetë vetë pa përjashtim kanë filluar t'i kryejnë namazet në mënyrë të plotë; ky është një instruktim dhe një udhëzim i tillë nëpërmjet gjuhës së gjendjes dhe një akt i tillë, saqë i ka pakësuar në asgjë vuajtjen, lodhjen dhe mundimin; madje ajo e bën njeriun që ta dojë. Ne shpresojmë nga mëshira dhe nga përkujdesja Hyjnore se, ashtu siç e kanë dhënë mësim studentët e Risale-i Nurit këtë dhe kanë udhëzuar për tek kjo çështje nëpërmjet veprave dhe gjendjeve të tyre, po ashtu nëpërmjet Imanit *tahkikij* -besimit të vërtetë e të fuqishëm- në zemrat e tyre, ata do të bëhen si një kështjellë e fortifikuar, duke i çliruar besimtarët prej dyshimeve dhe skepticizmit të njerëzve të çudhëzimit.

Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje duke na penguar ne nga të folurit dhe nga takimi me të tjerët nuk na shkakton dëm; sepse gjuha e gjendjes është më e fuqishme dhe më e efektshme se sa gjuha e të folurit. Meqenëse burgosja është për trajnim dhe edukim, në qoftë se ata e duan vërtet kombin, le t'i lejojnë të burgosurit të takohen me studentët e Risale-i Nurit, me qëllim që ata të mund të marrin për një muaj ose madje për një ditë më shumë trajnim dhe edukim se sa ajo që ata ndryshe do ta merrnin për një vit, dhe me qëllim që të gjithë ata të burgosurit të mund të bëheshin persona të dobishëm për kombin, për vendin e për njerëzit, dhe që të shpëtonin të ardhmen dhe Ahiretin e tyre. Do të kishte qenë shumë e dobishme në qoftë se do ta kishim pasë trajtesën "*Udhëzuesi për të rinjtë"*. I lutemi Allahut që ta lehtësojë hyrjen e asaj trajtese këtu.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Sot m'u kujtua bashkëbisedimi ndërmjet vëllait tim të madh të ndjerë Mulla Abdull-Ah[195] dhe Hazreti Zijaed-din[196], rreth të cilit ju keni njohuri. Pastaj unë mendova për ju dhe thashë me vete: Në qoftë se do të ngrihej perdeja -perdeja e së Padukshmes, në qoftë se e

---

[195] Mulla Abdullah: Është vëllai i madh i Ustadh Said Nursit; ai e mësoi ustadhin kur ishte fëmijë; pastaj më vonë u bë nxënësi i ustadhit kur pa gjenialitetin e tij. Përkthyesi

[196] Zijaeed-din: ishte prej Evlijave të drejtë të shquar në Turqinë lindore. Përkthyesi

Padukshmja do të zbulohej- në qoftë se të gjithë këta myslimanë të sinqertë fetarë e të zellshëm, të cilët tregojnë një qëndrueshmëri të tillë në këto kohë të paqëndrueshme, duke mos u tronditur e luhatur nga vazhdimësia e këtyre gjendjeve torturuese e pikëlluese, do të shfaqeshin të ishin Evlija ose madje pole shpirtërorë, rëndësia që ata do të kishin në shikimin tim dhe interesi për ta, do të shtohej shumë pak; ose në qoftë se ata do të më shfaqeshin të ishin persona të zakonshëm midis masave, vlera dhe pozita e lartë që do t'u jepja, kurrsesi nuk do të pakësohej. Kështu vendosa, sepse shërbimi për të shpëtuar Imanin -besimin- nën këto kushte e rrethana tepër të rënda e të vështira ka një vlerë shumë më të madhe se sa çdo gjë tjetër.

Në kushte të tilla të stuhishme e të paqëndrueshme, virtytet dhe veçoritë e dhëna nga rangjet personale dhe mendimet e mira të të tjerëve, shpërbëhen kur ato mendime të mira shkatërrohen, dhe dashuria e tyre pakësohet. Për më tepër, ai që posedon virtyte dhe veçori, do të ndihej në vetvete i detyruar që të adoptonte mënyra artificiale, formalitete të kota e të boshatisura dhe një dinjitet të rëndë e të mërzitshëm me qëllim që të ruante pozitën e tij në shikimin e tyre.

Falënderime të pafundme qofshin për Zotin xh.sh., ne nuk kemi nevojë për artificializma të ftohta si ato.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë ju përgëzoj me të gjithë shpirtin, zemrën dhe mendjen time për "Dhjetë netët"; dhe i lutem me përgjërim mëshirës së gjërë Hyjnore dhe shpresoj prej saj që ato të sjellin fitime të mëdha për "pjesëmarrjen tonë shpirtërore".

Mbrëmë unë pashë në ëndërr sikur kisha ardhur tek ju dhe u zgjova sapo isha gati të drejtoja faljen si imam. Kur- sipas eksperiencës sime- ëndrra do të interpretohej, dy nga vëllezërit e mi prej heronjve të fshatit Sava dhe Homa[197], erdhën duke interpretuar ëndrrën në emrin e ju të gjithëve.

Vëllezërit e mi!

Pavarësisht se kjo situatë -burgu- ka shkaktuar njëfarë frike e një parandjenjë të keqe kundrejt Risale-i Nurit tek përkrahësit -e qeverisë-

[197] Homa: një fshat afër Barlas. Përkthyesi

dhe tek disa zyrtarë duke u tërhequr prej tij, veçse ama ajo ka shkaktuar tek të gjithë kundërshtarët, tek njerëzit e fesë dhe tek nëpunësit e lidhur me biznes një interesim dhe një përmallim ndaj tij.

Mos u shqetësoni, o vëllezërit e mi! Këto drita do të shndërrisin.[198] Sipas interpretimit të Sabriut, në përputhje me aluzionin e Sures *Vel-Asr*, Risale-i Nuri është mjet për të ruajtur Anadollin, Ispartan dhe Katamonun, prej fatkeqësive qiellore e tokësore, ashtu si anija -e Nuhut a.s.- në malin *Xhudi*; prandaj ata nuk duhet të ndërhyjnë tek ai, ose fatkeqësitë e parashikuara do të binin menjëherë mbi ta. Ata duhet të vijnë në vete. Unë ua them përsëri çfarë u thashë pak para katastrofës, dhe para se ato letra qenë dërguar tek ju. Sipas njoftimeve që kam marrë tani, Kastamonuja, rrethinat e saj dhe kështjella po qajnë sikur të mbanin zi për Risale-i Nurin; Ato i kanë kapur ethet dhe po lëkunden me tërmete; Në dashtë Zoti xh.sh. ajo do të ribashkohet me Risale-i Nurin, dhe do të qeshë përsëri dhe do të bëjë falënderime.

Unë u shkrova ju në ditën tjetër rreth dy fitimeve të mia të rëndësishme. Në të dytin unë thashë, duke bërë lutje e lavdërime me qindra gjuhë... deri në fund.

Diçka mungon këtu, ajo duhet të jetë: Secili prej nesh, sipas shkallës së tij, ofron... me qindra gjuhë... dhe kështu me rradhë.

Gjithashtu, një burrë i vjetër i nderuar prej fshatit të Savas, me të cilën jam shumë i lidhur, ishte kapur pas meje dhe ne erdhëm bashkë; kjo më kënaqi shumë dhe kuptova prej një veprimi të tillë lidhjen e fortë të fshatit me mua. Unë i çoj përshëndetje të veçanta atij vëllai.

• • •

Vëllai im i dashur!

Vërseti, *"Dhe atje mosbesimtarët humbën plotësisht (kur i mbuloi ndëshkimi ynë)",* [199] tregon aluzionin e *"(Betohem) për kohën (nëpër shekuj)! Me të vërtetë që njeriu është në humbje të plotë"*[200] se të gjitha luftërat dhe shkatërrimi i mosbesimtarëve kanë shkaktuar dëme dhe humbje të padëgjuara. Gjithashtu ndodhet një tregues në frazën *"Wel-*

---

[198] Vëre, o Vëlla! Në burgun e Denizlit, kur gjithçka në dukje ishte kundra tij, dhe madje prokuroria kërkonte ekzekutimin e tij, Ustadhi thonte: Mos u shqetësoni, o vëllezërit e mi, këto "Drita do të shndërrisin". Shikoni se si këto fjalë u bënë realitet.

Nënshkruan studentët e tij.

[199] Kur'an, 40:85

[200] Kur'an, 103:1-2

A'sr" (*Betohem) për kohën*!, e cila tregon datën 1360 sipas kalendarit Hixhri, në të cilën hipokritët dhe mosbesimtarët do të sulmonin Risale-i Nurin, por ata do të ishin humbësit. Sepse Risale-i Nuri është një shkak që fatkeqësitë si tërmeti dhe lufta të prapësohen e të zbuten. Kjo mund të jetë një shenjë e mbuluar se ndërprerja e tij nga aktiviteti tërheq fatkeqësi.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur!

Unë supozoj se trajtesa e vogël të cilën e prodhoi Burgu i "Denizlit" do të jetë mbrojtja jonë e vërtetë dhe e fundit, sepse komplotet e mëdhaja të kurdisura kundra nesh qysh prej një viti dhe që buronin nga dyshime të pabaza, ishin sa vijon:

Ata na sulmuan ne me pretekste të pabaza të tilla, si: puna për të themeluar një tarikat Sufi, ata janë një shoqëri e fshehtë... janë një mjet për forcat e jashtme... shfrytëzojnë ndjenjat fetare për qëllime politike... orvaten për të shkatërruar republikën, ngatërrohen në qeveri dhe prishin rendin dhe qetësinë publike... por lavdi Zotit të Gjithëfuqishëm planet e tyre dështuan. Përveç të vërtetave të besimit dhe të Kur'anit, studimit rreth Ahiretit dhe punës për lumturinë e përjetshme, ata nuk gjetën asgjë në këtë fushë të gjërë midis qindra studentëve dhe qindra trajtesave, letrave e librave të shkruara gjatë një periudhe tetëmbëdhjetë vjeçare. Prandaj ata filluan të kërkojnë ndonjë pretekst të kotë, nëpërmjet të cilit, të mbulojnë komplotet e tyre.

Por përballë mundësisë së ndonjë sulmi kundra nesh, duke mashtruar disa drejtues të qeverisë duke i kthyer ata kundra nesh të nxitur nga një organizatë ateiste e tmerrshme e fshehtë e cila punon aktualisht në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rrugën dhe në emrin e mosbesimit absolut, trajtesa "Frutat e besimit" e cila është aq e qartë si dielli dhe i largon të gjitha dyshimet dhe është aq e qëndrueshme dhe e palëkundur si një mal, do të jetë mbrojtja më e fuqishme për ne kundra tyre, dhe në dashtë Zoti xh.sh., do t'i heshtë ata.

Unë mendoj se ne u bëmë ta shkruanim këtë trajtesë për hir të kësaj.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi!

Pavarësisht se vendi i juaj është shumë i ngushtë, por ama zemrat tuaja janë më të gjëra se sa ajo ngushtësi; dhe gjithashtu ju keni liri më shumë se sa kemi ne.

Dijeni, o vëllezërit e mi!

Baza jonë më e rëndësishme për fuqinë tonë dhe pika jonë e mbështetjes është Solidariteti. Kujdes! Ruhuni! Mos e lejoni pezmatueshmërinë e shkaktuar nga këto vuajtje e mundime që t'ju bëjë të gjeni gabime e të meta tek njëri-tjetri. Ankesa është si të kundërshtoje Kaderin Hyjnor. Prandaj asnjëri prej jush të mos thotë: Po të mos kishte qenë kështu e ashtu, nuk do të kishte ndodhur kështu; As mos e përgojoni njëri-tjetrin. Unë kam mësuar e kuptuar se nuk kishte shpëtim apo marifet për ne që t'i shmangnim sulmet e këtyre. Ata do të na sulmonin çfarëdo që të kishim bërë.

Ne nuk kemi gjë tjetër veçse t'u përgjigjemi atyre me durim, me dhënie falënderimesh, me kënaqësi ndaj Kaderit Hyjnor dhe nështrim ndaj caktimit të Tij derisa të na vijë në ndihmë Përkudesja Hyjnore.

Na duhet të përpiqemi që të fitojmë shpërblim të madh dhe merita të shumta në një kohë të pakët dhe me punë të pakët.

Unë bëj dua të sinqerta për mirëqënien e vëllezërve tonë atje.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një ngushëllim i madh përballë ndryshimeve të shpejta të jetës së kësaj bote, të zhdukjes dhe tatëpjetës së saj, largimit të kënaqësive të saj të pafrytshme e kalimtare, dhe përballë goditjeve që i bien njeriut prej ndarjeve, është takimi me shokë të vërtetë.

Po, ndonjëherë njeriu përshkon një distancë që merr njëzet ditë dhe shpenzon njëqind lira për hir të takimit me vëllain e tij për një ose për dy orë.

Atëherë, në këtë kohë të çuditshme në të cilën shumë rrallë mund të gjendet ndonjë shok i sinqertë, takimi ynë me dyzet-pesëdhjetë shokë së bashku për një ose dy muaj dhe bisedimi ynë së bashku për hir të Zotit xh.sh. dhe duke marrë e duke dhënë ngushëllim të vërtetë, i bën këto vështirësi dhe këto humbje financiare, që na kanë rënë, jashtë mase të lira dhe të parëndësishme. Unë vetë do ta kisha pranuar këtë

mundim vetëm për të takuar njërin nga vëllezërit e mi këtu pasi kam qenë ndarë prej tyre qysh prej dhjetë viteve.

Dijeni se shfaqja e ankesave është kundërshtim ndaj Kaderit Hyjnor, ndërsa falënderimet janë nënshtrim ndaj tij.

Unë ju siguroj ju, o vëllezërit e mi, se në qoftë se do të vinte tani exheli dhe të vdisja, do ta prisja atë me rehati të zemrës e me qetësi; sepse unë kam bindje të plotë se midis jush ka shumë Saida të fortë, të qëndrueshëm e të rinj, të cilët do ta marrin përsipër misionin (e Risale-i Nurit), do ta ruajnë atë, do ta mbrojnë dhe do ta trashëgojnë atë shumë më mirë se sa ky Said i dobët, i moshuar, i pafuqishëm dhe i sëmurë. Unë u ndjeva shumë mirënjohës dhe i lumtur për ata, emrat e të cilëve janë shkruar në bllokun e Nazifit, të cilët në mënyrë të efektshme forcojnë moralet. Sidoqoftë, unë i pata supozuar se ata do të ishin kështu. Zoti u dhëntë sukses atyre dhe i bëftë shembuj të mirë për të tjerët. Amin.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Meqenëse ju e keni lidhur veten tuaj me Risale-i Nurin për të fituar shpërblimin e Ahiretit dhe për të përmbushur një lloj ibadeti, nuk ka dyshim se çdo orë prej orëve tuaja -nën këto kushte e rrethana të vështira- bëhen si ibadeti i njëzet orëve. Dhe njëzet orë punë në shërbim të Kur'anit dhe Imanit -meqenëse në to ka *xhihad maënevij*- fitojnë vlerën e njëqind orëve. Dhe ato njëqind orë që kalojnë duke takuar vëllezër të mirë, të cilët janë muxhahidë të vërtetë, secili prej tyre ka rëndësinë e njëqind njerëzve, dhe mbajtja e lidhjeve vëllazërore me ta, duke i mbështetur ata -me forcë shpirtërore- dhe duke marrë ndihmë prej tyre, duke i ngushëlluar ata dhe duke marrë ngushëllim prej tyre, vazhdimësia me ta në këtë shërbim të shenjtë ndaj imanit me solidaritet të vërtetë dhe me qëndrueshmëri të plotë, dhe duke përfituar prej cilësive të tyre të larta dhe duke fituar vlerën dhe kualifikimin e studentit në medresetu *el-zehra* hyrjen në këtë vend provimi, në këtë shkollë të Jusufit, dhe secili mori pjesën e caktuar për të nga Kaderi Hyjnor, dhe hëngri ushqimin e caktuar për të në këtë vend, duke fituar *sevab* -shpërblim... Është e domosdoshme të bëni falënderime për të ardhmen tuaj këtu, të zbukuroheni me durim dhe t'i përballoni të gjitha vuajtjet e mundimet duke menduar për të gjitha dobitë e lartëpërmendura.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi!

Unë sinqerisht shpresoj se heronj të vendosur e të fortë si çeliku si ata të Ispartës dhe të rrethinave të saj (si shembulli i Husrevit dhe i Hafiz Aliut), do të shfaqen edhe këtu në Kastamonu. Lavdërime të pafundme qofshin për Zotin që ajo provincë i përmbushi shpresat e mia, duke dërguar heronj të shumtë për të na ndihmuar. U dërgoj përshëndetjet e mia të gjithë vëllezërve, të cilët janë me ju, dhe të cilët janë gjithmonë të pranishëm në imagjinatën time por emrat e të cilëve unë nuk mund t'i shkruaj, dhe unë lutem për mirëqënien e tyre.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur, besnikë, të qëndrueshëm e të sinqertë!

Unë po ju përshkruaj njërën nga rrethanat e mia këtu, jo që t'ju dëshpëroj ju dhe as që të përpiqemi të merrni ndonjë masë fizike të domosdoshme, por që të përfitoj nga shumimi i duave tuaja sipas rregullit të bashkimit të përpjekjeve të përbashkëta, dhe me qëllim që ju të shtoni vetëpërmbajtjen, kujdesin dhe të visheni me durim, me rezistencë dhe të mbroni me zell solidaritetin tuaj të ngushtë.

Tortura dhe mundimi që unë vuaj këtu në një ditë janë më të mëdha se sa kam vuajtur për një muaj në Burgun Eskishehir. Masonët e tmerrshëm kanë bërë që të më sundojë një mason zullumqar me qëllim që të gjejnë ndonjë pretekst në fjalën time: "mjafton më me kaq", e cila buron nga indinjata ime e thellë dhe nga zemërimi i madh ndaj torturave që më japin; ata duan ta shfrytëzojnë këtë fjalë dhe ta bëjnë si arsye për agresionin e tyre mizor, dhe kështu nën të mbulojnë gënjeshtrat e tyre. Si një shenjë e mrekullueshme e përkujdesjes Hyjnore, unë vetëm jap falënderime me durim dhe jam i vendosur të vazhdoj duke duruar e duke dhënë falënderime.

Përderisa ne i jemi nënshtruar Kaderit Hyjnor, dhe ne e dimë se këto vështirësi konsiderohen si një mjet për të fituar shpërblim më të madh në përputhje me kuptimin e rregullit, "*Më të mirat e punëve janë ato më të vështirat*", prandaj, ne i konsiderojmë ato -nga ky këndvështrim- si një mirësi shpirtërore.

Pastaj vështirësitë kalimtare të kësaj dynjaje, në të shumtat e rasteve përfundojnë në gëzime e mirësi. Dhe ne jemi plotësisht të bindur me shkallën e "sigurisë absolute" se ne ia kemi dedikuar jetët tona një të vërteteje madhështore më të ndritshme se sa dielli, një të vërtete të bukur si bukuria e parajsës, dhe të ëmbël e të kënaqshme si

kënaqësia e lumturisë së përjetshme. Prandaj, nuk duhet të dalë kurrë ankesa prej nesh, por këto rrethana të vështira duhet të na shtyjnë që ne të themi: Ne jemi në një xhihad maënevij -xhihadin e fjalës- me të cilin krenohemi, dhe falënderojmë Allahun që na favorizoi me të.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur!

Këshilla ime e parë dhe e fundit për ju është që ju të ruani solidaritetin; të shmangni egoizmin, arrogancën dhe rivalitetin, të ruani vetëpërmbajtjen dhe të jeni të kujdesshëm.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Është e kuptueshme nga akuza e prokurorit të përgjithshëm se planet e ateistëve të fshehur, të cilët mashtruan disa prej drejtuesve të qeverisë duke i shtyrë ata të lëvizin kundra nesh, janë asgjësuar dhe kanë dalë të rreme.

Tani ata po përpiqen të fshehin gënjeshtrat e tyre duke na akuzuar se po formojmë një shoqëri politike dhe një grup revolucionar sekret, dhe si rezultat i kësaj, ata nuk më lejojnë të kem kontakt me asnjë, sikur të gjithë ata që kanë kontakt me ne, na bashkohen, gjithashtu edhe zyrtarët e lartë janë të kujdesur për të na shmangur, dhe ata përpiqen të shihen me sy të mirë nga eprorët e tyre duke na bezdisur e duke na rënë në qafë. Unë do t'i shtoja pjesën e poshtme fundit të kundërshtimeve të mia, por pata një ide që nuk më lejoi. Pjesa ishte kjo:

Po, ne jemi një shoqëri dhe ne jemi një shoqëri që në çdo shekull ka pasë treqind e pesëdhjetë milion anëtarë[201]. Në çdo ditë nëpërmjet pesë namazeve të detyruara anëtarët e saj demonstrojnë me nderim të plotë lidhjen e tyre me parimet e asaj shoqërie të shenjtë. Nëpërmjet programit të shenjtë *"Padyshim që besimtarët janë vëllezër"*,[202] ata nxitojnë për të ndihmuar njëri-tjetrin me lutjet e tyre dhe me fitimet e tyre të shumta shpirtërore.

---

[201] Tani afërsisht një miliardë e gjysëm. Përkthyesi.
[202] Kur'an, 49:10

Dhe kështu, ne jemi anëtarët e asaj shoqërie të shenjtë e të madhe, dhe detyra jonë e veçantë është që t'u mësojmë besimtarëve në një mënyrë të sigurtë e të verifikuar të vërtetat e besimit dhe t'i shpëtojmë ata dhe vetet tona prej asgjësimit të përjetshëm dhe prej burgosjes së përhershme e të vetmuar në Botën e ndërmjetme. Ne nuk kemi asnjë lidhje me ndonjë shoqëri të kësaj bote, politike, intriguese dhe as me ndonjë grup klandestin dhe as me ndonjë shoqëri sekrete të pakuptim e të pabazë lidhur me të cilat ne jemi akuzuar; ne nuk e ulim veten në gjëra të tilla.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Sot para agimit unë ndjeva një keqardhje të madhe për të gjithë ju. Atëherë, mua m'u kujtua "Trajtesa për të sëmurit", dhe ajo më ngushëlloi.

Po, kjo fatkeqësi është si një lloj sëmundje sociale. Shumica e ilaçeve të lidhura me besimin që janë përmendur në atë trajtesë e bëjnë punën e tyre edhe në këtë sëmundje gjithashtu. Ashtu siç i thashë atij të sëmuri të bekuar në ErZurum, dhimbja e të gjitha mundimeve ka kaluar; ajo çfarë ka mbetur prej saj janë mirësitë e saj, dobitë e saj që shohin tek kjo botë, tek Ahireti, tek besimi dhe tek Kur'ani. Kjo do të thotë se ajo fatkeqësi e vetme kalimtare është transformuar në mirësi të shumta të përhershme. Sa për të ardhmen, meqenëse ajo është mosekzistuese tani, fatkeqësitë që do të vazhdojnë në atë kohë nuk japin dhimbje tani. Të shkaktosh dhimbje nga mosekzistenca nëpërmjet iluzioneve -mashtrimeve- do të ishte mungesë besimi në mëshirën e Allahut dhe në Kaderin e Tij xh.sh..

Së Dyti: Shumica e njerëzimit në tokë tani janë sprovuar e goditur me fatkeqësi, fizike e jofizike, dhe në zemrat, shpirtërat dhe në mendjet e tyre.

Fatkeqësia jonë e krahasuar me të tyren është shumë e lehtë, rehatuese dhe e dobishme. Ajo shkakton fitime e dobi materiale e shpirtërore për zemrën, shpirtin, imanin, shëndetin dhe për mirëqënien.

Së Treti: Në qoftë se nuk do të kishim hyrë në burg këtu në mes të këtyre stuhive, kjo fatkeqësi e lehtë do të ishte shumë e rëndë për shkak të kontakteve tona me zyrtarët dyshues, dhe do të na zbriste ne fatkeqësia e sjelljes me artificializëm e me lajkatime ndaj tyre.

Së Katërti: Duke i parë me pak shpenzime miq të vërtetë, më të mëshirshëm se sa vëllezërit -dhe duke takuar vëllezër të Ahiretit, të

cilët janë si udhëzues e këshillues, këtu në këtë dimër të dyfishtë fizik e shpirtëror, në të cilin janë ndërprerë punët, dhe në këtë shkollë të Jusufit e cila është një departament i Medresetu Ez-Zehra; dhe duke i vizituar ata, dhe duke përfituar prej cilësive të tyre personale, dhe duke marrë forcë prej veçorive të tyre të larta e të bukura, të cilët janë si drita që përhapet nëpër objekte transparente, dhe duke marrë ndihmë prej ndihmës së tyre shpirtërore, prej gëzimeve dhe prej ngushëllimeve të tyre; që të gjitha këto e ndryshojnë formën e kësaj fatkeqësie, duke e transformuar atë në një lloj skene të Përkujdesjes Hyjnore.

Një faqe e hollë e kësaj përkujdesje të fshehur është se të gjithë studentët e Risale-i Nurit këtu thirren Hoxhallarë. Ti i sheh se gjuhët e të gjithëve i përmendin ata me respekt e nderim me fjalën hoxhallarë... hoxhallarë...

Ndodhet një aluzion tjetër në këtë, ashtu siç është transformuar ky burg në një medrese -shkollë fetare-, po ashtu studentët e Risale-i Nurit që të gjithë do të bëhen mësues, dhe në dashtë Zoti xh.sh. në sajë të këtyre hoxhallarëve, edhe burgjet e tjerë do të bëhen shkolla gjithashtu.

• • •

Vëllezërit e mi!

Në qoftë se do të lexoheshin këto letra të vogëla ngushëlluese, si kjo, dhe të studioheshin bashkë me trajtesën "Frutat e besimit" sidomos me pjesët e fundit të saj, dhe nëse vëllezërit do ta diskutonin në formë reflektive midis tyre ndonjë çështje që ju vjen ndërmend prej Risale-i Nurit, njeriu do të fitonte -në dashtë Zoti- nderin e të qënurit "student i shkencave fetare".

Figura të shquara si Imam Shafiiu, Zoti qoftë i kënaqur me të, i dha rëndësinë më të madhe kësaj, duke thënë: "Madje edhe gjumi i studentëve të shkencave të sheriatit konsiderohet si adhurim".

Në qoftë se në këtë kohë që nuk ka shkolla fetare, sikur të vuheshin njëqind mijë mundime në këto vende torture për shkak të qënies studentë të tillë të lartësuar, as një rëndësi nuk duhet t'u jepet atyre mundimeve. Përkundrazi ne duhet të buzëqeshim me gëzim e kënaqësi në fytyrën e atyre vështirësive duke thënë: *"Më të mirat e punëve, janë ato më të vështirat*". Sa për shpenzimet për jetesë të familjeve të vëllezërve tanë të varfër, meqenëse shikimi në fatkeqësi duhet të drejtohet tek ajo fatkeqësi e cila është më e madhe se sa ajo e tyre, ndërsa në mirësi duhet të drejtohet tek mirësia më e pakët, tek ata që

janë më shumë të privuar, dhe kjo në bazë të një Rregulli të Kur'anit, të imanit dhe të Risale-i Nurit; atëherë ata janë rehat dhe më mirë se sa tetëdhjetë përqind e njerëzve.

Prandaj ata nuk kanë të drejtë të ankohen; përkundrazi e drejta e tyre është të japin tetëdhjetë shkallë falënderimesh, falënderim mbi falënderim.

Pastaj Kaderi Hyjnor caktoi që ne ta takojmë fatin tonë këtu dhe të hamë rizkun -ushqimin- e caktuar për ne. Drejtësia e Mëshirës Hyjnore na ka grumbulluar së bashku këtu; familjet janë lënë në amanet tek Furnizuesi i tyre i vërtetë, duke i çliruar ata vëllezër përkohësisht nga detyrimi i mbikqyrjes për ushqimet e tyre, ashtu siç do t'i çlirojë një ditë krejtësisht prej tyre dhe do t'i shkarkojë... Meqenëse realiteti është ky, ne duhet të themi: *"Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve",*[203] duke ia dorëzuar çështjen tonë Atij dhe duke bërë falënderime të shumta.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë jam me fat dhe falënderoj Zotin që gjendem pranë jush në të njëjtën ndërtesë (të burgut) pavarësisht se nuk mund t'ju takoj. Ndonjëherë, në mënyrë të pavullnetshme më vjen në zemër se duhet të merren disa masa të domosdoshme.

Për shembull, një i burgosur u dërgua tek krahu i burgut pranë meje nga Masonët, i cili ishte edhe gënjeshtar edhe spiun. Meqenëse shkatërrimi është i lehtë, sidomos midis të rinjve dembelë si ata, unë mësova nga bezdisjet e mëdha të atij maskarai të poshtër dhe nga korruptimi që ai u bënte të rinjve, se ateistët përpiqen të përhapin korrupsionin dhe të prishin moralet përballë udhëzimit dhe reformimit tuaj ndaj tyre.

O vëllezërit e mi! Në këtë situatë është e domosdoshme -madje është tepër esenciale dhe e domosdoshme- të bëhet kujdes i madh, dhe sa të jetë e mundur të mos ofendoheni nga të burgosurit e vjetër dhe as t'i ofendoni ata, dhe të mos lejoni grindje e mosmarrëveshje, dhe duhet të ruani gjakftohtësinë, të vetëpërmbaheni dhe të zbukuroheni me durim.

Gjithashtu, o vëllezërit tonë, me sa të jetë e mundur është e domosdoshme të ruani forcën e solidaritetit dhe të vëllazërisë

[203] Kur'an, 3:173

nëpërmjet shfaqjes së sakrificës, braktisjes së egoizmit dhe nëpërmjet modestisë.

Prokopia me çështjet e dynjasë më pikëllon, prandaj unë kam besim në mendjemprehtësinë tuaj, pasi nuk mund t'i marr në konsideratë pa qenë nevoja.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi!

Kundra çdo mundësie, unë duhet të shpjegoj një çështje që m'u shfaq në këtë mëngjes. Duke bërë pyetjen: "Jam kureshtar të di se çfarë mund të thonë filozofët ateistë për këtë, dhe me çfarë mund ta mbështesin ata vetveten?", sepse qysh prej njëzet viteve nefsi im dhe shejtani im kanë hetuar nëse të vërtetat që ne kemi marrë nga Kur'ani nuk lënë ndonjë vend për dyshim apo ngurrim, ato të vërteta të cilat janë aq të qarta si dielli ose si dita. Meqenëse nefsi im dhe shejtani nuk gjetën asnjë gabim apo mangësi në asnjë qosh apo skutë, ata të dy heshtën. Unë mendoj se e vërteta e cila, heshti nefsin dhe shejtanin tim që janë shumë të ndjeshëm dhe që punojnë bashkë, është e aftë dhe në gjendje që t'i heshtë edhe më kryeneçët dhe të pabindurit e njerëzve.

Meqenëse ne punojmë për hir dhe në rrugën e një të vërteteje e cila është më e madhja dhe më e rëndësishmja e të vërtetave, më e qëndrueshmja dhe më e palëkundshmja, dhe e cila nuk mund të çmohet apo të vlerësohet me asnjë vlerë materiale, çfarëdo qoftë ajo; dhe në qoftë se do të jepeshin nefsi, shpirti, shoku, i dashuri dhe madje e gjithë bota si çmim për të, kjo përsëri do të ishte e lirë; atëherë ne sigurisht që duhet t'u përgjigjemi me qëndrueshmëri të plotë të gjitha mjerimeve dhe vuajtjeve që na bien, dhe t'i përballojmë me durim të gjitha mundimet e armiqve. Ka shumë gjasa që ata të lëvizin kundra nesh një numër prej hoxhallarëve të mashtruar ose prej Shehëve të cilët në dukje shfaqen si njerëz të devotshëm...

Përballë një pozicioni si ky, është e domosdoshme që ne të ruajmë Unitetin dhe solidaritetin tonë, dhe të mos humbasim kohën me ta në debate e diskutime bosh.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

M'u shfaq në këtë mëngjes para agimit se arsyeja e vërtetë për këtë sulm të gjërë e agresiv kundra nesh nuk është "Rrezja e Pestë", por *"Hizb en-Nuri*" dhe "*Çelësi i besimit*" si dhe "*Huxhxhetul Ba'ligah" (Prova elokuente).*

Unë lexova një pjesë prej "*Hizb En-Nurit*" me vëmendje dhe shqyrtova "*Çelësin e besimit*" dhe kuptova se ateistët nuk mundnin ta mbronin rrugën e tyre të mosbesimit absolut përballë goditjeve të këtyre dy shpatave të mprehta prej diamanti, por e shfaqën "Rrezen e Pestë" si shkak të jashtëm, dhe atë e bënë për arsye të lidhjes së saj të pjesshme me politikën. Kështu ata e mashtruan me të qeverinë duke e nxitur kundra nesh.

Në të njëjtën kohë m'u shfaq se në qoftë se ndonjëri prej vëllezërve tonë të dobët do ta braktiste punën përkohësisht, ndoshta ai do të mund të shpëtonte nga kjo fatkeqësi", dhe unë doja t'u jepja leje për këtë. Por papritmas m'u shfaq mua në zemër: Ai që lidhjet e të cilit me të kanë vazhduar deri në këtë masë, që ka hyrë në këtë provim dy herë, dhe i cili ka vuajtur kaq shumë mundime për hir të tij dhe është dëmtuar shumë, nuk i lejohet ta braktisë në një mënyrë të përzemërt, mënyrë që do të ishte edhe e dëmshme, edhe e padobi, por ai do të mund ta bënte atë thjesht për t'i mashtruar ata, vetëm duke shfaqur një shmangie prej tij në pamje të jashtme. Përndryshe kjo do t'i shkaktonte dëm edhe vetes së tij, edhe neve, edhe rrugës sonë të shenjtë, dhe si një dënim për atë që bëri, personi do të merrte goditje në kundërshtim me qëllimet e tij.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ai i cili vuan torturat dhe mundimet e këtij burgu, i cili është më i ftohtë dhe më i ngushtë se sa vendet e tjerë, nuk ka dyshim se ai ka dëshirë të ikë prej asaj që e shkaktoi këtë burgosje dhe futjen e tij në të, secili sipas shkallës së tij. Por shkaku i tij i jashtëm që është "Risale-i Nuri" që i bën të fitojnë ata, të cilët vuajnë mundime, *imanin tahkiki* -besimin e sigurtë e të verifikuar- dhe vdekje të lumtur -fund të mirë- dhe shpërblim të bollshëm prej veprave të mira të qindra punjonjësve që burojnë nga pjesëmarrja shpirtërore, unë them: këto dobi i transformojnë ato vuajtje të hidhura në mëshira të ëmbëla e të kënaqshme, prandaj çmimi i këtyre dy rezultateve është: Besnikëria e palëkundur dhe qëndrueshmëria e plotë. Prandaj, të jesh i penduar dhe ta braktisësh atë, do të ishin dy humbje të mëdhaja. Ky burg është më i mirë për ata studentë të cilët nuk kanë lidhje me dynjanë, ose që kanë

shumë pak lidhje; madje kjo burgosje është më e preferueshme për lirinë, dhe nga një aspekt është një vend lirie. Ndërsa meqenëse për ata të cilët janë të lidhur me dynjanë dhe janë në gjendje të mirë e të pasur, paratë e shpenzuara bëhen sadeka të shumëfishuara për ta, dhe orët e shpenzuara -kalimtare- të jetës transformohen në ibadete të shumëfishuara për ta, prandaj duhet që ata të bëjnë falënderime në vend të ankesave.

Sa për grupin e fukarenjve dhe të të dobëtive të mjerë, meqenëse ata nuk fitonin shpërblim -thevab- të madh jashtë burgut, por ngarkoheshin me përgjegjësi të rënda, atëherë ky burg që i bën ata të fitojnë mirësi të shumta dhe shpërblime të mëdha, dhe duke mos mbajtur mbi shpatullat e tyre asnjë lloj përgjegjësie, dhe mundimet që lehtësohen nëpërmjet ngushëllimit midis vëllezërve... kjo kërkon që ata të japin falënderime.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një person i devotshëm në Kastamonu më tha duke u ankuar: Unë kam rënë; unë e kam humbur gjendjen time shpirtërore të mëparshme, dhe kam humbur dritat dhe ndriçimet". Unë i thashë: Përkundrazi, ti ke përparuar dhe je lartësuar mbi ndriçimet dhe zbuluesat të cilat lajkatojnë egon, japin një shije të frutave të Ahiretit ndërsa akoma je në këtë botë, dhe nxisin egocentrizmin. Duke braktisur egoizmin dhe duke mos kërkuar kënaqësitë kalimtare dhe nëpërmjet vetëmohimit, ti ndoshta ke fluturuar në një stacion më të lartë e më sublim.

Po, një mirësi Hyjnore e rëndësishme është mosbërja e personit, i cili ka braktisur egoizmin e tij, ta perceptojë mirësinë me qëllim që ai të mos bëhet krenar e mendjemadh.

O Vëllezërit e mi! Si rrjedhojë e kësaj të vërtete, ata që mendojnë në mënyrë të ngjashme me atë person ose interesohen për stacione të ndritshme të cilat i japin mendimet e mira të të tjerëve, kur hedhin vështrimin tek ju, dhe midis jush shohin studentë të cilët shfaqen në veshjen e modestisë, të vetëmohimit dhe që janë vënë në shërbim të njerëzve, ju përfytyrojnë ju prej njerëzve të rëndomtë ose të zakonshëm, dhe thonë: A këta janë heronjtë e realitetit dhe burrat e tij? Ose a këta do ta sfidojnë të gjithë dynjanë? Ah, medet! Ku janë këta me ata muxhahidë në rrugën e këtij shërbimi të shenjtë, dhe të cilët kanë parakaluar Evlijatë e drejtë në këtë kohë, të cilët janë të pafuqishëm para tyre?"

Në qoftë se ata janë shokë përjetojnë zhgënjim, dhe në qoftë se janë kundërshtarë e gjejnë kundërshtimin e tyre të justifikuar.

Said Nursi

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Në shikimin tim frutat[204] e burgut tuaj janë aq të ëmbëla e të rëndësishme ashtu si frutat e Firdeusit -Parajsës. Ato realizuan shpresat e mëdha që kisha për ju dhe konfirmuan pretendimet e mia; gjithashtu demostruan për bukuri fuqinë e mbështetjes së ndërsjellë dhe solidaritetin.

Ato pena të bekuara kur bashkohen, shfaqin vlerën treqind ose të katërqind penave nën këto kushte e presione, si bashkimi i tre ose i katër elifave[205] (që janë përmendur në trajtesën e sinqeritetit). Një gjendje shpirtërore e cila e ruan unitetin tuaj në këto kushte të ngatërruara provon atë çfarë thashë unë dje.

Po,- nuk ka gabim në krahasim -ashtu si një Evlija- i madh që nuk mund të ngjitet në stacionin e një sahabeje të vogël lidhur me shërbimin për islamin ashtu siç kanë mendim unanim për këtë *Ehli Es-sunneh* -Sunitët-, po ashtu një vëlla i sinqertë prej vëllezërve tonë i cili ka braktisur shanset e nefsit -kënaqësitë e nefsit- të tij në këtë kohë dhe punon në shërbim të imanit dhe përpiqet në rrugën e vetëmohimit, dhe bën aq sa mundet për të ruajtur solidaritetin dhe unitetin, këtij vëllai i jepet një pozitë më e lartë se ajo e një shenjtori -Evlijai.

Dhe kështu u binda dhe ju me rolin tuaj e mbështesni këtë bindjen time, Zoti qoftë përjetësisht i kënaqur me ju. Amin!

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Trajtesa “Frutat e besimit” ka një rëndësi shumë të madhe dhe një vlerë shumë të lartë. Shpresoj që Allahu të hapë me të zemrat e shumë njerëzve në ndonjë kohë.

Duket se ju e keni kuptuar plotësisht vlerën e saj, sepse ju nuk e keni lënë këtë vend studimi, këtë shkollë të Jusufit, pa mësim.

---

[204] Domethënë, trajtesat që ata kishin shkruar, veçanërisht “Fruatat e besimit”.

[205] Elif: Shkronja e parë e alfabetit arab, e shkruar si një vizë vertikale dhe vlera numerike e së cilës është një. Përkthyesi

Unë them atë që i referohet nefsit tim: Në qoftë se fruti i të gjithë këtij shqetësimi dhe shpenzimi do të ishte vetëm kjo trajtesë dhe trajtesa e "Mbrojtjes", si dhe qënia me ju në të njëjtin vend, ai i zvogëlon në asgjë shpenzimin dhe shqetësimin; madje edhe në qoftë se do ta vuanim dhjetë herë më shumë këtë fatkeqësi, ajo përsëri do të ishte e lirë –jo e shtrenjtë- në rrugën e këtyre çështjeve.

Unë kam formuar bindje të plotë si rezultat i eksperiencave të mia të shumta dhe sidomos në këtë burg të ngushtë: Të preokupuarit me Risale-i Nurin, si duke e lexuar atë po ashtu edhe duke e shkruar, e lehtëson shumë vuajtjen dhe shqetësimin si dhe shkakton gëzim dhe një ndenjë ngrohtësie. Ndërsa në kohën që unë nuk preokupohem me të, ajo fatkeqësi dyfyshohet, dhe më pikëllojnë mua gjëra të parëndësishme. Duke u mbështetur mbi disa arsye, unë mendoja se Husrevi, Hafiz Aliu dhe Tahiri ishin në një vuajtje të madhe, por pashë se ata dhe ata të cilët ishin me ta ishin më të qëndrueshëm dhe më të dorëzuar ndaj Urdhrit të Allahut, dhe gjenin rehatinë dhe qetësinë e zemrës.

Unë thoja: Dua të di, cili është shkaku? Tani e kam kuptuar se ata janë duke kryer detyrat e tyre të natyrshme, dhe nuk preokupohen me gjëra që nuk u interesojnë, dhe as nuk ndërhyjnë në çështjen e Kaderit dhe të vendimit Hyjnor.

Ata as nuk shqetësohen, as nuk tronditen, as nuk kritikojnë askënd, gjë që buron nga egoizmi dhe nga synimi i interesit vetjak. Janë zbardhur fytyrat e studentëve të Risale-i Nurit me qëndrueshmërinë dhe qetësinë e zemrave të tyre si dhe kanë shfaqur forcën shpirtërore të Risale-i Nurit përballë ateizmit.

I lutemi Allahut që t'i bëjë dinjitetin e vërtetë dhe heroizmin, brenda përulësisë së tyre të plotë dhe brenda vetëmohimit, të shpërndahen tek të gjithë vëllezërit tanë. Amin.

• • •

Vëllezërit e mi!

Një egoizëm i tmerrshëm që buron nga pakujdesia dhe nga dashuria për këtë botë, po sundon në këtë kohë. Prandaj njerëzit e realitetit duhet të braktisin egoizmin dhe mendjemadhësinë, edhe në qoftë se ato do të ishin në një formë të lejuar. Meqenëse studentët e vërtetë të Risale-i Nurit e kanë shkrirë egoizmin e tyre, i cili i ngjason një blloku akulli, në personalitetin kolektiv dhe në pellgun e

përbashkët të xhematit, ata në dashtë Zoti xh.sh., nuk do të lëkunden nga këto stuhi e shtrëngata.

Po, një plan i rëndësishëm dhe i mirëprovuar i hipokritëve është, që t'i grumbullojnë bashkë njerëzit të cilët që të gjithë janë si oficerë dhe si gjykatës, lidhur me ndonjë çështje të vetme dhe në një vend të ngushtë me qëllim që t'i bëjnë ata të qëndrojnë të fohtë, të pezmatuar, zemërakë e kritik ndaj njëri-tjetrit; dhe duke i nxitur me qëllim që të luftojnë kundra njëri-tjetrit, ata shkatërrojnë moralet e tyre. Atëherë, hipokritët me lehtësi u japin goditje atyre të cilët kanë humbur fuqinë e tyre dhe i vrasin ata.

Meqenëse studentët e Risale-i Nurit kanë marrë rrugën e dashurisë dhe të vëllazërisë si dhe "asgjësimin në vëllezër", në dashtë Zoti, do ta prishin këtë plan përçarës të mirëprovuar të hipokritëve.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një herë në të kaluarën, në një vend një shejh i madh kishte aq shumë *muridë* -ndjekës- saqë njerëzit e qeverisë në atë vend u bënë të shqetësuar nga frika se mos ndoshta do të implikoheshin në çështje politike; dhe njerëzit e shtetit deshën ta shpërndanin xhematin e Shehut. Shejhu u tha njerëzve të shtetit: Unë kam vetëm një murid e gjysëm -një ndjekës e gjysëm- dhe jo tjetër. Në qoftë se dëshironi le t'i vëmë në provë e në testim. Kështu, Shejhu ngriti një tendë në një krahinë prej krahinave të Medinesë, dhe u bëri ftesë mijëra muridëve -ndjekësve- të tij për të shkuar atje dhe pastaj i urdhëroi duke u thënë: Unë do t'ju vë ju në provë. Kush është me të vërtetë muridi im dhe i bindet urdhërit tim, do të shkojë në xhennet. Ndërkohë u bëri ftesë atyre për tek tenda njëri pas tjetrit. Ai kishte therrur një dele në mënyrë sekrete; dhe kjo u duk për muridat -ndjekësit- sikur ai kishte therrur njërin nga muridët e tij të zgjedhur dhe e kishte dërguar në xhennet. Kur mijërat e muridëve e panë rrjedhën e gjakut që vërshonte nga jashtë, ata nuk iu bindën më shehut dhe hoqën dorë prej tij si dhe filluan ta mohonin. Vetëm një burrë tha: "t'u bëfsha kuban", dhe shkoi tek ai; dhe pas tij shkoi edhe një grua gjithashtu. Kurse të gjithë të tjerët u shpërndanë. Shejhu u tha burrave të shtetit: Tani ju e patë vetë se unë kam një murid e gjysëm!

Falënderime të pafundme qofshin për Zotin xh.sh. që në provimin dhe në gjykatën e Eskishehir, Risale-i Nuri humbi vetëm një student e gjysëm-krejtësisht ndryshe nga ai shejh në të shkuarën. Nëpërmjet

përpjekjeve të heronjve të Ispartës dhe të rrethinave të saj, u shtuan dhjetë mijë studentë në vend të një studenti e gjysëm.

Në dashtë Zoti xh.sh., edhe në këtë provim, nëpërmjet përpjekjeve të heronjve të vendeve të lindjes dhe të perëndimit, nuk do të humbasë shumica, përkundrazi, në vend të një të humburi të vetëm do të vijnë dhjetë.

• • •

Një herë në të shkuarën, një njeri i cili ishte jomusliman gjeti një mjet për të arritur në shkallën e kalifit të shejhut brenda një udhëtimi shpirtëror në tarikatin Nakshibendi, dhe nisi detyrën e dhënies udhëzim. Kur muridët -nxënësit- nën trajnimin e tij filluan të përparonin shpirtërisht, njëri prej tyre zbuloi se ky murishidi -udhëzuesi- i tyre kishte pësuar një rënie të rëndë. Pastaj udhëzuesi kuptoi nëpërmjet mendjemprehtësisë së tij se gjendja e tij ishte zbuluar, dhe ndërkohë i tha atij muridi: kështu, ti më njohe!

Muridi -nxënësi- i tha: Meqenëse unë e arrita këtë stacion nëpërmjet udhëzimit tënd, unë do të të respektoj e do të të nderoj tani e tutje edhe më shumë se më parë".

Muridi nisi t'i lutej me përgjërim Allahut të Lartësuar të Gjithëfuqishëm që ta udhëzonte drejt murshidin -mësuesin- e tij, derisa Allahu e shpëtoi nga ajo që ai kishte rënë, dhe i tejkaloi në sukses të gjithë muridët në përparim shpirtëror, dhe përsëri u bë një murshid i vërtetë për ta... kjo do të thotë se ndonjëherë muridi -nxënësi- bëhet Shejh për shejhun e tij. Atëherë, vlera dhe përparimi është që, studenti të mos e lërë vëllain e tij kur e sheh të sprovuar me ndonjë gjë të keqe, në një situatë të keqe, por forcon vëllazërinë e tij me të dhe përpiqet që ta reformojë. Kjo është shenja e besnikëve dhe e të drejtëve. Ndërsa hipokritët i shfrytëzojnë situata të tilla dhe i bëjnë publike: "Këta, për të cilët mendoni shumë, janë thjesht njerëz të zakonshëm e të paaftë", dhe këtë e bëjnë për të shkatërruar solidaritetin e vëllezërve dhe për të prishur mendimet e mira të tyre për njëri-tjetrin.

Sidoqoftë, pavarësisht se ne kemi vuajtur shumë në këtë fatkeqësi, por ama meqenëse kjo është një çështje që ka të bëjë me të gjithë botën islame, ajo ka një vlerë shumë të madhe dhe çdo gjë tjetër përballë saj është shumë e lirë –jo e ngjashme-, duke ditur se ngjarje të ngjashme me të nuk u bënë pronë e botës islame për shkaqe politike, fetare ose për shkaqe të tjera.

• • •

Meqenëse nënshkrimi -firma- e çuditshme në fillim të botimit të trajtesës ***El-levamiu*** *Rrezëllimat* -vepra e Saidit të vjetër- koinçidon me pak ndryshim me rrethanat e mia të tanishme dhe ekzaktësisht me vitin shtatëdhjetë e dy, unë e kam përfshirë atë këtu. Në qoftë se ju e konsideroni të përshtatshme ju mund t'ia shtoni asaj fundit të Fjalës mbrojtëse në vend të një nënshkrimi, dhe trajtesës së Frutave dhe letrave të shkurtëra.

Ai nënshkrim i çuditshëm përbëhet nga tre rreshta e gjysëm që vijojnë:

Lutësi
Varri im i rrënuar në të cilin janë grumbulluar stivë shtatëdhjetë e
nëntë kufoma të Saidit me gjynahet e tij dhe me brengat,
E tetëdhjeta u bë një gurë varri tek varri im;
Ato të gjithë së bashku vajtojnë për Rënien e islamit.
Unë jam i sigurt se e ardhmja e Azisë,
me tokën e saj dhe me qiellin e saj,
së bashku do t'i dorëzohen
dorës së pastër e të ndritshme të islamit,
sepse ajo premton lulëzimin e besimit;
dhe i jep paqe e siguri njerëzimit.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Arsyeja për rëndësinë e madhe që unë i jap solidaritetit tuaj nuk është vetëm për shkak të avantazheve të tij për ne dhe për Risale-i Nurin, por për masat e besimtarëve të cilët nuk janë brenda sferës së *Imanit tahkikij* -besimit të sigurtë e të verifikuar-, dhe ata janë shumë në nevojë për një pikë mbështetjeje dhe për një të vërtetë të qëndrueshme të cilën një xhemat, i cili nuk tundet nga ngjarjet, e gjen të sigurt, që të përqëndrohen mbi atë të vërtetë të sigurtë për të qenë të qëndrueshëm përballë rrymave të tmerrshme të çudhëzimit me qëllim që ajo të jetë për ta një provë e fortë, një udhëzues i qëndrueshëm, një pikë referimi, një autoritet që nuk mashtrohet e nuk mashtron, dhe që nuk tërhiqet e nuk lëkundet. Ai që sheh solidaritetin tuaj të fuqishëm formon bindjen se ndodhet një e vërtetë e cila nuk mund të sakrifikohet për asgjë, dhe që nuk mund të përkulet para njerëzve të çudhëzimit, as nuk mund të mposhtet; ai do të forconte besimin e tij, do të thellohej fuqia e tij shpirtërore dhe do të shpëtonte -me leje të Zotit- prej bashkimit të rradhëve të njerëzve të shthurjes dhe të atyre të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Bëni kujdes! Mos polemizoni, ruhuni nga polemika! Veshët spiunë do të përfitojnë prej saj. Me të drejtë ose të gabuar, ata që debatojnë në situatën tonë aktuale janë në gabim. Madje edhe në qoftë se do të kishin të drejtë deri diku, duke polemizuar, ata do të mund të na shkaktonin ne një dëm të madh. Unë do ta përsëris për ju të vërtetën që ua përmenda vëllezërve të mi të ndjeshëm në burgun "Eskishehir".

Gjatë luftës së Parë botërore, unë mbahesha si një i burgosur së bashku me nëntëdhjetë e nëntë oficerë në një fjetinë të gjatë në veri të Rusisë. Meqenëse ata kishin respekt për mua më shumë se sa e meritoja, nëpërmjet këshillës sime për ta, unë nuk lejoja zhurmë apo shqetësim. Por, atëherë, gjaknxehtësia -rrëmbimi- duke u shkaktuar nga shtrëngimi -burgosja- ngacmimi i nervave, filloi t'u jap shkas grindjeve të ashpra. Unë u thashë tre a katër prej tyre: Shkoni atje ku ka zhurmë e britma, dhe ndihmoni ata të cilët janë në gabim. Ata e bënë këtë, dhe grindjet e dëmshme pushman. Pastaj ata më pyetën: Përse ti ndërmore një veprim të tillë të padrejtë? Unë u thashë: "Personi që është me të drejtën është i paanshëm, i ndershëm; ai do ta sakrifikonte të drejtën e tij të pjesshme -sa një peshë dirhem- për hir të rehatisë së të tjerëve dhe për hir të interesave të tyre që janë të shumta dhe të mëdhaja. Ndërsa ai që është në gabim, në të shumtën e rasteve është arrogant dhe egoist dhe nuk sakrifikon asgjë, dhe kështu zhurma shtohet.

• • •

Vëllezërit e mi!

Ju duhet që në mënyrë të përsëritur e të vëmendshme të lexoni pjesët në trajtesat që përfshihen në letrat e vogëla të cilat janë një mjet ngushëllimi, durimi dhe vetëpërmbajtjeje, unë jam më i dobëti midis jush dhe kam pjesën më të madhe prej kësaj fatkeqësie pikëlluese. Veçse unë, në sajë të Zotit, e përballoj me durim atë mundim. Lavdi Zotit dhe falënderimet qofshin për Të, unë nuk jam pezmatuar prej atyre që m'i kanë ngarkuar mua të gjitha fajet dhe përgjegjësitë, dhe as nuk jam zemëruar me ata të cilët vetëm kanë mbrojtur vetveten dhe i kanë hedhur fajet në mënyrë të nënkuptuar mbi xhematin dhe na i kanë ngarkuar ne, se ne paskemi formuar një shoqëri politike.

Unë kërkoj që, meqenëse ne jemi vëllezër, ju duhet të më imitoni mua në këtë durim.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë dhe o shokët e mi në bujtinën e kësaj dynjaje!

Unë mendova sonte -me ndjenjat krenare dhe me damarin e temperamentit të Saidit të vjetër- për shtyrjen tonë bashkarisht për tek gjykata me dy duart e lidhura midis ushtarëve me bajoneta të mbërthyera. Kjo më bëri të ndjehesha shumë i zemëruar. Por papritmas m'u shfaq se ne duhej t'i përgjigjeshim kësaj skene -situate- jo me zemërim, por me krenari, falënderime dhe me gëzim, sepse në shikimin e qënieve të panumërta të vetëdijshme, të melekëve, të qënieve shpirtërore dhe të njerëzve të realitetit, dhe të atyre midis njerëzve me ndërgjegje dhe me iman tahkikij -me besim të sigurt dhe të verifikuar- ne shfaqemi si një karvan i heronjve në rrugën e së vërtetës, të realitetit, të Kur'anit dhe të besimit, duke sfiduar këtë shekull. Dhe meqenëse Mëshira Hyjnore dhe kënaqësia e Zotit janë drejtuar tek ne dhe me shikimin e tyre vlerësojnë me miratim e admirim, atëherë s'kanë asnjë rëndësi shikimet fyese të një bande prej bjerraditesish të shthurur. Madje, një ditë kur unë shkova me makinë -për shkak të sëmundjes- unë ndjeva një shtrëngim të fortë, mirëpo, kur shkova së bashku me ju me duart e mia të lidhura unë ndjeva një ngrohtësi të madhe dhe gëzim në shpirt. Domethënë, ajo gjendje shpirtërore buroi nga ky sekret -kuptim. Unë e kam thënë shumë herë dhe do ta përsëris: Asnjë nuk është parë në histori që të ketë përmbushur aq shumë shërbim në rrugën e së vërtetës dhe të ketë fituar aq shumë shpërblim ndërsa të ketë vuajtuar kaq pak vështirësi se sa studentët e Risale-i Nurit.

Sado shumë mundime të vuajmë, përsëri ajo nuk është e kushtueshme.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij.

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ikja jonë prej kësaj fatkeqësie dhe shpëtimi ynë prej saj është i pamundur në dy drejtime:

I Pari: Meqenëse Kaderi Hyjnor caktoi që ne duhej ta takonim pjesën e fatit tonë këtu, ne në çdo mënyrë do të kishim ardhur këtu. Prandaj kjo situatë është më e mira.

I Dyti: Ne nuk gjetëm asnjë mënyrë për të shpëtuar prej komploteve që ishin kurdisur kundra nesh. Unë i perceptova ato, por s'kishte rrugëdalje -shpëtim. Madje as Shejh Abdul Hakimi dhe as Shejh Abdul Baki nuk gjetën rrugë për të shpëtuar vetveten. Kjo do të thotë se të ankuarit për njëri-tjetrin në këtë fatkeqësinë tonë është edhe e padrejtë, edhe e pakuptim, edhe e dëmshme, dhe është të ndjesh një lloj largimi e ftohje prej Risale-i Nurit.

Ruhuni! T'i konsiderosh disa prej aktiviteteve të studentëve kryesues -të zgjedhur- se janë shkaku i kësaj fatkeqësie dhe të ndjehesh i indinjuar, i zemëruar me ta, kjo do ishte tërheqje prej Risale-i Nurit dhe pendim për të mësuarit e të vërtetave të besimit. Dhe ajo do të ishte një fatkeqësi shpirtërore shumë më e madhe se sa fatkeqësia materiale. Unë betohem se megjithëse pjesa ime prej kësaj fatkeqësie është njëzet ose tridhjetë herë më e madhe se e secilit prej jush, për shkak se ata kanë vepruar me qëllim të pastër, unë nuk do të mërzitesha me ta edhe sikur kjo fatkeqësi, e cila ndodhi për shkak të mungesës së kujdesit, të ishte dhjetë herë më e madhe. Gjithashtu do të ishte e pakuptim të kundërshtosh gjërat që kanë kaluar, sepse ato nuk mund të riparohen.

O vëllezërit e mi! Shqetësimi e dyfishon fatkeqësinë; gjithashtu ai rrënjos fatkeqësi fizike në zemër; gjithashtu ai nënkupton kundërshtim dhe kritikë ndaj Kaderit Hyjnor dhe nënkupton akuzë ndaj mëshirës Hyjnore. Meqenëse në çdo gjë ka një aspekt bukurie -ka një anë të mirë- dhe se në çdo gjë është një manifestim i Mëshirës Hyjnore, dhe Kaderi Hyjnor vepron me drejtësi e urtësi; atëherë ne jemi të detyruar që të mos i japin rëndësi asnjë mundimi të vogël që mund të vuajmë në rrugën e një detyre të shenjtë që po e kryejmë e cila i intereson të gjithë botës islame në këtë kohë.

• • •

[Një gjendje e parëndësishme e zakonshme dhe e thjeshtë prej gjendjeve të mia u bë e domosdoshme që ta shkruaja për ju!]

Vëllezërit e mi!

Kam formuar bindje të plotë se syri i keq ndikon tek unë shumë ashpër dhe më bën të sëmurë. Unë e kam përjetuar këtë në raste të shumta. Unë do të doja me të gjithë zemrën dhe shpirtin tim t'ju shoqëroja ju në të gjitha rrethanat, por sipas rregullit të shquar*: "Syri i keq e fut devenë në tenxhere dhe njeriun në varr*"[206], syri i keq ka efekt mbi mua, më godet. Sepse ata që më shikojnë, ose më shohin me armiqësi të fortë, ose me vlerësim e respekt. Të dyja këto shikime gjithashtu gjenden tek disa njerëz të cilët posedojnë aftësinë e efektit -goditjes- me syrin e keq. Prandaj unë kam vendosur në qoftë se do të ishte e mundur dhe nëse ata nuk do të më detyronin, unë nuk do t'ju shoqëroj gjithmonë kur ju shkoni në gjykatë.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Këtë mëngjes para agimit, papritmas m'u shfaq një pjesë. Po, unë e konfirmoj kerametin -ndodhinë e jashtëzakonshme- të Risale-i Nurit lidhur me tërmetin që Husrevi e shkroi në mënyrë të hollësishme; çfarë unë mendova gjithashtu u përqëndrua mbi atë. Sepse ashtu si koinçidimi i katër rasteve të agresionit të ashpër kundra Risale-i Nurit dhe studentëve të tij dhe katër rastet e sulmeve të tërmeteve të cilat nuk ishin rastësi, po ashtu koinçidenca e saktë e dy qendrave të përhapjes së Risale-i Nurit, Ispasrta dhe Kastamonuja, duke u ruajtur nga fatkeqësia në krahasim me vendet e tjera; dhe ashtu siç aludohet nga sure *Vel-Asr,* meqenëse mjetet e shpëtimit prej luftës së Dytë Botërore -'humbjes' më të madhe të njerëzimit në fundin e kohës- janë besimi dhe veprat e mira; atëherë nuk do të ishte thjesht rastësi që Risale-i Nuri e përhapi *imanin tahkikij* -besimin e sigurtë e të verifikuar- në të gjithë Anadollin, dhe Anadolli shpëtoi nga humbjet e mëdha të luftës në një mënyrë të jashtëzakonshme. Gjithashtu, ashtu si koinçidenca e saktë e atyre që pengojnë shërbimin e Risale-i Nurit ose e atyre që gabojnë në atë shërbim, duke marrë goditje ose prej mëshirës ose prej zemërimit, që nuk mund të jetë thjesht rastësi - prej të cilave ka patur qindra incidente; po ashtu mijërat e incidenteve -pothuajse pa përjashtim- të të gjithë atyre të cilët i shërbejnë mirë Risale-i Nurit duke përjetuar bereqet në mjetet e jetesës së tyre, dhe qetësi të zemrës dhe rehati e lumturi, nuk mund të jetë thjesht rastësi.

---

[206] El-Ajluni, Kafsh el-khafa, II, 76; al-magribi; xhami el-Shaml, II-49;

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Sipas kuptimit të brendshëm të vërsetit Kur'anor,

"E ndodh që ju mund të mos e pëlqeni një gjë që është në të vërtetë e mirë për ju..."[207] Dhe sipas kuptimit të rregullit të përcaktuar "*e mira është në atë çfarë zgjedh Allahu",* arritja e shumicës së trajtesave private e më të fshehta të Risale-i Nurit në duart e njerëzve më të padëshiruar, duke i sfiduar njerëzit më arrogantë e kryeneçë, dhe duke shfaqur gabimet e atyre që janë në pozitat më të larta të shtetit... i bëri ato të shafqeshin prej nga prapa perdes së rregullit të përcaktuar ***Sirren tenevveret****, 'Ndriçoi në mënyrë të fshehur'.*

Synimi i tyre deri tani ishte që ta zvogëlonin çështjen e Risale-i Nurit, donin ta bënin atë çështje të shfaqej e parëndësishme, por megjithatë ata kuptuan se ajo është një çështje shumë e madhe, dhe se tërheqja e vëmendjes për tek ajo hap rrugën për triumfe të ndritshme e të reja të Risale-i Nurit dhe armiqt e tij bëhen ta lexojnë atë me interes e habi. Madje ai ndriçoi shumë njerëz ngurrues, të habitur e të nevojshëm në Gjykatën e Eskishehirit, dhe i shpëtoi ata. Ai i transformoi ato mundimet tona në mëshirë. Ai shërbim i shenjtë do t'i shfaqë këtë herë triumfet e tij -në dashtë Zoti xh.sh.- në një fushë më të gjërë, në gjykata të shumta dhe në shumë qendra. Po, ata të cilët e shikojnë stilin dhe shpjegimin e Risale-i Nurit nuk mund të qëndrojnë indiferentë ndaj tij. Ato nuk u ngjasojnë veprave të tjera me ndikimin e tyre vetëm në mendje e në zemër, por gjithashtu nënshtrojnë edhe nefsin dhe ndjenjat.

Qënia juaj të liruar nuk i shkakton dëm këtij fakti, por pafajësia ime do të ishte e dëmshme. Madje edhe nefsi im urdhërues për të liga ka pranuar që të sakrifikojë, për hir të një të vërtete të vetme që prek botën islame, jo vetëm jetën time të kësaj dynjaje, por në qoftë se do të ishte e domosdoshme, edhe jetën e Ahiretit dhe lumturinë e saj gjithashtu për lumturinë e njerëzve të besimit nëpërmjet Risale-i Nurit.

• • •

[E përfshirë këtu është vazhdimi i ngjarjes së tërmetit prej letrës së Husrevit; fillimi nuk është përfshirë.]

---

[207] Kur'an, 2:216

Unë më vonë pashë në një gazetë tjetër faktet e çuditshme e plotësuese që vijojnë: Përpara tërmetit, macet edhe qentë u grumbulluan së bashku në grupe, katër ose pesë.

Ato qetësisht, pa zhurmë, u ulën bashkë duke e vështruar njëri-tjetrin si mendueshëm, të trishtuar e të hutuar, pastaj u shpërndanë. Asnjëra nga këto kafshë nuk u pa as gjatë tërmetit, as menjëherë para tij dhe as pas tij. Një gjë tjetër e çuditshme që ata shkruan është se këto kafshë njoftuan për ardhjen e katastrofës, e cila u shkaktua nga gjynahet tona, nëpërmjet gjuhës së gjendjes, dhe ato nuk e kuptuan atë dhe u habitën.

Midis qindra gjërave që qysh prej vitesh Bediuzzamani i ka parashikuar në Risale-i Nur është se ateistët do t'i shmangeshin ndërhyrjes tek Risale-i Nuri dhe tek studentët e tij, sepse në qoftë se do t'u vinte dëm atyre, atëherë fatkeqësitë, duke pritur në afërsi, do t'i bënin ata të pendoheshin njëqind herë më shumë. Tërmeti e verifikoi këtë me nënshkrimin e tij, atëherë katër fatkeqësi më shumë ndodhën...

Zoti dhëntë besim në zemrat tona dhe në zemrat e atyre që sulmojnë Risale-i Nurin, dhe u dhëntë atyre mend që ta njohin të vërtetën, dhe të na shpëtojë neve prej këtyre burgjeve të nëndheshme dhe t'i shpëtojë ata prej fatkeqësive. Amin.

Husrevi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë dhe o shokë në fatkeqësi!

Duke pasë dijetarë të bekuar, organizatorë të mirë dhe studentë të sinqertë të devotshëm midis jush, unë u ndjeva shumë i sigurtë se ju do të ruanit unitetin dhe solidaritetin tuaj përballë armiqve të shumtë, të fuqishëm e finokë. Unë u ndjeva i rehatuar dhe nuk u preokupova me ju. Por tani është bërë e domosdoshme që të shpjegoj një numër çështjesh.

E Para: Unë nuk kisha ndërmend të dërgoja ndonjë gjë në Ankara, se mos ajo do të vononte lirimin tuaj. Por meqenëse gjykata i ngatërroi trajtesat që janë private e të fshehta dhe ato të cilat nuk janë të tilla dhe letrat e vjetëra dhe të rejat, dhe i dërgoi ato në Ankara, ishte e domosdoshme që t'u dërgoja atyre departamenteve "Fjalët Mbrojtëse", të cilat japin përgjigje shumë të fuqishme lidhur me trajtesat private, dhe veçanërisht me Sufjanin dhe Dexhalin e muslimanëve - Antikrishtin- në Rrezen e Pestë, dhe Frutat e besimit, të cilat e copëtojnë mosbesimin arrogant që buron prej filozofisë Natyraliste dhe

sulmet e saja të pafytyra kundra besimit, me qëllim që grupi i ekspertëve atje të mos mund t'i mbështesin gjykimet e tyre mbi ato trajtesa private dhe të mos sundojnë kundra nesh ashtu si grupi i parë.

Pika e Dytë: Vëllezërit e mi të dashur! Ndërsa po shkruaja përgjigjjen ndaj letrës suaj të rëndësishme, ata më dhanë mua të njëjtën letër. Unë pata filluar Pikën e Dytë dhe ajo mbeti e papërfunduar. Tani unë jam duke e plotësuar. Prandaj mbajeni shënim. Në qoftë se kjo ide është përhapur nga avokati juaj i padobishëm, padyshim ai është një plan i atyre që kërkojnë të na akuzojnë me qëllim që ashtu si grupi i ekspertëve këtu, komiteti në Ankara të marrë si bazë trajtesat private të pabotuara, dhe veçanërisht "Rrezen e Pestë", t'i shtrijnë ato tek të gjithë Risale-i Nuri dhe pastaj ta konfiskojnë dhe duke nxjerrë si përfundim se çështjet e diskutuara në Rrezen e Pestë janë ato çfarë studiojnë studentët e mjerë të cilët lexojnë Risale-i Nurin, i kanë akuzuar të gjithë ata për shkak të krimit tim. Drejtori i burgut dhe ndihmësprokurori duke shkaktuar vështirësi për mua nëpërmjet pengimit tim nga të folurit dhe duke konfiskuar çfarë kam shkruar, është një shenjë e fuqishme që Ankaraja të bëhet të na sundojë para se të arrijnë atje përgjigjjet e parefuzueshme të mbrojtjeve.

Pika e Tretë: Në fakt, kryetari i Gjykatës tha në atë ditë se ai do t'i dërgonte librat, dokumentet dhe mbrojtjet me rëndësi, të cilat do ta zgjasnin çështjen, në Ankara. Këto sigurisht që kanë arritur tani. Në qoftë se dërgohen dy Fjalët e mia mbrojtëse, të mirëvendosura dhe sqaruese, ata do të mund ta zgjidhnin shpejt çështjen; ajo nuk do të zgjatej por do të mbaronte shpejt; dhe ata që janë me familje, do të liroheshin. Ndërsa vetë unë dhe ata që janë si unë, të cilët nuk kanë askënd, nuk do të lirohemi, por do të mbetemi në burg, pasi ai është vendi më i mirë për të mbrojtur të vërtetat e besimit kundra ateistëve dhe apostatëve -felëshuesve.

Pika e Katërt: Risale-i Nuri nuk e ka marrë pafajësinë, dhe mbrojtja ime nuk është marrë në konsideratë, përgënjeshtrimi juaj i jashtëm nuk do t'ju shpëtojë ju; për shkak të të gjithë qënies së tij, ne të gjithë jemi të lidhur së bashku. Vetëm shumë pak prej vëllezërve tanë të cilët kanë një lidhje të vogël, do të mund të shpëtonin. Në fakt, Gjykata e Eskishehirit e demonstroi këtë. Gjatë vitit të kaluar ata futën spiuna midis nesh të cilët me kujdes regjistruan disa informacione që dolën në shesh prej studentëve të pamatur e të rrëmbyer, dhe kanë përdorur çdo mjet për të na shkatërruar e për të na bërë që të pendohemi për rrugën tonë, madje ata mobilizuan kundër nesh edhe Shejh Abdul Hakimin. Por ata e shkatërruan edhe atë në të njëjtën

mënyrë ashtu siç na shkatërruan ne, Shejh Abdullahin dhe Shejh Sulejmanin, të cilët më kanë kundërshtuar mua herë pas here, kështu përgënjeshtrimi juaj ndaj tyre dhe shmangia juaj nuk do të bëjë absolutisht asnjë ndryshim në atë çfarë ata mendojnë, dhe në atë çfarë ata e quajnë "Dënim vetëgjykimor", pikërisht ashtu siç nuk bëri ndryshim në Eskishehir.

Pika e Pestë: Ne kemi kuptuar me siguri nëpërmjet eksperiencave tona si këtu po ashtu edhe në Eskishehir se, për shkak të tij, të gjithë duke qenë e njëjta çështje, atëherë nevoja jonë më e madhe është për solidaritet të plotë, dhe jo duke u fyer, duke u zemëruar dhe duke qenë kritikë për shkak të dyfishimit të vuajtjeve dhe të mjerimit. Me keqardhje, ishit ju tek të cilët unë kisha më shumë konfidencë dhe besova më shumë. Ndonjëherë kur unë ndiej ndonjë brejtje -dhembje therrëse- prej ankthit, unë kujtoj Qamil Hoxhën dhe Siddik Hoxhën prej Stambollit dhe njerëzit në Provincën e Kastamonus, të cilët kanë shfaqur një besnikëri të jashtëzakonshme, dhe ankthi, shqetësimi, im avullon, zhduket. Kini kujdes që organizata e fshehtë e cila mbështet mosbesimin absolut të mos depërtojë tek ju. Ajo depërtoi tek krahu (i burgut) pranë meje dhe më shkaktoi torturë të papërshkrueshme. Diskutojeni këtë ndërmjet jush tani pa debat; unë do të pranoj vendimin tuaj. Por në qoftë se në diskutimet tuaja ju merrni në konsideratë mundësinë nëse mbrojtja ime shkon në Ankara dhe studiohet atje, gjykata këtu do të mund të arrinte të marrë një vendim rreth atyre, lirimi i të cilëve është i mundshëm; dhe mundësinë që ata të cilët luftojnë kundra nesh, dhe që syrgjynosën Abdul Bakin, Abdul Hakimin dhe Haxhi Sulejmanin dhe e bënë Shejh Shemsiun të qëndrojë këtu pasi kishte qenë liruar zyrtarisht, dhe nuk do t'i lirojë ata si Hafiz Mehmetin dhe Sejjid Shefikun, për shkak të përkrahjes së tyre të fortë ndaj fesë dhe refuzimit për t'u përkulur para udhëheqësit të vdekur dhe portretit të tij, dhe mungesa e demonstrimit të tyre për të mbështetur ateizmin dhe bidatet -risitë. Ju gjithashtu duhet të merrni në konsideratë se është shumë e rëndësishme që Risale-i Nuri të shfaqet në mënyrë të pakuptueshme dhe në një çështje të përgjithshme madhështore në një kohë kur ata kundërshtojnë vetveten në qendrat e tyre, njerëzit e shushatur e ngurrues të besimit të mund t'i gjejnë studentët prapa tyre, dhe duke mos iu shmangur atij mund t'u shfaqet atyre se studentët janë të lidhur pas një të vërteteje të patundur dhe të pamposhtme. Ruhunu! Kini kujdes prej gabimeve të njëri-tjetrit; kini respekt në vend të qënies të zemëruar, dhe ndihmojeni njëri-tjetrin në vend të qënies kritikë.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Që prej disa ditëve unë e kam ndryshuar formën e lutjeve të mia, pasi unë e hoqa fjalën "*Sa'dikinë*" (të vërtetët, besnikët) prej duasë sime e cila përmban: *"Vagfir lena..."* ose "*Vef-fik Talebete Resailin-Nur essadikinë*" "*Na fal ne*.." ose *"Jepu sukses studentëve të vërtetë e besnikë të Risale-i Nurit",* "lutje" të cilën ndonjëherë e kam përsëritur deri tani njëqind herë. Këtë e bëra me qëllim që të mos privohen prej atyre duave ata vëllezër të cilët i shikojnë vetet të detyruar të veprojnë në përputhje me "*Er-ruhsatu esh-sherijjeh* -"*lejueshmërinë e sheriatit*" dhe që në pamje të jashtme kanë hequr dorë prej nesh, ose që për shkak të ankthit dhe të shqetësimit të shkaktuara nga vuajtja e pikëllimi, veprojnë në një mënyrë që është në kundërshtim me '*Azimetin'*, '*Vendosmërinë'* dhe '*besnikërinë'*.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllai im i dashur, Hafiz Aliu![208]

Mos u shqetëso për sëmundjen tënde. Zoti i Gjithëfuqishëm të dhëntë shërim. Amin. Ti po bën një fitim shumë të madh, pasi çdo orë ibadeti në burg është e barabartë me dymbëdhjetë orë. Në qoftë se dëshiron ndonjë ilaç, unë kam ca këtu; unë mund të t'i dërgoj ty ato. Sidoqoftë, ndodhet një sëmundje e lehtë që po përhapet nëpër rrethe. Nuk ka dyshim se do të jem i sëmurë në ditën që do të paraqitem në Gjykatë... Ndoshta ti ke marrë një pjesë nga sëmundja ime me qëllim që të më ndihmosh, ashtu si ata të kohëve të hershme të cilët me vetëflijim të jashtëzakonshëm sëmureshin e vdisnin në vend të njëri-tjetrit.

• • •

[Një ngushëllim i bukur dhe në kohën më të përshtatshme.]

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Për çdo fatkeqësi ne themi: "*të cilët thonë kur u bie fatkeqësi, "Vërtetë të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi."* [209]

---

[208] Hafiz Aliu: Njëri prej studentëve kryesorë të Risale-i Nurit në zonën e Ispartas. Përkthyesi.
[209] Kur'an, 2:156

Unë jap ngushëllimet e mia për veten time, për ju, dhe për Risale-i Nurin. Por unë përshëndes të ndjerin Hafiz Aliun dhe përshëndes varrezën e Denizlit, sepse vëllai ynë heroik i cili e njohu me shkallën e "sigurisë absolute" të vërtetën e trajtesës "Frutat e besimit", e la trupin e tij në varr duke u ngjitur si melekët tek yjet dhe tek bota e shpirtërave, me qëllim që të ngjitet tek stacionet e "Shikimit të Sigurisë" dhe të "Sigurisë Absolute".

Dhe gjeti qetësinë e rehatinë duke u shkarkuar nga detyra e tij të cilën e përmbushi ashtu siç duhet. I lutemi Allahut të Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë që t'i shkruajë të mira në Regjistrin e punëve të tij aq sa numri i të gjitha shkronjave të Risale-i Nurit, të shkruara e të lexuara. Amin.

Derdhtë Ai bekime e mëshirë në shpirtin e tij sa numri i tyre... Amin, dhe i bëftë Kur'anin Kerim dhe Risale-i Nurin shoqërues të këndshëm e miqësorë për të në varr... Amin. Dhe dhëntë Ai dhjetë heronj për të zënë vendin e tij në Fabrikën e "Nurit" dhe i bëftë ata të punojnë... Amin... Amin... Amin.

Ndërsa ju, o vëllezërit e mi, kujtojeni atë në duatë tuaja, ashtu siç e kujtoj unë, duke përdorë një mijë gjuhë në vend të gjuhës së tij, duke shpresuar prej mëshirës së Tij xh.sh. që ta bëjë të fitojë një mijë jetë dhe një mijë gjuhë në vend të asaj jete të vetme dhe të asaj gjuhe të vetme që i humbi.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Lavdërime e falënderime të pafundme qofshin për Allahun xh.sh. që në këtë kohë të jashtëzakonshme dhe në këtë vend të çuditshëm, na e lehtësoi dhe na lejoi që nëpërmjet jush të fitojmë nderin e stacionit të lartë të të qënit studentë të shkencave fetare dhe për të kryer punë e shërbime të rëndësishme.

Është parë në raste të shumta prej njerëzve të zbulesave të gjendjeve të atyre në varreza, se një student serioz dhe i përmalluar për shkencat fetare kur vdes, ndërsa është i preokupuar me studime -duke fituar dije-, e shikon veten e tij -ashtu si martirët- të gjallë duke u ushqyer dhe duke studiuar akoma. Madje njëri nga njerëzit e zbulesave të gjendjeve të atyre që janë në varreza vështroi se si u përgjigj një student -i cili vdiq kur po studionte gramatikën dhe sintaksën- ndaj Melekëve, pyetjeve të Munker dhe Nekir në varrin e tij. Ai zbulues pa se kur e pyeti meleku: Kush është Zoti yt? U përgjigj: "Kush" është

kryefjalë, dhe, “Zoti yt” është kallëzuesi i saj. Ai dha një përgjigje gramatikore, sepse e supozoi veten të ishte në medresenë e tij duke marrë dije.

Kështu, si ajo ngjarje: Unë mendoj se i ndjeri “Hafiz Ali” është i preokupuar me Risale-i Nurin ashtu siç e kishte zakon në jetë, dhe është në formën e një studenti dije fetare duke marrë dijen më të lartë e sublime, dhe është ngjitur në shkallën e martirëve dhe tek niveli i tyre i jetës. Dhe në përputhje me këtë rregull, me atë bindje unë lutem për të në duatë e mia, dhe ashtu si për të unë lutem edhe për Mehmet Zuhdun dhe për Hafiz Mehmedin duke thënë: O Zot! Nënshtroji këta deri në Ditën e kijametit që të preokupohen me të vërtetat e imanit -besimit- dhe me misteret e Kur’anit brenda Risale-i Nurit me gëzim e kënaqësi të plotë... Amin, në dashtë Zoti xh.sh..

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë nuk mund ta harroj vëllain e ndjerë Hafiz Aliun. Dhimbja e ndarjes së tij më ka tronditur shumë. Unë mendoj se ai i ndjerë u largua në vendin tim, ashtu siç kishte persona vetësakrifikues të cilët ndonjëherë vdisnin në vend të shokëve të tyre. Në qoftë se ata si shembulli juaj që ndiqni sistemin e tij nuk do të përmbushnin detyra e shërbime të larta ashtu siç i përmbushi ai, do të kishte qenë një humbje e madhe për shërbimin e Kur’anit dhe të islamit. Dhimbjet e mia pakësohen e zhduken kur unë mendoj për ju që jeni trashëgimtarët e tij, dhe ato ua lënë vendin gëzimit dhe ngrohtësisë.

Është e çuditshme, tek unë aktualisht ka lindur një dëshirë për të shkuar tek ajo botë, tek Bota e ndërmjetme tek e cila shkoi vëllai ynë me jetën e tij shpirtërore, madje edhe me jetën e tij fizike, dhe iu zbulua shpirtit tim një skenë tjetër. Ashtu siç dërgojmë përshëndetje për vëllezërit tanë në Isparta prej këtu dhe bisedojmë me ta dhe shkëmbejmë lajme, po ashtu Bota e ndërmjetme, në të cilën banon tani Hafiz Aliu, është bërë Isparta ose si Kastamonuja në shikimin tim. Madje unë dëgjova se dikush prej këtu u dërgua atje mbrëmë (domethënë vdiq), dhe unë u pikëllova dhjetë herë më shumë; përse nuk i kisha çuar Selam Hafiz Aliut me të? Pastaj m’u shfaq në zemër: Nuk ka asnjë nevojë për mjete ndërmjetësuese për të çuar selam. Sepse lidhja e tij e fuqishme është si një telefon. Gjithashtu ai vjen dhe e merr! Ai shehid -martir- i madh e bëri të dashur për mua qytetin e Denizlit, unë nuk dëshiroj tani që ta lë atë. Ai, Mehmet Zuhdu dhe

Hafiz Mehmeti po vazhdojnë detyrat e tyre duke i shërbyer besimit dhe Risale-i Nurit, detyra që i përmbushën në jetët e tyre. Ata i vështrojnë nga një vend i afërm, dhe ndoshta ndihmojnë në përmbushjen e tyre. Meqenëse ata morën vende të larta tek sfera e Evlijave të mëdhenj -për shkak të shërbimeve të tyre të mëdhaja- unë i përmend emrat e atyre të dyve së bashku me Hafiz Mehmetin dhe së bashku me ata të Poleve shpirtërorë në "zinxhirin" tim, dhe u dërgoj atyre dhuratat tona.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Sinqeriteti juaj, besnikëria dhe qëndrueshmëria janë të mjaftueshme për të shpërfillur e për të mos marrë parasysh të metat e njëri-tjetrit dhe t'i mbuloni ato kur ju keni rënë nën peshën e këtyre mundimeve e vështirësive. Lidhja e vëllazërisë e lidhur me zinxhirin e Risale-i Nurit është një mirësi e madhe, një akt i tillë i mirë saqë shkakton të falen një mijë të këqija. Ju duhet të veproni me dashuri e me falje ndërmjet jush në përputhje me mbipeshimin e veprave të mira ndaj të këqijave ashtu si në Ringjalljen më të madhe, në Gjyqin e Fundit ku drejtësia Hyjnore do t'i zhdukë të këqijat, do t'i falë duke i bërë të mirat të peshojnë më shumë. Sepse të bëhesh i zemëruar për shkak të një veprimi të vetëm të keq, dhe të acarohesh në një mënyrë të dëmshme nga pezmatueshmëria, dhe të shqetësohesh për shkak të vështirësive, do të ishte një padrejtësi e dyfishtë.

I Lutemi Allahut që ta zhdukni mërzinë e pezmatueshmërinë duke e ndihmuar njëri-tjetrin në qetësim dhe duke dhënë ngushëllim.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Arsyeja që unë nuk kam folur me ju që prej disa ditësh është një sëmundje e rëndë që më ka rënë që shkaktohet nga helmimi, shembullin e së cilës unë nuk e kam përjetuar kurrë deri tani.

Unë falënderoj Allahun xh.sh. në emër të Risale-i Nurit deri në frymën e fundit të jetës sime, dhe krenohem me vëllezërit e mi të qëndrueshëm, të fuqishëm e punëtorë të cilët nuk lëkunden brenda sferës së "Nurit"[210] dhe sferës së "Trëndafilit"[211], së bashku me

[210] Sfera e Nurit: Aludon për grupin e studentëve të Nurit në fshatin Islam Köy, në krye të të cilëve është Hafiz Aliu. Përkthyesi

besnikët vetësakrifikues në Kastamonu. Dhe unë gjej ngushëllim të efektshëm dhe një mbështetje të plotë me ta përballë të gjitha torturave të tiranëve. Madje, edhe në qoftë se do të vdisja qysh tani, unë do ta takoja exhelin -vdekjen time- duke qenë i gëzuar në zemër dhe i kënaqur, duke parë se ata janë të pranishëm.

Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje më futën në burg për shkak të dyshimeve dhe iluzioneve të tyre të pabaza, sikur unë po i sfidoja dhe po i kundërshtoja në shesh. Ndërsa Kaderi Hyjnor më hodhi mua në burg, sepse unë nuk u kam bërë thirrje për tek e mira, nuk kam folur me ta dhe nuk jam përpjekur që t'i reformoj.

Në qoftë se do të qëndroja në burg vetëm me pak vëllezër, unë do t'u kërkoja departamenteve të qeverisë në Ankara që të zhvillonin një gjyq të hapur i cili do të ngjallte interesin e të gjithë botës islame. Në dashtë Zoti xh.sh. do të dërgojmë kopje të shumta nga Trajtesa "Frutat e besimit" dhe pjesë nga "Mbrojtja", me shkronja të reja, tek të gjitha departamentet e larta të rëndësishme.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një pjesë nga hadithet profetike janë alegorikë. Ato nuk janë të veçantë dhe as të pjesshëm, as nuk shikojnë tek vende të përgjithshme. Një pjesë tjetër prej hadithëve shpjegojnë ndryshimet fetare -grindjet, konfliktet- që do të godasin ummetin islam; ato tregojnë vetëm një kohë të vetme dhe vende të caktuara duke përmendur Hixhazin dhe Irakun si shembuj.

Në të vërtetë, në kohën e Abasidëve u shfaqën sekte të shumtë të çudhëzuara të cilat dëmtuan Islamin, të tilla, si: Muëtezilitët, Revafidët, Xheberitët, Ateistët dhe heretikët nën maska të ndryshme. Në një kohë kishte tronditje shumë të rënda lidhur me Sheriatin dhe me parimet e besimit; disa figura kryesuese të islamit si Buhariu, Muslimi, Imami A'Dham Ebu Hanifeja, Imam Shafi, Imam Malik, Imam Ahmed Ibn Hambel, Imam Gazali, Gauth El-Aëdham dhe Xhunejd El-Bagdadi, u shfaqën dhe e shuan zjarrin e atyre përçarjeve fetare. Fitorja vazhdoi përreth treqind vite, por sektet e njerëzve të çudhëzimit, fshehurazi, nëpërmjet politikës, i bënë myslimanët të binin në fitnen -konfliktin- e Hulagu dhe të Xhengiz Hanit. Edhe hadithi Sherif edhe Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, në mënyrë të qartë

---

[211] Sfera e trëndafilit: Aludon për grupin e studentëve të Nurit në Isparta, në krye të të cilëve është Huzrevi. Përkthyesi

e treguan këtë konflikt së bashku me datën e tij. Dhe meqenëse fitneja -grindja- e kësaj kohës sonë është më e madhja e fitneve, hadithe të shumta dhe aluzione të shumta Kur'anore njoftojnë për to dhe për datat e tyre.

Duke bërë anologji me këtë, kur një hadith sherif shpjegon ngjarjet që do të kalojnë tek ummeti në mënyrë të përgjithshme universale, ai ndonjëherë shpjegon një ngjarje të vetme me datën e saj si një shembull prej asaj të përgjithshmeje. Pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit kanë bërë disa interpretime të haditheve alegorike të tilla si këto, kuptimet e të cilëve nuk kuptohen plotësisht. Fjala e Njëzet e Katërt dhe "Rrezja e Pestë" e sqarojnë dhe e shfaqin këtë të vërtetë nëpërmjet rregullave dhe parimeve.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

M'u shfaq në zemër se unë duhet t'ju shpjegoj një të vërtetë me qëllim që ju të mos e akuzoni njëri-tjetrin për egoizëm dhe për pabesi.

Një ditë unë vëzhgova se njëri prej Evlijave të mëdhenj, i cili e kishte braktisur egoizmin dhe nefsi i tij udhëzues për të liga ishte asgjësuar, pashë se ai ankohej shumë prej nefsit urdhërues për të liga. Unë u habita në këtë çështje. Më vonë unë kuptova në mënyrë të plotë se me vdekjen e nefsit urdhërues për të liga, pajisjet e tij -të nefsit- u dorëzohen damarëve të temperamentit dhe emocioneve, me qëllim që përpjekja e nefsit -lufta për të cilën shpërblehet- të mund të vazhdojë deri në fund të jetës së personit.

Dhe kështu ata evlija të mëdhenj ankohen prej këtij armiku të dytë trashëgues të nefsit urdhërues për të liga. Për më tepër, vlera shpirtërore, stacioni dhe virtyti nuk shikojnë tek kjo dynja që ato të ndihen; por meqenëse disa prej atyre që janë tek stacioni më i lartë nuk i perceptojnë mirësitë e mëdhaja Hyjnore që u janë dhuruar, ata e konsiderojnë vetveten të jenë më të mjerët dhe më të falimentuarit se çdokush tjetër, gjë që tregon se zbulesa, kerameti, ndriçimet dhe dritat të cilat në shikimin e njerëzve të zakonshëm konsiderohen se janë boshti i plotësimeve, nuk mund të jenë kurrë kriter dhe as mjete për ato stacione dhe për vlerën shpirtërore. Kjo e provon këtë të vërtetë se, ndërsa një orë e vetme prej jetës së një sahabiu -shoku- të nderuar të profetit a.s.m. është e barasvlershme me një ditë prej jetës së një Evlijau -shenjtori- të madh, dhe madje me dyzet ditë prej vuajtjeve dhe "Iëtikafit" -veçimit- të tij; nuk duken tek çdo sahabi ato gjendje të jashtëzakonshme shpirtërore dhe zbulesa ashtu siç është tek Evlijatë.

Dhe kështu, o vëllezërit e mi!

Jini të kujdesshëm! Mos i lejoni nefset tuaj urdhërues për të liga t'ju mashtrojnë ju nga këndvështrimi i krahasimit të të tjerëve me veten tuaj dhe duke menduar keq për to; mos i lejoni ata që t'ju bëjnë juve të dyshuar për aftësinë e Risale-i Nurit për të bërë trajnim dhe edukim.

. . .

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

[Vetë të rinjtë e pabindur konfirmojnë se nëntë shuplaka që ata morën lidhur me pesë çështje në "Udhëzuesin për të rinjtë" dhe në "Frutat e besimit" të Risale-i Nurit janë një shembull i hollë i kerametit të Risale-i Nurit.]

I Pari është Fejziu, i cili ndonjëherë më ndihmon. Në fillim unë i thashë atij: Ti e ke ndjekur një lexim të Trajtesës së "Frutave", kështu mos bëj bezdi. Ai bëri bezdi, dhe mori një shuplakë, ai nuk mundi ta përdorë krahun e tij për një javë.

Po, është e vërtetë
Fejziu

I Dyti është Ali Riza, i cili më ndihmon mua dhe shkruan Frutat. Një ditë unë do ta mësoja rreth asaj çfarë ai kishte shkruar. Nga dembelia, ai bëri një justifikim -arsye- rreth gatimit të ushqimit dhe nuk erdhi. Ai papritmas mori një shuplakë: megjithëse tigani i thellë ishte në formë të mirë, fundi -i tiganit- papritmas ra bashkë me ushqimin.

Po, është e vërtetë
Ali Riza

I Treti është Zijai. Ai shkroi çështjet rreth rinisë dhe namazet e detyruar nga "Frutat" për vetveten, dhe filloi të kryente faljet. Por pastaj ai u bë dembel dhe i braktisi faljen dhe shkrimin. Ai papritmas mori një goditje: pa asnjë arsye dhe në një mënyrë të jashtëzakonshme, zymbylja e tij dhe rrobat në të, që ishin pranë tij, morën flakë. Asnjëri midis atij grumbulli të madh duke mos qenë në dijeni të kësaj derisa ato ishin djegur tregon se ajo ishte një "shuplakë mëshire" e synuar.

Po, është e vërtetë
Zijai

I Katërti është Mahmudi: Unë i lexova atij çështjet rreth Rinisë dhe namazet nga trajtesa e "Frutave" dhe i thashë të mos luante kumar dhe të kryente namazet. Ai ra dakord. Por ai u mposht nga përtacia,

dhe nuk u fal dhe luajti kumar. Ai papritmas mori një “Shuplakë zemërimi”: Ndërsa po luante kumar, ai humbi tre apo katër herë, dhe pavarësisht varfërisë së tij, ai duhej t’i jepte dyzet lira, xhaketën dhe pantallonat e tij kundërshtarit, dhe ai akoma nuk ka ardhë në vete.

Po, është e vërtetë
Mahmudi

I Pesti: Një djalë rreth të katërmbëdhjetave i quajtur Sulejman, gjithmon shkaktonte zhurmë dhe në të njëjtën kohë duke i nxitur edhe të tjerët. Unë i thashë të sillej mirë dhe të kryente faljet, ose sjellja e tij do t’i shkaktonte telashe dhe do ta fuste në rrezik. Ai filloi t’i kryejë namazet, por më vonë i braktisi dhe nisi përsëri të bënte trazira. Ai papritmas mori një shuplakë; atij i ra zgjebja dhe duhej të qëndronte në shtrat për tri javë.

Po, është e vërtetë
Sulejmani.

I Gjashti është Ömeri, i cili në fillim më ndihmoi; ai nisi të kryente faljet dhe e la këngën. Pastaj një natë, një këngë arriti tek veshët e mi e cila po këndohej pranë derës sime; ajo më shqetësoi meqë po recitoja tesbihatet e mia. Unë u zemërova, dola dhe pashë se çuditërisht ishte Ömeri. Dhe e pazakontë për mua, i dhashë atij një goditje. Pastaj, çuditërisht, në mëngjesin tjetër, ai u dërgua në një burg tjetër.

I Shtati: Një Gjashtëmbëdhjetëvjeçar i quajtur Hamza, i cili për shkak se kishte një zë të bukur, këndonte këngë, gjithashtu duke hapur oreksin e të tjerëve dhe gjëra shqetësuese. Unë i thashë të mos e bënte ose përndryshe ai do të merrte shuplakë. Pastaj papritmas dy ditë më vonë ai vuajti tortura për dy javë.

Po, është e vërtetë
Hamzai

Ka edhe shuplaka të tjera si këto, por fleta mbaroi dhe kështu është kuptimi.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ministri i arsimit ngriti perden prej fytyrës së tij dhe zbuloi mosbesimin absolut në një maskë tjetër. Ai duhet ta ketë shkruar atë deklaratë me një mënyrë tjetër para se të merrte mbrojtjet tona të fundit. Unë nuk mendoja që t’i dërgoja ato tek ai departament, por ama me rekomandimin e vëllezërve të mi dhe me aprovimin e tyre u bë e

qartë se dërgimi i tyre ishte i domosdoshëm dhe i përshtatshëm. Sepse një ministër fanatik deri në këtë shkallë për ateizmin, nuk do të mund të rrinte duarkryq e indifirent përballë atyre dokumenteve dhe letrave private të fshehta që u dërguan në Ankara. Ai papritmas u godit në kokë nga mbrojtjet e parefuzueshme; ajo që ndodhi ishte e shkëlqyeshme.

Në dashtë Zoti xh.sh. kjo do të japë shkas për një lëvizje të fuqishme në favor të Risale-i Nurit në atë departament gjithashtu.

O vëllezërit e mi! Meqenëse disa njerëz janë si ai, t'u nënshtrohesh atyre është një lloj vetëvrasjeje, madje konsiderohet pendesë që je kapur pas islamit, madje konsiderohet shkëputje prej fesë. Sepse ata janë aq fanatikë për ateizmin saqë ata nuk do të kënaqeshin prej atyre si ne thjesht me bindje, me dorëzim dhe me shtirje se i bindemi, por ata thonë: Braktise zemrën tënde, ndërgjegjen dhe vetëdijen dhe puno vetëm për dynja".

Në një situatë të tillë si kjo, nuk ka zgjidhje tjetër veçse të ruajmë qëndrueshmërinë, të vetëpërmbahemi, të mbështetemi tek Allahu xh.sh. dhe t'ia lëmë çështjen përkujdesjes Hyjnore duke bërë lutje që, me të vërtetat e tyre të fuqishme të cilat u kanë mbërritur me katër sunduqe, ato -Risale-i Nuri- të jenë fitimtar. Eksperienca jonë deri tani ka treguar se duke iu shmangur njëri-tjetrit, duke u mërzitur, duke u larguar nga Risale-i Nuri, duke iu nënshtruar atyre, ose madje duke iu bashkuar, që të gjitha këto nuk kanë asnjë dobi. Koha e ka vërtetuar këtë me prova. Kurrë mos u shqetësoni! Alarmi kërcënues i atij ministri tregon dobësinë dhe frikën e tij, dhe se ai është i detyruar jo të sulmojë, por që të mbrojë vetveten.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Sami Bej më tha se njëri prej vëllezërve tanë nga Homa, një student i quajtur Ali, vdiq rreth të njëjtës kohë ashtu si Hafiz Aliu. Mehmed Aliu, njëri prej heronjve të Homës, gjithashtu më shkroi dhe më tregoi. Kështu në shumë prej duave të mia unë e kam bërë atë Ali një shok për martirin e madh Hafiz Aliun.

Kohët e fundit një grua, e cila është e lidhur me ne, pa në ëndërr se tre nga vëllezërit tonë kishin vdekur. Interpretimi i asaj ëndrre është se këto dy "Alitë" dhe Mustafai, i cili në burg deshi të bëhej një ndjekës i Risale-i Nurit dhe u var, shkoi në Ahiret në vend të të gjithë neve, dhe ata u vetëflijuan për mirëqënien tonë.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e të palëkundur, që e njihni natyrën e vërtetë dhe kuptimin e mbështetjes tek Zoti xh.sh.!

Megjithëse qysh prej njëzet viteve unë nuk kam pasë kurreshtjen as që të lexoj dhe as që të pyes rreth ndonjë gazete, veçse ama unë sot -me shumë keqardhje- pashë vetëm për hir të disa vëllezërve tonë të dobët, një artikull gazete. Unë kuptova nga ajo se në mënyrë të fshehur dhe të hapur, disa rryma -lëvizje- të rëndësishme po luajnë pjesët e tyre të rrezikshme. Meqenëse ne shfaqemi në shikimin publik, në shesh, supozohet se ne jemi të lidhur me ato lëvizje. Ne i lutemi Allahut që katër kutiat me trajtesat e fuqishme dhe të parefuzuara dhe me blloqet e mbrojtjeve vendimtare do të prodhojnë rezultate të mira për ne, për besimin, për Kur'anin dhe për Islamin.

Ne nuk kemi ndërhyrë në çështjet e dynjasë së tyre dhe nuk kanë provuar kundra nesh asnjë tregues -provë- për ndërhyrjen tonë në to. Prandaj, Ankaraja u detyrua që t'i kërkojë të gjitha trajtesat e Risale-i Nurit me qëllim që t'i hetojë e t'i shqyrtojë me imtësi.

Meqenëse realiteti është ky, dhe meqenëse deri tani në shërbim të Risale-i Nurit ne kemi parë e dëshmuar manifestimin e përkujdesjes Hyjnore deri në një shkallë të pohueshme -të gjithë ne e kemi përjetuar këtë, në mënyrë të pjesshme dhe universale, dhe meqenëse shumë prej lëvizjeve politike botërore janë duke mbledhur forcat kundra njëra-tjetrës: dhe meqenëse ne nuk mund të bëjmë asgjë veçse të jemi të kënaqur me vendimin Hyjnor dhe t'i nënshtrohemi Kaderit të Tij, dhe të marrim ngushëllimin e madh dhe të lartë që buron nga shërbimi i besimit, i Kur'anit dhe i Risale-i Nurit, atëherë ajo që është e domosdoshme për ne që të bëjmë, është të mos shqetësohemi, të mos tronditemi dhe të mos dëshpërohemi; secili prej nesh ta mbështesë tjetrin, ta ndihmojë shpirtërisht, të forcojmë moralin e njëri-tjetrit, të mos kemi frikë dhe ta presim këtë fatkeqësi duke u mbështetur tek Zoti xh.sh., mos u jepni rëndësi gazetarëve zhurmëmëdhenj të cilët e bëjnë qimen tra; ne duhet ta zvogëlojmë çdo gjë që ata e zmadhojnë.

Vëllezërit e mi! Jeta e kësaj dynjaje, veçanërisht në këtë kohë dhe nën këto kushte, është pa vlerë.

Po, le ta presim me kënaqësi çdo gjë na bie.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Dy ose tre nga vëllezërit e mi kanë një mënyrë të mirë për të ngushëlluar vetvetet. Ata thonë këtë: Disa nga vëllezërit tanë të rinj në këtë burg i përballojnë me durim një ose dy vite apo ndoshta dhjetë vite prej kësaj fatkeqësie për shkak të një apo dy orë të aktivitetit të paligjshëm.

Madje disa prej tyre japin falënderime, duke thënë se ata kanë qenë të shpëtuar prej mëkateve të tjera. Ata thonë: Përse duhet të ankohemi për gjashtë ose shtatë muaj mundimi të dobishëm e të mirë, meqënëse ne jemi vënë në shërbim në aktivitetin më të ligjshëm dhe jemi duke i shërbyer besimit nëpërmjet Risale-i Nurit?

Unë i përshëndes ata. Po, të vuash vështirësi për pesë ose për dhjetë muaj me qëllim që të shpëtosh imanin tënd dhe imanin e të tjerëve për pesë ose dhjetë vite, kjo është shkak krenarie e falënderimesh në rrugën e një shërbimi të shenjtë, të dobishëm e të këndshëm, dhe të një ibadeti -adhurimi- të lartë reflektiv. Në një hadith sherif thuhet: "*Që një njeri të vijë në besim nëpërmjet teje, do të ishte më e mirë për ty se sa një fushë e mbushur me dhi të kuqe e me dele".*[212]

Prandaj ju duhet të mendoni për të gjithë njerëzit këtu, në gjykatë dhe në Ankara, besimi i të cilëve ka shpëtuar, dhe do të shpëtojnë nga dyshimet e tmerrshme nëpërmjet shkrimeve dhe shërbimit tuaj, dhe të japim falënderime me durim dhe me kënaqësi.

Në qoftë se Partia e Popullit Republikan, e cila qeveris në Ankara, do të kundërshtonte me kryeneçësi pjesët e fuqishme të Risale-i Nurit të cilat shkojnë atje, dhe nuk bën orvatje që ta mbrojë atë me qëllimin e pajtimit me të, atëherë kjo do të thotë se vendi më i rehatshëm për ne është burgu; dhe gjithashtu do të thotë se ateistët kanë kombinuar -e bashkuar- komunizmin dhe ateizmin, dhe se qeveria është e detyruar t'u nënshtrohet fjalëve të tyre. Dhe atëherë Risale-i Nuri të tërhiqet nga mejdani -sheshi- dhe të ndërpritet aktiviteti i tij, dhe fatkeqësitë materiale dhe jomateriale do të fillonin sulmet.

• • •

[212]Buhari Xhihad 102;

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

O ju bashkësi e xhindeve dhe e njerëzve! "A nuk erdhën te ju të Dërguar nga mesi juaj..."[213]

[Megjithëse këto vërsete pohojnë se profetët u dërguan edhe prej xhindeve gjithashtu, kjo ç'ka vijon është përgjigjja e ustadhit për një pyetje që synoi ta zgjidhë këtë vështirësi.]

Vëllai im i dashur!

Në të vërtetë kjo pyetja jote ka një rëndësi shumë të madhe, por meqenëse funksioni kryesor i Risale-i Nurit është të shpëtojë njerëzimin nga çudhëzimi dhe nga errësirat e mosbesimit absolut, ai nuk ka vend për çështjet e këtij lloji dhe nuk i diskuton ato. Figurat kryesuese të gjeneratave të para të islamit gjithashtu nuk i diskutuan shumë ato. Sepse çështje të tilla të papara e të padukshme zbulohen para shfrytëzimit për keq. Gjithashtu personat mashtrues mund t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre, ashtu siç i kryejnë në këtë kohë hipnotizuesit dhe spiritualistët sharlatanizmat e tyre nën emrin e "marrjes së njoftimeve prej xhindeve". Prandaj kjo çështje nuk duhet të diskutohet shumë, me qëllim që ata të mos e shfrytëzojnë për të dëmtuar fenë. Gjithashtu asnjë profet nuk është dërguar prej xhindeve pas vulës së profetëve a.s.m..

Pastaj, Risale-i Nuri është përpjekur të provojë ekzistencën e xhindeve dhe të qënieve shpirtërore me prova të pakundërshtueshme me qëllim që të hedhë poshtë idetë e materializmit të cilat kanë flamosur me murtajë humanizmin në këtë kohë. Ai i ka futur këto çështje në shkallën -vendin- e tretë, duke ua lënë të tjerëve diskutimin e hollësishëm të tyre -çështjeve.

Shpresojmë që Allahu xh.sh. të përgatisë ndonjë student të Risale-i Nurit që të shpjegojë "Suren *Er-Rahman*" në të ardhmen, dhe ta zgjidhë këtë çështje.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

---

[213] Kur'an,6:130

Për çdo fatkeqësi ne themi: *"Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi."* [214]

Vdekjet e Hafiz Aliut, Hafiz Mehmetit dhe të Mehmed Zÿhdy ishin vërtet një humbje e madhe jo vetëm për ne, por për Ispartën, dhe madje edhe për këtë vend dhe për botën islame. Por deri tani, si një manifestim i përkujdesjes Hyjnore, kurdo që ka humbur një student i Risale-i Nurit, dy ose tre studentë të tjerë janë shfaqur menjëherë të cilët ndjekin të njëjtin sistem. Prandaj, unë kam shpresa të fuqishme se do të shfaqen studentë seriozë të cilët do t'i përmbushin detyrat e atyre studentëve në një formë tjetër. Ata tre njerëz të bekuar përmbushën në një periudhë të shkurtër barasvlerën e njëqind viteve prej detyrave duke i shërbyer çështjes së besimit.

I lutemi Allahut që t'u dhurojë mëshirë atyre sa numri i shkrojave të Risale-i Nurit të cilat ata i shkruan, i botuan dhe i lexuan. Amin!

Dërgoni prej meje ngushëllimet e mia për të afërmit e (Hafiz Muhammed) dhe për fshatin e tij të bekuar. Unë e kam bërë atë një shok për Hafiz Aliun dhe Mehmed Zÿhdyn, dhe i kam përfshirë emrat e të tre atyre midis emrave të atyre mësuesve të mi të cilët ishin polet shpirtërorë. Dhe unë e kam bërë hafiz Akif shokun e Asimit dhe të Lutfiut.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Sipas kuptimit të brendshëm të "*E mira është në atë çfarë zgjedh Zoti"*, është e mirë që u shty kjo çështja jonë. Sepse dashuria për atë njeri të vdekur të tmerrshëm po ngulitet në të gjitha shkollat, në departamentet e qeverisë dhe në të gjitha rrethet e njerëzve.

Dhe kjo gjendje do të kishte një efekt të rëndë e të dhimbshëm në botën islame dhe në të ardhmen. Risale-i Nuri i cili demonstron me prova vendimtare natyrën e vërtetë të atij njeriu, duke kaluar tani - jashtë dëshirave tona- në duart e atyre që janë në majë dhe të atyre që janë më të lidhurit ngushtë me atë njeri -të cilët do të jenë të fundit që do ta braktisin - dhe Risale-i Nuri duke u studiuar me vëmendje dhe me kurreshtje, është një ngjarje e tillë e rëndësishme saqë edhe sikur një mijë njerëz si ne të dërgoheshin në burg, dhe madje të

[214] Kur'an,2:156

ekzekutoheshin, përsëri do të ishte një çmim i lirë për sa ka të bëjë me fenë islame. Sepse kjo të paktën do t'i shpëtojë më kryeneçët e tyre prej mosbesimit absolut dhe prej apostazisë -felëshimit- dhe do t'i nxirrte ata në "mosbesimin e dyshuar" si dhe do të zbuste e kufizonte agresionet e tyre arrogantë dhe të pafytyra.

Ne kemi pretenduar me fjalët e fundit që ne i thamë për fytyrat e tyre në gjykatë:

"Le të sakrifikohen edhe kokat tona gjithashtu për një të vërtetë të shenjtë për të cilën janë sakrifikuar kokat heroike të milionave", se ne do të qëndrojmë deri në fund. Ne nuk heqim dorë nga kjo çështje, dhe shpresoj që të mos ketë midis jush prej atyre që e braktisin atë. Meqenëse ju e keni përballuar me durim dhe keni bërë rezistencë deri tani, atëherë zbukurohuni me durim dhe me qëndresë, sepse fati ynë -kismeti- prej rizkut dhe detyra jonë këtu nuk kanë mbaruar akoma... Sigurisht ata nuk do ta kundërshtojnë me kryeçësi Risale-i Nurin me qëllim që të mbrojnë rrugën e tyre, e cila është provuar në mënyrë të pamohueshme tek trajtesa "Frutat e besimit" se ajo përbëhet nga asgjësimi absolut dhe nga burgimi i përhershëm i vetmuar; por ata do të kërkojnë ndonjë mjet për të bërë pajtim ose do ta lënë.

"Durimi është çelësi i lumturisë dhe i gëzimit."

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Në Rrezen e Parë, aluzionet që janë shpjeguar prej vërsetit, *"A mos vallë është njësoj si ai i cili ishte i vdekur, të cilit Ne i dhamë jetë, dukę i vënë atij një dritë me anë të së cilës ai të ecë mes njerëzve..."* [215] tregojnë për Risale-i Nurin, dhe me fjalën "i vdekur" aludohet për këta studentë të mjerë të Risale-i Nurit. Tani, në ngjarjet e tanishme, njëra prej atyre shenjave është duke u kuptuar. Sepse, duke mbështetur jetën, civilizimin dhe kënaqësinë, ata të cilët na shtypin duke na akuzuar neve se nuk i japim rëndësi atij stili jetese; ata bëjnë akuza kundra nesh, dhe madje dëshirojnë të na burgosin me punë të rëndë ose të na ekzekutojnë. Por ata nuk mund të gjejnë asnjë masë ndëshkimore të ligjshme për këtë. Sa për ne, ne mbështesim vdekjen, parathënien e jetës së përhershme dhe perden e saj, dhe i godasim ata me të në kokat e tyre për t'i sjellë në vete, dhe punojmë me të gjithë fuqinë tonë për t'i

[215] Kur'an, 6:122

shpëtuar ata nga dënimi, nga asgjësimi i përjetshëm dhe nga burgimi i përhershëm i vetmuar. Madje edhe në qoftë se do të më jepeshin edhe dënimet më të rënda për shkak të trajtesave të fuqishme që janë dërguar në Ankara, dhe ata të cilët japin e caktojnë dënimet të shpëtonin nëpërmjet trajtesave prej ekzekutimit të vdekjes, edhe zemra ime edhe nefsi im do të ishin të kënaqur. Domethënë, ne dëshirojmë që ata të kenë jetë në të dyja botët dhe kjo është ajo çfarë ne kërkojmë, ndërsa ata duan që ne të vdesim dhe kërkojnë pretekste për këtë. Por ne nuk mposhtemi përpara tyre, sepse realiteti i vdekjes; dhe tridhjetë mijë kufoma njerëzore në çdo ditë i shfaqin aq qartë dhe dukshëm ashtu si dielli shpalljet dhe dekretet për tridhjetë mijë ekzekutime të përjetshme dhe për tridhjetë mijë burgime të vetmuara për njerëzit e çudhëzimit. Le të bëjnë ata çfarë të duan.

Sipas llogaritjes së *xhefrit* dhe *Ebxhed*, vërseti, *"...Partia e Allahut do të jetë fitimtare"*[216] ka dhënë sihariqe, madje edhe gjatë dymbëdhjetë viteve të mposhtjes sonë më të hidhur, për fitoren tonë së bashku me datën e saj. Meqenëse Realiteti është ky, ne, që tani e tutje, do t'ju themi sa vijon, edhe gjykatës, edhe njerëzve:

Ne përpiqemi që të jemi të shpëtuar prej ekzekutimit të përhershëm, i cili rri gjithmonë në pritë para syve tonë, dhe që të jemi të shpëtuar prej errësirës së përhershme të burgimit të vetmuar të varrit, i cili e hap derën e tij për ne dhe në mënyrë të pashmangshme na bën thirrje. Ne jemi duke ju ndihmuar juve që të shpëtoni prej asaj fatkeqësie të tmerrshme të pashmangshme. Çështjet e politikës dhe të kësaj dynjaje, të cilat në shikimin tuaj janë më të rëndësishmet, në shikimin tonë dhe në atë të realitetit kanë pak vlerë, dhe për ata që nuk interesohen drejtpërdrejtë, janë të pakuptimta, të parëndësishme dhe të pavlefshme.

Ndërsa detyrat njerëzore të domosdoshme dhe esenciale me të cilat ne jemi preokupuar kanë një lidhje të përnjëmendshme, të vërtetë, me gjithësecilin në të gjitha kohët. Ata të cilët nuk e pëlqejnë këtë detyrën tonë dhe duan t'i japin fund asaj, le t'i japin fund vdekjes dhe të mbyllin varrin!

Pikat e treta dhe e katërta nuk janë shkruar tani.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

[216] Kur'an, 5:56

Një nga çudirat e Risale-i Nurit është se qysh prej dhjetë vitesh Ustadh Bediuzzamani në mënyrë të përsëritur tha: O ateistë dhe felëshues! Mos ndërhyni tek Risale-i Nuri! Sepse Risale-i Nuri është një mjet për zmbrapsjen e fatkeqësive ashtu si sadekatë -lëmoshat-; Prandaj, sulmi kundra tij ose pengimi i tij nga aktiviteti dobëson mbrojtjen e tij nga katastrofa. Në qoftë se ju e trazoni, i bini më qafë atij, atëherë fatkeqësitë që janë duke pritur në afërsi, do t'ju bien me përmbytje. Ndodhen fatkeqësi të shumta që ne kemi dëshmuar lidhur me këtë.

Sa herë që Risale-i Nuri dhe studentët e tij janë sulmuar gjatë katër viteve të shkuara, një fatkeqësi apo katastrofë ka ardhur, duke demonstruar rëndësinë e Risale-i Nurit dhe se ai është mjet për të larguar e zmbrapsur fatkeqësitë. Midis qindra ngjarjeve që Bediuzzamani parashikoi nëpërmjet Risale-i Nurit, fatkeqësitë kanë nënshkruar -kanë vënë firmën- për drejtësinë e tyre me dorën e tërmeteve; katër fatkeqësitë që i ndoqën ato, treguan se si Risale-i Nuri është mjet për zmbrapsjen e fatkeqësive. Zoti dhëntë besim në zemrat e atyre që na sulmojnë ne dhe Risale-i Nurin, dhe dhëntë mend e sy në kokat e tyre që ta shohin të vërtetën; dhe na shpëtoftë neve nga këto burgje të nëndheshme dhe ata prej atyre fatkeqësive. Amin!

Husrevi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Është një manifestim prej manifestimeve të Përkujdesjes Hyjnore që ndërsa e prisnim ministrin e Arsimit të shpërthente e të na sulmonte, ndonëse ai nuk i kishte parë mbrojtjet tona, dokumentet, librat, por vetëm i kishte parandjerë e perceptuar; dhe megjithëse departamentet më të larta të shtetit i kishin studiuar trajtesat tona më të fuqishme private, si Rrezen e Pestë dhe Shtojcën e "Gjashtë Sulmeve" me qëllim që t'i kritikonin; dhe mbrojtjet tona që kundërshtuan me ashpërsi mosbesimin absolut dhe me gjithë guximin zbritën goditje të fuqishme mbi të -unë them se ndërsa prisnim që Ankaraja të vepronte me ashpërsi kundra nesh; kur ç'të shohësh, ata morën një qëndrim të zbutur, madje një qëndrim pajtues, një pozicion që lidhet me rëndësinë e çështjes. Një arsye për këtë manifestim të Përkujdesjes Hyjnore është kjo: Risale-i Nuri duke u lexuar me kujdes e me vëmendje në të gjithë vendin, si rezultat i interesit, është bërë një "*ders'hanë*" e madhe ose

një vend i madh studimi dhe duke u studiuar nga të gjitha departamentet e qeverisë.

Po, mësime të tilla të lartësuara duke u studiuar në këtë kohë në një shkallë të tillë gjithëpërfshirëse dhe universale, sigurisht është një shembull domethënës i Përkujdesjes Hyjnore dhe është një shenjë e fuqishme që Risale-i Nuri e ka copëtuar mosbesimin absolut.

O Vëllezërit e mi! Duke supozuar se mund të jetë një justifikim për disa burra familjarë e të dobët të cilët kanë vuajtur shumë mundim e humbje, që janë me të ardhura të pakta, mund të tërhiqen pak prej Risale-i Nurit dhe prej nesh, ose madje mund të na braktisin, unë them se si rrjedhojë e kësaj mundësie, ata mund të ndryshojnë pasi të jenë liruar: do të ishte një humbje e rëndë për ata që e kanë paguar këtë çmim, material dhe jo material, për mallrat e një vlere të tillë, dhe kanë vuajtur shumë tortura në rrugën e tyre, në qoftë se do të hiqnin dorë prej tyre, kjo do të ishte një humbje e madhe. Në qoftë se ata papritmas e braktisin Risale-i Nurin dhe pjesët e tij, dhe lidhjen e tyre me të, dhe braktisin mbrojtjen e tyre ndaj nesh dhe nuk na shërbejnë më, kjo do të ishte një humbje e panevojshme për ata dhe për ne. Për këtë arsye, përveç të qenurit i kujdesur, është e domosdoshme të mos ndryshojnë besnikërinë e tyre, lidhjet e tyre dhe shërbimin ndaj besimit.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një manifestim i Përkujdesjes Hyjnore dhe një shembull i mbrojtjes Hyjnore është se, unë kam dëgjuar se komiteti i ekspertëve në Ankara është mposhtur përballë të vërtetave të Risale-i Nurit, dhe ndërsa ndodhen disa arsye për ta kritikuar e për ta kundërshtuar fort, komiteti thjesht nxori vendimin për pafajësinë e Risale-i Nurit. Megjithatë, shprehjet e ashpëra në trajtesat private dhe fjalët sfiduese në Mbrojtjet të cilat i kundërshtojnë ata, dhe sulmet e ashpëra të ministrit të arsimit, dhe prania e dy filozofëve materialistë të lidhur me ministrinë e arsimit në grupin e ekspertëve, dhe prania e një dijetari të madh i cili mbështet masat e reja (përmbysjet), dhe një organizatë ateiste e fshehtë gjatë vitit të kaluar nxiste partinë e popullit Republikan dhe ministrinë e arsimit kundra nesh...

Unë them:

Ndërsa ne prisnim kundërshtime të ashpra dhe dënimet më të rënda prej grupit të ekspertëve -për arsyet e lartëpërmendura- por ndërkohë

Mbrojtja Hyjnore dhe Përkujdesja e të Gjithëmëshirshmit na erdhën në ndihmë, dhe u shfaqi atyre stacionin e lartë të Risale-i Nurit dhe i largoi ata prej dhënies së kritikave të ashpëra. Madje me idenë që të na shpëtonin neve nga dënimet dhe kjo për shkak të çështjes së Eskishehirit dhe të incidentit të famshëm të 31 Marsit unë nuk duhej të shihesha si një i dënuar më parë për krime politike, dhe për të treguar se ne veprojmë vetëm për fe e për besim dhe nuk kemi qëllime politike, ata thanë: "Said Nursi ka pretenduar qysh prej shumë kohësh se është një trashëgimtar i Profetit, dhe ka adoptuar e përqafuar pozitën e një *Muxhed-didi* -Ripërtëritësi- në shërbim të Kur'anit dhe të Imanit. Domethënë ndonjëherë ai mposhtet nga një gjendje dalldie -ekstaze- dhe shmanget. Me këtë paragraf dhe me shprehjet jofetare të filozofëve, ata i thonë cilitdo njeriu që mbështet fenë: Atëherë ai punon për *texhdid* -ripërtëritje- nëpërmjet trashëgimisë së profetësisë! Ata i kanë përdorur ato terma filozofike jofetare me qëllim që edhe të kritikojnë opinionet tepër të mira për mua që kanë disa nga vëllezërit e mi, opinione të cilat janë shumë më të larta se sa i meritoj; ose duke më atribuuar një dalldi, ekstazë gjatë fjalës sime të ashpër, me qëllim që të më shfajësojnë mua nga përfshirja në politikë dhe që të mos dënohem prej saj; dhe për t'i lajkatuar deri diku ata të cilët na kundërshtojnë dhe që janë armiqësorë kundra nesh; dhe për të treguar se aluzionet e Kur'anit, treguesit e çuditshëm të Imam Aliut, dhe të vërtetat e Gauth el-Aëdham, që të gjitha janë të fuqishme; dhe për të thyer ambicien, egoizmin dhe mendjemadhësinë të cilat duke i krahasuar me të tjerët ata mendojnë se ato janë të pranishme tek unë. Nga fillimi gjer në fund, Risale-i Nuri jep përgjigje për ato fjalë në mënyrë aq të shndritshme si dielli. Dhe meqenëse rruga jonë është vëllazëria dhe braktisja e egoizmit, dhe meqenëse ne nuk kemi bërë asnjë shprehje të ekzagjeruar e të dalldisur që të tregojë vetëmburrje; jeta e thjeshtë me përulësi e Saidit të Ri në kohën e Risale-i Nurit, dhe shpërfillja e tij ndaj opinioneve të mira për të prej vëllezërve të tij të bekuar dhe duke i moderuar ata me instruksionet dhe me mësimet e tij të përsëritura; -që të gjitha këto- i hedhin krejtësisht poshtë nënkuptimet e atyre shprehjeve, dhe i largojnë ato nga mendja.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë nuk do t'jua dërgoj juve vendimet unanime të komitetit të ekspertëve, për momentin, me qëllim që të mos u shkaktohet asnjë dëm atyre të cilët na informuan. Ky komiteti i fundit i ekspertëve ka bërë qartë gjithçka që ka mundur për të na shpëtuar neve prej të keqes

së njerëzve të çudhëzimit dhe të bidatit, dhe na ka nxjerrë të pafajshëm prej të gjitha akuzave të bëra kundra nesh. Ata na japin neve të ndjejmë e të perceptojmë se ata e kanë kapur plotësisht atë çfarë jep mësim Risale-i Nuri, dhe unanimisht kanë vendosur se pjesa më e madhe e Risaleve është shkruar në mënyrë shkencore dhe janë për besimin; dhe se "Saidi" i shpjegon pikëpamjet e tij edhe me sinqeritet, edhe me seriozitet; Dhe forca dhe fuqia që janë tek ai nuk janë ashtu siç i atribuohet se ai dëshiroka të formojë një tarikat Sufi dhe të themelojë një xhemat që të konfrontohet me qeverinë; por forca dhe fuqia e tij janë veçse për t'ua përcjellë e mësuar të vërtetat e Kur'anit atyre që kanë nevojë për to.

Ata thanë gjithashtu lidhur me trajtesat private të Risale-i Nurit për të cilat u shprehën se ato janë të pashkolluara, nuk janë shkencore: "Ai ndonjëherë kalon në ekstazë dhe vuan shqetësime emocionale dhe turbullira mendore", dhe prandaj ai nuk mund të jetë përgjegjës për këto trajtesa". Kështu kuptohet nga vendimi i tyre.

Gjithashtu, lidhur me termat "Said i Vjetër" dhe "Saidi i Ri", ata thanë se ndodhen dy personalitete dhe nënkuptuan se në të dytin gjenden një fuqi e jashtëzakoshme besimi dhe njohje për të vërtetat e Kur'anit: dhe për hir të filozofëve materialistë, ata thanë: ndodhet mundësia e një lloji dalldie tek ai dhe një turbullirë mendore". Ata e thanë këtë me qëllim që të na shpëtonin prej pasojave të shprehjeve të trajtesave private të fshehta, dhe për të qetësuar ndjenjat e kundërshtarëve tanë; dhe gjithashtu ata thanë -brenda kësaj ndjeshmërie-: Ndoshta ai është goditur me ndonjë sëmundje mendore dhe e shikon imagjinatën si realitet".

Trajtesat e Risale-i Nurit të cilat janë shumë më të larta se sa produktet e tjera të mendjes, formojnë një përgjigje të mjaftueshme për nënkuptimin e kësaj mundësie, duke e refuzuar atë totalisht. Ata i kanë shtënë në dorë këto trajtesa, dhe trajtesat që përmbajnë "Fjalën Mbrojtëse" dhe trajtesën e Frutave, të cilat i lanë të gjithë avokatët në habi.

Unë falënderoj shumë Allahun që m'u dhurua mua -me këtë mundësi- ajo për të cilën aludon hadithi sherif.

Gjithashtu, komiteti i ekspertëve vendosi unanimisht për t'i shpallë të pafajshme të gjithë fushën tonë -mua dhe vëllezërit e mi- prej akuzave. Ata thanë: "Ata -studentët, vëllezërit- janë të lidhur me Saidin për shkak të veprave të tij shkencore të holla për të shpëtuar besimin dhe Ahiretin e tyre, dhe nuk kemi gjetur asnjë shenjë të

nënkuptojë qëllimin e tyre të keq kundra qeverisë, dhe nuk kemi gjetur asgjë të tillë as në letrat e tyre dhe as në librat e tyre"; dhe vendimin e firmosën tre persona: Njëri prej tyre ishte filizof Nexhati, tjetri ishte Jusuf Zijai (Dijetari), dhe i treti ishte filozof Jusufi.

Është një koinçidencë e hollë se ndërsa ne, për veten tonë, e quajmë këtë burg se është një shkollë e Jusufit, *Medresetu Jusufie*, dhe trajtesën e Frutave si frutat e saj, edhe këta të dy të quajtur me emrin Jusuf thanë nëpërmjet gjuhës së gjendjes: Edhe ne gjithashtu kemi marrë pjesë fshehurazi në mësimet e kësaj shkolle të Jusufit - *Medresetu ez-zehra*.

Për më tepër, dëshmia e hollë e tyre për mundësinë e dalldisë - ekstazës- dhe të turbullirave janë frazat si "Fjala e Tridhjetë e Tre dhe Mektubi i Tridhjetë e Tre me Tridhjetë e Tre Dritaret... si dhe shprehjet e tjera të ngjashme me to..., po kështu dëgjimi i tij macet duke bërë tesbihate me Emrin "Ja Rahim, Ja Rahim... "dhe se e sheh vetveten si një gur varri..."

Ata i shfaqën këto shprehje si tregues dalldie dhe shikimin e imagjinatës si realitet.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Meqenëse ne jemi nën Mbrojtjen Hyjnore ashtu siç tregojnë për të shenja të shumta, dhe meqenëse Risale-i Nuri nuk është mposhtur përballë armiqve të shumtë tiranë, dhe meqenëse ai e ka heshtur deri diku ministrin e arsimit dhe partinë e popullit republikan, dhe meqenëse ata të cilët e ekzagjëruan aq shumë çështjen tonë saqë e bëri qeverinë të shqetësuar dhe të tronditur, do të përpiqen me çdo mjet që t'i fshehin gënjeshtrat dhe shpifjet e tyre... atëherë duhet patjetër që ne të vishemi me durim dhe të ruajmë gjakftohtësinë tonë me nështrim të plotë ndaj urdhrit të Allahut dhe të jemi të qëndrueshëm, dhe në mënyrë të veçantë, të mos ndjehemi të zhgënjyer, dhe të mos biem në pesimizëm kur ndonjëherë ndodh e kundërta e asaj që ne shpresuam, dhe të mos lëkundemi përpara stuhive të përkohshme kalimtare.

Po, zhgënjimet mund të shkatërrojnë moralin dhe entuziazmin e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, ndërsa për studentët e Risale-i Nurit, të cilët i shohin favoret e përkujdesjes dhe të mëshirës

Hyjnore nën vuajtjet, mundimet dhe përpjekjet, ai -zhgënjimi- forcon përpjekjet e tyre, përparimin dhe seriozitetin e tyre. Para dyzet vitesh njerëzit politikanë të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje më dërguan në spitalin e çmendisë duke thënë se unë po vuaja nga një krizë e përkohshme çmendurie. Unë u thashë atyre: Atë çfarë ju e shikoni racionale, mendore, unë e shoh mungesë logjike, çmendurie; unë tërhiqem prej asaj gjendje të mirë mendore.

Unë vëzhgoj tek ju rregullin: Të gjithë njerëzit janë të çmendur, por çmenduria e tyre ndryshon sipas kapriçove -tekave- të tyre".

Tani gjithashtu unë them të njëjtën fjalë për ata të cilët më atribuan një çmenduri të përkohshme me qëllim që të më shpëtonin mua dhe vëllezërit e mi prej një përgjegjësie të madhe dhe sikur një lloj çmendurie më paska rënë për shkak të trajtesave private të fshehta: unë e përsëris fjalën duke shpjeguar kënaqësinë time për çmendurinë në dy drejtime:

Së Pari: Në një hadith të saktë, thuhet*: "Më i plotësuari në besim prej besimtarëve është ai të cilin njerëzit e zakonshëm e konsiderojnë të çmendur".*[217] Njerëzit e zakonshëm i vlerësojnë kështu për shkak se ata janë përtej konceptimit të tyre, pasi nuk mund t'i perceptojnë stacionet e lartësuara që ata kanë arritur në iman.

I Dyti: Unë nuk kënaqem vetëm duke më atribuar mua çmendurinë, por do të sakrifikoja mendjen time të plotë dhe të gjithë jetën time me të gjithë krenarinë për hir të shpëtimit të vëllezërve të mi, për hir të mirëqënies së tyre dhe për t'i shpëtuar ata nga errësirat e këtij burgu.

Në qoftë se ju e mendoni të përshtatshme të shkruhet një letër falënderimi për ata tre persona, dhe u thoni atyre se ne i lejojmë të ndajmë me ta fitmet tona shpirtërore.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë, dhe shokët e mi të sinqertë në shërbim të Kur'anit dhe të besimit, dhe o shokët e mi të pandashëm në rrugën e së vërtetës dhe të realitetit dhe në botën e ndërmjetme dhe në Ahiret!

Me rastin e afrimit të kohës së ndarjes prej njëri-tjetrit, duhet që gjithësecili prej jush ta falni krejtësisht njëri-tjetrin për shkak të

---

[217] Transmeton. Ahmedi, Hakimi. Etj.

gabimeve dhe tensioneve që shkaktohen nga mërzitjet dhe nga shqetësimi dhe të cilat ndodhën për shkak se nuk u ruajtën parimet e sinqeritetit. Ju jeni vëllezër më të afërm për njëri-tjetrin se sa më të përkushtarit prej vëllezërve të gjakut, dhe vëllai i mbulon të metat e vëllait të tij, i fal ato dhe i harron.

Unë nuk ia atribuoj ndryshimet tuaja të pazakonta dhe egoizmin këtu nefseve urdhërues për të liga, dhe unë nuk mund ta gjej atë të përshtatshme me studentët e Risale-i Nurit; përkundrazi unë e konsideroj atë të jetë një lloj i egoizmit të përkohshëm i cili gjendet madje edhe tek Evlijatë e drejtë të cilët i kanë braktisur nefset e tyre.

Prandaj nga ana juaj, mos e prishni mendimin tim të mirë për ju nëpërmjet kokëfortësisë, dhe pajtohuni me njëri-tjetrin.

• • •

Vëllezërit e mi!

Kuptohet nga raporti i komitetit të ekspertëve se Risale-i Nuri i mposhti të gjitha grupet që na kundërshtojnë, sepse duke përsëritur trajtesën "Huxhxhehull-llahul-Baligah" dhe trajtesën për të mosharit dhe trajtesën rreth sinqeritetit, ata janë duke tërhequr vëmendjen për tek ato. Për më tepër, qëllimi ekstrem dhe sipërfaqësor i pseudohoxhallarëve fanatikë si kritikat, përgjigjjet për të cilat janë mjaft të qarta; dhe thënia e tyre pa kapur se cilat çështje nuk kanë lidhje dhe cilat janë në të vërtetë të përputhshme, se "ka një kontradiktë ndërmjet tyre", dhe pohimi i tyre pa ngurrim dhe vlerësimi i tyre për nëntëdhjetë përqind të trajtesave pavarësisht refuzimit të fuqishëm në shtojcën e "Huxhumat Sitte" "Gjashtë Sulmet", prej atyre që kanë nxjerrë fetvanë për bidate -risi- dhe sulmet mbi ta, është vetëm që të justifikojnë vetveten. Për më tepër, njoftimi i tyre me shfaqjen se thënia ime që, kristianët e përndjekur fetarë të cilët janë vrarë nga armiqtë e fesë në fund të kohës mund të jenë një lloj martirësh, është kontradiktore me sulmet e ashpra të Shtojcës duke kryer faljet me kokë të pambuluar dhe duke e bërë thirrjen e ezanit në Turqisht, kjo i jep bindje njeriut se ata janë shpartalluar përfundimisht prej Risale-i Nurit.

Said Nursi

• • •

RREZJA E KATËRMBËDHJETË

“Mbrojtjet”

Një shtojcë shumë e shkurtër e Raportit tim.

Unë i them kësaj Gjykatës së Afjonit:

Ashtu siç thashë në raportin tim, i cili është paraqitur tek ju dhe është vënë para ligjit dhe drejtësisë së tij: të bastisësh shtëpinë time tri herë në mënyrë të paligjshme, më shtyn të bëj pyetje dhe, pastaj arrestimi që më bëtë, e gjitha kjo përbën shkelje ndaj dinjitetit të të tre gjykatave dhe prek drejtësinë dhe respektin e tyre, dhe madje i fyen. Sepse ato tre gjykata dhe tre komitete ekspertësh i kanë hetuar e shqyrtuar me imtësi gjatë dy viteve librat dhe letrat e mia të cilat i kam shkruar për njëzet vite. Dhe ata nxorën vendimin e tyre unanim për pafajësinë tonë; dhe u rikthyen tek ne librat dhe letrat tona.

Pas pafajësisë, qysh prej tre viteve, unë jetoj në *inziva* -i veçuar- prej njerëzve dhe nën mbikqyrjen më të rreptë, unë kam qenë në gjendje të shkruaj vetëm një letër të padëmshme një javë për disa nga shokët e mi. Ishte sikur të gjitha lidhjet e mia të kësaj bote të ishin këputur, sepse megjithëse mua më ishte dhënë liria, unë nuk mund të kthehesha në vendlindjen time. Ajo ka dhunuar nderin e atyre tre gjykatave për të ngritur përsëri të njëjtën çështje tani, është sikur të shpërfillnit krejtësisht dhe duke mos marrë parasysh vendimet e tyre të drejta.

Për hir të mbrojtjes së nderit të atyre gjykata të cilat vepruan me drejtësi ndaj meje, unë shpresoj nga gjykata juaj që të kërkoni ndonjë shkak tjetër dhe ndonjë çështje tjetër me të cilat të më akuzoni, përveç çështjeve që janë: “Risale-i Nuri”, “Organizimi i një shoqërie politike”, “Themelimi i ndonjë tarikati sufi” dhe “Mundësia e prishjes së rendit dhe të qetësisë publike”, pasi ato përbëjnë të njëjtën çështje! Unë kam shumë gabime. Unë kam vendosur t’ju ndihmoj juve lidhur me aktet e mia të dëmshme, meqë unë kam vuajtur më shumë jashtë burgut se sa brenda tij. Unë tani do të gjeja më shumë rehati ose në varr ose në burg. Me të vërtetë që më është mërzitur jeta. Mjaft tani më me këto njëzet vite torture në burgim të vetmuar nën mbikqyrje të padurueshme dhe në poshtërim. Kjo do të shkaktonte zemërimin

Hyjnor. Kjo do ta çonte në humbje këtë vend. Unë po ju kujtoj juve këtë:

Vendstrehimi më i madh dhe më i fuqishëm për ne është:

"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve!"[218]

"Allahu është më se i Mjaftueshëm për mua, nuk ka Zot tjetër të Adhuruar tjetër-përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem, dhe Ai është Zoti i Arshit madhështor".[219]

• • •

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.
Dhe prej Tij ne kërkojmë ndihmë.

[Ky peticion, të cilin pas një heshtje që zgjati tetëmbëdhjetë vite, u detyrova ta paraqes tek gjykata dhe një kopje të të cilit unë jam duke ia dërguar Ankarasë, përmban kundërshtimet e mia të shkruara lidhur me akuzën, për të cilën unë jam i detyruar ta paraqes.]

Kjo është një përmbledhje e një Fjale të shkurtër mbrojtëse: Duhet të dihet se është ekzaktësisht e njëjta vërtetësi - që dy herë ia kam thënë prokurorit të përgjithshëm dhe inspektorit të policisë dhe në rastin e tretë ia thashë drejtorit të policisë dhe gjashtë ose shtatë individëve të policisë, të cilët erdhën tri herë dhe kërkuan shtëpinë time në Kastamonu, dhe ajo çfarë u thashë në përgjigje pyetjeve të prokurorit të përgjithshëm në Isparta, dhe Gjykatës së Denizlit dhe të Afjonit, është sa vijon:

Unë u thashë: kam jetuar vetëm për tetëmbëdhjetë deri në njëzet vite. Kam jetuar tetë vite në Kastamonu përballë rajonit të policisë, dhe në vende të tjera për njëzet vite, nën mbikqyrjen dhe nën vëzhgim të vazhdueshëm; dhe vendi ku rrija është kërkuar në disa raste, por nuk është gjetur as aluzioni dhe as shenja më e vogël që të kishte të bënte me këtë dynja apo me politikat. Në qoftë se do të kishte pasë ndonjë gjë që të ndërhynte tek ato, sigurisht policia dhe drejtësia do të kishin qenë në dijeni të saj, ose ata e njohën por e injoruan; domethënë, ata janë përgjegjës në një shkallë më të lartë se sa unë.

Meqenëse çështja është kështu, atëherë përse më bezdisni deri në këtë shkallë pa qenë nevoja, pa i shkaktuar dëm as vendit, as kombit dhe as njerëzve. Duke ditur se askund në botë nuk shqetësohen ata që

[218] Kur'an, 3:173
[219] Kur'an, 9:129

janë të veçuar, të vetmuar dhe që preokupohen me jetët e tyre të Ahiretit.

Ne studentët e Risale-i Nurit nuk e bëjmë Risale-i Nurin një mjet për rrymat politike, madje as për të gjithë universin. Për më tepër, Kur'ani Kerim na ka ndaluar rreptë nga marrja me politikë. Sepse detyra kryesore e Risale-i Nurit është që t'i shërbejë Kur'anit Kerim nëpërmjet të vërtetave të besimit dhe nëpërmjet provave shumë të fuqishme dhe vendimtare, kundër mosbesimit Absolut -i cili e shkatërron jetën e përhershme dhe gjithashtu e transformon jetën e kësaj bote në një helm të tmerrshëm e të padurueshëm.

Metoda jonë në këtë: Është të shfaqim të vërtetat e Imanit të mbështetura me argumente të fuqishëm që do t'i detyronin edhe filozofët më kryeneçë që t'i nënshtrohen besimit. Prandaj ne nuk kemi të drejtë që ta bëjmë Risale-i Nurin mjet për çfarëdo qoftë, dhe kjo për disa arsye:

Së Pari: Me qëllim që të mos transformohen të vërtetat e Kur'anit -të cilat tejkalojnë diamantet në vlerë- në copa qelqi që thyhen në shikimin e njerëzve të pakujdesshëm meqë mund t'i imagjinojnë ato si propagandë politike duke u shërbyer disa qëllimeve të caktuara, dhe që të mos përbuzen ato kuptime të vlefshme Kur'anore.

Së Dyti: Metoda e Risale-i Nurit që përbëhet nga: Mëshira, drejtësia, vërtetësia, realiteti dhe ndërgjegjja, na pengon rreptë nga ndërhyrja në çështje politike ose në pushtetin qeverisës. Sepse në qoftë se do të ndodheshin atje disa prej atyre që janë sprovuar me ateizëm dhe meritojnë me të ndëshkim, mirëpo prapa gjithësecilit prej tyre është një numër prej fëmijëve, të sëmurëve, dhe pleqve të pafajshëm.

Në qoftë se do të zbriste tek ndonjëri prej atyre të sprovuarve dhe të merituesëm për dënim ndonjë katastrofë ose ndonjë fatkeqësi, atëherë ata të pafajshëm gjithashtu do të digjeshin me zjarrin e tyre pa pasë bërë asnjë faj. Po kështu, meqenëse arritja e rezultatit të dëshiruar është çështje e dyshuar, prandaj ne jemi të penguar rreptësisht për të ndërhyrë në çështjet administrative gjë që mund të prishë rendin publik nëpërmjet mjeteve politike.

Së Treti: Në një kohë të çuditshme si kjo koha jonë, pesë parime të qëndrueshme janë të domosdoshme -esenciale- me qëllim që të shpëtojmë jetën sociale të këtij vendi dhe kombi nga anarkia dhe copëtimi. Këto parime janë:

1-Respekti i ndërsjellë

2-Dhembshuria e mëshira

3-Largimi nga ajo që është haram -e ndaluar.

4-Ruajtja e rendit.

5-Të flakim paligjshmërinë dhe anarkinë dhe të jemi të bindur ndaj autoritetit.

Dëshmia që Risale-i Nuri kur shikon tek jeta e shoqërisë i vërteton dhe i përforcon këto pesë parime në një mënyrë të fuqishme dhe të shenjtë dhe ruan gurin themeltar të rendit publik, është se për më shumë se njëzet vite, Risale-i Nuri i ka bërë njëqind mijë njerëz anëtarë të padëmshëm e të dobishëm të këtij kombi e vendi. Kjo do të thotë se Provincat e Ispartës dhe të Kastamonus dëshmojnë për këtë.

Kjo do të thotë se me dijeni ose padijeni shumica më e madhe e atyre të cilët përpiqen të pengojnë Risale-i Nurin janë duke tradhëtuar vendin, kombin dhe sundimin e Islamit për hir të anarkisë dhe të ekstremizmit.

Njëqind e tridhjetë trajtesat prej pjesëve të Risale-i Nurit të cilat i kanë dhënë njëqind e tridhjetë mirësi të mëdhaja e dobi këtij kombi, nuk mund të refuzohen prej dëmeve të imagjinuar të dy ose tre prej pjesëve të saj, të cilat supozohen të jenë të dëmshme në shikimin sipërfaqësor të pakujdesisë së mashtruar. Ai që i refuzon ato trajtesa për këto dyshime e iluzione, sigurisht është i padrejtë dhe tiran i madh.

Sa për fajet dhe gabimet e mia personale të parëndësishme, unë detyrohem pa dëshirën time të them këtë:

Unë jam dikush i cili ka jetuar i vetmuar dhe i veçuar në syrgjynosje që i ngjason një burgimi të vetmuar dhe i larguar nga rrethanat e njerëzve.

Gjatë kësaj kohe unë nuk kam shkuar asnjëherë me dëshirën time në treg, në ndonjë vendtakim me njerëzit dhe në xhamitë që ka pjesëmarrje të mirë. Pavarësisht se kam vuajtur shumë mundime e persekutime, unë asnjëherë nuk i jam drejtuar qeverisë për rehatinë time, ndryshe nga të internuarit e tjerë me mua. Gjatë njëzet viteve unë nuk kam lexuar asnjë gazetë të vetme, as nuk e kam dëgjuar dhe as nuk kam qenë kurreshtar rreth saj. Siç dëshmohet nga të gjithë shokët e mi të afërt dhe nga ata me të cilët takohem, për plot dy vite në Kastamonu dhe shtatë vite në vendet e tjera unë nuk kam mësuar asgjë për konfliktet dhe për luftërat në botë, dhe nëse është deklaruar paqë apo jo, dhe cilat janë palët ndërluftuese, kush u përfshi në luftime... dhe nuk kam qenë kureshtar rreth saj dhe nuk kam pyetur për të. dhe për afërsisht tre vite nuk kam dëgjuar as radion që ishte pranë meje. Por unë triumfalisht u përballa me mosbesimin absolut nëpërmjet

Risale-i Nurit; unë u konfrontova me atë mohim absolut i cili shkatërron jetën e përhershme dhe madje e transformon jetën e kësaj bote në dhimbje të shumëfishta dhe në torturë e vuajtje; dhe me Risale-i Nurin, i cili vjen nga shkëlqimet e Kur'anit, unë kam shpëtuar besimin e njëqind mijë njerëzve të tillë, siç është dëshmuar prej tyre, dhe për njëqind mijë njerëz e ka transformuar vdekjen në dokumente lirimi në vend të ekzekutimit të përjetshëm. A ka ndonjë ligj që të kërkojë që një person i tillë -synon vetveten- duhet të sfilitet e të bezdiset deri në këtë shkallë, duhet të bëhet të vuajë, madje të bëhet të vajtojë, gjë që i bën të qajnë njëqind mijë prej vëllezërve të tij. Madje çfarë interesi ka në këtë? A nuk është kjo një tirani e paparë, e paprecedent në emrin e drejtësisë? A nuk është një gabim i paprecedent i drejtësisë në emër të ligjit?

Në qoftë se ju më akuzoni ashtu si disa prej zyrtarëve të cilët bënë kërkime në shtëpinë time duke thënë: "Ti dhe një ose dy nga trajtesat e tua kundërshtoni regjimin tonë dhe parimet tona..."

Përgjigjja:

Së Pari: këto parimet tuaja të reja nuk kanë absolutisht të drejtë të ndërhyjnë tek ata që jetojnë të veçuar e të vetmuar dhe që janë të tërhequr.

Së Dyti: Të refuzosh diçka është një gjë, dhe të mos e pranosh atë është krejtësisht gjë tjetër. Ata që janë në pushtet shikojnë dorën dhe jo zemrën. Të gjitha qeveritë kanë kundërshtarë të fuqishëm të cilët nuk ndërhyjnë në qeveri dhe në çështjet administrative dhe në rendin publik. Madje edhe krishterët të cilët ishin nën sundimin e kalifit Umer, Zoti qoftë i kënaqur me të, nuk përziheshin në ato çështje, megjithëse ata e refuzonin islamin dhe ligjet e sheriatit. Atëherë, duke u mbështetur në parimin e lirisë së mendimit dhe të ndërgjegjjes, në qoftë se disa nga studentët e Risale-i Nurit nuk pranojnë sistemin dhe parimet tuaja dhe i kritikojnë me baza shkencore, dhe në qoftë se ata veprojnë kundër me ato parime, madje edhe në qoftë se janë armiqësorë ndaj kryetarit të regjimit, ata nuk mund të preken ligjërisht por me një kusht të vetëm i cili është: që ata të mos ndërhyjnë në çështjet administrative dhe të mos prishin rendin dhe qetësinë publike.

Sa për trajtesat, unë thashë se ato ishin private të fshehta dhe ishte i ndaluar botimi i tyre. Në fakt, lidhur me trajtesën e cila qe shkaku për këtë ngjarje të hidhur, vetëm një ose dy herë gjatë tetë viteve në Kastamonu dikush ma solli mua një kopje të vetme. Në të njëjtën ditë

e vendosa atë dikund. Ndërsa tani ju po e botoni forcërisht atë, ajo është bërë e famshme.

Është e njohur se, në qoftë se ka ndonjë gabim në një letër, vetëm fjalët gabim hiqen, dhe të tjerat lejohen të qëndrojnë. Si rezultat i katër muajve hetimi e shqyrtimi me imtësi në Gjykatën Eskishehir, vetëm pesëmbëdhjetë fjalë u gjetën në njëqind trajtesa të Risale-i Nurit që ishin shkak kritike, dhe tani vetëm në dy faqe prej katërqind faqeve të koleksionit të "*Dhul-fikarit*" ndodhen shpjegimet e vërseteve Kuranore që kanë të bëjnë me trashëgiminë e gruas dhe me mbulesën -Hixhabin- e saj; dhe ai koment u shkrua para tridhjetë vitesh dhe tani nuk përputhet e nuk përshtatet me kodin civil. Kjo provon në mënyrë vendimtare se synimi i Risale-i Nurit nuk është dynjaja, por të gjithë njerëzit kanë nevojë për të. Katërqind faqet e koleksionit *Dhul-Fikar* nuk mund të konfiskohen për shkak të dy faqeve. Ato dy faqe mund të hiqen dhe koleksioni të na rikthehet; është e drejta jonë që ai të na rikthehet.

Në qoftë se ju do të thonit si ata të cilët e supozojnë pafesinë të jetë një lloj politike dhe në këtë ngjarje ata kanë thënë: "Ti po na prish civilizimin tonë dhe kënaqësitë tona me këto trajtesat e tua..."

Unë përgjigjem: Është një parim universal i pranuar gjërësisht se asnjë komb nuk mund të vazhdojë në ekzistencë pa fe. Në mënyrë të veçantë, në qoftë se do të ishte mosbesim absolut, ky do të shkaktonte në këtë botë tortura më të dhimbshme se sa Ferri, ashtu siç është provuar me siguri të plotë në trajtesën "Udhëzuesi për të rinjtë". Ajo trajtesë tani është botuar zyrtarisht. Në qoftë se, -Ruajnë Zot- një mysliman lëshon fenë -dezerton-, ai bie në mosbesim absolut; ai nuk mbetet në "mosbesimin e dyshuar", i cili e mban atë gjallë deri në një farë mase. Ai gjithashtu nuk mund të jetë si ateistët e Europës. Dhe në lidhje me kënaqësitë e jetës që i përfytyron, ai bie shumë më poshtë se sa niveli i kafshëve; sepse për to -për kafshët- nuk ka kuptim e shkuara dhe e ardhmja.

Për shkak të çudhëzimit të tij, vdekjet e të gjitha qënieve të së shkuarës dhe të së ardhmes, dhe qënia e tij që do të ndahet përjetësisht prej tyre, e dërrmon zemrën e tij me dhimbje të vazhdueshme. Në qoftë se besimi hyn në zemrën e tij dhe ai bëhet besimtar, atëherë ata miq e shokë të panumërt menjëherë ngrihen, vijnë në jetë. Ata thonë nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tyre: "Ne nuk kemi vdekur... dhe nuk jemi asgjësuar...! Dhe ndërkohë ajo gjendje e skëterrshme transformohet në kënaqësi si të parajsës.

Meqenëse Realiteti është ky, unë ju sjell ndërmend sa vijon:

Mos e kundërshtoni Risale-i Nurin, sepse ai mbështetet tek Kur'ani. Ai nuk mund të mposhtet. Ose përndryshe çështja e këtij vendi do të ishte pikëlluese[220]. Në qoftë se dikush do të përpiqej që ta shuante dritën e tij, ai do të shkonte në një vend tjetër dhe do të ndriçonte atje.

Gjithashtu, në qoftë se do të kisha pasë koka sa numri i qimeve të flokëve në kokën time, dhe në çdo ditë njëra të pritej prej trupit, unë nuk do ta përkulja këtë kokë, e cila i është dedikuar Kur'anit, për ateizmin dhe për mosbesimin absolut, unë nuk do ta dhe nuk mund ta braktis këtë shërbim të besimit dhe të Risale-i Nurit.

Sigurisht, ndonjë gabim në deklaratat e dikujt, i cili ka qenë në izolim qysh prej njëzet vitesh, do të shpërfilleshin. Ai është duke mbrojtur Risale-i Nurin, prandaj nuk mund të thuhet se ai është shmangur nga subjekti.

Gjykata e Eskishehirit nuk gjeti asgjë, pasi i studioi për katër muaj njëqind trajtesat e tij, si ato private po ashtu edhe të tjerat, përveç një ose dy pikave që preknin një temë e cila bënte të domosdoshme një dënim të lehtë; dhe gjykata shpalli dënimin me gjashtë muaj burg për pesëmbëdhjetë prej të akuzuarve numri i të cilëve ishte njëqind e njëzet vetë. Edhe ne gjithashtu e kryem dënimin.

Dhe meqenëse para pak vitesh të gjitha pjesët e Risale-i Nurit arritën në duart e autoriteteve të Ispartas, të cilët pasi i shqyrtuan ato për disa muaj, i rikthyen ato tek pronarët e tyre...

Dhe përderisa nuk u gjet asnjë shenjë që të prekë drejtësinë dhe rendin gjatë tetë viteve në Kastamonu pavarësisht kërkimeve të holla...

Dhe meqenëse gjatë kërkimeve të fundit në Kastamonu -para disa vitesh- disa trajtesa u gjetën nën stivën e druve, gjë që nënkupton mosbotimin e tyre, madje humbjen e tyre...

Dhe meqenëse drejtori i policisë në Kastamonu dhe gjykatësi më premtuan, duke më dhënë fjalën e sigurt se do të m'i kthenin librat e mi të padëmshëm që ishin fshehur, para se t'i merrja ato libra, në ditën vijuese papritmas erdhi urdhri nga Isparta për arrestimin tim; dhe meqenëse gjykatat e Denizlit dhe të Ankarasë shpallën pafajësinë tonë dhe i rikthyen të gjitha trajtesat; atëherë sigurisht, si rrjedhojë e gjashtë

---

[220] Tërmetet e fuqishëm që ndodhën katër herë në kohën kur Risale-i Nuri luftohej provoi se "çështja e këtij vendi do të ishte pikëlluese". Autori.

fakteve të përmendur, kërkohet nga pozitat e tyre që Gjykata e Afjonit dhe prokurori i saj i përgjithshëm ta marrin në konsideratë pikërisht këtë të drejtë të rëndësishme timen, ashtu siç bënë Gjykata e Denizlit dhe prokurori i përgjithshëm i saj. Unë kam shpresë që prokurori i përgjithshëm, i cili mbron të drejtat e njerëzve, gjithashtu do t'i mbrojë të drejtat e mia personale, të cilat për shkak të lidhjes sime me Risale-i Nurin, janë si të drejta të rëndësishme publike; dhe unë e pres këtë prej tij. Saidi i Ri qysh prej njëzet e dy vitesh është tërhequr nga jeta sociale, dhe nuk i njeh ligjet e tanishme dhe bazat e mbrojtjes aktuale, se si duhet të kryhet mbrojtja; dhe ai do të paraqesë për këtë gjykatë të re njëqind faqet e parefuzueshme të mbrojtjes që i paraqiti në Gjykatat e Eskishehirit dhe të Denizlit; ai e ka kryer dënimin për fajet e tij deri në atë kohë; dhe pas asaj në Kastamonu dhe në Emirdag ai jetoi në një lloj burgimi të vetmuar nën mbikqyrje të vazhduar. Unë them se ky Saidi i Ri, çështja e të cilit është kështu, preferon të rrijë i heshtur, dhe ia lë fjalët Saidit të Vjetër.

Saidi i Vjetër thotë këtë: Meqenëse Saidi i Ri është tërhequr prej dynjasë, nuk flet me njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, dhe nuk e gjen të justifikueshme për t'u mbrojtur veçse në qoftë se detyrohet për të. por meqenëse çështja prek shumë artizanë e fshatarë të pafajshëm meqë ata po burgosen për shkak të ndonjë lidhje të vogël me mua, kjo më shkaktoi shumë keqardhje, meqë në këtë stinë të zënë me punë, ata kanë qenë të pamundur të fitojnë mjetet e tyre të jetesës për familjet dhe për fëmijët e tyre.

Kjo çështje më preku shumë në ndërgjegje dhe më bëri të vajtoja nga thellësitë".

Prandaj, unë betohem në Allahun madhështor se po të kishte qenë e mundur, unë do t'i kisha marrë të gjitha mundimet e tyre. Në qoftë se do të ketë ndonjë faj, ai është faji im. Ata janë të pafajshëm. Për shkak të kësaj situate të dhimbshme, unë them, pavarësisht heshtjes së Saidit të Ri: Meqenëse Saidi i Ri iu përgjigj qindra pyetjeve të panevojshme të prokurorëve të përgjithshëm të Ispartës, Denizlit dhe të Afjonit, edhe unë gjithashtu kam të drejtë t'i drejtoja ministrit aktual të drejtësisë, me qëllim për të mbrojtur të drejtat e mia, tre pyetjet të cilat para trembëdhjetë vitesh ia bëra ministrit të punëve të brendshme, dhe kryesisht Kaja Shukrut:

Pyetja e Parë: Cili ligj shpall se duhet të arrestohen njëqind e njëzet njerëz duke më përfshirë edhe mua për shkak të thjesht një grindjeje me fjalë me një xhandar rreshter, një njeri i zakonshëm prej Egirdir, i cili megjithëse nuk është një student i Risale-i Nurit po

mbante një letër të parëndësishme timen? Pastaj me përjashtim të pesëmbëdhjetë personave prej të pafuqishmëve të mjerë, pafajësia e tyre u vërtetua nga shpallja e pafajësisë për ta pas katër muajsh hetimi prej Gjykatës. Në përputhje me çfarë parimesh mund t'i bëni mundësi të tilla në vend të ndodhive? Dhe në përputhje me çfarë rregulli drejtësie shkaktoni humbjen e mijëra lirave për shtatëdhjetë të mjerë të cilët më parë morën pafajësinë nga Gjykata e Denizlit pas nëntë muajsh hetimi?

Pyetja e Dytë: Sipas Parimit Hyjnor: *"... Dhe askush nuk do të mbajë barrën e tjetrit"*,[221] madje edhe një vëlla gjaku nuk mund të mbajë përgjegjësi për fajet e vëllait të tij, atëherë, me çfarë ligji drejtësie ishte arrestimi im në muajin e Ramazanit për shkak të një trajtese të shkurtër botimi i të cilës ishte ndaluar, e cila kishte kaluar në duart e mia një ose dy herë gjatë tetë viteve, e cila për herë të parë u shkrua qysh prej më shumë se njëzet e pesë viteve, e cila i shpëton besimtarët prej vënies në dyshim të një numri prej pikave të rëndësishme dhe i pengon ata prej mohimit të disa haditheve alegorike të keqkuptuara; -unë them- për shkak të kësaj trajtese që u gjet tek një njeri të cilin e njohim që është prej një vendi të largët prej nesh, dhe kuptimi i gabuar që iu dha kësaj, dhe një letër sulmuese u gjet në Kutahja dhe në Ballëkesir; dhe të arrestoni tani në këtë të ftohtë me ngricë fshatarë e artizanë të shumtë thjesht pse kanë shtënë në dorë një trajtesë të zakonshme të shkruar nga unë, ose pse më kanë shëtitur në makinën e tyre, ose për shkak të shoqërisë së tyre ndaj meje, ose për shkak se kanë lexuar ndonjë prej librave të mi, dhe t'i shkatërrosh ata, dhe t'u shkaktosh atyre, vendit dhe kombit dëme materiale dhe dëme shpirtërore me vlerën e mijëra lirave duke u mbështetur në dyshime të pabaza?... Unë pyes: Çfarë ligji drejtësie e kërkon këtë? Dhe cili artikull ligji e bën të domosdoshëm këtë? Unë kërkoj t'i mësoj këto ligje me qëllim që të mos ndërmarr ndonjë hap të gabuar.

Po, një arsye për arrestimin tonë si në Denizli po ashtu në Afjon është Rrezja e Pestë. Madje edhe në qoftë se do të supozonim të pamundurën që Rrezja e Pestë shikon tek dynjaja dhe tek politika, -megjithëse ajo u shkrua kur isha në Darul-Hikmeh Islamijje, dhe origjinali i saj u shkrua edhe më përpara saj, me idenë për të shpëtuar besimin e njerëzve të zakonshëm -përballë atyre të cilët i mohojnë disa hadithe për shkak se ata menduan se ato ishin të paarsyeshme, dhe meqenëse ata nuk dinin se si ato duhej të interpretoheshin- madje edhe sikur ajo të ishte shkruar në këtë kohë, meqenëse ishte private, dhe nuk

[221] Kur'an, 6:164

u gjet tek unë gjatë kërkimeve, dhe parashikimet e saj rreth të ardhmes dolën të vërteta, dhe ajo largon dyshimet në çështjet e besimit, dhe nuk e prish rendin publik, dhe nuk konfrontohet me persona të caktuar, por shpjegon një të vërtetë shkencore në mënyrë të përgjithshme - meqenëse çështja është kështu- sigurisht edhe sikur kuptimi i hadithit të shihet në përputhje me persona të caktuar në këtë kohë, dhe para se të paraqitej dhe të bëhej publike në gjykata, ajo është mbajtur si private, e fshehtë, me qëllim që të mos i japë shkas debatit, pra ajo kurrsesi nuk përbën ndonjë krim. Unë gjithashtu nuk e quaj të mundshme që në ndonjë gjykatë në botë të konsiderohet krim të thuash: "të mohosh diçka është një gjë, dhe të mos e pranosh atë mbi baza shkencore ose të mos veprosh në përputhje me të është diçka krejtësisht tjetër. Ajo trajtesë nuk e pranon mbi baza shkencore një sistem i cili do të vijë në të ardhmen e afërt, madje ajo e refuzon."

Shkurtazi: Risale-i Nuri qysh prej tridhjetë vitesh i ka shkulur rrënjët e mosbesimit absolut, i cili shkatërron jetën e përhershme, e transformon jetën e kësaj dynjaje në një helm të tmerrshëm duke i shkatërruar të gjitha kënaqësitë dhe ëndjet e saja; Risale-i Nuri në mënyrë të sukseshme i ka vrarë idetë ateiste të natyralistëve; ka provuar në mënyrë të shndritshme me argumente të fuqishëm parimet që do t'i sjellin lumturinë këtij kombi në këtë jetë dhe në tjetrën; dhe ai bazohet mbi realitetin e lartë të Kur'anit, prej Fronit Hyjnor. Unë pretendoj dhe jam gati ta provoj, se jo një apo dy pika të një trajtese të tillë të shkurtër si ajo por edhe sikur të kishte një mijë gabime, mijëra aspektet e tij të mira e domethënëse, do t'i bënin ato të harroheshin.

Pyetja e Tretë: Është një rregull se në qoftë se në një letër prej njëzet fjalëve, pesë konsiderohen të dënueshme, atëherë ato pesë fjalë hiqen dhe të tjerat lejohen të qëndrojnë. Atëherë meqenësë pasi Gjykata e Eskishehirit i hetoi dhe i shqyrtoi me imtësi për katër muaj dhe mundi të gjejë vetëm pesëmbëdhjetë prej njëqind mijë fjalëve që për shikimin sipërfaqësor u imagjinuan të dëmshme; dhe meqenëse kabineti bëri pyetje vetëm për shpjegimet e dy vërseteve të Kur'anit, për shkak se ato kundërshtonin ligjin aktual, ndonëse ato ishin shkruar para tridhjetë viteve, në dy prej katërqind faqeve të koleksionit *Dhul Fikar*; dhe komitetet e ekspertëve të Denizlit dhe të Ankarasë pyetën vetëm për pesëmbëdhjetë gabime, dhe meqenëse deri tani Risale-i Nuri ka qenë mjet për reformimin e karaktereve të qindra e mijëra njerëzve, dhe ka sjellë e realizuar me mijëra dobi për vendin dhe për kombin; - meqenëse është kështu, cilit parim të qeverisë së republikës i përshtatet kjo, të arrestosh në këtë stinë pune dhe në këtë dimër të ashpër njerëz mjeranë si familja Çalishkan të cilët më shërbejnë mua duke kërkuar

kënaqësinë e Zotit xh.sh., për shkak se ato kanë kryer ndonjë shërbim të vogël për Risale-i Nurin, ose pse kanë shkruar një prej trajtesave të tij meqë ai ka shpëtuar besimin e tyre, dhe pse ishin vëllazërorë ndaj meje nga dhembshuria për pleqërinë time dhe pse isha i huaj në Emirdag? Cili nga ligjet e tij do ta lejonte një gjë të tillë? Meqenëse në përputhje me ligjin e lirisë së ndërgjegjes parimet e Republikës, nuk ndërhyjnë tek ata pa fe, sigurisht ai bën të domosdoshëm që ata të mos ndërhyjnë as tek ata të cilët nuk kanë lidhje me dynjanë, dhe nuk polemizojnë me njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, që punojnë në mënyrë të dobishme për Ahiretin e tyre, për besimin dhe për Atdheun e tyre. Unë e di se politikanët që sundojnë në Azi, ku u shfaqën profetët, nuk do të dhe nuk mund t'i përjashtojnë, t'i nxjerrin jashtë ligjit, takvanë dhe veprat e mira, të cilat qysh prej një mijë vitesh kanë qenë aq esenciale e të domosdoshme për këtë komb sa ushqimi dhe ilaçi. Humanizmi kërkon që të mos vihen re dhe të falen të metat që vijnë brenda pyetjeve të dikujt i cili i ka kaluar njëzet vite të jetës së tij, i izoluar dhe i veçuar nga njerëzit, pyetje të tilla që i bëri me mendjen e Saidit të vjetër para njëzet vitesh.

Unë e konsideroj si detyrë patriotike që t'ju kujtoj sa vijon, për të mirën e vendit, të kombit dhe të sigurisë publike:

T'i arrestoni dhe t'i bëni të zemëruar në këtë mënyrë për shkak të ndonjë lidhjeje të vogël me mua dhe me Risale-i Nurin, mund t'i kthejë kundra qeverisë shumë njerëz të cilët janë fetarë të dobishëm për vendin dhe për sigurinë e tij, kështu duke i hapur rrugën anarkisë. Ka më shumë se njëqind mijë njerëz të cilët e kanë shpëtuar Imanin e tyre nëpërmjet Risale-i Nurit dhe janë bërë të padëmshëm dhe shumë të dobishëm për kombin. Me moderimin dhe me dobinë e tyre, ata ndoshta mund të gjenden në çdo departament të gjërë të qeverisë së Republikës dhe në çdo nivel të shoqërisë. Është e domosdoshme që këta njerëz të mos ofendohen por të mbrohen. Unë ndiej një shqetësim të madh që disa persona zyrtarë nuk u vënë vesh ankesave tona dhe as nuk na lejojnë të flasim dhe na shtypin me pretekstet nga më të ndryshmet duke i hapur rrugën anarkisë për dëmin e këtij vendi.

Gjithashtu, për të mirën e qeverisë unë them këtë: Meqenëse Gjykatat e Denizlit dhe të Ankarasë e hetuan me imtësi Rrezen e Pestë, dhe nuk e kundërshtuan atë, por na e rikthyen atë neve, atëherë është e domosdoshme për qeverinë që procese gjyqësore të mos rihapen më zyrtarisht, duke u dhënë shkas zhurmave dhe thashethemeve.

Ashtu siç e fsheha atë trajtesë para se ta shtinte në dorë gjykata dhe ta shpallte, po ashtu Gjykata dhe autoritetet e Afjonit nuk duhet ta

bëjnë atë objekt pyetjeje dhe përgjigjjeje. Sepse ajo trajtesë është e fuqishme dhe e parefuzueshme. Ajo bëri parashikime, dhe ato dolën me të vërtetë. Për më tepër, qëllimi i saj nuk është kjo botë, tek e shumta njëri prej kuptimeve të saj të shumta i përshtatet një personi i cili është i vdekur dhe ka shkuar.[222] Më shtyn ndërgjegjja që t'ju kujtoj, për hir të interesit të vendit dhe të kombit dhe për hir të ruajtjes së rendit publik dhe të qeverisë, sa vijon:

Të mos ju shtyjë fanatizmi për atë njeri të vdekur në kritikimin e atij njoftimi të së padukshmes dhe të kuptimit që erdhi në atë trajtesë, në çështjet zyrtare, pasi ajo do ta zgjeronte fushën për shtimin e njoftimit.

• • •

Për Prokurorin e Përgjithshëm dhe për kryetarin dhe anëtarët e gjykatës.

[Unë po ju paraqes ju me qëllim që të mbroj të drejtat e mia, ekzaktësisht të njëjtat nëntë "parimet" të cilat i paraqita tek autoritetet gjyqësore të Denizlit]

Unë -siç e dini- jam një person që ka braktisur jetën shoqërore dhe sidomos jetën zyrtare dhe politike që ka aspekte të holla. Prandaj, unë nuk di se çfarë pozite duhet të merret në situata të tilla, dhe nuk mendoj për të, pasi të menduarit për të më pikëllon shumë. Por unë jam i detyruar që t'i paraqes këtë mbrojtje dhe këtë peticion të çorganizuara, që është përfundimi dhe përmbledhja e përgjigjjes që unë dhashë për pyetjet e shumta, të përsëritura kuturu të një anëtari të padrejtë të një gjykate tjetër. Ndoshta asaj i mungon rregulli dhe përmban përsëritje të pavend dhe të panevojshme si dhe shprehje të fuqishme të cilat mund të veprojnë kundra meje, dhe fjali në kundërshtim me ligjet e reja, të cilat unë nuk i njoh. Por meqenëse kjo mbrotje orientohet drejt së vërtetës dhe e synon atë, atëherë për hir të së vërtetës duhet të shpërfillen e të mos vihen re gabimet. Ky peticion dhe kjo fjalë e mbrojtjes bazohen mbi nëntë parime.

Parimi i parë: Meqenëse në përputhje me Parimin e Republikës, -parimin- e lirisë së ndërgjegjjes, qeveria e Republikës nuk ndërhyn tek njerëzit e pafesisë dhe të shthurjes, atëherë ajo sigurisht nuk duhet të ndërhyjë as tek njerëzit e fesë dhe të takvasë -devocionit... dhe

[222] Synon Mustafa Qemalin. Përkthyesi

meqenëse asnjë komb nuk mund të jetojë pa fe, dhe veçanërisht në qoftë se do të merrnim në konsideratë se kontinenti i Azisë nuk u ngjason popujve të Europës nga aspekti i fesë, dhe se islami nuk i ngjason krishterimit nga këndvështrimi i jetës individuale dhe i jetës që i përket Ahiretit, dhe muslimani ateist nuk u ngjason ateistëve të tjerë; prandaj kjo fe është bërë një nevojë e natyrshme në thellësitë e këtij kombi i cili ka ndriçuar të gjitha anët e dynjasë qysh prej një mijë viteve me fenë e tij dhe me mbrojtjen e tij heroike duke u kapur fort pas kësaj feje përballë të gjitha sulmeve të botës dhe agresioneve të saj kundra tij. Nuk ka asnjë lloj progresi apo civilizimi që mund të zërë vendin e fesë, ose të drejtësisë veçanërisht të mësuarin e të vërtetave të besimit në shpirtin e këtij kombi, të cilat janë nevoja e brendaqenësishme e këtij kombi. As nuk mund ta zërë vendin e tyre, dhe as nuk mund ta bëjnë ta harrojnë atë nevojë. Atëherë, sigurisht asnjë qeveri e këtij kombi në këtë vend nuk duhet të ndërhyjë tek Risale-i Nuri nga aspekti i drejtësisë, i ligjit dhe i rendit publik.

Parimi i Dytë: Meqenëse ka ndryshim të madh midis "të refuzosh dhe të hedhësh poshtë një gjë dhe midis që të mos veprosh në përputhje me atë gjë", të gjitha qeveritë kanë kundërshtarë të ashpër; mund të ketë xhemate myslimane nën sundimin e Zoroastrianëve, dhe mund të ketë hebrenj e të krishterë nën sundimin e një qeverie islamike ashtu si në kohën e Umer Ibn Hattabit, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe megjithatë mbrohet liria personale për atë që nuk prish rendin dhe që nuk i shkakton dëm administratës së shtetit. Qeverive u intereson e jashtmja; ato shohin dorën dhe nuk shikojnë se çfarë ndodhet brenda zemrës; dhe meqenëse ata të cilët duan të prishin rendin publik, të shkaktojnë trazira në administratë dhe të ndërhyjnë në politika, padyshim që do të jenë të lidhur me gazetat, me rrymat dhe me çështjet e ditës me qëllim që të mësojnë rreth lëvizjeve, situatave dhe ngjarjeve që do t'i ndihmonin, që kështu të mos bëjnë lëvizje të gabuara dhe të mos u rrëshqasë këmba, dhe meqenëse Risale-i Nuri i ka ndaluar në mënyrë të rreptë studentët e tij, madje shokët e mi të afërm e dinë se unë qysh prej njëzet e pesë viteve i kam lënë gazetat, dhe madje as nuk kam pyetur për to dhe as nuk kam qenë kureshtar dhe të mendoj për to; dhe meqenëse qysh prej dhjetë viteve unë jam tërhequr prej jetës sociale deri në një shkallë të tillë saqë përveç shpartallimit të Gjermanisë dhe përhapjes së Bolshevizimit -komunizmit- unë nuk kam dëgjuar lajme rreth asaj që po ndodh në botë dhe rreth situatës aktuale, atëherë sigurisht askush nuk mund të më sulmojë mua dhe vëllezërit e mi si unë në bazë të urtësisë së qeverisë, të ligjeve të politikës dhe të parimeve të drejtësisë, dhe në qoftë se ata do të sulmonin, do ta bënin

këtë për shkak të iluzioneve ose për shkak të urrejtjes dhe të kryeneçësisë.

Parimi i Tretë: Unë jam i detyruar të jap detajet e zgjatura vijuese të kundërshtimeve të pakuptimta dhe të panevojshme të prokurorit të përgjithshëm të gjykatës së mëparshme, të cilat ai i bëri për shkak të një keqkuptimi jo lidhur me ligjin por për dashurinë e tij me fanatizëm ndaj një personi të vdekur.

***Së Pari*:** para se të binte në duart e qeverisë, unë e trajtova Rrezen e Pestë si private dhe të fshehtë; dhe pavarësisht kërkimeve që u bënë, qeveria nuk gjeti tek unë asnjë kopje të saj. Gjithashtu qëllimi i kësaj trajtese ishte vetëm të shpëtonte njerëzit e zakonshëm nga dyshimet lidhur me besimin e tyre dhe nga mohimet lidhur me hadithet alegorike. Ajo trajtesë i shikon aspektet e kësaj dynjaje të haditheve veçse në mënyrë indirekte, në vend të tretë ose të katërt. Parashikimet që ajo bën, janë të vërteta. Për më tepër, ajo nuk i kundërshton politikanët dhe as njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje; ajo vetëm bën parashikime. Gjithashtu ajo nuk specifikon ndonjë person. Ajo shpjegon në mënyrë të përgjithshme një kuptim të vërtetë të një hadithi. Por ata e zbatuan atë të vërtetë të përgjithshme për një person të tmerrshëm që jetoi në këtë shekull, dhe që iu përshtat plotësisht atij. Prandaj ata e kundërshtuan atë, duke e supozuar se kjo trajtesë ishte shkruar në këto vite. Në fakt origjinali i kësaj trajtese ishte më përpara se të hyja në "*Darul-Hikme"* por ajo më vonë u vendos në rregull dhe u përfshi në Risale-i Nur. Kjo ishte si më poshtë vijon:

Para dyzet viteve, në vitin para shpalljes së kushtetutës,[223] unë erdha në Stamboll. Komandanti i përgjithshëm i Ushtrisë japoneze u kishte drejtuar disa pyetje Ulemave -dijetarëve- të asaj kohe të Stambollit. Hoxhallarët e Stambollit më pyetën mua rreth tyre. Ata më bënë edhe shumë pyetje të tjera lidhur me këtë.

Dhe brenda këtyre pyetjeve, ata më pyetën, për shembull, rreth një hadithi, i cili thotë*: "Në fundin e kohës, një individ i tmerrshëm do të shfaqet në mëngjes dhe në ballin e tij do të jetë e shkruar: ky është kafir -mohues"*.[224]

Unë u thashë: Ky person i çuditshëm do të vijë për të drejtuar këtë komb; ai do të ketë vënë në kokë një kapele strehëgjërë dhe do t'i bëjë edhe të tjerët ta veshin atë -ta vënë."

---

[223] - Shpallja e lirisë: këtu aludon për shpalljen e dytë të kushtetutës, korrik 1908

[224] Transmeton Buhari, Muslim etj.

Pasi e morën këtë përgjigje, ata më pyetën: "A nuk do të jenë kafira -mohues- ata që do ta vënë në kokë atë?" Unë u thashë: Ata do të detyrohen që ta vënë në kokë atë kapele strehëgjërë; kur kapelja të vihet në kokë, do të thotë: Mos bëj sexhde! Por besimi në kokat e atyre që e veshin atë kapele strehëgjërë, do ta bëjë atë kapele të bie në sexhde, në dashtë Allahu, dhe do ta fusë në islam".

Pastaj ata thanë: Ky person do të pijë ujë, dhe do t'i shpohet dora e tij, dhe ai nëpërmjet kësaj do të njihet se është Sufjani.

Unë u thashë atyre në përgjigje: "Thuhet zakonisht për dikë që është shumë prishanik se ai ka një vrimë në dorën e tij. Domethënë ai nuk mund të mbajë asgjë në të. Paraja nuk mund të rrijë në dorën e tij, ajo rrjedh prej tij dhe humbet.

Dhe kështu, ai person i tmerrshëm dhe i çuditshëm do të jetë i sprovuar me alkool, raki (që është e lëngshme); dhe pija do ta bëjë atë të sëmurë, dhe ai do të bëhet tepër prishanik, dhe do t'ua bëjë zakon edhe të tjerëve që të jenë prishanikë".

Pastaj, njëri prej tyre pyeti: Kur të vdesë ky person Shejtani do të shpallë me zë të lartë për dynjanë në zonën Dikili Tash në Stamboll, "Filani vdiq".

Unë u thashë: Ky lajm do të shpallet nëpërmjet telegrafit", por unë kur dëgjova më vonë për shpikjen e radios, mësova se përgjigjja ime e hershme nuk do të kishte qenë e plotë... Dhe thashë pas tetë vitesh kur isha në "Darul-Hikmeh": shejtani do ta shpallë njoftimin për të gjithë botën nëpërmjet Radios".

Pastaj ata më bënë shumë pyetje rreth Barrierës -pengesës- së Dhul-Karnejnit, për Xhuxh Maxhuxhët, për Dabetul-Erd, për Dexhalin dhe për zbritjen e Isait-Jezusit-a.s., dhe unë iu përgjigja atyre. Në fakt, përgjigjjet janë shkruar pjesërisht në trajtesat e mia të vjetra. Pas një periudhe kohe, Mustafa Qemali dërgoi dy letra me kod, me shifra-tek një shoku im Tahsin Bej i cili në atë kohë ishte guvernator -vali- i qytetit të Vanit, dhe më bëri thirrje për në Ankara që të më shpërblente që kisha botuar trajtesën *EL-Hutuvat es-sitte,*[225] *Gjashtë Sulmet* dhe unë shkova. Meqenëse Shejh Sanusi nuk e njihte kurdishten, u

[225] Në atë periudhë ndodheshin atje dy qeveri: qeveria e kalifatit në Stamboll nën pushtimin anglez; dhe qeveria e copëtuar në Ankara që drejtohej nga Mustafa Qemali dhe luftonte shtetet pushtuese. Në këtë kohë ustadh Said Nursi ishte në Stamboll dhe botoi atje këtë trajtesë kundra pushtimit anglez dhe për të shfuqizuar e hedhur poshtë politikën e tyre; dhe pati atëherë një ndikim të madh. Përkthyesi

propozua që unë të merrja vendin e tij si "predikues i përgjithshëm" për provincat lindore me një pagë treqind lira. Gjithashtu m'u ofrua edhe një post si një deputet, dhe posti im i mëparshëm së bashku me anëtarët e tjerë të Dar-el-Hikmeh brenda Drejtorisë së çështjeve të fesë. Për më tepër, duke u miratuar nga njëqind e gjashtëdhjetë e tre prej dyqind deputetëve, u caktua -u dhanë njëqind e pesëdhjetë mijë lira për *Medresetu Ez-Zehra*, për universitetin tim në lindje, themelet e të cilit unë i kisha vendosur në Van, dhe kjo u pranua.

Por kur vërejta se parashikimet e origjinalit të Rrezes së Pestë, përshtateshin duke u bërë realitet mbi një person të cilin e pashë atje, u detyrova që t'i braktisja ato detyra të rëndësishme, pasi formova bindje se do të ishte e pamundur të kuptohesha me këtë person, apo të bashkëpunoja me të, apo të qëndroja në këmbë para tij; dhe unë i flaka çështjet e dynjasë, çështjet e politikës dhe jetën shoqërore, dhe të gjithë kohën time ia kushtova vetëm shpëtimit të imanit. Megjithatë një numër prej zyrtarëve të padrejtë dhe tiranë më detyruan të shkruaja dy ose tre trajtesa të cilat shikonin tek dynjaja.

Më vonë, në lidhje me disa pyetje të bëra nga disa persona rreth haditheve alegorike të cilat japin njoftimet për ngjarjet në fundin e kohës, unë e risistemova atë trajtesë të vjetër. Ajo mori emrin e Rrezes së Pestë. Risale-i Nuri nuk mund të numërohet kronologjikisht. Për shembull, Letra e Tridhjetë e Tretë u shkrua para Letrës së Parë, dhe origjinali i Rrezes së Pestë dhe disa pjesë të tjera u shkruan para Risale-i Nurit. Sidoqoftë... kundërshtimet e paligjshme, të panevojshme dhe të pasakta dhe pyetjet e prokurorit të përgjithshëm, të bëra për shkak të dashurisë me fanatizëm ndaj Mustafa Qemalit, më detyruan t'i jepja këto shpjegime jashtë subjektit. Unë do të jap këtu si një shembull disa gjëra krejtësisht personale dhe të paligjshme që ai i tha në emrin e ligjit. Ai tha:

"A nuk je i penduar sinqerisht për atë çfarë ke sjellë në Rrezen e Pestë? Pasi ti e ke fyer dhe e ke poshtëruar kur the për të: "Ai është bërë si pompë uji nga pirja e shumtë e verës dhe e rakisë". Unë them në përgjigje ndaj këtij fanatizmi krejtësisht të pakuptim dhe të gabuar që buron nga dashuria për të: "Fitorja dhe nderi i një ushtrie heroike nuk mund t'i atribuohet vetëm atij; ai mund të ketë vetëm një pjesë të saj. Do të ishte tiranike dhe një padrejtësi e madhe në qoftë se plaçkat e luftës, pasuritë dhe furnizimet -racionet- e një ushtrie do t'i jepeshin që të gjitha komandatit të saj. Po, ai prokuror i përgjithshëm, ashtu siç më akuzoi që unë nuk e dua atë njeri të padrejtë dhe me shumë të meta, thjesht duke më akuzuar mua si një tradhtar, po ashtu unë e

akuzoj atë se nuk e do ushtrinë, pasi ai ia atribuion të gjithë nderin dhe të gjithë plaçkat morale njeriut të cilin ai do, duke e privuar ushtrinë prej të gjithë lavdisë.

Realiteti është se gjërat pozitive, dhe shembujt e mirësisë dhe të virtytit duhet të shpërndahen midis komunitetit dhe ushtrisë, dhe gjërat negative, shkatërrimi dhe të metat, i atribuohen drejtuesit. Sepse ekzistenca e diçkaje është e varur nga ekzistenca e të gjitha kushteve dhe elementeve të saj, dhe komandanti është vetëm se njëri prej kushteve. Ndërsa mosekzistenca e një gjëje dhe shembja e saj, ndodh nëpërmjet ekzistencës së njërit prej kushteve dhe të elementeve të saj duke u prishur dhe duke u shkatërruar.

Shembujt e të mirës dhe të virtyteve, tek pjesa më e madhe, janë pozitive dhe i përkasin ekzistencës. Udhëheqësit nuk mund t'i pretendojnë ato. Shembujt e së keqes dhe të të metave janë shkatërruese dhe i përkasin mosekzistencës, dhe udhëheqësit janë përgjegjës për to.

Meqenëse realiteti është ky, atëherë si mund t'i thuhet kryetarit të një fisi, i cili arriti fitore "Të Lumtë, o Hasan Aga"? Dhe në qoftë se ai fis mposhtet, u drejtohen fyerjet dhe sharjet individëve të atij fisi? ... Dhe kjo gjykohet të jetë e kundërta e së vërtetës.

Dhe kështu, në emrin e gjykatës, prokurori i përgjithshëm më ngarkoi me faj dhe më akuzoi dhe veproi në një mënyrë krejtësisht në kundërshtim me të vërtetën dhe realitetin.

Ashtu si shembulli i gabimit të këtij personi, më erdhi një person para Luftës së Parë Botërore kur unë isha në qytetin e Vanit; disa persona fetarë e të devotshëm më thanë: "Disa nga komandantët ushtarakë veprojnë në kundërshtim me fenë. Prandaj, eja dhe bashkohu me ne; ne do të rebelohemi kundra tyre".

Unë u thashë: Ato sjellje të këqija dhe ato akte jofetare janë të veçanta për komandantët si ata; ushtria nuk mund të mbajë përgjegjësi për të. Në këtë ushtri Osmane mund të gjenden njëqind mijë prej Evlijave të Allahut. Unë nuk mund ta nxjerr shpatën time kundra kësaj ushtrie, prandaj unë nuk mund të bashkohem me ju. Këta më lanë mua, nxorën shpatat e tyre dhe ndodhi ngjarja e pafrutshme e Bitlisit.[226] Pak më vonë shpërtheu lufta, ushtria mori pjesë në të, në emrin e fesë; ajo hyri në xhihad, dhe njëqind mijë martira prej saj u ngritën në shkallën

[226] Një rebelim i fiseve kurde përreth qytetit të Bitlisit kundra vendimit të unionit dhe të progresit para luftës së Parë Botërore.

e shenjtërisë -të Evlijave. Ata konfirmuan atë çfarë unë thashë, duke nënshkruar shkallët për shenjtërinë e tyre me gjakun e tyre.

Sidoqoftë unë u detyrova që ta zgjas pak, dhe për këtë më shtynë sjelljet e prokurorit të përgjithshëm i cili veproi me tallje ndaj meje dhe ndaj Risale-i Nurit për shkak të ndjenjave të gabuara, të parëndësishme dhe të anshmërisë, në emrin e drejtësisë, një shenjë e pamohueshme e së cilës është paprekshmëria, qëndrueshmëria ndaj të gjitha ndjenjave dhe jashtë ndikimeve.

Parimi i Katërt: Pas shqyrtimit me imtësi për katër muaj të qindra kopjeve të trajtesave dhe të letrave, Gjykata e Eskishehirit mundi të jepte dënimin me gjashtë muaj burg vetëm për pesëmbëdhjetë prej njëqind e njëzet vetëve, dhe një vit për mua, për shkak të pesëmbëdhjetë fjalëve në një ose në dy prej njëqind trajtesave. Ata shpallën pafajësinë time në çështjet e formimit të ndonjë tarikati Sufi, të organizatave politike, dhe për çështjen e kapeles, dhe ne e kryem afatin e dënimit. Pastaj në Kastamonu, ata nuk gjetën asgjë për të më dënuar megjithëse kërkuan, shqyrtuan dhe hetuan shumë për disa herë. Dhe para disa vitesh në Isparta të gjitha pjesët e Risale-i Nurit pa përjashtim, si ato private po ashtu edhe të tjerat, ranë në duart e autoriteteve. Ato u rikthyen tek pronarët e tyre veçse pas tre muajsh hetimi e shqyrtimi. Dhe pas disa vitesh, të gjitha pjesët e Risale-i Nurit mbetën për dy vjet në gjykatat e Denizlit dhe të Ankarasë, pastaj ato të gjitha u rikthyen tek ne.

Meqenëse fakti është ky, ata të cilët më akuzojnë mua, Risale-i Nurin dhe studentët e Risale-i Nurit, që flasin në emër të ligjit por që veprojnë me urrejtje dhe na qortojnë e na fyejnë nën ndikimin e ndjenjave dhe të emocioneve personale dhe në mënyrë të paligjshme; kjo nuk do të thotë akuzë vetëm kundra nesh por, para kësaj, do të thotë akuzë kundra Gjykatave të Eskishehirit dhe të Kastamonusë, dhe do të thotë të akuzosh nëpunësit e rendit në atë provincë; gjithashtu do të thotë akuzë ndaj sistemit të drejtësisë në Isparta, ndaj Gjykatës së Denizlit dhe ndaj Gjykatës së krimeve të rënda në Ankara. Domethënë ata i bëjnë të gjithë ato institucione ortakë në krimin tonë (në qoftë se kemi ndonjë faj). Sepse në qoftë se ne do të kishim pasë ndonjë faj, kjo do të thotë se ato autoritete të sigurisë në tre provincat e tjera ose në katër nuk paskan mundur të shohin gjë pavarësisht hetimit të hollë dhe shqyrtimit me imtësi, ose ato e kanë parë, por kanë mbyllë sytë, sikur ato dy gjykata nuk paskan mundur ta njohin ndonëse bënë kontroll të imët për dy vite ose nuk paskan lexuar me vëmendje e me interesim; dhe kjo i bën ato autoritete më fajtore se sa neve. Sidoqoftë, në qoftë

se ne do të kishim pasë dëshirë për të ndërhyrë në çështjet e kësaj dynjaje, nuk do të kishte qenë zëri që del prej nesh si një zëzëllimë e mizës, por do të kishte qenë një zë ushtues si gjylet e topave.

Po, një njeri që është mbrojtur fuqishëm e ndikueshëm dhe pa pasë frikë përpara Gjykatës ushtarake pas incidentit të tridhjetë e një Marsit[227] në Bitlis, dhe në zyrën e kryetarit të parlamentit përballë zemërimit të Mustafa Qemalit... Si mund të akuzohet ky person se paska drejtuar në mënyrë të fshehtë komplote politike gjatë tetëmbëdhjetë viteve dhe pa e kuptuar askush? Padyshim ai që bën një akuzë të tillë, sigurisht që është tendencioz -i anshëm. Ne kemi shpresë se ashtu si prokurori i përgjithshëm i Denizlit, prokurori i përgjithshëm i Afjonit do të na shpëtojë neve nga e keqja dhe nga akuzat e njerëzve të tillë, dhe të demonstrojë drejtësinë.

Parimi i Pestë: Një parim i rëndësishëm i studentëve të Risale-i Nurit është që me sa të jetë e mundur ata të mos ndërhyjnë në politika, as në çështjet e administratës dhe as në aktivitetet e qeverisë, dhe këtë ta bëjnë për arsye që të punojnë me sinqeritet në shërbimin ndaj Kur'anit pasi ky shërbim u mjafton atyre, dhe i bën ata të panevojshëm për gjëra të tjera.

Gjithashtu, askush që hyn në politikë, midis rrymave të fuqishme që sundojnë tani, nuk mund ta ruajë pavarësinë dhe sinqeritetin e tij; sepse ndonjëra prej këtyre rrymave do ta tërhiqte atë për tek vetja dhe do ta bënte të punonte për llogari të saj dhe do ta shfrytëzonte për qëllimet e saja të kësaj bote; gjë kjo që do të çonte në prishjen e shenjtërisë së punës dhe të shërbimit të tij.

Gjithashtu, në luftën materiale, për shkak të tiranisë dhe të despotizmit të skajshëm që sundojnë në këtë shekull, ai do të duhej të shtypte përkrahës të shumtë të pafajshëm të një personi për shkak të gabimit që ai person ka bërë. Ose ai përndryshe do të shpartallohej. Gjithashtu do të dukej me shikimin e atyre që kanë braktisur fenë për dynjanë, ose që e shfrytëzojnë atë, se të vërtetat e shenjta të Kur'anit, të cilat nuk mund të shfrytëzohen për asgjë, janë shfrytëzuar për propagandë politike. Gjithashtu çdo klasë e njerëzve, përkrahës dhe kundërshtarë, zyrtarë dhe njerëz të zakonshëm, duhet të kenë një pjesë prej atyre të vërtetave dhe që të gjithë kanë nevojë për to. Prandaj,

[227] Ngjarja e tridhjetë e një Marsit: Është një lëvizje kryengritëse në ushtri në 1909 dhe rezultoi në rrëzim nga froni i Sulltan Abdul-Hamid. Pavarësisht se luajti një rol paqësor, Bediuzzamani u arrestua pas kryengritjes së bashku me shumë të tjerë dhe u bë gjyq, por mori pafajësinë.

Studentët e Risale-i Nurit duhet t'u shmangen krejtësisht politikave dhe luftës materiale, dhe në asnjë mënyrë të mos përfshihen në to, me qëllim që ata të mund të mbeten krejtësisht të paanshëm.

Parimi i Gjashtë: Risale-i Nuri nuk duhet të sulmohet në këtë çështje për shkak të gabimeve të mia personale ose të atyre prej disave nga vëllezërit e mi. Ai është i lidhur drejtëpërdrejtë tek Kur'ani, dhe Kur'ani është i lidhur tek Arshi Madhështor. Kush e ka aftësinë ta shtrijë dorën e tij dhe ta zgjidhë, ta zbërthejë? Gjithashtu siç tregohet nga tridhjetë e tre vërsetet e Kur'anit, dhe me tre *kerametet* e së padukshmes të Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe me parashikimin e së padukshmes të Shejh Gejlanit, iu shenjtëroftë sekreti, Risale-i Nuri ka kryer një shërbim të jashtëzakonshëm për këtë vend dhe është një burim për bereqet material dhe për shkëlqim shpirtëror për të, dhe prandaj Risale-i Nuri nuk mund të mbajë përgjegjësi për gabimet tona personale të papërfillshme, kjo është e pamundur dhe nuk lejohet kurrë që të mbahet përgjegjës. Përndryshe ky vend do të përballet me humbje dhe me dëme të mëdhaja materiale dhe shpirtërore që do të jenë të pamundura të riparohen.

Në dashtë Zoti xh.sh., sulmet dhe intrigat djallëzore kundra Risale-i Nurit prej ateistëve armiqësorë ndaj nesh do të dështojnë, sepse studentët e tij nuk mund të krahasohen me të tjerët, ata nuk mund të shpërndahen dhe as të bëhen që ta braktisin; nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes së Allahut, ata nuk do të shpartallohen. Në qoftë se nuk do t'i kishte ndaluar Kur'ani ata prej mbrojtjes fizike... ata studentë, të cilët janë kudo dhe që kanë fituar dashurinë e masave të këtij kombi dhe vlerësimin e tij, këtë vlerësim i cili konsiderohet si një gjë vitale -si gjaku i jetës- së këtij kombi, nuk do të përfshiheshin kurrë në ngjarje të papërfillshme e të pafrutshme si Shejh Saidi[228] dhe si Ngjarjet e Menemenit.[229]

Në qoftë se ata -Ruajna Zot!- do të persekutoheshin deri në atë pikë që do të detyroheshin, dhe Risale-i Nuri do të sulmohej, atëherë ateistët dhe hipokritët të cilët mashtruan qeverinë, padyshim që do të pendoheshin rëndë, do të bëheshin një mijë herë më shumë pishman.

---

[228] Revolta e famshme e Shejh Saidit e cila shpërtheu në shkurt të vitit 1925 në Turqinë lindore. Bediuzzamani i këshilloi shumë fort drejtuesit e saj kundra ndërrmarjes së një akti të tillë kundra qeverisë, pasi ajo do "ta bënte Ahmedin të vrasë Hysejnin". Përkthyesi.

[229] Një incident i vogël i cili ndodhi në qytetin e Menemenit në Turqinë perëndimore në 1930 por u hodh në erë nga qeveria dhe u shtyp mizorisht. Bediuzzamani nuk u përfshi absolutisht.

Shkurtazi: Meqenëse ne nuk ndërhyjmë në botët e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, edhe ata gjithashtu nuk duhet të ndërhyjnë në punën tonë për Ahiret dhe në shërbimin tonë për besimin.

• • •

[Unë jam duke treguar këtu një kujtesë të vjetër dhe një anektodë të këndshme, nëpërmjet mbrojtjes, rreth gjykatës së Eskishehirit, dhe që ka mbetur e fshehur gjer tani dhe nuk u shkrua në raportet zyrtare të qeverisë, as nuk është përfshirë në Fjalët e mia Mbrojtëse.]

Ata më pyetën mua atje: Çfarë mendon ti rreth sistemit të Republikës?" Unë u përgjigja: Ashtu siç e provon biografia ime që gjendet tek ju, unë kam qenë një republikan fetar përpara gjithësecilit prej jush, me përjashtim të kryetarit të Gjykatës që është i përparuar në moshë. Një përmbledhje e kësaj është sa vijon: Unë po jetoja në atë kohë, në një vend të veçuar -ashtu si gjendja ime e tanishme- nën kubenë e këtij varri të zbrazur. Ata më binin mua supë, dhe unë ua jepja thërrimet e bukës mizave. Unë e haja bukën time duke e zhytur atë në supë. Ata më pyetën për shkakun dhe unë u thashë: kombet e mizave dhe të bletëve janë republikanë. Unë ua jap thërrimet mizave nga respekti për republikanizmin e tyre".

Atëherë ata më thanë: Ti me këtë po kundërshton *"Es-Selefu es-salih" "Gjeneratat e të drejtëve të hershëm të islamit".* Unë u thashë në përgjigje: Katër kalifët e drejtë ishin edhe kalifë dhe njëkohësisht edhe presidentë Republikanë. Ebu Bekri i Drejtë, Zoti qoftë i kënaqur me të, ishte padyshim, si presidenti për Dhjetë të përgëzuarit me Xhennet dhe për sahabët e nderuar. Por jo nën këtë emër apo formë të zbrazur, përkundrazi, gjithësecili prej tyre ishte president republike dhe fetar që mbante kuptimin e drejtësisë së vërtetë dhe të lirisë në përputhje me sheriatin".

Atëherë, o prokurori i përgjithshëm dhe o anëtarët e Gjykatës! Ju po më akuzoni mua tani për kundërshtimin e një ideje të cilën e kam pasë qysh prej pesëdhjetë viteve.

Ndërsa në qoftë se ju më pyesni rreth republikës sekulariste -laike-, ajo çfarë unë kuptoj prej saj është se sekular -laik- do të thotë të jesh i paanshëm; domethënë, një qeveri, e cila në përputhje me parimin e lirisë së ndërgjegjjes, nuk ndërhyn as tek ateistët dhe të shthururit dhe as tek njerëzit e fesë dhe të takvasë -devocionit. Unë tani nuk i njoh situatat politike dhe gjendjet në të cilat jeton qeveria e Republikës dhe çfarë forme ka marrë, sepse unë jam i veçuar nga jeta shoqërore qysh prej njëzet e pesë vitesh; në qoftë se ajo ka marrë një formë të

tmerrshme veprimi për llogari të ateizmit dhe ka filluar të miratojë ligje të cilat dënojnë atë që punon për Ahiretin e tij dhe për besimin e tij - Ruajna Zot!, unë them për ju pa frikë se, në qoftë se do të kisha një mijë shpirtëra, unë nuk do të ngurroja që t'i sakrifikoja në rrugën e besimit tim dhe të Ahiretit tim. Bëni çfarë të doni! Fjala ime e fundit është: *"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve, dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*. Në qoftë se ju do të më dënonit padrejtësisht me vdekje ose me burgosje me punë të rënda, unë them: Ashtu siç ka zbuluar e treguar Risale-i Nuri me siguri absolute, unë nuk do të ekzekutohem, por do të lirohem dhe do të shkoj në botën e dritës dhe të lumturisë. Sa për ju, o armiqtë tonë të fshehur e të maskuar që na shtypni për llogari të çudhëzimit!, Meqenëse unë e di se ju do të dënoheni me asgjësim të përjetshëm dhe me burgim të vetmuar, dhe unë e kam parë këtë, unë e kam marrë krejtësisht hakun mbi ju. Unë jam gati ta dorëzoj shpirtin tim me një qetësi të plotë. Këtë ua thashë atyre.

Parimi i Shtatë: Si rrjedhojë e hetimeve sipërfaqësore -që u zhvilluan në vende të tjera-, neve na akuzoi Gjykata e Afjonit për përpjekje për të ngritur një shoqëri politike. Përgjigjja ime është kjo:

***Së Pari*:** Siç dëshmohet nga të gjithë ata të cilët më kanë shoqëruar, unë nuk kam lexuar asnjë gazetë qysh prej nëntëmbëdhjetë vitesh, as nuk ia kam vënë veshin ndonjërës, dhe as nuk kam pyetur për ndonjë; dhe për dhjetë vjet e pesë muaj unë nuk kam marrë asnjë njoftim përveç shpartallimit të Gjermanisë dhe rrezikut të komunizmit, dhe unë nuk kam qenë kurioz, dhe nuk i kam njohur. Një person i tillë sigurisht që nuk ka absolutisht asnjë lidhje me politikat, dhe asnjë lidhje me ndonjë shoqëri politike.

***Së Dyti*:** Njëqind e Tridhjetë pjesët e Risale-i Nurit janë të gjitha të pranishme për të gjithë për t'i parë. Duke kuptuar se ato nuk përmbanin asnjë qëllim tjetër përveç të vërtetave të besimit, Gjykata e Eskishehirit nuk i kundërshtoi ato me përjashtim të një ose dy pjesëve, dhe Gjykata e Denizlit nuk e kundërshtoi fare asnjërën; dhe pavarësisht se ishim nën mbikëqyrje për tetë vite, forcat e mëdhaja policore të Kastamonus nuk mundën të gjenin asnjë për të akuzuar përveç dy personave që më ndihmonin në çështjet e mia dhe tre personave të tjerë, dhe ato akuza ishin thjesht pretekste. Kjo është një provë vendimtare se studentët e Risale-i Nurit në asnjë mënyrë nuk janë një shoqëri politike. Ndërsa, në qoftë se koncepti i "Shoqërisë" tek prokuroria e përgjithshme është një xhemat -komunitet- besimi që punon për ahiretin e tij, ne do të thonim në përgjigje:

Në qoftë se emri “Shoqëri” do t’u jepej studentëve të universitetit dhe zejtarëve, ajo gjithashtu mund të aplikohet edhe për ne -me këtë konceptim. Por në qoftë se ju na quani ne një xhemat që do të prishë sigurinë e brendshme duke shfrytëzuar ndjenjat fetare, ne do të përgjigjeshim:

Fakti se në asnjë vend për një periudhë më shumë se njëzet vite në këto kohë të stuhishme, studentët e Risale-i Nurit nuk e kanë thyer rregullin e brendshëm dhe nuk e kanë prishur rendin publik, dhe asnjë incident i tillë nuk është regjistruar as nga qeveria dhe as nga ndonjë gjykatë, -ky fakt- e hedh poshtë këtë akuzë. Ndërsa, në qoftë se pandehni se forcimi i ndjenjave të besimit do të çojë në të ardhmen në prishjen e sigurisë së brendshme dhe se kjo është ajo çfarë ju synoni kur na drejtoni akuzën e “shoqërisë”, atëherë ne themi:

Së Pari: Të gjithë predikuesit -me në krye drejtorinë e çështjeve fetare- kryejnë të njëjtin shërbim.

Së Dyti: Studentët e Risale-i Nurit nuk janë vetëm larg prishjes së sigurisë, rendit dhe të stabilitetit, por ata punojnë me të gjithë fuqinë e tyre dhe me të gjithë bindjen për ta ruajtur kombin prej anarkisë dhe shkatërrimit dhe përpiqen me të gjitha mundësitë për të ruajtur rendin publik dhe sigurinë.

Dëshmia për këtë është përmendur në Pesë Parimet.

Po, ne jemi një xhemat -komunitet- dhe qëllimi dhe programi ynë është që së pari të shpëtojmë veten tonë dhe pastaj kombin tonë prej asgjësimit të përhershëm dhe prej burgimit të vetmuar në Botën e ndërmjetme, dhe për të mbrojtur bashkëkombësit prej anarkisë dhe paligjshmërisë -shthurjes-, dhe për t’i mbrojtur vetet tona me të vërtetat e besimit të Risale-i Nurit kundra ateizmit, i cili është një mjet për të shkatërruar jetët tona në këtë botë dhe në tjetrën.

Parimi i Tetë: Ata na drejtojnë akuza duke u mbështetur në disa fjali të ashpra që kanë ardhur në Risale-i Nur dhe duke u mbështetur në disa hetime sipërfaqësore që u zhvilluan në disa vende, dhe ne në përgjigje të kësaj, themi: Meqenëse qëllimi ynë është besimi dhe Ahireti dhe ai nuk është në luftë e në konfrontim me njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje; Dhe meqenëse ashpërsia, kundërshtimi i pjesshëm e shumë i pakët që ka ardhur në një ose në dy trajtesa nuk ishte i synuar nga ana jonë -ndoshta ne u përplasëm me ta në kalim kur po përparonim drejt qëllimit tonë-, prandaj ky nuk mund të konsiderohet qëllim politik. Dhe meqenëse mundësitë -gjasat- janë një gjë dhe ndodhitë janë diçka tjetër, dhe ajo për të cilën ne jemi akuzuar

është një prishje e mundshme e rendit publik, dhe jo se e kemi prishur, kjo është një akuzë e kotë dhe e pakuptim, dhe i ngjason akuzës ndaj një personi për krimin e vrasjes, thjesht se është e "mundur" që ai ta bëjë një veprim të tillë. Dhe meqenëse Gjykatat në Eskishehir, në Kastamonu, në Isparta dhe në Denizli nuk mundën të gjenin -pavarësisht hetimeve të tyre të rrepta- asgjë që të përbënte një krim real dhe asnjë provë akuze në mijëra kopje të Risale-i Nurit dhe në letrat e shkëmbyera midis dhjetëra mijëra njerëzve gjatë njëzet viteve; dhe megjithëse Gjykata e Eskishehirit nuk gjeti asgjë përveç se një letre të vogël, ajo u detyrua të përdorë nën një artikull të një ligji 'elastik', për të na ngarkuar me përgjegjësi, dhe mundi vetëm të jepte një dënim me gjashtë muaj burgim për pesëmbëdhjetë prej njëqind vetave, në një mënyrë që ata duhej t'i kishin dënuar të gjithë ata që jepnin mësim fetar.

Në qoftë se do të supozonim se do të ndodhej një person midis jush -si ne-dhe të hetoheshin njëzet prej letrave të tij të cilat i ka shkruar gjatë një viti... në qoftë se do të realizohej kjo, a nuk do të ishte e mundur të gjendeshin në këto letra njëzet fjali që do ta turpëronin dhe do ta vinin para përgjegjësisë? Prandaj, fakti se në njëzet mijë kopje prej trajtesave dhe letrave prej njëzet mijë njerëzve ata nuk mundën të gjejnë njëzet fjali të dënueshme, tregon se qëllimi i Risale-i Nurit është vetëm Ahireti. Ai nuk ka lidhje me dynjanë.

• • •

Parimi i Nëntë: Ashtu si me çështjet të cilat prokurori i drejtë i Gjykatës së Denizlit i përfshiu në akuzë për shkak të raporteve të padrejta dhe sipërfaqësore të vendeve të tjera, po kështu me Gjykatën e Afjonit -siç u tregua nga ajo që ne përjetuam ndërsa pyeteshim-, pretekstet janë bërë me qëllim që ne të akuzohemi lidhur me të njëjtat çështje, dhe me letra të padatuara -pa datë- dhe me korrespondenca që janë bërë gjatë njëzet ose pesëdhjetë ose dhjetë viteve. Dhe Rrezja e Pestë -përgjigjjet vendimtare të së cilës gjenden në parimin e tretë të lartëpërmendur dhe në Pyetjen e Dytë të peticionit tim që u përmend më parë -dhe katër ose pesë trajtesat prej njëqind e tridhjetë trajtesave të Risale-i Nurit, dhe një numër prej trajtesave që qenë hetuar nga Gjykata e Eskishehirit dhe për të cilat u krye dënimi, më vonë u përfshinë nga ligjet e amnistisë dhe morën pafajësinë prej Gjykatës së Denizlit- dhe tani përpiqen që të gjejnë pretekste të kota prej atyre letrave që të jenë si mjete akuze për ne.

Sa Çudi! Ai i cili, nëpërmjet një fjalimi të tij, nënshtroi tetë batalione ushtrie në ngjarjen e 31 Marsit, të cilat nuk ia kishin vënë

veshin as Shejhul Islamit dhe as fjalës së Ulemave -dijetarëve. A është e mundur që ai t'i bindte e t'i mashtronte vetëm gjatë tetë viteve shembullin e këtyre burrave? Dhe a mund të thuhet se ai vetëm mundi të mashtronte pesë burra në një provincë të madhe, në provincën e Kastamonus?

Sepse ju i nxorët të gjitha librat e mi dhe letrat private, të fshehta dhe të hapura në Kastamonu prej poshtë stivës së druve, dhe pasi i studiuat ato për tre muaj, nuk mundët të gjenit në atë provincë të madhe, në atë qytet të madh, veçse Fejziun, Eminin, Hilmiun, Teufikun dhe Sadikun. Sepse Fejziu dhe të tjerët kishin kryer disa shërbime personale për mua për hir të Zotit xh.sh., ata i dërguan në burg bashkë me tre vëllezër dhe me tre a katër të tjerë që i gjetën në Emirdag, të cilët më ndihmuan mua për tre vite e gjysëm. Në qoftë se unë do të kisha bërë çfarë deklaroi ai raport sipërfaqësor, nuk do të kisha mashtruar pesë apo dhjetë njerëz por pesëqind ose ndoshta pesë mijë ose madje pesëqind mijë. Ashtu si tek Gjykata e Denizlit unë shfaqa shumë gabime në raportet e policisë, po kështu këtu unë do të tregoj një ose dy shembuj:

Ata na akuzuan për "prishje feje" për shkak se, duke ndjekur një zakon islamik të praktikuar qysh nga koha e profetit a.s.m., unë përpilova një "*Hizb Kur'ani*" si një '*en'ame*' e madhe prej qindra vërseteve të mirënjohura të cilët formojnë bazat e Risale-i Nurit.

Gjithashtu, ata donin të na dënonin duke na treguar se trajtesa rreth veshjes islame u shkrua dhe u botua në këtë vit, ndonëse unë tashmë e kam kryer një vit dënim për të, dhe unë e konsideroja atë trajtesë si private, dhe siç u njoftua në raportin e policisë, ajo u nxor prej nga poshtë stivës së druve. Pastaj, kur unë e kundërshtova me fjalë të ashpra atë person të njohur i cili mori kryesinë e qeverisë në Ankara, dhe ai nuk u përgjigj por preferoi heshtjen, veçse ama pas vdekjes së tij, realiteti i hadithit sherif e shfaqi gabimin e tij- të cilin e kisha shkruar para dyzet viteve- dhe ai realitet dhe ato kritika që ishin të natyrshme e të domosdoshme, dhe që i kishim marrë si private, të përgjithshme dhe jo veçanërisht për atë person, prokurori i përgjithshëm e aplikoi atë në kuptim të fjalëpërfjalshëm mbi atë person dhe e bëri një shkelje të dënueshme, dhe boshtin e përgjegjësisë mbi ne. A mund të ketë ndonjë krahasim midis hirit ose kujtimit të një njeriu që është i vdekur, është larguar dhe që nuk ka më asnjë lidhje me qeverinë, dhe midis ligjeve të drejtësisë së Allahut të Gjithëfuqishëm, që janë një manifestim i Sovranitetit të Tij xh.sh.?

Gjithashtu, liria e ndërgjegjjes e cila -prej parimeve të adoptuara nga qeveria e Republikës- është njëra tek e cila ne jemi mbështetur më shumë dhe me të cilën jemi mbrojtur, është bërë diçka që ne e kemi dhunuar, dhe sikur ne po e kundërshtojmë atë.

Gjithashtu, për shkak se unë kritikova të këqiat dhe të metat e civilizimit, gjëra të paimagjinueshme më janë atribuar mua në raportet e policisë: sikur unë nuk pranoj përdorimin e radios[230], të aeroplanëve dhe të trenave; ata më akuzojnë për qënien time si kundërshtar për progresin e civilizimit modern. Duke bërë një krahasim me këto shembuj, në dashtë Zoti xh.sh., ashtu si prokurori i përgjithshëm i drejtë dhe i paanshëm i Denizlit, edhe Gjykata e Afjonit do të shfaqë se sa në kundërshtim me drejtësinë është ky trajtim, dhe nuk do t'u japë asnjë rëndësi iluzioneve në ato raporte policie.

Gabimi më i çuditshëm është ky: Aeroplani, treni dhe radioja të cilat konsiderohen prej mirësive të mëdhaja të Allahut Fuqiplotë; këto mirësi duhet të takohen duke i bërë falënderime të panumërta Allahut; por meqenëse njerëzimi nuk iu përgjigj atyre me falënderime, ranë mbi kokat e tyre bombat e avioneve.

Gjithashtu edhe radioja është një mirësi e madhe Hyjnore, dhe falënderimet për të mund të tregohen duke e bërë atë një recituese Kur'ani me miliona gjuhë, duke i lejuar të gjithë njerëzit në faqen e tokës që ta dëgjojnë. Gjithashtu unë thashë kur shpjegova në Fjalën e Njëzet se Kur'ani parashikon dhe bën njoftime për çudirat e civilizimit aktual, dhe shpjeguam në të, kur treguam njërën prej shenjave dhe aluzioneve të vërsetit, se mohuesit do ta mposhtin botën islame nëpërmjet trenit. Dhe në kohën kur unë i nxisja myslimanët për tek këto çudira të qytetërimit, disa prokurorë të përgjithshëm të gjykatave të mëparshme i bënë këto si bazat për të na akuzuar neve, sikur unë i kundërshtokam këto shpikje.

Pastaj njëri prej tyre tha: Emri *Risale-i Nur* vjen nga Drita e Kur'anit Kerim, domethënë, inspirohet prej tij, dhe është trashëgimtare, dhe kryen detyrën e mesazhit të Sheriatit të profetësisë. Dhe prokurori i përgjithshëm i dha një kuptim të gabuar dhe e bëri bazën e akuzave të tjera, sikur unë paskam thënë, se Risale-i Nuri është një *Resul* -Profetësi Hyjnore. Unë gjithashtu kam provuar me

---

[230] Me qëllim që t'i paraqesim falënderime Allahut ndaj mirësisë së Radios, që është një mirësi e madhe Hyjnore, unë thashë, ajo duhet të recitojë Kur'anin që ta dëgjojnë atë të gjithë njerëzit në faqen e tokës, edhe atmosfera të bëhet një Hafize -lexuese e Kur'anit Kerim". - Autori.

argumente vendimtare në njëzet vende në Fjalët e mia mbrojtëse: Se ne nuk e bëjmë fenë, as Kur'anin, dhe as Risale-i Nurin një mjet apo një instrument as sikur të fitohej e gjithë bota, ato nuk mund të shfrytëzohen kurrë; dhe se ne nuk do ta ndryshonim as edhe njërën prej të vërtetave të tyre as për sundimin e të gjithë botës. Dhe ne në realitet kështu jemi. Ka pasur me mijëra tregues e shenja për këtë që kam pretenduar për më shumë se njëzet vite.

Por duket nga rruga e prokurorisë së Gjykatës së Afjonit dhe në vendimet e saj të bazuara mbi hetime të tjera, mbi raporte të tjera të policisë: se ne i shpenzokemi të gjitha përpjekjet tona mbi intrigat e kësaj bote dhe për të fituar kotësirat -gjërat kalimtare- të kësaj dynjaje, dhe qenkemi duke e bërë fenë një mjet për gjërat e ulëta dhe qenkemi duke e prishur e zvetënuar shenjtërinë e saj, dhe duke i bërë këto qëllimin tonë. Meqenëse është kështu, me të gjithë fuqinë tonë unë them:

"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe Ai për ne është Rregulluesi më i mirë i punëve".

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Një shtojcë për kundërshtimet e mia të shkruara ndaj akuzave të bëra kundra nesh nga Gjykata e Afjonit.

[Atyre që u adresohem në këtë kundërshtim nuk janë prokurori i përgjithshëm dhe gjykata, por zyrtarët dyshues dhe dashakëqinj të cilët për shkak të raporteve të prokurorëve të përgjithshëm të vendeve të tjera dhe të informatorëve, agjentëve dhe dedektivëve, e kanë kthyer kundra nesh situatën e jashtëzakonshme këtu dhe në zyrën e hetuesisë.]

Së Pari: Ashtu si sa larg drejtësisë do të ishte nëse i quan studentët e Risale-i Nurit, të cilët janë të pafajshëm dhe nuk kanë asnjë lidhje me politikat, duke i emërtuar një "shoqëri politike" gjë e cila është krejtësisht e pabazë dhe nuk ka ndodhë kurrë tek ne, dhe t'i akuzosh të mjerët, të cilët kanë përqafuar Risale-i Nurin dhe nuk kanë asnjë qëllim tjetër përveç besimit dhe Ahiretit, për botim veprash për atë

shoqëri, ose për qënien e tyre oficerë aktivë apo anëtarë të saj, ose për leximin e Risale-i Nurit ose që ua mësojnë atë të tjerëve ose pse e shkruajnë, duke i gjykuar ata kështu të jenë fajtorë për ndonjë krim, dhe duke i dërguar në gjykatë -të gjitha këto- janë një provë se sa larg drejtësisë do të ishte kjo; prova e prerë është sa vijon:

Në përputhje me parimet e lirisë së mendimit dhe lirisë shkencore, ata të cilët lexojnë veprat e dëmshme të shkruara për të kundërshtuar Kur'anin nga Doktor Dozi dhe nga ateistët e tjerë nuk konsiderohen të kenë kryer krime, kurse ata të cilët kanë shumë nevojë për të vërtetat e Kur'anit dhe të besimit dhe janë të përmalluar për të vepruar kështu, si dhe e lexojnë dhe e shkruajnë Risale-i Nurin, i cili i jep mësim ato të vërteta aq qartë sa drita e ditës, konsiderohen fajtorë krimesh. Pastaj ata na akuzuan neve vetëm për disa fjali që kanë ardhur në një ose dy trajtesa private të fshehta -me qëllim që të mos shpjegoheshin gabimisht dhe kjo ndodhi qysh para se ato të paraqiteshin në gjykata- duke ditur se ato trajtesa i kishte hetuar gjykata e Eskishehirit, me përjashtim të njërës prej tyre -dhe kundërshtoi vetëm se një ose dy çështje në Trajtesën e *Hixhabit*- veshjes islame; dhe unë iu përgjigja atyre me përgjigje vendimtare si në peticionin tim po ashtu edhe në kundërshtimet e mia. Dhe ne thamë: "Ne kemi dritë në duart tona dhe jo topuzin e politikave", dhe këtë e provuam në Gjykatën e Eskishehirit me njëzet aspekte; edhe Gjykata e Denizlit i hetoi të gjitha trajtesat e Risal-i Nurit pa përjashtim dhe nuk i kundërshtoi asnjërën prej tyre. Por ata prokurorë të padrejtë i përgjithësuan dhe i shtrinë ato tre apo katër fjali tek të gjithë Risale-i Nuri, dhe ashtu siç konfiskuan katërqind faqet e koleksionit "*Dhul-Fikar*" për shkak të dy faqeve, po ashtu ata deklaruan se ata të cilët lexojnë ose shkruajnë Risale-i Nurin do të ishin fajtorë krimi dhe më akuzuan mua se po kundërshtoja qeverinë. Unë i thërras ata të cilët janë të afërm me mua dhe shokët që më takojnë për të dëshmuar se për më shumë se dhjetë vite, përveç dy kryetarëve, një deputeti dhe Guvernatorit të Kastamonus, unë nuk kam ditur se kush janë drejtuesit e qeverisë, ministrat e saj, komandantët, zyrtarët dhe deputetët, dhe nuk kam qenë kureshtar që ta zbuloj. Veçse para një apo dy vitesh, një ose dy persona shfaqën një interes tek unë, dhe unë i njoha nëpërmjet tyre pesë apo gjashtë prej anëtarëve drejtues të qeverisë.

A do të ishte e mundur për dikë që dëshiron të kundërshtojë qeverinë të mos i njihte njerëzit që ai lufton, dhe të mos kishte dëshirë që t'i njihte, apo të mos i jepte rëndësi të mësuarit nëse ata janë miq apo armiq? Nga kjo kuptohet se ata fantazojnë pretekste krejtësisht të pabaza për të më shkatërruar mua sido që të ndodhë.

Meqenëse çështja është kështu, unë nuk i them gjykatës këtu por atyre njerëzve të padrejtë, unë nuk i jap aspak rëndësi edhe dënimit tuaj më të rreptë; ai nuk ka asnjë rëndësi. Sepse unë jam shtatëdhjetë e pesë vjeç dhe e kam një këmbë në varr, jam në pragun e derës së varrit. Të shkëmbeje një ose dy vite prej jetës së pafajshme të përndjekjes për rangun e martirizimit do të ishte lumturia më e madhe për mua. Në sajë të mijëra provave të Risale-i Nurit, unë besoj me sigurinë më të plotë se për ne vdekja është një dokument lirimi dhe një biletë për të hyrë në botën e qetësisë dhe të lumturisë. Edhe në qoftë se vdekja është një ekzekutim në anën e jashtme, për ne vështirësia e një ore kohe transformohet në një lumturi dhe në një çelës për mëshirë dhe një rast i madh për të kaluar tek bota e qëndrueshmërisë dhe e përjetësisë. Kurse, o armiqtë tonë të fshehur dhe o ju që po çudhëzoni e ngatërroni drejtësinë për llogari të ateizmit dhe e preokuponi qeverinë me ne pa asnjë arsye! Dijeni me siguri këtë dhe dridhuni! Sepse ju do të ekzekutoheni me asgjësim të përjetshëm dhe me burgim të vetmuar. Ne shohim se hakmarrja jonë mbi ju do të jetë në një mënyrë të dyfishtë. Dhe ja, ne e shohim atë dhe na vjen keq për ju! Po, sigurisht, realiteti i vdekjes, që e ka zbrazur këtë qytet njëqind herë në varreza, pa dyshim që ai duhet të ketë ndonjë qëllim e kërkesë më shumë se sa qëllimin e jetës dhe të jetuarit. Dhe përpjekja për të shpëtuar prej kthetrave të atij ekzekutimi të përhershëm është çështja më e rëndësishme e njeriut, madje ajo është më e madhja dhe më e rëndësishmja e domosdoshmërive të njerëzimit.

Meqenëse e vërteta është kjo, a nuk do të ishte e çuditshme që një grup prej njerëzve i akuzojnë studentët e Risale-i Nurit -të cilët u udhëzuan tek ai mister dhe që e gjetën atë të vërtetë- duke i vënë akuza të pabaza Risale-i Nurit, i cili e provon atë të vërtetë me mijëra prova e argumente? Ai që do të kishte sa një grimcë mend -madje edhe sikur të ishte i çmendur- do ta kuptonte se ata persona me ato akuzat e tyre e bëjnë vetveten të duken se sa shumë fajtorë janë ata vetë në sytë e së vërtetës dhe të drejtësisë.

Ndodhen tri çështje të cilat i mashtrojnë këta njerëz të padrejtë dhe i japin shkas iluzionit për ekzistencën e një shoqërie politike, gjë e cila është krejtësisht pa vend.

E Para: Fakti se, meqenëse qysh në të kaluarën studentët e mi kanë qenë lidhur fort me mua si vëllezër, i ka dhënë shkas përshtypjes së gabuar të ekzistencës së një ‘shoqërie’.

E Dyta: Disa nga studentët e Risale-i Nurit kanë vepruar sikur të ishin një grup islamik, si ato xhemate që gjenden në çdo vend të cilat i

lejojnë ligjet e republikës dhe nuk i kundërshtojnë; prandaj disa i imagjinuan se ata ishin një "shoqëri". Por ai numër i kufizuar prej tre apo katër studentëve nuk ka synuar asnjë lloj "shoqërie politike", por ajo është vetëm një vëllazëri e pastër dhe thjesht një lidhje e ngushtë duke punuar për Ahiretin.

E Treta: Ata të padrejtë i njohin vetet e tyre se janë mbytur në adhurimin e dynjasë dhe që janë shumë të çudhëzuar dhe të mposhtur prej dashurisë për këtë dynja dhe i kanë gjetur disa prej ligjeve të qeverisë të përshtatshme për vetveten, dhe prandaj thonë çfarë t'u vijë në mendjet e tyre: "Saidi dhe shokët e tij na kundërshtojnë neve dhe ligjet e qeverisë, të cilat u përshtaten tekave tona, atëherë ata janë një shoqëri politike".

Unë them: O ju fatkëqinj! Në qoftë se dynjaja do të kishte qenë e përjetshme dhe e amshuar, dhe në qoftë se njeriu do të qëndronte në të përjetësisht dhe në qoftë se detyrat e tij do të ishin vetëm politikat, ndoshta në këtë shpifjen tuaj do të kishte pasë ndonjë kuptim. Por dijeni se në qoftë se do t'i kisha hyrë punës nga dera e politikës -nga këndvështrimi i politikave- do të shikonit një mijë fjali të formuluara në një mënyrë sfiduese të politikës. Në qoftë se do të supozonim të pamundurën, -siç thoni ju- ne do të kishim punuar me të gjithë fuqinë tonë për qëllimet e kësaj dynjaje, për kënaqësitë dhe për politikat, një supozim që as shejtani nuk do të përpiqej që të bindte dikë, meqenëse në këto njëzet vite nuk ka pasë asnjë incident në të cilin ne të ishim përfshirë, dhe qeveria shikon dorën dhe jo zemrën, dhe të gjitha qeverië kanë kundërshtarë të ashpër, atëherë ju nuk mund të na gjykoni neve si fajtorë në emrin e ligjit. Fjala ime e fundit është:

"Allahu është më se i mjaftueshëm për mua. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor".[231]

"Një Ngjarje e Paligjshme"

[Pas pafajësisë sonë në Gjykatën e Denizlit, pavarësisht qënies sime i veçuar dhe i tërhequr në *ietikaf* gjatë tre viteve duke e braktisur krejtësisht politikën, kjo ngjarje e re, e cila rezultoi me dërgimin tonë në Burgun e Afjonit, është e paligjshme në dhjetë mënyra, ashtu siç do ta shpjegoj].

---

[231] Kur'an, 9:129

E Para: Megjithëse Risale-i Nuri është hetuar e shqyrtuar me imtësi nga tre gjykata, nga tre komitete ekspertësh, dhe nga shtatë departamente të qeverisë në Ankara dhe nga organet e tyre të drejtësisë, dhe që të gjithë ata pa përjashtim ranë dakort me unanimitet për pafajësinë e Risale-i Nurit, dhe për pafajësinë e "Saidit" dhe për pafajësinë e shokëve të tij numri i të cilëve arrinte në shtatëdhjetë e pesë; dhe ata nuk u dënuan as edhe me një ditë burgosje, -pavarësisht të gjithë kësaj, sulmi i tyre dhe agresioni ndaj atyre trajtesave, sikur ato të ishin letra të rrezikshme që do të prishnin rendin në vend, kjo do ta bënte gjithësecilin që ka sadopak arsye dhe paanshmëri- që të kuptonte se kjo është krejtësisht në kundërshtim me ligjin.

E Dyta: Ai person që ka qëndruar i veçuar në *Iëtikaf* në Emirdag gjatë tre viteve pas pafajësisë, dhe i cili ka jetuar si i huaj me derën e tij të mbyllur nga brenda dhe nga jashtë, dhe i cili nuk pranon askënd prej njerëzve që ta takojë veçse për ndonjë çështje tepër të domosdoshme; i cili hoqi dorë edhe nga puna e të shkruarit me të cilën kishte vazhduar qysh prej njëzet viteve, vijnë dedektivët, thyen kyçin e derës dhe hynë me dhunë në dhomën time për qëllime politike. Gjithkush që do të kishte sa një grimcë drejtësi do ta kuptonte se sa e paligjshme do të ishte t'i biesh më qafë atij në këtë mënyrë.

E Treta: Ashtu siç tha ai në gjykatë: Ai që nuk interesohet për të ditur lajmet rreth luftës së Dytë Botërore, ashtu siç konfirmohet nga shtatëdhjetë dëshmitarë, dhe as nuk pyeti rreth saj, dhe vazhdoi në këtë gjendje, dhe nuk lexoi asnjë gazetë që prej njëzet e pesë vitesh dhe nuk ua vuri veshin atyre, dhe i cili tha:

"O Zot! Të kërkoj mbrojtje të më ruash nga shejtani dhe nga politika" qysh prej tridhjetë vitesh, dhe që u është shmangur politikave me të gjithë fuqinë e tij, dhe i cili vuajti tortura të rënda gjatë njëzet e dy viteve, dhe i cili nuk iu drejtua as edhe një herë të vetme qeverisë -për të garantuar rehatinë e tij, për të lehtësuar kushtet e tij- me qëllim që të mos tërheqë vëmendjen e politikanëve dhe as të përfshihet në politika... Pavarësisht nga e gjitha kjo, a do të ishte në përshtatshmëri me ndonjë ligj të bastisësh shtëpinë e tij, -vendin e tij të veçuar- sikur ai të kurdiste komplote politike, dhe t'i shkaktoje atij vuajtje të padëgjuara ndërsa ishte i sëmurë? Gjithkush me sa një grimcë ndërgjegjje do të pikëllohej për këtë gjendje!

E Katërta: Gjykata e Eskishehirit e shqyrtoi Risale-i Nurin për gjashtë muaj për shkak se ne ishim akuzuar për formimin e një shoqërie politike dhe për themelimin e një tarikati Sufi, dhe për shkak të atij dyshimi dhe për shkak të urrejtjes personale të kryetarit të

madh[232], ajo nxiti disa anëtarë të ministrisë së drejtësisë që të vepronin kundra nesh, por ajo gjykatë na dha pafajësinë për akuzat e organizimit të ndonjë "shoqërie politike", për themelim të ndonjë tarikati Sufi dhe i dha pafajësi Risale-i Nurit prej akuzave. Dhe vetëm duke e bërë një pretekst trajtesën e *Hixhabit* -mbulesën e grave - e cila konsiderohet vetëm një pjesë e vogël e Risale-i Nurit, ajo dha dënim me gjashtë muaj burg për pesëmbëdhjetë prej njëqind studentëve, jo në përputhje me ligjin, por arbitrarisht. Dhe megjithëse deri kur u plotësuan hetimet, ata mbetën në burg për katër muaj e gjysëm, domethënë ata kryen dënimin për një muaj e gjysëm, dhe dhjetë vite më vonë Gjykata e Denizlit përsëri me një numër pretekstesh si organizimi i një shoqërie politike dhe themelimi i një tarikati Sufi, dhe pasi i shqyrtoi dhe i kontrolloi të gjitha shkrimet, letrat dhe veprat që ishin shkruar për njëzet vite, me një hetim që zgjati për nëntë muaj -sapo i akuzoi këto vepra se po nxisin themelimin e një shoqërie ose të një tarikati Sufi, ajo dërgoi pesë kutia me libra për tek gjykata e lartë penale në Ankara, dhe megjithëse ato libra e letra iu nënshtruan për dy vite hetimit prej anës së Gjykatës së lartë penale në Ankara dhe prej gjykatës së Denizlit, ata morën një vendim unanim për pafajësinë e këtyre trajtesave dhe letrave prej akuzave të drejtuara tek ato si formimi i një shoqërie ose të një tarikati Sufi si dhe pretekste të tjera të ngjashme me këto[233], dhe i rikthyen të gjithë librat tek pronarët e tyre. Ato gjithashtu u dhanë pafajësi Saidit dhe shokëve të tij. Prandaj ai që nuk e ka humbur humanizmin e tij do të kuptonte se sa e paligjshme do të ishte ta shohësh atë si një aktivist politik dhe ta akuzoje atë për qënien e tij komplotues, dhe të nxisësh nëpunësit e gjykatës kundra tij duke e konsideruar atë si burrë Tarikati.]

E Pesta: Meqenëse Dhembshuria ka qenë një parim i jetës sime qysh prej tridhjetë vitesh, dhe një themel i rrugës sime dhe i metodës

---

[232] Aludon për Mustafa Qemalin. Përkthyesi.

[233] Baza dhe qëllimi i Risale-i Nurit është *El-imanu el-tahkikij* -besimi i sigurt dhe i verifikuar- dhe shfaqja e të vërtetës së Kur'anit. Për këtë arsye, tre gjykata i kanë dhënë pafajësinë Risale-i Nurit lidhur me akuzën e formimit të një tarikati Sufi. Për më tepër, asnjë person nuk ka thënë gjatë këtyre njëzet viteve: "Saidi më ka dhënë mua udhëzim tarikati". Pastaj, një rrugë tek e cila për një mijë vite kanë qenë lidhur shumica e paraardhësve të këtij kombi, nuk mund ta bëjë përgjegjëse atë me të cilën janë lidhur anëtarët e këtij kombi. Pastaj hipokritët e fshehtë e ngjisin emrin e tarikatit tek realiteti i islamit. Nuk mund të akuzohet çdokush i cili përballet për mbrojtjen e fesë së këtij kombi se ai është një ndjekës tarikati. Ndërsa lidhur me akuzën për organizimin e 'shoqërisë', ajo vëllazëri islame që është tek ne ka si synim vëllazërinë e Ahiretit, dhe nuk është shoqëri politike, ashtu siç shpallën tre gjykatat pafajësinë për ne nga kjo akuzë.

së Risale-i Nurit, unë nuk i shmangem vetëm kritikës ndaj tiranëve të cilët më kanë persekutuar, por madje nuk mundem as edhe t'i takoj ata me lutje kundra tyre -me mallkim- dhe këtë e bëj me qëllim që të mos u vijë asnjë dëm të pafajshmive.

Madje kjo dhembshuri është pikërisht ajo që më ka penguar që t'i kundërshtoj -ose madje as t'i mallkoj- disa të shthurur dhe madje disa tiranë të pafe të cilët më shtypën mua për shkak të një urrejtjeje të fortë, me qëllim që të mos bëhem shkak për ndonjë dëm material që mund t'u vijë të mohuarve të mjerë si shembulli i babait të atij tirani apo nënës së tij, ose që të mos u shkaktohet dëm shpirtërave të pafajshëm si fëmijët e tij. Prandaj, për shkak të katër ose pesë të pafajshmive të tillë, unë mund ta kritikoj atë tiran tradhtar; madje unë ndonjëherë i fal ata. Për shkak të kësaj dhembshurie unë nuk ndërhyj absolutisht në qeveri dhe as nuk e prish rendin publik. Për më tepër, unë e kam rekomanduar këtë aq fort tek të gjithë shokët e mi, saqë disa nga policët e drejtë në tre provincat kanë pranuar se "studentët e Risale-i Nurit janë policë të një lloji; ata ruajnë rendin dhe sigurojnë qetësinë publike". Ka mijëra dëshmitarë për këtë fakt, dhe ata e kanë konfirmuar atë me anë të eksperiencës së tyre njëzet vjeçare dhe me mijëra studentë -e kanë mbështetur atë duke mos u përfshirë kurrë në ndonjë incident të regjistruar nga policia; atëherë cili ligj lejon që të bastiset shtëpia e atij njeriu të mjerë, sikur ai të ishte një revolucionar dhe një burrë komplotist dhe të trajtohej me padrejtësi nga ana e këtyre njerëzve mizorë, ta fyesh atë, dhe pavarësisht se nuk u gjet asgjë në shtëpinë e tij, sikur ai të ishte një kriminel i shumëfishtë ata i konfiskuan një kopje të rrallë të Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm dhe disa tablo që gjendeshin të varura në murin e tij, sikur ato të ishin letra të dëmshme?

Çfarë ligji do t'i lejonte këto sjellje kundra mijëra personave fetarë të cilët e kanë mbrojtur rendin me moralet e mira të tyre? Dhe çfarë interesi ka në nxitjen e tyre dhe duke i shtyrë ata me forcë që të marrin një qëllim kundra rendit dhe sistemit?

E Gjashta: Në sajë të Zotit xh.sh. unë jam një njeri i cili ka njohur prej shkëlqimit të Kur'anit qysh prej tridhjetë vitesh se si fama e përkohshme e kalimtare e dynjasë, dhe lavdia e saj e karakterizuar me egoizëm si dhe adhurimi i famës dhe i pozitës në të janë gjëra pa dobi, pa kuptim dhe pa asnjë të mirë, atëherë një mijë e një falënderime qofshin për Allahun; prandaj ai qysh prej asaj kohe është përpjekur me të gjitha mundësitë të luftojë me nefsin e tij urdhërues për të liga, dhe megjithëse shokët e tij dhe ata të cilët i kanë shërbyer atij e dinë me

njohjen e sigurt dhe dëshmojnë se ai ka bërë gjithçka që është e mundur për të thyer fuqinë e nefsit të tij, për të shpëtuar nga egoizmi i tij dhe për të shmangur hipokrizinë dhe artificializmin e tij; ai është përpjekur qysh prej njëzet vitesh t'i kundërshtojë të gjithë ata që e kanë lavdëruar e mburrur dhe që janë orientuar drejt personit të tij të shtyrë nga mendimi i mirë, gjë kjo që e bën gazmor nefsin e çdo njeriu; dhe i kundërshtoi të gjithë ata që e shohin atë të përshtatshëm për rangje shpirtërore; madje ai iku prej tyre me të gjithë fuqinë, dhe ua ktheu mendimin e mirë të tepruar të cilin e kanë shokët e tij të afërm dhe miqtë e tij të veçantë në një mënyrë saqë i pikëlloi dhe u lëndoi ndjenjat e tyre. Dhe në letrat e tij përgjigjëse nuk e pranonte kurrë lavdërimin e tyre, dhe mendimin e mirë të tepruar të tyre, pasi ai të gjithë virtytin ia atribuoi Risale-i Nurit i cili konsiderohet një komentim i Kur'anit Kerim, dhe nuk ia atribuonte vetvetes së tij, madje e privoi vetveten prej virtyteve dhe i drejtoi studentët e Risale-i Nurit që të kapen pas personalitetit kolektiv të Risale-i Nurit dhe e konsideroi vetveten thjesht si një shërbëtor të zakonshëm të Kur'anit Kerim, dhe kjo provon në mënyrë vendimtare se ai kurrë nuk është përpjekur që të shfaqë personin e tij dhe që ta bëjë vetveten të dashur, por e ka refuzuar.

Kështu, a ka ndonjë ligj që të lejojë ndonjë përgjegjësi, ose që të lejojë të sulmohet banesa e këtij personi të huaj, të sëmurë, të veçuar në dhomën e tij, që është shumë i moshuar, i dobët dhe i mjerë, të lejohet të thyhet kyçi i derës së tij dhe të hynë punonjësit e inspektoriatit në dhomën e tij, sikur ai të kishte bërë ndonjë krim të rëndë? Dhe kjo thjesht se disa prej shokëve të tij të largët e lavdëruan atë më shumë se sa e meritonte dhe pse e panë atë të përshtatshëm për një rang shpirtëror, pasi ata kishin për të një mendim të mirë të tepërt dhe për shkak të asaj çfarë tha për të një predikues në rajonin e Kytahjas të cilin ai nuk e njihte?

Megjithëse unë nuk kam dërguar asnjë letër në qytet, por ama u shkrua një letër mbi të cilën u vendos një firmë e fallsifikuar, gjë e cila i bëri ata të imagjinonin se unë isha përgjegjës për të; po ashtu për shkak të një libri ndikues që nuk njihej shkruesi i tij në qytetin Ballëkesir... A këto çështje i lejojnë ata të bastisin shtëpinë dhe ta kontrollojnë atë?... ndonëse ata nuk gjetën në shtëpi përveç *virdeve* - një libër lutjesh- dhe përveç tablove... Çfarë ligji në botë dhe çfarë politike e lejojnë një sulm të këtillë?

E Shtata: A do ta lejonte ndonjë ligj për një të mjerë i cili, megjithëse në këtë kohë brenda vendit kur ndodhen kaq shumë parti

dhe rryma të gjalla politike, të brendshme e të jashtme, dhe terreni është i gatshëm për ta shfrytëzuar, domethënë të fitosh diplomatë dhe politikanë të shumtë si mbështetës në vend të një grushti prej shokëve të tij; ai u shkroi të gjithë shokëve të tij duke u thënë: Ruhuni , që të mos të zhdukeni e qëroheni prej atyre rrymave politike, mos u përfshini në politika! Ruhuni që të mos prishni rendin", dhe këtë ua thonte me qëllim që ai t'i shmangej plotësisht hyrjes në politikë, që të mos dëmtohej sinqeriteti i tij, që të mos tërhiqte vëmendjen e qeverisë për tek vetja, dhe që të mos bëhej i preokupuar me dynjanë.

Rryma e mëparshme si rezultat i imagjinatave të saj, i bëri keq dhe dëm atij për shkak të shmangies së tij nga kjo, ndërsa rryma e re për shkak të pretendimit të saj: "Ai nuk na ndihmon dhe nuk bashkëpunon me ne". Ato të dyja i shkaktuan Atij dëm dhe pikëllim të fortë. Megjithatë, ai nuk ndërhyri kurrë në botën e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, por u preokupua me çështjet e Ahiretit të tij deri në atë shkallë saqë ai nuk i dërgoi vëllait të tij që ndodhet në Nurs as edhe një letër të vetme gjatë njëzet e dy viteve dhe as nuk u dërgoi shokëve të tij në ato provinca dhjetë letra gjatë njëzet viteve. Atëherë cili ligj lejon të ndërhyhet deri në këtë shkallë tek ky person i preokupuar me Ahiretin e tij?

Në një kohë që nuk ndërhyn asnjë kundra përhapjes së librave ateiste, të cilat janë libra shumë të dëmshëm për vendin, për kombin dhe moralin, dhe as nuk ndërhyn tek botimet e komunistëve, dhe këtë e bënë në emrin e ligjit të lirisë, u konfiskuan pjesët e Risale-i Nurit sikur ato të ishin letra të dëmshme dhe u paraqitën në gjykatë. Kjo ndodhi ndonëse tre gjykata nuk gjetën në këto trajtesa asnjë çështje të dëmshme; ato trajtesa qysh prej njëzet vitesh kanë bërë thirrje për tek më e mira e jetës shoqërore të këtij vendi dhe të këtij kombi, për forcimin e moraleve të tij, për të siguruar Rendin dhe qetësinë dhe për të forcuar vëllazërinë islame me botën islame, këtë vëllazëri e cila konsiderohet një pikë mbështetjeje dhe një forcë reale, dhe për t'ia rikthyer shoqërinë e kësaj bote islame këtij ummeti dhe për ta përforcuar në një mënyrë të efektshme. Ministri i brendshëm i urdhëroi dijetarët e drejtorisë së çështjeve fetare që ta shqyrtojnë me imtësi Risale-i Nurin për qëllim kritike, dhe pas tre muajsh hetimi, ata jo vetëm që nuk e kritikuan, por kuptuan siç duhet vlerën e tij dhe përmendën duke thënë se Risale-i Nuri është një vepër me një vlerë shumë të madhe, dhe i vendosën trajtesat si "*Dhul Fikar*" dhe *"Asa Musa*" në bibliotekën e drejtorisë së çështjeve fetare; dhe ashtu siç e panë Haxhillarët koleksionin e trajtesave të "*Asa Musa*" të vendosur në varrin e profetit Muhammed a.s.m..

A ka ndonjë ligj, ose ndërgjegje, ose drejtësi që të lejonte konfiskimin e Risale- Nurit dhe ta grumbullonte e ta paraqiste në gjykatë?

E Teta: Pas njëzet e dy vitesh internimi të pajustifikueshëm dhe pikëllues, dhe pasi iu dha liria ai nuk deshi të shkonte në vendin e tij në të cilin lindi dhe ku gjenden me mijëra nga familjet dhe nga të dashurit e tij, por preferoi vetminë dhe syrgjynosjen me qëllim që të mos ketë kontakt me jetën sociale dhe politikat, dhe e la namazin në xhami megjithëse ka shpërblim të madh në namazin me xhemat -dhe preferoi namazin e vetmuar në dhomën e tij... Domethënë ai është një njeri që kërkon t'i shmanget respektit që i bëjnë atij njerëzit... Dhe siç dëshmohet nga njëzet vitet e jetës së tij dhe e konfirmuar prej mijëra turqve të vlefshëm, se ai preferonte një turk të vetëm fetar e të devotshëm mbi shumë kurdë neglizhentë, ashtu siç e provoi vetë në gjykatë se një vëlla i vetëm turk me besim të fuqishëm si "Hafiz Aliu" ishte më i preferueshëm se sa njëqind kurdë neglizhentë.

Domethënë, një person i cili u shmanget takimit të njerëzve veçse për një çështje esenciale, dhe këtë me qëllim që të mos jetë objekt i respektit dhe i nderimit të tyre, dhe madje nuk shkon as në xhami, dhe i cili punoi me të gjithë fuqinë e tij dhe me të gjitha veprat e tij për vëllazërinë islamike dhe me qëllim që myslimanët ta donin njëri-tjetrin; dhe i cili e konsideroi kombin turk si mbajtësin e flamurit të Kur'anit dhe vlerësohet prej Kur'anit, dhe për këtë shkak e deshi shumë këtë komb dhe e kaloi jetën e tij... atëherë a lejohet që një *vali* -guvernator i mëparshëm- ta fyejë këtë person me zyrtarizëm dhe të bëjë propagandë dhe të hedhë frikën në zemrat e të gjithëve, me thënien e tij- "Ai është kurd dhe ju jeni turq; Ai është Shafii dhe ne jemi Hanefi", duke i bërë kështu shokët e tij të tremben e të largohen.

Pastaj unë pyes: A ka ndonjë ligj apo interes që orvaten ta detyrojnë një person të veçuar nga jeta shoqërore dhe ta detyrosh atë të vendosë një kapele strehëgjërë, ndonëse për më shumë se njëzet vjet dhe në dy gjykata, ai nuk është detyruar ta ndryshojë mënyrën e veshjes -*kijafetin*-e tij? Duke ditur se kapelja u hoq nga kokat e gjysmës së ushtrisë.

E Nënta: Këtu është një pikë shumë e rëndësishme dhe e fuqishme[234], por unë këtu do të qëndroj i heshtur meqë ajo prek shumë politikat.

---

[234] Fakti se ndodheshin krishterë dhe hebrenj nën qeveritë islame dhe myslimanë në qeveritë kristiane dhe zoroastriane tregon se kundërshtarët që nuk prishin rendin publik dhe as nuk ndërhyjnë në qeveri nuk mund të

E Dhjeta: Ky është një sulm, të cilin asnjë ligj nuk e lejon, dhe është pa dobi, dhe vetëm se e bën qimen tra për shkak të disa iluzioneve të pabaza, dhe nuk është pjesë e asnjë ligji. Edhe lidhur me këtë gjithshtu unë do të qëndroj i heshtur me qëllim që të mos prek politikat, me të cilat, sipas rrugës sonë, ne nuk kemi lidhje. Dhe kështu ne themi, ndërsa jemi përballë dhjetë fytyrave të këtij trajtimi të paligjshëm:

"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve".

Said Nursi

• • •

Unë kam edhe ca pika të tjera të cilat dua t'ua paraqes autoriteteve të Afjonit, dhe gjykatës dhe policëve të tij.

E Para: Shumica e profetëve duke u shfaqur në lindje dhe në Afrikë, dhe shumica e filozofëve duke u shfaqur në perëndim dhe në Europë, kjo është një shenjë e Kaderit Hyjnor qysh nga parapërjetësia se në Azi feja është dominuese ndërsa filozofia vjen në vendin e dytë. Duke u mbështetur mbi këtë shenjë të Kaderit, madje edhe në qoftë se nuk janë fetarë ata që sundojnë në Azi, të paktën nuk duhet të ndërhyjnë tek ata të cilët punojnë për fenë; madje duhet t'i inkurajojnë.

E Dyta: Kur'ani i gjithurtë është si mendja dhe fuqia e mendimit të kokës së tokës. Në qoftë se do të dilte Kur'ani -Ruajna Zot!- prej kësaj toke, toka do të çmendej. Nuk do të ishte larg arsyes të supozohet se një planet tjetër të përplasej me kokën e saj të zbrazur nga arsyeja, dhe do të shkaktonte shpërthimin e kijametit. Po, Kur'ani është një zinxhir, një litar i fortë i Allahut që e lidh tokën me Fronin Hyjnor. Ai e ruan tokën më shumë se forca e gravitetit. Kështu, Risale-i Nuri, i cili është një komentim i vërtetë i Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm, dhe këto trajtesa që kanë demonstruar ndikimin e tyre që prej njëzet vitesh në këtë shekull dhe në këtë atdhe për këtë komb konsiderohet një mirësi më e madhe Hyjnore dhe një mrekulli e pamposhtur e Kur'anit. Prandaj qeveria nuk duhet të ndërhyjë tek ai dhe nuk duhet të përpiqet që t'i trembë studentët e tij me qëllim që t'i largojë prej tij, por duhet

---

cënohen nga ana ligjore. Për më tepër, njeriu nuk është përgjegjës për "mundësitë". Përndryshe gjithësecili do të duhej të dërgohej në gjykatë dhe duhej të gjykohej për shkak të 'mundësisë' sepse gjithkush mund t'i vrasë njerëzit e tjerë.

t'i mbrojë këto trajtesa të Risale-i Nurit dhe t'i nxisë njerëzit që ta lexojnë.

E Treta: Në Gjykatën e Denizlit, lidhur me të gjithë besimtarët që vijnë duke i ndihmuar me dua për falje ata të cilët janë larguar tek e shkuara, duke ua lënë -paraqitur- veprat e tyre të mira shpirtërave të tyre, unë thashë sa vijon:

Kur ju të pyeteni prej miliarda besimtarëve ankues në Gjyqin e Fundit: "Përse ju deshët t'i shkatërronit me burgosje e përndjekje studentët e Risale-i Nurit, të cilët përpiqeshin të shpëtonin vendin dhe kombin nga anarkia, nga pafesia dhe nga shthurja, dhe orvateshin të shpëtonin bashkëkombësit e tyre prej asgjësimit të përjetshëm, ndonëse ju për shkak të ligjit të lirisë i shikuat me tolerancë botimet e ateistëve, të komunistëve dhe të shoqërive politike që prodhonin anarkistë, dhe ju nuk i bezdisët ata? Çfarë përgjigjje do të jepnit ju dhe ata të cilët duan t'i dënojnë dhe t'i shkatërrojnë studentët e Risale-i Nurit, të cilët u shërbejnë të vërtetave të Kur'anit?

Edhe unë gjithashtu po ju pyes të njëjtën gjë!... Këtë ua thashë atyre, dhe ata njerëz të drejtë dhe të paanshëm na dhanë neve pafajësinë, duke demonstruar drejtësinë dhe ndershmërinë e sistemit gjyqësor.

E Katërta: Unë prisja që të merresha në pyetje nga një vend konsultimi ose në Ankara ose në Afjon, ku do të bëheshin pyetje e përgjigje rreth çështjeve kryesore e të rëndësishme dhe lidhjes së Risale-i Nurit me to.

Po, Risale-i Nuri është mjeti më i fuqishëm dhe ilaçi më i efektshëm për këtë komb në këtë vend për të rikthyer vëllazërinë e mëparshme islame, dashurinë e mëparshme; mendimin e mirë, dhe ndihmën e tyre morale midis treqind e pesëdhjetë milionë myslimanëve, dhe për të gjetur rrugët e këtij bashkëpunimi. Ne do të përmendim sa vijon një shenjë të qartë për këtë:

Në Mekë këtë vit, një dijetar i madh mori përsipër përkthimin e pjesëve të mëdhaja të Risale-i Nurit në gjuhët indiane dhe arabe dhe i dërgoi këto përkthime në Indi dhe në Hixhaz -Arabi- duke thënë: "Risale-i Nuri lufton që të sigurojë unitetin dhe vëllazërinë islamike, që është mbështetja jonë më e fuqishme, kështu ai demonstron se kombi turk është gjithmonë në pararojë nga aspekti i fesë dhe i besimit".

Gjithashtu unë prisja se do të bëheshin pyetje madhështore si malet e larta, të tilla si: "Cila është shkalla e shërbimit të Risale-i Nurit dhe i

studentëve të tij kundra komunizmit i cili është transformuar në një lëvizje anarkiste në atdheun tonë? Si mund të ruhet e të mbrohet ky vend i bekuar prej kësaj rrëkeje të tmerrshme?”... Ndërsa prisja e parashikoja pyetje të këtilla, kur ç’të shohësh, unë u befasova nga çështje të parëndësishme që nuk kishin peshë as sa krahu i një mize dhe nuk kalonin çështjet e pjesshme dhe nuk kërkonin përgjegjësi, që buronin nga inate personale dhe nga shpifje të paramenduara të cilat e bënin qimen tra... Dhe kështu vuajta prej këtyre kushteve dhe rrethanave të rënda dhimbje të tilla që nuk i kam vuajtur kurrë më parë në jetën time.

Pyetje të pakuptimta u bënë rreth një ose dy çështjeve të pjesshme personale të cilat më parë tre gjykata i patën hetuar dhe pastaj shpallën pafajësinë.

E Pesta: Risale-i Nuri nuk mund të kundërshtohet dhe as të mposhtet. Ai qysh prej njëzet vitesh ka heshtur edhe filozofët më kryeneçë. Ai i demonstron të vërtetat e besimit në mënyrë aq të qartë si dielli në mesditë. Ata të cilët sundojnë në këtë vend duhet të përfitojnë prej fuqisë së tij.

E Gjashta: Të shkatërroni figurën time të parëndësishme për shkak të gabimeve të mia personale, dhe nëpërmjet trajtimit përbuzës duke helmuar opinionin publik rreth meje, kjo nuk i bën dëm Risale-i Nurit, përkundrazi kjo e forcon atë - nga ndonjë aspekt. Sepse në qoftë se do të heshtte gjuha ime e përkohshme, gjuhët e pavdekshme të njëqind mijë kopjeve të Risale-i Nurit, nuk mund të heshtin; ato do të flasin. Dhe ashtu siç kanë bërë deri tani, mijërat e gjuhëve të fuqishme të studentëve të tij të sinqertë do ta vazhdojnë atë shërbim të shenjtë e universal deri në Ditën e Kijametit, në dashtë Zoti xh.sh..

E Shtata: Ashtu siç e kemi përmendur në mbrojtjet tona përpara gjykatave të mëparshme në të cilat paraqitëm provat tona, armiqtë tonë zyrtarë dhe jozyrtarë të cilët mashtruan qeverinë, duke i bërë disa prej anëtarëve të saj kryesues dyshues rreth nesh, dhe duke i shkaktuar aparatit të drejtësisë të lëvizë kundra nesh, ose janë mashtruar rëndë ose kanë qenë mashtruar nga të tjerët dhe janë revolucionarë tepër tradhtarë duke punuar për llogari të anarkisë, ose ata janë prej armiqve të islamit, prej felëshuesve të cilët luftojnë të vërtetën e Kur’anit, dhe prej ateistëve... duke e quajtur tiraninë absolute “Republik” me qëllim që të na sulmojnë, dhe duke e bërë regjimin një mburojë për apostazinë absolute, dhe duke e quajtur shthurjen absolute ‘civilizim’, dhe duke e quajtur shtrëngimin arbitrar për llogari të mosbesimit ‘ligj’, ata edhe na kanë shkatërruar neve, edhe kanë mashtruar qeverinë, si

dhe e kanë bërë aparatin e drejtësisë të merret me ne pa asnjë motiv. Duke i referuar ata tek zemërimi i *"El-Kahhar Dhul-Xhelal" "Detyruesit Zotërues të Gjithëlavdisë",* ne kërkojmë mbrojtje e strehim tek kështjella *"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe Ai për ne është Rregulluesi më i mirë i punëve",* me qëllim që të na mbrojë neve nga të këqijat e tyre.

E Teta: Në vitin e kaluar Rusia dërgoi shumë njerëz për të bërë Haxhin si propagandë me qëllim që të tregojë se ata janë më të respektuar ndaj Kur'anit se sa kombet e tjerë dhe, për shkak të fesë, të përpiqet ta kthejë botën islamike kundra popullit fetar të këtij vendi. Por koleksionet e Risale-i Nurit ishin shpërndarë në atë kohë edhe në Mekë, edhe në Medine, edhe në Damask, në Egjipt dhe në Alep, duke tërhequr vlerësimin e dijetarëve fetarë, -ato trajtesa- edhe e thyen propagandën komuniste, dhe i treguan botës islame se kombi turk dhe vëllezërit e tyre vazhdojnë të jenë të kapur pas fesë së tyre dhe pas Kur'anit, dhe se ata janë si vëllezërit më të mëdhenj të popujve të tjerë të islamit dhe komandanti i tyre heroik në shërbim të Kur'anit. Domethënë ato koleksione të Risale-i Nurit e demonstruan këtë të vërtetë në ato qendra dhe në ato qytete islame.

Në qoftë se shërbimet e mëdhaja të Risale-i Nurit përballen me këto lloje torturash e dhimbjesh, a nuk e shihni të mundshme të shpërthejë me zemërim globi tokësor?

E Nënta: është një përmbledhje e shkurtër e një çështjeje e cila u provua dhe u shpjegua në mbrojtjen time në Denizli.

Në qoftë se do të supozonim se një komandant i madh ushtarak dhe një gjeni pati mundësi nëpërmjet inteligjencës së tij gjeniale që t'ia atribuonte vetvetes të gjitha aktet pozitive të ushtrisë, dhe t'ia atribuonte të këqiat e tij dhe aktet e tij negative personale ushtrisë, atëherë me këtë ka pakësuar numrin e të gjitha virtyteve dhe të akteve të mira, të cilat janë sa numri i individëve të ushtrisë, në një të mirë të një personi të vetëm; dhe kur ia atribuon të këqiat dhe gabimet e tij ushtrisë, ai i ka shumuar këto të këqija aq sa numri i ushtarëve në ushtri, dhe kjo do të ishte një padrejtësi e tmerrshme dhe në kundërshtim me të vërtetën. Prandaj unë i thashë prokurorit të përgjithshëm në njërën prej gjykatave të mëparshme kur ai më sulmoi mua për shkak të një shuplake ndaj atij personi[235] kur e shpjegova para dyzet vjetësh atë hadith sherif: "Është e vërtetë që unë po e fyej atë për shkak të parashikimeve të bëra nga hadithet, por unë gjithashtu jam

[235] Aludon për Mustafa Qemalin. Përkthyesi

duke mbrojtur nderin e ushtrisë dhe jam duke e ruajtur atë prej gabimeve të mëdhaja. Ndërsa ti, je duke njollosur nderin e ushtrisë, e cila konsiderohet mbajtësja e flamurit të Kur'anit, dhe është komandantja heroike e botës islame, dhe i mohon dhe fyen virtytet dhe vlerat e saj për hir të një shokut tënd të vetëm".

Ai prokuror i përgjithshëm iu nënshtrua drejtësisë -me leje të Zotit- dhe shpëtoi nga gabimi.

E Dhjeta: Meqenëse është e domosdoshme që institucioni i drejtësisë duhet të ruajë të vërtetën e drejtësisë dhe të mbrojë të drejtat e të gjithë atyre që i drejtohen pa asnjë dallim, dhe duhet të punojë vetëm për hir të së drejtës dhe vetëm në emrin e saj, ne shohim se Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, në ditët kur ai drejtonte kalifatin, u ul përpara gjykatës së bashku me një çifut për t'u gjykuar. Në një rast tjetër, një gjykatës i drejtë pa se njëri prej nëpunësve të tij u zemërua mbi një vjedhës keqbërës kur po ia priste dorën, dhe menjëherë gjykatësi urdhëroi që nëpunësi të pushohej, dhe me shumë pikëllim tha: Ata që deri tani kanë qenë ndikuar nga ndjenjat e tyre personale në këtë mënyrë ndërsa janë duke ekzekutuar ligjin, kanë kryer krime të mëdhaja". Ai që i përzien ndjenjat e tij me zbatimin e ligjit të drejtësisë, sigurisht që ka bërë një krim të rëndë."

Po, nëpunësi, kur ekzekuton një vendim ligjor, në qoftë se nuk do t'i vinte keq për të dënuarin, veçse ama ai nuk duhet as të zemërohet me të, sepse në qoftë se do të vepronte kështu, do të ishte tiran. Madje njëri prej gjykatësve të drejtë ka thënë: Personi i cili ekzekuton me zemërim dënimin me vdekje kur është në "kisas" -shpagim- nëse inatoset gjatë ekzekutimit, konsiderohet vrasës." Në qoftë se e vërteta e pastër dhe e paanshme është ajo që duhet patjetër të sundojë në gjykatë, atëherë është e çuditshme që studentët e Risale-i Nurit -të cilët janë të pafajshëm, shumë të nevojshëm për ngushëllim dhe për shfaqjen e drejtësisë tek e drejta e tyre- ata po zbulohen para fyerjeve dhe keqtrajtimeve këtu, pavarësisht shpalljes së vendimit për pafajësinë tonë prej tre gjykatave, dhe pavarësisht se ka shumë shenja që nëntëdhjetë përqind e këtij kombi janë të gatshëm të dëshmojnë se studentët e Risale-i Nurit janë të padëmshëm dhe të dobishëm për këtë komb dhe për këtë atdhe. Dhe meqenëse ne kemi vendosur që ta përballojmë çdo fatkeqësi dhe fyerje me të gjithë durimin, ne rrimë të heshtur duke ia referuar çështjen Allahut dhe duke thënë: Ndoshta në këtë çështje ka ndonjë gjë të mirë." Por, unë u frikësova se këta mjeranë të pafajshëm duke u keqtrajtuar në këtë mënyrë për shkak të dyshimeve të pabaza dhe të raporteve dashakëqinj të agjentëve dhe të

informatorëve, do të çonte në zbritjen e fatkeqësive, dhe prandaj u detyrova ta shkruaja këtë. Sidoqoftë, në qoftë se ka ndonjë gabim në këtë çështje, ai është i imi.

Këta mjeranë më ndihmuan mua vetëm për hir të kënaqësisë së Allahut dhe për të shpëtuar besimet e tyre dhe për hir të Ahiretit të tyre. Që ata të marrin një trajtim të tillë, në një kohë që janë të merituesheëm për nderim e vlerësim, kjo ka zemëruar edhe dimrin -kjo është e mjaftueshme që ta bëjë gjithkënd të zemëruar. Për më tepër, është e habitshme, por ata po bëjnë përsëri deklarata të pabaza rreth formimit të një "shoqërie politike", ndonëse tre gjykata e hetuan këtë aspekt dhe shpallën vendimin për pafajësi; dhe as gjykatat, as policia dhe as komitetet e ekspertëve nuk kanë zbuluar ndonjë shenjë për ndonjë "shoqëri" që të mund të justifikonte një akuzë të tillë: Studentët e Risale-i Nurit janë një vëllazëri e cila shikon tek Ahireti, ashtu si studentët e një mësuesi, ose studentët e universitetit, ose si studentët e një mësuesi Kur'ani i cili është duke i bërë ata hafiza, duke ua mësuar përmenësh Kur'anin.

Ata që kanë bërë akuza kundra tyre duke i quajtur një "shoqëri politike", atëherë duhet t'i shikojnë kështu të gjithë zejtarët, të gjithë predikuesit dhe të gjithë nxënësit dhe studentët e shkollave se qenkan shoqëri të tilla. Prandaj, unë nuk shoh asnjë nevojë për t'i mbrojtur ata të burgosur këtu si një rezultat i akuzave të tilla të pakuptimta e të pabaza.

Megjithatë, nuk ka asgjë fare që të më pengojë mua për të mbrojtur Risale-i Nurin me të njëjtat fakte me të cilat unë e kam mbrojtur tre herë më parë, sepse Risale-i Nuri është i lidhur ngushtë edhe me këtë vend, edhe me botën islame, edhe është shkak i dobishëm për begati e për bekime materiale e shpirtërore për këtë vend e komb. Asnjë ligj apo politikë nuk e ndalon këtë dhe nuk mund ta ndalojë. Po, ne jemi një shoqëri, por jemi një shoqëri e cila në çdo shekull ka pasë treqind e pesëdhjetë milionë anëtarë. Në çdo ditë me namazet e detyruara, anëtarët e saj shfaqin pesë herë me nderim të plotë lidhjen e tyre me parimet e asaj shoqërie të shenjtë, dhe dëshirën e tyre për t'i shërbyer asaj. Në përputhje me programin e shenjtë *"Padyshim që besimtarët janë vëllezër (në islam)",*[236] ata nxitojnë me lutjet dhe me fitimet e tyre shpirtërore për të ndihmuar njëri-tjetrin. Po, ne jemi anëtarët e asaj shoqërie të shenjtë e të gjërë. Dhe detyra jonë e veçantë është që t'i përcjellim në formë vërtetuese e konfirmuese tek njerëzit e imanit të

[236] Kur'an, 49:10

vërtetat Kur'anore të besimit, dhe t'i shpëtojmë ata dhe veten tonë prej asgjësimit të përjetshëm dhe prej burgimit të vetmuar të përhershëm në Botën e ndërmjetme. Ne nuk kemi asnjë lidhje me ndonjërën prej shoqërive të kësaj dynjaje, as me shoqëritë politike komplotuese, dhe as me shoqëritë e fshehura revolucionare politike, siç jemi akuzuar; ne nuk e ulim veten tek asnjë shoqëri e tillë e fshehtë dhe e pakuptim. Sidoqoftë, katër gjykata e kanë hetuar këtë deri në detajet më të holla, dhe atëherë na dhanë pafajësinë lidhur me të.

Said Nursi

• • •

Kundërshtimet e mia të shkruara, të cilat formojnë një shtojcë dhe një shtesë për mbrojtjen time, dhe që u dërguan tek Gjashtë Departamentet e qeverisë në Ankara, dhe u paraqitën tek Gjykata penale e Afjonit.

Unë them për këtë gjykatën e Afjonit: Mjaft më tani! Durimi im është sosur! Është një tirani mizore dhe e paprecedent që përveç asaj që më keni shqetësuar e më keni rënë më qafë qysh prej njëzet e dy vitesh pa asnjë motiv dhe duke më mbajtur nën mbikëqyrje të vazhdueshme në syrgjynosje në izolim të plotë dhe në burgim të vetmuar, duke i burgosur në mënyrë të paligjshme tre herë studentët e Risale-i Nurit, dhe duke na shkaktuar neve humbjen e qindra mijëra lirave për shkak të dyshimeve të pabaza dhe duke përdorur 'mundësitë' në vend të fakteve; dhe kjo, pavarësisht faktit se përveç dy ose tre çështjeve gjashtë gjykatat kanë qenë të pamundura të gjejnë ndonjë gjë në kundërshtim me ligjin në njëqind pjesët e Risale-i Nurit. E ardhmja dhe brezat e së ardhmes do t'i mallkojnë tiranët të cilët kanë qenë përgjegjës për të. Ndërsa në Gjyqin e Fundit ne kemi besim të plotë se këta tiranë do të flaken duke rënë në thellësirat e Xhehennemit - Ferrit, dhe kjo na bën neve të gjejmë ngushëllim, dhe duke qëndruar të heshtur ne kemi duruar. Përndryshe ne do t'i kishim mbrojtur me të gjithë fuqinë të drejtat tona.

Dhe kështu gjatë pesëmbëdhjetë viteve ne kemi hyrë në Gjashtë gjykata, dhe janë hetuar Risale-i Nuri dhe letrat tona qysh prej njëzet vitesh, dhe përfundimi ishte se ne morëm pafajësi të plotë prej Pesë gjykatave, ndërsa gjykata e Eskishehirit bëri si pretekst pesë ose dhjetë fjalë në trajtesën e shkurtër rreth *Hixhabit*-mbulesës së grave, një çështje të vetme, dhe dha një dënim të lehtë kundra nesh, duke u mbështetur mbi një ligj 'elastik'. Kur ata e bënë këtë, unë shkrova sa vijon në korrektimin të cilin pas gjykatës së apelit, unë ia dërgova

zyrtarisht Ankarasë si një shembull i vetëm për vendimin e paligjshëm: Qysh prej një mijë e treqind e pesëdhjetë vitesh, duke ndjekur konsensusin dhe rregullat e treqind e pesëdhjetë mijë komenteve të Kur'anit, unë shpjegova vërsetin Kur'anor rreth *Hixhabit* -mbulesës së grave- i cili ka mësuar e urdhëruar një praktikë të fuqishme e të përjetshme islame dhe një parim të shenjtë të treqind e pesëdhjetë milionë njerëzve, me qëllim që t'i mbrojmë ato kundra kundërshtimeve të një ateisti dhe ndaj kritikave të tij kundra civilizimit të Kur'anit. Në qoftë se do të kishte ndonjë drejtësi në botë, ajo do të shpallte një vendim për të shfuqizuar dënimin dhe masën ndëshkimore që është marrë kundra një njeriu i cili duke shpjeguar vërsetin ka ndjekur rrugën e paraardhësve tonë; ajo do ta hiqte këtë njollë të çuditshme prej aparatit të drejtësisë së këtij shteti islamik.

Unë e shkrova këtë në shtojcën që përmbante korrektimet e mia dhe ia tregova prokurorit të përgjithshëm. Ai u tmerrua dhe tha: Të lutem! Nuk është nevoja për gjithë këtë. Dënimi yt është i lehtë, dhe vetëm një pjesë e vogël e tij ka mbetur. Nuk është nevoja që ta paraqesësh këtë.

Kështu, ju keni kuptuar vërtet shembuj të çuditshëm si ky në mbrojtjet dhe në kundërshtimet e mia të cilat ua kam dërguar juve dhe departamenteve të qeverisë në Ankara. Ajo që unë kërkoj e shpresoj nga gjykata e Afjonit është kjo: Unë pres prej jush në emrin e drejtësisë së vërtetë që ju t'i jepni lirinë e plotë Risale-i Nurit i cili ka një bereqet dhe një shërbim të barasvlershëm me atë të një ushtrie të plotë në rrugën e dobive dhe të interesit të këtij kombi e vendi.

Përndryshe, futja e disa prej shokëve të mi në burg për shkakun tim do të më shtynte mua të bëja një mëkat që të meritonte dënimin më të madh me qëllim që t'i thoja lamtumirë kësaj jete të këtillë, dhe u shfaq në zemrën time sa vijon:

Ndërsa është detyrë që qeveria të më japë mbrojtje të plotë dhe të më ndihmojë, meqë ndodhet një interes i madh për kombin dhe një dobi e madhe për vendin në këtë çështje, fakti se ajo po më bën presion e po më shtyp mua tregon se banda e fshehtë e ateizmit e cila më ka luftuar qysh prej dyzet vitesh dhe disa prej individëve të bandës së komunistëve me të cilën tani ajo është bashkuar, dhe të cilët kanë mundur të zënë pozita të rëndësishme në qendrat zyrtare, janë këto që po drejtojnë sulme kundra meje. Kurse qeveria, ose nuk është në dijeni të kësaj çështjeje, ose me dijeni e lejon atë.

I nderuar kryetar i gjykatës! Nëse më lejoni, unë do t'ju drejtoja juve një pyetje për të cilën jam shumë kureshtar: Përse politikanët më kanë privuar prej të gjitha të drejtave civilie, prej të gjitha lirive dhe madje edhe prej të gjitha të drejtave të mia në jetë, ndonëse unë nuk kam qenë kurrë i përfshirë në politika dhe nuk kam hyrë në betejat e tyre; dhe më trajtuan si të isha një gjakderdhës që i ka lyer duart me gjakun e qindra viktimave, dhe më vensdosën në një burgim të vetmuar dhe në një vend të izoluar tre muaj e gjysëm, dhe u përpoqën të më shkatërrojnë jetën time duke më helmuar njëmbëdhetë herë. Dhe kur shokët e mi të kujdesshëm e të vëmendshëm dhe studentët e mi besnikë donin të më mbronin kundra planeve vrasëse të këtyre, këta i ndaluan ata që të kontaktoheshin me mua, madje më privuan edhe nga studimi i librave të mi të bekuar dhe të padëmshëm, me të cilët jam mësuar në vetminë time, në pleqërinë, në sëmundjen dhe në syrgjynosjen time.

Unë shpresova që prokurori i përgjithshëm të më jepte mua vetëm një libër prej librave të mi, dhe megjithëse e kishte premtuar, ai nuk e bëri, kështu u detyrova të qëndroja i vetmuar në një krah të madh burgu, në një vend të mbyllur e të ftohtë pa asgjë që të preokupoja veten time; dhe në vend që nëpunësit, shërbyesit dhe rojet të na trajtonin mirë në një mënyrë që të gjeja ndonjë ngushëllim a qetësi, ata thjesht u nxitën që të më shikonin me armiqësi e me ashpërsi. Një shembull i vogël prej këtij trajtimit të tyre është ky: Unë u shkrova një peticion drejtorit të burgut, prokurorit të përgjithshëm dhe kryetarit të gjykatës, dhe ia dërgova atë njërit prej vëllezërve të mi që ta shkruante me shkronjat e reja të cilat nuk i njoh. Peticioni u shkrua dhe iu dha atyre. Ata e konsideruan këtë një krim të madh nga ana ime, dhe menjëherë nisën t'i bllokonin të gjitha dritaret e dhomës sime dhe i gozhduan. Tymi i sobës më bënte shumë dëm; dhe unë insistova që ata ta linin të hapur një dritare. Tani ata e gozhduan dhe e bllokuan edhe atë dritare gjithashtu. Megjithëse rregullat e burgut përcaktojnë që izolimi total të mos i kalojë pesëmbëdhjetë ditë, ata më mbajtën në izolim të plotë tre muaj e gjysëm, dhe nuk lejuan asnjërin prej shokëve të mi që të më takonin. Gjithashtu, gjatë tre muajve një akuzë prej dyzet faqesh ishte shkruar kundra meje, dhe ata ma treguan mua. Por unë nuk i njihja shkronjat e reja, dhe meqenëse isha i sëmurë dhe me shkrim të keq, unë u kërkova atyre që të më dërgonin dy nga studentët e mi, të cilët e njohin gjuhën time dhe që të mund ta lexonin fletë-akuzën, dhe që të shkruanin kundërshtimet dhe mbrojtjet e mia. Por ata nuk e lejuan dhe nuk e pranuan këtë. Ata thanë: Le të vijë avokati që ta lexojë! Më vonë ata as atë nuk e lejuan, por i thanë njërit prej

vëllezërve të mi: "Shkruaje fletë-akuzën me shkronjat e vjetëra dhe jepia atij!" Por shkrimi i asaj fletë-akuze merrte gjashtë ose shtatë ditë; dhe kështu në vend të leximit që zgjaste një orë të vetme ata e zgjatën këtë punë në gjashtë deri në shtatë ditë, dhe këtë e bënë vetëm për të penguar çdo kontakt me mua. Kjo është një shtypje e tmerrshme dhe më privon mua krejtësisht nga e drejta e mbrojtjes. Edhe një Vrasës që ka bërë njëqind krime dhe është dënuar me ekzekutim nuk do të trajtohej në këtë mënyrë në ndonjë vend të botës. Në të vërtetë, unë po vuaj një dhimbje shumë të madhe meqë nuk di asnjë arsye për këtë torturë të paprecedent. Unë dëgjova se kryetari i gjykatës është i drejtë dhe i dhembshur, prandaj unë e paraqita këtë peticion e ankesë si një provë e parë dhe e fundit.

Said Nursi

i cili është i sëmurë, i mjerë dhe në izolim të plotë.

• • •

Akuza përmban katër pika bazë lidhur me mua.

Pika e Parë: Pretendimi se unë jam një person që krenohet me veten dhe egoist. Unë e kam refuzuar këtë pretendim me të gjithë fuqinë time. Komiteti i ekspertëve në Gjykatën e Denizlit tha: "Në qoftë se Saidi do të pretendonte se është Mehdiu i pritur, të gjithë studentët e tij do ta kishin pranuar atë".

Pika e Dytë: Botimi i veprave të tij fshehurazi.

Armiqtë e fshehur nuk duhet t'i keqinterpretojnë gjërat, sepse nuk ndodhet asgjë që prek politikat dhe rendin publik. Gjithashtu ata nuk duhet t'i bëjnë një pretekst makinën shumëfishuese dhe letrat e vjetëra. Gjashtë gjykatat dhe departamentët e ndryshëm të qeverisë në Ankara e kuptuan goditjen e drejtuar nga Risale-i Nuri[237] për Mustafa

[237] Prokuroria e përgjithshme bëri një akuzë si rezultat i keqkuptimit lidhur me "Kerametet e Risale-i Nurit", disa prej të cilave u shfaqën si shuplaka - goditje- disiplinuese. Ata pretenduan se ne themi që "fatkeqësitë dhe tërmetet që ndodhën në kohën kur po sulmoheshin studentët e Risale-i Nurit dhe Risale-i Nuri, ishin goditje të dhëna prej Risale-i Nurit... Ruajna Zot! Ne as nuk e kemi thënë dhe as nuk e kemi shkruar këtë, por ne e kemi përmendur në shumë vende, duke sjellë argumente, se Risale-i Nuri është si *Sadekatë* e pranuara, prandaj ai është një mjet për të larguar fatkeqësitë dhe për të zmbrapsur katastrofat. Sa herë që Risale-i Nuri sulmohet, ai e fsheh vetveten; dhe atëherë fatkeqësitë e shfrytëzojnë rastin dhe na sulmojnë. Po, me qindra ngjarje e ndodhi dhe dëshimia dhe konfirmimi i mijëra studentëve të Risale-i Nurit, na tregon ne pamundësinë e ekzistencës së rastësisë në koinçidencat e atyre ngjarjeve, ashtu siç e shfaqëm ne pjesërisht në gjykata; ne besojmë në mënyrë të sigurt se këto koinçidenca

Qemalin, dhe ato nuk na shqetësuan rreth saj dhe na dhanë pafajësinë, duke na i kthyer të gjithë librat, duke i përfshirë edhe Rrezen e Pestë. Për më tepër, veprat e tij të këqija u treguan me qëllim që të ruhej vlera dhe dinjiteti i ushtrisë. Domethënë, një person nuk u pëlqye me qëllim që të lavdërohej e vlerësohej me të gjithë dashurinë ushtria.

Pika e Tretë: "Ai nxit thyerjen e rregullit dhe prishjen e qetësisë publike". Kjo akuzë e çuditshme refuzohet nga faktet se gjatë një periudhe njëzet vjeçare gjashtë gjykata dhe policia e dhjetë provincave nuk kanë regjistruar asnjë incident të vetëm që ndonjëri prej qindra mijëra studentëve të Risale-i Nurit dhe qindra mijëra kopjet e pjesëve të Risale-i Nurit të kenë thyer rendin apo të kenë prishur qetësinë publike, ata nuk kanë gjetur asgjë të tillë. Do të ishte e pakuptim të përgjigjeshe për çështje të pakta të parëndësishme në këtë akuzë të re, sepse tre gjykata na kanë dhënë pafajësinë për pikërisht këto çështje dhe ato kanë pas përgjigje në mënyrë të përsëritur. Meqenëse akuza ndaj nesh me këto çështje është e barasvlefshme me akuzën ndaj Gjykatës penale të Ankarasë, dhe ndaj gjykatave të Denizlit dhe të Eskishehirit, të cilat na dhanë ne pafajësinë lidhur me to, unë ua lë atyre gjykatave të përgjigjen për to. Por ndodhen dy ose tre çështje të tjera.

***E Para*:** Megjithëse ata shpallën vendimin për pafajësinë tonë dhe e rikthyen atë libër tek ne pasi e kontrolluan dhe e hetuan plotësisht gjatë një kohe që zgjati dy vjet në Gjykatën e Denizlit dhe në gjykatën e krimeve të rënda në Ankara, veçse ata dallgëzuan, ngritën një ose dy çështje që erdhën në trajtesën e Rrezes së Pestë lidhur me një komandant[238] i cili ka vdekur dhe i ka mbaruar çështja, dhe i bëri ato si akuzë kundra nesh. Ne themi: Të drejtosh një kritikë të drejtë të përgjithshme ndaj një personi që ka vdekur, që është larguar dhe që i është këputur lidhja me qeverinë, kjo nuk vlerësohet si mëkat -shkelje- në shikimin e ligjit.

Pastaj, duke manipuluar faktet, prokuroria mori një aspekt të atij interpretimi të përgjithshëm dhe e aplikoi atë për atë komandant; duke ditur se asnjë ligj nuk mund ta vlerësojë si krim në qoftë se një e qindta e një kuptimi, i cili mund të kuptohet ndërsa i referohet dikujt, është gjetur në një trajtesë private e të fshehtë. Për më tepër, ajo trajtesë i ka shpjeguar hadithet alegorike në mënyrë të shkëlqyer.

---

janë provë për pranueshmërinë e Risale-i Nurit, janë një tregues për Nderimin Hyjnor dhe janë një lloj *kerameti* i dhuruar nga Kur'ani për Risale-i Nurin. Autori.

[238] Aludon për Mustafa Qemalin. Përkthyesi.

Meqenëse ato shpjegime janë shkruar para tridhjetë ose dyzet vitesh, dhe përgjigje vendimtare janë dhënë në mbrojtjen dhe në kundërshtimet e mia, të cilat janë paraqitur tek tre gjykata të tjera dhe tek gjykata e juaj, dhe tek gjashtë departamente të qeverisë në Ankara, dhe nuk kanë marrë kritikë, atëherë sigurisht kjo nuk mund të konsiderohet të jetë në mospajtim me ndonjë ligj në qoftë se shpjegimet e kuptimit të vërtetë të hadithit dalin që t'i përshtaten një individi me të meta.

Pastaj meritat ndaj një personi i cili ishte brenda një përmbysjeje, që çoi në gabime të shumta, nuk i referohen vetëm atij meritat e atyre reformave, por i referohen ushtrisë dhe qeverisë, ndërsa ai ka vetëm një pjesë të tyre. Dhe ashtu siç nuk do të ishte krim ta kritikosh atë për fajet e tij, po ashtu nuk mund të thuhet se ajo është duke sulmuar reformat. Gjithashtu si do të ishte e mundur të konsiderohet krim të mos pëlqesh një njeri i cili e ktheu xhaminë e Aja Sofias në një shtëpi idhujsh - ndonëse ajo ishte një burim i përjetshëm nderi i këtij kombi heroik dhe si një Inxhi vezulluese në xhihadin e tij dhe në shërbimin ndaj Kur'anit, dhe duke qenë një dhuratë e çmueshme përkujtimi prej dhuratave të shpatave të stërgjyshërve të saj guximtare, dhe i cili gjithashtu e trasformoi zyrën e Shejhul-Islamit në një shkollë të mesme vajzash?

Çështja e Dytë** me të cilën më akuzoi prokutoria**.

Tre gjykata më kanë dhënë pafajësinë për këtë çështje; ai shpjegim i shkëlqyer në interpretimin e hadithit sherif (në Rrezen e Pestë) para dyzet vitesh e shpëtoi kombin. Sepse Shejhul-Islami -për xhindët dhe për njerëzit- "Zembilli Ali Efendi", deklaroi duke thënë: "Nuk ka asnjë lejim për ta vënë në kokë kapelen srehëgjërë, as edhe si shaka".

Dhe të gjithë Shejhët e Islamit dhe të gjithë *Ulematë* -dijetarët- islamë e konsideruan atë të palejueshme. Prandaj masat e myslimanëve ishin në rrezik kur ata u detyruan për ta vënë atë kapele strehëgjërë, pasi ata ishin para dy zgjedhjeve. Por, meqenëse në një pjesë të Rrezes së Pestë, e cila u shkrua para dyzet vitesh, ajo thotë: "Veshja -vënia në kokë- atë kapele strehëgjërë do të bëhet me detyrim, dhe ajo kapele do të thotë: mos bën sexhde, por besimi -imani- që gjendet në atë kokë do ta detyrojë edhe atë kapele që të bëjë sexhde dhe, në dashtë Zoti, do ta bëjë atë myslimane", ajo i shpëtoi masat e myslimanëve edhe nga heqja dorë me vullnet nga feja e tyre, edhe nga revolta e rebelimi. Megjithëse asnjë ligj nuk mund të propozojë një gjë të tillë për ata që jetojnë të veçuar, dhe për njëzet vjet asnjëra prej gjashtë autoriteteve provinciale nuk më ka detyruar mua ta vesh atë kapele; dhe gratë dhe

fëmijët dhe Imamët e xhamive dhe nëpunësit në zyrat e tyre dhe shumica e fshatarëve nuk janë të detyruar që ta veshin atë kapele strehëgjërë, dhe tani në kohët e fundit është hequr edhe prej kokave të ushtarëve; gjithashtu në shumë provinca tani beretat dhe takijet nuk janë të ndaluara. Sidoqoftë kjo -mosvënia e kapeles strehëgjërë- u bë një element akuze kundra meje dhe kundra vëllezërve të mi. A do të mundej ndonjë ligj në botë, ndonjë parim, ose ndonjë interes, ta konsideronte këtë akuzë krejtësisht të pakuptimtë të jetë një krim?

Çështja e Tretë *me të cilën jam akuzuar:*

Nxitja për të prishur rendin dhe qetësinë publike në Emirdag. Kundërshtimi im për këtë është sa vijon:

Së Pari: Është lista ime e parefuzueshme e kundërshtimeve, e cila është paraqitur tek gjykata këtu dhe tek gjashtë departamentet e Qeverisë në Ankara me dijeninë dhe me lejen e kësaj gjykate. Prandaj unë po e paraqes pikërisht të njëjtin kundërshtim si përgjigje ndaj akuzës.

*Së Dyti**:*** Siç dëshmohet nga të gjithë ata që janë takuar me mua në Emirdag dhe siç konfirmohet nga njerëzit e asaj province dhe nga policia e saj, në vetminë time unë i jam shmangur me të gjithë fuqinë time përfshirjes në politika. Madje unë braktisa edhe shkrimin -kompozimin- dhe letërkëmbimin me të tjerët. Unë nuk shkrova asgjë tjetër përveç dy pjesëve, njëra rreth urtësisë së përsëritjes në Kur'an, dhe tjetra rreth melekëve. Unë shkruaja vetëm një letër në javë që të nxisja njerëzit nëpërmjet saj për të lexuar Risale-i Nurin; madje për tre vite unë i shkrova vetëm tre ose katër letra vëllait tim i cili është myfti dhe që gjatë njëzet viteve ka qenë prej studentëve të mi, dhe që është shumë i shqetësuar për mua, dhe i cili më dërgonte gjithmonë mua urime për festat fetare. Dhe megjithëse për njëzet vite nuk i kam shkruar asnjëherë vëllait tim tjetër i cili është në rajonin tim të lindjes, unë po akuzohem në fletëpadi për prishje të rendit dhe të qetësisë, dhe përsëri se po "kundërshtokam reformat". Në përgjigje unë them këtë:

Fakti se më shumë se njëzet mijë kopje të Risale-i Nurit, gjatë njëzet viteve, janë studiuar prej njëzet mijë, madje prej njëqind mijë njerëzve me të gjithë zellin e pranimin, dhe megjithatë gjashtë gjykata dhe punonjësit e policisë së dhjetë provincave nuk gjetën asgjë dhe nuk regjistruan asnjë incident kundra tyre, për prishje të rendit dhe të qetësisë publike; kjo tregon se në qoftë se do të kishte pasë vetëm një mundësi të vetme prej mijëra mundësive kundra nesh, ata do ta merrnin atë, dhe do ta shfrytëzonin këtë mundësi si një fakt të

vërtetuar. Por, në qoftë se do të kishte një mundësi të vetme brenda dy ose tre mundësive, dhe nuk do të shfaqej asnjë shenjë për të, atëherë ajo mundësi nuk do të konsiderohej krim. Dhe nuk është një mundësi prej një mijë mundësive, por gjithësecili duke përfshirë edhe prokurorin e përgjithshëm i cili më sulmon -është mundësia- që ai të vrasë shumë njerëz, që të prishë rendin publik dhe sigurinë për llogari të komunizmit dhe të anarkistëve. Domethënë, t'i shikosh në mënyrë kaq të ekzagjëruar mundësitë sikur ata të ishin fakte të vërteta dhe t'i shfrytëzosh ato mbi këtë bazë do të ishte tradhti e drejtësisë dhe e ligjit; do të ishte përbuzje nga ana e gjykatës dhe e ligjit paraqitja e një mundësie të çuditshme e të ekzagjëruar në vend të ngjarjeve.

Për më tepër, çdo qeveri ka kundërshtar, dhe ta kundërshtosh ideoligjikisht nuk përbën krim. Qeveria shikon dorën dhe jo zemrën; ajo merr anën e jashtme; ajo nuk gjykon atë çfarë ndodhet në zemra. Në mënyrë të veçantë dikush që ka kryer shërbime të mëdha për këtë vend dhe komb dhe që nuk ka shkaktuar asnjë dëm, dhe në kohët e fundit nuk ka ndërhyrë në jetën sociale, por është bërë të jetojë në izolim të plotë, dhe veprat e të cilit janë vlerësuar e duartrokitur në qendrat më të rëndësishme të botës islame[239]; unë kam frikë se ata të cilët i bëjnë këto akuza krejtësisht të jashtëzakonshme e të pabaza ndaj personave të tillë, sigurisht në mënyrë të pavetëdijshme po shfrytëzohen për llogari të anarkisë dhe madje të komunizmit.

---

[239] Në të tetëdhjetin e njëqind gabimeve rreth këtyre veprave në akuzë, prokurori i përgjithshëm tha: "Interpretimet në Rrezen e Pestë "janë të pasakta".

Përgjigjja ime për këtë është: Në Rrezen e Pestë erdhi fjalia vijuese: Një interpretim -dhe Zoti e di më së miri- është ky, dhe kuptimi i kësaj fjalie është: "Është e mundshme që njëri kuptim i hadithit të jetë ky". Logjikisht, kjo nuk mund të provohet të jetë gabim; kjo fjali nuk mund të përgënjeshtrohet. Ajo mund të provohej të jetë gabim vetëm se duke provuar pamundësinë e saj.
Së Dyti: Qysh prej njëzet viteve madje qysh prej dyzet viteve, ata të cilët më kanë kundërshtuar, dhe ata që janë orvatur të kundërshtojnë Risale-i Nurin nuk i kanë refuzuar interpretimet as në bazë logjike dhe as shkencore, dhe secili prej njerëzve të ditur-dijetarëve fetarë të cilët më kundërshtojnë mua dhe mijëra studentët e Risale-i Nurit -i kanë konfirmuar ato dhe nuk kanë thënë: Në këto interpretime ka këndvështrime. Prandaj unë ia referoj paanshmërisë suaj ta gjykoni se sa e padrejtë do të ishte për ata, të cilët nuk dinë se sa sure janë në Kur'an, ta takojnë atë fjali me mosbesim, duke e refuzuar këtë interpretim.
Shkurtazi: Kuptimi i interpretimit do të thotë se është një kuptim i ngjashëm ose i mundshëm i një hadithi ose i një vërseti prej shumë kuptimeve.

Unë kam kuptuar prej disa shenjave se armiqtë tonë të fshehur përpiqen të përçmojnë e ta ulin vlerën e Risale-i Nurit, dhe përhapin supozimin e ekzistencës së idesë së Mehdiut -nga aspekti politik- brenda tij, dhe pretendojnë se Risale-i Nuri është mjet për këtë ide; dhe kërkojnë e hetojnë se ndoshta do të gjejnë ndonjë mbështetje për ta për këto supozime të kota. Ndoshta për shkak të këtyre dyshimeve unë po bëhem të vuaj tortura të këtilla. Unë u them atyre armiqve të fshehur tiranë dhe atyre që i dëgjojnë ata dhe që janë armiqësorë ndaj nesh: Ruajna Zot! Përsëri, Ruajna Zot! Unë nuk e kam pasë një pretendim të tillë, dhe nuk e kam tejkaluar limitin tim dhe as nuk i kam bërë të vërtetat e besimit si një mjet personal apo një instrument për të fituar rang, famë dhe emër për veten time. Dhe veçanërsisht tridhjetë vitet e fundit të jetës sime shtatëdhjetë e pesë vjeçare dëshmojnë për këtë, dhe dëshmon Risale-i Nuri që ka arritur njëqind e tridhjetë trajtesa, dhe dëshmojnë me mijëra persona të cilët më kanë shoqëruar mua.

Po, studentët e Risale-i Nurit e dinë këtë dhe unë kam treguar prova për këtë në gjykata se, jo të fitoj për vetveten ndonjë pozitë apo famë, apo të fitoj ndonjë pozitë shpirtërore ose rang të lartë, por me qëllim që t'u shërbej besimtarëve me të gjithë bindjen dhe fuqinë time në çështjen e besimit, unë jam gati të sakrifikoj jo vetëm jetën time në këtë botë dhe rangjet e saja të përkohshme, por -në qoftë se do të ishte e domosdoshme- edhe jetën time të Ahiretit dhe rangjet e saja të përjetshme, të cilat i kërkon gjithkush; dhe madje, me qëllim që të jem një mjet për t'i shpëtuar nga zjarri disa mjeranë prej njerëzve të besimit -në qoftë se do të ishte e domosdoshme- unë do të pranoja të braktisja edhe xhennetin -parajsën- dhe të futesha në Ferr. Ashtu siç e dinë këtë vëllezërit e mi të vërtetë, po ashtu unë e kam provuar atë në disa aspekte në gjykata. Të më akuzosh mua në këtë mënyrë për mungesë sinqeriteti në shërbimin tim ndaj Risale-i Nurit dhe ndaj besimit, dhe ta përçmoni Risale-i Nurin dhe ta zhvlerësoni atë, kjo do ta privonte këtë komb prej të vërtetave të tij sublime.

A mos vallë këta fatkëqinj imagjinojnë se dynjaja është e qëndrueshme dhe e përjetshme? Apo mos vallë imagjinojnë se të gjithë ata si shembulli i tyre e shfrytëzojnë fenë dhe besimin për dobitë dhe interesat e kësaj bote? Ky supozim i ka çuar ata të sulmojnë një person i cili ka sfiduar njerëzit e çudhëzimit në dynja dhe ka sakrifikuar jetën e tij të kësaj bote në rrugën e shërbimit të imanit; Dhe ai është i gatshëm që ta sakrifikojë edhe jetën e tij të Ahiretit -në qoftë se do të ishte e domosdoshme- në rrugën e këtij shërbimi. Dhe ai nuk do të ishte i gatshëm që ta ndryshonte sundimin e të gjithë botës me një të vërtetë të vetme të besimit, ashtu siç ka deklaruar nëpër gjykata. -Ai

supozim- i ka çuar ata që të sulmojnë një person i cili ka ikur me të gjithë fuqinë e tij prej politikës dhe prej të gjitha rangjeve materiale dhe shpirtërore të cilat aludojnë për politikën, qoftë nga larg apo nga afër dhe këtë ai e bën nëpërmjet misterit të sinqeritetit; dhe ka duruar e përballuar tortura të pashembullta gjatë njëzet viteve, dhe megjithatë nuk zbriti -për shkak të rrugës së besimit- që të përfshihet në politka. Pastaj ai e konsideron vetveten -nga aspekti i nefsit- në një shkallë shumë më të ulët se sa studentët e tij; prandaj ai gjithmonë pret duatë e tyre dhe që ata të kërkojnë falje për të. Dhe megjithëse ai e konsideron veten të dobët dhe të parëndësishëm, veçse ama disa nga vëllezërit e tij të sinqertë i atribuojnë atij në letrat e tyre private disa nga vlerat e virtytet e Risale-i Nurit, meqë ai është interpretues për shkëlqimet e forta të besimit të cilat burojnë prej Risale-i Nurit, dhe si rrjedhojë e një zakoni i cili nuk ka asnjë nënkuptim politik, ata i japin atij një rang të lartë -ashtu si një njeri që i drejtohet një personi të zakonshëm dhe i thotë: ti je mirëbërësi im... ti je mbreti im...!- dhe njerëzit i japin atij -nga këndvështrimi i mendimit të mirë- shkallë më të larta se sa ai meriton, të cilat janë një mijë herë më të larta se sa shkalla dhe vlera e tij. Dhe ata ndjekin një zakon të vjetër të pranueshëm e të praktikuar midis profesorit dhe studentëve të tij, -një zakon që nuk është kundërshtuar nga askush- dhe ka kuptimin që ata të jenë mirënjohës, dhe e lavdërojnë atë shumë tepër; dhe shkruajnë lavdërime të ekzagjeruara për të, që për një kohë të gjatë ka qenë zakoni që të shkruheshin në fund të librave të pranueshëm; në qoftë se ata i bëjnë këto gjëra, a do të mund të konsiderohej kjo një krim? Është e vërtetë se ekzagjerimi në një aspekt të tij konsiderohet se është një kundërshtim me të vërtetën; por një person si unë që nuk ka askënd, i cili është i huaj, i vetmuar, me armiq të shumtë, dhe ndodhen gjëra të shumta që e bëjnë atë t'i humbasë ndihmësit e tij, kështu thjesht me qëllim që të forcojë moralin e tyre përballë kaq shumë kundërshtarësh dhe me qëllim që t'i pengojë ata nga ikja dhe me qëllim që të mos e shkatërrojë entuziazmin e atyre të cilët e lavdërojnë atë në mënyrë të tepruar, ai e ndryshoi një pjesë të asaj që ata kishin shkruar duke ia referuar atë Risale-i Nurit dhe nuk e refuzoi atë plotësisht. Prandaj mund të kuptohet se sa shumë larg të drejtës dhe ligjit janë disa nëpunës zyrtarë, kur orvaten që ta bëjnë shërbimin e personit të lartëpërmendur ndaj besimit se ai shërbim na shikoka tek kjo dynja, ndonëse ai ka arritur moshën e pleqërisë dhe është tek dera e varrit. Fjala ime e fundit është:

"Të cilët thonë kur u bie fatkeqësi, Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi". [240]

Said Nursi

• • •

Shtojcë

Unë pashë se ishte shkruar në fund të Raportit përfundimtar lidhur me hetimet që u zhvilluan nga ana e gjykatës së hetimeve sa vijon:

"Këshilli i ministrave vendosi para katër muajsh ndalimin e botimit të trajtesës "Mrekullitë e Kur'anit", domethënë "Fjalën e Njëzet e Pestë" dhe konfiskimin e numrave të saj prej tregut me pretekstin se shpjegimet e saj lidhur me tre vërsetet kundra civilizimit nuk ishin në përputhje me kodin civil të tanishëm.

Duke iu përgjigjur kësaj, ne themi:

Trajtesa "Mrekullitë e Kur'anit" është tani e pranishme brenda Trajtesës "Dhulfikar", e cila ka afërsisht katërqind faqe, dhe unë e pata botuar duke hedhur poshtë kritikat e civilizimit parëndimor ndaj Kur'anit Kerim, duke iu përgjigjur në një mënyrë që nuk mund të kundërshtohet kurrë; dhe ato u përfshinë në tre prej trajtesave të mia të vjetra. Njëri nga vërsetet është rreth *Hixhabit* -Mbulesës së grave; vërseti i dytë është rreth trashëgimisë. *"...nënës i takon një e gjashta"*[241]; dhe i treti ishte gjithashtu për trashëgiminë *"Meshkujt do të marrin dyfishin e pjesës së femrave".*[242] megjithëse unë e shpjegova në dy faqe para njëzet vitesh dhe disa para tridhjetë vitesh urtësinë e kuptimeve të këtyre vërseteve në një mënyrë që do të heshtte edhe filozofët, veçse ama ata imagjinuan sikur ato të ishin shkruar sot. Dhe në vend të bllokimit të trajtesës "Dhul-Fikar" që kishte katërqind faqe, ishte e mundur të hiqeshin vetëm këto dy faqe, dhe të na kthehej neve trajtesa, dhe kjo është një e drejtë ligjore për ne; Sepse në qoftë se do të gjendeshin një fjalë e vetme ose dy fjalë të dëmshme në një letër, këto dy fjalë hiqen, dhe lejohet botimi i asaj letre; dhe duke bërë analogji me këtë, ne kërkojmë këtë të drejtën tonë nga gjykata juaj e drejtë. Meqenëse asnjë nuk mundi të gjente rastin që të vinte të lexonte për mua fletëakuzën dyzet-faqëshe, e cila m'u dha para një muaji, ata e

[240] Kur'an, 2:156
[241] Kur'an, 4:11
[242] Kur'an, 4:176

lexuan atë për mua sot (që përkon me datën 11 qershor)... ata e lexuan akuzën dhe unë e dëgjova; unë gjeta se mbrojtja të cilën e pata shkruar para dy muajsh, po ashtu edhe shtojca e kësaj mbrojtjeje si dhe shtesa e saj, të cilën e shkrova para një muaji, dhe e dërgova tek zyra juaj dhe tek gjashtë deparamentet e qeverisë në Ankara; ato kundërshtime e hedhin poshtë dhe e dërrmojnë atë fletakuzë. Prandaj unë nuk shoh absolutisht asnjë nevojë për të rishkruar një mbrojtje të re. Unë vetëm do të them tani, me qëllim që t'i sjell ndërmend prokurorisë, dy ose tre pikat vijuese:

Arsyeja pse unë nuk e mora parasysh akuzën dhe nuk iu përgjigja ishte që të shmangia fyerjen ndaj tre gjykatave të drejta të cilat na kishin dhënë neve pafajësinë dhe nuk desha që t'i përbuzja. Sepse ato gjykata na dhanë pafajësinë pasi i shqyrtuan me imtësi të gjitha pikat në akuzën e tanishme. Të shpërfillësh plotësisht dhe të mos i marrësh parasysh këto vendime, kjo përbën shkelje e fyerje ndaj nderit të sistemit të drejtësisë.

Pika e Dytë: Për shkak të keqinterpretimeve të mëdha, duke u dhënë kuptime të paimagjinueshme njërës apo dy çështjeve prej mijërave, prokuroria na akuzoi për disa shkelje.

Sidoqoftë, ato çështje janë në koleksionet e mëdhaja të Risale-i Nurit. *Ulematë* -dijetarët- e universitetit të Az'harit në Kajro, dijetarët kryesues të Damaskut, Dijetarët e saktë të Mekës e të Medinesë dhe ata të Alepit e të tjerë, dhe veçanërisht dijetarët hetues të drejtorisë së çështjeve fetare, që të gjithë i kanë parë ato dhe i kanë vlerësuar e lavdëruar me admirim dhe kanë vënë firmat e tyre tek ato. Atëherë u habita dhe u çudita kur pashë se prokurori i përgjithshëm solli disa kundërshtime në fletakuzë sikur ai të ishte ndonjëri prej dijetarëve të fesë ose ndonjë shejh prej shejhëve të saj. Le të supozojmë se unë kam disa gabime dhe prokuroria ishte korrekt në atë që akuzon, megjithëse mijëra dijetarë nuk i kanë njollosur dhe as nuk i kanë kundërshtuar-, ato përsëri nuk përbëjnë krim; ato do të ishin thjesht gabime shkencore. Për më tepër, tre gjykata na dhanë pafajësi edhe ne, edhe të gjithë Risale-i Nurit. Vetëm gjykata e Eskishehirit dha dënime të lehta për mua dhe për pesëmbëdhjetë prej njëqind shokëve të mi për shkak të pesëmbëdhjetë fjalëve në Shkreptimën e Njëzet e Katërt, e cila është rreth Hixhabit -mbulesës së grave. Unë pata përmendur në shtojcën e mbrojtjes sime të cilën e paraqita tek ju se, në qoftë se do të kishte pasë ndonjë drejtësi në faqe të tokës ajo nuk do ta kishte pranuar atë vendim kundra meje për shkak të shpjegimit tim për atë vërset, i cili ndoqi në atë shpjegim gjykimin e treqind e pesëdhjetë mijë

komenteve. Prokurori i përgjithshëm u orvat me zgjuarsinë e tij dhe me shumë vështirësi të zgjidhte disa fjali në librat dhe në letrat e shkruara gjatë njëzet viteve të kaluara dhe t'i modifikonte kundra nesh. Ndërkohë janë bërë pesë ose gjashtë gjykata -dhe jo vetëm tre-, të cilat na kanë dhënë pafajësi, shoqëruese në këtë mëkat ose në këtë krim të imagjinuar. Unë jam duke i sjellë ndërmend prokurorisë që të mos prekë nderin e atyre gjykatave të drejta.

Pika e Tretë: Të kritikosh apo të kundërshtosh një udhëheqës i cili ka vdekur e ka ikur, që lidhjet e të cilit me qeverinë janë këputur, dhe i cili ishte shkaku për disa faje në reforma, nuk mund të jetë mëkat apo krim në shikimin e ligjit. Dhe kritika jonë për të nuk ka qenë në mënyrë të qartë; por prokurori i aplikoi për atë udhëheqës pohimet dhe deklaratat e mia të përgjithshme e universale nëpërmjet keqinterpretimeve të tij. Ai i botoi ato kuptime të fshehta -private-, të cilat ne nuk ia themi askujt, dhe tërhoqi vëmendjen e të gjithë njerëzve për tek ato. Në qoftë se do të kishte ndonjë mëkat në këto kuptime, atëherë prokurori i përgjithshëm është fajtor. Sepse kjo është nxitje e masave, dhe tërheqja e vëmendjes së tyre tek ato kuptime.

Pika e Katërt: Për shkak të dyshimeve të pabaza, duke përsëritur të njëjtën histori të vjetër, duke grumbulluar ujë prej një mijë rrëkeve, prokuroria shqyrtoi aluzionet për një shoqëri sekrete, pavarësisht pafajësisë sonë të qartë lidhur me këtë çështje që na u dha nga tre gjykata. Sidoqoftë, ndërsa ndodhen shoqëri politike të shumta të cilat janë të dëmshme për këtë komb e vend, të cilat shihen me tolerancë dhe lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre, kurse ta quash një shoqëri sekrete solidaritetin e studentëve të Risale-i Nurit, që siç vërtetohet nga dëshmia e mijëra dëshmitarëve dhe shenjave dhe nga fakti se gjashtë provincat nuk na kundërshtuan, ky solidaritet është vetëm për të mirën e vendit, kombit, dhe të fesë për llogari të lumturisë në këtë botë dhe në tjetrën, dhe se këta studentë luftojnë kundra rrymave nga brenda dhe jashtë vendit, rryma të cilat janë të prirura për korrupsion e shthurje. Prandaj të bësh akuzë për formimin e një shoqërie të fshehtë dhe për prishje të rendit publik, megjithëse nuk është regjistruar gjatë njëzet viteve asnjë incident për prishje të sigurisë kundra asnjë studenti prej studentëve të Risale-i Nurit numri i të cilëve është qindra mijëra... akuza të tilla nuk zemërojnë vetëm llojin njerëzor por e bëjnë edhe tokën të zemëruar, duke e bërë ta refuzojë një akuzë të tillë... Sidoqoftë, nuk është aspak e nevojshme të thuash ndonjë gjë më shumë; sepse mbrojtja ime -të cilën e shkrova para kësaj fletakuze- dhe shtojca e mbrojtjes sime janë të mjaftueshme për përgjigje ndaj prokurorit të përgjithshëm.

I Burgosuri në Burgun e Afjonit

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Unë them këtë për gjykatën e Afjonit dhe për gjykatën e krimeve të rënda.

Për shkak se qysh në rininë time të hershme unë nuk mund të duroja të isha i sunduar, unë i këputa lidhjet e mia me dynjanë. Tani jeta është bërë një peshë e rëndë për mua me këtë shtypje të pakuptim e të panevojshme. Unë nuk kam fuqi të duroj persekutimin e mijëra nëpunësve zyrtarë jashtë burgut. Unë jam lodhur me këtë lloj jete. Me të gjithë fuqinë time, unë ju kërkoj që të më dënoni. Hyrja në varr nuk është brenda fuqisë sime, dhe unë duhet të mbetem në burg. Ju e dini mirë se akuzat e kota për të cilat më akuzoi prokuroria janë krejtësisht të pabaza dhe mosekzistuese.

Unë nuk mund të dënohem për shkak të tyre. Por unë kam faje të rënda përpara detyrave të mia të vërteta, për të cilat unë në efekt mund të dënohem. Në qoftë se do të ishte me vend pyetja, unë do t'i përgjigjesha pyetjes suaj. Po, krimi im i vetëm prej fajeve të mia të rënda është ky: Mua m'u shfaq këtu në burgun e Afjonit se, në shikimin e Realitetit, ishte një faj i pafalshëm që, për shkak se nuk e kisha shikuar dynjanë, unë nuk e kisha kryer detyrën e rëndë me të cilën kam qenë ngarkuar në emrin e vendit, të kombit, dhe të fesë, dhe mosnjohja e kësaj nuk më shfajësoi.

Fakti se tre gjykatat na kanë dhënë pafajësinë në këtë drejtim tregon se sa larg nga e drejta dhe nga drejtësia kanë rënë ata të cilët i japin emrin "një shoqëri politike mondane" studentëve të Risale-i Nurit -lidhja e pastër e të cilëve me Risale-i Nurin dhe me autorin e tij janë të sinqerta dhe thjesht për hir të Ahiretit- dhe orvaten që t'i shfaqin ata fajtorë duke i ngarkuar me përgjegjësi. Ne u themi gjithashtu:

Baza dhe themeli i shoqërisë njerëzore dhe veçanërisht e Ummetit islam janë lidhjet e sinqerta midis fiseve dhe grupeve, dhe ekzistenca e një vëllazërie shpirtërore dhe bashkëpunuese ndaj vëllezërve besimtarë brenda kombit islam, dhe ekzistenca e një lidhjeje të sinqertë ndaj kombit të tij, ndaj llojit, dhe ekzistenca e një lidhjeje të qëndrueshme e

të pamposhtme me të vërtetat e Kur'anit të cilat shpëtojnë jetën e përhershme me ata që i propagandojnë ato, si dhe me lidhje të ngjashme me këto të cilat përbëjnë themlin e jetës shoqërore. Dhe t'i mohosh këto lidhje, do të të çonte në pranimin e 'rrezikut të kuq' i cili rri në pritë duke na përgjuar -i cili përhap farën e tmerrshme të anarkisë nga veriu, i cili shkatërron gjeneratën më të re, kombësinë, dhe hap rrugën për prishjen totale të civilizimit njerëzor dhe të jetës shoqërore- unë them se me atë mohim dhe me atë pranim mund t'u japësh studentëve të Risale-i Nurit 'emrin e një shoqërie'. Prandaj studentët e vërtetë të Risale-i Nurit shfaqin lidhjen e tyre të shenjtë me të vërtetat e Kur'anit dhe shfaqin lidhjen e tyre që nuk këputet me vëllezërit e tyre në jetën e Ahiretit. Dhe meqenëse ata janë të lumtur të pranojnë çdo dënim që mund të marrin për shkak të asaj vëllazërie, ata e pranojnë në gjykatën tuaj të drejtë të vërtetën ashtu siç është. Ata nuk e ulin veten që të mbrohen me gënjeshtra, me servilizëm, me dredhi e me lajka.

I burgosuri Said Nursi

• • •

Një shtesë për shtojcën e kundërshtimeve të mia që u paraqit tek Prokuroria e përgjithshme e Gjykatës së Afjonit.

Së Pari: Unë i them gjykatës se meqenëse akuza e re bazohet mbi akuzat e vjetra të Gjykatave të Denizlit dhe të Eskishehirit, dhe mbi hetime sipërfaqësore dhe mbi grupe sipërfaqësore ekspertësh, të cilët kanë qenë kundra nesh, unë pretendoj në gjykatën tuaj se në qoftë se unë nuk do të provoja njëqind gabime në këtë akuzë, do të isha i kënaqur me njëqind vite dënimi. Unë tashmë e kam provuar çështjen time.

Në qoftë se dëshironi, unë ju paraqes juve listën që përmban më shumë se njëqind gabime.

Së Dyti: Kur letrat dhe librat tonë u dërguan në Ankara prej Gjykatës së Denizlit, unë u shkrova vëllezërve të mi -ndërsa isha shumë i shqetësuar dhe i dëshpëruar se vendimi do të shpallej kundra nesh -paragrafin i cili është në fund të disa mbrojtjeve të mia, i cili është: "Në qoftë se nëpunësit e drejtësisë të cilët janë duke e shqyrtuar Risale-i Nurin me idenë që ta kritikojnë atë, do të forconin ose do të shpëtonin besimin e tyre nëpërmjet tij, dhe pastaj të më dënonin me ekzekutim, dëshmoni se unë kam hequr dorë nga të drejtat e mia, dëshmoni se unë do t'i fal ata. Sepse ne jemi këtu për shërbim.

Funksioni i Risale-i Nurit është që të forcojë e të shpëtojë besimin. Ne jemi të ngarkuar për t'i shërbyer besimit pa bërë dallime ndërmjet armikut dhe mikut dhe në mënyrë të paanshme".

Dhe kështu, o anëtarët e gjykatës! Duke u mbështetur mbi këtë të vërtetë, dhe në dritën e saj, provat e fuqishme dhe të parefuzueshme të Risale-i Nurit kanë drejtuar zemrat e njerëzve të vetë gjykatës; prandaj çfarëdo që të bëni kundra meje, unë do t'ju fal juve; unë nuk do të mbaj aspak mëri me ju. Për shkak të saj, megjithëse kam qenë i mërzitur dhe i zemëruar nga tirania e skajshme dhe nga shtypja që kam vuajtur, dhe nga trajtimi përbuzës dhe shpifja ndaj personit tim, që kanë qenë deri në atë shkallë saqë kurrë nuk i kam përjetuar më parë, unë i kam duruar ato dhe madje as nuk kam folur keq për ata që u përfshinë dhe as nuk jam lutur për keq ndaj tyre.

Koleksionet e Risale-i Nurit, të cilat ju i keni shtënë në dorë janë mbrojtja ime e pakundërshtueshme dhe e parefuzueshme; dhe ato janë kundërshtimet e mia ndaj të gjitha akuzave të bëra kundra nesh dhe ndaj krimeve për të cilat jam i akuzuar.

Është e çuditshme se ndonëse dijetarët kryesues të Kajros, Damaskut, Alepit, Medinesë dhe Mekës, si dhe dijetarët e saktë të Drejtorisë së çështjeve fetare i kanë studiuar e shqyrtuar në mënyrë të hollësishme koleksionet e Risale-i Nurit, dhe duke mos dhënë kritika ata i kanë vlerësuar e lavdëruar ato, kurse personat e "zgjuar" të cilët përpiluan akuzën kundra nesh shfaqen nëpërmjet një gabimi të jashtëzakonshëm e të dukshëm -duke pohuar se Kur'ani përmban dyzet sure- gjë kjo që tregon se sa në mënyrë të sipërfaqshme e konsideruan ata çështjen. Pavarësisht se qindra e mijëra prej njerëzve të realitetit e konfirmuan dhe e vërtetuan Risale-i Nurin, nën këto kushte të rënda duke qenë vetë në internim, i vetmuar, i mjeruar dhe objekt i sulmeve të tmerrshme, ai prokuror, i cili madje nuk di se sa sure ndodhen në Kur'an, tha: "Megjithëse Risale-i Nuri përpiqet që ta shpjegojë Kur'anin dhe të interpretojë hadithet, veçse ama ai nuk ka natyre shkencore dhe vlerë të lartë për sa i përket paraqitjes së njohurisë tek lexuesit e tij". Nga kjo kuptohet se sa shumë larg janë kritikat e tij prej ligjit, realitetit, të drejtës dhe drejtësisë.

Unë gjithashtu kam këtë ankesë për ju:

Megjithëse për dy orë ju na bëtë neve të dëgjojmë të gjithë fletakuzën prej dyzet faqesh, e cila përmban qindra gabime dhe lëndon zemrat tona, pavarësisht ngulmimit tim, ju nuk më lejuat mua as dy minuta që të lexoja një faqe e gjysëm si përgjigje, që ishin e vërteta e

plotë. Prandaj, në emër të drejtësisë unë kërkoj që të më lejoni mua ta lexoj listën time të plotë të kundërshtimeve.

Së Treti: Çdo qeveri ka kundërshtarë, por përderisa ata nuk prishin rendin publik, ata nuk mund të preken ligjërisht. Atëherë a do të ishte e mundur që unë dhe ata si shembulli im që jemi të tërhequr nga dynjaja dhe përpiqemi vetëm për varrin, që të braktisim punën për jetën e përhershme në përputhje me rrugën që e kanë ndjekur të parët tonë për një mijë e treqind vite dhe brenda limiteve që na udhëzon Kur'ani ynë madhështor, dhe në dritën e parimeve të cilat i shenjtërojnë treqind e pesëdhjetë milionë besimtarë në çdo shekull; dhe pastaj të preokupohemi me jetën e shkurtër dhe të përkohshme të kësaj dynjaje dhe të mbështesim ligjet dhe parimet e pamoralshme të civilizimit të ulët, madje ligjet barbare e ç'njerëzore ashtu si në bolshevizëm, dhe t'i adoptojmë ato si rrugën tonë? Asnjë ligj në botë dhe asnjë njeri që ka sa një grimcë drejtësi nuk mund t'i detyrojë të tjerët që ta pranojnë këtë me atë. Ne vetëm u themi atyre që na kundërshtojnë neve: "Ne nuk ju kemi shqetësuar, edhe ju mos na shqetësoni."

Dhe kështu duke u mbështetur mbi këtë fakt, ne nuk jemi me një udhëheqës i cili ka nxjerrë dekrete sipas tekave të tij në emrin e ligjit, për ta shndërruar xhaminë e Aja Sofias në shtëpi idhujsh dhe zyrën e Shejhul Islamit në një shkollë të mesme për vajza. Ne nuk jemi me të as në ide, as në çështje, as lidhur me motivin dhe as me rezultatin; dhe ne nuk e gjejmë veten të detyruar që ta pranojmë një çështje si kjo.

Por megjithëse për njëzet vite unë jam shtypur rëndë gjatë robërisë sime torturuese, unë nuk jam përfshirë në politikë, as nuk i kam provokuar autoritetet, dhe as nuk e kam prishur rendin publik. Megjithëse unë kam qindra mijëra vëllezër studentë të Risale-i Nurit, asnjë incident nuk është regjistruar për përfshirje në politikë dhe për prishjen e rendit dhe të qetësisë. Unë jam i lodhur nga jeta për shkak të trajtimit krejtësisht poshtërues dhe të padrejtë ndaj personit tim këtu në këtë internim në periudhën e fundit të jetës sime, saqë një trajtim të tillë unë kurrë nuk e kam vuajtur më parë dhe i cili më ka lënduar shumë. Unë madje ndjej neveri edhe për lirinë, nën këtë shtypje. Unë u kam shkruar një peticion -kërkesë- duke thënë se në kundërshtim me gjithkënd tjetër, unë nuk dua të më lironi dhe as të më jepni pafajësi, por dua të dënohem dhe jo të më jepni dënim të lehtë; unë dua dënimin më të rëndë. Sepse me qëllim që të shpëtoj nga ky trajtim tiranik i pashembull, i paprecedent dhe i jashtëzakonshëm, nuk ka zgjidhje tjetër për mua përveç hyrjes ose në varr ose në burg. Por meqenëse vetvrasja nuk lejohet me sheriat, dhe exheli i vdekjes është i panjohur

dhe jashtë fuqisë sime, unë do të isha i kënaqur me burgosje që unë tani po e vuaj në një izolim të vetmuar fillikat qysh prej gjashtë muajsh[243].

Megjithatë, unë nuk po e paraqes këtë peticion për tani, për hir të dëshirës së vëllezërve të mi të pafajshëm.

Së Katërti: Gjatë këtyre tridhjetë viteve prej jetës sime, periudhë në të cilën e quaja veten me emrin e "Saidit të Ri", unë pretendoj dhe them: Unë jam përpjekur me sa mundësi kam pasë për të përmbajtur nefsin tim urdhërues për të liga, për ta edukuar dhe për ta ruajtur prej zhytjes në vetëmburrje, në kërkim fame dhe në krenari, dhe ndoshta më shumë se njëqind herë i kam plagosur ndjenjat e studentëve të Risale-i Nurit të cilët kanë mendime të mira të tepruara për mua. Për këtë dëshmojnë ajo çfarë kam shkruar në Risale-i Nur dhe faktet që lidhen me personin tim; si dhe dëshmojnë njerëzit e drejtë -të paanshëm- dhe të gjithë shokët të cilët më kanë takuar me qëllim të shëndoshë dhe me seriozitet. Ashtu siç vërtetohet edhe nga shokët e mi të afërm, edhe nga vëllezërit e mi, dhe nga shenjat që ata kanë vëzhguar, unë u kam thënë atyre: "Unë nuk jam pronari i mallrave të Nurit, unë jam vetëm një lajmëtar i dobët dhe i thjeshtë në dyqanin e xhevahireve të Kur'anit". Unë jam i vendosur që të sakrifikoj jo vetëm rangjet e kësaj dynjaje dhe pozitën e lartë dhe famën, por edhe në qoftë se do të supozonim se më është dhënë një rang i madh shpirtëror, unë do ta sakrifikoja edhe atë gjithashtu për t'i shërbyer besimit dhe Kur'anit, nga frika e mundësisë së përzierjes së nefsit tim me sinqeritetin në shërbimin që kryej, duke prishur kështu sinqeritetin tim dhe qëllimin e pastër. Dhe me të vërtetë e kam bërë këtë. Dhe megjithëse kam vepruar në këtë mënyrë, dhe megjithëse nuk i kam pranuar dhe i kam refuzuar falënderimet e disa prej vëllezërve të mi për shkak të përfitimeve të tyre prej Risale-i Nurit -të cilat janë paraqitur në gjykatën tuaj të nderuar sikurse ajo të ishte një çështje politike- ju e keni bërë respektin e tyre për mua, që është më i madh se sa ai i djalit për babain e tij, subjek pyetjesh. Ju i keni shtyrë disa prej tyre që ta mohojnë atë respekt. Ju na keni bërë neve të dëgjojmë me habi. A mund të imagjinohej kjo të jetë një krim për dikë të mjerë që të lavdërohet megjithëse ai vetë nuk është i lumtur me këtë dhe nuk e konsideron vetveten të denjë?

Së Pesti: Unë sigurisht ju them me çiltërsi të plotë se të akuzosh studentët e Risale-i Nurit që i përkasin një "shoqërie politike" dhe

[243] E njëjta situatë vazhdon edhe pasi kanë kaluar shtatëmbëdhjetë muaj. Autori.

ndonjë ndërlikimi në politikë kur ata nuk kanë asnjë lidhje me asnjë shoqëri, grupim politik, parti, apo me lëvizje politike, -kjo me dijeni apo pa dijeni është luftë kundra nesh për llogari të një organizate ateiste sekrete e cila qysh prej dyzet vitesh vepron në mënyrë të drejtëpërdrejtë kundra islamit dhe besimit, ose në emrin e një lloji komunizmi i cili prodhon anarki në këtë vend. Sepse tre gjykata kanë dhënë pafajësinë lidhur me të gjithë studentët e Risale-i Nurit dhe me trajtesat e Risale-i Nurit. Vetëm gjykata e Eskishehirit më dha mua një vit dënim dhe gjashtë muaj dënim për pesëmbëdhjetë prej njëqind e njëzet vëllezërve të mi. Ndoshta ajo që e shtyu gjykatën e Eskishehirit që të marrë atë vendim është ardhja e një paragrafi që u shkrua herët dhe i cili erdhi brenda një trajtese të vogël që lidhet me një çështje të pjesshme e cila është *Hixhabi* dhe ajo fjali ishte sa vijon: "Sipas asaj që kam dëgjuar, në qendrën e qeverisë, një lustraxhi u suall pa turp ndaj gruas me shalë të zbuluara të një personi të rëndësishëm. A nuk është kjo sjellje e pahijshme e një goditje e fuqishme në fytyrat e atyre të cilët nuk e njohin kuptimin e turpit prej armiqve të dëlirësisë dhe të *Hixhabit*?" atëherë të akuzosh Risale-i Nurin dhe studentët e tij tani, do të thotë të akuzosh dhe të padisësh tre gjykatat dhe të jesh përbuzës ndaj tyre.

Së Gjashti: Risale-i Nuri nuk mund të luftohet e të kundërshtohet. Të gjithë dijetarët islamë të cilët e kanë parë atë, kanë konfirmuar se ai është një komentim i çmuar dhe i vërtetë i Kur'anit Kerim; domethënë ai përmban argumente të fuqishëm për të vërtetat e tij; ai është një mrekulli shpirtërore prej mrekullive të Kur'anit në këtë shekull, dhe një pengesë e fuqishme për këtë komb e për këtë vend kundra rreziqeve dhe shkatërrimeve që rrinë në pritë nga veriu. Prandaj unë kam kuptuar se është detyrë e gjykatës suaj jo t'i trembë studentët e tij, por për sa ka të bëjë me të drejtat e përgjithshme, t'i inkurajojë ata, dhe unë e pres këtë prej jush. Në sajë të lirisë shkencore, librat dhe gazetat e atyre pa fe dhe të disa politikanëve ateistë -libra të cilët janë të dëmshëm për kombin, për vendin dhe për sigurinë publike- nuk kundërshtohen, dhe nuk bëhet ndërhyrje tek ato; atëherë sigurisht nuk është krim të jesh një student i Risale-i Nurit dhe të shpëtosh besimin e të riut të pafajshëm i cili ka nevojë për ndihmë, dhe t'i ruash të rinjtë prej rënies në imoralitet; madje qeveria dhe ministria e arsimit duhet ta vlerësojnë këtë punë dhe ta nxisin. Fjala ime e fundit është:

I lutemi Zotit të Gjithëfuqishëm që t'u jap sukses gjykatësve ta zbatojnë ligjin me drejtësi të vërtetë. Amin.

"Allahu Vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i Mirë i punëve". [244] *"Atëherë dije se Allahu është Mbrojtës për ty. Sa Mbrojtës i Shkëlqyer dhe sa Ndihmues i Shkëlqyer!* [245]

Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve.

Said Nursi

• • •

Fjala ime e Fundit

Dëshiroj të them këtë për gjyqtarët e gjykatës.

Unë kam kuptuar si nga fletakuza po ashtu edhe nga izolimi im i gjatë i vetmuar se, në këtë çështje është kryesisht personi im ai i cili synohet; dhe është parë i përshtatshëm shkatërrimi i karakterit tim. Sikur personi im qenka i dëmshëm për qeverinë, për sigurinë publike dhe për vendin, dhe se ai e bëka fenë një maskë, paska qëllime të kësaj dynjaje dhe se ndiqka ndonjë lloj politikash. Përballë kësaj unë ju them me siguri të plotë sa vijon:

Për shkak të këtyre dyshimeve të pabaza, mos i lëndoni studentët e Risale-i Nurit nëpërmjet shpifjes ndaj personit tim, sepse ata i janë përkushtuar Risale-i Nurit, këtij vendi dhe kombi dhe janë një vlerë e madhe për to. Ose përndryshe do t'i shkaktohej këtij vendi dhe këtij kombi një dëm i madh, dhe kjo do të hapte rrugën për rrezik ndaj atyre të dyjave. Unë gjithashtu jua them me siguri këtë: Unë kam vendosur ta pranoj -për llogari të rrugës që unë po ndjek tani- çdo lëndim, çdo fyerje, çdo trajtim poshtërues, çdo torturim dhe çdo dënim me burgosje që më bëhen, me kusht që të mos i vijë asnjë dëm as Risale-i Nurit dhe as studentëve të tij për shkakun tim; dhe në këtë ka shpërblim për mua në Ahiret dhe ai është mjet për shpëtimin tim dhe për të më çliruar nga të këqiat e nefsit tim urdhërues për të liga. Dhe ndërsa qaj nga një aspekt, veçse ama jam i lumtur nga një aspekt tjetër. Në qoftë se këta të pafajshëm të mjerë nuk do të kishin hyrë në burg me mua për hir të kësaj çështjeje, unë do të kisha folur me të gjithë fuqinë në mbrojtje tek gjykata juaj. Ju gjithashtu e keni parë se personi i cili shkroi fletakuzën dëshiron të shkatërrojë karakterin tim me keqinterpretimet e tij dhe me ekzagjerimet, dhe duke i keqinterpretuar disa prej tyre duke

[244] Kur'an, 3:173
[245] Kur'an, 8:40

u dhënë mendime të gabuara dhe duke e paraqitur në atë mënyrë sikur të gjitha letrat dhe librat e mi, private dhe joprivate, që u shkruan gjatë këtyre njëzet deri në tridhjetë vite të jetës sime na qenkan shkruar këtë vit, dhe se nuk qenkan parë nga asnjë gjykatë, nuk paskan hyrë në asnjë gjykatë, nuk i paska përfshirë asnjë ligj amnistie dhe nuk qenkan zbuluar me kalimin e kohës. Dhe megjithëse unë e kam përmendur më shumë se njëqind herë se personi im është me gabime dhe me rëndësi të pakët, dhe ndonëse kundërshtarët e mi përpiqen me çdo mënyrë duke bërë shpifje ndaj meje, prapëseprapë ajo nuk ka pasur asnjë efekt në shikimin dhe në vlerësimin publik për mua, dhe arsyeja, që megjithëse ata shfrytëzojnë çdo rast për të më përçmuar në shikimin e njerëzve, veçse ama kjo nuk ka pasë asnjë ndikim, gjë e cila është e mjaftueshme për t'i shqetësuar politikanët, -arsyeja- është kjo: Është një nevojë shumë e madhe dhe e fortë këtu në këtë kohë dhe në këto rrethana për një numër njerëzish për të dhënë mësim fenë dhe për të forcuar besimin, njerëz që nuk do ta sakrifikonin të vërtetën për asgjë, që nuk do ta bënin atë një instrument për asgjë, dhe që nuk do të merrnin asnjë pjesë për nefset e tyre. Vetëm në këtë mënyrë do të ishte i mundur të përfitohej prej asaj që ata japin mësim rreth fesë, dhe do të bëheshin të besonin me siguri e bindje të plotë.

Po, duket se në asnjë kohë apo vend nuk ka pasë nevojë kaq të madhe për një shërbim të tillë, pasi rreziqet kanë ardhur me fuqi të plotë nga jashtë.

Megjithëse unë kam pranuar e deklaruar se personi im i dobët nuk mjafton për ta përmbushur këtë nevojë apo atë boshllëk, disa prej tyre supozojnë se diçka nga ajo mund të realizohet nëpërmjet meje, jo për shkak të ndonjë virtyti të veçantë në personin tim, por për shkak të rreptësisë dhe madhësisë së nevojës për dikë që ta përmbushë këtë detyrë, dhe për shkak se nuk është shfaqur ndonjë në mënyrë të dukshme që ta mbajë atë përgjegjësi më të madhe.

Qysh prej një kohe shumë të gjatë unë e kam shqyrtuar këtë çështje me habi e çudi, por vetëm tani e kam kuptuar urtësinë në këtë vlerësim publik, për të cilin unë nuk jam aspak i denjë -pavarësisht të metave të mia të mëdha. Urtësia në të është kjo: Këtu në këtë kohë, Risale-i Nuri dhe personaliteti kolektiv i studentëve të tij e kanë drejtuar atë nevojë të madhe tek vetja e tyre. Ata e kanë supozuar personin tim se është një përfaqësues i realitetit të çuditshëm të Risale-i Nurit dhe personaliteti i tij i pastër dhe i sinqertë -pavarësisht pjesës sime nga vepra e tij dhe nga shërbimi duke qenë veçse një e mijëta- dhe ata shfaqin ndaj meje një lloj shikimi -vlerësimi. Por kjo është edhe e

dëmshme për mua edhe një peshë. Gjithashtu për shkak të shërbimit tim ndaj tij, ata e kanë konsideruar personin tim të parëndësishëm të jetë i përfshirë në parashikimet rreth Risale-i Nurit, i cili është një pasqyrë ku reflektohet mrekullia e Kur'anit të gjithurtë në këtë kohë, dhe në personalitetin kolektiv të studentëve të tij të sinqertë, të bërë nëpërmjet *Ilhamit* -Inspirimit Hyjnor- prej disa Evlijave të tillë si Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, dhe prej Gauth El-Aëdham, iu shenjtëroftë sekreti. Më duket se kam gabuar, sepse në disa vende unë ia atribuova diçka prej shikimit të mirë të tyre personit tim dhe nuk ia drejtova Risale-i Nurit. Arsyeja për këtë ishte dobësia ime; unë në pamje të jashtme e pranova një pjesë të saj për vetveten me qëllim që të parandaloja gjërat që do të mund t'i frikësonin ata të cilët më ndihmojnë që të shtoja dhe rrisja mirëbesimin dhe konfidencën e tyre në atë çfarë thashë.

Unë ju paralajmëroj për çka vijon:

Nuk është nevoja të fyeni personin tim kalimtar, i cili është tek dera e varrit; nuk është e nevojshme t'i jepni atij aq shumë rëndësi. Dhe duhet ta dini mirë se ju nuk mund të ndesheni me Risale-i Nurin dhe nuk mund ta luftoni atë! Ju nuk mund ta mposhtni atë. Duke e luftuar atë ju do t'i shkaktonit dëm të madh këtij kombi e këtij vendi. Prandaj ju nuk mund t'i shpërndani e t'i përçani studentët e tij. Sepse mbrojtësi i Kur'anit në këtë kohë dhe aktet e tij heroike -të cilat në shikimin e botës islame janë si ato të kohëve të hershme- nuk do t'i lejojnë bijtë e paraardhësve të kësaj toke, të cilët dhanë dyzet deri në pesëdhjetë milionë martirë në rrugën e mbrojtjes së Kur'anit, që ta braktisin atë.

Madje, edhe në qoftë se nga ana e jashtme do të tërhiqeshin, ata studentë të sinqertë përsëri janë të lidhur me të gjithë jetët dhe shpirtërat e tyre. Ata nuk do ta braktisin Risale-i Nurin, i cili është një pasqyrë e atij realiteti, dhe ata nuk do të kënaqeshin -me atë braktisje- që t'i shkaktohej dëm atdheut, kombit dhe sigurisë publike. Fjala ime e fundit është:

"*Por nëse ata kthejnë kurrizin, atëherë thuaju (o Muhammed a.s.) "Allahu është më se i mjaftueshëm për mua. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor".*[246]

• • •

[246] Kur'an, 9 :129

Një peticion i dërguar për tek Këshilli i Ministrave.

Unë kam një kërkesë shumë të rëndësishme për ta paraqitur tek kabineti.

Unë i kërkoj kabinetit që pesëmbëdhjetë faqet e Rrezes së Pestë, e cila për herë të parë është shkruar para disa vitesh, dhe që më vonë u përfshi tek fundi i koleksionit të quajtur *Siraxhun Nur -Llamba Ndriçuese*, i cili ka më shumë se treqind faqe, dhe ishte shkaku për daljen e vendimit nga ana e këshillit të ministrave për ta konfiskuar të gjithë atë koleksion - i kërkoj kabinetit që ato pesëmbëdhjetë faqe të hiqen prej koleksionit "*Siraxhun Nur*".

Sepse është vërtetuar e konfirmuar se ai koleksion është i suksesshëm në shumë mënyra për të gjithë dhe sidomos për njerëzit e goditur me fatkeqësi e me bela dhe për të moshuarit të cilët kanë dyshime në aspektet e imanit. Pra unë kërkoj që pjesa e cila imagjinohet të jetë e dëmshme, të hiqet dhe të jepet leja për treqind faqet e mbetura që të botohen, me qëllim që të goditurit me fatkeqësi dhe të moshuarit të mund të marrin ngushëllim prej atij koleksioni si dhe të përfitojnë ata të cilët janë në nevojë për të vërtetat e besimit që ai i përmban.

Për më tepër, në katërqind faqet e koleksionit *Dhul Fikar*, dy faqe të shkruara para tridhjetë viteve duke shpjeguar dy vërsete rreth trashëgimisë dhe rreth mbulesës së grave si përgjigje ndaj filozofëve të Europës, dhe një rresht të vetëm rreth bankave në trajtesën "*Isharatul-Ixhaz*", e botuar para tridhjetë viteve rreth vërsetit, *"Ndërsa Allahu ka lejuar tregtinë dhe ka ndaluar kamatën"*[247], dhe afërsisht një rresht i shkruar para tridhjetë vitesh ndërsa isha në Dar'el-Hikmeh, midis gjashtë pyetjeve të drejtuara për zyrën e Shejhul-Islamit nga kryeprifti i kishës Anglikane -unë kërkoj që këto pjesë të hiqen, ndërsa koleksioni "*Dhul Fikar*", i cili është konfiskuar me pretekstin e atyre dy faqeve dhe të një rreshti -për shkak se ato nuk janë në përputhje me kodin civil të tanishëm- të na kthehet. Sepse ajo trajtesë është vlerësuar shumë nga bota islame dhe dobitë e saj në fakt janë parë, dhe ajo i provon në mënyrë të mrekullueshme tre prej shtyllave të Imanit. Kjo është ajo që ne kërkojmë dhe kjo është e drejta jonë. Sepse ashtu si në qoftë se do të gjendeshin pesë fjalë të ndaluara në një letër, ato fjalë hiqen dhe lejohet të botohet pjesa tjetër e letrës, po ashtu edhe ne kërkojmë garantimin e kësaj të drejte ligjore të rëndësishme për ne.

---

[247] Kur'an, 2 : 275

Dhe në emrin e të gjithë atyre që i shërbejnë Kur'anit dhe besimit dhe që përpiqen të vendosin rendin dhe qetësinë dhe që i shërbejnë këtij vendi e këtij kombi nëpërmjet Risale-i Nurit, ne u kërkojmë juve që të na shpëtoni ne prej shtypjes së atyre që e bëjnë qimen tra. Gjithashtu unë nuk kam parë asnjë kopje të trajtesës "Gjashtë Sulmet" të cilën e shkrova para tetëmbëdhjetë vjetësh, dhe të cilën e shkrova ndërsa isha shumë i zemëruar nga shtypja e rëndë që po vuaja në atë kohë; duke thënë se ajo ishte private, unë nuk dhashë leje që ajo të botohej. Sidoqoftë ajo ra në duart e tre apo katër gjykatave, dhe ata e rikthyen atë tek pronarët e saj.

Said Nursi

• • •

Letër Falënderimi

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

[Kjo u shkrua për të falënderuar komitetin e ekspertëve të Drejtorisë së çështjeve fetare. Unë do të shpjegoj tre 'Pika' me qëllim që t'i ndihmoj ata për të korrigjuar e amenduar kritikat e tyre të pjesshme që kanë ardhur në hetimet e tyre, përgjigjja për të cilat është e qartë.]

E Para: Unë i falënderoj ata dijetarë në tre mënyra. Për veten time unë jam mirënjohës ndaj tyre.

Së Pari: Përveç Rrezes së Pestë, përmbledhja e tyre është vlerësimi për trembëdhjetë pjesët e koleksionit "*Llamba Ndriçuese*".

***Së Dyti*:** Refuzimi nga ana e tyre për akuzat e bëra kundra nesh për themelimin e një tarikati Sufi, që po formojnë një shoqëri politike, dhe se po prishim rendin publik.

Së Treti: Mbështetja nga ana e tyre për çështjen time në gjykatë. Domethënë, unë i thashë gjykatës: Në qoftë se ka ndonjë gabim, ai është i imi. Studentët e Risale-i Nurit janë të sinqertë dhe të pafajshëm, dhe punojnë me Risale-i Nurin për besimin e tyre. Kështu, komiteti i tyre i ekspertëve i shfajësuan studentët e Risale-i Nurit, dhe të gjithë gabimin ma ngjitën mua. Kështu unë u them anëtarëve të saj: Zoti qoftë i kënaqur me ju! Por ama ata i bënë ortakë në krimin tim, të ndjerin Hasan Fejzi dhe të ndjerin Hafiz Ali, dhe dy ose tre të tjerë të cilët janë trashëgimtarët e atyre dy martirëve të bekuar dhe që punojnë sipas sistemit të tyre. Prandaj ata gabuan në këtë drejtim. Sepse ata ishin të parët në shërbim të besimit dhe jo ortakë në mëkate, dhe ishin

pa mëkate; ata i dërgoi Përkujdesja Hyjnore si ndihmësit e mi, nga mëshira për dobësinë time.

Pika e Dytë: Komiteti i ekspertëve tha se disa nga rrëfenjat në Rrezen e Pestë janë *Daifeh* -të dobëta- dhe disa të tjera janë *Meuduë* -të trilluara-, dhe se disa të tjera ishin keqinterpretuar. Dhe prokuroria e përgjithshme i shkroi gjykatës së Afjonit raportin e saj në të njëjtën mënyrë. Por unë provova në një listë prej pesëmbëdhjetë faqesh se ai përmbante tetëdhjetë e një gabime. Komiteti i respektuar i ekspertëve duhet të shohë listën. Si shembull i njërit prej gabimeve është sa vijon: Prokurori tha: "Të gjitha interpretimet janë të gabuara, dhe rrëfenjat ose janë *Daifeh* ose *Meuduë* dhe unë them: Të interpretosh një hadith do të thotë, të thuash se filan kuptim dhe ky ose ai kuptim është i mundshëm ose ndoshta ai synohet nga hadithi. Sipas shkencës së logjikës është e mundshme të hidhet poshtë mundësia e atij kuptimi vetëm duke provuar pamundësinë e tij. Por ama ai kuptim është parë me sy në këtë shekull dhe është bërë realitet; kështu njëri aspekt i universalitetit të nivelit aludues të kuptimit ka shfaqur dukshëm një shkreptimë të parashikimeve të tij të mrekullueshme duke dalë e vërtetë në këtë kohë, dhe prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të mohohet dhe as të kundërshtohet. Gjithashtu është provuar në listë se thënia e prokurorit se "të gjitha rrëfenjat ose janë *Daifeh* ose *Meuduë*, është e gabuar në tre aspekte.

I Pari: Është gabim në dhjetë drejtime t'i mohosh rrëfenja të tilla në tërësinë e tyre, sepse Imam Ahmed Ibn Hanbel, i cili dinte përmendësh një milion hadithe, dhe Imam Buhariu i cili kishte mësuar përmendësh pesëqindmijë hadithe, nuk patën guximin që t'i mohonin ato rrëfenja; sidoqoftë një mohim i tillë është i pamundur; dhe prokurori nuk i ka parë të gjithë librat e haditheve; dhe pjesa më e madhe e ummetit islam kanë pritur në çdo shekull shfaqjen e kuptimeve të atyre rrëfenjave, ose të shikonin një aspekt të kuptimeve të tyre të përgjithshme; madje ato kuptime pothuajse janë pranuar nga ummeti; dhe një numër i aspekteve dhe i shembujve të tyre të cilat janë krejtësisht të vërteta janë shfaqur dhe janë parë.

Aspekti i Dytë: Kuptimi i *Meuduë* -e trilluar- do të thotë se një rrëfenjë nuk është një hadith me një zinxhir autentik autoritetesh; nuk mbështetet prej filanit, dhe prej filanit. Por *Mauduë* nuk do të thotë se kuptimi i tij është i gabuar. Meqenëse midis Ummetit, në mënyrë të veçantë njerëzit e realitetit dhe ata që ua kanë zbuluar atyre realitetet, dhe disa prej dijetarëve të hadithit dhe ata që janë të kualifikuar për ta interpretuar sheriatin -meqenëse të gjithë këta- i kanë pranuar dhe kanë

pritur shfaqjen e asaj që ato tregojnë, atëherë sigurisht ato rrëfenja përmbajnë të vërteta që shohin gjithkënd -orientohen tek të gjithë- ashtu si proverbat.

Aspekti i Tretë: Unë pyes: A ka ndonjë çështje apo një rrëfenjë që nuk është kundërshtuar në ndonjë libër të dijetarëve, medhhebet dhe metodat e të cilëve janë të ndryshme? Për shembull, njëra prej rrëfenjave rreth shfaqjes së disa dexhalëve brenda islamit është hadithi vijues, i cili parashikon në mënyrë të qartë konfliktin e Hulagu dhe të Xhengiz Hanit: *"Kalifati Abasid do të vazhdojë gjatë, derisa ai të bie në duart e dexhalit"*[248]. Ashtu si ky hadith i cili deklaron se pas pesëqind vitesh do të shfaqet një dexhal në islam dhe do të shkatërrojë kalifatin... po ashtu ndodhen rrëfenja të shumta të cilat njoftojnë për figurat e kohës së fundit. Megjithatë disa prej muxhtehidëve të cilët ishin prej medhhebeve të ndryshëm, ose që idetë e të cilëve ishin ekstreme, nuk i pranuan ato rrëfenja, duke thënë se ato ishin ose *Daifeh* ose *Meuduë.*

Sidoqoftë... arsyeja pse unë e kam shkurtuar këtë histori të gjatë lidhet me Risale-i Nurin, sepse ashtu si katër tërmetet e fuqishëm që koinçiduan me kohën kur Risale-i Nuri dhe studentë e tij po sulmoheshin, duke demonstruar zemërimin e tokës, po ashtu dy tërmete të fuqishëm ndodhën këtu në orën që unë po shkruaja këtë përgjigje. Çështja ishte sa vijon:

Ishin dy tërmete "duke koinçiduar" me vuajtjen që kisha përjetuar nga plagët e shkaktuara prej operacionit kirurgjik të raportit të ekspertëve, i cili më ishte dhënë mua në atë mbrëmje dhe për shkak të vështirësive të mia të mjerueshme që nuk kisha kontakt me të tjerët. Po, unë e mora në atë mbrëmje raportin prej drejtorisë së çështjeve fetare, tek e cila unë kisha vendosur besimin më të madh gjatë tetë muajve të vuajtjeve në një burgim të vetmuar fillikat, dhe kisha pritur që ajo do të vinte në ndihmën tonë. Këtë mëngjes unë kuptova se në çështjet më bajate e të papërfillshme ata nuk më kishin ndihmuar mua por prokurorin e përgjithshëm. Unë pashë se ata thanë: "Saidi tha se katër tërmetet e fundit ishin prej kerameteve të Risale-i Nurit". Dhe ashtu siç kisha shkruar në listën e gabimeve, unë them: Risale-i Nuri është prej llojit të sadekasë së pranuar e cila është mjet për të zmbrapsur fatkeqësitë, dhe sa herë që ai është sulmuar, fatkeqsitë gjejnë rastin e dhënë dhe bien, dhe ndonjëherë toka zemërohet me

[248] Kenz el-Ummal, XIV, 271, No:33, 436; Musnad al-Firdauws, 111, 447; etj.

tërmete. Dhe sapo vendosa ta shkruaja këtë, ra tërmeti këtu,[249] gjë që më bëri ta lija shkrimin e kësaj pjese; prandaj unë do të kaloj tek Pika e Tretë:

Pika e Tretë: O Dijetarët e saktë, të vërtetë e të paanshëm të komitetit të ekspertëve! Ka qenë një zakon midis njerëzve të dijes - qysh prej shumë kohësh- dhe një praktikë e pranueshme është se ata shkruajnë lavdërime e vlerësime, ndonjëherë të ekzagjeruara, dhe ndonjëherë shkruajnë të kundërtën, në fundet e librave të vlefshëm të shkruar nga të tjerët, dhe duke i botuar ato, dhe autori në çështje duke u falënderuar e duke qenë i kënaqur me shkruesit e lavdërimeve dhe vlerësimeve të tilla; dhe rivalët e tyre gjithashtu nuk i akuzonin ata për vetëmburrje.

Prandaj shkrimi prej një numri nga studentët e veçantë e të sinqertë të Risale-i Nurit të tillë si i ndjeri Hasan Fejzi dhe martiri Hafiz Ali, atë shkrim të cilin ata e shkruan me idenë që të më ndihmonin në pafuqinë time, në dobësinë, në internimin dhe në mospraninë e familjes dhe të të afërmeve dhe përballë sulmeve të armiqve të shumtë tiranë dhe për t'i nxitur ata që janë të nevojshëm për të përqafuar Risale-i Nurin; dhe ato lavdërime e vlerësime u quajtën një lloj vetëmburrjeje dhe vetëpëlqimi, ndonëse unë ia atribuoj lavdërimin dhe vlerësimin Risale-i Nurit, dhe pavarësisht se nuk ia ktheva atë plotësisht.

Kështu unë nuk kam mundur ta barazoj -të vendos një paralelizëm- midis konsideratës suaj për atë lavdërim se paska qenë vetëpëlqim dhe midis atij studimi të vëmendshëm që mbani, atij bashkëpunimi të mirë dhe paanshmërisë... Prandaj unë jam shumë i dëshpëruar prej kësaj; duke ditur se ato shokët e mi të sinqertë nuk kanë menduar kurrë për politikat. Nuk mund të thuhet për fjalën e tyre: Për Risale-i Nurin në këtë kohë konfirmohet e bëhet realitet një aspekt dhe një kuptim i pjesshëm prej kuptimit aludues universal të hadithit. Sepse koha e ka provuar dhe e ka vërtetuar atë. Le të supozojmë se kjo fjalë është shumë e ekzagjeruar dhe madje gabim, ai përsëri do të ishte vetëm se një gabim shkencor, dhe jo tjetër. Çdo person mundet që të shkruajë bindjen e tij personale, gjithkush mund t'i shkruajë mendimet e tij. Ju e dini më mirë se, sa shumë mendime e opinione të ndryshme janë shkruar në veprat e dymbëdhjetë medhhebeve të sheriatit, dhe

---

[249] Këto dy tërmete koinçiduan me ditën e premte 18.9,1948, në mëngjes.
Nënshkruan në emrin e studentëve të Risale-i Nurit të cilët mbahen në burgun e Afjonit. Halil, Mustafa, Mehmet, Fejzi, Husrev.

veçanërisht studiuesit e Medhhebeve Hanefi, Shafii, Maliki dhe Hanbeli, dhe ato të afërsisht shtatëdhjetë autoriteteve të shkencave të teologjisë -Kelam- dhe të parimeve të fesë. Megjithatë në asnjë kohë nuk ka qenë nevoja për përputhshmëri e pajtueshmëri midis dijetarëve të fesë aq e madhe sa në kohën e tanishme, dhe që ata t'i shmangen kundërshtimit dhe polemikave. Tani ne jemi të detyruar që t'i lëmë mënjanë kundërshtitë në çështjet dytësore dhe të mos i bëjmë ato subjekt debati.

• • •

Unë kam tre pyetje për t'ua drejtuar *Hoxhallarëve* të paanshëm të komitetit të Ekspertëve:

E Para: A është fajtor dhe përgjegjës një person në qoftë se dikush e lavdëron atë me nijet të mirë? Dhe sidomos në qoftë se personi i lavdëruar nuk e do lavdërimin, dhe madje e refuzon me të gjithë fuqinë e tij ose e drejton atë lavdërim tek dikush tjetër? Por ai me qëllim që të mos e humbasë shokun e tij të sinqertë, nuk e qorton atë, dhe i përgjigjet me heshtje dhe duke i thënë se lavdërimi është njëqind herë më i madh se sa ai e meriton. A konsiderohet kjo heshtja e tij vetëpëlqim dhe kërkim për interesin personal?

Pyetja e Dytë: Në këtë kohë të sulmeve të tmerrshme ndaj fesë, në qoftë se ndonjëri prej studentëve ashikë për të vërtetën të Risale-i Nurit do të shfaqte bindjen e tij personale të gabuar, me një gabim shkencor të pjesshëm e të padëmshëm, a do të ishte i merituesshëm për këtë fyerje e përçmim? Duke ditur se ndodhen çështje fetare që vlerësohen me madhësinë e maleve të larta? Ndërsa ai i lavdëruar pret një paralajmërim të butë prej dijetarëve dhe profesorëve si shembulli juaj për atë gabim, a do të ishte e lejueshme që ai të ndëshkohet nga ana e drejtësisë?

Pyetja e Tretë: Risale-i Nuri i cili ka sfiduar qysh prej njëzet viteve edhe kundërshtarët e panumërt më kryeneçë dhe ka shpëtuar imanin e qindra mijëra njerëzve dhe ka forcuar besimin e tyre, a është e përshtatshme kjo kritika juaj ndaj tij për shkak të një ose dy çështjeve në të? Gjithashtu unë u sjell ndërmend atyre dijetarëve të nderuar:

Ata kritikuan parathënien me të cilën fillon lavdërimi për Ahmed Fejziun, sikur unë paskam lavdëruar me të veten time, duke ditur se ajo parathënie ishte refuzimi e mospranimi im ndaj atij lavdërimi dhe për ta hequr atë lavdërim. Dhe në fakt unë e hoqa një pjesë të tij, dhe

korrigjova pjesën tjetër, por duke qenë i detyruar të nxitoja, unë nuk munda ta modifikoja, kështu unë e dërgova parathënien të plotë tek njëri nga vëllezërit e mi. Pastaj ai e vendosi letrën në fillimin e lavdërimit. Pastaj kur ajo u dërgua tek një vëlla tjetër, ajo u kap nga qeveria. Sa e çuditshme, në një lavdërim të tillë privat i cili ishte thjesht një mendim personal dhe shkencor, dhe u dërgua nga shoku tek shoku me idenë e konsultimit rreth modifikimit dhe korrigjimit të plotë të tij, a meriton kjo kaq kundërshtime të forta?

Pastaj, të grumbullosh letrat private që ishin me qëllim urimi, inkurajimi dhe për t'i kënaqur ata, duke i bërë në dy vëllime të lidhur me të kuqe e të zezë me qëllim që të mos humbisnin, të cilat i shtiu në dorë policia gjatë kohës së hetimit, a mund të nxirren vendime për këto, e pastaj të bëhen subjekt pyetjeje dhe përgjigjjeje, dhe pastaj përpjekja për t'i lidhur ato me politikat? A ka nevojë çështja për këtë... A nuk ngjason kjo me dikë që nuk sheh dragonjtë dhe gjarpërinjtë e tmerrshëm duke sulmuar Kur'anin, dhe në të njëjtën kohë preokupohet me pickimin e mushkonjave!

Lënia e Saraçoglu[250], i cili e quan fenë dhe edukimin Muhammedan "helm", dhe koleksionin *Siraxhun-Nur* i cili e demonstron të vërtetën aq qartë si dielli dhe që është balsami më i mirë për të gjitha plagët e njerëzimit, dhe sidomos debati e kundërshtimi për ekzistencën e interpretimeve të haditheve të dobëta në fundin e trajtesës, a nuk është kjo një ndihmë për konfiskimin e atij koleksioni?

Ne presim prej personave si ju melhem për plagët tona, dhe të jeni ndihmësit tonë me fuqinë e mendjemprehtësisë suaj, dhe jo të lëndohemi prej kritkave tuaja të pjesshme.

I burgosuri Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

[Kjo formon parathënien për pjesët që e ndjekin atë.]

Me idenë për të na ndihmuar pak për të refuzuar me dëshmi të vërteta, të drejta e të paanshme vendimin e gjykatës së Afjonit kundra nesh dhe për ta kthyer gjykatën e Apelit në favorin tonë, dhe me qëllim që të tregojmë shkurtazi disa prej gabimeve në akuzë, ne i kemi shkruar ekzaktësisht pjesët prej trajtesave private që ata i përmendën

[250] Kryeministri në atë kohë. -Përkthyesi.

se ishin faje të dënueshme. Ne do të tregojmë gabimet e tyre, dhe do t'i vendosim ata të cilët na dënuan në vendin e përgjegjësisë.

Për shembull, me qëllim që të dënohem me dënimin më të rëndë, ata shkruan në fund të fletakuzës si një indeks të gjitha fajet e mia: "Çështjet që i refuzon Said Nursi":

Një: heqjen e perandorisë dhe të kalifatit. Kjo është edhe gabim dhe njëkohësisht pakujdesi. Sepse para pesëmbëdhjetë viteve në Gjykatën e Eskishehirit unë iu përgjigja një pyetjeje rreth shkrimit tim në Shkreptimën e Njëzet e Gjashtë, trajtesa për të moshuarit: "Mua më dëshpëroi vdekja e pushtetit të kalifatit", dhe përgjigjja ime e heshti gjykatën. Ai i cili e konsideron krim një kujtesë të parëndësishme, e cila u shua me kohën, dhe e cila mori vendimin e amnistisë dhe të pafajësisë, ai vetë është fajtor. Si një dëshmi dokumentare për këtë krim imagjinar, ata treguan një hadith prej njërës midis Shkreptimave, i cili gjithashtu gjendet në trajtesën "Mrekullitë e Profetit Muhammed a.s.m.*: "Pas meje kalifati do të zgjasë tridhjetë vjet, pastaj ai do të jetë një monarki lakmitare, dhe pastaj korrupsion e tirani"*.[251]

Domethënë, pas katër kalifëve të drejtë do të jetë korrupsion. Unë shkrova në njërën nga trajtesat e mia të vjetëra se ky hadith përmbante tre mrekulli nga e padukshmja për të ardhmen. Por në vendim -në akuzë- erdhi se ky ishte një krim që e kisha kryer: Në njërën nga trajtesat e tij Saidi thotë: "Pas kalifatit do të ketë tirani e korrupsion".

O anëtarët sipërfaqësorë të komitetit të ekspertëve! Ai që e konsideron të jetë një krim shpjegimin e mrekullisë së një hadithi sherif i cili njofton nëpërmjet një shenje nga e padukshmja për një ngjarje që do të ndodhte në këtë kohën tonë e cila do të shkaktojë kaos në të gjithë tokën, dhe që njofton për një korrupsion të madh shpirtëror e material në të gjithë njerëzimin... unë them se ai që e konsideron faj këtë, është vetë fajtor shpirtërisht dhe materialisht.

Ata gjithashtu shkruan: Nga fajet e tij është sa vijon: Ai i konsideron mrekullitë e revolucionit -reformat- bidat, çudhëzim dhe ateizëm, dhe i konsideron mbylljen e teqeve, të zavijeve dhe të shkollave fetare, pranimin e laicizmit dhe vendosjen e parimeve nacionaliste në vend të parimeve islame, detyrimin për të vënë kapelen strehëgjërë, heqjen e hixhabit, përdorimin e detyruar të shkronjave latine në vend të shkronjave të Kur'anit, dhe kryerjen e ezanit dhe të ikametit në gjuhën turke, dhe anullimin e mësimeve fetare nëpër shkolla, dhënien e të drejtave të gruas në trashëgimi njëlloj si burri dhe

[251] Transmetojnë Ahmdi dhe Tirmidhiu

shfuqizimin e poligamisë -martesës me më shumë se një grua- si dhe gjëra të tjera si këto... ai i konsideron të gjitha këto bidate, çudhëzim dhe ateizëm... Nuk ka dyshim se ai është i akuzuar për reaksion.

O anëtarët e padrejtë të komitetit të ekspertëve!

Në qoftë se do të mundeshit të mohoni atë çfarë urdhëron Kur'ani i cili është imami qiellor i shenjtë i treqind milion njerëzve në çdo shekull, i cili përmban programet e të gjitha lumturive të tyre, i cili është thesari i shenjtë i jetës së kësaj bote dhe i tjetrës, i cili në mënyrë të qartë në shumë vërsetet e tij, të cilat nuk mbajnë interpretim, urdhëron *Hixhabin* -mbulesën e grave-, rregullat e trashëgimisë, lejon martesën me më shumë se një grua, që bën thirrje për ta përmendur Allahun, nxit për të dhënë mësim shkencat e fesë, për t'i përhapur ato dhe për t'i ruajtur shenjat e fesë... në qoftë se do të kishit mundësi t'i dënoni të gjithë muxhtehidët -interpretuesit- e islamit, gjykatësit dhe të gjtihë shejhët e islamit... dhe në qoftë se do të kishit mundësi të anulloni kalimin e kohës dhe të shfuqizoni vendimin e disa gjykatave që u dhanë pafajësi atyre trajtesave, dhe të anulloni ligjet për amnisti, që dolën për to, dhe të mohonit aspektin e fshehtë e privat të tyre... dhe në qoftë se do të kishit mundësi të hiqnit lirinë e mendimit prej këtij vendi dhe prej qeverisë së tij... dhe të mohonit qënien e kundërshtimit të atyre trajtesave vetëm me logjikë e shkencërisht... Unë them, në qoftë se do të kishit mundësi për këtë, atëherë më konsideroni fajtor për ato çështje, ose përndryshe do të jeni ju fajtorë të tmerrshëm në gjykatën e së vërtetës, të realitetit dhe të drejtësisë!

Said Nursi

• • •

[Megjithëse paragrafi është kundra tyre, gjykata në mënyrë të çuditshme e shfaqi atë të jetë kundra nesh.]

Unë i them gjykatës së nderuar të ministrisë së drejtësisë!

Në qoftë se do të kishte ndonjë drejtësi në faqen e tokës, ajo do ta hidhte poshtë një vendim të padrejtë për të dënuar një njeri i cili, duke u mbështetur në pajtueshmërinë dhe në konfirmimin e treqind e pesëdhjetë mijë komenteve të Kur'anit dhe duke ndjekur besimet e paraardhësve tonë për një mijë e treqind e pesëdhjetë vite, shpjegoi një Rregull Hyjnor që është konsideruar si më i shenjti dhe pikërisht e vërteta në jetën shoqërore të treqind e pesëdhjetë milion myslimanëve

në çdo shekull për një mijë e treqind vite; duhet patjetër që të shfuqizohet ai vendim.

• • •

[Një paragraf të cilin gjykata e shkroi me çudi dhe me vlerësim në vendimin e saj, sikur ai të ishte kundra nesh, por i cili në fakt i dënon ata.]

Në Letrën e Njëzet e Gjashtë, Said Nursi flet për vetveten kështu: "Ky vëllai juaj i varfër ka tre personalitete, të cilët janë shumë larg nga njëri-tjetri.

I Pari: Në lidhje me qënien time si një lajmëtar i thesarit të lartë të Kur'anit të gjithurtë, unë kam një personalitet të përkohshëm, i cili i përket vetëm shërbimit të Kur'anit.

Karakteri tej mase i lartësuar i kërkuar nga pozita e një lajmëtari nuk është karakteri im; unë nuk e posedoj një karakter të tillë. Përkundrazi, ai përbëhet nga cilësi që bëhen të domosdoshme nga pozita dhe nga detyra. Çfarëdo që ju shihni tek unë prej këtij lloji cilësie, ai nuk është i imi; kështu që mos më konsideroni mua që ta posedoj atë; ai i përket pozitës.

Personaliteti i Dytë: Nëpërmjet mirësisë së Zotit të Gjithëfuqishëm, një personalitet më jepet mua në kohën e adhurimit, kur unë jam i orientuar drejt derës së Hyjnisë xh.sh.; ky personalitet shfaq disa shenja. Këto shenja burojnë prej "njohjes së njeriut gabimet dhe të metat e tij dhe prej perceptimit të tij se ai është i varfër dhe i pafuqishëm dhe duke kërkuar strehim me nënshtrim të plotë para Fuqisë Hyjnore", të cilat janë bazat dhe kuptimi i adhurimit. Nëpërmjet këtij personaliteti, unë e njoh veten time të jem më i mjeri, më i pafuqishmi më i varfëri dhe më me të meta se çdokush tjetër përpara Allahut. Atëherë, sikur të mblidhej e gjithë dynjaja për të më lavdëruar e për të më vlerësuar mua, ata nuk do të mund të më bënin të besoja se unë jam i mirë ose paskam ndonjë lloj plotësimi.

Personaliteti i Tretë: Unë kam personalitetin tim të vërtetë, domethënë, personalitetin e zvetënuar të Saidit të vjetër, domethënë disa damarë të karakterit të trashëguar nga Saidi i vjetër. Ndonjëherë ai priret drejt hipokrizisë dhe dëshiron rang e pozitë. Gjithashtu, për shkak se unë nuk vij nga një familje me pozitë e me emër, veçoritë e mia të ulëta duhet të vëzhgohen të tilla si; qënia ime kursimtar deri në pikën e kopracisë.

O vëllezërit e mi!

Unë nuk do të përshkruaj shumë prej të metave të mia të fshehta të këtij personaliteti dhe prej gjendjeve të tij të këqija me qëllim që të mos ju ftoh e t'ju largoj juve krejtësisht prej meje. Allahu xh.sh. ka shfaqur përkujdesjen e Tij të mëshirshme tek unë që ma ka nënshtruar këtë personalitetin tim, i cili është si ushtari më i ulët, duke e vënë në shërbim të mistereve të Kur'anit që i ngjason pozitës më të lartë të mareshallit. Një mijë falënderime qofshin për Allahun xh.sh.! Nefsi është më i ulët se çdo gjë, dhe detyra është më e lartë se çdo gjë...

I Gjithë lavdërimi i takon Allahut, kjo është nga mirësia e Zotit tim.

• • •

[Kjo është një fjali që e trembi keq gjykatën, kështu ata e regjistruan atë kundra nesh në vendim. Megjithatë ato fjalë të fuqishme qenë shkruar para pesëmbëdhjetë viteve dhe pastaj u ndryshuan dhe u zbutën me këtë formulim që vijon.]

Duhet që ky paragrafi që vijon, t'i shtyjë ata për tek drejtësia dhe paanshmëria: "O vëllezërit e mi! Për hir të të pafajshmive dhe të moshuarve, mos merrni hak ndaj atyre që më vrasin me padrejtësi. Torturat e varrit dhe të Ferrit janë të mjaftueshme për ta".

Ju e shikoni se ne jemi në kundërshtim dhe në oponencë të plotë me ju, dhe trajtimet tuaja të ashpra janë dëshmitarë për këtë. Ju sakrifikoni fenë dhe Ahiretin tuaj për hir të dynjasë suaj ndërsa ne jemi të gatshëm vazhdimisht të sakrifikojmë dynjanë tonë për hir të fesë sonë dhe për hir të Ahiretit tonë, dhe ky është misteri i kundërshtimit që është mes nesh sipas mendimit tuaj.

Sigurisht, të sakrifikosh dy ose tri vite nga jeta jonë e cila po kalon në poshtërim e fyerje nën sundimin tuaj me qëllim që të fitojmë martirizim të shenjtë në rrugën e Zotit xh.sh., do të ishte si *Uji i Keutherit* për ne. Por, me qëllim që t'ju bëjmë ju të dridheni e të frikësoheni, duke u mbështetur në shkëlqimin dhe në treguesit e Kur'anit të gjithurtë, unë ju njoftoj juve me siguri të plotë:

"Ju nuk do të jetoni pasi të më vrisni mua! Një Dorë Detyruese -e papërballueshme- do t'ju marrë juve prej kësaj dynjasë suaj, që është xhenneti juaj dhe e dashura juaj, dhe do t'ju dëbojë prej saj, dhe do t'ju flakë menjëherë në errësirat e përjetshme. Pas meje, udhëheqësit tuaj si Nimrudi do të vriten shpejt e do të dërgohen tek unë, dhe do t'i kap për

gryke përpara prezencës Hyjnore, dhe do të marr hakun tim prej tyre dhe drejtësia Hyjnore duke i flakur ata në ultësirën më të ulët.

O ju fatkëqinj që i shisni fenë dhe jetët tuaja të Ahiretit për këtë dynja! Në qoftë se me të vërtetë doni të jetoni, mos ndërhyni tek unë dhe mos më prekni me të keqe! Në qoftë se ndërhyni, dijeni se hakmarrja ime mbi ju do të merret e shumëfishtë. Dijeni mirë këtë, dhe u frikësofshi!

Unë shpresoj nga mëshira Hyjnore se vdekja ime do t'i shërbejë fesë më shumë se jeta ime, dhe vdekja ime do të shpërthejë mbi kokat tuaja si një bombë duke ju shpërndarë! Atëherë më shqetësoni në qoftë se guxoni! Në qoftë se do të bënit ndonjë gjë, ju do ta shihni!" Kjo përfundon me një vërset Kur'anor.

• • •

[Gjykata e regjistroi këtë kundra meje, pavarësisht se është një paragraf që i akuzon ata për qënien e tyre ekstrem.]

Në letra vjen kjo:

Në Ankara, Mustafa Qemali hyri tepër i zemëruar dhe i indinjuar në zyrën e kryetarit të Asamblesë. Ai tha: "Ne të kemi ftuar këtu me qëllim që të shpjegosh idetë e tua të rëndësishme për ne. Por ti erdhe dhe shkrove gjëra rreth pesë namazeve të përditshme, dhe mbolle përçarje midis nesh. Saidi ia ktheu atij: "Ai i cili nuk falet është tradhtar, dhe vendimi i tradhtarit është i papranueshëm." Pastaj Mustafa Qemali shfaqi një lloj ndjese e pajtimi duke u tërhequr nga zemërimi dhe indinjata e tij.

Dhe pavarësisht se Saidi i lëndoi ndjenjat e Mustafa Qemalit dhe plagosi parimet e tij, por ama Mustafa Qemali nuk i bëri të keqe.

Sigurisht është një keramet vezullues i Risale-i Nurit dhe një fuqi e madhe, e jashtëzakonshme e personalitetit të tij kolektiv dhe i studentëve të tij heroik në të ardhmen, që prej Risale-i Nurit të tremben komandantë autoritarë arrogantë ashtu siç trembeshin prej Saidit të vjetër.

• • •

[Një pjesë e cila u shkrua kundra nesh, por që e bëri gjykatën fajtore.]

Thuhet -në trajtesa- “Ne nuk jemi me një udhëheqës i cili ka lëshuar dekrete sipas tekave të tij në emrin e ligjit dhe që i zbatoi ato me forcë për ta kthyer xhaminë e Aja Sofias në një shtëpi idhujsh, dhe që e ka bërë zyrën e shejhul Islamit një shkollë të mesme për vajzat; ne nuk jemi me të as me mendim, as në subjekt, as në motiv dhe as në rezultatet, dhe nuk e gjejmë veten tonë të detyruar për ta pranuar një çështje si kjo.

Dhe shkruhet në peticionin e tij që daton me 29.8.1948: “Në zemrën time erdhi ky mendim: Ndonëse është shumë e domosdoshme për hir të kombit dhe për dobinë e vendit që qeveria duhet të më mbrojë plotësisht dhe të më ndihmojë, por ajo po më shtyp. Kjo sugjeron se ata që luftojnë kundra meje janë një organizatë e fshehtë ateiste dhe një grup prej organizatës së komunistëve të cilët janë bashkuar me atë organizatë. Këta kanë arritur të kapin pozita zyrtare të rëndësishme në shtet, dhe tani po më sulmojnë dhe konfrontohen me mua. Ndërsa qeveria, ose nuk i njeh ata, ose i lejon. Sa çudi! Si do të mund të ishte një krim të kritikosh e të mos duash një njeri i cili e ka kthyer xhaminë e Aja Sofias në një shtëpi idhujsh, e cila është një qendër e përjetshme krenarie për një komb heroik, dhe një dekoratë e ndritshme në botë duke treguar shërbimin dhe xhihadin e tij në rrugën e Kur’anit dhe që është një dhuratë përkujtimore e çmueshme prej dhuratave të shpatave të paraardhësve të saj guximtare... që e ka kthyer atë në shtëpi idhujsh dhe që e ka kthyer zyrën e Shejhul-Islamit në shkollë të mesme për vajza?

• • •

[Ky paragraf është më i fuqishmi për të cilin gjykata mendoi se kjo do të zbriste dënimin mbi Saidin.]

Është fjala të cilën e lëshoi Saidi në gjykatën e Denizlit kundra armiqve të tij të fshehtë, veçse ama gjykata e kuptoi gabim, madje tërësisht gabim, sikur ai paragraf të ishte krejtësisht kundra shtetit dhe qeverisë, dhe e shfaqi si shkak për të dhënë dënimin mbi mua.]

Ai i quajti disa ligje të reja të shtetit, i cili ka kryer reformat, “Detyrim arbitrar për llogari të mosbesimit”; e ka quajtur republikën “Despotizmi absolut”; e ka quajtur regjimin “apostazi absolute”, dhe i ka quajtur komunizmin dhe civilizimin “shthurje absolute”.

• • •

[Një pjesë e shkruar me admirim e vlerësim në vendimin e gjykatës.]

Ai përmend: ***Të shkruarit e Risale-i Nurit ka dobi e përfitime të shumta si për këtë botë ashtu edhe për tjetrën: këto janë:***

1-Xhihadi *maënevij* -xhihadi i fjalës- kundra njerëzve të çudhëzimit.

2-Ndihmesa për profesorin në përhapjen e të vërtetave

3-Shërbimi ndaj myslimanëve lidhur me besimin.

4-Përfitimi i dijes nëpërmjet penës.

5-Kryerja e një ibadeti reflektiv, një orë e të cilit është ndonjëherë i barasvlefshëm me një vit ibadeti.

Gjithashtu ai ka pesë lloje prej dobive të kësaj bote:

1-Bereqet në rizk-furnizim.

2-Lehtësi e kënaqësi në zemër.

3-Lehtësi e bollëk në mjetet e jetesës.

4-Sukses në punë.

5-Pjesëmarrja në duatë e të gjithë studentëve të Risale-i Nurit për fitimin e vlerës së studentit të dijes.

Të rinjtë e universitetit do t'i kuptojnë së shpejti këto çështje, dhe universiteti do të transformohet në një shkollë të Risale-i Nurit.

• • •

[Është e çuditshme që ky vetëflijim i pastër të konsiderohet mëkat e krim.]

Njëri nga dy planet e ndjekur prej hipokritëve të fshehur: Është të shkatërrojnë emrin tim të mirë, sikur vlera e dritave të Risale-i Nurit do të zhvlerësohej e përçmohej.

I Dyti: Është shkaktimi i shqetësimit dhe i tronditjes tek studentët e Risale-i Nurit, sikur ata me këtë pengojnë përhapjen e Risale-i Nurit.

Mos u shqetësoni, o vëllezërit e mi! Le të sakrifikohen kokat tona, kokat e ne të mjerëve, për një të vërtetë të shenjtë për të cilën janë sakrifikuar gjithashtu me miliona koka heroike!

• • •

[Është e çuditshme por parathënia dhe lavdërimi i Hasan Fejziut është më e sinqerta dhe krejtësisht e vërtetë, e cila ishte e përputhshme me realitetin dhe aspak e dëmshme por me dobi të madhe për shumë njerëz; u tha se ajo përbën një akt të dënueshëm, dhe qënia e saj e përfshirë tek fundi i njërit prej koleksioneve të Risale-i Nurit, u dha si arsyeja për konfiskimin e trajtesës.]

Hasan Fejziu shkroi një letër, një përmbledhje e së cilës është kjo:

"O Risale-i Nur! Nuk ka dyshim se ti je gjuha e së vërtetës dhe inspirim -ilham- prej të Vërtetit, dhe je shkruar me lejen Tij. "Unë nuk jam prona e askujt. Unë nuk jam marrë prej asnjë libri, unë nuk jam vjedhur prej asnjë vepre. Unë i përkas Krijuesit dhe Kur'anit. Unë jam një dritë e mrekullueshme që lëshohen nga një vepër e pavdekshme. Ti je libri më vezullues i të vërtetës dhe i mëshirës. Ti e zbukuron dhe e nderon ndonjë prej studentëve të tu të sinqertë e të veçantë me dekoratat e shenjtërisë dhe të dijetarëve të pastër. Për më tepër, trajtesat e tua nuk kanë hyrë nëpër gjykata si një kriminel apo i dyshuar, por si një mësues, instruktor dhe udhëzues. Në çdo seancë gjyqi ti ke shfaqur në mënyrë të shkëlqyer e brilante forcën dhe fuqinë tënde, madhështinë dhe krenarinë tënde. Ti i ke lagur dhe i pastruar ata me ujin e besimit dhe të Kur'anit.

"O Ustadh, shërbëtori dhe interpretuesi i Risale-i Nurit! O Ustadh, shërbëtori i Zotit, o djali shpirtëror i imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur prej Tij, dhe o nxënësi i Gauth El-Aëdham, iu shenjtëroftë sekreti! Ngremë mua tek shkalla e lartë e njohjes tënde!" Vetëm sa vlera e një muaji prej furnizimeve, rreth një kilogram, e mbështjellur në letër dhe e varur nga një gozhdë. Ai arriti tek një ekzistencë e pashtershme brenda privimit të tij. Ai hoqi dorë prej pranimit të dhuratave.

Në qoftë se ai do të kishte pranuar sadeka e lëmosha, ai do të kishte qenë milioner sot".

[Ata pyetën vetëm për njërën prej nëntë arsyeve për emërimin e Risale-i Nurit me këtë emër. Ata thanë se nuk kishin parë asnjë me emrin e Nurit midis studentëve të tij të afërm e të dalluar. Dhe ashtu siç u përgjigjëm ne për këtë në shënim, Nuri Benli dhe Kyreli Nuri Orëndreqësi janë tashmë nga të dalluarit në shërbimin e Risale-i Nurit. Domethënë, ata nuk mund ta kritikojnë Risale-i Nurin, kështu detyrohen t'i mbështesin pretendimet e tyre mbi çështje e pretekste të parëndësishme e të pjesshme.]

Ai përmend në Fjalën e Njëzet e Gjashtë:

Arsyeja pse Tridhjetë e Tre Fjalët, Tridhjetë e Tre Letrat, Tridhjetë e Një Shkreptimat dhe Trembëdhjetë Rrezet janë quajtur Risale-i Nur është kjo: Gjatë gjithë jetës sime Fjala *Nur –Dritë*- më ka konfrontuar në çdo vend. Për shembull, fshati im quhet Nurs. Emri i nënës sime të ndjerë është Nurie. Njëri nga profesorët e mi në Tarikatin Nakshibendi ishte Sejjid Nur Muhammed; njëri prej profesorëve të mi në Tarikatin Kaderi ishte Nureddin. Njëri prej profesorëve të mi në Kur'an quhej Nuri. Dhe prej studentëve të mi ata që janë të lidhur më shumë me mua kanë qenë ata me emrin Nuri. (Por sa e çuditshme është që nuk ndodhet asnjë prej studentëve të dalluar me Emrin Nuri). Dhe ajo që sqaron dhe i ndriçon më shumë librat e mi janë krahasimet rreth dritës. Dhe ajo që i ka zgjidhur vështirësitë e mia më të mëdha lidhur me të vërtetat Hyjnore është Emri ***En-Nur*** *Drita* prej Emrave të Bukur Hyjnorë.

Dhe për entuziazmin tim të fortë ndaj Kur'anit dhe për përkufizimin e shërbimit tim në të, imami im i veçantë është Hazreti Uthman Dhun-Nurejni, Zoti qoftë i kënaqur prej tij.

• • •

[Trajtesa "Huxhumat-i Sitte" "Gjashtë Sulmet" dhe shtojca e saj qenë shkruar para njëzet vitesh për të përballuar agresionin e tmerrshëm e tiran. Dhe ajo është një trajtesë tepër private dhe e fshehtë, dhe ka kaluar nëpër duart e gjykatave të shumta. Ajo u shkrua kur unë isha shumë i zemëruar dhe gjatë Luftës së Dytë botërore; të gjitha ato e justifikojnë zemërimin. Kështu konsiderohet të jetë shumë larg çdo drejtësie ta shohësh atë si një krim, sikur ajo të ishte shkruar tani, dhe ta konfiskosh.]

Parathënia e Shtojcës 'Gjashtë Sulmet' fillon me sa vijon:

"Kjo shtojcë u shkrua me qëllim që të shmangë fyerjet, zemërimin dhe urrejtjen që do të na bëhen neve në të ardhmen. Domethënë, ajo u shkrua se kur të thuhet: "Shikoni njerëzit qullashë të asaj kohe!", pështima e fyerjeve të tyre të mos bie në fytyrat tona, ose ndryshe që ta fshijë, ta heqë prej tyre. U shkrua ky raport dhe kjo listë që të kumbojnë veshët e udhëheqësve të Europës, barbarëve të fshehur nën maskat humanitare! Dhe u ngultë kjo në sytë e verbër të atyre shtypësve të padrejtë e pa ndërgjegje të cilët bënë të na sundojnë këta tiranë tradhtarë.

Është një peticion me të cilin të goditen si me çekan kokat e ndjekësve të civilizimit të ulët, i cili i ka shkaktuar njerëzimit në këtë

shekull dhimbje të skëterrshme, saqë ai bërtet në çdo vend duke thënë: Rroftë Ferri!

“Në periudhën e fundit, agresionet e fshehura të ateistëve të maskuar kundra të drejtave të besimtarëve të mjerë dhe kundra fesë kanë marrë formën më të shëmtuar tiranike. Unë do të veçoja duke përmendur agresionin e tyre ndaj meje, duke provokuar xhaminë time private të cilën e riparova vetë, dhe isha në te me disa shokë të dashur; u bë thirrja për ibadet dhe e kryem ezanin dhe ikametin në mënyrë të fshehtë. Ndërkohë na u tha: Përse e bëni ikametin e namazit në gjuhën arabe fshehurazi? Durimi im u sos duke qëndruar i heshtur: Dhe ja, unë nuk u drejtohem këtyre njerëzve të ulët që u ka vdekur ndërgjegjja, meqë këta nuk janë të meritueshëm për adresim, por unë do t’u drejtohem atyre udhëheqësve si faraonë të cilët me despotizmin e tyre arbitrar luajnë me fatet e këtij kombi. Unë u them atyre: O njerëzit e ateizmit dhe të bidatit që jeni shmangur nga rruga e drejtë e fesë, unë ju kërkoj juve t’u përgjigjeni gjashtë pyetjeve.

Pyetja e Parë: Çdo qeveri në botë, çdo popull që sundon, madje edhe kanibalët -njeringrënësit- edhe drejtuesit e grupeve të banditëve, kanë disa parime, disa ligje, në përputhje me të cilat ata sundojnë.

Kështu, në përputhje me çfarë parimi e ndërmerrni këtë agresion të jashtëzakonshëm? Hë, na e shfaqni atë ligj! Apo mos vallë ju i pranoni si ligj tekat e një numri prej zyrtarëve të përbuzur? Sepse nuk ka ligj në botë që të lejojë ndërhyrjen në një adhurim privat personal; nuk mund të jetë një ligj i tillë.

• • •

[Është për të të ardhur keq se ata morën një ose dy fjali prej trajtesës “Shtatë Shenjat” si pretekst për ta konfiskuar dhe si provë kundra nesh, ndonëse ajo ishte një trajtesë e vjetër, private dhe e fshehtë. Por ajo përmban një të vërtetë të fuqishme e të fortë dhe meriton të shpallet për të gjithë botën e njerëzimin për të mirën e jetës shoqërore.]

“Idioti më i madh në botë është ai i cili pret progres, mirëqënie dhe lumturi prej ateistëve anarkistë si këta. Njëri prej këtyre idiotëve, i cili ka zënë një pozitë të rëndësishme, tha: Ne mbetëm prapa për shkak të thënies sonë: All-llah, All-llah... Ndërsa Europa përparoi për shkak të fjalës së saj: Pushkë dhe artileri!

“Në përputhje me rregullin, “një idioti duhet t’i përgjigjesh me heshtje”, përgjigja për njerëz të këtillë është heshtja. Por për shkak se prapa disa idiotëve janë ata njerëz të zgjuar fatzinj të cilët i ndjekin, ne themi këtë:

“O ju fatzinj! Kjo dynja është një bujtinë. Çdo ditë me kufomat e tyre, tridhjetë mijë dëshmitarë vendosin firmat e tyre për dekretin “Vdekja është realitet” dhe e dëshmojnë këtë pohim. A mund ta vrisni ju vdekjen? A mund t’i kundërshtoni këta dëshmitarë? Meqenëse ju nuk mundeni, atëherë vdekja i bën njerëzit të thonë: Allah, Allah”.

Cila nga pushkët dhe artileritë tuaja mund t’i japë dritë errësirës së përhershme që e konfronton njeriun në agoninë e vdekjes në vend të fjalës “Allah, Allah”, dhe ta transformojë dëshpërimin e tij absolut në shpresë absolute? Meqenëse ka vdekje dhe ne do të hyjmë në varr, dhe kjo jetë ikën dhe një jetë e përhershme vjen, atëherë në qoftë se do të thuhej njëherë “Pushkë dhe artileri!”, duhet medoemos të thuhet një mijë herë, “Allah, Allah.”

• • •

[Është e çuditshme, një fjali prej “Shkreptimës së Gjashtëmbëdhetë” ndërsa është në favorin tonë, ata e kthyen në një fjali kundra nesh, dhe shfaqën dëshirën për ta konfiskuar atë trajtesë të çmueshme.]

Nga Shkreptima e Gjashtëmbëdhjetë: “Sa për fatkeqësinë e luftës, ajo do t’i shkaktonte një dëm të madh shërbimit tonë ndaj Kur’anit. Sepse ashtu si i Gjithëfuqishmi i Gjithëlavdishëm i Cili e pastron atmosferën e mbushur me re për një minut dhe e shfaq diellin rrezatues në qiejt e qartë, po ashtu Ai xh.sh. mund t’i largojë këto re të zeza e të pamëshirshme dhe t’i shfaqë të vërtetat e Sheriatit si dielli ndriçues me të gjithë lehtësinë dhe pa humbje. Ne e presim këtë nga mëshira e Tij e gjërë. Dhe i lutemi Atij që të mos na i shesë neve shtrenjtë ato. Dhe i lutemi që t’u japë mendë kokave të udhëheqësve dhe t’u japë besim zemrave të tyre. Kjo do të ishte e mjaftueshme; dhe atëherë do të ndreqeshin e drejtoheshin vetë çështjet”. “Meqenëse ajo që mbani në dorën tuaj është dritë; dhe jo një topuz, dhe drita as nuk mund të kundërshtohet dhe as nuk mund të iket prej saj, dhe asnjë dëm nuk vjen prej shfaqjes së saj; atëherë përse i porosisni shokët tuaj të marrin masat e të jenë të kujsesshëm dhe i pengoni ata që të shfaqin trajtesa të ndritshme të shumta të Risale-i Nurit për të gjithë njerëzit?

Përmbajtja e përgjigjes së kësaj pyetje në mënyrë të përmbledhur është kjo: “Kokat e shumicës së atyre që janë në krye janë të dehura

dhe ato nuk mund t'i lexojnë. Madje edhe në qoftë se do t'i lexonin, ata nuk mund t'i kuptojnë ato; ata u japin atyre kuptim të gabuar, dhe ndërhyjnë e sulmojnë; dhe me qëllim që ata të mos sulmojnë, ato nuk duhet që t'u tregohen derisa ata të vijnë në vete.

Prandaj, unë i këshilloj vëllezërit e mi të jenë të vëmendshëm dhe të mos ua japin të vërtetat atyre që janë të papërshtatshëm...

• • •

[Megjithëse *Hixhabi* -mbulesa e grave- është një urdhër Kur'anor, dhe një përgjigjje shumë e fuqishme është dhënë lidhur me të në Risale-i Nur, dhe kjo trajtesë është shkruar para një kohe të gjatë, dhe një dënim me burg është kryer për të, ata përsëri e konsideruan atë si një krim që e kemi kryer dhe si një provë kundra nesh. Ata gjithashtu duke e cilësuar si një akt të dënueshëm dhe si pretekst për ta konfiskuar fillimin e një të vërtete të madhe e cila erdhi në 'trajtesën e të moshuarve' dhe tek 'Udhëzuesi për të rinjtë' atë të vërtetë të vlefshme e të dobishme për të gjithë njerëzit; e gjitha kjo tregon se ata janë të pamundur të gjejnë ndonjë gjë për ta kritikuar e për ta plagosur.]

Në Shreptimën e Njëzet e Katërt, pas shpjegimit se Hixhabi është një urdhër Kur'anor, ai thotë: Fakti se, sipas njoftimeve të dëgjuara, gruas kokëzbuluar të një njeriu me pozitë të lartë në botë iu afrua një llustraxhi i rëndomtë këpucësh mu në kryeqytetin e vendit Ankara, në treg në mesditë para gjithkujt, -ky akt i pahijshëm- jep një goditje në fytyrat e paturpshme të atyre që kundërshtojnë mbulesën e grave!

Ndërsa në Shkreptimën e Njëzet e Gjashtë, rreth të moshuarve, thotë: "Në një ditë prej ditëve të fundit të vjeshtës, u ngjita në majen e kështjellës së Ankarasë, të cilën e ka goditur pleqëria dhe rrënimi më shumë se sa mua. Ajo u duk para meje si të ishte formuar prej ngjarjeve historike të gurëzuara. Pleqëria e stinës së vitit së bashku me pleqërinë time, plakja e kështjellës dhe pleqëria e Shtetit të lavdishëm Osman, dhe vdekja e sundimit të kalifatit, dhe pleqëria e dynjasë, që të gjitha këto më shkaktuan mua të shikoja gjendjen më të trishtueshme, të mjerueshme dhe melankolike nga maja e asaj kështjelle të lartë për tek luginat e së shkuarës dhe për tek malet e së ardhmes... Ndërsa kërkoja ngushëllim duke parë tek ana e djathtë, domethënë tek e shkuara, babai im, stërgjyshërit dhe raca njerëzore u shfaqën në formën e një varri të madh të mbushur me errësirë; kështu e shkuara më dëshpëroi në vend që të më jepte ngushëllim e dritë.

E ardhmja m'u shfaq mua në formën e një varreze të madhe të errët për mua dhe për ata si unë të brezit të ardhshëm; edhe kjo më tmerroi në vend që të më jepte ngushëllim.

Pastaj hodha vështrimin tek koha ime e tanishme, ajo m'u shfaq si një arkivol duke mbajtur trupin tim të vuajtur, të dëshpëruar e të sfilitur si i theruri mes vdekjes dhe jetës.

• • •

[Ndërsa duhej që ta vlerësonin siç duhet këtë fjali, ata e kritkuan atë dhe e morën si një provë kundra nesh.]

Ai përmend: Unë e shpenzova shumicën e rrogës që e kam marrë prej Darul-Hikmeh el-Islamij-jeh, dhe vura mënjanë një sasi të vogël për të shkuar në Haxh. Nëpërmjet bereqetit që shkaktohet prej kursimit dhe vetëmjaftueshmërisë, ajo sasi e pakët parash ishte e mjaftueshme për mua. Ajo më ndaloi nga të qenurit i poshtëruar. Dhe akoma ka mbetur diçka prej asaj shume të bekuar parash".

Pastaj, në Shkreptimën e Njëzet e Dytë pasi tregon se ajo është një trajtesë private e fshehtë për vëllezërit e tij besnikë e të sinqertë, thotë:

Treguesi i Parë: Përse njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje ndërhyjnë tek çështjet e Ahiretit tënd sa herë që u jepet rasti, ndonëse ti nuk ndërhyn në çështjet e dynjasë së tyre?... Ajo që duhet t'i përgjigjet kësaj pyetjeje janë autoritetet e provincës së Ispartës dhe njerëzit e saj".

• • •

[Ata të cilët e vlerësojnë si krim këtë shpresë të sinqertë e të çuditshme dhe këtë dëshirë të pastër që burojnë nga besimi, sigurisht ata janë pikërisht fajtorët.]

Në një letër të nënshkruar me emrin Said, përmendet: "Unë çuditesha prej fëmijëve të pafajshëm, mosha e të cilëve ishte nga shtatë deri në dhjetë vjeç të cilët vraponin pas meje kur më shihnin mua duke ngarë një pajton, dhe ata më mbanin për duarsh, isha kureshtar ta dija arsyen. Pastaj, papritmas m'u shfaq mua se "me një parandjenjë për të ardhmen, grupi i këtyre fëmijëve të pafajshëm parandjenë se nëpërmjet Risale-i Nurit ata do të gjenin lumturi dhe do të ishin të shpëtuar prej rreziqeve shpirtërore.

• • •

Ta gjykosh këtë pjesë si një krim ndonëse fillimi është në favorin tim dhe fundi është një dëshirë e një shpresë, do të ishte përtej të gjithë drejtësisë -paanshmërisë.]

Përmendet se, "një numër vërsetesh dhe hadithesh aludojnë unanimisht për një të vërtetë të ndritshme në këtë shekull, dhe shfaqin *Muxheddidin* -Ripërtëritësin- më të madh i cili do të vijë në fund të botës; dhe se detyra më e rëndësishme prej tre detyrave të tij të mëdha është shpëtimi i Imanit", dhe përmend se rigjallërimi i sheriatit, vendosja e kalifatit si dhe gjëra të tjera të ngjashme me to janë prej detyrave të mëdhaja e të gjithanshme të një sfere shumë të gjërë, dhe se nuk do të kishte dëm në mospërmendjen e tyre ato dy detyrat -të cilat do ta dominojnë atë sferë të gjërë- pasi kjo do t'i bënte kundërshtarët e Risale-i Nurit, dhe veçanërisht politikanët, që ta kritikonin e ta sulmonin; prandaj disa fjali të hiqen, dhe disa të korrigjohen e modifikohen, dhe do t'i dërgojë ato tek vëllezërit e tij të përpiktë e verifikues.

Dhe në një letër të nënshkruar, Said Nursi shkruan: "Fakti se vërsetet *"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty fitore të qartë",* dhe *"Edhe që Allahu të të japë ndihmë të madhe pa kufi"*[252] në shkrim Kur'anor që ndodhen mbi portën e jashtme të ndërtesës së ministrisë së luftës, e cila u shndërrua në universitet, -fakti se qenë mbuluar me pllaka mermeri dhe tani kanë dalë në dritë, kjo është një shenjë për lejimin përsëri të shkrimit Kur'anor, një mjet për përdorimin e shkrimit Kur'anor që e synon Risale-i Nuri, dhe gjithashtu ajo është një shenjë se universiteti do të transformohet në një medrese të Risale-i Nurit."

• • •

[Ky është shënimi i Husrevit tek fundi i letrës sime të titulluar "*Tekbiret e Haxhillarëve*", e cila jep një përgjigje të plotë ndaj kritikave për shpjegimet e mia.]

Në letrën e nënshkruar nga Said Nursi, me titullin *"Tekbiret e Haxhillarëve në Arefat*", është përgjigjja ndaj një numri të rëndësishëm prej studentëve të Risale-i Nurit të cilët pyesin me ngulm rreth një udhëheqësi të shquar prej Ehli-Bejtit -Familjes së Profetit, i cili do të vijë në fund të kohës; ata supozojnë se je ti ai personalitet. Por ti, refuzon me ngulm për t'i pranuar idetë e tyre, dhe ikën prej një sugjerimi të tillë. Kjo është një kontradiktë. Ne dëshirojmë përgjigjje për këtë çështje".

---

[252] Kur'an, 48: 1, 3

Përgjigjja: Personaliteti kolektiv i komunitetit të shenjtë të cilin do ta përfaqësojë Mehdiu i pritur prej të Dërguarit të Zotit do të ketë tre detyra: të shpëtojë imanin, rigjallërimi i shenjave islame me emrin e kalifatit Muhammedan, dhe ai personalitet do të orvatet ta përmbushë këtë mision duke parë mosveprimin e shumë dekreteve të Kur'anit dhe të ligjeve të Sheriatit Muhammedan. Meqenëse Studentët e Risale-i Nurit e shohin detyrën e Parë në mënyrë të plotë në Risale-i Nur, duke thënë se detyrat e dyta dhe e treta janë në vendin e dytë e të tretë, ata me të drejtë mendojnë se personaliteti kolektiv i Risale-i Nuri është një lloj Mehdiu.

Meqenëse disa prej tyre e supozojnë këtë interpretuesin e dobët të tij të jetë përfaqësuesi i atij personaliteti kolektiv, ata ndonjëherë e thërrasin atë me të njëjtin emër. Madje një grup prej Evlijave shohin në kerametet e tyre prej së padukshmes se Risale-i Nuri është Mehdiu i kohës së Fundit dhe pikërisht udhëzuesi i saj; ata thonë: kjo çështje kuptohet nëpërmjet interpretimit, verifikimit dhe hulumtimit. Por ndodhet një konfuzion në dy pika, dhe ato duhet patjetër të interpretohen.

E Para: Dy detyrat e fundit, pavarësisht se nuk janë të së njëjtës rëndësi apo shkallë me detyrën e parë nga këndvështrimi i realitetit, por ama kalifati Muhammedan dhe Uniteti islamik tek masat e njerëzve, tek politikanët dhe sidomos tek ata që janë ndikuar prej ideve të këtij shekulli -këto dy detyrat e fundit janë- një mijë herë më të rëndësishme se sa detyra e parë.

Pavarësisht se Allahu dërgon në çdo shekull një Mehdi dhe një udhëzues, dhe në fakt janë dërguar, veçse ama atyre nuk u është dhënë titulli i Mehdiut të Madh të fundit të kohës pasi ata kryen vetëm njërën prej atyre tre detyrave e funksioneve.

E Dyta: Ai person i madh i cili do të shfaqet në Fundin e kohës do të jetë nga Ehli-Bejti, dhe unë edhe në qoftë se do të isha si djali shpirtëror i Hazreti Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, meqë kam marrë prej tij mësimin e Hakikatit, dhe meqenëse në një sens Ehlibejti -Familja e Profetit Muhammed a.s.m.- i përfshin studentët e vërtetë të Risale-i Nurit, dhe nga ky aspekt konsiderohem prej Risale-i Nurit, por ama nuk është e lejueshme në metodën e Risale-i Nurit të dëshirosh ndonjë lloj egoizmi ose personaliteti, ose rang personal ose të fitosh famë apo emër. Madje edhe në qoftë se do të më jepeshin rangje Ahireti, unë do ta shihja veten time të detyruar që t'i lija ato me qëllim që të mos prishja sinqeritetin e Risale-i Nurit...

Një përgjigjje gjysëmpranimi për temën u dha[253], pasi nuk ka ndonjë refuzim të prerë apo mospranim serioz për këtë çështje të Mehdiizmit".

• • •

[Ngjarjet në këtë pjesë janë fakte, dhe meqenëse në mënyrë të jashtëzakonshme, tre minuta pas thënies sime: Mos më shqetësoni, sepse toka do të zemërohet me ju", ra një tërmet; Duhej që ata ta merrnin këtë çështje seriozisht dhe ta miratonin këtë çështje me habi, ashtu siç kërkohet nga dhembshuria, dhe jo ta bënin objekt kritite.]

Thuhet: "Dhjetë orë pasi kisha dhënë deklaratën time për katër orë dhe duke vuajtur shqetësime të shumta, pothuajse në të njëjtën kohë shpërtheu zjarri në ministrinë e Arsimit, gjë e cila shkaktoi një humbje me vlerën e dy milion lirave dhe demonstroi se Risale-i Nuri është një mjet për të zmbrapsur fatkeqësitë. Sepse në qoftë se ai sulmohet, fatkqesitë gjejnë një rrugë dhe godasin e bien".

Dhe në letrën me numër njëqind e dyzet e një, ajo provon se zjarri në ministrinë e Arsimit në Ankara dhe në garazhin e Makinave, dhe në një fabrikë në Izmir, dhe në një ndërtesë të madhe në Adana duke u djegur krejtësisht pasi unë kisha dhënë deklaratën për katër orë e gjysëm, këto ngjarje nuk mund të ishin rastësi, atëherë përmend fjalën e tij: Mos më privoni prej trajtesave, ose përndryshe do të ishte një humbje e madhe për mua dhe për këtë vend, dhe toka zemërohet e indinjohet me tërmete", dhe tre minuta pas kësaj fjalës së tij ra tërmeti dhe zgjati tre sekonda, dhe demonstroi kështu zemërimin e tokës, dhe shpërtheu zjarri në ministrinë e arsimit në kohën kur sulmohej Risale-i Nuri dhe studentët e tij. Disa tërmete kanë koinçiduar me agresionin kundra Risale-i Nurit dhe studentëve të tij; ashtu siç është provuar katër herë nga gjykatat, ngjarje të tilla nuk mund të jenë rastësi. Ngjarje të shumta kanë treguar se Risale-i Nuri është një mjet për të zmbrapsur fatkeqësistë në këtë vend".

Në letrën me numër njëqind e dyzet e shtatë: "Këtë herë, dimri shfaqi zemërimin e tij të tërbuar në kohën kur u sulmuam. Moti shpërtheu me stuhi dhe me të ftohtë të hidhur, por kur sulmet ndaluan ndaj Risale-i Nurit dhe ndaj studentëve të tij, dhe kur ata studentë përjetuan një lloj kënaqësie e lehtësie, ato ditë me të ftohtë të hidhur acar filluan të buzëqeshin si në ditët e para të pranverës.

---

[253] O gjykatë e padrejtë! A do mund të ketë ndonjë përgjigjje më vendimtare se sa kjo?

Nënshkroi Husrevi në emër të studentëve të Risale-i Nurit.

Zjarri që shpërtheu në ministrinë e arsimit është një goditje e fuqishme.

• • •

[Situata që duhet të bekohet e përshëndetet, nuk duhet të shihet me sy kundërshtimi.]

Njëra nga pyetjet e shumta të pakuptimta që ato më pyetën këtë herë në gjykatë, ishte: "Me çfarë jeton ti", unë u thashë: Me bereqetin e kursimit". Një person që në një muaj Ramazani në Isparta jetoi me një çyrek buke, me një kilogram kos dhe me një kilogram oriz nuk do ta ulte e poshtëronte veten për dynjanë për mjetet e jetesës dhe nuk do të detyrohej të pranonte dhurata".

• • •

[Si me mbrojtjen që Zybejri[254] e lexoi në gjykatë, lavdërimi i tij brilant i shtyu ata që ta vlerësonin atë me lejen e Zotit, saqë me çudi e përfshinë atë në vendim.]

Një pjesë me titullin: "Rinia jonë kërkon t'iu mësohet e vërteta dhe realiteti, dhe të kenë moralin më të lartë", në faqen e dhjetë Zyjber Gündÿzalp shkroi me makinë shkrimi: "Risale-i Nuri i cili i shpëton myslimanët e shekullit të njëzet dhe të gjithë njerëzimin prej ideve të errëta e shtypëse, nuk u shkrua nëpërmjet dëshirës së autorit dhe nuk ishin mendimet e tij, por Risale-i Nuri është *Ilham* -inspirim- që e lëshoi Zoti i të gjitha botëve në zemrën e autorit; dhe ato janë trajtesa të larta e të çmuara".

Në faqen e dymbëdhjetë erdhi sa vijon: "Në qoftë se do t'i thuhej një studenti që shërben në fushën e Risale-i Nurit: "Kopjoji këto libra në vend të Risale-i Nurit, dhe unë do të të jap të gjithë pasurinë e "Fordit", ai do të përgjigjej para se ta ngrejë majën e penës së tij prej shkrimit të trajtesave të Risale-i Nurit: Edhe sikur të më jepnit të gjithë pasurinë e botës si dhe të gjithë sundimin e saj, unë nuk do ta pranoja atë".

Në faqen pesëmbëdhjetë: "Në qoftë se shkalla e lidhjes sonë me autorët e ndershëm do të ishte njëqind shkallë, atëherë shkalla e lidhjes

[254] Zÿber Gündÿzalp (1920-1971) u lind në provincën e Konias dhe u bë një student i Bediuzzamanit ndërsa punonte si një telegrafist për zyrën e postës, dhe më vonë u bë njëri prej studentëve të tij më të afërm. Ai u bë njëri prej figurave kryesuese të lëvizjes pas vdekjes së Bediuzzamanit. Përkthyesi

sonë me një personalitet të madh si Bediuzzamani i cili na udhëzon për tek lumturia e dynjasë dhe e Ahiretit është miliona e miliona herë, madje e pafund.

Në faqen dymbëdhjetë: "Personaliteti kolektiv i Risale-i Nurit ka diagnostikuar sëmundjet sociale, shpirtërore dhe fetare të këtij shekulli, dhe përkujdesja Hyjnore ua ka afruar të gjithë njerëzimit në këtë kohë të vërtetat e Kur'anit të gjithurtë në një mënyrë që do t'i kuronte të gjitha sëmundjet shoqërore kronike me ilaçet që burojnë prej të vërtetave të Kur'anit.

Në faqen dyzet e katërt: Bediuzzamani ka thënë: "Kush i lexon këto trajtesa të Risale-i Nurit për një vit të plotë, mund të jetë dijetar i madh në këtë kohë. Po, ashtu është".

Në faqen pesëdhjetë e katërt: "Gjykatësit që e studiojnë Risale-i Nurin nuk nxjerrin vendime të pagoditura -të pasakta."

• • •

[Kjo pjesë është krejtësisht në favorin tim dhe është e vërtetë e saktë, dhe nuk duhet të jetë përfshirë me shkeljet në vendimin e gjykatës.]

Ahmed Fejziu ndreqi një pjesë të veprës së tij, por duke iu dashtë të nxitonte, ai e dërgoi atë pa plotësimin e korrektimeve. Në të, thuhet: A nuk nënkuptohet se duke lënë Saraçoglun, i cili e quan fenë dhe edukimin Muhammedan "helm" dhe duke kundërshtuar trajtesën "Llamba ndriçuese" e cila e demonstron realitetin Kur'anor aq qartë si dielli dhe e provon atë të jetë kurimi i plotë për plagët e njerëzimit, - a nuk nënkupton që ju po ndihmoni për konfiskimin e atij koleksioni?"

Thuhet sa vijon në njërën prej Fjalëve të Mbrojtjes, e paraqitur në gjykatë në një datë të panjohur. Ai deklaroi se as ai vetë dhe as studentët nuk ishin preokupuar me politikë; Shkrimet që shfaqën të jenë agresive ishin private; kishte liri mendimi dhe ndërgjegjeje; madje edhe në qoftë se ajo lart u shfaq të jetë kritike për ndonjë ligj, megjithatë kjo nuk përbën një krim; shumë prej trajtesave nën shqyrtim kanë qenë shkruar para një kohe të gjatë në të shkuarën; ato janë shqyrtuar nga komitetet e ekspertëve dhe janë gjetur të jenë të padëmshme; ashtu siç ka pasë më parë akuza për to në gjykatën e Eskishehirit, po ashtu ato kanë marrë pafajësinë në gjykatën e Denizlit; prandaj nuk është e drejtë që ato të gjykohen përsëri për të njëjtën shkelje; studentët e Risale-i Nurit deri tani nuk janë përfshirë në asnjë aktivitet që do të prishte rendin publik; dhe se meqenëse asnjë nuk

është emëruar qartë në Rrezen e Pestë dhe qëllimi i saj ishte vetëm për njoftim, kjo gjithashtu nuk përbën krim. Shembuj të tjerë mund të mendohen në të njëjtën mënyrë.

Said Nursi

• • •

Për Kryesinë e Gjykatës së Apelit

[Përsëri ata nuk më lejuan të flas në seancën e gjyqit që u zhvillua në gjykatën e apelit për të diskutuar mundësinë e shfuqizimit të vendimit të padrejtë kundra nesh që e nxori gjykata e Afjonit. Gjithashtu ata nuk lejuan asnjë që të vinte për të më ndihmuar me shkrimin. Pavarësisht shkrimit tim të keq me dorë dhe që isha i sëmurë, këtë ankesë që e shkrova ndërsa jam i sëmurë unë e paraqes tek gjykata juaj -e cila ka vepruar me drejtësi dy herë më parë ndaj nesh- si një shtojcë për peticionin tim lidhur me apelin.]

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Ky është një peticion për Gjykatën më të madhe të Ringjalljes, dhe një ankesë për tek Gjykata Hyjnore, dhe le ta dëgjojë atë gjykata e apelit në kohën e tanishme dhe brezat e ardhshëm në të ardhmen dhe le ta dëgjojnë profesorët e universitetit dhe studentët e tij të kulturuar. Prej qindra torturave dhe fatkeqësive që kam vuajtur gjatë këtyre njëzet e tre viteve, unë kam zgjedhur dhjetë prej tyre për t'i paraqitur tek drejtësia e Gjykatës Hyjnore të Zotëruesit të lavdisë, Sundimtarit Absolut -duke ia paraqitur Atij ankesën.

E Para: Pavarësisht gabimeve të mia, unë ia kam dedikuar jetën time lumturisë së këtij kombi dhe për shpëtimin e besimit të tij fetar. Duke thënë, le të sakrifikohet koka ime për një të vërtetë, domethënë, për të vërtetën e Kur'anit, për të cilën janë sakrifikuar me miliona koka heroike, unë kam punuar me Risale-i Nurin me të gjithë fuqinë time. Nëpërmjet ndihmës Hyjnore, unë kam përballuar torturat më mizore, dhe nuk jam tërhequr.

Për shembull, një shembull prej trajtimit tepër mizor që kam vuajtur e përballuar në gjykatën dhe në burgun e Afjonit: Megjithëse tre herë, dhe në çdo herë afërsisht dy orë, ata më detyruan mua dhe studentët e pafajshëm të Risale-i Nurit të cilët prisnin ngushëllim prej

drejtësisë së gjykatës të dëgjonim fletakuzën e mbushur plot shpifje, ata nuk na lejuan neve më shumë se një ose dy minuta që të mbronim të drejtat tona, pavarësisht kërkesave të mia të përsëritura për pesë ose dhjetë minuta.

Megjithëse u mbajta për njëzet muaj në një izolim të plotë, ata nuk lejuan asnjë për të më vizituar e për të më parë përveçse dy ose tre shokëve vetëm për një kohë tre ose katër orë. Kjo vizitë më ndihmoi vetëm për një pjesë të vogël në shkrimin e mbrojtjes sime. Pastaj ata i penguan edhe këta gjithashtu, dhe i trajtuan shumë keq si dhe i ndëshkuan. Ata na detyruan të dëgjonim fletakuzën pesëmbëdhjetë faqëshe të prokurorit të përgjithshëm që e kishte mbushur me gënjeshtra, me shpifje dhe me keqkuptime; saqë unë provova në të tetëdhjetë e një gabime, dhe ata nuk më lejuan që të flisja dhe të përgjigjesha. Në qoftë se do të më kishin lejuar, unë do t'u kisha thënë:

Ju mohoni fenë tuaj dhe fyeni stërgjyshërit tuaj -duke i cilësuar se ata ishin të çudhëzuar- dhe mohoni profetin tuaj a.s.m. dhe nuk i pranoni ligjet e Kur'anit Kerim; ndërsa nuk ndërhyni tek hebrenjtë, as tek të krishterit, as tek mexhusët -zoroastrianët- dhe as tek hipokritët felëshues prej anarkistëve dhe prej përkrahësve të komunizmit, dhe këtë e bëni në përputhje me lirinë e ndërgjegjjes.

Qeveria Britanike që e dimë se sa fanatike është për krishterimin dhe sa arrogante, i lejon milionat e myslimanëve që ndodhen nën sundimin e tyre ta lexojnë Kur'anin në çdo kohë dhe për të marrë mësime prej tij; këto mësime të cilat i refuzojnë të gjitha besimet e kota dhe të gjitha parimet mohuese të Anglisë. Pastaj kundërshtarët e çdo qeverie mund t'i shfaqin hapur idetë e tyre dhe mund t'i botojnë këto ide, dhe gjykatat e këtyre qeverive nuk ndërhyjnë tek ta. Ndërsa lidhur me mua, megjithëse autoritetet e Ispasrtës, Gjykata e Denizlit, Gjykata penale e Ankarasë, Drejtoria e çështjeve të fesë, dhe gjykata e apelit e cila ka hetuar dy -ose madje tre- herë, të gjitha ato gjykata i kanë hetuar e shqyrtuar me imtësi gjatë këtyre dyzet viteve të jetës sime njëqind e tridhjetë librat e mi dhe të gjitha letrat dhe trajtesat, madje edhe ato private e të fshehta -në ato gjykata. Dhe Risale-i Nuri me të gjitha kopjet e tij private dhe joprivate kanë qenë në duart e tyre për një periudhë rreth tre vite, dhe megjithatë ata nuk kanë gjetur asgjë që të kërkonte edhe dënimin më të vogël. Unë pyes: Çfarë krimi kemi bërë që ju keni dhënë këtë ndëshkim të rëndë kundra nesh dhe këtë burgosje të vetmuar pavarësisht faktit që unë jam shumë i dobët, i shtypur, i mposhtur dhe duke duruar kushtet më të vështira; çfarë ligji, dobie dhe ndërgjegje do ta pranonin këtë? Megjithëse Risale-i Nuri,

koleksionet e të cilit janë të plota para jush, është bërë një udhëzues i fuqishëm dhe drejtues për më shumë se dyqind mijë studentë të vërtetë të gatshëm për t'u sakrifikuar, dhe me këtë ato koleksione i kanë shërbyer sigurisë dhe stabilitetit të vendit. Pastaj mbrojtja ime të cilën e paraqita dhe që arrin katërqind faqe ka provuar pafajësinë tonë në mënyrë krejtësisht të sigurtë, prandaj sigurisht që ju do të pyeteni rreth kësaj në Gjyqin e Fundit.

E Dyta: Ata e konsideruan shpjegimin tim të vërseteve të Kur'anit rreth Hixhabit -mbulesës së grave-, trashëgimisë, Dhikrit për Allahun, martesën me më shumë se një grua, dhe roli im duke refuzuar fuqishëm e duke hedhur poshtë kundërshtimet e bëra ndaj tyre nga ana e civilizimit perëndimor... ata i konsideruan njërën prej akuzave të drejtuara ndaj meje.

Unë do të përsëris këtu paragrafin që e pata sjellë para pesëmbëdhjetë vitesh në gjykatën e Eskishehirit dhe pastaj në gjykatën e Apelit në Ankara.

Kjo pjesë do të jetë ankesa ime në gjykatën e gjyqit të madh të Ringjalljes dhe një paralajmërim e zgjim për grupet e kulturuar dhe për mësuesit e ndriçuar të brezave të ardhshëm; dhe do të jetë së bashku me trajtesën *El-Huxh-xhetuz-Zehra* -Prova Ndriçuese, si një lloj shtojce e peticionit tim për në gjykatën e Apelit, e cila dy herë ka vepruar me drejtësi për pafajësinë time dhe e ka dëgjuar thirrjen time për drejtësi. Gjithashtu e përsëris këtë paragraf për prokurorin e përgjithshëm i cili nuk më la rast për të folur dhe për të cilin provova tetëdhjetë gabime të përfshira në fletakuzën e tij që e kishte mbushur me gabime, dhe e paraqes përsëri për komitetin e gjykatësve të cilët nxorën vendimin për dy vjet burgim të vetmuar fillikat së bashku me dy vjet internim tjetërkund nën mbikëqyrje të afërt dhe me dy vite punë të rëndë:

Unë i them gjykatës së ministrisë së drejtësisë:

Të dënoni një person i cili shpjegon parimin më shenjtë Hyjnor i cili është pikërisht e vërteta me të cilin gjykojnë dhe në përputhje me të cilin veprojnë treqind e pesëdhjetë milion myslimanëve gjatë një mijë e treqind e pesëdhjetë viteve. Ky komentator në shpjegimin e tij mbështetet në atë që e kanë konfirmuar dhe që kanë rënë dakort treqind e pesëdhjetë mijë komentatorë, dhe ndjek besimet e paraardhësve tonë për një mijë e treqind e pesëdhjetë vite, unë them: ta dënoni këtë komentator është një vendim i padrejtë të cilin duhet ta refuzojë drejtësia; në qoftë se do të kishte ndonjë drejtësi në faqen e

tokës duhet ta shfuqizonte këtë vendim i cili dënon këtë komentator. Dhe le ta dëgjojnë këtë edhe veshët e shurdhët të shekullit tonë aktual. A nuk do të thotë se të dënosh një person i cili e ka braktisur politikën, që është veçuar prej jetës shoqërore dhe që nuk i pranon nga aspekti i logjikës dhe i shkencës, disa ligje Europiane të cilat u pranuan në këtë vend me kërkesë të disa rrethanave të caktuara -duke e dënuar atë për shkak të komentimit të disa vërseteve Kur'anore; a nuk do të thotë kjo mohim ndaj islamit dhe tradhti ndaj milionave prej stërgjyshërve tonë fetarë e heroikë dhe akuzën ndaj komentimeve të Kur'anit?

E Treta: Një arsye që ata përmendën për të justifikuar vendimin kundra nesh ishte prishja e rendit dhe e qetësisë publike. Ata bënë shpjegim të gabuar për kuptimin e disa fjalive që erdhën në disa letra personale dhe në disa trajtesa private që nuk kalojnë më shumë se pesëdhjetë fjali, ndonëse Risale-i Nuri përmban më shumë se njëqind mijë fjalë e fjali, dhe ata shikuan një mundësi të vogël e shumë të largët që nuk kalonte as një përqind dhe madje as një në një mijë, dhe e konsideruan këtë mundësi të largët si një ngjarje reale, dhe me të duan të na dënojnë.

Unë u bëj thirrje për të dëshmuar atyre që e kanë njohur jetën time këto tridhjetë deri në dyzet vite, dhe thërras për dëshmi mijërat e studentëve të veçantë dhe të pastër të Risale-i Nurit, dhe them:

Kur komandanti i përgjithshëm i ushtrisë Angleze që pushtoi Stambollin dhe hodhi farërat e përçarjes midis myslimanëve saqë madje mashtroi edhe Shejhul-Islamin dhe disa dijetarë të tjerë dhe i bëri që të sulmonin njëri-tjetrin dhe u zgjerua përçarja midis komitetit të unionit dhe të progresit dhe midis partisë së harmonisë me qëllim që të shtronin rrugën për fitoren e grekëve dhe për shpartallimin e lëvizjes nacionale. Në atë kohë unë fillova të hartoja librin tim "Gjashtë Sulmet" kundra Anglezëve dhe kundra grekëve dhe Sejjid Eshref Edib mori përsipër botimin dhe shpërndarjen e kësaj vepre gjë që ndihmoi në asgjësimin dhe shkatërrimin e efektit të planit të skëterrshëm të atij komandanti... duke mos u tërhequr edhe përballë kërcënimit të ekzekutimit; dhe i cili nuk shkoi në Ankara ndonëse qeveria e Ankarasë i bëri ftesë si vlerësim nga ana e tyre për luftën e tij; dhe i cili në Rusi nuk u shqetësua nga vendimi i ekzekutimit që e shpalli komandanti Rus, dhe që pati mundësi në ngjarjet e 31 Marsit me një ligjëratë të vetme të qetësonte tetë batalione të ushtrisë që t'u bindeshin oficerëve të tyre, dhe në gjykatën ushtarake duke shpërfillur kërcënimin e ekzekutimit u tha pashave kryesues kur i thanë: Edhe ti gjithashtu je reaksionar, edhe ti ke kërkuar ligjin e sheriatit", dhe iu

përgjigj: “Në qoftë se kushtetutësia përbëhet nga despotizmi i një partie, atëherë le të dëshmojnë njerëzit dhe xhindet se unë jam reaksionar dhe i gatshëm që të sakrifikoj edhe shpirtin tim në rrugën e një çështjeje të Sheriatit”, duke u shkaktuar oficerëve me rangje të lartë ta vlerësonin e admironin. Dhe ndërsa ai priste vendimin për ekzekutim, ata shpallën vendimin e tyre për pafajësinë e tij dhe atëherë e lanë të lirë; dhe madje ai nuk i falënderoi ata për këtë por tha ndërsa ishte në rrugën e tij për të dalë: Rroftë Ferri për tiranët!; dhe siç është shkruar në vendimin e gjykatës së Afjonit kur Mustafa Qemali i tha atij me zemërim në zyrën e kryetarit të Asamblesë: Ne të ftuam ty këtu që të na thoje idetë e tua të larta, por ti erdhe dhe shkrove disa gjëra rreth pesë namazeve të përditshme dhe mbolle konflikt midis nesh”. Ai iu përgjigj para afërsisht pesëdhjetë deputetëve:

“Çështja më e madhe pas çështjes së Imanit është namazi. Dhe ai që nuk falet konsiderohet tradhtar dhe vendimi i tradhtarit është i refuzuar”; dhe e detyroi atë komandant të frikshëm të përmbante zemërimin dhe të bënte një lloj kërkimi ndjese; pastaj lidhur me të, asnjë prej punonjësve të rendit dhe të qeverisë në gjashtë provinca nuk kanë regjistruar asnjë incident për studentët e Risale-i Nurit që të kenë prishur rendin dhe qetësinë publike përveç një incidenti të vogël lidhur me njërin nga studentët e vegjël për një mbrojtje të drejtë -përveç kësaj nuk është regjistruar asgjë tjetër ndonëse ata studentë numërohen me qindra e mijëra. Dhe askush nuk ka dëgjuar se ndonjëri prej studentëve të Risale-i Nurit ka hyrë në burg për shak të ndonjë krimi apo akti të dënueshëm; dhe nëse ndonjëri prej tyre ka hyrë, ka hyrë veçse për të reformuar të burgosurit. Dhe megjithëse me qindra e mijëra kopje të Risale-i Nurit janë të shpërndara në të gjitha anët e vendit, askush nuk ka parë dëm tek ato; madje nuk kanë gjetur prej tyre përveç dobisë gjatë njëzet e tre viteve. Pastaj tre gjykata të tre autoriteteve vendore-provinciale -shpallën vendimet për pafajësi, ashtu siç dëshmojnë e konfirmojnë qindra mijërat e studentëve të Risale-i Nurit me fjalët dhe me veprat e tyre për vlerën e Risale-i Nurit. Pastaj, a mund të akuzohet një person që jeton i veçuar, i vetmuar, që është i moshuar, i varfër dhe e shikon veten tek dera e varrit, dhe që i ka braktisur me të gjithë fuqinë dhe bindjen e tij gjërat e përkohshme, i cili nuk shqetësohet për asnjë rang të kësaj bote, por merret vazhdimisht me ato gjëra që do ta bënin t’i shlyente fajet dhe gabimet e mëparshme dhe me çështje që i vlejnë jetës së tij të amshuar; dhe i cili nga dhembshuria e fortë dhe nga dëshira e tij për të shmangur dëmet prej të pafajshmive dhe të moshuarve, nuk i mallkon ata që e torturojnë dhe as tiranët. A mund të akuzohet një njeri i këtillë dhe të thuhet për të: ky njeri i moshuar që

jeton i veçuar përpiqet të prishë rendin dhe stabilitetin, dhe qëllimet e tij janë komplotet e dynjasë, dhe korrespondenca, letrat e tij janë për këtë botë, dhe për këtë arsye ai është fajtor?

Ata që e thonë një gjë të tillë për të, dhe e dënojnë atë nën kushte të tilla të rënda, nuk ka dyshim se ata janë fajtorët, dhe do ta paguajnë çmimin e kësaj në gjykatën më të madhe në Ringjallje.

A mund të thuhet për një njeri të këtillë i cili qetësoi tetë regjimente të ushtrisë dhe i detyroi ato t'u bindeshin disiplinës dhe oficerëve të tyre nëpërmjet një ligjërate të vetme dhe i cili qe në gjendje para dyzet viteve që me një fjalë të vetme t'i bënte mijëra njerëz të mbanin anën e tij dhe të ishin përkrahësit e tij, dhe i cili nuk e përkuli kokën e tij përpara tre komandantëve arrogantë e të tmerrshëm -që u përmendën më parë- dhe as nuk u frikësua prej tyre dhe i cili tha para gjykatave:

"Dijeni mirë se sikur të kisha koka sa numri i qimeve në kokën time dhe në çdo ditë të këputej njëra prej tyre prej trupit tim, unë nuk do ta përkulja këtë kokë, e cila u është dedikuar të vërtetave të Kur'anit, përpara ateizmit dhe mohimit absolut, dhe nuk do t'i tradhtoj atdheun, kombin dhe islamin. A do të ishte e mundur pas kësaj të thuhej për një njeri që nuk ka lidhje me askënd në qytetin e Emirdagut, veçse me disa prej shokëve të Ahiretit dhe tre prej atyre që i shërbejnë... a mund të thuhet:

Ky Saidi ka punuar fshehurazi në Emirdag me qëllim që të prishë rendin, dhe ka helmuar mendjet e disa njerëzve duke u dhënë atyre idenë e prishjes së qetësisë.

Njëzet veta u mblodhën përreth tij dhe shkruan letra private duke e vlerësuar, gjë e cila tregon se ai po nxit një revoltë dhe është përfshirë në politikat e fshehura të qeverisë"?

Unë ia referoj atë ndërgjegjjes suaj që ta kuptoni se sa shumë larg të drejtës, drejtësisë dhe paanshmërisë janë ata të cilët e torturojnë atë, sa shumë kanë devijuar, me një armiqësi e urrejtje të paprecedent, duke e flakur atë në burg për dy vite, në një burgim fillikat, dhe duke mos e lejuar atë të flasë në gjykatë.

A do të ishte e arsyeshme dhe a do të ishte e mundur që dikush i cili ka marrë vëmendjen publike njëqind herë më të madhe se sa e meriton, që i solli mijëra njerëz në bindje me një ligjëratë, dhe nxiti mijëra njerëz që t'i bashkohen shoqërisë *Ittihad Muhammedi* me një artikull gazete, dhe i bëri pesëdhjetë mijë njerëz që ta dëgjojnë me admirim fjalimin e tij në Xhaminë e Aja Sofias... A është e arsyeshme

dhe a do të ishte e mundur që një njeri i këtillë të punoka fshehurazi gjatë tre viteve në qytetin e Emirdagut dhe pastaj të mos kishte sukses veçse të bindte disa vetë, dhe të hiqte dorë prej çështjeve të Ahiretit dhe të zhytej në komplotet politike dhe ta mbushte varrin e tij -të afërm prej tij- me errësira në vend të dritës? Edhe vetë shejtani nuk do të mund të bënte ndokënd ta pranonte këtë!

E Katërta: është përmendja e tyre se unë nuk e vë në kokë kapelen strehëgjërë duke e bërë këtë një arsye të rëndësishme për dënimin tim. Ata nuk më lejuan mua të flas, ndryshe unë do t'u kisha thënë këtë atyre që po përpiqeshin të më ndëshkonin:

Unë qëndrova si një mysafir për tre muaj në një rajon të policisë në qytetin e Kastamonus dhe askush nuk më tha atje mua: "Ti duhet ta vendosësh në kokë kapelen strehëgjërë". Dhe megjithëse në tre gjykata unë nuk e vura atë kapele në kokën time dhe nuk e kam hequr prej kokës sime kiafetin –kësulën- time në tre seancat gjyqësore të të tre gjykatave, ata nuk ndërhynë tek unë. Është e vërtetë se disa zyrtarë të cilët nuk kanë pasë pjesë prej fesë e morën atë si një pretekst dhe ndërhynë tek unë në një mënyrë jozyrtare duke më bezdisur gjatë njëzet e tre viteve dhe më kanë ngushtuar e shqetësuar shumë. Dhe fëmijët, gratë, fshatarët, nëpunësit në zyrat e tyre, dhe ata të cilët veshin bereta nuk janë të detyruar ta vendosin atë kapele. Dhe nuk ka dobi fizike në vënien e saj në kokë. Megjithatë një person që jeton i veçuar si unë ka vuajtur njëzet vite për shkak të mosvënies në kokë atë kapele dhe për shkak të shpifjeve, duke ditur se të gjithë Muxhtehidët dhe Shejhët e islamit e kanë ndaluar atë. Ata që po përpiqen të më dënojnë përsëri pa asnjë të drejtë, dhe ashtu siç nuk ndërhyjnë tek asnjëri prej atyre që pijnë alkool ditën ashiqare në muajin e Ramazanit dhe që nuk kryejnë namazin, në emër të lirisë individuale, atëherë ata që më akuzuan për shkak të kijafetit -veshjes sime, në mënyrë të përsëritur, vazhdimisht dhe me këtë inat dhe me këtë ashpërsi, ata do të pyeten për këtë kur të shikojnë burgun e përhershëm fillikat në varr dhe kur të sillen tek Gjykata më e madhe.

E Pesta: Risale-i Nuri i cili ka fituar pranimin e njëqind mijë prej njerëzve të Imanit dhe i cili ka paraqitur gjatë njëzet e tre viteve dobi të shumta -të pastërta dhe të largëta prej çdo lloj dyshimi e dëmi- për kombin dhe atdheun, konfiskohet për më të papërfillshmen e shkaqeve. Për shembull, u konfiskua koleksioni "*Dhul-Fikar*", *mrekullitë e profetit Muhammed a.s*.m. të cilat kanë shpëtuar besimin e njëqind mijë vetave -u konfiskua- për shkak të një shpjegimi të saktë e të vërtetë për dy ajete në vetëm dy faqe prej totalit të faqeve të saj që

arrin katërqind, edhe pse ky koleksion u sulmua me kalimin e kohës dhe janë shpallur për të ligje të shumta amnistie, a mund të konfiskohet ai koleksion i vlefshëm e i dobishëm për shkak të vetëm një apo dy fletëve të tij? Ndërsa tani po konfiskohen trajtesa të tjera të vlefshme për shkak të një apo dy fjalëve -duke u dhënë atyre kuptime të gabuara- brenda një mijë fjalëve. Kushdo që e dëgjoi këtë fletakuzën e tretë dhe vendimin që e publikuam do të bindej me siguri prej kësaj që themi. Ndërsa ne, për çdo fatkeqësi, themi:

"*(të cilët thonë kur u bie fatkeqësi): Vërtet të Allahut jemi dhe padyshim tek Ai do të kthehemi".*[255]

"Dhe Allahu Vetëm na mjafton neve dhe Ai për ne është Rregulluesi më i mirë i punëve".

E Gjashta: Unë u them atyre që e akuzojnë interpretuesin e mjerë të Risale-i Nurit -domethënë veten e tij- për shkak se disa studentë të Risale-i Nurit bëjnë një lavdërim të ekzagjeruar në të dhe shfaqin një mendim të mirë të tepruar, duke dërguar letra inkurajimi, përgëzimi, vlerësimi e falënderimi pasi patën përfituar shumë prej provave të patundshme të besimit dhe që fituan mësime të parefuzueshme lidhur me besimin, të cilat janë tek shkalla e "njohjes së sigurisë"... unë u them atyre:

Unë jam një njeri i dobët, i pafuqishëm, i syrgjynosur dhe gjysmanalfabet, kur ata i nxisin njerëzit kundra meje me propagandën e tyre dhe i frikësonin ata prej meje, sa herë që unë gjeja ilaç për sëmundjet e mia nga ilaçet e Kur'anit Kerim dhe prej të vërtetave të larta të besimit, unë i shkruaja ato të vërteta të çmueshme nga ana ime se do të jenë një ilaç i plotë për bijtë e kombit dhe të atdheut, dhe meqenëse shkrimi im ishte i keq, kisha shumë nevojë për ndihmesa, dhe Përkujdesja Hyjnore më lehtësoi duke më dhënë ndihmësa të veçantë, të sinqertë e të qëndrueshëm.

Natyrisht unë nuk mund ta refuzoj në mënyrë të prerë mendimin e mirë të tyre dhe lavdërimin e tyre të sinqertë, apo t'i ofendoja e të plagosja ndjenjat e tyre; një sjellje e këtillë do të ishte në kundërshtim me dritat e inspiruara prej thesarit të Kur'anit. Prandaj, me qëllim që të mos largoheshin prej meje këta ndihmësa me pena diamanti dhe me zemra guximtare unë e ktheja lavdërimin e tyre ndaj personit tim të pafuqishëm e të falimentuar për tek Risale-i Nuri i cili është pronari i vërtetë për këtë lavdërim, meqë ai reflekton mrekullinë shpirtërore të

[255] Kur'an, 2 : 156

Kur'anit, si dhe ia referoj personalitetit kolektiv të studentëve të Risale-i Nurit. Dhe kur u thoja atyre: "Ju më jepni mua një pjesë e cila e kalon njëqind herë pjesën time", unë i lëndoja deri diku ndjenjat e tyre. A ka ndonjë ligj që ta akuzonte e ta fajësonte dikë për shkak se individët e tjerë e lavdërojnë atë pavarësisht se ai e urren këtë lavdërim? A mund të gjendet si ky ligj që të mund të justifikojë një zyrtar që të më bëjë akuzë për këtë në emër të ligjit?

Megjithëse u shkrua në faqen pesëdhjetë e katërt të vendimit të gjykatës, e cila u shkrua kundra nesh por të cilën e publikuam: "Ai personalitet i cili do të shfaqet në fundin e botës do të jetë prej paraardhësve të Ehlibejtit -Familjes së Profetit, dhe ne studentët e Risale-i Nurit mund të konsiderohemi të jemi anëtarët e familjes së Profetit vetëm në një kuptim -vetëm nga aspekti shpirtëror. Pastaj në rrugën e Risale-i Nurit nuk mund të ketë vend për egoizëm, as për dëshirë për pozitë, ose për famë e për rang dynjaje. Madje unë e shoh veten time të detyruar madje të braktis edhe rangjet e Ahiretit -në qoftë se do të më ishin dhënë -me qëllim që të mos prish sinqeritetin që ndodhet në metodën e Risale-i Nurit. Dhe megjithëse në faqet 22 dhe 23 u shkruan këto shprehje: "Njeriu duke i njohur të metat e tij, dhe duke kuptuar varfërinë dhe pafuqinë, dhe duke kërkuar strehim me përulësi para Allahut; me atë personalitet unë e njoh veten time të jem më i mjeri, më i pafuqishmi, më i varfëri dhe më me të meta përpara Allahut se sa çdokush tjetër prej njerëzve, sikur të mblidhej e gjithë dynjaja duke më lavdëruar, përsëri kjo nuk do të më sillte bindje se unë jam dikush i mirë, me një rang të lartë shpirtëror e moral. Me qëllim që të mos ju ftoh e t'ju largoj prej meje krejtësisht, unë nuk do t'ju them shumë të meta e veçori të këqija të personalitetit tim të tretë të vërtetë. Nga mirësia e Tij, Zoti i Gjithëfuqishëm e ka nënshtruar këtë personalitet i cili është si ushtari më i ulët, në pozitën e shërbimit tek misteret e Kur'anit që janë si pozita më e lartë e mareshallit. Nefsi është më i ulët se çdo gjë, dhe detyra është më e larta se çdo gjë. Njëmijë e një falënderime qofshin për Zotin xh.sh.!

Megjithëse kjo është shkruar në vendimin e gjykatës, ata më gjetën mua fajtor për qënien time si një Udhëzues i madh dhe një Mehdi për shkak të lavdërimeve të të tjerëve, lavdërime të cilat në fakt i referohen Risale-i Nurit me atë kuptim -nuk ka dyshim se ata që më bëjnë fajtor për këtë, meritojnë të marrin dënimin e tyre për krimet e mëkatet e mëdhaja që kanë bërë.

E Shtata: Megjithëse gjykata e Denizlit, Gjykata penale e Ankarasë dhe gjykatat e apelit me unanimitet na dhanë pafajësinë neve

dhe të gjitha trajtesave të Risale-i Nurit dhe i rikthyen ato dhe letrat tona tek ne, dhe megjithëse ata thanë:

"Madje edhe sikur të supozonim se ndodhi gabim në vendimin e pafajësisë së gjykatës së Denizlit, meqenëse gjykata e Apelit dha pafajësinë tuaj, atëherë vendimi i pafajësisë u bë i formës së prerë, i qëndrueshëm dhe përfundimtar, kështu çështja nuk mund të rigjykohet përsëri". Dhe megjithëse unë kalova tre vite në qytetin e Emirdagut, i veçuar duke duke mos pasur kontakt me asnjë me përjashtim të disave që më ndihmonin -dhe punonin si ndihmësrrobaqepës- dhe nuk flisja me asnjë përveç se me disa njerëz fetarë në raste tepër të rralla dhe të domosdoshme dhe vetëm për pesë ose dhjetë minuta. Nuk shkruaja letra përveç se një letre në javë që të nxisja për të lexuar Risale-i Nurin (saqë madje unë nuk i kam dërguar as vëllait tim i cili është myfti, veçse tre letra gjatë tre viteve), madje e lashë edhe hartimin me të cilin isha marrë qysh prej tridhjetë viteve me përjashtim të dy pikave në njëzet faqe në të cilat trajtova dy çështje shumë të rëndësishme e të dobishme për njerëzit e besimit dhe për njerëzit e Kur'anit; ato janë "*Urtësia e përsëritjes në Kur'an*" dhe *"disa çështje rreth melekëve*"... Nuk kam hartuar gjë tjetër përveç atyre të dyjave, por unë vetëm dhashë leje për trajtesat që i kishin rikthyer gjykatat dhe që u kishin dhënë pafajësinë të bëheshin në formën e koleksioneve; dhe kur gjykata riktheu pesëqind kopje prej trajtesës "*El-Ajetul-Kubra*" e cila qe botuar me shkronjat e vjetëra unë u dhashë pranimin dhe miratimin tim vëllezërve të mi që t'i shumëfishonin nëpërmjet një makine shumëfishimi -me dijeninë time se ligji nuk e ndalonte atë në mënyrë zyrtare- me qëllim që të përfitonte prej saj bota islame, dhe unë preokupova veten time vetëm me korrigjimin e tyre dhe nuk jam preokupuar kurrë me politikën. Për më tepër, megjithëse leja zyrtare na ishte dhënë neve për t'u rikthyer tek vendlindja jonë, në kundërshtim me të syrgjynosurit e tjerë, unë pranova vuajtjet e internimit me qëllim që të mos përfshihesha në politka dhe në dynja, dhe nuk u ktheva.

Atëherë drejtimi i kësaj akuze të tretë e cila përmban çështje të kota e gënjeshtra si dhe keqinterpretime dhe orvatje për të dënuar një njeri të këtillë, sundohet nga dy kuptime të tmerrshme të cilat unë nuk do t'i shpreh për tani. Trajtimi që kam marrë këto njëzet muajt e fundit e provon këtë gjë. Dhe unë them këtë: Varri dhe Ferri janë të mjaftueshëm, dhe unë ia referoj atë Gjyqit të Fundit në ditën e kijametit.

E Teta: Meqenëse Rrezja e Pestë u rikthye tek ne pasi qëndroi për dy vjet në duart e Gjykatave të Denizlit dhe të Ankarasë, ajo iu shtua

fundit të një koleksioni të madh të quajtur "Llamba Ndriçuese", së bashku me mbrojtjen time që çoi në pafajësinë tonë në Gjykatën e Denizlit. Sigurisht, më parë ne e patëm mbajtur atë si private e të fshehtë, por meqenëse gjykatat e bënë atë të shpallur e të reklamuar dhe e rikthyen pasi na dhanë pafajësinë neve, unë lejova shumëfishimin e saj duke parë se ajo ishte e padëmshme. Origjinalja e kësaj trajtese që u shkrua para rreth dyzet viteve lidhur me interpretimet e haditheve alegorike qarkullonte midis njerëzve qysh prej shumë kohësh; dhe megjithëse një numër dijetarësh i vlerësuan si *daifë* -të dobëta- disa prej këtyre haditheve, veçse ama unë e shkrova këtë trajtesë për t'i shpëtuar njerëzit e besimit prej dyshimeve sepse kuptimet e jashtme të këtyre haditheve kanë qenë kundërshtuar shumë; veçse ama disa prej interpretimeve të tyre të jashtëzakonshme u bënë të qarta për të gjithë për t'i parë. Prandaj ne u detyruam që ta fshihnim këtë trajtesë dhe ta bënim atë një trajtesë të fshehtë e private me qëllim që të mos komentohej gabimisht. Më vonë, pasi disa gjykata e hetuan, e shqyrtuan me imtësi, pastaj e shpallën, e reklamuan dhe pastaj na e rikthyen; por ato iu rikthyen edhe njëherë tjetër që ta marrin atë si shkak për të na dënuar. Prandaj ne ia referojmë atë ndërgjegjjes së këtyre që duan të na dënojnë se sa larg drejtësisë është kjo çështje, larg të vërtetës dhe paanshmërisë që përsëri na gjejnë neve fajtorë për shkak të saj, ashtu siç i referojmë këto ankesat tona tek gjykata më e lartë Hyjnore,dhe themi:

"Dhe Allahu Vetëm na mjafton neve dhe Ai për ne është Rregullatori më i mirë i punëve".

E Nënta: Kjo pikë është shumë e rëndësishme, por meqenëse ata që na kanë dënuar neve e kanë studiuar Risale-i Nurin, unë nuk e kam shkruar atë me qëllim që të mos i zemëroj.

E Dhjeta: Kjo është shumë e fuqishme dhe e rëndësishme, por përsëri me qëllim që të mos i ofendoj, unë nuk e kam shkruar për tani.

Said Nursi

I burgosuri në një burgim të vetmuar fillikat

• • •

[Pjesë e një peticioni e shkruar gjatë gjykatës së Eskishehirit para pesëmbëdhjetë viteve dhe e dërguar tek këshilli i ministrave.][256]

Një peticion iu dërgua kabinetit qeveritar para pesëmbëdhjetë vitesh lidhur me këtë të njëjtën çështje. Tani, meqenëse ajo ka dalë

O ju që jeni ngarkuar me autoritet! Unë kam vuajtur një padrejtësi ngjashmëria e së cilës rrallë është parë në botë. Të qëndrosh i heshtur para një padrejtësie të tillë është mosrespekt për të drejtën. Prandaj unë jam i detyruar të nxjerr në shesh një fakt tepër të rëndësishëm; unë them: tregojeni fajin që kam kryer me qëllim që ashtu siç e kërkon ligji ose të më ekzekutojë ose të më japë njëqind e një vite burgim, ose provoni se unë jam krejtësisht i çmendur, ose ndryshe jepuni liri të plotë vetes sime, trajtesave të mia, shokëve të mi, dhe i llogaritni e i mblidhni humbjet tona prej atyre që i kanë shkaktuar.

Po, çdo qeveri ka një ligj dhe një parim në përputhje me të cilin jepen dënimet. Në qoftë se nuk do të kishte asgjë në ligjet e qeverisë së republikës që bëjnë të domosdoshme dënimin më të rëndë për mua e për shokët e mi, atëherë neve duhet të na jepet liria jonë e plotë, si dhe dëmshpërblimi, vlerësimi dhe të kërkoni falje. Sepse në qoftë se shërbimi im i rëndësishëm ndaj Kur'anit, i cili është i qartë dhe hapur, do të ishte kundra qeverisë, unë duhej të merrja jo një vit dënim në këtë mënyrë dhe një numër prej shokëve të mi të merrnin gjashtë muaj secili, por duhej të më jepej dënimi me vdekje ose njëqind e një vite burgim dhe atyre të cilët janë të lidhur ngushtë me mua duhej t'u jepeshin dënimet më të rënda. Ndërsa në qoftë se shërbimi ynë nuk është kundra qeverisë, atëherë ne nuk duhet të marrim dënime, akuza dhe burgosje, por vlerësim dhe dëmshpërblim. Sepse njëqind e njëzet trajtesa janë bërë interpretues të këtij shërbimi, dhe ato kanë qenë në gjendje t'i sfidojnë filozofët e mëdhenj të Europës dhe t'i përmbysin e shkatërrojnë të gjitha parimet e tyre ideologjike.

Sigurisht një shërbim i tillë efektiv do të prodhonte ose rezultate të tmerrshme brenda vendit, ose do të çonte në një rezultat shkencor të lartë e shumë të dobishëm, prandaj nuk mund të shpallet një vendim për të më burgosur vetëm një vit, dhe sikur ne të luanim lojëra fëmijësh për të hedhur hi në sytë e masave dhe për t'i mashtruar, dhe për të fshehur intrigat e tiranëve dhe gënjeshtrat e tyre kundra nesh; sepse ata që janë si unë, ose duhet të ngjiten me krenari tek litarët e varjes dhe të ekzekutohen ose të jenë të lirë në pozitën e në vendin që e meritojnë.

Po, një hajdut i zgjuar mund të vjedhë diamante me vlerën e një mijë lirave, kështu ai nuk do ta dënonte vetveten për të njëjtin dënim për vjedhjen e një copë qelqi që nuk vlen pothuase asgjë. Asnjë hajdut nuk do ta bënte këtë, madje asnjë krijesë e vetëdijshme.

---

përsëri, unë detyrohem që t'ua dërgoj atë përsëri departamenteve përkatëse të qeverisë.

Një hajdut i tillë është i zgjuar e finok, ai nuk do të ishte krejtësisht idiot në atë mënyrë.

O ju efendilerë!

Le të supozojmë se unë jam si ai hajdut sipas iluzioneve tuaja. Përse të zgjidhja një zonë të varfër prej rrethit të qytetit të Ispartës ku kam jetuar i tërhequr në vetmi për një kohë nëntë vitesh. Atëherë në vend që të orientoja idetë e disa indëvidëve të sinqertë (mbi të cilët u dhanë dënime të lehta) kundra qeverisë duke vënë kështu në rrezik veten time, dhe trajtesat e Risale-i Nurit të cilat janë qëllimi i jetës sime, në një kohë që do të kishte qenë më mirë për mua të qëndroja në një pozitë të lartë në Ankara ose në Stamboll -ashtu siç kam qenë më parë- dhe t'i orientoja me mijëra njerëz drejt qëllimit që kam ndjekur. Atëherë unë do të kisha mundësi të ndërhyja dhe të merrja pjesë në çështjet e dynjasë me një krenari që i përshtatet metodës sime në vend të zbulimit para këtij dënimi të parëndësishëm e poshtërues.

Me qëllim që të tregoj gabimet e atyre të cilët duan të më ulin mua me qëllim që pozitës që mbaj t'i mungojë gjithë rëndësia dhe dobia, unë u them atyre duke qenë i detyruar të përmend diçka nga egoizmi dhe nga hipokrizia ime e së kaluarës dhe jo për hir të krenarisë dhe të lavdërimit:

Ata të cilët e patën të lehtë të shikonin mbrojtjen time e cila u publikua nën titullin "Dëshmia e dy shkollave të fatkeqësisë" dëshmojnë se ai i tërhoqi me një ligjëratë të vetme tetë regjimente kryengritës dhe i çoi në bindje gjatë ngjarjeve të tridhjetë e një Marsit, dhe ashtu siç shkruan edhe gazetat, ai qe në gjendje me një artikull të vetëm në kohën e luftës për pavarësi, me artikullin e titulluar "*Gjashtë Sulmet"* të përmbushë shërbimin e rëndësishëm duke i kthyer mendimet e *Ulemave* -dijetarëve- të Stambollit kundra Anglezëve dhe në favor të lëvizjes nacionale. Dhe në xhaminë e Aja Sofias me mijëra njerëz u kënaqën me *hytben* -ligjërimin- e tij. Dhe u përshëndet me duartrokitje të fuqishme nga asambleja e deputetëve në Ankara. Dhe njëqind e gjashtëdhjetë e tre deputetë miratuan caktimin e një vlere prej njëqind e pesëdhjetë mijë lirash për shkollën e tij fetare dhe universitetin; dhe pa frikë iu përgjigj krejtësisht në mënyrë të qëndrueshme udhëheqësit të zemëruar në zyrën e kryetarit të asamblesë dhe madje e ftoi atë për të kryer namazin; dhe ndërsa ishte në Dar'el-Hikmeh el-islamijjeh u vlerësua unanimisht i denjë nga qeveria e unionit dhe e progresit për detyrën e ftesës së efektshme që u bëri filozofëve të Europës për të pranuar Urtësinë e islamit; dhe *Isharatul-ixhaz* -Shenjat e mrekullisë-, vepra të cilën e shkroi në fronte

gjatë luftës -dhe e cila tani është konfiskuar- u shfaq shumë e vlefshme për Enver Pashën, i cili në atë kohë ishte komandant i përgjithshëm, dhe e admiroi atë aq shumë saqë ai nxitoi për ta takuar me të gjithë respektin -dhe këtë nuk e kishte bërë me askënd- dhe ai vendosi të jepte letrat e domosdoshme për botimin e këtij libri që të kishte pjesë nga nderi i asaj dhurate dhe prej sevapit të saj, dhuratës së luftës, ashtu siç u përmend xhihadi i autorit të librit në luftë me gjithë mirësinë dhe vlerësimin... Një burrë i këtillë nuk mund të heshtet duke u trajtuar në këtë mënyrë sikur të ishte ndërlikuar në krime të vogëla si vjedhja e ndonjë kali ose si rrëmbimi i një vajze ose si vjedhja e xhepave, dhe kështu ta dënoni me një vit burgim dhe ta trajtoni atë sikur të ishte hajdut dhish apo delesh. Ai do të preferonte ekzekutimin mbi vuajtjen nën shtypjen arbitrare të një detektivi të lig ose të një polici të zakonshëm me një vit burgosje që tani ju po e ndëshkoni së bashku me mbajtjen e tij nën mbikëqyrjen për një vit, pasi është torturuar për dhjetë vite pa asnjë arsye me një mbikëqyrje shtypëse -megjithëse ai nuk mund të duronte as sundimin e mbretit. Në qoftë se një burrë i këtillë do të dëshironte të përfshihej në çështjet e dynjasë dhe në qoftë se ai do ta kishte ushqyer një dëshirë të tillë, dhe në qoftë se shërbimi i tij do ta kishte lejuar, ai do të kishte ndërhyrë në të deri në një shkallë dhjetë herë më të madhe se sa ngjarja e “Menemenit” dhe se sa revolta e Shejh Saidit.

Domethënë, do t’ju bënte juve të dëgjonit një zë gjëmimtar si gjëmimi i gjyleve të topit dhe jo një zëzëllimë si zëzëllima e krahëve të mizës!

Po, unë paraqes ç’ka vijon para shikimeve të qeverisë së Republikës: kjo situatë është shkaktuar nëpërmjet intrigave, komploteve dhe propagandës së organizatës së fshehtë e cila më zbuloi mua para këtyre fatkeqësive. Dëshmia se propaganda e gjërë, terrori dhe një komplot janë orkestruar kundra nesh në një mënyrë që nuk është parë kurrë në ndonjë ngjarje, është kjo; megjithëse unë kam njëqind mijë shokë, asnjëri prej tyre nuk ka mundur të më shkruajë asnjë letër qysh prej gjashtë muajsh, dhe as të më dërgojë përshëndetje e selam, dhe fakti se për shkak të informimit të komplotuesve të cilët përpiqen të mashtrojnë qeverinë, pyetjet, hetimet dhe kërkimet janë kryer në mënyrë të vazhdueshme duke filluar nga provincat lindore për tek ato në perëndim.

Plani që kurdisën këta intrigantë ishte dukshëm për të organizuar një incident që do të ishte shkaku për mijëra persona si unë për të marrë dënimet më të rënda, por ajo përfundoi në fund me një dënim

shumë të papërfillshëm që mund t'i jepej çdo njeriu të zakonshëm që ka kryer ndonjë vjedhje të papërfillshme; sepse u dha dënimi me burgim për gjashtë muaj për pesëmbëdhjetë njerëz të pafajshëm prej njëqind e pesëdhjetë vetave. Sepse a ka ndonjë person me vetëdije dhe me mend që të shponte pak një luan të madh në bishtin e tij me shpatën e tij të mprehtë e të ndritshme prej diamanti që e mban në dorë dhe ta kthente atë kundra tij? Sepse në qoftë se ai do të kishte dashur ta ruante vetveten prej atij luani dhe po të kishte dashur që ta vriste, ai do ta përdorte atë shpatë në një vend tjetër të asaj ergërsire.

Nxjerrja e këtij vendimi nga ana juaj kundra meje tregon se ju keni iluzione se unë jam si një burrë i atillë, sepse ajo është mënyra që ju më keni akuzuar e më keni dënuar. Në qoftë se unë do të kisha vepruar në një mënyrë kaq në kundërshtim me ndërgjegjjen dhe arsyen, ky vend i madh nuk do të ishte terrorizuar dhe opinioni publik nuk do të ishte kthyer kundra meje me propagandë. Do të ishte dashur që ju të më trajtonit si një i çmendur i zakonshëm dhe të më kishit dërguar në një spital çmendie.

Ndërsa në qoftë se do të kisha qenë një person i rëndësishëm ashtu si rëndësia e masave që ju i merrni kundra meje, atëherë nuk do të ishte e arsyeshme dhe e logjikshme ta shponi atë luan ose atë dragua në bisht dhe t'i bënte ato ta sulmonin atë, përkundrazi, ai duhej të mbronte vetveten me sa të mundej. Dhe kështu, unë preferova të jetuarin në vetmi i veçuar qysh prej pesëmbëdhjetë vitesh me zgjedhjen time dhe kam përballuar dhimbje e vuajtje të tilla që s'mund t'i mbajë njeriu; Dhe nuk kam ndërhyrë në asnjërën prej çështjeve të qeverisë dhe nuk kam dashur të ndërhyj; dhe kjo për arsye se detyra ime e shenjtë më pengon prej kësaj.

O njerëzit e ngarkuar me autoritet!

A do të ishte e mundur që në njëqind e njëzet trajtesat e një personi i cili, ashtu siç u shkrua nëpër gazeta para njëzet e pesë vitesh, me një artikull gazete u shkaktoi tridhjetë mijë njerëzve të pranonin idetë e tij, dhe tërhoqi vëmendjen e ushtrisë së lëvizjes; i cili iu përgjigj me gjashtë fjalë pyetjeve të kryepriftit Anglikan i cili donte që përgjigjja për to të ishte me gjashtëqind fjalë, dhe i cili jepte ligjërata në fillimin e periudhës së lirisë si një diplomat kryesues -a do të gjendeshin vetëm pesëmbëdhjetë fjalë lidhur me politikën dhe me dynjanë në njëqind e njëzet trajtesat e një burri të tillë. A do të ishte e mundur që të bindej ndonjë mendje se ky burrë na ndiqka rrugën e politikës dhe se ai na paska objektiva të kësaj dynjaje? Sepse ai në qoftë se do të kishte dashur të merrej me politikë dhe të ndërhynte në qeveri, kjo do të ishte

shfaqur në mënyrë të dukshme ose të nënkuptuar në njëqind prej vendeve të vetëm një libri. Në qoftë se qëllimi i tij do të kishte qenë të drejtonte kritika politike, a nuk do të kishte mundur që të gjente ndonjë gjë tjetër për ta kritikuar përveç çështjeve të *hixhabit* dhe të trashëgimisë të cilat janë prej temave dhe prej parimeve që kanë ekzistuar qysh në të kaluarën?

Po çdo njeri që ka ndonjë ide politike të caktuar mund të gjejë qindra e mijëra vende që t'i kritkojë regjimin e kësaj qeverie i cili bëri këtë përmbysje të madhe reformash, dhe nuk do të përkufizohej vetëm tek këto dy çështje të njohura. A do të ishte e mundur që reformat e qeverisë së Republikës të përbëheshin vetëm nga një ose nga dy çështje të vogëla? Megjithëse unë nuk kisha synuar të drejtoja asnjë kritikë ndaj saj, për shkak të një ose dy fjalëve në njërin ose në dy librat e mi që i pata shkruar para shumë kohësh në të kaluarën, u tha: "Ai po sulmon regjimin sundues dhe reformat e tij".

Kështu unë ju pyes tani: A do të ishte e arsyeshme që i gjithë vendi të preokupohej me një çështje shkencore, e cila nuk kërkon as dënimin më të vogël, në një mënyrë që shkakton panik?

Kështu, shpallja e një dënimi të lehtë e të papërfillshëm për mua dhe disa persona nga shokët e mi dhe propaganda e fuqishme e bërë kundra nesh në të gjithë vendin dhe duke i bërë të na urrejnë neve; dhe Shukri Kaja, ministri i brendshëm, duke sjellë një forcë të madhe në qytetin e Ispartas që të kryente një detyrë të cilën mund ta kryente një ushtar i vetëm -domethënë që të më arrestonin mua; dhe kryeministri, Ismeti, duke shkuar për tek provincat lindore me këtë lidhje; dhe për dy muaj në burg qënia ime i ndaluar nga të folurit me askënd; dhe askush duke mos pyetur për mua dhe as duke më dërguar përshëndetje ndërsa isha i vetmuar në këtë syrgjynosje; -të gjitha këto tregojnë një situatë shumë të çuditshme të pakuptim, të pa urtësi dhe që nuk i përshtatet asnjë qeverie në dynja -duke ditur se masdari -rrënja- e fjalës *Hukume* –qeveri- do të thotë t'i trajtojë çështjet me *hikmet* - urtësi. Pra "qeveri" do të thotë: të qeverisësh me urtësi, dhe jo gjithçka që do të mund të përfshihej çdo qeveri, dhe veçanërisht një qeveri e ligjshme si qeveria e Republikës, e cila i përmbahet më shumë se çdo gjë tjetër ligjit. Unë dëshiroj që mbrojtja e të drejtave të mia të jetë brenda kornizave të ligjit.

Unë i akuzoj si kriminelë ata që veprojnë kundra ligjit në emër të ligjit. Sigurisht ligjet e qeverisë së Republikës i refuzojnë aktet arbitrare të kriminelëve të tillë. Unë shpresoj që të më kthehen të drejtat.

• • •

Një shembull i vërtetësisë së Risale-i Nurit

Shënim

Ashtu si njerëzit e paanshëm dhe të ndriçuar të cilët e lexojnë trajtesën vijuese[257], e cila u shkrua para nëntëmbëdhjetë vitesh, që do ta kuptojnë qartë se Risale-i Nuri, me të gjitha njëqind e tridhjetë trajtesat e tij lidhet vetëm me besimin dhe me Ahiretin dhe u shkrua me atë thelb -kuptim-, krejtësisht i lirë e i pastër prej të gjitha politikave dhe prej motiveve të kësaj dynjaje; ky fakt i qartë dhe i sigurtë mbështetet nga hetimet e gjata dhe studimet e hollësishme të kryera nga gjykatat e Eskishehirit, të Ispartas, Denizlit dhe të Afjonit. Në këtë lidhje, ne kërkojmë interesimin dhe ndihmën tuaj që të na rikthehen të gjithë librat, të cilët më shumë se njëzet muaj mbahen nga Gjykata e Afjonit, dhe as pika më e vogël prej tyre nuk është treguar nga gjykata e Apelit që të përbëjë ndonjë shkelje; dhe të cilat kanë shpëtuar besimin e mijëra njerëzve, dhe janë vlerësuar e duartrokitur prej lexuesve të tyre, prej dijetarëve dhe prej botës islame.

Pjesa më e madhe e librave që mbahen nga gjykata e Afjonit u mblodhën nga të parët e shokëve tonë të liruar. Duke thënë: Ne ia japim këto librat tonë Ustadhit, pronarit të tyre; ato duhet t'i dorëzohen atij; ata m'i referuan mua ato. Në mënyrë të veçantë, ata lanë në gjykatë Kur'anin e praruar i cili qe shkruar për të shfaqur 'koinçidencat' e mrekullueshme të shkronjave, dhe ishte midis librave të konfiskuar. Para së gjithash ne presim që të na kthehen shpejt ato libra dhe Kur'ani, të cilët më parë na qenë rikthyer prej gjykatave të Denizlit dhe të Ankarasë.

Said Nursi

• • •

[257]-Pavarësisht qënies së saj e shkruar disa vite para proceseve tona gjyqësore në Eskishehir dhe në Denizli, letra e gjashtëmbëdhjetë i refuzoi të gjitha kundërshtimet e bëra kundra nesh sikur ajo i shihte tre gjykatat (domethënë, Gjykatat e Eskishehirit, Denizlit dhe të Afjonit) duke treguar qartë se kjo ishte një lloj i përkujdesjes Hyjnore, i nderimit Hyjnor dhe një keramet.

LETRA E GJASHTËMBËDHJETË

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

ٱلَّذِينَ قَالَ لَهُمُ ٱلنَّاسُ إِنَّ ٱلنَّاسَ قَدْ جَمَعُوا۟ لَكُمْ فَٱخْشَوْهُمْ
فَزَادَهُمْ إِيمَٰنًا وَقَالُوا۟ حَسْبُنَا ٱللَّهُ وَنِعْمَ ٱلْوَكِيلُ

"Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Njerëzit u thanë atyre: 'Vërtetë, populli (pagan) ka grumbulluar kundër jush (një ushtri të madhe), kështu që frikësojuni atyre'. Por kjo në të vërtetë vetëm e shtoi besimin dhe thanë: All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve."[258]

Kjo letër ka manifestuar kuptimin e vërsetit, فَقُولَا لَهُ قَوْلًا لَّيِّنًا *"Dhe i flisni atij butë e shtruar."*[259], dhe nuk u shkrua me vrull e fuqishëm.

> Ajo është përgjigjja ndaj një pyetjeje që m'u bë në mënyrë të qartë dhe të nënkuptuar nga shumë njerëz.

[Mua nuk do të më pëlqente kurrë që ta regjistroj këtë përgjigje, as nuk e dëshiroj një gjë të tillë, sepse unë të gjithë çështjen time e kam lënë në dorë të Zotit Gjithëfuqishëm, dhe jam mbështetur vetëm tek Ai. Por meqenëse nuk jam lënë i qetë që të gjej rehati në botën time dhe, meqenëse ata më kanë drejtuar vëmendjen dhe shikimin drejt dynjasë, unë detyrohem të parashtroj "pesë pika" me gjuhën e Saidit të Vjetër, dhe jo në gjuhën e Saidit të Ri, me qëllim që t'ua shpjegoj realitetin e situatës si shokëve të mi, ashtu edhe njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, si dhe atyre në pushtet, dhe në një mënyrë të tillë të shpëtoj jo vetëm veten time, por edhe shokët e mi dhe "Fjalët" e mia nga dyshimet dhe keqtrajtimet e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje.]

■ PIKA E PARË

Është bërë pyetja: "Përse ti je tërhequr nga politikat dhe tani nuk ke të bësh fare me to?"

Përgjigjja: Saidi i Vjetër, afërsisht para nëntë ose dhjetë vjetësh u përfshi në politika deri diku. Në të vërtetë, duke menduar se ndoshta do t'i shërbente fesë dhe njohjes nëpërmjet politikave, ai u

[258] Kur'an, 3: 173
[259] Kur'an, 20:44

mërzit dhe u lodh për asgjë. Ai shikoi se ajo ishte një rrugë e rrezikshme e cila ishte e dyshimtë, plot me vështirësi dhe e panevojshme për mua, si dhe formonte një pengesë për detyrat më të domosdoshme. Pjesa më e madhe e saj ishte mashtrime e gënjeshtra dhe ishte një mundësi që personi, pa e ditur, të jetë vegël në dorën e të huajit, kundërshtarit.

Për më tepër, ai që futet në politikë ose është i suksesshëm në pozitë, ose është në opozitë. Sa për të qenët i suksesshëm, meqenëse unë nuk jam as funksionar shtetëror dhe as deputet në parlament, atëherë të merresh me politikë është e panevojshme dhe e pakuptim për mua. Politika nuk ka kuptim për mua që të ndërhyj në të. Në qoftë se do t'i bashkohesha opozitës, unë do ta bëja një gjë të tillë ose nëpërmjet ideve, ose nëpërmjet forcës. Në qoftë se ndërhyrja ime do të ishte nëpërmjet ideve, ajo s'ka nevojë për mua, sepse çështjet janë të gjitha të qarta dhe gjithësecili i njeh ato ashtu si unë. T'i japësh gjuhës më kot, duke e lëshuar pa fre, është e pakuptim.

Në qoftë se unë do t'i bashkohesha opozitës për qëllim force dhe për të nxitur e shkaktuar ndonjë incident, do të ishte mundësia të kryheshin mijëra mëkate me qëllim që të arrihet një objektiv i dyshimtë. Shumë njerëz do të goditeshin me fatkeqësi për shkak të një individi të vetëm. Ndërgjegjja ime nuk do ta pranonte bërjen e mëkateve dhe t'u shkaktonte të pafajshmive të bënin faje e mëkate për shkak të një ose dy mundësive, në dhjetë mundësi. Prandaj Saidi i Vjetër e la cigaren së bashku me gazetat, politikën dhe bisedat rreth politikave të dynjasë. Dëshmia vendimtare për këtë është fakti se për tetë vitet e shkuara unë nuk kam lexuar as edhe një gazetë dhe as nuk kam dëgjuar ndonjë gazetë të lexohet nga dikush. Le të dalë ndonjëri e të thotë se unë kam lexuar ndonjë gazetë apo kam dëgjuar ndonjë duke e lexuar. Ndërsa para tetë viteve Saidi i Vjetër lexonte ndoshta tetë gazeta në çdo ditë.

Përveç kësaj, për pesë vitet që kaluan unë kam qenë nën mbikëqyrje dhe nën kontrollin më të rreptë. Cilido që do të kishte vëzhguar edhe aluzionin më të vogël për aktivitet politik, do ta thonte atë. Por për një njeri që është me nerva si unë, i patrembur, pa frikë, pa lidhje me dikë, i cili e konsideron dredhinë më të madhe në lënien e dredhisë në përputhje me parimin اِنَّمَا الْحِيلَةُ فِي تَرْكِ الْحِيَلِ *"Dredhia më e mirë është ta braktisësh dredhinë."* Ai njeri, gjendja e të cilit do të ishte kjo, idetë e tij nuk do të mbeteshin sekret as tetë ditë, e jo më tetë vite, sepse në qoftë se do të kishte pasur oreks e dëshirë

për politika, ai nuk do të kishte lënë asnjë nevojë për hetim e mbikëqyrje dhe do të kishte dhënë zë si e shtëna e artilerisë.

■ **PIKA E DYTË:** *Përse Saidi i Ri u shmanget politikave me një vrull të tillë të fuqishëm?*

Përgjigjja: *Ai u shmanget kështu furishëm për t'i shërbyer imanit dhe Kur'anit, i cili është shërbimi i rëndësisë më të madhe, nevoja më e madhe dhe është më e pastërta dhe më e drejta, me qëllim që të mos sakrifikojë pa qenë nevoja dhe me zell të tepruar për një ose dy vite të dyshimta nga jeta e kësaj dynjaje përpjekjen dhe fitimin e më shumë se të miliarda viteve të jetës së përhershme,* sepse ai thotë: Unë po plakem.. dhe nuk e di sa do të jetoj pas kësaj moshe, *kështu çështja më e rëndësishme për mua duhet të jetë përpjekja për jetën e përhershme, dhe çelësi për lumturinë e përjetshme është besimi, prandaj njeriu duhet të punojë për të.* Por, meqenëse unë jam i detyruar nga Sheriati që t'u shërbej njerëzve lidhur me të mësuarit me qëllim që edhe ata gjithashtu të mund të përfitojnë, unë dëshiroj ta kryej një detyrë të tillë. Megjithatë, një shërbim i tillë i intereson jetës shoqërore dhe asaj të kësaj bote, të cilat unë nuk mund t'i bëj. Gjithashtu në kohë të stuhishme nuk është e mundur ta kryesh një shërbim të tillë plotësisht dhe drejt. Prandaj unë e lashë mënjanë atë aspekt dhe zgjodha aspektin e shërbimit të besimit, i cili është më i rëndësishmi, më i domosdoshmi dhe më i sakti. Unë po e lë atë derë të hapur me qëllim që të vërtetat e besimit që i kam fituar për veten time dhe ilaçet shpirtërore që i kam përjetuar vetë, të mund të arrihen e të fitohen nga të tjerët. Ndoshta Zoti i Gjithëfuqishëm do ta pranojë këtë shërbim dhe do ta bëjë atë si shpërblesë e shlyerje për gjynahet e mia të mëparshme.

Me përjashtim të Shejtanit të mallkuar, askush tjetër, –qoftë besimtar ose jobesimtar, i drejtë apo ateist–, nuk ka të drejtë ta kundërshtojë këtë shërbim. *Sepse mosbesimit nuk i ngjason asgjë tjetër. Në të vepruarit si tiran, si i lig dhe në mëkatet e mëdha ndoshta mund të jetë ndonjë kënaqësi djallëzore e mbrapshtë, por në mosbesim nuk ndodhet absolutisht asnjë lloj kënaqësie. Ai është dhimbje mbi dhimbje, errësirë mbi errësirë dhe torturë mbi torturë.*

Sa në kundërshtim me arsyen do të ishte për një njeri si unë i cili nuk është lidhur me askënd, që është i vetmuar dhe i detyruar të shlyejë gjynahet e tij të mëparshme, që ta linte mënjanë punën për një jetë të amshuar të pafundme dhe të braktiste shërbimin ndaj një drite të shenjtë si besimi dhe ta flakte vetveten në moshë të pleqërisë

në lojërat e panevojshme e të rrezikshme të politikave dhe, sa në kundërshtim me urtësinë do të ishte kjo! Kjo do të ishte një çmenduri, madje edhe të çmendurit do ta kuptonin atë!

Por, në qoftë se ti thua: "Si të pengon shërbimi i Kur'anit dhe i imanit nga politika?" Unë do të thoja: *Meqenëse të vërtetat e besimit dhe të Kur'anit janë, secila prej tyre, si diamante, në qoftë se unë do të ndotesha nga politikat, njerëzit e zakonshëm, të cilët mashtrohen lehtë, do të pyesin me habi për ato diamante që unë mbaj, duke thënë, "A nuk janë ato për propagandë politike për të tërhequr më shumë mbështetës?" Ata do të mund t'i vlerësonin diamantet si copa të rëndomta xhami.* Atëherë duke qenë i përfshirë në politika, unë do t'u bëja keq atyre diamanteve të çmuar dhe do ta ulja e katandisja vlerën e tyre. Dhe kështu, o ju që e keni kufizuar shikimin tek kjo dynja! Përse luftoni kundra meje? Përse nuk më lini në punën ime?

Në qoftë se ju thoni: Disa Shejhë –udhëheqës shpirtërorë– ndërhyjnë ndonjëherë në çështjet tona, dhe njerëzit ndonjëherë të thërrasin ty me emrin Shejh.

Unë përgjigjem: O ju Efendilerë! Unë nuk jam Shejh.. unë jam një hoxhë. Dëshmia është kjo: Unë kam qenë këtu qysh prej katër vitesh, dhe në qoftë se unë do t'i kisha mësuar një njeriu të vetëm tarikatin Sufi, ju do të kishit të drejtë të ishit dyshues. Por unë i kam thënë gjithësecilit që ka ardhur tek unë: *Besimi është i domosdoshëm, Islami është i domosdoshëm; kjo nuk është periudha e Tarikatit Sufi.*

Në qoftë se ju thoni: Ata të thërrasin ty me emrin "Saidi Kurdi"; ndoshta ti ke disa ide nacionaliste dhe kjo nuk u përshtatet interesave tona.

Unë do të përgjigjesha: O ju Efendilerë! Gjërat që i ka shkruar Saidi i Vjetër dhe Saidi i Ri janë në shesh. Unë po përmend si dëshmi pohimin e sigurt: اَلْاِسْلَامِيَّةُ جَبَّتِ الْعَصَبِيَّةَ الْجَاهِلِيَّةَ *"Islami e ka shfuqizuar organizimin fisnor të periudhës së injorancës.*" Prej vitesh unë i kam konsideruar nacionalizmin negativ dhe racizmin si një helm vdekjeprurës, meqenëse ajo është një llojshmëri e sëmundjes evropiane. Evropa e ka infektuar Islamin me atë sëmundje duke menduar të shkaktonte ndarje e përçarje dhe që Islami të mund të copëtohej e të ishte më i lehtë për të rënë në kurth e për t'u gëlltitur. Studentët e mi dhe ata që kanë patur lidhje me mua e dinë se prej

shumë vitesh unë jam përpjekur që ta kuroj këtë sëmundje. Meqenëse çështja është kështu, o ju njerëz Efendilerë!.. do të isha kureshtar të di, përse ju e bëni çdo incident një pretekst për të më sulmuar duke më rënë në qafë? Në përputhje me çfarë parimi ju më shkaktoni hidhërim për çdo ngjarje të kësaj bote, si të ndëshkonit e t'i shkaktonit shqetësim një ushtari në perëndim për shkak të një gabimi që ka bërë një ushtar në lindje – për shkak të qënies së të dyve ushtarë – ose si të dënonit një dyqanxhi në Bagdad për shkak të një krimi të kryer nga një shitës në Stamboll – për shkak të qënies së tyre në të njëjtën linjë biznesi? Si mund ta pranojë këtë ndërgjegjja? Dhe çfarë përfitimi mund të kërkojë?

■ **PIKA E TRETË:** Shokët dhe të dashurit e mi, të cilët mendojnë për hallin tim, për rehatinë dhe habiten kur unë kaloj në heshtje, pa zhurmë dhe me durim ndaj çdo fatkeqësie që më bie, më bëjnë pyetjen e mëposhtme: "Si mund t'i durosh vështirësitë dhe telashet me të cilat po përballesh, ndërsa më parë ti ishe shumë krenar dhe i zemëruar dhe nuk mund të duroje as edhe fyerjen më të vogël?"

Përgjigjja: Dëgjojini dy ngjarjet e shkurtëra dhe tregimet dhe ju do t'i merrni përgjigjet tuaja prej tyre:

Tregimi i parë: Para dy vjetësh një pushtetar foli në mënyrë fyese dhe pa baza për mua pas shpine. Më vonë ata ma treguan këtë. Përafërsisht një orë unë u preka dhe u lëndova për shkak të damarit të rrëmbimit të Saidit të Vjetër. Pastaj me anë të mëshirës së Zotit të Gjithëfuqishëm fakti i mëposhtëm më ndodhi mua, ai e largoi hidhërimin dhe më bëri ta fal atë person. Ai fakt është siç vijon:

Unë iu drejtova nefsit tim duke i thënë, *në qoftë se fyerjet e tij dhe mangësitë që ai i përshkruan lidhen me personin tim dhe me nefsin tim, All-llahu qoftë i kënaqur me të, sepse ai ka treguar të metat e nefsit tim. Në qoftë se ai ka folur të vërtetën, ai më ka nxitur mua që ta edukoj nefsin tim dhe më ka ndihmuar të shpëtoj nga mendjemadhësia. Në qoftë se ai ka folur rremas e pabesisht, ai më ka ndihmuar të shpëtoj nga hipokrizia dhe nga fama e pamerituar, e cila është burimi i hipokrizisë.* Po, unë nuk qeshë pajtuar me nefsin tim, sepse unë nuk e pata edukuar atë. Në qoftë se dikush më thotë se ndodhet një akrep në qafën time ose në kraharor ose ndryshe ma tregon mua atë, unë do t'i isha mirënjohës atij njeriu dhe jo i ofenduar prej tij.

Por në qoftë se fyerjet e njeriut u drejtuan ndaj besimit tim dhe ndaj cilësisë sime, ndaj qënies shërbëtor i Kur'anit dhe i Imanit, kjo s'ka të bëjë me mua, unë e referoj atë tek Pronari i Kur'anit, i cili më ka vënë në shërbim mua. Ai është i Gjithëfuqishëm, Ai është i Gjithurtë.

Dhe në qoftë se fjala e tij është thjesht për të më blasfemuar, për të më sharë e fyer, edhe kjo nuk më përket mua, sepse unë jam një i huaj i syrgjynosur dhe i kam të lidhura duart e mia dhe nuk më takon mua të mbroj dinjitetin; kjo u takon autoriteteve të këtij fshati tek i cili unë jam një mysafir dhe nën mbikëqyrje, pastaj i takon zonës dhe pastaj rrethit. Të fyesh një të burgosur, një rob, kjo i takon pronarit të tij që ta mbrojë robin, ai e mbron të burgosurin. Atëherë, meqenëse realiteti i çështjes është kjo, zemra ime u lehtësua. Unë thashë?

وَأُفَوِّضُ أَمْرِيٓ إِلَى ٱللَّهِ إِنَّ ٱللَّهَ بَصِيرٌۢ بِٱلْعِبَادِ *"Dhe çështjen time unë ia lë All-llahut, vërtetë që All-llahu është Gjithëvëzhgues i robëve (të Tij)."*[260]

Dhe e konsiderova atë ngjarje sikur të mos kishte ndodhur dhe e harrova. Por për fat të keq, më vonë u kuptua se *Kur'ani nuk e kishte falur atë, pra e ndëshkoi...*

Tregimi i dytë: Këtë vit unë dëgjova që më kishte ndodhur një ngjarje. Megjithëse unë e dëgjova ngjarjen në vija të përgjithshme pasi ajo kishte ndodhur, unë u trajtova sikur të kisha qenë i lidhur ngushtë atë ngjarje. Sidoqoftë, unë nuk mbaj korrespondencë – letërkëmbim- me ndokënd, dhe në qoftë se do ta mbaja, unë i shkruaj tepër rrallë, lidhur me disa çështje të besmit, vetëm ndonjë shoku.

Në fakt unë i kam shkruar vetëm një letër vëllait tim gjatë katër viteve. Unë e pengoja veten time nga përzierja me të tjerët, edhe njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj bote më pengonin nga kjo. Unë kam qenë i mundur të takohem vetëm me një ose me dy nga shokët e mi të ngushtë një herë në javë. Sa për vizitorët që vijnë në fshat, ndoshta një herë në muaj, një ose dy nga ata takoheshin me mua për një ose dy minuta lidhur me ndonjë çështje që ka të bëjë me Ahiretin. Në mërgim, i huaj, i vetmuar, pa kërkënd, i mbyllur dhe i ndaluar nga çdo gjë, nga çdo njeri, në një fshat që ishte i papërshtatshëm për dikë si unë për të punuar për të siguruar mjetet e

[260] Kur'an, 40: 44

jetesës, madje, para katër vitesh, unë riparova një xhami të rrëzuar dhe punova si imam në të dhe si predikues për katër vjet -All-llahu e pranoftë- meqë unë kam një dëshmi për imam dhe për predikim nga krahina ime. Megjithatë unë nuk munda të shkoj në xhami në këtë Ramazan të bekuar që kaloi. Ndonjëherë unë i kryeja pesë faljet e detyruara në vetmi dhe u privova nga kryeja e faljeve me xhemat që ka njëzet e pesë merita më shumë.

Dhe kështu, unë shfaqa të njëjtën vetëpërmbajtje dhe durim përballë këtyre dy ngjarjeve që më ranë ashtu siç bëra ndaj trajtimit të atij pushtetari para dy vitesh. Dhe në dashtë All-llahu xh.sh., unë do të vazhdoj të bëj kështu. Unë mendoj e them sa vijon: Në qoftë se ky keqtrajtim, ky pikëllim dhe kjo shtypje që më kanë rënë nga njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje janë për nefsin tim të keq e të gabuar, unë i fal ata. Ndoshta nefsi im do të përmirësohet me këtë pikëllim dhe, ndoshta kjo do të jetë një shlyerje për gjynahet e tij. Unë kam përjetuar shumë nga gjërat e mira në këtë bujtinë të dynjasë; në qoftë se përjetoj pak nga sprovat e saj, unë përsëri do të bëj falënderime.

Në qoftë se njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj bote më shtypin për shkak të shërbimit tim ndaj besimit dhe ndaj Kur'anit, mbrojtja për këtë nuk më përket mua, unë ia referoj atë të Gjithëfuqishmit dhe Detyruesit të Vetëm.

Në qoftë se qëllimi i këtij pikëllimi është të shkatërrojnë vlerësimin dhe orientimin e njerëzve ndaj meje, për të shuar famën e pameritуar e cila është e pathemeltë, që shkakton hipokrizi dhe shkatërron sinqeritetin, atëherë Zoti i bekoftë ata!.. sepse unë i konsideroj qënien i mbajtur në respekt e vlerësim nga njerëzit në përgjithësi dhe fitimin e një fame midis tyre si të dëmshme për njerëz si unë. *Ata që kanë lidhje me mua, e dinë që unë nuk dëshiroj që të më shfaqet respekt, në të vërtetë unë nuk e honeps dot atë.* Madje unë e kam qortuar një shokun tim të vlefshëm ndoshta pesëdhjetë herë për shkak se shfaq për mua respekt të tepruar.

Në qoftë se qëllimi i tyre në shpifjet që bëjnë për mua për të më përçmuar në sytë e njerëzve dhe përfolja e tyre ndaj meje lidhet me të vërtetat e besimit dhe të Kur'anit për të cilat unë jam interpretues, ata përpiqen më kot, *sepse yjet e Kur'anit, nuk mund të mbulohen me ndonjë gjë, me ndonjë perde. "Ai që i mbyll sytë e tij, vetëm vetë nuk shikon; ai vetëm ditën e tij e bën natë dhe nuk e bën natë atë për dikë tjetër."*

■ **PIKA E KATËRT:** Përgjigjje për një numër pyetjesh të dyshimta.

Pyetja e parë e dyshimtë: Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, më thonë: "Me çfarë jeton ti? Si ushqehesh pa punuar? Ne nuk duam njerëz në vendin tonë që rrinë kot pa punë dhe jetojnë nga përpjekja e të tjerëve."

Përgjigjja: Unë jetoj me kursim dhe bereqet. Unë nuk ndjehem borxhli ndaj askujt përveç Krijuesit të Vetëm, i Cili më furnizon mua, dhe unë kam marrë një vendim që të mos bëhem borxhli ndaj askujt tjetër. Po, ai i cili jeton me njëqind para, madje me dyzet para, nuk pranon të bëhet i obliguar ndaj ndokujt. Unë nuk dëshiroj ta shpjegoj këtë çështje. Po ta bëja këtë, do të ishte gjëja më e papëlqyeshme për mua, sepse ajo mund të më bënte të ndjeja një lloj krenarie ose egoizmi. Por meqenëse njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje më pyesin rreth kësaj në mënyrë të dyshimtë, unë do të përgjigjesha si më poshtë:

Qysh nga fëmijëria ime, gjatë gjithë jetës sime, ka qenë një parim i jetës sime që të mos pranoj asgjë nga njerëzit, madje as zekatin, të mos pranoj rrogë. Unë u detyrova ta pranoj një rrogë vetëm për një ose dy vjet nga Hikme el-Islamije –Bashkësia Islame- me këmbënguljen e shokëve të mi dhe që të mos bëhem i detyruar ndaj njerëzve për një mjet jetese të kësaj bote. Njerëzit e trevës së vendlindjes sime dhe ata të cilët më kanë njohur mua në zonat e tjera, e dinë këtë. Gjatë këtyre pesë viteve të mërgimit, shumë shokë janë përpjekur seriozisht me këmbëngulje që të më bëjnë t'i pranoj dhuratat e tyre, por unë nuk kam pranuar asnjërën nga ato.

Dhe kështu, në qoftë se më thuhet: Si, atëherë, jeton ti?" Unë përgjigjem: *Unë jetoj nëpërmjet bekimeve –bereqetit– dhe përkujdesjes Hyjnore. Nefsi im urdhërues për të liga, megjithëse meriton çdo fyerje dhe përbuzje, veçse ama, si një keramet që buron nga shërbimi i Kur'anit, unë marr begati dhe bekime të cilat janë një dhuratë Hyjnore në mënyrën e vlerës ushqyese.* Në përputhje me vërsetin:

وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ *"Dhe shpalle lart mirësinë e Krijuesit Tënd."*[261], unë do të kujtoj mirësitë që më ka dhuruar Krijuesi i Gjithëfuqishëm dhe do të përmend disa shembuj duke dhënë në

[261] Kur'an, 93: 11

efekt falënderime ndaj tyre. Por pavarësisht kësaj, unë kam frikë se kjo do të shkaktonte hipokrizinë dhe krenarinë të futen tek ky falënderim shpirtëror gjë që do të bënte që bereqeti dhe begatia të këputeshin e të priteshin, sepse ta shfaqësh një bereqet të fshehtë Hyjnor bëhet shkak për ndërprerje. Por çfarë mund të bëjë, unë jam i detyruar ta tregojë atë.

• *Dhe kështu, e para:* Këto gjashtë muaj një shinik (peshe) grurë, që përbëhet nga tridhjetë e gjashtë (çyrekë) bukë, më ka mjaftuar mua. Ka mbetur akoma bukë; ajo nuk ka mbaruar. Dhe se sa kohë do të zgjasë, unë nuk e di. [262]

• *E dyta:* Në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, unë mora ushqim vetëm nga dy shtëpi, dhe të dyja nga ato më bënë të sëmurë. Unë kuptova se jam i ndaluar nga të ngrënit e ushqimit të të tjerëve. Në pjesën tjetër të kohës, në të gjithë Ramazanin, tre çyrekë buke dhe një okka[263] oriz më mjaftuan mua, ashtu siç u dëshmua dhe u tregua nga Abdull-llah Çavush, pronari i një shtëpie të bekuar dhe një mik besnik, i cili e shikoi përdorimin tim me kursim, me ekonomi. Madje orizi mbaroi dymbëdhjetë ditë pas përfundimit të Ramazanit.

•*E treta:* Për tre muaj në mal, një okka gjalp qe e mjaftueshme për mua dhe për miqtë e mi, duke ngrënë prej tij çdo ditë bashkë me bukën. Madje në një rast unë pata një mysafir të bekuar i quajtur Sulejman. Buka e tij dhe buka ime gati po mbaronte. Ishte ditë e mërkurë. "Unë i thashë atij të shkonte në fshat dhe të merrte ca bukë," sepse në një largësi dy orësh për secilën anë nga ne nuk ndodhej asnjë njeri nga i cili mund të blihej ndonjë bukë. "Ai tha se dëshironte të qëndronte me mua në mal ditën e enjte në mbrëmje me qëllim që ne të mund të faleshim e luteshim së bashku." Duke thënë: *"Mbështetja e besimi ynë është tek All-llahu",* unë i thashë atij të qëndrojë. Më vonë, megjithëse nuk kishte lidhje me këtë dhe nuk kishte arsye për të, ne të dy filluam të ecim derisa arritëm në majë të malit. Atje kishte ca ujë në kanë dhe ne kishim pak sheqer dhe ca çaj. Unë i thashë atij: "Vëlla! Bëj ti ca çajë!" Ai nisi ta bëjë atë; ndërsa unë u ula nën një dru cedri duke parë nga lart një rrungajë, përrua të thellë. Unë mendova me keqardhje me veten time: ne kemi vetëm një copë bukë të myshkur e cila do të jetë e mjaftueshme për ne vetëm këtë mbrëmje. Çfarë do të bëjmë ne për dy ditë dhe çfarë do t'i them unë këtij njeriu zemërdëlirë, të padjallëzuar? Ndërsa

[262] Ajo zgjati një vit.
[263] Domethënë kilogram.

duke e menduar këtë, unë befas e ktheva kokën time në mënyrë të pavullnetshme dhe pashë një copë të madhe buke lartë në drurin e cedrit midis degëve; ajo ishte me pamje nga ne, po na shikonte ne. Unë thirra: "Sulejman, lajme të gëzueshme! Zoti i Gjithëfuqishëm na ka dërguar neve ushqim." Ne e morëm bukën dhe duke e soditur atë, pamë se asnjë zog apo kafshë e egër nuk e kishte prekur atë.. Dhe për njëzet apo tridhjetë ditë, askush absolutisht nuk ishte ngjitur në majë të atij mali. Buka qe e mjaftueshme për ne për dy ditët. Ndërsa ne po hanim dhe ajo gati po mbaronte, Sulejmani i drejtë i cili kishte qenë më besniku i shokëve besnikë për katër vjet duke u ngjitur malit u drejtua drejt nesh duke sjellur bukë.

•*E katërta:* Unë e kam blerë këtë pallto të përdorur që e kam veshur para shtatë vjetësh. Për pesë vjet, unë kam shpenzuar vetëm katër lira e gjysmë për rroba, veshje të brendshme, pantofla, papuçe dhe për çorapë. Kursimi, mëshira Hyjnore dhe bereqeti më kanë mjaftuar mua.

Kështu, ndodhen gjëra të shumta si këto shembuj dhe lloje të shumta të bekimeve Hyjnore. Njerëzit e këtij fshati dinë shumë nga shembujt e bereqetit. Por mos pandehni se unë po i përmend këto shembuj nga krenaria, përkundrazi, unë kam qenë i detyruar t'i përmend ato. Gjithashtu mos mendoni se ato shembuj janë shkak të mirësisë sime. *Këto shembuj bereqeti ishin ose dhurata Hyjnore për miqt e sinqertë të cilët më kanë vizituar mua, ose një nderim Hyjnor për shkak të shërbimit të Kur'anit, ose një begati e përfitim që rezulton nga kursimi, ose ato kanë qenë furnizimi (rizk) për katër macet të cilat rrinë me mua këtu dhe që recitojnë Emrin Hyjnor,* ***"Ja Rahim!, Ja Rahim!"*** *O Mëshirëplotë! O Mëshirëplotë! Ato janë furnizime që vijnë në formën e bereqetit dhe unë përfitoj prej tyre gjithashtu.* Po, në qoftë se ti do t'i dëgjoje me vëmendje mjaullimat e tyre të përvajshme, ti do të kuptoje se ato janë duke thënë: "***Ja Rahim, Ja Rahim!"*** *O Mëshirëplotë! O Mëshirëplotë!*

Me që ra fjala e maceve, kjo më sjell ndërmend pulat. Unë kam një pulë. Në këtë dimër pothuajse çdo ditë pa përjashtim, si një makinë, ajo më ka sjellë një vezë nga thesari i Mëshirës Hyjnore. Kurse një ditë, ajo më solli dy vezë dhe unë u habita. I pyeta shokët e mi: "A mund të ndodhë kjo?" Ata u përgjigjën: "Ndoshta kjo është një dhuratë Hyjnore."

Pula ka gjithashtu një zogth që e ka klloçitur në verë. Edhe ajo filloi të bëjë vezë në fillim të Ramazanit të bekuar dhe vazhdoi për dyzet ditë. As unë dhe as ata që më ndihmojnë mua nuk kemi asnjë dyshim, se duke qenë edhe zogth, edhe në dimër, edhe në Ramazan, kjo situatë e bekuar ishte vetëm një dhuratë dhe mirësi Hyjnore. Dhe sa herë që pula ndalonte së bëri vezë, zogthi menjëherë fillonte, duke mos më lënë mua pa vezë.

Pyetja e dytë e dyshimtë: Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dunjaje pyesin: "Si mund të kemi besim dhe të jemi të sigurt që ti nuk do të ndërhysh në çështjet e dynjasë sonë? Në qoftë se ne të lëmë të lirë, ti ndoshta mund të ndërhysh në to. Gjithashtu, si mund ta dimë ne që ti nuk je finok? Si ta dimë ne që kjo nuk është një dredhi që ti e shfaq veten tënde sikur e ke braktisur dynjanë duke mos marrë pasuri nga njerëzit haptas, por ndoshta ti e merr atë fshehtas?"

Përgjigjja: Qëndrimi im para njëzet vitesh dhe situata në Gjykatën ushtarake dhe në periudhën para shpalljes së kushtetutës, të cilat janë të njohura nga ata që më njohin, dhe mbrojtja ime në Gjykatën ushtarake në atë kohë që quhej "Dëshmia e dy shkollave të fatkeqësisë", tregon në mënyrë vendimtare se jeta që kam jetuar ishte e tillë që unë nuk kam përdorur as edhe hilen më të vogël, dhe jo më finokërinë e dredhinë. Në qoftë se do të ishte përdorur dredhia në këtë pesëvjeçarin e fundit, kërkesa do t'u ishte bërë ju me servilizëm e lajka. Një njeri hileqar përpiqet t'i bëjë njerëzit për vete e të hyjë në zemrën e tyre; ai gjithmonë orvatet t'i mashtrojë njerëzit e t'ua hedhë atyre; ai nuk e tregon të vërtetën. *Ndërsa unë nuk kam pranuar ta ul e poshtëroj veten time pavarësisht sulmeve më të ashpra dhe kritikave që u drejtuan kundër meje. Duke thënë, "Unë mbështetem tek All-llahu"*, unë ua ktheva shpinën njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje.

Për më tepër, ai i cili zbulon realitetin e kësaj bote dhe njeh Ahiretin nuk pendohet kurrë nëse është i gjykueshëm e i ndjeshëm; ai nuk kthehet përsëri tek dynjaja e të luftojë për të.

Pastaj një njeri që ka kaluar pesëdhjetë vite nga mosha e tij, i cili nuk ka lidhje me ndonjë gjë dhe është i vetmuar, nuk do ta sakrifikonte jetën e përhershme për një ose dy vite me dërdëllime, sharlatanizma e mashtrime të kësaj dunjaje. Në qoftë se do të vepronte kështu, ai nuk është finok, por i marrë e i çmendur. Çfarë do të mund të bënte një idiot i marrë sa të merresh e të shqetësohesh me të?

Sa për dyshimin e braktisjes së dynjasë nga ana e jashtme, ndërsa nga ana e brendshme e kërkokam atë, unë them, në përputhje me vërsetin Kur'anor:

وَمَآ أُبَرِّئُ نَفْسِيٓ ۚ إِنَّ ٱلنَّفْسَ لَأَمَّارَةٌۢ بِٱلسُّوٓءِ *"Edhe unë nuk e shfajësoj veten time (nga faji). Padyshim që uni (nefsi njerëzor) është i prirur drejt së keqes."*[264]

"Unë nuk e nxjerr të larë nefsin tim, pasi nefsi kërkon çdo gjë të keqe. Sepse në këtë dynja kalimtare, në këtë bujtinë të përkohshme, në kohë të pleqërisë, në një jetë të shkurtër, nuk është e arsyeshme të shkatërroj jetën e përhershme e të amshuar dhe lumturinë e përjetshme për një kënaqësi të vogël. Meqenëse nuk është e levërdishme për të arsyeshmit dhe të vetëdijshmit, nefsi im, me hir e me pahir, i është nënshtruar arsyes dhe e ka ndjekur atë."

Pyetja e tretë dyshuese: njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje thonë: "A na do ti ne? A na miraton ne? Në qoftë ti na do, përse ti rri i ftohtë, mospërfillës dhe nuk ke të bësh fare me ne? Në qoftë se ti nuk na pëlqen, kjo do të thotë se ti na kudërshton dhe ne i shtypim ata që na kundërshtojnë."

Përgjigjja: Në qoftë se unë do ta kisha dashur dynjanë tuaj, përkrah jush, unë nuk do të isha tërhequr prej saj. Unë nuk ju pëlqej as ju dhe as dynjanë tuaj. Por unë nuk ndërhyj as tek ajo, as nuk përzihem me ju, sepse unë kam synime të ndryshme dhe çështje të ndryshme që kanë mbushur zemrën time për të menduar për gjëra të tjera. Detyrimi - urdhëri juaj- është të shikoni dorën, gjendjen e jashtme, dhe jo zemrën, atë të brendshme, sepse ju dëshironi vazhdimësinë e sistemit dhe vendosjen e rendit publik. Për sa kohë që unë nuk ndërhyj tek ato, atëherë ju nuk keni të drejtë të thoni: "Edhe zemra gjithashtu duhet të na dojë", ndonëse ju kurrësesi nuk jeni të denjë për të...

Në qoftë se ju ndërhyni në çështjen e zemrës, unë them: "Ashtu siç dëshirohem dhe s'më pritet për pranverën gjatë këtij dimri, por unë nuk mundem ta sjellë atë, po ashtu unë kam mall dhe s'më pritet që bota të drejtohet dhe unë lutem për të dhe dëshiroj që njerëzit e kësaj bote të reformohen, por kjo është përtej dëshirës dhe përpjekjes sime, kështu unë jam i pafuqishëm për to. Unë në fakt, as

[264] Kur'an, 12: 53

nuk mund të ndërhyj për to, sepse nuk është as detyra ime, as nuk kam aftësi...

Pyetja e katërt dyshuese: Njerëzit e kësaj bote thonë: "Ne kemi përjetuar shumë fatkeqësi, ne nuk kemi më besim tek asnjë njeri. Si mund të jemi të sigurt që nëse të jepet rasti ti nuk do të ndërhysh në çështjet tona në mënyrën që dëshiron ti?"

Përgjigjja: Pikat e lartëpërmendura duhet t'ju japin ju bindje e besim. Përveç kësaj, meqenëse unë nuk ndërhyra në dynjanë tuaj, ndërsa isha në qytetin tim të lindjes midis studentëve të mi dhe të afërmve dhe ndërsa jetoja në mesin e atyre që më dëgjonin dhe më kërkonin këshilla, madje unë nuk ndërhyra në dynjanë tuaj edhe në ngjarjet më tronditëse; a mund të ndërhyjë në to dikush që është i vetmuar në mërgim, me askënd pranë tij, që është i huaj, i dobët, i pafuqishëm, i kthyer me të gjithë fuqinë e tij drejt Ahiretit, i shkëputur nga të gjitha lidhjet shoqërore nga korrespodenca, letërkëmbimi, i cili ka gjetur vetëm pak shokë me të cilët janë lidhur në aspektin e Imanit dhe të Ahiretit dhe kjo lidhje është prej së largu, i cili është më i huaj se çdo kush tjetër dhe të cilin gjithkush tjetër e vlerëson dhe e shikon si të huaj, në qoftë se një njeri i tillë do të ndërhynte në dynjanë tuaj të pafrytshme e të rrezikshme, sigurisht ai do të ishte në një çmenduri të dyfishtë...

■ **PIKA E PESTË:** Kjo lidhet me pesë çështje të vogëla.

• **E para:** Njerëzit e kësaj bote më thonë: "Përse ti nuk i vë në praktikë parimet e qytetërimit tonë, stilin tonë të jetës dhe mënyrën tonë të të veshurit? A do të thotë kjo që ti na kundërshton ne?"

Përgjigjja ime është: O ju Efendilerë! Me çfarë të drejte ju po më rekomandoni parimet e civilizimit tuaj? Ju jeni ata që më detyruat padrejtësisht të qëndroj në një fshat për pesë vjet dhe, madje më ndaluat nga letërkëmbimi dhe komunikimi me njerëzit. Ndërsa ju i latë të gjithë të syrgjynosurit në qytet me shokët e tyre dhe të afërmit, dhe atëherë ju u dhatë atyre letrat e lirimit duke u dhënë amnisti, pa asnjë arsye ju më izoluat dhe nuk më lejuat të takohem me asnjë nga banorët e qytetit tim, me përjashtim të një ose dy vetave. Kjo do të thotë se ju nuk më vlerësoni si një anëtar të këtij kombi dhe si një qytetar. Si mund të më rekomandoni që të zbatoj për veten time kodin tuaj civil? Ju e shndërruat dynjanë për mua në një burg. Gjëra të tilla nuk mund t'i rekomandohen dikujt në burg. *Ju e mbyllët derën e dynjasë për mua, kështu unë trokita tek dera e Ahiretit dhe mëshira Hyjnore e hapi atë për mua. Si mundet*

që zakonet dhe parimet e ngatërruara të Dynjasë t'i rekomandohen dikujt që qëndron në këmbë tek dera e Ahiretit? Kurdo që ju të më lironi dhe të më ktheni tek vendlindja dhe të më jepni të drejtat e mia, atëherë ju mund të më kërkoni të zbatoj parimet tuaja.

• **Çështja e dytë:** Njerëzit e kësaj bote thonë: "Ne kemi një departament shtetëror për të dhënë mësim parimet e fesë dhe të vërtetat e Islamit? Me çfarë autoriteti ti boton vepra fetare? Meqenëse ti je i dënuar me internim, ti nuk ke asnjë të drejtë të përzihesh në këto çështje."

Përgjigjja: E vërteta dhe realiteti nuk mund të kufizohen e ngushtohen! Si mund të ngushtohet besimi dhe të kufizohet Kur'ani? Ju mund të kufizoni parimet dhe ligjet e dynjasë suaj, kurse të vërtetat e besimit dhe të Kur'anit dhe parimet nuk mund të detyrohen e shtrëngohen në formën e trajtimeve dhe qëndrimeve të kësaj dynjaje, duke iu dhënë një veshje zyrtare dhe duke marrë një shpërblim për kryerjen e tyre. Përkundrazi, ato mistere të cilat janë dhurata Hyjnore, ato bekime, vijnë nëpërmjet një qëllimi të sinqertë dhe duke braktisur dynjanë dhe kënaqësitë epshore. Për më tepër, departamenti zyrtar shtetëror i juaj më pranoi dhe më emëroi si predikues ndërsa unë isha në qytetin tim të lindjes. Unë e pranova atë detyrë, por refuzova rrogën. Unë jam i pajisur me dëshmi. Me këtë dëshmi –dokument– unë mund të veproj si imam –drejtues falje– dhe si predikues në çdo vend, sepse internimi im ishte padrejtësi. Gjithashtu, meqenëse të syrgjynosurit u kthyen në familjet e tyre, atëherë dokumentet e mia të mëparshme janë akoma të vlefshme, të rregullta.

Së dyti: *Të vërtetat e besimit të cilat i kam shkruar, unë ia kam adresuar drejtpërdrejt nefsit tim. Unë nuk i ftoj për tek ato të gjithë njerëzit, përkundrazi, ata janë për shpirtërat e atyre që kanë nevojë për to dhe për zemrat e atyre që janë të plagosura; ata i kërkojnë ato ilaçe kur'anore dhe i gjejnë ato.* Vetëm për të siguruar mjetet e mia të jetesës pata shtypur një 'Trajtesën time rreth Ringjalljes' së të vdekurve para se të rekomandohej e të hynte në fuqi shkrimi i ri. Edhe guvernatori i mëparshëm, i cili ishte i padrejtë ndaj meje, e studioi Trajtesën dhe, meqenëse nuk gjeti asgjë për t'u kritikuar, ai nuk bëri asgjë kundra saj.

• **Çështja e tretë:** Disa nga shokët e mi, në pamje të jashtme qëndrojnë larg meje, sepse njerëzit e kësaj bote më shikojnë me dyshim dhe, me qëllim që të shfaqen të parapëlqyer e të mirë për njerëzit e kësaj bote, ata në të vërtetë, më kritikojnë mua. Ndërsa

njerëzit finokë të kësaj dynjaje, e menduan qëndrimin e tyre larg dhe shmangien e tyre prej meje, jo si besnikëri të tyre ndaj njerëzve të kësaj bote, por si një lloj hipokrizie dhe mungese ndërgjegjjeje, dhe ata i shikuan ata shokët e mi në mënyrë të pavaforshme dhe me të keq.

Kështu, unë them këtë: O shokët e mi të Ahiretit! Mos qëndroni larg shërbimit tim ndaj Kur'anit madhështor dhe mos ikni, sepse në dashtë Zoti xh.sh., asnjë dëm nuk do t'ju vijë nga unë. Supozoni se edhe në qoftë se më bie mua një padrejtësi e shtypje dhe vjen fatkeqësia mbi ju, ju nuk do të mund të shpëtoni prej saj duke u larguar prej meje, përkundrazi, duke vepruar kështu, ju do ta bënit vetveten tuaj më të meritushëm për fatkeqësi dhe për goditje. Pastaj çfarë ka ndodhur që ju të keni këto frikësime e dyshime të pabaza?..

• **Çështja e katërt:** Unë shikoj gjatë kohës së internimit tim se disa njerëz mburracakë të cilët kanë rënë në moçalin e politikave më shikojnë në një mënyrë që i përshtatet partishmërisë -njëanshmërisë, sektarizmit-, e rivalitetit, sikur unë jam lidhur me rrymat e kësaj dunjaje ashtu siç janë ata.

O ju Efendilerë! Unë jam në rrymën e besimit. Përballë meje është rryma e mosbesimit. Unë nuk kam lidhje me rrymat e tjera. Ndoshta disa nga ata që punojnë për një rrogë e shikojnë veteven si të justifikuar deri në një farë mase për të më kundërshtuar. Por, të marrë një qëndrim duke dalë kundra meje në rivalitet për asnjë rrogë apo shpërblim në emrin e patriotizmit, të më shqetësojë pareshtur e të më shtypë, ta dijë se ai njeri bën një gabim të rëndë, sepse, siç u provua më lartë, unë nuk kam lidhje fare me politikat e dynjasë. Unë ua kam dedikuar e kushtuar të gjithë kohën dhe jetën time të vërtetave të besimit dhe të Kur'anit. Meqenëse është kështu, atëherë le të mendojë ai i cili po më torturon e po më sulmon mua pareshtur në rivalitet se një trajtim i tij i tillë i ngjason të shkaktuarit dëm besimit në emrin e ateizmit dhe të mosbesimit.

• **Çështja e pestë:**

• *Meqenëse kjo botë është kalimtare.*

• *Meqenëse jeta është e shkurtër.*

• *Meqenëse detyrat vërtet esenciale janë të shumta.*

• *Meqenëse jeta e përhershme do të fitohet këtu.*

• *Meqenëse dynjaja nuk është pa pronar.*

• *Meqenëse kjo bujtinë e kësaj dynjaje ka një Drejtues Gjithëbujar e të Gjithurtë, meqenëse as e mira dhe as e keqja nuk do të mbeten pa shpërblim a dënim*

• *Dhe meqenëse sipas vërsetit,* لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا *"All-llahu nuk e rëndon askënd mbi mundësitë që ai ka."*[265]*, nuk është e detyruar ajo që është e papërballueshme dhe që nuk mund të kryhet,*

• *Meqenëse një rrugë e sigurt është e preferueshme mbi një rrugë të dëmshme,*

• *Meqenëse shokët e kësaj dynjaje dhe rangjet zgjasin vetëm deri tek dera e varrit.*

Atëherë sigurisht më fatbardhi është ai që nuk e harron Ahiretin për këtë dynja, nuk e sakrifikon Ahiretin për dynjanë, nuk e prish jetën e përhershme për jetën e dynjasë dhe nuk e harxhon jetën e tij në gjëra bajate e të kota, por e shikon veten se është një mysafir dhe vepron në përputhje me urdhërat dhe regullat e Pronarit të bujtinës; atëherë le ta hapë ai derën e varrit me besim dhe të hyjë në lumturinë e përjetshme me paqë...[266]

[265] Kur'an, 2: 286)

[266] Arsyeja për këto **"meqenëseve"** është kjo: Unë nuk u jap rëndësi padrejtësive dhe tiranisë që janë bërë kundra personit tim dhe nuk u kushtoj vëmendje. Unë them: "Nuk ia vlen të shqetësohesh për to"; dhe nuk ndërhyj në çështjet e dynjasë.

SHTOJCA E LETRËS SË GJASHTËMBËDHJETË

بِاسْمِهِ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

"Me Emrin e Tij që s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij."[267]

Pa asnjë arsye, "Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje" u bënë dyshues për një të huaj të pafuqishëm si personi im, dhe duke më imagjinuar se kam fuqinë e mijëra njerëzve, më vendosën nën kufizime të shumta e të forta. Ata nuk më dhanë leje që të qëndroj një ose dy netë në Bedre, një zonë e Barlas, as në njërin nga malet e Barlas. Unë dëgjova se ata thonë: *"Saidi ka një fuqi të barabartë me atë të pesëdhjetë mijë ushtarëve, prandaj ne nuk mund ta lirojmë atë."*

Ndërsa unë them: O ju njerëz fatkeqë që pikëpamja juaj është kufizuar tek kjo dynja! Si është që ju nuk i njihni çështjet e dynjasë, pavarësisht se po punoni për atë me të gjithë fuqinë tuaj dhe po qeverisni si të çmendur? Në qoftë se frika juaj është nga personi im i përkohshëm, kjo është një frikë që nuk justifikohet absolutisht, sepse një ushtar- dhe jo më pesëdhjetë mijë- mund të bëjë pesëdhjetë herë më shumë punë se sa unë, domethënë, ai mund të qëndrojë tek dera e dhomës sime dhe të më thotë mua: "Ti nuk mund të dalësh!"

Ndërsa, në qoftë se frika juaj është nga profesioni im i cili është thirje për tek Kur'ani, dhe nga fuqia morale e besimit me të cilën armatosem, atëherë ju duhet t'a dini se në lidhje me profesionin tim unë nuk kam fuqinë e pesëmbëdhjetë mijë ushtarëve, jeni të gabuar! Por kam fuqinë e pesëdhjetë milionëve, sepse nëpërmjet fuqisë së Kur'anit të gjithurtë, unë sfidoj të gjithë Evropën duke ju përfshirë edhe ju njerëzit femohues. Nëpërmjet dritave të besimit që kam botuar, unë kam shembur kështjellat e forta që ata i quajnë "shkencat filozofike dhe natyra". Unë i kam ulur më poshtë se sa kafshët filozofët më të mëdhenj të tyre femohues. Sikur të bashkohej e gjithë Evropa në të cilën të përfshiheshin edhe njerëzit tuaj femohues, nëpërmjet ndihmës së All-llahut xh.sh., ata nuk do të

[267] Kur'an, 17: 44)

mund të më bënin mua të mohoj dhe një çështje të vetme nga profesioni im. Dhe në dashtë Zoti, ata nuk do të mund të më shparatallojnë mua!..

Meqenëse çështja është kështu, ashtu siç nuk ndërhyj unë në çështjet e dynjasë suaj, atëherë edhe ju gjithashtu mos ndërhyni në Ahiretin tim!

Dhe mos bëni përpjekje! Në qoftë se ju do të bënit përpjekje, dijeni atëherë se ajo do të jetë pa frut dhe më kot!

Ajo që është paracaktuar nga All-llahu, nuk mund të kthehet me forcë; Një zjarr që është ndezur nga All-llahu, nuk mund të shuhet nga fryma.

Njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje janë jashtëzakonisht dhe tepër dyshues ndaj meje; mjaft thjesht, ata janë të frikësuar prej meje. Duke imagjinuar gjëra mosekzistuese tek unë, të cilat edhe në qoftë se do të ekzistonin, nuk mund të ishin shkak akuze, si qënia një sheh, ose një rang i rëndësishëm, ose një familje, ose si qënia e një udhëheqësi fisi, ose ndikuesi dhe pasja e ndjekësve të shumtë, ose takimi me njerëzit e vendlindjes sime, ose të qënurit i lidhur me çështjet e dynjasë, ose madje përfshirja në poltikë, ose në opozitë duke i imagjinuar këto gjëra që nuk gjenden tek unë, ata janë rrëmbyer nga dyshime të pabaza. Madje edhe në kohën kur po diskutonit çështjet e amnistisë për ata që janë në burg dhe jashtë tij, domethënë, ata që sipas tyre nuk i përfshin amnistia, më bllokuan e më ndaluan nga çdo gjë. Ndodhet një fjalë e mirë e përjetshme të cilën e tha një njeri i keq i përkohshëm:

Në qoftë se tirania ka artileri, pushkë dhe fortifikata, e drejta ka një krahë që nuk përthyhet, nuk përdridhet, dhe një fytyrë të pandryshueshme.

Dhe unë them:

> *Në qoftë se njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje kanë sundimin, forcën dhe fuqinë, kurse nëpëmjet shkëlqimit të Kur'anit, shërbëtori i tij;*
>
> *Ka dije të sigurt të palëkundur, një fjalë të paheshtur;*
>
> *një zemër të shëndoshë (që nuk mashtrohet), dhe ka një dritë të pashuar.*

Një komandant ushtarak nën mbikqyrjen e të cilit unë isha dhe disa shokë në mënyrë të përsëritur, më bënin këtë pyetje: “Përse nuk paraqet kërkesë për të marrë dokumentat e lirimit?”

Përgjigjja: Unë nuk paraqes kërkesë dhe unë nuk mund ta bëj kërkesën për pesë ose gjashtë arsye:

• **E para*:*** *Unë nuk kam ndërhyrë as në çështjet e njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje dhe as në dynjanë e tyre, që unë të jemë i dënuar nga ana e tyre dhe prandaj unë nuk duhet t’u paraqes kërkesë lidhur me këtë. Përkundrazi, unë i drejtohem Kaderit Hyjnor, sepse ai më ka dënuar mua për mangësitë dhe gabimet e mia ndaj tij.*

• **E dyta:** *Unë besoj dhe kam njohje të sigurt se kjo dynja është një bujtinë që ndryshon shpejt. Kështu, ajo nuk është një atdhe i vërtetë dhe gjithandej është e njëjta. Meqenëse unë nuk do të qëndroj përjetësisht në atdheun tim, do të ishte e kot të bësh përpjekje për të; nuk ia vlen të shkosh atje. Meqenëse gjithkund kjo dynja është një bujtinë, në qoftë se mëshira e Pronarit të bujtinës do të të zinte mik, atëherë gjithkush do të ishte një mik dhe çdo vend do të ishte i këndshëm. Ose ndryshe, në qoftë se ajo nuk do të të bënte mik,çdokush do të ishte armiqësor dhe çdo vend do të ishte një peshë e rëndë dhe ngushtësi e fortë në zemër.*

• **E treta:** Paraqitja e kërkesës mund të bëhet brenda suazës së ligjit. Por mënyra që unë jam trajtuar këto gjashtë vite ka qenë arbitrare dhe e jashtëligjshme. Ligji i internimeve nuk është zbatuar për mua. Ata më kanë shikuar sikur të kisha qenë i zhveshur e i privuar nga të gjitha të drejtat e civilizimit, dhe madje nga të gjitha të drejtat e dynjasë. Atëherë t’u paraqesësh kërkesën në emër të ligjit atyre, trajtimet e të cilëve me mua kanë qënë kështu të jashtëligjshme, do të ishte e pakuptim.

• **E katërta:** Këtë vit një zyrtar lokal paraqiti kërkesë për mua në emrin tim për të qëndruar për disa ditë në fshatin e Bedres, i cili është si një zonë e Barlas për një ndryshim ajri e klime dhe nuk më lejuan. Si mund t’u paraqitet kërkesa këtyre që refuzojnë një kërkesë të tillë të thjeshtë timen? Atëherë, në qoftë do t’u paraqisja atyre kërkesë, kjo do të ishte e padobishme dhe një ulje poshtëruese.

• **E pesta:** *Të kërkosh një të drejtë përpara atyre që e pretendojnë të drejtën si të padrejtë dhe t’u paraqesësh kërkesë atyre, kjo do të ishte një padrejtësi, do të ishte mungesë respekti*

ndaj së drejtës. Unë nuk dëshiroj të bëj një padrejtësi të tillë dhe të mos tregoj respekt për të drejtën. Dhe ajo është ashtu.

• **E gjashta:** Vuajtjet dhe vështirësitë që m'i kanë shkaktuar njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje nuk kanë qenë për shkak të politikës, sepse ata e dinë mirë që unë nuk përzihem në çështjet politike, përkundrazi, unë iki prej tyre. Ata, me dijeni apo pa dijeni, më tortuojnë për llogari të ateizmit agresiv për shkak të lidhjes sime me fenë. Prandaj t'u paraqesësh kërkesë atyre, do të thotë të shfaqësh pendim për fenë dhe të lajkatosh e të mburrësh rrugën e ateizmit agresiv.

Për më tepër, Kaderi Hyjnor, i cili është i drejtë, do të më ndëshkonte mua nëpërmjet duarve të tyre tiranike e mëkatare në qoftë se do t'u bëja kërkesë atyre dhe nëse do t'u drejtohesha për ndihmë, sepse ata po më shtypin për shkak të qënies sime i lidhur me fenë. Sa për kaderin Hyjnor, kohë pas kohe ai po më shtyp për shkak të hipokrizisë sime përpara 'njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, për shkak të mangësive të mia në fe e në sinqeritet. Meqenëse kjo është kështu, për kohën e tanishme unë nuk mund të jem i shpëtuar nga këto vuajtje e vështirësi. Në qoftë se unë do t'u drejtohesha për ndihmë njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, Kaderi Hyjnor do të thonte: "O hipokrit, paguaje dënimin për paraqitje kërkese!" Dhe në qoftë se unë nuk paraqes kërkesë, njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje do të thonin: "Ti nuk na pranon ne, atëherë vazhdo të vuash vështirësi!"

• **Arsyeja e shtatë:** Është e mirënjohur se detyra e një nëpunësi zyrtar është që të mos u japë asnjë rast individëve të dëmshëm me qëllim që të mos i shkaktojnë dëm shoqërisë dhe të ndihmojnë ata që janë të dobishëm. Ndërsa unë po i shpjegoja një aspekt të hollë të besimit që përfshihet në Fjalën لَآ إِلَٰهَ إِلَّا ٱللَّهُ *Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut"* një miku të moshuar i cili i është afruar derës së varrit, më erdhi nëpunësi zyrtar i cili më mbante nën arrest, sikur unë të sillesha keq e të bëja ndonjë krim, ndonëse ai nuk kishte ardhur tek unë për t'u interesuar për shumë kohë më parë. Ai i shkaktoi personit të sinqertë, që po dëgjonte, të privohej, dhe mua më shkaktoi zemërim. Ndodheshin disa njerëz, të cilëve ai nuk u dha rëndësi. Pastaj kur ata u sollën në mënyrë të panjerëzishme, në një mënyrë që do të helmonte jetën e shoqërisë në atë fshat, ai filloi të ishte i dashur, i shkueshëm me ta dhe vlerësues ndaj tyre.

Për më tepër, është e mirënjohur se sikur një kriminel të kishte bërë njëqind krime, ai mund të takohet me personat zyrtarë që e mbikëqyrin atë, qofshin ata zyrtarë të një rangu të lartë apo të ulët. Por në këtë vitin e fundit, megjithëse dy njerëz të rëndësishëm në qeverinë qëndrore të ngarkuar me detyrën e mbikëqyrjes sime kanë kaluar disa herë pranë dhomës sime, ata nuk janë takuar absolutisht me mua dhe as nuk kanë pyetur për gjendjen time. Në fillim unë supozova se ata nuk u afruan tek unë për shkak të armiqësisë, por më vonë u bë e qartë se ajo ishte për shkak të dyshimeve të tyre të frikshme.. ata iknin prej meje sikur unë do t'i përpija. Kështu, të njohësh një qeveri, anëtarët dhe zyrtarët e së cilës janë të ngjashëm me ata njerëz dhe t'i drejtohesh për ndihmë asaj e t'i paraqesësh kërkesë, nuk është e arsyeshme, por një poshtërim i kotë.

Në qoftë se do të kishte qenë Saidi i Vjetër, ai do të thonte si Antere: وَجَهَنَّمُ بِالْعِزِّ أَفْخَرُ مَنْزِلِ مَاءُ الْحَيَاةِ بِذِلَّةٍ كَجَهَنَّمَ

"Edhe uji i jetës bëhet Ferr (Xhehennem) nëpërmjet poshtërimit, ndërsa Ferri me dinjitet bëhet një vend krenarie."

Saidi i Vjetër nuk ekziston më, ndërsa Saidi i Ri "e quan të pakuptim madje edhe të folurit me me njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje, le të jetë dynjaja e tyre fundi i tyre!" Ata mund të bëjnë çfarë të duan. Ai rri i heshtur, duke thënë, ne do të gjykohemi së bashku me ta në Gjyqin e Fundit.

• **Arsyeja e tetë** për mosparaqitjen e kërkesës sime: Në përputhje me rregullin, "rezultati i një dashurie të paligjshme është torturë e pamëshirshme," Kaderi Hyjnor, i cili është i drejtë, më torturon mua nëpërmjet dorës despotike të njerëzve të dhënë vetëm pas dynjasë, për shkak se unë prirem drejt tyre, pasi ata nuk janë të denjë për të, dhe duke thënë, unë e meritoj këtë torturë, unë rri i heshtur, *sepse në Luftën e Parë Botërore unë luftova dhe shërbeva për dy vjet si komandant i një regjimenti vullnetarësh. I brohoritur dhe i lavërdruar nga komandanti i përgjithshëm i ushtrisë dhe nga Enver Pasha, unë sakrifikova studentët e mi të çmuar dhe shokët. Unë u plagosa dhe u zura rob.*

Duke u kthyer nga mbajtja si rob lufte, unë e hodha veten time në rrezik nëpërmjet veprave si hartimi i një libri ***"Hutuvatë sitte"*** *"Shtatë hapat" duke vënë në shënjestër me të kokat e anglezëve, të cilët kishin shtypur Stambollin. Unë i ndihmova ata që më mbajtën mua pa ndonjë shkak në këtë torturë dhe zënie rob, kurse ata po më*

ndëshkojnë në këtë mënyrë për atë ndihmë. Ata shokë këtu më shkaktuan në tre muaj mundimet dhe vështirësitë që vuajta në tre vite si rob lufte në Rusi.Por rusët nuk më penguan nga dhënia e mësimeve fetare, pavarësisht se ata më shikonin si një komandant i ushtarëve vullnetarë kurdë, si një njeri mizor që kishte therrur kazakët (njerëz nga Rusia Jugore, Ukrahina dhe Siberia) dhe robërit e luftës. Unë u jepja mësim shumicës së shokëve të mi të zënë robër lufte prej oficerëve, numri i të cilëve arriti nëntëdhjetë oficerë, saqë njëherë, komandanti rus erdhi e dëgjoi mësimin. Për shkak se ai nuk e njihte turqishten, ai mendoi se është instruksion politik dhe më ndaloi vetëm njëherë, por më vonë ai dha leje. Gjithashtu në të njëjtën kazermë ne bëmë një dhomë si xhami dhe unë drejtoja faljen me xhemaat si imam. Ata nuk ndërhynë fare dhe nuk më ndaluan nga përzierja dhe as nga komunikimi me të tjerët.

Ndërsa shokët e mi këtu, bashkëqytetarët e mi dhe njëfetarët -të të njëjtës fe- dhe ata që për dobitë e të cilëve në formën e besimit fetar unë jam përpjekur, më kanë mbajtur në një robëri torturuese jo për tre vjet, por për gjashtë pa asnjë arsye absolutisht, dhe megjithëse ata e dinë që unë i kam këputur lidhjet e mia me dynjanë dhe me politikën. Ata më kanë ndaluar nga përzierja me të tjerët. Ata më kanë ndaluar nga të dhënit e mësimit fetar, pavarësisht se unë kam një dëshmi për të, madje ata më kanë ndaluar edhe nga dhënia e mësimit privat në dhomën time. Ata më kanë ndaluar nga komunikimi me të tjerët. Madje ata më kanë penguar nga xhamia të cilën e riparova dhe tek e cila veprova si imam falje për katër vjet, ndonëse unë e kisha dokumentin e nevojshëm. Dhe tani, për të më privuar nga sevapi i kryerjes së faljeve me xhemaat, ata nuk më pranojnë si imam falje as për tre individë të thjeshtë, xhematin tim të përhershëm dhe vëllezërit e Ahiretit.

Përveç kësaj, pavarësisht se unë nuk e dëshiroj, në qoftë se dikush perj tyre më quan të mirë, nëpunësi zyrtar i cili më mban mua nën arrest bëhet xheloz dhe zemërohet, dhe përpiqet me të gjitha mënyrat, pa e vrarë ndërgjegjja, për të shkatërruar influencën time, me qëllim që t'u bëjë lajka eprorëve të tij e që të përfitojë prej tyre.

Kujt mundet dikush në një pozitë të tillë t'i drejtohet për ndihmë përveç Zotit të Plotfuqishëm? Në qoftë se gjykatësi është gjithashtu pretenduesi, natyrisht atij nuk mund t'i ankohesh. Hajde, thuaj ti! Çfarë mund t'i themi kësaj? Thuaj çfarë të duash, ndërsa unë them këtë: Ndodhen shumë hipokritë midis këtyre shokëve të mi. Hipokriti

është më i keq se sa mohuesi. Për këtë arsye, ata më bëjnë të vuaj torturë çka nuk më bënë mua të vuaj as rusët ateistë...

Dhe kështu, o ju fatkeqë! Çfarë u kam bërë dhe çfarë jam duke bërë? Unë po përpiqem të shpëtoj besimin tuaj dhe po i shërbej lumturisë suaj të përjetshme! Duket se shërbimi im nuk është ende i sinqertë dhe thjesht për hir të All-llahut xh.sh., prandaj ai ka efektin e kundërt. Si shpërblim, ju më torturuat mua në çdo rast. Sigurisht, ne do të takohemi në Gjyqin e Fundit, në Gjykatën më të madhe...

Dhe unë them: [حَسْبُنَا ٱللَّهُ وَنِعْمَ ٱلْوَكِيلُ] [نِعْمَ ٱلْمَوْلَىٰ وَنِعْمَ ٱلنَّصِيرُ]

"All-llahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve."[268] *"All-llahu është Mbrojtësi më i mirë, dhe më i Miri i Ndihmuesve!"*[269]

ٱلْبَاقِي هُوَ ٱلْبَاقِي

I Qëndrueshmi i vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!

Said Nursi

* * *

[268] Kur'an, 3: 173
[269] Kur'an, 8: 40

Letra nga Burgu

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Paqja qoftë mbi ju si dhe mëshira e Zotit dhe bekimet e Tij.

Vëllezërit e mi të dashur besnikë!

Unë do të shpjegoj në **"Tre Pika"** një ngushëllim të dobishëm për ata që po vuajnë fatkeqësinë e burgut, dhe për ata të cilët me mirësi i ndihmojnë dhe besnikërisht përkujdesen dhe mbikëqyrin ushqimin e tyre, i cili vjen nga jashtë.

● **Pika e parë**: Për çdo ditë nga ditët e jetës, të cilat kalojnë në burg, njeriu mund të fitojë shpërblimin e ibadetit të dhjetë ditëve dhe në efekt mund t'i kthejë orët e tij kalimtare -për sa ka të bëjë me rezultatin- në orë të qëndrueshme të përjetshme. Madje kalimi i pesë ose dhjetë viteve në burg mund të jetë mjet shpëtimi prej një burgu të përjetshëm të miliona viteve.

Kështu, ky fitim i madh është i kushtëzuar për njerëzit e besimit me kryerjen e faljeve të detyruara, me pendimin nga gjynahet që ishin shkaku i burgosjes së tij, dhe me falënderime plot durim. Sigurisht, burgu është një pengesë për shumë gjynahe, ai nuk u jep rast atyre mëkateve.

● **Pika e dytë**: Ashtu si zhdukja e kënaqësisë që shkakton dhimbje, po ashtu zhdukja e dhimbjes jep kënaqësi.

Po, duke menduar ditët e lumtura dhe të kënaqshme të së shkuarës, gjithkush ndjen një dhimbje dëshpërimi shpirtëror, përmallim dhe thotë: "Ah medet!" Dhe duke kujtuar ditët e kobshme e të mërzitshme të së shkuarës, përjeton një lloj kënaqësie meqenëse ato kanë kaluar dhe thotë: "Lavdërimi dhe falënderimi i takojnë Zotit xh.sh.", që fatkeqësia ka lënë shpërblimin e saj dhe është larguar. Ai psherëtin i lehtësuar. Domethënë një dhimbje e përk-ohshme që zgjat një orë, lë prapa një lloj kënaqësie shpirtërore në shpirt, ndërsa një orë e kënaqshme lë një dhimbje.

Meqenëse realiteti është ky, meqenëse orët e kobshme të kaluara së bashku me dhimbjet e tyre nuk ekzistojnë më e janë

zhdukur, dhe ditët dëshpëruese të së ardhmes janë gjithashtu mosekzistuese në kohën e tashme, dhe se nuk ka dhimbje nga asgjëja, pra nuk vjen dhimbje nga mosekzistenca, atëherë do të ishte marrëzi t'i shfaqësh ankesë tani për orët e dhimbjes së të shkuarës dhe të së ardhmes, të cilat janë mosekzistuese dhe të zhdukura. Përsëri, do të ishte marrëzi ta lësh nefsin urdhërues për të liga e neglizhent pa i kërkuar llogari dhe pastaj ta kalojë kohën me brenga e dëshpërime... A nuk është ky i tillë që vepron kështu një idiot më i madh se sa ai i cili vazhdon duke ngrënë e duke pirë gjatë gjithë ditës pa ndërprerë nga frika se mos bëhet i etur ose i uritur pas disa ditësh?

Po, sa kohë që fuqia e durimit nuk shpërndahet nga e majta e nga e djathta, domethënë, tek e shkuara dhe tek e ardhmja dhe mbahet fort në fytyrën e orës së tanishme dhe të ditës aktuale, kjo do të ishte e mjaftueshme që dëshpërimet të bien nga dhjetë në një.

Madje mua më kujtohet -dhe nuk po ankohem- se ato fatkeqësi, goditje materiale e shpirtërore, sëmundje e vuajtje që nuk i kisha përjetuar kurrë më parë në jetën time, më ranë brenda pak ditëve ndërsa isha në shkollën e tretë Jusufie. [270] Unë po dërrmohesha në mënyrë të veçantë nga dëshpërimi dhe pikëllimi i zemrës dhe i shpirtit që u shkaktua nga privimi e pamundësia për t'i shërbyer Kur'anit dhe besimit nëpërmjet Risale-i Nurit. Befas, përkujdesja Hyjnore më tregoi të vërtetën e lartëpërmendur, ndërkohë unë u ndjeva i kënaqur me sëmundjen time dëshpëruese dhe me burgosjen, sepse, duke thënë: "Është një përfitim i madh për një njeri të mjerë si unë, i cili pret tek dera e varrit, që ta shndërrojë një orë nga orët, e cila mund të kalojë në shkujdesje, në dhjetë orë ibadet." Kështu unë e falënderova shumë All-llahun xh.sh. .

● **Pika e tretë:** Ndodhet një fitim i madh me pak përpjekje kur i ndihmon me mëshirë të burgosurit, duke u dhënë atyre ushqimin që kanë nevojë, duke qetësuar plagët e tyre shpirtërore me ngushëllim dhe duke u dhënë furnizimet ushqimore që u vijnë nga jashtë. Këto vlerësohen si dhënie lëmoshe, sa sasia e atyre furnizimeve, dhe shkruhen në regjistrin e punëve të mira të atyre që i marrin përsipër këto shërbime, qofshin ata të cilët i sollën ato ushqime nga jashtë, apo rojet e mbikëqyrësit të cilët i ndihmuan ata, dhe sidomos në qoftë se i burgosuri është i vjetër, ose i sëmurë, ose i varfër ose i vetmuar, atëherë shpërblimi i kësaj dhënie sadekaje shpirtërore rritet shumë herë më tepër.

---

[270] Aludon për burgun e Afjonit kur hyri ustadh Said Nursi. (përkthyesi)

Kështu, kushti i këtij përfitimi të vlefshëm është të kryesh faljet e detyruara, me qëllim që një shërbim i tillë të jetë për hir të Zotit xh.sh..

Dhe një kusht tjetër është të nxitosh për t'i ndihmuar ata me sinqeritet, me mëshirë e gëzim dhe në një mënyrë të tillë që të mos i bësh ata të ndjehen borxhli dhe të detyruar kundrejt teje.

* * *

Një shtojcë e shkurtër nga "Udhëzuesi për të rinjtë"

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Ata që janë në burg ndjejnë nevojën më të madhe për ngushëllimin e vërtetë të Risale-i Nurit. Në mënyrë të veçantë ata të rinj të cilët duke vuajtur goditjet e rinisë, po i kalojnë jetët e tyre të reja e të këndshme në burg, kanë aq shumë nevojë për Risale-i Nurin, aq sa kanë nevojë për bukën.

Në të vërtetë, rinia më shumë u jep rëndësi ndjenjave se sa arsyes, dhe ndjenjat, emocionet dhe dëshirat janë të verbëra; ato nuk i marrin në konsideratë pasojat. Ato preferojnë një ons[271] të kënaqësisë së çastit mbi tonet e kënaqësisë së ardhme. Ata të rinj bëjnë vrasje për hir të një minuti kënaqësie hakmarrjeje dhe atëherë vuajnë tetëdhjetë mijë orë dhimbjen e burgut. Një orë kënaqësie e shthurjes në çështjen e nderit mund të shkaktojë nga prapa dhimbjet e mijëra ditëve prej frikës së burgut dhe të armiqve, të cilat shkatërrojnë me shqetësime lumturinë e jetës.

Ka edhe shumë kurthe e gracka të tjera, si shembulli i këtyre, për të rinjtë e mjerë për shkak të të cilave ato i transformojnë jetët e tyre më të ëmbëla në jetë të mjeruara e të hidhura. Merre në konsideratë shtetin e madh të veriut; ai ka shtënë në dorë pasionet e të rinjve të tij dhe po e trondit këtë shekull me stuhitë e tij; sepse ai ka bërë të ligjshme për të rinjtë e tij bijat e këndshme dhe gratë e njerëzve të drejtë. Këta të rinj veprojnë vetëm sipas ndjenjave të tyre, të cilat janë të verbëra ndaj të gjitha pasojave. Në të vërtetë, duke i

[271] 283 g.

lejuar burrat dhe gratë të shkojnë bashkë në banja publike, ata po nxisin imoralitetin. Ata e konsiderojnë të ligjshme për vagabondët dhe për të varfërit të plaçkisin pasuritë dhe pronat e të pasurve. I gjithë njerëzimi dridhet përpara këtyre krimeve dhe katastrofave.

Dhe prandaj është gjëja më e domosdoshme në këtë shekull për të rinjtë muslimanë dhe të rinjtë Turq të veprojnë heroikisht, dhe t'i përgjigjen këtij sulmi që bëhet nga dy drejtime, me shpatat e mprehta, si: "Frutat e Besimit", dhe "Udhëzuesi për Rininë", nga Risale-i Nuri. Përndryshe, ata të rinj të mjerë do të shkatërrojnë krejtësisht edhe të ardhmen e tyre në këtë botë, edhe jetët e tyre të këndshme, si dhe lumturinë e tyre në Ahiret dhe jetët e tyre të përhershme, duke i transformuar ato në tortura e vuajtje. Dhe për shkak të abuzimeve dhe shthurjeve ata përfundojnë në spitale, dhe për shkak të mendje-madhësisë dhe teprive në jetë ata bien në burgje. Në moshën e tyre të pleqërisë ata do të qajnë me hidhërim, me mijëra dhimbje e dëshpërime.

Në qoftë se, nga ana tjetër, ata e mbrojnë vetveten me edukimin e Kur'anit dhe me të vërtetat e Risale-i Nurit, ata do të bëhen vërtetë të rinj heroikë, qënie të plota njerëzore, muslimanë të suksesshëm dhe në disa mënyra sundues mbi qëniet e gjalla dhe mbi pjesën tjetër të botës shtazore.

Po, kur një i ri në burg shpenzon një orë nga njëzet e katër orët e ditës së tij të përditshme për kryerjen e pesë kohëve të detyruara të faljes dhe meqenëse burgu bëhet një pengues për gjynahet më të shumta dhe, nëse pendohet për gabimet që ishin shkaku i fatkeqësisë së tij dhe largohet nga mëkatet e tjera të dëmshme dhe të dhimbshme, ashtu siç do të jetë kjo një dobi e madhe për jetën e tij, për të ardhmen e tij, për vendin e tij, për kombin e tij dhe për të afërmit, po ashtu ai do të fitojë me rininë e tij të përkohshme, e cila zgjat dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet, një rini të ndritur të përjetshme. Këtë të vërtetë e sihariqojnë dhe e njoftojnë në mënyrë të sigurt të gjitha librat e shpalluar qiellorë, me në krye Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm.

Po, në qoftë se një i ri i tillë shfaq mirënjohjen për mirësinë e këndshme e të kënaqshme të rinisë nëpërmjet maturisë, përmbajtjes, bindjes dhe duke kryer ibadetin, ajo mirësi e dhuruar shtohet dhe nuk pakësohet dhe qëndron pa zhdukje, si dhe bëhet më e këndshme dhe më e bukur. Përndryshe, ajo do të bëhej e kobshme, e dhimb-shme, e trishtueshme dhe tmerr, dhe atëherë ajo do të largohej. Ajo do t'i

shkaktonte atij të bëhej si një rrugaç dhe i dëmshëm për të afërmit e tij, për atdheun e tij dhe për kombin e tij.

Në qoftë se i burgosuri është dënuar padrejtësisht, me kusht që ai të kryejë faljet e detyruara, çdo orë do të ishte e barasvlefshme me adhurimin e një dite, dhe burgu do të ishte për të si një qeli, si një vend i veçuar e i mbyllur nga bota. Ai do të konsiderohej si një oshënar midis të drejtëve të kohëve të lashta, të cilët largoheshin për në shpellë që t'ia kushtonin vetveten e tyre adhurimit. Kështu ai mund të jetë si ata oshënarë.

Në qoftë se ai është i varfër, i moshuar, i sëmurë dhe i dëshiruar për të vërtetat e besimit, me kusht që ai të kryejë faljet e detyruara dhe të pendohet, çdo orë do të bëhej e barasvlefshme me adhurimin e njëzet orëve dhe burgu do të bëhej si një shtëpi pushimi për të, dhe për shkak të miqve të tij atje që e vlerësojnë atë me dashuri, burgu bëhet një vend dashurie, trajnimi dhe edukimi. Ai ndoshta do të jetë më i lumtur të qëndrojë në burg se sa të jetë i lirë, sepse jashtë ai ngatërrohet dhe zbulohet para sulmeve të mëkateve nga të gjitha anët. Ai mund të marrë një edukim të plotë nga burgu dhe kur të lirohet nga burgu ai nuk është më vrasës, as i etur për hakmarrje, por është si ndonjë i penduar, i provuar në jetë, që ka fituar sjellje të mirë dhe i dobishëm për kombin e tij. Në fakt, të burgosurit e qytetit të Denizlit u bënë aq me sjellje të mira, në mënyrë të jashtëzakonshme pasi studiuan Risale-i Nurin vetëm për një kohë të shkurtër, saqë disa prej atyre që panë këtë rezultat, thanë: "Të lexosh Risale-i Nurin për pesëmbëdhjetë javë është më efektive për reformimin dhe rregullimin e tyre, se sa t'i fusësh ata pesëmbëdhjetë vjet në burg."

Meqenëse vdekja nuk vdes dhe exheli është i fshehur, ai mund të vijë në çdo kohë; dhe meqenëse varri nuk mund të mbyllet, dhe grup pas grupi hyjnë në të e humbasin; dhe meqenëse është treguar nëpërmjet të vërtetave të Kur'anit se për ata që besojnë, vdekja transformohet në fletë shkarkimi duke i liruar ata nga asgjësimi i përjetshëm, ndërsa për të këqinjt e të shthururit ajo është zhdukje përgjithmonë në asgjësim të përhershëm, ashtu siç shikohet me sy nga ana e jashtme, dhe është një ndarje e pambarim nga të dashurit dhe nga të gjitha qëniet, sigurisht dhe pa asnjë dyshim, njeriu më fatlum është ai i cili me durim dhe falënderime përfiton nga koha e tij në burg dhe, duke studiuar Risale-i Nurin, punon për t'i shërbyer Kur'anit dhe besimit të tij në rrugën e drejtë.

O njeri i sprovuar me ëndje dhe kënaqësi! Unë jam shtatëdhjetë e pesë vjeç dhe njoh me siguri të plotë nga mijëra eksperienca, prova dhe ngjarje, se kënaqësia e vërtetë, ëndja pa dhimbje, gëzimi pa hidhërim dhe lumturia e jetës gjenden vetëm në besim dhe në sferën e të vërtetave të besimit. ***Ndërsa një kënaqësi e vetme e kësaj dyjnaje shkakton dhimbje të shumta, sepse dynjaja, ndërsa të jep kënaqësinë sa një kokërr rrushi, por ama ajo të godet me dhjetë shuplaka pikëlluese duke ta plaçkitur kënaqësinë e jetës.***

O njerëz të mjerë që po vuani fatkeqësinë e burgut!.. Meqenëse bota juaj po qan dhe është e dëshpëruar dhe jeta juaj është turbulluar me dhimbje e fatkeqësi, atëherë bëni përpjekjet tuaja me qëllim që të mos qajë Ahireti juaj, dhe që jeta e juaj e përhershme të buzëqeshë e të jetë e ëmbël! Përfitoni nga burgu, sepse ashtu si ndonjëherë, nën rrethana të vështira përballë armikut, që vrojtimi i një ore mund të jetë i barasvlershëm me ibadetin e një viti, po ashtu në këto rrethana të vështira, mundimi i çdo ore i shpenzuar në adhurim bëhet i barasvlershëm me shumë orë; ai e transformon mundimin në mëshirë.

* * *

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë nuk ju sjell juve ngushëllimet e mia, por përshëndetjet e mia. Meqenëse për disa shembuj urtësie Kaderi Hyjnor na ka dërguar neve tek kjo shkolla e tretë e Jusufit, *-El-medresetu El-Jusufie* -, dhe se Ai do të na japë me ngrënë neve një pjesë të rëzqeve -ushqimeve- tona këtu, dhe rëzqet tonë na kanë bërë ftesë neve për këtu. Dhe meqenëse ashtu siç e kemi kuptuar me siguri nga eksperiencat tona të kaluara, mirësia dhe Përkujdesja Hyjnore ka manifestuar tek ne kuptimin e vërsetit, *"Ë ndodh që ju mund të mos e pëlqeni një gjë që është në të vërtetë e mirë për ju".*[272] dhe meqenëse vëllezërit tonë të rinj këtu në këtë shkollë të Jusufit janë më të nevojshmit e njerëzve për ngushëllimin që e sjell Risale-i Nuri, dhe se punonjësit në zyrat e drejtësisë janë më të nevojshëm se sa nëpunësit e tjerë për rregullat dhe për parimet e shenjta që i përmban Risale-i Nuri, dhe se pjesët e Risale-i Nurit e përmbushin për ju detyrën tuaj jashtë burgut, dhe pushtimet e tyre nuk ndalojnë, atëherë çdo orë kalimtare këtu në burg është e barasvlefshme me orë të përjetshme të kaluara në ibadet; sigurisht për shkak të këtyre pikave, ne duhet që me gëzim të bëjmë falënderime për këtë çështje me durim të plotë dhe me qëndrueshmëri.

---

[272] Kur'an, 2 :216

Unë do t'i përsëris ekzaktësisht për ju të gjitha letrat e shkurtëra që unë i kam shkruar si ngushëllim në Burgun e Denizlit.

I lutemi Allahut që t'ju ngushëllojnë gjithashtu edhe ato paragrafe të mbushura me të vërteta.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Unë i jap Allahut të Gjithëfuqishëm falënderime të pafundme që heronjtë janë shfaqur prej myftive, predikuesve, imamëve dhe hoxhallarëve, të cilët janë pretenduesit -pronarët- e vërtetë të Risale-i Nurit. Deri tani kanë qenë të rinjtë, ata të edukuar në shkollat laike, dhe mësuesit e tyre që i janë përkushtuar Risale-i Nurit. Tani, lavdi Allahut dhe në sajë të Zotit, o Ed'Hem, Ibrahim dhe o Ali... Ju i keni zbardhur fytyrat e studentëve dhe të mësuesve të shkollave fetare, dhe e keni transformuar ngurrimin dhe druajtjen e tyre në kurajo e guxim.

Së Dyti: Ata nuk duhet të dëshpërohen rreth këtij incidenti, i cili ndodhi për shkak të aktiviteteve të tyre të sinqerta për hir të Zotit xh.sh. dhe për shkak të ngacmimit. Sepse në lidhje me rezultatet e tij, Burgu i Denizlit u shkaktoi atyre që kishin vepruar pa kujdes të përshëndeteshin. Vështirësitë e tij ishin shumë të pakta dhe dobitë shpirtërore ishin të shumta.

I lutemi Allahut xh.sh. që kjo shkolla e tretë e Jusufit të mos mbetet prapa të dytës.

Së Treti: Meqenëse meritat dhe shpërblimet shtohen në përpjesëtim me vështirësitë, ne duhet të japim falënderime për këto kushte e rrethana. Ne duhet të përpiqemi të kryejmë detyrat tona në shërbim të besimit fetar me sinqeritet, i cili është detyra jonë, dhe jo të shqetësohemi për qënien të suksesshëm ose për të fituar rezultate të mira, gjë e cila i përket vetëm Allahut. Ne duhet të themi: "Çështjet më të mira janë më të vështirat".

Ne duhet ta dimë se kjo ngjarje është veçse një shenjë për pranimin e punëve tona, dhe ajo është një diplomë -dokument- që e kemi kaluar provimin e luftës sonë të shenjtë.

• • •

Unë kam një kërkesë që dua t'ua paraqes administratorëve të burgut dhe kryesisht drejtorit të burgut, e cila në dukje është e parëndësishme, por ka rëndësi të madhe në sytë e mi.

Pasi kam kaluar njëzet e dy vite në një izolim total, trupi im shtatëdhjetë e pesë vjeçar nuk mund t'i durojë vaksinat kundra sëmundjeve. Në fakt, para një kohë të gjatë mua më bënë vaksinë, dhe ajo la një plagë të qelbëzuar e cila ka vazhduar për njëzet vite. Ajo ishte si një helmim kronik. Dy doktorët në Emirdag dhe shokët e mi atje e dinë këtë. Gjithashtu, para katër vitesh në Denizli ata më bënë vaksinë mua së bashku me të gjithë të burgosurit e tjerë. Megjithëse nuk pati efekte mbi asnjërin prej tyre, ajo më bëri mua të sëmurë për tre javë. Nëpërmjet Ruajtjes Hyjnore, unë nuk u detyrova të shkoja në spital.

Domethënë, është krejtësisht e sigurt se trupi im nuk mund t'i përballojë vaksinat. Edhe arsyet e mia janë të forta, edhe qënia ime tej mase i dobët në moshën shtatëdhjetë e pesë vjeç, dhe ndoshta trupi im do të mund të përballonte vetëm një vaksinë të një fëmije dhjetë vjeç. Për më tepër, kjo është për shkak se e kam kaluar jetën time i veçuar në një izolim të plotë, dhe nuk kam kontakt me asnjë.

Gjithashtu, para dy muajsh guvernatori i provincës dërgoi dy doktorë për në Emirdag që të më bënin mua një ekzaminim të plotë mjekësor.

Ata nuk mundën të gjejnë asnjë shenjë të ndonjë sëmundjeje ngjitëse, përveç dhembjes së mesit -në kryqe, dhe që isha shumë i dobët, i vjetër dhe i vetmuar.

Kjo gjendja ime sigurisht që nuk më obligon mua për të bërë vaksinë.

Unë gjithashtu kam një kërkesë shumë të rëndësishme për ju: Mos më çoni mua në spital. Mos më detyroni mua për një situatë që unë nuk kam mundur ta përballoj këto njëzet e dy vite të qënies sime i veçuar dhe i mbyllur; domethënë, të vihem nën urdhërat e mjekëve dhe të atyre që nuk i njoh.

Unë kam filluar të mendoj për hyrjen në varr duke qenë i kënaqur, por për tani kam zgjedhur burgun, për hir të administratorëve të burgut, humanizmin e të cilëve unë e kam dëshmuar, dhe për të ngushëlluar të burgosurit e tjerë.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Mos u pikëlloni -o vëllezërit e mi- për fyerjet dhe keqtrajtimet që i drejtohen personit tim. Sepse ata nuk mundën të gjenin ndonjë mangësi në Risale-i Nur, dhe merren me personin tim të zakonshëm e me shumë të meta. Unë jam i kënaqur me këtë gjendje.

Madje edhe sikur të gjeja me mijëra fyerje, poshtërime, dhimbje e fatkeqësi personale për hir të shpëtimit të Risale-i Nurit dhe të shfaqjes së vlerës së tij, unë do ta falënderoja Allahun me krenari; dhe këtë me kërkesë të asaj që kam mësuar prej mësimit të Risale-i Nurit.

Prandaj mos u pikëlloni për mua nga ky aspekt.

Së Dyti: Ky sulm i gjërë, i ashpër dhe i pamëshirshëm ka filluar tani të ulet njëzetfish. Ata kanë grumbulluar pak njerëz në vend të mijëra studentëve të veçantë *Ha's* të Risale-i Nurit, dhe kanë grumbulluar një numër të kufizuar prej vëllezërve të rinj në vend të qindra mijërave prej atyre që janë të interesuar për Risale-i Nurin dhe janë të lidhur me të. Domethënë, fatkeqësia është transformuar në më të lehtën e gjendjeve me Përkujdesjen Hyjnore.

Së Treti: Mos u shqetësoni, o vëllezërit e mi, mos u dëshpëroni dhe mos i këpusni shpresat, sepse guvernatori i mëparshëm i provincës i cili për dy vite ka kurdisur komplote kundra nesh ka ikur në sajë të Përkujdesjes Hyjnore. Dhe ka një mundësi të fortë se ministri i brendshëm, dyshimet e të cilit kanë qenë shumë kundra nesh, e kanë lehtësuar sulmin e egër kundra nesh për dy arsye: sepse ai është nga vendlindja ime, dhe se stërgjyshërit e tij kanë qenë njerëz vërtet fetarë.

Së Katërti: Eksperienca e ngjarje të shumta kanë treguar në një mënyrë që e bëjnë njeriun krejtësisht të sigurt se, në qoftë se Risale-i Nuri qan, edhe toka dridhet, edhe qielli qan me vajtimin dhe me dëshpërimin e Risale-i Nurit. Këtë e kemi parë disa herë me sytë tonë dhe e kemi provuar gjithashtu në gjykatë.

Unë besoj se përkimi i gëzimit të Verës -në fillimin e saj- në këtë vit me përhapjen e Risale-i Nurit fshehurazi dhe buzëqeshja e saj me shumëfishimin e tij nëpërmjet makinës dhe duke u botuar, dhe përkimi i ashpërsisë dhe i zemërimit të dimrit me vajtimin e tij dhe me shqetësimin për konfiskimin e Risale-i Nurit, dhe për kërkimet e shumta në çdo vend dhe për ndalimin e aktivitetit të tij, sigurisht veçse është shenjë e fuqishme se Risale-i Nuri është një mrekulli më e madhe e ndritshme e të vërtetave të Kur'anit madhështor duke u manifestuar në këtë shekull; dhe se toka dhe universi janë të lidhur me të.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Papritmas m'u shfaq sot se unë më mirë se sa të jap ngushëllime për ata që u dërguan nga Kaderi Hyjnor tek kjo 'shkollë' në lidhje me Risale-i Nurin, unë duhet t'i përshëndes ata. Sepse secili ka ardhur në vendin e ndoshta një mijë prej vëllezërve tonë të pafajshëm, duke i shpëtuar ata deri diku nga lodhjet e mundimet. Për më tepër, së bashku me vazhdimësinë për t'i shërbyer besimit, ata po kryejnë një shërbim të madh në një kohë të shkurtër, ashtu si të bëje punën e njëqind viteve për dhjetë vite. Gjithashtu ata që kanë hyrë në këtë luftë të rëndë dhe në këtë provim që po zhvillohet në këtë shkollë të re të Jusufit, kanë hyrë me qëllim që të kenë një pjesë aktive prej rezultateve të saja të çmueshme universale. Gjithashtu ata janë duke u takuar me vëllezërit e tyre besnikë e të sinqertë pa vështirësi, për të cilët ishin përmalluar për t'i parë; dhe ata janë duke studiuar së bashku. Dhe gjithashtu meqenëse kohët e rehatisë nuk vazhdojnë në dynja, madje ato shkojnë për kot; sigurisht njerëzit që bëjnë fitime të mëdha me kaq shqetësim të pakët, duhet të përshëndeten.

O Vëllezërit e mi!

Ky sulm i gjërë që u ndërmor kundra nesh, është vetëm për të bllokuar pushtimet e Risale-i Nurit dhe sulmet e tij ndaj zemrave. Por ata e kanë kuptuar se sa më shumë të sulmohet Risale-i Nuri, aq më shumë shdrit ai, dhe fiton më shumë rëndësi dhe zgjerohet më shumë rrethi i mësimeve që ai jep. Prandaj Risale-i Nuri nuk mposhtet. Ai veçse fshihet nën perden e *Sir-ren tenev-veret –ndriçoi në mënyrë të fshehur*. Për këtë arsye ata kanë ndryshuar taktikat e tyre dhe nuk e sulmojnë më hapur Risale-i Nurin.

Po, meqenëse ne jemi nën Përkujdesjen Hyjnore, duhet t'i bëjmë falënderime të mëdhaja Zotit tonë të Gjithëlavdishëm duke u zbukuruar me durim të plotë.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ka ardhur koha që t'ju shpjegoj dy gjendje të çuditshme prej gjendjeve të mia:

E Para: Kur, duke qenë në këtë burgim të vetmuar fillikat -nuk isha në gjendje të takohesha me vëllezërit e mi të tillë si ju, të cilët unë i dua më shumë se jetën time, m'u shfaq mua se ndodhej një Përkujdesje Hyjnore dhe një dobi në këtë. Sepse shumë nga vëllezërit tonë të Ahiretit po shpenzonin pesëdhjetë lira për të ardhur në Emirdag për të më takuar, një takim që zgjaste pesëdhjetë minuta dhe ndonjëherë dhjetë minuta, dhe madje disa ktheheshin pa më takuar fare... dhe e flaknin vetveten në këtë shkollë të Jusufit me ndonjë pretekst të vogël.

Në qoftë se koha ime e ngushtë dhe gjendja ime shpirtërore që buronte nga të jetuarit i veçuar do ta lejonin, puna e shërbimit të Risale-i Nurit nuk do të më kishte lejuar që të bisedoja e të rrija gjatë me ata shokë besnikë.

E Dyta: Një herë në një kohë një dijetar i shquar u pa në fronte të shumtë të luftës nga ata që kishin shkuar për xhihad. Ata i thanë atij se e kishin parë dhe ai iu përgjigj: "Disa evlija janë duke e bërë këtë në vendin tim me qëllim që të fitojnë shpërblim për mua dhe që njerëzit e besimit të përfitojnë prej mësimeve të mia".

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në Denizli, ndërsa isha në burg, ishte bërë e njohur zyrtarisht se unë isha parë nëpër xhamia atje, dhe drejtori i burgut dhe rojtarët ishin njoftuar. Disa prej tyre u shqetësuan dhe u alarmuan, duke pyetur: Kush i hapi dyert e burgut për të?" Pikërisht e njëjta gjë ndodhi këtu. Por në vend që t'i atribuohet personit tim me shumë të meta një ngjarje e pjesshme e jashtëzakonshme, trajtesa *Hatm et-tasdiki El-Gajbij -Vula konfirmuese e së padukshmes*, i provon e i demonstron çudirat e jashtëzakonshme të Risale-i Nurit shumë më tepër se sa ajo ngjarje; i provon njëqind ose madje një mijë herë më shumë. Dhe studentët heroikë të Risale-i Nurit në veçanti i konfirmojnë ato me gjendjet e tyre të jashtëzakonshme dhe me penat e tyre për pranueshmërinë e Risale-i Nurit.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Mos u shqetësoni për mua, unë jam i kënaqur dhe i lumtur që jam me ju në të njëjtën godinë.

Detyra jonë e tanishme është të dërgojmë një kopje prej *Mbrojtjes* në Ispasrta. Në qoftë se do të ishte e mundur, duhet të bëhen njëzet kopje me makinë shumëfishuese dhe me shkronjat e reja, edhe me

shkronjat e vjetëra. Madje ajo duhet t'i shfaqet edhe prokurorit të përgjithshëm atje. Gjithashtu një kopje duhet t'i jepet avokatit tonë personalisht dhe një kopje tjetër duhet t'i jepet drejtorit të burgut që t'ia dorëzojë avokatit tonë të mbrojtjes. Gjithashtu duhet të dërgohet me shkronja të reja dhe të vjetra edhe tek departamentet e qeverisë në Ankara, ashtu siç u dërgua ndërsa ne ishim në Denizli. Në qoftë se do të përgatiten pesë kopje për t'i dërguar në Ankara, sepse kopjet e Risale-i Nurit me shkronja të vjetëra të cilat u konfiskuan, u dërguan tek ato departamente, dhe veçanërisht tek drejtoria e çështjeve fetare, para se ato të dërgoheshin këtu.

Gjithashtu, i thoni avokatit tonë, Ahmed Bey, kur të shkruhet mbrojtja ime me makinë shkrimi le t'i kushtojë një vëmendje të veçantë saktësisë së fjalëve dhe të shprehjeve; Sepse mënyra ime e shprehjes nuk i ngjason mënyrës së ndokujt. Ndonjëherë gabimi në një shkronjë të vetme, ose madje në një pikë, do ta ndryshonte çështjen dhe do ta prishte kuptimin. Gjithashtu, në qoftë se nuk ju jepet leja për të përdorë dy makina shkrimi që janë dërguar, ato dy makina duhet të rikthehen.

Gjithashtu mos u shqetësoni, mos u tronditni dhe mos u dëshpëroni sepse Përkujdesja Hyjnore do të na vijë shpejt në ndihmë sipas kuptimit të vërsetit,

"Padyshim pra, që me vështirësinë është lehtësimi".[273]

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Risale-i Nuri takohet me ju në vendin tim dhe u jep udhëzim të shkëlqyer vëllezërve tonë të rinj, të përmalluar për mësimet e Risale-i Nurit. Ne e kemi parë nga eksperienca se të preokupohesh me Risale-i Nurin, qoftë duke e studiuar, ose duke e lexuar me zë, ose duke e shkruar, jep një qetësi të zemrës dhe një rehati të shpirtit, shëndet për trupin, dhe jep bereqetin në rizk. Tani një hero i Risale-i Nurit si Husrevi u është dhuruar juve nga mirësia e Allahut.

Dhe Shkolla e Jusufit gjithashtu do të jetë, në dashtë Zoti, një vend tjetër i bekuar studimi, pjesë e *Medresetu ez-zehra*. Deri tani e kam fshehur Husrevin dhe nuk e kam shfaqur për Ehli-Dynjanë. Por koleksionet e botuara e kanë shfaqur atë krejtësisht tek politikanët, dhe

[273] Kur'an, 94: 6

asgjë nuk ka mbetur sekret. Prandaj unë kam përshkruar dy ose tre prej detyrave të tij për vëllezërit e mi të veçantë.

Por tani para nesh midis atyre që do ta dëgjojnë të vërtetën janë dy persona kryeneçë të tmerrshëm. Është shfaqur se ata të dy punojnë në favor të ateizmit dhe të komunizmit, njëri prej atyre të dyve është i njohur në Emirdag dhe tjetri është i njohur këtu; ata përpiqen që të përhapin dyshime kundra nesh me dredhitë dhe intrigat më të mëdhaja, dhe kjo duke shpifur e duke futur frikën në zemrat e nëpunësve.

Prandaj, ne duhet të kujdesemi shumë dhe të mos shfaqim shqetësim dhe ta presim Përkujdesjen Hyjnore me besim e mbështetje që të na vijë në ndihmë.

* * *

بِاسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَاِنْ مِنْ شَيْءٍ اِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

اَلسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ اَبَدًا دَآئِمًا

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë Lartësinë e Tij."

Paqja qoftë mbi ju si dhe mëshira e Zotit dhe bekimet e Tij përherë e përgjithmonë.

O shokët e mi në burg dhe vëllezërit në fe!

Më erdhi në zemër që t'ju shpjegoj një të vërtetë të rëndësishme, e cila me leje të Zotit xh.sh. do t'ju shpëtojë ju nga dënimi i dynjasë dhe i Ahiretit.

Ajo është sa vijon:

Për shembull, një person ka vrarë vëllanë e një personi tjetër, ose njërin nga të afërmit e tij. Kjo vrasje që buroi nga kënaqësia e një minuti hakmarrjeje, shkaktoi miliona minuta dëshpërimi për zemrën dhe dënimin e burgut. Dhe frika e hakmarrjes nga të afërmit e njeriut të vrarë dhe shqetësimi se do ta gjejë veten ballë për ballë me armikun e tij, do t'ia dëbojë të gjitha kënaqësitë e tij dhe ëndjet në jetë. Ai vuan torturat e frikës e të zemërimit. Ka vetëm një zgjidhje për këtë dhe ajo është pajtimi të cilin e urdhëron Kur'ani, dhe për tek

i cili bëjnë thirrje e nxitje e vërteta dhe realiteti, dobia, humanizmi dhe islami.

Po, në të vërtetë, realiteti dhe interesi është në paqe, sepse exheli, çasti i fundit i jetës, është caktuar, ai nuk ndryshon. Meqenëse çasti i exhelit kishte ardhur, i vrari në çdo rrethanë nuk do të mund të kishte mbetur i gjallë, ndërsa vrasësi u bë mjet për atë paracaktim Hyjnor.

Kështu në qoftë se nuk vendoset paqja, të dyja palët do të vuajnë vazhdimisht torturat e frikës dhe të hakmarrjes. Për shkak të kësaj, Islami urdhëron se: **"Një besimtar nuk duhet të mbajë mëri e të rrijë pa i folur një besimtari tjetër për më shumë se tre ditë.**! Në qoftë se ajo vrasje nuk erdhi si rezultat i një armiqësie të rrënjosur dhe të një mërie dhe, nëse ka qenë ndonjë hipokrit shkak për ndezjen e zjarrit të ngatërresës, atëherë duhet që paqja të vendoset shpejt, pasi, në qoftë se nuk do të arrihej pajtimi, do të zmadhohej e do të vazhdonte ajo fatkeqësi e pjesshme.

Ndërsa, në qoftë se dy palët do të pajtoheshin, dhe vrasësi do të pendohej për mëkatin e tij, dhe do të vazhdonte të lutej për të vrarin, atëherë të dyja palët do të fitonin shumë dhe do të bëheshin si vëllezër. Në vend të një vëllau të larguar, ai do të fitonte disa vëllezër fetarë; që do t'i dorëzoheshin bashkë caktimit dhe Kaderit të Zotit xh.sh. dhe e fal armikun e tij. Sidomos ata që kanë dëgjuar mësimet e Risale-i Nurit, janë të ftuar që t'i shmangen çdo gjëje që shkakton prishje midis dy vetëve, sepse vëllazëria që ndodhet brenda sferës së Risale-i Nurit, interesi i përgjithshëm, mirëqenia dhe paqja indivi-duale e publike kërkojnë që ata t'i lënë mënjanë të gjitha mëritë e armiqësitë që ekzistojnë midis tyre.

Kështu ishte në burgun e Denizlit; të gjithë të burgosurit të cilët ishin armiq, u bënë vëllezër nëpërmjet mësimeve të Risale-i Nurit. Kjo ishte një arsye për dhënien e pafajsisë sonë, dhe madje u shkaktoi edhe jobesimtarëve dhe kryengritësve të thonë rreth atyre të burgosurve: **"Mashaall-llah! Barekall-llah!** *Çfarë çudirash ka dashur Zoti! Sa të mëdha janë bekimet e Zotit xh.sh. !"* dhe ishte një lehtësim i plotë për ata të burgosur..

Unë vetë kam parë këtu njëqind burra të vuajnë padrejtësi e telashe për shkak të një njeriu të vetëm, saqë ata nuk dalin së bashku me të në oborrin e burgut në kohët e pushimit. Një besimtar burrëror me një ndërgjegje të shëndoshë nuk do t'i shkaktonte kurrë dëm

besi-mtarit, edhe sikur të ishte një gabim ose ndonjë interes i vogël vetjak.

Në qoftë se ai bën gabim dhe shkakton dëm, ai duhet të pendohet menjëherë.

* * *

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë përgëzoj Risale-i Nurin, ju përgëzoj juve, përgëzoj veten time dhe ju jap juve sihariqet e Husrevit, Hifzit dhe të Sejjidit nga Bartini.

Po, ata të cilët shkuan në Haxh këtë vit, ashtu siç gjetën dijetarë të shquar në Mekë që përpiqeshin t'i përkthenin koleksionet e Risale-i Nurit në gjuhën arabe dhe në gjuhën indiane, po ashtu e gjetën Medinenë që e kishte pranuar dhe ishte e kënaqur me koleksionet e Risale-i Nurit, pasi i vendosën ato tek varri i bekuar i profetit a.s.m. në *Raudat el-Mutahhara*.

Haxhi Sejjidi e pa me sytë e tij koleksionin e "*Asa-yi Musa*" "Shkopi i Musait" tek varri i profetit a.s.m.. Kjo do të thotë se Risale-i Nuri ka fituar pranueshmërinë e profetit a.s.m. dhe është futur brenda kënaqësisë së profetit fisnik Muhammedit a.s.m..

Risale-i Nuri i vizitoi ato vende të shenjta në vendin tonë, ashtu siç ishte qëllimi ynë dhe ashtu siç na njoftuan ata që po shkonin prej këtu për të bërë haxhillëkun.

Falënderime të pafundme qofshin për Zotin xh.sh., njëra nga dobitë e shumta të heronjve të Risale-i Nurit duke i botuar ato koleksione pasi i kishin korrektuar, është se ata më shpëtuan edhe mua si nga detyra e korrektimit të tyre, po ashtu edhe nga ai shqetësim; po ashtu meqenëse ato kopje do të formojnë bazën për të tjerat të shkruara me dorë, ata janë bërë si njëqind korrektorë.

I lutemi Allahut që të shkruajë një mijë të mira në regjistrin e veprave të tyre të mira për secilën prej shkronjave të atyre koleksioneve.

Amin. Amin. Amin.

• • •

Një ëndërr ndjellamirë që doli e vërtetë

Aliu, i cili më ndihmon mua, erdhi tek unë dhe më tha: “Unë pashë në ëndërr që ti dhe Husrevi puthët dorën e Profetit Muhammed a.s.m.”. Pastaj unë mora letrën që më tregonte se Haxhillarët e kishin parë koleksionin “*Shkopi i Musait*”, i cili qe shkruar nga Husrevi, tek varri i profetit a.s.m.. Kjo në efekt do të thotë se, koleksioni “Shkopi i Musait” e puthi dorën e profetit a.s.m. në vendin tim nëpërmjet penës së Husrevit, dhe u gjet i pranueshëm nga profeti Muhammed a.s.m..

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë dhe o shokët e mi në burg!

Së Pari: Mos u shqetësoni që nuk kemi qenë në gjendje që ta takojmë njëri-tjetrin personalisht. Ne në mënyrë të vazhdueshme e takojmë njëri-tjetrin shpirtërisht.

Cilado prej trajtesave të Risale-i Nurit që ju bie në dorë për ta lexuar, ose të cilën e dëgjoni, ju do të më shihni mua brenda saj, por me cilësinë e një shërbëtori të Kur’anit të madh në vend të personit tim të zakonshëm.

Duke ditur se unë gjithashtu, takohem me ju në imagjinatë në të gjitha duatë e mia, në letrat tuaja dhe në lidhjet tuaja; dhe është sikur neve jemi së bashku në të gjithë kohën në ndonjë sferë të ekzistencës.

Së Dyti: Ne u themi këtë studentëve të rinj të Risale-i Nurit në këtë shkollë të re të Jusufit: ashtu siç është provuar me argumente të qarta dhe me tregues nga Kur’ani që i kanë penguar dhe i kanë detyruar të dorëzohen ekspertët se: “Studentët besnikë të Risale-i Nurit do të hynë në varret e tyre në një gjendje besimi -do të kenë mbyllje të mirë dhe do të hynë në varr me iman... dhe se çdo student -sipas shkallës së tij- do të jetë pjesëmarrës, do të marrë një pjesë prej fitimeve shpirtërore dhe prej duave të të gjithë vëllezërve të tij. Është sikur çdonjëri prej tyre të kërkonte falje Hyjnore dhe të adhuronte me mijëra gjuhë”.

Këto dy dobi dhe dy rezultate të rëndësishme dhe në këtë kohë të çuditshme i zhdukin të gjitha vështirësitë e mundimet. Dhe kështu, Risale-i Nuri i bën studentët e tij t’i fitojnë këto dy përfitime të mëdhaja me një çmim shumë të vogël.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Mbrojtjet që u ngritën në gjykatën e Afjonit përmbajnë të vërteta të rëndësishme që lidhen me ne, me Risale-i Nurin, me këtë vend dhe me botën islame.

Ndoshta është e domosdoshme që të përgatiten pesë deri në dhjetë kopje prej tyre me shkronja të reja me qëllim që ato të dërgohen tek departamentet e qeverisë në Ankara.

Nëse ata na lirojnë ose na ndëshkojnë, kjo s'ka asnjë rëndësi për ne; detyra jonë tani është që t'i njoftojmë qeverinë, gjykatat dhe këtë komb për ato të vërtetat që përmbajnë mbrojtjet. Ndoshta kjo detyrë është njëra nga arsyet që Kaderi Hyjnor na dërgoi neve në këtë vend studimi. Ato duhet të shkruhen tani me makinë shkrimi sa më shpejt të jetë e mundur. Edhe sikur ata të na lironin sot, ne përsëri do të ishim të detyruar t'i dërgonim ato në Ankara. Mos ju mashtrojë askush që t'i shtyni ato për më vonë; mjaftë tani me vonesa! Le të jetë kjo mbrojtja jonë e fundit përballë shtypjes së skajshme dhe torturave të papara që i kam vuajtur tri herë gjatë pesëmbëdhjetë viteve për të njëjtën çështje me akuza të trilluara. Meqenëse në gjykatat e kaluara ata na e dhanë neve ligjërisht një makinë shkrimi që ne të mund ta mbronim veten tonë, ata nuk mund të përmendin asnjë ligj për të na penguar neve nga e drejta jonë këtu. Në qoftë se ju nuk gjeni zgjidhje zyrtarisht, avokati ynë duhet të shkruajë pesë kopje jashtë me një makinë shkrimi, por ai duhet t'u kushtojë shumë vëmendje atyre që të mos përmbajnë asnjë gabim.

Said Nursi

. . .



Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur të rinj dhe të burgosur të vjetër!

Unë kam formuar një bindje se, për sa ka të bëjë me përkujdesjen Hyjnore, ju jeni një shkak i rëndësishëm për hyrjen tonë këtu. Domethënë, me ngushëllimet e tij dhe me të vërtetat e besimit, Risale-i Nuri është që t'ju shpëtojë nga dëshpërimi i kësaj

fatkeqësie të burgut, nga shumë dëme të kësaj dynjaje, dhe nga të kaluarit e jetës suaj padobi e në kotësi nëpërmjet dëshpërimit e brengës duke e çuar jetën kot në erërat e fantazisë, që ta shpëtojë Ahiretin tuaj që të mos jetë si dynjaja e juaj e dëshpëruar e vajtuese dhe është që t'ju japë ju një ngushëllim të vërtetë.

Meqenëse realiteti i çështjes është ky, natyrisht ju duhet të jeni vëllezër me njëri-tjetrin, si të burgosurit e Denizlit dhe si studentët e Risale-i Nurit. Ju mund të shikoni se ata po kujdesen me shumë vigjilencë për ju dhe duke u lodhur për ju, ata i kontrollojnë të gjitha gjërat tuaja, ushqimin, bukën dhe supën që vjen nga jashtë me qëllim që të mos futet ndonjë thikë midis jush dhe që të mos sulmoni njëri-tjetrin për ta vrarë sikur ju të ishit bisha të egëra, pavarësisht se ju nuk kënaqeni në kohën tuaj të lirë kur dilni për pushim nga frika se mos shpërthen konflikti midis jush. Dhe kështu, o shokët e rinj, që nga natyra jeni trima e të guximshëm! Me një kurajo të madhe morale ju duhet t'u thoni këtyre vëllezërve në këtë kohë:

"Jo thika, por në qoftë se do të na jepeshin edhe mauzerë e revolverë dhe urdhëri për të qëlluar gjithashtu, ne nuk do t'i lëndonim vëllezërit tanë që janë të mjeruar dhe që po vuajnë fatkeqësi ashtu si ne. Nëpërmjet udhëzimit dhe me urdhrin e Kur'anit, besimit, vëllazërisë Islame dhe intereseve tona, ne kemi vendosur që t'i falim ata dhe të mos përpiqemi t'i ofendojmë, madje edhe pse më parë ekzistonin njëqind arsye për mërinë dhe armiqësinë tonë." Dhe kështu transformojeni këtë burg në një vend të mirë studimi.

* * *

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ata njerëz që janë futur në të njëjtën politikë ose në një profesion të vetëm, ose në ndonjë detyrë të vetme ose në ndonjë shërbim të vetëm që lidhet me jetën shoqërore ose që kanë ndonjë lloj tregtie të veçantë... secili prej këtyre grupeve të njerëzve të dhënë vetëm pas kësaj dynjaje kanë një takim të përgjithshëm që u përket atyre që të diskutojnë në të çështjet e tyre. Po ashtu studentët e Risale-i Nurit të cilët punojnë në shërbimin e shenjtë të *Imanit Tahkikij* -besimit të sigurt e të verifikuar-, ardhja e tyre në takimin e përgjithshëm në këtë shkollë të Jusufit me Dekretin e Kaderit Hyjnor dhe të shtyrë nga Përkujdesja Hyjnore, nuk ka dyshim se ai ka dobi shpirtërore të shumta dhe rezultate të mëdhaja të çmueshme në dashtë Zoti xh.sh.;

dhe secili nga studentët kryesues të Risale-i Nurit do të jetë si shkronja elif[274], vlera e së cilës është një në qoftë se është e veçuar, ndërsa kur ajo është me motrat e saja, domethënë me tre Elifët e tjerë së bashku duke qenë pranë njëri-tjetrit, atëherë ato kanë vlerën e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetës, dhe gjithashtu sevapi -shpërblimi- dhe shërbimi i lartë i atij vëllai që iu bashkua këtij takimi do të jetë i njëmijëfishtë; elifi i vetëm do të bëhej një mijë.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Arsyeja pse ata i bllokuan dritaret e mia dhe duke i mbërthyer me gozhda ishte që të më veçonin nga të burgosurit dhe të këpusnin shkëmbimin e përshëndetjeve midis nesh në lidhje me proceset gjyqësore. Ata në dukje bënë si pretekst diçka tjetër; prandaj mos u shqetësoni.

Përkundrazi, meqenëse ata preokupohen me personin tim të parëndësishëm dhe duke mos i shkaktuar shumë dëm Risale-i Nurit dhe studentëve të tij, unë jam seriozisht dhe sinqerisht i kënaqur. Meqenëse ata po më persekutojnë mua duke fyer e torturuar personalitetin tim, kjo do të thotë se ata nuk po bëjnë të njëjtën gjë me ju dhe me Risale-i Nurin; prandaj unë i bëj falënderime me durim Allahut dhe nuk shqetësohem. Edhe ju gjithashtu nuk duhet të shqetësoheni. Unë kam mendimin se armiqtë tonë të fshehur duke drejtuar vëmendjen e zyrtarëve për tek personi im, ky është një shembull i Përkujdesjes Hyjnore dhe një gjë e mirë nga këndvështrimi i mirëqënies së Risale-i Nurit dhe i studentëve të tij. Disa nga vëllezërit e mi nuk duhet të bëhen të zemëruar dhe të flasin ashpër. Ata duhet të veprojnë me maturi dhe të mos shqetësohen.

Gjithashtu ata nuk duhet që t'ia thonë këtë çështje gjithësecilit. Sepse ka spiuna të cilët u japin kuptime të gabuara asaj që thonë vëllezërit tonë naivë dhe ata të cilët nuk janë mësuar akoma të jenë të kujdesshëm. Spiunët e bëjnë qimen tra dhe mund t'i informojnë zyrtarët për to. Situata jonë tani nuk është një çështje shakaje.

---

[274]Elif: Shkronja e parë e alfabetit arab, e shkruar si një vizë vertikale dhe vlera numerike e së cilës është një. Përkthyesi

Megjithatë, mos u shqetësoni. Ne jemi nën Mbrojtjen Hyjnore dhe jemi të vendosur t'i takojmë të gjitha vështirësitë me durim të plotë dhe madje me falënderime. Ne jemi të obliguar të bëjmë falënderime; sepse një sasi e vogël vështirësie sjell shumë shpërblim e mëshirë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Për dy arsye të rëndësishme, dhe si pasojë e një paralajmërimi të fuqishëm, unë kam qenë i detyruar t'ua lë, lidhur me zemrën, detyrën e të gjitha mbrojtjeve studentëve të Risale-i Nurit të cilët kanë qenë dërguar këtu dhe që do të jenë studentët e tij kryesues në të ardhmen, dhe veçanërisht ua kam lënë Husrevit, Refetit, Tahirit, Fejziut dhe Sabriut.

Arsyeja e Parë: Unë kam kuptuar me siguri nga zyra e hetuesisë dhe nga disa shenja të tjera se ata përpiqen të shkaktojnë vështirësi kundra meje, me të gjithë fuqinë që kanë, dhe ikin prej shfaqjes sime dhe duke i mposhtur ata me logjikë, dhe ata kanë marrë komunikim zyrtar.

Ata nuk më lejojnë mua të flas me pretekste të ndryshme, sikur në qoftë se do të flisja, unë do të shfaqja fuqi shkencore dhe aftësi politike të mjaftueshme për t'i heshtur gjykatën dhe politikanët. Madje gjatë hetimit unë iu përgjigja njërës prej pyetjeve duke thënë: "Nuk më kujtohet".

Gjykatësi u çudit, u bë konfuz dhe tha: Si mund të harronte një person si ti që ka zgjuarsi dhe njohje të jashtëzakonshme?

Po, ata e supozuan lartësinë e jashtëzakonshme të Risale-i Nurit dhe zbulimet e tij shkencore të ishin produkt i mendimit tim dhe prandaj i kishte marrë frika dhe habia, dhe nuk donin që unë të flisja me askënd. Gjithashtu, ata mendojnë se ai që takohet me mua, bëhet menjëherë një student i devotshëm i Risale-i Nurit; prandaj ata nuk më lejojnë mua që të takohem me askënd. Madje drejtori i drejtorisë së çështjeve fetare, tha: "Kushdo që takohet me të, tërhiqet menjëherë për tek ai; Forca e tërheqjes së tij është e fuqishme."

Kjo do të thotë se gjëja më e mirë për ne dhe interesi ynë kërkon që çështjet e mia t'ua lë juve tani. Dhe fjalët e mia mbrojtëse të vjetëra

e të reja, të cilat i keni ju, duhet të marrin pjesë në konsultimet tuaja, kjo do të ishte e mjaftueshme për këtë çështje.

Arsyeja e Dytë: U shty për një kohë tjetër në dashtë Zoti. Megjithatë një tregues paralajmërimi është ky: Një detyrë tej mase e fuqishme e cila shikon tek Ahireti së bashku me një gjendje shpirtërore me një efekt veprues më ka bërë mua që t'i braktis politikën, leximin e gazetave dhe gjëra të ngjashme me to prej gjërave kalimtare gjatë njëzet e pesë viteve; dhe më ka penguar mua që të preokupohem me to. Këto dy arsye gjithashtu më pengojnë mua krejtësisht edhe nga prokopia me këtë çështje në detaje. Ju përmbusheni gjithashtu detyrën time duke u konsultuar ndonjëherë me dy avokatët e mbrojtjes.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Kjo m'u shfaq mua në zemër tani ndërsa po kryeja namazin: për shkak të mendimit të tyre tepër të mirë për ty, vëllezërit e tu presin udhëzim e ndihmë materiale dhe shpirtërore prej teje. Ashtu si në çështjet e dynjasë që ti ua ke dorëzuar gjërat studentëve të tu të veçantë, duke ua lënë ato studentëve kryesues *-erkan-* që t'i konsultojnë, dhe ti ke vepruar mirë, po ashtu ti ke caktuar Risale-i Nurin dhe personalitetin kolektiv të studentëve të tij për ta përmbushur veprën tënde shkencore në lidhje me besimin, Kur'anin dhe Ahiretin; dhe personaliteti kolektiv i atyre studentëve të sinqertë e të veçantë e kryen atë detyrën tënde së bashku me detyrën e tyre në mënyrën më të mirë e më të plotë. Dhe ata në fakt e kryejnë atë tani dhe vazhdimisht.

Për shembull, dikush që takohet me ty dhe merr prej teje një udhëzim të shkurtër e të pjesshëm përkohësisht si dhe një këshillë të vogël, mund të marrë prej një pjese të vetme të Risale-i Nurit një udhëzim njëqind herë më të madh. Ata mund të marrin gjithashtu këshillë prej tij në vendin tënd. Pastaj studentët e veçantë të Risale-i Nurit e kryejnë këtë detyrën tënde në çdo kohë. I lutemi Allahut që personaliteti i tyre kolektiv, stacioni i të cilit është tepër i lartësuar dhe lutjet e pranueshme të të cilit të jenë mbështetje për ta, të jenë një ustadh dhe ndihmës. Dhe kështu m'u shfaq ky kuptim dhe solli ngushëllim për shpirtin tim, dha sihariq dhe më bëri të ndjehem i qetë dhe i rehatuar.

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ndodhja e dy shpërthimeve në dy ditë në një mënyrë të jashtëzakonshme e domethënëse kur nuk kishte ndonjë shkak të jashtëm për to, kjo nuk i ngjason rastësisë.

I Pari: Shpërthimi i fuqishëm i sobës prej hekuri që gjendej e hedhur në oborrin tim në mënyrë të befasishme dhe shkaktoi një zë të fortë si një revolver, dhe hekuri i fortë dhe i trashë i pjesës së saj të poshtme shpërtheu si bombë, duke e çarë atë më dysh.

Hamdi rrobaqepësi u tremb prej saj dhe ne mbetëm të habitur; duke ditur se ajo sobë e kishte përballuar qymyrgurin në këtë dimër.

I Dyti: Në ditën tjetër në oborrin e Fejziut, pa ndonjë shkak të jashtëm, gota e vendosur në majë të shtambës së ujit papritmas u shpërbë dhe u thërrmua në një mëyrë të jashtëzakonshme. M'u shfaq mua se bombat e vendosura që të shpërthenin kundra nesh i shpërthyen kopjet e mbrojtjeve që ne i dërguam tek gjashtë departamentet e qeverisë në Ankara, dhe soba e zemërimit e cila ndizet që të na djegë neve me zjarrin e saj, u copëtua duke mos na shkaktuar neve asnjë dëm.

Gjithashtu është e mundur që soba ime e dashur, shoku im i vetëm e i dobishëm t'i ketë dëgjuar dëshpërimt dhe lutjet e mia, dhe po më jepte mua njoftimet: "Ti do largohesh prej këtij burgu të errët, dhe nuk mbetet nevojë më për mua..."

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Sot, për shkak të një paralajmërimi shpirtëror, unë ndjeva një shqetësim dhe një dëshpërim për ju. Dhe u dëshpërova për gjendjet e vëllezërve tonë të cilët dëshirojnë të dalin shpejt prej burgut si rezultat i shqetësimit të tyre rreth mjeteve të tyre të jetesës. Dhe në minutin që unë mendova për këtë, m'u shfaq në zemër një kujtesë e bekuar së bashku me një të vërtetë dhe me një sihariq, sa vijon: Tre Muajt do të vijnë pas pesë ditësh, të cilët janë vërtetë të bekuar dhe janë muaj në të cilët ibadetet shpërblehen në mënyrë të shumëfishtë. Sepse në qoftë se vepra e mirë shpërblehet me dhjetë të mira në kohët e tjera, në muajin Rexheb një e mirë shpërblehet me njëqind të mira; në muajin Shaëban shpërblehet me më shumë se treqind të mira, dhe në muajin e bekuar të Ramazanit ato arrijnë në një mijë të mira; ndërsa në netët e të premteve në Ramazan arrijnë në mijëra, dhe në Natën e Kadrit e mira bëhet në tridhjetë mijë të mira.

Prandaj, sigurisht është një përfitim shumë i madh t'i shpenzosh ato tre muaj -të cilët janë kështu një treg i bekuar për tregtinë e Ahiretit duke siguruar fitime të bollshme për të, dhe janë një ekspozitë e jashtëzakonshme për njerëzit e Realitetit dhe të adhurimit, dhe në tre muajt mund të sigurohet për besimtarët një jetë prej tetëdhjetë vitesh... dhe kalimi i këtyre tre muajve në këtë shkollë të Jusufit, e cila e rrit dhe e shton fitimin e dhjetëfish.

Nuk ka dyshim se ky është një fitim i madh dhe një fitore e madhe. Dhe sado që të jenë mundimet, ato janë thjesht mëshirë e pastër.

Ashtu siç është çështja kështu lidhur me ibadetin, po ashtu lidhur me shërbimin e Risale-i Nurit dhe me punën për të përhapur Risale-i Nurin, në lidhje jo me sasinë por me cilësinë, përfitimet e tij janë të pesëfishta. Sepse njerëzit që në mënyrë të vazhdueshme hyjnë në këtë bujtinë -burg- dhe pastaj lirohen, dhe pastaj bëhen mjete për përhapjen e mësimeve të Risale-i Nurit. Ndonjëherë sinqeriteti i një personi të vetëm arrin përfitimet e njëzet personave. Pastaj nuk ka rëndësi nëse do të kishte ndonjë vështirësi përballë përhapjes së misterit të sinqeritetit në Risale-i Nur midis radhëve të të burgosurve të cilët janë më të nevojshmit e njerëzve për ngushëllimin që gjendet në Risale-i Nur, dhe sidomos ata të cilët janë të prirur ndaj heronjve politikë. Në lidhje me problemet e mjeteve të jetesës, meqenëse këto tre muaj janë një treg për Ahiretin, unë u ndjeva krejtësisht i gëzuar për këtë dhe kuptova se duke qenë këtu brenda deri në festën e Bajramit është një mirësi e madhe Hyjnore, sepse meqenëse gjithësecili prej jush u dërgua në këtë burg në vend të shumë studentëve të tjerë të Risale-i Nurit, dhe disa prej jush në vend të një mijë studentëve, ata do të ndihmojnë për punën tuaj jashtë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Unë ju jap urimet me të gjithë zemrën e shpirtin tim për muajin e Rexhepit dhe për Natën e Shenjtë të *Regaipit* nesër.

Së Dyti: Mos e braktisni shpresën dhe mos u shqetësoni dhe mos u tronditni. Në dashtë Zoti, Përkujdesja Hyjnore do të na vijë neve në ndihmë. Bomba që po përgatitej gjatë këtyre tre muajve të fundit, shpërtheu.

Njoftimet e dhëna nga soba, nga gota e Fejziut, dhe nga dy gotat e Husrevit dolën të vërteta. Por ajo nuk ishte e tmerrshme, ishte e lehtë. Në dashtë Zoti, zjarri do të shuhet krejtësisht. Të gjitha sulmet e tyre janë për të diskretuar personin tim dhe për të njollosur pushtimet e Risale-i Nurit. Goditja që njeriu më i dëmshëm se sa hipokritët e fshehur në Emirdag dhe i cili ishte thjesht një peng në duart e ateistëve të fshehtë, dhe gjysmëhoxhallarët të cilët favorizojnë bidatet, -goditja që ata përpiqeshin të na e japin neve aq të fuqishme sa të kishin mundësi, u zvogëlua njëzetfish.

Në dashtë Zoti xh.sh., ata nuk do të na shkaktojnë neve as edhe një plagë, dhe ajo çfarë ato mendojnë dhe synojnë dhe planet e tyre për të na trembur e për të na larguar nga njëri-tjetri dhe nga Risale-i Nuri, do të asgjësohen. Është absolutisht e domosdoshme që nga respekti për këto muaj të bekuar, duke besuar se ato japin shpërblim të bollshëm për ne, ne me qëndrueshmëri duhet të japim falënderime me durim, dhe duke u mbështetur tek Allahu, t'i nënshtrohemi rregullit *"Ai që beson në Kaderin Hyjnor, shpëton nga brenga".*

Said Nursi

• • •

Për zyrën e kryeministrisë, ministrinë e drejtësisë dhe për ministrinë e punëve të brendshme[275].

Të gjithë anëtarët e qeverisë të cilët qenë bashkëkohës dhe panë rrethanat e vështira në të cilat kaloi vendi qysh prej shpalljes së kushtetutës, dhe gjatë luftës së Parë Botërore, dhe periudhën e armëpushimit, formimin e qeverisë nacionale, pushtimin e aleatëve ndaj vendit dhe hyrjen e tyre në Stamboll, dhe periudhën e shpalljes së Republikës... Ata të cilët kanë njohuri për ato rrethana dhe të cilët tani kanë zënë poste të rëndësishme në shtet, më njohin mirë... Megjithatë, më lejoni të hedhim një shikim tek jeta ime sikur në një film.

Jam lindur në Fshatin Nurs në Provincën e Bitlisit. Si një student, unë kam debatuar me dijetarët që i kam takuar, dhe nëpërmjet Përkujdesjes Hyjnore, i kam mposhtur në diskutime shkencore të

[275]-Kjo pjesë u shkrua nga avokatët e Ustadh Bediuzzamanit dhe me lejen e tij ndërsa ai po mbahej në Burgun e Afjonit, dhe u dërgua tek ministritë të cilat u përmendën më lartë. Nënshkroi Sungur.

gjithë ata që më kanë kundërshtuar, derisa arrita në Stamboll. Në Stamboll, në atmosferën e tij të përzier me pasojën e famës dhe të pozitës nuk i ndërpreva debatet e mia. Shpifjet dhe përfoljet e smirëzive dhe të armiqve më shkaktuan që të dërgohesha në spitalin e çmendisë me urdhërin e Sulltan Abdul-Hamidit -Zoti e mëshiroftë shumë- pastaj, me shpalljen e kushtetutës, unë tërhoqa vëmendjen e qeverisë së komitetit të unionit dhe të progresit me aktivitetet e mia gjatë incidentit të Tridhjetë e Një Marsit. Unë i konfrontova ata me propozimin për të hapur një universtet islamik në Van të quajtur "*El-Medresetu'z Zehra*", që i ngjasonte Universitetit të Azharit. Madje unë i vendosa themelet e tij. Pastaj sapo shpërtheu lufta e Parë Botërore, unë i grumbullova studentët e mi dhe mora pjesë në luftë si komandanti i një force ushtarake të një regjimenti vullnetarësh. Ne hymë në beteja që zhvilloheshin në frontin e kaukazit kundra rusëve agresorë në Bitlis dhe u zura rob prej tyre; por Përkujdesja Hyjnore më shpëtoi nga qënia ime i zënë rob lufte. Dhe erdha në Stamboll. Unë u emërova si anëtar i Dar'El-Hikmeh, El-Islamijjeh. Gjatë periudhës së armëpushimit, unë punova kundra forcave pushtuese me të gjithë fuqinë time, dhe me fitoren e qeverisë nacionale, mua m'u bë ftesa prej saj që të shkoja në Ankara, ku unë përsërita propozimin tim për të hapur universitetin në Van.

Jeta që pata jetuar deri atëherë pati qenë ajo e një patrioti. Unë pata dashur që t'i shërbeja fesë nëpërmjet politikave. Por qysh atëherë e në vazhdim unë ia ktheva shpinën krejtësisht dynjasë, dhe sipas shprehjes sime, e varrosa "Saidin e Vjetër". Si "Saidi i Ri" duke iu përkushtuar krejtësisht Ahiretit, unë u tërhoqa nga dynjaja. Duke u tërhequr prej jetës shoqërore, unë shkova në një vend të veçuar tek kodra *Jusha* në Stamboll. Më vonë unë shkova në Bitlis e në Van, në rajonin tim të lindjes, ku unë atje jetova në një shpellë. Unë qëndrova i vetmuar me kënaqësitë e shpirtit dhe të ndërgjgjjes sime. Domethënë, duke marrë si parimin tim*: "I kërkoj mbrojtje Allahut që të më ruajë nga Shejtani dhe nga Politika",* unë u zhyta në thellësirat e botës sime shpirtërore. Duke e kaluar kohën time në studimin e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm, unë fillova të jetoja si "Saidi i Ri". Por manifestimet e Kaderit Hyjnor më dërguan mua, si një internim, nga një qytet në tjetrin. Pastaj gjatë kësaj kohe lindën nga thellësia e zemrës sime kuptime të mëdhaja që buronin nga shkëlqimet e Kur'anit Kerim. Unë ua diktova ato trajtesa atyre personave që ishin rreth meje, ato trajtesa që u dhashë emrin "Risale-i Nur"; ato erdhën në të vërtetë prej dritës së Kur'anit Kerim. Prandaj ky emër buroi nga thellësia e ndërgjegjjes sime, dhe unë jam krejtësisht i bindur, i sigurt dhe i vendosur se këto

trajtesa të Risale-i Nurit nuk janë bluar me mendimet e mia, por janë *ilham* -inspirim- Hyjnor që e lëshoi Allahu në zemrën time prej Dritës së Kur'anit Kerim, dhe qofshin të bekuar të gjithë ata që i kanë kopjuar ato trajtesa; ne u themi atyre shkruesve: ***Barekall-llah***. Dhe unë jam krejtësisht i sigurt se nuk ka rrugë tjetër për të ruajtur besimin e të tjerëve përveç kësaj rruge, prandaj të mos pengohen ato shkëlqime për ata që janë në nevojë të tyre. Kështu, i morën, i rrëmbyen menjëherë ato trajtesa duart e sigurta për t'i përhapur, dhe unë kuptova me siguri se ky ishte një nënshtrim Hyjnor dhe një shtytje Hyjnore për të ruajtur Imanin e myslimanëve dhe askush nuk mund ta ndalojë atë nënshtrim dhe atë shtytje Hyjnore; dhe unë ndjeva një domosdoshmëri për t'i inkurajuar të gjithë ata që punojnë në këtë rrugë duke iu bindur asaj që më urdhëron mua feja ime.

Këto trajtesa të cilat tani kapin numrin njëqind e tridhjetë përbëhen krejtësisht nga diskutimet rreth Ahiretit dhe besimit, dhe nuk përmbajnë çështje që synojnë dynjanë dhe politikat. Megjithatë, ato u bënë objekt interesi për një numër oportunistësh.

Gjykatat zhvilluan hetime shkencore mbi ato trajtesa, dhe unë u arrestova dhe u dërgova në burgjet e Eskishehirit, të Kastamonus dhe të Denizlit. Procese gjyqësore u mbajtën; ato i kryenin ekspertë të specializuar. Veçse ama e vërteta -Në sajë të Zotit -shfaqej vazhdimisht dhe drejtësia zinte vendin e saj të përshtatshëm për to. Megjithatë, këta oportunistë nuk u mërzitën kurrë duke na gjuajtur në ujë të turbullt. Këtë herë ata më arrestuan mua dhe më dërguan në Afjon. Unë jam nën arrest dhe jam duke u pyetur.

Ata më akuzojnë mua sa vijon:

1-Ti ke themeluar një shoqëri politike.

2-Ti përhap ide që kundërshtojnë regjimin.

3-Ti synon qëllime politike.

Dëshmia për këto janë dhjetë ose pesëmbëdhjetë fjali në dy ose në tre prej trajtesave të mia.

O Ministër i Respektuar!

Siç tha Napoloni: "Më sillni një fjali që nuk mund të interpretohet -që nuk mund t'i jepet një kuptim i dytë-, dhe unë t'ju ekzekutoj juve me të". Nuk ka fjali të shprehur nga njeriu e cila të mos jetë shkak për interpretime, që të mos përbëjë ndonjë shkelje duke i bashkangjitur asaj kuptime të detyruara. Në mënyrë të veçantë shkrimet e dikujt si unë i cili ka mbushur moshën shtatëdhjetë e pesë vjeç, që është tërhequr krejtësisht nga jeta e kësaj dynjaje, dhe që ia ka kushtuar këtë

jetë këtu asaj të Ahiretit -sigurisht shkrimet e një personi të këtillë do të ishin të lira; pasi ato janë të shoqëruara me *nijet* -qëllim- të mirë, me mendim të mirë, dhe në to nuk ka as ngurrim dhe as shmangie e frikë. Do të ishte e pandershme dhe e padrejtë t'i studiosh e t'i hetosh ato thjesht me qëllim që të kërkosh shkelje në to; kjo nuk do të ishte asgjë tjetër, veçse padrejtësi. Asnjëra prej njëqind e tridhjetë trajtesave të mia nuk përmban ndonjë qëllim që lidhet me çështjet e kësaj dynjaje. Duke buruar prej dritës së Kur'anit, ato të gjitha kanë të bëjnë me Ahiretin dhe besimin. Sidoqoftë, të gjitha proceset gjyqësore të mbajtura deri tani kanë ardhur me të njëjtin përfundim dhe kanë rezultuar në pafajësi. Prandaj është një akt i turpshëm që të merren gjykatat në mënyrë të panevojshme dhe t'i detyrojnë t'i largojnë besimtarët e pafajshëm prej punës dhe biznesit të tyre në emrin e vendit dhe të kombit. Ndërsa Saidi i vjetër e harxhoi të gjithë jetën e tij për hir të lumturisë së vendit dhe të kombit, si do të ishte e mundur që të merrej me politikat pasi u bë Saidi i Ri, që ka arritur moshën shtatëdhjetë e pesë vjeç dhe është tërhequr krejtësisht prej dynjasë? Unë mendoj se edhe ju gjithashtu jeni të bindur plotësisht për këtë.

Unë kam vetëm një qëllim, dhe ai është ky: Në këtë kohë që unë po i afrohem varrit; në këtë atdhe që është vend islam, ne dëgjojmë zërin e kukuvajkave bolshevike. Ky zë kërcënon themelet e besimit në botën islame, dhe i lidh njerëzit dhe veçanërisht rininë për tek vetvetja, pasi i bën ata të humbasin besimin e tyre.

Unë me gjithë çfarë kam në ekzistencë, i luftoj këta, dhe u bëj thirrje myslimanëve dhe veçanërisht të rinjve për të besuar. Ne jemi gjithmonë në luftë kundra këtyre masave ateiste. Unë dëshiroj të hyj në Praninë Hyjnore me këtë luftën time. Kjo është e gjitha ajo që unë bëj. Sa për ata që më pengojnë mua prej këtij qëllimi, kam frikë se ata janë komunistë gjithashtu. Qëllimi im i shenjtë është kooperimi dhe bashkëpunimi me forcat e fesë të cilat kanë përqafuar luftën kundra këtyre armiqve të besimit.

Më jepni lirinë time, më lironi! Le të punojmë për të reformuar rininë, që është helmosur nga komunizmi, dhe për besimin e këtij vendi! Le t'i shërbejmë Unitetit Hyjnor!

I burgosuri Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ilaçi më i efektshëm për shqetësimet e frikshme, si fantazma dhe për dëshpërimet e kësaj dynjaje, sidomos në këtë kohë, dhe veçanërisht për ata të cilët janë goditur nga fatkqësia, dhe në mënyrë të veçantë për studentët e Risale-i Nurit, është ngushëllimi dhe futja e gëzimit në zemrat e njëri-tjetrit, dhe të forconi moralin e njëri-tjetrit, dhe si vëllezër të vërtetë e të devotshëm lëshoni balsam mbi dëshpërimet dhe fatkeqësitë e njëri-tjetrit, dhe me dhembshuri e mëshirë të vërtetë i zbusni dhe i qetësoni zemrat e plagosura të njëri-tjetrit.

Vëllazëria e vërtetë midis nesh, e cila shikon tek Ahireti, nuk e toleron njëanshmërinë dhe fyerjen -mbetjen e hatrit.

Unë jam i mbështetur krejtësisht tek ju dhe mbahem pas jush, dhe ju e dini se unë kam vendosur të sakrifikoj i gëzuar jo vetëm ngushëllimin, sedrën dhe nderin tim për ju, por gjithashtu edhe shpirtin tim, dhe në të vërtetë ju mund ta shikoni këtë. Unë madje ju betohem se qysh prej tetë ditësh zemra ime ka vuajtur një torturim të rëndë si rezultat i një ngjarjeje të papërfillshme prej dy studentëve kryesues të Risale-i Nurit, të cilët në pamje të jashtme qëndrojnë larg dhe e mërzitën njëri-tjetrin në vend që ta ngushëllonin njëri-tjetrin; kjo i shkaktoi shpirtit, zemrës dhe mendjes sime të vajtonin e të bërtisnin duke thënë:

Oh Medet! Sa keq! Na ndihmo ne, o Mëshiruesi më i madh! Na ruaj ne dhe na shpëto nga e keqja e shejtanëve prej xhindeve dhe njerëzve, dhe mbushi zemrat e vëllezërve të mi me besnikëri, me dashuri dhe me ndjenja vëllazërore ndaj njëri-tjetrit! O Vëllezërit e mi të palëkundur e të fortë si çeliku! Më ndihmoni mua në misionin tim. Situata jonë është jashtëzakonisht e ndjeshme. Unë u mbështeta tek ju deri në atë shkallë saqë unë ia dorëzova të gjitha detyrat e mia personalitetit tuaj kolektiv. Atëherë ju -me sa të keni mundësi- duhet të më ndihmoni menjëherë.

Sigurisht, ngjarja ishte e papërfillshme, kalimtare dhe e parëndësishme, por madje edhe një fije floku apo një thërrime në qoftë se do të binte në beben e syrit tonë, do t'i shkaktonte dhimbje, dhe po të binte tek susta kryesore e orës sonë, do ta bënte atë të ndalojë. Kjo ngjarje e papërfillshme vlerësohet si shumë e rëndësishme meqë për të njoftuan tre shpërthime lëndore dhe tre vëzhgime jolëndore.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Shpërthimi i sobës sime dhe shpërbërja -copëtimi- i gotave të Fejziut, Sabriut dhe Husrevit parashikuan ndodhjen e një fatkeqësie që do të na vinte. Është absolutisht e domosdoshme që ne të praktikojmë solidaritetin e vërtetë dhe të mos i vëmë re gabimet e njëri-tjetrit, dhe kjo është pika më e fuqishme e mbështetjes, dhe kurrë të mos ofendoheni prej një heroi të Risale-i Nurit si Husrevi, meqenëse ai merr vendin tim dhe është një përfaqësues i rëndësishëm i personalitetit kolektiv të Risale-i Nurit.

Para disa ditësh unë ndjeva një dëshpërim të madh dhe një pikëllim të thellë në kraharorin tim, dhe thashë me vete i shqetësuar: "Armiqtë tonë paskan gjetur një mënyrë për të na mposhtur". Edhe soba ime edhe vëzhgimi krejtësisht i saktë që bëra në imagjinatën time dhanë njoftime të sakta.

Kini kujdes! Ruhuni! Ruhuni! Riparojeni menjëherë solidaritetin tuaj, i cili deri tani ka qenë i fortë si çeliku. Ndodhet një mundësi e madhe që ky incident do të shkaktojë më shumë dëm -sidomos në këtë periudhë- ndaj shërbimit tonë në rrugën e Kur'anit dhe ndaj besimit se sa ndaj qënies sonë të futur në burg.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Nata e Mi'ëraxhit të profetit Muhammed a.s.m. është si një '*Natë Kadri*' e dytë. Fitimi i shpërblimit me punë të vazhdueshme -me sa të jetë e mundur- rritet në këtë natë nga një në një mijë. Gjithashtu, në përputhje me misterin e pjesëmarrjes shpirtërore, në këtë Natë të çmueshme e të bekuar, në dashtë Zoti, ashtu si disa melekë të cilët e lavdërojnë Allahun me dyzet mijë gjuhë, ju do t'i kryeni ibadetet dhe duatë me dyzet mijë gjuhë; dhe sidomos kjo do të bëjë të fitohet shumë shpërblim në këtë vend sprove, dhe ju do të jepni falënderime nëpërmjet adhurimit tuaj në këtë natë për stuhinë e ardhshme që do të na godiste e cila u zvogëlua një mijëfish.

Së bashku me urimin kujdesin tuaj të plotë dhe maturinë, unë ju jap juve lajmet e gëzueshme se përkujdesja Hyjnore është duke u manifestuar për ne në mënyrën më të qartë.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Ju përgëzoj me të gjithë zemrën dhe shpirtin tim për *Natën e Miraxhit.*

Së Dyti: Pretendimi ynë qysh prej njëzet vitesh ka qenë se studentët e Risale-i Nurit -me sa ka qenë e mundur- nuk e kanë prishur qetësinë dhe rendin publik. Veçse ama kjo çështja e burgut tonë mund të konsiderohet si një shenjë e fortë dhe si një provë për ta plagosur atë pretendimin tonë. Sepse ata të cilët na sulmojnë pretendojnë se ne e prishim rendin dhe qetësinë. Veçse ama Përkujdesja Hyjnore u shfaq në mënyrë të jashtëzakonshme dhe nëpërmjet *kerametit* të sinqeritetit tuaj dhe të besnikërisë suaj; sepse ajo e ka lehtësuar ashpërsinë e fatkeqësisë nga njëqind në një dhe trau u bë qime nëpërmjet mirësisë së Tij. Përndryshe ata të cilët e bëjnë qimen tra, lidhur me ne, do ta kishin shfrytëzuar këtë rast për të përhapur shpifje kundra nesh dhe ndoshta do t'i nxisnin njerëzit për t'i besuar.

Së Treti: Mos mendoni dhe mos u shqetësoni fare për mua. Qënia ime në të njëjtën ndërtesë si ju, i zhduk të gjitha vështirësitë e mia dhe dëshpërimin tim. Në fakt, qënia jonë të grumbulluar së bashku këtu është e rëndësishme në shumë drejtime, dhe në shumë mënyra është e dobishme për shërbimin tonë ndaj besimit. Saqë dërgimi i atyre të vërtetave të rëndësishme të cilat i përmban 'shtojca e kundërshtimeve' tek gjashtë departamentet e qeverisë këtë herë, që tërhoqëm vëmendjen e tyre dhe që influencuan deri diku tek ata, kjo i ka zhdukur të gjitha vështirësitë dhe lodhjet tona.

Së Katërti: Prokopia me mësimet e Risale-i Nurit edhe e largon dëshpërimin, edhe mund të konsiderohet si pesë lloje ibadeti.

Së Pesti: Fatkeqësia e mëparshme u lehtësua njëqindfish në sajë të mësimeve të Risale-i Nurit. Përndryshe për shkak të ndjeshmërisë së kohës dhe të vendit, që qimja mund të ishte bërë tra, domethënë do të ishte si të hidhje shkëndinë në barut. Madje disa zyrtarë thanë: Ata të cilët dëgjojnë mësimet e Risale-i Nurit nuk ndërhyjnë në çështje. Në qoftë se të gjithë do t'i kishin dëgjuar mësimet e tij, nuk do të kishte ndodhur asgjë. Me sa të keni mundësi, mos i lejoni gjërat të shkallëzohen; mos lejoni asgjë tjetër t'u shtohet vështirësive të burgut. Ashtu si studentët e Risale-i Nurit, të burgosurit e tjerë duhet të jenë vëllezër dhe të mos zemërohen me njëri-tjetrin.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur, besnikë e të sinqertë!

Është bërë e detyrueshme për ne që t'i praktikojmë me aq sa ne mundemi brenda limiteve të mundësisë parimet e trajtesës mbi sinqeritetin dhe sinqeritetin në kuptimin e vërtetë midis nesh dhe ndaj njëri-tjetrit.

Unë kam marrë njoftim të sigurtë se për tre muajt e kaluar u caktuan tre njerëz këtu për t'i larguar nga njëri-tjetri vëllezërit e mi të veçantë duke luajtur mbi ndryshimet në mendime ose në temparamente. Gjithashtu ata janë duke e shtyrë pa asnjë shkak afatin e proceseve tona gjyqësore me qëllim që t'i bëjnë të mërzitur studentët e vendosur të Risale-i Nurit dhe për t'i tronditur ata; si dhe për t'i bërë dyshues ata që janë të pavendosur e delikatë dhe që t'u shkaktojnë atyre të heqin dorë nga shërbimi i tyre për Risale-i Nurin.

Prandaj, ruhuni! Bëni kujdes! Mos e lini atë vëllazëri vetëflijuese dhe atë dashuri të vërtetë që e keni mbajtur deri tani, të lëkundet. Në qoftë se ajo vëllazëri e dashuri do të lëkundeshin sa një fije -thërrime-, ajo do të na shkaktonte ne një dëm të madh. Sepse vetëm një tronditje e vogël në Denizli u shkaktoi hoxhallarëve të tillë të mbanin distancë e të rrinin ftohtë. Shërbimi ynë ndaj Kur'anit e besimit bën të nevojshëm që, në qoftë se do të ishte e domosdoshme, ne do të sakrifikonim edhe shpirtërat tonë për njëri-tjetrin.

Fetarët e vërtetë nuk bëhen të mërzitur me njëri-tjetrin për shkak të vështirësive apo të ngacmueshmërisë që burojnë nga gjëra të tjera; ato me përulësi të plotë, me modesti dhe nënshtrim ua atribuojnë të metat dhe mangësitë veteve të tyre, dhe përpiqen të shtojnë dashurinë e tyre dhe sinqeritetin. Ose përndryshe ne do të goditeshim në shkallë shumë të madhe, dhe do të kishte gjasa të shkaktonim një dëm të pandreqshëm. Duke ia lënë temën mendjemprehtësisë suaj, unë po e shkurtoj atë këtu.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Si rrjedhojë e një paralajmërimi të rëndësishëm që unë kam marrë, ndodhen tani një ose dy detyra në lidhje me Risale-i Nurin, të cilat janë përpjekja me sa keni fuqi nëpërmjet mësimeve të Risale-i Nurit dhe jo të hyni në polemika, as të jeni të njëanshëm ndërmjet të burgosurve të

tjerë të mjerë në këtë shkollë të tretë të Jusufit. Sepse keqbërësit e rrezikshëm të cilët janë të fshehtë përpiqen të shfrytëzojnë ndryshimet, meritë, qëllimet personale, urrejtjen dhe inatin. Meqenëse, nëse do të ishte e domosdoshme, shumica e shokëve tonë të burgosur manifestojnë një damar heroizmi -shpirtin e heroizmit- gjë e cila i bën ata të gatshëm të sakrifikojnë jetët e tyre, kombin dhe për të dashurit, sigurisht ata burra guximtarë duhet të sakrifikojnë për të mirën e kombit, të paqës e të qetësisë këtu në burg kokëfortësinë e tyre, urrejtjen dhe armiqësinë, të cilat janë krejtësisht të padobishme dhe tej mase të dëmshme në këto kohë të stuhishme. Sepse në këtë mënyrë ata mund të jenë të shpëtuar nga korrupsioni i atyre që janë të fshehur, që punojnë fshehurazi në favor të anarkisë dhe terrorit dhe për të ngulitur tek njerëzit idetë e komunizmit.

Ose përndryshe -domethënë në kundërshtim me këto, do të ishte çështja- në këtë kohë të vështirë si ai që hedh shkëndi në barot, që do t'i shkaktonte dëm njëqind të burgosurve të mjerë dhe studentëve të pafajshëm të Risale-i Nurit dhe kësaj provincës së Afjonit, madje do të çonte në ndërhyrjen e një shoqërie sekrete e cila është këtu por që rrënjët e së cilës janë jashtë.

Meqenëse ne kemi hyrë në burg për hir të atyre nëpërmjet Kaderit Hyjnor, madje një grup prej nesh nuk dëshiron të largohet prej burgu për hir të lumturisë dhe të rehatisë së tyre shpirtërore, dhe ne jemi të gatshëm të sakrifikojmë rehatinë tonë për hir të rehatisë së të tjerëve prej vëllezërve tonë, dhe ne do të përballojmë me durim çdo vështirësi e mundim, atëherë duhet që edhe ata vëllezërit tonë të rinj të bëhen gjithashtu si të burgosurit e burgut të Denizlit, të mos zemërohen me njëri-tjetrin, të mos mërziten dhe të mos mbajnë mëri, por është e domosdoshme që ata të pajtohen me njëri-tjetrin si vëllezër të dashur duke i qetësuar ndjenjat e tyre dhe për hir të shenjtërisë së muajit të Shaëbanit dhe të muajit të bekuar të Ramazanit. Prandaj, ne dhe unë i konsiderojmë ata të jenë brenda rrethit të studentëve të Risale-i Nurit dhe i përfshijmë ata në duatë tona.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Në përputhje me kuptimin "*E mira qëndron në atë që zgjedh Allahu"*, ndodhen shumë shembuj të së mirës për shtyrjen e

kohës së gjykimit tonë dhe për ata prej vëllezërve tonë që kanë qenë liruar duke qenë këtu të pranishëm në ditën e gjykimit.

Po, meqenëse çështja e Risale-i Nurit i intereson të gjithë botës islame dhe sidomos këtij vendi, atëherë duhet të ketë tubime të gjalla të tilla si këto takime me qëllim që të tërheqim vëmendjen e të gjithë njerëzve për tek të vërtetat e tij. Dhe kështu Risale-i Nuri i jep mësimet e tij të shkëlqyera dhe me qartësi të plotë për miqtë dhe armiqtë; saqë ka shfaqur edhe sekretet më të fshehura tek armiqtë e tij më kryeneçë pa asnjë ngurrim në këto tubime të këtilla që janë përtej të gjitha shpresave tona dhe marrjes së masave, dhe përtej fshejhes sonë të atyre trajtesave, përtej përçmimit të armiqve tonë, dhe jashtë vullnetit tonë.

Meqenëse e vërteta është kështu, duhet që ne t'i konsiderojmë mundimet dhe vështirësitë që po i vuajmë tani dhe të cilat janë të pjesshme e shumë të pakta si një ilaç të hidhur, si kininë, dhe duke dhënë falënderime me durim, të themi: "Edhe kjo gjithashtu do të kalojë në dashtë Zoti xh.sh.".

Së Dyti: Unë e shkrova këtë për drejtorin e kësaj shkolle të Jusufit: Kur isha rob lufte në Rusi Stuhia Bolshevike -Revolucioni bolshevik- së pari shpërtheu në burgje, ashtu si Revolucioni Francez që së pari filloi në burgje dhe me të burgosurit të cilët njihen në histori me emrin "vagabontë". Për shkak të kësaj si në Eskishehir po ashtu edhe në Denizli studentët e Risale-i Nurit u përpoqën të reformonin të burgosurit e tjerë me sa të ishte e mundur. Në të dy burgjet reformimi ishte shumë i suksesshëm.

Këtu në Afjon ai madje do të jetë edhe më i sukseshëm, sepse si rezultat i instruksionit të Risale-i Nurit në këtë kohë të ndjeshme, stuhia[276] e fortë që fryu ishte veçse një e qindta e asaj që do të kishte qenë. Përndryshe rrymat e dëmshme jashtë të cilat i shfrytëzojnë konfliktet e incidenteve të atilla, dhe që i presin raste të tilla, do ta kishin hedhur shkëndinë në barutin e zi dhe do të kishin shkaktuar të shpërthente flaka...

Said Nursi

• • •

[276]Stuhia ishte një revoltë që shpërtheu në burg, por asnjë nga studentët e Risale-i Nurit nuk u përfshi në të. Autori.

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur, besnikë e të qëndrueshëm në shërbimin ndaj Kur'anit, të cilët nuk bëhen të shkurajuar prej vështirësive dhe nuk ikin prej nesh!

Për shkak të ndonjë vuajtje fizike dhe shpirtërore, nefsi im urdhërues për të liga më dëshpëroi mua tani për hirin tuaj, por papritmas m'u shfaq në zemër sa vijon: Edhe në qoftë se do t'i kishit vuajtur këto vështirësi dhjetë herë më shumë me qëllim që të takoheshit me të gjithë vëllezërit tuaj këtu nga afër, kjo përsëri do të kishte qenë shumë e lirë. Shfaqet e domosdoshme se ashtu si në kohët e hershme njerëzit e realitetit grumbulloheshin bashkë dhe takoheshin të paktën një ose dy herë në vit, edhe studentët e Risale-i Nurit grumbullohen së bashku brenda çdo pak vitesh në Shkollën e Jusufit. Në përputhje me rrugën e Risale-i Nurit e kurorëzuar me frikën ndaj Zotit dhe me asketizëm, dhe në përputhje me metodën e tij të karakterizuar me dhënien e mësimeve tek të gjithë njerëzit, dhe në mënyrë të veçantë tek ata që janë të nevojshëm, madje dhe tek kundërshtarët, dhe për t'i lejuar personalitetit të tij kolektiv që të flasë, atëherë kjo shkollë e Jusufit është vendi më i mirë për studentët e Risale-i Nurit dhe shumë i përshtatshëm për këto qëllime, saqë edhe në qoftë se kjo do të shkaktonte një mijë vështirësi e mundime, nuk do të kishte asnjë rëndësi.

Disa prej vëllezërve tonë të dobët duke u bërë të mërzitur prej burgjeve tona të mëparshëm dhe duke e lënë rrethin e Risale-i Nurit u shkaktoi atyre një dëm të pallogaritshëm, por asnjë dëm nuk ishte për Risale-i Nurin dhe për studentët e tij; përkundrazi në vend të tyre u shfaqën studentë më të vendosur e më të sinqertë.

Meqenëse sprovat e dynjasë janë të përkohshme dhe kalojnë shpejt, duke na lënë neve frutat dhe shpërblimet e tyre, ne duhet të mbështetemi tek Përkujdesja Hyjnore dhe të japim falënderime me durim.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: I dërgoni dy faqet e fundit, ose me shkronjat e vjetra ose të shkruara nga makina e shkrimit, jozyrtarisht tek kryetari i gjykatës

me anë të ndonjë personi serioz që ju e shihni të përshtatshëm; ia jepni atij gjithashtu shënimin vijues, të shkruar më vete:

Saidi ju paraqet juve falënderimin e tij dhe thotë: "Rojtarët i hapën dritaret, por prokurori i përgjithshëm nuk lejon asnjërin prej vëllezërve të mi që të vijë tek unë. Dhe ai kërkon që ju t'ia jepni atij *Mus'hafin sherif* -i cili është në gjykatë me qëllim që ai të mund ta lexojë gjatë këtyre muajve të bekuar. Ai dërgoi tre *xhuze* prej atij Mus'hafi tek drejtoria e çështjeve fetare si një model me qëllim që ata të mund ta botojnë atë fotografikisht. Përveç kësaj, ai kërkon njërin prej koleksioneve të Risale-i Nurit i cili është në gjykatë me qëllim që ai të mund ta lexojë atë në këtë vetminë e tij, në këtë burgim të vetmuar fillikat dhe në këto mundime të rënda, që të mund ta rehatojë atë dhe që të jetë një shok për të.

Duke ditur se ato koleksione kanë kaluar në tre ose në katër gjykata, dhe ato gjykata nuk i kanë kundërshtuar. Gjithashtu ato trajtesa kanë qenë vlerësuar e lavdëruar shumë prej dijetarëve kryesues të Mekës, Medinesë, Damaskut, Alepit dhe prej Universitetit të Azharit në Kajro, dhe asnjë prej tyre nuk i ka kritikuar dhe nuk i ka kundërshtuar ato..."

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Fejziu ka dy kopje të "*Hizb en-Nur*"[277] me vete. Në qoftë se ai nuk ka nevojë për të dyja, le të ma dërgojë mua njërën prej tyre, ose le të shkruajë Mehmed Fejziu një kopje tjetër. Gjithashtu trajtesa rreth Ramazanit dhe trajtesa e botuar e "*El-Ajetul-Kubra*" janë të nevojshme këtu.Uleni shpejt tensionin midis jush -pajtohuni, dhe riparojeni dëmin. Kujdes! Ruhuni! Shmangia më e vogël i shkakton dëm të madh rrethit të Risale-i Nurit. Mos u rrëmbeni prej ndjenjave që burojnë nga vështirësitë. Shpërthimi i sobës sime ishte një shenjë e kësaj fatkeqësie.

Said Nursi

---

[277]- Një trajtesë prej dyzet e pesë faqesh të cilën Bediuzzamani e përshkruan si "Manifestim të kuptimit të hadithit".
Mendimi reflektiv i një ore mund të jetë më i mirë se ibadeti nafile i një viti, si një provë e ndritshme e Risale-i Nurit, një dua e lartë që buron prej tij, dhe një model i vogël prej tij.Përkthyesi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë: Husrev, Muhammed, Fejzi dhe Sabri!

Duke besuar tek ju me të gjithë fuqinë time, unë prisja të hyja në varr me qetësi të zemrës dhe t'jua lija juve mbarëvajtjen dhe ruajtjen e Risale-i Nurit. Unë mendoja se asgjë fare nuk do t'ju ndante ju nga njëri-tjetri. Tani ka një njoftim zyrtar lidhur me planet e tmerrshme për të shkaktuar diferenca, ftohje e largime midis studentëve kryesues të Risale-i Nurit. Meqenëse, ashtu siç kërkohet medoemos nga fuqia e besnikërisë suaj dhe nga lidhja juaj e fortë me Risale-i Nurin, ju jeni të gatshëm t'i sakrifikoni jetët tuaja për njëri-tjetrin nëse do të ishte e domosdoshme, atëherë nuk ka dyshim, dhe madje duhet që ju t'i sakrifikoni edhe ndjenjat tuaja të pjesshme e kalimtare të cilat janë të parëndësishme për hir të të tjerëve, sepse përndryshe sigurisht që do të shkaktohej një dëm i madh për ne në këtë periudhë, dhe siç ka mundësi të ndodhë ndarje dhe largim prej sferës së Risale-i Nurit... unë e them këtë dhe dridhem nga ky përfundim.

Qysh prej tre ditësh unë përsëri kam qenë tronditur prej një dëshpërimi të tillë saqë nuk e kam përjetuar kurrë më parë. Unë tani kam kuptuar me siguri se një rrëmbim e zemërim aq i vogël -sa një qime në sy- do të kishte efektin e një bombe në jetën tonë me Risale-i Nurin.

Madje unë do t'jua them gjithashtu edhe këtë: Shumë përpjekje u bënë gjatë asaj stuhie -Revolte- të kaluar për të na lidhur ne me të. Tani ata po përpiqen që t'ju ndajnë e t'ju largojnë juve nga njëri-tjetri. Megjithëse kam vuajtur dhjetë herë më shumë se sa ju për hirin tuaj, unë kam vendos që të mos i vërej gabimet e asnjërit prej jush. Unë kërkoj nga ju në emrin e profesorit tonë, personalitetit kolektiv të Risale-i Nurit, që të braktisni egoizmin dhe të mos ngulmoni me të, sido që të jetë, i justifikueshëm ose jo i tillë.

Në qoftë se do të kishte gishtërinj të fshehtë duke luajtur në atë vend të çuditshëm, për shkak të qënies suaj së bashku, le të shkojë njëri prej jush tek dhoma e Tahirit.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ju lutem mos ofendoheni për rëndësinë e madhe që u kam dhënë ju të treve që u mbetet qejfi prej njëri-tjetrit. Sepse ashtu si unë, Husrevi dhe Fejziu janë disi të pashoqërueshëm -të pashkueshëm me shokë- dhe të rezervuar. Gjithashtu ata ndryshojnë nga njëri-tjetri në temperament. Sa për Sabriun, ai është i përfshirë në jetën shoqërore nëpërmjet të afërmve të tij dhe mënyrës së mjeteve të tij të jetesës, dhe është i detyruar të jetë i kujdesshëm. Meqenëse, për shkak të këtyre ndryshimeve të mënyrave dhe të temperamenteve, të tre ju keni qenë ndoshta të pamundur të ruani durimin dhe vetëpërmbajtjen në burbujën e oborrit dhe në turmat e tij të zhurmshme, unë jam bërë i shqetësuar dhe dyshues. Sepse vetëm një kundërshtim i vogël tani shkakton shumë dëm.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë dhe o bashkëstudentë në këtë shkollë të Jusufit!

Nata e ardhshme është Nata e mirë e "*Lejlejtu en-nisf min Shaëban*" -*Nata e Bera'etit*. Ajo është si një bërthamë e shenjtë e të gjithë vitit dhe si një lloj prej programeve të paracaktimeve njerëzore -të fatit njerëzor. Prandaj kjo Natë fiton Shenjtëri prej *Natës së Kadrit.*

Dhe ashtu siç shumëfishohen të mirat deri në tridhjet mijë në Natën e Kadrit, po ashtu vepra e mirë dhe çdo shkronjë prej shkronjave të Kur'anit në "*Natën e Bera'etit*" shtohen deri në njëzet mijë sevabe.

Në qoftë se një e mirë e vetme shpërblehet me dhjetë të tilla në kohët e tjera, në tre muajt -e Rexhepit, Shaëbanit dhe Ramazanit- ato të mira shtohen e arrijnë në njëqind mijë të tilla. Dhe në këto Netë të shquara e të bekuara të mirat shtohen e rriten deri në dhjetë mijë, në njëzet mijë dhe deri në tridhjetë mijë të mira.

Këto Netë të bekuara mund të jenë të barasvlefshme me ibadetin e pesëdhjetë viteve. Prandaj prokopia me sa të jetë e mundur -me këndimin e Kur'anit Kerim, me istigfar -kërkim falje- dhe me salevate mbi profetin a.s.m. në këtë natë është një fitim shumë i madh.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju, dhe Zoti ju shpëtoftë në të dyja botët!

Ju përgëzoj me të gjithë zemrën dhe shpirtin tim për *Natën e mirë të Beraetit* e cila mund t'i bëjë besimtarët të fitojnë barasvlerën e ibadetit të pesëdhjetë viteve. Unë pres me siguri të plotë nga Mëshira Hyjnore që nëpërmjet misterit të pjesëmarrjes shpitrërore dhe të shkëlqimit të solidaritetit, ashtu si disa Melekë të cilët i shprehin falënderimet me dyzet mijë gjuhë, po ashtu të gjithë studentët e sinqertë të Risale-i Nurit në këtë Natë të bekuar sikur e adhurojnë Allahun dhe i kërkojnë falje me Dyzet mijë gjuhë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Së Pari: Me sugjerimin e disa hoxhallarëve të cilët përkrahin bidatet -risitë-, padia ka kundërshtuar një çështje të Rrezes së Pestë, sikur ajo nuk pranon ardhjen e Dexhalit në islam si dhe dexhalët e tjerë. Përgjigjja për këtë është hadithi i saktë: "*Kalifati do të vazhdojë me djemtë e xhaxhait tim Abbasit derisa ai -kalifati- të kalojë në dorën shkatërruese të Dexhalit*".[278]

Ky hadith sherif përveç se konsiderohet një mrekulli e ndritshme prej mrekullive të profetit tonë a.s.m., ai tregon në mënyrë të qartë se kalifati Abasid do të shfaqet dhe do të vazhdojë për një kohë të gjatë afërsisht pesëqind vjet dhe pastaj do të shkatërrohet nga dora e një Dexhali prej tre Dexhalëve të tillë, si: Xhengiz dhe Hulagu, pastaj ai do të sundojë pabesisht e tradhtisht brenda islamit. Domethënë, siç tregohet nga hadithe të shumta, se ndodhet një dëshmi e qartë se tre Dexhalë do të shfaqen në Botën Islame. Parashikimet e bëra prej hadithit të lartëpërmendur janë dy mrekulli të qarta.

E Para: është se "Kalifati Abasid", i cili do të vinte në ekzistencë, do të vazhdonte për pesëqind vite.

E Dyta: Se ky kalifat do të shkatërrohej nga dora e një Dexhali tiran e mizor të tillë, si: Xhengiz dhe Hulagu.

Sa çudi! A do të ishte e mundur për pronarin e Sheriatit i cili njoftoi në librat e hadithit për gjëra të pjesshme që lidhen me shenjat e

[278] Musnad El-Firdeus, vëllimi III, 447.etj…

islamit dhe të Kur'anit, të mos parashikonte ngjarjet e çuditshme të cilat janë në këtë kohën tonë? Dhe a do të ishte e mundur që të mos kishte aluzione për studentët e Risale-i Nurit, të cilët në mënyrë të palëkundur i shërbejnë Kur'anit në mes të atyre ngjarjeve të çuditshme, në sferën më të gjërë dhe nën kushtet më të vështira, dhe frutat e shërbimit të të cilëve njihen e pranohen njëlloj nga miqtë dhe armiqtë?

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

"Dhe kështu ata u mbuluan me poshtërim dhe mjerim..."[279]

[Një pikë e hollë rreth këtij vërseti]

Vëllai im i dashur Rë'fet Bey, komandanti i Risale-i Nurit dhe shërbëtori i Kur'anit!

Kombi çifut ka qenë gjithmonë i skajshëm në dashurinë e tij për jetën dhe për këtë botë, dhe prandaj ai i ka merituar goditjet e poshtërimit dhe të mjerimit që i ka marrë në çdo shekull. Veçse ama në lidhje me çështjen e Palestinës, kjo nuk është dashuri për jetën dhe për këtë botë, por është një lloj i rëndësishëm i ndjenjave nacionale dhe fetare, sepse Palestina është vendi ku janë varrosur profetët e Bijve të Israelit, dhe profetët i përkisnin kombit të tyre. Si rrjedhojë, ata nuk kanë marrë këtë herë goditje të shpejta. Ose ndryshe si do të ishte e mundur që një grusht i vogël njerëzish të jetonte në mes të atij grumbulli të madh arabësh pa marrë goditje të shpejta dhe pa u rënë poshtërimi e mjerimi?

• • •

Pyetje: A ka ndonjë vërset që tregon se toka është e rrumbullakët dhe në cilën prej sureve të Kur'anit Kerim? Sepse unë jam ngurrues nëse ajo është e sheshtë -e drejtë- apo e rrumbullakët. Të gjitha vendet janë vendosur nëpër toka të rrethuara nga deti. Dhe çfarë është ajo që i ruan anët -brigjet -e këtyre deteve të gjërë? Unë kërkoj që ju të jepni një shpjegim, dhe unë puth duart e tua.

Ali Hoxha nga Emirdagu

[279] Kur'an, 2 :61

Risale-i Nuri i ka zgjidhur pyetjet e këtij lloji. Dijetarët islamë kanë pranuar se toka është e rrumbullakët, dhe kjo nuk është aspak në kundërshtim me fenë. Fjala "*Sat'h*" në vërset[280] nuk tregon se toka nuk është e rrumbullakët. Për më tepër, kthimi drejt 'Kibles' -*Istikbal elkibleh* -është kusht për kryerjen e namazeve tek Muxhtehidët - Interpretuesit e sheriatit; dhe ky kusht është i aplikueshëm për çdo pjesë të namazeve, duke përfshirë rënien në Ruku dhe rënien në sexhde, dhe kjo do të ishte e mundur vetëm me rrumbullakësinë e tokës. Sipas Sheriatit Kibleja është një kolonë -rresht -i ndritshëm që ngjitet nga maja e Qabesë për tek Arshi dhe shtrihet prej nga ana më e poshtme e saj deri rrafsh me tokën. Dhe kryerja e të gjitha akteve të faljes në drejtim të 'Kibles' do të ishte e mundur vetëm me rrumbullakësinë e tokës.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij.[281]

Paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ju përherë e përgjithmonë!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ju përgëzoj me të gjithë zemrën dhe shpirtin tim për ardhjen e Muajit të Ramazanit dhe i lutemi Allahut që ta bëjë *Natën e Kadrit* për ju më të mirë se një mijë muaj. Amin. Dhe ta pranojë atë si ibadetin e tetëdhjetë viteve të jetës së kaluar në adhurim... Amin.

Së Dyti: Unë mendoj se ka shumë dobi dhe shembuj mirësie në qëndrimin tonë këtu deri në festë. Në qoftë se ne do të liroheshim tani, ne do të humbisnim të gjithë të mirat e shkollës së Jusufit, dhe përveç kësaj, ne do të merreshim me çështjet e dynjasë në këtë muaj të bekuar, muajin e Ramazanit i cili shikon thjesht dhe vetëm Ahiretin, dhe kjo do t'i prishte jetët tona shpirtërore.

Në përputhje me *"e mira qëndron në atë që zgjedh Allahu*", do të gjejmë gëzim të madh e mirësi më të shumta, në dashtë Zoti.

Ju gjithashtu, o vëllezërit e mi, e keni kuptuar në gjykatë se meqenëse ata nuk mund të gjejnë asgjë kudra nesh as me vetë ligjet e

[280]Kur'an, 88:20.
[281] Kur'an, 17:44

tyre, ata diskutojnë vogëlima krejtësisht të parëndësishme si disa çështje të pjesshme në disa letra të pjesshme të cilat kanë më pak lidhje me ligjin se sa krahu i një mize. Sepse ata nuk kanë gjetur rrugë për të sulmuar çështjet domethënëse dhe universale të Risale-i Nurit.

Gjithashtu, ne kemi një avantazh tjetër, ai është se ata merren me personin tim që s'ka rëndësi dhe më shpifin për të më ulur në vend të marrjes së tyre me studentët e shumtë të Risale-i Nurit dhe me trajtesat e përhapura gjërësisht dhe me çështjet universale të Risale-i Nurit. Kaderi Hyjnor nuk i lejon ata të ndërhyjnë tek Risale-i Nuri dhe tek studentët e tij, por i preokupon ata me mua. Kështu unë ju them juve dhe të gjithë shokëve të mi: Për mbarëvajtjen tuaj dhe të Risale-i Nurit, unë i pranoj me gjithë zemër, madje edhe me miratimin e nefsit tim urdhërues për të liga, dhe me gëzim e mirënjohje, të gjitha vështirësitë e ardhura mbi personin tim. Dhe ashtu si Xhenneti që nuk është i lirë -i pashtrenjtë-, po ashtu edhe Xhehennemi nuk është i panevojshëm.

Dhe meqenëse dynjaja dhe vështirësitë e saja janë të përkohshme dhe kalojnë shpejt, edhe për keqtrajtimet që ne i marrim prej duarve të armiqve tonë të fshehur ne do të marrim hak në mënyrë të shumëfishtë, madje njëqindfish; dhe këtë hak do ta marrim në Gjyqin e Fundit, dhe pjesërisht edhe në këtë dynja.

Dhe ne në vend të urrejtjes dhe të zemërimit me ta, do të na vijë keq për gjendjen e tyre. Meqenëse realiteti është ky, atëherë duhet që ne të mbështetemi tek Allahu dhe t'i nënshtrohemi çfarëdo gjëje që ka dekretuar Kaderi Hyjnor për ne dhe të besojmë në Përkujdesjen Hyjnore e cila na mbron neve, dhe të mos shqetësohemi. Por duke qenë të kujdesur, dhe duke u zbukuruar me durim të plotë dhe me falënderime, dhe duke forcuar lidhjet e dashurisë, të unitetit dhe shoqërinë e përzemërt me vëllezërit tonë këtu në këto ditë të bekuara të këtij muaji të bekuar, muajit të Ramazanit, dhe ta kalojmë atë në një atmosferë të vëllazërisë së sinqertë, të ngushëllimit, të lidhjes së fortë, dhe duke u marrë me recitimin e *virdeve* në këtë muaj në të cilin rritet sevabi deri në një mijë, dhe të përpiqemi që të mos mërzitemi nga këto mundime të pjesshme të përkohshme e kalimtare, por të preokupohemi me mësimet tona shkencore; dhe ky është një fat i madh, që Zoti ia jep cilit të dojë.

Dhe mësimet shumë ndikuese të Risale-i Nurit në këtë provim të vështirë dhe duke i bërë ta lexojnë edhe armiqtë e tij, kjo është një fitore shumë e rëndësishme për të.[282]

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij.

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Siç rrëfehet në hadithe të sakta: *"Kërkojeni Natën e Kadrit në gjysmën e dytë të Ramazanit, veçanërisht në Dhjetë Ditët e Fundit".*[283]

Prandaj është një lumturi e madhe që të përpiqemi të përfitojmë prej *Natës së Kadrit*, e cila mund të fitojë për njeriun sa tetëdhjetë vite jetë të mbushur me ibadet, dhe e cila ka mundësi të jetë midis netëve të ardhshme.

Së Dyti: Në përputhje me kuptimin e "*Ai që i beson Kaderit Hyjnor, shpëton nga brenga"* dhe sipas rregullit të urtë: "*shiko tek ana e mirë e gjërave*" dhe sipas vërsetit Kur'anor:

"Të Cilët e dëgjojnë Fjalën dhe ndjekin më të lartën prej saj (kuptimin më të mirë në të); pikërisht këta janë ata të cilët i ka udhëzuar Allahu, pikërisht këta janë njerëzit e brumosur me mendje të shëndoshë",[284] ne duhet të shikojmë tek ana e mirë e çdo gjëje, aspektin që na jep qetësi të mendjes, me qëllim që të mos preokupohen zemrat tona me gjendje të shëmtuara të pakuptimta, kalimtare dhe të panevojshme për ne, por të cilat janë madje të dëmshme dhe që shkaktojnë dëshpërim e pikëllim. Në Fjalën e Tetë u përmend:

Një burrë hyri në një kopësht, ndërsa një tjetër e la atë. Njeriu fatbardhë pa lulet dhe gjërat e bukura dhe e qetësoi dhe e gëzoi vetveten. Por njeriu fatkeq pa vetëm gjërat e shëmtuara dhe të pista,

---

[282] Sigurisht që është e keqe që disa nga vëllezërit tonë në mënyrë të panevojshme mohojnë se janë studentët e Risale-i Nurit, dhe veçanërisht..., dhe që ata po i fshehin shërbimet e tyre të konsiderueshme të së shkuarës, por për shkak të atij shërbimi ne duhet t'i falim ata dhe nuk duhet të ndjehemi të zemëruar prej tyre.

[283] Transmeton Buhariu

[284] Kur'an, 39:18

ndonëse ishte i pamundur t'i pastronte ato; ato gjëra i çuan të përziera atij dhe ia pështirosën; atëherë ai e la atë dhe vazhdoi rrugën pa qenë i mundur të pushonte fare. Tani fazat e jetës shoqërore të njeriut dhe veçanërisht shkolla e Jusufit, i ngjason një kopështi. Ai përmban edhe gjëra të shëmtuara edhe gjëra të bukura, si dhe gjëra dëshpëruese dhe gjëra të gëzueshme. Personi i ndjeshëm është ai që e preokupon vetveten me gjërat e bukura dhe që japin gëzim dhe i shpërfill gjërat dëshpëruese e të shëmtuara, dhe jep falënderime me gëzim në vend të ankesave dhe të shqetësimit.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Ka një mundësi të fortë që nesër në mbrëmje të jetë Nata e Kadrit. Disa prej autoriteteve shkencore deklaruan se ajo është nesër. Edhe në qoftë se nuk do të ishte në fakt, meqenëse Ummeti e konsideron të jetë kështu, në dashtë Zoti ajo do të pranohet e tillë.

Së Dyti: Unë jam i mërzitur rreth rehatisë së vëllezërve tonë në krahun e gjashtë të burgut, ku ka pasë trazira. Ka një gisht nga jashtë i cili nxit trazira në burg dhe veçanërisht në krahun e gjashtë. Vëllezërit e mi atje duhet të jenë të vëmendshëm e të kujdesshëm, dhe të mos ndërlikohen në asgjë.

Së Treti: A e keni dërguar pjesën -paragrafin- tek avokati, që t'ia lexojë kryetarit të Gjykatës? Gjithashtu, për shkak se është e njëjta çështje, Halil Hilmiu nuk është vetëm avokati i Sabriut, por i gjithësecilit. Kjo është si e shoh unë atë. Ai duhet tani të ndihmojë avokatin tonë të parë për llogari të të gjithë neve.

Së Katërti: Unë ia dhashë parathënien Tashkopruly Sadik Beut, Sabriut që ta shkruajë. Në qoftë se ajo tashmë është shkruar, pjesa që është korrektuar duhet t'i dërgohet atij. Një kopje e shkruar rishtas duhet të dërgohet tek unë. Unë kam këtu një kopje të një poeme të shkurtër të Sadikut. Në qoftë se ju nuk keni një kopje, unë do t'jua dërgoj atë juve.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Ju dërgoj përshëndetje për festën tuaj, si dhe përshëndes edhe të burgosurit që janë me ju. Unë i konsideroj ata, të cilët shkëmbejnë përshëndetje me ju, të më kenë përshëndetur edhe mua.

Është sikur unë i kam bërë vizitat e festës tek të gjithë ata; ju duhet ta dini këtë dhe duhet t'ua thoni atyre.

Së Dyti: Për shkak të paralajmërimit të sobës sime të hedhur në oborr që shpërtheu duke u thërrmuar pa ndonjë arsye të jashtme, dhe veprimi ynë me kujdes të plotë me vetëpërmbajtje si rrjedhojë, forca e asaj "stuhie" u pakësua njëqindfish dhe baruti i zi nuk u ndoz. Tani përsëri shishet e ujit duke u thërrmuar në mënyrë të jashtëzakonshme pa ndonjë arsye të jashtme, kjo na njofton neve se duhet të sillemi përsëri me gjakftohtësi, me durim e me maturi. M'u shfaq mua se hipokritët e fshehur dëshirojnë të përdorin njerëzit e shthurur dhe komunistët felëshues kundra njerëzve të drejtë fetarë; madje ata po përpiqen të ndërhyjnë këtu.[285]

Vëllezërit e mi të dashur, besnikë dhe të palëkundur!

Unë ju përshëndes ju me të gjithë zemrën dhe shpirtin tim që e shëruat shpejt plagën tonë. Si rrjedhojë, unë u ndjeva krejtësisht i rehatuar e i gëzuar mbrëmë. Dihet se *El-Medresetu ez-zehra* zgjerohet dhe pajis mendjet dhe zemrat nëpërmjet misterit të sinqeritetit të vërtetë dhe të vetëfljimit serioz, dhe duke braktisur egoizmin, dhe nëpërmjet modestisë së plotë, brenda rrethit të Risale-i Nurit; dhe ajo i përhap këto gjëra nëpër qarqe. Atëherë duhet medoemos që të mos prishen ato mësime të fuqishme dhe ajo lidhje vëllazërore e fortë prej atyre gjërave kalimtare dhe pafundësisht të pjesshme të cilat lindin prej ndjenjave dhe emocioneve, dhe mos u rrëmbeni dhe mos u iritoni ndaj njëri-tjetrit.

Trajtesa rreth Sinqeritetit është këshilluesi më i mirë në këtë fushë.

---

[285]- Dje unë u ndjeva i lumtur dhe i gëzuar. Pastaj unë kuptova se vëllai im në Nurs qysh para tetë muajve më kishte dërguar ca mjalt në një shishe në Emirdag. Dje ai arriti këtu nga Emirdagu. Unë u thashë atyre që të ma sillnin shpejt atë. Unë prita, por ajo nuk më erdhi. Lumturia ime u shndërrua menjëherë në zemërim. Ishte shkaku i asaj shisheje me mjalt -i cili në shikimin tim ishte njëqind herë më i çmueshëm se sa shishja- duke iu dhënë një të huaji dhe duke u dërguar në treg, që atëherë shishja papritmas u thye. Unë kam dërguar një sasi prej atij mjalti të ëmbël, një dhuratë prej fshatit Nurs, vendlindja ime, me qëllim që të gjithë vëllezërit e mi të shijojnë prej tij si një ëmbëlsirë feste.

Ata kanë kurdisur tani një plan të tmerrshëm për të na goditur dhe për t'i bërë studentët e Risale-i Nurit ta shohin ftohtë njëri-tjetrin duke luajtur me ndryshimet në idetë dhe në temperamentet e tyre, dhe për t'i ndarë ata nga njëri-tjetri. Sigurisht ishte thjesht një zënkë e vogël, por vetëm një qime në sy shkakton dhimbjen e një guri. Prandaj shishja ime dha njoftime për të sikur ai të ishte një incident i madh. I ndjeri Hafiz Aliu -Zoti qoftë i kënaqur me të- duke u ankuar pak përpara vdekjes së tij rreth një situate të tillë shumë të pjesshme më ka ardhur ndërmend ndoshta njëqind herë dhe më ka dëshpëruar.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë ia dhashë drejtorit të burgut kundërshtimet e shkruara të studentëve. Unë i thashë atij:

"Ne duam ta dërgojmë këtë, së bashku me pjesën e fundit të kundërshtimeve të mia të shkruara, tek drejtoria e çështjeve fetare dhe tek gjykata penale e Ankarasë, të cilat na kanë dhënë pafajësinë neve dhe trajtesave tona, dhe në qoftë se do të ishte e përshtatshme të dërgoni gjithashtu listën e gabimeve dhe të korrektimeve, por privatisht dhe vetëm për informacion".

Ai tha: "Do të ishte e përshtatshme". Tani ju mund t'i kërkoni avokatit që t'i bëjë gati disa kopje të kundërshtimeve të shkruara të studentëve dhe dy kopje të listës.

Gjithashtu, i shkruani drejtorisë së çështjeve fetare dhe i thoni: meqenëse ju shkruat në mënyrë përfekte dhe korrekte në raport rreth Saidit dhe shokëve të tij, atëherë ju dërgojani Afjonit këtë herë, pasi është detyra juaj që t'i mbroni dijetarët e fesë; Edhe Saidi i shtypur edhe studentët e shokët e tij të pafajshëm janë mirënjohës ndaj departamentit tuaj.

Sidoqoftë, çështja lidhet me fenë dhe me dijen, kështu departamenti i çështjeve fetare duhet të interesohet për të para policisë dhe drejtësisë apo ndonjë departamenti tjetër. Për këtë arsye, edhe në Denizli, edhe në Afjon ne së pari iu drejtuam departamentit tuaj, duke i dërguar ankesat tona tek dijetarët atje. Shkruani një paragraf duke shprehur këtë kuptim.

Said Nursi

• • •

Vëllai im i dashur e besnik Re'fet Bey!

Nga respekti për Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm, dhe për hir të lidhjeve të tua me Kur'anin, dhe në nder të njëzet viteve të tua në shërbim të besimit nëpërmjet Risale-i Nurit, jepini fund menjëherë kësaj mërie e urrejtje midis jush sepse ajo është e tmerrshme pavarësisht qënies së saj si diçka e pjesshme -në dukje- veçse ama ajo është e dhimbshme e pikëlluese lidhur me situatat tona aktuale. Kjo do të ishte një ndihmë e madhe për hipokritët e fshehtë të cilët përpiqen të na dëbojnë e të na shkatërrojnë, dhe është si të hudhësh një fije të ndezur shkrepëseje në barut të zi. Prandaj, o vëllezërit e mi, mos u pezmatoni nga njëri-tjetri.!

I nxisni të tjerët të heqin dorë prej saj. Sepse përndryshe ka një mundësi të fortë që për shkak të një të drejte të pjesshme personale që nuk vlen as sa një *dirhem* -peshë- mund të shkaktohen tonelata dëme për ne, për shërbimin ndaj Kur'anit dhe ndaj Imanit.

Unë betohem se në qoftë se ndonjëri prej jush do të më fyente mua në mënyrën më të tmerrshme dhe ta nëpërkëmbte krejtësisht nderin tim, por të mos e braktiste shërbimin ndaj Kur'anit, besimit dhe ndaj Risale-i Nurit, unë do ta falja atë dhe do të bëja paqë me të dhe do të përpiqesha të mos ofendohesha. Ju e dini se armiqtë tonë përpiqen të shfrytëzojnë edhe mosmirësjelljen më të vogël midis vëllezërve, prandaj pajtohuni shpejt. Hiqni dorë nga të qënurit zemërakë, gjë e cila është e pakuptim dhe e dëmshme. Përndryshe, ashtu si Shemsiu, Shefiku dhe Teufiku, disa prej nesh në dukje do t'u bashkohen atyre që na kundërshtojnë, duke i shkaktuar dëm shërbimit tonë ndaj imanit.

Meqenëse Përkujdesja Hyjnore na ka dhuruar neve shumë në vend të të humburve që janë larguar prej nesh, përsëri ajo Përkujdesje do të na mbështesë e do të na ndihmojë në dashtë Zoti xh.sh..

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Drejtori i burgut siç duket e pëlqeu shumë veprën "*El-Ajetul-Kubra*" dhe trajtesën "*Udhëzuesi për të rinjtë*". Tani ai dëshiron koleksionin "*Asa Musa" "Shkopi i Musait*", dhe koleksionin "*Dhul-Fikar*". Unë i thashë atij se do t'ia dërgoja ato. Në qoftë se ndodhen kopjet e tyre këtu në Afjon, vendoseni mënjanë secilën prej koleksioneve "*Shkopi i Musait*", "*Dhul Fikarin*" (në vëllim të madh, të lidhur) "*Udhëzuesi për të rinjtë*", dhe *El-Ajetul-Kubra*".

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Ky raport ka pasur ekzaktësisht të njëjtin rezultat si ai i Denizlit. Ata na kanë shfajësuar neve për pikat me të cilat na kanë akuzuar, por me qëllim që t'i bëjnë për vete ata dhe të tregojnë se ata nuk janë Studentë të Risale-i Nurit, dhe për shkak të një damari të *Vehabizmit*, ata na kanë kritikuar neve me disa kritika shkencore. Unë mendoj se ky raport ka arritur para se të shkruhej akuza, sepse akuza i përfshin disa pika prej tij.

Sidoqoftë, lista jonë e gabimeve dhe e korrektimeve u përgjigjet atyre në mënyrë të plotë. Çfarë mendoni për këtë? Gjithashtu si janë përgjigjjet e mia të reja? A janë ato të sakta? Unë i shkrova ato me shumë nxitim kur isha në një gjendje të mjeruar.

Së Dyti: Deri tani ata në dukje kanë qenë preokupuar me personat tonë, me çështjet e një shoqërie politike, formimin i një tarikati Sufi dhe me disa letra të parëndësishme private. Por tani, me konfiskimin e trajtesës "*Siraxhun-Nur*" dhe të trajtesës "*Gjashtë Sulmet*", dhe komiteti i ekspertëve duke drejtuar vëmendjen tek Risale-i Nuri, dhe intrigat e armiqve tonë të fshehur kanë bërë që Risale-i Nuri të sulmohet në një lloj mënyre, në një kohë që ai është mjeti për të siguruar qetësinë në këtë vend. Dhe ashtu si në shumë raste më parë, mu në kohën që vendi po sulmohej në këtë mënyrë, ndodhën dy tërmete të fuqishëm, ashtu siç ndërsa po e shkruaja atë diskutim. Kjo më afirmoi mua duke thënë: Nuk është nevoja ta shkruash atë. Kështu unë nuk e shkrova më. Pastaj sot unë dëgjova se ekziston frika e një lufte. Kështu unë i thashë pesonit përgjegjës këtu: "Sa herë që sulmohet Risale-i Nuri, toka bëhet e zemëruar ose ekziston frika e luftës. Ne kemi përjetuar shumë ngjarje të tilla saqë asnjë mundësi rastësie nuk ka mbetur, dhe këto kanë qenë treguar në gjykata. Domethënë, shqetësimi im i tmerrshëm rreth Risale-i Nurit më parë, dhe kritikat xhelozë të komitetit të ekspertëve, dhe konfiskimi i një pjese të rëndësishme të Risale-i Nurit, megjithëse unë nuk e kuptova atë, koinçidoi me trajtesën "*Siraxhun-Nur*" -e cila është si një sadeka e pranueshme dhe një mjet për të larguar fatkeqësitë- u zhduk pas perdes së fshehtësisë, ra tërmeti dhe frika e shpërthimit të luftës.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Mos u shqetësoni! Ne jemi nën përkujdesjen dhe mbrojtjen Hyjnore. Mundimet e jashtme mbajnë shembuj të shumtë mëshire. Komiteti i ekspertëve u detyruan të kundërshtojnë një pjesë prej Risale-i Nurit... Nuk ka dyshim se zemrat e ekspertëve janë bërë prej Nurxhuve.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur, të palëkundur, të patrembur, të cilët nuk do ta braktisnin kurrë punën për Ahiretin për këtë botë kalimtare!

Mos u dëshpëroni që po mbetem këtu edhe për një periudhë tjetër për shkak të dëshirës së tyre për ta zgjeruar rrethin e çështjes sonë. Përkundrazi, jini të kënaqur, ashtu si unë. Sepse meqenëse jeta nuk ndalon por nxiton drejt zhdukjes, në vendet e sprovave të tilla si ky, ajo bëhet e përjetshme nëpërmjet frutave që ajo fiton për Ahiretin. Për më tepër, rrethi i mësimeve të Risale-i Nurit është duke u zgjeruar. Për shembull, dijetarët e komitetit të ekspertëve janë duke u detyruar që ta studiojnë me shumë vëmendje trajtesën "*Siraxhun-Nur*". Gjithashtu është e mundur që në qoftë se ne do të liroheshim tani, kjo do të na shkaktonte mangësi në punën tonë në shërbim të besimit në një ose dy aspekte.

Unë nuk dëshiroj të largohem nga burgu ndonëse unë vuaj vështirësi më shumë se ju. Edhe ju gjithashtu përpiquni -sipas mundësive- të jeni të duruar, të vetëpërmbajtur dhe të mësoheni me këtë lloj jete këtu dhe duke u preokupuar me kopjimin e Risale-i Nurit dhe me studimin e tij që të gjeni ngushëllim e gëzim.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Në qoftë se do të ishte e domosdoshme, unë mund t'ju dërgoj juve dy kopje të listës së gabimeve nga fundi i mbrojtjeve, të cilat unë i kam këtu me shkronjat e reja. Ato duhet të dërgohen tek Drejtoria e çështjeve fetare përveç përgjigjjes ndaj komitetit të ekspertëve, dhe tek Gjykata Penale e Ankarasë. Një kopje e përgjigjjes ndaj komitetit të ekspertëve duhet që t'i dërgohet gjithashtu gjykatës këtu.

Së Dyti: Është gjë e mirë që ata e kanë zgjeruar çështjen tonë. Deri tani ata e kanë bërë atë të shfaqet e vogël dhe e parëndësishme me qëllim që ta zhvlerësonin atë, por fshehurazi i jepnin asaj shumë rëndësi. Situata tani do të jetë më e volitshme për punën tonë në rrugën e besimit dhe të Kur'anit, në dashtë Zoti xh.sh..

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Në qoftë se udhëtimi për në Haxh do të kishte qenë i lirë dhe i lejueshëm, disa prej nesh ndoshta do ta kishin bërë haxhillëkun.

I lutemi Allahut që ta pranojë këtë nijetin -qëllimin- tonë sikur ne të kishim shkuar vërtet në haxh, dhe që t'i japë shërbimit tonë ndaj besimit dhe ndaj Risale-i Nurit shpërblim të madh si shpërblimi i haxhit ndërsa ne po vuajmë në këto rrethana të mbushura me mundime e vështirësi.

Së Dyti: Meqenëse ne në mënyrë të përsëritur kemi thënë se "Risale-i Nuri është një koment i fuqishëm dhe i vërtetë i Kur'anit", m'u shfaq se unë duhet të shpjegoj një fakt, meqenëse disa njerëz të pavëmendshëm nuk e dinë kuptimin e plotë të kësaj. Fakti është ky:

Ndodhen dy lloje të komenteve të Kur'anit:

I Pari është lloji i mirënjohur. Komentet e këtij lloji shpjegojnë e sqarojnë frazeologjinë e Kur'anit, fjalët dhe fjalitë e tij.

Lloji i dytë shpjegon, provon dhe sqaron me argumente të fuqishëm të vërtetat e Kur'anit që lidhen me besimin.

Ky lloj ka rëndësi të madhe. Ndonjëherë komentet e mirënjohur, të cilët shpjegojnë aspektin e jashtëm, e përfshijnë këtë llojin e fundit në mënyrë të përmbledhur. Por Risale-i Nuri e ka marrë këtë lloj si bazën e tij të drejtëpërdrejtë. Dhe Risale-i Nuri është një komentim i

kuptimeve të Kur'anit Kerim i cili i hesht në një mënyrë të paparë edhe filozofët më kryeneçë.

Së Treti: Këtë mëngjes unë do të shkruaja diçka, por nuk e bëra. Tani e njëjta çështje është shfaqur, dhe nëpunësi Salim Bey dha leje. Husrevi dhe Tahiri duhet të vijnë nesër me qëllim që të shkruajnë një peticion për kabinetin qeveritar.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

A mos vallë ne dhe Risale-i Nuri qenkemi më të dëmshmit rreth e qark saqë të gjithë shkruesit e tjerë janë të lirë të shkruajnë dhe të gjithë klasat e njerëzve janë të lira të takohen bashkë? Por pa edukim fetar, myslimanët nuk mund të sundohen përveç se me një despotizëm absolut dhe me një ryshfet të pakufishëm. Sepse, ashtu si një mysliman -i cili braktis fenë e tij- që nuk mund të bëhet një çifut i vërtetë dhe as një krishter i vërtetë, por bëhet një ateist dhe krejtësisht i korruptuar dhe i çudhëzuar, po ashtu myslimani nuk mund të bëhet kurrë komunist, por një anarkist terrorizues; dhe atëherë ai nuk do të mund të sundohej me asgjë tjetër përveç despotizmit absolut. Ndërsa ne studentët e Risale-i Nurit po punojmë për të ndihmuar administratën, për të vendosur rendin e qetësinë dhe për lumturinë e këtij vendi dhe kombi. Ata që na kundërshtojnë neve janë anarkistë ateistë dhe armiqtë e vendit dhe të kombit. Është e domosdoshme që qeveria të mos ndërhyjë tek ne, por të na mbrojë neve dhe të na ndihmojë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Lirimi i botuesve të Risale-i Nurit të tillë, si Re'fet, Ed'hemi, anëtarët e Familjes Çalishkanë dhe të Burhanit tregon se nuk është e ndaluar të përhapet Risale-i Nuri dhe gjykata nuk ndërhyn në të. Gjithashtu ajo është një shenjë se ajo ka vendosur se nuk është shoqëri politike. Gjithashtu, zgjatja e periudhës së çështjes sonë dhe tërheqja e shikimeve të tyre tek Risale-i Nuri në një fushë të gjërë, është vetëm se një ftesë e përgjithshme për leximin e Risale-i Nurit

dhe një njoftim zyrtar për të, gjë e cila nxit tek dëgjuesit e përmalluar dëshirën për ta lexuar atë. Kjo ka qenë mjet që ne njerëzit e imanit të përfitojmë dobi të mëdhaja që i tejkalojnë mundimet tona njëqind herë. Dhe kjo është një shenjë, në dashtë Zoti, se ky mësim i shenjtë do të ketë efektin e një bombe atomike kundra trupave agresivë të çudhëzimit të cilët janë në sulm në këtë kohë gjithandej tokës në mënyrën më të gjërë e më të tmerrshme.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë: Reëfet, Mehmed, Fejzi, Sabri!

Unë mora një paralajmërim të ashpër dhe një shenjë, dhe kërkoj seriozisht nga ju për hir të Risale-i Nurit dhe nga respekti për këtë festë dhe për hir të të drejtave të vëllazërisë sonë të mëparshme midis nesh: përpiquni ju, o tre vëllezër, që ta qetësoni e shëroni këtë plagën tonë të re. Sepse armiqtë tonë të fshehur po ndjekin dy plane: njëri është që të shkatërrojnë karakterin tim me trajtim fyes, dhe i dyti është që të na bëjnë neve të ftohur e të na largojnë nga njëri-tjetri. Të kritikosh, të kundërshtosh dhe të ofendohesh prej Husrevit është të shkaktosh ndarje midis nesh. Unë ju them juve se në qoftë se Husrevi do të kishte një mijë gabime, unë përsëri do të isha i kujdesur dhe do të kisha frikë të flisja kundra tij. Sepse ta kundërshtosh atë tani, do të thotë të kundërshtosh direkt Risale-i Nurin dhe mua dhe do të thotë të mbështesësh ata të cilët na kanë shkatërruar neve. Ajo do të ishte tradhti e tmerrshme, saqë një gjë e jashtëzakonshme më ndodhi pa asnjë arsye të jashtme, ashtu si shpërthimi i sobës sime.

Gjithashtu unë jam i mendimit se torturat e fundit që më kanë rënë rezultuan prej mungesës suaj të pakuptimtë e të dëmshme të solidaritetit. Një gisht i tmerrshëm po i trazon gjërat tani këtu, dhe veçanërisht në krahun e Gjashtë të burgut.

Mos më bëni të qaj në këtë festë; pajtohuni menjëherë në mënyrë të përzemërt!

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Unë desha që vetëm dy ose tre prej vëllezërve tonë të liroheshin sot, por Përkujdesja Hyjnore i shtyu për më vonë ata, i la prapa këtu, me qëllim që ata të fitojnë dobi, për të mirën e tyre; madje mbetja jonë në këtë situatë afërsisht tre javë ka qenë e domosdoshme, madje absolutisht e domosdoshme, sepse prania jonë së bashku në këtë festë është e domosdoshme për ne, për Risale-i Nurin, për shërbimin tonë dhe për rehatinë tonë materiale e shpirtërore; dhe që ta marrim pjesën tonë të plotë prej duave të haxhillarëve, dhe për t'i shpëtuar trajtesat që kanë qenë dërguar në Ankara nga konfiskimi dhe që të shtohen në numër ata që kanë dhembshuri për ne dhe që u vjen keq për qënien tonë të shtypur dhe të përqafojnë metodën e Risale-i Nurit, dhe që kjo të mund të jetë një provë se ne nuk u drejtohemi për ndihmë tradhtarëve të vendit, të kombit dhe të fesë duke pranuar gabimet e rënda që po bëhen aktualisht.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Duke mos qenë në gjendje ta durojnë -për shkak të damarit të tyre të Vehabizmit- interesimin e madh të Imam Aliut (Zoti qoftë i kënaqur me të) dhe vlerësimin për Risale-i Nurin, dhe të ndikuar nga dyshime të pabaza, saqë vitin e kaluar i shkaktuan ujit të Zemzemit të derdhet, dhe këtë vit i penguan njerëzit nga shkuarja për të bërë haxhillëk, komiteti i ekspertëve drejton kritikat e tyre të padrejta, të pasakta, të pajustifikueshme dhe prej smire ndaj Rrezes së Pestë. Në këtë kohë dyshimi dhe shqetësimi, vendi më i sigurt për ne është burgu. Në dashtë Allahu, Risale-i Nuri do të fitojë lirinë edhe për ne, edhe për vetveten. Meqenëse nën këto rrethana të vështira përballë kaq shumë kundërshtarëve ato po i bëjnë vetveten të lexohen në një mënyrë të paparë, dhe duke i bërë studentët e tyre të punojnë në burg në mënyra të ndryshme, dhe nëpërmjet Përkujdesjes Hyjnore duke mos lejuar që ato të shkatërrohen; atëherë ne duhet të jemi shumë të kënaqur me këtë dhe të bëjmë falënderime në vend të ankimit. Për shkak të kësaj kënaqësie, unë jam në gjendje t'i përballoj të gjitha mundimet e mia të rënda. Unë nuk ndërhyj në punët e Zotit xh.sh..

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Prej këtyre dy kopjeve, njëra është e imja dhe tjetra është e drejtorit. Korrektojeni kopjen e drejtorit në përputhje me kopjen e shkruar me dorëshkrimin tim. Ndërsa po studioja këtë herë trajtesën *"El-Ajetul-Kubra*", unë pashë se Stacioni i Dytë deri në fund, dhe "biseda" në fund kishin një rëndësi shumë të madhe, dhe unë përfitova shumë prej saj. Njëri nga ju duhet ta lexojë dhe tjetri ta dëgjojë, me qëllim që edhe ju të përfitoni gjithashtu. Përveç kësaj, duke bërë korrektime, vëllezërit tonë nuk duhet të mbeten pa punë, por duhet të studiojnë me nga dy.

Së Dyti: Kopja ime e Fjalës së Dhjetë dhe letrat që ndodhen këtu dhe gjërat e tjera si këto nuk duhet as të humbasin dhe as të mbeten kot, pa u lexuar. Unë do t'ia lë Xhejlanit që ta shohë e kontrollojë këtë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ndërsa duke lexuar tani *Xhalxhalutijen*, m'u tregua momenti kur më ndodhi kjo pyetje: jam kureshtar të di, çfarë lidhje është ndërmjet sures "*Thumma nun*" në frazën "*Bi hak-ki tebareke thumma nun wa sa'il,* në shkallën e njëzet e gjashtë, e cila tregon trajtesën rreth Kaderit Hyjnor?" Unë pashë kur po lexoja fillimin e asaj sureje, "*Nun", "Për Penën dhe për (shënimin, regjistrin) që njerëzit shkruajnë"*[286]*,* Pashë se ajo është fjala "*Nun*" e cila është origjina, baza, burimi i parapërjetshëm i të gjitha penave, shkrimit dhe librave, dhe tregon Penën e Kaderit Hyjnor, dritën, dhe dritën e njohjes së parapërjetshme. Domethënë ashtu si *"Betohem për (erërat) që shpërndajnë pluhur"*[287]*,* që shikon tek Trajtesa rreth "*Grimcave të vockëla*" me një lidhje të fuqishme që nxjerr si rrjedhim një tregues, po ashtu fjala "*Nun*" shikon tek Trajtesa rreth "*Kaderit Hyjnor*" me një tregues të fuqishëm.

Said Nursi

• • •

[286] Kur'an, 68: 1
[287] Kur'an, 51: 1

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Në përputhje me kuptimin e "*e mira është në atë që zgjedh Allahu*", ndodhet një e mirë në shtyrjen e çështjes sonë. Zemra ime e dëshironte këtë shtyrje afati, dhe liria e Risale-i Nurit kërkoi që ajo duhet të ishte kështu. Duke e ngushëlluar njëri-tjetrin, duke forcuar moralin e njëri-tjetrit dhe duke diskutuar në mënyrë shkencore dhe me bashkëbisedim të këndshëm, dhe duke shkruar e studiuar Risale-i Nurin, ju do të jeni të suksesshëm në tërheqjen e Mëshirës Hyjnore, që e zhduk pikën e vështirësisë, dhe i transformon këto orë kalimtare në orë të përjetshme.

Së Dyti: Meqenëse ne i shkëmbyem urimet e festës në burgun e përkohshëm të gjykatës, unë ju dërgoj ju ëmbëlsirën e festës që është një zemzemi të cilin e solli heroi i qytetit të Konias Vëlla Zybejri dhe mjalt prej fshatit Nurs i cili ka një kuptim të madh për mua. Futni një në shishen e mjaltit dhe i përzieni ato së bashku. Pastaj lëreni ujin e zemzemit në të dhe pijeni me shëndet të mirë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Një pyetje shumë e rëndësishme e domethënëse u bë nga dikush i rëndësishëm. Ai më pyeti: Ju nuk jeni një shoqëri politike dhe tre gjykata ju kanë dhënë juve pafajësinë për këtë pikë, dhe kjo gjithashtu është vërtetuar për shkak se gjashtë Provinca të cilat ju kanë mbajtur ju nën mbikëqyrje qysh prej njëzet vitesh nuk kanë bërë asnjë akuzë lidhur me të. Megjithatë, ndodhet një lidhje e çuditshme midis studentëve të Risale-i Nurit që nuk gjendet në asnjë shoqëri politike apo grup. Ne do të donim që kjo vështirësi të jetë zgjidhur për ne; a keni mundësi të na e zgjidhni atë?

Unë në përgjigje thashë këtë: Është e vërtetë, studentët e Risale-i Nurit nuk janë një shoqëri politike të asnjë lloji, dhe as një grup i organizuar për ndonjë interes politik, dynjaje, negativ, personal apo të përgjithshëm; dhe ata nuk mund të jenë kështu. Ata janë bijtë dhe bijat, dhe nipërit e mbesat e heronjve të vjetër të këtij atdheu, prej miliona të përkushtuarve ndaj islamit, të cilët me gëzim të plotë i sakrifikuan jetët e tyre për të fituar Rangun e martirizimit. Ata kanë trashëguar një

pjesë prej shpirtit të asaj sakrifice dhe vetëflijimi saqë ata e shfaqën atë lidhje të jashtëzakonshme e cila e shtyu këtë vëllain e tyre të pafuqishëm e të dobët të thotë para gjykatës së Denizlit: "Le të sakrifikohen edhe kokat tona gjithashtu për një të vërtetë për të cilën janë sakrifikuar me miliona koka heroike!" Ai e tha këtë fjali në emrin e tyre, duke e lënë gjykatën në habi dhe në heshtje vlerësuese.

Domethënë, studentët e Risale-i Nurit janë të përkushtuarit e vërtetë, të sinqertë e pozitivë të cilët veprojnë vetëm për kënaqësinë e Allahut dhe të Ahiretit; saqë shoqëritë e fshehta të rezikshme të Masonëve, komunistëve, korruptuesve, ateistëve, të pafeve dhe të Tashnakëve[288] nuk kanë gjetur asnjë mjet për t'i kundërshtuar ata, dhe kështu dëshirojnë t'i shkatërrojnë e t'i përçajnë nëpërmjet ligjeve "Elastike" -të lakueshme- duke mashtruar qeverinë dhe drejtësinë. Në dashtë Zoti ata nuk mund të bëjnë asgjë; përkundrazi, ata do të jenë mjet për të shtuar numrin e heronjve vetëflijues të Risale-i Nurit dhe të besimit".

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Unë do t'ju tregoj ju një pyetje dhe përgjigjje që ndodhi para dyzet vjetësh, e cila i ngjason asaj të djeshmes.

Lidhja e studentëve të "Saidit të Vjetër" ishte aq e fortë me profesorin e tyre saqë arriti shkallën e sakrifikimit dhe të vetëflijimit. Prandaj Saidi i Vjetër qe në gjendje të sfidonte veprimet e shumta aktive që i ndërmerrnin bandat armene dhe revolucionarët Tashnakë përreth qyteteve të Vanit dhe Bitlisit, madje i bënte ata të ndalonin tek caqet e tyre deri në një shkallë.

Dhe kur ai gjeti për studentët e tij pushkë mauzer, u transformua medreseja në një gjendje që i ngjasonte kapanonit ushtarak -pasi librat ishin krah për krah me pushkët. Pastaj erdhi një gjeneral nga ushtria, i pa ato dhe tha: kjo nuk është medrese, kjo është një kazermë ushtrie. Dhe ai urdhëroi duke thënë: "Grumbullojini pushkët meqë u bë dyshues si rrjedhojë e incidentit të Bitlisit. Nga ne ata morën

[288]-Një organizatë martirësh që synonte të formojë një shtet Armen Brenda tokave osmane. Dhe nga burrat e saj më të shquar ishte Antraniku. Përkthyesi.

pesëmbëdhjetë pushkë; dhe pas afërsisht dy muajsh shpërtheu lufta e Parë Botërore, dhe unë kërkova që të më ktheheshin pushkët e mia... Sidoqoftë... Ata më pyetën mua në lidhje me çfarë u përmend lart: Revolucionarët armenë, midis të cilëve ka të përkushtuar të zjarrtë e të gatshëm për të sakrifikuar jetët e tyre, tremben prej jush, kështu që kur ju ngjiteni në Malin Erekdaĝi pranë Vanit, ata tërhiqen e shkojnë tjetërkund.

Çfarë force keni ju që i bëni ata të veprojnë kështu?"

Në përgjigjje unë u thashë atyre: Meqenëse të përkushtuarit armenë e shfaqin këtë vetëflijim të çuditshëm për jetën kalimtare të kësaj bote dhe për interesat e nacionalizmit të vogël e negativ, dhe na sulmojnë neve, atëherë sigurisht studentët që luftojnë për jetën e përhershme dhe për interesat pozitive të kombit të gjërë e të shenjtë islam, dhe janë ata që besojnë me siguri se exheli është një dhe nuk ndryshon; nuk ka dyshim se këta studentë nuk mund të mbeten prapa atyre të përkushtuarve[289], këta pa ngurrim dhe me krenari e sakrifikojnë jetën dhe exhelin e tyre të përcaktuar dhe pak vite të kësaj jete të jashtme, të rreme për milionat e viteve të jetës së vërtetë e të amshuar dhe në rrugën e ruajtjes dhe të mirëqenies së miliarda njerëzve besimtarë e të devotshëm".

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur, të dhembshur e besnikë!

Qysh prej dy ditësh unë kam ndjerë një dhimbje në kokën time dhe në nervat prej ndikimit të gripit. Dhe duke ndjerë nevojën e ngushëllimit dhe të shoqërimit në rrethana të tilla për t'u takuar me shokë unë u ngushtova nga një vetmi e tmerrshme dhe nga qënia ime i veçuar. Ankesat vijuese më ndodhën: Përse e vuajmë ne këtë torturë? Cila është dobia e tij për shërbimin tonë në rrugën e Kur'anit dhe të Imanit?

Pastaj, në këtë mëngjes papritmas m'u shfaq sa vijon: Futja jonë në këtë provim të vështirë dhe duke u goditur prej këtij guri prove disa

[289] Me pafuqi, unë them në emrin e vëllezërve të mi: Në qoftë se do të ishte e domosdoshme, ne do t'i zëmë e do t'i parakalojmë ata, në dashtë Zoti. Ne do të tregojmë se ne jemi trashëgimtarët e stërgjyshërve tonë si në fe, po ashtu edhe në heroizëm.

herë me qëllim që të shihet qartë nëse ne jemi flori apo tunxh; dhe provimi ynë në çdo anë e aspekt me sprova padrejtësie, dhe duke kaluar madje nëpër sita më të holla tre ose katër herë për të parë nëse nefset tonë urdhërues për të liga do të marrin një pjesë ose janë duke luajtur ndonjë dredhi, e gjitha kjo është shumë e domosdoshme për shërbimin tonë, i cili duhet të jetë thjesht dhe vetëm në emrin e të vërtetës dhe të realitetit, dhe prandaj Kaderi Hyjnor dhe Përkujdesja Hyjnore e lejuan këtë sepse njoftimi për këtë shërbim të lartë në këtë fushë provimi përballë armiqve kryeneçë e të padrejtë dhe pretekseve të tyre; kjo i ka bërë njerëzit të kuptojnë se: ky shërbim ndaj Kur'anit buron drejtëpërdrejt prej të vërtetës dhe Realitetit, dhe tek ai shërbim nuk përzihen as dredhia, as mashtrimi, as egoizmi, as mburrja, as qëllimi personal dhe as interesat e dynjasë dhe të Ahiretit. Masat e besimtarëve nuk do të kishin pasë besim në të po të mos kishte qenë ky provim; pasi gjuha e gjendjes së tyre thonte: "Ndoshta ata janë duke na mashtruar neve". Edhe elita e besimtarëve do të kishin pasë dyshimet e tyre dhe do të kishin thënë:

"Ndoshta ata veprojnë kështu për të arritur rangje shpirtërore për vetveten dhe për të fituar besimin e njerëzve dhe për t'u admiruar; ashtu siç e bëjnë një gjë të tillë ata të cilët e shesin vetveten për të fituar rangje shpirtërore. Dhe si rrejdhojë ata nuk do të besonin në shërbimin. Por pas sprovës u detyrua edhe personi më kokëfortë e kryeneç të nënshtrohet. Në qoftë se mundimi juaj është një, fitimet tuaja janë një mijë, në dashtë Zoti.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Njoftimi në gazeta për ngjarjen që ndodhi kur isha rob lufte në Rusi[290] shtoi interesin dhe respektin e njerëzve pavarësisht ndalimeve të rrepta të tyre dhe përpjekjes së tyre për t'i larguar njerëzit prej nesh. Përgjegjësi i rojeve tha: Tre persona zyrtarë thanë dje në oborrin e burgut ndërsa ishin në favor për të bërë fyerje ndaj nesh dhe sidomos ndaj meje, kur Saidi shfaqet tek dritarja njerëzit grumbullohen dhe e shohin. Prandaj ai nuk duhet të qëndrojë në këmbë përpara dritares ose ne do ta ndryshojmë krahun e tij të burgut.

[290]Synon mosngritjen në këmbë të Ustadh Said Nursi për komandantin Rus. Përkthyesi.

O Vëllezërit e mi! Mos u shqetësoni! Unë kam vendosur që t'i përballoj vështirësitë sido që të jenë; dhe ato do të ndryshohen – në dashtë Allahu- në gëzime e kënaqësi nëpërmjet bekimit dhe lutjeve tuaja.

Në esencë ai incident është i vërtetë, por për shkak se unë nuk kisha dëshmitarë, unë kurrë nuk e kam përshkruar në detajë. Unë nuk e dija që një skuadër kishte ardhur për të më ekzekutuar; unë e kuptova këtë më vonë. Unë nuk e dija që atëherë komandanti Rus tha diçka në Rusisht në një mënyrë shfajësimi -kërkimi ndjese. Domethënë, majori mysliman që ishte i pranishëm dhe i cili e njoftoi ngjarjen për gazetën e kuptoi çfarë kishte thënë komandanti Rus në mënyrë të përsëritur: "Më fal!"

O Vëllezërit e mi! Kur unë preokupohem me Risale-i Nurin mundimet e vështirësitë pakësohen. Domethënë, detyra jonë është të preokupohemi me trajtesat dhe të mos u japim rëndësi gjërave kalimtare, dhe të bëjmë falënderime me durim.

Said Nursi

• • •

Një veçori e çuditshme në karakterin e Bediuzzamanit.

[Kjo u shfaq me 15 Teshrin-i Ev-vel, 1949 në Revistën "Ehli Sunneh". Kjo u shkrua nga pronari i Revistës i cili është avokat.]

Kur u plagosa dhe u zura rob në Bitlis gjatë Luftës së Parë botërore, edhe Bediuzzamani gjithashtu u zu rob në të njëjtën ditë. Ai u dërgua në Siberi, në njërin prej kampeve të robërve të luftës. Unë u dërgova në ishullin e Nangunit pranë Bakut.

Një ditë, Nikolla Nikollajaviç e vizitoi kampin me qëllim që të inspektonte të burgosurit.

-Të burgosurit ngriheshin në këmbë duke e respektuar- ndërsa kur kaloi para Bediuzzamanit, ky nuk lëvizi fare dhe e injoroi; kjo tërhoqi vëmendjen e komandantit të përgjithshëm. Për ndonjë pretekst, ai kaloi para tij edhe njëherë tjetër, dhe përsëri Bediuzzamani nuk u trazua, nuk u shqetësua. Ai kaloi për herë të tretë, dhe ndaloi para tij, dhe ndërkohë midis tyre u zhvillua dialogu vijues nëpërmjet një përkthyesi:

"A më njeh se kush jam?"

“Po, të njoh. Ti je Nikolla Nikollajaviç, daja i Carit dhe komandanti i përgjithshëm i frontit kaukazian”.

“Atëherë, përse më fyen?”

“Më fal, por unë nuk të kam fyer. Unë po bëj thjesht atë që më urdhëron besimi im.

Çfarë urdhëron besimi yt? -“Unë jam një dijetar islam. Unë kam besim në zemrën time. Ai që ka besim në zemrën e tij është më i lartë se sa ai që nuk ka besim. Në qoftë se unë do të isha ngritur në këmbë, do të isha treguar i parespekt ndaj besimit tim. Unë nuk u ngrita për këtë arsye.”

“Atëherë, duke thënë që unë jam pa besim, ti po fyen edhe personin tim, edhe ushtrinë të cilës i përkas, edhe kombin tim, edhe Carin.

Do të ngrihet menjëherë një gjykatë ushtarake dhe ti do të pyetesh”.

Me këtë urdhër, u ngrit gjykata ushtarake. Erdhën disa oficerë Turq, Gjermanë dhe austriakë duke insistuar që Bediuzzamani t’i kërkonte falje komandantit Rus, por ai iu përgjigj atyre sa vijon:

“Unë dëshiroj të udhëtoj për në botën e Ahiretit, tek prania e të dërguarit të Zotit, dhe më duhet të kem vetëm një pashaportë për në Ahiret. Unë nuk mund të veproj në kundërshtim me besimin tim”.

Asnjëri nuk mundi të hapë gojën përballë kësaj fjale, dhe të gjithë prisnin rezultatin.

Gjykata e përfundoi procesin gjyqësor me nxerrjen e vendimit për ekzekutim për shkak të fyerjes së Carit dhe të ushtrisë Ruse. Bediuzzamani i tha me gëzim oficerit që drejtonte skuadrën e cila erdhi për të ekzekutuar vendimin:

“Më lejoni mua vetëm pesëmbëdhjetë minuta që të kryej detyrën time”. Ndërkaq ai mori avdes, pastaj ndërsa duke kryer dy rekatë namaz, u shfaq Nikolla Nikollajaviç. Ai tha:

“Më fal! Unë supozova se kur ti veprove ashtu, e bëre për të më fyer mua, dhe mora masat ligjore kundra teje. Por tani unë kuptova se ti paske vepruar vetëm sipas besimit tënd dhe paske zbatuar atë çfarë urdhëron ai besim. Prandaj vendimi shfuqizohet. Ti meriton respekt për vendosmërinë dhe devocionin tënd. Unë të shqetësova ty, të lutem përsëri që të më falësh.”

Një major, njëri prej shokëve të Bediuzzamanit, e përshkroi këtë veçori të lartë të karakterit të tij dhe vendosmërinë e tij në besim, gjë e cila është një shembull i mirë për të gjithë myslimanët, ashtu siç e dëshmoi vetë atë ngjarje. Kur e dëgjova këtë, në mënyrë të pavullnetshme sytë e mi u mbushën me lotë.

Abdurrahim[291]

• • •

Vëllezërit e mi!

Meqenëse më është prerë oreksi për ushqim, dhe për shkak se dhuratat më dëmtojnë, unë ju kam dërguar juve pjesën time të ushqimit, e cila përbëhet nga tre copa gjalpi, një shportë rrush, një çantë me molla, dy pako -koli- çaj dhe sheqer. Unë kisha vendosur që t'ju dërgoja diçka si dhuratë për ju, por mësova se edhe ju kishit prej saj gjithashtu. Unë e pata pranuar atë me qëllim që të mos zemërohej me mua *El-Medresetul ez-zehra* duke thënë: Ai nuk hëngri prej dhuratës sime! I shisni këto lëndë tek ata që u nevojiten me çmime të lira dhe tek ata që i meritojnë, sepse unë do të blej me paratë e tyre vezë, kos dhe bukë, dhe kjo dhuratë e bekuar të jetë vërtetë shërim për mua, për ata që e pijnë, për *Medresetu ez-zehra* dhe për ata që e përdorin. Le të jetë Husrevi përgjegjës për shitjen dhe Xhejlani e Hifziu t'i shesin ato.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Kjo që vijon m'u shfaq mua në lidhje me artikullin e gazetës rreth meje: Një komandant arrogant Rus e përmbajti zemërimin e tij dhe u qetësua përballë dinjitetit të besimit tuaj, dhe kërkoi falje, ndërsa nëpunësit zyrtarë të cilët e shohin qëndrueshmërinë e mësimeve të fuqishme e të sinqerta të Risale-i Nurit që e tejkalojnë njëqind herë qëndrueshmërinë që e shfaq personi im; unë them: në qoftë se nuk zbuten zemrat e tyre, dhe ngulmojnë në kryeneçësinë e tyre, atëherë ata nuk do t'i pastronte gjë tjetër përveç zjarrit të Xhehennemit. Sepse kjo jetë e shkurtër e kufizuar nuk e nxë këtë krim

[291]Pavarësisht se Ustadhi nuk urdhëroi që të përfshihej kjo pjesë të cilën e botoi gazeta, veçse ama ajo u përfshi këtu meqë ajo përmban një shembull instruktiv, ngjall interesim dhe është shumë prekëse. Nënshkroi Husrevi.

të madh; pasi yndira nuk mund të hahet në qoftë se prishet, ndryshe nga kosi e qumështi. Ne i lutemi Allahut që Risale-i Nuri t'i ketë shpëtuar shumë prej tyre para se ata të jenë prishur.

Së Dyti: Le t'i shkruajë Mehmet Fejziu Bedriut dhe t'i thotë atij se unë jam duke i përfshirë ata të gjithë, që ai i kishte përmendur në letrën e tij, në lutjet e mia. Edhe ata gjithashtu duhet të luten për mua.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Më është shfaqur mua se unë duhet ta përshkruaj trajtimin e çuditshëm dhe instruktiv që unë kam marrë gjatë dy periudhave të mia të robërisë -në Rusi dhe këtu- sa vijon:

Unë isha në një repart në Kosturna në Rusi bashkë me nëntëdhjetë oficerë të tjerë të cilët po mbaheshin si robër lufte. Unë u jepja atyre mësim fetar herë pas here. Një ditë erdhi komandanti Rus, e pa këtë dhe tha: Ky kurd që ishte komandanti i një regjimenti vullnetarësh ka therrë shumë prej ushtarëve tonë, dhe vjen tani e na jep mësime politike këtu; kjo është e pamundur, unë do ta ndaloj; ai nuk duhet të japë mësim. Por pas dy ditësh ai tha: "Duket se mësimet tuaja nuk janë politike, por fetare e morale, prandaj ti mund të vazhdosh të japësh mësim".

Në robërinë time të dytë: këtu në këtë burg, nëpunësit e gjykatës e ndaluan njërin prej vëllezërve të mi të afërm për të ardhur tek unë, ndonëse ai kishte dëgjuar leximin tim prej Risale-i Nurit qysh prej njëzet vitesh, dhe ai vetë i lexonte më mirë se unë. Gjithashtu ata i ndaluan që të vinin tek unë ata të cilët më ndihmonin mua në çështjet e mia të domosdoshme e të veçanta me qëllim që ata të mos merrnin mësim prej meje. Megjithatë Risale-i Nuri nuk lë nevojë për mësim tjetër, dhe ne nuk kemi mësime të tjera, dhe ne nuk kemi sekrete që të mos kenë dalë në shesh. Megjithatë, disa rrethana më bënë mua ta shkurtoj këtë histori të gjatë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Dy ose tri herë më është shfaqur një gjendje shpirtërore e Rëndësishme. Ajo është një gjendje që i ngjason asaj që më shtyri që të jetoja i veçuar në Malin Jusha në Stamboll para tridhjetë vitesh dhe më bëri mua ta lija jetën shoqërore vezulluese të Dari El-Hikmeh el-Islamijjeh, madje ajo nuk më lejoji të qëndroja as me Abdurrahmanin e mjerë, i cili ishte studenti i parë i Risale-i Nurit dhe heroi i tij, me qëllim që ai të përmbushte disa nga gjërat e mia të domosdoshme. Ajo gjendje që ishte një revolucion i shpirtit tim shfaqi natyrën e Saidit të Ri.

Tani fazat e para të ngjashme me atë gjendje kanë filluar tek unë, dhe unë mendoj se kjo është një shenjë për shfaqjen e Saidit të tretë, i cili do ta braktiste krejtësisht dynjanë. Domethënë, Risale-i Nuri dhe studentët e tij heroikë do t'i përmbushin detyrat e mia, dhe nuk mbetet më nevojë për mua.

Sidoqoftë, të gjitha pjesët gjithëpërfshirëse të Risale-i Nurit dhe të gjithë studentët e tij të palëkundur e të sinqertë japin mësim shumë më mirë se unë.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Së Pari: Unë kam hamendësuar prej një numri shenjash se prej koleksioneve që janë botuar, është trajtesa "*Udhëzuesi për të rinjtë*" ajo që ata i kanë dhënë më shumë rëndësi. Unë mendoj se "*Hüve Nüktesi* (Ajri: Një Dritare për Unitetin Hyjnor) i ka thyer kurrizët e armiqve tonë ateistë të fshehur dhe e ka copëtuar idhullin e Natyrës, bazën dhe mbështetjen e tyre. Sepse megjithëse ishte e pamundur deri diku që ta fshihje atë idhull në dheun e dendur, por ama një gjë e tillë ishte e pamundur pasi u shfaq kjo "*Hüve Nüktesi*" për ta bërë në ajrin e hollë e transparent. Si rrjedhojë, për shkak të mosbesimit të tyre kryeneç dhe të rebelimit felëshues, ata po mashtrojnë drejtësinë dhe po e nxisin atë kundra nesh.

Në dashtë Zoti, Risale-i Nuri do t'i kthejë shikimet e drejtësisë në favorin tonë dhe do ta asgjësojë këtë sulm gjithashtu.

Së Dyti: Ajo që u botua në këtë periudhë, qoftë në Revistën "Ehli es-Sunneh" ose në gazetën lokale këtu, gjithashtu edhe intervista e zjarrtë që zhvilloi Zybejri, u bënë si një shpallje e mirë dhe efektive për t'u preokupuar me Risale-i Nurin. Lexojini pjesët rreth nesh që do

të më kënaqnin mua, në vendin tim, dhe atëherë më njoftoni mua për to.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë: Mehmed, Mustafa, Ibrahim, dhe Xhejlan!

Së Pari: Dje ju pashë ju të katërve në një bisedë vëllazërore të këndshme, dhe unë isha shumë i kënaqur dhe i gëzuar për këtë. Unë e dëgjova atë me kënaqësi e gëzim sikur të isha me ju në atë bashkëbisedim. Por unë papritmas pashë se në dy anët tuaja ndodheshin njerëz që ju dëgjonin për spiunazh. Dëgjimi zgjati për gjysmë ore. Ndërkaq unë u shqetësova dhe thashë me vete: Është e mundur që midis tyre të jetë ndonjë spiun dhe do t'i japë kuptime të gabuara fjalës dhe do ta bëjnë qimen tra, pasi ata dëgjonin me vëmendje. Vëllezërit që janë duke biseduar nuk po i shohin ata për shkak se nuk po shfaqen të jenë të kujdesshëm dhe për shkak të kënaqësisë së bashkëbisedimit dhe të bashkëshoqërimit në të. Dhe unë u shkrova ju një përgjigje lidhur me këtë.

Lavdi Zotit, unë mësova se në atë fjalë nuk kishte dëm, megjithatë, kujdesuni! Të jesh i kujdesshëm është shumë e domosdoshme në këtë kohë të ndjeshme.

Së Dyti: Unë kuptova nga një letër e shkruar prej Hasan Hoxhës se mendimi i tij i mirë për mua është njëqind herë më i madh se sa unë e meritoj, dhe se ai do të jetë një përhapës i Risale-i Nurit i cili vepron me të njëjtin sistem si heroi i Denizlit, i ndjeri Hasan Fejziu. Në dashtë Zoti xh.sh., Hasana dhe Fejzi të tjerë si ai do të shfaqen në Afjon gjithashtu dhe nuk do të mbeten prapa Denizlit, dhe do t'i transformojnë mundimet tona në mëshirë.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi!

Unë nuk kam qenë kurioz rreth gazetave, por artikujt duke na mbështetur neve që shfaqen në këtë kohë edhe tek Revista "Eh-li es-sunneh" edhe tek "Sebi-Lür-Reshad", i kanë bërë konfuzë ata njerëz xhelozë dhe ata ateistë armiqësorë të fshehur të cilët na kundërshtojnë

neve. Mundësia që këta do të përpiqen që t'i heshtin ata shokë, më bëri të shqetësohem.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Një ngushëllim i vërtetë i cili i zhduku fatkeqësitë e mia pikëlluese.

I Pari: Mundimet tona transformohen në mëshirë e gëzim.

I Dyti: Qetësia dhe gëzimi që burojnë prej kënaqësisë dhe nënshtrimit ndaj drejtësisë së Kaderit Hyjnor.

I Treti: Gëzimi që buron prej Përkujdesjes Hyjnore të veçantë për studentët e Risale-i Nurit.

I Katërti: Kënaqësia që buron prej zhdukjes së fatkeqësisë e cila është kalimtare.

I Pesti: Shpërblimet e mëdhaja.

I Gjashti: Mosndërhyrja në punët dhe në Dëshirën e Allahut.

I Shtati: Vuajtja e pak vështirësive dhe marrja e pak plagëve përballë edhe sulmeve më të ashpra.

I Teti: Këto vështirësi duke qenë shumë të vogëla në krahasim me ato që i vuajnë të tjerët.

I Nënti: Gëzimi që buron nga ndikimi i këtyre njoftimeve të larta për përfundimin e provimit të vështirë në shërbim të Risale-i Nurit dhe besimit.

Këto nëntë gëzime shpirtërore janë një balsam dhe një ilaç aq qetësues dhe aq i ëmbël saqë nuk mund të përshkruhen; ato i lehtësojnë dhimbjet tona të tmerrshme.

Said Nursi

• • •

Vëllezërit e mi të dashur, besnik e të palëkundër!

Me të gjitha dredhitë e tyre, sulmet e hipokritëve këto dhjetë muaj, dhe kapja e tyre pas një zyrtari nuk ka tronditur madje as edhe studentin më të ri. Shpifjet e tyre janë të parëndësishme. Përballë qindra gënjeshtrave të tij që ne i provuam, ai gjeti një gabim të vetëm dhe tha se ishte në kundërshtim me faktet, në njërën prej letrave tona, që një gazetë kishte njoftuar se drejtori i mëparshëm ishte graduar. Por gabimi ishte i gazetës. Sidoqoftë... shpifje të tilla nga njerëz të tillë pothuajse nuk kanë asnjë efekt mbi ne, dhe në dashtë Zoti, ato nuk do

t'i shkaktojnë asnjë dëm rrethit të Risale-i Nurit. Ashtu siç ju thashë më parë, mos u jepni rëndësi shpifjeve të shkruara të atij zyrtari, mos i lini ato të ngatërrojnë idetë tuaja.

Në qoftë se ndodhet ndonjë pikë ligjore, përgjigjja për të cilën nuk gjendet në mbrojtjet e mia, jepni një përgjigje të shkurtër. Dhe thoni: "Saidi thotë: Me qëllim që të mos i bezdis tre gjykatat të cilat na kanë dhënë neve pafajësinë, dhe as që të jemi përbuzës ndaj tyre, unë nuk do t'i jap rëndësi asaj akuze dashakeqe duke iu përgjigjur. Mbrojtja ime e gjatë, dhe veçanërisht dhjetë pikat duke treguar dhjetë mënyra që ajo është e paligjshme, jep një përgjigje të plotë e të saktë".

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Së Pari: Është një shembull i Përkujdesjes Hyjnore që unë nuk e dëgjova akuzën shpifëse të prokurorit të përgjithshëm; përndryshe unë do t'i isha përgjigjur me fjalë të ashpra. Unë do t'i kisha thënë kryetarit të gjykatës: Unë do të të çoj ty në gjykatë. Me këtë dua të them: Do të të çoj në Gjykatën e Gjyqit të fundit për padrejtësinë që na ke bërë, dhe do të të çojmë në një gjykatë Dynjaje për sjelljen tënde të paligjshme. Dhe arsyeja që thashë se unë nuk kam avokat, ishte që t'u tregoja atyre se ne të gjithë kemi një avokat për çështjen tonë të përgjithshme e cila na përket të gjithë neve; dhe lidhur me sulmet ndaj personit tim, vetëm unë mund t'u përgjigjem atyre. Ju mund t'ia thoni këtë Ahmed Hikmetit.

Së Dyti: Mbrojtjet tona të mëparshme janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur akuzave të prokurorit.

Së Treti: Mustafa Osmani dhe Xhejlani më shkruan e më thanë se ajo që u tha në gjykatë nuk kishte shkaktuar ndikim të keq në mes të rrethit të Risale-i Nurit, dhe as nuk e kishte turbulluar fare pastërtinë e zemrave. Unë e pashë edhe hero Tahirin; edhe ai kishte të njëjtin mendim. Unë isha kureshtar se si mendonin Husrevi, Fejziu dhe Sabriu.

Së Katërti: Unë mendoj se mosbesimi dhe çudhëzimi na sulmojnë tani neve në formën e shoqërive sekrete dhe të grupeve politike për shkak se Kaderi Hyjnor i bën ata të na torturojnë neve me këtë tirani të skajshme dhe me akuzën e të qenurit një shoqëri politike. Kjo do të thotë se ndodhet një nevojë parësore dhe e rëndësishme që besimtarët të bashkohen. Ne qemë të pavetëdijshëm për atë fakt, prandaj ne e morëm goditjen e drejtësisë prej Kaderit Hyjnor.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Kur ndodhet një kabinet qeveritar despotik i cili i pengon njerëzit që të shkojnë në haxh, që derdh ujin e zemzemit, që lejon që ne të trajtohemi në mënyrë të padrejtë, që nuk shqetësohet për konfiskimin e trajtesave "*Dhul Fikar*" dhe "*Siraxhun-Nur*", që gradon në postë nëpunësit zyrtarë të cilët na torturojnë neve ligësisht dhe në mënyrë të paligjshme, dhe që nuk dëgjon vajtimin tonë me zë të lartë, vajtimin e të shtypurve në shtëpitë tona nëpërmjet gjuhës së gjendjes; në një kohë të këtillë, vendi më i mirë për ne është burgu, veçse, nëse do të ishte e mundur, do të ishte më mirë në qoftë se ne do të transferoheshim në një burg tjetër.

Së Dyti: Ashtu siç i detyruan ata njerëzit më të papërshtatshëm që t'i lexojnë trajtesat tona më private e të fshehura, po ashtu ata këmbëngulin dhe na detyrojnë neve që të formojmë një shoqëri politike. Por ne nuk kemi ndjerë aspak nevojë për të qenë një shoqëri politike apo një grup i fshehtë Revolucionar i ndonjë lloj. Sepse vëllazëria islame që gjendet në xhematin e bashkuar të besimtarëve është zhvilluar tek studentët e Risale-i Nurit në mënyrë të sinqertë e të pastër dhe të kurorëzuar me vetëflijimin më serioz dhe me martirizim të plotë që i kanë trashëguar prej miliona paraardhësve të tyre heroikë, të cilët i sakrifikuan me mallëngjim të plotë shpirtërat e tyre në rrugën e një të vërteteje, dhe studentët e Risale-i Nurit u lidhën aq fort me atë të vërtetë saqë nuk lë asnjë nevojë deri tani për formimin e ndonjë shoqërie politike, ose të ndonjë grupi revolucionar të fshehtë apo të hapur".

Kjo do të thotë se tani ka një nevojë, sepse Kaderi Hyjnor i ka bërë ata të na sundojnë; Ata na tiranizojnë me akuzat e një shoqërie politike imagjinare. Dhe Kaderi Hyjnor na jep neve goditje me duart e tyre, duke thënë: Përse nuk keni pasë sinqeritet dhe solidaritet të plotë dhe përse nuk keni qenë një parti e vërtetë e Allahut", dhe prandaj ai -Kaderi- ka vepruar me drejtësi.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Unë e di që ju nuk keni nevojë për ngushëllim. Forcojeni moralin e njëri-tjetrit, dhe kjo do të jetë e mjaftueshme. Rreshtat e tablosë që e kam varur në mur përballë meje janë të mjaftueshëm për mua. Është kuptuar se ky sulmi i fundit ishte krejtësisht i pajustifikueshëm dhe një kërcënim i paligjshëm, dhe rezultati i dyshimeve të pabaza dhe i dobësisë.

Megjithatë, qëndrimi i njerëzve dhe i policisë ishte një lloj kundërshtimi ndaj atij sulmi të pakuptim.

Së Dyti: A është e përshtatshme mbrojtja ime për t'iu përgjigjur edhe akuzave të reja?

Gjithashtu, a po punojnë Zyjberi dhe avokatët? Ata nuk janë të shqetësuar, apo jo? Ata nuk duhet të shqetësohen fare. Nga këndvështrimi i çështjeve me të cilat ata na kanë akuzuar, ata duhet t'i akuzojnë të gjithë ata që mbajnë vëllazëri besimi, madje edhe xhematet e atyre që kryejnë namazet të të gjithë imamëve, si dhe studentët e të gjithë mësuesve dhe profesorëve. Domethënë, ata e kanë gjetur veten përpara kundërshtarëve të fuqishëm dhe na sulmuan neve me iluzione të jashtëzakonshme duke përdorur mundësitë në vend të ndodhive reale.

Së Treti: Bindja ime personale është që ne duhet të mbetemi në burg deri në pranverë. Dihet se çështjet ndërpriten në Dimër. Në dashtë Zoti, Përkujdesja Hyjnore do të na vijë përsëri në ndihmë.

Said Nursi

• • •

[Njëra nga letrat e Husrevit]

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Profesori ynë i Dashur!

Ndërsa detyra kryesore e dijetarëve të komitetit të ekspertëve ishte që t'i ruante e t'i mbronte besimtarët dhe sidomos ata që mbajnë lart Kur'anin, me raportet e njëanshme rreth nesh ata i kanë nxitur autoritetet ligjore të Afjonit që të na hetojnë neve në detajet më të hollësishme, i kanë nxitur që të të mbajnë ty, o profesori ynë i dashur, nën shtypjen më të egër për tetë muaj; kanë qenë shkaku për burgosjen tonë duke i tërhequr studentët; dhe i kanë studiuar të vërtetat e

mrekullueshme e të pamohueshme të Risale-i Nurit me një shpirt xhelozie. Nuk ka dyshim se shkrimet e tua duke iu përpjigjur raporteve të tyre, të cilët nxisin gjykatën e Afjonit kundra nesh, ishin vepra e dhembshurisë tënde. E jo më të të mbrojnë ty, o profesor i dashur, që qysh prej njëzet e pesë vitesh ke qenë duke luftuar kundra armiqve tonë të fshehur me një grusht studentësh dhe me Risale-i nurin i cili përmban të vërtetat më të rëndësishme të Kur'anit; megjithëse është e drejta jote të bësh pyetje të shumta për këta dijetarë të cilët kanë formuar një front kundra nesh në këtë kohë më të rrezikshme, pyetjet e tua shumë të pjesshme nuk bëjnë asgjë përveç paralajmërimit ndaj tyre. Përkujdesja e veçantë Hyjnore e cila është një mirësi e madhe Hyjnore dhe duke buruar prej burimeve për të cilat ne kemi shumë nevojë në këto kohë të ndjeshme, e ka transformuar dëshpërimin tonë në krenari, është shfaqur përsëri këtu në Burgun e Afjonit. Toka, e cila nuk është dridhur qysh prej tetë muajsh, u zemërua përsëri sot dhe u trondit dy herë ashtu siç i përkruanit ju tërmetet që binin kur ti, o profesor i dashur dhe kur Risale-i Nuri, sulmoheshit. Edhe ne gjithashtu e dëshmuam atë, dhe ai i forconte shpresat tona. Asaj i vinte keq për vetminë tënde të jashtme përballë sulmeve të rrepta të armiqve mizorë të etur për të të shkatërruar. Ajo pati një dhembshuri fizike ndaj pafuqisë tënde, të erdhi në ndihmë, dhe me lëkundjen e tokës vërtetoi drejtësinë e çështjes tënde.

Duke dhënë sihariqet e "Fitorja është e jona" e cila nëpërmjet Hyjnisë, një fuqie engjëllore, del nga pena jote e bekuar; ajo na bëri ne vërtet mirënjohës ndaj profesorit tonë të dashur.

I Qëndrueshmi i Vetëm,
Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!

Studenti yt me shumë të meta, Husrevi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Së Pari: Ajo që është e domosdoshme është kujdesi, vetëpërmbajtja dhe konsultimi.

Së Dyti: Më është shfaqur mua se Zybejri më është dhënë në vend të nipit tim të ndjerë Abdurrahmanit, dhe Xhejlani në vend të nipit të ndjerë Fuadit. Prandaj, unë jam duke ua dorëzuar atyre punën time.

Së Treti: Jam njoftuar se gjyqtarët e gjykatës e kanë bërë një pretekst të një letre që e shkrova dhe u vendos në krye të "*Mâidetul*

Kur'anit" të Ahmed Fejziut të zellshëm por të pakujdesshëm. Duke thënë: Saidi i afirmon lavdërimet dhe gjërat e tjera të shkruara për të, ata a kanë bërë këtë një arsye për të më akuzuar. Unë në mënyrë të përsëritur thashë se Ahmed Fejziu para çdo gjëje tjetër duhet ta shpjegojë atë -se letra u shkrua me qëllim që të mos i pranojë letrat e tjera për të, dhe kështu që ai nuk duhet ta korrigjojë pjesën tjetër të saj-megjithatë ai shkroi gjëra të panevojshme, të cilat i bëjnë ata të zemëruar. Edhe në qoftë se ai do të kishte një mijë të meta, unë nuk do të ofendohesha prej tij, por ai duhet të jetë i matur nga të vepruarit me guxim dhe rrëmbimthi me qëllim që të mos i vijë dëm Risale-i Nurit.

Së Katërti: Vëllai Ahmed Fejzi, heroi e familjes Fejzi, duhet të sillet si Tahiri në krahun e burgut të Tahirëve, që është medreseja e tij, dhe duhet t'i nxisë studentët e tij, në vend të atyre që kanë qenë liruar, me mësimet e Risale-i Nurit dhe me shkrimin e trajtesave të tij. Fletoret e studentëve të rinj, të cilat ai m'i dërgoi dje e transformuan gjendjen time të dëshpëruar në gjendje gëzimi. Unë thashë: "Lavdi Zotit!"

• • •

Këtë herë, sulmi është në një shkallë shumë të gjërë. Për shkak të dyshimeve të tyre të pabaza kryeministri dhe kabineti qeveritar na sulmuan neve në përputhje me ndonjë plan. Sipas njoftimeve që unë kam marrë, dhe sipas disa shenjave, për shkak të raporteve të rremë dhe të intrigave të hipokritëve të fshehur, ata na kanë shfaqur neve të jemi shumë të lidhur ngushtë me lëvizjen e kalifatit dhe me një xhemat të fshehtë që i përket tarikatit Nakshibendi, dhe madje duke e drejtuar atë; dhe i kanë shkaktuar qeverisë që të shqetësohet shumë rreth nesh. Për dëshmi ata tregojnë koleksionet e mëdhenj duke u bërë në vëllime në Stamboll dhe duke u dërguar gjithandej botës islame dhe duke u mirëpritur në çdo vend, dhe e kanë trembur qeverinë dhe në mënyrë të pajustifikueshme i kanë kthyer hoxhallarët xhelozë zyrtarë dhe nëpunësit zyrtarë dyshues kundra nesh. Ata mendojnë se dokumente të shumtë dhe dokumente të bollshëm do të dalin në dritë, dhe se me damarin e Saidit të vjetër, unë nuk do të isha në gjendje që t'i duroja dhe do të shkaktoja turbullira. Por falëndrime të pafundme qofshin për Allahun e Gjithëfuqishëm, Ai e zvogëloi njëmijëfish fatkeqësinë. Në të gjitha kërkimet e tyre ata nuk gjetën asgjë që të na lidhnin neve me ndonjë xhemat ose shoqëri të fshehtë. Ne nuk kemi lidhje që ata ta kishin gjetur. Prandaj prokurori u detyrua të përdorë gënjeshtra e shpifje, duke u dhënë gjërave kuptime të gabuara, dhe duke bërë supozime rreth gjërave që nuk ishin shkelje. Meqenëse e vërterta është

kjo, ne dhe Risale-i Nuri kemi shpëtuar nga nëntëdhjetë e nëntë përqind të fatkqesisë.

Prandaj, ne duhet që ta presim mirësinë e Përkujdesjes Hyjnore me falënderim, me durim dhe me përgjërim që ajo të manifestohet plotësisht mbi ne. Atëherë ne duhet të japim falënderim, madje një mijë falënderime dhe jo ankesa dhe t'u japin ndihmë të ardhurve dhe të larguarve të kësaj shkolle të Jusufit dhe t'i ngushëllojmë ata me mësimet e Risale-i Nurit.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllai im i dashur e besnik!

Unë kuptova nga një paralajmërim i ashpër se ti dhe Ahmed Fejziu kishit ndjekur një metodë jashtë rrugës së Risale-i Nurit, rrugë e cila është moskonfrontim, mosluftim dhe për të mos u zhytur me njerëzit e dhënë vetëm pas kësaj dynjaje (pushtetin qeverisës) dhe për të mos hyrë në çështjet e politikës, por vetëm për t'u mbrojtur kur është krejtësisht e domosdoshme; ato pjesë që i paraqitët dhe i lexuat në gjykatë prej shumë çështjesh ishin të dëmshme dhe nënkuptonin konfrontim dhe luftim dhe me një stil politik. Ajo i ka shkaktuar dëm të madh Risale-i Nurit. Në fakt ato ishin shkaku që ne të dënohemi dhe për keqtrajtimin që kam marrë. Unë nuk jam i zemëruar me ty dhe me Ahmed Fejziun, por ka qenë dashtë që më parë të ma tregonit mua. Ajo pozitë (mbrojtja) ju është dhënë ju të dyve si një Dekret Hyjnor material. Ju duhet të veproni si unë për ta riparuar dëmin.

Gjithashtu është e domosdoshme që Fejziu ta braktisë stilin politik të mbrojtjes me të gjithë fuqinë e tij, dhe ashtu si Tahiri, ta preokupojë vetveten me Risale-i Nurin dhe me studentët e rinj.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur!

Është e domosdoshme që të përpiqeni të botoni dyzet e ca faqe për mua dhe për Risale-i Nurin, listën e gabimeve dhe të korrektimeve dhe shtojcën e saj dhe përgjigjen ndaj gazetës "Posta", edhe me shkronja të vjetëra dhe me të reja, në Isparta dhe në Stamboll, dhe nëse do të ishte e mundur edhe këtu gjithashtu. Meqenëse gjykata është duke i

shumëfishuar me makinë çështjet që ata i supozojnë të jenë kundra nesh, atëherë është e drejta jonë ligjore që t'i shumëfishojmë të njëjtat çështje së bashku me nëntëdhjetë gabimet, dhe këtë ne duhet ta bëjmë.

Pastaj, mbrojtja ime e gjatë dhe kundërshtimet e shkruara të shokëve të tillë si Ahmed Fejziu, Zÿbejri, Mustafa Osman, Husrev, Sungur dhe Xhejlani do të botohen gjithashtu, në dashtë Zoti xh.sh..

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

M'u shfaq mua se unë duhet të shkruaj dhe t'ju tregoj juve dy ngjarjet të çuditshme të holla që ndodhën brenda dy orëve, dhe që në pamje të jashtme ishin të parëndësishme, por në fakt të rëndësishme.

E Para: Unë po lexoja për dy njerëz të destinuar për Risale-i Nurin një çështje të rëndësishme e cila m'u shfaq në zemër Natën e Kadrit prej "Udhëzuesit për të Rinjtë"; pastaj sapo e lexova "ai fitoi për sudentët e Risale-i Nurit në dhjetë javë nivelin e studimit që studentët e medreseve të tjera e fitojnë në pesë ose dhjetë vite". Kjo më ndodhi kështu mua: ashtu si nëpërmjet Përkujdesjes Hyjnore Saidi i Vjetër fitoi për pesëmbëdhjetë javë, kur ishte në moshën pesëdhjetë vjeç njohurinë që zakonisht fitohej në medrese për pesëmbëdhjetë vite studimi, po kështu nëpërmjet mëshirës Hyjnore në këtë kohë ku nuk ka medrese, Risale-i Nuri është i mjaftueshëm për të fituar për pesëmbëdhjetë javë njohjen e shkencave të realitetit dhe të besimit që ndryshe do të fitoheshin për pesëmbëdhjetë vite; ashtu siç e kanë vërtetuar pesëmbëdhjetë mijë njerëz nëpërmjet eksperiencave të tyre këto pesëmbëdhjetë vite.

Së Dyti: Në atë të njëjtën kohë, dritarja ime, e cila është e rëndë, pa ndonjë arsye të jashtme, ra sipër pjatave të mia, shisheve dhe ushqimit.

Unë supozova se edhe dritarja dhe të gjitha shishet e mia dhe gotat e ujit u thyen, edhe ushqimet që ato përmbanin u rrënuan. Por në mënyrë të mrekullueshme, asnjë gjë nuk u thye dhe as nuk u prish. Vetëm gjella që e kisha marrë si dhuratë, u derdh. Por ishte destinuar për studentët e ri të Risale-i Nurit, duke ruajtur parimin tim për mospranimin e dhuratave, dhe duke e konfirmuar me gjërat e tij të jashtëzakonshme në incidentin e parë.

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi!

Në një mënyrë krejtësisht në kundërshtim me ligjin, dokumentet tona dhe pjesët shtesë për apel akoma nuk janë dërguar tek gjykata e Apelit. Tre avokatët tonë të autorizuar duhet të gjejnë ndonjë rrugë që të sigurojnë që ata të dërgohen sa më shpejt të jetë e mundur. Sepse ata duke e zgjatur paraburgimin tonë për njëmbëdhjetë muaj mbi disa pretekste, dhe duke mos më lejuar të flas në gjykatë, dhe duke më mbajtur në një burgim të vetmuar fillikat për njëmbëdhjetë muaj në kushte të ftohti, torturuese dhe pikëlluese, tregon një anshmëri dashakeqe të pranuar nga drejtësia. Prandaj është e domosdoshme që të dy avokatët tonë dhe ju të bëni gjithçka që është në fuqinë tuaj për ta transferuar zhvillimin e gjyqit në një gjykatë tjetër në një provincë tjetër.

Said Nursi

• • •

Me Emrin e Tij, qoftë Ai i lavdëruar!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë, të sinqertë, të palëkundur dhe të përkushtuar!

Së Pari: Arsyeja që unë nuk mbaj një kopje të Misterit të *"Ty Ne të kemi Dhuruar",*[292] me vete është se para një kohe të gjatë ndodhën ca ngatërresa në dy parandjenjat që kisha.

E Para: Unë perceptova nëpërmjet një parandjenje në një ngjarje të tmerrshme që do t'i ndodhte vetëm këtij vendi, dhe shfaqja e tiranëve. Misteri i fuqishëm u bë i dukshëm pas dymbëdhjetë vitesh ashtu siç e kisha parashikuar, por në sferë të gjërë, në faqen e tokës. Sigurisht në pamje të jashtme ndryshoi ajo që kisha parashikuar, por në realitet ajo doli krejtësisht e saktë dhe e vërtetë e pastër. Për këtë arsye, unë nuk e mbaj me vete atë trajtesë dhe nuk ua jap të tjerëve.

Së Dyti: Para dyzet viteve unë në mënyrë të përsëritur thoja: "Unë shoh një dritë", unë sihariqoja për këtë. Unë e supozoja dritën të ishte në një shkallë të gjërë e të përgjithshme. Por ajo ishte Risale-i Nuri;

[292] Kur'an, 108: 1

unë e mendoja rrethin e studentëve të Risale-i Nurit se ishte sfera politike e të gjithë vendit, dhe unë isha i gabuar.

Efendilerë!

Unë ju falënderoj ju që e kam flamurin e Ditës së shenjtë të pavarësisë të varur tek oborri im. Gjatë luftës kombëtare në Stamboll, Ankaraja njohu se unë kam përmbushur shërbimin e ndoshta të një divizioni ushtarak nëpërmjet botimit dhe shpërndarjes së trajtesës së titulluar "*Gjashtë Sulmet*" kundra anglezëve dhe grekëve, sepse dy herë Mustafa Qemali më njoftoi mua në mënyrë të koduar duke më kërkuar që të shkoja në Ankara. Ai madje tha: "Ne duhet ta kemi këtu këtë hoxhë heroik! Domethënë është e drejta ime ta vë këtë flamur në këtë ditë.

Said Nursi

• • •

Mbrojtjet e Studentëve të Risale-i Nurit.

[Fjalët mbrojtëse të studentëve të Risale-i Nurit gjatë proceseve të tyre gjyqësore në Gjykatën e Afjonit, në vitin 1948 në një atmosferë të mbushur me dënime me vdekje me qëllim që të fusnin panik tek njerëzit. Dhe gjatë së cilës studentët e Risale-i Nurit ishin të parët që u dënuan, dhe pastaj të gjitha kopjet e Risale-i Nurit u rikthyen.]

Ne themi sa vijon përballë atyre të cilët duke u larguar prej realitetit dhe drejtësisë, e kanë quajtur lidhjen e studentëve të Risale-i Nurit me Risale-i Nurin dhe me interpretuesin e tij, e cila shikon thjesht dhe në mënyrë të sinqertë tek Ahireti, një shoqëri politike dynjaje, dhe janë orvatur që ta shfaqin këtë si një shkelje të dënueshme, pavarësisht se tre gjykata u kanë dhënë atyre pafajësi për këtë. Ne themi: Nuk është e mundur t'i akuzosh studentët e Risale-i Nurit se janë të lidhur me organizata dhe me shoqëri politike veçse me dy çështje:

E Para: Duke mohuar lidhjet bazë mbi të cilat ndërtohet jeta shoqërore njerëzore, dhe sidomos kombi islam që është një dashuri e pastër midis të afërmve, dhe lidhje e ngushtë midis fiseve dhe grupeve, dhe një vëllazëri bashkëvepruese shpirtërore brenda kombësisë islame. Dhe është lidhja e fuqishme e karakterizuar me vetëflijim e

vetësakrificë për bijtë e llojit dhe të kombit të tij; është lidhja që nuk këputet dhe përkushtimi për të mbështetur të vërtetat e Kur'anit, të cilat shpëtojnë jetët e tyre të përhershme, dhe për ata që i përhapin ato. Vetëm duke i mohuar këto lidhje, të cilët sigurojnë jetën shoqërore, dhe duke pranuar rrezikun e kuq që po vjen nga veriu dhe i cili po përhap farën e tmerrshme të anarkisë dhe të terrorit duke i shkatërruar popujt dhe rininë e tyre, dhe duke i tërhequr fëmijët e gjithësecilit për tek vetvetja shkatërron farefisninë dhe kombësinë, si dhe hap rrugën për ta prishur krejtësisht civilizimin human dhe shoqërinë.

Vetëm me këto dy çështje mund t'i akuzosh studentët e Risale-i Nurit se kanë lidhje me shoqëri dhe organizata, dhe për hir të kësaj studentët e Risale-i Nurit shfaqin -pa ngurrim lidhjen e tyre të pathyeshme me të vërtetat e Kur'anit, dhe me vëllezërit e tyre të Ahiretit; dhe demonstrojnë të vërtetën e gjendjes së tyre përpara gjykatës suaj të drejtë, dhe nuk ulen që ta mbrojnë vetveten me dredhi, me gënjeshtra e lajka.

I Burgosuri Said Nursi

• • •

[Mbrotja e Husrevit]

Për gjykatën e krimeve të Rënda të Afjonit

Prokurori i përgjithshëm më ka drejtuar dy akuza: njëra prej tyre është e përgjithshme dhe universale dhe tjetra është akuzë e veçantë. Akuza e përgjithshme është përpjekja ime në rrugën e Risale-i Nurit dhe pjesëmarrja ime në krimin imagjinar që i atribuohet profesorit tim. Ndërsa akuza e veçantë është rreth çështjeve personale dhe të veçanta të jetës sime e cila dallohet me vulën e *inzivasë* -e të jetuarit i veçuar; dhe kjo në realitet nuk përbën asnjë mëkat apo krim, pasi ato janë çështje të pjesshme e të parëndësishme. Dhe unë them në përgjigje ndaj akuzës së prokurorisë rreth pjesëmarrjes sime në krimin imagjinar të profesorit tim dhe rreth përpjekjeve dhe shërbimit tim në rrugën e Risale-i Nurit. Unë marr pjesë në metodën e profesorit tim, madje marr pjesë bashkë me të dhe e ndihmoj atë me të gjithë shpirtin dhe zemrën time në krimin imagjinar që i atribuohet atij në çështjen e Risale-i Nurit, i cili përmbush shërbime të shenjta për botën islame, dhe veçanërisht për këtë atdhe dhe për këtë komb, dhe do të vazhdoj ta falënderoj Allahun dhe do ta lavdëroj deri në fund të jetës sime i cili më dha sukses për këtë shërbim imani.

O Gjyqtarë të respektuar!

Dëshmia ime e sigurtë për suksesin që e kemi parë si rrjedhojë e shërbimit tonë ndaj Risale-i Nurit është se ndërsa shkrimi im ishte shumë i keq duke shkruar shkronjat e Kur'anit, por ama ai u përmirësua aq shumë saqë ishte përtej fuqisë dhe mundësive të mia. Madje unë munda të shkruaja tre kopje të shkëlqyera të pashembullta prej Kur'anit Kerim. Njëra prej tyre është para duarve tuaja.

Dëshmia e Dytë: Është se unë pata sukses në shkrimin e afërsisht gjashtëqind kopjeve të pjesëve të ndryshme të Risale-i Nurit, i cili ka siguruar dobi e përfitime shumë të mëdha për këtë vend, për këtë komb, për këtë fe dhe për moralet e mira qysh prej njëzet vitesh.

Në fakt, për një kohë të shkurtër, për një muaj, unë shkrova katërmbëdhjetë trajtesa, siç e dinë edhe shokët e mi. Unë e gjej të tepërt që t'i mbroj gjithashtu ato pika që lidhen me pjesën time në shërbimin e shenjtë të mësuesit tim, të cilat supozohen të jenë shkelje. Unë vërtetoj dhe i mbështes me të gjithë fuqinë time gjithçka që erdhi në mbrojtje të cilën e shkroi profesori ynë dhe në shtojcën e mbrojtjes së tij dhe e konsideroj atë si mbrojtje për mua dhe e paraqes te gjykata juaj e lartë si kundërshtimet e mia.

Gjyqtarë të respektuar!

Profesori ynë -i cili ndodhet aktualisht në gjykatën tuaj- me veprat e tij të bekuara rreth besimit, me të vërtetat e Kur'anit dhe me trajtesat e ndritshme të Risale-i Nurit nuk synon asgjë lidhur me dynjanë, dhe as një qëllim politik.

Për më tepër, ashtu siç e konfirmojmë unë dhe shokët e mi shërbimin e shenjtë që ai ka kryer për këtë vend e komb, po ashtu edhe patriotët në qeverinë e unionit e të progresit e konfirmuan këtë. Sepse në atë kohë, ata dhanë nëntëdhjetë mijë lira ari për universitetin e tij në Van, i quajtur "*Medresezu-ezzehra*". Edhe dashuruesit e këtij atdheu i konfirmuan me admirim përpjekjet e tij patriotike e shkencore.

Atëherë, njëqind e gjashtë dhjetë e tre deputetë prej dyqind deputetëve miratuan që të caktonin njëqind e pesëdhjetë mijë lira, kur fondet ishin të pakta, për atë universitet të tij në lindje. Unë dëshiroj të shfaq para gjykatës suaj të nderuar dhe të njoftoj se unë jam shumë krenar për shërbimin që kam kryer për Risale-i Nurin, për qënien time si shkrues i tij gjatë njëzet viteve, këtë shërbim të cilin prokuroria e ka konsideruar krim e mëkat për mua, dhe këtë për shkak se profesori im -Zoti e bekoftë- punoi gjatë gjithë jetës së tij për të përmbushur një shërbim të shenjtë, qëllimi i të cilit ishte të vendoste gurët themeltarë

për lumturinë dhe përparimin e këtij vendi dhe të këtij kombi. Dhe ky është shkaku që armiqtë e tij më kryeneçë e xhelozë dhe të cilët u përpoqën ta dënonin nëpër gjykata nuk mundën t'i kundërshtonin fjalët e tij të fuqishme dhe të efektshme dhe nuk mbeti asgjë para tyre veçse të dorëzoheshin e t'i nënshtroheshin asaj që ai thotë.

I Burgosuri Husrev Altënbashak

• • •

[Mbrojtja e Tahirit]

Për gjykatën e krimeve të rënda të Afjonit

Siç më është komunikuar nga zyra e prokurorisë së përgjithshme të gjykatës së Afjonit se akuza që më është drejtuar mua dhe profesorit tim Bediuzzaman Said Nursit dhe shokëve të mi të tjerë është shfrytëzimi i ndjenjave fetare për të nxitur popullin që të prishin stabilitetin dhe sigurinë e shtetit, dhe se ky është shkaku i paraqitjes sime para gjykatës.

Unë u jam përgjigjur të gjitha pyetjeve të cilat m'u drejtuan (qoftë tek gjykata e hetuesisë së Ispartës ose në zyrën e hetuesisë në Afjon) me përgjigje të sakta.

Gjykata e Denizlit na i riktheu të gjithë librat tonë të konfiskuar pasi ajo shpalli vendimin për pafajësinë tonë dhe nuk na dënoi. Sepse ne -me vëllezërit tonë të tjerë prej studentëve të ustadhit tim Bediuzzamanit- lexonim dhe e kopjonim Risale-i Nurin dhe mbanim korrespondencë me letra midis nesh, ndonëse unë para gjashtë vitesh -pa lejen e profesorit tim- botova pesëqind kopje prej trajtesës "*Rrezja e Shtatë*", e autor Bediuzzaman Said Nursi në një shtypshkronjë në Stamboll me shkronja të vjetëra. Gjykata e Denizlit shpalli vendimin e saj që daton me 20/7/1945 që t'i rikthejë tek ne të gjithë këto libra me sunduqet e tyre. Dhe atëherë këto trajtesa -kundrejt çmimit të botimit- u shpërndanë tek studentët e Risale-i Nurit të cilët ishin të mallëngjyer për to.

Dhe kështu, si rrjedhojë e vendimit të asaj gjykate, i cili qe ratifikuar nga gjykata e Apelit dhe ishte bërë i formës përfundimtare, para dy vitesh unë bleva një makinë shumëfishuese në Stamboll dhe letra, dhe i çova ato në Isparta.

Prej tre koleksioneve që i keni shtënë në dorë, dy qenë shkruar nga vëllai im Husrev Altënbashak, dhe koleksionin e tretë e shkrova unë. Para të gjithëve ne botuam Trajtesën "*Dhul-Fikar*", e cila përmban

"*Mrekullitë e Profetit Muhammed*" dhe "*Mrekullitë e Kur'anit*", këtë ne e shitëm pjesërisht dhe me ato para ne blemë letër për koleksionin "*Shkopi i Musait*". Pastaj ne e botuam koleksionin "*Shkopi i Musait",* dhe e shitëm atë, pastaj ne blemë letër për koleksionin "*Siraxhun-Nur*" dhe e botuam. Kjo vazhdoi për afërsisht një vit. Pastaj kur unë po çoja tridhjetë kopje të këtyre koleksioneve në Eĝirdir, më arrestuan dhe më dorëzuan tek autoritetet e drejtësisë në Eĝirdir.

Pastaj nuk kaloi shumë kohë kur u bastis shtëpia e Husrev Altënbashak për kontroll me iniciativë të autoriteteve të drejtësisë së Ispartas, dhe makina shumëfishuese dhe koleksionet e Risale-i Nurit u konfiskuan. Dhe ne u dërguam në gjykatë për t'u gjykuar për shkeljet e një viti më parë.

Meqenëse ato ishin vepra fetare të cilat nuk ishin të ndaluara, Husrev Altënbashakut, mua dhe një shoku tjetër na u dha dënimi me një muaj burg për botimin pa leje zyrtare të librave fetarë jo të ndaluar. Ne iu drejtuam gjykatës së Apelit, dhe para se ajo të merrte një vendim, unë u dërgova në burgun e Afjonit.

Tani, në gjykatën tuaj të lartë, për shkak të këtij shërbimit tim altruist për fenë time dhe për bashkëfetarët e mi, dhe veçanërisht për çështjen e Rrezes së Pestë, e cila përmban interpretime hadithesh dhe e cila na qe rikthyer nga gjykata e mëparshme, prokurori i përgjithshëm i gjykatës së Afjonit më akuzoi mua, akuzoi autorin e Risale-i Nurit, dhe Husrev Altënbashakun, dhe dyzet e gjashtë studentë të tjerë të Risale-i Nurit për prishje të qetësisë dhe të rendit, për shkak se ata i shkruan këto vepra dhe i lexuan.

Si një qytetar i vërtetë në këtë vend, unë do të flas në praninë tuaj, duke mos iu shmangur të vërtetës se unë kam qenë studenti i profesorit tim Said Nursi për të cilin unë kam respektin më të madh, i cili me këto vepra ka drejtuar sjelljet tona fetare dhe na ka bërë të përparojmë; dhe megjithëse ne e shohim atë me cilësinë e *Muxheddidit* - Ripërtëritësit fetar, por ama ai e refuzon këtë.

Unë dëshmoj me siguri të plotë se nuk gjendet tek ai, as tek trajtesat e tij dhe as tek studentët e tij asnjë përpjekje për prishje të rendit dhe të qetësisë, dhe në mënyrë të veçantë njëra nga akuzat e drejtuara tek ne ishte lidhur me paratë e siguruara prej shitjes së librave, lidhur me të cilën Gjykata e Ispartas ka qenë plotësisht e vetëdijshme dhe ka qenë krejtësisht e pamundur që të na gjejë ne fajtorë dhe për të na dënuar. Ashtu siç nuk kemi qenë ne aspak në nevojë për të siguruar mjetet tona të jetesës nëpërmjet shitjes së

librave, po ashtu ne i kemi përdorë paratë e siguruara nga shitja e tyre për të blerë makina shumëfishimi, letra dhe bojë. Nuk ka asnjë mundësi që ky shërbim, të cilin ne e kryejmë thjesht për hir të Zotit me qëllim të pastër, që të jetë një krim, prandaj ne i kërkojmë gjykatës suaj të lartë dhe ndërgjegjjes suaj që kopjet e Risale-i Nurit të rikthehen tek ne.

I Burgosuri, Tahir

• • •

[Mrojtja e Zybejrit]

Për Gjykatën penale të Afjonit

Unë jam i akuzuar për formimin e një shoqërie sekrete dhe për prishjen e rendit dhe të sigurisë së shtetit. Ashtu siç do të paraqes më poshtë, dhe ju do të bindeni plotësisht se unë nuk e kam bërë një krim të tillë, unë e hedh poshtë këtë akuzë qysh tani.

Po, unë jam një student i Risale-i Nurit... Unë e them këtë dhe e shpall me të gjithë gëzimin dhe bindjen, se të mohosh këtë gjë është në kundërshtim të plotë me mësimet e larta e të virtytshme të cilat na i ka dhënë mësim Risale-i Nuri, prandaj unë nuk mund ta kryej një krim të tillë. Një person i cili lexon Risale-i Nurin nuk mund ta fshehë atë. Përkundrazi, ai do ta shpallte me krenari e pa frikë. Sepse Risale-i Nuri nuk përmban asnjë fjalë të vetme dhe asnjë fjali që të bënte të domosdoshëm frikën apo ngurrimin.

Unë jam përpjekur të përshkruaj vlerën e Risale-i Nurit në dyzet deri në pesëdhjetë faqe. Unë nuk mund të them se unë e kam lavdëruar atë. Sepse unë nuk e kam aftësinë ta lavdëroj dhe t'i jap hakun që i takon as edhe një pjese të vogël të Risale-i Nurit, e jo më të gjitha koleksioneve të tij. Sepse këto trajtesa janë një komentim i vërtetë i Kur'anit Kerim i cili është mendja e universit, dhe dielli i tij ndriçoi rrugën e njerëzimit dhe e ka drejtuar dhe udhëzuar atë qysh prej më shumë se një mijë e treqind viteve. Dhe ashtu siç e përmenda, në qoftë se ju do të gjenit ndonjë çështje që lidhet me ndonjë shoqëri sekrete në veprat për të cilat u përpoqa që t'u jap vlerën, ju atëherë mund të më dënoni mua për krimin e përpjekjes për të shpërndarë vepra të dëmshme. Por ky Risale-i Nur që është hartuar në një mënyrë të shkëlqyer dhe të pashembullt dhe i cili është konfirmuar e admiruar nga dijetarë të mëdhenj; që është mjaft i fuqishëm për të reformuar një shoqëri të korruptuar; që është një udhëzues për njerëzit e shekullit të

njëzet dhe që i shpëton ata nga çudhëzimi dhe nga shthurja që po tërhiqen poshtë nga Materializmi dhe nga Natyralizmi, dhe i shpëton prej errësirës së dendur të ideve të tyre; dhe nëpërmjet shkëlqimit të Kur'anit Risale-i Nuri hap për njerëzimin një rrugë që i çon ata në lumturi, në shpëtim, dhe duke ua shfaqur qartë atë dritën e tij. Kështu koleksioni i Risale-i Nurit nuk përmban asnjë diskutim lidhur me krimin për të cilin jam akuzuar; unë kam mendimin që, edhe gjykata juaj gjithashtu do ta pranonte dhe do të pajtohej me këtë, se vendimi për të më dënuar do të ishte në kundërshtim me drejtësinë.

Unë u pyeta gjatë hetimit: A je ti një student i Risale-i Nurit?

Unë thashë: Unë nuk e konsideroj veten time të denjë për të qenë studenti i një gjeniu të tillë si Bediuzzaman Said Nursi. Por në qoftë se ai më pranon, unë me krenari pohoj: "Po, unë jam një student i Risale-i Nurit".

Duke qenë shpifur në raste të shumta prej armiqve të tij të fshehtë profesori im Bediuzzaman Said Nursi, autori i pashembullt i Risale-i Nurit, u dërgua në gjykatë, dhe në çdo herë ka marrë pafajësinë. Risale-i Nuri ka qenë hetuar e shqyrtuar rresht për rreshti nga komitetet e profesorëve dhe nga dijetarët islamë dhe ata i kanë dhënë raportet e tyre duke deklaruar se vepra është shkruar me njohje të madhe -të pakaluar- dhe është një komentim i vërtetë për Kur'anin. Meqenëse kjo është e vërtetë, atëherë përse dërgohet ai nëpër gjykata? Unë do të shpreh për ju bindjen time të plotë rreth kësaj çështjeje:

Ata të cilët lexojnë Risale-i Nurin, dhe veçanërisht i riu perceptues, fitojnë një besim të fortë. Ata bëhen të palëkundur, vetëflijues, fetarë dhe të përkushtuar ndaj vendit të tyre. Dhe kur gjendet besimi në cilindo vend qoftë, atëherë nuk ka vend për shthurjen dhe për imoralitetin që të jenë si një rezultat i natyrshëm i disa ideologjive të dëmshme. Dhe sa më shumë të shtohet numri i atyre të cilët armatosen me këtë besim të fuqishëm, aq më shumë ngushtohet fusha përpara zgjerimit të Masonëve dhe komunistëve. Risale-i Nuri provon në mënyrë racionale, të logjikshme e shkencore me vërsetet nga Kur'ani dhe me prova e argumente tej mase të fuqishëm se filozofia materialiste, mbi të cilën bazohet komunizmi, nuk ka asnjë lidhje me të vërtetën dhe Realitetin, dhe se teoritë e saj janë krejtësisht të pabaza, të kota. Risale-i Nuri i ndriçon mendjet e atyre që kanë rënë në errësirën e kësaj ideologjie të korruptuar dhe i shpëton ata. Ai e provon ekzistencën e Zotit me dëshmi e prova të fuqishme të tilla saqë ato nuk mund të mohohen e të kundërshtohen as nga materialistët të cilët besojnë veçse në atë që mund të shohin sytë e tyre.

Me stilin e tij origjinal e tërheqës dhe me artin e lart letrar, kjo vepër e mrekullueshme mjaft thjesht e bën vetveten të lexohet dhe veçanërisht prej studentëve të shkollave të mesme dhe të universiteteve.

Për shkak të kësaj, komunistët dhe masonët e dinë se Risale-i Nuri formon një pengesë të fuqishme për hapjen e ideve të tyre helmuese. Ata kanë përdorur shpifje të ndryshme e dredhi me qëllim që ta eliminojnë Risale-i Nurin, ose që ai të mos lexohet, meqë, si një koment i vërtetë Kur'ani, është një burim i fuqishëm besimi. Megjithëse nuk është shfaqur asnjë shenjë prej gënjeshtrave që ia ngjisin Risale-i Nurit, por përsëri ata vazhdojnë duke na sulmuar neve. Nga kjo kuptohet se ata duan të na frikësojnë neve, të na bëjnë që ta braktisim Risale-i Nurin dhe në të njëtën kohë të vendosin para nesh botimet e tyre të kalbura e të korruptuarra. Kështu, duke i shkaktuar kombit dhe rinisë të humbasin krejtësisht besimin e tyre, ata dëshirojnë të shkaktojnë një rënie në standartet morale, dhe kështu ta bëjnë qeverinë të shembet në vetvete.

Ambicia e tyre është që t'ia dorëzojnë këtë vend dhe popullin e tij ndonjë fuqie -shteti- të huaj. Unë dëshiroj të shpall në prani të gjykatës suaj me të gjithë qartësinë dhe pa asnjë ngurim:

Le ta dinë këta këtë dhe le të dridhen; ne nuk frikësohemi nga kërcënimet e tyre; sepse ne e kemi parë të vërtetën dhe realitetin në Risale-i Nur, dhe i kemi mësuar ato prej tij dhe i kemi besuar ato.

I riu turk është i zgjuar, jo në gjum. Dhe ky komb mysliman turk nuk mund t'i nënshtrohet sundimit të ndonjë shteti tjetër. Rinia myslimane vetëflijuese -duke u mbështetur tek fuqia e besimit të saj të sigurt- nuk mund ta lejojë shitjen e atdheut të tij, dhe kombi fetar turk heroik dhe rinia besimtare turke nuk mund të tremben dhe as të frikësohen. Prandaj ne e lexojmë Risale-i Nurin dhe do të vazhdojmë ta lexojmë sepse ai na ngre neve tek niveli më i lartë i krijimit njerëzor dhe tek shkalla më e lartë; dhe Risale-i Nuri na mëson neve -ne të rinjve- fenë e cila është shkaku i përparimit tonë në të gjitha fushat, dhe ngulit tek ne të rinjtë dashurinë për fenë, për vendin e kombin, dhe na bën neve dashurues të vërtetë të fesë që do të sakrifikonim të gjitha qëniet tona për të. Ashtu siç përmenda më lartë, unë kam lexuar shumë pak prej Risale-i Nurit, dhe megjithatë unë kam përfituar shumë. Kjo vepër përbën rëndësinë më të madhe për këtë vend, për këtë komb dhe për të gjithë njerëzimin, dhe në qoftë se do të kisha pasuri, unë do ta kisha shpenzuar të gjithë për ta botuar atë. Sepse unë jam i gatshëm të sakrifikoj të gjithë qënien time për fenë time, dhe për hir të lumturisë

së përjetshme të kombit dhe të vendit tim dhe për hir të mirëqënies së tyre.

Për më tepër, unë nuk e kam pranuar Risale-i Nurin me naivitet. Tridhjetë e tre vërsetet e Kur'anit, dhe imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe Abdul Kadir Gejlani, Zoti qoftë i kënaqur me të, bënë parashikime se Risale-i Nuri do të shkruhej e do të jepte udhëzim për njerëzit e këtij shekulli. Për më tepër, pjesët e Risale-i Nurit që unë i kam lexuar më bënë mua të formoj mendimin se ky koleksion përbëhet nga vepra që japin mësim të vërtetën dhe realitetin dhe që reformojnë humanizmin.

Unë ndjeja një boshllëk në shpirtin tim, dhe ndërsa kërkoja një libër për të lexuar, unë gjeta Risale-i Nurin. Sapo e lexova atë, mësova se unë nuk mund të ndahem më prej tij, sepse ndjeva se Risale-i Nuri do ta plotësonte nevojën e papërmbajtur të zemrës sime. Unë gjeta në të provat e logjikshme të besimit për të më shpëtuar mua nga dyshimet rreth besimit dhe njohjes. Në këtë mënyrë unë shpëtova nga shqetësimi dhe nga dëshpërimi që e shkaktonin tek unë dyshimet dhe skepticizmi. Dhe kuptova nga këto të vërteta se Risale-i Nuri u shkrua për njeriun e këtij shekulli.

Besimi i fuqishëm është i domosdoshëm me qëllim që njeriu të mund të fitojë virtyte të larta të nevojshme për sjellje të mirë, për etikë e mirësjellje të lavdërueshme. Meqenëse të vërtetat e besimit janë shpjeguar me anë të provave shumë të fuqishme dhe me shembuj të qartë në Risale-i Nur, sa më shumë që ta lexoj unë atë, aq më i fortë bëhet besimi im.

Në këtë mënyrë, unë shpëtova prej braktisjes së fesë sime, e cila është e vërteta dhe realiteti dhe përmban parimet e civilizimit më të lartë, dhe shpëtova nga fatkeqësia e gëlltitjes prej përbindëshit të kuq. Kështu, meqenëse Risale-i Nuri i shpëton lexuesit e tij prej fatkeqësive të shumta materiale e shpirtërore; u jep atyre njohuri që e tejkalon njohjen që mund të marrë një student i diplomuar universiteti; ngulit tek ata dashurinë për islamin, për vendin dhe për kombin; dhe u mëson atyre bindjen ndaj Zotit, dhe të jenë të zellshëm në punë e në aktivitet dhe të dhembshur; asnjë prej atyre që e kuptojnë vlerën e tij nuk do ta braktisnin atë, cilido të ishte çmimi. Ky respekt i sinqertë dhe ky nderim nuk mund të nxirreshin prej zemrës së asnjë njeriu cilido qoftë ai.

Risale-i Nuri përshkruhet nga prokuroria e përgjithshme si një vepër e dëmshme. Unë protestoj me fjalët më të ashpra ndaj kësaj gjëje

të çuditshme të paprecedentë të cilën nuk do të mund ta thonte dikush që do të kishte sadopak vetëdije e ndërgjegje.

Prokuroria përmend se unë nxisja për të lexuar Risale-i Nurin... Po, është e vërtetë. Zemrat e të gjithë të ndriçuarve -të kulturuarve- u lënduan prej këtyre shpifjeve, madje ato vajtuan dhe kërcëlluan dhëmbët e tyre.

Shekulli i njëzet është një kohë që idetë pozitiviste janë mbisunduese.

Gjërat për të cilat nuk ka prova e dëshmi nuk besohen, dhe ne nuk i besojmë ato. Ne duam provë se Risale-i Nuri është i dëmshëm.

Në qoftë se një tjetër prej qëllimeve të armiqve tonë të fshehtë të cilët i shpikin këto gënjeshtra është të shkatërrojnë solidaritetin e atyre që lexojnë Risale-i Nurin, i cili manifestohet nëpërmjet përqafimit të tyre njëri-tjetrin në mënyrë të jashtëzakonshme për shkak të lidhjeve të islamit dhe për hir të shërbimit të Kur'anit, dhe shprehin vetëm respekt, dhembshuri dhe dashuri për atë vëllazëri, dhe nuk ka asnjë qëllim tjetër në dukje. Armiqtë tanë nuk duhet të luftojnë kundra nesh për asgjë. Unë jam më i prapambeturi, dhe më i zakonshmi prej atyre të cilët lexojnë Risale-i Nurin, megjithatë unë u jap atyre këtë përgjigje:

Edhe në qoftë se ndonjëri prej nesh do të ishte në lindje dhe tjetri në perëndim dhe ndonjëri të ishte në veri dhe tjetri në jug, dhe njëri në Ahiret dhe tjetri në dynja, ne përsëri do të ishim bashkë. Në qoftë se i gjithë universi do të grumbullohej, ai nuk do të mund të na ndante prej profesorit tonë të lartë, Said Nursi dhe as nga Risale-i Nuri dhe as nga njëri-tjetri. Sepse ne i shërbejmë Kur'anit dhe ne do t'i shërbejmë atij. Për shkak se ne besojmë në realitetin e Ahiretit, asnjë forcë nuk mund ta çrrënjos këtë dashuri dhe këtë solidaritetin tonë. Të gjithë myslimanët do të grumbullohen bashkë në vendbanimin e lumturisë së përjetshme.

Me lejen tuaj, unë do të përshkruaj një fakt të rëndësishëm lidhur me mirëqënien e vendit dhe të kombit tonë: njëri prej planeve sekrete të komunistëve është të nxisin popullin kundra qeverisë; përveç raporteve të rreme që u paraqitën zyrtarëve në qeveri për ta çuar në burg Bediuzzaman Said Nursin dhe për të shfaqur se veprat e tij janë të dëmshme, dhe ka përpjekje për të bërë propaganda të rreme të cilat nuk i beson asnjëri prej individëve të kombit.

Meqenëse ky komb është i bindur plotësisht dhe qysh prej shumë vitesh se Bediuzzaman Said Nursi është një gjeni i rrallë prej gjenive

të islamit në këtë shekull, dhe është një dijetar i shquar në çdo aspekt, dhe asnjë propagandë nuk mund ta shkatërrojë këtë bindje të vërtetë të tyre.

Unë bëj shumë lavdërime e falënderime për Allahun e Gjithëfuqishëm që Ai më ka favorizuar mua me përfitimin prej veprave të këtij profesori të madh. Unë jam borxhli me të gjithë zemrën dhe me shpirtin tim ndaj këtij profesori, meqë unë kam marrë mësime të vlefshme rreth besimit dhe islamit. Dhe unë jam i gatshëm të dergjem në këtë burg të kësaj bote për shumë vite për këtë profesor të lartë i cili ka kaluar shumë vite duke shkruar e duke hartuar me qëllim që të shpëtojë rininë tonë që të mos bëhet ushqim për komunizmin dhe që të mos jetë burgu i vetmuar fillikat fundi i saj.

Qysh prej njëzet vitesh, Risale-i Nuri -i cili është një komentim i Kur'anit Kerim- u jep mësime për besimin, islamin dhe për virtytin miliona individëve, dhe i mbron ata nga ateizmi. Edhe në qoftë se do të më jepej dënim me vdekje për hir të këtyre trajtesave, unë do të nxitoja për tek litarët e varjes duke thirrur: Allah!... Allah!... Ja Resulall-llah!.

Risale-i Nuri i cili mbron rininë tonë nga gëlltitja prej komunizmit dhe nga braktisja e fesë së saj, dhe që të mos bie në humnerat e fatkeqësive dhe të katastrofave që e çojnë atë në tradhti ndaj atdheut, që për këtë krim nuk ka dënim tjetër përveç ekzekutimit me plumba... Unë do të isha i gatshëm që të dënohesha me vdekje duke më gjuajtur me plumba për hir të këtyre trajtesave të Risale-i Nurit, dhe jam i gatshëm që të shfaq gjoksin tim ndaj atyre plumbave pa frikë dhe pa ngurrim; edhe në qoftë se do të më bënin copash me thika në rrugën e profesorit tim Bediuzzaman, unë do t'i lutesha Allahut që ta bënte gjakun tim që derdhet në të gjitha drejtimet, të shkruante: "Risale-i Nur, Risale-i Nur".

Gjyqtarë të respektuar të gjykatës!

Leximi i Risale-i Nurit, përfitimi i njohurisë prej tij është vërtet e mrekullueshme dhe origjinale, dhe në të vërtetë nuk ka të ngjashëm. Qëllimi i llojeve të tjera të edukimit është të sigurojnë përfitime materiale dhe për të arritur pozita të ndryshme. Njerëzit kryesisht studiojnë për qëllime materiale dhe për të qenë në gjendje të bëhen të famshëm, domethënë vazhdimi për këto studime nuk bëhet me dëshirë, por për të arritur ato qëllime materiale. Ndërsa Risale-i Nuri i ngjason një universiteti të lirë të paorganizuar. Ata të cilët vazhdojnë në këtë universitet duke lexuar Risale-i Nurin, nuk kërkojnë asnjë objektiv

dynjaje por kërkojnë vetëm shërbimin ndaj besimit dhe Kur'anit dhe asgjë tjetër.

Megjithatë, Risale-i Nuri, i cili përbëhet nga trajtesa serioze e shkencore rreth të vërtetave të besimit, lexohet me një entuziazëm, me një pasion dhe me një kënaqësi të tillë saqë ai zgjon tek ata që e lexojnë atë me sinqeritet të ndjejnë një dëshirë për ta lexuar disa herë.

Megjithëse ata që e lexojnë dhe e shkruajnë Risale-i Nurin mund t'i gjejnë jetët e tyre në rrezik tek dyert e sallave të gjyqit, deklarojnë hapur se ata i lexojnë këto vepra të mrekullueshme, dhe se ata do t'i lexojnë ato. Madje edhe sikur ata ta dinin se vendimi do të jepej për ekzekutimin e tyre, ata nuk ngurrojnë për ta shfaqur këtë qëndrueshmëri e vazhdimësi. Kjo veçori e Risale-i Nurit, njëra prej cilësive të saja të jashtëzakonshme, do t'i bënte ata të pyesnin: "A mos vallë shpirtërat e këtyre, të cilët pranojnë këtë, janë të lirë -jo të shtrenjtë- për to deri në këtë limit?"

Atëherë ndodhet një e vërtetë e lartë tek Risale-i Nuri dhe tek Bediuzzamani, dhe sigurisht që nuk ndodhen gjëra të dëmshme në këto vepra; edhe ata nuk e mohuan leximin e tij.

Normalisht studentët bëhen të studiojnë nën shtrëngimin dhe detyrimin e disiplinës dhe të autoritetit. Megjithatë, Bediuzzamani nuk detyron askënd që ta studiojë Risale-i Nurin, dhe qindra e mijëra lexuesit e studiojnë atë me përkushtim e vendosmëri, shumica e të cilëve madje duke mos e pasë parë asnjëherë atë. Një metodë e tillë e çuditshme edukimi nuk ishte parë kurrë më parë në ndonjë medrese; nuk është parë as në kohën e lashtë, as në kohën e tanishme, dhe as nuk është hasur në ndonjë universitet. Prokurori më tha mua se "respektin që ti e shfaq ndaj Bediuzzamanit, nuk e shfaq për komentatorët e tjerë".

Kjo është e vërtetë. Respekti dhe nderimi jepen në lidhje me madhështinë dhe arritjet, dhe mirënjohja dhe falënderimet jepen në raport me shkallën që dikush ka përfituar.

Dhe përfitimet prej veprave të Bediuzzamanit janë të një shkalle, aq të madhe saqë ne nuk i shohim në vepra të tjera.

Masonët dhe komunistët harxhuan çdo përpjekje me qëllim që Bediuzzamani, mendimtari dhe shkrimtari më i madh islam i shekullit të njëzet, të mos njihej prej nesh, dhe veçanërisht nga të rinjtë.

Por kombi mysliman turk dhe rinia e njohën atë hero të fesë, profesorin tonë, dhe ata përfituan prej tij, dhe i bënë edhe të tjerët

gjithashtu të përfitonin prej tij. Për shkak të kësaj, lidhja e tyre e jashtëzakonshme me të dhe besimi i tyre nuk mund të tronditen e të këputen.

Meqenëse vërsetet Kur'anore në Risale-i Nur shpjegohen në gjuhën tonë turke me një art e stil shumë të lartë, dhe pa i humbur këto vërsete veçoritë e tyre që konsiderohen si mrekullia më e madhe për to, çdo klasë e njerëzve -burra, gra, zyrtarë, tregtarë dhe filozofë- mund ta lexojnë e ta kuptojnë atë.

Duke përfituar prej tij deri në atë shkallë që ata munden, ata bëhen madje edhe më të lidhur me të. Studentët e shkollave të mesme, studentët e universitetit, profesorët, letrarët dhe filozofët, që të gjithë e lexojnë atë.

Këto klasa të edukuara përfitojnë prej tij deri në një shkallë të jashtëzakonshme, duke afirmuar origjinalitetin e tij dhe artin më të lartë të hartimit të tij, dhe duke ndjerë një dëshirë të fortë për ta lexuar të gjithë veprën.

Kur njerëzit perceptues dhe vlerësues e njohin për herë të parë Bediuzzamanin dhe Risale-i Nurin, ndjehen shumë të dëshpëruar që nuk i kishin njohur qysh prej një kohe të mëparshme, dhe me qëllim që të kompesojnë kohën e humbur, ata nuk e çojnë kot kohën e lirë, madje edhe në qoftë se do të kishin sikur pesë minuta kohë, ata marrin Risale-i Nurin, dhe e lexojnë atë ditën dhe natën. Ky interesim i jashtëzakonshëm dhe kjo kërkesë nuk ka qenë shfaqur për veprën e ndonjë psikologu, sociologu apo filozofi, pasi prej këtyre përfitojnë vetëm njerëzit e arsmiuar.

Në qoftë se një student i shkollës së mesme ose një grua shtëpiake do të lexonin veprën e një filozofi të shquar, ai ose ajo nuk do të përfitonin prej saj. Ndërsa gjithkush do të përfitojë prej Risale-i Nurit në përputhje me nivelin e tij. Për këtë arsye, i gjithë kombi pret vendimin tuaj për t'i dhënë pafajësinë Bediuzzamanit dhe studentëve të Risale-i Nurit. Në qoftë se në këtë kohë vështirësish Said Nursi nuk do të kishte ngulitur tek studentët e tij nevojën për durim, vetëpërmbajtje dhe moderim, ashtu si kur ishte komandant i një regjimenti vullnetarësh në Luftën e Parë Botërore që i grumbulloi studentët e tij për të luftuar -atëherë me mijëra studentë të Risale-i Nurit, nga nderimi i madh për të, do t'i ngrehnin çadrat e tyre në kodrat e qytetit të Afjonit duke pritur në to vendimin e pafajësisë prej gjykatës penale në Afjon.

Puna që bëjnë Said Nursi dhe Risale-i Nuri nuk mund të vlerësohet brenda kornizës së ligjit dhe të provohet se është një shoqëri sekrete; përse nuk mund të provohet ajo? A mos vallë do të ishte i paaftë për ta provuar ligjërisht një person i cili konsiderohet një ekspert ligjor, që është ngritur deri tek zyra e prokurorit të përgjithshëm? Por meqenëse nuk ekziston formimi i një shoqërie të tillë të fshehtë, askush nuk mund ta provojë ekzistencën e një shoqërie të tillë politike. Prandaj ata nuk mund ta provojnë.

Prokurori i përgjithshëm në fillim tha: "Studentët e Risale-i Nurit nuk janë një shoqëri politike". Ky mendim dhe ky gjykim i tij ishin krejtësisht të sakta dhe në përputhje me ligjin. Dhe pastaj më vonë për ndonjë arsye, ai tha se "ata janë një shoqëri politike". Natyrisht kjo fjala e fundit është e pavlefshme. Kjo është një kontradiktë, ky është një mendim dhe jo gjykim.

Ne jemi të sigurt se gjyqtarët do ta shohin qartë këtë fakt dhe do të japin vendimin që "Nuk ka shoqëri sekrete".

Gjyqtarë të respektuar!

Në qoftë se duke vuajtur pikëllim e brenga, një pjesë do të këputej prej zemrës -nëse do të ishte zakon i zemrës- atëherë njoftimi për një të ri duke humbur fenë e tij do ta bënte zemrën të copëtohej sa numri i grimcave të saja të vockëla.

Kështu, pafajësia që ju do të jepni, do të jetë shkaku që të shpëtonin rinia islame dhe bota islame prej kësaj pasoje të tmerrshme. Dhe ky është njëri nga shkaqet që më lidh mua me hallka që nuk këputen me Bediuzzamanin dhe me veprat e tij.

Vendimi që do ta shpallni për t'i dhënë pafajësi Risale-i Nurit dhe për ta lejuar atë që të qarkullojë, do t'i shpëtojë rininë turke dhe myslimanët prej fatkeqësisë së ateizmit sepse padyshim Risale-i Nuri i cili është thesari i të vërtetave të larta do të njihet dhe do të bëhet i famshëm në të gjitha anët e botës. Dhe ju do të vlerësoheni prej të gjithë njerëzimit. Vendimi juaj për t'i dhënë pafajësi Risale-i Nurit do t'i bëjë brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të jenë mirënjohës ndaj jush, dhe sa më shumë që të lexohet dhe të përfitohet prej tij, aq më shumë do të vlerësoheni ju.

Ruhuni! Mos i supozoni këto fjalët e mia të sinqerta të jenë hipokrizi. Absolutisht jo! Sepse unë nuk kam frikë prej askujt, dhe nuk dridhem prej asnjërit.

Por, me lejen tuaj, unë dëshiroj të them edhe këtë: Në qoftë se prokurori vazhdon të bëjë akuza të tilla të përbuzshme kundra Risale-i Nurit, kundra autorit të tij dhe kundra lexuesve të tij, ndonëse -Risale-i Nuri- është si një ilaç i efektshëm kundra komunizmit dhe kundra masonëve në këtë vend të bekuar; dhe në qoftë se prokurori nuk heq dorë krejtësisht prej akuzave të tij të gabuara dhe nga irritimet e tij personale dhe nga ndjenjat e tij, ai me këtë ndihmon masonët dhe komunistët që ata të shumohen e të përhapen.

• • •

[Pjesë nga shtojca e Zybejrit për gjykatën e Apelit]

Nëpërmjet provave të tij, Risale-i Nuri riparon besimin e njerëzve që kanë qenë shkatërruar nga dyshimet dhe nga skepticizmi të mbjella prej botimeve të organizatave ateiste sekrete.

Njëri prej mistereve të hollë që e lidh dhe e bën rininë të kapen pas Risale-i Nurit, si të ishte me një prekje elektrike, është sa vijon: Për shumë vite me një përkushtim dhe vetëflijim të pakrahasueshëm dhe në kohën e pleqërisë dhe të sëmundjes së tij -domethënë në një kohë që ai kishte nevojë për kujdesje dhe për t'u preokupuar me të, Bediuzzaman Said Nursi duroi dhe përballoi të gjitha llojet e papërshkrueshme të shtypjes dhe të torturimit që i binin nga ana e armiqve të tij të fshehtë prej masonëve dhe komunistëve dhe prej atyre që u mashtruan prej tyre. Me shikimin e tij të vërtetë dhe real, ai perceptoi e dalloi dredhi e intriga të shumta tradhtare kundra fesë, dhe ka shkruar vepra rreth besimit, që do t'i asgjësonin planet e fshehta të tmerrshme e finoke.

Por sa pikëlluese dhe sa e dhimbshme është të vuajë ky kampion i madh i islamit dhe ky personalitet i madh gjenial prej torturave të burgjeve qysh prej njëzet e pesë vitesh, prej burgimit të vetmuar fillikat dhe duke u bërë përpjekje për ta eliminuar! Por edhe në qoftë se do të vuante autori i Risale-i Nurit dhe do të ndëshkohej si rezultat i dyshimeve që burojnë prej fyerjeve të komunistëve dhe prej dredhive të tyre, vepra e tij -Risale-i Nuri- vazhdon të lexohet me një interesim dhe me një entuziazëm gjithmonë në rritje.

Dëshmia e parë dhe më e fuqishmja është kjo: Të rinjtë që e lexojnë veprën "Shkopi i Musait", e cila është shumëfishuar me shkronja të reja, menjëherë fillojnë të mësojnë leximin me shkronjat e Kur'anit -me alfabetin arab- me qëllim që të mund të lexojnë trajtesat e tjera. Kjo heq pengesën e mosnjohjes së shkrimit Kur'anor; kjo mosnjohje ishte një pengesë përpara mësimit të shumë shkencave, dhe

i detyronin ata për të lexuar libra të shumtë të cilët qenë shkruar për t'i larguar njerëzit nga Kur'ani. Dhe kur rinia e çdo kombi iu afrua, dhe po pajisej me këto shkenca dhe po armatosej me to, kjo do të thotë se ai popull nisi të ecë në rrugën e progresit dhe të përparimit. Këtu rinia ka filluar të mbushin shpirtërat e tyre të djegur për nevojën e besimit dhe të islamit, me dritat e Risale-i Nurit, i cili është një komentim i Kur'anit Kerim. Kështu, duke fituar besim të sigurt e të verifikuar, rinia jonë do të luftojë kundra pafesisë dhe komunizmit dhe nuk do ta lejojnë kurrë që t'ua shesin atdheun e tyre armiqve të islamit.

Prandaj, në qoftë se komunistët do të gjenin rast për t'i shkatërruar të gjithë letrën dhe bojën, shumë të rinj si unë dhe njerëz të moshuar do të ishin të gatshëm të sakrifikonin vetveten, dhe me qëllim që të botonin Risale-i Nurin, i cili është thesari i të vërtetave, do t'i bënin nëse do të ishte e mundur- lëkurat e tyre letra dhe do ta bënin gjakun bojë.

Po! Po! Po! Një mijë herë.

Prokurori i përgjithshëm brenda akuzave të tij thotë: "Said Nursi ka helmosur mendimet e studentëve të universitetit me veprat e tij". Ne si përgjigjje themi këtë:

"Në qoftë se Risale-i Nuri do të ishte helm, atëherë ne kemi nevojë për tonelata prej këtij helmi, dhe për mijëra kilogram. Dhe në qoftë se do të njihej një vend ku ky helm të gjendej me shumicë, atëherë le të na e dërgojnë atë neve me shpejtësi me aeroplan!"

Kur ne studentët e Risale-i Nurit vuajmë nga padrejtësia e tiranëve, dhe kryejmë shërbimet tona në rrugën e besimit dhe të islamit, ne preferojmë që ta dorëzojmë shpirtin në burgje dhe tek litarët e varjes dhe jo në divanin e rehatisë. Sepse ne e dimë se do të ishte një mirësi e madhe Hyjnore të vdesësh si martir në burgje në të cilët jemi flakur padrejtësisht për shkak të shërbimit ndaj Kur'anit, dhe ne e preferojmë këtë vdekje mbi një jetë që në pamje të jashtme duket liri por në anën e saj të brendshme realiteti i saj është despotizëm absolut.[293]

I Burgosuri Zybejr Gyndyzalp
Prej provincës së Konias
Burgu i Afjonit

[293]Pasi kjo mbrotje dhe shtojca e saj u dërgua për tek Gjykata e Apelit autoritetet e gjykatës dërguan një telegraf duke urdhëruar që Zybejri të lirohet prej Burgut.

[Mbrojtja e Mustafa Sungar[294]]

Për gjykatën Penale të Afjonit

Prokuroria ka kërkuar të më dënojë edhe mua me akuzën se i përkas Shoqërisë së Nurxhuve që nxisin njerëzit kundra qeverisë.

Së Pari: Nuk ka shoqëri me emrin Shoqëria e Nurxhuve, dhe unë nuk i përkas një shoqërie të tillë. Unë jam një anëtar i një shoqërie të shenjtë e të madhe islame, e cila në çdo shekull për një mijë e treqind e pesëdhjetë vite ka pasë treqind milionë anëtarë, dhe e cila u themelua nga Profeti Muhammed a.s.m., nga lavdia e universit, e cila është e gjërë dhe e ndritshme dhe premton lumturi të përjetshme për të gjithë njerëzimin. Të gjitha falënderimet qofshin për Zotin xh.sh., unë jam i vendosur që t'u nënshtrohem urdhëresave të saja të shenjta me të gjithë fuqinë time.

Sa për Risale-i Nurin, i cili është një mrekulli e Kur'anit, qënia ime një student i tij gjë të cilën prokurori e konsideron të jetë një krim dhe mëkat, -Risale-i Nuri- më ka mësuar detyrat e mia fetare dhe të imanit, dhe më ka mësuar se islami është feja më e lartë dhe më e shenjtë dhe se ajo është rruga e vetme për lumturinë e njerëzimit. Risale-i Nuri më ka mësuar se Kur'ani është Dekreti Hyjnor që ka zbritur prej Zotit të të gjitha botërave, i Cili është i Gjithëpranishëm dhe Gjithëshikues në çdo vend, dhe e gjithë ekzistenca duke filluar nga grimcat dhe duke përfunduar tek yjet dhe diejt është nën fuqinë dhe nën administrimin e Tij të parapërjetshëm, dhe më ka mësuar mua se Kur'ani është një mrekulli Hyjnore shikimi i të Cilit i rrethon dhe i përfshin parapërjetësinë, paspërjetësinë dhe të gjitha ngjarjet; dhe se ai është më i lartë se të gjithë librat, është një libër i mrekullueshëm në dyzet aspekte, është një fjalë e parapërjetshme që e sihariqon të gjithë njerëzimin për lumturinë e përjetshme dhe i bën të përmalluarit për të të jenë përjetësisht mirënjohës ndaj tij. Risale-i Nuri provon se i dërguari i Allahut u dërgua nga Krijuesi i Universit dhe, me të gjitha gjendjet e tij ishte më i plotësuari i të gjithë njerëzve, më besniku dhe më i larti në të gjitha aspektet e plotësimit, dhe se Ai i paraqiti të gjithë njerëzimit -nëpërmjet dritës së islamit- sihariqin më të madh dhe ngushëllimin më të shenjtë; dhe se ai administroi me pushtetin e tij shpirtëror një të pestën e llojit njerëzor qysh prej afërsisht

[294] Mustafa Sungur ka lindur në 1929. Ai e ka shoqëruar Ustadhin gjithandej derisa arriti tek "asgjësimi i tij në Risale-i Nur". Ashtu siç tha për të Ustadhi: "Unë do t'ia lë amanet atij dhe vëllezërve të nderuar drejtimin e studentëve të Risale-i Nurit. Zoti e bekoftë dhe ia zgjattë jetën". Përkthyesi.

katërmbëdhjetë shekujsh, dhe shkruhen në regjistrin e veprave të tij të mira të gjitha ato që i fiton ummeti i tij prej veprave të mira qysh prej një mijë e treqind viteve; dhe ai është shkaku për krijimin e universit, dhe se ai është i dashuri i Zotit. Ai -Risale-i Nuri- më ka mësuar se Ahireti, Xhenneti dhe Xhehennemi janë e vërtetë dhe realitet; dhe këtë e provon me argumente e prova të ndritshme që burojnë prej Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm.

Me fjalët dhe me fjalitë e tij, Risale-i Nuri dëshmon se është një shkëlqim prej dritës së Kur'anit Kerim dhe prej dritës së Muhammedit a.s.m. dhe kjo nëpërmjet qënies së tij i lidhur me Kur'anin dhe me qënien e tij si koment i veçantë për të, dhe me këtë konsideratë ai i përket qiellores dhe Fronit Hyjnor. Dhe kështu, Risale-i Nuri -që është akuzuar se na i nxitka njerëzit kundër qeverisë- me të gjitha pjesët e tij (Fjalët, Shkreptimat, Rrezet dhe Letrat) vetëm jep mësim rreth të vërtetave Hyjnore, rreth parimeve islame dhe rreth mistereve të Kur'anit. Atëherë si do të mund të konsiderohej krim apo mëkat leximi i Risale-i Nurit, i cili është kaq i lartësuar dhe i denjë për nderim, dhe i cili jep mësim moralet e mira, virtytin dhe të vërtetat e besimit? Si vallë konsiderohet krim e mëkat të kopjuarit e këtyre trajtesave të cilat na udhëzojnë neve për tek lumturia e përjetshme ose që e bëjnë vëllain besimtar që të përfitojë prej tij nga aspekti i besimit?

Si mund të konsiderohet kjo nxitje për njerëzit se na qenka kundra qeverisë? Dhe të shkosh për vizitë tek autori i një vepre të tillë të bekuar e të lartë, një përmendore drite i cili është i stolisur me shkallën më të lartë të besimit, me morale të lavdërueshme, me virtyte dhe është tek maja e plotësimeve humane, dhe formimi i një vëllazërie në rrugën e Kur'anit Kerim me studentët e Risale-i Nurit të cilët janë të pajisur me besim të ngulitur thellë dhe me akide të patundur, dhe të cilët kanë marrë mbi supet e tyre të mbrojnë dinjitetin e islamit dhe të vërtetat e Kur'anit në këtë shekull, dhe të cilët nuk kanë objektiv tjetër përveç fitimit të kënaqësisë... A përbën kjo formim të një shoqërie? Cila ndërgjegje e pastër e drejtë do të mund të shpallte dënim mbi këta?

Gjyqtarë të respektuar!

Risale-i Nuri me të gjitha pjesët e tij duke filluar nga "Fjalët" dhe "Shkreptimat" dhe duke përfunduar tek "Shuaati" të cilat i kanë afirmuar edhe dijetarët më të mëdhenj dhe të cilat japin një shkallë të lartë besimi dhe një entuziazëm të madh islam për ata që e lexojnë, -Risale-i Nuri- nuk është tjetër veçse një komentim i ndritshëm i Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm, dhe secila nga pjesët e tij

janë një diell që zhduk sëmundjet shpirtërore dhe largon errësirat shpirtërore.

Ndërsa profesori ynë, autori i Risale-i Nurit, e ka kaluar të gjithë jetën e tij në rrugën e imanit dhe në rrugën e Kur'anit dhe ka duruar në këtë rrugë të gjitha llojet e mundimeve dhe të vështirësive; dhe ai është përpjekur që t'i përhapë këto të vërteta të Kur'anit në këtë shekull që t'i shpëtojë bijtë e këtij kombi të bekuar prej sulmeve të tmerrshëm të komunistëve dhe prej të gjitha llojeve të pafesisë; dhe faqja e bardhë e jetës së tij të pastër pa ndonjë faj dëshmon se ai është i ngarkuar dhe i kualifikuar për këtë mision të shenjtë të të shkruarit të Risale-i Nurit në këtë kohë. Ai nuk na mëson ne -Ruajna Zot- për imoralitet dhe as për plaçkitje e shkatërrim, por ai na ka dhënë mësime për të shpëtuar imanin. Dhe kjo ndoshta përbën qëllimin më të madh dhe objektivin më të rëndësishëm për njerëzimin në faqen e tokës; dhe ai qysh prej njëzet e pesë vitesh është përpjekur të shpëtojë besimin e qindra mijëra njerëzve nëpërmjet Risale-i Nurit, dhe veçanërisht për njerëzit mjeranë si unë që nuk dinim asgjë rreth islamit, dhe na ka dhënë neve mësime rreth besimit i cili është lumturia më e madhe në jetë dhe qëllimi i tij më i rëndësishëm dhe padyshim konsiderohet një mirësi Hyjnore. Ne themi sa vijon për ata të cilët në një mënyrë katërcipërisht -plotësisht- i kundërshtojnë këto të vërteta dhe që mohojnë këtë shërbim të shenjtë duke e konsideruar atë një rrezik për jetën shoqërore -u themi sa vijon:

Në qoftë se do të ishte një krim kjo sipërmarrja e tij për të shpëtuar njerëzit nga pasojat e tmerrshme si rënia dhe shthurja morale, nga ateizmi, nga mungesa e besimit, për t'i udhëzuar ata për në besim dhe për të ecur në rrugën që ka projektuar Allahu dhe për tek thirrja për t'iu bindur urdhërave të fesë dhe për t'i gëzuar ata me lumturinë e përhershme të islamit...

Në qoftë se ky do të ishte faj e krim atëherë ju mund të thoni se ai është i dëmshëm për jetën shoqërore, ose përndryshe kjo prokurori është shpifja më e madhe dhe një krim i pafalshëm.

Qëllimi i Risale-i Nurit nuk është kjo dynja, por është lumturia e përjetshme e Ahiretit dhe arritja e kënaqësisë së Zotit xh.sh.; qëllimi i tij është kënaqësia e të Qëndrueshmit të Parapërjetshëm, Mëshirëplotë të Gjithëlavdishëm, që bukuria dhe hijeshia në këtë botë nuk përbëjnë veçse një hije të dobët të Bukurisë së Tij, dhe të gjitha çudirat e holla të Xhennetit nuk përbëjnë veçse një shkreptimë prej dashurisë së Tij xh.sh.. Duke pasë kështu një qëllim të këtillë Hyjnor e të shenjtë dhe një objektiv të tillë të lartë, unë një mijë herë më shumë deklaroj se Risale-i Nuri është krejtësisht i pastër dhe larg gjërave kalimtare të

tilla si, nxitja e njerëzve kundra qeverisë. Dhe ne i kërkojmë mbrojtje Allahut që të na ruajë prej të keqes së atyre të cilët me shpifjet e këtij lloji përpiqen të na shtypin neve dhe na pengojnë nga puna për t'i shërbyer besimit ose nga të mësuarit rreth fesë.

Gjyqtarë të respektuar!

Ashtu siç është treguar nga tridhjetë e tre vërsetet e Kur'anit, dhe siç tregohet nga Imam Aliu (Zoti qoftë i kënaqur me të), dhe nga Gauth El-Aëdham dhe nga qindra dijetarë hulumtues e verifikues, Risale-i Nuri është një dritë nga Kur'ani dhe ata të cilët kapen pas saj do ta shpëtojnë besimin e tyre, në dashtë Zoti xh.sh.. Sigurisht Risale-i Nuri nuk mund të shuhet dhe as të humbasë. Për shembull, sulmet e bëra ndaj tij gjatë këtyre njëzet e pesë viteve me qëllimin që ta eliminonin, kanë qenë shkaku i përhapjes së tij dhe i ndriçimit të tij në mënyrë të jashtëzakonshme. Sepse pronari i tij është Sulltani i Gjithëlavdishëm, nën fuqinë e të Cilit dhe nën urdhërin e të Cilit është çdo gjë nga parapërjetësia për tek paspërjetësia. Sepse të vërtetat e tij janë të vërtetat e Kur'anit, dhe nëpërmjet Mbrojtjes dhe Përkujdesjes së Tij, Allahu i Gjithëfuqishëm do ta bëjë atë të shndërrisë gjithmonë, in shaall-llah.

Gjyqtarë të respektuar!

Në qoftë se do të ishte një krim për të lexuar dhe për të shkruar Risale-i Nurin - i cili jep mësim besimin islam me dashurinë më të madhe dhe me entuziazëm, dhe i cili nuk njeh asnjë qëllim tjetër përveç kënaqësisë Hyjnore, dhe i cili sigurisht është një mrekulli e lartë e Kur'anit në këtë shekull dhe një komentim i ndritshëm i tij -dhe dhënia e këtyre trajtesave të tij- që përmbajnë të vërtetat e besimit- vëllezërve besimtarë, dhe në qoftë se lidhjet e fesë dhe vëllazëria islame të cilat urdhërohen nga feja, dhe vëllazëria e shenjtë Hyjnore e bashkimit në rrugën e Kur'anit dhe të besimit për dashurinë e Zotit përbëka një shoqëri politike, atëherë për mua që t'i përkas një shoqërie të tillë do të ishte fatmirësia ime më e madhe, dhe një lunturi më e madhe se ajo e dhënë nga ndonjë favor apo shpërblim. Falënderime të pafundme qofshin për Zotin e Gjithëfuqishëm, i Cili i dhuroi një të mjeri si unë favorin më të madh të të qenurit student i Risale-i Nurit, i cili e bën njeriun të fitojë një lumturi e një fatmirësi të tillë. Fjala ime e fundit është:

"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregullesi më i mirë i punëve".

"Allahu është më se i Mjaftueshëm për mua, nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Tek Ai unë mbështetem plotësisht dhe Ai është Zoti i Arshit Madhështor".[295]

Mustafa Sungur
Mësues

• • •

Shtojca e Mbrojtjes së Mustafa Sungur për gjykatën e Apelit.

1- Gjykata penale e konsideroi leximin dhe kopjimin e Risale-i Nurit nga ana ime dhe dhënien e tij ndonjërit prej vëllezërve besimtarë të nevojshëm që të përfitojnë prej tij -e ka konsideruar- krim dhe faj sepse unë -sipas prokurorisë- paskam nxitur popullin kundra qeverisë. Duke ditur se unë më parë thashë në mbrojtjen time si përgjigje ndaj kësaj akuze sa vijon:

Risale-i Nuri të cilën e konsideroni se nxitka njerëzit kundra qeverisë, në realitet është vetëm se një komentim i vërtetë i Kur'anit Kerim, dhe ai -me të gjitha pjesët e tij- jep mësim për të vërtetat e besimit, dhe i jep gjithkujt që e lexon dhe e shkruan atë një lumturi të madhe. Ai kurrë nuk ka synuar çështje të ulëta dynjaje dhe të përkohshme si nxitja e njerëzve kundra qeverisë, të cilat janë prej akteve të shkatërruesve dhe të bjerraditësve të pamoral; përkundrazi synimi i Risale-i Nurit është arritja e kënaqësisë së Allahut e cila është shkalla më e lartë e fatit më të mirë. Unë krenohem për qënien time një shërbyes i pafuqishëm dhe njëri prej studentëve të Risale-i Nurit, i cili më bën mua të fitoj, kur e lexoj dhe e shkruaj, mirësinë më të madhe dhe virtytin më të lartë që janë mirësia e imanit dhe virtyti i tij. Dhe megjithëse unë thashë se unë e di se të jesh student i Risale-i Nurit konsiderohet si mirësia më e madhe Hyjnore, dhe unë e lavdëroj dhe e falënderoj Allahun gjithmonë që më dha këtë mirësi dhe e dhuroi mbi këtë person të varfër e të mjerë si shembulli im, dhe megjithatë u shpall vendimi për të më dënuar mua, sepse ata e konsideruan lidhjen time me besimin dhe me islamin si një krim duke mos u mbështetur në asnjë ligj dhe në asnjë dëshmi, dhe kanë vepruar krejtësisht në kundërshtim me të vërtetën dhe realitetin.

2- Unë dëshmoj se kur studioja në institutin Gölköy në Kastamonu, disa mësues na jepnin neve mësime ateizmi dhe na thonin se Muhammedi a.s.m. -Ruajna Zot!- është ai i cili e shkroi Kur'anin Kerim, dhe se islami tani ishte shfuqizuar, dhe se qytetërimi ecën në

[295] Kur'an, 9 :129

rrugën e përparimit; prandaj do të ishte një gabim i madh dhe një reaksion dhe prapambetje ta ndjekësh Kur'anin në këtë shekull. Madje njëri prej mësuesve një ditë na tha:

"Myslimanët e kalojnë jetën e tyre në dhimbje dhe në torturim të vazhdueshëm sepse ata kryejnë namazin dhe e kujtojnë Ahiretin. Dhe një atmosferë dëshpërimi sundon vazhdimisht në xhamitë islame; ndërkohë që krishterët e kalojnë jetën e tyre të lumtur e plot jetë në një atmosferë muzike dhe argëtimi".

Ata përpiqeshin që të këpusnin të gjitha lidhjet midis zemrave dhe imanit e islamit dhe t'i zëvendësonin ato me mohim e ateizëm. Dhe kështu ndërsa isha në një gjendje që po më nguliteshin këto ide të tilla helmuese dhe i zbuluar para vrasjes së besimit tim me këto mësime ateiste të dëmshme deri në atë shkallë që unë u shtyva në rrymën e këtyre ideve dhe fillova t'i përhap përreth meje -Ruajna Zot!-, kur papritmas lexova disa trajtesa të Risale-i Nurit, të cilat i marrin dritat e tyre prej Kur'anit Kerim dhe të cilat i shfaqin të vërtetat e imanit dhe të vërtetat e islamit me argumente të ndritshëm dhe me prova të jashtëzakonshme dhe që argumentojnë se feja islame ka qenë gjithnjë një mjet për lumturinë e njeriut dhe për shpëtimin e tij, dhe se islami është dielli shpirtëror, drita e të Cilit nuk do të shuhet dhe nuk mund të shuhet, dhe kur ç'të shohësh, me këto trajtesa të Risale-i Nurit u dëbuan të gjitha idetë helmuese dhe në zemrën time u përhap imani. Në qoftë se unë arrita të besoj Kur'anin, atëherë a nuk duhet t'i afroja gëzimin e pafundmë dhe lumturinë që ndjeva heroit të dhembshur, besnik e të vërtetë Ustadh Bediuzzamanit, që i kisha fituar këto nëpërmjet Risale-i Nurit të bekuar që ai i kishte shkruar, dhe si unë shpëtova prej jetës së pakujdesisë dhe të çudhëzimit dhe dola në bregun e besimit dhe të dritës, dhe se Risale-i Nuri i cili na bën neve të fitojmë iman të vërtetë konsiderohet dielli i udhëzimit për të gjithë njerëzit në këtë shekull dhe është mjet lumturie për ta. Dhe se Bediuzzamani duke u ngarkuar me detyrën e rëndë të hartimit të Risale-i Nurit, sigurisht ka kryer shërbimin më të madh të besimit, dhe ai me këtë konsiderohet një mirësi e madhe Hyjnore për të gjithë njerëzimin dhe veçanërisht për njerëzit e besimit; dhe e njoftova atë për dëshpërimin tim të madh, për dhimbjen time të thellë dhe për ftohjen time të fortë për sulmet agresive të tmerrshme që bënë disa organizata të fshehta të Sufjanit ndaj Kur'anit dhe islamit, dhe si ata -ashtu siç e përmenda më parë- e stolisin ateizmin për bijt e këtij populli heroik islam dhe orvaten të shkatërrojnë themelet islame Hyjnore të shenjta me të cilat lidhen me miliona njerëz dhe përpiqen të shkatërrojnë lumturinë e tyre të përjetshme.

Unë i shfaqa atij hidhërimin tim të madh dhe ftohjen time të fortë ndaj këtyre idiotëve të cilët i duartrokasin këta keqbërës dhe brohorasin shkatërrimet e tyre tiranike, agresive e të ulëta. Dhe iu adresova shokëve të mi në shkollë të cilët kishin rënë në dyshime lidhur me besimin e tyre:

"Eani, le t'i braktisim këto teka të nefseve tonë; le të përkulemi përpara të vërtetave të Kur'anit dhe të shpejtojmë për tek medreseja e Risale-i Nurit, udhëzuesi për tek lumturia në këtë shekull. Le t'i braktisim gënjeshtrat e këtyre idiotëve gënjeshtarë... këto gënjeshtra që ne i kemi dëgjuar për muaj e për vite dhe i kemi duartrokitur dhe që na i sollën neve sikur ato të ishin pikërisht e vërteta, dhe le ta bëjmë Bediuzzaman Said Nursin profesor për ne dhe të kapemi pas mësimeve të tij me të gjithë zemrat tona me qëllim që të dalim prej errësirave në dritë. A nuk burojnë të gjitha këto nga gëzimi që ai gjeti në besimin e tij dhe në dashurinë e tij për Kur'anin dhe islamin, dhe nga lidhja e tij me to, dhe nga përkushtimi i tij për kombin e tij dhe nga dëshira e tij që gjithkush ta arrinte besimin e vërtetë të verifikuar dhe të arrinte lumturinë e vërtetë?

A është krim ta lidhësh vetveten me Zotin dhe të shpallësh se islami është feja më e lartë dhe ajo që sjell virtytin dhe lumturinë? Në këtë kohë ka filluar një sulm shkatërrues dhe rrënues kundra islamit dhe kundra Kur'anit prej të gjitha anëve dhe kanë filluar shpifjet të grumbullohen kundra Kur'anit dhe kundra profetit Muhammed a.s.m. dhe bëhen përpjekje që ato -Kur'ani dhe profeti- të bëhen të refuzuar, të cilët janë tej mase të lartësuar, të shenjtë e të çmueshëm; ndërsa lejohen librat që përhapin pafesinë, ateizmin dhe për t'u zhveshur prej fesë dhe prej moraleve; dhe janë grumbulluar lavdërimet dhe vlerësimet për fatkëqinjt prej armiqve të islamit duke i mbajtur me respekt kundërshtarët e Zotit, dhe duke i përmendur veprat e tyre të paligjshme dhe bidatet me admirim e vlerësim, dhe duke neglizhuar shenjtërinë dhe epërsinë e Kur'anit dhe lartësinë dhe vërtetësinë e profetit Muhammed, duke ditur se Risale-i Nuri shpjegon ekzistencën e Zotit xh.sh. dhe shpjegon se të gjitha qëniet e këtij universi dëshmojnë unitetin e Krijuesit të tyre dhe se Ai është Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, dhe se njeriut, meqenëse iu dhanë arsye dhe mund të mendojë, ai është pasqyra më gjithëpërfshirëse e Emrave të bukur Hyjnorë, dhe është si një lloj monarku mbi të gjitha krijesat e tjera. Atëherë në qoftë se ky njeri do të lidhej me Allahun nëpërmjet adhurimit dhe besimit dhe do ta mbronte vetveten kundra çudhëzimit dhe shthurjes dhe kundra gjynaheve të mëdhaja, ai do të meritonte pozitën e një mysafiri të nderuar në shkallën më të lartë dhe të arrinte

mirësitë e Xhennetit të përjetshëm e të amshuar. Ndërsa në qoftë se ai do të mohonte Krijuesin e tij dhe do të binte në çudhëzim e në pakujdesi, do t'i përshkruante ortak Allahut dhe nuk do t'i bindej, atëherë ai do të ishte më i çudhëzuar se sa kafshët dhe meriton nivelin më të ulët në ndëshkimin e përjetshëm në Ferr. Dhe Kur'ani është Fjala e Allahut, dekretet dhe urdhërat e të cilit nuk ndryshojnë dhe nuk mund të ndryshojnë; dhe islami na çon neve tek civilizimi më i lartë, dhe se lumturia e vërtetë dhe e vazhdueshme nuk mund të arrihet për njerëzimin veçse duke ndjekur urdhërat e Kur'anit dhe duke u lidhur me të... këto janë çështjet që i ka sqaruar Risale-i Nuri dhe i ka argumentuar në mënyrë të sigurt, dhe prandaj Risale-i Nuri e merr vendin e tij të lartë sepse ai buron prej mrekullive të Kur'anit dhe prej Dritës Hyjnore... Atëherë si vallë besimi në këtë, përhapja dhe shpallja e tij konsiderohen krim?

Sa e çuditshme! Leximi i novelave dhe i tregimeve të shkruara kundra islamit, dhe i librave që nxisin epshet e paligjshme, botimi i librave tej mase të dëmshëm e të rrezikshëm për vendin dhe kombin, dhe pastaj duke u lavdëruar dhe duke u rekomanduar këto libra të rrezikshëm... të gjitha këto janë të lejueshme dhe nuk konsiderohen krim. Atëherë, a mund të vlerësohet si një krim në qoftë se lexojmë e shkruajmë Risale-i Nurin, i cili përshkruan Diellin e Islamit -të cilin qindra miliona njerëz e kanë ndjekur dhe në të cilin ata kanë gjetur lumturinë e vërtetë- ose në qoftë se rendisim karakteristikat e tij të larta, për të cilat neve na mungon aftësia për t'i lavdëruar? A mundet dikush që ka sa një grimcë besim në zemrën e tij dhe që dëshiron mirëqënien e vendit dhe të kombit t'i konsiderojë krime ato që u përmendën më lart?

Gjyqtarë të respektuar të Gjykatës së Apelit!

Kjo çështje e paraqitur në praninë tuaj të lartë është drejtpërdrejtë çështja e besimit dhe e Kur'anit. Është çështja e lumturisë së përjetshme dhe e shpëtimit të miliona njerëzve. Të gjithë profetët dhe të dërguarit me në krye profetin tonë më të nderuar a.s.m., dhe të gjithë Evlijatë dhe të gjithë paraardhësit tonë besimtarë të cilët kanë udhëtuar për në botën e Ahiretit, kanë lidhje nga aspekti shpirtëror me këtë çështje të madhe. Dhe ju sot keni në duart tuaja një rast që të fitoni dashurinë e atyre miliona prej njerëzve të realitetit, duatë e tyre dhe shefaatin e tyre. Dhe se e vërteta e lartë, e quajtur "Risale-i Nur" është para jush. Atëherë, a ka ai si qëllim rangjet e ulëta e të përkohshëm dhe pozitat e kësaj dynjaje, apo fitimin e kënaqësisë së Allahut që është lumturia më e madhe, gëzimi më i madh dhe fatmirësia më e

lartë? Dhe a mos vallë ai i nxit njerëzit që të jenë imoralë, apo i zbukuron ata me besim dhe me moralin më të lartë dhe me virtyt?

Përpara jush është Risale-i Nuri, i cili derdhet nga mrekullia e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm që është Dritë Hyjnore. Meqenëse fitimi i Imanit dhe kalimi me këtë Iman në dynja për tek lumturia e botës së Ahiretit është qëllimi më i rëndësishëm për njeriun, dhe meqenëse Risale-i Nuri paraqet -nëpërmjet shkëlqimeve të Kur'anit- të vërtetat e imanit, dhe i afron qindra e mijëra lexuesit dhe shkruesit e tij tek ky qëllim, dhe siç dëshmohet nga vërsete të shumtë të Kur'anit dhe nga hadithe të profetit Muhammed a.s.m., edhe nga Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të dhe nga shumë Evlija si Gauth El-Aëdham, Zoti qoftë i kënaqur me të, ai -Risale-i Nuri- sigurisht që e ka fituar atë çështje; Sigurisht dhe padyshim, nëpërmjet dashurisë suaj të lartësuar për të vërtetën dhe për drejtësinë, mbi çdo lloj shqetësimi të përkohshëm, ju do ta kuptoni dhe vlerësoni faqen e vërtetë të Risale-i Nurit, faqen Kur'anore dhe vlerën e tij të vërtetë, dhe do ta njihni se studentët e Risale-i Nurit nuk ndjekin asnjë qëllim tjetër përveç kënaqësisë së Allahut.

Gjyqtarë të nderuar të Gjykatës së Apelit!

Me moralin e tij të lartë, me virtytin dhe me dhembshurinë, profesori ynë i shquar Bediuzzaman Said Nursi, lufton për t'i shpëtuar njerëzit nga errësira e dendur e ideve të rreme dhe nga burgosja e përjetshme fillikat, dhe duke duruar e përballuar vuajtjet dhe torturat më të rënda, ai është ngritur tek shkalla më e lartë e plotësimit në këtë kohë nëpërmjet qënies së tij i ngarkuar nga Zoti i Gjithëfuqishëm me detyrën e shenjtë të botimit të të vërtetave të Kur'anit; megjithatë krejtësisht në kundërshtim me të gjithë të vërtetën dhe drejtësinë, ai është flakur në burg. I moshuar, i sëmurë, dhe pa askënd, duke praktikuar besimin e tij dhe adhurimin në mënyrë më të lartësuar, duke poseduar zgjuarsinë më të ndritshme dhe njohjen, dhe duke mos pasë qëllim tjetër përveç shpëtimit të besimit të njerëzve, vuajtja e tmerrshme e profesorit tonë, i cili është shtatëdhjetë e pesë vjeç, i cili e do vërtet humanizmin, në të ftohtin e madh të burgut të Afjonit, na e copëton zemrën dhe na shkakton mundimin më të rëndë.

Ne presim nga drejtësia juaj e lartë dhe e lidhur me të vërtetat dhe nga dashuria juaj dhe nga lidhja juaj me dashurinë për humanizmin, presim manifestimin e dhembshurisë së drejtësisë.

Mustafa Sungur

• • •

[Mbrojtja e Mehmet Fejziut]

Për gjykatën penale të Afjonit

Prokurori i përgjithshëm e konsideroi qënien time si sekretar të Profesorit tim Said Nursi dhe që jam i lidhur fort me Risale-i Nurin dhe qënien time në shërbim të madh në këtë fushë... e konsideroi atë si akuzë, si një shkelje. Unë them përballë kësaj se unë e pranoj këtë akuzë me të gjithë fuqinë që kam dhe unë krenohem me të; sepse unë kam një dëshirë të fuqishme të bashkëlindur për njohje. Dëshmi për këtë është se kur kontrolluan shtëpinë time në ngjarjen e Denizlit, gjetën në të pesëqind e tetëdhjetë libra shkencorë dhe arabisht dhe i regjistruan ato zyrtarisht; dhe megjithëse unë jam i varfër dhe në fillim të jetës dhe njohuria ime për gjuhën arabe akoma është e mangët, ashku im për dijen, dhe dëshira ime e fortë për të mësuar janë ato të cilat më shtynë mua që t'i siguroj këto libra të ndryshëm që vetëm një person në një mijë njerëz do të mund t'i kishte në këtë kohë.

Për shkak të këtij kapaciteti të natyrshëm tek unë, unë po kërkoja një mësues të vërtetë. Dhe falënderime të pafundme qofshin për Zotin që Ai më dha mua nga afër atë që e mendoja të largët.

Po, jeta e profesorit tim, Said Nursi dëshmon se qëllimi i vetëm i tij në jetë ka qenë njohja dhe të mësuarit e shkencave islame. Unë kam kuptuar qartë edhe nëpërmjet vëzhgimeve të mia, edhe nga biografia e tij e botuar, dhe nga ajo që kam mësuar prej studentëve të tij të vjetër, se dëshira ime e bashkëlindur për dije gjendet tek profesori im në mënyrë të jashtëzakonshme dhe deri në një shkallë të tillë saqë ai vazhdon ta ruajë cilësinë e studentit të dijes -në kundërshtim me të gjithë dijetarët e diplomuar prej shkollave të vjetëra islame, gjë e cila e bëri atë të aftë për t'i përballuar të gjitha mundimet dhe fatkeqësitë.

Dhe meqenëse njerëzit e politikës nuk i kuptuan gjendjet e çuditshme të profesorit tim dhe janë përpjekur për t'i lidhur këto gjendje me një lloj politike me të cilën ai nuk ka asnjë lidhje, saqë ata e flakën atë në burg.

Por Allahu xh.sh. e bëri këtë dashuri për dijen që gjendet tek ai si një çelës për të vërtetat e Kur'anit, dhe u shfaq Risale-i Nuri, i cili i ka lënë në habi të gjithë dijetarët dhe filozofët. Gjatë kësaj kohe e gjeta profesorin tim në qytetin e Kastamonus përbri meje, të cilin e kam kërkuar gjatë gjithë jetës sime, natyra e të cilit ishte e ngjashme me mua, por pafundësisht më e lartësuar. Unë e konsideroj këtë një mirësi

Hyjnore dhe do të vazhdoj ta falënderoj Allahun për këtë deri në fundin e ditëve të jetës sime.

Me qëllim që profesori im ta ruante dinjitetin e dijes dhe vendin e saj, ai nuk pranon, -dhe nuk ka pranuar gjithashtu- as sadeka, as dhurata dhe as gjëra të ngjashme me to; dhe i pengonte gjithashtu edhe studentët e tij prej gjërave të tilla. Ai nuk e ka përkulur kokën e tij para askujt. Dhe prej situatave të tij të jashtëzakonshme ai nuk pranonte në luftë ndërsa ishte në rreshtin e parë të frontit të luftës të hynte në hendek dhe këtë e bënte për të ruajtur dinjitetin e dijes. Gjithashtu ai heroikisht duke ruajtur dinjititetin e dijes dhe të mësimit përkrah tre komandantëve[296] të tmerrshëm, ishte krejtësisht i palëvizur, i qetë tek zemërimi i tyre dhe i heshti ata. Prandaj, unë e pranoj atë si profesorin tim të vërtetë, meqë unë e dija se ai ishte dikush që kishte sakrifikuar gjithçka për të ruajtur dinjitetin e lartë të këtij kombi dhe të këtij vendi dhe nderin e dijetarëve të kombit turk dhe sakrifikoi gjithçka në rrugën e saj. Madje, edhe në qoftë se do të supozonim të pamundurën, sikur një profesor kaq shumë i përkushtuar për këtë vend dhe komb të kishte njëqind të meta, ato duhet të shiheshin me tolerancë dhe të mos kundërshtoheshin. Atë e vlerësuan patriotët -në emrin e Atdheut dhe në emrin e kombit- në periudhën e dytë të kushtetutës, po ashtu ishte gjendja edhe në periudhën e Republikës.

Një shembull për vlerësimin e tyre ndaj shërbimeve të mëdhaja të profesorit për dijen është se komiteti i qeverisë së unionit dhe të progresit dha nëntëdhjetë mijë lira ari për universitetin e tij në lindje të quajtur *El-Medresetu eZ-Zehra*. Dhe ky do të organizohej në të njëjtën linjë me atë të universitetit të Az'harit. Themelet e tij u vendosën në provincën e Vanit, por ai mbeti i pandërtuar për shkak të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore. Pastaj qeveria e parë e Republikës para njëzet e pesë vitesh dha njëqind e pesëdhjetë mijë lira me miratimin e njëqind e gjashtëdhjetë e tre deputetëve. Dhe marrja vetë përsipër e këtij profesori të nderuar për të ngritur një universitet si ai i Az'harit, për ndërtimin e të cilit morën pjesë për të kontribuar mijëra dijetarë, dhe iu afrua shumë realizimit të këtij objektivi, tregon se të gjithë patriotët dhe dashuruesit e vendit të tyre, së bashku me mësuesit e medreseve -shkollave fetare- duhet ta vlerësojnë dhe ta duartrokasin.

Sa për ne, për shkak se gjetëm një profesor të tillë, ne vendosëm të përballojmë çdo vështirësi e mundim. Unë kam respekt të pakufishëm për të si një dijetar i jashtëzakonshëm në këtë kohë, i cili nëpërmjet

[296]Aludon për komandantin Hashid Basha në gjykatë, për Mustafa Qemalin dhe për komandantin Rus Nikolla Nikollajaviç. –Përkthyesi.

shkëlqimit të dijes dhe të vërtetave të veprave të tij të larta që arrijnë njëqind e tridhjetë më ka shkaktuar mua të avancoj në rrugën e besimit dhe të njohjes. Në dashtë Zoti xh.sh., ky respekti im do të vazhdojë për të gjithë përjetësinë.

Dhe megjithëse kërkimet dhe hetimet vazhduan për muaj për të provuar akuzën e drejtuar ndaj meje nga ana e prokurisë së përgjithshme rreth "shfrytëzimit të fesë dhe të ndjenjave fetare me synimin për të ngritur një shoqëri të fshehtë që do të prishte rendin dhe stabilitetin e shtetit", por ama këto hetime nuk qenë në gjendje ta verifikojnë asnjë shoqëri të tillë, dhe as ne nuk kemi asnjë lidhje me një gjë të tillë. Lidhja jonë e vetme brenda kornizës së ligjeve të Republikës, është për Risale-i Nurin, i cili ka hyrë në provimet më të vështira dhe është takuar me respektin e duhur prej komiteteve më të larta të ekspertëve dhe ka marrë pafajësinë nga gjykatat e autorizuara të ligjit. Kjo nuk është tradhti ndaj kombit, por përpjekje shkencore në një mënyrë që është një dobi e drejtëpërdrejtë për vendin dhe për kombin.

Përveç kësaj, ne nuk kemi asnjë qëllim politik dhe asnjë qëllim tjetër. Kështu, meqenëse pafajësia jonë dhe sinqeriteti ynë janë të qarta në këtë çështje, unë kërkoj manifestimin e drejtësisë prej gjykatës suaj të drejtë dhe pafajësinë time ashtu si në Gjykatën e Denizlit.

I Burgosuri Mehmed Fejzi, Pamukçu,

në Burgun e Ajonit

• • •

[Mbrojtja e Ahmed Fejziut]

Për gjykatën penale të Afjonit

Gjyqtarë të respektuar!

A nuk është e drejta e besimtarit dhe detyrë e tij që të takohet me një dijetar fetar dhe të lexojë librat e tij që lidhen me të vërtetat e fesë dhe të kopjojë këto libra dhe të nxitojë për t'i ndihmuar vëllezërit e tij në fe dhe në rrugën e shërbimit të fesë së tij, të Kur'anit dhe të profetit? A ka ndonjë ligj që të na ndalojë neve nga ky shërbim ndaj fesë? A mos vallë është krim të kritikosh disa aspekte të rrymave ateiste imorale të kohës sonë? Ne jemi një klasë fetare prej popullit e cila nuk ka asnjë lidhje as me politikën dhe as me administratën e shtetit. Të mendosh mirë për dikë dhe ta konsiderosh atë të denjë është një mendim personal që mund të mbahet nga gjithkush. Ne e njohim

Bediuzzamanin të jetë dijetari më i lartë i fesë në kohët tona. Ne e njohim atë të jetë ai që ndjek realitetin, dhe i cili i shpreh dhe i shpjegon të vërtetat e fesë pa iu lajkatuar askujt. Ne e quajmë atë *Muxhed-did*, për shkak të shërbimit të tij ndaj fesë dhe duke u mbështetur tek të vërtetat e patundshme të Kur'anit, marrja e tij përsipër mbrojtjen e vendit tonë kundra rrymave të imoralitetit dhe të mosbesimit të cilat e kërcënojnë atë. Në një vend në të cilin liria e fesë dhe e ndërgjegjes janë ligj, ne nuk mund të mbahemi fajtorë për një shkelje për shkak të mendimeve që ne kemi në dritën e ndërgjegjjeve tona. Prandaj, ne nuk detyrohemi t'i japim llogari askujt.

Sa për çështjen e personave të parashikuar në hadith që do të vijnë në fundin e kohës: ne nuk e shpikëm këtë. Ato kanë origjinën e tyre në fe. Në disa hadithe, profeti a.s.m. tha se jeta e ummetit të tij do t'i kalonte një mijë e pesëqind vjet. Këto hadithe përshkruajnë shumë ngjarje historike të rëndësishme në jetën e ummetit Muhammedan dhe ato paralajmërojnë që të ruhen prej të këqijave të tyre. Ne themi se ata që do të bien në këto të këqija nga pakujdesia dhe nga injoranca, do të bien në mjerim e në shkatërrim të përhershëm, dhe ndodhen shenja e tregues fetar të panumërt rreth këtyre çështjeve. Ne jemi njerëz që kemi besuar në Allahun, në të dërguarin e Tij dhe në Kur'anin. Atëherë duke u mbështetur tek ky besim dhe duke u mbështetur tek vërtetësia e profetit a.s.m., a të mos punojmë ne për t'i shpëtuar vetet tona prej shkatërrimit të përhershëm? A të mos shohim se çfarë ndodh përreth nesh? A të mos e shpjegojmë këtë duke u mbështetur tek të vërtetat fetare dhe të pyesim: A ka ardhur kjo kohë e rrezikshme? A ne jemi ky brez që biem pre e atyre rreziqeve dhe shkatërrimeve? A t'i injorojmë argumentet e ndritshëm që gjenden para nesh dhe t'i injorojmë të vërtetat e qëndrueshme dhe të vërtetat shkencore të cilat provojnë për ne ekzistencën Hyjnore dhe të lëmë fenë tonë, dhe të shtyhemi pas rrymës e cila e konsideron ateizmin si kolonën më të madhe të civilizimit europian?... Në qoftë se ne do ta bënim këtë atëherë kush do të na shpëtonte neve prej shkatërrimit të përhershëm? A ta injorojmë këtë dhe të mos mendojmë për të? A mundet për dikë që beson se nuk gjendet gjë mbi Kur'anin dhe mbi të vërtetat e Kur'anit që ta flakte vetveten në shkatërrim të përjetshëm nga frika prej dënimeve kalimtare? Ose a do t'i jepte ai ndonjë denjësi vlerave kalimtare? A do ta braktiste ai detyrën e tij të shërbimit në Rrugën e Zotit, në rrugën e profetit të Tij dhe në rrugën e fesë? Atëherë këto janë faktorët e vërtetë që na lidhin neve me Bediuzzamanin. A ka ndonjë burim tjetër feje që mund t'i heshtë nevojat e parapërjetshme të shpirtërave tonë?

Prokurori i përgjithshëm i nderuar na rekomandoi neve mijëra libra arabisht të cilët mbushin libraritë por që nuk e interpretojnë shpirtin e shekullit tonë aktual. Ai vetë dhe ata që mendojnë si ai mund të mos e pëlqejnë përmbledhjen e njohjes, thesarin e lirisë dhe realitetin e lartësuar të quajtur Risale-i Nur, dhe ata mund ta kritikojnë atë.

Kjo është një çështje që i përket atij, ai është i lirë për të. Por ai nuk mund të ndërhyjë në dashurinë dhe në preferencën tonë ndaj këtij libri ose atij. Ne e duam Risale-i Nurin dhe e shohim se ai është një libër i vërtetë feje, nuk ka hipokrizi, dhe ai është një koment i Kur'anit Kerim. Vlerat dhe gjykimet e vlerave janë çështje ndërgjegjeje. Askush nuk mund të ndërhyjë në to. Po, ne pajtohemi se autori i Risale-i Nurit gjithmonë jep mësim të vërtetën e pastër; dhe mohimi i kësaj nga prokurori i përgjithshëm dhe mospranimi i tij nuk e dobëson këtë besimin tonë dhe as nuk e trondit.

Ne nuk e pranojmë Risale-i Nurin për hir të kerametit të tij në botën fizike, por për hir të shfaqjes së kerametit të plotë shkencor i cili e sfidon botën e njohjes në mësimet e tij të Dritës. A mund të na tregoni neve një Bediuzzaman të dytë i cili megjithëse periudha e tij (zyrtare) e studimit nuk ishte më shumë se tre muaj, të përhapë një dritë të tillë vezulluese njohjeje, dhe që me çudirat e dijes së tij shfaqi një logjikë aq të përparuar në çështjet përfundimtare të shkencës saqë i la në habi edhe mendimtarët më të mëdhenj; dhe me një gjuhë që e mësoi vetëm në gjysmën e dytë të jetës së tij pati një stil magjepsës shpjegimi dhe një pasion të tillë tërheqës; i cili vërshon me dashuri e zjarr, dhe shkrimet e tij duken të bollshme si një det besimi, si një thesar i njohjes Hyjnore dhe një oqean urtësie?

A e vlerësoni ju të tepërt që ne e konsiderojmë atë të jetë profesori, monumenti i virtytit dhe i dritës i cili nuk shfaq as prirjen më të vogël ndaj mburrjes kalimtare e sipërfaqësore; as nuk e ul veten tek asnjë dobi sado e madhe që të jetë dhe as tek gjërat që e ndotin njeriun sado të fuqishme të jenë thirrjet e këtyre gjërave, dhe nuk ka pritur asgjë prej askujt dhe nuk ka kërkuar ndërmjetësimin e dikujt për diçka, dhe nuk ka pranuar çfarë i është afruar; ai dha shembullin më të mirë për ndershmërinë dhe dëlirësinë, i duroi të gjitha llojet e mundimeve dhe të vuajtjeve, dhe ia kushtoi veten shfaqjes së realitetit dhe shfaqjes së dritave të Kur'anit dhe njohjes së Muhammedit a.s.m..

Ndërsa përpara dhimbjeve të vendit dhe të kombit, zemra e tij e dhembshur qante me pikëllim e keqardhje. Dhe pavarësisht të gjitha llojeve të tradhtisë dhe të fyerjeve para të cilave u zbulua, ai nuk hoqi dorë nga përmbushja e detyrës së tij për t'i gëzuar njerëzit përreth tij;

dhe pavarësisht pleqërisë dhe vetmisë, ai u përpoq e luftoi me të gjithë fuqinë në rrugën e Zotit xh.sh. për t'i shpëtuar njerëzit prej puseve të injorancës dhe prej thellësirave të mohimit -ateizmit. Dhe në këtë kohë kur vlerat morale kanë humbur, ne e shohim atë -përveç kerametit të tij shkencor që u përmend më lartë- një shembull vetëflijimi dhe altruizmi dhe shembull për moderim e ndershmëri, model plotësimi dhe virtyti i denjë për t'u njohur e ndjekur; a e shikoni këtë si tepri nga ana jonë?

Atëherë, kështu ne i shohim Bediuzzamanin dhe veprat e tij. A mos vallë lidhja jonë me të që buron nga besimi ynë, dhe pjesëmarrja me vërsetet e Kur'anit dhe me hadithet profetike në qortimin dhe përçudnimin ndaj mohimit -, pafesisë dhe ndaj shthurjes morale na bën neve të ndotur me përfshirjen tonë në politika kalimtare? A do të ishte e mundur të quhet korrupsion puna për reformimin e shpirtërave të pafajshëm të një grupi prej bijve të këtij vendi të cilët nuk e kanë pasë të lehtë qysh prej njëzet e pesë vitesh mësimin rreth të vërtetave të fesë? Dhe a mos vallë shpëtimi i tyre prej shkatërrimit të përjetshëm dhe njoftimi i tyre rreth Allahut xh.sh., të Dërguarit të Tij dhe rreth Kur'anit është korruptim për ta?

Gjyqtarë të respektuar!

Ne nuk jemi përfshirë në asnjë mënyrë në politika. Ne e dimë se për ata si ne që veprojnë jashtë poltikës, politika mban mijëra fatkeqësi, rreziqe dhe përgjegjësi. Prandaj ne nuk u japim asnjë rëndësi gjërave të jashtme kalimtare. Ne vetëm shohim fytyrën e mirë të dynjasë e cila na çon tek Kënaqësia Hyjnore. Prandaj ne e refuzojmë fuqishëm akuzën se ne ndjekim politikat ose kundërshtojmë konceptin e shtetit. Në qoftë se do të kishte pasë ndonjë qëllim të tillë, do të kishte pasë ndonjë manifestim të vogël të tij gjatë njëzet e pesë viteve.

Po, ne kemi një cilësi kundërshtuese, por ama është një kundërshtim kundra shthurjes morale dhe kundra ateizmit. Dhe ky kundërshtim buron nga pjesëmarrja jonë -nga domosdoshmëria- me Kur'anin duke përdorur shprehjet e tij të ashpëra dhe paralajmërimet gjithëpërfshirëse rreth këtyre gjërave. Në qoftë se këto arsye dhe ky stil i drejtë dhe i sinqertë shpjegimi nuk ju bind juve, na dënoni me çfarëdo lloj ndëshkimi që ju kënaqeni. Por mos harroni se Hazreti Isai a.s. -Jezusi- i cili sot ka gjashtëqind milion ndjekës, u dënua me vdekje si një hajdut i zakonshëm nga autoritetet e kohës së tij vetëm për shkak se zemra e tij rrihte për lumturinë e njerëzimit dhe që mbajti amanetin e përcjelljes së mesazhit.

Duke pasë folë lirshëm, ne do të jemi krenar për t'u përballë me dënimin tonë. Me thirrjen:

"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve", ne i hapim duart tona para Gjykatës së Plotësuesit të nevojave.

I Burgosuri Ahmed Fejzi Kul
Në Burgun e Afjonit

• • •

[Mbrojtja e Xhejlanit]

Për gjykatën penale të Afjonit.

Duke e bërë qimen tra, për shkak të shërbimit tim ndaj profesorit dhe ndaj Risale-i Nurit, për të cilin unë jam krenar, prokuroria më paraqet mua si një burrë politik të rrezikshëm dhe si një komplotues finok. Në përgjigje ndaj pjesës së madhe të krimit imagjinar që ai më jep mua dhe me të cilin akuzohet Risale-i Nuri, unë them këtë:

Unë jam shumë i lidhur me profesorin tim Bediuzzaman, prej të cilit, duke lexuar veprat e tij rreth fesë, besimit dhe moralit, unë kam përfituar deri në atë shkallë që unë jam gati të sakrifikoj jetën time për hir të tij. Megjithatë lidhja ime me të nuk është ashtu siç thotë prokurori "e dëmshme për vendin dhe kombin dhe për të nxitur njerëzit kundra shtetit"; përkundrazi, ajo është një lidhje e pakëputur në rrugën për të shpëtuar veten time nga asgjësimi i përjetshëm i varrit, prej të cilit askush nuk mund të shpëtojë, dhe për të shpëtuar besimin e vëllezërve të mi në fe, që ashtu si unë, kanë nevojë të shpëtojnë në këto kohë të rrezikshme, duke rregulluar sjelljen e tyre, dhe duke u bërë anëtarë të dobishëm të kombit dhe të vendit.

Unë jam njëri prej atyre që janë të afërm me të. Nga koha në kohë për katër vite unë me krenari i kam shërbyer atij. Gjatë kësaj kohe, unë nuk kam dëshmuar për të veçse virtyt të plotë. Unë nuk e kam dëgjuar atë asnjëherë të thotë një fjalë të vetme rreth qënies së tij një Mehdi ose Një Muxhed-did. Më shumë se njëqind mijë kopje të Risale-i Nurit dhe qindra e mijëra studentë të Risale-i Nurit të cilët kanë shpëtuar imanin e tyre duke i lexuar ato, dëshmojnë për modestinë e tij të plotë. Ky profesori im i bekuar e sheh veten e tij një student prej studentëve të Risale-i Nurit. Kjo është ajo që ai pretendon. Kjo mund të shihet lehtë në shumë nga letrat e tij, të cilat ju i keni në duart tuaja, dhe veçanërisht tek trajtesa rreth sinqeritetit, që është përfshirë tek

koleksioni “Shkopi i Musait”. Ai në mënyrë të përsëritur thotë në letrat e tij:

“Të vërtetat e qëndrueshme janë si dielli dhe si diamanti; ato nuk mund të ndërtohen mbi persona kalimtarë, dhe personat e përkohshëm nuk mund t’i pretendojnë ato të vërteta të çmueshme”. Kështu, ta akuzosh atë për mburrje dhe për pretendimin se është- një Mehdi dhe Muxheddid i fesë nuk është diçka që do ta bënte ndokush me arsye të shëndoshë. Sepse në qoftë se ju do t’i lexonit me vëmendje dhe me paanshmëri të gjitha trajtesat dhe letrat e tij, do të formonit bindje të sigurtë se ai është një gjeni dhe një dijetar shumë i thellë i kohëve ngjashmëria e të cilit nuk është parë prej shekujsh. Ai është një shpëtimtar i besimit shëmbëllimi i të cilit nuk është hasur, i cili në kohën kur shkëndijat e kuqe të komunizmit po merrnin flakë për të djegur çatitë e shtëpive tona; ai është një patriot shumë më i dobishëm dhe produktiv për vendin dhe për kombin se sa një ushtri. Unë jam i hidhëruar që nuk kam qenë një student më i hershëm i një vepre të tillë dhe i një profesori të tillë të shquar i cili e shkroi atë.

Gjyqtarë të respektuar të gjykatës!

Unë kam parë në veten time dobi të mëdhaja të panumërta prej leximit të Risale-i Nurit, prandaj unë mora përsipër të botoja trajtesën “Udhëzuesi për të rinjtë” në Eskishehir dhe me leje zyrtare, dhe këtë e bëra me qëllim që të përfitojnë ata si unë prej bijve të këtij vendi; domethënë ndërmora një shërbim patriotik të lartë, dhe unë dëshiroj t’ju pyes:

Unë, duke qenë një person i varfër për Mëshirën e Allahut, mora përsipër botimin e Risale-i Nurit, i cili është një koment i vërtetë dhe i parefuzueshëm i Kur’anit Kerim, domethënë ndërmora një shërbim besimi. Atëherë a do të ishte e drejtë dhe në përputhje me drejtësinë që unë të përballem me këtë trajtim të egër në një kohë që duhej të trajtohesha me vlerësim e kurajo? Unë i kërkoj gjykatës suaj të drejtë që ju të jepni vendimin për lirinë e Risale-i Nurit, sepse ai është ushqim për shpirtërat tonë, mjet shpëtimi, dhe çelësi për lumturinë tonë. Në qoftë se rrethanat, disa prej të cilave unë i përmenda dhe i numërova lart përbëjnë një krim në shikimin tuaj, unë do ta pranoja me kënaqësi të plotë edhe dënimin më të rëndë që ju mund të jepni.

I Burgosuri Xhejlan Çalishku, prej Emirdagut,

Burgu i Afjonit

• • •

[Mbrojtja e Mustafa Osmanit]

Për Gjykatën Penale të Afjonit

Duke iu përgjigjur akuzës që më është drejtuar rreth pjesëmarrjes sime në aktivitetet imagjinare të Bediuzzaman Said Nursit për të formuar një shoqëri të fshehtë dhe për të shfrytëzuar ndjenjat fetare për prishjen e rendit dhe të shtetit dhe për t'u ngritur kundra sistemit në fuqi, unë them sa vijon:

Po, ashtu si studentët tjerë të Risale-i Nurit, unë fillova të grumbulloja trajtesat e Risale-i Nurit dhe t'i lexoja ato me qëllimin që të mësoja moralet e Kur'anit të cilat janë epigrafi i edukimit të civilizuar dhe fetar të përshtatshme me dinjitetin historik të kombit tonë mysliman turk. Unë synova të bëhem një anëtar i dobishëm i vendit dhe i kombit, dhe ta mbroj atë kundra efekteve të ideologjive të huaja.

Ka ardhur shthurja dhe imoraliteti në vend të moraleve me të cilat u njohën stërgjyshërit tonë të cilët e regjistruan famën e tyre në histori; dhe kjo shthurje filloi të zhvillohej e të përhapej dhe të prishë jetën shoqërore deri në atë shkallë saqë vetë njerëzit e moralit të keq u bënë të neveritur prej kësaj shthurjeje morale të përhapur, gjë e cila e shqetësoi opinionin publik, dhe u bë biseda nëpër tubime në çdo shtëpi dhe u bë fjala e gazetave dhe e revistave të cilat konsiderohen gjuha që shpreh opinionin publik. Pastaj këto gjendje të dhimbshme duke u përhapur shpejt janë bërë thjesht një fatkeqësi e përgjithshme... Në një gjendje të këtillë, Risale-i Nuri mundi të më shpëtonte mua prej rënies morale ashtu siç i shpëtoi të gjithë myslimanët që e lexojnë atë; këto trajtesa të Risale-i Nurit u dhanë atyre që i kërkuan prej meje me ngulm -pasi e mësuan se unë i kam dëgjuar dhe i kam lexuar këto vepra- me qëllim që ai të mund të rregullonte edhe moralet e tyre gjithashtu. Me këtë punën time unë kam ndihmuar për të shpëtuar shumë prej individëve të cilët ishin gati duke rënë në shthurje morale dhe gati që të ishin anëtarë të dëmshëm për vendin dhe kombin. Risale-i Nuri mundi me mësimet e tij efektive që t'i shpëtonte këta njerëz dhe t'i bënte ata individë të dobishëm për njerëzimin dhe t'i mbronte ata përpara epidemisë së komunizmit të kuq që filloi të përhapet në vendin tonë dhe prej të cilës filloi bota të dridhet nga frika. Atëherë Bediuzzamani konsiderohet një Muxhahid shpirtëror që meriton vlerësim e respekt. Ndërsa arma e ndritshme dhe efektive për këtë xhihad është Risale-i Nuri i cili për një periudhë njëzet vjeçare i transformoi njëzet mijë individë -ose ndoshta më shumë- në individë të dobishëm për vendin dhe kombin. Atëherë si mundet që kjo nxitja ime

për të lexuar Risale-i Nurin të konsiderohet krim? Dhe si mundet që hartimi i Risale-i Nurit të jetë akuzë ndaj autorit të tij?... unë pyes ndërgjegjjet tuaja.

2- Hadithi për të cilin prokurori i përgjithshëm tha është *Meuduë* dhe prandaj ai është një gjykim joshkencor; ai hadith është *Sahih* -i saktë- dhe ka ardhur në librat e haditheve; dijetarët e hadithëve e pranojnë atë. Para periudhës së revolucionit kushtetues dhe gjatë tij japonezët dhe kisha Anglikane u bënë disa pyetje dijetarëve të asaj periudhe, dhe dijetarët e Stambollit ia paraqitën këto pyetje Bediuzzamanit i cili e përmblodhi interpretimin e këtij hadithi brenda trajtesës emri i të cilës u bë tani Rrezja e Pestë. Pranimi i këtyre përgjigjjeve nga ana e këtyre dijetarëve dhe moskundërshtimi i tyre tregon saktësinë e hadithit.

Jo vetëm kjo pjesë prej Risale-i Nurit, por të gjitha të vërtetat që kanë ardhur në të janë aq të fuqishme saqë asnjë dijetar i vërtetë islam nuk mund t'i kundërshtojë, prandaj ne shohim se të gjithë dijetarët e vërtetë në këtë vend -qysh prej periudhës së kushtetutës- me në krye drejtorinë e çështjeve fetare u detyruan t'i vlerësonin e t'i respektonin këto trajtesa. Prandaj nuk mund të zhduken të vërtetat e tij dhe argumentet e tij të fuqishëm nga ana e një ose dy individëve të cilët nuk kanë pjesë prej dijes reale, por veçse kanë emrin dijetarë; madje kjo çështje do të ishte qesharake. Risale-i Nuri lexohet me të gjithë respektin në të gjitha anët e vendit nga të gjitha klasat e popullit për të shpëtuar jetën e tyre të përhershme dhe besimin e tyre, dhe se dobitë e tij materiale dhe shpirtërore janë të mëdhaja dhe të dukshme. Prandaj me mijëra bashkëqytetarë të cilët kanë përfituar dhe i kanë admiruar të vërtetat e Kur'anit dhe të vërtetat e imanit kanë një ndjenjë respekti dhe mirënjohjeje të thellë për autorin e këtyre trajtesave... Atëherë a mos vallë të shkruarit e disa letrave për autorin nga ana e këtyre -duke u nisur nga mirënjohja e tyre për të- dhe kuptimi i hadithit sherif që është çështja e akuzës duke u mbështetur tek të vërtetat që nuk mund të refuzohen, dhe shikimi në të sikur është bërë realitet në këtë vend duke u mbështetur në disa akte e vepra... dhe duke shfaqur urimet e tyre që vendi ynë të mos bie pre e anarkistëve dhe e këtij rreziku të kuq, -a mos vallë konsiderohen këto tradhti ndaj regjimit? A mos vallë këto janë dashaligësi e kritikë ndaj reformave? Dhe megjithëse ky dijetar i respektuar ka hyrë në disa gjykata për shkak të këtyre shpifjeve dhe janë shpallur vendimet e tyre për t'i dhënë pafajësi, por ama ai vazhdon të akuzohet me të njëtat akuzat e mëparshme dhe të burgoset në burgje të vetmuar nëpër gjykata, ndonëse ai është një person që jeton i veçuar, është i avancuar në moshë dhe në vetmi.

Ndërsa lidhur me ne, përpjekjet dhe orvatjet tona për të shpëtuar besimin tonë janë konsideruar si një provë se ne u orvatkemi për të prishur rendin dhe sigurinë e shtetit; ne i drejtojmë pyetjen gjykatës suaj: Cila ndërgjegjje e drejtë mund ta shpallë një vendim të këtillë? Ne e lëmë këtë për ndërgjegjjet tuaja.

3- Le të vijmë tek shkaku i akuzës tjetër që thuhet se ne "i mbajmë fotografitë e Bediuzzamanit sikur ato të ishin fotografi të shenjta dhe se grumbullojmë letrat e tij, dhe se i dërgojmë letra atij". Ne themi si përgjigje ndaj kësaj: Është e drejta ime -si e çdo individi tjetër- që t'i dërgojë atij letra e mesazhe urimi, t'i njohë edhe të tjerët që e duan atë dhe të mbaj fotografitë e tij... Jo vetëm fotografitë e tij të thjeshta, por sikur fotot e tij të stoliseshin me flori e me xhevahirë, kjo do të ishte gjë e pakët përkrah asaj mirësie që ofroi ky gjeni i madh. Ai më shpëtoi jetën time shpirtërore dhe të përhershme nga asgjësimi, dhe më bëri mua të shijoj lumturinë në jetën time materiale, dhe veprat e tij janë bërë mjet për të shpëtuar besimin e mijëra individëve të tjerë si unë. Kjo është e drejta ime. Unë nuk mendoj se kjo përbën faj, dhe në fund them:

Ashtu siç mund të dëshmojnë policia e dy provincave dhe disa qytete, me qëllim që të jenë në gjendje t'i shërbejnë këtij vendi, kombi, dhe humanizmi, Studentët e Risale-i Nurit -të cilët kanë shpëtuar vetvetet prej shthurjes morale me leximin e Risale-i Nurit dhe i kanë shpëtuar edhe të tjerët gjithashtu- i kanë shërbyer për shumë vite këtij atdheu dhe këtij kombi me një shërbim madhështor të cilin nuk mund ta kryenin mijëra policë. Kështu, në vend që ata të shihnin vlerësim e lavdërim, u keqkuptuan dhe u trajtuan sikur të ishin agjentë të të huajve; ne u burgosëm, u paraqitëm nëpër gjykata. U pezulluan bizneset dhe intereset tona dhe u lanë familjet dhe fëmijët tonë në një gjendje të mjeruar e të këputur. Çfarë demokracie e pranon këtë gjendje pikëlluese për familjet tona dhe këtë vajtim për fëmijët tonë, dhe ndërgjegjja e cilit sundimtar të drejtë do ta pranonte këtë?

Unë pyes me këtë gjykatën tuaj dhe ndërgjegjjen tuaj. Prandaj unë kërkoj në emër të gjykatës suaj të respektuar dhe në emrin e kombit të lavdishëm turk dhe në emrin e asamblesë së tij të lartë e të drejtë, nën hijen e së cilës ju veproni, që të shpallni vendimin për lirinë e botimit të Risale-i Nurit dobitë dhe përfitimet e të cilit nuk mund të mohohen kurrë, dhe gjithashtu të shpallni vendimin për pafajësinë tonë.

Mustafa Osman, prej Safranbolulu
Burgu i Afjonit

• • •

[Mbrojtja e Hifzi Bajramit]

Për gjykatën Penale të Afjonit

Akuzat që më janë drejtuar mua janë për shkak se unë lexoj veprat e dijetarit islam Bediuzzamanit i cili është akuzuar për shfrytëzimin e ndjenjave fetare për prishjen e rendit dhe të stabilitetit të shtetit, duke ditur se këto vepra janë shumë të çmueshme me dobi të madhe për kombin dhe vendin. Ato japin mësime shumë të dobishme për të vërtetat e Kur'anit dhe të besimit. Gjithashtu dhënia nga unë e disa prej këtyre veprave për disa prej shokëve të mi, me kërkesën e tyre - pasi zbulova përfitimin tim shumë të madh prej atyre veprave nga aspekti fetar e moral, dhe kjo duke ndjekur mënyrën tonë të përpjekjes për të arritur sevapin dhe shpërblimin nëpërmjet përhapjes së këtij edukimi fetar e moral. Gjithashtu, me pretekstin e një numri të njohurish duke më dërguar letra të një natyre shoqërore e shkencore në adresën time... Këto janë pretekstet tek të cilat mbështeten për të më bërë mua fajtor dhe si ortak në krim. Unë i kundërshtoj me sa vijon këto çështje me të cilat jam akuzuar:

1. Unë nuk mendoj se leximi i Risale-i Nurit nga ana ime me qëllim që të mësoj dhe që të ruaj fenë time dhe besimin tim, as dhënia e këtyre trajtesave nga ana ime për disa prej atyre me qëllim për të mësuar -nuk mendoj të jenë mëkat e krim; sepse këto trajtesa kanë kaluar nëpër gjykata të shumta dhe kanë marrë pafajësinë nga ana e tyre dhe pastaj janë rikthyer tek autori i tyre. Ato janë trajtesa që kanë marrë vlerësimin e dijetarëve të vendeve islame dhe të dijetarëve të vendit tonë; ato nuk përmbajnë ndonjë ide që shkakton turbullira ashtu siç pretendon prokurori i përgjithshëm. Secila prej këtyre trajtesave është një komentim i rëndësishëm i Kur'anit Kerim në çdo pjesë të tyre nga fillimi gjer në fund. Ato i ftojnë njerëzit për tek morali i lartë dhe tek virtyti, dhe japin mësime islame dhe edukim fetar në mënyrë të efektshme dhe janë shkak për të ruajtur popujt nga rënia në gremina. Prandaj ato nuk janë vetëm libra të dobishëm për këtë komb dhe për këtë vend, por ato gjithashtu janë të dobishëm për të gjithë njerëzimin nga aspekti shpirtëror. Sepse askush nuk ka regjistruar në asnjë vend ndonjë incident të dëmshëm ndaj vendit dhe kombit apo kundra administratës së shtetit që të ketë marrë pjesë në të ndonjëri prej studentëve të Risale-i Nurit; dhe policia nuk ka regjistruar asnjë incident të këtij lloji kundra tyre. Përveç kësaj, është krejtësisht e gabuar të thuash se: "Ata e studiojnë dhe e lexojnë Risale-i Nurin fshehurazi", dhe të shkaktosh dyshime rreth një shoqërie të fshehtë. Sepse, qoftë shkencore ose politike, studentët e Risale-i Nurit nuk kanë

lidhje me asnjë shoqëri të hapur apo të fshehtë. Madje Bediuzzamani së bashku me disa studentë të Risale-i Nurit u paraqitën në gjykatën e krimeve të rënda në Denizli para disa vitesh për pikërisht këto akuza. Dhe megjithëse të gjitha pjesët e Risale-i Nurit u hetuan dhe u shqyrtuan me hollësi, ato gjykata u detyruan të shpallnin vendimin për pafajësinë e të gjithëve dhe për pafajësinë e Risale-i Nurit. Unë nuk e di se si konsiderohet leximi i veprave të një autori që për të dhe për veprat e tij është shpallë pafajësia –si konsiderohet një provë për një krim të madh të tillë për prishje rendi dhe përpjekje kundra regjimit; dhe si mund të jetë kjo një arsye për ta akuzuar? Cila është shkalla e drejtësisë në këtë çështje? Unë këtë pyetje ua referoj ndërgjegjjeve tuaja.

2. Ndodhet një trajtesë tjetër e cila u dërgua tek unë ndërsa isha në burg prej dikujt nga Bajazit, të cilin nuk e njoh. Kjo trajtesë u bë shkak për akuzën ndaj meje. Unë nuk e kam parë këtë trajtesë, as nuk e di përmbajtjen e saj. Në qoftë se ajo do të ishte ndonjëra prej trajtesave të Risale-i Nurit, unë do ta pranoja. Ju pyesni për të që t'ju përgjigjem për këtë akuzën time.

Në fjalën e prokurorit të përgjithshëm erdhi diçka rreth çështjes së *Mehdiizmit*, dhe këtë e kam dëgjuar vetëm prej tij. Ndërsa profesori im është i pafajshëm dhe i pastër prej të gjitha akuzave të këtilla. Ashtu siç nuk e kam dëgjuar atë të përmendë diçka të tillë, po ashtu unë nuk e kam parë atë në asnjërën prej veprave të tij. Për më tepër, në çdo rast Ai i ka ndaluar studentët e tij që ta nderojnë atë dhe ta lartësojnë, apo që t'i japin atij rang, dhe ai i ka qortuar ata të cilët kanë shkruar për të letra të tilla. Ne gjithmonë e kemi njohur atë të jetë një dijetar i rëndësishëm i cili nuk kërkon asnjë rang, as pozitë, dhe të jetë një hoxhë i saktë dhe i drejtë.

I Burgosuri Hifzi Bajram

• • •

[Mbrojtja e Mustafa Emirdagli]

Për Gjykatën Penale të Afjonit

Unë do t'i përgjigjem akuzës imagjinare me të cilën prokuroria e përgjithshme akuzoi profesorin tim Bediuzzamanin:

Shërbimi që kam kryer për profesorin tim dhe për Risale-i Nurin i ngjason thjesht një pike uji përprara një oqeani mirësie e favori. Unë nuk jam aspak i penduar për këtë lidhje. Ashtu siç sakrifikohen copat e vogëla të qelqit në rrugën për të fituar një thesar shumë të çmueshëm

diamantesh, po ashtu unë jam i gatshëm në çdo kohë që të sakrifikoj jetën time në rrugën e Risale-i Nurit i cili është mjet për të shpëtuar jetën time të përhershme. Dobitë dhe përfitimet e Risale-i Nurit për Ahiretin dhe për dynjanë janë vërtetuar. Prandaj heqja dorë prej atyre dobive të mëdha dhe shfaqja ftohtësi e largim prej Risale-i Nurit dhe prej profesorit tim të respektuar, që të mos e godasë jetën e tronditur e të shkurtër të Dynjasë ndonjë dëm prej një burgosjeje të përkohshme dhe prej mundimeve të parëndësishme, ose të tregohesh indiferent ndaj tyre -Risale-i Nurit dhe Ustadhit-, unë e konsideroj këtë braktisje një fyerje të madhe ndaj profesorit tim, gjeniut të kohës, dhe ndaj synimit të tij të vetëm të madh i cili është shërbimi ndaj imanit dhe Kur'anit. Unë nuk dëshiroj t'u shmangem as edhe një thërrmijë atyre çfarë ai lejon dhe komandon.

Gjyqtarët e Respektuar!

Përse duket e tepërt që, pavarësisht varfërisë sime, të jem studenti i një dijetari të madh i cili lufton bolshevizmin që përpiqet të përhapë helme në atdheun tonë të dashur? Kjo sigurisht provon se pasuritë e Risale-i Nurit janë shumë më të mëdhaja se sa pasuritë e të gjithë dynjasë. Lërini Profesorin dhe Risale-i Nurin të lirë përgjithmonë me qëllim që t'i shpëtojnë miliona të rinjtë të popullit turk dhe që ata të bëhen anëtarë të dobishëm të vendit. Nevoja e ne të rinjve të popullit turk për Risale-i Nurin është shumë më e madhe se nevoja për ajër e dikujt që mbahet në një izolim të ngushtë, më e madhe se sa nevoja për dritën e qartë të atij që jeton në errësirë të dendur, dhe se sa nevoja e të uriturit dhe të eturit në shkretëtirë, dhe se sa nevoja e atij që po mbytet në det për dikë që ta shpëtojë.

Prandaj nuk përshtatet me nderin e drejtësisë, për shkak të fakteve, disa prej të cilëve i kam përmendur, që të dënoni Bediuzzamanin, i cili ka fituar respektin tonë dhe mendimin më të madh të mirë tonin, dhe me të cilin kemi lidhje që nuk këputen kurrë, dhe të dënoni shumë mjeranë të cilët janë bërë studentët e tij me qëllim të pastër e të mirë.

I Burgosuri Mustafa Açet

Burgu i Afjonit

• • •

[Mbrojtja e Halil Çalishkan]

Për Gjykatën Penale të Afjonit

Gjyqtarë të respektuar të gjykatës!

Në fletakuzën që e paraqiti prokurori i përgjithshëm, e konsideroi shërbimin tim ndaj ustadhit si një krim të madh që e kisha kryer. Profesori im erdhi në qytetin tonë si një mysafir në vitin 1944 dhe qëndroi atje qysh prej katër vitesh. Ky profesori im qysh prej dyzet vitesh i ka braktisur të gjitha kënaqësitë, ëndjet dhe rehatinë e jetës dhe i është përkushtuar shërbimit të imanit dhe të islamit dhe veçanërisht për të shpëtuar lumturinë e përjetshme të myslimanëve në vendin tonë. Me mësimet e Risale-i Nurit rreth besimit dhe moralet, ai ka ndërtuar -ngritur- një pengesë kundra ideve të dëmshme të komunizmit, të cilat po i shkaktojnë dëm të madh fesë sonë sidomos kombit tonë, i cili është mysliman e turk. Dëmi material dhe shpirtëror që shkakton bolshevizmi është shumë i madh. Gjithashtu Risale-i Nuri parandalon gjëra të ngjashme të dëmshme ndaj kombit, dhe këtë e realizon nëpërmjet mësimeve të besimit dhe të moralit të Risale-i Nurit -vlerën e të cilit e njohin të gjithë dijetarët. A mos vallë ky shërbimi im -për të cilin jam krenar ndaj ustadhit nga koha në kohë gjatë viteve, konsiderohet krim? Gjithashtu u shfaq të jetë krim që unë hoqa dorë nga qënia ime një rrobaqepës për të kryer atë shërbim. Po, edhe sikur të sakrifikoja jetën time në rrugën e profesorit tim dhe në rrugën e Risale-i Nurit -i cili na udhëzoi neve tek e vërteta dhe realiteti dhe i cili është në komentim i vërtetë i Kur'anit- a konsiderohem unë fajtor dhe tradhtar për atdheun?... Unë ju pyes ju.

I nderuar kryetar i Gjykatës!

Unë kam lexuar disa pjesë të Risale-i Nurit dhe i kam kopjuar disa prej tyre. Falënderime të pafundme qofshin për Zotin xh.sh. për përfitimin e madh prej këtyre trajtesave, sepse zemra ime qysh në fillim ka qenë lidhur shumë me dijen dhe e mallëngjyer për të. Megjithëse unë jam i lidhur nga afër me këto trajtesa të Risale-i Nurit, veçse ama unë nuk kam gjetur në të nxitje për popullin kundra qeverisë dhe as thirrje për të themeluar ndonjë shoqëri të fshehtë që të prishë rendin dhe qetësinë dhe nuk kam dëgjuar prej profesorit tim asgjë rreth *Mehdiizmit* ose rreth çështjes së *Muxhed-didit* dhe asnjë nxitje kundra stabilitetit. Synimi i vetëm i ne studentëve të Risale-i Nurit dhe i shërbimit tonë ndaj Risale-i Nurit dhe ndaj ustadhit është përmbushja e një detyre të shenjtë ndaj islamit dhe sidomos përmbushja e një detyre të shenjtë ndaj kombit mysliman turk nga aspekti i besimit dhe i moralit. Prandaj është e domosdoshme dhe detyrë mosndërhyrja tek Risale-i Nuri dhe tek studentët e tij si rezultat i këtyre shërbimeve të tyre. Ky është synimi ynë dhe ky është objektivi ynë, dhe asgjë tjetër veç këtyre. Përmbushja jonë e këtyre detyrave është në rrugën e fitimit të kënaqësisë së Zotit.

Natyrisht ne nuk mund ta përmbushim këtë detyrë të shenjtë në rrugën e dynjasë dhe në rrugën e dobive dhe të përfitimeve të saj, dhe nuk heqim dorë kurrë prej asaj detyre. Studentët e pastër të Risale-i Nurit -zemrat e atyre studentëve- nuk preokupohen me objektiva e synime dynjaje, sepse zemrat e tyre janë të preokupuara me besim dhe me çështje Ahireti, prandaj neve nuk na kishte shkuar ndërmend ajo që na akuzoi prokurori i përgjithshëm për formimin e një shoqërie sekrete, dhe as nuk mund ta durojmë një akuzë të këtillë.

Gjyqtarë të respektuar të gjykatës!

Ne besojmë se ju i keni kuptuar synimet, qëllimet dhe natyrën e studentëve të Risale-i Nurit, dhe keni formuar opinionin se ne nuk kemi asnjë lidhje me krimet për të cilat na ka ngarkuar prokuroria. Prandaj ne kërkojmë prej gjykatës suaj të lartë dhe prej vetëdijes e ndërgjegjjeve tuaja që librat tonë të rikthehen tek ne, të lirë, dhe të shpallni vendimin për pafajësinë tonë.

I Burgosuri Halil Çalishkan, prej Emirdagud

Burgu i Afjonit

• • •

[Mbrojtja e Mustafa Gÿl]

Për Gjykatën Penale të Afjonit

Unë nuk jam anëtar në një shoqëri të fshehtë, po ashtu edhe profesori im Bediuzzaman nuk ka formuar një shoqëri të këtillë. Ai në mënyrë të vazhdueshme na ka dhënë mësime rreth të vërtetave të Kur'anit dhe na ka paralajmëruar me të fortë që të mos kemi asnjë lidhje me politikën. Unë jam vetëm student i një profesori të madh Said Nursi. Unë jam lidhur me të dhe me Risale-i Nurin nga thellësia e zemrës dhe e shpirtit tim, dhe unë jam i gatshëm për çdo lloj dënimi në rrugën e Risale-i Nurit dhe në rrugën e profesorit tim. Profesori im nëpërmjet Risale-i Nurit ka shpëtuar imanin tim dhe jetën time të Ahiretit. Qëllimi i tij është që t'i shpëtojë të gjithë myslimanët dhe të gjithë bashkëpatriotët nga mosbesimi dhe që ata të fitojnë lumturi të përjetshme.

Është bërë e qartë në të gjitha proceset tona gjyqësore se ne nuk kemi lidhje me asnjë ambicie politike. Megjithëse realiteti është ky, ne përsëri në mënyrë të padrejtë e kot jemi tërhequr për tek gjykata. Ne kemi kuptuar nga kjo se ata dëshirojnë të thyejnë solidaritetin tonë. Solidariteti ynë nuk kthehet tek asnjë qëllim politik apo çështje e kësaj

bote. Ne vetëm kemi respektin më të madh për profesorin tonë. Ata të cilët e lexojnë Risale-i Nurin fitojnë një besim të jashtëzakonshëm, islamin, moral të mirë dhe plotësim. Ne jemi të paaftë për të mos pasë dashuri të madhe për profesorin tonë. Unë jam i lidhur me të gjithë qënien time ndaj profesorit tim dhe ndaj studentëve të Risale-i Nurit. Kjo lidhje nuk do të këputej apo të thyhej edhe sikur të ekzekutohesha. Unë dhe të gjithë vëllezërit e mi jemi të pafajshëm. Ne kërkojmë me të gjithë fuqinë tonë që Risale-i Nuri të lihet i lirë. Unë kërkoj që profesorit tonë të lartë dhe studentëve të pafajshëm të Risale-i Nurit dhe mua të na jepet pafajësia.

Mustafa Gÿl nga Isparta

• • •

[Mbrojtja e Ibrahim Fakazli]

Për gjykatën penale të Afjonit

Gjyqtarë të respektuar!

Akuza që na është drejtuar së pari është e kotë dhe lidhet me dynjanë; ajo është politike. Nuk ka dyshim se ju -o gjyqtarë të respektuar- e keni kuptuar që me shikimin e parë ndaj nesh se ne nuk jemi nga ata që punojnë në fushën e politikës. Megjithatë edhe në qoftë se qindra njerëz autoritarë do të siguronin se kjo akuzë e ftohtë dhe e huaj do të ishte qind për qind e realizuar, dhe sikur mendja ime të ishte njëqind herë më e madhe se sa mendja ime aktuale, ndikimi shpirtëror që e lë tek unë Risale-i Nuri dhe autori i tij i nderuar do të ishte i mjaftueshëm për mua që të braktis kënaqësinë kalimtare e të përkohshme politike dhe që të ikja me të gjithë qënien time dhe me ekzistencën time për tek rruga që na çon në Ahiret dhe për tek rruga që na çon tek shpëtimi prej Ferrit. Lidhja jonë qoftë me autorin e nderuar të Risale-i Nurit dhe respekti ynë për të, ose leximi Risale-i Nurin, ose kopjimi i trajtesave të tij ose marrëdhëniet dhe lidhjet tona me studentët e Risale-i Nurit... të gjitha këto lidhje janë për hir të Ahiretit, ashtu siç u afirmua nga gjykata penale e Denizlit dhe nga gjykata e Apelit. Mendimet që ne i kemi marrë prej Risale-i Nurit na bëjnë ftesë që as të mos e teprojmë në këto lidhje të ndritshme dhe as që të mos i ndryshojmë me asnjë qëllim të kësaj dynjaje apo material. Ky besimi ynë do të qëndrojë me ne deri në çastin e fundit të jetëve tona.

Gjyqtarë të respektuar të gjykatës!

Meqenëse ne u mblodhëm këtu për shkak të kësaj akuze të tmerrshme, unë shoh se ndërgjegjja ime dhe dashuria ime për vendin

tim më detyrojnë që t'ju shpjegoj këtë fakt të rëndësishëm. Unë kam parë në qarqet tona dhe në mjedisin tek i cili banoj reformat e mëdha që i ka arritur Risale-i Nuri. Këtë e kanë parë gjithashtu edhe njerëzit. Për një periudhë më shumë se dhjetë vite, shumë individë -edhe unë me ta- mësuan rrugën për në shtëpitë e tyre dhe të interesohen për familjet e tyre dhe lanë kryeneçësinë -mosbindjen- dhe njohën shijen e lumturisë familjare. Baballarët e këtyre dhe nënat e tyre i ngrejnë tani duart e tyre duke bërë lutje për atë që ishte shkak për një transformim të këtillë. Dhe ju keni mundësi të dëgjoni më shumë rreth kësaj çështjeje prej familjeve të provincës sonë dhe prej zonave fqinje të saj. Kur hyri Risale-i Nuri në burgun e Denizlit, ndikimi i tij ishte shumë pozitiv tek të burgosurit, dhe vazhdon ky ndikim pozitiv edhe tek të burgosurit e rinj. Gjithashtu kur hyra në burgun e Afjonit, unë pashë se çdo i burgosur, me të cilin flisja, bënte dua për të mirë për studentët e Risale-i Nurit dhe më kujtonte mua ndryshimin e madh ndërmjet gjendjeve të tyre të mëparshme me gjendjet e tyre të tanishme...

Këto janë të vërteta konkrete dhe gjenden para të gjitha shikimeve. E vërteta është se unë habitem shumë se si mund të thuhet se unë merrem me çështje politike thjesht pse i dërgoj letra autorit të respektuar të Risale-i Nurit, nga dashuria që kam për të? Këto trajtesa të cilat kanë qenë të dobishme për mua dhe për të gjithë bijt e llojit tim nga aspekti moral dhe shoqëror dhe nga aspekti i jetës së Ahiretit, për qënien e atij koleksioni një komentim i vërtetë i Kur'anit Kerim, ose pse unë u dërgova letra ngushëllimi disa bashkëqytetarëve të mi! Unë them në mes të kësaj çudie dhe habie se kjo punë nuk mund të jetë vend akuze apo mëkati. Mundësia e ardhur këtu është se armiqtë e fshehur të Kur'anit -dhe si rrjedhojë të Risale-i Nurit- janë ata të cilët i kanë bërë nëpunësit e drejtësisë dhe të rendit të kenë dyshime, hamendje dhe frikësime ndaj nesh me qëllim që të na flakin neve në burg, por padyshim gjyqtarët e respektuar do t'i njohin këto të vërteta dhe do t'i vendosin duart e tyre në ndërgjegjjet e tyre që të japin vendimin e tyre të drejtë i cili ka shumë shpërblim tek Allahu. Dhe ata do ta bëjnë kombin mysliman turk i cili i pret këto vendime me të gjithë interesimin në të gjitha anët e këtij vendi... mirënjohës e falënderues për ta.

I Burgosuri, Ibrahim Fazakli

Në Burgun e Afjonit

RREZJA E PESËMBËDHJETË

PROVA E NDRITSHME

Kjo përbëhet nga dy stacione

Ky mësim në anë të jashtme duket si një trajtesë e vogël, por në realitet ajo është një trajtesë e madhe, e fuqishme dhe shumë e gjërë. Ai është një frut besimi dhe një frut Kur'ani dhe parajse i cili u poq nga jeta ime e mendimit reflektiv dhe nga bashkimi i njohjes së sigurisë dhe i shikimit të sigurisë në jetën shpirtërore të Risale-i Nurit, i cili bazohet në sigurinë e realitetit nëpërmjet dëshmive të tij 'tahkiki'.

Said Nursi

Stacioni i Parë

Një përmbledhje konçize e Letrës së Njëzet dhe pjesa e parë e mësimit që u dha në shkollën e tretë të Jusufit. Kjo përbëhet nga tre pjesë.

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Dhe prej Tij ne kërkojmë ndihmë.

Ai që ka kaluar tridhjetë e pesë vite i veçuar nga njerëzit; krejtësisht në vetmi, që e ka braktisur dhe harruar dynjanë, dhe sidomos gjatë netëve, dhe duke pasë vuajtur për njëzet e tre vite shqetësimin e të qenurit nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe nën përgjim të përhershëm, akte këto që përmbanin e fshehnin armiqësinë dhe urrejtjen, saqë u bë të ndjehej i mërzitur dhe i shqetësuar prej kalimit të një ore nga koha e tij me ndonjërin prej njerëzve dhe në një vend të vetëm, përveç atij që është i mallëngjyer për Risale-i Nurin dhe atij që shkon për ta ndihmuar.

Unë them: E transferuan me detyrim këtë të mjerë -mua të pafuqishmin- tek krahu i pestë i burgut dhe penguan vëllezërit e mi që të më takonin, me pretekstin e peticionit që e shkrova për Gjykatën e

Apelit rreth mbajtjes sime në një burgim të vetmuar për njëmbëdhjetë muaj. Dhe ndërsa ndjehesha vërtetë i shqetësuar se nuk do të isha në gjendje t'i përballoja kushtet shumë shtrënguese e të ngushta, kur papritmas -si një shenjë zemërimi dhe indinjate- i ftohti u bë aq i ashpër saqë në qoftë se do të kisha qenë në vendin tim të mëparshëm, unë nuk do të kisha mbijetuar.

Vështirësia u shndërru në lehtësi, dhe ai mundim u transformua në mëshirë për mua. Ndërkaq m'u shfaq në zemrën time ndërsa po recitoja tesbihatet që ndjekin namazet:

Pavarësisht se studentët e Risale-i Nurit po e kryejnë detyrën e tyre -në vendin tënd- duke i përcjellë të vërtetat e Risale-i Nurit me seriozitet e me sinqeritet, në secilin prej krahëve të burgut, por ama për shkak se ky krahu i pestë që i ngjason vendit të veçuar të asketëve dhe vazhdimisht mbushet dhe boshatiset, atëherë ai është më i nevojshmi për mësimet e Risale-i Nurit. Gjithashtu edhe të rinjtë dhe të moshuarit sigurisht kanë shumë nevojë për instruksionin e tij të sigurt e të fuqishëm rreth besimit në ekzistencën e Zotit dhe në Unitetin e Tij xh.sh., meqë ata lexojnë çfarë shkruajnë gazetat prej sulmeve të Rusëve ndaj besimit me sulmet e ateizmit të tmerrshëm dhe me mohimin e Krijuesit Madhështor. Kjo ishte ajo që m'u shfaq në zemër gjatë recitimit të tesbihateve pas namazit.

Ndërkohë m'u kujtua Fraza e shenjtë e *tehlilit* të cilën prej shumë vitesh e rexitoj dhjetë herë pas namazit të Sabahut, e cila është:

"la-ilahe il-lall-llahu, Vahdehu, la sherike lehu, lehul Mulku, Velehul-Hamdu, Juhji, Ve Jumitu, Ve Huve Hajjun la Jemut. Bijedihil-Hajru, Ve Huve ala kul-li Shej'in Kadir, Ve ilejhil Mesir."

"Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut; Ai është Një; Ai nuk ka shokë; E Tij është e gjithë prona; Atij i takon lavdërimi; Vetëm Ai jep jetë; Ai shkakton vdekje. Ai është i Gjallë që nuk vdes; e gjithë mirësia është në Dorën e Tij; Dhe Ai është i Gjithëfuqishëm mbi gjithçka; Dhe me Të, të gjitha gjërat e kanë fundin e tyre".[297]

Këtë *tehlil* madhështor dhe këtë teuhid të madhërishëm i cili mban Emrin më të Madh -sipas një rrëfenje- e ka demonstruar në mënyrë të hollësishme dhe aq të qartë si dielli -Letra e Njëzet- në njëmbëdhjetë fjalët prej fjalëve të saj dhe në njëmbëdhjetë argumentet prej argumenteve të domosdoshmërisë së ekzistencës së Tij xh.sh. dhe të Unitetit të Hyjnisë së Tij; si dhe solli njëmbëdhjetë sihariqe e lajme të

[297] Buhariu, Adhan 155

gëzueshme.

Po, unë e përsërisja këtë fjali të shenjtë me reflektim të thellë duke menduar të shkruaja një përmbledhje të shkurtër të Letrës së Njëzet; papritmas më erdhi në zemër: Mësoja këtë përmbledhje konçize Nadir Hoxhës dhe të rinjve këtu. Kështu, duke thënë "*Bismil-lah..." Në Emrin e Allahut*... fillova ta japë mësim:

Kjo fjali duke demonstruar Unitetin Hyjnor përmban njëmbëdhjetë Sihariqe dhe njëmbëdhjetë prova prej të vërtetave të besimit. Për tani, unë do të tregoj shkurtazi vetëm provat duke ua referuar shpjegimet e tyre më të detajuara dhe sihariqet e tyre Letrës së Njëzet dhe pjesëve të tjera të Risale-i Nurit.

Megjithatë, unë e shoh të përshtatshme të shkruaj këtu ca pika që nuk ua kam treguar të burgosurve kur po e shkruaja këtë mësim.

Dhe kështu, njëmbëdhjetë fjalët prej asaj Fjale Njësie janë sa vijon:

Fraza: *la ilahe il-lall-llahu*, *Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.*

Prova e besimit në këtë fjali është trajtesa "El-Ajetul Kubra", e cila është botuar. Për shkak se ajo është një vepër e jashtëzakonshme e pashoqe, në njoftimet e pjesëve të ndryshme të Risale-i Nurit, Imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij, tha: "...Dhe për hir të trajtesës El-Ajetul Kubra më mbro mua nga vdekja e befasishme", dhe duke e bërë atë trajtesë –El-Ajetul-Kubra një ndërmjetësuese, nëpërmjet fitoreve të trajtesës në gjykatat e Ankarasë dhe të Denizlit dhe përhapja e tij në mënyrë efektive dhe të fshehtë, kjo ishte arsyeja që studentët e Risale-i Nurit të merrnin pafajësinë, dhe meqenëse botimi i saj në mënyrë të fshehtë bëri që studentët e Risale-i Nurit të burgoseshin për nëntë muaj, kjo në mënyrë të qartë afirmoi parashikim me keramet të Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe lutjen e tij për studentët e Risale-i Nurit.

Po, Rrezja e Shtatë, *El-Ajetul Kubra*, ka shfaqur tridhjetë e tre Unanimitete të mëdhaja dhe prova universale në të gjitha qëniet. Duke aluduar për dëshmi të panumërta në secilën provë universale, ajo së pari provon se qiejt tregojnë ekzistencën e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm dhe unitetin me fjalët e yjeve; toka me frazat dhe me fjalitë e kafshëve dhe të bimëve; dhe kështu me rradhë, derisa Universi si një tërësi, me fjalët e të gjitha përmbajtjeve dhe të qënieve të tij, dhe me të vërtetat e mundësisë, të krijueshmërisë dhe të ndryshimit -ajo i provon ato aq qartë si qartësia e ditës. Ata të cilët dëshirojnë një besim të palëkundur dhe që kërkojnë një shpatë të pathyeshme për të luftuar pafesinë dhe anarkinë duhet t'i referohen trajtesës "*El-Ajetul Kubra*".

Fraza e Dytë: ***Vahdehu****, Ai është Një.*

Një tregues konçiz i provës në këtë frazë është sa vijon:

Në çdo aspekt të Universit një Unitet, një njësi, është e dukshme. Për shembull, Universi shfaq një unitet dhe njësi nëpërmjet qënies së tij si një qytet i sistemuar, si një pallat madhështor, si një libër kuptimplotë i materializuar, dhe si një Kur'an i mishëruar çdo vërset i të cilit, çdo shkronjë dhe madje çdo pikë në të është një mrekulli dhe një Kur'an i mishëruar. Gjithashtu meqenëse llampa e pallatit është një dhe e njëjta, dhe kandili që tregon kohët është gjithashtu një dhe i njëjti, dhe kuzhinieri i tij i flaktë... është i njëjti, dhe spërkatësi i tij me ujë... është i njëjti, dhe kështu... një... një... një deri në një mijë... dhe qindrat e mijëra gjërave që ai përmban janë të gjitha një dhe e njëjta, atëherë ai provon në mënyrë vendimtare se pronari, sunduesi, shkruesi dhe autori i pallatit, i qytetit, i librit dhe i Kur'anit të mishëruar është ekzistues, Një dhe i Vetëm.

Fraza e Tretë: ***la sherike lehu****, Ai nuk ka shokë.*

Një tregues i shkurtër i provës në këtë është sa vijon:

Vërseti sublim.

"Thuaju: "Po të kishte pasur zota e perëndi të tjerë bashkë me Të, siç thonë ata, atëherë ata sigurisht që do të kishin kërkuar të gjenin një rrugë drejt Zotit të Arshit..." është burimi i Rrezes së "*El-Ajetul Kubra*", profesori dhe baza e saj. Domethënë, në qoftë se Allahu do të kishte pasur ndonjë ortak, dhe të tjerët të kishin ndërhyrë në krijim dhe në Hyjninë e Tij, rregulli i universit do të kishte qenë prishur". Por rregulli i përkryer në çdo gjë, të vogël e të madhe, të pjesshme dhe universale, duke filluar nga krahu i mizës më të vockël dhe prej qelizës së vockël të bebes së syrit dhe duke përfunduar tek zogjt e panumërt që fluturojnë në ajër dhe tek sistemi diellor, ky rregull i përkryer jep dëshmi e prova të sigurta e vendimtare për pamundësinë dhe mosekzistencën e asnjë ortaku të atillë. Gjithashtu ai dëshmon në mënyrë të pakundërshtueshme për ekzistencën dhe Unitetin e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm.

Fraza e Katërt: ***Lehul Mulku****, e Tij është e gjithë prona.*

Një tregues konçiz i një prove të gjatë të përfshirë në këtë frazë:

Ne shohim me sytë tonë se prapa perdes së të padukshmes ndodhet Pronari i një fuqie absolute dhe i një njohjeje të pakufishme i Cili e ka bërë faqen e tokës një tokë të lërueshme aq të gjërë sa gjërësia e vetë

tokës; dhe në çdo pranverë mbjell në të farëra që janë më shumë se sa njëqind mijë lloje bimësh, i përhap ato të gjitha së bashku dhe të përziera me njëra-tjetrën, dhe pastaj i mbledh të korrat e tyre në mënyrë të dallueshme pa qenë të përziera dhe pa ngatërresë dhe me rregull të plotë; dhe nëpërmjet dorës së mëshirës dhe të urtësisë ua shpërndan ato të korra dyqind mijë llojeve të bimëve dhe të kafshëve duke ua dhënë ushqimin -furnizimin- e përshtatshëm e të caktuar sipas nevojës së tyre. Ai i kryen këto akte të mëdhaja në pronat e Tij të gjëra e të pasura, dhe veçanërisht në faqen e tokës. Atëherë, ata që nuk e besojnë këtë Drejtues të Gjithurtë dhe Pronarin Mëshirëplotë, do të detyroheshin të mohonin edhe këtë tokë bashkë me të korrat e saja, dhe do të ishin si sofistët idiotë.

Fraza e Pestë: ***Velehul Hamdu****, Atij i takon lavdërimi.*

Ky është tregues shumë i shkurtër për pikërisht provën e shtrirë të përfshirë në këtë frazë: Po, ne shohim me sytë tonë dhe kuptojmë qartë me mendjet tona deri në limitin e të qenurit e vetëkuptueshme se, "Një Furnizues Mëshirëplotë dhe një Mirëbërës Gjithëbujar sundon dhe drejton çështjet e qytetit të universit, kujdeset për çështjet e lagjes së tokës dhe zhvillon e rrit fushimin -kampingun- e njerëzve dhe të kafshëve. Madje Ai e ka tranformuar tokën në një anije tregtare, dhe në një tren për të sjellë furnizimet ushqimore me qëllim që mirësitë e Tij të panumërta të falënderohen e të lavdërohen; dhe duke e bërë pranverën si një vagon treni të mbushur me njëqind mijë lloje ushqimesh; dhe i mbush kraharorët, të cilët u ngjasojnë kutiave të konservave, me qumësht të shijshëm për t'ua dërguar krijesave të gjalla të nevojshme, racionet e të cilave janë sosur në fund të dimrit. Kushdo që ka sa një grimcë mend, do të besonte padyshim se kjo çështje sigurisht është prej veprave të një Furnizuesi Mëshirëplotë. Dhe ai që nuk e beson këtë dhe shmanget duke rënë në mohim është një idiot, një kafshë e humbur, meqë atëherë ai do të detyrohej t'i mohonte të gjitha mirësitë e rregullta dhe ushqimet e veçanta në faqen e tokës, të cilat janë shkak për të dhënë lavdërime e falënderime.

Fraza e Gjashtë: ***Juhji****, Vetëm Ai jep jetë.*

Një aluzion tej mase i shkurtër për provën në këtë frazë:

Po, është provuar në Fjalën e Dhjetë dhe në pjesët e tjera të Risale-i Nurit se në çdo pranverë në faqen e tokës një ushtri e lavdishme ngrihet duke ardhë në jetë; ajo përbëhet prej treqind mijë lloje speciesh të qënieve të gjalla të një shumëllojshmërie të pafundme. Me anëtarët e saj të panumërt, të gjithë atyre u jepen jetët dhe pajisen me gjërat e

domosdoshme me rregull të plotë e me sistem të përkryer, gjë e cila na shfaq neve njëqind mijë modele nga modelet e Ringjalljes më të madhe, madje na shfaq shenjat e saj. Të gjitha ato krijesa të panumërta të ndryshme të cilat janë të përziera, e të ngatërruara me njëra-tjetrën dhe bashkë vijnë në jetë me drejtpeshim të përkryer, me rregull dhe pa gabim, pa harresë dhe pa mangësi, pa konfuzion, dhe i dallon ato pavarësisht përzierjes së tyre, dhe duke mos neglizhuar asnjërin prej tyre. Ato qindra mijëra specie kafshësh me anëtarët e tyre të panumërt, të cilët që të gjithë ndryshojnë për sa i përket formave të tyre, artit dhe mjeteve të tyre të jetesës, vijnë në jetë nga pikat e lëngut e quajtur spermë, i cili i gjithi është i ngjashëm, nga farërat që i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe nga kokrrat e vockëla të insekteve të cilat të gjitha janë të ngjashme, dhe nga lëngu dhe vezët e zogjve të cilat janë ose të njëjtat ose vetëm ndryshojnë pak nga njëra-tjetra. Po, Ai që e realizon këtë është vetëm Krijuesi i Gjithëditur dhe është Jetëdhënësi dhe i Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi i Përhershëm, i Cili i shkruan njëqind mijë libra të ndryshëm nga njëri-tjetri në faqen e tokës dhe në pranverë dhe i shkruan bashkarisht, të ndërfutur, pa gabim, me një shkrim të përkryer; dhe vepron me autoritet sipër tyre me një përkujdesje të pakufishme dhe punon në to me një urtësi të pafundme... ai person që nuk do ta besonte këtë, padyshim që do të detyrohej të mohonte vetveten dhe t'i mohonte të gjitha qëniet e gjalla të shpërndara në të gjithë tokën dhe të lidhura me spangon -shiritin- e kohës në të gjitha stinët e pranverave të shkuara dhe që gjenden në fytyrat e tokës së gjallë dhe në hapësirën e gjallë; dhe ai vetë do duhej të ishte më idioti dhe më fatkeqi i krijesave të gjalla.

Fraza e Shtatë: ***Ve Jumitu****, Ai shkakton vdekjen.*

Një tregues shumë i shkurtër i provës së përfshirë në këtë frazë:

Në vjeshtë kur treqind mijë speciet e krijesave të gjalla janë duke u shkarkuar prej detyrave të tyre nën emrin e vdekjes, çdo lloj dhe çdo anëtar i tyre i lënë farërat e tyre amanet tek Dora e Urtësisë së Gjithëruajtësit të Gjithëlavdishëm, ato farëra të cilat janë si kutia të fletëve të punëve të tyre, si indekse të aktiviteteve të tyre dhe listat që do t'i përmbushin në pranverën e ardhshme; ato i ngjasojnë shpirtit të tyre të qëndrueshëm nga njëri aspekt –ashtu si farat shumë të vockëla të pemës së fikut të cilat i mbajnë të gjitha ligjet që sundojnë në jetën e pemës së tyre, dhe secila prej tyre është si një shpirt i pavdekshëm i saj- ku në të Krijuesi i Gjithurtë, i Gjalli që nuk vdes, shkruan me penën e Kaderit -si shkrimi në fuqinë e memories- historinë e jetës së pemës dhe sikur ajo të ishte një libër i madh... Atëherë ai person që

nuk e beson këtë Krijues të Gjithurtë, të Gjallin e Përjetshëm i Cili nuk vdes, një person i tillë sigurisht nuk do të ishte vetëm një idiot dhe një kafshë e dalldisur, por gjithashtu më fatkeq se shejtani me të cilin mbahet i ndezur zjarri i Xhehennemit, dhe do të dënohet me vdekje të përjetshme.

Po, këto akte që u përmendën dhe të cilat tregojnë provat e këtyre frazave janë akte të urta universale e gjithëpërfshirëse që përfshijnë çudira e mrekulli të panumërta -këto akte- nuk mund të jenë kurrë pa Atë që i realizoi ato; përndryshe, kjo do të ishte një pamundësi e njëqindfishtë dhe një kotësi absolute; t'ua atribuosh ato shkaqeve të verbëra, të pafuqishme, të pavetëdijshme, të vdekura, të pajeta, të ngatërruara, të çrregullta dhe të papërmbajtura, është e pamundur një mijë herë, e papranueshme dhe krejtësisht e pabazë.

Në qoftë se ato çështje të urta do t'i atribuoheshin dikujt tjetër, veç Vepruesit të Gjithurtë, atëherë do të duhej të ekzistonte një fuqi absolute dhe një mjeshtëri e përkryer lidhur me formëdhënien e të gjitha bimëve dhe luleve në çdo grimcë të dheut, dhe çdo molekulë e ajrit duhej të posedonte aftësinë për t'i njohur të gjitha ligjëratat dhe të gjitha fjalët e folura nëpër radio e telefonë, dhe për t'ua mësuar ato edhe molekulave të tjera.

Madje asnjë shejtan nuk do të mundte të bënte ndokënd që ta pranonte një ide të tillë të jashtëzakonshme.

Dënimi për mosbesimin dhe për mohimin, janë kaq larg prej arsyes dhe realitetit dhe përbëjnë fyerje dhe agresion kundra të gjitha qënieve, -ai dënim- do të mund të ishte vetëm se zjarri i tmerrshëm i Xhehennemit, që është thjesht drejtësi e pastër. Ne sigurisht duhet të themi: Le të jetojë Ferri për këta mohues!

Fraza e Tetë: ***Ve Huve Haj-jun La jemut****, Ai është i gjallë që nuk vdes.*

Një tregues tej mase i shkurtër i provës në këtë frazë është ky:

Diejt e vegjël që shihen për shembull, gjatë ditës në flluskat e sipërfaqes së detit dhe mbi faqen e lumit rrjedhës, zhduken me largimin e atyre flluskave, dhe flluskat që vijnë pas tyre i shfaqin të njëjtët diej si ato të mëparshmet; dhe me këtë ato tregojnë diellin që është në qiell dhe dëshmojnë për të. Dhe me zhdukjen dhe me vdekjen e tyre ato tregojnë për ekzistencën e një dielli të vazhdueshëm e të përjetshëm. Gjithashtu krijesat në sipërfaqen e detit gjithmonë të ndryshueshëm të Universit, dhe në hapësirën e pafundme që përtëritet gjithnjë, në fushën e lërueshme të grimcave të vockëla, dhe në lumin e

kohës, i cili me rrjedhjen e tij i tërheq të gjitha qëniet kalimtare dhe i përfshin tek vetja e tij, qënie të cilat në mënyrë të vazhdueshme e shpejt rrjedhin dhe largohen; dhe vdesin së bashku me shkaqet e tyre të jashtme. Në çdo ditë, dhe në çdo vit, një univers vdes dhe një tjetër i ri vjen në vend të tij, dhe në mënyrë të vazhdueshme vdesin botërat udhëtuese dhe universet rrjedhës në fushën e grimcave pasi të merren prodhimet prej tyre.

Dhe ashtu siç tregojnë flluskat dhe diejt e vegjël me zhdukjen e tyre diellin e përjetshëm, po ashtu vdekja e atyre krijesave të panumërta dhe zhdukja e atyre prodhimeve dhe shkarkimi i tyre së bashku me shkaqet e tyre të jashtme tregojnë me qartësi e me siguri të plotë si dita dhe si dielli në mesditë për domosdoshmërinë e ekzistencës së të Gjallit që nuk vdes, për Diellin e Përjetshëm, për Krijuesin e Pavdekshëm, për Urdhëruesin Më të shenjtë, për Unitetin e Tij dhe për ekzistencën e Tij. Të gjitha qëniet dëshmojnë për këto një mijë herë në mënyrë më të qartë e të sigurtë se sa ekzistenca e vetë universit. Tani sigurisht që ju keni kuptuar se sa i shurdhët, idiot dhe i dëmshëm është dikush që nuk i dëgjon këto zëra të lartë dhe këto dëshmi të fuqishme që mbushin universin, dhe që nuk u kushton vëmendje atyre.

Fraza e Nëntë: ***Bijedihil Hajr****, E gjithë mirësia është në Dorën e Tij.*

Një tregues i shkurtër i provës i përfshirë në këtë frazë është sa vijon:

Ne shohim në çdo sferë të universit, në çdo botë të qënies, në çdo nivel të tij, në çdo individ të tij, në çdo anëtar, dhe madje në çdo qelizë të trupit të tij, shohim që secila prej tyre posedon një magazinë ose depo duke përfshirë furnizimet e saj rezervë me ushqime, posedon një fushë të lërueshme ose një thesar duke prodhuar e ruajtur të gjitha domosdoshmëritë e saj. Sepse mu në kohën e duhur, me rregull e drejtpeshim të plotë, me urtësi e përkujdesje të plotë, të gjitha domosdoshmëritë u jepen atyre qënieve të nevojshme nga një Dorë e fshehtë, jashtë fuqisë dhe vullnetit të tyre. Për shembull, malet përmbajnë të gjitha mineralet dhe kimikatet e domosdoshme për njeriun dhe për qëniet e gjalla, dhe gjërat e domosdoshme për jetën. Ato janë thesare e depo të mbushura në mënyrë të përkryer nëpërmjet Urdhërit dhe planit të një të Vetmi.

Ashtu si toka që është një fushë e lërueshme, një lëmë dhe një kuzhinë që përgatit ushqimet e të gjitha gjallesave me rregull e me

drejtpeshim të plotë duke e realizuar atë me fuqinë e Furnizuesit të Gjithurtë, madje tek çdo njeri dhe tek çdo gjymtyrë prej gjymtyrëve të tij është një depo dhe një thesar për ruajtje, madje tek çdo qelizë e trupit gjithashtu ndodhet një depo e vogël që u përshtatet depove rezervë të furnizimeve... Dhe kështu në çdo qënie ka një magazinë; madje edhe magazina e botës së Ahiretit është banesa e dynjasë, dhe fusha dhe depoja e Xhennetit është bota islame dhe humanizmi i vërtetë, i cili prodhon të mirën, bukurinë dhe dritat e kësaj bote. Dhe një depo prej depove të Xhehennemit janë lëndët e prishura dhe grupet e ndotura të kësaj bote, të cilët vijnë nga mosekzistenca, të cilat janë të këqija dhe prodhojnë të këqijat, gjërat e shëmtuara dhe mosbesimin, dhe të cilët ndotin botërat e ekzistencës, që janë të mira. Dhe depoja e nxehtësisë së yjeve dhe burimi i saj është Ferri; ndërsa thesari i dritave i tyre dhe burimi i tyre është Parajsa. Atëherë duke aluduar për të gjithë ato thesare të panumërt, fraza "*E gjithë mirësia është në Dorën e Tij*", demonstron një provë shumë të ndritshme.

Po, kjo frazë, së bashku me frazën, "*Në Dorën e Tij janë çelësat e të gjitha gjërave*", tregojnë për atë që nuk është krejtësisht i verbër dy prova për Hyjninë dhe Unitetin, gjërësia e të cilave është e pafundme; dhe ato të dyja janë çudira dhe mrekulli të pakufishme. Për shembull, shiko vetëm sa vijon prej atyre thesareve e depove të pafundme: Rregulluesi i Gjithurtë, Pronari i Çelësave të farërave dhe të bërthamave, i atyre depove të vockëla që secila prej tyre përfshin anëtarët dhe destinacionet e pemës së madhe ose të lules së ndritur, ashtu siç zgjon dhe e hap derën e vockël të farës me urdhrin e Tij 'zgjohu' dhe me Çelësin e Vullnetit të Tij, me rregull e me drejtpeshim të plotë, po ashtu Ai hap thesarin e madh të tokës me çelësin e shiut. Pa gabim Ai i hap të gjitha farërat, të cilat janë depot të vockëla dhe lëngu riprodhues i bimëve; të gjitha origjinat e kafshëve dhe të gjitha pikëlat që janë lëngu riprodhues i zogjve dhe i insekteve fluturues, lëng i cili përbëhet nga uji dhe ajri; Ai i hap ato të gjitha së bashku, pa gabim dhe këtë nëpërmjet marrjes nga ana e tyre urdhrin e hapjes dhe të zhvillimit... Allahu xh.sh. në të njëjtën kohë i hap të gjitha thesaret dhe depot e universit qofshin universale e të pjesshme, ose fizike dhe jofizike me një çelës të veçantë për secilën nëpërmjet Dorës së urtësisë, të vullnetit, të mëshirës dhe të dëshirës.

Në qoftë se dëshiron ta njohësh këtë dhe ta shohësh, hidhe vështrimin tek thesaret e tua të vogëla që janë zemra jote, truri yt, trupi yt dhe stomaku yt. Hidhe vështrimin tek kopështi yt dhe tek pranvera e cila është lulja e tokës dhe tek lulet dhe frutat e saj. Ai xh.sh. i hap ato me një dorë të padukshme me çelësa të dallueshëm e të ndryshëm që

vijnë nga fabrika e ***Kun Fejekun*** *"Bëhu! Dhe ajo bëhet (në çast)"* i hap me rregull të plotë dhe me drejtpeshim me mëshirë dhe me urtësi. Ajo Dorë e fshehtë nxjerr pesha të mëdha ushqimesh nga një kuti e vockël që peshon më pak se një ons (peshë) dhe ua paraqet ato krijesave të gjalla si një gosti e madhe.

A do të ishte e mundur që forca e verbër, natyra e shurdhët, rastësia e pasynim apo shkaqet e pajeta, injorante e të pafuqishme të ndërhynin në një akt të tillë të pafundmë, i cili çon në këtë shkallë rregulli, njohjeje dhe intuite, dhe në një mjeshtëri të hollë arti me urtësi të plotë që rastësia nuk do të mund t'i afrohej kurrë (një akti të tillë), në një autoritet të drejtpeshuar në të cilin nuk ka absolutisht asnjë gabim, dhe në një Hyjni Madhështore e të drejtë me drejtësi të plotë në të cilin nuk ka aspak padrejtësi?

A do të ishte e mundur për atë që nuk i sheh të gjitha gjërat përnjëherësh dhe që nuk mundet t'i drejtojë ato përnjëherësh, dhe që nuk i vë të gjitha grimcat, planetët dhe të gjitha yjet së bashku nën urdhërin e tij dhe të ndërhynte në këtë administrim dhe drejtim të çështjeve të cilat në të gjitha anët janë me urtësi, me mrekulli dhe me ekuilibër?

Dhe kështu, ai njeri që nuk beson një Rregullues të këtillë të punëve, Rregullatorin Mëshirëplotë, dhe Zotin e Gjithurtë në Dorën e të Cilit është e gjithë mirësia, i Cili ka Çelësat e të gjitha gjërave, ai do të ishte krejtësisht i çudhëzuar, i rënë në mohim; *"*Ai nuk ka tjetër përveç zjarrit "Ferrit", i cili zemërohet e tërbohet ashtu siç deklaron vërseti, *"Ai (zjarri) pothuaj shpërthen me vrull".* Xhehennemi -Ferri- thotë me gjuhën e gjendjes së tij: "Ai e meriton ndëshkimin tim të përjetshëm sepse ai nuk është i denjë për mëshirë."

Fraza e Dhjetë: ***Ve Huve Ala Kul-li Shej'in Kadir****, Dhe Ai është i Gjithëfuqishëm mbi gjithçka.*

Një tregues tej mase konçiz i provës i përfshirë në këtë frazë është sa vijon: Sapo të vijë çdo krijesë e vetëdijshme në këtë bujtinë të kësaj bote dhe i hap sytë e saj, shikon se një fuqi mban në kapjen e saj të gjithë universin dhe prej asaj fuqie janë një njohje e parapërjetshme dhe gjithëpërfshirëse e cila kurrë nuk ngatërron asgjë, dhe një urtësi shumë e saktë dhe një përkujdesje e madhe të cilat kurrë nuk veprojnë pa qëllim dhe pa drejtpeshim. Dhe ashtu siç e bën -ajo Fuqi- çdo individ të ushtrisë së grimcave të tërhequr në ekstazë si një dervish Mevlevi dhe e përdor atë në detyra të shumta, po ashtu në të njëjtën kohë dhe në përputhje me të njëjtin ligj, i shkakton globit tokësor të

udhëtojë duke përshkuar në një vit distancën e njëzet e katër mijë viteve, përsëri si një Mevlevi ashik.

Dhe në të njëjtën kohë dhe në përputhje me të njëjtin ligj, nëpërmjet të cilit ajo u dërgon njerëzve dhe kafshëve prodhimin e stinëve, ajo e bën diellin si një sovajkë ose si një çikrik i tjerrëses, dhe duke e lëvizur atë gjithashtu në qendrën e tij si një ashik në ekstazë, duke i nështruar planetët të cilët janë individët e ushtrisë së sistemit diellor e duke i përdorë në shërbime e në detyra të mëdha me rregullsi dhe ekuilibër të plotë.

E njëjta fuqi shkruan me të njëjtin ligj të urtësisë dhe në të njëjtën kohë qindra mijëra lloje në të gjithë faqen e tokës, dhe secili prej atyre llojeve janë si qindra e mijëra libra, i shkruan ato bashkarisht dhe të ndërfutur, pa ngatërresë dhe pa harresë duke shfaqur me të mijëra modele të Ringjalljes më të madhe.

Dhe e njëjta fuqi, në të njëjtën kohë e transformon fletën e ajrit në një tablo fshirjeje dhe ripohimi duke i bërë të gjitha grimcat e tij sikur të ishin majat e penës së atij libri dhe pikat e tij; duke i përdorë ato në detyra të shumta brenda asaj që ka përcaktuar Urdhri dhe dëshira Hyjnore, madje ajo u ka dhënë aftësi secilës prej atyre grimcave me qëllim që t'i marrë të gjitha fjalët dhe ligjëratat sikur ajo t'i njihte të gjitha ato dhe i transmeton ato pa gabim; ajo e përdor secilën prej tyre sikur të ishte një vesh i vockël dhe një gjuhë e vockël, duke provuar se ai element i ajrit është një fron i Urdhrit dhe i Dëshirës Hyjnore. Dhe kështu sipas këtij treguesi të shkurtër: Ai i Cili e bëri universin si një qytet të mirërregulluar, si një pallat madhështor, si një bujtinë të lulëzuar, si një libër të mrekullueshëm dhe si një Kur'an, të qartë, dhe i Cili me Fuqinë e tij mban në kapjen e Tij me balancën e njohjes dhe me rregullin e urtësisë të gjitha nivelet e krijesave, botërat dhe grupet e tyre duke filluar nga grimcat e tyre dhe duke përfunduar tek tërësia e të gjithë universit; Ai i drejton çështjet e tyre, vepron me autoritet sipër tyre dhe shfaq brenda asaj fuqie madhështore urtësinë e tij të madhe dhe mëshirën e Tij të gjërë dhe shpall brenda Hyjnisë së Tij absolute dhe bën të njohur ekzistencën e Tij dhe Unitetin e Tij në mënyrë më të qartë se sa dielli në mes të ditës. Dhe kundrejt bërjes së Tij të njohur kërkon të njohurit me Të nëpërmjet besimit, dhe kundrejt bërjes së vetes së Tij të dashur kërkon dashurinë për Të nëpërmjet ibadetit; dhe kundrejt mirësive të Tij kërkon falënderime e lavdërime ndaj Tij.

Ata të cilët nuk e njohin këtë të Gjithëmëshirshëm Mëshirëplotë dhe të cilët nuk përpiqen ta duan Atë nëpërmjet adhurimit, por çudhëzohen duke rënë në mohim dhe ushqejnë një lloj armiqësie ndaj

Tij... këta nuk janë tjetër veçse shejtanë në forma njerëzore, dhe janë si nimrudë dhe faraonë të vegjël. Nuk ka dyshim se ata meritojnë një ndëshkim të përjetshëm të pafund.

Fraza e Njëmbëdhjetë: ***Ve Ilejhil Mesir****, Dhe me Të, të gjitha gjërat e kanë fundin e tyre.*

Domethënë, fundi është për tek sfera e pranisë së Tij xh.sh., dhe për tek bota e Tij e qëndrueshme, dhe për tek banesa e Ahiretit të Tij, dhe për tek vendbanimi i lumturisë, ashtu siç është Ai tek prania e të Cilit do të kthehen të gjitha krijesat e universit; ato mbështeten tek Ai, dhe i referohet fuqisë së Tij i gjithë zinxhiri i shkaqeve, duke ditur se shkaqet janë perde që janë vënë para akteve të asaj fuqie, me qëllim që të mbrohet dinjiteti dhe krenaria e saj e shenjtë. Atëherë të gjitha shkaqet e jashtme janë thjesht perde dhe nuk kanë aspak efekt në krijim. Po të mos ishin urdhëri dhe dëshira e Tij xh.sh. nuk do të mundej -as edhe grimca- të lëvizte.

Një tregues shumë i shkurtër i provës i përfshirë në këtë frazë është sa vijon:

Së Pari: Ne ju referojmë juve Fjalën Dhjetë dhe shtojcën e saj, Fjalën e Njëzet e Nëntë, Çështjen e Shtatë të Frutave të besimit, Rrezen e Tretë dhe trajtesat e Risale-i Nurit rreth besimit.

Në të vërtetë ato trajtesa e kanë provuar këtë shtyllë të besimit me prova të pafundme, ato madje i detyrojnë edhe mohuesit më kryeneçë që të pranojnë që ekzistenca e Ahiretit është aq e sigurt si ekzistenca e kësaj bote.

Së Dyti: Një e treta e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm shikon tek Ringjallja e të vdekurve dhe tek Ahireti; dhe i ndërton të gjitha pretendimet e tij mbi atë realitet. Prandaj, ashtu si të gjitha mrekullitë e Kur'anit dhe argumentet e tij, të cilat provojnë vërtetësinë e tij -Kur'anit-, tregojnë për ekzistencën e Ahiretit, po ashtu të gjitha mrekullitë e profetit që dëshmojnë për vërtetësinë e profetësisë së tij, dhe të gjitha dëshmitë e profetësisë së tij dhe të gjithë argumentat e vërtetësisë së tij dëshmojnë për Ahiretin dhe ringjalljen; sepse çështja më e madhe për tek e cila bëri ftesë ai profet fisnik gjatë gjithë jetës së tij ishte Ahireti, ashtu siç bënë ftesë njëqind e njëzet e katër mijë pejgamberë a.s. për tek jeta e amshuar dhe tek lumturia e përjetshme, e sihariquan njerëzimin për të dhe provuan vërtetësinë e pretendimeve të tyre me prova të sigurta dhe me mrekulli të panumërta.

Nuk ka dyshim se të gjitha mrekullitë e tyre dhe provat e tyre që tregojnë profetësinë e tyre në pretendimet e tyre gjithashtu dëshmojnë

për Ahiretin dhe për jetën e qëndrueshme të cilat janë pretendimet e tyre më të mëdhaja dhe më të vazhdueshme.

Duke bërë analogji me këtë, të gjitha provat që provojnë shtyllat e tjera të besimit dëshmojnë për ndodhjen e Ahiretit dhe për hapjen e dyerve të banesës së lumturisë së përjetshme.

Së Treti: Krijuesi i këtij universi i Cili i krijoi të gjitha grimcat e tij, planetët, pjesët dhe nivelet duke i caktuar secilës prej tyre një detyrë, por detyra të shumta me urtësi të plotë dhe duke i nështruar vazhdimisht dhe duke shfaqur plotësinë e Tij, fuqinë e Tij dhe Hyjninë e Tij. Dhe Ai i Cili i dërgon grupet e krijesave karvan pas karvani, madje botë pas bote ripërtëritëse udhëtuse për tek bujtina e kësaj dynjaje dhe për tek fusha e provimit të kësaj jetës së dynjasë me qëllim që të shfaqë manifestimet e pafundme të Emrave të Tij të bukur të përjetshëm dhe që të marrë të gjitha imazhet e atyre krijesave, aktet dhe gjendjet e tyre me kamerat e botës së Ndërmjetme dhe për kinematë e Ahiretit të ngritura në botën e Shëmbëllesës. Dhe pasi t'i lirojë ato i dërgon grupet e tjera karvan pas karvani, madje dërgon një lloj prej botërave rrjedhëse dhe udhëtuese për tek ajo fushë, me qëllim që t'i përmbushin ato detyra dhe të jenë pasqyra për manifestimet e Emrave të Tij. Prandaj a do të ishte e mundur për këtë Krijues Hirplot, për Autorin e Gjithëlavdishën, Allahun Zotërues të Plotësisë që të mos bënte banesë shpërblimi dhe ndëshkimi? Dhe të mos realizonte ringjalljen më të madhe dhe gjyqin e fundit për njerëzit, të cilët me vetëdije dhe me mend ju përgjigjen në këtë botë kalimtare të gjitha qëllimeve të Krijuesit, duke e dashur Atë me të gjithë kapacitetin e tyre dhe duke e bërë Atë t'i dojë ata; duke e njohur Atë dhe duke e bërë Atë të njohur; duke kërkuar me dua të pafundme lumturinë e përjetshme në Ahiret; dhe meqenëse, duke poseduar inteligjencë, ata vuajnë vuajtje të pafundme, mallëngjehen për jetën e përhershme, e cila është kënaqësi e pastër, me të gjitha qëniet e tyre, shpirtërat dhe kapacitetet e tyre; -a do të ishte e mundur që të mos ketë ky njeri shpërblim dhe dënim? Ruajna Zot! Një mijë herë Ruajna Zot!

Meqenëse këta tregues të shkurtër janë provuar e shpjeguar në mënyrë të ndritshme të fuqishme dhe të detajuar në Risale-i Nur, ne ju referojmë juve atje dhe e presim shkurt këtu këtë histori të gjatë.

"Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që Vetëm Ti je i Gjithëdituri i Gjithurti".[298]

[298] Kur'an, 2 :32

Një përmbledhje e shkurtër e Sures el-Fatiha

[Pjesa e Dytë e mësimit të vetëm që unë e dhashë pasi u trasnferova përkohësisht prej burgimit të vetmuar në shkollën e Tretë të Jusufit për tek shoqërimi i tjerëve.]

Ky është një shembull i shkurtër i mësimeve të dhëna për studentët e Risale-i Nurit në burg:

Ndërsa duke recituar suren *el-Fatiha* gjatë namazeve, ajo më urdhëroi mua të shpjegoja një pikë prej oqeanit të saj dhe një shkreptimë të vetme prej shtatë ngjyrave në dritën e diellit të saj. Sigurisht ne i kemi shkruar disa pika të holla shumë të këndshme dhe të ëmbëla prej këtij thesari të shenjtë të Kur'anit, pjesërisht në letrën e Njëzet e Nëntë dhe veçanërisht në udhëtimin imagjinar në "*Nunin*" e "*Naëbudu*", në trajtesën *"*Tetë Simbolet" dhe në komentin Kur'anor të titulluar "Shenjat e mrekullisë" si dhe në pjesë të tjera të Risale-i Nurit. Por ama unë u detyrova -nga një këndvështrim- të shkruaja reflektimet e mia gjatë namazeve, por vetëm aluzionet për shtyllat e besimit dhe për provat e tyre nga pikërisht ajo përmbledhje e ëmbël e Kur'anit, në formën e një ekstrakti të përmbledhur dhe në mënyrën e Pjesës së Parë lart. Kështu duke ia referuar frazën *"Bismil-Lahir-rahmanir-Rahim"* dy ose tre trajtesave të Risale-i Nurit, unë po filloj me "*El-Hamdu Lil-Lahin".*

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve, "I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

*I Vetmi Zotërues (*Gjithëshikues) *i Ditës së Gjyqit (*Ditës së Ringjalljes*).*

Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë.

Drejtona në Rrugën e Drejtë.

*Në Rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar Mëshirën Tënde, jo (*në rrugën*) e atyre që merituan zemërimin Tënd mbi vete dhe as (*në rrugën*) e atyre të cilët humbën".*[299]

Fraza e Parë: *El-Hamdu lil-lahi, Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun.*

Një aluzion shumë i shkurtër për provën e të vërtetave të besimit në këtë frazë është:

Shkaku i dhënies së lavdërimeve dhe të falënderimeve në univers, janë mirësitë dhe favoret që vijnë me bollëk, në mënyrë të qëllimshme, dhe veçanërisht dërgimi i qumështit të pastër, të shijshëm dhe ushqyes ndërmjet gjakut dhe jashtëqitjes për të vegjëlit dhe për fëmijët e pafuqishëm; po ashtu janë edhe mirëbërësitë dhe dhuratat e qëllimshme, dhe nderimet dhe gostitë e mëshirshme të cilat kanë mbuluar të gjithë faqen e tokës; madje kanë mbuluar të gjithë universin. Çmimi për këto është të thuash ***Bismil-lah*** në fillim, dhe pastaj ***El-Hamdu lil-lah*** në fund; dhe midis tyre të perceptosh mirëbërësinë në vetë mirësinë dhe pastaj prej saj të arrish tek njohja e Zotit të Gjithëlavdishëm. Hidhe vështrimin tek pikërisht vetja jote, tek stomaku yt dhe tek shqisat e tua! Sa shumë të nevojshme janë ato për gjëra të shumta dhe për mirësi të bollshme! Sa shumë ushqime e kënaqësi kërkojnë ato me çmimet e lavdërimeve dhe të falënderimeve! Shikoje këtë dhe krahasoji të gjitha krijesat e gjalla me veten tënde.

Dhe kështu, lavdërimet e pafundme që afrohen me gjuhët e gjendjeve dhe të fjalëve kundrejt këtyre mirësive të gjithanshme tregojnë aq qartë si dielli për ekzistencën e një Hyjnie Universale të Një të Vetmi Unik i Cili është i Adhuruari, i Lavdëruari dhe Mirëbërësi Mëshirëplotë.

Fraza e Dytë: *Rabbil-A'lemine, Zotin e të gjitha botëve.*

Një aluzion shumë i shkurtër për provën e përfshirë në këtë frazë është: Ne shohim me sytë tonë se brenda universit nuk janë me mijëra, por me miliona botëra, universe të vegjël, shumica e tyre të ndërfutura njëra brenda tjetrës. Megjithëse kushtet për administrimin dhe drejtimin e këtyre janë të gjitha të ndryshme, ato organizohen, mbahen dhe administrohen në mënyrë aq perfekte, saqë ashtu si një fletë e vetme duke u mbajtur vazhdimisht para shikimit të Tij, universi ripërtërihet e ndryshohet, dhe ashtu si një rresht, secila prej atyre botërave shkruhet nga pena e fuqisë dhe e Kaderit të Tij. Shfaqen

---

Kur'an, 1:1-7

dëshmi universale e të pjesshme aq sa numri i grimcave dhe i qënieve që vijnë nga përbërja e tyre, dhe në çdo çast e moment, për domosdoshmërinë e ekzistencës dhe për unitetin e të gjitha botëve i Cili i drejton këto miliona botëra prej botërave dhe universeve udhëtues me një Hyjni absolute që Zotëron njohje dhe urtësi të pafundme dhe me një përkujdesje e mëshirë që përfshijnë çdo gjë. Të mos e vërtetosh, të mos e kapësh, të mos e kuptosh ose të mos e shohësh një Hyjni madhështore të Këtillë e cila i drejton dhe i organizon të gjitha gjërat duke filluar nga fusha e lërueshme e grimcave për tek sistemi diellor dhe për tek Rruga e Qumështit, dhe prej qelizës në trup për tek depoja e tokës dhe për tek i gjithë universi duke i administruar me të njëjtin ligj, me të njëjtën Hyjni dhe me të njëjtën urtësi, sigurisht kjo do ta bënte personin të meritojë dënim të pafundmë, dhe mohon vlefshmërinë e tij për të të ardhur keq për të -për ta mishëruar.

Fraza e Tretë: *Er-Rahmanir-Rahijm, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.*

Një aluzion shumë i shkurtër për provën në këtë frazë është: Po, ekzistenca dhe realiteti i një mëshire të pakufishme është aq e qartë dhe e dukshme në univers sa drita e diellit. Kjo mëshirë e gjërë dëshmon në mënyrë të sigurt –si dëshmia e ditës për diellin- për Një të Gjithëmëshirshëm Mëshirëplotë të fshehur pas perdes së të Padukshmes.

Po, një pjesë e rëndësishme e mëshirës është Rëzku –ushqimi-, meqë ai i jep kuptimin e ***Er-Rez-zak,*** *Furnizuesit* Emrit Hyjnor ***Er-Rahman,*** *i Gjithëmëshirshmi;* ajo mëshirë shprehet nga Emri Hyjnor **Er-*Rez-zak,*** *Furnizuesi*. Vetë rëzku -furnizimi me ushqime- e tregon Furnizuesin Mëshirëplotë në një mënyrë aq të qartë deri në atë shkallë saqë ai i cili do të kishte sa një grimcë vetëdije do të detyrohej ta vërtetonte dhe ta besonte.

Për shembull, Ai dërgon ushqim për të gjitha qëniet e gjalla, veçanërisht për të pafuqishmit dhe për të vegjëlit gjithandej tokës dhe atmosferës, në një mënyrë vërtet të çuditshme përtej dëshirave dhe fuqisë së tyre, nga asgjëja, nga farërat e ngjashme me njëra-tjetrën, nga pikat e ujit dhe nga kokrrat e tokës. Ai i bën zogjtë të kërkojnë ushqim dhe ua sjell atë zogjve të dobët e të pafletë, në foletë tek majat e pemës. Ai e nënshtron luaneshën e uritur ndaj drangut -këlyshit- të saj, saqë ajo nuk e ha mishin që e gjen por ua jep atë këlyshëve të saj. Ai e dërgon qumështin e këndshëm, ushqyes, të pastër e të bardhë, si uji i Keutherit, prej burimeve të kraharorëve për tek të vegjëlit e qënieve

humane dhe për tek të vegjëlit e kafshëve të tjera, pa u ndotur prej gjakut të kuq dhe prej jashtëqitjes së papastër, duke u dërguar gjithashtu edhe butësinë e dhembshurinë e nënave që t'u vijnë në ndihmë atyre; dhe këtë e realizon pa asnjë ngatërresë, pa gabim dhe pa ndotje. Dhe ashtu siç shpejtojnë e nxitojnë ushqimet e përshtatshme për tek të gjitha pemët e nevojshme për një lloj ushqimi -rëzku- në mënyrë të jashtëzakonshme, po ashtu Ai u dhuron një tryezë të shtrirë ushqimesh shqiseve të njeriut, të cilat kërkojnë ushqime fizike dhe jofizike, si dhe mendjes së tij, zemrës dhe shpirtit.

Është sikur universi të përbëhej nga qindra mijëra tryeza të shtruara prej çdo lloji varieteti të ndryshëm, të gjithë të ndërfutur e të mbështjellë njëri brenda tjetrit si petalet e trëndafilit, ose si mbulesat -lëvoret- e kallirit të misrit njëra sipër tjetrës. Me një shumësi të gjuhëve të ndryshme, të pjesshme dhe universale sa numri i tryezave dhe i ushqimeve që ato mbajnë dhe sa numri i mirësive të tyre, këto tregojnë për gjithësecilinn, i cili nuk është krejtësisht i verbër, të Gjithëmëshirshmin, Furnizuesin, Mëshirëplotin dhe Gjithëbujarin.

Në qoftë se do të thuhej: Fatkeqësitë, shëmtitë dhe të këqijat në këtë botë janë në kundërshtim me atë mëshirë gjithëpërfshirëse, dhe e prishin atë.

Përgjigjja: kësaj çështjeje i është përgjigjur në mënyrë të kënaqshme në pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit të tilla, si Trajtesa rreth Kaderit Hyjnor. Duke jua referuar juve ato, ne këtu do të japim vetëm një aluzion të shkurtër, sa vijon:

Të gjitha elementet, të gjitha botërat e qënieve, dhe të gjitha krijesat, kanë detyra të shumta, të pjesshme dhe universale dhe secila prej atyre detyrave fiton rezultate e fruta të shumtë. Shumica absolute e tyre janë rezultate të bukura, interesa të dobishme dhe mirësi e mëshira. Dhe një pjesë e pakët prej tyre bëhet e keqe dhe shëmti e pjesshme dhe e dukshme dhe padrejtësi për ata që kanë humbur aftësinë dhe që veprojnë gabimisht, ose për ata që meritojnë ndëshkim ose disiplinim, ose për ata që do të jenë mjet për të prodhuar filiza të shumta të së mirës. Në qoftë se mëshira do ta pengonte atë element dhe atë qënie universale nga kryerja e asaj detyre me qëllim që të pengohet ardhja e asaj të keqeje të pjesshme, atëherë nuk do të ndodhnin të gjitha rezultatet e të tjera të saj të mira e të bukura. Meqenëse mosekzistenca e një të mire është e keqe dhe prishja e bukurisë është e shëmtuar, atëherë të këqijat, shëmtitë dhe mizoritë do të ndodhnin sa numri i atyre rezultateve. Domethënë, do të kryheshin qindra të këqija e padrejtësi për të penguar ardhjen e një të keqeje të

vetme. Dhe kjo do të ishte krejtësisht në kundërshtim me urtësinë, dobinë dhe me mëshirën e Hyjnisë.

Për shembull, gjërat si bora, i ftohti, zjarri dhe shiu kanë qindra dobi e qëllime. Në qoftë se nëpërmjet zgjedhjes së tyre njerëzit e pakujdesshëm dhe të pamatur dëmtojnë vetvetet e tyre, për shembull në qoftë se ata i fusin duart e tyre në zjarr dhe thonë: Nuk ka mëshirë në krijimin e zjarrit, atëherë, dobitë e mira, të mëshirshme dhe të vlefshme të zjarrit të cilat nuk numërohen, do ta përgënjeshtronin atë dhe do t'i jepnin një goditje në gojë. Për më tepër, dëshirat vetjake të njeriut dhe emocionet janë të verbëra për pasojat, nuk mund të jenë kriter -masë- ose balancë e ligjeve të mëshirës, të Sovranitetit dhe të Hyjnisë të cilat janë në fuqi në univers. Ai i shikon gjërat në përputhje me ngjyrën e pasqyrës së tij. Zemra e errësuar dhe e pamëshirë e shikon universin si duke qarë, të shëmtuar, të errët, dhe tiranik. Por në qoftë se ai e shikon nëpërmjet syrit të besimit e gjen atë në formën e një njeriu të madh i veshur me shtatëdhjetë mijë mantele të bukur; e gjen gjithmonë duke qeshur e buzëqeshur me mëshirë. Dhe e shikon llojin njerëzor brenda tij si një univers të vogël, dhe çdo njeri si individ si një botë më e vogël, dhe thotë nga thellësitë e zemrës së tij dhe të shpirtit të tij:

Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve, I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. I Vetmi Zotërues (Gjithëshikues) i Ditës së Gjyqit!...

Fraza E Katërt: *Ma'liki Jeumid-din, i Vetmi Zotërues (Gjithëshikues) i Ditës së Gjyqit.*

Një tregues shumë i shkurtër i provës së përfshirë në këtë frazë është:

Së Pari: Të gjitha dëshmitë që tregojnë për Ringjalljen dhe Ahiretin dhe që dëshmojnë për provën e ***Ve ilejhil Mesir****, Dhe me Të, të gjitha gjërat e kanë fundin e tyre* në fundin e pjesës së parë të këtij mësimi, gjithashtu dëshmojnë për të vërtetën e gjërë të besimit të cilën e tregon ***Maliki Jeumid-din****, I Vetmi Zotërues (Gjithëgjykues) i Ditës së Gjyqit.*

Së Dyti: Ashtu si Hyjnia e Autorit të këtij kozmosi dhe Mëshira e Tij e gjërë, dhe urtësia e Tij e përjetshme; edhe bukuria e Tij, Madhështia e Tij, dhe Plotësia e Tij e Parapërjetshme dhe e paspërjetshme; edhe Atributet e Tij madhështore absolute dhe me qindra nga Emrat e Tij të bukur, që të gjithë këto sigurisht që kërkojnë Ahiretin –ashtu siç u tha në fundin e Frazës së Dhjetë- po kështu

profeti fisnik Muhammedi a.s.m. me qindra nga mrekullitë e provat e tij... edhe të gjithë profetët e tjerë dhe mesazhierët a.s. edhe të gjithë librat e shpallur qiellorë dhe fletët e shenjta me të gjitha dëshmitë e tyre të panumërta dëshmojnë për Ahiretin.

Atëherë personi që nuk beson në jetën e amshuar të Ahiretit e flak vetveten në një lloj ferri edhe në këtë botë, që buron nga mosbesimi i tij, dhe vuan tortura të vazhdueshme. Siç është përshkrur në "Udhëzuesin për të rinjtë", nëpërmjet vdekjes dhe largimit të tyre, e gjithë e shkuara dhe e ardhmja, krijesat dhe qëniet në mënyrë të vazhdueshme lëshojnë dhimbje të pafundme mbi shpirtin dhe mbi zemrën e tij, duke e bërë atë të vuajë torturat e Ferrit para se të hyjë në të në Ahiret.

Së Treti: "Dita e Gjyqit aludon për një provë të madhe e të fuqishme të Ringjalljes së të vdekurve. Por një situatë e befasishme e veçantë shkaktoi që të shtyhet për në një kohë tjetër ajo provë. Ndoshta nuk ka mbetur më nevojë për të; sepse Risale-i Nuri ka provuar me qindra prova të fuqishme e të sigurta se, ardhja e agimit të Ringjalljes së të vdekurve dhe ardhja e pranverës së Tubimit të madh është aq e sigurtë si ardhja e ditës pas natës dhe si ardhja e pranverës pas dimrit.

Fraza e Pestë: *"IJ-Jakę Naëbudu, Ve IJ-Jakę Neste-inu", "Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë Ndihmë"*

M'u shfaq mua se para se të tregoj provën e përfshirë në këtë frazë, unë duhet të tregoj një udhëtim imagjinar që ka një të vërtetë, i cili është përshkruar në Letrën e Njëzet e Nëntë. Ai ishte sa vijon:

Ashtu siç është shpjeguar në Risale-i Nur, dhe veçanërisht në komentin Kur'anor "Shenjat e mrekullisë" (Isharatul Ixhaz) dhe në "Tetë Simbolet", një herë ndërsa kërkoja mrekullitë e Kur'anit, unë gjeta katër ose pesë parashikime të mrekullueshme tek fundi i sures *El-Fet'h* dhe një mrekulli historike në vërsetin: *"Kështu këtë ditë Ne do ta nxjerrim trupin tënd (të vdekur nga deti)".*[300]

Madje gjeta shkreptima të shumta mrekullie në shumë prej fjalëve të Kur'anit dhe pika të holla mrekullie në disa nga shkronjat e tij... Gjatë kësaj kohe ndërsa unë po lexoja suren el-Fatiha, një pyetje më erdhi në zemrën time me qëllim që të më njoftonte për një mrekulli në "*nunin*" i cili është tek "*Naëbudu, Ve nestein" "Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë Ndihmë".*

Kur'an, 10:92

Pyetja është: Përse tha: "*Naëbudu... Ve nestein*" me nunin e vetës së parë shumës dhe nuk tha "A'ëbudu... Estein" (me vetën e parë njëjës)?

Papritmas një fushë e gjërë u hap para imagjinatës sime nga dera e atij *nuni* (ne), dhe mësova me shkallën e shikimit misterin e madh në namazin me xhemat. Unë pashë dobitë e saja të mëdhaja dhe mësova me siguri se kjo shkronjë e vetme në vetvete ishte një mrekulli. Kjo ishte sa vijon: kur në atë kohë unë po kryeja faljen në xhaminë Bajazit dhe kur po thoja: *"Ijjakę naëbudu ve ijjakę nestinë",* pashë se xhemati i asaj xhamie e mbështesnin këtë pretendimin tim me thënien e tyre ashtu siç thoja unë, dhe merrnin pjesë plotësisht me mua në këtë pretendimin tim dhe në lutjen time *tek "Ihdina!" "Drejtona, na drejto!"* duke më konfrimuar mua. Pikërisht në këtë kohë u hoq perdja nga para imagjinatës sime dhe pashë sikur të gjitha xhamitë e Stambollit u transformuan dhe u bënë si një xhami e madhe e Bajazit, dhe të gjtihë ata që kryenin falje në to thonin si unë: *IJ-Jakę Naëbudu, Ve IJ-Jakę Neste-inu", "Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë Ndihmë",* duke mbështetur pretendimin tim dhe duke i thënë *Amin* duasë sime. Pastaj brenda marrjes së tyre formën e ndërmjetësve për mua, u hoq një perde tjetër përpara imagjinatës sime; unë pashë se bota islame mori formën e një xhamie shumë të madhe me Mekën dhe Qabenë si *Mihrab*. Radhët e të gjithë muslimanëve duke kryer namazet ishin në rrathë përballë *Mihrabit* të shenjtë. Duke thënë si unë *"Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë Ndihmë", "Drejtona në rugën e Drejtë*", secili prej tyre i konfirmonte të gjithë, bënte lutje në emrin e të gjithë atyre, duke i bërë të gjithë falësit ndërmjetës për të. Pastaj, duke menduar: Ajo çfarë pretendon një komunitet i tillë i madh nuk mund të ishte gabim, dhe duatë –lutjet- e tij nuk do të refuzoheshin, kjo i largonte dyshimet djallëzore"... dhe ndërsa vërtetoja dobitë e mëdhaja e të vetëkuptueshme të namazit me xhemat, u hoq një perde tjetër.

Unë pashë se universi dhe të gjitha shumëllojshmëritë e krijesave ishin sikur po kryenin namazet nëpërmjet gjuhëve të qënieve të gjendjes së tyre, dhe duke bërë adhurim në një mënyrë të veçantë për secilën. Duke iu përgjigjur me një adhurim të gjërë Hyjnisë gjithëpërfshirëse të të Adhuruarit të Vetëm të Gjithëlavdishëm, secili grup vërtetonte dëshminë e të gjithë të tjerëve për Unitetin Hyjnor, pasi secili prej tyre arrinte të provonte të njëjtin rezultat, dhe ndërsa po i vëzhgoja këto gjëra, u hoq një perde tjetër: Unë pashë se ashtu si universi –i cili është një njeri i madh –thotë me gjuhën e gjendjes dhe

me gjuhën e kapacitetit dhe të nevojës së bashkëlindur të shumë prej pjesëve të tij, dhe me gjuhën e fjalës së qënieve të vetëdijshme: *"Ijjakę naëbudu ve ijjakę nesteine" "Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm Ty të mbështetemi dhe të kërkojmë ndihmë",* duke shfaqur adhurimin e tyre ndaj Krijuesit të tyre, ndaj Hyjnisë së Tij të mëshirshme, po ashtu trupi im, ky univers i vogël, ashtu si trupi i çdo falësi me mua në atë xhemat të madh, thotë me grimcat e tij me forcat dhe me ndjenjat gjithashtu: "*Ijjakę naëbudu, ve ijjakę nestein*", me gjuhën e bindjes dhe të nevojës ndaj Hyjnisë së Krijuesit të tij, duke iu nënshtruar urdhrit Hyjnor dhe duke iu dorëzuar Vullnetit të Tij xh.sh.. Unë pashë se ai xhemat prej grimcave, fuqive dhe ndjenjave paraqisnin në çdo moment nevojën e tyre për përkujdesjen e Krijuesit të tyre të Gjithëlavdishëm dhe i shtrinin ato para mëshirës dhe ndihmës së Tij. Unë pashë me çudi misterin e madh të xhematit në namaz dhe vëzhgova mrekullinë e bukur të *nunit* të "*naëbudu*". Kështu unë dola prej atij udhëtimi imagjinar tek dera e *nunit*, nga e cila hyra. Dhe falënderova Allahun duke thënë ***El-Hamdu lil-lah***. Dhe u përpoqa ta them *"ijjakę naëbudu ve ijjakę nesteine"* me gjuhën e atyre tre xhemateve, atyre tre shokëve të mëdhenj e të vegjël.

Tani ne e kemi plotësuar parathënien dhe le të vijmë tek çështja jonë kryesore. Dhe një tregues i shkurtër i provës së aluduar nga *"ijjakę naëbudu ve ijjakę nesteine*", është:

Së Pari: Ne shohim me sytë tonë se në univers dhe veçanërisht në faqen e tokës, brenda një aktiviteti madhështor, të vazhdueshëm dhe të rregullt, shohim një krijueshmëri, një Hyjni absolute të mëshirshme dhe administruese brenda këtij aktiviteti dhe kësaj Krijueshmërie që u përgjigjet me urtësi të plotë dhe me mirësi e përkujdesje lutjeve për ndihmë dhe përgjërimeve të bëra me veprim, me gjuhë dhe me gjendje prej gjallesave të panumërta, duke iu përgjigjur aktivisht secilës. Ne shohim manifestimet e një Hyjnie absolute dhe të një të Adhuruari universal brenda kësaj Hyjnie dhe brenda shfaqjeve të përgjigjjeve ndaj çdo gjallese në mënyrë aktive kundrejt mijëra llojeve të adhurimit të të gjitha qënieve, veçanërisht qënieve të gjalla, dhe adhurimit të vullnetshëm e të bashkëlindur të të gjitha grupeve të njerëzimit në të gjitha shumëllojshmëritë e tij. Këtë e sheh mendja e shëndoshë dhe e vëzhgon Imani, ashtu siç njoftojnë për të të gjithë librat qiellorë dhe të gjithë profetët a.s..

Së Dyti: Prokopia e secilit prej tre xhemateve të përmendura në parathënie, për të cilën aludon *nuni* i "*naëbudu*", prokopia e të gjithë atyre së bashku me adhurimet e natyrshme e të vullnetshme dhe me

forma të ndryshme tregon në mënyrë të vetëkuptueshme se ato janë një përgjigje me mirënjohje ndaj një Hyjnie ndaj të Cilit drejtohet adhurueshmëria dhe janë dëshmi të sigurta e të panumërta për ekzistencën e një të Adhuruari të Shenjtë. Dhe secili prej atyre tre xhemateve të përmendur, secili grup dhe çdo individ duke filluar nga tërësia e të gjithë universit për tek xhemati i grimcave të trupit shprehin lutje për ndihmë, dhe bëjnë dua me veprim dhe me gjendje, duke dëshmuar në mënyrë të padyshimtë për Një të Vetëm Unik i Cili është Administruesi i Dhembshur dhe Mëshirëplotë.

Për shembull, ashtu siç është thënë në Fjalën e Njëzet e Tre, pranimi i tre llojeve të duave të të gjitha krijesave në tokë në një mënyrë që është vërtet e çuditshme dhe përtej të gjitha parashikimeve dëshmon në mënyrë të sigurt për një Krijues Mëshirëplotë, Përgjigjës të lutjeve...

Po, ashtu siç shohim me sytë tonë një përgjigjje duaje ndaj çdo bërthame e fare të cilat i luten Krijuesit të tyre me gjuhën e kapacitetit të bashkëlindur që të bëhet një pemë dhe një kalli, po ashtu ne shohim dërgimin e furnizimeve me ushqime tek të gjitha kafshët, duart e të cilave nuk mund t'i arrijnë, dhe të gjitha domosdoshmëritë e jetëve të tyre u jepen atyre, dhe përgjigjja ndaj kërkesave të tyre që janë jashtë fuqisë së tyre, dhe ia kërkojnë të Vetmit Unik me gjuhën e nevojës së bashkëlindur. Këto përgjigjje dhe këto ndihma dëshmojnë në mënyrë të qartë për Një Krijues Gjithëbujar, i Cili u përgjigjet të gjitha atyre duave që dalin prej gjuhës së nevojës së bashkëlindur, ashtu siç i shohim me sytë tonë, dhe i Cili shtyn krijesa të çuditshme të pavetëdijshme për t'u ardhur në ndihmë atyre kafshëve në kohën më të përshtatshme dhe me urtësinë më të plotë.

Dhe kështu, duke bërë analogji me këto dy pjesë, përgjigjja ndaj të gjitha llojeve të duave të bëra nga gjuha e fjalës, dhe sidomos përgjigjja ndaj duave të pejgamberëve në mënyrë të jashtëzakonshme dëshmon për provën e Unitetit Hyjnor që është tek *"ijjake nesteine" "Dhe Vetëm Ty ne të kërkojmë ndihmë".*

Fraza e Gjashtë: *"Ihdinas-Siratal-Mustekijm", "Drejtona në Rrugën e Drejtë".*

Një tregues i shkurtër për provën e saj është:

Ashtu si rruga më e shkurtër, midis rrugëve që të çojnë nga një vend për tek një tjetër, është rruga e Drejtë, dhe më e shkurtëra e vijave të shtrira nga një pikë e largët për tek një pikë tjetër është vija e drejtë, po ashtu më të drejta dhe më direktet e rrugëve shpirtërore dhe

të metodave të brendshme janë më të shkurtërat dhe më të lehtat. Për shembull, të gjitha krahasimet në Risale-i Nur ndërmjet rrugëve të besimit dhe të mosbesimit demonstrojnë në mënyrë vendimtare se rruga e besimit dhe e vërtetimit të Unitetit Hyjnor është shumë e shkurtër, direkte, e drejtë dhe e lehtë, ndërsa rrugët e mosbesimit dhe të mohimit janë shumë të gjata, të vështira dhe të rrezikshme. Domethënë, mosbesimi dhe shirku nuk janë të bazuara, të arsyetueshme në këtë univers të drejtë e plot urtësi, në të cilin gjithçka shtyhet për tek më e lehta dhe më e shkurtëra e rrugëve; ndërsa të vërtetat e besimit dhe të vërtetimit të Unitetit Hyjnor janë aq esenciale dhe të domosdoshme në këtë univers sa domosdoshmëria e diellit në të.

Gjithashtu, më e lehta e rrugëve në moralet njerëzore, më e dobishmja, më e shkurtëra dhe më e shëndosha është në Rrugën e drejtë dhe në *Istikamet* -moderim.

Për shembull, në qoftë se fuqia e arsyes shmanget nga urtësia e rrugës së mesme dhe të lehtë, e cila është rruga e dobishme dhe e drejtë, ajo do të binte ose në tepri dhe në mashtrime të rrezikshme, ose në mangësi dhe në marrëzi të kobshme, dhe bie pre e të gjtiha llojeve të vështirësive në rrugët e tyre të gjata.

Dhe në qoftë se fuqia e zemërimit nuk e ndjek rrugën e guximit, e cila është rruga e mesme, ajo do të binte ose në tepri dhe në një tërbim e arrogancë të rrezikshme dhe shtypëse, ose në mangësi e në një druajtje, frikë e burracakëri të poshtëruar e të dhimbshme, dhe si dënim për gabimin e shmangies nga rruga e drejtë vuan tortura të vazhdueshme të ndërgjegjjes.

Dhe në qoftë se fuqia e orekseve -dëshirave- shtazore shmanget nga rruga e mesme e sigurtë e dëlirësisë -ndershmërisë- dhe bie ose në tepri dhe në shthurjen dhe në imoralitetin e kobshëm e të turpshëm, ose në mangësi dhe në ftohtësi seksuale, domethënë një paaftësi për të përjetuar kënaqësi, dhe vuan torturat e asaj sëmundjeje shpirtërore. Kështu duke bërë analogji me këto që u përmendën më lart, *istikameti* -moderimi- është rruga më e dobishme, më e lehta dhe më e shkurtëra midis rrugëve të ndjekura në jetën personale dhe shoqërore të njeriut. Në qoftë se njeriu do ta humbiste rrugën e drejtë të moderimit, atëherë ato rrugë do të ishin shumë të gjata, plot me telashe dhe të dëmshme.

Domethënë, ashtu si *"Ihdinas-siratal-Mustekijm" "Drejtona në Rrugën e drejtë",* që është një dua gjithëpërfshirëse dhe një adhurim i gjërë, po ashtu ajo tregon një provë të Unitetit Hyjnor, dhe një mësim

në urtësi dhe në mësimin e moraleve.

Fraza e Shtatë: *"Siratal-ledhine en'amte alejhim" "Në Rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mëshirën Tënde..."*

Një tregues i shkurtër i provës së përfshirë në këtë frazë është:

Së Pari: Përgjigjja për pyetjen se kush synohet me *"Alejhim" (e atyre të cilëve*), është vërseti:

"... atëherë ata do të jenë në shoqërinë e atyre mbi të cilët Allahu ka derdhur Mëshirën e Tij; (në shoqërinë) e pejgamberëve, të siddikuneve (të të sinqertëve, ndjekësve më të afërt të pejgamberit a.s.m. si Ebu Bekr es-Siddiku etj.), të martirëve, të të drejtëve...",[301] vërseti rendit katër klasat e njerëzimit të cilët kanë marrë mirësinë e ndjekjes së rrugës së *istikametit* –moderimit. Domethënë, me *pejgamberët* ai aludon për profetin Muhammed a.s.m., i cili është prijësi i katër klasave; me *Siddikunë* (të sinqertëve, dashuruesit e së vërtetës) aludon për Ebu Bekrin e drejtë, Zoti qoftë i kënaqur me të; me "*martirët*" aludon për Hazreti Umerin, Hazreti Uthmanin dhe për Hazreti Aliun, Zoti qoftë i kënaqur me ta. Me këto parashikime, se pas profetit Muhammed a.s.m. dhe pas Ebu Bekrit, edhe Hazreti Umeri, edhe Hazreti Uthmani, edhe Hazreti Aliu do të ishin edhe kalifë edhe martirë, ky vërset shfaq një shkreptimë mrekullie.

Së Dyti: Këto katër klasa të cilat janë më të vërtetat e llojit njerëzor, më të drejtat dhe më të lartat bënë thirrje me të gjithë fuqinë dhe me prova të panumërta, me mrekulli, keramete, me dëshmi e zbulesa për tek e vërteta e Unitetit Hyjnor, dhe pretendimin e tyre e konfirmuan shumica e njerëzimit qysh prej Hazreti Ademit a.s.. Nuk ka dyshim se ajo është një e vërtetë aq e sigurtë si ajo e diellit.

Me qindra mijëra mrekullitë dhe provat e tyre, këta anëtarë të shquar të njerëzimit kanë provuar vërtetësinë dhe saktësinë e tyre; dhe unanimiteti i tyre në çështjet pozitive të tilla si Uniteti Hyjnor dhe ekzistenca e domosdoshme e Krijuesit formon një provë të tillë saqë kurrsesi nuk mund të dyshohet.

Po, e vërteta e madhe të cilës i besuan ato katër klasa që u përmendën dhe të cilat përfaqësojnë llojin më të drejtë njerëzor i cili është rezultati i rëndësishëm i krijimit të universit dhe i kalifit në tokë, dhe janë më të lartësuarit e krijesave të gjalla, madje ata janë më të vërtetët dhe më të verifikuarit e udhëzuesve dhe imamët e tyre në

[301] Kur'an 4:69

plotësim. Këta e kanë njoftuar me unanimitet dhe me pajtueshmëri atë të vërtetë të cilës i besuan në mënyrë të palëkundur me shkallët e ‘sigurisë absolute’, me ‘shikimin e sigurisë’, dhe me ‘njohjen e sigurisë’. Dhe ata e pranuan dhe u qetësuan me të në mënyrë të patundur duke e shfaqur të gjithë universin me të gjitha qëniet e tij si një provë.

Sa çudi, a nuk kryen një krim të pakufishëm ai që nuk e njeh këtë të vërtetë të madhe dhe që e mohon... a nuk meriton ai një ndëshkim të përjetshëm?!

Fraza e Tetë: *“Gajril-Magdubi alejhim Ve led-Daal-lin”, “Jo, (në rrugën) e atyre që merituan zemërimin Tënd mbi vete, Dhe as (në rrugën) e atyre të cilët u humbën”.*

Historia njerëzore dhe librat e shenjtë njoftojnë me unanimitet dhe në mënyrë të sigurt e të qartë duke u mbështetur mbi raportimet unanime, mbi ngjarjet universale të sigurta, mbi njohjen dhe mbi vëzhgimet njerëzore se si në mijëra raste ndihma u arriti në mënyrë të jashtëzakonshme nga e padukshmja profetëve a.s., të cilët ishin njerëzit e rrugës së drejtë, dhe si iu dha atyre ekzaktësisht ajo çfarë ata kërkuan; dhe zbritja e zemërimit dhe e fatkeqësive qiellore ndaj armiqve të tyre mohues në qindra raste, kjo tregon në mënyrë vendimtare dhe të padyshimtë se ky univers dhe lloji njerëzor brenda tij kanë një Zot sundimtar, të Drejtë, Mirëbërës, Gjithëbujar, Fuqiplotë, Rregullues dhe Nënshtrues, i Cili në shumë ngjarje të ndryshme historike, në mënyrë të jashtëzakonshme u dhuroi fitore dhe shpëtim shumë profetëve të nderuar të tillë, si: Nuhut, Ibrahimit, Musait, Hudit dhe Salihut a.s, dhe në të njëjtën kohë zbriti fatkeqësi të tmerrshme qiellore në dynja mbi shtypësit dhe mohuesit e shumtë të tillë si: Themudi, Adi, Faraoni si dënim për rebelimin e tyre kundra profetëve.

Meqenëse qysh nga koha e Ademit a.s., dy rryma të fuqishme mospajtuese -kundërshtuese- kanë ardhur deri tek ne;

E Para: Janë njerëzit e profetësisë, të drejtësisë dhe të besimit të cilët arritën mirësinë dhe lumturinë e kësaj bote dhe të tjetrës, duke ndjekur rrugën e drejtë. Meqenëse ata vepruan në përputhje me bukurinë e vërtetë, me rregullin dhe me plotësinë e universit, ata morën mirësitë e Pronarit të universit, dhe përjetuan lumturi në këtë botë dhe në tjetrën; dhe ata u bënë mjet për ta ngjitur njeriun në nivelet e melekëve, madje edhe më lartë se ai nivel; dhe ata fituan dhe i bënë njerëzit e besimit të fitonin një Xhennet shpirtëror edhe në këtë dynja, së bashku me një lumturi të përjetshme në Ahiret...

E gjitha kjo ndodh nëpërmjet misterit të të vërtetave të besimit.

Rryma e dytë: Janë ata njerëz që u shmangën nga rruga e drejtë dhe nëpërmjet teprive dhe mangësive i tranformuan mendjet e tyre si një instrument torture dhe si një vegël për të grumbulluar dhimbje, dhe e zbritën njerëzimin në një shkallë më të ulët se sa kafsha, dhe ata merituan zemërimin Hyjnor, dhe zbritën mbi ta goditjet e fatkeqësive si dënim për padrejtësitë që ata bënë në dynja. Përveç kësaj, ata e bënë universin nëpërmjet çudhëzimit tek i cili kanë rënë, dhe nëpërmjet mendjeve të lidhura me qënie, -e bënë si një vend zie të përgjithshme dhe si një thertore për qëniet e gjalla që duke u përmbysur në vazhdimësinë e zhdukjes, dhe të ndarjes, dhe duke e parë universin si shumë të shëmtuar e të ngatërruar, u shkaktojnë ndërgjegjjeve të tyre të vuajnë një ferr shpirtëror edhe në këtë botë dhe duke i bërë vetvetet të meritojnë një torturë të përjetshme në Ahiret. Dhe kështu, ky ajet Kerim në fundin e sures El-Fatiha *"Në Rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mëshirën Tënde, jo (në rrugën) e atyre që merituan zemërimin Tënd mbi vete, dhe as (në rrugën) e atyre të cilët u humbën",* na njofton neve për këto dy rryma të mëdha.

Burimi i të gjitha krahasimeve të përmendura në Risale-i Nur, dhe baza dhe udhëzuesi i tij është ky vërset.

Meqenëse trajtesat e Risale-i Nurit e shpjegojnë këtë vërset me qindra krahasime, ne ju referojmë ju tek ato për shpjegim të mëtejshëm, dhe mjaftohemi këtu me këtë tregues të shkurtër.

Fraza e Nëntë: *"Amin"*

Një aluzion shumë i shkurtër për këtë:

Nuni në *"Naëbudu"* dhe në *"nestein"* na tregon neve ato tre xhemate të mëdhenj, veçanërisht xhematet e atyre të cilët vërtetojnë Unitetin Hyjnor në Xhaminë e botës së islamit, dhe sidomos xhematet e milionave që i kryejnë namazet në atë kohë; dhe ai *nun* na vendos ne midis radhëve të tyre dhe hap rrugën për ne që të marrim një pjesë prej ndërmjetësive të tyre; atëherë ne gjithashtu, nëpërmjet Fjalës *Amin* bashkohemi në duatë e atij xhemati të adhuruesve besimtarë, duke vërtetuar atë çfarë thonë ata, dhe duke u lutur e përgjëruar që ndërmjetësimi i tyre dhe kërkimi i ndihmës nga ana e tyre të pranohen; ajo i transformon adhurimin tonë të pjesshëm, duatë dhe përgjërimet tona të pjesshme në një adhurim universal, në dua e përgjërime universale, duke i shkaktuar Hyjnisë Universale e të gjithanshme që t'i përgjigjet asaj. Domethënë, nëpërmjet misterit të vëllazërisë së besimit dhe unitetit islamik, nëpërmjet lidhjeve të unitetit të xhematit të

milionave në xhaminë islame në kohën e faljeve, dhe nëpërmjet Radiove shpirtërore, *Amin* në fund të sures El-Fatiha fiton universalitet dhe mund të bëhet si miliona *Amin*.[302]

Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjtiha botëve.

"Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që Vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."[303]

---

[302] Dhe kështu, në qoftë se një njeri i zakonshëm do të merrte diçka me përmasën e një bërthame, njeriu i plotë i cili ka përparuar shpirtërisht do të merrte një pjesë sa një pemë palme, secili sipas shkallës së tij; por ama një person i cili nuk ka përparuar akoma, nuk duhet t'i kujtojë qëllimisht këto kuptime kur reciton el-Fatihanë, me qëllim që të mos prishë e dëmtojë sensin dhe qetësinë e tij ndaj pranisë Hyjnore. Kur ai të arrijë në një stacion të tillë, ato kuptime do ta shfaqin vetveten për të.
Ne e pyetëm profesorin tonë të na sqaronte fjalën "qëllimisht" e cila erdhi në këtë shënim, dhe ne e regjistruam ekzaktësisht përgjigjjen që morëm: Unë e shoh se të preokupohesh me kuptimet gjithëpërfshirëse dhe të lartësuara të Fatihasë dhe të *tesheh-hudit*, jo qëllimisht por në mënyrë indirekte, dhe jo në mënyrë të detajuar, e cila shkakton një lloj pakujdesie ndaj pranisë Hyjnore, por në mënyrë konçize e të përmbledhur, largon pakujdesinë dhe i jep një shkëlqim adhurimit dhe lutjeve. Kjo e shfaq krejtësisht vlerën e lartë të faljeve, të *Fatihasë* dhe të *tesheh-hudit*. Ndërsa ajo çfarë synohet nga fjala "të mos preokupohesh qëllimisht", e cila erdhi në fundin e pjesës së dytë, është se prokopia me pikërisht detajet e atyre kuptimeve i shkakton njeriut të harrojë faljet dhe ndoshta i pakëson e i prish sensin ndaj pranisë Hyjnore. Unë ndjej se prokopia me to në mënyrë indirekte dhe të përmbledhur fiton dobi të mëdhaja. Autori.

Nënshkroi në emrin e studentëve të Risale-i Nurit
në shkollën e tretë të Jusufit, Xhejlani.

[303] Kur'an 2:32

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Dhe Atij ne i kërkojmë ndihmë.

Pjesa e Tretë

E një mësimi të vetëm, i cili u dha në shkollën e tretë të Jusufit.

Parathënie

Pjesa e dytë u shkrua me urdhrin e nënkuptuar të sures El-Fatiha gjatë pesë namazeve të përditshëm, dhe me shkëlqimin e dritës së Fjalës së *Shehadetit*: *"Esh hedu en la ilahe il-lall-llah"*. "*Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut"*. Gjithashtu, u detyrova ta shkruaja - për tre arsye që për momentin unë nuk jam i lejuar që t'i zbuloj- këtë pjesën e tretë, i shtyrë nga një paralajmërim shpirtëror që erdhi nga fjalia: *"Eshhedu enne Muhammeden Resulull-llah", "Dëshmoj se Muhammedi a.s.m. është i dërguari i Allahut"*, dhe me shkëlqimin e dritës së vërsetit Kur'anor që është në fund të sures *el-Fet'h*, i cili shfaqi pesë mrekulli nga e padukshmja; është vërseti vijues:

Ai është i Cili ka çuar të Dërguarin e Tij (Muhammedin a.s.m.) me udhëzim dhe fenë e vërtetë (islamin), që Ai ta shpallë e ta bëjë atë përmbi të gjitha fetë.

"Dhe i Gjithëmjaftueshëm është Allahu si Dëshmues."

Muhammedi (a.s.m.) është i Dërguari i Allahut, dhe ata që janë me të janë të ashpër ndaj mohuesve (të Allahut) dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre..." deri në fund të vërsetit)"[304]

Sa për hollësitë e kësaj pjesë, për sqarimet e saj dhe për provat e mbështetura me dëshmi e tregues, ne ia referojmë trajtesës "Mrekullitë e profetit" të botuara brenda koleksionit "Dhul Fikar" dhe trajtesës "Hizb en-Nur" që është botuar në gjuhën Arabe. Këtu do të aludohet për to me tre tregues shumë të shkurtër. Në treguesin e dytë dhe në të tretin do të shkruhet çfarë i ngjason përkthimit të pjesës së veçantë të Shehadetit *"Muhammedun Resulul-llah", "Muhammedi është i Dërguari i Allahut xh.sh"* në trajtesën e vogël të hartuar këtu, e cila është përmbledhja e përmbledhjes së Hizb En-Nurit arabisht, dhe të

[304] Kur'an, 48:28-29

cilën unë e përdor vazhdimisht në mendimin tim reflektiv në arabisht së bashku me fjalën e *teuhidit* -e Unitetit Hyjnor, duke i përsëritur ato në tesbihatet që ndjekin namazet.

Treguesi i Parë

Muhammedi a.s.m. i cili iu përgjigj me adhurim universal dhe me bërjen të njohur manifestimit të Hyjnisë së Pronarit të Universit, Hyjnisë së Tij të përjetshme, mirësive të Tij të pafundme, është aq i domosdoshëm për universin ashtu siç është dielli. Sepse ai është profesori më i madh i njerëzimit, është profeti i tij më i madh, është lavdia e botës, dhe ai të cilit iu bë adresimi me "*Po të mos ishe ti, po të mos ishe ti, Unë nuk do t'i kisha krijuar sferat –planetët*". Realiteti i Muhammedit a.s.m. ishte arsyeja për krijimin e botës, rezultati i saj dhe fruti më i plotë i saj. Po ashtu, të vërtetat e lidhura me universin të tilla si plotësitë e tij të vërteta dhe qënia e tij duke u bërë si pasqyra të qëndrueshme për Hirplotin e Gjithëlavdishëm të Amshuar, dhe manifestimi i Emrave të Tij dhe i veprave -të ngarkuara me detyra- prej akteve të Tij të urta, dhe mesazhet e Tij më kuptimplote, dhe ai duke mbajtur një botë të qëndrueshme, duke prodhuar rezultatin e Ahiretit dhe një botë lumturie për të cilën përmallohen të gjitha krijesat e vetëdijshme- të gjitha këto realizohen nëpërmjet realitetit Muhammedan dhe profetësisë së tij a.s.m.. Meqenëse është kështu, universi dëshmon në mënyrën më të fuqishme e vendimtare për profetësinë e tij. Për më tepër, profetësia e Muhammedit a.s.m. dhe realiteti Muhammedan japin sihariqe të sigurta për jetën e përhershme, për të cilën me qëllim që të shpëtohet nga mosekzistenca, asgjësia, ekzekutimi i përhershëm dhe nga asgjësimi absolut, i gjithë njerëzimi, me në krye botën e islamit, dhe të gjitha krijesat e vetëdijshme luten në mënyrë të vazhdueshme dhe me zell, me të gjitha fuqitë e natyrave të tyre gjithëpërfshirëse, me gjuhët e të gjitha aftësive të tyre, dhe me të gjitha lutjet e tyre, me adhurimin dhe me përgjërimet.

Kështu ata dëshmojnë për profetësinë e Muhammedit a.s.m. dhe për realitetin Muhammedan, duke miratuar e mbështetur se ai është krenaria e njerëzimit dhe më i nderuari i krijesave. Për më tepër, në përputhje me rregulin, "*Shkaku është si Vepruesi*", barasvlera e të gjitha veprave të mira të kryera në çdo ditë prej treqind e pesëdhjetë milionë besimtarëve duke u regjistruar në librin e veprave të mira të Muhammedit a.s.m., dhe personi i vetëm i Muhammedit a.s.m. duke arritur në një stacion duke manifestuar adhurimin universal dhe shkëlqimin e qindra miliona adhuruesve të drejtë, kjo dëshmon në mënyrë vërtetë të fuqishme për profetësinë e tij, duke e vërtetuar atë.

Treguesi i Dytë

Paragrafi vijues tregon më shumë se njëzet dëshmi, të cilat unë gjithmonë i shqyrtoj në mënyrë reflektive në virdet e mia, për profetësinë e Muhammedit a.s.m.. Ne do të përmbledhim përmbajtjet e saj në mënyrë të shkurtuar. Paragrafi është ky:

Muhammedi është i Dërguari i Allahut, gjithmonë besnik ndaj premtimit të Tij, nëpërmjet dëshmisë së shfaqjes së tij të menjëhershme me një fe të plotë, islamin, dhe me sheriatin, pavarësisht qënies së tij anafalbet, me imanin më të fuqishëm, me besimin dhe adhurimin, dhe me çështjen më të lartësuar, me duatë dhe me përgjërimet, me mesazhin më të përgjithshëm, me qëndrueshmërinë më të plotë, me frytëzimin më të çuditshëm, të gjitha këto janë të pashoqe" .[305]

Një përkthim i këtyre paragrafeve dhe një shpjegim i përmbledhur i kuptimeve të tyre janë dëshmitë vijuese për profetësinë e Muhammedit a.s.m..

E para e atyre dëshmive është një provë e profetësisë që buron prej njëmbëdhjetë gjendjeve prej gjendjeve dhe cilësive të tij a.s.m.. Po, shfaqja e tij –pavarësisht qënies analfabet- papritmas dhe pa pasur ndonjë eksperiencë të mëparshme, me një fe e cila i ka lënë në habi njerëzit e ditur dhe filozofët e katërmbëdhjetë shekujve dhe ka fituar vendin e parë midis feve të shpallura, kjo është një cilësi e pashoqe; kjo gjendje nuk ka të ngjashme.

Gjithashtu i pashembullt është fakti se islami, i cili u shfaq prej fjalëve të tij, akteve dhe sjelljeve, në të gjitha kohët ka edukuar dhe zhvilluar nefset, shpirtërat dhe mendjet e treqind e pesëmbëdhjetë milionë njerëzve duke i shtyrë ata për në përparim shpirtëror... edhe kjo gjendje është e pashoqe. Për më tepër, ai u shfaq me një sheriat të tillë saqë për katërmbëdhjetë shekuj ai ka sunduar me ligjet e tij të drejta një të pestën e njerëzimit, duke i çuar ata në përparim material e shpirtëror... edhe kjo gjendje është e pashoqe.

Po kështu, ajo Qënie a.s.m. u shfaq me një iman e besim të tillë dhe me një fuqi të tillë besimi saqë të gjithë njerëzit e realitetit e kanë vërtetuar atë me unanimitet, meqë ata marrin shkëlqim të përhershëm prej tij; besimi i tij ishte në shkallën më të lartë e më të fuqishme. Kundërshtimi nga ana e armiqve të tij të panumërt në atë kohë duke mos i shkaktuar as shqetësimin më të vogël, as dyshimin apo

---

[305] Këto paragrafe të shkruara në *Italik* kanë ardhur në tekst në gjuhën arabe. Përkthyesi.

ngurrimin, kjo tregon gjithashtu se fuqia e besimit të tij ishte e pashoqe dhe e pashembullt.

Gjithashtu ai shfaqi një adhurim të tillë ndaj Zotit dhe një robëri ndaj Tij xh.sh. saqë duke sjellë bashkë fillimin dhe fundin e adhurimit, duke mos imituar askënd, ai i pa dhe u përshtat me misteret më të hollë të adhurimit, dhe madje i përmbushi ato në kohët e trazirave më të mëdhaja. Edhe kjo ishte një gjendje e pashoqe.

Gjithashtu ai iu përgjërua Krijuesit të tij Gjithëbujar dhe bëri lutje të holla të tilla saqë askush nuk e ka arritur shkallën e atyre duave e lutjeve deri në këtë kohë, pavarësisht takimit të shumë mendjeve. Për shembull, në duanë e "*Xheushan el-Kebir*" duke i marrë si ndërmjetës një mijë e një Emrat Hyjnorë, ai e përshkruan Krijuesin e Tij madhështor në një mënyrë të mrekullueshme që i përshtatet Atij dhe e bën Atë të njohur në një mënyrë të pakrahasueshme. Kështu askush nuk e ka arritur shkallën e njohjes së tij lidhur me Krijuesin.

Ai i ftoi njerëzit për tek feja me një qëndrueshmëri të tillë dhe e shpalli profetësinë e tij me një guxim të tillë saqë megjithëse njerëzit e tij, xhaxhai i tij, fuqitë e mëdhaja të botës, dhe ndjekësit e feve të mëparshme ishin që të gjithë kundërshtarë dhe armiqësorë ndaj tij, ai nuk u tremb dhe nuk u tërhoq aspak, por ai i sfidoi të gjithë ata dhe me sukses përmbushi detyrën e tij; edhe kjo është një gjendje e pashoqe.

Kështu këto tetë gjendje apo cilësi të çuditshme e të pashoqe formojnë një dëshmi vërtet të fuqishme për vërtetësinë e tij dhe për profetësinë. Ato gjithashtu tregojnë se ka siguri të plotë lidhur me seriozitetin e tij të plotë, besnikërinë, saktësinë dhe vërtetësinë e Tij. Në çdo ditë në *teshehhud* me miliona gjuhë Bota islame deklaron: *"**Es-selamu alejke ej-juhen-nebij-ju ve rahmetull-llahi ve berekatuhu**" "Paqja qoftë mbi Ty, o profet! Dhe mëshira dhe bekimet e Zotit xh.sh. qofshin mbi ty!"* ajo paraqet funksionin me të cilin ai qe ngarkuar, dhe duke afirmuar sihariqet e lumturisë së përjetshme të cilat ai i solli, ajo me mirënjohje thotë: "*Paqja qoftë mbi ty, o profet*!" përballë rrugës së sigurt që të çon tek jeta e përhershme të cilën njerëzimi e kërkon dhe për të cilën përballohet me një dëshirë të thellë e të bashkëlindur, kështu duke u takuar me të shpirtërisht dhe duke e përshëndetur atë në emrin e treqind milionëve, madje të qindra milionëve.

Dëshmia e dytë, e cila përmban njëzet dëshmi universale, si dhe shumë të tjera*: "Nëpërmjet dëshmisë së të gjitha të vërtetave të besimit për vërtetësinë e tij*.

Domethënë, të vërtetat, realitetet dhe vërtetësia e gjashtë shtyllave të besimit dëshmojnë në mënyrë vendimtare për profetësinë e Muhammedit a.s.m. dhe për vërtetësinë e tij. Sepse personaliteti kolektiv i jetës së tij si i Dërguar dhe baza e të gjitha pretendimeve të tij, dhe esenca e profetësisë së tij ishin ato gjashtë shtylla të besimit. Prandaj, të gjithë dëshmitë që verifikojnë dhe provojnë vërtetësinë e atyre shtyllave, provojnë gjithashtu të vërtetën e profetësisë së Muhammedit a.s.m. dhe saktësinë e tij... Ashtu siç e shpjeguan trajtesa e "Frutave të besimit" dhe shtojcat e Fjalës së Dhjetë provën e shtyllave të tjera të besimit për realizimin e Ahiretit, po ashtu secila nga shtyllat e besimit së bashku me provat e tyre formojnë një provë për profetësinë e tij a.s.m..

Dëshmia e Tretë universale, e cila përmban me mijëra dëshmi: "*Nëpërmjet dëshmisë së personit të tij a.s.m., nëpërmjet mijëra mrekullive të tij, plotësimeve dhe lartësisë së moraleve të tij".*

Domethënë, ai ishte një provë për vetveten aq e ndritshme si dielli, nëpërmjet dëshmisë së fuqishme të profetësisë së tij dhe të vërtetësisë së mijëra mrekullive, arritjeve dhe plotësimeve dhe nëpërmjet karakterit të tij të lart dhe moralit të bukur. Po, siç është provuar në trajtesën e mrekullueshme të "Mrekullive të Profetit Muhammed a.s.m." me anë të më shumë se treqind rrëfenjave të shëndosha, në përputhje me vërsetet me kuptim të qartë si, *"Dhe hëna u ça më dysh"*[306] dhe "*Dhe nuk e hodhe ti (pluhurin në sytë e armikut, o Muhammed a.s.m.), kur e lëshove nga grushtet e tua, por e hodhi Allahu ..."*[307] hëna duke u çarë më dysh me shenjën e një gishti të vetëm të dorës së tij; dhe uji duke shpërthyer në pesë burime -rubineta- prej pesë gishtërinjve të të njëjtës dorë; dhe e gjithë ushtria e etur duke pirë ujë prej këtyre, dhe dëshmia e tyre për këtë; dhe hedhja e tij një grusht pluhur me të njëjtën dorë ndaj ushtrisë agresore të armikut dhe hyrja e pluhurit në sytë e gjithësecilit prej tyre dhe shpartallimi i tyre gjatë sulmit të tyre; dhe gurët e vegjël duke shprehur *tesbihate* në të njëjtën dorë sikur ato të ishin njerëz, duke thënë "Lavdi Zotit" - dhe qindra ngjarje të tilla si këto, të cilat njoftohen nga rrëfenja të shëndosha; dhe disa të tjera rreth të cilave ndodhen raportime me unanimitet të pëshkruara në librat e biografisë dhe të historisë, dhe mrekullitë të cilat sipas dijetarëve numërohen rreth një mijë, duke u shfaqur nga dora e tij; dhe sipas miqve dhe armiqve të tij njëlloj, cilësitë e tij të larta dhe morali i mirë

[306] Kur'an, 54: 1
[307] Kur'an, 8:17

duke qenë në shkallën më të lartë,[308] dhe pajtueshmëria në mendim unanim tek shkalla e sigurisë absolute e të gjithë njerëzve të Realitetit, të cilët kanë arritur plotësimin shpirtëror duke e ndjekur Atë, dhe të cilët kanë arritur "shikimin e sigurisë" në realitet, se plotësimet dhe arritjet e Muhammedit a.s.m. ishin tek niveli më i lartë; dhe arritjet shpirtërore të botës islame, të cilat burojnë nga feja e tij; po ashtu edhe të vërtetat e islamit madhështor –të gjitha këto japin dëshmi për plotësimet e tij të jashtëzakonshme. Kjo sigurisht do të thotë se kjo qënie a.s.m. dëshmoi në mënyrën më të ndritshme dhe universale për vetë profetësinë e tij.

Dëshmia e katërt, e cila përmban dëshmi të shumta të fuqishme: "*Nëpërmjet dëshmisë së Kur'anit, me të gjitha të vërtetat dhe provat e tij."* Domethënë, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm dëshmon për profetësinë dhe për vërtetësinë e tij me të vërtetat dhe me provat e tij të panumërta.

Po, me të gjitha të vërtetat e tij të sakta, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm, ashtu siç është provuar në trajtesën "Dhul Fikar", është i mrekullueshëm në dyzet aspekte, ka ndriçuar katërmbëdhjetë shekujt dhe ka sunduar nëpërmjet ligjeve të tij të pandryshueshëm një të pestën e njerëzimit; dhe qysh nga ajo kohë e gjer tani ai i ka sfiduar të gjithë ata që e kanë kundërshtuar; dhe madje nuk ka guxuar asnjëri prej tyre të kundërshtojë edhe një sure të vetme; dhe ashtu siç është provuar në trajtesën "El-A'jetul Kubra", Gjashtë aspektet e Kur'anit janë të ndritshme, në to nuk mund të hyjnë kurrë dyshimet; dhe vërtetësia e tij mbështetet nga gjashtë stacione të larta; i cili bazohet mbi gjashtë të vërteta të palëkundura; dhe i cili lexohet me zell e me respekt të plotë në çdo moment nga qindra e miliona gjuhë, dhe është shkruar me shenjtërinë në zemrat e miliona hafizëve; dhe nga dëshmia e të cilit burojnë të gjitha dëshmitë dhe besimi i botës së islamit; dhe nga burimi i të cilit vërshojnë të gjitha shkencat e besimit dhe të islamit; dhe ashtu siç i vërteton ai të gjithë librat e mëparshëm qiellorë, po ashtu ai konfirmohet e vërtetohet prej tyre; -me të gjtiha të vërtetat e tij dhe me të gjitha provat e tij të vërtetësisë së tij, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm dëshmon për vërtetësinë dhe profetësinë e Muhammedit a.s.m..

---

[308] Saqë Hazreti Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, trimëria dhe guximi i të cilit ishin në shkallën më të lartë, tha: "Kur ne frikësoheshim ndërsa luftonim në betejë, ne fshiheshim pas të Dërguarit të Zotit xh.sh..." Historia tregon se madje edhe armiqtë e tij të asaj kohe mbështetën faktin se të gjitha cilësitë e tij ishin më të lartat, ashtu si guximi i tij.

Dëshmitë universale e Pesta, e Gjashta, e Shtata dhe e Teta:

Nëpërmjet dëshmisë së Xheushan el-Kebir, dhe shenjtërisë së aluzioneve të tij; dhe Risale-i Nurit dhe fuqisë së provave të tij; dhe të shkuarës, dhe unanimitetit të shenjave të saj për një profet të ardhshëm; dhe të ardhmes, dhe konfirmimit të mijëra ngjarjeve të saj.

Domethënë, *Xhaushan el-Kebir*, i cili i shikon edhe në mënyrë të qartë edhe aluduese një mijë e një Emrat e Bukur Hyjnorë, është lutje e jashtëzakonshme, e cila nga një aspekt buron nga Kur'ani; *xhaushani* është më eprorja e të gjitha lutjeve të tjera të recituara nga ata të cilët kanë përparuar në njohjen e Zotit; të cilin e solli Xhebraili a.s. si *vahj* në një betejë luftarake duke thënë: Hiqe mburojën dhe në vend të saj lexo këtë *Xhaushan*. Të vërtetat që ai i përmban dhe përshkrimet e tij të sakta e perfekte për Krijuesin e Gjithëlavdishëm dëshmojnë për profetësinë e Muhammedit dhe për vërtetësinë e Tij.

Po ashtu, duke i provuar në mënyrë racionale dhe të logjikshme si një provë e vetme me njëqind e tridhjetë pjesët të tij të gjitha të vërtetat e profetësisë së Muhammedit a.s.m., duke dhënë mësim e duke i bërë të kuptueshme çështjet, të cilat në shikimin e filozofisë janë larguar nga arsyeja, në mënyrën më të arsyeshme e të lehtë, sikur ato të ishin pikërisht para syve të dikujt, Risale-i Nuri -i cili nga një drejtim e mori shkëlqimin nga *Xhaushani* dhe u lind prej tij- dëshmon në mënyrë universale për profetësinë dhe vërtetësinë e Muhammedit a.s.m..

Gjithashtu e shkuara ishte një dëshmitare universale për profetësinë e tij, sepse ngjarje të shumta të cilat ndodhën para fillimit të profetësisë së tij të quajtura *irhasat*, dhe çudirat që u quajtën si mrekullitë e profetit të ardhshëm dhe që raportohen me unanimitet në histori dhe në librat e biografisë, dëshmojnë në mënyrë autentike për profetësinë e tij. Ndodhen lloje të shumta të ndryshme prej këtyre *irhasateve*. Një pjesë e tyre përshkruhen në dëshmitë që do të vijnë më poshtë, dhe të tjerat tregohen në formën e rrëfenjave të shëndosha në *Dhul Fikar* dhe në librat e historisë.

Për shembull, dërgimi i zogjve *Ebabil* për të goditur ushtrinë e Ebrehesë, e cila erdhi për të shkatërruar Qabenë, me gurë duke u lëshuar prej kthetrave të atyre zogjve në kokat e ushtarëve, gjë e cila ndodhi para lindjes së tij; dhe në natën e lindjes së tij, të gjithë idhujt e Qabesë duke u përmbysur; dhe pallati i Kisras në Persi u shkatërrua; dhe zjarri i zoroastrianëve -mexhusëve, adhuruesve të zjarrit- u shua në atë natë, i cili kishte qenë i ndezur në mënyrë të vazhdueshme për një mijë vite; dhe reja duke i bërë hije profetit a.s.m., ashtu siç

njoftojnë Prifti Bahira dhe Halime Saëdije... si dhe ngjarje të shumta si këto, njoftuan për profetësinë e tij para fillimit të atij misioni.

Gjithashtu e ardhmja, domethënë ngjarjet të cilat ndodhën pas vdekjes së tij a.s.m., ai i parashikoi dhe njoftoi se ato do të ishin të shumta e të ndryshme. Disa ishin parashikime rreth familjes së tij dhe sahabëve të nderuar, rreth pushtimeve islame. Janë provuar në Trajtesën "Mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m." (të botuara brenda koleksionit *Dhul Fikar*) me rrëfenja të shëndosha tetëdhjetë ngjarje të cilat ndodhën ashtu siç i parashikoi ai. Për shembull, Hazreti Uthmani duke u martirizuar ndërsa ishte duke lexuar Kur'an; Imam Hysejni duke u martirizuar në Kerbela; pushtimet e Sirisë, Iranit dhe Stambollit; shfaqja e dinastisë Abaside, dhe Xhengiz e Hulagu duke e shkatërruar atë, e të tjera si këto, që të gjitha janë përshkruar në mënyrë të hollësishme mbi bazat e rrëfenjave të shëndosha dhe në librat e historisë dhe të biografisë së profetit a.s.m.. Kjo do të thotë se parashikimet e shumta për ngjarjet e së ardhmes dhe për të ardhmen, të cilat provojnë vërtetësinë e Muhammedit a.s.m., dëshmojnë gjithashtu në mënyrë të fuqishme e vendimtare për profetësinë e Muhammedit a.s.m. dhe për vërtetësinë e saj.

Dëshmitë e Nënta, e Dhjeta, e Njëmbëdhjeta dhe e Dymbëdhjeta:

Nëpërmjet dëshmisë së Ehli-Bejtit -Familjes së Muhammedit- për vërtetësinë e tij nëpërmjet fuqisë së besimit të tyre të sigurt tek shkalla e 'sigurisë absolute'; dhe të sahabëve të tij, nëpërmjet besimit të tyre të plotë tek shkalla e 'shikimit të sigurisë'; dhe të dijetarëve të pastër nëpërmjet fuqisë së hetimeve dhe të verifikimeve të tyre tek shkalla e 'njohjes së sigurisë'; dhe të poleve shpirtërorë, nëpërmjet përputhshmërisë së ndriçimeve dhe të zbulesave të tyre për profetësinë e tij dhe për sigurinë e saj.

Domethënë, prej dëshmive universale për vërtetësinë dhe drejtësinë e Muhammedit a.s.m. janë:

E Nënta: Dëshmia e Ehli Bejtit, e Familjes së Profetit Muhammed a.s.m., për të cilët u manifestua kuptimi i "*Dijetarët e Ummetit tim janë si pejgamberët e bijve të Israilit*", dhe të cilët mbahen të barabartë me pasardhësit e Profetit Ibrahim a.s. në *Salevatet e teshehhudit*; të cilët janë Evlija të mëdhenj, dhe dymbëdhjetë imamët, Zoti qoftë i kënaqur me ta; dhe para të gjithë atyre janë Imam Aliu, Hasani, Husejni, Zoti qoftë i kënaqur me ta; Shejh Gejlani, Ahmed Rifaiu, Ahmad El-Bedavi, Ibrahim al-Dasuki, dhe Ebu'l-Hasan al-Shazeli, u shenjtëroftë sekreti i tyre, edhe të tjerë si shembulli i tyre; të gjithë këta

dëshmojnë me unanimitet me besimin e tyre të sigurt, me zbulesat, me vëzhgimet dhe me kerametet e tyre dhe me udhëzimin e tyre që e shfaqën në Ummet, dhe mbështesin me imanin e tyre të fuqishëm profetësinë e Muhammedit a.s.m. dhe vërtetësinë e tij.

Dëshmia e Dhjetë: Dëshmia e Sahabëve të nderuar të cilët janë më të virtytshmit e njerëzve dhe më të lartësuarit e tyre në pozitë pas profetëve a.s.; të cilët e qeverisën botën nga lindja në perëndim me drejtësi dhe me ndershmëri pasi u ndriçuan me dritën e Muhammedit a.s.m. në një periudhë të shkurtër kohe, dhe pavarësisht qënies së tyre nomadë analfabetë, u shfaqën në shtetet e mëdha dhe u bënë profesorët e popujve të civilizuar, të shkencës e të politikës, u bënë mësues për ta dhe politikanë të urtë e të drejtë; ata e transformuan atë shekull në më të mirin e shekujve dhe në shekullin e lumturisë. Këto sahabe të nderuar pasi hetuan dhe shqyrtuan çdo gjendje prej gjendjeve të Muhammedit a.s.m., dhe panë me sytë e tyre fuqinë e mrekullive të tij të shumta, i lanë armiqësinë e tyre të mëparshme dhe rrugët e paraardhësve të tyre, dhe shumë prej tyre si Halid Ibn Velidi dhe Ikrima Ibnu Ebi Xhehl e braktisën tribalizmin e baballarëve të tyre. Ata duke e përqafuar islamin në një mënyrë vërtetë të përkushtuar dhe vetëflijuese, dhe duke besuar në vërtetësinë e Muhammedit dhe në profetësinë e tij me shkallën e 'shikimit të sigurisë', kjo formon një dëshmi universale të palëkundur.

Dëshmia e Njëmbëdhjetë: Është dëshmia e mijërave prej njerëzve të verifikimit, domethënë, dëshmia e muxhtehidëve, e imamëve dhe e dijetarëve autoritarë, të cilët njihen si të pastërtit dhe të vërtetët, dhe e filozofëve gjenialë të tillë si Ibnu Sina dhe Ibnu Rushd, të cilët besuan në mënyrë të arsyeshme e të logjikshme, pavarësisht ndryshimit të metodës së secilit prej tyre nga e tjetrit, duke u mbështetur në mijëra prova vendimtare dhe në argumente të fuqishëm derisa arritën shkallën e 'njohjes së sigurisë'... Besimi i të gjithë këtyre në Muhammedin a.s.m., në profetësinë e tij, në vërtetësinë dhe në drejtësinë e tij është një dëshmi e tillë universale saqë vetëm ai që do të ishte me zgjuarsinë e të gjithë atyre do të mund ta kundërshtonte.

Risale-i Nuri është njëri prej atyre dëshmitarëve të vërtetë në këtë kohë, para të cilit mohuesit i kanë gjetur vetvetet të padobishëm, kështu duke mashtruar policinë dhe drejtësinë, ata janë përpjekur ta heshtin atë nëpërmjet gjykatave.

Dëshmia e Dymbëdhjetë: është dëshmia e poleve shpirtërorë, secili prej tyre ka tërhequr tek rrethi i instruksionit të tij një pjesë të rëndësishme të ummetit në botën islame, dhe nëpërmjet edukimit të tij

të çuditshëm, vizioneve dhe kerameteve i ka bërë ata njerëz të përparojnë shpirtërisht, dhe progresi i të cilëve bazohet mbi ndriçimet dhe zbulesat e realiteteve në vend të provave -ata panë "në mënyrë eksperimentale" nëpërmjet ndriçimeve të tyre profetësinë dhe vërtetësinë e Muhammedit a.s.m. dhe se vërtetësia e tij ishte e shkallës më të lartë.

Atëherë dëshmia e këtyre me unanimitet dhe me përputhshmëri për profetësinë dhe për misionin e tij është një konfirmim i fuqishëm i tillë saqë ai që nuk ka arritur në atë shkallë të virtyteve dhe të plotësimeve aq të lartë sa ajo e tyre, nuk mund ta fshijë apo ta zhdukë atë.

Dëshmia e Trembëdhjetë: e cila përbëhet nga katër prova të sigurta të shtrira e universale, është:

Nëpërmjet dëshmisë së kohëve të shkuara dhe e unanimitetit të sihariqeve të falltarëve, të zërave nga e padukshmja, të njohësve në të gjitha periudhat e së shkuarës, dhe nëpërmjet dëshmisë së sihariqeve të profetëve dhe të mesazhierëve Hyjnorë, paqja qoftë mbi ta, dhe nëpërmjet dëshmisë së tyre dhe lajmeve të tyre të gëzueshme për profetësinë e Muhammedit a.s.m., në librat e shenjtë të mëparshëm.

Një shpjegim i shkurtër i pjesës së lartë do të jepet këtu, ndërsa detajet e tyre të plota dhe zinxhiri i tyre ndodhen në fund të trajtesës "Mrekullitë e Profetit" e botuar brenda koleksionit "Dhul Fikar".

Është regjistruar me rrëfenja të shëndosha, dhe pjesërisht me raportime me unanimitet, në historitë dhe në librat e hadithit dhe në biografinë e Profetit se midis më të shquarve dhe më të famshmive të njerëzimit në kohët e hershme, me në krye profetët, njohësit, fallatrët dhe zërat nga e padukshmja, parashikuan profetësinë dhe ardhjen e Muhammedit a.s.m. në mënyrë të qartë, me unanimitet dhe në mënyrë të përsëritur në formën e "*Irhasateve*". Meqenëse më të fuqishmet dhe më të sigurtat e atyre parashikimeve janë përshkruar në mënyrë të detajuar tek mrekullitë e Profetit Muhammed, ne ju referojmë ju tek ajo dhe këtu vetëm do të themi nëpërmjet një treguesi të shkurtër: Prej qindra vërseteve në librat e shpallur qiellorë si Teurati, Inxhili dhe Zeburi, njëzet vërsete rreth profetësisë së Muhammedit që janë afër të qenurit të qarta janë shkruar në Letrën e Nëntëmbëdhjetë, tek trajtesa "Mrekullitë e Profetit". Ndërsa Husejn el-Xhisri gjeti njëqind vërsete rreth profetësisë së Muhammedit a.s.m., pavarësisht ndryshimeve të shumta në tekstet e tyre të bëra nga çifutët dhe të krishterët, dhe i shkroi ato në librin e tij.[309]

[309] Husejn al-Xhisri, al-Risalat al-Hamidija.

Sipas një rrëfenje të shëndoshë lidhur me të cilën ka raportime me unanimitet, falltarët, me në krye Shikk dhe Satih, të cilët nëpërmjet xhindëve dhe qënieve shpirtërore dhanë informacion rreth të Padukshmes dhe që tani quhen mediume, parashikuan në mënyrë të qartë ardhjen e të dërguarit të Allahut dhe se ai do ta zhdukte perandorinë persiane. Ata pohuan në mënyrë të përsëritur në një mënyrë që nuk mund të dyshohej se një profet do të shfaqej së afërmi në Hixhaz. Gjithashtu, Ka'b Ibn Lu'ayyi, njëri nga stërgjyshërit e Profetit dhe një Njohës, dhe shumë njohës e shenjtorë të tjerë të tillë si: Sajf Ibn Dhi Yazan dhe Tubba prej sundimtarëve të Jemenit dhe të Abisinisë, parashikuan qartë profetësinë e Muhammedit a.s.m., dhe e njoftuan atë në pozitën e tyre. Më të rëndësishmet dhe më të sigurtat e tyre janë përfshirë në Letrën Nëntëmbëdhjetë. Madje njëri prej atyre mbretërve tha: Unë do ta preferoja më shumë të isha shërbëtor i Muhammedit mbi sundimin e kësaj mbretërie". Një tjetër tha: "Në qoftë se do të kisha jetuar për ta parë, unë do të kisha qenë kushëriri i tij". Domethënë, unë do të kisha qenë një shërbëtor i përkushtuar dhe një ministër i tij, si Aliu, Zoti qoftë i kënaqur prej tij. Historia dhe librat e biografisë i kanë botuar të gjitha këto parashikime, duke treguar se njohësit e afirmuan profetësinë dhe vërtetësinë e Muhammedit a.s.m. me një dëshmi të fuqishme universale.

Gjithashtu, qëniet shpirtërore të quajtur *Hatif*, të cilat janë dëgjuar por nuk janë parë, bënë parashikime rreth profetësisë së Muhammedit a.s.m, në të njëjtën mënyrë ashtu si njohësit dhe si falltarët, duke e parashikuar profetësinë e tij në mënyrën më të qartë. Gjithashtu, duke parashikuar profetësinë e tij, shumë gjëra të tjera të tilla si: kafshët e sakrifikuara për idhujt, idhujt, gurët e varrëve e afirmuan profetësinë dhe vërtetësinë e Tij; duke e dëshmuar këtë nëpërmjet gjuhës së historisë.

***Dëshmia e Katërmbëdhjetë*:** Pjesa vijuese në arabisht aludon për dëshminë e fuqishme të universit:

Nëpërmjet dëshmisë së universit për profetësinë gjithëpërfshirëse të Muhammedit a.s.m. nëpërmjet synimeve të saj dhe qëllimeve Hyjnore në të, ose përndryshe ai nuk do të ishte asgjë, sepse nëpërmjet dërgimit të një njeriu dhe veçanërisht të Muhammedit, vlera dhe detyrat e tij u vendosën, bukuritë dhe plotësimet e tij u bënë të qarta, dhe urtësia në të vërtetat e tij u kuptuan. Sepse profetësia e tij i zbuloi ato dhe ishte mjet për kuptimin e tyre. Po të mos kishte qenë profetësia e tij, ky univers i përkryer, ky libër i madh me kuptime të përjetshme do të kishte qenë kot, kuptimet e tij do të ishin zhdukur dhe plotësimet

e tij do të kishin rënë krejtësisht, gjë e cila është e pamundur në drejtime të shumta.

Trajtesa e El-Ajetul Kubra përmendi lidhur me këtë paragraf sa vijon:

Ashtu siç tregon universi Autorin e tij, Shkruesin, dhe Skalitësin, i Cili e krijoi, e administron dhe e organizon atë, dhe i Cili duke e dekoruar, duke e përcaktuar dhe planifikuar, ushtron autoritet e kontroll të plotë mbi të sikur ai të ishte një pallat, një libër, një ekspozitë, dhe një vend shfaqjeje, po ashtu ai kërkon një lajmëtar të lartë, një zbulues të vërtetë, një profesor të saktë, dhe një mësues besnik, i Cili do t'i njihte qëllimet Hyjnore në krijimin e tij, që t'i bënte ato të njohura, që do t'i jepte mësim shembujt e urtësisë Hyjnore në ndryshimet e tij, të shpallte rezultatet e lëvizjeve të tij funksionale, dhe të shpallte vlerën dhe plotësimet e qënieve brenda tij. Meqenëse kjo është kështu dhe universi e shfaq ekzistencën e tij, sigurisht duke dëshmuar në mënyrë të fuqishme dhe universale për vërtetësinë e Muhammedit a.s.m., i cili i përmbushi këto detyra më mirë se kushdo tjetër, dhe për qënien e tij zyrtari më i lartë e më besnik i Krijuesit të tij, ai deklaron: *"Unë dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Zotit xh.sh."* Po, nëpërmjet dritës që solli profeti Muhammed a.s.m., natyra e universit, vlera, plotësimet, detyrat, rezultatet dhe vlera e qënieve brenda tij dhe fakti se ato janë nëpunëse, që të gjitha u bënë të njohura dhe të kuptueshme. Madje i gjithë universi u bë si mesazhe kuptimplote Hyjnore; si një Kur'an i mishëruar Hyjnor dhe si një ekspozitë madhështore e veprave Hyjnore. Në qoftë se nuk do të ishte drita e Tij, universi do të bëhej thjesht një rrënojë e shkretë, dhe një vend zie i ngatërruar dhe i tmerrshëm, duke u rrokullisur në errësirat e mosekzistencës, asgjësisë, vdekjes dhe zhdukjes. Si rrjedhojë e kësaj të vërtete, plotësimet e universit, transformimet e qëllimshme dhe kuptimet e përjetshme deklarojnë në mënyrë të fuqishme: *"Ne dëshmojmë se Muhammedi është i Dërguari i Allahut".*

Dëshmia e Pesëmbëdhjetë: Kjo që vijon është një pjesë arabisht e cila përmban dëshmi të shumta të shenjta. Ajo tregon dëshminë e shenjtë për profetësinë e Muhammedit të dhënë nëpërmjet akteve të Hyjnisë dhe veprave të mëshirës së Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, i Cili ushtron autoritet e kontroll të plotë mbi universin, dhe nëpërmjet vullnetit të Tij, urdhërit dhe fuqisë ndodhin të gjitha ndryshimet dhe transformimi, lëvizja dhe pushimi, duke filluar nga grimcat për tek planetët dhe të gjitha dispozitat e jetës dhe të vdekjes; ky paragraf arabisht shpreh këtë dëshmi të lartë:

Nëpërmjet dëshmisë së pronarit të universit, Krijuesit dhe Rregullatorit të tij, për profetësinë e Muhammedit a.s.m., nëpërmjet veprave të Mëshirës së tij dhe akteve të Hyjnisë së Tij; të tilla si mëshira e shpalljes së Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm mbi të; dhe shfaqja e llojeve të shumta të mrekullisë nga dora e tij; duke e ndihmuar dhe duke e mbrojtur atë në të gjitha rrethanat; duke e përjetësuar fenë e tij me të gjitha të vërtetat e saj, duke e ngritur atë në një pozitë të respektit dhe të nderimit të lartë dhe duke e nderuar mbi të gjitha krijesat që shihen e vëzhgohen; dhe akti i Tij i Hyjnisë duke e bërë profetësinë e Muhammedit a.s.m. një diell shpirtëror në univers, dhe duke e bërë fenë e tij indeksin e plotësimeve të shërbëtorëve të Tij; dhe duke e bërë realitetin e tij një pasqyrë gjithëpërfshirëse për manifestimet e Hyjnisë së Tij, dhe duke i besuar atij detyrat e domosdoshme për ekzistencën e krijesave në univers të tilla si domosdoshmëria e mëshirës, e urtësisë, e drejtësisë që janë aq të domosdoshme si ushqimi, uji, ajri dhe drita.

Duke ia referuar detajet e kësaj dëshmie më të gjërë, të sigurt e të shenjtë Risale-i Nurit, ne këtu vetëm do të hedhim një shikim tek një kuptim i përmbledhur e konçiz i tij.

Meqenëse -në përputhje me drejtësinë, urtësinë, mëshirën, favorin dhe mbrojtjet të cilat ne i shohim në mënyrë të rregullt e të sistemuar në univers- është praktika e Hyjnisë që gjithmonë të mbrojë të mirët dhe të godasë të këqinjtë dhe gënjeshtarët, ashtu siç kërkohet nga "aktet e mëshirës së Tij", Rregulluesi i kësaj bote dhe Administruesi shpalli mbi Muhammedin a.s.m. Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm; Ai i dhuroi atij aftësisht një mijë mrekulli prej llojeve të shumta; dhe me mëshirë e ruajti atë në të gjitha rrethanat dhe në situatat e rrezikshme, madje edhe me anë të një pëllumbi dhe të një merimange; dhe i dha atij sukses të plotë në të gjitha detyrat e tij; dhe e përjetësoi fenë e tij së bashku me të gjitha të vërtetat e saj; dhe i shkaktoi fesë së tij islame të përhapet gjithandej tokës dhe tek të gjithë njerëzimi; dhe duke e ngritur atë në një pozitë nderimi mbi të gjitha krijesat dhe në një rang të përhershëm pranueshmërie që është më i lartë se ai i më të shquarve të njerëzimit; dhe duke i dhënë personit të tij të mbajë më të bukurat e cilësive të lavdëruara e të larta, ashtu siç bien dakord miqtë dhe armiqtë, saqë e bëri një të pestën e njerëzimit prej Ummetit të tij. E gjitha kjo dëshmon në mënyrën më vendimtare për vërtetësinë dhe profetësinë e Muhammedit a.s.m..

Gjithashtu ne shohim nga këndvështrimi i 'Akteve të Hyjnisë' se Regulluesi dhe Administruesi i kësaj bote e bëri profetësinë e

Muhammedit a.s.m. një diell në univers, dhe ashtu siç është provuar në Risale-i Nur, e bëri atë të largojë të gjitha llojet e errësirave dhe t'i shfaqë të vërtetat e tij të ndritshme, dhe i bëri të lumtur të gjitha qëniet e vetëdijshme, madje të gjithë universin, me sihariqet e jetës së përhershme; dhe Ai e bëri fenë e tij një indeks plotësimesh për të gjithë njerëzit e pranueshëm të adhurimit dhe një program të fortë për aktet e tyre të adhurimit; dhe ashtu siç tregohet nga Kur'ani dhe nga *Xheushani*, Ai e bëri realitetin e Muhammedit, i cili është personaliteti i tij kolektiv, një pasqyrë gjtihëpërfshirëse për manifestimet e Hyjnisë së Tij; dhe ashtu siç tregohet nga të vërtetat e lartëpërmendura, dhe nga fakti se çdo ditë për katërmbëdhjetë shekuj, ai ka fituar barasvlerën e të gjitha veprave të mira të të gjithë ummetit të tij, dhe nëpërmjet veprave dhe gjurmëve të tij në jetën shoqërore dhe shpirtërore të njeriut, Ai e bëri atë udhëheqësin më të lartë, profesorin, dhe modelin më të mirë të të gjithë njerëzimit; dhe e dërgoi atë për t'i ardhur në ndihmë të gjithë njerëzimit me detyrat e shenjta e sublime, dhe i bëri njerëzit aq shumë të nevojshëm për fenë e tij, për sheriatin dhe për të vërtetat e islamit[310], aq sa ata kanë nevojë për mëshirë, urtësi, drejtësi, ushqim, ajër, ujë dhe dritë… Kështu duke dhënë dëshminë e shenjtë për profetësinë e Muhammedit a.s.m. me dymbëdhjetë prova vendimtare universale –meqenëse është kështu, a do të ishte e mundur që profetësia e Muhammedit a.s.m., e cila i manifeston kështu këto dëshmi universale e të gjëra të Pronarit të universit, i Cili nuk është indiferent as për të rregulluar krahun e një mizeje ose të një luleje, të mos ishte një diell për universin?

• • •

[310] Kur po vuaja në pleqërinë dhe në dobësinë time, unë ndjeva një të miliontën e ushqimit shpirtëror që vinte nga profeti Muhammed a.s.m..

Në qoftë se do të kisha mundur, unë do ta kisha falënderuar atë duke bërë miliona salevate për të me miliona gjuhë. Kjo ishte sa vijon:

Unë vuaj shumë nga ndarja dhe zhdukja, megjithëse dynjaja të cilën e dua dhe gjërat në të më lënë mua me largimin e tyre dhe me ndarjen e tyre prej meje. Unë e di se edhe unë gjithashtu do të largohem. Mua më sundojnë një dhimbje e një pikëllim i fortë. Por unë gjej ngushëllim dhe shpëtoj krejtësisht prej këtij pikëllimi duke dëgjuar lumturinë e përjetshme dhe jetën e pavdekshme nga Profeti Muhammed a.s.m.; saqë kur unë them: *"Esselamu alejke ejjuhen nebijju ve rahmetull-llahi ve berakatuhu"* në *teshehhud*, unë i paraqes atij besëlidhjen time me të, bindjen time dhe nënshtrimin tim ndaj misionit të tij dhe duke i dhënë urime për detyrën e tij i shpreh një lloj falënderimi atij dhe një përgjigje ndaj atij sihariqi për lumturinë e përjetshme, dhe kështu të gjithë myslimanët i japin këto përshëndetje pesë herë në çdo ditë.

Secila prej këtyre pesëmbëdhjetë dëshmive përmban dëshmi të shumta; madje dëshmia e Dytë e provoi pretendimin: "*Eshhedu enne Muhammeden Resulull-llah*" në mënyrën më të fuqishme e të sigurt dhe duke shpallur realitetin e saj, vlerën dhe rëndësinë, saqë në çdo ditë pesë herë në *teshehhud* bota islame e shpall atë për universin me miliona gjuhë. Gjithashtu, me mijëra miliona besimtarë pa ngurrim pranojnë dhe vërtetojnë se Realiteti Muhammedan a.s.m., që është baza e atij pretendimi, është fara origjinale e universit, është arsyeja për krijimin e tij, dhe fruti i tij më i plotë. Dhe Pronari i Universit e bëri atë personalitet kolektiv të Muhammedit lajmëtarin më të lartë të sovranitetit të Hyjnisë së Tij; e bëri zbuluesin e saktë të talismanit të universit dhe të enigmës së krijimit dhe një shembull të ndritur të mirësive dhe të mëshirës së Tij; e bëri gjuhën elokuente të mëshirës dhe të dashurisë së Tij; dhe përgëzuesin më të fuqishëm të sihariqeve për jetën e amshuar dhe për lumturinë në botën e përjetshme; dhe e bëri vulën e të dërguarve të Tij dhe më të madhin e profetëve të Tij. Nga kjo mund të shikohet se çfarë gabimi i madh, çfarë marrëzie dhe krimi kryejnë ata njerëz të cilët nuk e pranojnë një të vërtetë të tillë si kjo, ose që nuk i japin rëndësi asaj, dhe çfarë humbje të madhe do të pësonin ata.

Kështu siç u tregua në pjesën e dytë, sureja el-Fatiha në faljet Rituale demonstron me prova vendimtare afirmimin e Unitetit Hyjnor në pohimin "*Eshhedu en la-ilahe il-lall-llah", "Dëshmoj se nuk Zot tjetër përveç Allahut"*, e cila thuhet në teshehhud, duke vënë firma të panumërta për të; po kështu kjo ***pjesa e Tretë*** paraqet dëshmi të fuqishme për realitetin e profetësisë të pretenduar në: "*Eshhedu enne Muhammeden Resulull-llah", "Dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Allahut",* duke e vulosur atë me nënshkrime të panumërta konfirmimi.

O Më i Mëshirshmi i mëshiruesve! Në nderim të profetit Tënd më të nderuar, na e lejo neve shefaatin e tij, na jep neve sukses në ndjekje të sunnetit të tij, dhe na bëj neve komshi të Familjes së tij dhe të sahabëve të tij në Botën e Lumturisë! Amin. Amin. Amin.

O Zot! Jepi atij bekime e paqe, si dhe Familjes së tij dhe sahabëve, sa numri i shkronjave të Kur'anit, të recituara e të shkruara. Amin.

Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je I Gjithëdituri, i Gjithurti.

*** * ***

Prova e Ndritur

Stacioni i Dytë

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Dhe prej Tij ne kërkojmë ndihmë.

[Njëra nga të vërtetat e vërsetit të fundit të sures el-Fatiha, i cili tregon krahasimin midis njerëzve të udhëzimit dhe të rrugës së drejtë me atë të njerëzve të çudhëzimit dhe të rebelimit, dhe i cili është burimi i të gjitha krahasimeve në Risale-i Nur, shprehet gjithashtu në mënyrë të çuditshme dhe të mrekullueshme nga vërseti i sures *Nur*.

"*Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës. Shembulli i Dritës së Tij është si të kishim një qoshe të errët dhe në të një llambë, llamba e futur në një kupë qelqi, kupa e qelqit si të ishte yll që shkëlqen i ndezur nga një pemë e bekuar, nga ulliri, as nga lindja (që nuk i merr rrezet vetëm në mëngjes), as nga perëndimi (që nuk i merr rezet vetëm pasdite, por është nën rrezet e diellit gjate gjithë ditës), vaji i të cilit digjet vetvetiu edhe pse nuk e ka prekur zjarri fare. Dritë përmbi Dritë! Allahu udhëzon drejt Dritës së Tij atë që do Ai. Dhe Allahu sjell shembuj e përngjasime për njerëzimin dhe Allahu është për çdo gjë i Gjithëditur.*[311] Dhe një vërset vijues:

*"Ose (gjendja e mosbesimtarit) është si errësira në detin e gjërë e të thellë të mbuluar nga valë masive, të mbuluara nga re të zeza, ...(*deri në fund të vërsetit).[312]

Është provuar në Rrezen e Parë se vërseti i parë lart, Vërseti i Dritës, përmban dhjetë aluzione për Risale-i Nurin, ai në mënyrë të mrekullueshme e parashikon atë koment të Kur'anit Kerim. Kjo ishte arsyeja kryesore që emri *Nur* -Drita- iu dha Risale-i Nurit. Si rrjedhojë e përshkrimit, në krahasimin e një udhëtimi imagjinar në një pjesë të Letrës së Njëzet e Nëntë, të një mrekullie që i ngjasonte *Nunit* të "*Naëbudu*" në fjalën "*Nur*" në këtë vërset të jashtëzakonshëm, udhëtari në trajtesën "El-Ajetul-Kubra" pyeti të gjithë universin dhe çdo lloj të

[311] Kur'an 24:35
[312] Kur'an 24:40

qënieve me qëllim që të kërkonte, të gjente dhe të mësonte rreth Krijuesit të tij. Ai erdhi për ta njohur Atë nëpërmjet tridhjetë e tre rrugëve dhe provave bindëse me 'sigurinë e njohjes' dhe me 'shikimin e sigurisë'. Udhëtari i palodhur dhe i pangopur udhëtoi gjithashtu me mendjen e tij, me zemrën dhe imagjinatën nëpër shekuj dhe nëpër nivelet e qiejve dhe të tokës, dhe duke parë e inspektuar të gjithë botën si një qytet, ai e hipi mendjen e tij ndonjëherë mbi urtësinë e Kur'anit, dhe ndonjëherë mbi filozofi, dhe duke parë me ngulm nivelet më të largëta nëpërmjet teleskopit të fuqishëm të imagjinatës, ai e pa realitetin ashtu siç është, dhe pjesërisht na informoi neve për të në trajtesën El-Ajetul-Kubra.

Tani, prej atyre botërave dhe niveleve të shumtë tek të cilat ai hyri në udhëtimin e tij imagjinar, i cili kishte kuptimin e një krahasimi dhe ishte krejtësisht në përputhje me realitetin, ne do të shpjegojmë nëpërmjet shembullit vetëm tre nivele, shumë të përmbledhur, me qëllim që të ilustrojmë krahasimin tek fundi i sures *El-Fatiha*. Por kjo do të jetë vetëm nga këndvështrimi i fuqisë së arsyes. Ne ua referojmë juve Risale-i Nurin për vëzhgimet dhe krahasimet e tjera.

Shembulli i Parë është ky:

Udhëtari, i cili kishte ardhur në botë vetëm për të gjetur Krjuesin e Tij dhe që u bë i njohur me Të, i tha arsyes: "Ne kemi pyetur çdo gjë lidhur me Krijuesin tonë dhe kemi marrë përgjigje plotësisht të kënaqshme. Me qëllim që të mësojë rreth Diellit, njeriu duhet të pyesë vetë Diellin, kështu, ne do të bëjmë një udhëtim tjetër me qëllim që ta gjejmë e të bëhemi të njohur me Krijuesin tonë nëpërmjet manifestimeve të atributeve të tij të 'njohjes', të 'dëshirës' dhe të 'fuqisë' dhe nëpërmjet akteve të Tij të dukshme dhe nëpërmjet manifestimeve të Emrave të Tij..."

Kështu, Ai hyri në botë. Pastaj njerëzit e çudhëzimit të cilët përfaqësojnë rrymën ë dytë, hipën në anijen e tokës. Udhëtari veshi -vuri- syzet e shkencës dhe të filozofisë të cilat nuk e ndjekin urtësinë e Kur'anit, dhe duke parë sipas programit të gjeografisë, e cila nuk e lexon Kur'anin, pa se toka udhëtonte shtatëdhjetë herë më shpejt se sa një gjyle topi duke përshkuar distancën e njëzet mijë viteve për një vit në një orbitë në mes të një hapësire të pafundme. Ajo kishte marrë mbi vetveten qindra e mijëra lloje gjallesash të pafuqishme e të mjera. Ai kuptoi se në qoftë se ajo do ta ngatërronte rrugën e saj sikur për një minut, ose në qoftë se do të humbiste rrugën dhe të përplasej me një planet tjetër, ajo do të shpërbëhej duke i lëshuar të gjitha ato krijesa të mjera në asgjësi, në mosekzistencë, në kotësi e në humbje.

Duke perceptuar fatkeqësinë e madhe të rrymave të *"...Jo (në rrugën e atyre që merituan zemërimin Tënd mbi vete dhe as në (rrugën), e atyre të cilët u humbën",*[313] dhe errësirat mbytëse *"ose (gjendja e mosbesimit) është si errësira në detin e gjërë e të thellë të mbuluar nga valë masive..."*[314] ai thirri nga thellësitë e tij: "Oh sa keq! çfarë kemi bërë? Përse hipëm në këtë anije të tmerrshme? A ka ndonjë rrugë për të shpëtuar prej saj?" Ndërkaq duke i copëtuar syzet e filozofisë së verbër, ai iu bashkua rrymës së "*atyre të cilëve Ti u ke dhuruar Mëshirën Tënde".*[315]

Papritmas urtësia e Kur'anit i erdhi atij në ndihmë. Duke i dhënë atij një teleskop i cili shfaq realitetin, ajo i tha atij të shikonte nëpërmjët tij. Ai hodhi vështrimin dhe pa Emrin e *"**Rabbis-semavati ve erd"** "Zoti i qiejve dhe i tokës"* duke ndriçuar si një diell në yjësinë e Fjalës së Tij xh.sh."

"*Ai është i Cili e ka bërë tokën të dobishme dhe të përshtatshme për ju, kështu që ecni nëpër rrugë dhe hani nga rizku (të mirat e furnizimi) i Tij..."*[316]

Zoti, Mbështetësi, e ka bërë tokën një anije të rregullt e të sigurt, dhe e mbushi atë me qënie të gjalla së bashku me furnizimet e tyre me ushqim, duke e bërë atë të udhëtojë përreth diellit në detet e universit për dobi të shumta dhe për shembuj urtësie, duke sjellë prodhimet e stinëve për ata të cilët janë të nevojshëm për rizk-furnizim. Dy Melekët -engjëjt- e quajtur *Thaur* dhe *Hut* u caktuan nga Allahu xh.sh. si kapitenë dhe drejtues të asaj anije. Dhe ata të dy e morën atë në udhëtimin e saj nëpër mbretërinë Hyjnore e cila është me madhështi të pafundme me qëllim që t'i kënaqë krijesat e Krijuesit të Gjithëlavdishëm dhe mysafirët e Tij në hapësirën e këtij universi të gjërë, udhëtari kuptoi se kjo shfaqi realitetin e "*Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës",* duke bërë të njohur Krijuesin e tij nëpërmjet këtij Emri. Me të gjithë zemrën dhe shpirtin e tij ai thirri duke thënë: *"El-Hamdu lil-lahi Rabbil a'lemine", "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve",* dhe iu bashkua grupit të *"atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mëshirën Tënde".*

Shembulli i Dytë i asaj që pa udhëtari në udhëtimin e tij nëpër botëra:

---

[313] Kur'an 1 : 7
[314] Kur'an 24:40
[315] Kur'an 1 : 7
[316] Kur'an 67:15

Pasi ai udhëtar e la anijen e tokës, hyri në botën e njeriut dhe të kafshëve. Ai e pa atë botë nëpërmjet syzeve të shkencës natyrale e cila nuk e merr jetën dhe shpirtin e saj nga feja, dhe pa se megjithëse ato gjallesa të panumërta kishin nevoja të pafundme dhe sulmoheshin nga armiq të bezdisshëm të panumërt dhe nga ngjarje mizore, kapitali i tyre ishte vetëm i njëmijëti ose i njëqindmijëti i asaj për të cilën ata kishin nevojë. Fuqia e tyre gjithashtu ishte ndoshta një e milionta e asaj që ishte e domosdoshme për t'i luftuar ato gjëra të dëmshme. Duke qenë të lidhur me to nëpërmjet mendjes së tij dhe nga mëshira për qëniet e llojit të tij, atij i erdhi aq shumë keq për to për gjendjen e tyre të tmerrshme, dhe duke ndjerë një dhimbje të tmerrshme ishte aq i dëshpëruar dhe i pikëlluar, saqë ai u pendua një mijë herë për hyrjen e tij në këtë botë të pikëlluar e të mjerë.

Ndërkaq papritmas i erdhi në ndihmë urtësia e Kur'anit Kerim, dhe duke i dorëzuar atij teleskopin e *"atyre të cilëve Ti u ke dhuruar mëshirën Tënde",* duke i thënë atij: Shiko! Ndërkohë ai hodhi vështrimin dhe pa se secili prej Emrave të bukur Hyjnorë të tillë, si: ***Er-Rahman, Er-Rahim, Er-Rezzak, El-Mun'im, El-Kerim, El-Hafidhu****, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, Furnizuesi, Mirëbërësi, Gjithëbujari* dhe *Gjithëruajtësi,* secili ndriçonte si dielli vezullues nëpërmjet manifestimit të "*Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës*", në yjësitë e vërseteve të tilla, si:

"Nuk ka asnjë krijesë të gjallë që Ai të mos e ketë mbërthyer pas balukeve të ballit (ta ketë nën sundimin e Tij të plotë.)[317]

"Dhe sa shumë krijesa të gjalla nuk mbartin dot ushqimin e tyre! Allahu është i Cili i ushqen ata dhe ju..."[318]

"Dhe vërtet që ne i kemi nderuar Bijtë e Ademit..." [319]

"Vërtet që të devotshmit në besim do të jenë në lumturi (në xhennet).[320]

Ato e mbushën botën e njeriut dhe të kafshëve me mëshirë e me mirësi duke e transformuar atë në një parajsë të përkohshme. Udhëtari kuptoi se kjo dynja me gjithçka që ajo përmban bën të njohur në mënyrë perfekte Mikpritësin Gjithëbujar të kësaj bujtine të bukur e të vlefshme për t'u vëzhguar, të mbushur me mësime instruktive, dhe një mijë herë përsëriti duke thënë: *"El-Hamdu lil-lahi Rabbil-Alemine".*

---

[317] Kur'an 11:56
[318] Kur'an 29:60
[319] Kur'an 17:70
[320] Kur'an 82:13

Shembulli i Tretë i qindra prej vëzhgimeve gjatë udhëtimit të tij:

Ai udhëtar në dynja, i cili deshi të njohë Krijuesin e tij, nëpërmjet manifestimeve të Emrave të Tij të bukur dhe atributeve të Tij madhështore iu adresua mendjes dhe imagjinatës së tij duke u thënë: Ejani të ngjitemi tek qiejt e lartë ashtu si shpirtërat dhe melekët duke i lënë trupat tonë në tokë, dhe le t'i pyesim banorët e qiejve për Krijuesin tonë. Ndërkohë ai i hipi mendjes, mendimit, shpirtit dhe imagjinatës dhe u ngjitën të gjithë në qiej duke e marrë astronominë si udhëzuesin e tyre; ato panë me teleskopin e *"atyre që merituan Zemërimin Tënd mbi vete"* dhe *"të atyre të cilët u humbën"*, domethënë me teleskopin e filozofisë e cila nuk i kushton vëmendje fesë, dhe ndërkaq udhëtari pa: Me mijëra trupa qiellorë dhe yje të përflakur, një mijë herë më të mëdhenj se toka dhe duke lëvizur të ndërfutura njëri brenda tjetrit njëqind herë më shpejt se sa gjylja e topit, ndërsa janë të pavetëdijshme, të pajeta dhe të paqëllimta. Në qoftë se rastësisht njëra prej tyre do ta kishte ngatërruar rrugën e saj për një sekond, ajo do të ishte përplasur me një glob tjetër të pavetëdijshëm në atë botë të pakufishme, të zbrazur e të pafundme, duke shkaktuar pështjellim e kauz të plotë, si kijameti. Në cilindo drejtim që pa udhëtari u mbush me frikë, me tmerr e habi, dhe u pendua një mijë herë që u ngjit në qiell. Mendja dhe imagjinata e tij u copëtuan e u tronditën plotësisht. Ato të dyja thanë: Ne nuk duam të njohim kuptime të këtilla të shëmtuara të dhimbshme e torturuese si torturimi i Ferrit, madje ne tërhiqemi prej vëzhgimeve të tyre, sepse detyra jonë themelore është të shohim të vërtetat e bukura dhe t'i shfaqim ato.

Dhe ndërsa thonin kështu, papritmas nëpërmjet manifestimit *"Allahu është Drita e qiejve dhe e tokës"* ndriçuan Emrat Hyjnorë ***"Ha'likus semavati vel-Erd"***, *"Krijuesi i qiejve dhe i tokës"*; ***"Museh-hirish-shemsi Vel kamer"*** *"Nënshtruesi i Diellit dhe i Hënës"* dhe ***"Rabbul-Alemine"*** *"Zoti i të gjitha botëve"*, secili prej këtyre ndriçoi si dielli në yjesitë e këtyre vërseteve:

"Dhe vërtet që Ne e kemi zbukuruar qiellin më të afërt me Drita,..."[321] dhe

"A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si ne e kemi ndërtuar atë dhe zbukuruar..."[322]

---

[321] Kur'an 67:5
[322] Kur'an 50: 6

"Pastaj Ai istewa ila (u ngrit lart drejt) qiellit dukę i bërë ata shtatë qiej..."[323]

Dritat e atyre Emrave Hyjnorë i mbushën të gjithë qiejt me dritë dhe me melekë, duke i transformuar ato në një xhami madhështore ose në një fushim ushtarak. Ndërkaq udhëtari hyri brenda grupit të *"atyre të cilëve Ti u ke dhuruar Mëshirën Tënde";* ai shpëtoi prej errësirave të *"atyre të cilët u humbën",* dhe *"ose (gjendja e mosbesimtarit) është si errësira në detin e gjërë e të thellë të mbuluar nga valë masive...";* dhe papritmas ai pa një mbretëri të bukur madhështore e të mirërregulluar si parajsa. Duke vëzhguar se në të gjitha anët banorët e saj po bënin të njohur Krijuesin e Gjithëlavdishëm, vlera e mendjes së tij dhe e imagjinatës u shtua njëmijëfish, dhe detyrat e atyre të dyjave u lartësuan në të njëjtën shkallë.

Duke ia referuar Risale-i Nurit vëzhgimet e tjera të udhëtarit nëpër univers, të cilat janë të krahasueshme me këto tri shembuj që u përmendën prej qindra shembujve tek udhëtimi i tij për të njohur Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm nëpërmjet manifestimeve të Emrave të Tij, ne këtu mjaftohemi me këto tregues të përmbledhur dhe e presim shkurt këtë histori të gjatë.

Tani, ashtu si ai udhëtari nëpër botë, ne do të përpiqemi ta njohim Krijuesin e univesit nëpërmjet veprave dhe manifestimeve të vetëm Atributeve të ***Njohjes***, ***Vullnetit*** dhe ***Fuqisë*** midis shtatë Atributeve të mëdhaja të shenjta të Krijuesit tonë dhe prej argumenteve që japin ato tre atribute madhështore. Për detajet e tyre ne ju referojmë ju tek Risale-i Nuri.

Pjesa vijuese në arabisht është përmbledhja dhe substanca *e Hizb en-Nurit*, të cilën unë vazhdimisht e recitoj në mënyrë reflektive. Ai shpjegon tre nga tridhjtetë e tre shkallët e Fjalisë "*Allahu Ekber*". Kjo ndiqet nga një lloj përkthimi i pjesës arabisht, që përbëhet nga tregues të shkurtër, të cilat hapin rrugën e fitimit të besimit në Njohjen Hyjnore, Vullnetin, dhe fuqinë me shkallën e 'shikimit të sigurisë' duke shfaqur manifestimet e tyre në univers, e cila është një temë që i ka preokupuar shumë dijetarët e teologjisë dhe të parimeve të besimit.

Duke shfaqur manifestimet e ***Njohjes***, ***Vullnetit***, dhe ***Fuqisë*** treguesit vijues hapin kështu rrugën për besim të plotë -me shkallën e njohjes së sigurisë- në ekzistencën dhe në Unitetin e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, dhe për vërtetimin e atij besimi.

---

[323] Kur'an 2:29

Me Emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Dhe thuaj: "Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun i Cili nuk ka lindur bir (e asnjë lloj pasardhësi) dhe i Cili nuk asnjë shok a të barabartë në Mbisundimin e Tij, as nuk është Ai aq poshtë sa të ketë Veli (ndihmues, mbrojtës e mbështetës). Dhe lartësoje Atë me gjithë madhështinë dhe madhërinë (thuaj ***Allahu Ekber*** *-Allahu është më i madh!)".*[324]

Allahu është më i madh se çdo gjë tjetër lidhur me fuqinë dhe njohjen, sepse Ai është Njohësi i të gjitha gjërave me njohjen gjithëpërfshirëse të domosdoshme të Esencës së Tij.[325] *Asgjë nuk mund të fshihet prej Njohjes së Tij për shkak të misterit të prezencës së saj, dëshmimit dhe gjithëpërfshirjes së dritësisë; dhe për shkak të misterit të ekzistencës që bën të domosdoshme universalitetin, dhe drita e njohjes gjithërrethon të gjithë botën e ekzistencës. Po, rregulli i balancuar, peshat e rregullta, urtësia e përgjithshme dhe e qëllimshme, dhe mirësitë e veçanta gjithëpërfshirëse, dhe dekretet e mirorganizuar, dhe paracaktimet frutdhënëse dhe orët e përcaktuara e të specifikuara të vdekjes, dhe furnizimet e rregullta, dhe mjeshtëritë e larta të artit, dhe përkujdesja e stolisur, dhe rregulli krejtësisht i përkryer, harmonia, rregullshmëria, mjeshtëria, balancimi dhe dallueshmëria absolute, që të gjitha këto tregojnë njohjen gjithëpërfshirëse të Gjithënjohësit të së padukshmes.*

"A nuk e di Ai i Cili ka krijuar? Dhe Ai është më i Buti dhe më Dashamirësi (ndaj robëve të Tij), i Mirënjohuri për çdo gjë".[326]

Krahasimi ndërmjet artit të hollë të njeriut, i cili tregon vetëdijen e tij, dhe krijimit të bukur të njeriut, i cili tregon Krijuesin e njeriut, është krahasimi i dritës së dobët, të vockël, të një xixëllonje në një natë të errët me shkëlqimin e diellit në mes të ditës.

Duke i dhënë një përkthim të përmbledhur paragrafit lart ne do të bëjmë një tregues të shkurtër për njohjen Hyjnore, këtë të vërtetë më të rëndësishme të besimit, dhe studimin e saj të detajuar do t'ia referojmë Risale-i Nurit.[327]

---

[324] Kur'an 17:111

[325] "Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë: ashtu siç është e domosdoshme drita gjithëpërfshirëse për Diellin. Autori.

[326] Kur'an 67:14

[327] Pjesa e mbetur e kësaj trajtese u shkrua ndërsa po vuaja nga një sëmundje e tmerrshme, për shkak të qënies i helmosur, që unë nuk e kisha përjetuar kurrë më parë në jetën time. Prandaj gabimet e mia

Po, ashtu si mëshira që e shfaq vetveten më qartë se dielli nëpërmjet furnizimeve të çuditshme me ushqime dhe provon në mënyrë vendimtare se prapa perdes së të padukshmes është një i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë, po ashtu "njohja" e cila është përmendur në qindra vërsete të Kur'anit, dhe e cila –nga një aspekt- është e para e Shtatë Atributeve të mëdhaja, e shfaq vetveten si drita e diellit me frutat e rregullit dhe të drejtpeshimit në gjëra, dhe bën të njohur me siguri ekzistencën e Njohësit të të gjitha gjërave.

Po, krahasimi ndërmjet artit të regullt e të balancuar, i cili tregon vetëdijen dhe njohjen e njeriut, dhe krijimit të njeriut në modelin më të mirë, që tregon njohjen dhe urtësinë e Krijuesit të njeriut, i ngjason krahasimit midis dritës së dobët të xixëllonjës në një natë të errët me dritën gjithëpërfshirëse të diellit në mes të ditës.

Tani, para se të shpjegojmë dëshmitë e Njohjes Hyjnore, ne do të përmendim në mënyrë të përmbledhur bashkëbisedimin e shenjtë i cili ndodhi gjatë Miraxhit të profetit a.s.m.. Sepse Miraxhi i Muhammedit a.s.m. tregon e dëshmon se, nëpërmjet manifestimeve të tij në univers, Atributi i Shenjtë i Njohjes tregon Esencën më të pastër dhe të Shenjtin e Vetëm në mënyrën më të qartë. Kur në atë natë ai mori adresimin Hyjnor në praninë e Allahut, meqenëse ai ishte dërguar si përfaqësues në emrin e të gjitha qënieve të gjalla dhe të çdo lloji krijese, në vend që të jepte përshëndetjen '*Es-Selam'* të qënieve të vetëdijshme, ai tha: ***"Et-tehijjatul-Mubarekat es-salevatu et-tajjibatu lil-lahi".*** *"Përshëndetjet, bekimet, salevatet dhe fjalët e mira janë të gjitha të Allahut*", duke i dhënë kështu Krijuesit të tij dhuratat e krijesave, duke e shfaqur mënyrën që ata bëjnë të njohur Zotin e tyre nëpërmjet manifestimeve të atributit të Njohjes.

Domethënë, me katër fjalët, përshëndetjet, bekimet, salevatet dhe fjalët e mira, ai aludonte për përshëndetjet, urimet, adhurimin dhe për njohjen e tyre të këndshme e të mirë ndaj Njohësit të së padukshmes të katër grupeve kryesore të qënieve të gjalla që ato e ofrojnë nëpërmjet manifestimeve të njohjes së parapërjetshme dhe të paspërjetshme. Për këtë arsye, recitimi i këtij bashkëbisedimi të shenjtë të Miraxhit në kuptimin e tij të gjërë është bërë një pjesë e detyrueshme e *teshehudit* për të gjithë myslimanët. Duke ia referuar shpjegimin e detajuar të atij bashkëbisedimi të shenjtë Risale-i Nurit, ne do të shpjegojmë një kuptim të tij në formën e katër treguesve të shkurtër.

---

duhet të shihen me tolerancë. Husrevi mund t'i modifikojë, t'i ndryshojë dhe të korrektojë çdo pjesë që ai e konsideron të papërshtatshme. Autori.

Fjala e Parë: ***"Et-tehijjatu lil-lahi"***. Në mënyrë të përmbledhur është kjo:

Për shembull, një Mjeshtër i aftë shpik një makineri të mrekullueshme me njohjen e tij të thellë dhe me zgjuarsinë e tij të jashtëzakonshme, dhe gjithkush që e sheh atë, e duartroket dhe e përshëndet mjeshtërin; duke e lavdëruar dhe duke e uruar atë, i jep atij dhuratat materiale dhe jomateriale. Edhe makineria gjithashtu, duke e shfaqur artin e hollë e të jashtëzakonshëm të Mjeshtërit, dhe talentin dhe njohjen e tij dhe duke vepruar në mënyrë perfekte dhe pikërisht ashtu siç deshi ai, e miraton dhe e duartroket atë nëpërmjet gjuhës së qënies së saj, dhe në efekt e përshëndet atë dhe i jep atij dhurata jomateriale.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, të gjitha speciet e qënieve të gjalla në univers, së bashku me të gjithë anëtarët e tyre individualë, në çdo drejtim janë makineri të mrekullueshme e të jashtëzakonshme, të cilat -ashtu si qëniet e vetëdijshme, njerëzit, xhindët dhe melekët përshëndesin dhe duartrokasin Autorin e tyre me gojë- nëpërmjet gjuhëve të qënieve të tyre dhe të jetëve e duartrokasin dhe e përshëndesin Mjeshtrin e tyre, Autorin e Gjithëlavdishëm, i Cili e bën Vetveten të njohur nëpërmjet manifestimeve të holla e të thella të njohjes së Tij gjithëpërfshirëse, e cila i sheh lidhjet e çdo gjëje me çdo gjë tjetër, dhe i njeh të gjitha gjërat e domosdoshme për jetën e secilës dhe ia dërgon ato asaj në kohën e duhur.

Duke e përshëndetur Atë, qëniet deklarojnë: **"*Et-tehijjatu lil-lah*"** Ato me adhurim e japin çmimin e jetëve të tyre direkt për Krijuesin e tyre, i Cili i njeh të gjitha krijesat së bashku me të gjitha gjendjet e tyre. Në Natën e Miraxhit, në emrin e të gjitha krijesave të gjalla, Muhammedi a.s.m. tha: "***Et-tehijjatu lil-lahi***", në vend të përshëndetjes *"Es-selamu*" në praninë e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, dhe dha përshëndetjet e grupeve të të gjithë qënieve të gjalla, dhuratat e tyre, dhe selamin e tyre shpirtëror.

Po, ashtu si me rregullin dhe me drejtpeshimin e saj, një makineri e rregullt dhe e zakonshme në mënyrë të padyshimtë shfaq një mjeshtër të talentuar dhe të aftë; po ashtu secila nga makineritë e gjalla të panumërta të cilat mbushin universin shfaqin një mijë e një mrekullitë e njohjes. Nuk ka dyshim se gjallesat tregojnë për domosdoshmërinë e ekzistencës së Autorit të tyre të përjetshëm dhe për përshtatshmërinë e Tij për t'u adhuruar nëpërmjet manifestimeve të njohjes të cilat janë si drita e diellit në krahasim me atë çfarë tregon ajo makineri që është si drita e dobët e një xixëllonje.

Fjala e Dytë e lartë nga Fjalët e Miraxhit: që është ***"El-Mubarekat"*:**

Meqenëse sipas hadithit, *"namazet rituale janë Miraxhi i besimtarit"*[328] dhe marrin manifestimin e Miraxhit më të madh; dhe meqenëse udhëtari nëpër botë gjeti Krijuesin e Tij, Njohësin e së padukshmes, nëpërmjet Atributit të Njohjes në çdo botë, edhe ne gjithashtu le të hyjmë së bashku me atë udhëtar në botën e gjërë të bekimeve *"**El-Mubarekat**"*, e cila i bën ata që vështrojnë, të deklarojnë: *"Sa të mëdhaja janë bekimet e Zotit xh.sh.*". Ashtu si udhëtari, ne do të përpiqemi ta njohim Krijuesin tonë me njohjen e sigurisë, nëpërmjet manifestimeve të mrekullisë së hollë të atributit madhështor të Hyjnisë, Atributit të Njohjes, dhe këtë nëpërmjet vëzhgimit të asaj bote, botës së bekimeve *"**Mubarekat**"* dhe duke e studiuar atë; dhe veçanërisht të vegjëlit e pafajshëm e të bekuar të qënieve me shpirtëra, dhe farërat e krijesave të gjalla, të cilat janë konteinerët -enët- e vockëla të programeve të jetëve të tyre.

Po, ne shohim me sytë tonë se të gjithë ata të vegjël të bekuar e të pafajshëm dhe ato depo e kutia të bekuara, papritmas të gjitha -së bashku dhe veçmas- zgjohen e vihen në lëvizje me njohjen e të Gjithëditurit të Gjithurtë dhe vazhdojnë drejt qëllimit të krijimit të tyre. Ato u shkaktojnë atyre që i shohin ato në realitet, të thonë: *"Zoti i bekoftë këto një mijë herë! Çfarë çudirash të pafundme ka dashur Zoti xh.sh.!"*

Për shembull, të gjitha farërat, vezët, spermat, dhe bërthamat kanë një rregull të hollë e preçiz i cili buron nga njohja; dhe ai rregull është brenda një balance të përkryer, që buron nga një mjeshtëri e plotë; dhe ajo balancë është brenda një organizimi të ri; dhe ky organizim është brenda një peshoreje të vazhdueshme dhe balancimi; dhe peshorja dhe balancimi janë brenda një dallueshmërie dhe të ushqyeri, dhe secila duke poseduar shenja duke e dalluar qëllimisht atë nga shoqet e saj; dhe kjo dallueshmëri dhe ushqyeshmëri janë brenda një dekorimi plot art dhe zbukurimi; dhe ky zbukurim është brenda dhënies se formave dhe të gjymtyrëve me urtësi, me përshtatshmëri dhe me përkryerje; dhe kjo dhënie e formave është së bashku me ndryshimet në mish dhe në pjesët e ngrënshme të atyre krijesave dhe frutave për të ngopur të nevojshmit për rizk -ushqim- në mënyrë bujare duke iu përshtatur shijeve të tyre; edhe kjo gjithashtu është brenda qëndisjeve të mrekullueshme dhe stolisjes të cilat reflektojnë njohuri dhe janë të

[328] Buhariu

gjitha të ndryshme; dhe kjo është brenda erërave të mira të ndryshme dhe shijeve të kënaqshme të shumëllojshme. Kështu nëpërmjet zbulimit dhe zhvillimit të të gjitha këtyre formave me rregullsi e dallueshmëri të plotë, dhe ndërsa duke qenë të ndryshme pa gabim apo mangësi në një shpejtësi absolute dhe në një gjërësi absolute... edhe pse janë në një shumësi absolute, dhe me këtë situatë të jashtëzakonshme duke vazhduar gjatë gjithë stinëve; të gjitha ato qënie të bekuara, veçmas dhe bashkarisht, demonstrojnë në mënyrë të dukshme nëpërmjet pesëmbëdhjetë gjuhëve të lartëpërmendura mrekullitë e aftësive të mjeshtërit të tyre dhe njohjen e Tij të mrekullueshme, duke bërë të njohur me qartësi si dielli Gjithënjohësin e së padukshmes dhe Autorin e tyre, Ekzistenca e të Cilit është e domosdoshme. Për shkak të kësaj dëshmie vërtet të ndritshme e të gjërë të tyre dhe të përshëndetjeve të tyre të cilat i shprehu për to profeti a.s.m. i cili foli në emrin e të gjitha krijesave në Natën e Miraxhit dhe tha: ***"El-Mubarekat**", "bekime"* në vend të ***"Es-Selam**"* "*përshëndetjeve"*.

Fjala e Tretë: është *"**Es-salevat".***

Këtë fjalë të shenjtë e cila u fol gjatë Miraxhit të madh të Muhammedit a.s.m., e japin qindra miliona besimtarë përpara Pranisë Hyjnore në çdo ditë të paktën dhjetë herë në *tesheh-hud* gjatë namazeve të detyruara, të cilat janë miraxhi i veçantë për besimtarin. Ata e shpallin atë në të gjitha anët e universit. Meqenëse të gjitha të vërtetat e Miraxhit janë provuar në Fjalën e Tridhjetë e Njëtë në mënyrën më të fuqishme e vendimtare, madje ajo u adresohet pjesërisht edhe mohuesve ateistë më kryeneçë, për provat dhe për detajet ne jua referojmë atë Fjalë, dhe këtu në mënyrë shumë të përmbledhur, ne do të hedhim një vështrim tek bota e çuditshme e llojeve të ndryshme të qënieve të vetëdijshme dhe të qënieve me shpirtëra, të cilat ilustrojnë kuptimin e gjërë të kësaj Fjalës së Tretë të Miraxhit. Ne gjithashtu do të përpiqemi të kuptojmë nëpërmjet manifestimit të njohjes së parapërjetshme Mëshirën e plotë dhe Dhembshurinë e Krijuesit tonë, dhe gjërësinë e fuqisë së Tij dhe vullnetin Gjithëpërfshirës brenda ekzistecës dhe unitetit të Tij.

Po, ne shohim në këtë botë se çdo qënie e gjallë ndjen dhe percepton me ndjenjat dhe me natyrën -edhe në qoftë se nuk do të ishte me vetëdije dhe mendje- se ajo vuan dobësi e pafuqi të pakufishme dhe nevojat e kërkesat e saj janë të pafundme. Meqenëse fuqia e saj dhe kapitali janë të pamjaftueshëm për të përmbushur madje edhe një të mijtën e këtyre, e sheh atë të kërkojë ndihmë duke qarë me të gjithë

fuqinë, dhe përgjërohet në mënyrë të natyrshme dhe të nënkuptuar.

Ajo kërkon strehim tek Divani i të Gjithëditurit të Gjithëfuqishëm me zërin e saj të veçantë, me gjuhën e saj të veçantë, dhe me duatë, përgjërimet, salevatet dhe me një lloj lutjesh e bekimesh të veçanta për të. Sepse ne shohim se një i Gjithëfuqishëm i Gjithurtë dhe i Gjithëditur Absolut njeh çdo nevojë të atyre qënieve të gjalla dhe ua plotëson atyre; Ai sheh çdo sëmundje prej sëmundjeve të tyre dhe u vjen në ndihmë, dhe dëgjon çdo thirrje e lutje që ato bëjnë në mënyrë të natyrshme; ato i kërkojnë Atij ndihmë dhe Ai u përgjigjet atyre. Zoti xh.sh. e transformon vajtimin e tyre në buzëqeshje të ëmbëla, dhe e shndërron kërkimin ndihmë të tyre në lloje falënderimi e lavdërimi. Kjo ndihmë e urtë, njohëse dhe e mëshirshme bën të njohur në mënyrë vërtet të ndritur nëpërmjet manifestimeve të njohjes dhe të mëshirës Një Përgjigjës të lutjeve, Një Ndihmues, Një Mëshirëplotë dhe Gjithëbujar. Kështu të gjitha salevatet dhe ibadetet që nisen nga këto botëra -nga botërat e qënieve me shpirtëra- duke u ngjitur tek Ai Përgjigjës i lutjeve dhe tek Ai Ndihmues, -të gjitha ato i shprehu- me këtë kuptim dhe i paraqiti dhe i posaçëroi Muhammedi a.s.m. në Miraxhin më të madh, dhe çdo besimtar i përsërit ato në Miraxhin më të vogël, në çdo namaz, duke thënë: *"**Essalevatu et-tajjibatu lil-Lah".***

Fjala e Katërt e shenjtë: që është *"**Et-taj-jibatu lil-Lah**" "të gjitha fjalët e mira janë të Allahut"*.

Meqenëse shumë nga të vërtetat e Risale-i Nurit më janë shfaqur mua ndërsa recitoja tesbihatet që ndjekin namazet e detyruara; mjaft thjesht unë jam shtyrë në mënyrë të pavullnetshme të shpjegoja nëpërmjet treguesve të përmbledhur të vërtetat e shoqëruara edhe me suren *el-Fatiha*, edhe me fjalët e *tesheh-hudit*. Dhe kështu fjala e shenjtë : "***Et-tajjibatu***" e cila u tha në Miraxhin e Muhammedit a.s.m. e cila përmban kuptimet e fjalëve, të adhurimit dhe të veprave të mira të pakufishme që burojnë prej njerëzve, xhindeve, melekëve dhe qënieve shpirtërore të cilët janë banorët e njohjes, të besimit dhe të cilët posedojnë vetëdije universale; dhe të cilët e zbukurojnë të gjithë universin me fjalët e tyre të mira, me veprat e mira dhe me ibadetet e tyre të këndshme, të cilat që të gjitha orientohen drejt botës së bukurive, dhe të cilët i kuptojnë plotësisht bukuritë e pafundme të Hirplotit Absolut të përjetshëm dhe bukurinë e përhershme të Emrave të Tij të bukur të cilët e zbukurojnë universin; dhe ato u përgjigjen atyre me pasion, me zell dhe me adhurim universal. Kjo fjalë u referohet fjalëve të mira të pafundme që ata i shprehin për Krijuesin e tyre nëpërmjet erërave të mira e të këndshme të besimit të tyre të

ndritur, njohjes së gjërë rreth Tij dhe lavdërimit e falënderimit që ata i paraqesin ndaj Krijuesit të tyre të Gjithëlavdishëm. Meqenëse fjalët e mira në këtë kuptim u thanë gjatë Miraxhit, i gjithë ummeti e përsërit atë fjalë të shenjtë në *tesheh-hud* në çdo ditë pa u mërzitur e pa u lodhur.

Po, ky univers është një pasqyrë e cila reflekton bukurinë e përjetshme dhe hijeshinë e pakufishme, dhe përbëhet nga manifestimet e Tij xh.sh.. Të gjitha bukuritë dhe plotësimet e universit vijnë nga ajo bukuri e përjetshme dhe bëhen të bukura nëpërmjet lidhjes me të, dhe u shtohet vlera e tyre. Përndryshe, -po të mos kishte qenë ajo lidhje- universi do të kishte qenë një rrënojë, një banesë pikëllimesh, dhe një vend krejtësisht konfuz. Lidhja e tyre me atë bukuri kuptohet nëpërmjet njohjes dhe afirmimit të njerëzve, të engjëjve dhe të qënieve shpirtërore, të cilët janë lajmëtarët -njoftuesit- e sovranitetit të Hyjnisë. Madje m'u shfaq mua se ndodhet një mundësi e fortë se me qëllim që të transmetohen gjithandej lavdërimi i bukur dhe falënderimi i hijshëm i atyre lajmëtarëve dhe lëvdatat e tyre ndaj të Vetmit Unik të Cilin ata adhurojnë, dhe për t'i ngjitur ato deri tek Froni më i Madh, dhe për t'i paraqitur ato vepra të mira tek Prania Hyjnore, i është dhënë elementit të ajrit një gjendje vërtet e çuditshme dhe e jashtëzakonshme me anë të grimcave të tij, si ushtarët nën urdhëra, për ta përmbushur këtë mision, sikur ato grimca të ishin gjuhë të zvogëluara folëse dhe veshë të vegjël dëgjues.

Dhe kështu, ashtu si njerëzit dhe melekët të cilët e njohin të Adhuruarin e Gjithëlavdishëm me besimin dhe me ibadetet e tyre, po ashtu i Gjithurti Zotërues i Lavdisë e bën të njohur Vetveten në mënyrë të dukshme e të ndritur duke vendosur aftësi gjithëpërfshirëse të shumta tek thirrësit -njoftuesit- duke i pajisur ato me aparate të mrekullueshme e të jashtëzakonshme dhe duke e bërë secilin prej tyre të jetë i lidhur me të gjithë universin, sikur secila prej tyre të ishte një univers i zvogëluar. Për shembull, Ai e shfaq Vetveten në mënyrë aq të qartë si dielli në mes të ditës duke krijuar makineri të shumta të jashtëzakonshme në një hapësirë me përmasën e një arre të vetme në një vend të vockël në trurin e njeriut; dhe e bëri fuqinë e memories si një bibliotekë të madhe.[329]

Ne tani do të aludojmë për një kuptim shumë të përmbledhur të pjesës arabisht që u përmend lart e cila tregon prova universale të

[329] Sëmundja ime e rëndë nuk më lejon mua të vazhdoj; dhe kjo që shkrova është vetëm një burim dhe ndihmë për detyrën e Husrevit në përkthim. Autori.

njohjes gjithëpërfshirëse, përfshin prova të panumërta duke i sjellë ato së bashku dhe duke i bërë ato si një provë e shtrirë, dhe demonstron njohjen gjithëpërfshirëse nëpërmjet pesëmbëdhjetë dëshmive. Ne do të japim një lloj përkthimi të pjesës arabisht.

E Para e pesëmbëdhjetë dëshmive: "*Rregulli i balancuar".*

Rregullsia e drejtpeshuar dhe sistemi i mirëbalancuar të vëzhguara në të gjitha krijesat dëshmojnë për një njohje gjithëpërfshirëse. Po, duke filluar nga i gjithë universi i cili i ngjason një pallati madhështor e të regullt, dhe prej sistemit diellor, dhe prej elementit të ajrit grimcat e të cilit transmetojnë fjalët dhe tingujt në një mënyrë të çuditshme e të habitshme dhe shfaq një rregull të mahnitshëm, dhe prej sipërfaqes së tokës, e cila në çdo pranverë me rregull të plotë përgatit treqind mijë specie të ndryshme... deri tek gjymtyrët, qelizat, grimcat dhe sistemet truporë të të gjitha qënieve të gjalla -një rregull i balancuar dhe një rregullshmëri e përkryer, të cilat janë veprat e një njohjeje të thellë, gjithëpërfshirëse, të sigurta e të pagabueshme, kjo do të thotë se ato dëshmojnë në mënyrë krejtësisht të qartë e vendimtare për një Njohje gjithëpërfshirëse.

Dëshmia e Dytë: "*Një balancë e rregullt*".

Në të gjitha krijesat në univers, të pjesshme dhe universale, duke filluar nga planetët për tek rruazat e kuqe dhe të bardha në gjak, në çdo gjë ndodhet një masë krejtësisht e rregullt dhe një balancë e përshtatshme, të cilat në mënyrë të vetëkuptueshme tregojnë një Njohje gjithëpërfshirëse dhe dëshmojnë për të në mënyrë vendimtare. Po, ne për shembull, shohim se gjymtyrët e sistemeve trupore të një mizeje ose të një qënieje humane dhe madje edhe qelizat e trupit dhe rruazat e kuqe e të bardha të gjakut, janë vendosur me një balancë aq të ndjeshme dhe me një masë aq të hollë dhe janë aq të përshtatshme e të denja për njëra-tjetrën, dhe përpjesëtimi i tyre i ndërsjëllë së bashku me gjymtyrët e tjera të trupit janë aq me rregullsi dhe janë në një harmoni të tillë me të, saqë kurrësesi nuk do të ishte e mundur që dikush të cilit i mungon njohja e pafundme të mund t'ua kishte dhënë atyre ato situata.

Gjithashtu, një balancë kaq e përkryer, një masë aq e rregullt dhe një sundim kaq i pagabueshëm në të gjitha krijesat e gjalla dhe në të gjitha llojet e krijesave duke filluar nga grimcat e vockëla për tek planetët e sistemit diellor saqë ato provojnë në mënyrë përfundimtare një njohje gjithëpërfshirëse dhe dëshmojnë për të me qartësi të plotë se kjo do të thotë se të gjitha dëshmitë për njohjen janë gjithashtu dëshmi

për ekzistencën e të Gjithëditurit të Vetëm. Meqenëse do të ishte e pamundur dhe e papranueshme që të kishte një atribut pa dikë që ai cilëson, të gjitha provat e njohjes formojnë një provë të fuqishme, krejtësisht të sigurtë dhe të lartë për Njohësin e Parapërjetshëm ekzistenca e të Cilit është e domosdoshme.

Dëshmia e Tretë: që është: *"Dhe urtësia e përgjithshme dhe e qëllimshme".*

Në të gjithë krijueshmërinë dhe aktivitetin në univers, dhe në të gjitha ndryshimet, duke i ngritur në jetë, duke i ngarkuar me detyra dhe duke i shkarkuar ato prej tyre, të gjitha krijesat dhe të gjitha speciet e krijesave kanë funksione, përdorime, dhe qëllime të cilat janë aq të qëllimshme dhe njohëse saqë ato nuk lënë asnjë vend për rastësinë. Ne shohim se në lidhje me krijimin ai që nuk posedon njohje gjithëpërfshirëse në asnjë mënyrë nuk do të mund të ishte pronari i asnjërës prej tyre dhe në asnjë aspekt. Për shembull, megjithëse është vetëm një copë mish, së bashku me dy detyrat e saja kryesore, gjuha, e cila është njëra prej qindra gjymtyrëve të njeriut -njeriu duke qenë vetëm njëri prej krijesave të gjalla të panumërta- është mjeti për qindra shembuj urtësish, rezultatesh, frutash dhe përdorimesh.

Funksionet e saj lidhur me të shijuarit e ushqimeve, njohja e të gjitha lezeteve, shijeve, të ndryshme, duke njoftuar trupin dhe stomakun, duke qenë një inspektore e saktë e kuzhinave të Mëshirës Hyjnore, dhe një interpretuese e përpiktë -tek kryerja e funksionit të fjalëve- dhe një qendër transmetimi -shkëmbim telefoni- për zemrën, shpirtin dhe për mendjen; të gjitha tregojnë në mënyrën më të ndritur e vendimtare për një njohje gjithëpërfshirëse. Në qoftë se nëpërmjet qëllimeve dhe frutave të saj një gjuhë e vetme jep një dëshmi të tillë, atëherë gjuhë të panumërta, dhe qënie të gjalla të panumërta dhe krijesa të pafundme tregojnë e dëshmojnë për një njohje të pafundme me qartësinë dhe sigurinë e diellit në mesditë. Ato shpallin se nuk ka absolutisht asgjë fare jashtë limiteve të njohjes së të Gjithënjohësit të së Padukshmes, dhe jashtë Urtësisë dhe Vullnetit të Tij.

Dëshmia e Katërt: "*Përkujdesjet gjithëpërfshirëse e të veçanta*".

Domethënë, përkujdesjet dhe shembujt e mëshirës dhe të mbrojtjes që u dhurohen të gjitha krijesave të gjalla në botën e qënieve të vetëdijshme dhe të gjitha specieve, çdo individi, në mënyrë të veçantë dhe të përshtatshme, tregojnë në mënyrë të vetëkuptueshme një njohje gjithëpërfshirëse, dhe japin dëshmi të panumërta për ekzistecën e domosdoshme të Një të Gjithëdituri Zotërues të një përkujdesje të

gjithanshme i Cili i njeh ato që i marrin mirësitë dhe përkujdesjen, dhe i njeh nevojat e tyre.

> **Shënim:** Shpjegimi i fjalëve të pjesës arabisht, e cila është përmbledhja dhe esenca e Risale-i Nurit, tregon të vërtetat të cilat Risale-i Nuri -duke qenë i distiluar prej Kur'anit- i ka marrë prej shkreptimave të vërseteve Kur'anore, dhe veçanërisht provat dhe dëshmitë për Njohjen, Vullnetin dhe Fuqinë. Sepse Risale-i Nuri shpjegon prova shkencore të cilat i tregojnë fjalët arabisht. Kjo do të thotë se përveç qënies sqarime, shpjegime e përkthime të atyre fjalëve arabisht, secila prej atyre provave shkencore shpjegon një tregues dhe një pikë të hollë të bëra nga vërsetet e Kur'anit Kerim.

Le të kthehemi tek çështja jonë kryesore. Po, me sytë tonë ne shohim se ndodhet një i Gjithëditur Mëshirëplotë i Cili na njeh neve dhe i di gjendjen tonë dhe gjendjen e të gjitha qënieve me shpirtëra dhe i përfshin të gjithë ata me mëshirën dhe me dhembshurinë e Tij si dhe i merr ata nën mbrojtjen e Mëshirës së Tij me njohje dhe me shikim, dhe ua plotëson të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre dhe i ndihmon me Përkujdesjen dhe me Dhembshurinë e Tij.

Prej shembujve të panumërt: Përkujdesjet e veçanta dhe të përgjithshme të dhuruara mbi njeriun si rizk -ushqime, ilaçe dhe mineralet për të cilat ai ka nevojë, këto tregojnë në mënyrën më të qartë për një njohje gjithëpërfshirëse, duke dhënë dëshmi për një të Gjithëmëshirshëm Mëshirëplotë aq sa numri i ushqimeve, i ilaçeve dhe i mineraleve.

Po, veprat e urta dhe të qëllimshme si të ushqyerit e njeriut dhe veçanërisht të vegjëlit dhe të pafuqishmit, dhe sidomos dërgimi i ushqimit tek gjymtyrët e trupit që kanë nevojë për të prej kuzhinës së stomakut, deri tek qelizat e tij, secilës u dërgohet çfarë i përshtatet... Po kështu bërja e maleve të larta si farmaci dhe si depo për të gjitha mineralet e domosdoshme për njeriun, kjo do të mund të ndodhte vetëm se nëpërmjet një njohjeje gjithëpërfshirëse. Rastësia e paqëllim, forca e verbër, natyra e shurdhët, shkaqet e pajeta e të pavetëdijshme dhe elementet e thjeshta e të papërmbajtura kurrësesi nuk mund të ndërhyjnë në këtë të ushqyer, administrim, mbrojtje dhe planifikim që karakterizohen nga njohja, shikimi, urtësia, mëshira dhe përkujdesja. Shkaqe të tilla të jashtme si ato janë thjesht të vëna në punë dhe të përdorura brenda limiteve të njohjes dhe të urtësisë së Një të Gjithëdituri Absolut, me urdhrin e Tij, me lejen e Tij, dhe janë si perde për dinjitetin Fuqisë Hyjnore.

Dëshmitë e Pesta dhe e Gjashta: që janë: *vendimi i rregullt* dhe *paracaktimi i frutshëm.*

Format dhe përpjesëtimet e të gjitha gjërave, dhe veçanërisht të bimëve, pemëve, kafshëve dhe të njerëzve janë prerë me një mjeshtëri të madhe arti sipas parimeve të vendimit dhe të Kaderit Hyjnor, të cilat janë dy llojet e njohjes së parapërjetshme, të prera -të qepura- në një mënyrë krejtësisht të përshtatshme me shtatin e secilës dhe u vishen atyre në mënyrë të përkryer. Secilës u jepen format më të mirëvendosura, të rregullta dhe të urta. Këto, veçmas dhe së bashku, tregojnë një njohje të pafundme dhe dëshmojnë sa numri i tyre për një Autor të Gjithëditur.

Po, prej shembujve të panumërt, le të hedhim shikimin vetëm tek një pemë e vetme dhe tek një individ njerëzor; ne shohim se si nga ana e jashtme po ashtu dhe e brendshmja e pemës frutdhënëse dhe këtij njeriu që mban gjymtyrë të shumta u janë përvijëzuar -u janë përcaktuar limitet- nga kompaset e së padukshmes dhe nga një penë e hollë e njohjes, dhe secilës prej gjymtyrëve u janë dhënë forma krejtësisht të rregullta e të përshtatshme me qëllim që ato të mund të prodhojnë frutat dhe rezultatet e kërkuara dhe të kryejnë detyrat e natyrave të tyre. Sa për këtë, meqenëse kjo do të mund të ndodhte vetëm se nëpërmjet njohjes së pafundme, ato dëshmojnë sa numri i bimëve dhe i kafshëve për ekzistencën e domosdoshme dhe për njohjen e pakufishme të Një Autori Formëdhënës dhe të Një të Gjithëdituri Përcaktues i Cili i njeh lidhjet e gjithçkaje me çdo gjë tjetër dhe i mban këto në shikim, dhe që njeh përkufizimin nëpërmjet kompaseve dhe penës së vendimit dhe të Kaderit të njohjes së parapërjetshme të anëve të jashtme dhe të brendshme të njerëzve si ai dhe të pemëve të tjera si ajo, dhe speciet e tyre dhe raportet dhe format e drejtpeshuara; dhe ato dëshmojnë për të Vetmin i Cili e realizon këtë.

Dëshmitë e Shtata dhe e Teta: *Exhelet -vdekjet e paracaktuara dhe Rizku i regullt i fiksuar.*

Në dukje, exheli -ora e caktuar e vdekjes- dhe rizku -ushqimi- shfaqen të jenë të panjohura dhe të papërcaktuara, por për një shembull të rëndësishëm urtësie nën perden e paqartësisë, exheli është i paracaktuar dhe i specikifikuar në faqen e fatit të çdo gjallese në Regjistrin e parapërjetshëm të vendimit dhe të Kaderit Hyjnor; exheli as nuk mund të përshpejtohet dhe as të shtyhet për më vonë. Ka dëshmi të shumta se edhe rizku i çdo qënieje të gjallë është gjithashtu i paracaktuar dhe i shkruar në tablotë e vendimit dhe të Kaderit Hyjnor. Për shembull, një pemë e madhe duke lënë prapa kur ajo vdes farërat e

saj të cilat janë si një lloj i shpirtit të saj, me qëllim që ajo të vazhdojë detyrat e saj në vend të saj, dhe kjo duke ndodhur nëpërmjet ligjit të Urtë të Një Gjithëruajtësi të Gjithëditur, dhe qumështi, ushqimi i të vegjëlve dhe i të rinjve, duke vërshuar prej kraharorëve, dhe shfaqja e tij prej ndërmjet gjakut dhe jashtëqitjes dhe duke u derdhur në gojat e tyre i pastër, i papërzier dhe i pandotur; kjo e refuzon mundësinë e rastësisë dhe shfaq qartë se ato ndodhin nëpërmjet ligjit të mëshirshëm të Gjithëfurnizuesit të Gjithëditur Mëshirëplotë. Ju mund të bëni analogji me këto dy shembuj të vegjël për të gjitha krijesat e gjalla dhe për qëniet me shpirtëra.

Kjo do të thotë se në realitet edhe exheli -ora e caktuar e vdekjes- edhe rizku i çdo personi janë shkruar e paracaktuar në Regjistrin e fatit të tij. Por për shembuj shumë të rëndësishëm të urtësisë, edhe exheli, edhe rizku janë fshehur pas perdes së të padukshmes, dhe shfaqen të jenë të paqarta, të papërcaktuara, dhe në dukje të lidhura me rastësinë. Sepse në qoftë se exheli do të kishte qenë paracaktuar si perëndimi i diellit, njeriu do ta kishte kaluar gjysmën e jetës së tij në pakujdesi absolute dhe do të humbiste duke mos punuar për Ahiretin, dhe gjysmën e dytë do ta kishte kaluar në panik të tmerrshëm, si dikush që në çdo ditë sikur bën një hap më shumë drejt litarëve të vdekjes duke e keqësuar njëqindfish fatkeqësinë e vdekjes. Për këtë mister të hollë fatkeqësitë prej të cilave vuan njeriu janë lënë nën perden e së padukshmes. Madje edhe Exhelin e Dynjasë, i cili është kijameti, Allahu xh.sh. e ka lënë të fshehur -nga Mëshira dhe nga Dhembshuria e Tij- prapa perdes së të padukshmes, për të njëjtën arsye.

Sa për Rizkun, meqenëse pas mirësisë së jetës ai është thesari më i madh i mirësive, dhe burimi më i pasur i falënderimeve dhe i lavdërimit, dhe miniera më gjithëpërfshirëse e adhurimit, e lutjeve, e përgjërimit, ai në dukje ka mbetur i paqartë dhe i shfaqur të jetë i lidhur me rastësinë. Dhe kjo është me qëllim që të mos mbyllet dera e kërkimit të rizkut me dua prej Gjithëfurnizuesit Gjithëbujar në çdo kohë, dhe që të mos mbyllet dera e kërkimit me *vesile* dhe *shefaat* nëpërmjet lavdërimeve dhe falënderimeve ndaj Zotit xh.sh.; sepse në qoftë se rizku do të kishte qenë i përcaktuar, si lindja dhe perëndimi i Diellit, natyra e tij do të kishte qenë krejtësisht e ndryshme. Dyert e falënderimit, lutjet dhe përgjërimet me mirënjohje, dhe madje edhe adhurimi me përulësi do të kishin qenë mbyllur.

Dëshmitë e Nënta dhe e Dhjeta: që janë: "*Persosuria e rregullt dhe stolisja e kujdesshme".*

Domethënë, të gjitha krijesat e bukura të cilat shfaqin manifestimet

e një bukurie të përjetshme dhe një hijeshi të amshuar veçanërisht në pranverë në faqen e tokës, për shembull, lulet, frutat, zogjtë e vegjël dhe mizat, dhe sidomos insektet e zbukuruar xixëlluese e fluturues në krijimin e tyre, në format dhe në gjymtyrët janë nga mjeshtëria e mrekullueshme, nga arti i hollë i jashtëzakonshëm dhe nga përsosuria e mahnitshme dhe plotësia e mrekullueshme e Autorit të tyre të Gjithëlavdishëm; si dhe të gjitha llojet dhe makineritë e vockëla të cilat tregojnë mjeshtërinë e mrekullueshme të mjeshtrit të tyre, tregojnë në mënyrë vendimtare për një njohje vërtet gjithëpërfshirëse, dhe -le të mos ketë gabim në shprehje- një njohje tej mase artistike e shkencore të natyrshme, dhe dëshmojnë se është krejtësisht e pamundur që rastësia e paqëllim dhe shkaqet e pavetëdijshme dhe të ngatërruara të mund të ndërhynin.

Ndërsa fraza "*dhe stolisja e kujdesshme*" do të thotë se ato artifakte të holla janë stolisur në një mënyrë aq të këndshme, janë zbukuruar në një mënyrë aq të ëmbël dhe shfaqin një bukuri dhe një art aq tërheqës, saqë autori i tyre do të mund t'i krijonte këto vetëm se nëpërmjet një njohjeje të pafundme. Ai njeh mënyrën më të mirë të gjithçkaje, dhe dëshiron të shfaqë për qëniet e vetëdijshme bukurinë e mjeshtërisë së përsosur dhe plotësinë e bukurisë së saj. Sepse Ai i krijon dhe i zbukuron lulen më të vogël të pjesshme dhe mizën më të vockël me kujdesin më të madh, me mjeshtërinë dhe artin duke u dhënë atyre rëndësinë më të madhe. Ky zbukurim i kujdesshëm dhe kjo stolisje në mënyrë të vetëkuptueshme tregojnë një njohje të pakufishme dhe gjithëpërfshirëse, dhe dëshmojnë sa numri i atyre bukurive për ekzistencën e domosdoshme të një Autori të Gjithëditur Zotëues të Bukurisë.

Dëshmia e Njëmbëdhjëtë, e cila përmban pesë dëshmi e prova universale: *'Rregull krejtësisht të plotësuar, balancë, dallueshmëri, absolutësi, në lëhtësi absolute... Krijimi i gjërave në shumësi absolute me mjeshtëri absolute... dhe në shpejtësi absolute me drejtpeshim absolut... në gjërësi absolute me plotësinë e bukurisë së artit... Dhe në largësi absolute me përputhje absolute... dhe në përzierje absolute me dallueshmëri absolute.'*

Kjo dëshmi është një formë tjetër dhe më e mirë e rreshtave të ngjashëm tek fundi i pjesës arabisht lart, por për shkak të sëmundjes sime të rëndë, ajo shpjegoi pesë ose gjashtë dëshmi që ajo i përfshin në formën e vetëm një treguesi shumë të shkurtër.

Së Pari: Gjithandej tokës ne shohim bërjen e makinerive të gjalla të çuditshme me të gjithë lehtësinë dhe kollajllëkun në çast, të cilat

burojnë nga një njohje e plotë dhe nga një mjeshtëri e përsosur, madje një pjesë bëhen në një minut të vetëm në formë të rregullt e të drejtpeshuar, secila e ndryshme nga shoqet e saja; të gjitha tregojnë për një njohje të pafundme dhe dëshmojnë së plotësia e asaj njohjeje janë në përpjesëtim me shkallën e lehtësisë që rezulton nga mjeshtëria dhe njohja në art.

Së Dyti: Krijesat e përkryera të artit më të madh brenda shumësisë së pafundme dhe bollëkut më të madh pa gabim dhe pa ngatërresë tregon për një njohje të pakufishme dhe dëshmojnë sa numri i tyre për të Gjithëdituri Absolut dhe për të Gjithëfuqishmin Absolut.

Së Treti: Krijesat të cilat janë me balancën dhe me drejtpeshimin më të hollë pavarësisht qënies së tyre të krijuara me shpejtësi absolute, tregojnë një njohje të pakufishme dhe dëshmojnë sa numri i tyre për të Gjithëdituri Absolut dhe për të Gjithëfuqishmin Absolut.

Së Katërti: Krijimi i qënieve të gjalla të panumërta në sipërfaqen e gjerë të tokës me mjeshtërinë më të madhe, me stolisjen dhe me zbukurimin e artit pavarësisht shtrirjes së tyre të gjërë, tregon një njohje gjithëpërfshirëse e cila nuk ngatërron asgjë, i shikon të gjitha gjërat së bashku, dhe për të cilën asgjë nuk është pengesë për ndonjë gjë tjetër. Kjo gjithashtu dëshmon, veçmas dhe bashkarisht, se ato janë artifaktet e Një të Gjithëdituri për të gjitha gjërat dhe të Një Gjithëfuqishmi mbi gjithçka.

Së Pesti: Ardhja në ekzistencë e individëve të specieve të cilët janë larg nga njëri-tjëtri, ku njëri është në lindje, një tjetër në perëndim, një tjetër në veri dhe një tjetër në jug, në të njëjtën mënyrë, secili duke i ngjasuar një tjetri por megjithatë të dallueshëm, të ndryshëm, kjo do të mund të ndodhte vetëm se nëpërmjet një fuqie të pafundme të të Gjithëfuqishmit Absolut, i Cili e drejton të gjithë universin nëpërmjet Fuqisë së Tij dhe me një njohje absolute që i përfshin të gjitha krijesat së bashku me gjendjet e tyre. Prandaj këto krijesa dëshmojnë në mënyrë të pakufishme për njohjen gjithëpërfshirëse të të Gjithënjohësit të së padukshmes.

Së gjashti: Krijimi i makinerive të gjalla të shumta në dallueshmëritë krejtësisht të veçantë dhe i shenjave pikëlluese pavarësisht ngjashmërisë së tyre, dhe megjithëse janë në një përzierje absolute dhe në vende të errëta -si bërthamat që gjenden nën dhé- dhe pa ngatërresë, pa gabim, dhe krijimi i të gjitha aparateve -gjymtyrëve të tyre pa ndonjë mangësi në krijim dhe në mënyrë të mrekullueshme tregojnë aq qartë si dielli një njohje të parapërjetshme, dhe dëshmojnë

në mënyrë të qartë si dita për Hyjninë dhe krijueshmërinë e Një të Gjithfuqishmi Absolut dhe Një të Gjithëdituri Absolut. Për detajet ne ju referojmë ju tek Risale-i Nuri dhe e presim shkurt këtu një histori të gjatë.

Tani ne do të fillojmë me çështjen e **Vullnetit** -Dëshirës- e cila është një '*Hulasatul Hulasah'* përmbledhja e trajtesës El-Ajetul Kubra.

Kjo pjesë përbëhet nga një provë e gjatë universale e Vullnetit Hyjnor, e cila përmban shumë prova të vullnetit. Në një përkthim të shkurtër të saj ne dhamë dëshmi duke i provuar në mënyrë vendimtare Vullnetin Hyjnor, Zgjedhjen dhe Dëshirën.

Të gjitha dëshmitë lart për njohjen Hyjnore janë gjithashtu dëshmi për Vullentin Hyjnor. Sepse manifestimet dhe veprat e Njohjes dhe të Vullnetit shfaqen bashkarisht në të gjitha krijesat.

Kuptimi i përmbledhur i pjesës së lart arabisht:

Çdo gjë ekziston nëpërmjet vullnetit dhe dëshirës së Tij xh.sh.. Ajo çfarë dëshiron Ai ndodh, dhe ajo që Ai nuk e dëshiron, nuk ndodh. Në qoftë se Ai nuk do të kishte dashur, asgjë nuk do të kishte ndodhur.

Një provë është kjo:

Ne shohim se midis mundësive të pafundme e të ngatërruara dhe rrugëve të ndryshme të pafrutshme, midis elementeve ndërhyrës e të ndërfutur të cilët rrjedhin si rrëke duke shkaktuar kaos, dhe në mes të gjërave të shumta të ngjashme me të vërtetën, gjë e cila është shkaku i çrregullimit, çdo krijesë me esencën e saj specifike, me cilësitë e veçanta, me karakterin individual dhe me formën e saj të dallueshme, merret brenda një sistemi të saktë, të përkryer e të rregullt; të gjithë gjymtyrët dhe organet e saj peshohen me një balancë dhe një peshore të ndjeshme e të saktë dhe i bashkangjiten asaj; gjymtyrët e saj të kundërta e të ndryshme krijohen të gjalla dhe me një art të skajshëm thjesht nga një lëndë e pajetë dhe e vdekur. Për shembull, një qënie humane krijohet me njëqind organe të ndryshme prej një pike lëngu, dhe një zog bëhet me gjymtyrë dhe me organe të shumta të ndryshme nga një vezë e thjeshte dhe vishet në një formë të mrekullueshme, dhe një pemë ngrihet e shfaqet prej një bërthame të vockël, që përmban thjesht karbonin e pajetë, azotin, hidrogjenin dhe oksigjenin, së bashku me degët dhe shkarpat e saj dhe me të gjithë anëtarët dhe pjesët, dhe vishet në një formë të rregullt e të frutshme. Kjo, në mënyrë të vetëkuptueshme, të padyshimtë vendimtare dhe të domosdoshme provon se të gjitha krijesave së bashku me të gjitha pjesët e tyre,

grimcat, forma dhe natyra, u jepen gjendjet e tyre të veçanta e të përkryera nëpërmjët vullnetit, Zgjedhjes, Dëshirës dhe Qëllimit të Një të Gjithëfuqishmi Zotërues të një fuqie absolute. Kjo gjithashtu provon se gjithçka drejtohet nga një vullnet gjithëpërfshirës. Këto krijesa të veçanta duke treguar në këtë mënyrë të padyshimtë Vullnetin Hyjnor shfaqin se të gjitha krijesat japin dëshmi sa numri i tyre me një siguri aq të qartë si dielli në mesditë për Vullnetin Hyjnor duke i përfshirë të gjitha gjërat, dhe se ato përmbajnë prova të panumërta për ekzistencën e domosdoshme të Një të Gjithëfuqishmi Zotërues të vullnetit.

Të gjitha dëshmitë për Njohjen Hyjnore të përmendura lart janë gjithashtu dëshmi për Vullnetin Hyjnor, meqenëse të dyja funksionojnë bashkarisht me fuqinë. Njëra nuk mund të jetë pa tjetrën. Ashtu si e gjithë korrespondenca dhe përputhshmëritë ndërmjet gjymtyrëve të specieve që tregojnë se Autori i tyre është Një dhe i Njëjti; po ashtu, tiparet e tyre duke qenë të dallueshme dhe të ndryshme nga njëri-tjetri në mënyrë të urtë e të qëllimshme tregojnë në mënyrë vendimtare se Autori i tyre i Vetëm i Unitetit vepron me vullnet dhe me zgjedhje. Ai krijon çdo gjë me vullnet, me zgjedhje, me dëshirë dhe me qëllim.

Kjo shënon fundin e shpjegimeve të mia lidhur me kuptimin e pjesës arabisht, e cila shtjellon një provë universale të Vullnetit Hyjnor. Unë pata synuar që të shkruaja edhe më shumë pika të rëndësishme, lidhur me çështjen e Njohjes Hyjnore, por truri im u bë shumë i lodhur për shkak të sëmundjes që po vuaja si rezultat i qënies i helmuar, kështu ajo u shty për një kohë tjetër.

Pjesa arabisht rreth **Fuqisë Hyjnore**:

Zoti është më i madhi! Nëpërmjet Fuqisë dhe njohjes së Tij, Ai është më i madh se të gjitha gjërat. Sepse Ai është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat me një fuqi absolute e gjithëpërfshirëse, e domosdoshme e thelbësore për Esencën e Tij më të pastër dhe më të shenjtë. Është e pamundur që e kundërta e asaj fuqie të ndërhyjë në të, sepse ajo nuk ka shkallë; të barabarta janë para saj grimcat dhe yjet, të pjesshmet dhe universalet, pjesa dhe e tëra, bërthama dhe pema, bota dhe njeriu -nëpëmjet misterit të rregullit krejtësisht të vëzhguar e të përkryer, balancës, dallueshmërisë, përpikërisë, së bashku me lehtësinë në shumësinë absolute, shpejtësinë dhe përzierjen; dhe nëpërmjet mistereve të dritësisë, tejdukshmërisë, reciprocitetit, balancës, rregullit dhe nënshtrimit; dhe nëpërmjet mistereve të ndihmës së unitetit, lehtësisë së unitetit dhe manifestimit të Njësisë; dhe nëpërmjet mistereve të domosdoshmërisë, të shkëputjes së plotë

dhe tjetërisë së Esencës; dhe nëpërmjet mistereve të pakufizueshmërisë, mosqënies e lidhur nga hapësira, dhe pandashmërisë; dhe nëpërmjet mistereve të transformimit të pengesave dhe bllokimeve në mjete lehtësie; dhe nëpërmjet misterit të intuitës se e pjesshmja, pjesa, bërthama dhe njeriu nuk janë më të ulët lidhur me artin dhe elokuencën se sa yjet, se universalja, e tëra dhe pema e krijimit; kështu Krijuesi i asaj është Krijuesi i kësaj nëpërmjet intuitës vëzhguese; dhe nëpërmjet misterit të të pjesshmeve dhe të tërat duke qenë në mënyrë të pashmangshme në kapjen e Krijuesit të gjërave të cilat janë rrethuese dhe pjesë si qënie të shkruara në miniaturë të ngjashme me to, ose janë pikëla të shtrydhura e të mjelura, sepse ato dhe të ngjashmet e tyre janë përfshirë në të parën me balancën e njohjes së tij, ose janë të mjelura, të shtrydhura prej tyre në përputhje me parimet e urtësisë së Tij; dhe nëpërmjet misterit të një kurani të dinjitetit i shkruar me grimcat e eterit mbi një atom ose mbi grimcën më të vockël duke mos qenë më të pakta në elokuencë ose në art të mrekullueshëm se sa një kuran i madhështisë i shkruar me bojën e yjeve dhe të diejve në faqen e qiejve; gjithashtu nëpërmjet lidhjes së tyre me fuqinë e Krijuesit të universit, trëndafili i lulëzuar duke mos qenë më i pakët në elokuencë dhe në art se sa ylli Venus; as miza duke mos qenë më e ulët se sa elefanti; as mikrobi nuk është më i ulët se sa hundëbriri; dhe as bleta nuk është më e ulët se sa palma. Për më tepër, lehtësia e skajshme dhe shpejtësia në krijimin e gjërave u shkakton njerëzve të çudhëzimit të ngatërrojnë formimin me vetëformimin, i cili bën të domosdoshëm pamundësi të panumërta dhe është një iluzion -mashtrim; ndërsa ajo provon për njerëzit e udhëzimit se në lidhje me fuqinë e Krijuesit të universit grimcat dhe yjet janë të barabarta, i latësuar qoftë Ai, sepse nuk ka zot tjetër përveç Atij; Allahu është më i Madhi!

Përpara se të japim një përkthim për këtë pjesë arabisht nga këndvështrimi i çështjes vërtet të gjërë të Fuqisë Hyjnore, dhe një kuptim të përmbledhur të tij, unë do të zbuloj një të vërtetë e cila mu shfaq në zemrën time. Ajo ishte sa vijon:

Ekzistenca e fuqisë Hyjnore është më e sigurtë se sa ekzistenca e universit. Në të vërtetë, veçmas dhe së bashku, krijesat janë fjalë të mishëruara të fuqisë; ato e demonstrojnë ekzistencën e saj me ‘shikimin e sigurisë’.

Ato dëshmojnë sa numri i tyre për të Gjithëfuqishmin Absolut, i cili cilësohet nga ajo. Nuk është nevoja ta provosh atë fuqi me prova të mëtejshme; por duhet të provohet një e vërtetë madhështore që i përket

fuqisë dhe e cila është një bazë e rëndësishme në besim dhe guri themeltar për Ringjalljen e madhe dhe Tubimin, dhe është boshti i domosdoshëm për të kuptuar çështje të shumta të besimit dhe të vërtetat kuranore, dhe ashtu siç pretendohet nga vërseti:

"Krijimi i ju të gjithëve dhe Ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm".[330] dhe për shkak se jo gjithkush e ka gjetur rrugën për tek ajo nëpërmjet përdorimit të arsyes, disa njerëz kanë mbetur të hutuar dhe të pakuptuar përpara fuqisë, dhe të tjerët e kanë mohuar atë, dhe prandaj është e domosdoshme të provojmë një të vërtetë madhështore lidhur me të.

Sa për bazat e lartëpërmendura, themelin, boshtin, pohimin dhe të vërtetën, është kuptimi i vërsëtit të lartëpërmendur. Domethënë: O njerëz dhe xhindë! Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve në Ditën e Ringjalljes është aq e lehtë për fuqinë Time sa ajo e krijimit të një njeriu të vetëm! Fuqia Hyjnore e krijon pranverën me aq lehtësi ashtu siç krijon Ai një lule të vetme. Për atë fuqi nuk ka ndryshim ndërmjet të pjesshmes dhe universales, të voglës dhe të madhes, të shumtës dhe të paktës. Ajo i lëviz planetët me aq lehtësi ashtu siç lëviz grimcat.

Në nëntë 'shkallë' pjesa arabisht që u përmend lart, e shpjegon këtë çështje madhështore me një provë të fuqishme vendimtare. Në mënyrë shumë të përmbledhur, kuptimi i saj është sa vijon:

Baza e shkallëve tregohet nga kjo:

Sepse Ai është i Gjithëfuqishëm me një fuqi absolute gjithëpërfshirëse, e domosdoshme dhe thelbësore për Esencën më të pastër e më të shenjtë; është e pamundur që e kundërta e asaj fuqie të ndërhyjë në të, sepse ajo nuk ka shkallë; të barabarta janë para saj grimcat dhe yjet, të pjesshmet dhe universalet, pjesa dhe e tëra, bërthama dhe pema, bota dhe njeriu.

Domethënë, Fuqia Hyjnore është e tillë saqë ajo është e gjithanshme mbi të gjitha gjërat, i rrethon të gjitha gjërat, është esenciale për Ekzistuesin e Vetëm të domosdoshëm, dhe sipas logjikës është e domosdoshme për Të; është e pamundur që ajo të ndahet prej Tij; nuk ka mundësi që ajo të jetë. Meqenëse Esenca më e pastër dhe më e shenjtë posedon një fuqi të tillë të domosdoshme, pafuqia, e kundërta e saj, sigurisht që nuk mund të ndërhyjë në të. Pafuqia nuk mund ta cënojë -ta shkelë- atë Esencë të të Gjithëfuqishmit. Meqenese

[330] Kur'an, 31:28

ekzistenca e shkallëve në një gjë ndodh nëpërmjet ndërhyrjes së të kundërtave të saj -për shembull, shkallët dhe nivelet e të nxehtit ndodhin nëpërmjet ndërhyrjes së të ftohtit, dhe shkallët e bukurisë, nëpërmjet ndërhyrjes së shëmtisë- pafuqia, e kundërta e kësaj Fuqie Esenciale, kurrësesi nuk mund t'i afrohet asaj; nuk ka asnjë lloj mundësie për të qenë kjo. Nuk mund të ketë asnjë shkallë në atë Fuqi Absolute. Meqenëse nuk mund të ketë shkallë në Të, yjet dhe grimcat janë të barabarta për Atë Fuqi, dhe nuk ka ndryshime për Të midis pjesës dhe të tërës, ose midis një individi dhe species. Ardhja në jetë e një bërthame dhe e një peme të madhe, e universit dhe e një njeriu, dhe e një individi dhe e të gjitha qënieve me shpirtëra në ringjalljen e të vdekurve është e barabartë në lidhje me Atë Fuqi, dhe që të gjitha janë njëlloj të lehta. Nuk ka ndryshim midis të madhes dhe të voglës, të shumtës dhe të paktës. Dëshmitarë vendimtarë për këtë të vërtetë janë arti i përkryer, rregulli, balanca, dallueshmëria dhe shumësia që ne shohim në krijimin e gjërave me shpejtësi absolute, me lehtësi absolute dhe me kollajllëk të plotë.

Shkalla e Parë:

Nëpërmjet misterit të rregullit krejtësisht të plotë të vëzhgueshëm, balancës, dallueshmërisë, dhe përpikërisë së bashku me lehtësinë absolute në shumësi, me shpejtësinë dhe përzierjen.

Për kuptimin e kësaj, shiko të vërtetën e lartë.

Shkalla e Dytë:

Nëpërmjet mistereve të drejtësisë, tejdukshmërisë, reciprokërisë, balancës, rregullit dhe nënshtrimit.

Për shpjegimin e detajuar të kësaj, ne ju referojmë ju fundin e Fjalës së Dhjetë, Fjalës së Njëzet e Nëntë, dhe këtu do të bëjmë vetëm një aluzion të shkurtër. Ashtu si në lidhje me dritësinë, dhe nëpërmjet Fuqisë Hyjnore, drita e diellit reflektohet aq lehtë mbi sipërfaqen e detit dhe mbi të gjitha flluskat e tij ashtu siç reflektohet mbi një copë të vetme xhami; të dyja janë të barabarta; po ashtu është aq e lehtë për Fuqinë e ndritur të Dritës së dritave për të krijuar e rrotulluar qiejt e yjet si lehtësia për të krijuar mizat dhe grimcat dhe për t'i rrotulluar ato; asgjë nuk është e vështirë për Të.

Gjithashtu, ashtu si nëpërmjet cilësisë së tejdukshmërisë dhe nëpërmjet Fuqisë Hyjnore, imazhi i diellit është i pranishëm me të njëjtën lehtësi në një pasqyrë të vockël ose në beben e syrit, dhe ashtu si, nëpërmjet Urdhrit Hyjnor, drita e tij reflektohet mbi të gjitha gjërat e ndritshme dhe pikëlat, mbi grimcat e tejndritshme dhe mbi

sipërfaqen e detit; po ashtu, meqenëse fytyrat e brendshme të esencave të gjërave janë të tejdukshme dhe të ndritshme, manifestimi dhe efekti i një Fuqie Absolute i krijon të gjitha qëniet e gjalla me lehtësinë e një individi të vetëm; nuk ka ndryshim midis të shumtës dhe të paktës të madhes dhe të voglës.

Gjithashtu në qoftë se do të vendoseshin dy arra në dy pjatat e një peshoreje të ndjeshme të përkryer e cila peshon malet, pastaj do të vendosej një bërthamë e vogël në njërën nga dy pjatat e saj, ajo do ta ngrente me lehtësi atë pjatë në maje të një mali dhe do ta ulte tjetrën në fund të luginës. Dhe në qoftë se do të vendoseshin dy male të barabartë në vend të dy arrave, njëri nga dy malet do të ngrihej në qiej dhe tjetri do të ulej në thellësitë e luginave me të njëjtën lehtësi si në qoftë se do të vendosej në njërën nga dy pjatat e saj një bërthamë e vogël.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në terminologjinë e shkencës së teologjisë 'Kelam', mundësia është e barabartë në lidhje me ekzistencën dhe mosekzistencën. Domethënë, në qoftë se nuk ka asgjë për të shkaktuar ekzistencën e tyre, gjërat të cilat nuk janë të domosdoshme por të mundshme janë të barabarta në lidhje me ekzistencën; nuk ka ndryshim. E pakta ose e shumta, e madhja ose e vogëla, janë të njëjtat në lidhje me këtë mundësi e barazi.

Kështu krijesat janë të mundshme, dhe meqenëse brenda sferës së mundësisë ekzistenca e tyre dhe mosekzistenca jane të barabarta, atëherë është e lehtë për Fuqinë e pakufishme të parapërjetshme të Ekzistuesit të vetëm të domosdoshëm t'i japë ekzistencë një qënieje të vetme të mundshme dhe ta vishte çdo gjë në një qënie të përshtatshme, duke prishur balancën e mosekzistencës. Dhe kur detyrat e qënies përfundojnë Ai ia heq -zhvesh- veshjen e saj të ekzistencës së jashtme dhe e dërgon atë në dukje në mosekzistencë, por në fakt tek një ekzistencë brenda sferës së Njohjes së Tij. Kjo do të thotë se në qoftë se gjërat i atribuohen të Gjithëfuqishmit Absolut, atëherë ardhja në jetë e pranverës bëhet aq e lehtë sa ajo e një luleje, dhe ardhja në jetë e të gjithë njerëzimit në ringjalljen e të vdekurve është aq e lehtë sa ardhja në jetë e një njeriu të vetëm. Ndërsa në qoftë se ato do t'u atribuoheshin shkaqeve, një lule bëhet aq e vështirë sa pranvera, dhe një mizë do të bëhej aq e vështirë sa të gjitha qëniet e gjalla.

Gjithashtu, nëpërmjet misterit të rregullit, vënia në lëvizje e një anijeje të madhe ose e një aeroplani nëpërmjët shtypjes së një butoni me anë të gishtit të dikujt është aq e lehtë sa vënia sa vënia në lëvizje sustën e një ore duke kthyer çelësin me gishtin e dikujt. Po ashtu meqenëse nëpërmjet parimeve të njohjes së parapërjetshme, dhe të

ligjeve të urtësisë së përjetshme, manifestimeve universale të Dëshirës Hyjnore dhe principeve të saj të specifikuara, të gjitha gjërave universale dhe të pjesshme, të mëdhaja dhe të vogla, të shumta dhe të pakta, u janë dhënë një kallëp jolëndor, masa dhe përpjesëtime të veçanta, dhe limite të caktuara; ato janë krejtësisht brenda rregullit të Njohjes Hyjnore dhe të ligjeve të Vullnetit Hyjnor.

Sigurisht kjo është aq e lehtë për të Gjithëfuqishmin Absolut për ta rrotulluar sistemin diellor dhe për t'i shkaktuar anijes së tokës të udhëtojë rreth orbitës së saj vjetore nëpërmjet Fuqisë së Tij të pafundme ashtu siç është e lehtë për Të ta bëjë gjakun të qarkullojë në trup në mënyrë të rregullt e të urtë, dhe t'i bëjë ruazat e kuqe e të bardha të qarkullojnë në gjak, dhe t'i bëjë grimcat të qarkullojnë në rruazat e vockla; sepse pa vështirësi Ai e krijon një qënie humane së bashku me organet e tij të mrekullueshme nga një pikë lëngu në modelin e universit. Kjo do të thotë se, në qoftë se do t'i atribuohej Fuqisë së parapërjetshme të pafundme, krijimi i universit është aq i lehtë sa krijimi i një qënieje të vetme humane. Por në qoftë se nuk do t'i atribuohej asaj Fuqie, do të bëhej aq e vështirë për të krijuar një qënie të vetme humane së bashku me organet e saj të çuditshme, me gjymtyrët e shqiset, aq sa krijimi i universit.

Gjithashtu, nëpërmjet misterit të nënshtrimit, bindjes dhe përputhshmërisë ndaj urdhrave, me urdhërin 'Para marsh!' një komandant e shtyn për në sulm një ushtar të vetëm, dhe po me të njëjtin urdhër, ai e shtyn për të sulmuar një ushtri të madhe e të disiplinuar.. Po ashtu, qëniet, që secila prej tyre është krejt e bindur ndaj ligjeve të Dëshirës Hyjnore, duke marrë shenjat e Urdhrit Hyjnor Kreativ, dhe ashtu si ushtari i gatshëm dhe si shërbëtori i urdhëruar me një dëshirë të bashkëlindur dhe me një zell të natyrshëm brenda sferës së parimeve të linjës së veprimit të përcaktimit nga njohja dhe nga urtësia e parapërjetshme, dhe secila prej tyre është njëmijë herë më e bindur dhe më e nënshtruar ndaj urdhrave se sa ushtarët e ushtrisë, këto qënie dhe sidomos gjallesat, secila prej tyre, sapo të marrë urdhrin Hyjnor: "Dil prej mosekzistencës në ekzistencë dhe fillo detyrën tënde", Fuqia Hyjnore i vesh asaj me lehtësi absolute një ekzistencë të veçantë në mënyrën që e ka përcaktuar njohja dhe në formën e specifikuar nga Dëshira, dhe e merr atë për dore për tek fusha e ekzistencës.

Po kështu, me të njëjtën lehtësi dhe me të njëjtat forcë e fuqi, Allahu xh.sh. e krijon ushtrinë e gjallesave në pranverë dhe e ngarkon atë me detyra.

Domethënë, në qoftëse çdo gjë i atribuohet asaj Fuqie, krijimi i të gjithë ushtrisë së grimcave të vockla dhe i divizioneve të yjeve është aq e lehtë dhe pa shqetësim si krijimi i një grimce të vetme dhe i një ylli të vetëm. Ndërsa në qoftë se do t'i atribuohej shkaqeve, krijimi i një grimce në beben e syrit të një qënije të gjallë ose në trurin e saj së bashku me aftësinë e saj për të kryer detyrat e saja të çuditshme, do të kishte qenë aq i vështirë e me telashe sa ai i ushtrisë së kafshëve.

Shkalla e Tretë:

Nëpërmjet mistereve të ndihmës së unitetit, lehtësisë së unitetit, dhe manifestimit të Njësisë.

Ne do ta shohim kuptimin e saj nëpërmjet treguesve të shkrutër.

Domethënë, për shkak të Unitetit të Sovranitetit të Tij, dhe të gjithë subjektet duke vepruar në përputhje me urdhrat e Tij, do të ishte aq e lehtë për një sundimtar dhe për një komandant të përgjithshëm të sundojë vende të shtrira, dhe një komb të madh si sundimi i njerëzve të një fshati. Sepse për shkak të unitetit të dekretit të tij, anëtarët e kombit bëhen një mjet lehtësimi ashtu si ushtarët, dhe urdhrat e ligjet e tij ekzekutohen me lehtësi. Dhe meqenëse kombi i bindur i bashkohet komandantit të vetëm, ashtu si individët e ushtrisë, nëpërmjet fuqisë së mbështetjes mbi fuqinë e komandantit dhe tek depot e tij të municionit dhe tek ushtria, secili mund ta zërë rob mbretin e armikut dhe mund të përmbushë vepra që e tejkalojnë shumë forcën e tij individuale. Lidhja e tij me atë sundimtar e bën atë të fitojë një forcë e një fuqi të pafundme, kështu që ai mund të kryejë vepra të mëdhaja. Por në qoftë se këputet lidhja, ai do ta humbiste atë fuqi të gjërë, dhe me fuqinë e tij të pjesshme do të kryente vepra vetëm sipas shkallës së fuqisë së tij të pjesshme dhe sipas municioneve të pakta dhe pajimeve të kufizuara që mban në shpinën e tij. Sepse në qoftë se do të kërkohej prej atij ushtari që të kryente të gjitha veprat që ai i përmbushte duke qenë i mbështetur tek fuqia e lidhjes së tij me sundimtarin, atëherë do të bëhej e domosdoshme ekzistenca e fuqisë së një ushtrie të plotë në krahun e tij dhe të kishte mbi shpinë depot e armëve dhe të municioneve të sundimtarit.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, për shkak të unitetit të sovranitetit të Tij dhe të sundimit absolut, Sulltani i parapërjetësisë dhe i paspërjetësisë, Autori i Gjithëfuqishëm e drejton universin me aq lehtësi si të drejtonte një qytet të vetëm dhe e krijon pranverën me aq lehtësi si të krijonte një kopësht të vetëm, dhe i ngjall të gjithë të vdekurit në ringjallje me aq lehtësi si krijimi i gjetheve të pemëve të

atij kopështi dhe i luleve dhe i frutave të tij në pranverën e ardhshme dhe e krijon mizën me sistemin e një shqiponje të madhe me lehtësi e kollajllëk; dhe me lehtësi e bën njeriun mikrokozmos. Ndërsa në qoftë se do t'u atribuohej shkaqeve, një mikrob do të bëhej aq i vështirë sa një hundëbri, dhe një frut do të bëhej aq problematik sa një pemë madhështore.

Gjithashtu, ndoshta, çdo grimceje e cila kryen detyrat e saja të çuditshme në trupin e një krijese të gjallë, duhej t'i jepej një sy që t'i shikonte të gjitha gjërat dhe një njohje që t'i njihte të gjitha gjërat me qëllim që ajo të mund t'i përmbushte ato detyra të holla e të përsosura jetike.

Gjithashtu, lehtësia dhe kollajllëku arrijnë një shkallë të tillë në unitet saqë ato bëhen të domosdoshme. Sepse në qoftë se pajisja e një ushtrie është nga një dorë, nga një uzinë ajo bëhet aq e lehtë si pajisja e një ushtari të vetëm. Ndërsa në qoftë se duar të shumta të ndryshme do të ndërhynin dhe pjesë të ndryshme të pajimeve do të silleshin nga uzina të ndryshme, atëherë pajisja e një ushtari të vetëm -për sa i përket sasisë- do të mund të përgatitej vetëm me një mijë vështirësi; meqenëse ndërhyjnë oficerë të shumtë, kjo do të ishte aq e vështirë sa pajisja e një mijë ushtarëve.

Gjithashtu, në qoftë se drejtimi dhe komandimi i një mijë ushtarëve do t'i jepej një oficeri të vetëm, nga një aspekt ajo do të bëhej aq e lehtë si komandimi i një ushtari të vetëm; ndërsa në qoftë se ato do t'u caktoheshin dhjetë oficerëve ose vetë ushtarëve, kjo do të shkaktonte konfuzion dhe vështirësi të madhe.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, në qoftë se të gjitha gjërat do t'i atribuoheshin të Vetmit të Unitetit, ato do të bëheshin aq të lehta si një gjë e vetme. Por në qoftë se ato do t'u atribuoheshin shkaqeve, një krijesë e vetme e gjallë do të bëhej aq e vështirë sa e gjithë toka, dhe ndoshta e pamundur.

Kjo do të thotë se në unitet lehtësia dhe kollajllëku janë tek niveli i domosdoshmërisë. Dhe me ndërhyrjen e duarve të shumta, vështirësitë arrijnë pamundësinë.

Ashtu siç është thënë në Mektubat -Letrat-, në qoftë se ndryshimet e ditës dhe të natës, dhe lëvizjet e yjeve, dhe ndërrimi i stinëve të vitit si, vjeshta, dimri, pranvera dhe vera, do t'i referoheshin një Organizatori të Vetëm dhe një Urdhëruesi të Vetëm, atëherë Ai Urdhërues Madhështor e urdhëron tokën e cila është njëra nga ushtarët e Tij duke i thënë:

“Ngrihu, rrotullohu dhe udhëto!” ndërkohë toka nga gëzimi e kënaqësia e marrjes së urdhërit lëviz me dy lëvizje, ditore e vjetore si një dervish mevlevi në ekstazë, dhe bëhet një mjet shumë i lehtë për ndryshimin e stinëve, për lëvizjen e dukshme dhe imagjinare të yjeve, duke shfaqur lehtësi të plotë dhe kollajllëk të pafundmë në Unitet.

Por në qoftë se çështja nuk do t’i lihej Atij Urdhëruesi të vetëm, por do t’u lihej shkaqeve dhe tekave dhe dëshirave të yjeve, dhe do t’i thuhej tokës: “Ndalo ti në vendin tënd, dhe mos udhëto!”, atëherë në çdo natë e ditë mijërat e yjeve dhe të diejve mijëra herë më të mëdhenj se toka do t’u duhej të përshkonin distancat e mijëra miliona viteve, me qëllim që nëpërmjet udhëtimit të tyre, situatat e tokës dhe të qiejve si stinët dhe dita e nata, të mund të ndodhin. Por kjo do të ishte aq e vështirë deri në shkallën e pamundësisë.

Fraza “*Dhe manifestimi i Njësisë*” aludon për një të vërtetë të gjërë, shumë të hollë, të thellë e të shtrirë. Duke ia referuar shpjegimin dhe provën e saj Risale-i Nurit, ne këtu do të shtjellojmë një pikë të vetme nëpërmjet krahasimit.

Po, ashtu si nëpërmjet dritës së tij dielli e ndriçon tokën dhe është një shembull uniteti, po ashtu nëpërmjet imazhit të tij, reflektimit, dhe shtatë ngjyrave të dritës së tij, dhe formës që shfaqet në të gjitha gjërat e tejdukshme që janë përballë tij, të tilla si pasqyrat, kjo formon një shembull Njësie. Në qoftë se dielli do të posedonte njohje, fuqi e dëshirë dhe copat e xhamit, piklat dhe flluskat në të cilat reflektohen diejt e vegjël duke shfaqur të kenë kapacitet, nëpërmjet ligjit të Dëshirës Hyjnore, në secilën prej tyre dhe pranë secilës, një diell i plotë do të ishte i pranishëm së bashku me imazhin dhe me cilësitë e tij, si dhe në të gjitha vendet e tjerë.

Duke mos pasë mangësi në fuqinë e tij në dispozicion, nëpërmjet urdhërit, efektit dhe fjalës së fuqisë Hyjnore, ai do të ishte shkaku i manifestimeve vërtet të shtrira, duke demonstruar kështu lehtësinë dhe kollajllëkun e jashtëzakonshëm të Njësisë.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, ashtu si në lidhje me Unitetin e Tij, Autori i Gjithëlavdishëm shikon nëpërmjet njohjes së Tij, dëshirës dhe fuqisë, të cilat i rrethojnë të gjitha gjërat, dhe është i pranishëm dhe Gjithëshikues gjithandej, dhe ashtu si lidhur me Njësinë e Tij dhe nëpërmjet manifestimeve të saj, Ai është i pranishëm së bashku me Atributet dhe Emrat e Tij tek të gjitha gjërat dhe veçanërisht tek gjallesat, saqë me lehtësi të plotë, për një çast, Ai e krijon një mizë në modelin e një shqiponje dhe një qënie humane sipas sistemit të

universit. Ai krijon krijesa të gjalla në mënyrë aq të mrekullueshme, saqë sikur të mblidheshin bashkë të gjitha shkaqet, ato nuk do të mund të bënin një bilbil apo një mizë. Dhe Ai i Cili e krijoi bilbilin, është pikërisht Ai i Vetëm i Cili i krijon të gjitha zogjtë; dhe Ai i Cili e krijon një qënie humane, do të mund të ishte vetëm Ai i Cili krijoi universin.

Shkallët e katërta dhe e pesta:

Dhe nëpërmjet mistereve të domosdoshmërisë, të shkëputjes së plotë dhe tjetërisë së Esencës; dhe nëpërmjet mistereve të pakufizueshmërisë, mosqënies i lidhur nga hapësira dhe të pandashmërisë.

Duke qenë shumë e vështirë për të shprehur realitetin e këtyre dy shkallëve për gjithësecilin, kuptimi i tyre do të shpjegohet në një ose në dy pika shumë të shkurtëra. Domethënë, në lidhje me fuqinë e Një të Gjithëfuqishmi Absolut ekzistenca e të Cilit është tek shkalla e domosdoshmërisë, më e fuqishmja dhe më e qëndrueshmja e shkallëve të ekzistencës, dhe është e parapërjetshme dhe e paspërjetshme, dhe i Cili është krejtësisht i shkëputur dhe i lirë prej materiales, dhe natyra e shenjtë e të Cilit është krejtësisht e ndryshme për të gjitha natyrat e tjera, në lidhje me fuqinë e Tij yjet janë si grimcat e vockëla, dhe ringjallja e të vdekurve është si pranvera. Dhe për t'i sjellë në jetë të gjithë njerëzit në Ringjallje është aq e lehtë si sjellja në jetë e një njeriu të vetëm.

Sepse ajo që është sa një thua gishti prej llojit të fuqishëm prej niveleve të ekzistencës mban një mal të madh të një niveli të lehtë - jolëndor- prej niveleve të ekzistencës, dhe mund ta vejë në lëvizje. Për shembull një pasqyrë dhe aftësia e kujtesës, të cilat janë prej nivelit të ekzistencës së fuqishme e të jashtme mund të mbajnë njëqind male dhe njëqind libra prej nivelit të ekzistencës së botës së shëmbëllesave dhe të ekzistencës jomateriale, të cilat janë të dobëta dhe jolëndore, dhe ato mund t'i përfshijnë e t'i drejtojnë.

Kështu, sado më e ulët, lidhur me fuqinë, niveli i ekzistencës së botës së shëmbëllimeve është prej nivelit të jashtëm, llojet e ekzistencës të krijuara aksidentalisht të qënieve të mundshme janë mijëra herë më të ulëta dhe më të dobëta se sa ekzistenca e domosdoshme e parapërjetshme dhe e përhershme, saqë një manifestim prej asaj ekzistence të shenjtë aq sa një grimcë do të mund të drejtonte një botë prej botërave të qënieve të mundshme.

Me keqardhje, meqenëse tre arsye të ngjashme me sëmundjen e cila buron nga helmimi në kohën aktuale, nuk më lejojnë ta shpjegoj plotësisht këtë të vërtetë të madhe dhe pikat e saj të holla, ne ia referojmë Risale-i Nurit dhe një kohe tjetër.

Shkalla e gjashtë

Dhe nëpërmjet mistereve të transformimit të pengesave dhe bllokimeve në mjete lehtësie.

Nëpërmjet një ligji të manifestimit të Vullnetit Hyjnor i quajtur në shkencë "Nyja -lidhja- e jetës", dhe të një Urdhri kreativ, dhe nëpërmjet komandës dhe vullnetit duke u kthyer drejt tyre, degët e pavetëdijshme dhe rrënjët e forta e të ashpra të një peme të madhe nuk formojnë pengesa apo bllokime për furnizimet dhe ushqimet e domosdoshme që kalojnë tek frutat e saj, tek gjethet dhe lulet nga "nyja e jetës", e cila është si forca lëvizëse dhe si stomaku i pemës; madje ato lehtësojnë procesin.

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, meqenëse të gjitha pengesat (e mundshme) në krijimin e universit dhe të krijesave pushojnë së qëni pengesa përballë një manifestimi të vullnetit dhe lidhur me urdhërin Hyjnor, dhe bëhen mjete lehtësie, Fuqia e përjetshme i krijon universin dhe të gjitha speciet e krijesave në tokë me aq lehtësi si krijimi i një peme të vetme. Asgjë absolutisht nuk është e vështirë për Të. Në qoftë se të gjitha aktet e krijimit nuk do t'i atribuoheshin asaj Fuqie, atëherë krijimi dhe administrimi i një peme të vetme do të kishte qenë aq i vështirë si krijimi dhe administrimi i të gjitha pemëve, madje si universi. Sepse atëherë të gjitha gjërat do të bëheshin pengesa e bllokada; madje edhe sikur të grumbulloheshin bashkë të gjitha shkaqet, ato nuk do të mund ta dërgonin ushqimin e domosdoshëm për frutat, gjethet, degët dhe shkarpat në mënyrë të rregullt e të sistemuar prej stomakut dhe forcës lëvizëse të "nyjes së jetës" të një peme, e cila vjen nga urdhëri dhe vullneti; veçse në qoftë se do t'i atribuohej secilës prej pjesëve të pemës, madje secilës prej grimcave një shikim që të shihte të gjithë pemën dhe çdo pjesë të saj, dhe secilën prej grimcave të saj; dhe një njohje gjithëpërfshirëse, dhe një fuqi të aftë për gjithçka.

Dhe kështu, ngjitu tek këto pesë shkallë dhe hidhe një vështrim: Shiko çfarë vështirësish -madje pamundësish- janë të pranishme në mosbesim dhe në shirk, dhe sa larg janë ato prej arsyes dhe logjikës; dhe sa të papranuara janë ato. Atëherë, shiko se çfarë lehtësie ndodhet në Rrugën e Kuranit, madje ajo lehtësi e tij është tek shkalla e domosdoshmërisë, dhe sa e pranueshme dhe e arsyeshme është ajo;

dhe çfarë e vërtete e sigurt dhe e kënaqshme gjendet në rrugën e tij, aq e sigurtë sa është e domosdoshme. Kuptoje këtë dhe thuaj***: "El hamdu lil Lah ala niëmetil iman",*** *"Lavdi Zotit për mirësinë e besimit"!*

[Vështirësitë që unë vuaja dhe pagatishmëria ime shkaktoi që pjesa e mbetur e kësaj shkalle të rëndësishme të shtyhet për një kohë tjetër, në dashtë Zoti xh.sh.]

Shkalla e shtatë

Dhe nëpërmjet misterit se e pjesshmja, pjesa, bërthama dhe njeriu nuk janë më të ulët lidhur me artin dhe me elokuencën se sa yjet, universalja, e tëra dhe pema e krijimit.

> **[Shënim**: Baza, thesari dhe dielli i të vërtetave të përfshira në këto nëntë shkallë janë vërsetet,
> "*Thuaj: Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm."*
> *"Allahu Es-Samed, i Kërkuari përjetësisht, Absoluti.*"[331]
> Ato janë tregues të shkurtër për shkreptimat prej manifestimit të Njësisë Hyjnore dhe të të Kërkuarit Përjetësisht. Duke bërë një ose dy pika, ne do të hedhim një shikim shumë të shkurtër tek kuptimi i kësaj shkallës së shtatë, dhe sa për detajet ne ju referojmë Risale-i Nurin.]

Domethënë, një grimcë e cila kryen detyra të mrekullueshme në sy apo në tru, nuk është më e ulët se sa një yll; as pjesa nuk është më e ulët se sa e tëra; për shembull, truri dhe syri nuk janë më të ulët, lidhur me artin dhe krijimin, se sa njeriu si një tërësi; dhe as individi i pjesshëm nuk është më i ulët lidhur me bukurinë e artit dhe me mrekullitë e krijimit të tij se sa specia e universales; as lidhur me gjymtyrët e tij të çuditshme dhe aftësitë njeriu nuk është më i ulët se sa të gjitha speciet e kafshëve; dhe as fara e cila është si një indeks, si një program dhe si aftësia e kujtesës, nuk është më e ulët lidhur me mjeshtërinë e hollë dhe me qënien e saj si thesar se sa pema e saj e lartë; as njeriu i cili është një botë e vogël nuk është më i ulët në krijimin e tij se sa universi i madh, meqë ai -njeriu- është krijuar në modelin më të bukur dhe posedon gjymtyrë të jashtëzakonshme gjithëpërfshirëse të krijuara për të kryer detyra të çuditshme. Kjo do të thotë se Ai i Cili krijon grimcën nuk mund të jetë i pafuqishëm të krijojë yllin. Dhe Ai i Cili krijon një organ si gjuha, sigurisht Ai me lehtësi e krijon njeriun. Dhe Ai i cili krijon një njeri të vetëm në mënyrë kaq të përkryer sigurisht mund t'i krijojë të gjitha kafshët, dhe këtë ai e realizon para syve tonë. Dhe Ai i cili i krijon një farë si një

[331] Kuran 112:1-2

list, një indeks, një regjistër i ligjeve që lëshohen nga Urdhri Hyjnor, dhe si një nyje e jetës, sigurisht Ai është Krijuesi i të gjitha pemëve. Dhe Ai i Cili e krijon njeriun si një lloj fare të botës dhe si frutin e saj gjithëpërfshirës, e bën atë pasqyrën për të gjithë Emrat Hyjnorë, dhe të lidhur me të gjithë universin, dhe e bëri kalifin e Tij në tokë, sigurisht Ai zotëron një fuqi të tillë që Ai e krijon universin më aq lehtësi siç e krijon njeriun, dhe e vendos atë në rregull.

Prandaj, kushdo që është krijues, autor dhe zot për grimcën, të pjesshmen, bërthamën dhe për njeriun, në mënyrë të vetëkuptueshme dhe të padyshimtë Ai është Krijuesi i yjeve, i specieve, i të tërës, i universaleve, i pemëve dhe i gjithë universit. Që kjo të ishte ndryshe, do të ishte e pamundur dhe e papranueshme.

Shkalla e Tetë:

Dhe nëpërmjet misterit të të pjesshmeve dhe të tërave duke qenë në mënyrë të pashmangshme në kapjen e Krijuesit të gjërave të cilat janë të rrethuara dhe pjesë si qënie të shkuara në minimaturë të ngjashme me to, ose janë pikëla të shtrydhura e të mjelura, sepse ato dhe të ngjashmet e tyre janë përfshirë në të parën me balancën e njohjes së tij, ose janë të mjelura, të shtrydhura prej tyre në përputhje me parimet e urtësisë së Tij.

Domethënë, lidhja e të pjeshmeve të rrethuara dhe e individëve, e bërthamës dhe e farërave të cilat përfshihen nga e tëra, universalet dhe deri tek universalet e mëdhaja gjithëpërfshirëse, janë në kapjen e Krijuesit të atyre të pjeshmeve dhe padyshim nën autoritetin dhe drejtimin e Tij me qëllim që nëpërmjet balancave të Njohjes së Tij dhe penave të saj të holla, Ai mund ta përfshijë atë libër të madh gjithëpërfshirës në qindra pjesë e në regjistrat e vegjël.

Pastaj, lidhja dhe krahasimi i pjesëve dhe i të pjesshmeve të rrethuara me universalet gjithëpërfshirëse janë të ngjashme me pikat e mjelura ose me pikat e shtrydhura prej universaleve gjithëpërfshirëse.

Për shembull, bërthama e bostanit është si të ishte nje pikë e mjelur prej të gjitha anëve të bostanit ose si një pikë në të cilën është shkruar i plotë libri i bostanit, saqë ajo mban indeksin e tij, përmbajtjet dhe programet e tij.

Meqenëse çështja është kështu, do të bëhej e domosdoshme që ato të pjesshme, pikëla, pika dhe individë të ishin në Dorën e Autorit të asaj të tëre gjithëpërfshirëse, me qëllim që t'i shtrydhë a t'i mjelë ato individë, pikëla e pika prej tyre nëpërmjet parimeve të ndjeshme të urtësisë së Tij. Kjo do të thotë se Ai i Cili krijon farën dhe individin duhet të jetë pikërisht Ai i Cili krijon të tërën dhe universalet, dhe universalet e tjera dhe llojet të cilat janë më të mëdhaja dhe gjithashtu i

përfshijnë ato, dhe kjo nuk mund të jetë ndryshe. Prandaj Krijuesi i një njeriu të vetëm i krijon të gjithë njerëzit, dhe Ai i cili sjell në jetë një njeri të vetëm të vdekur, mund të jetë vetëm Ai i Cili i ringjall xhindët dhe njerëzit dhe të gjithë të vdekurit në ringjallje, dhe do t'i ringjallë ata. Kështu, shikoje se çfarë pretendohet e deklarohet nga vërseti:

"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm",[332] është një e vërtetë krejtësisht e sigurtë dhe e ndritshme dhe është realiteti.

Shkalla e nëntë:

Dhe nëpërmjet misterit të një kurani të dinjitetit i shkruar me grimcat e eterit mbi një atom ose mbi grimcën më të vockël duke mos qenë më të pakta në elokuencë ose në art të mrekullueshëm se sa një kuran i madhështisë i shkruar me bojën e yjeve dhe të diejve në faqen e qiejve; gjithashtu nëpërmjet lidhjes së tyre me fuqinë e Krijuesit të universit, trëndafili i lulëzuar duke mos qenë më i pakët në elokuencë dhe në art se sa ylli Venus; as miza duke mos qenë më e ulët se sa elefanti; as mikrobi nuk është më i ulët se sa hundëbriri; dhe as bleta nuk është më e ulët se sa palma. Për më tepër, lehtësia e skajshme dhe shpejtësia në krijimin e gjërave u shkakton njerëzve të çudhëzimit të ngatërrojnë formimin me vetëformimin, i cili bën të domosdoshëm pamundësi të panumërta dhe është një iluzion -mashtrim; ndërsa ajo provon për njerëzit e udhëzimit se në lidhje me fuqinë e Krijuesit të universit grimcat dhe yjet janë të barabarta, i latësuar qoftë Ai, sepse nuk ka zot tjetër përveç Atij; Allahu është më i Madhi!

> [Unë desha të shpjegoja kuptimin e kësaj shkallës së fundit me hollësi, por me keqardhje unë u pengova nga pikëllimi e shqetësimi im i skajmë që burojnë nga shtypja arbitrare, dhe nga dobësia dhe sëmundja e rëndë, që u shkaktuan nga helmimi. Prandaj unë kam qenë i detyruar të mjaftohem me këtë tregues të shkurtër.]

Domethënë, në qoftë se një kuran madhështor do të shkruhej mbi një grimcë e cila supozohet të jetë e pandashme, dhe që quhet në shkencën e teologjisë -Kelam- dhe në filozofi "*xheuheri-i ferd*", në grimcat e eterit, që është një lëndë akoma më e hollë, dhe në qoftë se një kuran tjetër madhështor do të shkruhej në yjet dhe në diejt në faqet e qiejve, dhe atëherë të dy ato të krahasoheshin, kurani mikroskopik i shkruar në grimca nuk do të ishte më i ulët lidhur me mrekullinë dhe artin e mrekullueshëm se sa kurani madhështor duke praruar në faqen e qiejve; madje në ndonjë mënyrë ai do të ishte më i lartë.

---

[332] Kuran, 31:28

Pikërisht në të njëjtën mënyrë, nga këndvështrimi i origjinalitetit dhe i elokuencës në krijimin e tyre, në lidhje me Fuqinë e Krijuesit të universit trëndafili nuk është më i ulët se sa ylli Venus; miza nuk është më e ulët se sa elefanti; dhe një mikrob është më i çuditshëm në lidhje me krijimin e tij se sa një hundëbri; dhe me aftësitë e saja të mrekullueshme të bashkëlindura bleta është më e lartë se palma.

Kjo do të thotë se Ai i Cili e krijon bletën, mund t'i krijojë të gjitha kafshët.

Ai i Cili sjell në jetë një njeri të vetëm, mund t'i sjellë në jetë të gjithë njerëzit në Ringjalljen e të vdekurve dhe t'i tubojë ata së bashku në fushën e tubimit më të madh, dhe do t'i grumbullojë ata. Absolutisht asgjë nuk është e vështirë për Të, sepse përpara syve tanë në çdo pranverë Ai krijon njëqind mijë shembuj të ringjalljes me lehtësinë dhe me shpejtësinë më të madhe.

Në mënyrë shumë të përmbledhur, kuptimi i fjalisë së fundit arabisht është ky:

Meqenëse njerëzit e çudhëzimit nuk i njohin të vërtetat e palëkundura të 'shkallëve' të lartëpërmendura, dhe meqenëse krijesat vijnë në ekzistencë me lehtësi të skajshme dhe tepër shpejt, ata e imagjinojnë formimin e tyre dhe krijimin nëpërmjet një fuqie të pafundme të Autorit, të jetë vetëformim dhe se ata vijnë në ekzistencë nga vetvetja. Ata kështu kanë hapur për vetveten dyert e bestytnive dhe të pamundësive të pakufishme e të papranuara, të cilat as një mendje dhe madje as iluzioni nuk mund t'i pranonin. Për shembull, në atë gjendje do të bëhej e domosdoshme t'i jepje secilës prej grimcave të qënies së gjallë një fuqi të aftë për të krijuar çdo gjë, dhe një njohje dhe një shikim që të shikonte gjithçka. Domethënë, duke mos pranuar një Zot të Vetëm, Unik, ata u detyruan nga rrugët e tyre të pranojnë zotëra sa numri i grimcave, dhe kështu meritojnë të hyjnë midis më të ulëtive të ultësirës në Ferr.

Sa për njerëzit e udhëzimit, të vërtetat e fuqishme dhe të parefuzueshme të shkallëve të lartëpërmendura u japin zemrave të tyre të pastërta dhe mendjeve të tyre të drejta e të shëndosha bindjen më të fortë dhe besimin më të fuqishëm, dhe ngjiten tek niveli i 'shikimit të sigurisë', kështu që ata besojnë pa dyshim, pa skepticizëm dhe me qetësi të plotë të zemrës, dhe në lidhje me Fuqinë Hyjnore, nuk ka ndryshim midis yjeve dhe grimcave, apo midis më të voglës dhe më të madhes, sepse ato gjëra të çuditshme ndodhin mu para syve tonë.

Dhe çdo mrekulli arti konfirmon pohimin e vërsetit,

"Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëvë janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm"[333] dhe dëshmon se ajo çfarë ai pohon është e vërtetë e pastër dhe realitet, dhe nëpërmjet gjuhëve të qënieve e të gjendjeve të tyre, ato deklarojnë: "*Allahu Ekber*" sa numri i tyre. Dhe me të gjithë fuqinë tonë dhe me bindjen ne afirmojmë pretendimin e vërsetit, dhe dëshmojmë me prova të panumërta se ajo çfarë ai pohon është e vërtetë e pastër dhe realitet.

"Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga çna ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."[334]

O Zot! Jepi bekime e paqe atij të cilin Ti e dërgove si mëshirë për të gjitha botët, dhe të gjithë lavdërimet e falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të të gjitha botëve.

• • •

[333] Kuran, 31:28
[334] Kuran, 2:32

Një Fjalë lavdëruese që u përgjigjet pyetjeve: Ç'është Risale-i Nuri? Cila është natyra e vërtetë e tij, dhe cila është natyra e interpretuesit të tij?

Shërbëtorët e lartë të fesë të cilët përshkruhen në hadithe se do të vijnë në fillim të çdo shekulli nuk janë novatorë -njerëz të bidateve- ata janë ndjekës. Domethënë, ata nuk shpikin vetë asgjë të re; ata nuk sjellin asnjë urdhëresë të re; ata ndreqin dhe forcojnë fenë duke ndjekur e duke iu bindur pikë për pikë themeleve të urdhëresave të fesë dhe të sunnetit të profetit Muhammed a.s.m.; ata shpallin kuptimin e vërtetë dhe origjinal të fesë; ata largojnë e shfuqizojnë çështjet e pabaza të cilat kanë qenë përzier me fenë; ata refuzojnë dhe shkatërrojnë sulmet e bëra kundra fesë; ata vërtetojnë urdhëresat Hyjnore, dhe shpallin e bëjnë të njohur fisnikërinë dhe lartësinë e dekreteve Hyjnorë. Vetëm, duke mos e prishur pozitën bazë as duke mos e dëmtuar shpirtin origjinal, ata i kryejnë detyrat e tyre nëpërmjet metodave të reja të bindjes të përshtatshme për konceptimin dhe kuptimin e shekullit, dhe në mënyra të reja dhe me detaje të reja.

Këto nëpunës Hyjnorë i konfirmojnë pozitat e tyre nëpërmjet akteve dhe veprave të tyre. Ato i përmbushin detyrën e tyre të reflektimit, qëndrueshmërinë e besimit të tyre dhe sinqeritetin e tyre. Ata shfaqin në aktet e tyre shkallën e tyre të besimit. Ata shfaqin se i ndjekin pikë për pikë praktikat e profetit Muhammed a.s.m. dhe se me të vërtetë ata janë veshur me robën profetike.

Shkurtazi: Për *ummetin* e Muhammedit a.s.m. ata formojnë modelet e përkryera në lidhje me veprat dhe moralin dhe me ndjekjen dhe kapjen pas sunnetit të profetit a.s.m., ata janë shembuj të denjë për t'u ndjekur. Veprat që ata i shkruajnë duke shpjeguar librin e Allahut dhe duke sqaruar urdhëresat e fesë, dhe duke i paraqitur këto në përputhje me konceptimin dhe kuptimin e shekullit dhe me shkallët e tij të njohjes, ato vepra nuk janë produktet e mendjeve të tyre të larta e pjellore; ato nuk janë as rezultat i zgjuarsisë dhe i njohjes së tyre; por ato janë drejtpërdrejt inspirimet -ilhamet- dhe shtytjet e esencës së pastër të profetësisë a.s.m. i cili është burimi i shpalljes. *Xhal xhalutijjeh, Mathnavi Sharif,* dhe *Futuh el-Gajb* dhe vepra të tjera të tilla, që të gjitha janë të këtij lloji. Ata persona të shenjtë kanë një pjesë në renditjen e atyre veprave të zgjedhura dhe në mënyrën e tyre të shpjegimit; domethënë, ato janë vendet ku kuptimet e tyre manifestohen dhe reflektohen.

Për të ardhur tek Risale-i Nuri dhe interpretuesi i tij:

Meqenëse në këtë vepër të lartë ka një shkëlqim të lartësuar dhe një përsosuri të pafundme që nuk janë hasur kurrë në ndonjë vepër më

parë; dhe meqenëse është vëzhguar se ajo nuk është parë deri më sot në ndonjë vepër, ai është trashëgimtari i shkëlqimeve të kuranit, i cili është një Llambë Hyjnore dhe dielli i udhëzimit dhe hëna e lumturisë; është një fakt aq i qartë si dielli se baza e Risale-i Nurit është drita e pastër e kuranit dhe se ai mban shkëlqimin e dritave të Muhammedit a.s.m. deri në një shkallë më të lartë se sa veprat e Evlijave - shenjtorëve; dhe se pjesa tek ai, lidhja me të, dhe autoriteti i shenjë sipër tij prej Esencës më të pastër të profetësisë a.s.m. janë më të mëdhaja se sa në veprat e Evlijave, dhe arrijtjet dhe plotësimet e atij i cili është interpretuesi i tij dhe vendi i manifestimit është i lartësuar dhe i pashok në të njëjtën shkallë.

Po, ndërsa akoma në fëmijërinë e tij dhe duke mos pasë studiuar kurrë, në hapësirën e një studimi tremujor me qëllim që të shpëtohet prej aspekteve të jashtme, interpretuesi i Risale-i Nurit u bë trashëgimtari për shkencat e hershme e të vonshme, për njohjen mistike, për realitetet e gjërave, për misteret e universit, për urtësinë Hyjnore, e cila nuk i qe dhuruar asnjërit më parë. Me dijen e tij dhe me qëndrueshmërinë morale, që përbëhej nga të qenurit i tij dëlirësi e mishëruar, nga guximi i tij i jashtëzakonshëm dhe nga vetëmjaftueshmëria e tij e plotë, ai ishte një mrekulli e krijimit, një mishërim i Përkujdesjes Hyjnore; dhe aftësitë e tij iu dhanë prej Allahut.

Si një dijetar i pashok, si një gjeni i jashtëzakonshëm duke sfiduar të gjithë botën e dijes përpara se të arrinte moshën e pubertit, ai i heshti të gjithë dijetarët me të cilët ai debatoi, dhe iu përgjigj në mënyrë krejtësisht të saktë dhe pa ngurrim të gjitha pyetjeve që iu bënë atij; mbajti mantelin e 'profesorit' qysh prej moshës katërmbëdhjetë vjeç dhe në mënyrë të vazhdueshme rrezatoi shkëlqimin e njohjes dhe dritën e urtësisë. Me hollësinë dhe thellësinë e shpjegimit të tij, me vetëdijen dhe lartësinë e shtjellimeve të tij, dhe me intuitën, mendjemprehtësinë dhe dritën e urtësisë, ai i habiti dijetarët dhe studiuesit, duke merituar fitimin e titullit ***Bediuzzaman***, *"Mrekullia e kohës*". Si dikush që me cilësitë e tij të larta dhe me virtytet shkencore përhapi dhe provoi në mënyrën më të përkryer fenë e Muhammedit a.s.m., ai sigurisht mori favoret më të larta të prijësit të profetëve a.s.m., dhe qe nën mbrojtjen dhe nën patronazhin e tij të lartë. Padyshim ai ishte një njeri me virtyt të lartë e fisnik i cili avancoi tek shkalla e profetit më të shenjtë a.s.m., dhe veproi nën komandën e tij, dhe ishte trashëgimtari për të vërtetat e tij dhe reflektoi dritat e tij.

Ashtu siç tregohet nga bërja e tij dritat dhe njohjen e Muhammedit a.s.m. dhe rrezatimin e Llampës Hyjnore -Kuranin- të vezullojnë në mënyrën më të ndritshme, dhe kuptimet matematikore të kuranit dhe të

hadithit duke u përmbushur tek ai, dhe shpjegimet matematikore të vërseteve duke shprehur shprehjet profetike të përqëndruara mbi të, atëherë nuk ka dyshim se ai ishte një pasqyrë e shkëlqyer për profetësinë Hyjnore në shërbim të çështjes së besimit, dhe fruti i ndritshëm përfundimtar i pemës së profetësisë, dhe gjuha përfundimtare e realitetit në lidhje me trashëgiminë e gjuhës së profetësisë, dhe mbajtësi i fundit i 'Llambës Hyjnore' në lidhje me shërbimin e besimit.

Në emrin e studentëve të Risale-i Nurit të cilët morën pjesë në mësimin e vetëm shkollës së tretë të Jusufit, që përbëhet nga "*prova e ndritur*" dhe "*Zuhretun Nur*".

Ahmed Fejzi, Ahmed Nazif, Salahuddin, Zybejr, Xhejlan, Sungur, Tabançalë.

Ata më kanë dhënë mua një pjesë shumë më të madhe se sa e meritoj. Por nga mungesa e kurajos për t'i fyer këta nënshkrues, unë qëndrova i heshtur, dhe e pranova lavdërimin e tyre në emrin e personalitetit kolektiv të studentëve të Risale-i Nurit.

• • •

Me Emrin e Tij qoftë Ai i lavëruar!
Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij.

Paqja qoftë mbi ju dhe mëshira e Zotit dhe bekimet, përherë e përgjithmonë!

O profesori ynë më i dashur, i bekuar, me vlerë më të lartë dhe i mirë!

O profesori ynë i nderuar, që e ke braktisur krejtësisht dëshirën tënde dhe që ia ke lënë të gjitha çështjet Dëshirës Hyjnore, që e shikon mëshirën dhe urtësinë e Kaderit Hyjnor në çdo fatkeqësi të jashtme dhe mundim, dhe me besim të plotë dhe me nënshtrim pret me durim të plotë rezultatet e atij manifestimi Hyjnor! Në këtë shekull të tmerrshëm kur në disa vende gjërat mbi të cilat mbështeten besimtarët, kanë filluar të thërrmohen, dhe me botimet duke kundërshtuar shtyllat e besimit, mohuesit e Zotit kapardisen në mënyrë të hapur e me arrogancë, dhe për të vepruar në kundërshtim me urdhërat e kuranit, dhe duke mos besuar në forcat shpirtërore, dhe duke ia atribuuar të drejtën e krijimit natyrës së pavetëdijshme, të verbër e të shurdhët i konsiderojnë shenjat e civilizimit dhe qënien e tyre të 'kulturuar' dhe 'intelektualë' -në një kohë të tillë, profesori ynë i dashur shkroi Risale-

i Nurin, një mrekulli e Kuranit, dhe duke ofruar ilaçet qetësuese për zemrat e trazuara e të mjera që kanë nevojë për ujin e jetës së besimit, u dha atyre lajmet e gëzueshme të lumturisë së përjetshme. Në rrugën e tij të realitetit e cila i provon mësimet e saj me argumente dhe prova vendimtare e kategorike, dhe nëpërmjet misterit të Udhëzuesit tonë të shquar (a.s.m.), të cilit i referohet "*shkaku është si vepruesi*", barasvlera e të gjitha veprave të mira të kryera nga qindra mijëra studentë të Risale-i Nurit të cilët kanë shpëtuar besimin e tyre nëpërmjet Risale-i Nurit, kanë kaluar tek regjistri i veprave të tij të mira!

Ashtu si në burgun e Denizlit Allahu i Gjithëfuqishëm dhuroi trajtesën "*Frutat e Besimit*", ilaçet e të cilës ishin mjaft të efektshme për ta zvogëluar në asgjë pikëllimin e burgosjes, dhe ajo erë e mirë e trëndafilit i zhduku të gjitha dhimbjet e gjëmbave të tij, duke larguar të gjithë dëshpërimin tonë të përkohshëm; po kështu, këtu në burgun e Afjonit, vështirësitë fizike të një dite, të cilat janë të barabarta me vështirësitë e një muaji në burgun e Denizlit, Gjithëbujari i Gjithëmëshirshëm Zotëruesi i bukurisë i ka dhuruar dorës tënde, o profesori ynë i dashur, prova sublime duke afirmuar Unitetin Hyjnor dhe duke vërtetuar e vlerësuar profetësinë e Muhammedit a.s.m., të cilat janë ilaçe dhe antidote. Ne studentët e Risale-i Nurit që kemi mësuar të lexojmë dhe të shkruajmë, i konsiderojmë këto tre trajtesa të shkurtëra të jenë prova përfundimtare të vërtetësisë së Risale-i Nurit dhe si një lloj përmbledhje e tij, në të njëjtën mënyrë si programi dhe indeksi i një pishe madhështore të mbyllura e të përfshira në farën e saj.

Ne jemi të paaftë për të përshkruar virtytet e këtyre tre trajtesave, por duke i lexuar ato, shpirtërat tonë përjetojnë një qetësi të madhe, vuajtjet tona fizike transformohen në gëzim, dhe ato na sjellin neve fruta të panumërt prej kopështit të besimit. Me njëmbëdhjetë provat e saj të Unitetit Hyjnor, e para e tyre largon errësirën e mosbesimit, çudhëzimin dhe natyrën në këtë kohë. E dyta shpjegon me prova të shenjta të besimit Suren *El-Fatiha*, burimin, bazën dhe profesorin e të gjitha krahasimeve në Risale-i Nur. Dhe e treta shpjegon në mënyrë brilante në një mënyrë që i jep siguri të plotë pjesës rreth profetësisë së Muhammedit a.s.m., e cila t'u shfaq ty në zemër, o profesori ynë i dashur, këtu në burgun e Afjonit.

Megjithëse nuk jemi të denjë për asgjë, ne do të përpiqemi me të gjithë fuqinë tonë t'i botojmë këto vepra, të cilat ne i kemi marrë.

Duke bërë lavdërime e falënderime të pafundme për Zotin e Gjithëfuqishëm, ne i lutemi Atij duke thënë "O më Mëshiruesi i

mëshiruesve! Qofsh Ti i kënaqur me profesorin tonë përherë e përgjithmonë!

I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!

Në emrin e studentëve të Risale-i Nurit
Zyjber, Çejlan, Sungur, Ibrahim

• • •

Parathënia e predikimit të Damaskut

Me Emrin e Tij qoftë Ai i lavdëruar!
Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij.

Paqja qoftë mbi ju dhe mëshira e Zotit dhe bekimet përherë e gjithmonë!

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

[Duke parandier të ardhmen, Saidi i Vjetër perceptoi të vërtetat e shprehura në këtë predikim arabisht, i cili me ngulmimin e autoriteteve fetare të Damaskut, e mbajti para dyzet viteve në xhaminë Umejade para një xhemati me afërsisht dhjetë mijë vetash, i cili përfshinte njëqind dijetarë fetarë; ai i dha njoftimet e atyre të vërtetave me siguri të plotë sikur ato të realizoheshin së shpejti.

Por, dy luftërat Botërore dhe njëzet e pesë vitet e despotizmit absolut e vonuan realizimin e tyre; dhe vetëm tani shenjat e kësaj, të cilat u parashikuan atëherë, kanë filluar të shihen në botën islame. Prandaj në qoftë se ju e konsideroni të përshtatshme, mund ta botoni përkthimin e kësaj pjese më të rëndësishme e instruktive, jo si një predikim të vjetëruar, të dalë mode, por si një instruksion të freskët e të drejtpërdrejt me çështjet shoqërore dhe islame duke iu adresuar në mënyrë direkte, në 1371 në vend të 1327, xhematit të treqind e shtatëdhjet milion njerëzve (tani më shumë se një miliardë) në xhaminë e botës islame, dhe jo vetëm xhematit të xhamisë Umejade.]

Është e përshtatshme këtu të shkruajmë përgjigjjen më të rëndësishme për një pyetje më të rëndësishme. Sepse Saidi i Vjetër foli në mënyrë parashikuese në atë mësim para dyzet vitesh sikur ai po i shihte mësimet e çuditshme të Risale-i Nurit dhe efektet e tij. Për këtë arsye, unë jam duke i shkruar atë pyetje dhe atë përgjigjje këtu. Kjo është sa vijon:

Shumë më kanë pyetur mua dhe studentët e Risale-i Nurit: "Përse Risale-i Nuri nuk mposhtet përballë kundërshtimit kaq të madh dhe përballë kaq shumë filozofëve kryeneçë dhe njerëzve të çudhëzimit?

Duke penguar deri në një shkallë përhapjen e librave të vlefshëm e të vërtetë mbi besimin dhe islamin, dhe nëpërmjet kënaqësive të tyre të dynjasë dhe shthurjes, ata kanë privuar shumë të rinj dhe të tjerët prej të vërtetave të besimit. Por sulmet e tyre tepër të dhunshme, trajtimi dashalig, gënjeshtrat dhe propaganda janë drejtuar tek Risale-i Nuri,

për ta shkatërruar atë dhe për t'i larguar njerëzit prej tij dhe për t'i bërë ata që ta braktisin. Pavarësisht kësaj, Risale-i Nuri ka përhapur në një mënyrë që nuk është parë kurrë në ndonjë vepër tjetër gjashtëqind mijë kopje prej trajtesave të tij të shkruara me dorë me një zell të përhershëm dhe të botuara në mënyrë të fshehtë. Si është e mundur që ai e bën vetveten të lexohet me një entuziazëm të tillë si brenda dhe jashtë vendit? Cila është arsyeja për këtë?

Në përgjigje të shumë pyetjeve të këtij lloji ne thamë:

Duke qenë një koment i vërtetë i Kur'anit të gjithurtë nëpërmjet mistereve të mrekullisë së tij, Risale-i Nuri demonstroi se në çudhëzim është një lloj ferri në këtë botë, ndërsa në besim është një lloj parajse. Ai tregon dhimbjet e rënda që ndodhen në mëkate, në vepra të këqija dhe në kënaqësi të ndaluara, dhe provon se në veprat e mira, në virtytet dhe në të vërtetat e Sheriatit gjenden kënaqësi si kënaqësitë e parajsës. Në këtë mënyrë ai shpëton të ndjeshmit midis atyre që kanë rënë në shthurje e në çudhëzim. Sepse në këtë kohë ndodhen dy rrethana të tmerrshme:

E para: Meqenëse emocionet e njeriut të cilat janë të verbëra për pasojat e gjërave, dhe preferojnë një ons prej kënaqësisë së tanishme mbi tonelata prej gëzimeve të së ardhmes, -këto emocione- kanë sunduar -në këtë shekull- mbi vëmendjen dhe mbi arsyen, atëherë e vetmja rrugë për t'i shpëtuar të shthururit nga shthurja e tyre është t'u tregosh atyre dhimbjen e pranishme në vetë kënaqësinë dhe për t'i mposhtur ato emocione. Sepse njeriu në këtë kohën tonë, megjithëse është i vetëdijshëm për kënaqësitë e Ahiretit dhe për mirësitë e tij të çmueshme si diamanti, ai preferon mbi to kënaqësitë e kësaj dynjaje të cilat janë si copa xhami që thyhen shpejt, ashtu siç tregon vërseti,

"Ata të cilët parapëlqejnë jetën e kësaj bote në vend të jetës së Ahiretit..."[335] Dhe duke u mbështetur mbi këtë, dhe nga dashuria e madhe për dynjanë, ti e sheh atë të shtyhet pas njerëzve të çudhëzimit dhe i ndjek ata pasi ishte prej njerëzve të besimit.

Rruga e vetme për ta shpëtuar atë prej rrezikut të kësaj shtytjeje është t'i tregosh dhimbjet e Ferrit dhe torturën e tij edhe në dynja gjithashtu.

Dhe kjo është rruga që merr Risale-i Nuri.

Sepse në këtë kohë, për shkak të kryeneçësisë që buron nga mosbesimi absolut dhe nga intoksikimi i shkaktuar nga shthurja dhe çudhëzimi që burojnë nga shkenca, ndoshta vetëm një në dhjetë ose madje një në njëzet mund të shtyhet t'i braktisë rrugët e tij të liga

---

[335] Kuran, 14:3

nëpërmjet argumentimit të ekzistencës së Ferrit dhe të torturave të tij dhe pasi të jetë bërë i njohur Krijuesi xh.sh..

Duke pas dëgjuar këtë, njerëz të tillë ka gjasa të thonë: "Allahu është Fajfalës e Mëshirëplotë... dhe Ferri është shumë larg". Dhe pastaj vazhdojnë në shthurjen e tyre. Zemrat dhe shpirtërat e tyre mposhten nga emocionet e tyre.

Kështu, duke shfaqur nëpërmjet shumicës së krahasimeve rezultatet e rënda dhe të tmerrshme që shkaktohen nga mosbesimi dhe çudhëzimi në këtë dynja, Risale-i Nuri i bën madje edhe njerëzit më kryeneçë të ndjehen të neveritur tek ato kënaqësi të mbrapshta e të paligjshme, duke i çuar ata të bëjnë pendesë. Krahasimet e shkurtëra në Fjalët e Gjashta, e Shtata dhe e Teta, dhe një krahasim i gjatë të cilin e përmban Vendqëndrimi i Tretë i Fjalës së Tridhjetë e Dytë e çojnë njeriun të ndjehet i neveritur nga shthurja dhe çudhëzimi i rrugës që ai ka marrë, dhe e bëjnë atë t'i pranojnë mësimet që ato japin. Si një shembull, unë do të tregoj në mënyrë të përmbledhur situatat që unë vëzhgova në një udhëtim imagjinar, të cilat në fakt ishin realitet. Ata të cilët dëshirojnë më shumë detaje mund të shikojnë tek fundi i librit "*Sikke-i tasdikil Gajb*".

Kur gjatë atij udhëtimi imagjinar unë hodha vështrimin tek bota e kafshëve, nëpërmjet këndvështrimit të filozofisë materialiste dhe të njerëzve të çudhëzimit dhe të shkujdesjes, pashë se nevojat e panumërta të kafshëve dhe uria e tyre e tmerrshme së bashku me dobësinë dhe pafuqinë e tyre m'u shfaqën mua si më të mjerat e më të dhimbshmet; dhe unë lëshova një klithmë me dëshpërim e pikëllim. Pastaj unë e vështrova atë botë nëpërmjet teleskopit të urtësisë së kuranit dhe të besimit, dhe papritmas Emri Hyjnor ***Er-Rahman,*** *i Gjithëmëshirshmi* rrezatoi prej yjësisë së ***Er-Rezzak****, Gjithëfurnizuesi* si dielli vezullues; ai e ndriçoi me dritën e mëshirës së tij atë botë të uritur e të mjerë të kafshëve.

Pastaj unë pashë një botë tjetër brenda kësaj botës së kafshëve; ajo ishte bota e zogjve të vegjël të cilët përpiqeshin në nevojën dhe në pafuqinë e tyre, dhe të cilën e kishte mbuluar një errësirë pikëlluese e dhimbshme, gjë e cila e bënte çdo njeri të ndjente keqardhje. Unë qeshë shumë i hidhëruar që kisha parë nëpërmjet syrit të njerëzve të çudhëzimit. Papritmas, besimi më dha mua syze të tjera dhe unë pashë nëpërmjet tyre Emrin Hyjnor ***Er-Rahim****, Mëshirëploti* i cili lindi nga yjësia e dhembshurisë; ai e transformoi dhe e ndriçoi atë botë të dëshpëruar në një botë gëzimi e të bukur, duke i shndërruar lotët e mi të ankesës dhe të dëshpërimit në lotë gëzimi e falënderimesh.

Pastaj, bota e humanizmit u shfaq tek unë si në një ekran kinemaje. Unë vështrova nëpërmjet teleskopit të njerëzve të çudhëzimit dhe e

pashë atë botë të ishte aq e errët dhe e tmerrshme saqë unë bërtita nga thellësitë e zemrës sime: Ah, medet! Sepse ata kishin dëshira e shpresa që shtriheshin deri në përjetësi, kishin mendime dhe imagjinata që rrethonin universin, kishin përmallim për lumturinë e përhershme dhe për parajsën, dhe kishin kapacitet të bashkëlindur dhe fuqi mbi të cilat nuk ishte vënë limit dhe të cilat ishin të lira, por pavarësisht nevojave të tyre të panumërta dhe dobësisë dhe pafuqisë së tyre, ata ishin të zbuluar para sulmeve të armiqve të panumërt dhe para goditjeve të fatkeqësive të panumërta. Nën kërcënimin e vazhdueshëm të vdekjes ata i jetonin jetët e tyre të shkurtëra në gjendjet më të mjeruara. Duke e parë gjithmonë varrin, i cili për të çudhëzuarit është dera për një errësirë të përhershme, ata vuajtën goditjet e vazhdueshme të vdekjes dhe të ndarjes, gjendjen më të dhimbshme për zemrën dhe ndërgjegjen. Unë pashë se, veçmas dhe në grupe, ata po hidheshin në atë pus të errët. Dhe kështu në kohën që e pashë këtë botën e humanizmit duke u mbytur në errësira të këtilla dhe isha gati të qaja me zemrën time, me shpirtin, me mendjen dhe me të gjitha aftësitë e mia të holla të bashkëlindura, dhe madje me të gjitha grimcat e qënies sime, kur papritmas dritat dhe fuqia e besimit që burojnë nga kurani i copëtuan ato syze çudhëzimi dhe i dhanë mendjes sime një shikim depërtues me të cilin të shikoja Emrat e bukur Hyjnorë të cilët rrezatuan si dielli vezullues prej yjësive të tyre; kështu Emrin Hyjnor ***El-Adilu**, i Drejti* e pashë duke u shfaqur prej yjësisë së ***El-Hakimu**, i Gjithurti* dhe Emrin Hyjnor ***Er-Rahman**, i Gjithëmëshirshmi* prej yjësisë së ***El-Kerim**, Gjithëbujari,* dhe Emrin Hyjnor ***Er-Rahim**, Mëshirëploti* prej yjësisë së ***El-Gafur**, Fajfalësi* -domethënë në kuptimin e tij- dhe Emrin Hyjnor ***El-Ba'ithu**, Ringjallësi* duke lindur prej yjësisë së ***El-Va'rithu**, Ai që bën të trashëgohet*, dhe Emrin Hyjnor ***El-Muhji**, Jetëdhënësi* duke lindur në yjësinë e ***El-Muhsin**, Mirëbërësi* dhe Emrin Hyjnor ***Er-Rabb**, Zoti, Mbështetësi* prej yjësisë së ***El-Malik**, Pronari*.

Këto Emra Hyjnorë e ndriçuan të gjithë botën e humanizmit dhe të gjitha botët brenda saj; ato i larguan të gjitha gjendjet e skëterrshme, hapën dritare për botërat e ndritshme të Ahiretit, dhe përhapën dritë në të gjitha anët e botës së humanizmit. Ndërkohë, unë thashë: **"*El-Hamdu lil-Lah..Esh-Shukru lil Lah***" *"Lavdrimi i takon Allahut, falënderimi i takon Allahut"* sa numri i grimcave në botë! Dhe pashë me syrin e sigurisë dhe kuptova me njohjen e sigurisë: se *"në besim ndodhet një lloj parajse edhe në këtë botë gjithashtu, ndërsa në çudhëzim ndodhet një lloj ferri edhe në këtë dynja gjithashtu*.

Pastaj në atë udhëtim imagjinar u shfaq bota e tokës. Rregullat e errëta e hipotetike të filozofisë të cilat nuk i binden fesë paraqiten me imagjinatën time në një botë të tmershme e të çuditshme. Duke

udhëtuar me anije mbi hapësirën e tokës së plakur -e cila udhëton shtatëdhjetë herë më shpejt se sa një gjyle topi duke përshkuar distancën e njëzet e pesë mijë viteve në një vit, dhe duke u zbuluar në çdo çast para shpërbërjes dhe shkatërrimit, dhe në brendësi të saj ajo mban tërmete të frikshëm dhe mbi shpinën e saj është ky njeri i mjerë i cili udhëton me të në atmosferën e hapësirës së pakufishme...

Situata e këtij njeriu të mjerë m'u shfaq mua në një errësirë të shkretë. Sytë e mi u errësuan; ndërkohë unë i hodha për tokë syzet e filozofisë dhe i copëtova. Pastaj unë vështrova me një shikim të ndriçuar me urtësinë e kuranit dhe të besimit, dhe papritmas Emrat Hyjnorë ***Khalikul Erdi Ves-sema-vat, El-Kadiru, El-Alimu, Er-Rabb, Allah, Rabbussema-vati vel-erd, ve Museh-hiri Sh-Shemsi vel-Kamer,*** *Krijuesi i tokës dhe i qiejve, i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri, Mbështetësi -Zoti-, Allahu, Zoti i qiejve dhe i tokës, Nënshtruesi i diellit dhe i hënës",* ndriçuan si dielli në yjësitë e mëshirës, të madhështisë dhe të Hyjnisë. Ato e ndriçuan atë botë të errët, të shkretë e të tmerrshme saqë globi u shfaq për syrin tim të besimit si një anije e mirërregulluar, e nënshtruar, e këndshme dhe e sigurt, ose si një aeroplan apo tren. Ajo përmbante ushqimet e gjithësecilit, dhe ishte e përgatitur për tregti, për kënaqësi si dhe për t'i transpotruar qëniet me shpirtëra nëpër një mbretëri të gjërë Hyjnore përreth diellit. Ndërkaq unë thashë: "***El –hamdu lil –lah alà niëmetil iman"*** '*lavdi Zotit për mirësinë e besimit*' sa numri i grimcave të tokës.

Kjo është provuar me shumë krahasime në Risale-i Nur, se ata që ndjekin shthurjen dhe çudhëzimin vuajnë një torturë të skëterrshme edhe në këtë botë gjithashtu, ndërsa nëpërmjet manifestimeve të besimit, besimtarët dhe të drejtët mund të shijojnë nëpërmjet stomakut të islamit dhe të humanizmit kënaqësitë e Parajsës. Ata mund të përfitojnë sipas shkallës së besimit të tyre. Por në këto kohë të stuhishme, rrymat të cilat mpijnë shqisat e ndjenjat dhe që e kthejnë shikimin e njeriut mbi çështjet dytësore, anësore, duke e zhytur atë në to, ia kanë mpirë ndenjat dhe e kanë hutuar. Si rrjedhojë e kësaj, njerëzit e çudhëzimit janë të pamundur përkohësisht që ta ndjejnë torturën e tyre, kurse njerëzit e udhëzimit janë të mposhtur nga pakujdesia dhe nuk mund ta vlerësojnë siç duhet kënaqësinë e vërtetë të besimit.

Rrethana e dytë e tmerrshme e këtij shekullit tonë aktual: Në të shkuarën të krahasuar me të tashmen, kishte vetëm pak mosbesim absolut apo çudhëzim që buronin nga shkenca, apo mosbesimi që buron nga kryeneçësia e mbrapshtë. Prandaj instruksioni i dijetarëve islamë të atyre kohëve dhe argumentet e tyre ishin të mjaftueshëm dhe largonin shpejt çdo mosbesim që buronte nga dyshimet. Besimi në

Zotin ishte i përgjithshëm, dhe ata mund t'i bindnin shumicën e njerëzve që t'i braktisnin çudhëzimin dhe gabimin e tyre me anë të mësimit të tyre rreth Krijuesit dhe duke u kujtuar atyre zjarrin e xhehennemit.

Ndërsa tani ndodhen njëqind mosbesimtarë absolutë në një qytet të vogël në vend të ndoshta një mosbesimtari në të gjithë vendin. Ata të cilët e humbasin rrugën e tyre për shkak të shkencës dhe të dijes dhe me kryeneçësi kundërshtojnë të vërtetat e besimit janë shtuar njëqindfish në krahasim me kohët e hershme. Me krenarinë si ajo e faraonit dhe me çudhëzimin e tyre të tmerrshëm këta mohues kryeneçë i kundërshtojnë të vërtetat e besimit. Prandaj një e vërtetë e shenjtë do të ishte shumë e nevojshme që do t'i shkatërronte krejtësisht bazat e mosbesimit të tyre në këtë botë, ashtu si një bombë atomike, që të ndalonte agresionin e tyre dhe që t'i sillte disa prej tyre në besim.

Lavdi Zotit që me krahasimet e tij të shumta, si një ilaç i përkryer për plagët e kësaj kohe, Risale-i Nuri -një mrekulli e Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm duke buruar prej shkëlqimeve të tij- ka shpartalluar madje edhe më të këqinjtë e atyre mohuesve kryeneçë me shpatën prej diamanti të Kuranit. Provat dhe argumentet e tij sa numri i atomeve të universit duke demonstruar Unitetin Hyjnor dhe të vërtetat e besimit tregojnë se gjatë njëzet e pesë viteve ai nuk është mposhtur as përballë sulmeve më të egra, por ai vetë ka mbisunduar dhe ka qenë fitimtar.

Po, me krahasimet e tij të besimit dhe të mosbesimit, udhëzimit dhe çudhëzimit, Risale-i Nuri i provon ato të vërteta në mënyrë vendimtare. Ai që do t'i studionte, për shembull, provat dhe shkreptimat e Fajlës së Njëzet e Dy -me dy stacionet e saja- dhe do të hidhte vështrimin tek Vendqëndrimi i Parë i Fjalës së Tridhjet e Dy ose do të lexonte Dritaret e Letrës së Tridhjetë e Tre, dhe njëmbëdhjetë provat e koleksionit 'Shkopi i Musait', do të kuptonte se të vërtetat e Kuranit të manifestuara në Risale-i Nur janë pikërisht ato që mund ta thyejnë kurrizin e mosbesimit absolut dhe mund ta shkatërrojnë çudhëzimin e mbrapshtë në këtë kohë.

Ashtu si pjesët e Risale-i Nurit të cilat zgjidhin misteret më të mëdhaja të fesë dhe enigmën e krijimit në botë që janë grumbulluar së bashku në koleksionin e mistereve "*Tilsimlar mexhmuas*", unë shpresoj tek Allahu i Madhërishëm që gjithashtu të grumbullohen ato pjesë të shpërndara, të cilat provojnë me dëshmi e argumente se njerëzit e çudhëzimit jetojnë në Ferr edhe në këtë dynja, dhe se njerëzit e udhëzimit i provojnë kënaqësitë e xhennetit edhe në këtë dynja gjithashtu dhe se besimi është si fara e parajsës ndërsa mosbesimi është një bërthamë prej bërthamave të Zekkumit të Ferrit.

Unë shpresoj që të grumbullohen ato pjesë të Risale-i Nurit në një koleksion të përmbledhur dhe të botohen me ndihmën e Allahut dhe me suksesin prej Tij.

Said Nursi

Me Emrin e Tij qoftë Ai i lavdëruar!
Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij!

Vëllezërit e mi të dashur, besnikë, të palëkundur, të qëndrueshëm, të përkushtuar dhe besëplotë!

Ju e dini se komiteti i ekspertëve të Ankarasë nuk qe në gjendje t'i mohonte shembujt e kerameteve dhe të parashikimeve që shikonin Risale-i Nurin; anëtarët e tij vetëm gabimisht supozuan se unë kisha një pjesë në to dhe kundërshtuan duke thënë: "Gjëra të tilla nuk duhet të ishin shkruar në libër; kerametet nuk duhet të bëhen publike". Në përgjigje të kësaj kritike të pjesshme unë thashë në mbrojtjen time:

"Ato nuk janë të miat dhe në çdo mënyrë unë nuk do të guxoja t'i pretendoja keramete të tilla; përkundrazi ato janë distilimet dhe shkreptimat e mrekullisë së Kuranit të cilat duke marrë formën e kerameteve në Risale-i Nur, i cili është një koment i vërtetë i kuranit, janë një lloj i Nderimit Hyjnor (me qëllim që të forcojë moralin e studentëve të tij).

Të bësh publike një Nderim Hyjnor është një lloj falënderimi, është e lejueshme dhe e pranueshme. Tani, për një arsye të rëndësishme, unë do ta shpjegoj pak përgjigjjen time. Unë gjithashtu u pyeta përse unë i bëj ato publike dhe përse unë përqëndrohem kaq shumë mbi këtë pikë, dhe përse gjatë këtyre muajve të fundit unë kam shkuar edhe më tej në këtë çështje. Shumica e letrave lidhen me kerametet?

Përgjigjja: Megjithëse në këtë kohë në shërbimin e Risale-i Nurit për besimin fetar, qindra e mijëra riparues -reformatorë- janë të domosdoshëm përballë mijëra forcave shkatërruese; dhe megjithëse unë kam nevojë për qindra shkrues e ndihmës; dhe megjithëse njerëzit dhe autoritetet duhet të na ndihmojnë neve me vlerësim e kurajo, dhe të mbajnë lidhje me ne, në vend që të na shmangen duke mos pasë kontakt me ne; dhe megjithëse besimtarët janë të detyruar t'i japin preferencë shërbimit të besimit mbi prokopitë e jetës së kësaj bote dhe mbi përfitimet e saj, pasi ai -shërbimi i besimit- shikon tek jeta e amshuar; duke marrë veten time si një shembull, unë them këtë:

Për shkak se kundërshtarët tonë më pengojnë mua nga pasja kontakt me njerëzit, dhe nga pasja e ndihmësve, dhe nga çdo gjë; dhe ata -kundërshtarët- duke shkatërruar me sa mundën moralin e shokëve

të mi, dhe duke i bërë ata të më shohin ftohtë mua dhe Risale-i Nurin; dhe për shkak të qënies sime i rënduar me detyrat e një mijë njerëzve pavarësisht qënies sime i vjetër, i sëmurë, i dobët, i mjerë, i huaj dhe pa askënd; dhe për shkak të qënies sime i detyruar të shmang pasjen e kontakteve me njerëzit dhe për t'u përzier me ta për shkak të një lloji sëmundjeje fizike të shkaktuar nga qënia ime i izoluar dhe i shtypur; dhe për shkak se ata i trembnin njerëzit në mënyrë aq të efektshme dhe po shkatërrojnë moralin e tyre; -për shkak të gjitha këtyre dhe përballë të gjitha atyre pengesave, unë u bëra të shkruaja gjërat e atij lloji me qëllim që të mbledh forcat shpirtërore përreth Risale-i Nurit, dhe t'i përshkruaj Nderimet Hyjnore, të cilët janë mjet për të forcuar moralin e studentëve të Risale-i Nurit, dhe për të shfaqur se në vetvete Risale-i Nuri është aq i fuqishëm sa një ushtri (dhe nuk ka nevojë për të tjerët).

Sepse ta shesësh vetveten -Ruajna Zoti!- dhe ta bësh vetveten të pëlqyer, dhe të mburresh e të krekosesh do t'i shkaktonte dëm misterit të sinqeritetit, i cili është një parim i rëndësishëm i Risale-i Nurit. Ashtu si, në dashtë Zoti, Risale-i Nuri do ta mbrojë vetveten dhe do të demonstrojë vlerën e tij të vërtetë, po kështu ai në efekt do të na mbrojë edhe neve gjithashtu, dhe do të jetë mjeti për të na u falur të metat tona.

Duke u dërguar me mijëra përshëndetje të gjithë vëllezërve dhe motrave të mia, dhe veçanërisht të pafajshmive dhe pleqve të nderuar, duatë e të cilëve janë të pranueshme, dhe duke bërë dua për të gjithë, ne i përshëndesim ata për muajin e Ramazanit dhe kërkojmë që ata të bëjnë dua për ne.

Vëllai juaj i sëmurë
Said Nursi

* * *

Me Emrin e Tij qoftë Ai i lavdëruar!

Ky vëllai juaj i pafuqishëm e thotë këtë edhe për atë shok të vjetër i cili e kundërshtoi, edhe për të vëmendshmit, edhe për ju: Nëpërmjet shkëlqimit të Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm, Saidi i Ri i paraqet provat dhe të vërtetat e besimit në mënyrë aq logjike e korrekte, saqë ato nuk i detyrojnë vetëm dijetarët myslimanë por gjithashtu edhe filozofët europianë më kryeneçë që t'u nënshtrohen, dhe këtë ata e bëjnë. Sa për shenjat dhe aluzionet e kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm, nga niveli i kuptimeve të tij aluduese, duke tërhequr vëmendjen tek Risale-i Nuri, i cili është njëra nga

mrekullitë e tij në këtë kohë, kjo është një shenjë e mrekullisë së kuranit -të ngjashme me parashikimet aluduese e simbolike të Imam Aliut, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe Gauth El A'ëdhamit, Zoti qoftë i kënaqur me të, lidhur me rëndësinë dhe vlerën e Risale-i Nurit.

Të vepruarit kështu bëhet gjithashtu e domosdoshme nga elokuenca e mrekullueshme e asaj gjuhe të së padukshmes.

Por m'u shfaq mua në burgun e Eskishehirit në një kohë të tmerrshme kur ne kishim nevojën më të madhe për një ngushëllim të shenjtë: "Ti përmend evliatë e kohëve të hershme duke dëshmuar për pranueshmërinë e Risale-i Nurit, por në përputhje me kuptimin e brendshëm të vërsetit:

"Dhe nuk ka asgjë të njomë ose të thatë që të mos jetë shkruar në shkrim të qartë"[336] është kurani ai që duhet ta ketë fjalën në këtë çështje.

A e gjen ai të pranueshëm Risale-i Nurin?

Si e sheh ai atë?

Unë u përballa me këtë pyetje të çuditshme. Kështu unë kërkova ndihmë prej kuranit, dhe brenda hapësirës së një ore unë kuptova se Risale-i Nuri ishte njëri element i kuptimeve aluduese të tridhjetë e tre vërseteve, nga niveli i përbërë prej detajeve të kuptimeve të qarta (dhe të përfshira në përgjithësinë e kuptimeve aluduese), dhe se ndodheshin deduktime të fuqishme për përfshirjen e tij dhe për karakteristikën dalluese. Një pjesë të këtyre unë i pashë në mënyrë të detajuar dhe një pjesë e pashë në formë të përmbledhur. Në shikimin tim nuk ka mbetur asnjë dyshim, asnjë ngurrim dhe asnjë skepticizëm. Dhe unë e shkrova atë bindjen time të fortë me qëllimin për të forcuar besimin e besimtarëve nëpërmjet Risale-i Nurit, dhe ua dhashë atë vëllezërve të mi më të afërm me kusht që ajo të mbahej private, e fshehur. Në trajtesë ne nuk themi se ky është kuptimi i qartë i vërsetit, që të mos thonë hoxhallarët se 'ai është goditur nga syri i keq'. Dhe ne nuk themi se kjo është përgjithësimi i kuptimit aludues. Ne themi se nën kuptimin e qartë të vërsetit ndodhen disa shtresa ose nivele njëri prej të cilëve është kuptimi aludues e simbolik, dhe se kuptimi aludues është një përgjithësim. Në çdo shekull ky ka veçori. Dhe në këtë shekull Risale-i Nuri është një element në përgjithësimin e atij niveli të kuptimit aludues. Deduktimet e nxjerra nëpërmjet parimeve të shkencës së *xhefrit* dhe të numrave, të praktikuara qysh prej kohëve të hershme nga dijetarët -ulematë- madje provat, shfaqin se ai element mbahet qëllimisht në shikim dhe do të përmbushë një funksion të rëndësishëm,

---

[336] Kuran 6:59

dhe kjo nuk e dëmton vërsetin e kuranit dhe as kuptimin e tij të qartë; por i shërben mrekullisë së tij dhe elokuencës

Ai i cili nuk mund t'i mohojë deduktimet e panumërta të bëra nga njerëzit e realitetit prej aluzioneve kuranore, nuk duhet ta mohojë këtë, dhe askush nuk mund ta mohojë. Por, në qoftë se njeriu, i cili nga habia e vlerëson si të pagjasë që një vepër e tillë e rëndësishme të shfaqej në dorën e një personi të zakonshëm si unë, do ta mendonte krijimin e një pishe me madhësinë e një mali prej një fare me madhësinë e një kokre gruri duke qenë shenjë e Fuqisë Hyjnore dhe e madhështisë Hyjnore ai sigurisht do të detyrohej të thonte se shfaqja e kësaj vepre në një kohë të tillë të një nevoje shumë të madhe prej një personi krejtësisht të pafuqishëm e nevojtar si unë është dëshmi për shtrirjen e gjërë të Mëshirës Hyjnore.

Nëpërmjet nderit të Risale-i Nurit, unë ju siguroj ju dhe ata të cilët kundërshtojnë, se këto aluzione dhe parashikime simbolike dhe treguesit e Evlijave, gjithmonë më kanë shtyrë të bëj falënderime e lavdërime e të kërkoj falje për gjynahet e mia. Unë mund ta provoj për ju nëpërmjet pamjeve -vështrimeve- që ju keni patur nga jeta ime, mu para syve tuaj këto njëzet vite, se asnjëherë, madje as edhe për një minut, ato nuk e kanë mburrur egon time dhe nuk e kanë bërë nefsin tim urdhërues për të liga krenar dhe arrogant.

Megithatë, njeriu nuk është pa mangësi e pa harresë. Unë kam të meta të shumta për të cilat nuk jam i vetëdijshëm. Gjithashtu ndoshta idetë e mia janë kacavarë e kanë hyrë vjedhurazi, dhe ndodhen disa gabime në disa trajtesa. Mirëpo meqenëse ata nuk i kundërshtojnë parimet e rreme dhe të prishura të njerëzve të çudhëzimit, të maskuara nga montimi i përkthimeve të bëra nga njeriu në vend të shkronjave të shenjta të kuranit, me shkronjat e mangëta të shkrimit të ri (latin), dhe duke i dëmtuar kuptimet e qarta të vërseteve, ata sigurisht nuk duhet të kundërshtojnë dikë të mjerë e të persekutuar, i cili shpjegon një pikë të hollë të mrekullisë së Kuranit me qëllim që të forcojë besimin e vëllezërve të tij, deri në shkallën e shkurajimit të tij në shërbimin e tij ndaj besimit, pasi jo vetëm njerëzit e realitetit, por kushdo që do të kishte sa një thërmijë drejtësi e paanshmëri, nuk do të pajtohej me këtë.

Përveç kësaj, unë do të them këtë: Përballë sulmeve të tmerrshme të çudhëzimit në këtë kohë, rrugët e fuqishme e të vërteta, metodat dhe tarikatet prej miliona ndjekësish të përkushtuar, janë mposhtur në dukje.

Por një person gjysmanalfabet nën mbikëqyrjen e vazhdueshme duke jetuar përballë policisë, dhe kundërshtimi prej fushatash shumanshme të shpifjes me qëllim që ta bëjnë gjithkënd ta shajnë atë -

një person i tillë- nuk nuk mund të ketë pretendim për Risale-i Nurin, i cili është më i avancuar se sa ato rrugë të tjera dhe u ka rezistuar sulmeve në mënyrën më të fuqishme, dhe ajo vepër nuk mund të jetë produkt i aftësisë së tij, dhe ai nuk mund të krenohet me të. Përkundrazi, ajo është dhuruar direkt nga Mëshira Hyjnore si një mrekulli e kuranit të gjithurtë në këtë kohë. Ai i shtrin duart për tek ajo dhuratë e kuranit së bashku me mijëra nga shokët e tij. Sigurisht detyra e interpretuesit kryesor i ra atij, por dëshmia se ajo nuk është vepra e mendimit të tij, e njohjes dhe e zgjuarsisë është se në Risale-i Nur ndodhen pjesë të cilat u shkruan në gjashtë orë, të tjera që u shkruan në dy orë, të tjera që u shkruan në një orë, dhe disa madje për dhjetë minuta.

Unë betohem se madje edhe me fuqinë e memories së Saidit të Vjetër (Zoti qoftë i kënaqur me të),[337] me mendimin tim unë nuk do të mund ta shkruaja për dhjetë orë atë që shkruhej për dhjetë minuta. Me mendjen dhe me kapacitetin tim, unë nuk do të mund ta shkruaja për dy ditë trajtesën që shkruhej për një orë. Dhe as unë dhe as filozofi më i saktë fetar nuk do të mund t'i kërkonte e shqyrtonte çështjet e Fjalës së Tridhjetë dhe ta shkruante për gjashtë ditë, megjithëse ajo u shkrua për një ditë në gjashtë orë. Dhe kështu me radhë.

Domethënë, pavarësisht qënies sime i falimentuar, unë jam lajmëtari dhe shërbëtori i një dyqani të pasur me xhevahirë të mrekullueshëm.

Nga mëshira dhe nga bujaria e Tij, Zoti na bëftë neve dhe studentët e Risale-i Nurit të qëndrueshëm me pastërti e sinqeritet në këtë shërbim, dhe na dhëntë ne sukses. Amin!

Në përnderim të prijësit të profetëve.

Said Nursi

• • •

[337] Duke e synuar atë të jetë një lutje, disa nga shkruesit e shkruan frazën "Zoti qoftë i kënaqur me të" pas emrit të këtij Saidi të mjerë. Unë do doja ta ndryshoja atë, por m'u shfaq se meqenëse ajo është një lutje duke kërkuar kënaqësinë e Zotit, nuk duhet të ndërhyhet tek ajo, prandaj unë nuk e ndryshova.

Kapitulli i Dytë i Shkreptimës së Njëzet e Nëntë

(Rreth frazës: "***El Hamdu lil lah***!")

[kjo trajtesë e shkurtër, e quajtur Kapitulli i Dytë, shpjegon vetëm nëntë prej dritave të panumërta dhe avantazheve të besimit në Allah, e cila e bën njeriun të deklarojë duke thënë: "*El Hamdu lil Lah" lavdërimi i takon Allahut*".]

Bismil-lahir-Rahmanir Rahijm.

◘ Pika e Parë

Para së gjithash do të tregohen dy gjëra:

1. Filozofia është një palë syze të errëta e cila e shfaq çdo gjë të jetë e shëmtuar dhe e frikshme. Ndërsa besimi në Zotin është një palë e tejdukshme e qartë dhe e ndritshme syzesh, i cili e shfaq çdo gjë të jetë e bukur dhe e njohur.

2. Njeriu është i lidhur me të gjitha krijesat, ka një lloj tregtie me të gjitha gjërat, dhe nga natyra është i detyruar të takohet, të flasë dhe të jetë fqinjësor, i përzemërt, me gjërat që e bllokojnë atë; po ashtu ai posedon gjashtë aspekte: një të majtë, të djathtë, të sipërm, të poshtëm, ballor dhe aspektin e pasmë.

Duke i vënë secilën prej këtyre dy palë syzeve, njeriu mund të shohë krijesat dhe gjërat e pranishme në aspektet e përmendura lart.

Aspekti i djathtë: Ajo çfarë synohet nga ky aspekt është e shkuara. Kur ajo shihet nëpërmjet syzeve të filozofisë, ajo çfarë shikohet është një varrezë e madhe, e errët, e tmerrshme dhe e përmbysur, ku kijameti i tokës së të shkuarës ka ndodhur. Nuk ka dyshim se kjo pamje e hedh njeriun në një panik të madh, në frikë e dëshpërim.

Por, kur ky aspekt shikohet nëpërmjet syzeve të besimit, edhe në qoftë se shfaqet se toka është përmbysur, ashtu siç është, nuk ka pasë humbje në jetë; kuptohet se personeli i saj dhe banorët janë transferuar për tek një botë tjetër, një botë e mbushur me dritë. Varret dhe gropat shihen të jenë tunele të nëndheshëm të hapura që të shpiejnë për tek një botë tjetër e mbushur me dritë. Kjo do të thotë se, gëzimi, lehtësia, mirëbesimi dhe paqja e qetësia e mendjes, që besimi i jep njeriut, është

një mirësi Hyjnore që e bën njeriun ta përsërisë edhe mijëra herë më shumë frazën ***"El Hamdu lil Lah"***.

Aspekti i majtë: Kur e ardhmja shikohet nëpërmjet syzeve të filozofisë, ajo shfaqet në formën e një varri të madh, të zi e të tmerrshëm, i cili do të na kalbë ne e do të na bëjë pre e gjarprinjve dhe akrepave të cilët do të na eliminojnë. Por kur ajo -e ardhmja- shikohet nëpërmjet syzeve të besimit, ajo shihet në formën e një vakti ngrënieje që përfshin çdo lloj të ushqimeve më të shijshme dhe pijeve të cilat Zoti i Gjithëfuqishëm dhe Krijuesi i Gjithëmëshirshëm i ka përgatitur për njeriun. Kështu kjo e bën njeriun ta përsërisë me mijëra herë frazën: "***El Hamdu lil Lah".***

Aspekti i sipërm: Ky aspekt janë qiejt. Kur një person shikon tek ky aspekt nëpërmjet syzeve të filozofisë, ai ndjen një frikë të plotë tek shpejtësia dhe larmia e lëvizjeve si garat e kuajve ose monovrat ushtarake -të miliona yjeve dhe trupave qiellorë në hapësirë të pafundme. Ndërsa kur një besimtar i vështron ato, ai sheh se ashtu si ato manovra të çuditshme e të mrekullueshme po bëhen ta kryejnë atë funksion nën mbikëqyrjen e një komandanti dhe me komandën e tij, po ashtu yjet janë duke e zbukuruar botën e qiejeve dhe janë llamba dritëdhënëse për të.

Si rrjedhojë, ai nuk ndjen frikë e panik tek gara e atyre kuajve, por njohje, familjaritet e dashuri. Sigurisht është e pakët të thuash: ***"El Hamdu lil Lah"*** me mijëra herë për mirësinë e besimit, i cili e ndriçon kështu botën e qiejve.

Aspekti i poshtëm: Ky është toka. Kur njeriu e vështron këtë botë me syrin e filozofisë, ai e sheh atë si një kafshë të zgjidhur, të pakapister duke bredhur pa qëllim rreth diellit, ose si një anije e shpuar dhe e pakuptim, dhe ai mposhtet nga frika dhe ankthi.

Ndërsa kur ai vështron me besim, ai e sheh atë në formën e një anijeje të Mëshirëplotit të Vetëm duke çarë rrjedhën e saj rreth diellit nën komandën e Zotit të Gjithëfuqishëm, me të gjithë ushqimin e saj, pijen dhe veshjen në kuvertë, për kënaqësinë e njerëzimit. Kështu ai fillon të deklarojë me ndjenjë të madhe duke thënë: ***"El Hamdu lil Lah"*** për këtë mirësi që buron nga besimi.

Aspekti ballor: Në qoftë se një person i cili zhytet në filozofi e vështron këtë aspekt, ai sheh se të gjitha krijesat e gjalla, qofshin njerëz apo kafshë, janë duke u zhdukur grup pas grupi me shpejtësi të madhe drejt saj. Domethënë, ato janë duke shkuar në mosqënie dhe duke pushuar së ekzistuari. Meqenëse ai e di se edhe vetë gjithashtu është një udhëtar në atë rrugë, atij i del nga mendja me brengë.

Ndërsa për një besimtar duke vështruar me syrin e besimit, njerëzit që udhëtojnë për tek ai aspekt nuk janë duke kaluar për tek bota e

mosekzistencës, ata po transferohen nga një mallesë -kullotë- për tek një tjetër ashtu si nomadët, dhe duke u shpërngulur nga një botë e përkohshme për tek një tjetër e përjetshme, dhe nga një fermë e shërbimit dhe e punës për tek zyra e rrogave -pagave-, dhe nga një vend mundimi e vështirësie për tek një vend bollëku e rehatie.

Besimtari e takon këtë aspekt me kënaqësi e mirënjohje. Vështirësitë që ndodhen në rrugë si vdekja dhe si varri janë burime lumturie për arsye të rezultateve të tyre. Sepse rruga që të çon për tek botërat e ndritshme kalon nëpërmjet varrit, dhe lumturia më e madhe është rezultati i fatkeqësisë më të keqe e të dhimbshme. Për shembull, Jusufi a.s. e arriti lumturinë e të qenurit sundimtar i Egjiptit vetëm nëpërmjet qënies i hedhur në pus nga vëllezërit e tij dhe i flakur në burg nga shpifjet e Zelihasë.

Në të njëjtën mënyrë, një fëmijë që vjen në botë nga mitra e nënës së tij, vetëm e arrin lumturinë e kësaj bote si rezultat i vështirësive torturuese dhe shtypëse që ai përjeton në rrugë.

Aspekti i Pasmë: Domethënë, meqenëse ai i cili i vështron ata që kanë mbetur prapa me shikimin e filozofisë nuk mund mund të gjejë përgjigjje për pyetjen: "Prej nga kanë ardhur ata dhe ku do të shkojnë, dhe përse erdhën ato në tokën e kësaj bote?", ai natyrisht mbetet në torturimin e hutimit dhe të dyshimit.

Por në qoftë se do të vështronte nëpërmjet syzeve të besimit, ai do të kuptonte se njerëzit janë vëzhgues të dërguar nga Sulltani i Parapërjetësisë për të shqyrtuar e studiuar mrekullitë e mahnitshme të fuqisë të shfaqura në ekspozitën e universit, dhe se pasi të marrin shenjat dhe rangjet e tyre në përputhje me shkallën që ata kanë kapur vlerën dhe madhështinë e atyre mrekullive të fuqisë dhe me shkallën me të cilën mrekullitë tregojnë madhështinë e Sulltanit të papapërjetësisë, njerëzit do të rikthehen tek bota e Atij Sulltani. Kështu ai do të thonte: ***"El Hamdu lil Lah***" për mirësinë e besimit që ia ka dhënë atij këtë mirësi. Meqenëse lavdërimi i dhënë në thënien: ***"El Hamdu lil Lahi***" për mirësinë e besimit i cili i largon kështu shtresat e lartëpërmendura të errësirës, është gjithashtu një mirësi, lavdërimi duhet të jepet edhe për të gjithashtu. Dhe lavdërimi duhet të jepet në herën e tretë për këtë mirësinë e dytë të lavdërimit, dhe në herën e katërt për mirësinë e tretë të lavdërimit... Domethënë, një zinxhirë i pafundmë lavdërimi lindet nga një shqiptim i vetëm i frazës ***"El Hamdu lil Lah".***

◘ Pika e Dytë

Njeriu duhet të thotë: ***"El Hamdu lil Lah"*** për mirësinë e besimit i cili i ndriçon këto gjashtë aspekte, sepse ashtu si meqenëse ai largon errësirën e gjashtë aspekteve, ai mund të konsiderohet një mirësi e madhe për shmangien e së keqes, po ashtu meqenëse i ndriçon ato, ai mund të mendohet si një mirësi e dytë, për tërheqjen e dobive.

Prandaj, meqenëse njeriu nga natyra është i civilizuar, ai është i lidhur me të gjitha krijesat në gjashtë aspektet, dhe nëpërmjet mirësisë së besimit ka mundësinë e përfitimit prej gjashtë aspekteve.

Kështu sipas kuptimit të vërsetit,

"Kështu që ngado që të drejtoheni apo të ktheni fytyrat, atje është Fytyra e Allahut..."[338] njeriu gjen ndriçim në cilindo prej gjashtë aspekteve që gjendet.

Në fakt, ai që është një besimtar, ka një jetë e cila në efekt shihet nga themeli i botës deri tek fundi i saj. Kjo jetë e tij merr ndihmë nga drita e një jete e cila shtrihet nga parapërjetësia tek paspërjetësia. Në të njëjtën mënyrë, në sajë të besimit i cili i ndriçon gjashtë aspektet, koha e ngushtë e njeriut dhe hapësira transformohen në një botë të gjërë të rehatshme. Kjo botë e shtrirë bëhet si shtëpia e njeriut, dhe e shkuara dhe e ardhmja si koha e tashme për shpirtin dhe zemrën e tij. Largësia midis tyre zhduket.

◘ Pika e Tretë

Fakti se besimi jep burimet e mbështetjes dhe të ndihmës, bën të domosdoshme thënien: "***El Hamdu lil Lah***".

Po, për shkak të pafuqisë së tyre dhe të armiqve të tyre të pafundmë, njerëzimi janë në nevojë të një baze mbështetjeje të cilën ata mund ta përdorin për t'i zmbrapsur ata armiq. Gjithashtu, për shkak të shumësisë së nevojave të tyre, dhe varfërisë së tyre të skajshme, ata kanë nevojë për një burim ndihme prej të cilit mund të kërkojnë ndihmë, me qëllim që nëpërmjet tij të mund të përmbushin nevojat e tyre.

O njeri! Pika jote e vetme e mbështetjes është besimi në Zot. Baza e vetme e ndihmës për shpirtin dhe ndërgjegjen është besimi në Ahiretin. Ai që nuk i njeh këto dy burime vuan ankth e frikësim të vazhdueshëm në zemrën dhe në shpirtin e tij, dhe ndërgjegjja e tij torturohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ndërsa personi i cili kërkon mbështetje nga pika e parë dhe ndihmë nga e dyta, përjeton shumë kënaqësi e gëzime në zemrën dhe në

[338] Kuran, 2:115

shpirtin e tij, kështu ai edhe gjen ngushëllim, edhe ndërgjegjja e tij qetësohet.

◘ Pika e Katërt

Duke treguar se kënaqësi të ngjashme ekzistojnë dhe do të ekzistojnë, drita e besimit largon dhimbjen që ndodh kur kënaqësitë e ligjshme fillojnë të dobësohen e të zhduken. Për më tepër, duke treguar burimin e mirësive, ai siguron se mirësitë vazhdojnë dhe nuk pakësohen.

Gjithashtu, duke treguar kënaqësitë e njohjes -miqësisë- së ripërtërirë, kjo largon dhimbjen e ndarjes dhe të ikjes.

Domethënë, ndërsa dhimbje të shumta ndodhin nga mendimi i kalimit dhe i zhdukjes së një kënaqësie të vetme, besimi i largon ato duke të të kujtuar kthimin e kënaqësisë. Në qoftë se një frut nuk ka pemë, kënaqësia e tij është e kufizuar dhe mbaron me ngrënien e tij, dhe mbarimi i tij është shkak dëshpërimi.

Ndërsa në qoftë se njihet pema e frutit, nuk ka dhimbje kur fruti mbaron së ekzistuari, sepse ndodhen fruta të tjerë për të ardhur në vendin e tij.

Në të njëjtën kohë, përtëritja në vetvete është një kënaqësi. Sepse dhimbjet që e dëshpërojnë më shumë shpirtin njerëzor janë dhimbjet që burojnë nga ndarja. Kurse drita e besimit i largon ato dhimbje nëpërmjet shpresës së takimit të përtërirë dhe të kthimit të takimeve të ngjashme.

◘ Pika e Pestë

Gjërat midis këtyre qënieve të cilat njeriu i imagjinon se janë armiqësore, të huaja, të pajeta dhe të humbura sikur jetimët ose të vdekurit, drita e besimit ia shfaq atij si miqësore, si vëllezër, si të gjalla dhe si duke lavdëruar Zotin xh.sh.. Domethënë një njeri i cili shikon me syrin e pakujdesisë i supozon qëniet në botë të jenë të dëmshme si armiq, dhe e merr frika; ai i sheh gjërat si të huaja. Sepse në shikimin e çudhëzimit, nuk ka lidhje vëllazërie midis të shkuarës dhe atyre të së ardhmes. Ndodhet vetëm një lidhje e parëndësishme dhe e pjesshme midis tyre. Dhe si rrjedhojë, vëllazëria e njerëzve të çudhëzimit është vetëm një minut brenda një mijë viteve. Në shikimin e besimit, të gjithë trupat qiellorë shfaqen si të gjallë dhe si të njohur me njëri-tjetrin. Besimi e shfaq secilin prej tyre se është duke e lavdëruar Zotin xh.sh. nëpërmjet gjuhës së gjendjes së saj. Nga ky këndvështrim të gjithë posedojnë një lloj jete dhe një shpirt në përputhje me secilin.

Prandaj nuk ka frikë e panik kur trupat qiellorë shikohen me këtë vështrim të besimit; ka njohje, familiaritet e dashuri. Vështrimi i mosbesimit i sheh qëniet humane të pafuqishme ashtu siç janë për të siguruar dëshirat e tyre, si pa pronar dhe pa mbrojtës; ai i imagjinon ato të jenë të pikëlluara e të dëshpëruara si jetimët vajtues për shkak të pafuqisë së tyre.

Shikimi i besimit, nga ana tjetër, i sheh ato si krijesa të gjalla, jo si jetimë por si nëpunës të ngarkuar me detyra; si shërbëtorë duke lavdëruar e lartësuar Allahun.

◘ Pika e Gjashtë

Drita e besimit i paraqet këtë dynja dhe Ahiretin si dy tryeza duke shfaqur varietete të shumta mirësish prej të cilave një besimtar përfiton nëpërmjet dorës së besimit, nëpërmjet shqiseve të tij të brendshme e të jashtme dhe nëpërmjet aftësive të tij të holla shpirtërore. Në këndvështrimin e çudhëzimit, sfera prej të cilës një qënie e gjallë mund të përfitojë zvogëlohet e kufizohet tek kënaqësitë materiale. Ndërsa në shikimin e besimit, ajo shtrihet deri në një sferë e cila i rrethon qiejt dhe tokën. Po, një besimtar e konsideron diellin të jetë një llambë e varur në tavanin e shtëpisë së tij, dhe hënën të jetë një dritë nate. Kështu ato bëhen mirësi për të, dhe sfera prej të cilës ai përfiton është më e gjërë se sa qiejt. Me vërsetet elokuente,

"Dhe Ai e ka bërë të nënshtruar për ju diellin dhe hënën",[339] dhe

"Ai është i Cili ju bën të mundur juve të udhëtoni nëpër tokë e det",[340] kurani i shpjegimit të mrekullueshëm aludon për këtë mirësi të mrekullueshme dhe për bekimet që burojnë nga besimi.

◘ Pika e Shtatë

Është e njohur nëpërmjet besimit se ekzistenca e Zotit është një mirësi që i tejkalon të gjitha mirësitë e tjera, është një mirësi e madhe e cila është një bazë dhe burim duke përfshirë shumëllojshmëri të pafundme mirësish, lloje të panumërta bekimesh dhe varietete të pallogaritshme dhuratash. Atëherë, si rrjedhojë, është detyrë dhe borxh për njeriun që të japë lavdërime e falënderime për mirësitë e besimit sa numri i grimcave në botë. Një numër i këtyre janë treguar në pjesë të ndryshme të Risale-i Nurit; duke diskutuar besimin në Allahun, ato e heqin perden prej këtyre mirësive dhe i shfaqin.

---

[339] Kuran, 14:33
[340] Kuran, 10:22

Njëra nga mirësitë që duhet të jepet lavdërimi me gjithë lavdërimin që fraza ***"El Hamdu lil Lah"*** e tregon me *lamin*[341] e përcaktimit, është mirësia e Mëshirës Hyjnore.

Madje, mëshira përmban mirësi sa numri i qënieve të gjalla të cilat e manifestojnë Mëshirën Hyjnore. Sepse njeriu veçanërisht është i lidhur me të gjitha krijesat e gjalla, dhe në këtë drejtim, gëzohet nga lumturia e tyre dhe dëshpërohet nga dhimbja e tyre. Kështu një mirësi që gjendet tek një individ i vetëm, është gjithashtu një mirësi për shokët e tij. Një tjetër që përmban mirësi sa numri i fëmijëve që janë të bekuar me dhembshurinë dhe butësinë e nënave të tyre, dhe e cila meriton lavdërim e lartësim është Dhembshuria Hyjnore. Po, një person me ndërgjegjje i cili ndien hidhërim e keqardhje nga vajtimi i një fëmije të panënë dhe të uritur, sigurisht ai do të ndjehej i kënaqur nga dhembshuria e nënës për fëmijën e saj; padyshim që ai është i kënaqur dhe i lumtur. Kështu, kënaqësitë e këtij lloji, secila janë një mirësi dhe kërkojnë dhënie lavdërimesh e falënderimesh.

Një tjetër prej mirësive duke kërkuar lavdërime e falënderime sa numri i të gjitha varieteteve dhe shembujve të urtësisë të përfshira në univers është Urtësia Hyjnore. Sepse ashtu si nefsi i njeriut që është pajisur me manifestimin e Mëshirës Hyjnore, dhe zemra e tij me manifestimin e Dhembshurisë Hyjnore, po ashtu, mendja e tij merr kënaqësi nga hollësitë e Urtësisë Hyjnore. Kështu, në këtë drejtim ato kërkojnë lavdërime e lartësime të pafundme nëpërmjet deklarimit ***"El hamdu lil Lah"***.

Një tjetër është mirësia e ruajtjes, për të cilën duhet të jepet lavdërimi sa numri i manifestimeve të Emrit Hyjnor ***El-Va'rithu***, *Trashëguesi –Ai që bën të trashëgohet;* dhe sa numri i pasardhësve të cilët vazhdojnë pas kalimit të paraardhësve të tyre, dhe sa numri i qënieve të botës tjetër, dhe sa numri i akteve të njeriut të cilat ruhen me qëllim që të jenë mjet që ata të marrin shpërblimin e tyre në Ahiret; lavdërimi duhet të jepet me madhështi të ***"El Hamdu lil Lah***" sa të mbushë të gjithë hapësirën me tingullin e saj. Sepse vazhdimi i mirësisë është më e vlefshme se sa vetë mirësia. Përjetësimi i mirësisë është më e kënaqshme se sa vetë mirësia. Të banosh përjetësisht në parajsë është më e lartë se sa vetë parajsa; dhe kështu me radhë. Si rrjedhojë, mirësitë që i përmban Atributi Hyjnor ***El-Hafidhu***, *Gjithëruajtësi* janë shumë të mëdhaja dhe më të larta se sa të gjitha mirësitë ekzistuese në të gjithë universin.

Kështu, ky Atribut kërkon një ***"El Hamdu lil Lah***" aq të madhe sa bota.

---

[341] Lami i përcaktimit; domethënë ***'Li'*** tek "El Hamdu ***li***l lah"

Ju mund t'i krahasoni pjesën tjetër të Emrave Hyjnorë me katër Emrat e përmendur këtu, dhe meqenëse në secilën ndodhen mirësi të pafundme, secili kërkon lavdërime e falënderime të pafundme.

Gjithashtu, Profeti Muhammed a.s.m. i cili është mjeti për arritjen e mirësisë së besimit dhe ka autoritetin për t'i hapur të gjitha thesaret e mirësisë, është gjithashtu një mirësi e tillë saqë njerëzimi i mbetet borxh për të gjithë përjetësinë që ta lavdërojë dhe ta brohorasë atë.

Gjithashtu, mirësitë e islamit dhe të kur'anit të cilat janë indeksi dhe burimi i të gjitha varieteteve të mirësisë, materiale dhe shpirtërore, kërkojnë e meritojnë lavdërime të pambarim e të pafund.

◘ Pika e Tetë

El Hamdu lil Lah, Lavdi Zotit, i Cili sipas kuranit të kalibrit më të lartë, i cili është shpjeguesi i tij, ky libër madhështor i njohur si universi, e lavdëron dhe e lartëson me të gjithë kapitujt dhe pjesët e tij, me të gjitha faqet dhe rreshtat, dhe me të gjitha fjalët dhe shkronjat Esencën më të pastër e më të shenjtë të të Vetmit Unik, të Cilin universi e lavdëron dhe e lartëson nëpërmjet bërjes të dukshme atributet e Tij të bukurisë dhe të plotësisë. Kjo është sa vijon: Në përputhje me kapacitetin e saj, qoftë e madhe apo e vogël, çdo skalitje në këtë libër të madh lavdëron dhe lartëson Skalitësin e saj, i Cili është Një i Vetëm dhe i Kërkuar Përjetësisht, nëpërmjet shfaqjes së Atributeve të Tij të lavdishme.

Gjithashtu, çdo skalitje në librin e universit jep lavdërime nëpërmjet shfaqjes së atributeve të bukurisë së Shkruesit të saj, i Cili është i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë.

Gjithashtu, nëpërmjet reflektimit dhe pasqyrimit të manifestimeve të Emrave të bukur Hyjnorë, të gjitha skalitjet, pikëlat dhe qëndisjet në këtë libër shprehin lavdërime për të Vetmin Unik më të pastër e më të shenjtë duke e lavdëruar Atë, dhe duke e lartësuar e lëvduar.

Gjithashtu, secila poemë në këtë libër të universit e lartëson dhe e lavdëron Hartuesin e saj, i Cili është i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëditur.

◘ Pika e Nëntë

.....[342]

---

[342] Unë nuk e kam çelësin për këto shifra që të mund t'i deshifroj. Për më tepër, as edhe koka e atij që është duke agjëruar nuk mund t'i deshifrojë ato, dhe as t'i zbulojë kuptimet e tyre. Më falni, unë munda të bëj vetëm kaq, dhe atë nëpërmjet ndihmës morale të autorit, shkëlqimit shpirtëror të Natës së Kadrit dhe duke qenë në afërsi të Meulana Xhelalud-din.

Përkthyesi, Abdul Mexhid Nursi

L U T Ë S I

[343]Varri im i rrënuar në të cilin janë grumbulluar stivë shtatëdhjetë e nëntë kufoma [344] të Saidit me gjynahet e tij dhe me brengat.

E tetëdhjeta u bë një gurë varri tek varri im.

Ato gjithë së bashku vajtojnë [345] për rënien e Islamit.

Së bashku me gurin e varrit tim dhe me varrin e përjetshëm të kufomave të vdekura, unë shkoj përpara për tek fusha e së ardhmes së të nesërmes.

Unë jam i sigurt se e ardhmja e Azisë, me tokën e saj dhe me qiellin e saj, së bashku do t'i dorëzohen dorës së pastër e të ndritshme të Islamit, sepse ajo premton lulëzimin e besimit; dhe i jep paqe e siguri njerëzimit.

---

[343] Ky rresht është nënshkrimi i Tij.

[344] Meqenëse trupi ripërtërihet dy herë në çdo vit, kjo do të thotë se (në çdo vit) dy Saida kanë vdekur. Gjithashtu në këtë vit Saidi është në vitin e Tij të shtatëdhjetë e nëntë. Domethënë, një Said ka vdekur në çdo vit. Nga kjo nënkuptohet se Saidi do të jetojë deri në këtë datë.

[345] Me një parandjenjë të së ardhmes, Ai e parashikoi këtë gjendje njëzet vjet para se ajo të ndodhë.

Bismil-lahi RrahmaniR-Rahim

O Allah! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë! O i Vetëm Unik! O i Gjallë i Përjetshëm! O Vetekzistues i Përhershëm! O i Ditur! O i Drejtë! O i Shenjtë!

Për hir të Emrit Tënd më të madh, dhe në përnderim të Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm dhe në nderim të profetit Tënd më të madh a.s.m. dhuroju lumturi të përjetshme në Parajsë botuesve të këtij libri, koleksionit të Rrezeve të Bediuzzaman Said Nursit, dhe të gjithë atyre që i ndihmojnë ata. Amin! Jepu atyre sukses të pafundmë në shërbim të besimit dhe të Kuranit. Amin! Për çdo fjalë të Rrezeve shkruaju një mijë merita në regjistrat e veprave të tyre të mira. Amin! Dhe dhuroju atyre qëndrueshmëri, vazhdimësi dhe sinqeritet në botimin e Risale-i Nurit. Amin! O më Mëshiruesi i mëshiruesve! Jepu lumturi në këtë botë dhe në botën tjetër të gjithë studentëve të Risale-i Nurit. Amin! Ruaji ata prej të keqes së shejtanëve të xhindëve dhe të njerëzve. Amin! Dhe fali të metat e këtij të pafuqishmi të mjerë Saidit... Amin!

Në emrin e të gjithë studentëve të Risale-i Nurit
Said Nursi

Përmbajtja

RREZJA E DYTË

Kjo formon 'Pikën' e shtatë rreth gjashtë Emrave më të mëdhenj dhe është rreth Emrit më të madh të Allahut, të Vetmit. Kjo përmban tre 'Stacione' dhe një përfundim.....

Stacioni i Parë: Tre 'fruta' për vërtetimin e Unitetit Hyjnor.....

Fruti i parë: Në Unitetin Hyjnor dhe në Vërtetimin e Tij, Bukuria Hyjnore dhe Plotësia Hyjnore bëhen të dukshme....

Fruti i dytë: Plotësitë e universit realizohen nëpërmjet Unitetit Hyjnor dhe kuptohen detyrat e lartësuara të qënieve...

Fruti i tretë: Të gjitha plotësimet e njeriut dhe qëllimet e tij të larta lidhen me Unitetin Hyjnor...

Stacioni i Dytë: Tre çështje që bëjnë të domosdoshme Unitetin Hyjnor...

E para**:** Atributet e pakufishme dhe absolute dhe Emrat, veprat e të cilëve duhet të vëzhgohen në univers....

E dyta: Lehtësia në Unitet dhe vështirësitë dhe pamundësitë në shirk...

E treta: Ai që krijon një qënie të vetme duhet të jetë pikërisht Ai që krijon të gjithë universin.....

Stacioni i Tretë: Tre Shenja universale për afirmimin e Unitetit Hyjnor....

Shenja e parë dhe prova**:** 'Ai është Një': Në çdo gjë është një Unitet dhe Uniteti tregon Një të Vetëm....

Shenja e dytë**:** 'Ai nuk ka shokë': Në çdo gjë ka një rregull të patëmetë dhe një balancë dhe këto mund të ndodhin vetëm se nëpërmjet unitetit, sepse ndërhyrja shkakton konfuzion... Çfarë thua ti për shëmtinë, provat dhe për vdekjen që gjenden midis bukurisë dhe të të mirës? Përse i Gjithëmëshirshmi Absolut e jep të keqen?

Shenja e tretë: Vulat e panumërta të Unitetit Hyjnor të aluduara nga fraza *"i gjithë sundimi i takon Atij dhe i gjithë falënderimi i përket Atij*".....

Përfundim.....

Një pyetje që lidhet me ringjalljen e të vdekurve....

Një lutje rreth Unitetit Hyjnor.....

RREZJA E TRETË

Një lutje e cila shpjegon vërsetin: *"Në krijimin e qiejve e të tokës (*deri në fund të vërsetit)".....

RREZJA E KATËRT

Një pikë e hollë rreth vërsetit: *"Dhe Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve"*.

Shkallët.....

Shkalla e parë: Kënaqësia e vërtetë e pavdekshmërisë qëndron në pavdekshmërinë e të Qëndrueshmit të plotësisë, në afirmimin e Tij dhe në besimin tek Ai...

Shkalla e dytë: Nëpërmjet lidhjes që rezulton nga besimi, me pafuqinë e tij dhe me varfërinë, njeriu mund të mbështetet mbi një fuqi të pafundme dhe tek forca e Furnizuesit Gjithëbujar....

Shkalla e tretë: Dispozitat e fuqisë kreative dhe rëndësia e njeriut pavarësisht vogëlsisë së tij të jashtme...

Shkalla e katërt: Lidhjet dhe ekzistencat që i fiton besimi për njeriun ...

Shkalla e pestë: Jeta nga këndvështrimi i të Gjallit të Përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm, në katër çështje....

Çështja e parë: Esenca dhe realiteti i jetës....

Çështja e dytë: Të drejtat e vërteta të jetës...

Çështja e tretë: Detyrat e bashkëlindura të jetës në tre mënyra (rrugë)....

Çështja e katërt: Kënaqësia e vërtetë dhe lumturia e jetës....

Shkalla e gjashtë: Tre prova se të gjithë shembujt e bukurisë të shfaqura prej këtyre qënieve kalimtare janë shenjat, shkreptimat dhe manifestimet e një bukurie të përjetshme, të shenjtë...

Prova e parë: Bukuria e objektit të punuar me mjeshtëri të hollë artistike tregon bukurinë e Mjeshtrit....

Prova e dytë: Përmban pesë pika...

Pika e parë: Bukuritë në qëniet janë hijet e një Bukurie të shenjtë të fshehur...

Pika e dytë: Qëniet e njëpasnjëshme kalimtare shfaqin një bukuri të pandryshueshme...

Pika e tretë: Dhënia i bukurisë është nga i Bukuri...

Pika e katërt: Secili nga Emrat e bukur Hyjnorë zotëron një bukuri të shenjtë, një manifestim i të cilës e bën të bukur botën e gjërë...

Pika e pestë: Universi u bë një ekspozitë çudirash me qëllim që të shfaqë bukuritë e Autorit të tij...

Prova e tretë përbëhet nga tre pika...

Pika e parë: Krijesat janë stolisur me qëllim dhe janë bërë të bukura me qëllim që të bëjnë të njohur Krijuesin e tyre dhe ta bëjnë Atë të Dashur...

Pika e dytë: Dashuria e vërtetë e njerëzimit për Zotin tregon për një Bukuri të Pashoqe...

Pika e tretë: Ekzistenca është e mirë e pastër, dhe mosekzistenca është thjesht e keqe e pastër...

Kapitulli i pestë (i shkreptimës së Njëzet e Nëntë): Pesë pika rreth shkallëve të "*Dhe Allahu vetëm na mjafton neve"*... origjinali është në arabisht.

RREZJA E PESTË

Rreth shenjave të kohës së fundit...

Parathënia përbëhet nga pesë 'pika'....

Stacioni i dytë përbëhet nga njëzet 'çështje'.....

Tre 'çështje' të shkurtëra duke plotësuar atë që u përmend lart...

RREZJA E GJASHTË

Përgjigjje për dy pyetje rreth formulës së recituar në pjesën e *teshehhudit* të namazeve rituale..

Pyetja e parë: Cila është arsyeja për frazat e bekuara të *teshehhudit* duke u recituar gjatë namazeve?....

Pyetja e dytë: Rreth krahasimit të teshehhudit rreth Muhammedit a.s.m. me Ibrahimin a.s..

Përgjigjja përmban tre 'aspekte'...

RREZJA E SHTATË

Shenja më e madhe .....

Një paralajmërim i rëndësishëm dhe një pohim i qëllimit....

Parathënie: Dy humnera që trondisin sigurinë e besimit në këtë shekull, dhe mjetet e shpëtimit prej tyre...

Kapitulli i parë: lidhur me provat e ekzistencës së Hyjnisë...

Dëshmia e qiejve dhe e çdo gjëje që ato përmbajnë....

Dashmia e atmosferës...

Dëshmia e tokës dhe e faqeve të saj...

Dëshmia e deteve dhe e lumenjve...

Dëshmia e maleve dhe e fushave...

Dëshmia e pemëve dhe e bimëve, duke përfshirë tre të vërteta....

Dëshmia e botëve të kafshëve dhe të zogjve, duke përfshirë tre të vërteta gjithëpërfshirëse....

Dëshmia e botës së humanizmit; profetët dhe unanimiteti i tyre...

Dëshmia e udhëheqësve shpirtërorë dhe pajtueshmëria e tyre....

Dëshmia e melekëve dhe e qënieve shpirtërore dhe pajtueshmëria e tyre...
Dëshmia e mendjeve të drejta dhe e zemrave të shëndosha...
Dëshmia e shpalljes Hyjnore e cila shpall pesë të vërteta....
Dy ndryshimet midis shpalljes dhe inspirimit
Dëshmia e natyrës së inspirimit në katër 'drita'...
Dëshmia e Muhammed arabiut a.s.m...
Nëntë dëshmi për vërtetësinë e profetësisë së Tij...
Tre format e konsensusit të sigurt duke e konfirmuar atë...
Dëshmia e kuranit, dhe gjashtë 'pika' duke treguar madhështinë e tij...
Dëshmia e kozmosit, nëpërmjet dy të vërtetave të mëdhaja...
E vërteta e parë**:** 'Krijueshmëria' dhe 'mundësia'...
E vërteta e dytë: bashkëpunimi universal....
Dëshmia e stacionit të adresimit direkt tek Zoti, në praninë e Tij, në dy të vërteta...
E vërteta e parë: Aktiviteti i vazhdueshëm i urtë dhe madhështor në univers...
E vërteta e dytë: Ligjërimi Hyjnor...
Kapitulli i dytë: Lidhur me provat e Unitetit Hyjnor....
Vendqëndrimi i parë, katër të vërtetat e shenjta duke dominuar në kozmos...
Fruti i parë: Hyjnia Absolute...
Fruti i dytë: Perëndia Absolute...
E vërteta e tretë: Plotësitë....
E vërteta e katërt: Sovraniteti...
Vendqëndrimi i akteve të Krijuesit, bota e krijimit dhe zanafilla, pesë të vërteta gjithëpërfshirëse...
E vërteta e parë: Ajo e madhështisë dhe e lartësisë....
E vërteta e dytë: Absolutësia e akteve Hyjnore....
E vërteta e tretë: Lehtësia, shpejtësia dhe rregulli i krijimit...
E vërteta e katërt: Pikat e Unitetit dhe konvergjenca në qëniet...
E vërteta e pestë: Sistemi i përkryer dhe rregullsia e kozmosit...
Vendqëndrimi i tretë, i ndriçuar prej katër të vërtetave...
E vërteta e parë: E vërteta e hapjes....
E vërteta e dytë: E vërteta e mëshirës...
E vërteta e tretë: E vërteta e rregullimit dhe e administrimit...
E vërteta e katërt: E vërteta e dhembshurisë dhe e furnizimit me ushqim....
Rreth qëllimit të Risale-i Nurit...

RREZJA E NËNTË

Pjesa e parë e shtojcës së Fjalës së Dhjetë, Ringjallja dhe bota tjetër...

Parathënie, që përbëhet nga dy 'pika'...

Pika e parë: Katër prova duke demonstruar se besimi në Ahiretin është themelor për jetën e shoqërisë dhe për jetën personale të njeriut...

Pika e dytë: Dëshmia për të vërtetën e Ringjalljes prej shtyllave të tjera të besimit....

RREZJA E NJËMBËDHJETË

Frutat e Besimit....

Çështja e parë: Një orë për Zotin...

Një përmbledhje e çështjes së dytë: Si mund të shpëtojmë prej litarëve të vdekjes...

Çështja e tretë: Një ngjarje instruktive...

Çështja e katërt: Çështja më shtypëse...

Çështja e pestë: Rinia do të ikë....

Çështja e gjashtë: Të gjitha shkencat flasin për Zotin dhe bëjnë të njohur Krijuesin...

Çështja e shtatë: "Na mëso ne gjithashtu rreth Ahiretit" duke përfshirë përgjigjjet e Emrave Hyjnorë, të Engjëjve, të profetit Muhammed a.s.m. dhe të Kuranit...

Një përmbledhje e çështjes së tetë: Një numër dobish prej besimit në Ahiretin i cili shikon tek jeta sociale dhe personale e njeriut...

Provat e ringjalljes trupore...

Dy 'pika' rreth Ferrit...

Rreth frazës: Allahu Ekber

Çështja e nëntë: Shtyllat dhe të vërtetat e islamit janë një tërësi e pandashme, në tre 'pika'...

Çështja e dhjetë: Një lule e Emirdagut. Një përgjigje tej mase e fuqishme ndaj kundërshtimeve të ngritura rreth përsëritjes në kuran....

Përfundimi, përbëhet nga dy shtojca...

Çështja e njëmbëdhjetë: Frutat e shijuar në këtë botë prej besimit në melekët...

Përfundim...

Një shtojcë për shtesën e çështjes së njëmbëdhjetë...

RREZJA E DYMBËDHJETË

Pjesë prej fjalëve mbrojtëse të Bediuzzamanit të dhëna në gjykatën e Denizlit.

RREZJA E TREMBËDHJETË

Letrat dritëlëshuese të cilat Bediuzzaman Said Nursi ua dërgoi studentëve të tij ndërsa ishte në burgun e Denizlit, të cilat ilustrojnë në mënyrë brilante xhihadin e madh të Risale-i Nurit...

RREZJA E KATËRMBËDHJETË

Përmban pjesë nga mbrojtjet e Bediuzzamanit gjatë gjyqit të tij në burgun e Afjonit, letrat që ai i shkroi për studentët e tij të burgosur, dhe pjesë prej fjalëve mbrojtëse të studentëve të tij...

Fjala mbrojtëse e Bediuzzamanit dhe peticionet që ai i dërgoi tek gjykata e Apelit dhe tek qeveria në Ankara....

Letra e Gjashtëmbëdhjetë: E përfshirë nga Bediuzzamani në katërmbëdhjetë Rreze për shkak të lidhjes së saj me mbrojtjen e tij...

Letrat e shkruara nga Bediuzzamani për studentët e tij ndërsa ishin në burgun e Afjonit me qëllim që t'i ngushëllonte, t'i ndriçonte dhe t'i udhëzonte...

Pjesë prej fjalës mbrojtëse të dhëna prej disa studentëve të Risale-i Nurit gjatë proceseve të tyre gjyqësore në gjykatën e Afjonit.

RREZJA E PESËMBËDHJETË

Stacioni i parë: Përbëhet nga tre 'pjesë'...

***Pjesa e parë*:** Një përmbledhje konçize e njëzet letrave të cilat në njëmbëdhjetë fraza rreth Unitetit Hyjnor japin njëmbëdhjetë prova prej të vërtetave të besimit...

Pjesa e dytë: Një përmbledhje e shkurtër e sures *El Fatiha*. Aluzionet për të vërtetat e besimit dhe provat e tyre prej thesarit të kësaj sureje, në nëntë fraza...

***Pjesa e tretë*:** Një shpjegim brilant me provat e pjesës së dytë të pohimit të besimit "*Muhammedi është i dërguari i Allahut",* në tre 'tregues'...

Stacioni i Dytë...

Tre prej botërave që i vizitoi udhëtari nëpër univers, të cilat ilustrojnë krahasimin e njerëzve të besimit dhe të çudhëzimit, në tre 'shembuj'...

Duke kërkuar njohjen e Krijuesit të universit nëpërmjet tre prej 'shtatë' Atributeve të Tij, njohja, dëshira dhe fuqia...

Atributi i '*Njohjes'* siç tregohet nga fjalët e *teshehhudit* në pesë namazet e detyruara, së bashku me njëmbëdhjetë 'dëshmi'....

Atributi i '*Dëshirës'*; një provë universale e kësaj...

Atributi i '*Fuqisë'*; prova krejtësisht bindëse dhe të parefuzueshme në nëntë 'shkallë'.

Parathënia e predikimit të Damaskut...

Kapitulli i Dytë i Shkreptimës së Njëzet e Nëntë, mbi frazën "***El Hamdu lil lah"...***

Përmbajtja...